ILIRËT DHE ILIRIA
TE AUTORËT ANTIKË

BOTIMET TOENA

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ARKEOLOGJISË

ILIRËT DHE ILIRIA

TE AUTORËT ANTIKË

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2002

Përgatitur nga:

SELIM ISLAMI (Redaktor përgjegjës)
FRANO PRENDI, HASAN CEKA, SKËNDER ANAMALI

Botimi i parë:
Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë v. I
ILIRËT DHE ILIRIA te autorët antikë. Tiranë 1965.

Botimi i dytë:
ILIRËT DHE ILIRIA te autorë antikë. Prishtinë 1979.

Botimi i tretë:
U financua nga Fondacioni "PRO YLLIRIA" (Zvicër)
dhe Misioni arkeologjik italian në FOINIKE.

Botues: Fatmir Toçi
Përkujdesja grafike: Majlinda Cami
Kopertina: Irena Toçi
ISBN 99927 - 1 - 639 - 8
© Instituti i Arkeologjisë

BOTIMET TOENA
Rr. "Muhamet Gjollesha", K.Postare 1420, Tiranë
Tel.: (355) (4) 240116; 240117
Tel./Fax: (355) (4) 240117
E-mail: toena@icc.al.eu.org
Http://www.toena.com.al

HYRJE

Vëllimi me burimet e autorëve antikë grekë e latinë si dhe bizantinë të hershëm që u paraqitet lexuesve, është i pari në serinë e vëllimeve me burimet e Historisë së Shqipërisë, përgatitur nga Instituti i Historisë e Gjuhësisë.(Sot Instituti i Arkeologjisë)

Në këtë vëllim janë dhënë burimet për historinë e lashtë të Shqipërisë, për ilirët dhe Ilirinë. Kronologjikisht ato përfshijnë një periudhë të gjatë që fillon me Homerin dhe mbaron me shek. VII të e.sonë. Meqenëse ndonjë burim antik me rëndësi nuk na është ruajtur, veçse në dorë të dytë e të tretë, nëpërmjet autorësh më të vonë, u pa e nevojshme që përsa i përket zgjedhjes së autorëve të mos i përmbaheshim rigorozisht këtij rregulli dhe përmblodhëm në listën e burimeve tona edhe veprën e Zonarës, për arsye se në të ka të dhëna me rëndësi që nuk i gjejmë tek autorët e tjerë.

Kolektivi që punoi për përgatitjen e këtij vëllimi është përpjekur të grumbullojë këtu pjesën dërmuese të burimeve letrare ekzistuese për këtë periudhë më se njëmijë e pesëqind vjeçare të historisë së Ilirisë. Nga veprat e autorëve të shfrytëzuar janë lënë pa u marrë vetëm disa pjesë të vogla të cilat ose përsërisin të dhënat që i gjejmë ndër autorët më të vjetër, ose nuk sjellin ndonjë gjë të re për historinë e Ilirisë. Nuk janë përfshirë në këtë vëllim vetëm ato pak autorë të cilët për fat të keq nuk gjenden në bibliotekat tona, por që megjithatë nuk japin ndonjë gjë të madhe.

Përsa i përket tematikës së trajtuar në këto burime, ajo është e shumanëshme. Përveç çështjeve me karakter thjesht historiko-politik, të cilat zënë vendin e parë, në to trajtohen edhe të tilla me karakter gjeografik, etnografik, ekonomik, organizativo-politik, juridik, fetar, etj., por këto të fundit paraqiten shumë më të zbehta.

Lajmet e para mbi fiset Ilire dhe vendin e tyre i gjejmë që në monumentet më të hershme të letërsisë helene, që në poemat e Homerit e të Hesiodit. Por interesi i shkrimtarëve grekë për trevat e Ilirisë dhe ilirët u shtua sidomos në shek. VI-V para e.sonë, kur në brigjet lindore të Adriatikut u themeluan kolonitë e para helene si Dyrrahu, Apollonia, Buthroti, etj. Lidhjet e ngushta që mbanin këto qytete me metropolet, si edhe ardhjet e shpeshta të udhëtarëve e tregtarëve grekë për t'u njohur e tregtuar me vendet e pasura me minerale si edhe me prodhime blegtorale e bujqësore të Ilirisë, bënë që në këtë kohë bota greke të merrte njohuri më të plota e të sakta për ilirët e Ilirinë. Në veprat e gjeografëve dhe historianëve të mirënjohur grekë të shek. VI-V para e.sonë si Hekateu, Herodoti dhe në mënyrë të veçantë Thukididi, ne gjejmë të dhëna, megjithëse nganjëherë të shkurtëra e të shpërndara, shumë të rëndësishme me karakter historiko-gjeografik, etnografik dhe ekonomik për Ilirinë në periudhën e formimit të shoqërisë së hershme me klasa dhe të lindjes së formacioneve të para shtetërore, shtete këto që luajtën një rol jo të vogël në ngjarjet historike të zhvilluara në botën e Mesdheut në shekujt e mëpastajmë deri në pushtimin romak. Nuk është, pra, aspak e rastit që pikërisht në këtë kohë (shek. IV-II para e.sonë) të shtohen në mënyrë të ndjeshme të dhënat burimore mbi historinë e Ilirisë. Për fat të keq një pjesë e madhe e veprave, që përmbanin këto të dhëna kanë humbur. Të tilla janë p.sh. veprat e Theopompit, Agatharhidit, historitë e fushatave të Filipit II dhe Aleksandrit të Maqedonisë kundër ilirëve, Historia e Pompe Trogut, "Historia e Epirit" e Proksenit, bashkëkohës i Pirros etj. Vlerën e madhe që do të kishin këto vepra si burime të

dorës së parë për historinë e ilirëve në epokën e lulëzimit më të madh të tyre ekonomiko-shoqëror e politik-kulturor e tregojnë më së miri veprat e shkrimtarëve të mëvonshëm si Diodori i Siqelisë, Kurt Rufi, Plutarhu, Arriani, Atheneu, Justini, etj., të cilët kanë shfrytëzuar këta autorë më të lashtë dhe na kanë kumtuar pjesë të shkëputura, shpesh herë shumë të shkurtuara e të gjymtuara, nga shkrimet e tyre. Për fat të keq nuk janë të pakta edhe ato raste kur nga veprat historike të ruajtura kanë humbur pikërisht ato libra e kapituj që trajtonin kryesisht ngjarje të zhvilluara në trevën e Ilirisë në këtë kohë.

Në mes të veprave të historianëve dhe gjeografëve grekë të kohës helenistike të arritura tek ne në formë të plotë ose të pjesshme, siç janë ato të Aristotelit, Demostenit e Skylaksit, dallohet vepra e shquar historike e Polibit, në të cilën shtjellohet historia e vendeve të botës së Mesdheut në periudhën që nga viti 264 deri në vitin 146 para e. sonë. Në këtë histori të parë botërore Polibi na jep të dhëna shumë të rëndësishme e të sakta mbi historinë e mbretërisë së fundit dhe më të fuqishme ilire, mbretërisë ardiane, e cila ariti të bashkonte rreth vetes një numër të madh fisesh ilire dhe të bëhej, për një kohë, pengesë kryesore për realizimin e planeve pushtuese të shtetit skllavopronar romak në Lindje. Fillin e tregimit historik të Polibit e ndjek pa e këputur shkrimtari romak Tit Livi, i cili e çon atë deri në vitin 9 para e. sonë. Por për fat të keq librat që trajtonin periudhën mbas vitit 168 kanë humbur.

Ndër shkrimtarët e vonë, ai që u interesua seriozisht për historinë e shekujve të mëparshëm dhe në veprën e të cilit ne gjejmë të dhëna me vlerë për qëndresën e ilirëve kundër pushtimit romak në kohën e Augustit, është Dion Kasi, i cili megjithëse nuk shkëlqen nga fryma kritike, mbetet gjithmonë një gjurmues i mirë.

Një burim tjetër që flet për historinë e rezistencës kundër pushtimit romak është edhe Historia e Velei Paterkulit, dëshmitar i disa prej këtyre ngjarjeve, i cili me ngjyra të gjalla pikturon tablonë e kësaj epoke historike të luftës së ilirëve kundër pushtuesve romakë.

Është e tepërt të theksojmë rëndësinë që ka libri i Apianit për historinë e Ilirisë, megjithëse, siç thotë edhe ai vetë, u gjet përpara shumë vështirësive për të paraqitur një histori të plotë të ilirëve, kështu që u detyrua të kufizohet vetëm me paraqitjen e disa fakteve dhe episodeve historike pa lidhje midis tyre.

Mjaft interesante paraqiten për studjuesin e historisë dhe gjeografisë së Ilirisë, vepra e gjeografit Skymn dhe në mënyrë të veçantë vepra gjeografiko-historike e Strabonit. Vlera e veprës së Strabonit, si burim për njohjen e krahinave ilire, qendron jo vetëm në shfrytëzimin e gjerë nga ana e tij e disa gjeografëve të rëndësishëm, më të vjetër, si Efori, Eratostheni, Posidoni, etj., por edhe në vetë përshtypjet e tij personale që ai grumbulloi në udhëtimet e tij të gjata. Përveç të dhënave shumë të rëndësishme me karakter gjeografiko-etnografik, vepra e Strabonit është e ngjeshur edhe me të dhëna të vlefshme mbi të kaluarën e Ilirisë. Krahas Strabonit vlen të përmendet për rëndësinë që ka për historinë tonë të lashtë dhe vepra enciklopedike e Plinit të Vjetër mbi "Historinë e Natyrës", në të cilën përmbahen të dhëna të çmueshme mbi shtrirjen e fiseve ilire, mbi pasojat e pushtimit romak, mbi organizimin administrativ të Ilirisë, mbi pasurinë e nëntokës, mbi florën e faunën e saj etj.

Për periudhën fill mbas pushtimit romak rëndësi të madhe përveç veprës së Plinit kanë edhe fjalimet e letrat e oratorit të shquar romak Ciceronit, si dhe komentarët e Jul Cezarit, veçanërisht komentari mbi "Luftën civile", një pjesë e së cilës u zhvillua në Iliri. Në këtë drejtim mund të nxirren të dhëna me vlerë edhe nga "Biografitë e perandorëve" të shkruara nga Suetoni.

Nëqoftëse për periudhën deri në shek. e I të e. sonë, ne trashigojmë, siç e pamë më sipër, një numër të dhënash, në përgjithësi me vlerë të madhe dokumentimi historik, mbas këtij shekulli ato bëhen gjithnjë më të rralla e më të varfëra, për të mos thënë se shterrin fare. Kjo shterpësi në këtë periudhë stabilizimi të përkohshëm politik në Ilirinë e pushtuar,

spjegohet me faktin e kalimit të vëmendjes së shkrimtarëve antikë në krahinat e Lindjes, drejt së cilave ishin drejtuar edhe armët romake. Në mes të shkrimtarëve që na kanë lënë të dhëna për Ilirinë e kësaj kohe, janë gjeografët Pompon Mela e Klaud Ptolemeu. Vepra e këtij të fundit është më e rëndësishmja për epokën romake dhe njëra nga më të rëndësishmet e kohës antike. Megjithëse në veprën e tij ka shumë pika të errëta dhe pasaktësira, numri i madh i emrave të fiseve dhe vendbanimeve që na i kumton Ptolemeu, duke i shoqëruar këto edhe me kordinatat përkatëse gjeografike, përbën një bazë të rëndësishme për studimin e Ilirisë në shek. I-II të e. sonë.

Mungesa e të dhënave historike për Ilirinë e shek. II-III e. sonë, shndërrohet në shek. IV-VII në një prodhimtari të madhe letrare të autorëve antikë dhe bizantinë prej nga mund të nxirren të dhëna me vlerë për historinë e Ilirisë në periudhën e vonë antike. Në këtë kohë treva e Ilirisë, sikurse edhe trevat e tjera të Gadishullit Ballkanik, sulmohen dendur nga fiset barbare që vijnë nga Veriu. Në këto rrethana krahinat danubiane të Ilirikut janë të detyruara të përballojnë peshën e rëndë të këtyre sulmeve. Kjo gjendje e vështirë për perandorinë romake e shkaktuar nga jashtë prej hordhive barbare, u bë akoma më serioze me luftat e brendshme shoqërore dhe konfliktet e tjera të ndezura midis pretendentëve për fronin perandorak. Të gjitha këto ngjarje, të cilat zhvilloheshin me shpejtësinë më të madhe në këtë kohë dhe prej të cilave varej vetë fati i perandorisë, tërheqin vëmendjen e shkrimtarëve dhe kronikëve, të cilët u përpoqën t'i pasqyrojnë ato dikush më shumë e dikush më pak në veprat e tyre.

Të dhëna të shkurtëra, por të rëndësishme për Ilirinë e fundit shek. III-IV të e. sonë, për gjendjen e përgjithëshme të saj, për ekonominë, jetën e popullsisë, për dyndjen e barbarëve dhe pasojat e tyre, i ndeshim tek Eutropi, Orosi, Aurel Viktori, Hieronimi, në "Panagjyrikët", në "Historinë e perandorëve", etj.

Të dhëna me shumë vlerë për ekonominë e Ilirisë në shek. IV të e. sonë ka dhe vepra "Mbi përshkrimin e botës" si dhe poemat e Klaudianit. Pavarësisht nga forma e tyre, poemat e Klaudianit janë në disa raste i vetmi burim për luftat në mes gotëve dhe perandorisë në Iliri, në fundin e shek. IV. Tek ai ne gjejmë dhe njohuri për prodhimin zejtar dhe bujqësor, për vendosjen e fiseve barbare në tokat ilire, etj. Të dhëna me interes dhe të besueshme për historinë e Ilirisë në gjysmën e dytë të shek. IV i ndeshim edhe tek antiohasi Amian Marcelini.

Burime shumë të rëndësishme mbi të cilat mund të ndërtohet gjeografia historike e trevave të Ilirisë në kohën e vonë antike, janë edhe "Itinerarët romakë" të formuluar përfundimisht në formën e paraqitur në vëllimin tonë, gjatë shek. IV të e.sonë.

Historiografia e shek. V të e. sonë për Ilirinë, përfaqësohet kryesisht nga shkrimtarët Prisku e Malhu, të cilët përshkruajnë sulmet e hunëve dhe ostrogotëve në trevën e Ilirisë dhe japin të dhëna të vlefshme mbi gjendjen e krahinave të saja të veçanta. Një burim me shumë vlerë historiko-gjeografike që i përket fillimit të shek. V të e. sonë është padyshim dhe "Lista e rangjeve të perandorisë", ku jepen të dhëna të shumta mbi ofiqet administrativo-ushtarake në provincat e diocezet e prefekturës së Ilirikut. Burim tjetër i rëndësishëm që shpreh gjendjen administrative në provincat romake të Lindjes në shek. V dhe fillimin e shek. VI të e. sonë, është vepra e Hieroklit "Shoqërues udhëtimi".

Në sa shek. V, karakterizohet për një varfëri burimesh letrare, laike ose kishtare, shek. i VI i e. sonë përkundrazi shënon një gjallërim të ndjeshëm të literaturës. Kështu veprat e historianëve bizantinë Prokopit të Cezaresë, Jordanit, Menandrit,Malalës, Semokatës, etj. janë burimet kryesore për të fituar njohuri të shumta mbi gjendjen e perandorisë në vazhdim të gjithë shek. VI e fillimit të shek. VII të e. sonë.

Në mes të këtyre shkrimtarëve spikat Prokopi i Cezaresë, veprat e të cilit merren si burimi letrar më i rëndësishëm i perandorisë Bizantine në kohën e Justinianit.

Të dhënat e autorëve të sipërpërmendur bizantinë shpesh herë paraqiten jo vetëm si më të rëndësishmet, por dhe të vetmet të dhëna për historinë e trevave Ballkanike gjatë shek. VI-VII të e. sonë.

Në këtë vëllim, përveç burimeve me karakter gjeografik, etnografik dhe historik janë përfshirë edhe burime me karakter juridik. Është fjala për ligjet e botuara në "Kodeksin e Theodosit", "Kodeksin e Justinianit" dhe "Novelat" e tij. Këto urdhëresa të veçanta drejtuar sundimtarëve të prefekturës së Ilirikut ose të diocezeve dhe provincave ilire, trajtojnë probleme nga më të ndryshmet qoftë me karakter juridik, qoftë dhe me karakter ekonomiko-shoqëror, administrative etj. Interpretimi dhe studimi i gjithanshëm i tyre është detyrë kryesore për të gjithë ata që merren me historinë e prefekturës së Ilirikut në shek. III-VI të e. sonë.

Burimet që përmendëm më lart formojnë një bazë të rëndësishme për rindërtimin e historisë së paraardhësve të popullit tonë, ilirëve. Megjithatë duhet thënë se për shkak të karakterit të tyre fragmetar, ato flasin vetëm për disa nga ngjarjet dhe aspektet e historisë së ilirëve. Në përgjithësi ato e prekin historinë e ilirëve në mënyrë të tërthortë dhe vetëm në ato raste, kur ngjarjet mpleksen me historinë e popujve fqinjë grekë, maqedonë ose romakë. Historia e ilirëve, përkundrazi, nuk u bë kurrë object i një studimi të veçantë, për asnjë nga autorët antikë. Edhe atëherë kur ajo u trajtua si temë më vete, siç është rasti i Apianit, ajo mbeti vetëm një grumbullim i varfër faktesh të shkëputura. Arësyeja është se autorët antikë i kanë njohur, në përgjithësi, shumë pak ilirët. Rastet kur ata kanë qenë vetë dëshmitarë të ngjarjeve që përshkruajnë, janë shumë të rralla. Shumica e atyre i kanë marrë të dhënat nga duar të dyta e të treta. Nuk janë të paktë ata autorë që i kanë përshkruar ngjarjet e ndodhura pas dhjetra ose qindra vjetësh, duke u mbështetur në vepra ose kronika më të vjetra të shfrytëzuara në mënyrë jo kritike. Të shkruara në rrethana të tilla dhe nganjëherë bile dhe nga persona jo kompetentë, ngjarjet historike kanë përfunduar shpesh në përshkrime të përcipta, të varfëra dhe të pasakta. Në të shumtën e rasteve autorët antikë, duke dashur t'u japin veprave të tyre një mveshje artistike ose një ton të theksuar retorik, sambas modës së kohës, janë larguar nga thelbi i çështjes dhe kanë humbur në trillime fantastike, duke iu shmangur kështu së vërtetës historike. Më në fund, dhe kjo është më e rëndësishmja, shumica e shkrimtarëve i kanë parë ilirët nën syrin e interesave të shtetit të vet, apo të klasës sunduese që ata mbronin, gjë që nuk u ka lejuar të shkruajnë me objektivitet për ngjarjet dhe aspektet e jetës politike e shoqërore të ilirëve. Për të gjitha këto arsye shfrytëzimi i tyre duhet bërë në mënyrë shumë kritike. Në të gjitha rastet këto burime janë me shumë boshllëqe, prandaj për të ndërtuar një tablo sa më afër të vërtetës historike, studjuesit duhet t'u drejtohen patjetër edhe burimeve arkeologjike, epigrafike e numizmatike të kësaj periudhe, vlera e të cilave, në këto kushte, është e paçmuar.

Në këtë vëllim burimet janë radhitur kronologjikisht d.m.th. sipas kohës në të cilën kanë jetuar autorët. Në krye të çdo autori jepen njohuri të shkurtëra mbi jetën e shoqërinë në të cilën ai jetoi e punoi, mbi veprat e karakterin e tyre, mbi qendrimin e autorëve ndaj ngjarjeve; njëkohësisht jepet dhe vlera që ka çdo burim për historinë e lashtë të vendit tonë. Përveç kësaj është dhënë edhe edicioni i veprës, sambas të cilit është bërë përkthimi.

Përkthimet janë mbështetur kryesisht mbi tekstet më të mira, në radhë të parë mbi botimet e autorëve antikë nga shtëpia botuese Teubner e Laipcigut. Gjatë punës sonë shpesh na është dashur të këshillohemi dhe nganjëherë edhe të përdorim, krahas origjinalit, edhe ndonjë përkthim nga më të mirët e gjuhëve më të njohura.

Në përkthim janë ruajtur renditjet, librat, kapitujt e paragrafet sipas botimit prej ku është bërë përkthimi.

Kolektivi ynë bëri të gjitha përpjekjet që përkthimi t'i qendronte sa më besnik origjinalit dhe njëkohësisht të ishte i qartë e i kuptueshëm. Ai beson se në përgjithësi ia ka arritur këtij qëllimi. Një vëmendje jo e vogël iu kushtua përshtatjes në gjuhë shqipe të emrave grekë e latinë, shumica e të cilëve deri më sot kanë qenë të huaja për gjuhën tonë.

Ne u munduam të ruajmë me çdo mënyrë trajtën e shqiptimit origjinal të tyre dhe ndryshuam vetëm prapashtesat. Në disa raste si p.sh. tek Ptolemeu, Itinerarët, Stefan Bizantini, tek listat e Prokopit, Ravenatit si dhe të Hieroklit, emrat janë lënë ashtu siç janë në origjinal.

Për të lehtësuar leximin e shfrytëzimin e burimeve, këto të fundit janë shoqëruar edhe me ndonjë koment e sqarim të nevojshëm. Përveç komentit dhe spjegimeve, vëllimi me burimet është pajisur me një tregues emrash, duke dhënë për çdo zë gjithë autorët e veprat e tyre. Me qëllim që t'i shërbejë sa më mirë lexuesve në të janë përfshirë jo vetëm emra personash dhe gjeografikë, por edhe emra sendesh, kryesisht me karakter ekonomik. Fjalorthi i termave që i bashkangjitet këtij vëllimi, shpresojmë se do të bëjë gjithashtu një shërbim të mirë, duke plotësuar mungesat që nuk janë dhënë në shënimet përkatëse. Në fund tekstit i janë bashkangjitur edhe dy harta mbi shtrirjen e fiseve ilire, mbi vendosjen e qyteteve e qendrave të tjera të banimit, mbi rrugët e provincat e krijuara në Iliri.

Një ndihmë të çmueshme në përkthimin e një pjese të teksteve greke e latine na kanë dhënë prof. Sotir Papakristo, Stefan Prifti, Pashko Geci, Henrik Lacaj, Kolë Shiroka e Koço Bozhori, të cilëve ne u shfaqim me këtë rast falenderimet tona. Gjithashtu falënderojmë edhe zotin Injac Zamputi për kontributin që ka dhënë në periudhën fillestare të përgatitjes së këtij vëllimi.

Duke dhënë për botim, për herë të parë në gjuhën shqipe, burimet e autorëve antikë për ilirët e Ilirinë, kolektivi që përgatiti këtë vëllim ka pasur për qëllim të vëjë në duart e studentëve, mësuesve dhe gjurmuesve të historisë së Shqipërisë një tekst ndihmës dhe shumë të nevojshëm për punën e tyre dhe zhvillimin e mëtejshëm të shkencës së re historike shqiptare.

Autorët e këtij vëllimi do të pritnin me kënaqësi çdo vërejtje e sugjerim që do të bëhej nga ana e lexuesve për përmirësimin e tij në një botim të dytë.

HOMERI

Me emrin e Homerit, poetit epik legjendar të Greqisë, për qenien dhe veprimtarinë letrare të të cilit kritika moderne ka mendime të ndryshme, janë lidhur dy poemat e mrekullueshme të letërsisë greke që shkëlqejnë dhe në letërsinë botërore: "Iliada" dhe "Odisea".

"Iliada" e cila përshkruan luftën e grekëve kundër Trojës, u formua aty nga shek. VIII para e. sonë, kurse "Odisea" në të cilën janë paraqitur peripecitë e udhëtimit të Odisesë gjatë kthimit të tij për në atdhe, u formua në shek. VII. Është vërtetuar arkeologjikisht se poemat e Homerit, megjithëse të mveshura shumë me fantazi poetike, pasqyrojnë ngjarje të vërteta historike, të një kohe shumë më përpara formimit të tyre, pikërisht në shek. XIII-XII si dhe ndryshimet e ndodhura në dy shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit para e. sonë. Ato krahas me të dhënat arkeologjike janë një burim i rëndësishëm për njohjen e jetës së Greqisë të asaj kohe.

Në poemat e Homerit ne ndeshemi dhe me disa të dhëna për historinë e Ilirisë si p.sh. për pjesëmarrjen e paionëve në luftën e Trojës, për lokalizimin e vendbanimeve të tyre, për pjellorinë e tokës së tyre, dhe asaj të thesprotëve (Epir), etj. Këto grimca njoftimesh kanë rëndësi mbasi janë lajmet e shkruara më të vjetra që kemi për historinë e Ilirisë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Homeri Ilias* edidit Gulielmus Dindorf editio quinta, correctior quam curavit C. Hentze Pars I et II; editio stereotypa. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1921.

2) *Homeri Odyssea* edidit Gulielmus Dindorf editio Quinta, correctior quam curavit C. Hentze. Pars II, editio stereotypa. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1925.

HOMERI

I. ILIAS

(Iliada)

LIBRI II

Tani më poshtë, do të përmend ata që Argon pellazgjik banonin
si edhe ata që banonin Alën, Alopën e Trehinën,
si edhe ata që zotëronin Fthian si edhe Helladën me gra të bukura.
.....
Guneu nga Kyfi solli njëzet e dy anije;
e ndiqnin atë enienët, ashtu edhe perrebejt luftarakë
të cilët banonin në Dodonën dimërkeqe,
.....
Hipothou solli fiset e pellazgëve fqinjë,
ata të cilët banonin Larisën pjellore;
ata i udhëhiqte Hipothou e Pileu, pinjoll i Aresit,
dy të bijtë e pellazgut Letho Teutamidit.
.....
Gjithashtu Pyraihmi solli paionët harklakuar
larg prej Amydonit, nga Aksi shtratgjerë,
Aksi, uji shumë i bukur i të cilit vërshon tokën,
.....

LIBRI X

Pastaj atij iu përgjegj Doloni, i biri i Eumedit:
"Ty unë këto do t'i them me përpikmëni.
Anës së detit kanë zënë vend karianët e paionët harklakuar
si edhe lelegët, kaukanët dhe pellazgët hyjnorë,
kurse në Thymbrë u vendosën lykët e myzët e patrembur[1)]
.....

LIBRI XVI

O Zeus, mbret dodonas e pellazgjik, që banon larg,
që kujdesesh për Dodonën dimërkeqe ku për rreth janë selët,
aty banojnë fallxhorët që s'lajnë këmbët e flenë për tokë[2)]
.....
I pari hodhi heshtën vezulluese Patrokli
për karshi dhe drejt mesit ku shumica luftonte,
afër kiçit të anijes së Protesilaut zëmërmadh,
dhe goditi Pyraihmin i cili paionët kalorë me përkrenare
i solli prej Amydonit, prej brigjeve të Aksit të gjërë;
atë e goditi në sup të djathtë, kurse ai me shpinë në pluhur
ra duke bërtitur, dhe shokët e tij paionë u frikësuan.
.....

[1)] Dolonin e kishte zënë Odiseu afër anijeve helene. Atij i flet Doloni.
[2)] Këto fjalë ia drejton Zeusit Akili.

LIBRI XVII

I biri i shkëlqyeshëm i Lethos të Pellazgut,
Hipothou, e tërhiqte prej këmbe përmes përleshjes së tmerrshme,[1]
lidhur me tërkuzë nga kyçi i këmbës,
për t'i bërë qejfin Hektorit dhe trojanëve.
.....
Këtë të rënë[2] e mëshiroi Lykomodi luftëdashës,
duke shkuar qendroi pranë dhe qëlloi me heshtën vezulluese,
dhe vrau Apisaun, të birin e Hipasit, prijës të popujve,
në mëlçi të zezë, nën zemër, që ra në gjunjë,
nga Paionia pjellore ai kishte ardhur,
dhe pas Asteropeut shquhej në beteja.
Për këtë i erdhi keq Asterope luftarakut
që i nxituar u drejtua të luftonte me danajt,
.....

LIBRI XXI

Atëherë i biri i Peleut me heshtën majëprehtë
u vërsul i pezmatuar për të vrarë Asteropeun,
të birin e Pelegonit; këtë Aksi shtratgjerë
e kishte lindur me Peribenë e Akesamenit, të bijën
më të madhe të tij, me të cilën në shtrat kishte rënë lumi i thellë.
Atij Akili iu vërsul, kurse ai nga ana e lumit i doli përballë
duke pasur dy heshta në duar; zemërimin që kishte në kokë
Ksanthi ia kishte ndezur për djemt e fuqishëm të vrarë në luftë
të cilët Akili pa mëshirë i kishte vrarë dhe hedhur në lum.
Kur ata u ndeshën ball për ball,
i pari foli Akil hyjnori këmbëshpejtë:
"Kush je ti prej burrave qe kundër meje guxon të vish?
Është fatkeq ai djalë që mërinë time kundërshton"
Atij menjëherë iu përgjegj i biri i shkëlqyer i Pelegonit:
"O Peleid zëmërgjërë, për fisin tim pse pyet?
Jam nga Paionia pjellore dhe e largët,
burrave paionë heshtëgjatë u prij; kam
njëmbëdhjetë ditë që kam ardhur në Ilion.
Fisi i im vjen prej Aksit me rrjedhë të gjerë
(prej Aksit që me ujë shumë të mirë tokën vërshon)
që lindi Pelegonin, shtizorin e përmendur; prej këtij thonë
se Linda unë. Tashti të luftojmë o Akil i ndritur".
Kështu kërcënueshëm ai foli, kurse Akili hyjnor e ngriti
heshtën peljade; por në të njëjtën kohë me dy heshta
përballë i dolli Asteropeu heroi;
dhe menjëherë mburojën e qëlloi, por në asnjë vend
mburoja nuk u ça; e ndaloi floriri, dhuratë hyjnore;
me heshtën tjetër shkarazi i goditi llërën e krahut
të djathtë nga rodhi gjak i zi, kurse arma që kaloi mbi të
u ngul në tokë e uritur për mish.
Pastaj i dyti Akili drejtoi heshtën

[1] Kufomën e Patroklit të vrarë.
[2] Lokritin, shok të tij.

kundër Asteropeut, që donte t'a vriste,
prej kësaj ai shpëtoi, kurse heshta u ngul
deri në gjysmë të shtizës prej frashëri në bregun e lartë të lumit.
Në atë kohë Peleidi shpatën e mprehtë, duke nxjerrë nga brezi,
u sul mbi të; kurse ai heshtën e Akilit
nuk mund t'a nxirrte nga bregu ku dora e shëndoshë e kishte futur.
Tri herë u përpoq, i hidhëruar, ta rrëmbente,
tri herë fuqia e la; dhe radhën e katërt, kur plot mëri
përpiqej të mirrte heshtën prej frashëri të Aiakidit
më përpara Akili ia nxori shpirtin.
I goditur në bark afër kërthizës nga ku
u derdhën në tokë të brendëshmet, terri i mbuloi sytë
kur ishte duke dhënë shpirt.
.....
Pastaj ai [Akili] shkoi kundër kalorëve paionë me përkrenare
të cilët kishin frikë të kalonin lumin,
mbasi panë trimin në një betejë të tmerëshme
të vrarë nga krahu i fortë i Peleidit.
Këtu ai vrau Thersilohun, Mydonin, Astypylin,
Mnesin, Thrasin, Ainin dhe Ofelestin;
dhe shumë të tjerë do t'i kishte vrarë këmbëshpejti Akil,
nëqoftëse nuk do të ishte futur në mes lumi i thellë e i trubullt.

2. ODYSSEA

(Odisea)

LIBRI XIV

U ënda për nëndë ditë, kurse në natën e dhjetë të zezë,
vala e madhe më shtyu në tokën e thesprotëve.
Këtu më priti mbreti i thesprotëve Feidoni
hero e bujar; i biri i tij i dashur erdhi
të më marri në shtëpi, të dërmuar nga të ftohtit e nga lodhja,
pasi më ngriti më çoi në pallatin e të jatit
ku më dha të dyja, këmishë dhe mantel.
Këtu unë dëgjova për Odiseun; kurse ai [mbreti] thoshte
se e priti dhe u suall bujarisht me të kur kthehej në atdhe,
më tregoi të gjitha pasuritë që Odiseu kishte grumbulluar
bakrin, arin dhe hekurin shumë të punuar.

Një pasuri që mjaftonte për të mbajtur etër e bij për dhjetë breza;
Kaq gjëra të çmueshme gjendeshin në pallatin mbretëror.
Dhe thonte se në Dodonë kishte shkuar për t'u këshilluar me hyun
dhe për të dëgjuar nga lisi i gjatë fallxhor mendimin e Zeusit
në se duke u kthyer në tokat pjellore të Ithakës së tij,
pas një kohe të gjatë, të tregohej apo jo se kush ishte.

LIBRI XIX

Unë tani mora vesh kthimin e Odiseut;
diku, në tokat pjellore të thesprotëve
jeton dhe sjell thesare të shumta dhe të çmueshme
.....

Kështu më tha mbreti i thesprotëve Feidoni,
i cili pasi u bëri fli perëndive të pavdekshëm
kishte pregatitur një anije të shpejtë dhe bashkë me njerëz e kishte nisur
për të çuar Odiseun në atdheun e tij.
Por mua më përcolli më përpara, me që rastësisht erdhi një anije
thesprote, e cila lundronte për në Dulihin e pasur me grurë.
Por më parë ai më tregoi pasuritë që Odiseu kishte mbledhur,
me të cilat mund të mbahet një familje për dhjetë breza;
Kaq gjëra të çmueshme gjendeshin në pallatin mbretëror.
Pastaj thonte se kishte vajtur në Dodonë për t'u këshilluar me hyun
dhe për të dëgjuar nga lisi i gjatë falxhor mendimin e Zeusit,
në se duke u kthyer në atdheun e tij,
pas një kohe të gjatë, të tregonte ose jo se kush ishte.

HESIODI

Hesiodi, poet grek, jetoi në shek. VIII-VII para e. sonë. Lindi në Beoti, në një familje fshatare dhe vetë ai u muar me bujqësi. Shkroi dy poema në heksametër. Njëra e quajtur "Theogonia" (Krijimi i perëndive) ka përmbajtje krejtësisht mithologjike. Në të flitet mbi prejardhjen e perëndive dhe krijimin e botës. Në veprën e dytë "Erga kai hemerai" (Punë dhe ditë), e cila paraqitet më e përsosur se e para, jepen kryesisht udhëzime për bujqësinë, për mënyrat e punimit të tokës si edhe një kalendar për bujkun. Ai thekson në këtë vepër rëndësinë e madhe që ka punimi i tokës në kohë të përshtatshme. Me një realizëm të theksuar Hesiodi përshkruan këtu edhe marrëdhëniet shoqërore të kohës së tij dhe luftën kundër fuqizimit të aristokracisë fisnore. Poema e tij është një burim i rëndësishëm për teknikën e ekonomisë fshatare të Greqisë së vjetër; në të përshkohet mendimi se puna nuk është turp, se turp është vetëm dembelia dhe se puna i sjell njeriut pasuri dhe pavarësi.

Në këtë vepër të Hesiodit ne ndeshemi në disa vargje, të cilat bëjnë fjalë edhe për fushat e gjera pjellore, kullotat e pasura dhe për kopet e mëdha të bagëtive në Epir.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Hesiodii Carmina recensuit Aloisius Rzach, editio tertia, accedit certamen quod dicitur Homer et Hesiodi. Lipsia in aedibus B.G. Teubneri 1913.

HESIODII

CARMINA

(Poema)

Fragment 134 (156)

Është një fushë, Hellopia, shumë pjellore dhe me luadhe të mira
e pasur në dele dhe në qe këmbëharkuar;
këtu banojnë burra me shumë kope gjedhësh
dhe një sasi e panumër fise mortarësh;
këtu, në pjesën më të fundit është ndërtuar Dodona;
këtë Zeusi e deshi që të jetë një faltore
e vyer për njerëzit...

HERODOTI

Herodoti, i quajtur babai i historisë, lindi në Hilakarnas rreth vitit 484 dhe vdiq nga viti 425. Nga viti 455-452 fillon një udhëtim të gjatë nëpër vendet e Evropës, Azisë dhe Afrikës. Midis të tjerave viziton krahina të ndryshme të Gadishullit Ballkanik si Ilirinë, Thrakinë e Maqedoninë.

Për një kohë Herodoti qëndroi në Athinë ku u afrua me rrethin e Perikliut. Këtu ai, me sa duket, vendosi të shkruajë dhe veprën e tij të madhe të quajtur "Historia" në 9 libra, ku përshkruan luftën greko-persiane në të gjitha fazat e saja deri në vitin 479 para e. sonë.

Herodoti në këtë vepër, e cila dallohet për një diapason të gjerë mendimi, për mjeshtëri e deri diku edhe për objektivizëm në paraqitjen e ngjarjeve, jep përveç historisë së grekëve dhe persëve edhe ngjarje nga historia e atyre popujve, me të cilët ata kishin marrëdhënie. Vepra e tij përmban edhe të dhëna me rëndësi gjeografike e etnografike. Duke folur për historinë e popujve të ndryshëm ai përshkruan kushtet natyrore të vendeve të tyre, besimet, zakonet, banesat, veshjen, armatimin e tyre, monumentet e artit, legjendat, mitet etj.

Herodoti për të parën herë dha një vepër të përgjithshme historike të mbështetur mbi një kritikë historike, megjithëse të sipërfaqshme. Historia e Herodotit është një burim shumë i rëndësishëm historic dhe disa nga faktet e përshkruara prej tij kanë gjetur vërtetimin e tyre edhe nga të dhënat arkeologjike.

Në veprën e Herodotit ne gjejmë të dhëna shumë të rëndësishme për pellazgët. Përveç kësaj ky është i pari autor që zë në gojë emrin e ilirëve. Janë interesante në veprën e tij edhe njoftimet për pushtimin e paionëve nga Megabazi, mbi mënyrën e jetesës dhe disa zakone të tyre, si edhe për tokat e kullotat e Apollonisë.

Përkthimi është mbështetur në botimin: *Herodoti Historiarum* libri IX edidit Henr. Rudolph. Dietsch, editio altera curavit curatamque emendavit H. Kallenberg; vol. I-II, editio stereotypa. Lipsiae in aedibus B. G. Teubneri 1926.

HERODOTI

HISTORIAE

(Historitë)

LIBRI I

46 ... Me *[jonët]* u përzien dhe kadmët, dryopët, fokidasit e çliruar nga taksat, molosët dhe arkadasit pellazgë dhe dorët, epidaurasit si edhe shumë fise të tjera[1].

57 Çfarë gjuhe flitnin atëherë pellazgët është një çështje, për të cilën nuk mund të them asgjë. Vetëm nëqoftëse mund të mësojmë, ndoshta, ndonjë mendim nga pellazgët e ditëve tona, nga ata që janë akoma sot në Kreston[2] sipër tyrsenëve, të cilët, dikur fqinjë të dorëve të sotëm, banonin në tokën e quajtur tani Thesali, nëqoftëse këtyre pelazgëve u shtohen ata që kanë themeluar Plakienë dhe Skylakenë në Helespont dhe që kanë banuar dikur me athinasit, dhe banorët e qyteteve të tjera pellazge, emri i të cilavet është ndryshuar, del se pellazgët kanë pasë gjuhë barbare. Pra nëqoftëse e tillë ishte gjuha e pellazgëve del se popullsia e Atikës, pellazge me prejardhje, harroi të folmen e saj, duke u kthyer në helenë, prej të cilëve mësoi edhe gjuhën; pasi e folmja e krestonasve dhe e plakieasve, që është e njejtë, nuk ka asgjë të përbashkët me atë të fqinjëve të tyre, provë e qartë se këto dy fise pellazge ruajnë akoma në ditët tona gjuhën që sollën në këtë vend atëherë, kur u vendosën atje.

58 Përsa i përket gjuhës helene ajo ka qenë përdorur prej tyre qysh në fillim, së paku kështu më duket. Pasi u ndanë nga pellazgët, ata në krye qenë të dobët, por duke u nisur nga një pakicë e ikur helenët u shtuan deri sa u bënë një popullsi e madhe, sidomos që nga koha kur shumë fise të tjera barbare u bashkuan me ta; më duket se e kam treguar qartë se pellazgët, të cilët nuk ishin veçse një popull barbar, përkundrazi nuk u shtuan kurrë.

LIBRI II

52 Pellazgët kishin zakon t'u flijonin perëndive çdo gjë, sikurse e mësova në Dodonë, dhe ato nuk kishin për ta ndonjë emër, pasi nuk i ka dëgjuar njeri t'i thërrisnin me emra. Ata i thirrnin në përgjithësi si perëndi, për arësye se pasi kishin vënë të gjitha gjërat në rregull, mbanin ligjet e gjithësisë. Ata arritën t'i njohin emrat e perëndive vetëm tepër vonë, kur i sollën nga Egjypti, (por emrin e Dionisit e mësuan, pasi mësuan emrat e perëndive të tjerë). Më vonë ata vajtën për t'u këshilluar për këto

[1] Kur ahejt u vendosën në Peloponez një pjesë e jonëve që banonin atje më parë ikën dhe u vendosën në Azi të Vogël, dhe një pjesë tjetër tek fiset që përmendëm më lart.
[2] Qytet në bregdetin e Thrakisë.

emra tek orakulli i Dodonës (ky orakull njihet si më i lashti i Helladës, dhe ishte atëherë i vetmi në këtë vend). Pellazgët kur pyetën orakullin e Dodonës në se mund t'i merrnin këto emra që vinin nga barbarë, ai u përgjegj se mundnin. Që prej kësaj kohe i kanë përdorë në flijimet e tyre dhe më pas helenët i morën këto emra nga pellazgët.

LIBRI IV

48 Istri është lumi më i madh nga gjithë ata që ne njohim. Ai rrjedh njësoj gjithmonë si në verë ashtu edhe në dimër; se duke filluar prej perëndimit dhe duke kaluar në Skythi bëhet i madh mbasi tek ai derdhen shumë lumenj të tjerë. Ata /lumenj/ që e bëjnë atë të madh janë pesë që kalojnë nga toka e Skythisë; ai që skythët e quajnë Porat, këtë helenët e quajnë Pyret, tjetri është Tiaranti, pastaj Arari, Napari dhe Ortesi. I pari është më i madhi nga tërë lumenjt dhe duke rrjedhur drejt lindjes bashkohet me ujrat e Istrit, kurse i dyti Tiaranti është i vogël dhe për më tepër rrjedh drejt perëndimit, ndërsa Arari, Napari dhe Ortesi duke kaluar ndërmjet këtyre të dyve derdhen në Istër. Këta lumenj skythas prej kohësh shtojnë ujrat e Istrit, kurse nga Agathyrsa buron lumi Mar, i cili derdhet në Ister. Nga majat e Hemit tre lumenj të mëdhenj rrjedhin në drejtim të veriut dhe derdhen në Ister, këta janë Atlas, Auras dhe Tibisi. Kurse përmes Thrakisë dhe krobyrëve thrakë rrjedhin Athri, Noe dhe Artani, të cilët derdhen në Ister. Prej Paionisë dhe malit Rodop, lumi Ski duke kaluar përmes Hemit derdhet në Ister, kurse nga toka e ilirëve, duke rrjedhur në drejtim të veriut, lumi Angri mbasi futet në fushën e tribalëve derdhet në lumin Brong, kurse Brongu në Ister.

LIBRI V

1 Ata që u pushtuan në Evropë prej persëve, në kohën e Darit sundoheshin nga Megabazi; ky shkatërroi së pari perinthasit që banonin rreth Helespontit, mbasi këta nuk pranonin t'i nënshtroheshin Darit.
Ata edhe më përpara ishin trajtuar keq prej paionëve. Paionët që banonin rreth Strymonit morën njoftim nga orakulli i Hyut që të sulmonin perinthasit pasi të jenë të rreshtuar të dy palët dhe të vepronin, nëqoftëse perinthasit do t'i thërrisnin me emër, nëqoftëse jo të rrinin të qetë. Paionët i zbatuan këto. Meqenëse perinthasit ishin rreshtuar në afërsi të qytetit, këtu u bë ndërmjet tyre një dyluftim në tri mënyra; u ndeshën burrë me burrë, kalë me kalë, qen me qen. Perinthasit fituan dy dyluftime dhe për këtë të gëzuar kënduan paianin. Paionët e morën këtë si shenjë të orakullit, tani meqenëse orakulli ishte plotësuar, për ne detyra jonë është zbatimi i tij. Kështu thanë paionët dhe sulmuan perinthasit që këndonin; shumë prej tyre i kapën, kurse një pjesë i zhdukën.

12 Një ngjarje në të cilën qe dëshmitar Dari, bëri të lindë te ky mbret dëshira për të urdhëruar Megabazin që t'i shpërnguli paionët e Evropës në Azi. Pirgesi e Mantyesi, të dy paionë, donin të bëheshin tiranë të paionëve. Menjëherë pasi Dari u kthye në Azi, ata shkuan në Sardë me motrën e tyre që ishte e bukur dhe me trup të derdhur; dhe duke gjetur rastin kur ky mbret qendronte në lagjet e jashtme të lydëve, ata e zbukuruan sa mundën më shumë dhe e dërguan për të mbushur ujë. Ajo mbante një

shtamë në kokë, tërhiqte një kalë për kapistalli, të cilin e kishte lidhur pas krahut dhe tirrte li. Darit, kur e pa këtë që po kalonte, i tërhoqi vëmendjen pasi ato që bënte ajo nuk i kishin zakon gratë e Persisë, Lydisë, ashtu edhe të pjesës tjetër të Azisë. Për këtë arsye, kur e pa urdhëroi disa nga rojet e tij ta ndiqnin dhe të shikonin çdo të bënte me kalin e saj. Ata e ndoqën, ajo shkoi në lum, i dha të pijë kalit ujë dhe pasi e mbushi shtamën e saj, u kthye po nga ajo rrugë me shtamë në kokë, me kapistallin e kalit të lidhur pas krahut dhe duke dredhur boshtin.

13 Dari i habitur nga të thënat e rojeve të tij, dhe nga ajo që kishte parë vetë kërkoi që ta sillnin tek ai. Kur ajo erdhi para Darit, vëllezërit e saj që po i vërenin të gjitha këto nga një vend i afërt u paraqitën edhe ata. Kur Dari i pyeti mbi vendin e tyre, të rinjtë iu përgjegjën se ishin paionë dhe se ajo ishte e motra e tyre. Mbreti i pyeti përsëri pse kishin ardhur në Sardë, çfarë njerëzish ishin paionët dhe në cilin vend të tokës banonin. Ata i thanë se kishin ardhur për t'i shërbyer atij, se Paionia me qytetet e saj gjendej në brigjet e Strymonit dhe se ky lum nuk ishte shumë larg Helespontit, se ishin me prejardhje teukrase dhe koloni e trojanëve. Kjo qe përgjegja për çdo njerën prej pyetjeve të tij. Ai donte të dinte akoma nëse gratë e këtij vendi ishin të gjitha kështu punëtore si motra e tyre. Ata pohuan pa e peshuar. E gjithë kjo punë, në fakt, nuk kishte qëllim tjetër veçse të sillte këtë përgjigje.

14 Atëherë Dari i shkroi Megabazit, të cilin e kishte lënë në Thraki, si komandant të një pjese të ushtrisë së tij, që t'i shpërngulte paionët nga tokat e tyre dhe t'i sillte tek ai së bashku me gratë e fëmijët. Menjëherë një lajmëtar kalorës arriti në Helespont dhe pasi e kaloi atë ia dha letrën Megabazit, i cili pasi e lexoi, zgjodhi dhe mori njerëz nga Thrakia për t'i treguar rrugën dhe marshoi me ushtrinë e tij kundër Paionisë.

15 Paionët, si morën vesh se persët po marshonin kundër tyre, u përgatitën që t'i zbrapnin dhe shkuan me të gjitha forcat e tyre në brigjet e detit, duke menduar se andej do të sulmoheshin. Por Megabazi, kur mori vesh se ata ruanin shtigjet nga ana e detit, kaloi me ndërmjetësinë e atyre që i tregonin rrugën nëpër vise të larta dhe duke i sulmuar qytetet e tyre, papritmas dhe para se ata të kujtoheshin, i pushtoi me lehtësi të madhe aq sa nuk u gjend asnjeri për t'i mbrojtur. Paionët kur mësuan se qytetet e tyre ishin në duart e armikut u shpërndanë dhe duke u kthyer në tokat e tyre iu dorëzuan persëve. Kështu një pjesë e paionëve, d.m.th. siriopaionët, paioplajt dhe ata që zinin atë pjesë të vendit që arrin deri te liqeni i Prasias u dëbuan nga banimet e tyre dhe u dërguan në Azi.

16 Paionët e rretheve të malit Pangajon (dhe doberët, agrianët, odomantët) dhe paionët e liqenit të Prasias, Megabazi nuk i nënshtroi dot. Shtëpitë e tyre janë ndërtuar në këtë mënyrë: Në mes të liqenit, mbi trarë të vënë kryq, janë vendosur shtroje dërrasash. Ato lidhen me tokën me anën e një ure. Trarët, mbi të cilët qendrojnë shtrojet në kohë të vjetra i vendosnin bashkarisht të gjithë banorët. Më vonë i vendosnin kështu: Secili nga ata që martohej sillte për çdo grua nga tre trarë nga mali që quhej Orbel dhe i vendoste aty; çdo burrë martohej me shumë gra. Atje rronin në këtë mënyrë: Secili mbi këto shtroje kishte një kasolle në të cilën banonte, dhe kishte një qepeng të lidhur mirë, i cili të çonte poshtë në liqen. Fëmijët e vegjël i lidhnin për këmbe me litarë nga frika se mos binin poshtë në liqen. Kuajt dhe bagëtitë e tyre i ushqenin me peshk. Ky /peshk/ kapet me shumicë aq të madhe sa që, nëqoftëse ndonjëri e hap qepengun, lëshon me litar koshin e zbrazët dhe pas pak e tërheq, koshi mbushet plot me peshq.

Ka dy lloj peshqish: njërin e quajnë paprak, tjetrin tilon.

17 Dhe kështu, paionët e nënshtruar u drejtuan për në Azi. Pas nënshtrimit të tyre, Megabazi dërgoi në Maqedoni si delegatë shtatë persë, të cilët sipas tij, ishin më të sprovuarit në ushtri. Ata u dërguan tek Amynta që t'i kërkojnë tokë dhe ujë për mbretin Dar. Rruga nga liqeni Prasia deri në Maqedoni është shumë e shkurtër. Së pari pranë liqenit gjendet miniera, nga e cila në një kohë më të vonë Aleksandri[1] nxirrte nga një talent argjend në ditë; pas minierës vjen mali i quajtur Dysoron; pasi kalohet ky mal arrihet në Maqedoni.

61 Në trekëmbëshin e tretë, në vargje gjashtërrokëshe, lexohet: "Mbreti Laodam ia ka kushtuar këtë trekëmbësh Apollonit, i cili qëllon gjithnjë shenjë, që të stolisë tempullin e tij[2]". Në kohën e këtij Laodamit që ishte i biri i Eteoklit, kadmejt, të dëbuar nga argasit, u strehuan tek enhelejt...

98 .../Aristagora/ që të fyente mbretin Dar, dërgoi në Frygi një njeri tek paionët, të cilët Megabazi i kishte sjellë nga Strymoni si rob dhe banonin atëherë në një fshat të Frygisë. Kur i dërguari arriti tek ata u tha këto fjalë: "Burra paionë, më dërgoi Aristagora, tiran i Miletit, që të ju propozoj shpëtimin, nëqoftëse dëshironi të bindeni. Tani e gjithë Jonia ngriti krye kundra mbretit dhe ju keni mundësi të shpëtoni dhe të ktheheni në vendlindjen tuaj. Ju vetë do të kujdeseni që të arrini deri në buzë të detit, dhe andej e tutje do të kujdesemi ne për ju". Pasi dëgjuan këtë, pajonët e pranuan me gëzim, morën fëmijët dhe gratë e tyre dhe u drejtuan nga deti, kurse disa prej tyre mbetën meqenëse kishin frikë. Si arritën në det kaluan prej andej në ishullin Hio, dhe mbasi ishin vendosur këtu në gjurmë të tyre u nis për t'i ndjekur një kalori e madhe persiane. Meqenëse nuk i arritën, lajmëruan në Hio që paionët të ktheheshin mbrapsht. Paionët nuk ju nënshtruan dhe banorët e ishullit Hio i shpunë nga Hio në Lesbo, kurse lesbasit i dërguan në Dorrisk. Prej aty arritën në këmbë në Paioni.

LIBRI VI

127 Smindyridi, i biri i Hipokratit, erdhi nga Italia. Ishte nga Sybarisi, një qytet atëherë shumë i lulëzuar, dhe kishte sjell me vete sende shumë luksoze. Erdhi po ashtu edhe Damasi nga Siria që ishte i biri i Amyrit, i quajtur i Urti. Këta erdhën nga Italia. Amfinesti epidamnas, i biri i Epistrofit, erdhi nga gjiu i Jonit[3].

137 Ja se si Miltiadi, i biri i Kimonit, ishte bërë zot i ishullit të Lemnit. Athinasit dëbuan më parë pellazgët nga Atika. A patën të drejtë apo kryen me këtë një padrejtësi, nuk kam ndërmend ta përcaktoj; mjafton ajo çka thuhet. Hekateu, i biri i Hegesandrit, tregon në Historitë e tij se kjo qe e padrejt. Athinasit, thotë ai, duke parë se toka, që ata u kishin lëshuar pellazgëve në këmbët e malit Hymet, si shpërblim për ndërtimin e murit që rrethon akropolin, ishte e punuar mirë, megjithëse më parë kishte qenë e

---

[1] Aleksandri I i Maqedonisë (495-450).
[2] Laodami ishte mbreti i Thebës. Trekmëbëshi ishte i vendosur në tempullin e Apollonit Ismen në Thebë (Beoti).
[3] Këta dhe të tjerë vajtën në Sikion, qytet i Peloponezit, për t'u martuar me të bijën e Klisthenit, tiranit të Sikionit

keqe dhe e pavlefshme, i dëbuan ata, pa asnjë shkak vetëm e vetëm prej lakmisë e dëshirës për t'a marrë tokën përsëri. Por athinasit thanë se e bënë me të drejtë. Pellazgët, thonë ata, duke banuar në rrëzën e malit Hymet, sulmonin tokat e tyre dhe i fyenin vajzat e reja të athinasve, të cilat venin për ditë për të marrë ujë në burimin e quajtur Eneakruno, pasi atëherë nuk kishte fare skllevër në Athinë dhe as në pjesën tjetër të Helladës. Sa herë që këto vajza të reja vinin tek burimi, pellazgët i përdhunonin në mënyrë më fyese dhe më të padenjë, dhe të pakënaqur nga ato që bënin në fund u përgatitën për t'i sulmuar dhe kur po e bënin këtë ata u zunë. Athinasit shtojnë se qenë treguar kaq zemërgjërë sa që duke i pasur në dorë mund t'i vrisnin, por nuk e bënë këtë dhe u mjaftuan, duke i urdhëruar të largoheshin nga vendi. Pellazgët të detyruar të braktisnin Atikën, u shpërndanë në vende të ndryshme dhe një pjesë prej tyre shkoi në Lemn. Ky tregim është i athinasve, i pari i përket Hekateut.

138 Pellazgët që u ngulën atëherë në Lemn vendosën të hakmerren kundër athinasve. Pasi dinin shumë mirë ditët e festave të tyre, ata ndërtuan anije me pesëdhjetë lopata dhe pasi zunë pritë grabitën gratë athinase që kremtonin festën e Artemisit, në Brauron. Pastaj hapën velat dhe i sollën në Lemn ku u martuan me to. Ato patën shumë fëmijë, të cilëve u mësuan gjuhën dhe zakonet e Athinës. Këta fëmijë, për këto arsye, nuk donin të kishin asnjë marrëdhënie me fëmijët e grave pellazge; dhe nëqoftëse ndonjeri prej tyre goditej, të gjithë i vinin në ndihmë dhe mbronin njëri-tjetrin. Ata kishin vendosur të ushtronin forcën e tyre mbi të gjithë fëmijët e vendit dhe ishin shumë më të fortë. Guximi dhe bashkimi i këtyre fëmijëve i bënë pellazgët të mendonin seriozisht. Si, thoshin ata në kulmin e hidhërimit, nëqoftëse sot ata janë gati t'i japin ndihmë njëri-tjetrit kundër fëmijëve të grave që i kemi marrë të virgjëra, nëqoftëse përpiqen që tani t'i mbizotërojnë ata, çka nuk do të bëjnë kur të kenë arritur moshën madhore. Ata morën vendimin t'i vrisnin të gjithë fëmijët që kishin pasur me gratë atikase, gjë që e bënë dhe në të njëjtën kohë masakruan edhe mëmat e tyre. Pas kësaj vepre dhe si kujtim të krimit të grave të Lemnit, të cilat dikur i kishin mbytur të gjitha në një natë burrat e tyre, bashkë me mbretin e tyre Thoas, u bë zakon që në Helladë të quhen të gjitha veprat kriminale vepra si ato të Lemnit.

139 Pasi pellazgët vranë gratë e grabitura dhe fëmijët që kishin pasur me to, toka nuk u prodhonte më dhe gratë e bagëtia nuk u pillnin. Të dëshpëruar nga uria dhe nga që gratë e tyre nuk lindnin, ata dërguan në Delf për t'iu lutur Hyut që t'i shpëtonte nga të këqiat. Pythia i urdhëroi që të pranonin atë dënim që do t'a gjenin të drejtë athinasit. Pellazgët shkuan në Athinë dhe premtuan se ishin gati të vuanin dënimin që do t'u jepnin për të larë krimin e tyre...

LIBRI VII

185 Helenët e Thrakisë dhe të ishujve pranë saj kishin njëqind e njëzet anije; në këto anije kishte njëzet e katër mijë burra; në këmbësori kishte thrakë paionë, eordë, botiaj etj...[1)]

[1)] Në luftën e helenëve kundër persëve të udhëhequr nga Kserksi.

LIBRI VIII

47 Të gjithë këta u gjetën në Salaminë[1]; ata banojnë këtej thesprotëve e Aheronit. Thesprotët janë fqinjë të ambrakasve e leukadasve, që erdhën në këtë luftë nga skajet kufitare...

137 Perdika, i biri i shtatë i këtij Aleksandrit, është ai që ndërtoi në këtë mënyrë shtetin e maqedonëve. Prej Argo shkuan tek ilirët tre vëllezër pinjollë të Temenit: Gauani, Aeropi dhe Perdika; dhe duke ikur nga ilirët u vendosën në Maqedoninë e sipërme në qytetin Lebae. Këtu ata shërbenin me rrogë te mbreti, njeri duke kullotur kuajt, tjetri gjedhët, kurse i vogli prej tyre Perdika qingjat.

LIBRI IX

43 Unë e di se kjo thënie e orakullit, të cilin Mardoni kujtonte se ishte për persët, nuk i përkiste atyre, por ilirëve dhe ushtrisë së enhelejve[2].

92 ... Helenët të nesërmen u morën me flijime që jepnin shenja të mira, duke pasur si fallxhor Deifonin, të birin e Evenit, burrë nga Apollonia, por nga Apollonia që ndodhet buzë detit Jon; babajt të këtij i pat ndodhur kjo:

93 Në këtë Apolloni ka dele, të cilat i janë kushtuar Diellit; këto dele ditën kulosin pranë lumit që buron nga mali Lakmon[3], dhe që kalon përmes tokës së Apollonisë dhe derdhet në det afër limanit të Orikut; natën i ruajnë burra të zgjedhur, qytetarë nga më të shquarit si nga pikëpamja e pasurisë ashtu edhe e fisit; secili nga këta i ruan një vit të tërë. Me të vërtetë apolloniatët i çmojnë shumë këto dele për arsye të një thënie që kanë marrë nga orakulli dhe i mbajnë në një shpellë larg qytetit.
Në atë kohë, pra, Eveni që zumë në gojë më sipër, ishte zgjedhur për të ruajtur delet; ndodhi që njëherë kur gjatë kohës rojes e zuri gjumi, erdhën në shpellë disa ujqër dhe shqyen afro gjashtëdhjet dele. Kur Eveni e kuptoi këtë heshti dhe nuk i tregoi askujt mbasi mendonte t'i vinte në vend duke blerë të tjera. Megjithëkëtë apolloniatëvet nuk u shpëtoi kjo ngjarje dhe, me ta marrë vesh, e nxorën Evenin në gjyq dhe e dënuan me verbim, sepse kishte fjetur gjatë kohës që duhet të ruante delet. Por menjëherë, pasi e verbuan Evenin, as delet nuk pillnin, as toka nuk jepte më fryt. Prandaj ata dërguan njerëz në orakullin e Dodonës, dhe në atë të Delfit për të marrë përgjigje, duke pyetur orakujt se cili ishte shkaku i kësaj fatkeqësie; dhe këta u përgjigjen se e kishin verbuar Evenin rojtësin e deleve të shenjta pa të drejtë; sepse vetë ata[4] i kishin dërguar ujqërit dhe se do të hakmerreshin për të, përderisa apolloniatët të dënoheshin për ato që bënë, ashtu si do të donte dhe ta quante të drejtë Eveni; dhe si të bëheshin këto, ata duhet t'i jepnin Evenit një shpërblim të tillë, për të cilin shumë njerëz do ta quanin të lumtur.

---

[1] Është fjala për grekët që u mblodhën në Salaminë për të luftuar kundër persëve.
[2] Në Salaminë para betejës, të dy ushtritë kundërshtare, grekët e persët, bënë flijë dhe pyetën orakujt. Sipas orakullit, shkruan Herodoti, ishte parashikuar që persët me të arritur në Greqi do të plaçkisnin tempullin e Delfit dhe se pas kësaj do të humbin të gjithë. Më pas Herodoti tregon se orakulli nuk kishte folë për persët, por për ilirët.
[3] Lumi Aoo (Vjosa).
[4] Perënditë, në emër të të cilëve flisnin orakujt.

94 Kjo pra, ka qenë përgjigja që u dhanë atyre orakujt, kurse apolloniatët e mbajtën të fshehtë këtë përgjigje dhe ngarkuan disa qytetarë për ta zbatuar. Këta vepruan kështu: Një ditë, kur Eveni po rrinte ulur në një fron erdhën dhe i ndejtën pranë, duke hapur bisedë me të për çështje të ndryshme; më në fund i shfaqën hidhërimin për të keqen që i ngjau dhe e pyetën çfarë dënimi do t'i pëlqente në rast se apollonianët do të dëshironin ta pranonin dënimin për të këqiat që i kishin bërë. Eveni, meqenëse nuk e dinte përgjigjen e orakujvet, zgjodhi dënimin e mëposhtëm duke thënë: Sikur t'i jepnin disa ara – dhe tregoi me emër dy arat e atyre qytetarëve që i dinte se ishin nga më të mirat në Apolloni – dhe një shtëpi pranë tyre, atë që ai e dinte se ishte më e mira nga gjithë shtëpitë e qytetit; po të bëhej, tha, zot i këtyre, nuk do të mbante këtej e tutje mëri dhe se ky dënim do të ishte i mjaftë për të. Kur mbaroi së foluri Eveni, ata që i rrinin pranë i përgjigjen: "O Even, këtë dënim e lajnë për ty apolloniatët, sipas thënies së orakullit, për shkak se të verbuan pa të drejtë. Kur i dëgjoi të gjitha këto fjalë, Evenit i erdhi shumë rëndë sepse u gënjye, kurse apolloniatët i blenë nga pronarët dhe ia dhanë atij ato që kishte zgjedhur. Menjëherë pas kësaj Evenit i erdhi vetia e orakullit, sa që u bë edhe i dëgjuar...

THUKIDIDI

Historian grek i lindur në Athinë rreth vitit 460 para e. sonë; vdiq mbas vitit 400. Në vitin 424 ishte komandant i një njësie detare të Athinës, pranë ishullit Thasos. Meqenëse nuk qe në gjendje të ndalonte rënien e Amfipolit, athinasit e dënuan në mungesë me vdekje. Deri në vitin 404 jetoi në mërgim, pastaj për pak vjet në Athinë.

Thukididi ka shkruar Historinë e luftës së Peloponezit, së cilës i kushtoi gjithë jetën. Por vepra e tij nuk është çuar deri në fund; ngjarjet pas vitit 411 nuk përfshihen në të. Vepra është ndarë në tetë libra. Në librin e parë, pas hyrjes, në të cilën Thukididi flet për qëllimin e veprës së tij, ndjek e ashtuquajtura "Arkeologji" ku tregon për madhështinë dhe rëndësinë e luftës së Peloponezit, dhe e krahason atë me ngjarjet më të vjetra të historisë së Greqisë, duke përfshirë këtu edhe luftën me persët. Pastaj spjegon shkaqet e luftës. Në librin e dytë fillon tregimin mbi vet luftën e Peloponezit. Ky tregim bëhet në mënyrë analistike, duke e ndarë çdo vit në verë e dimër. Kulmi i përshkrimit arrihet në librat 6 e 7 ku trajtohet ekspedita e Siqelisë. Me një forcë të madhe janë dhënë edhe fjalimet e veçanta të vëna në gojën e personave veprues me anën e të cilave Thukididi ilustron anë të ndryshme të kësaj lufte të madhe. Thukididi nuk u beson përëndive dhe mrekullive dhe nuk i spjegon ngjarjet historike me to, siç bëjnë paraardhësit e tij, duke përfshirë këtu edhe Herodotin. Kjo e bën atë të thellohet më tepër në njohjen e së vërtetës politiko-historike. Në krahasim me historiografët e mëparshëm, Thukididi është i pari historian i vërtetë, prandaj nëqoftëse Herodoti është quajtur babai i historisë, ky është themeluesi i saj. Ai është themeluesi i metodës kritiko-shkencore, të cilën e vuri në zbatim me mjeshtëri.

E gjithë koha antike e ka çmuar Thukididin. Shumë historianë e morën atë si shembull.

Në veprën e tij përmbahen të dhëna mbi luftën civile të Epidamnit, në vitin 436 para e. sonë dhe ndërhyrjen e fisit ilir të taulantëve në këtë luftë, mbi pjesëmarrjen e disa fiseve të Ilirisë së Jugut nga ana e Spartës ose Athinës gjatë luftës së Peloponezit etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Thucididis Historiae recensuit Carolus Hude. Vol. I, editio minor, editio stereotypa. Lipsiae in aedibus B.G.Teubneri 1915.

THUCIDIDIS

HISTORIAE

(Historitë)

LIBRI I

3... Para luftës trojane Hellada, me sa duket, nuk ka bërë asgjë me forca të përbashkëta. Mua bile më duket se ajo si tërësi nuk e mbante akoma këtë emër; se një emërtim i tillë as nuk ekzistonte para Helenit, birit të Deukalionit; dhe se emrin ia kanë dhënë asaj, sipas emrave të tyre, fiset e ndryshme, më tepër pellazgët.

24 Epidamni është një qytet që gjendet nga ana e djathtë kur hyn në gjirin e Jonit. Pranë tij banojnë barbarët taulantë, fis ilir. Këtë e kolonizuan kërkyrasit, kurse të parë bënë Falin, birin e Eratoklidit nga Korinthi, i fisit të Herakliut, i cili, sipas zakonit të vjetër, u thirr nga qyteti-mëmë[1]. Midis kolonistëve ishin edhe disa korinthas, dhe të tjerë nga fisi i dorëve. Me kalimin e kohës, ky qytet u bë i fuqishëm dhe me banorë shumë. Por thonë se për shkak të grindjeve të brendshme që patën për një kohë të gjatë midis tyre, u shkatërruan në një luftë me barbarët fqinjë dhe e humbën fuqinë e madhe të tyre. Më në fund, pak përpara kësaj lufte[2] populli i Epidamnit dëboi oligarhët nga qyteti, kurse këta të fundit u lëshuan kundër tij së bashku me barbarët dhe po i grabitnin banorët edhe nga toka, edhe nga deti.

Atëherë (epidamnasit që ishin në qytet) meqenëse ishin zënë ngusht, dërguan delegatë në Kerkyrë, si qytet-mëmë që e kishin, duke u lutur që të mos rrinin të paanshëm për ata që po shkatërroheshin dita ditës, por të kujdeseshin që t'i pajtonin të dëbuarit me ta dhe t'i jepnin fund luftës së barbarëve. Ja se ç'kërkuan delegatët të gjunjëzuar si lutësa në tempullin e Herës. Por kerkyrasit nuk e pranuan lutjen e tyre dhe i përcollën pa asgjë.

25 Kështu epidamnasit, si e kuptuan se nuk do të kishin ndonjë ndihmë nga Kerkyra, ranë ngusht e nuk dinin si t'i bënin ballë gjendjes që ishte krijuar; prandaj dërguan në Delfi dhe pyetën perëndinë në se duhej t'ua dorëzonin qytetin e tyre korinthasve, si të parë të kolonisë dhe të përpiqeshin t'i siguronin vetes ndonjë ndihmë nga ana e tyre. Perëndia iu përgjegj atyre që t'ua dorëzonin qytetin korinthasve dhe t'i njihnin ata si udhëheqës.

Sipas porosisë së orakullit epidamnasit erdhën në Korinth dhe u dorëzuan korinthasve koloninë, duke u vënë në dukje se i pari i saj ishte nga Korinthi.

---

[1] Kërkyra qe themeluar nga Korinthi në vitin 737, kurse Epidamni në 627 para e. sonë. Si i tillë, Korinthi quhej nga Kerkyra dhe nga Epidamni qytet-mëmë (metropol).

[2] Është fjala për luftën e Peloponezit (431-411 para e. sonë). Lufta civile e Epidamnit, për të cilën bëhet fjalë më poshtë, plasi në vitin 436/5 para e. sonë.

3 Si u treguan përgjigjen e orakullit, iu lutën atyre që të mos i linin të shkatërroheshin, por t'i mbronin.

Korinthasit për hir të së drejtës, pranuan t'i ndihmonin sepse mendonin se kolonia ishte po aq e tyre sa edhe e kerkyrasve, ashtu edhe për shkak të urrejtjes që
4 kishin kundër kerkyrasve, sepse këta nuk i përfillnin megjithëse ishin kolonistë të tyre. Kështu kerkyrasit nuk dërgonin në Korinth në festat e mëdha popullore flijimet sipas zakonit të vjetër, nuk u linin korinthasve vendin e parë në ceremonitë e flijimeve, sikurse bënin kolonitë e tjera, dhe në përgjithësi silleshin ndaj korinthasve me përbuzje. Nga gjendja ekonomike, kerkyrasit ishin në një radhë me helenët më të pasur të kohës, nga përgatitja ushtarake, ishin më të fortë se ata. Ata mburreshin nganjëherë me epërsinë e madhe të flotës së tyre, sepse dikur në Kerkyrë kanë pas banuar fajakët e përmendur si detarë. Ja sepse ata tregonin një kujdes të madh edhe më përpara për ndërtimin e flotës, dhe atëherë ishin shumë të fuqishëm; në fillim të luftës ata kishin njëqind e njëzet anije me tri serë lopatash.

1 26 Të nxitur nga të gjitha këto, korinthasit i shkuan në ndihmë Epidamnit me
2 kënaqësi; shpallën se mund të shkonte atje për t'u vendosur si kolonist kushdo që dëshironte dhe dërguan një garnizon të përbërë nga ambrakas, leukadas dhe nga
3 qytetarë të tyre. Këta shkuan më këmbë në Apolloni, e cila ishte koloni e korinthasve, sepse kishin frikë se mos pengoheshin prej kerkyrasve po të kalonin nëpër det. Por kur kerkyrasit morën vesh se në Epidamn kishin ardhur kolonistë dhe një garnizon dhe se kjo koloni u ishte dorëzuar korinthasve, u zemëruan rëndë. Ata menjëherë dolën në det me njëzetepesë anije, më vonë me një flotë tjetër dhe duke i kërcënuar kërkuan nga epidamnasit t'i pranonin përsëri të dëbuarit; puna është se të dëbuarit kishin ardhur në Kerkyrë dhe duke u permendur varret[1] dhe lidhjet fisnore u luteshin t'i kthenin në atdhe. Kerkyrasit kërkuan që të përzinin
4 gjithashtu edhe garnizonin e kolonistët, që kishin dërguar korinthasit.
Epidamnasit nuk pranuan asnjë nga këto kërkesa. Kerkyrasit atëherë e sulmuan
5 Epidamnin me dyzet anije, duke pasur me vete edhe të dëbuarit, të cilët donin t'i kthenin në atdhe; ata kishin marrë me vehte edhe ilirët. Pasi e blokuan qytetin ata shpallën se kush dëshironte nga të huajt dhe epidamnasit mund të largohej pa
1 pësuar gjë, përndryshe do t'i trajtonin si armiq. Por meqenëse epidamnasit nuk dëgjuan, kerkyrasit e rrethuan qytetin (ai ishte në një gadishull). 27 Kur të dërguarit e Epidamnit arritën në Korinth dhe prunë lajmin se qyteti ishte rrethuar, korinthasit filluan të përgatisin ushtri dhe në të njëjtën kohë shpallën me anë të kasnecëve se të gjithë ata që dëshironin mund të shkonin në Epidamn të jetonin në kushte të njëjta e të barabarta me banorët e parë dhe kolonistët e ri, nëqoftëse ndokush nuk vendoste të nisej menjëherë, por megjithatë dëshironte të merrte pjesë në koloni, atij i lejohej të
2 mbetej në Korinth, por duhej të paguante pesëdhjetë drahme të Korinthit si peng. Të gatshëm për t'u nisur si dhe të tillë që paguan paratë dolën shumë. Korinthasit iu lutën edhe megarasve t'i shoqëronin kolonistët me flotën e tyre, se mos kushedi kerkyrasit i ndalonin në det. Megarasit u treguan të gatshëm të lundronin me ta me tetë anije, ashtu edhe Peleu i Kefalenisë me katër anije. Ju drejtuan me lutje edhe epidaurasve, të cilët u dhanë pesë anije, kurse hermionasit një, trozenasit dy, leukadasit dhjetë dhe ambrakasit tetë. Nga thebanët dhe fliasit, korinthasit kërkuan para; nga elejtë gjithashtu para dhe anije pa detarë. Korinthasit vetë bënë gati tridhjet anije dhe tremijë hoplitë.

[1] E të parëve të tyre.

1 **28** Kur kerkyrasit morën vesh për këto përgatitje, shkuan në Korinth së bashku me delegatët, lakedemonë dhe sikyonas, dhe kërkuan prej korinthasve që të tërhiqnin nga Epidamni si garnizonin ashtu edhe kolonistët, të cilët nuk kishin asnjë punë në
2 Epidamn. Dhe nëqoftëse korinthasit kishin ndonjë pretendim për Epidamnin /thanë ata/, atëherë ata ishin gati t'a shpinin çështjen në gjyqin e qyteteve të Peloponezit të zgjedhur me marrëveshje nga të dy palët: kujt t'i njihte gjyqi të drejtën mbi kolorinë
3 ai edhe do t'a sundonte. Ata shfaqën gjithashtu dëshirën që çështja t'i paraqitej për zgjidhje orakullit të Delfit, vetëm që të mos shkonte puna deri në luftë. Në rast të kundërt, thanë kerkyrasit, përderisa korinthasit veprojnë me forcë, atëherë edhe ata do
4 të detyrohen të kërkojnë ndihmë tek aleatë që nuk janë të dëshirueshëm për korinthasit dhe sidomos, jo tek ata që kanë tani[1]. Korinthasit u përgjigjën se do t'i shqyrtonin këto propozime nëqoftëse kerkyrasit do të largonin nga Epidamni anijet e
5 tyre dhe barbarët; por sa kohë që epidamnasit ishin të rrethuar, ata nuk kanë përse ta paraqesin çështjen e tyre në gjyq. Kerkyrasit u përgjegjen se ata ishin gati ta bënin këtë nëqoftëse edhe korinthasit do të tërhiqnin njerëzit e tyre nga Epidamni. Ata
1 pranuan edhe që të dy ushtritë të qendronin në vendet e tyre dhe deri në vendimin e gjyqit të bënin armëpushim. **29** Korinthasit nuk pranuan asnjë nga këto propozime; kur anijet e tyre ishin armatosur dhe aleatët kishin ardhur, ata u dërguan më parë lajmëtarë kerkyrasve, me anën e të cilëve u shpallnin luftë, pastaj dolën në det me shtatëdhjetepesë anije e dymijë hoplitë dhe u drejtuan për në Epidamn me qëllim që
3 të fillonin veprimet ushtarake kundër kerkyrasve... Kur arritën në Akt të Anaktorit, në hyrje të gjirit të Ambrakisë, atje ku gjendet tempulli i Apollonit, kerkyrasit u nxorën përpara një lajmëtar me varkë, me anën e të cilit u kërkonin që të hiqnin dorë nga sulmi; në të njëjtën kohë ata hypën ushtrinë e tyre në anije, bënë të vjetrat gati
4 për lundrim, kurse të tjerat i meremetonin. Kur lajmëtari u kthye nga korinthasit pa ndonjë lajm paqësor dhe tetëdhjet anije korinthase ishin mbushur me ushtri (dyzet anije të korinthasve mbanin blokadën e Epidamnit) atëherë kerkyrasit u drejtuan kundër tyre në det të hapët, u vunë në rreshtim luftarak dhe filluan përleshjen.
5 Kerkyrasit korrën fitore të plotë, duke shkatërruar pesëdhjet anije korinthase[2]. Po atë ditë kerkyrasit i detyruan anijet që rrethonin Epidamnin, të dorëzoheshin duke u vënë si kusht që të gjithë të huajt do të shiteshin si skllevër, kurse korinthasit do të mbaheshin në vargoj deri në një vendim të dytë.

1 **31** Të zemëruar nga lufta me kerkyrasit, korinthasit, gjatë gjithë vitit pas kësaj beteje, dhe bile edhe në vitin tjetër[3], ndërtonin anije dhe përgatiteshin për një ekspeditë të madhe detare, ndërkaq flotën ata e mblodhën nga Peloponezi, kurse vozitësit i morën me pagesë nga krahinat e tjera të Helladës. Kur morën vesh përgatitjen e korinthasve
2 për luftë, kerkyrasit u trembën dhe (meqenëse ata nuk kishin aleancë me asnjë nga helenët, dhe nuk quheshin as si aleatë të athinasve, as të lakedemonëve) vendosën t'u drejtohen athinasve që të hyjnë në aleancën e tyre dhe të përpiqen të sigurojnë ndonjë
3 ndihmë prej tyre. Kur morën vesh këtë, korinthasit dërguan nga ana e tyre delegatë në Athinë[4] nga frika se mos bashkimi i flotës së Athinës me atë të Kerkyrës u ndalonte të përfundonin luftën ashtu si ata donin. Në mbledhjen e popullit që u mbajt /me këtë rast/ të dy palët këmbyen fjalime...

---

[1] D.m.th. jo tek peloponezasit, por tek athinasit kundërshtarë të rreptë të korinthasve.
[2] Viti 435/4 para e. sonë.
[3] Viti 434/3 para e. sonë.
[4] Viti 433/2 para e. sonë.

38 "... Megjithëse janë kolonistët tanë, ata gjithmonë qendrojnë të shkëputur nga ne dhe tani po na luftojnë duke thënë se nuk i dërguam në koloni për të pësuar fatkeqësira. Edhe ne nga ana jonë themi se nuk i themeluam kolonitë që të na fyejnë kolonistët tanë, por që të qendrojmë mbi ta dhe të gëzojmë respektin që na takon. Në të vërtetë kolonitë e tjera na nderojnë dhe kolonistët na duan shumë. Nëqoftëse shumica janë të kënaqur prej nesh, atëherë, me sa duket, pakënaqësia e kerkyrasve, si rast i vetëm, nuk ka asnjë bazë dhe ne nuk do të ndërmerrnim këtë fushatë të jashtëzakonshme po të mos ishim fyer në mënyrë të veçantë. Edhe sikur ne të ishim fajtorë, kerkyrasit duhet t'i kishin lënë rrugë zëmërimit tonë, kurse për ne le të ishte një turp veprimi me forcë kundër qëndrimit të tyre të urtë. Përkundrazi kerkyrasve u është rritur mendja me pasurinë e tyre dhe pa u matur na kanë bërë neve shumë padrejtësi dhe midis të tjerash për koloninë tonë Epidamnin, për të cilën nuk kishin asnjë pretendim sa kohë që ajo ishte në fatkeqësi, tani që ne i shkuam në ndihmë, ata e pushtuan me forcë dhe e mbajnë nën sundimin e tyre".

44... Pasi i dëgjuan të dy palët, athinasit thirrën dy herë mbledhjen e popullit. Në mbledhjen e parë fjala e korinthasve u prit jo më pak mirë se ajo e kerkyrasve; por në mbledhjen e dytë athinasit ndryshuan mendim dhe vendosën të mos lidhin me kerkyrasit një aleancë të tillë, sipas së cilës ata të kishin armiq dhe miq të përbashkët (sepse nëqoftëse kerkyrasit do të kërkonin nga athinasit që të sulmonin së bashku me ta Korinthin, atëherë athinasit do të shkelnin marrëveshjen që kishin me peloponezasit), por të lidhnin një aleancë mbrojtje me kusht që të ndihmonin njeri tjetrin në rast se ndokush do të sulmonte Kerkyrën, Athinën ose ndonjë nga aleatët e tyre.

Lufta me peloponezasit, sipas mendimit të athinasve, ishte e pashmangshme, prandaj ata edhe nuk donin t'ia linin Kerkyrën, që kishte një flotë të madhe korinthasve. Përveç kësaj athinasit donin më tepër të mbillnin armiqësinë midis këtyre dy shteteve dhe nëqoftëse do t'u qëllonte të bënin luftë me korinthasit ose me ndonjë shtet tjetër që kishte flotë, të kishin të bënin me një armik të dobësuar. Më në fund athinasit e quanin të përshtatshme pozitën e këtij ishulli *[*Kerkyrës*]* që ndodhej në rrugën për në Itali e Siqeli.

45 Kështu gjykuan athinasit kur vendosën të pranonin kerkyrasit në aleancën e tyre. Menjëherë pas largimit të korinthasve, athinasit u dërguan kerkyrasve dhjet anije si ndihmë...

46 Korinthasit, nga ana e tyre, pasi mbaruan përgatitjet për luftë u drejtuan me njëqindepesëdhjet anije kundër Kerkyrës... Duke u nisur nga Leukada ata iu drejtuan bregdetit përballë Kerkyrës dhe u ndalën në bregun e Himerit të Thesprotisë. Himeri është liman, kurse më tej, larg detit në Eleati të Thesprotisë është qyteti Efyra. Pranë tij shtrihen në drejtim të detit liqeni Aherusia, kurse nëpërmjet Thesprotisë kalon lumi Aheron që derdhet në këtë liqen, prej nga ai mori edhe emrin. Po këtu rrjedh edhe lumi Thyam, që ndan Thesprotinë nga Kestrina; midis këtyre dy lumenjve del në det kepi i Himerit. Këtu në këtë vend të bregdetit korinthasit dolën në tokë dhe vendosën lëmin.

47 Si morën vesh për afrimin e korinthasve, kerkyrasit armatosën njëqindedhjetë anije... dhe vendosën lëmin në një nga ishujt që quhen Sybote; këtu erdhën edhe të dhjetë anijet atikase. Te kepi i Leukimnës qendroi ushtria tokësore e kerkyrasve dhe njëmij hoplitë zakynthas që u kishin ardhur në ndihmë.

3 Korinthasve u erdhën në ndihmë shumë barbarë të bregdetit; banorët e këtushëm kishin prej kohësh marrëdhënie miqësore me ta.

LIBRI II

1 **68** Në këtë kohë[1], nga fundi i verës, ambrakasit me ushtrinë e tyre dhe me shumë barbarë, që kishin marrë me vete, u sulën kundër qytetit Argo të Amfilohisë. 2 Si shkak i marrëdhënieve armiqësore të tyre me argasit ka shërbyer para së gjithash kjo: Argon e Amfilohisë dhe Amfilohinë tjetër, që është në gjirin e Ambrakisë e zuri 3 Amfilohu, biri i Amfiarajt, të cilin kur u kthye nga lufta e Trojës në atdhe, nuk e kënaqte gjendja në Argo dhe e quajti vendin me emrin e atdheut të tij, Argo. Ky qytet ishte më i madhi në Amfilohi dhe popullsia e tij, më e pasura. Pas shumë brezash, banorët e këtij qyteti, të goditur nga shumë fatkeqësi, ftuan të ngulen në qytetin e tyre 4 ambrakasit, fqinjë me Amfilohinë dhe greqishten, që flasin ata sot e mësuan nga 5 ambrakasit e ardhur; amfilohët e tjerë janë barbarë. Me kalimin e kohës ambrakasit i nxorën argasit nga qyteti dhe e zunë atë vetë. Pas kësaj amfilohët u vunë nën 7 mbrojtjen e akarnanëve dhe së bashku thirrën në ndihmë athinasit, të cilët edhe u dërguan tridhjet anije me në krye strateg Formionin. Me ardhjen e Formionit ata e morën me forcë Argon, ambrakasit i kthyen në skllevër dhe në Argo u vendosën amfilohët bashkë me akarnanët. Pas kësaj u lidh për herë të parë aleanca midis 8 athinasve dhe akarnanëve. Ambrakasit në fillim u armiqësuan me argasit për shkak se 9 këta skllavëruan njerëzit e tyre; më vonë në kohën e luftës[2], ata ndërmorën fushatën e përmendur më lart me ushtrinë e tyre si edhe me kaonët dhe me disa barbarë të tjerë fqinjë. Si arritën në Argo, ambrakasit zunë fushat e tij, por meqenëse nuk e morën dot qytetin me sulm, u kthyen në shtëpi dhe u shpërndanë secili në fisin e vet. Ja se ç'ndodhi në këtë verë.

1 **80** Po në këtë verë, jo shumë kohë pas këtyre ngjarjeve, ambrakasit dhe kaonët, që donin të nënshtronin të gjithë Akarnaninë dhe ta shkëputnin nga Athina, nxitën lakedemonët të përgatisin një flotë nga forcat aleate dhe të dërgonin kundra Akarnanisë hoplitë[3]. Me Knemin, prej heleneve ishin ambrakasit, anaktorasit, 5 leukadasit dhe hoplitë peloponezas, që ai kishte marrë me vete kur po vinte. Nga barbarët ishin njëmij kaonë që qeverisen pa mbretër, në krye të cilëve ishin si prostatë për një vit Foti e Nikanori, që rridhnin nga fisi i parë. Bashkë me kaonët merrnin pjesë në ekspeditë edhe thesprotët, që qeverisen gjithashtu pa mbretër. Në krye të 6 molosëve dhe të atintanëve ishte Sabylinthi, kujdestar i mbretit Tharyp që ishte akoma fëmijë dhe parauejt i udhëhiqte mbreti i tyre Oroidi. Njëmij orestë, mbret i të cilëve ishte Antiohu, merrnin pjesë ne ekspeditë bashkë me parauejt dhe nën komandën e Oroidit, me pëlqimin e Antiohut. Edhe Perdika, fshehurazi nga Athina, dërgoi njëmij maqedonë, që arritën më vonë. Me këtë ushtri Knemi u nis, pa pritur 7 flotën korinthase, dhe duke kaluar nëpërmjet tokës së argasve, plaçkiti Limnenë, një 8 fshat i pambrojtur me mure. Pastaj arritën në Strato, qytet i madh i Akarnanisë, duke menduar se në rast se e shtinin në dorë këtë, do t'ishte lehtë për të nënshtruar pjesën tjetër të saj[4]

---

[1] Në vitin 429.
[2] Luftës së Peloponezit.
[3] Lakedemonët pranuan dhe dërguan forcat e tyre nën komandën e Knemit.
[4] Akarnanët kërkuan ndihmë nga flota atike, por kjo nuk lëvizi pse ia kishte frikën flotës korinthase.

2 **81**... Ndërkaq peloponezasit dhe aleatët e tyre, të ndarë në tre grupe, ishin drejtuar për në qytetin Strato, duke synuar të ngrinin lëmin në afërsitë e tij dhe të përpiqeshin të pushtonin muret me forcë, nëqoftëse me fjalë nuk do t'ia dilnin t'u
3 mbushnin mendjen. Në qendër të ushtrisë ecnin kaonët dhe barbarët e tjerë, në të djathtën e tyre leukadasit, anaktorasit dhe të tjerët që ishin bashkë me ta, kurse në të majtën Knemi me peloponezasit dhe ambrakasit. Këto njësi i ndanin largësi të mëdha
4 dhe në disa raste as që e shihnin njëri-tjetrin. Helenët marshonin të rreshtuar në formacion luftarak dhe me kujdes deri sa ngulën lëmin në një vend të përshtatshëm. Kaonët, përkundrazi që ishin plot besim në veten e tyre dhe që nga banorët e atyshëm të kontinentit numëroheshin si popullsia më luftarake, nuk u ndalën për të ngritur lëmin por, duke shkuar me vrull përpara bashkë me barbarët e tjerë, llogaritnin ta merrnin qytetin me sulmin e parë, kështu që nderi për këtë punë t'u përkiste vetëm
5 atyre. Stratasit e morën vesh se ata, pasi i kishin lënë helenët, po vazhdonin të afroheshin dhe llogaritën se po t'i thyenin sa ishin të veçuar, helenët nuk do të sulmonin më. Vendosën, pra, prita përrreth qytetit, dhe kur kaonët u afruan, i
6 sulmuan duke iu turrur nga qyteti dhe nga pritat. Paniku zotëroi ndër trupat dhe kaonët pësuan humbje të rënda; barbarët e tjerë, si i panë të thyer, nuk qendruan më dhe ua mbathën këmbëve. Në asnjërin nga dy lëmet helene nuk kishte arritur lajmi i betejës, sepse barbarët kishin shkuar shumë përpara dhe helenët kujtonin se po vraponin për të vendosur lëmin e tyre...

LIBRI IV

1 **126** O burra të Peloponezit![1)] Po të mos dyshoja se u ka kapur frika pse keni mbetur vetëm dhe se ata që sulmojnë janë barbarë dhe të shumtë në numër, fjalimit tim nuk do t'i shtoja disa shpjegime. Por tani, mbas braktisjes që na bënë aleatët tanë dhe përballë numrit të madh të armiqve, do të mundohem t'iu bëj të qartë për gjërat më të rëndësishme me fjalë të shkurtra. Për ju thuhet se jeni trima në luftë jo sepse keni patur gjithmonë pranë aleatë, por sepse e keni në shpirt trimërinë, dhe nuk keni
2 frikë nga numri i armiqve. Ju nuk vini nga shtete ku shumica sundon mbi pakicën, po ku pakica përkundrazi sundon shumicën, dhe këtë fuqi ata nuk e kanë fituar me mjet
3 tjetër veçse me luftë. Barbarët, nga të cilët ju tani po frikësoheni sepse nuk i njihni,
4 duhet ta dini se nuk janë të tmerrshëm. Këtë unë e kam kuptuar vetë dhe e kam
5 dëgjuar edhe nga të tjerët... Për njerëz që nuk i njohin ata janë të tmerrshëm. Dhe me të vërtetë për numrin e tyre të madh janë tmerr i syvet, për zhurmën e madhe janë të padurueshëm, dhe vringëllimi kërcënues i armëve në ajër ka hijen e frikshme. Por, kur ndeshin në kundërshtarë që u qendrojnë, nuk janë po ata. Nuk mbajnë rregull në luftë dhe nuk e kanë për turp të braktisin këtë apo atë pozicion kur i detyrojnë me forcë. Ikjen edhe sulmin e quajnë njësoj për nder; nuk mund të dallosh çfarë quajnë ata burrëri (dhe vetëm lufta që bën secili në kokën e tij mund t'i sigurojë atij pa turp edhe shkakun e shpëtimit) dhe kështu ata kujtojnë se është më e sigurtë t'iu kallin edhe juve frikën pa u rrezikuar, se sa të futen në përleshje, sepse ndryshe ata do të përdornin përleshjen në vend të frikësimit...

[1)] Në kapitujt e mëparshëm bëhet fjalë për fushatën e ndërmarrë nga Perdika II, mbret i Maqedonisë, i ndihmuar nga Brasida, komandant i spartanëve, kundër mbretit të lynkestëve, Arabeut. Në këtë luftë lynkestëve u erdhën në ndihmë ilirët (enkelejt) të cilët simbas fjalëve të Thuqididit ishin "një popull luftar". Përpara forcave të bashkuara të ilirëve dhe lynkestëve, maqedonët braktisën aleatët e tyre duke u larguar nga fusha e luftës me rrëmujë Brasida për t'u dhënë zemër ushtarëve të tij u mban fjalimin e mëposhtëm. Ngjarja zhvillohet në vitin 423 para e. sonë.

ISOKRATI

Lindi në Athinë në vitin 436 para e. sonë dhe vdiq po këtu në një moshë shumë të thyer, rreth 100 vjeç (viti 338). Ishte orator i njohur dhe mësues i retorikës. Në Kio e më vonë në Athinë hapi një shkollë oratorije dhe e shpuri përpara zhvillimin e artit të fjalës. Në shkollën e tij mësuan historianë, poetë e burra shteti të mëvonshëm. Kishte miqësi e marrëdhënie me shumë mbretër të kohës së tij.

Isokrati ëndërronte për një mbret, i cili ta bashkonte Greqinë për të luftuar kundër persëve dhe e gjeti këtë më në fund, shumë më largpamës se Demosteni, tek Filip i II i Maqedonisë.

Prej tij na janë ruajtur, pjesërisht jo në origjinal, 21 ligjërata dhe 9 letra. Ligjëratat e Isokratit janë përpunuar artistikisht, por fjalitë tepër të gjata shpesh herë të lodhin. Për historinë e Ilirisë është interesante ligjërata për Filipin e II të Maqedonisë, ku bëhet fjalë për pushtimet e tij në Ilirinë e Jugut.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Isocratis Orationes recognovit praefatus est indicem nominum addidit G.E. Benseler, editio altera, stereotypa, curante Fr. Blass. Vol. I-II. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1913, 1927.

ISOCRATIS

ORATIONES

(Ligjëratat)

5
Filipi

19 ... Pastaj më thanë se rreth tij janë maqedonët më të shquar, të cilët për gjëra të tjera mund të mos jenë aq të zotë, por sa për interesin e Filipit janë në gjendje ta dinë e ta kuptojnë më mirë se ti[1]. Përveç kësaj aty gjenden edhe shumë helenë, njerëz me vlerë e mend, me kështillat e të cilëve ai e ngriti shumë lart mbretërinë
20 e tij. Me të vërtetë çfarë s'ka bërë ky njeri? Thesalët, të cilët më parë sundonin në Maqedoni, a nuk i bëri me vete, sa që çdo thesal ka besim më tepër te Filipi, se sa
21 te bashkëqytetarët e tij? Nga qytetet e atjeshme disa me anë të mirëbërjes i bëri aleatë, ndërsa ata që i kishin rënë më qafë a nuk i prishi dhe i shkatërroi? Nuk i nënshtroi magnetasit, perrebejt, paionët dhe a nuk i vuri këta nën pushtetin e tij? Nuk u bë zot i pjesës më të madhe të tokave të ilirëve, përveç atyre që banojnë buzë Adriatikut?...

[1] D.m.th. se vetë autori, Isokrati.

DEMOSTENI

Orator grek i lindur në Athinë në vitin 384, vdiq më 322. Në moshën 20 vjeç mbajti para gjyqit fjalimin e parë kundër tutorëve të tij, që e kishin mashtruar duke i përvetësuar trashëgimin. Në vjetin 354 mbajti fjalimin e tij të parë publik me përmbajtje politike. Më vonë u vu në krye të partisë athinjote të pavarësisë, që luftonte kundër Filipit II të Maqedonisë. Tri ligjëratat e tij olynthike dhe katër filipike, të drejtuara kundër këtij, njihen si shembuj të paarritshëm të artit retorik. Në vitin 345 bashkë me Eskinin mori pjesë në delegacionin, që nënshkroi me Filipin një paqë të disfavorshme për Athinën. Në vitin 340 organizoi një lidhje antimaqedone, ku mori pjesë dhe fisi ilir i taulantëve, si dhe luftën kundër Filipit. Mori pjesë personalisht në luftën e Keronesë dhe mbajti një fjalim të përmortshëm për të vrarët në luftë. Me fjalimin e tij të përmendur "Mbi kurorën" e vuri përpara kundërshtarin e tij Eskinin, i cili e kishte quajtur të padenjë për kurorën e artë të dhënë për merita patriotike nga athinasit. Në vitin 324, i dënuar me 50 talente për arsye se kishte pasur gisht në çështjen e korruptimit të arkëtarit të Aleksandrit, Harpalit, u arratis për në Troezen. Mbas vdekjs së Aleksandrit u thirr rishtas me nderime, por iu desh të fshihej nga Antipatri. Për të mos rënë në dorën e tij i dha fund jetës, duke pirë helm. Koha antike e nderoi kujtimin e Demostenit, duke i ngritur një varg truporesh e portretesh; një nga më të bukurat e më shprehëset është koka, që u zbulua në vitin 1958 në Apolloni.

Emrin e Demostenit e mbajnë 60 ligjërata, ndër të cilat një tok jo origjinale; prej tij kemi edhe 56 hyrje (prooimia) nga të cilat një pjesë nuk ngjajnë të jenë të tijat. Në ligjëratat e tij kundër Filipit, Demosteni i drejtohet edhe ilirëve, liria e të cilëve kërcënohej gjithashtu nga mbreti maqedon.

Përkthimi është mbështetur në botimet:

1) *Demosthenis Orationes* ed. Carolus Fuhr, editio maior, Vol. I. Lipsia in aedibus B.G. Teubneri 1914.

2) *Demosthenis Orationes* ex. recensione Guilielmi Dindorfii Vol. II, III, editio Quarta correctior curante Friderico Blass, editio maior stereotypa. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1924, 1911.

DEMOSTHENIS

ORATIONES

(Ligjëratat)

PHILIPPICAE

(Filipiket)

I

Olynthiaca A (Olynthiaka)

12 ... Pastaj ai /Filipi/[1] bëri ç'deshi me Ferën, Pegazën, Magnetinë dhe u nis për
13 Thraki. Atje pasi shfronëzoi disa mbretër dhe vendosi të tjerë, u sëmur. Sapo u shërua, se mos u ruajt? Jo, bëri një sulm të papritur kundër Olynthit. Dhe nuk them asgjë për ekspeditat e tij kundër ilirëve, paionëve, kundër Arrybës kundër të gjithë të tjerëve, që mund të përmenden akoma...

23 ... Përsa i përket paionëve, ilirëve dhe të gjithë fqinjëve të tij në përgjithësi duhet besuar se për ta është më e kënaqshme të jenë të pavarur e të lirë se sa të nënshtruar. Janë njerëz që nuk janë mësuar të binden, kurse njeriu i ynë /Filipi/ thuhet se është një zot i rreptë...

IV

Contra Philippum A (Kundër Filipit)

48 Dhe nga ne disa sillen rrugëve, duke thënë se Filipi, në marrëveshje me lakedemonët, përgatit rrënimet e thebanëve dhe shkatërrimin e shtetit të tyre, të tjerë se ka dërguar delegatë tek mbreti[2], të tjerë se po fortifikon qytete në Iliri, të tjerë akoma shpifin sipas qejfit lajme që i përhapin andej e këndej...

VII

De Haloneso (Mbi Halonesin)

32 Ju e dëgjuat këtë korrigjim të cilin ai /Filipi/ e njeh si të drejtë dhe e pranon në letrën e tij[3], por ndërkaq ai pushton qytetin Fera dhe vendos një garnizon në fortesë, patjetër që të jetë e pavarur! Ai marshon kundër Ambrakisë, merr me forcë tre qytete në Kasopi: Pandosinë, Buketin dhe Elatenë, koloni të elejve, ku shkreton tokat e tyre. Pasi hyri me forcë ia dorëzoi këto qytete kunatit të tij Aleksandrit, i cili i robëroi. Me të vërtetë ai ka kujdes të madh për t'i bërë helenët të lirë e të pavarur! Veprat e tij e provojnë...

---

[1] Filipi II i Maqedonisë.

[2] Është fjala për mbretin e Persisë.

[3] Në ligjëratën e tij Demosteni kërkon që athinasit të fusin në traktatin e paqes me Filipin një korrigjim, sipas të cilit të sigurohen jo vetëm Athina e Maqedonia me aleatët e tyre, por edhe grekët që nuk bëjnë pjesë në këto aleanca dhe që nuk janë në rrezik të humbin lirinë nga Filipi II.

SKYLAKSI

Skylaksi është një udhëtar, gjeograf dhe historian grek nga Karianda e Karisë që ka jetuar midis shek. VI-V para e. sonë. Nga fundi i shek. VI me urdhër të Darit I të Persisë ndërmori një udhëtim eksplorimi në Indi dhe në brigjet e oqeanit Indian. Me emrin e këtij gjeografi është lidhur vepra e titulluar "Periplus tes thallases tes eikumenes Europes kai Azias kai Libyes" (Lundrimi gjatë brigjeve të Evropës, Azisë dhe Afrikës). Në të vërtetë kjo vepër nuk është e tij por e një autori tjetër të mëvonshëm të cilin është bërë zakon ta quajnë PseudoSkylaksi për ta dalluar nga Skylaksi i Kariandes. Periplusi është një përpilim i mesit të shek. IV para e.s. i mbështetur në njoftime të marra nga logografët e shek. VI. Hekateu dhe autorë të tjerë të shek. V para e. sonë.

Në këtë vepër jepet edhe një përshkrim gjeografik me shumë interes i krahinave bregdetare të Ilirisë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Geographi Graeci Minores, Joannes Franciscus Gail. Volumen primum. parisiis 1826.

SCYLACIS CARIANDENSIS

PERIPLUS

(Lundrim)

Istroi

20 Pas enetëve vjen popullsia e istërve dhe lumi Ister. Ky lum derdhet në Pont[1] me drejtim gati nga Egjipti. Lundrimi në viset e istërve zgjat një ditë e një natë.

Libyrnoi

Pas istërve vjen popullsia e liburnëve. Qytetet bregdetare të këtij fisi janë
21 Idasa, *[*qyteti i*]* atienitëve, Dyyrta, Halupsi, *[*qytetet e*]* olsëve, pedetëve, hemionëve. Ata i nënshtrohen pushtetit të grave. Gratë e burrave të lirë shkojnë edhe me skllevërit[2] e tyre dhe me burrat e krahinave fqinjë. Pranë tokave të tyre ka ishuj, emrat e të gjithëve nuk mund t'i them mbasi ka shumë prej tyre që janë pa emra. Ishulli i Istrit është treqind e dhjet stade i gjatë dhe njëqindenjëzet i gjerë; Kleitrei, Litria, Mentoride, këto janë ishujt më të mëdhenj. Lundrimi gjatë tokave të Libyrnidës zgjat dy ditë.

Illyrioi

Pas liburnëve vjen popullsia e ilirëvet; dhe banojnë ilirët gjatë anëdetjes
22 gjer në Kaoni; kjo ndodhet kundrejt Kerkyrës, ishullit të Alkinout. Është aty një qytet Helen, i quajtur Heraklea, bashkë me limanin e vet. Banojnë aty edhe popuj barbarë që quhen me një emër lotofagë; këta janë: hierastamnët, bulinët, hyllët (hyllët janë fqinjë me bulinët), këta të fundit thonë se aty kish banuar Hylli, i biri i Herakliut. Këta janë barbarë dhe banojnë në një gadishull pak më të vogël se Peloponezi. Prej këtij gadishulli, gjatë bregut të detit ngjitur me këta, banojnë bulinët, që janë ilirë. Lundrimi prej vendit të bulinëve gjer te lumi Nestos kërkon një ditë të gjatë.

Manloi

Pas nestëve vjen lumi Naron; gjerësia e këtij lumi është aq e madhe sa nëpër
24 të mund të lundrojnë edhe anije me tri sërë lopatash. Edhe maniejtë janë fis ilir. Pranë vendit që quhet emporion është një liqen i madh, i cili i përket tokës së

---

[1] Deti Zi.
[2] I përgjegjet termi greqisht dulloi.

autariatëve që janë edhe këta ilirë. Brenda në liqen është edhe një ishull i vogël, gjithësejt njëqindenjëzet stade, një tokë shumë e përshtatshme për bujqësinë. Prej këtij liqeni rrjedh lumi Naron që zumë në gojë më sipër.

Egheleis

25 Enhelejt janë fis ilir, ngjitur me Rizonin. Duhet të lundrosh një ditë e një natë që të arrish nga Buthoe gjer në Epidamn, qytet Helen; rruga më këmbë është tri ditë.

Illyrioi

26 Përbri është fisi i ilirëve, ku është qyteti Epidamn dhe pranë tij rrjedh lumi i quajtur Palamni. Nga Epidamni gjer në Apolloni, qytet Helen, udha më këmbë mban dy ditë. Apollonia është pesëdhjetë stade larg detit; anës qytetit shkon lumi i quajtur Aia. Kurse nga Apollonia në Amanti janë treqind e njëzet stade. (Lumi Aia del nga mali i Pindit dhe rrjedh anës së Apollonisë). Ky lum zbret në det, duke qenë larg tetëdhjetë stade nga Oriku, që është më thellë në detin Jon nga gjithë Orikia, kurse nga Amantia është larg gjashtëdhjetë stade. Fqinj me gjithë këta, në viset e brendshme, janë atintanët, sipër Orikisë dhe Kaonisë gjer në Dodonë. Në krahinën e Kastidas thuhet se ndodhet një fushë që quhet Erytheia. Këtu thuhet se kishte ardhur Geryoni dhe kish kullotur qetë. Në këto vise janë malet Keraune (në Epir) dhe aty afër është një ishull i vogël që quhet Sason. Prej këtej në Orik lundrimi mban një të tretën e ditës.

Orikoi

27 Orikët banojnë në krahinën e Amantisë; /amantët/ që shtrihen gjer këtu janë ilirë nga bulinët. Gryka e gjirit Jon shkon që nga malet Keraune, gjer te kepi i Japygisë. Prej maleve Keraune, gjer në qytetin Hydrunt të Japygisë, lundrimi është pesëqind stade; kjo është gryka e gjirit[1]; është brenda detit Jon. Adriatiku ka shumë limane; Adriatiku dhe Joni janë e njëjta gjë.

Haones

28 Pas ilirëve vinë kaonët. Kaonia ka limane të mira; kaonët banojnë nëpër katunde[2]. Lundrimi anës së Kaonisë mban gjysmë dite.

Thesprotoi

30 Pas Kaonisë vjen fisi i thesprotëve; edhe këta janë të shpërndarë nëpër katunde; dhe ky vend ka limane të mira, këtu është limani i quajtur Elaia. Në këtë liman derdhet lumi Aheron dhe është edhe liqeni Aherusia, nga i cili del lumi Aheronit. Lundrimi anës Thesprotisë zgjat gjysëm dite.

---

[1] D.m.th. ngushtica e Otrantit.

[2] I përgjigjet termit greqisht komas.

Molottoi

32 Pas Kasopisë vjen fisi i molosëve, edhe këta banojnë nëpër katunde; një pjesë e vogël e tokës së tyre zbret këtu gjer në det, ndërsa pjesa më e madhe shtrihet në viset e brendshme. Lundrimi anës detit të Molosisë mban dyzet stade.

Ambrakia

33 Pas Molosisë vjen Ambrakia, qytet Helen, tetëdhjetë stade larg detit. Anës detit ka një mur dhe një liman shumë të bukur. Prej këtej fillon Hellada, pa ndërprerje, gjer në lumin Pene dhe gjer në Homoli, qytet i Magnetisë që ndodhet anës lumit. Lundrimi i Ambrakisë mban njëqind e njëzet stade.

ARISTOTELI

Aristoteli lindi në vitin 384 para e. sonë në qytetin Stagira të Maqedonisë. Vdiq në vitin 322, i tërhequr nga jeta politike. Aristoteli është filozofi më i shquar dhe mendimtari më me influencë i kohës antike. Qysh në moshë të njomë shkoi në Athinë dhe u bë nxënës i Platonit. Më vonë Aristoteli krijoi këtu shkollën e tij filozofike që ishte në kundërshtim me atë të Platonit. Mbas një qëndrimi prej 20 vjetësh në Athinë dhe tre vjetësh në Azi të Vogël, Aristoteli u kthye në Maqedoni, ku u mor me edukimin e Aleksandrit të Madh. Kur Aleksandri filloi ekspeditën kundër persëve, Aristoteli e la oborrin mbretëror dhe shkoi në fillim në Stagira dhe më vonë, në vitin 334, në Athinë ku hapi një shkollë filozofike që njihet me emërin shkolla peripatetike. Kur mbas vdekjs së Aleksandrit në Athinë filloi të marrë përpjestime lëvizja antimaqedone, u vu në rrezik edhe jeta e Aristotelit, prandaj ai u tërhoq në pronat e tij në Eube ku mbas pak edhe vdiq.

Veprat që kemi trashëguar nga Aristoteli me përjashtim të atyre të humbura që nuk i njohim veçse nga ndonjë shënim i zbetë, tregojnë se sa e gjerë ka qenë veprimtaria e tij shkencore historike e letrare. Vepra kryesore e tij e përbërë nga tri pjesë të pakoordinuara: Metafizika, Fizika e Psikologjia, trajton çështje filozofike. Ndër veprat e tjera me rëndësi duhen përmendur shkrimet e tij mbi moralin, politikën dhe artin. Tek vepra "Politika" Aristoteli trajton doktrinën e tij mbi familjen dhe shtetin. Doktrina e tij mbi shtetin paraqet një përpjekje pa sukses për të justifikuar rendin skllavo-pronar, për ta paraqitur atë si një gjendje të përjetshme dhe të natyrshme të shoqërisë dhe për të forcuar shtetin skllavopronar. Simbas tij njeriu është "Zoon politikon" (Një qenie e gjallë e aftë për të krijuar një bashkësi të organizuar). Përsosmëria e këtij organizimi arrihet tek shteti. Përsa i përket formës së regjimit, Aristoteli është përkrahës i idealit aristokratik, të cilin e quan si sundim të njerëzve më të zot.

Në veprën "Politika" të Aristotelit ne gjejmë disa të dhëna të fragmentuara, shpesh jo të qarta mbi mënyrën e qeverisjes në Epidamn, Apolloni dhe tek molosët.

Aristoteli ka shkruar mbi 158 kushtetuta (Politeia) greke e të huaja, ndër të tjera edhe kushtetutën e Dyrrahit, epirotëve dhe të molosëve, por këto për fat të keq nuk kanë arritur deri tek ne. E vetmja kushtetutë e ruajtur është ajo e Athinës që u zbulua në Egjipt në fund të shekullit të kaluar.

Vepra të tjera që i atribuohen Aristotelit janë: "De animalium historia" (Mbi historinë e kafshëve) dhe "De mirabilibus auscultationibus" (Mbi mrekullitë e dëgjuara).

Në këto dy veprat e fundit gjejmë një tok shënimesh të vlefshme me karakter ekonomik për Ilirinë dhe Epirin.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Aristotelis Graece,* ex recens. Immanuelis Bekkeri, vol. I, II. Berolini 1831.

2) *Politica,* edidit Susemihl-Immisch. Lipsiae, in aedibus B.G. Teubneri. 1909.

3) *Aristotelis, De animalium historia,* textum recognovit Leonardus Dittmeyer. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1907.

4) *Aristotelis, De plantis, de mirabilibus auscultationibus,* etc. edidit Otto Apelt. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1888.

ARISTOTELI

1. POLITICA

LIBRI II

7 ... Ky autor[1] në sistemin e tij legjislative ngjan, gjithashtu, sikur nuk ka dashur të ndërtojë tjetër veçse një qytet-shtet të dorës së dytë, përderisa këtu të gjithë zejtarët do të ishin skllevër, pronë e përbashkët, dhe këta /zejtarë/ nuk do të formonin një pjesë të rëndësishme të shtetit. Por, nëqoftëse do të dëshironim që ata të kryejnë punë të dobishme publike, të jenë skllevër të shtetit, atëherë kjo duhet të bëhet si në Epidamn dhe ashtu sikurse Diofanti ka dashur ta vendosë në Athinë...

LIBRI IV

4 ... Por nuk është e mjaftë që këto shtete të përkufizohen vetëm me kaq; përkundrazi, meqenëse pjesët përbërëse edhe të demokracisë edhe të oligarhisë janë më të shumta, duhet akoma të pohojmë se kemi demokraci kur te ilirët, megjithëse më të pakët, sundojnë mbi shumicën jo të lirë të popullsisë, sikurse ngjan në Apolloni, që është në detin Jon dhe në Therë, (në këto dy qytete ishin të nderuar ata që shquheshin nga fisnikëria dhe që rridhnin nga ata që themeluan së pari kolonitë, megjithëse ishin të pakët ndër të shumtit), por nuk mund ta quajmë demokraci nga ana tjetër, kur sundojnë të pasurit edhe pse janë me shumicë, siç ndodhte në Kolofonë në kohë të vjetra. Atje më të shumtit zotëronin një pasuri të madhe, para se të bëhej lufta me lydët. Por ka demokraci, kur janë zotër të pushtetit të lirët dhe të varfërit, të cilët janë më të shumtë, kurse ka oligarhi, kur sundojnë të pasurit dhe më fisnikët, të cilët janë të pakët...

LIBRI V

1 ... Kushtetura pësoi edhe në Epidamn një ndryshim të pjesshëm; vendin e fylarhëve[2] e zuri bulea[3]. Kurse në helie[4], është e nevojshme akoma që të marrë pjesë paria, kur është rasti për të zgjedhur ndonjë zyrtar. Nga ana tjetër qenia në krye e një arhonti ishte një shprehje e regjimit oligarhik në këtë shtet.

---

[1] Aristoteli i referohet këtu një autori më të vjetër, të quajtur Falea nga Halkedoni, i cili përndryshe nuk njihet.
[2] Kryetar fisi.
[3] Këshilli i qytetit.
[4] Në Athinë Helieja ishte gjyqi i madh popullor, ndërsa në Korinth prej nga rridhnin kolonistët helenë të Dyrrahit, me këtë emër quhej mbledhja e përgjithshme e popullit

4 Në shtetin e Epidamnit për arsye të një martese u shkaktua një trubullirë. Një qytetar kishte fejuar të bijën me një djalosh. I ati i këtij, që ishte një qeveritar, e dënoi me gjobë të jatin e vajzës, i cili duke e ndjerë veten të fyer, ngriti në favor të tij të gjithë ata, që nuk gëzonin të drejta politike.

11 Ato[1] ruhen, në përgjithësi, nga procese të kundërta dhe veçanërisht nga gjithë sa synojnë të pakësojnë pushtetin mbretëror, mbasi autoriteti, sidoqoftë ky, është padyshim më i vazhdueshëm, kur ky shtrihet mbi më pak çështje. Edhe vetë monarhët në këto raste bëhen më pak despotë, i afrohen me sjelljet e tyre më shumë barazisë dhe anojnë më pak në lakmi përkundrejt të nënshtruave të tyre. Kjo ishte arsyeja e qendrimit për një kohë të gjatë të regjimit monarkik tek molosët e lakedemonët...

2. DE ANIMALIUM HISTORIA

(Mbi historinë e kafshëve)

LIBRI II

1,499 b ... Në Iliri dhe në Paioni, sikundër edhe gjetkë, ka derra njëthundrakë...

LIBRI III

20,522 b ... Lopët e Epirit, të mëdhatë japin secila një shtamë e gjysëm nga të dy sisët. Mjelësi qëndron në këmbë, duke u kërrusur pak, sepse nuk mund të arrijë po t'i qendrojë ndenjur. Përveç gomarit, në Epir, rriten edhe kafshë të tjera të trasha, dhe mbi të gjitha qetë dhe qentë. Kafshët e mëdha kanë nevojë për shumë ushqim, por kjo krahinë ka shumë kullota të mira dhe vende të përshtatshme në çdo stinë.
Qetë dhe delet më të mëdha janë ato që quhen pirrike, të cilat e kanë emrin nga mbreti Pirro...

LIBRI VI

18,572 b ... Në kohën e ndërzimit demi kullot me lopët dhe zihet me demat e tjerë; në kohë tjetër sekset rrinë të veçuar; kjo quhet "përbuzja e kopesë", ata, në Epir, shpesh nuk shihen për tre muaj; dhe përgjithësisht të gjitha, ose afërsisht të gjitha kafshët e egra, nuk kullosin bashkë me femrat përpara kohës së ndërzimit...

LIBRI VIII

7,593 b ... Kopetë e bagëtive vuajnë më pak kur lëvizin në ngrica, se sa në dëborë. Ato rriten nëqoftëse veçohen për një kohë të gjatë nga ndërzimi, prandaj barinjtë në Epir i mbajnë kopetë pirrike, si quhen ato, për nëntë vjet pa i ndërzyer që të mund të rriten.
Këtë ata e quajnë apotauri e lopëve. Numuri i këtyre kopeve arrin në katërqind dhe janë pronë e mbretit. Ato nuk rrojnë dot në vend tjetër, megjithëse është bërë një provë e tillë...

---

[1] Më sipër flitet për regjimet monarkike.

28,606 b ... Temperatura gjithashtu ndikon shumë; prandaj në Iliri, Thraki dhe Epir, gomarët janë të vegjël. Në Skythi dhe vendet keltike ata nuk gjenden fare, sepse në këto vende dimri është i ashpër...

LIBRI IX

1,608 a ... Qentë e gjuetisë të Molosisë nuk ndryshojnë aspak nga qentë e vendeve të tjera. Por qentë e kopeve të kësaj krahine ua kalojnë qenve të tjerë si në madhësi, ashtu edhe përsa i përket guximit të tyre, kur përleshen me kafshët e egra. Nga kryqëzimi i qenve molosë me ata lakonë del një lloj qeni që shquhet për guxim e durim...

45,630 a Bonasi gjendet në Paioni, në malin Messap, i cili ndan Paioninë nga Media. Paionët e quajnë monap. Është i madh sa një dem dhe më i rëndë; por nuk është një kafshë e gjatë dhe lëkura e tij kur rripet mund të mbulojë një shtresë ku të ulen shtatë vetë. Në formë i përngjan demit, por ay ka një perçe si të kalit që i arrin gjer te shpatullat, qimja e tij është më e butë e ajo e kalit dhe më e shkurtër. Ngjyra e qimes së tij është e kuqe. Ato janë të trasha e zbresin gjer te sytë dhe kanë një ngjyrë midis së kuqes dhe bojës së hirit jo si ajo e kuajve gështenjë po më e thellë: qimet e tij poshtë janë si lesh. Ato nuk janë as shumë të zeza, as shumë të kuqe.

Zëri i tyre është si ai i kaut. Brirët i kanë të përkulura e të mpleksura, të papërshtatshme për mbrojtje, të gjata një pëllëmbë ose diçka më shumë, aq të trasha sa secili prej tyre mund të mbajë një hemikoe ose diçka më shumë. Pjesa e zezë e brirëve është e mirë dhe e lëmuar. Një tufë flokësh është vendosur në mënyrë të tillë midis të dy syve, sa kafsha duket më mirë anash, se sa përballë. Si kau, ai nuk ka dhëmbë të sipërme përpara, ashtu si nuk kanë edhe kafshët e tjera me brirë. Këmbët i ka të ashpra dhe thundrat e çara. Bishtin të vogël në përpjestim me trupin, si atë të kaut, ai rrëmih tokën me thundrën e tij si demi. Lëkurën e pjesëve të sipërme e ka të fortë. Mishi i tij është një ushqim shumë i mirë dhe për këtë e gjuajnë...

3. DE MIRABILIBUS AUSCULTATIONIBUS

(Mbi mrekullitë e dëgjuara)

832 a,22 Thonë se tek ilirët e quajtur taulantë, bëjnë verë nga mjalti, pasi i shtrydhin hojet *[*mjaltit*]* i hedhin ujë dhe e ziejnë në kazan gjersa të mbetet gjysma. Këtë e hedhin ndër enë prej balte, dhe e lënë gjersa të mbetet gjysma, pastaj lëngun e shtien ndër enë prej druri. Këtu thonë se e lënë të fermentojë për një kohë të gjatë dhe bëhet si verë, dhe bile një verë e ëmbël dhe e fortë. Kurse tani thonë se kjo bëhet edhe në disa vende të Helladës dhe e tillë që nuk ndryshon aspak prej verës së vjetër aq sa ishte e pamundur për kërkuesit që ta dallonin...

833 a,36 Thonë se në Atintani, pranë kufijve të tokave të Apollonisë, ndodhet një shkëmb, nga i cili nuk duket se del zjarr i vërtetë, por ndizet duke i hedhur vaj.

833 b,45 Për Paioninë thonë se kur bien shira të vazhdueshme, në tokën e zbutur gjendet i ashtuquajturi ar i padjegshëm.
Flitet se toka në Paioni është aq e pasur me ar, sa shumë vetë kanë gjetur copa ari më të rënda se një mna. Thonë se janë gjetur edhe i janë dërguar mbretit të atjeshëm dy copë, njëra e rëndë 3 mna dhe tjetra 5 mna.

835 b,75 Thonë se në Epir ka drerë, të cilët duke gërmuar tokën me bririn e djathtë bëjnë gropa; ky bri është i dobishëm për shumë sende.

836 a,79 Në ishullin Diomedea, në detin Adriatik, thonë se gjendet një tempull i Diomedit, i admirueshëm dhe i shenjtë; rrotull tij fluturojnë shpendë të mëdha me sqep shumë të gjatë, të gjerë dhe të fortë; kur vijnë këtu helenët ato rrinë të qeta, ndërsa kur vijnë barbarë, që banojnë aty afër, u fluturojnë rreth e rrotull, ua shqyejnë kokët e tyre me kthetra e sqepa dhe mbasi u shkaktojnë shumë plagë i vdesin. Thonë se dikur këta kanë qenë shokët e Diomedit, që e humbën prijësin e tyre mbas mbytjes së anijes, prijës ky që u vra me dredhi nga Aineu, mbreti i atyre fiseve...

836 b,81 ... Atje /në ishujt Elektride/ gjenden me shumicë plepa, prej të cilëve nxirret ai që ne e quajmë qelibar, në fillim si dyllë, pastaj forcohet si gur. Ky mblidhet prej banorëve dhe dërgohet në Helladë. Prandaj thonë se në këta ishuj erdhi Dedali, i pushtoi dhe në njërën bëri fytyrën e vet, kurse në tjetrën të djalit, Ikarit. Pastaj mbasi e dëbuan pellazgët, të cilët shkatërruan Argon, Dedali iku dhe erdhi në ishullin Ikar.

839 a,104 Përveç kësaj pranë Epirit, burojnë ujëra të nxehta, prandaj ky vend quhet Pyriflegeton. Më kot thonë se mbi këtë vend nuk fluturon asnjë shpend, mbasi dihet se atje ka mjellma me shumicë.

839 b,104 Ndërmjet Mentorisë dhe Istrisë thuhet se gjendet një mal me një majë shumë të lartë, që e quajnë Delfion. Kur memtorët, që banojnë pranë Adriatikut, i ngjiten këtij mali, shikojnë së andejmi anijet që lundrojnë në Detin e Zi. Përveç këtij është edhe një vend tjetër ndërmjet /të dy fiseve/, në tregun e të cilit tregtarë të ardhur nga Deti i Zi shesin verëra nga ishujt Lesbo, Ko dhe Thaso, gjithashtu /sillet verë/ edhe prej atyre të Adriatikut me amfora të Korkyrës.

842 b,127 Në Apolloni, që ndodhet pranë krahinës së taulantëve, thonë se del asfalt dhe pisë si curila që shpërthejnë nga toka; këtu ai del më i zi dhe më i dendur se i Maqedonisë; dhe banorët thonë se jo larg këtij vendi është një zjarr, që qendron i ndezur vazhdimisht dhe zë një sipërfaqe fare të ngushtë, aq sa përfshin një pentakline[1]. Këndej del një erë squfuri dhe nishadri; përreth rritet një bar shumë i lartë dhe ç'është më e çuditshme, jo më larg se katër kut prej andej rriten drurë të lartë...

128 Thuhet se tek ilirët gjëja e gjallë pjell dy herë në vit, dhe më të shumtat bëjnë binjakë, bile shumë tre ose katër keca, disa pesë e më tepër. Përveç kësaj thonë se japin me lehtësi nga tri hemikoe qumësht. Thonë se edhe pulat nuk bëjnë një ve në ditë si në vende të tjera, po pjellin dy ose tri herë në ditë. Thuhet edhe se në Paioni qetë e egër bëhen shumë më të mëdhenj nga të gjithë ata që ndodhen ndër popullsi të tjera, edhe se brirët e tyre nxënë katër koe, bile brirët e disave edhe më shumë.

844 b,138 Thonë se në Iliri, tek fiset e quajtura ardiane, pranë kufirit me autariatët, ndodhet një mal i lartë dhe afër tij një gurrë, nga e cila shpërthen ujë me sasi të madhe, jo në çdo stinë, po vetëm në pranverë. Këtë ujë e marrin dhe ditën e ruajnë në një vend të mbuluar, ndërsa natën e nxjerrin përjashta. Kjo punë bëhet pesë a gjashtë ditë me radhë dhe pastaj uji ngrin e bëhet një kripë shumë e mirë; këtë kripë e mbajnë sidomos për bagëtitë. Së jashtmi nuk sjellin kripë në këto vise, për arsye se janë larg detit dhe nuk përzihen me të tjerët. Kripa u duhet shumë për kafshët, të cilave ua japin dy herë në vit. Në rast se s'ua japin, shumica e bagëtisë ngordh.

---

[1] Afërsisht 10 m^2

POLIBI

Historian i madh grek i lindur në Megalopol të Arkadisë aty nga viti 200 para e. sonë; vdiq mbas vitit 120. Mori pjesë në jetën politike të Greqisë dhe ishte një nga udhëheqësit e Lidhjes së Ahesë. Pas luftës së tretë maqedono-romake Polibi u dërgua si peng në Romë së bashku me njëmijë aheas të tjerë. Njohja me Romën dhe me përfaqësuesit e aristokracisë romake ndikuan në bindjet politike të Polibit: nga kundërshtar i romakëve ai u kthye në përkrahës i flaktë i tyre. Në 150 para e. sonë, pas 16 vjetësh qendrimi në Romë ai fitoi të drejtën të kthehet në atdhe. Por Polibi nuk qendroi shumë në Greqi. Ai u kthye përsëri në Romë ku kishte krijuar lidhje të forta me Scipion Emilianin, më parë si mësues e pastaj edhe si mik i tij. Pas kësaj Polibi ndërmori shumë udhëtime dhe shoqëroi Scipionin në ekspeditat e tij luftarake, gjë që e pasuroi horizontin dhe njohuritë e tij mbi botën e atëhershme.

Polibi është autor i një vepre të madhe historike prej 40 librash, që mban titullin "Historitë". Kjo është e para histori botërore e kohës antike. Në të trajtohet historia e vendeve të pellgut të Mesdheut prej vitit 264 deri në 146 para e. sonë. Vendin kryesor e zenë ngjarjet prej viteve 220-146. Periudha para vitit 220 që trajtohet në dy librat e parë jepet në mënyrë të përmbledhur. Këto libra kanë më tepër karakterin e një hyrje dhe kanë si qëllim të përgatisin lexuesin për të kuptuar ngjarjet që shtjellohen në librat e mëpastajmë. Nga ana tjetër me këto libra Polibi vendos një lidhje midis historisë së tij dhe asaj të Timeut që arrinte tamam deri në vitin 265/4 para e. sonë.

Nga vepra e Polibit janë ruajtur vetëm pesë librat e para; të tjerat janë vetëm në fragmente të mëdha ose të vogla.

Ideja kryesore e Polibit në këtë vepër është nënshtrimi i gjithë popujve të Mesdheut nga romakët. Këtu ai mundohet të provojë se sukseset e romakëve ishin të pashmangshme dhe mirëbërëse për popujt e tjerë, se pushtimet e tyre ishin të drejta, të nevojshme dhe të dëshirueshme nga popullsitë vendase. Në qendër të vëmendjes së Polibit është historia politike. Çështjet e jetës ekonomike e sociale ai i prek kalimthi. Rëndësi të madhe i jep ai rendit politik të vendeve të ndryshme. Polibi preferon një regjim të tillë në të cilin janë kombinuar në mënyrë të arsyeshme format e ndryshme politike. Kësaj forme ideale i avitet, sipas mendimit të tij, rendi shtetëror romak, në të cilin janë kombinuar në mënyrë logjike parimet monarkike, aristokratike e demokratike. Këtu qendron, sipas tij, arsyeja e suksesit të romakëve.

Në veprën e tij Polibi i rendit ngjarjet kronologjikisht, sipas olimpiadave, por meqenëse trajton historinë e vendeve të ndryshme ai detyrohet të kthehet herë mbas here në njerën apo tjetrën datë që ka marrë si pikënisje. Burimet ai i përdor në mënyrë kritike dhe mendimet e tij mundohet t'i mbështesë mbi të dhëna dokumentale. Si detyrë të historisë Polibi quante jo vetëm përshkrimin, por edhe spjegimin e ngjarjeve, shkakun e të cilave ai e shikonte kryesisht në faktorët psikologjikë (ndjenjat e njerëzve).

Pas historisë së "Luftës së Peloponezit" të Thuqididit, vepra e Polibit mund të quhet si më e mira vepër historike e kohës antike.

Për ne vepra e Polibit ka rëndësi të veçantë se në të trajtohen luftat iliro-romake dhe ngjarjet e tjera që u zhvilluan në tokat e Ilirisë në kohën e luftërave maqedono-romake, megjithëse ai, duke u nisur nga pozita zyrtare romake, i trajton këto jo në mënyrë objektive.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Polybii Historiae ed. L. Dindorfio, vol. I-V. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri, 1882-1924

POLYBII

HISTORIAE

(Historitë)

LIBRI I

13... Unë do të filloj sipas rendit kronologjik nga lufta e romakëve me kartagasit për Siqelinë[1]. Pastaj do të vijë lufta e Libisë, që pasohet nga tregimi i veprimeve të zhvilluara në Iberi nga kartagasit me Hamilkarin, pastaj me Hasdrubalin. Është e njëjta kohë kur romakët kaluan për herë të parë në Iliri dhe në këtë pjesë të Evropës...

LIBRI II

2 Në këto kohë[2] romakët vendosën të kalonin, për herë të parë me forca ushtarake, në Iliri dhe në këtë pjesë të Evropës[3]. Ata që duan me të vërtetë të kuptojnë qartë si u rrit dhe si u ndërtua sundimi romak – gjë që është objekt i studimit tonë – duhet sigurisht t'i shqyrtojnë këto ngjarje jo kalimthi, por me vëmendje të veçantë. Ata vendosën ta bëjnë këtë fushatë për këto shkaqe: Agroni, mbreti i ilirëve dhe i biri i Pleuratit, kishte një fuqi detare dhe tokësore shumë më të madhe nga ajo që kishin patur mbretërit e mëparshëm të Ilirisë. Pasi Demetri, i ati i Filipit[4], ia mbushi mendjen me anë të hollash, Agroni i premtoi se do të ndihmonte medionasit, që mbaheshin të rrethuar nga etolët...

3... Natën njëqind anije, me pesëmijë ilirë, lundruan në drejtim të Medionës, dhe iu avitën qytetit[5]. Si u futën në liman, të nesërmen, sapo u gdhi, zbarkuan me të shpejtë, pa zhurmë dhe të rreshtuar në njësi[6], simbas taktikës së tyre të zakonshme, u sulën kundër lëmit të etolëve. Këta, porsa e morën vesh këtë ngjarje, u habitën për sulmin e papritur dhe për guximin e ilirëve; por nga ana tjetër, duke pasur që prej shumë kohësh një mendim të lartë për veten e tyre dhe duke pasur besim në forcat e veta, nuk e humbën, por qendruan prapseprapë me guxim. Kështu, pra, pjesën më të madhe të hoplitëve dhe të kalorisë së tyre e radhitën përpara lëmit, në vendet sheshe; me pjesën tjetër të kalorisë dhe me këmbësorinë e lehtë zunë disa vende që ndodheshin përpara lëmit e që kishin pozita të mira. Por ilirët i ranë, së pari, këmbësorisë së lehtë dhe në saje të numrit më

---

[1] Lufta e parë punike 264-241 para e. sonë.
[2] Rreth vitit 229 para e. sonë.
[3] Në gadishullin e Ballkanit.
[4] Demetri II, mbret i Maqedonisë, i ati i Filipit V.
[5] Viti 231 para e. sonë.
[6] Në origjinal njësia e ilirëve quhet "speira" që është e barabartë me një kohortë d.m.th. me 1/10 e legjionit romak.

të madh e të peshës që kishte rreshtimi i tyre, i shkulën nga vendi të parët, ndërsa kalorët që ishin bashkë me këta, i detyruan të iknin e të bashkoheshin me
6 këmbësorinë e rëndë. Pastaj, që nga kodrat, ilirët u turrën kundër atyre që ishin të rreshtuar në fusha, dhe me të shpejt i thyen e i shpërndanë me ndihmën edhe të medionasve të rrethuar, të cilët njëkohësisht dolën dhe bënë sulmin kundër etolëve.
7 Një numër të madh prej tyre e vranë, një pjesë më të madhe e zunë rob dhe gjithë armët e materiali luftarak ra në duart e ilirëve. Kështu, pra, ilirët, pasi kryen urdhërat
8 që u kishte dhënë mbreti i tyre, ngarkuan plaçkën në anijet dhe menjëherë u nisën për në vendin e tyre.

6 **4...** Mbreti Agron, pasi u kthyen anijet dhe mori vesh nga komandantët ushtarakë rreziqet e luftës, u gëzua aq shumë se i kishte mposhtur etolët, duke menduar se ata ishin shumë mendjemëdhenj, sa që nga gëzimi u dha pas të pirit e pas dëfrimeve të tjera të këtij lloji; mirëpo këto i shkaktuan një të ftohur të rëndë, që në
7 pak ditë e përcolli në varr. Pas vdekjes së Agronit, mbretërinë e trashëgoi e shoqja, Teuta, e cila drejtimin e punëve e ushtronte me miq të besuar. Kjo, me mendjen e saj
8 prej gruaje, duke patur parasysh vetëm fitoren e korrur dhe pa i peshuar fare popujt fqinjë, së pari u dha leje atyre që lundronin të grabitnin çdo anije që do të gjenin
9 përpara; pastaj përgatiti një forcë ushtarake detare jo më të vogël se ajo e para dhe e nisi, duke i porositur prijësit të quanin si armike gjithë anëdetjen.

1 **5** Këta, sulmin e parë e bënë kundër Elidës dhe Mesenisë. Ilirët u binin
2 vazhdimisht në qafë këtyre krahinave, sepse bregdeti i tyre është tepër i gjatë dhe, në anën tjetër, qytetet e tyre kryesore që ishin qendra ushtarake, ishin shumë larg nga deti, e për këtë arsye ndihmat që dërgonin për t'u bërë ballë sulmeve të ilirëve arrinin shumë vonë; prandaj këta pa frikë i sulmonin këto vende vazhdimisht, duke i grabitur
3 e duke i shkretuar. Një ditë iu afruan qytetit Foinike dhe qendruan aty për të marrë
4 ushqime. Aty hynë në bisedime me disa galatë, të cilët ishin afro tetëqind vetë si mercenarë të epirotëve, për të ruajtur qytetin dhe u morën vesh me ta që ta lëshonin Foiniken me tradhëti. Me të vërtetë, ilirët në saje të ndihmës së galatëve nga brenda, me sulmin e parë pushtuan qytetin me gjithë ç'kishte[1]. Epirotët, me të marrë vesh këtë ngjarje, vrapuan shpejt në ndihmë me gjithë fuqitë e tyre. Pasi arritën në Foinike,
5 e ngritën lëmin buzë lumit, i cili rrjedh pranë qytetit, që ta kishin si mburojë dhe, për t'u siguruar, shkulën drurët e urës që ishte mbi lum. Në këtë e sipër, me që morën vesh se Skerdilaidi me pesëmij ilirë vinte kundër tyre nëpër tokë, duke kapërcyer
6 ngushticat e Antigonesë, dërguan një pjesë të fuqive për ta mbrojtur këtë qytet, por ata vetë me fuqitë e tjera e kalonin kohën të çkujdesur, duke marrë lirisht ushqime nga vendi e duke e lënë pas dore rojën e lëmit. Ilirët, pasi morën vesh se armiku i
7 kishte shpërndarë fuqitë dhe ishte i çkujdesur, u nisën natën kundër tij; pasi vendosën drurët mbi urë, kaluan lumin pa pësuar gjë dhe zunë një vend të fortë, ku qëndruan gjersa u gdhi. Me t'u gdhirë, të dy ushtritë u përleshën përpara qytetit; epirotët u
8 mundën, shumë mbetën të vrarë dhe më shumë u zunë robër, të tjerët ikën dhe shkuan tek atintanët.

1 **6** Epirotët, pas këtij dështimi, humbën çdo shpresë në fuqitë e veta dhe dërguan
2 delegatë tek etolët dhe tek fisi i ahejve, për t'iu lutur që t'u dërgonin ndihmë. Këta u prekën me të vërtetë nga fatkeqësitë e epirotëve

[1] Viti 230.

dhe menjëherë arritën në Helikranon për ndihmë. Nga ana e tyre edhe ilirët që pushtuan Foiniken erdhën po në këtë vend së bashku me Skerdilaidin, dhe në fillim u radhitën pranë atyre që kishin ardhur në ndihmë, duke pasur dëshirë të përleshen. Mirëpo, meqenëse pengoheshin nga ngushtica e vendit dhe, nga ana tjetër, kishin marrë letra nga Teuta që të ktheheshin sa më parë, mbasi një pjesë e ilirëve ishin shkëputur dhe ishin hedhur nga ana e dardanëve, bënë një armëpushim me epirotët, pasi u kishin shkretuar dhe grabitur vendin. Në bazë të këtij armëpushimi, qytetin dhe robërit që ishin qytetarë të lirë, ua kthyen epirotëve kundrejt një pagese si shpërblim, ndërsa skllevërit dhe gjithë plaçkën i ngarkuan në anijet e tyre, pastaj disa u kthyen nëpër det, ndërsa ata që ishin nën komandën e Skerdilaidit u kthyen nëpër tokë, duke kaluar përsëri nga ngushticat e Antigonesë. Kjo fushatë e ilirëve i habiti dhe u kalli tmerr helenëve që banonin gjatë bregdetit. Këta, kur panë se qyteti më i fortifikuar dhe më i fuqishëm i Epirit u shkatërrua dhe u shkretua në një mënyrë të pabesueshme, s'kishin më frikë vetëm për të ardhurat e tyre, si gjer tani, po edhe për vehten dhe për qytetet e tyre. Epirotët, si shpëtuan në mënyrë të papritur jo vetëm nuk menduan t'ua merrnin hakun keqbërësve, ose t'u shfaqnin mirënjohjen atyre që u erdhën në ndihmë, po përkundrazi, dërguan delegatë te Teuta dhe, bashkë me akarnanët, bënë aleancë me ilirët, duke marrë përsipër t'u ndihmonin këtyre të fundit që tani e tutje dhe të jenë armiq me ahejt dhe etolët. Me këto provuan qartë se ishin jo vetëm të pazotë të mendohen që në krye për punët e tyre, po ishin edhe bashkëshkelës ndaj mirëbërësve të tyre.

7... Në të tilla duar ata */epirotët/* e kishin lënë një qytet kaq të pasur[1].

8 Ilirët edhe në kohët e kaluara u binin pa pushim më qafë tregtarëve italikë, por sulmet e piraterisë i shtuan më tepër kur ndodheshin në Foinike. Atëherë një pjesë e flotës ilire u shkëput dhe u turr në det kundër tregtarëve italikë, disa prej të cilëve i grabitën, disa i vranë dhe jo pak prej tyre i morën robër. Romakët, në krye, nuk ia vinin veshin ankimeve që bënin tregtarët kundër ilirëve, po më vonë, kur panë se këto qarje sa vinin e po bëheshin më të dendura, atëherë dërguan për këtë punë në Iliri dy delegatë Gain dhe Leuk Koronganin. Teuta, kur u kthyen anijet nga Epiri, u habit tepër me plaçkën e shumtë si dhe me bukurinë e saj, se me të vërtetë Foinike atëherë shquhej si më i pasuri midis qyteteve të Epirit; prandaj iu shtua edhe një herë aq dëshira për t'u rënë më qafë helenëve. Po atëherë u përmbajt për pak kohë, për shkak të trazirave të brendshme; si i rregulloi shpejt punët me ilirët, që ishin shkëputur, rrethoi Isën, sepse vetëm ajo akoma nuk po i bindej asaj. Pikërisht në këtë kohë arritën delegatët e Romës, të cilët si u pranuan prej Teutës, parashtruan ankimet e tyre për padrejtësitë që u ishin bërë. Teuta, me mburrje e krenari, dëgjoi gjer në fund qarjet e romakëve. Pasi mbaruan këta, tha se do të përpiqej të kujdesej që romakët mos të pësonin ndonjë padrejtësi nga ilirët, por mbretërit nuk i lejonte zakoni që të ndalonin ilirët të përfitonin në mënyrë private nga të mirat e detit. Atëherë delegati më i ri, i zemëruar nga këto fjalë të mbretëreshës, iu përgjigj me një guxim që ishte për t'u lavdëruar në vetvete, po që nuk i përshtatej aspak kohës: "Romakët, o Teutë, kanë një zakon shumë të mirë që padrejtësitë private i ndjekin publikisht dhe u ndihmojnë atyre që dëmtohen padrejtësisht. Dhe do të përpiqemi që, po të dojë Zoti, për së shpejti të të detyrojmë të ndreqësh zakonet mbretërore të ilirëve". Teuta

[1] Në këtë kapitull Polibi mundohet të argumentojë se galatët si mercenarë gjithmonë kanë tradhëtuar padronët e tyre, prandaj dorëzuan edhe Foinikën.

e priti këtë përgjigje të romakut pa e peshuar dhe me gjaknxehtësi, sjellje që i përshtatet krejt natyrës së gruas; u ndez aq shumë sa, duke harruar çdo të drejtë njerëzore, dërgoi njerëz t'i ndjekin delegatët e të vrasin atë që kishte guxuar të fliste në atë mënyrë përpara saj. Romakët, kur mësuan këtë ngjarje të shëmtuar, u zemëruan shumë me sjelljen e paligjshme të gruas, filluan menjëherë përgatitjet, mblodhën ushtarët dhe iu përveshën përgatitjes së flotës.

9 Teuta, me të ardhur pranvera[1)], pasi ndërtoi anije akoma më shumë se përpara, i dërgoi përsëri në viset e Helladës. Një pjesë e këtyre anijeve u nis drejt për Kerkyrë, ndërsa pjesa tjetër qendruan në limanin e Epidamnit me shkakun se gjoja do të merrnin ujë dhe ushqime, po në të vërtetë për të pushtuar qytetin me dredhi. Meqenëse epidamnasit i pranuan pa të keq dhe në mënyrë të shkujdesur, ata hynë të paarmatosur, si për të mbushur ujë, duke patur thika të fshehura brenda në enët e tyre, dhe në këtë mënyrë, pasi therën ata që ruanin portën, u bënë shpejt zotër të hyrjes. Menjëherë arriti sipas marrëveshjes,ndihma e dërguar nga anijet dhe bashkë me këta pushtuan lehtë e shpejt pjesën më të madhe të mureve të qytetit. Por meqenëse banorët e qytetit, megjithëse të papërgatitur për këtë ngjarje të papandehur, vrapuan me të shpejtë për ndihmë dhe luftuan me guxim, ngjau që më në fund ilirët, megjithë qëndresën e tyre të gjatë, u dëbuan nga qyteti. Kështu, pra, epidamnasit në këtë rast, nga shkaku i pakujdesisë së tyre, u rrezikuan të humbnin atdheun, po në anën tjetër, në saje të trimërisë dhe të guximit të tyre, morën një mësim të mirë për të ardhmen pa u dëmtuar fare. Sa për ilirët, prijësat e tyre dolën menjëherë në det të hapët dhe, si u bashkuan me të parët, u drejtuan tok për në Kerkyrë. Këtu zbarkuan, duke u kallur frikën të gjithëve, dhe ndërmorën rrethimin e qytetit. Kerkyrasit, të dëshpëruar fare, dërguan delegatë tek etolët dhe ahejtë, njëkohësisht erdhën edhe delegatë nga Epidamni dhe nga Apollonia dhe bashkë me ata të Kerkyrës, iu lutën të dërgonin ndihma sa më parë dhe të mos i linin qytetet e tyre të shkatërroheshin nga ilirët. Etolët dhe ahejtë i dëgjuan dhe i pranuan me dashamirësi lutjet e delegatëve. Menjëherë vendosën të dërgojnë aty-për-aty dhjetë anijet e përgatitura të ahejve; në pak ditë ata u bënë gati dhe u nisën për në Kerkyrë, duke shpresuar se do të mund të shpërndanin rrethimin.

10 Ilirët, si morën edhe shtatë anijet e armatosura që u dërguan akarnanët sipas marrëveshjes, dolën për t'i pritur ahejtë dhe u përleshën me këta afër ishullit Paksos. Gjatë këtij luftimi anijet e akarnanëve dhe ato të ahejve që ishin radhitur kundrejt tyre, luftuan pa përfundim, duke mos u dëmtuar fare, përveç plagësh të vogla që morën disa nga detarët. Ilirët atëherë u vërsulën me anijet e tyre të lidhura nga katër dhe u përleshën me armiqtë. Ilirët pa u kujdesur fare për anijet e tyre, i kthyen këto anash dhe ndihmonin kështu sulmin e armiqve. Anijet e kundërshtarëve u ndeshën aq fort, sa mezi mund të lëviznin, mbasi ishin futur në mes sqepave të anijeve të lidhura bashkë. Atëherë ilirët, duke u hedhur mbi urat e anijeve të ahejve, i pushtuan ato për shkak të epërsisë së tyre në njerëz. Në këtë mënyrë zunë katër anije me nga katër sërë lopata, kurse një tjetër me pesë sërë lopatash e mbytën me gjithë burrat e saj... Në këtë kohë, ata që luftonin kundër arkananëve, duke parë se ilirët kishin fituar, i kthyen anijet dhe në saje të shpejtësisë në të lundruar dhe të një ere të favorshme, mundën të iknin e të arrinin të sigurtë në vendin e tyre. Ilirët, krenarë për fitoren e tyre, e kryen, pas

[1)] Viti 229 para e. sonë.

kësaj, rrethimin me lehtësi e guxim. Kerkyrasit, të dëshpëruar nga zhvillimi i ngjarjeve, pasi i qendruan për një kohë të shkurtër rrethimit u morën vesh me ilirët, duke pranuar një garnizon të tyre dhe bashkë me të edhe Demetër Farin. Pastaj menjëherë prijësat e ilirëve dolën në detin e hapur; pasi iu afruan Epidamnit, vendosën përsëri ta rrethojnë qytetin.

11 Po në këto kohë[1)], ata që kishin në dorë pushtetin më të lartë në Romë Gnej Fulvi dhe Aul Postumi, dolën nga kryeqyteti i Italisë, i pari me dyqind anije dhe i dyti në krye të fuqive tokësore. Qëllimi i parë i Fulvit ishte të lundronte në drejtim të Kerkyrës, se besonte të arrinte aty, pa u dorëzuar akoma qyteti. Dhe megjithëse u vonua, prapë vendosi të shkonte në këtë ishull për dy arsye: e para, që të mësonte me hollësi se ç'kishte ngjarë në qytet dhe, e dyta, që të kuptonte në se ishin të vërteta lajmet e dërguara nga Demetri. Demetri, të cilit i bënin shpifje dhe kishte frikë nga Teuta, dërgonte në Romë njerëz, duke u premtuar t'u dorëzonte qytetin me çdo gjë që kishte në zotërimin e tij. Kerkyrasit i pritën me gëzim romakët dhe në marrëveshje me Demetrin, ua dorëzuan atyre garnizonin ilir, dhe ata vetë, njëzëri, vendosën të vihen nën mbrojtjen e Romës, duke menduar se ky ishte i vetmi mjet për të shpëtuar, paskëtaj, nga padrejtësistë e ilirëve. Romakët, si u lidhën me miqësi me kerkyrasit, u nisën kundër Apollonisë, duke pasur me vete edhe Demetrin si udhëheqës për zgjidhjen e çështjeve të tjera. Po në këtë kohë edhe Postumi u nis nga Brendesi me njëzetmijë këmbësorë dhe pothuaj dymijë kalorës. Të dy ushtritë arritën në Apolloni, e cila i priti edhe ajo me gëzim dhe u vu nën mbrojtjen e tyre; menjëherë pastaj u nisën për Epidamn, për të cilin dëgjonin se ishte rrethuar. Ilirët si morën vesh arritjen e romakëve, hoqën dorë nga rrethimi dhe ikën me të shpejtë. Romakët si morën nën mbrojtjen e tyre dhe epidamnasit, u nisën për në viset e brendshme të Ilirisë, duke nënshtruar njëkohësisht ardianët. Si u bashkuan me ta edhe parthinët dhe atintanët, që dërguan delegatë për t'iu nënshtruar me dashje romakëve, këta i morën në miqësinë e tyre dhe pa vonesë u nisën për Isa, se këtë qytet e mbanin të rrethuar ilirët. Si arritën këtu, shpërndanë rrethimin dhe morën edhe isasit nën mbrojtjen e tyre. Pastaj, duke lundruar anës detit, pushtuan me forcë disa qytete të Ilirisë, midis të cilëve edhe Nutrian; këtu humbën jo vetëm shumë ushtarë, po edhe disa hiliarhë bashkë me tamijas-in. Gjithashtu zunë edhe njëzet anije që po transportonin nga vendi plaçkë lufte. Nga ilirët që rrethonin Isën, një palë me ndërhyrjen e Demetrit qendruan në ishullin Far, pa pësuar të keqe prej romakëve, ndërsa gjithë të tjerët u shpërndanë dhe kërkuan strehim në qytetin Arbon. Sa për Teutën, iku me një fuqi tepër të vogël dhe u fut në Rizon, një qytet i vogël, po i fortifikuar mirë, larg detit, afër lumit që quhej edhe ky Rizon. Konsujt pastaj si shtuan me anën e këtyre fitoreve fuqinë e Demetrit dhe numrin e të nënshtruarve të tij, u nisën për Epidamn me flotën e me fuqitë e tyre tokësore.

12 Gnej Fulvi u kthye në Romë, duke marrë me vete pjesën më të madhe të fuqive tokësore dhe detare; Postumi që mbeti në Iliri me dyzet anije, rekrutoi ushtarë në qytetet, që ishin rreth e rrotull dhe vendosi të kalojë aty dimrin, për të vigjëluar mbi fisin e ardianëve dhe gjithë ato fise të tjera që e kishin vënë veten nën mbrojtjen e romakëve. Kur erdhi pranvera, Teuta dërgoi delegatë në Romë dhe bëri paqë me këto kushte: "T'u paguante romakëve tributin që kishin kërkuar, të hiqej nga gjithë Iliria, duke mbajtur vetëm disa vende dhe gjë që kishte rëndësi të veçantë për helenët

[1)] Prapë në vitin 229 para e. sonë.

– të mos lundronte paskëtaj përtej Lisit me më shumë se dy anije, po edhe këto të
4 ishin të paarmatosura. Pasi u kryen këto, Postumi dërgoi më vonë delegatë tek etolët
dhe tek fisi i ahejve. Këta, me të arritur, së pari u shpjeguan arsyet e luftës dhe të
ndërhyrjes së tyre në Iliri dhe, në vazhdim të këtyre, u treguan hollësisht ngjarjet dhe
5 u lexuan kushtet e paqes që bënë me ilirët. Si u pritën dhe u përcollën me nderime
dhe me dashuri nga ana e popullsive në fjalë, u nisën përsëri për në Kerkyrë, pasi i
6 liruan helenët nga një frikë e madhe me anë të traktatit të përmendur sipër; se në këtë
7 kohë ilirët ishin armiq jo vetëm me disa, por me të gjithë. Ja pra, këto kanë qenë
shkaqet e ndërhyrjes së parë ushtarake të romakëve në Iliri dhe në këtë pjesë të
Evropës, si edhe shkaqet që lidhën marrëdhënie me Helladën me anë delegatësh. Pas
8 kësaj, romakët menjëherë dërguan delegatë të tyre në Korinth dhe në Athinë,
pikërisht kur korinthasit për herë të parë, pranuan që romakët të marrin pjesë në
lojërat istmike.

1 **65** Kur erdhi vera maqedonët dhe ahejtë e lanë fushimin e tyre dimëror.
Antigoni[1] u vu në krye të tyre dhe marshoi mbi Lakoninë me ushtarët e tij dhe me
2 aleatët. Ai kishte si trupa maqedone një falangë të përbërë nga dhjetëmijë vetë, një
njësi këmbësorie të lehtë prej tremijë vetësh, një njësi kalorie prej treqind vetësh;
pastaj vinin njëmijë agriej[2] dhe po kaq galatë, një njësi mercenarësh që përbëhej nga
tremijë këmbësorë dhe treqind kalorës, një njësi këmbësorësh ahej e formuar nga
3 tremijë burra të zgjedhur dhe treqind kalorës të tyre, njëmijë megalopolitë, të
armatosur si maqedonët dhe të komanduar nga bashkatdhetari i tyre Kerkida; aleatët
4 përbëheshin nga dymijë këmbësorë dhe dyqind kalorës beotë, njëmijë këmbësorë dhe
pesëdhjetë kalorës epirotë, po kaq akarnanë dhe më në fund njëmijë e gjashtëqind
ilirë të komanduar nga Demetër Fari; gjithsejt arrinin afërsisht në njëzet e tetë mijë
5 këmbësorë dhe njëmijë e dyqind kalorës. Kleomeni e priste këtë invadim; ai vuri roje
6 në të gjitha qafat që i kishte fortifikuar me hendeqe dhe pemë të prera; përsa i përket
atij, ai fushoi me ushtrinë e tij që arrinte afërsisht në njëzetmijë njerëz, në një vend të
quajtur Selasi[3]...

7 **70** Antigoni hyri në Spartë pa vështirësi. I trajtoi lakedemonët me fisnikëri të
1 madhe e butësi; vuri në vend regjimin e stërgjyshërve, pastaj, pas disa ditëve, ai u
largua nga qyteti me gjithë ushtrinë e tij, mbasi i kishte ardhur lajmi që ilirët kishin
pushtuar Maqedoninë dhe po shkretonin vendin.
... U kthye me shpejtësi të madhe në Maqedoni, ku i zuri në befasi ilirët, luftoi me ta
6 dhe i mundi...

LIBRI III

1 **16** Senati, duke parashikuar se kjo luftë[4] do të ishte e vështirë, e gjatë dhe do të
zhvillohej larg Romës, vendosi të rregullonte më parë punët në Iliri. Se këtu ja se
2 ç'ngjiste në këtë kohë: Demetër Fari jo vetëm kishte harruar të mirat që i kishin bërë
romakët, po edhe i kishte përbuzur, duke përfituar nga frika që i kishte zënë ata nga
galatët, më parë, dhe tashti në fund nga kartagasit. Demetri pra, duke patur gjithë
3 shpresën te oborri i Maqedonisë – se i kishte ndihmuar mbretit Antigon dhe kishte
marrë pjesë në luftën kundër Kleomenit – nisi të grabiste dhe të shkatërronte qytetet

[1] Antigon Dosoni (229-221 para e. sonë).
[2] Populsi jo greke në Etoli.
[3] Fshat në Lakoni.
[4] Lufta e dytë me Kartagën.

e Ilirisë që kishin hyrë nën mbrojtjen e romakëve dhe të lundronte përtej Lisit kundër traktatit, me pesëdhjetë anije, dhe të grabiste shumë nga ishujt Kyklade. Duke parë pra, romakët, këto ngjarje dhe, nga ana tjetër, duke kuptuar rritjen e fuqisë së mbretërisë maqedone, po shpejtonin të siguronin pozitat e tyre në lindje të Italisë; ata ishin të bindur se, para se të shpallej lufta në perëndim, do t'ja dilnin t'i bënin ilirët të pendoheshin për gabimet e tyre, si edhe të qortonin e të dënonin mosmirënjohjen dhe guximin e tepruar të Demetrit. Por u gënjyen në llogaritë e tyre, sepse Hanibali veproi më shpejt, duke pushtuar qytetin e zakanthëve. Në këtë mënyrë lufta u zhvillua jo në Iberi, po në pragun e Romës dhe në gjithë Italinë.

Megjithëkëtë, romakët, duke u nisur nga arsyet që thamë më sipër, dërguan Luc Emilin me ushtrinë për të vepruar në Iliri në pranverë të vitit të parë të njëqind e dyzetës olimpiadë[1].

18 Në këtë kohë Demetri, kur mori vesh qëllimet e romakëve, menjëherë dërgoi në Dimal një roje të mjaftueshme me pajisjet e nevojshme, ndërsa në qytetet e tjera kundërshtarët i vrau dhe pushtetin ua dorëzoi miqve të tij. Ai vetë zgjodhi pastaj, nga të nënshtruarit e tij, gjashtëmijë vetë me triměri të sprovuar dhe i vuri si roje të Farit. Komandanti romak, kur arriti me ushtri në Iliri, vuri re se armiqtë mburreshin me fortifikimin dhe pajisjen e Dimalit që pandehej si një qytet që s'e merrte dot dora e armikut, prandaj vendosi t'i bjerë Dimalit më parë, me qëllim që t'i hutonte armiqtë. Si u foli dhe i nxiti komandantët me radhë dhe mbasi vendosi në shumë vende mjetet e sulmit, filloi të rrethonte qytetin. Dhe pasi e pushtoi atë me forcë brenda shtatë ditëve, i mposhti shpirtërisht menjëherë të gjithë kundërshtarët. Prandaj menjëherë filluan të vinin njerëz nga të gjitha qytetet për t'ia besuar dhe dorëzuar veten romakëve. Ai, si i pranoi këta, secilin me kushte të arsyeshme, menjëherë pastaj lundroi për në Far, kundër Demetrit vetë. Pasi mori vesh se qyteti ishte i fortifikuar dhe se atje ishte grumbulluar një numër i madh burrash të zgjedhur, dhe përveç këtyre, se ishte furnizuar mirë me ushqime dhe me pajisjet e tjera që kërkonte lufta, dyshonte se mos rrethimi i tij zgjaste shumë dhe bëhej i vështirë; prandaj, duke i parashikuar të gjitha këto, përdori një taktikë të tillë që i përshtatej rastit: Pasi lundroi natën drejt ishullit me tërë ushtrinë, pjesën më të madhe të fuqisë e zbarkoi për ta fshehur në disa vende të pyllëzuara dhe gryka. Ai vetë, me t'u gdhirë, lundroi haptazi me njëzet anije kundër limanit që ishte fare afër qytetit. Duke parë anijet dhe duke përbuzur numrin, njerëzit e Demetrit dolën nga qyteti dhe vrapuan në liman, për të ndaluar zbarkimin e armikut.

19 Porsa arritën fare afër, u ndez një përleshje e fortë midis dy palëve; ata të qytetit vraponin vazhdimisht në ndihmë, gjersa dolën të gjithë dhe u futën në zjarrin e betejës. Nga ana tjetër, ata nga romakët që kishin zbarkuar natën arritën në këtë kohë, duke kaluar përmes vendesh të fshehta. Si zunë një kodër të fortë ndërmjet qytetit dhe limanit ua prenë udhën atyre që kishin dalë prej qytetit për ndihmë. Në këtë kohë Demetri me të vetët me të parë këtë lëvizje të armikut, hoqi dorë nga sulmet kundër zbarkimit të romakëve, mblodhi ushtarët, u dha zemër dhe u turr, i vendosur të matet në luftë me ushtritë armike, kundër atyre që kishin zënë kodrën. Romakët, si panë se ilirët po sulmonin me guxim e të rreshtuar mirë, u vërsulën edhe këta kundër radhëve të armikut, me një triměri të jashtëzakonëshme. Në këtë e sipër, romakët që kishin

[1] D.m.th. në vitin 219 para e. sonë.

zbritur nga anijet, me të parë gjendjen, i ranë armikut që prapa, duke sulmuar nga të
7 gjitha anët; ata u shkaktuan ilirëve turbullim dhe pështjellim të madh. Në këtë
mënyrë, duke luftuar përpara e prapa, njerëzit e Demetrit më në fund u thyen. Disa
8 morën rrugën për qytet, kurse shumica u shpërnda rrugë pa rrugë, në të katër anët e
ishullit. Demetri atëherë u tërhoq në anijet, të cilat qendronin në disa vende të
9 pabanuara, gati për çdo rast. Mbi këto anije hypi dhe u nis natën dhe, pa e pritur njeri
10 këtë gjë, arriti te mbreti Filip[1], ku e kaloi pjesën tjetër të jetës së tij. Ky ka qenë njeri
me guxim e trimëri, por guxim të verbër e pa pikë gjykimi. Prandaj edhe vdekjen e
pat të ngjashme me karakterin që pati gjithë jetën e tij. Në marrëveshje me Filipin, u
12 mundua të pushtonte qytetin e mesenëvet; po sulmi i tij ka qenë aq pa mend, sa në
mes të betejës u vra me armë në dorë; po për këto do të flasim më gjatë në kohën e
vendin e duhur. Komandanti romak, Emili, nga ana e tij, menjëherë e sulmoi Farin, e
pushtoi dhe e shkatërroi; pushtoi pastaj edhe krahinat e tjera të Ilirisë, i rregulloi
punët ashtu siç dëshironte vetë dhe nga fundi i verës u kthye në Romë, ku hyri me
triumf e shkëlqim të rrallë.

1 **25** Gjatë fushatës së Pirros romakët lidhën edhe një marrëveshje me kartagasit,
2 e fundit /kjo/ para luftës së Siqelisë. Ajo përmbante të gjitha pikat e marrëveshjeve të
3 mëparshme, por i shtohej edhe kjo: "Nëqoftëse njeri ose tjetri nga të dy shtetet bënte
aleancë me Pirron ai duhej të shënonte me shkrim këtë kusht: do t'u lejohej të
4 ndihmonin njëri-tjetrin, nëqoftëse njëri nga të dy sulmohej në vendin e tij; cilido
qoftë nga të dy që do të kishte nevojë për këtë ndihmë i takonte Kartagës ta
furnizonte me anije si transporti,ashtu edhe lufte, por secili vend mbante trupat me
5 shpenzimet e veta. Kartagasit do t'u shkonin në ndihmë romakëve, qoftë edhe në det,
në rast nevoje, por detarët nuk do të detyroheshin kurrë të zbritnin në tokë nëqoftëse
ata e kundërshtonin një gjë të tillë".

LIBRI IV

1 **5** Etolët kishin atëherë për strateg një farë Aristoni. Meqenëse, për shkak të
paaftësisë fizike nuk ishte në gjendje të qendronte në krye të ushtrisë dhe meqë ishte
farefis i Dorimahut dhe Skopës, gjeti mënyrën si të heqë dorë nga komanda në dobi të
2 këtij të fundit. Dorimahu nuk guxonte t'i shtynte haptas etolët që t'u shpallnin luftë
mesenasve; ai nuk mund të paraqiste asnjë shkak serioz, sepse gjithë bota e dinin se
ai nuk kishte kundër tyre asnjë ankim tjetër veç krimeve të veta dhe sarkazmës, që
3 përdorte. Ai hoqi dorë, pra, nga ky projekt, shkoi vetë tek Skopa dhe u përpoq ta
bindte të bashkohej me mendimet e tija luftarake kundrejt mesenasve. Ai u mundua t'i
4 provojë, se nuk kishte asgjë për t'u frikësuar prej maqedonëve, për shkak të moshës së
mbretit të tyre (Filipi nuk ishte atëherë më shumë se 17 vjeç); ai i kujtoi edhe ndjenjat
armiqësore të lakedemonëve ndaj mesenasve; marrëdhëniet e mira dhe besëlidhjen që
5 bashkonin elejtë /me etolët/; nga këto nxori përfundimin se mund të invadohej pa
rrezik Mesenia. Ai i kujtoi, njëkohësisht, për ta nxitur, plaçkën që do të mund të
bënte në këtë vend, i cili nuk e prêt këtë sulm dhe që në gjithë Peloponezin vetëm ai
6 ka mbetur i padëmtuar gjatë luftërave të Kleomenit. Ai i shtoi më në fund se kjo
ekspeditë do t'i bënte të fitonin simpatinë e gjithë popullit etol; se në rast se ahejtë do
7 t'u refuzonin kalimin, atëherë më kot do të ankoheshin për përdorimin e forcës

[1] Mbreti Filipi V i Maqedonisë.

kundër tyre; dhe nëqoftëse ata do të qendronin të qetë, nuk do të gjenin asnjë pengesë
8 nga kjo anë. Nuk do të mungonte preteksti për të sulmuar mesenasit, të cilët prej kohësh ishin shpallur armiq të ahejve dhe maqedonëve, duke u premtuar këtyre të
9 fundit aleancë. Duke i paraqitur këto arsye, si dhe të tjera të këtij lloji dhe të kësaj rëndësie, Dorimahu i ndezi Skopën dhe miqtë e tij në një mënyrë të tillë që pa pritur mbledhjen e popullit, pa u këshilluar me zyrtarët e tjerë, pa respektuar asnjë nga format e rregullshme, duke u tërhequr vetëm nga pasioni, dhe me autoritetin e tyre
10 filluan veprimet armiqësore njëkohësisht kundër mesenasve, epirotëve, ahejve, akarnanëve dhe maqedonëve.

1 **6** Ata dërguan menjëherë piratë, të cilët duke hasur pranë Kytherës një anije që i përkiste mbretit të Maqedonisë, e morën bashkë me ekuipazhin e saj në Etoli dhe e
2 shitën që nga komandanti e detarët e deri tek anija. Pastaj ata shkretuan bregdetin e Epirit, duke marrë hua për këtë inkursion anijet e Kefalenisë...

1 **9** Kur trupat u pajisën dhe u mblodhën në Megalopol, ashtu siç e kishin
2 vendosur ahejtë – sepse këtu e ndërpremë më parë – mesenasit erdhën prapë e u lutën që të mos i linin në mëshirën e një armiku që shkelte kaq haptas traktatet. Ata bile kërkuan të hynin në konfederatë dhe të ishin anëtarë me të drejta të barabarta, sikurse
3 edhe popujt e tjerë. Por kryetarët e ahejve kundërshtuan, duke thënë se ishte e pamundur për ta të pranonin këdo qoftë pa u këshilluar me Filipin dhe me aleatët e tyre të tjerë. Në të vërtetë asnjë prej aleatëve nuk e kishte denoncuar paktin që
4 Antigoni kishte përfunduar, gjatë luftës së Kleomenit, midis ahejve, epirotëve, fokidasve, maqedonëve, beotëve, akarnanëve dhe thesalëve...

1 **15** Përfundimi i këtyre bisedimeve qe ky: ahejtë do të dërgonin delegacione në
2 Epir, Beoti, Fokidë, Akarnani dhe tek Filipi për të paraqitur shkeljen e traktateve dhe invadimin me armë të Ahesë për të cilën etolët ishin tashmë dy herë fajtorë, për t'u kërkuar gjithë këtyre fuqive ndihmë, sipas marrëveshjeve dhe për t'iu lutur që të pranonin mesenasit në aleancë...

1 **16** Epirotët dhe mbreti Filip, pasi dëgjuan fjalët e delegatëve, i pranuan
2 mesenasit në aleancën e tyre. Aty për aty ata u zemëruan shumë me sjelljen e keqe të etolëve; por kjo nuk zgjati shumë, sepse nuk ishte e papritur për ta; veprime të tilla ishin të zakonshme për etolët. Prandaj, u zbutën dhe vendosën të mos e prishnin
3 paqen. Në anën tjetër lakedemonët meqenëse tashti shpejt e kishin fituar lirinë, në
5 saje të përkrahjes së Antigonit dhe të ndërhyrjes bujare të ahejve, e quanin për detyrë të mos bënin asgjë kundër maqedonëve dhe Filipit, prandaj dërguan fshehurazi tek etolët një përfaqësi dhe përfunduan me ta një pakt të fshehtë aleance dhe miqësie.

Në kohën kur rinia e ahejve ishte zgjedhur dhe përgatitur për ndihmën, që do t'u
6 dërgohej lakedemonëve dhe mesenasve, Skerdilaidi së bashku me Demetër Farin u nisën nga bregdeti i Ilirisë me nëntëdhjetë anije, kaluan përtej Lisit, në kundërshtim me marrëveshjen që kishin me romakët[1]. Ata zbarkuan në fillim në Pylos dhe
7 sulmuan këtë vend[2], por pa sukses. Pas kësaj Demetër Fari, mori me vete pesëdhjetë nga këto anije, sulmoi ishujt Kyklade dhe duke u sjellë rreth tyre, disave u mori para, disa i shkretoi.

---

[1] Shih libri II, 12.

[2] Viti 220 para e. sonë.

9 Gjatë kësaj kohe Skerdilaidi, duke u kthyer për në Iliri, qendroi në Naupakt me të dyzet anijet, i ftuar prej Amynës, mbretit të athamanëve që e kishte të tijin. Këtu, me
10 ndërmjetësinë e një farë Agelau, u mor vesh me etolët për ndarjen e plaçkës së luftës dhe mori përsipër t'u ndihmonte etolëve në veprimet e tyre kundër Ahesë. Kur
11 Agelau, Dorimahu dhe Skopa e lidhën këtë marrëveshje me Skerdilaidin, shtinë në dorë qytetin Kynethë, ngritën gjithë etolët dhe bashkë me ilirët u futën në Ahe.

7 **19...** Taurioni ishte lajmëruar për inkursionin e etolëve dhe për gjithë ato që kishin ndodhur në Kynethë; në të njëjtën kohë ai mësoi se Demeter Fari, duke u kthyer nga Kykladet, kishte zbarkuar në Kenkre[1]; ai iu lut këtij /Demetrit/ të kishte mirësinë të ndihmonte ahejtë, të kalonte anijet e tij nëpër istmë dhe të godiste në
8 befasi etolët, gjatë kalimit të tyre. Demetri kishte bërë një plaçkë të madhe në ishujt, por ai kthehej në kushte pak të nderuara, i ndjekur këmba këmbës nga rodasit; ai i dëgjoi, pra, me kënaqësi propozimet që iu bënë, aq më tepër që Taurioni merrte
9 përsipër shpenzimet e transportit të anijeve nëpër tokë. Ai përshkoi istmin, por arriti dy ditë pas kalimit të etolëve; u mjaftua, atëherë, të plaçkiste disa pika të bregdetit, pastaj u kthye në Korinth.

1 **25** Ai /Filipi V/ priti, në Korinth, delegatët e shteteve aleate dhe u këshillua me
2 ta mbi masat që duheshin marrë kundër etolëve. Beotët i akuzonin /etolët/ se kishin dhunuar në kohën e paqes, tempullin e Athinasë Itone, fokidasit, se kishin bërë një
3 ekspeditë kundër Ambrysës dhe Daulit[2] për t'i pushtuar këto qytete, epirotët se u kishin shkretuar vendin e tyre. Akarnanët vinin në dukje se si ata /etolët/ ishin bërë gati për të pushtuar qytetin Thyrion dhe si kishin guxuar ta sulmonin natën. Ahejt i
4 bënin fajtorë se kishin marrë Klarionin, në tokën e Megalopolit, kishin shkretuar në kalim Patrën dhe Farën, grabitur Kynethën dhe tempullin e Artemisit në Lusa, rrethuar Klitorin, sulmuar Pylon nga deti dhe në tokë ishin orvatur, së bashku me ilirët të shkatërronin Megalopolin, që sa kishte filluar të popullohej përsëri. Pasi
5 dëgjoi ankimet e tyre, këshilli i aleatëve votoi njëzëri t'u shpallej luftë etolëve...

1 **29** Filipi, duke kaluar dimrin në Maqedoni, i qe vënë punës me zell për të rekrutuar ushtri, për fushatën e ardhshme; njëkohësisht ai merrte masa për të siguruar
2 kufijtë e Maqedonisë nga barbarët që ishin nga ana e sipërme. Më vonë pati një takim me Skerdilaidin, duke e lënë veten në duart e këtij, me një guxim të madh, dhe
3 biseduan që të dy për të lidhur miqësi e aleancë midis tyre. Ai i premtoi Skerdilaidit ta ndihmonte për të rregulluar punët e Ilirisë, nga ana tjetër akuzoi – gjë fare e lehtë – etolët dhe më në fund e bindi me lehtësi që të pranonte propozimet e tij... Etolët ishin
5 zotuar t'i jepnin Skerdilaidit një pjesë të plaçkës, nëqoftëse ai do të shkonte me ta
6 kundër Ahesë. Ai pranoi dhe e mbajti fjalën, mirëpo etolët, si grabitën qytetin e kynethëve dhe si morën shumë robër e bagëti nuk e bënë Skerdilaidin pjesëtar në
7 asnjë nga ato që grabitën. Nga ky shkak ai ishte zemëruar shumë me etolët dhe prandaj porsa i propozoi Filipi, pranoi menjëherë të hynte edhe ai në aleancën e përbashkët, me kusht që të merrte njëzet talente në vit kundrejt pjesëmarrjes së tij me

[1] Kenkra, një nga të dy portet e Korinthit gjendej në gjirin e Saronikut. Porti tjetër Lehe, gjendej në gjirin e Korinthit.
[2] Qytete të Fokidës.

tridhjetë anije në luftën detare kundër etolëve.[1)]

30 Ndërsa Filipi merrej me këtë punë, delegatët që ishin dërguar tek aleatët shkuan më parë në Akarnani dhe paraqitën mesazhin e tyre. Këta menjëherë nënshkruan vendimin dhe morën pjesë në luftë kundër etolëve... Sa për epirotët, si dëgjuan delegatët, edhe ata e nënshkruan dekretin, por vendosën të luftonin me etolët vetëm atëherë kur edhe Filipi do t'u shpallte luftë. Njëkohësisht u thanë delegatëve të dërguar prej etolëve se epirotët dëshironin të rronin në paqe me ta; e tillë qe sjellja e tyre e dobët dhe gjithë mashtrime...

36 Kur Mahata mësoi se ç'kishte ndodhur në Lakedemoni, u kthye prapë në Spartë për të nxitur eforët dhe mbretërit që t'u shpallnin luftë ahejve. Ai thoshte që kjo ishte e vetmja mënyrë për t'u dhënë fund grindjeve që shkaktonin ndërmjet lakedemonëves kundërshtarët e rreptë të aleancës me etolët, dhe në Etoli ata që vepronin në mënyrë të njëjtë. Eforët dhe mbretërit u bindën. Pasi përfundoi me sukses bisedimet në saje të mendjelehtësisë së atyre , që i bëri për vete, Mahata u kthye, ndërsa Lykurgu në krye të një ushtrie të rregullt, së cilës iu shtuan edhe disa qytetarë, hyri në Argeia, qytetarët e së cilës nuk kishin marrë masa mbrojtjeje për shkak të marrëdhënieve të mira, që ekzistonin midis dy shteteve. Dhe me këtë sulm të papritur ai pushtoi Polihnën, Praisën, Leukën, Kifantën; ai sulmoi po kështu Glympesën dhe Zarakin[2)], por u zmbraps. Pas këtij sulmi lakedemonët shpallën gjendjen e luftës me ahejt. Duke përdorur të njëjtat argumente si edhe me spartanët, Mahata i bëri edhe elejt t'u shpallnin luftë ahejve. Punët venin mbarë për etolët, të cilët as që e prisnin këtë sukses; ata u nisën, pra, me guxim për në luftë. Tek ahejt ndodhte e kundërta. Filipi, tek i cili kishin mbështetur të gjitha shpresat e tyre, ishte akoma duke bërë përgatitje; epirotët ngurronin të hynin në luftë; mesenasit nuk lëviznin; ndërkaq etolët, duke përfituar nga verbëria e elejve dhe lakedemonëve, i vunë *[*ahejt*]* nga të gjitha anët në darën e luftës.

55 Polyrenët, lapajt dhe gjithë aleatët e tyre, duke parë se Knosi kërkonte aleancë me etolët, të cilët ishin në luftë me mbretin Filip dhe me ahejt, dërguan delegatët e tyre tek këta të fundit dhe tek Filipi për t'u kërkuar aleancë e ndihmë. Ahejt dhe Filipi i pranuan në aleancën e përbashkët dhe u dërguan ndihmë katërqind ilirë nën urdhërat e Platorit, dyqind ahej dhe njëqind fokidas. Ardhja e tyre qe një ndihmë e madhe për polyrenët dhe aleatët e tyre; brenda një kohe të shkurtër ata rrethuan Eleuthernën, Kydonën pastaj Apterën dhe i detyruan banorët e këtyre vendeve të shkëputen nga aleanca me Knosin dhe të bashkoheshin me ta...

61 Pra, në Peloponez ndodhnin këto ngjarje, ndërsa mbreti Filip, duke kaluar përmes Thesalisë, arriti në Epir. Këtu si bashkoi me ushtrinë maqedone gjithë forcat epirote, treqind hobëtarët, që kishin ardhur nga Ahea si dhe pesëqind kretas, që i kishin dërguar polyrenët, marshoi përpara dhe, duke kaluar përmes Epirit, arriti në krahinat e Ambrakisë. Po të kishte hyrë shpejt dhe pa u vonuar në zemër të Etolisë, ky sulm i papritur do t'i kishte dhënë fund menjëherë luftës. Po tani u bind se bëri gabim që i dëgjoi epirotët dhe rrethoi më parë Ambrakun, gjë që u dha kohë etolëve të forcoheshin dhe të merrnin masat e nevojshme kundër një sulmi të mundshëm.

[1)] Në vitin 219 para e. sonë.

[2)] Të gjitha këto qëndra janë në Argolidë, jo shumë larg kufirit të Lakonisë.

Epirotët, të cilët vinin interesin e tyre mbi interesin e aleatëve në përgjithësi, donin me çdo kusht të shtinin në dorë Ambrakun. Për këtë arsye ata i kërkuan Filipit të fillonte nga rrethimi dhe shkatërrimi i kësaj fortese; ata nuk mendonin për gjë tjetër veçse t'u merrnin përsëri Ambrakinë etolëve dhe shpresonin t'ia arrinin qëllimit duke pushtuar Ambrakun prej nga do të zotëronin mbi qytetin. Ambraku është me të vërtetë një vend i fortifikuar mirë, i rrethuar me mure dhe hendeqe; ndodhet midis liqenesh dhe lidhet me rrethin e vet vetëm me një rrugicë të ngushtë, pozita e tij është e shkëlqyer, mbizotëron edhe mbi qytetin edhe mbi gjithë krahinën. Filipi, pra, u bind nga epirotët, ngriti lëmin para Ambrakut dhe filloi përgatitjet për rrethimin e tij.

62 Në këtë kohë Skopa, në krye të gjithë forcave etole, përshkoi Thesalinë, hyri në Maqedoni, duke kaluar prishi të korrat e Pierrisë, bëri shumë plaçkë dhe në kthim iu drejtua Dionit. Hyri menjëherë në këtë qytet që e kishin zbrazur banorët, shkatërroi muret, banesat e gjimnazin, dogji portikët që rrethonin tempullin, shkatërroi gjithë kushtimet që kishin sjellë për zbukurimin e faltoreve ose për nevojat e veta besimtarët që mblidheshin këtu për panairet dhe, më në fund, përmbysi gjithë shtatoret e mbretërve... **63** Kur Filipi mori vesh ç'kishte ndodhur në Maqedoni e pa se ai vetë po i lante mëkatet e marrisë dhe ambicies së epirotëve. Megjithëkëtë ai s'hoqi dorë nga rrethimi i Ambrakut; ndërtoi ura dhe i shpejtoi aq shumë punimet për përgatitjet e tjera, sa u kalli tmerr banorëve të rrethuar dhe i detyroi të dorëzoheshin pas një rrethimi që zgjati gjithsejt dyzet ditë. Garnizonit etol, gjithsejt nja pesëqind vetë, i dha leje të tërhiqet dhe qytetin ua dorëzoi epirotëve, duke ua plotësuar kështu dëshirën që patën. Ai vetë mori ushtrinë dhe u nis pa vonuar për në Haradra[1)], duke u nxituar të kalonte gjirin e Ambrakisë në atë vend ku është më i ngushtë d.m.th. pranë kodrës së faltores së akarnanëve, që quhet Akti. Gjiri që zumë në gojë këtu sipër, ndodhet në mes të Epirit e të Akarnanisë dhe formohet prej detit të Siqelisë, me të cilin lidhet me anë të një gryke shumë të ngushtë, më pak se pesë stade. Duke hyrë më thellë në drejtim të tokës zgjerohet gjer në njëqind stade; gjatësia e tij prej detit arrin gjer në nja treqind stade; ndan Epirin nga Akarnania, duke patur këtë të fundit nga Jugu dhe të parin nga Veriu... **66** Ndërsa mbreti ishte i zënë akoma me këto punë, një i dërguar nga Maqedonia erdhi dhe e lajmëroi se dardanët, duke menduar se ai do të nisej për në Peloponez, po grumbullonin forca dhe po bënin përgatitje të mëdha për të hyrë në Maqedoni. Kur mori këtë lajm ai mendoi se gjëja më urgjente ishte të shkonte e të mbronte Maqedoninë.

I ktheu, pra, të dërguarit aheas duke i siguruar se pasi të rregullonte vështirësitë për të cilat e njoftuan, kujdesi i tij i parë do të ishte t'u shkonte në ndihmë me ushtrinë e tij. Pastaj ngriti lëmin dhe u kthye me shpejtësi të madhe nëpër rrugën që kishte ardhur. Në kohën kur do të kalonte gjirin e Ambrakisë, për t'u hedhur nga Akarnania në Epir, takoi Demetër Farin, i cili i ndjekur prej romakëve nga Iliria, ikte me një anije të thjeshtë. Unë kam folur në një vend tjetër më lart për këto ngjarje.

Filipi e priti me përzemërsi dhe e porositi të lundronte për në Korinth që të arrinte në Maqedoni nëpërmjet Thesalisë. Për vete ai përshkoi Epirin dhe ndoqi rrugën e vet pa u ndalur. Kur dardanët morën vesh nga disa dezertorë thrakas se ai ishte kthyer në Maqedoni dhe kishte arritur në Pela, i zuri frika dhe shpërndanë me të shpejtë ushtrinë e tyre megjithëse kishin zënë gjithë Maqedoninë... Është e njëjta kohë kur Emili[2)], duke u kthyer nga Iliria hyri me triumf në Romë...

[1)] Qytet i Epirit në gjirin e Ambrakisë (Artës) ndoshta pak në jug të Ambrakut; fjalë për fjalë do të thotë e çarë toke e formuar nga ujë që rrjedh me rrëmbim.

[2)] Luc Emil Pauli.

Këtu mbaron viti i parë i kësaj olimpiade[1].

1 **67** Kur erdhi dita e zgjedhjeve, etolët zgjodhën për strateg të tyre Dorimahun; ky me të marrë fuqinë në dorë mblodhi ushtrinë dhe hyri në krahinat e sipërme të Epirit, duke shkretuar vendin pa pikë mëshire dhe jo aq pse kështu ia kërkonte interesi i vendit të tij, se sa për t'u bërë keq epirotëve. Kur arriti në faltoren e Dodonës, dogji
2 portikët e tempullit, prishi një pjesë të madhe të kushtimeve dhe rrëzoi edhe muret e faltores...

LIBRI V

1 **3** Në të njëjtën kohë Dorimahu, strategu i Etolisë, dërgoi në Elidë Agelaun dhe Skopën me pesëqind kretas të rinj; nga ana e tyre elejt, nga frika se mos Filipi e rrethonte Kylenën, mblodhën mercenarë, armatosën qytetarët dhe e forcuan Kylenën
2 me kujdes. Duke parë këtë, Filipi la në Dyme mercenarët e ahejve, kretasit që ishin me të si edhe disa kalorës galatë, bashkë me këta edhe dymijë këmbësorë të zgjedhur ahej; kjo ishte në të njëjtën kohë një forcë rezervë dhe një masë, kundër ndonjë të papriture nga ana e elejve. Ai u shkroi mesenasve, epirotëve, akarnanëve dhe
3 Skerdilaidit të pajisnin flotat e tyre dhe u dha takim në Kefaleni; pastaj la Patrën në ditën e caktuar dhe iu afrua Kefalenisë nga ana e Pronës. Por meqenëse ky port i
4 vogël ishte i vështirë për t'u marrë me sulm dhe i vendosur mbi një gjuhëz toke mjaft të ngushtë, vazhdoi rrugën e vet gjatë bregut dhe shkoi e u ndal në Palea. Duke parë se ky vend ishte plot me grurë dhe në gjendje të ushqente ushtrinë, zbarkoi trupat dhe
5 vendosi lëmin aty pranë, ndërsa anijet i nxori në breg dhe i rrethoi me një kanal; pastaj mbreti dërgoi maqedonët për furnizime. Për veten e tij ai i erdhi përqark
6 qytetit, për të kërkuar se nga ç'anë mund të aviste maqinat pranë mureve dhe mund të kryente punime të tjera lidhur me rrethimin; meqenëse ndodhej këtu për të pritur
7 aleatët e tij, ai donte të bëhej zot i këtij vendi; së pari, për t'u shkëputur etolëve një port që varej prej tyre dhe që ishte për ta i domosdoshëm (në fakt ishin anijet e Kefalenisë që u shërbenin këtyre *[etolëve]* qoftë për të kaluar në Peloponez, qoftë për
8 të shkretuar brigjet e Epirit e të Akarnanisë), pastaj për të siguruar për vete dhe për
9 aleatët e tij një bazë detare, prej nga do të mund të sulmonte me lehtësi armikun. Në të vërtetë ishulli i Kefalenisë që ndodhet përballë gjirit të Korinthit dhe që laget nga
10 deti i Siqelisë, zotëron mbi krahinat e Peloponezit Verior dhe Perëndimor, në radhë të parë mbi Elidën, si edhe mbi pjesët perëndimore e jugore të Epirit, Etolisë dhe Akarnanisë.

1 **4** Vendi, pra, ishte zgjedhur për mrekulli për të grumbulluar aleatët, për të kërcënuar tokat e armikut dhe për të mbrojtur vendet mike; gjithashtu mbreti e kishte mendjen te pushtimi i ishullit. Ai kishte vënë re se Palea ishte e mbrojtur nga të gjitha
2 anët, si nga deti ashtu edhe nga shkrepat; kishte vetëm një vend shumë të ngushtë nga ana e Zakynthit, nga ku mund t'i aviteshin; ishte pikërisht ky vend që ai e zgjodhi për të vendosur makinat e tij dhe për të bërë punimet e rrethimit. Gjithë mendimi i tij dhe
3 gjithë kujdesi ishte tek ky projekt. Ndërkaq pesëmbëdhjetë anije arritën nga Skerdilaidi, i cili nuk mundi t'i dërgonte më shumë për shkak të komploteve dhe të trazirave të bëra nga dinastët e qyteteve të Ilirisë; ai mori po kështu përforcimet që i
4 kishin premtuar epirotët, akarnanët dhe mesenasit.

[1] Viti 219 para e. sonë.

6 Strategu i Akarnanisë, Aristofanti, erdhi atje e u takua me të gjitha forcat e vendit të tij. Akarnanët, të cilët dikur kishin vuajtur shumë dhe shpesh nga etolët, ëndërronin të merrnin hakun e tyre, duke u bërë armiqve sa më shumë dëme. Ata nuk ngurruan të shfrytëzonin rastin që u jepte ndërhyrja maqedone dhe të gjithë rrokën armët, jo vetëm ata që i detyronte shërbimi ushtarak, por edhe disa nga pleqtë. Epirotët, për të njëjtat arsye, i hynë edhe ata jo me më pak vrull kësaj pune; por vendi i tyre është kaq i shtrirë dhe sulmi i Filipit qe kaq i papritur sa që nuk patën kohë të grumbullonin trupat e tyre...

12 ... Mund të thonë, ndoshta, se Filipi ishte tepër i ri në këtë kohë për ta bërë përgjegjës për gabimet e tij dhe se fajtorët e vërtetë janë miqtë dhe këshilltarët që e rrethonin, midis të cilëve Arati dhe Demetër Fari. Megjithëse nuk kam qenë në këto ngjarje, nuk është e vështirë të them se cili prej të dyve do t'i ketë dhënë mbretit këto këshilla të këqija Përveç natyrave të ndryshme, për të cilat janë dalluar gjithmonë, Arati si armik i të gjitha puneve të shpejtuara dhe veprimeve të pamenduara, kurse Demetri për të kundërtën, ka një fakt tjetër që tregon në mënyrë të padiskutueshme karakterin e këtyre dy njerëzve; për këtë do të flas në kohën dhe në vendin e vet.

13 Filipi, të kthehemi prapë në çështjen tonë, mori nga Therma të gjitha ato që ishte e mundur të ngriheshin dhe u kthye nëpër të njëjtën rrugë nga kishte ardhur. Ai vuri në krye plaçkën bashkë me këmbësorinë e rëndë dhe, duke lënë si pararojë akarnanët dhe mercenarët, ai shpejtonte të kalonte qafat sa të ishte e mundur më shpejt; ai e parashikonte se etolët do të përfitonin, nga natyra e keqe e vendit për të sulmuar praparojën. Frika e tij u vërtetua menjëherë. Etolët ishin mbledhur rreth tremijë vetë dhe kishin ardhur në ndihmë nën komandën e Aleksandrit Trihon; meqenëse Filipi kishte zënë lartësitë ata nuk u avitën, por qendruan të fshehur. Por me t'u vënë në lëvizje praparoja, iu lëshuan menjëherë Thermës dhe goditën radhët e fundit të kolonës. Meqenëse ky sulm shkaktoi çrregullim në praparojën, etolët morën edhe më shumë guxim; nga ana tjetër i ndihmonte edhe terreni. Filipi që e priste këtë ngjarje kishte vendosur, gjatë zbritjes së vet, ilirët dhe pjesën e zgjedhur të këmbësorisë së lehtë në rrëzë të kodrës. Këta u sulën mbi forcat armike që ndiqnin dhe shqetësonin ushtrinë, vranë njëqind e tridhjetë vetë dhe zunë thuajse po aq; pjesa tjetër u tërhoq e çrregulluar nëpër udhë të pashkelura. Pas këtij suksesi, praparoja dogji Pamfinë, kaloi qafat pa pengesa dhe arriti maqedonët, sepse Filipi ishte ndalur në Metapë për ta pritur. Të nesërmen ai rrafshoi Metapën dhe shkoi e vendosi lëmin e vet në një qytet që quhet Akra. Të pasnesërmen, duke vazhduar të shkatërronte vendin, gjatë kalimit të tij, arriti në Konopë ku vendosi përsëri lëmin dhe kaloi edhe një ditë. Prej këndej u nis prapë dhe ndoqi bregun e lumit Ahelou deri në Strato; pastaj u hodh në bregun tjetër dhe e ndaloi ushtrinë e vet më larg se sa mund të arrinte një shigjetë, me qëllim që t'i tërhiqte banorët të dilnin jashtë mureve.

14 Mbreti ishte lajmëruar që rreth tremijë këmbësorë dhe katërqind kalorë etolë, si dhe pesëqind kretas, ishin përqendruar në Strato. Por meqenëse asnjeri nuk mori guximin të dilte, ai dha urdhër për nisje; pararoja hapi rrugën dhe gjithë ushtria u nis për në Limnea, ku gjendeshin anijet. Sapo ishte larguar praparoja, disa kalorës etolë dolën nga qyteti dhe filluan të godisnin radhët e fundit të saj. Kretasit dhe disa nga etolët u bashkuan më pas me kalorësinë; ndeshja u bë e përgjithshme dhe praparoja maqedone u detyrua të kthehet për të mbështetur luftimet. Beteja mbeti për një kohë

e papërcaktuar, por ilirët e ushtrisë mbretërore arritën në ndihmë të mercenarëve; armiqtë u tërhoqën dhe ikën pa parë rrugën nga vajtën, si kalorësia etole ashtu edhe
6 mercenarët. Pjesa më e madhe e tyre ua mbathën këmbëve drejt qytetit, të ndjekur deri tek portat dhe në rrëzë të mureve nga ushtarët e Filipit, të cilët vranë rreth
7 njëqind vetë. Pas kësaj ngjarjeje garnizoni i Stratos nuk guxoi të lëvizte më dhe praparoja e arriti me qetësi pjesën kryesore të ushtrisë dhe anijet.

1 **23** Si arriti para pozicioneve të Lykurgut, Filipi lëshoi më parë kundër tij
2 mercenarët; luftimet u zhvilluan në fillim në favor të lakedemonëve, sepse armatimi
3 dhe vendi që kishin zënë i ndihmonin shumë. Por Filipi dërgoi këmbësorinë për të mbështetur forcat që luftonin; në të njëjtën kohë, me ilirët ai i mori krahun armikut
4 dhe e sulmoi anash. Atëherë, kur mercenarët e Filipit, të nxitur nga mbështetja që u dhanë ilirët dhe këmbësoria e lehtë, e filluan përsëri betejën me një forcë të re, njerëzit e Lykurgut, të tronditur nga goditjet e ushtarëve të armatosur rëndë, u
5 tërhoqën dhe morën arratinë. Rreth njëqind prej tyre u vranë, pak më tepër u zunë robër, të tjerët u futën në qytet; përsa i përket Lykurgut ai u kthye në qytet me pak
6 njerëz natën, duke kaluar nëpër vende të fshehta. Filipi zuri kodrat me ilirët dhe
7 bashkoi pjesën kryesore të ushtrisë së tij me këmbësorinë e lehtë; gjatë kësaj kohe Arati, duke ardhur nga Amykla me falangën, kishte arritur tek portat e qytetit. Mbreti
8 kaloi lumin për të mbuluar marshimin e tij me këmbësorinë e lehtë dhe kalorësinë, kështu që këmbësoria e rëndë mundi të kalonte shumë e sigurtë zonën e vështirë në
9 rrëzë të kodrave. Ndërkaq garnizoni që doli nga qyteti, goditi kalorësinë e mbrojtjes: lufta u ndez gjithandej; këmbësorët luftuan me forcë dhe Filipi pati një fitore të plotë.
10 Ai i ndoqi kalorësit lakedemonë deri tek portat e qytetit, pastaj kaloi i qetë lumin Eurota dhe u vendos si praparojë pas falangës së vet.

1 **95** Në këtë kohë[1)] Skerdilaidi, mbasi kujtonte se Filipi i bënte një padrejtësi që s'ia kishte paguar tërë të hollat që i detyronte sipas marrëveshjes, dërgoi pesëmbëdhjetë anije të vogla, që t'ia merrnin me dinakëri të hollat. Kur arritën anijet
2 në Leukadë, të gjithë dolën dhe i pritën si miq, për shkak të aleancës që kishin lidhur
3 më parë. Nuk arritën, as nuk mundën të bëjnë këta ndonjë të keqe tjetër; por, kur erdhën korinthasit, Agathini dhe Kasandri, me katër anije të Taurionit dhe qendruan pranë atyre si miq, anijet e Skerdilaidit u ranë me të pabesë, rrëmbyen anijet bashkë
4 me njerëzit dhe ia dërguan Skerdilaidit. Pastaj ikën nga Leukada dhe u drejtuan për në Malea, duke zhveshur dhe duke zënë rob tregtarët...

1 **96** Në këtë kohë Ageta, strategu i Etolisë, thirri gjithë popullin nën armë dhe shkoi e shkretoi Akarnaninë; prej këndej ai u hodh në Epir dhe përshkoi pa asnjë pengesë gjithë këtë vend, duke vazhduar shkatërrimet e tij...

1 **97** Gjatë kësaj kohe, mbreti Filip zuri Bylazorën, qytetin më të madh të Paionisë që ishte kyç për dyndjet që vinin nga Dardania në Maqedoni. Ky pushtim e çliroi
2 pothuaj nga e gjithë frika që kishte nga dardanët; u bë e vështirë të hyhej prej këndej në Maqedoni që nga çasti që Filipi u bë zot i kësaj rruge...

1 **101** Kur ai /Filipi/ dëgjoi se anijet e Skerdilaidit merreshin me pirateri anëve të

[1)] Në vitin 217 para e. sonë.

Malesë dhe të gjithë tregtarët i trajtonin si armiq, dhe se, kundër marrëveshjes, kishin sulmuar edhe disa nga anijet e tija që ishin vendosur në limanin e Leukadës, përgatiti dymbëdhjetë anije të mbuluara, tetë të pambuluara dhe tridhjetë të lehta dhe lundroi përtej Euripit, për t'u rënë në befasi ilirëve, por edhe për të vazhduar veprimet kundër etolëve; sepse ai mendonte vetëm e vetëm t'i luftonte, mbasi nuk dinte asgjë mbi ngjarjet e Italisë. Mirëpo, në kohën kur Filipi po rrethonte Thebën, romakët ishin mundur prej Hanibalit në betejën e Tyrrenës, por ky lajm nuk kishte arritur akoma në Helladë. Filipi nuk mundi t'i arrinte ilirët dhe u ndal në Kenkre; prej këndej anijet e mbuluara i nisi për në Malea, duke i urdhëruar që të shkonin së këtejmi në Egion dhe Patra. Anijet e tjera i kaloi përmes istmit në portin Lehais, ku arritën të gjitha; ai vetë me miqtë shpejtoi të shkonte në Argolidë për të parë lojërat e Nemesë. Këtu, kur po shikonte lojërat gjymnike i erdhi një letërprurës nga Maqedonia, i cili i solli lajmin se romakët ishin mundur në betejë dhe Hanibali ishte bërë zot i gjendjes. Në atë çast letrën ai ia tregoi vetëm Demetër Farit, duke e porositur të heshtë për të. Ky, duke përfituar nga rasti, e këshilloi mbretin të hiqte dorë sa më parë nga lufta kundër etolëve, të fillonte një fushatë kundër Ilirisë dhe pastaj të hidhej në Itali. E gjithë Hellada ishte nën urdhërat e tij dhe do të mbetej e tij; ahejt ishin miqtë e tij dhe do t'i bindeshin me gjithë qejf, etolët do të kujtonin luftën që u kishte bërë dhe nuk do të guxonin të lëviznin. Ai shtoi se zbarkimi i tij në Itali, do të ishte fillimi i pushtimit të botës, gjë për të cilën ai ishte i destinuar më shumë se kushdo tjetër në botë. Ky ishte pikërisht rasti për të vepruar pas shkatërrimit që pësuan romakët.

108 Mbreti Filip, pas përfundimit të paqes, u kthye në Maqedoni me anën e detit. Këtu gjeti Skerdilaidin i cili duke vënë si shkak të hollat që kishte për të marrë nga Filipi – po me këtë shkak u kishte rënë me të pabesë edhe anijeve që ndodheshin në Leukadë – nga një anë kishte pushtuar Piseun, qytet i vogël në Pelagoni, kurse nga ana tjetër kishte bërë për vete me premtime dhe qytetet e Dasaretisë Antipatrenë, Krysondyonën, Gertuatin. Përveç këtyre ai kishte kryer sulme edhe kundër një pjese të madhe të Maqedonisë, që është në kufi të këtyre qyteteve. Filipi aty për aty u nis me ushtri, duke u kujdesur të ripushtonte qytetet që ishin shkëputur prej tij, me një fjalë ai mendonte të luftonte kundër Skerdilaidit sepse e gjykonte rregullimin e punëve të Ilirisë si kusht të domosdoshëm për të zbatuar planet e tij dhe sidomos për të kaluar në Itali. Demetri, në anën tjetër, ia ushqente orë e çast këtë shpresë e këtë vendim, aq sa Filipi ishte shtënë me mish e me shpirt pas kësaj ndërmarrjeje, të cilën e shihte edhe në ëndërr shpesh herë. Këtë e bënte Demetri jo për hir të Filipit – kjo mbase vinte në radhë të tretë – po më tepër nga mëria kundër romakëve e më shumë për veten e tij dhe për shpresat e veta, mbasi ishte i bindur se vetëm në këtë mënyrë mund të fitonte përsëri pushtetin në Far. Filipi atëherë, u nis me ushtrinë dhe ripushtoi qytetet që zumë në gojë këtu sipër; pushtoi, pra, Kreonin e Geruntin e Dasaretisë, dhe ndër qytetet rreth liqenit Lyhnid, Enhelanën, Kerakën, Sationën e Bojojën dhe në krahinën e kaloikinëve qytetin Bantia; përveç këtyre edhe qytetin e pisantinëve Orgesën. Si bëri këto, e dërgoi ushtrinë për të dimëruar. Ishte pikërisht dimri, kur Hanibali, si shkretoi krahinat më të pasura të Italisë, bëhej gati të kalonte dimrin në Gerunt të Daunisë. Në këtë kohë[1)] romakët zgjodhën për konsuj G. Terentin e L. Emilin.

[1)] Viti 216 para e. sonë.

109 Gjatë kohës së dimrit, Filipi mendoi se për t'ia arritur qëllimit, kishte nevojë për anije dhe për detarë, jo pse i shkonte mendja se do të ishte i zoti të matej në det me romakët, po pse me anën e flotës do të mund të transportonte sa më shpejt trupat në atë vend, që do ta zgjidhte për t'i rënë armikut befas. Ilirët atëherë, sipas mendimit të tij, kishin një zotësi të veçantë për të ndërtuar anije, prandaj i urdhëroi të ndërtonin njëqind anije, gjë që mendoj unë s'e kishte bërë gjer atëherë ndonjë nga mbretërit e Maqedonisë. Si u ndërtuan anijet, mblodhi ushtrinë në fillim të pranverës, i ushtroi pak maqedonët në punën e përdorimit të lopatave dhe u nis. Në kohën kur Antiohu kalonte Taurin, Filipi kalonte Euripin, arriti në kepin Malea dhe së këtejmi në viset rreth Kefalenisë dhe Leukadës për të parë së këtejmi më mirë lëvizjet e flotës romake. Kur mori vesh se anijet e armikut ishin ndaluar pranë Lilybesë u nis, pa u drojtur fare, drejt Apollonisë.

110 Kur u afrua në viset pranë lumit Aou, i cili rrjedh pranë qytetit të apolloniatëve, atëherë i ndodhi një panik si ata që ngjasin në ushtritë tokësore. Disa anije të praparojës, duke u ndalur në ishullin Sason, që ndodhet në grykën e detit Jon, erdhën natën tek Filipi dhe i njoftuan se disa anije që vinin nga ngushtica ishin ndalur pranë tyre dhe u thanë se kishin lënë në Reg anije romake me pesë rrema, të cilat shkonin për në Apolloni për t'i ardhur në ndihmë Skerdilaidit. Filipi kujtoi se gjithë kjo flotë do të sulej kundër tij; u tremb shumë dhe urdhëroi të kthehen prapa. Kjo tërheqje u bë në çrregullimin më të madh; udhëtuan pa u ndalur, një ditë dhe një natë dhe ditën e dytë arritën në Kefaleni. Këtu Filipi mori pak guxim; qendroi ca kohë në këtë ishull duke nxjerrë si shkak për kthimin e tij disa çështje që kishte për të rregulluar në Peloponez. Mirëpo nuk kishte asnjë arsye përse ta zinte gjithë kjo frikë. Skerdilaidi, duke ditur se Filipi ndërtonte gjatë dimrit një numër mjaft të madh anijesh dhe se priste një sulm nga deti, ua bëri të ditur këtë romakëve dhe u kërkoi ndihmë; por romakët vunë në lëvizje vetëm dhjetë anije të skuadrës së tyre në Lilybe; ishin ato që u dukën në Reg. Po të mos kishte humbur toruan Filipi, po të mos ua kish mbathur këmbëve, ai kishte rastin më të mirë të pushtonte Ilirinë, ndërsa romakët gjithë vëmendjen e tyre e kishin tek Hanibali dhe tek beteja e Kanës; ka të ngjarë që ai të kishte shtirë në dorë edhe anijet e tyre. Por atë e zuri frika nga fjalët e njërit e të tjetrit dhe u tërhoq në Maqedoni, ç'është e vërteta, pa humbje, por edhe pa lavdi.

LIBRI VII

9 U betuan një anë gjenerali Hanibal, Magoni, Mirkani, Barmokari, gjithë senatorët e Kartagës që u ndodhën me të dhe gjithë kartagasit, ushtarë të tij, nga ana tjetër Ksenofani nga Athina, i biri i Kleomahut, delegat i mbretit Filip, birit të Demetrit, duke vepruar në emër të tij, në emër të maqedonëve dhe të aleatëve të tyre. Betimi u bë përpara Zeusit, Herës dhe Apollonit, përpara hyut mbrojtës të kartagasve, Heraklit e Iolaut, përpara Aresit, Tritonit e Poseidonit, përpara hyjnive që merrnin pjesë në fushatë, Diellit, Hënës dhe Tokës, përpara lumenjve, liqenjve dhe ujërave, përpara gjithë perëndive të Kartagës, përpara gjithë perëndive të Maqedonisë e të Helladës tjetër, përpara gjithë perëndive që kryesojnë luftën e që janë dëshmitarë të këtij betimi. Hanibali, gjeneral i karatagasve, të gjithë senatorët e Kartagës që ishin me të dhe gjithë ushtarët kartagas që shërbenin në ushtrinë e tij thanë këto fjalë: "Me dëshirën tonë dhe tuajën, betohemi të kemi miqësi dhe dashuri midis nesh, si miq, fis e vëllezër, me këto kushte:

5 mbreti Filip, maqedonët dhe gjithë ata helenë që janë aleatë të tyre, do t'u japin
përkrahjen e tyre kartagasve; gjeneralit të tyre Hanibal, ushtarëve të tij, popujve që
varen prej Kartagës dhe rrojnë pas ligjeve të tyre, banorëve të Itikës, të gjitha
6 qyteteve dhe popujve që janë nën sundimin e Kartagës, ushtarëve të tyre dhe
aleatëve të tyre, dhe gjithë atyre qyteteve dhe popujve, me të cilët kemi lidhur miqësi
në Itali, në Kelti dhe në Ligistinë, dhe më në fund gjithë banorëve të këtyre
krahinave që do të bëheshin miq e aleatë me ne.
7 Në anën tjetër mbreti Filip, maqedonët dhe aleatët e tjerë helenë do të mbrohen dhe
ndihmohen nga ushtria kartagase, prej itikasve dhe prej gjithë qyteteve dhe popujve
që sundohen prej kartagasve, prej aleatëve dhe ushtarëve të tyre, prej gjithë popujve
dhe qyteteve që kemi miq në Itali, Kelti dhe Ligistinë si edhe prej gjithë atyre që do
8 të bënim aleatë në këtë pjesë të Italisë. Nuk do të mashtrojmë njëri-tjetrin dhe as do
të godasim njëri-tjetrin në befasi, do të veprojmë me gjithë sinqeritet e dashuri, pa
asnjë dredhi ose paramendim. Ju maqedonë do të jeni armiqtë e armiqve të
kartagasve, përveç atyre mbretërve, qyteteve dhe limaneve ndaj të cilëve ju jeni të
detyruar me betime dhe miqësi. Edhe ne kartagasit do të jemi armiq të armiqve të
9 mbretit Filip, përveç mbretërve, qyteteve dhe popujve, me të cilët jemi lidhur me
betim dhe me miqësi. Do të merrni pjesë edhe ju në luftën që bëjmë me romakët
10 gjersa perënditë të na japin neve edhe juve fitoren. Do të na dërgoni ndihmë sipas
11 marrëveshjeve që kemi sa herë që do të kemi nevojë. Nëqoftëse perënditë na japin
12 fitoren në luftën kundër Romës dhe aleatëve të saj dhe nëqoftëse romakët na
kërkojnë miqësi ne do të pranojmë vetëm me kusht që kjo miqësi të jetë e njëllojtë
edhe për ju, dhe që ata të mos shpallin asnjëherë luftë kundër jush, të mos jenë zotër
13 as të Kerkyrës, as të Apollonisë dhe Epidamnit, as të Farit, as të Dimalit dhe
parthinëve, as të Atintanisë. Nga ana tjetër t'i kthejnë Demetër Farit gjithë njerëzit e
14 tij që i mbajnë romakët si peng.
Nëqoftëse romakët ju shpallin luftë juve ose neve, do të ndihmojmë njëri-tjetrin,
15 sipas nevojës që do të çfaqet. Gjithashtu do të veprojmë edhe në rast se na shpall
16 luftë çdo popull tjetër, përveç mbretërve, qyteteve dhe popujve me të cilët jemi
lidhur me betime dhe aleancë. Nëqoftëse do ta gjejmë për mirë që të heqim ose të
17 shtojmë diçka në këtë traktat, këtë do ta bëjmë vetëm me pëlqimin e të dy palëve".

14,d Banorët e Orikut, qytet i parë që hasim nga e djathta, kur hymë në Adriatik.

LIBRI VIII

1 **13** Meqenëse Filipi, prej shumë kohësh, ëndërronte të shtinte në dorë Lisin dhe
2 Akrolisin, u nis për atje me ushtri. Pas një udhëtimi prej dy ditësh dhe si kaloi
ngushticat, qendroi pranë lumit Ardaksan, afër qytetit. Këtu vuri re se rrethi i Lisit
3 ishte përforcuar shumë mirë si nga ana e detit, si nga ajo e tokës, nga natyra dhe nga
dora e njeriut; edhe Akrolisi që ishte pranë, kishte aq lartësi të madhe dhe ishte aq i
fortë, sa që edhe një sy të vetëm të hidhte njeriu mbi të, do të kuptonte menjëherë se
pushtimi i tij ishte një gjë e pamundur; prandaj për këtë të fundit humbi çdo shpresë,
ndërsa për qytetin besonte akoma se mund të bënte diçka. Pra, pasi vuri re mirë
4 vendin që shtrihej midis Lisit dhe rrëzës së malit të Akrolisit, dhe pa se ishte i
përshtatshëm për sulmin e tij kundër qytetit, mendoi ta pushtonte me një luftim të
vogël dhe të përdorte një taktikë të përshtatshme për rastin.

U dha maqedonëve një ditë pushim dhe pati rast gjatë kësaj kohe t'u japë porositë dhe këshillat e duhura. Ndaj nate, mori pjesën më të madhe e më të zgjedhur të ushtarëve të tij me armatim të lehtë dhe e fshehu në disa lugina të pyllëzuara, që ishin nga ana e brendshme e tokës e që zotëronin mbi vendin që thamë më sipër. Të nesërmen, ai vetë mori peltastët dhe pjesën tjetër të ushtrisë së armatosur lehtë dhe u nis për në anën tjetër të qytetit, duke ecur anës detit: Pasi i erdhi qytetit rreth e rrotull dhe arriti në vendin e përmendur më lart, asnjeriut nuk i linte dyshim se ai mendonte të ngjitej përmes këtij për t'i rënë qytetit. Brenda në Lis ishin grumbulluar forca të mëdha nga krahinat e afërme ilire, posa kishin dëgjuar se kishte ardhur Filipi. Sa për Akrolisin, kishin aq besim të madh në fortifikimet e tij, sa vetëm një roje të vogël kishin lënë për ta ruajtur.

14 Prandaj, ndërsa po afroheshin maqedonët, vendasit filluan menjëherë të derdhen jashtë mureve të qytetit, duke pasur besim si në numrin e madh të forcave të tyre ashtu edhe në pozitën e fortë, prej natyre, të atyre vendeve. Mbreti mbajti në fushë peltastët, kurse ushtarët e armatosur lehtë i nisi drejt kodrave, për t'u përleshur rreptë me armikun. Ndërsa këta po kryenin urdhërin e mbretit, fati i luftës për një farë kohe mbetej i dyshimtë; por pastaj ushtarët e Filipit, nga vendi i vështirë dhe nga numri i madh i armikut, u detyruan të kthehen prapa dhe të tërhiqen tek peltastët. Vendasit morën guxim nga kjo fitore, i ndoqën ushtarët e Filipit, zbritën në fushë dhe u përleshën me peltastët.

Në këtë kohë ushtarët që ruanin Akrolisin, kujtuan se Filipi po i tërhiqte forcat e veta dhe po bëhej gati të hiqej krejt nga fusha e betejës, duke mos kuptuar se ai mundohej t'i nxirrte jashtë. Të mbështetur, pra, në pozitën e fortë të vendit, lanë pak vetë brenda në Akrolis dhe të tjerët të gjithë u derdhën nga rrugët e ngushta nëpër vendet e sheshuara të fushës, me qëllim që të ndiqnin armikun e t'ia rrëmbenin plaçkën.

Pikërisht në këtë çast, ushtarët e fshehur nga ana e tokës u ngritën, pa i vënë re njeri, u turrën me forcë e shpejtësi kundër këtyre, ndërsa njëkohësisht edhe peltastët e tërhequr u kthyen përsëri dhe i ranë armikut. Të turbulluar nga ky sulm i papritur, ata që kishin dalë nga qyteti Lis u shpërndanë, u tërhoqën dhe hynë brenda në qytet; po ata që kishin zbritur nga Akrolisi, nuk mundën të kthehen prapa, mbasi iu pre rruga prej ushtarëve që kishin zënë pritë. Kështu pra, ngjau kjo e papritur: Akrolisi u zu pa asnjë rrezik, kurse qyteti Lis ra të nesërmen, mbas luftimesh të mëdha kundër sulmeve të rrepta e të tmerrshme të maqedonëve.

Filipi, pra, si pushtoi këto vende, të cilat nuk shpresonte t'i merrte, vuri nën pushtetin e Maqedonisë të gjitha krahinat që ishin rreth e rrotull, kështu që qytetet më të shumta të Ilirisë ia çelën me dashje portat. Sepse pas pushtimit me forcë të fortesave që përmendëm më lart, nuk mbeti më asnjë vend i fortë kundër fuqisë së Filipit, dhe nuk kishte më asnjë siguri për ata që do t'i kundërshtonin atij.

LIBRI IX

22 Çdo gjë që ndodhte në Romë ose në Kartagë varej nga një njeri i vetëm, nga një kokë e vetme; unë e kam fjalën për Hanibalin. Ai i drejtonte vetë veprimet luftarake në Itali; ato të Iberisë, ai, ia besoi vëllait të tij, Hasdrubalit që ishte më i madhi, pastaj Magonit. Ishin ata që vranë dy gjeneralët romakë që komandonin në këto anë.

Në Siqeli ai qeverisi në fillim nëpërmjet Hipokratit pastaj me anë të libiasit Myon.
4 Njëlloj veproi edhe në Helladë e Iliri, me qëllim që t'u krijonte romakëve një shkak
5 tjetër për shqetësim dhe të drejtonte vëmendjen e tyre nga këto anë – lidhi aleancë me Filipin...

LIBRI X

1 **41** Etolët, të cilët mbështeteshin tek mbreti Atal, përhapnin kudo terror dhe sulmonin gjithandej nga toka, kurse Atali e Publi /Sulpic Galba/ vepronin nga deti.
2 Për këtë, ahejt shkuan t'i kërkojnë ndihmë Filipit; sepse, përveç etolëve, ata kishin frikë edhe nga Mahanida që qendronte me ushtrinë e tij në kufirin e Argolidës. Nga
3 ana e tyre beotët, duke pasur frikë flotën armike, i kërkonin një komandant dhe përforcime; por ata që ngulnin këmbë më shumë dhe i luteshin t'i mbronte ishin banorët e Eubesë. Edhe akarnanët e thërrisnin në ndihmë, kurse epirotët i kishin dërguar një delegacion. Nga ana tjetër qarkullonin fjalë se Skerdilaidi dhe Pleurati
4 ishin vënë në marshim; për më tepër thrakët, fqinjë të maqedonëve, dhe sidomos medët, thuhej se kishin ndërmend t'i suleshin këtij vendi menjëherë sa po që mbreti të largohej. Më në fund etolët kishin zënë ngushticat e Thermopylave... me shpresë
5 që t'i prisnin Filipit rrugën dhe ta ndalonin plotësisht që t'u jepte dorën aleatëve të tij të jugut, nga kjo anë...

LIBRI XVIII

12 **1...** Romaku[1] i tha atëherë atij /Filipit / se përgjigja e tij do të ishte e thjeshtë
13 dhe e qartë. Mbreti duhej të zbraste krejt Helladën, t'u kthente gjithë kundërshtarëve të tij robërit dhe të arratisurit e tyre, t'u dorëzonte romakëve tokat e Ilirisë që ishte
14 bërë zot pas paqes së Epirit dhe më në fund t'i kthente Ptolemeut gjithë qytetet, që kishte zënë pas vdekjes së Ptolemeut Filopator.

4 **5...** "Me ç'të drejtë, shtoi Filipi do të më kritikojnë tani që, duke qenë mik i etolëve dhe aleat i Prusisë, kam marrë armët kundër hiasve për t'i ardhur në ndihmë
5 aleatit tim. Dhe duke arritur kulmin e paturpësisë ata guxojnë të vihen në një radhë me romakët, të kërcënojnë maqedonët që të zbrazin gjithë Helladën. Kjo është një
6 kërkesë e tepërt; unë e pranoj me gjithë qejf nga ana e romakëve, por nga ana e
7 etolëve jo. Ç'është pra, vazhdoi ai, kjo Helladë nga e cila ju më urdhëroni të dal? Si i
8 caktoni ju kufijtë e saj? Midis vetë etolëve ka një numër të madh që nuk janë helenë; agrejt, apodotët, amfilohët nuk i përkasin Helladës[2]; atëherë këta m'i lini?".

8 **8...** Pasi Titi la Filipin për të shkuar tek aleatët që t'u paraqiste përfundimet e
9 bisedimeve, deklaroi se mbreti i Maqedonisë ishte gati t'u kthente etolëve Farsalën dhe Larisën, por jo Thebën; Rodit-Perenë por jo Jason dhe Bargylën; ahejve
10 Korinthin dhe Argon, kurse romakëve tha t'u dorëzonte tokat e Ilirisë dhe gjithë robërit...

---

[1] Është fjala për konsullin e vitit 198 para e. s. Tit Kuinkt Flamininin.
[2] Amfilohët banonin në Epir, midis lumit Ahelo dhe Ambrakisë; agrejt në bregun e djathtë të Ahelout, pikërisht në jug të athamanëve; apodotët në jugperëndim të Etolisë, midis kufirit të Lokridës dhe malit Koraks.

9 Ky kompromis nuk kënaqi asnjeri; të gjithë delegatët kundërshtuan dhe kërkuan që Filipi t'u nënshtrohej kushteve të vëna prej të gjithëve, d.m.th. të zbraste gjithë Helladën...

10 Duke parë se Titi ishte i prirur ta çonte çështjen para senatit, delegatët u bashkuan pa ngurruar, me pikëpamjen e tij dhe pranuan që Filipi të dërgonte një përfaqësi në Romë; por vendosën që edhe ata të dërgonin, nga ana e tyre, përfaqësues prej të gjitha shteteve aleate, për të mbrojtur çështjen e tyre në senat dhe për të paraqitur ankimet që kishin ndaj mbretit... Ai /Titi/ i dha /Filipit/ një armëpushim prej dy muajsh, duke i vënë si kusht që nga një anë të niset menjëherë një përfaqësi për në Romë, kurse nga ana tjetër të tërhiqte pa vonesë garnizonet nga Fokida e Lokrida...

12 Senati votoi për vazhdimin e luftës me Filipin...

47 Pas këtyre[1] thirrën gjithë të dërguarit e tjerë të popujve dhe të qyteteve dhe u njoftuan vendimet e këshillit. Kështu prej maqedonëve iu dha autonomia orestëve meqenëse ata gjatë luftës u bashkuan me romakët, kurse perrebejt, dolopët e magnetët i lanë të lirë...

Pleuratit i dhanë Lyhnidin dhe Parthën, qytete të Ilirisë të nënshtruara nga Filipi; Amynandrit i dhanë gjithë fortesat që ai ia kishte shkëputur gjatë luftës Filipit.

LIBRI XX

3 Kur aty nga fillimi i dimrit Antiohu ndodhej në Halkidë, epirotët i dërguan një përfaqësi me në krye Haropin, kurse elejtë me Kalistratin. Epirotët i luteshin të mos i tërhiqte në një luftë kundër Romës, por të kishte parasysh se ata ishin nga të gjithë helenët, fqinjë më të afërt të Italisë; po të mund të garantonte dhe të siguronte Epirin, ata ishin gati t'i hapnin portat e tyre, por nëqoftëse ai nuk e ndiente veten në gjendje të bënte një gjë të tillë aty për aty, ata i luteshin mos të zemërohej nëqoftëse ata kishin frikë të hynin në luftë me Romën. Elejt nga ana e tyre vinin t'i kërkonin ndihmë se kishin frikë nga një sulm i ahejve të cilët u kishin shpallur luftë. Mbreti iu përgjigj epirotëve se do t'u dërgonte përfaqësues për të biseduar me ta mbi interesat e tyre të përbashkëta...

10 Pasi u mor ky vendim, etolët shpejtuan të dërgonin Fenean bashkë me Lucin, për t'ia bërë të ditur atë Manit. Si u prit nga komandanti, ai filloi të mbronte çështjen e etolëve dhe përfundoi, duke thënë se ata kishin vendosur të viheshin në besë të romakëve. "A është vërtet kështu?" pyet Mani. Fenea e siguroi se po. "Në këtë rast, tha romaku, unë kërkoj para së gjithash që asnjë nga ju mos të kalojë në Azi, as duke përfituar nga autoriteti i tij, as nga ndonjë detyrë zyrtare; në radhë të dytë të më dorëzohen Dikearhu dhe epiroti Menestrati, i cili kishte ardhur në Naupakt për të ndihmuar etolët, si dhe Amynandri, mbreti i athamanëve, me njerëzit e tij që kanë tradhëtuar bashkë me të". "Por komandant, kundërshtoi Fenea, kushtet që ti na vë nuk pajtohen as me drejtësinë, as me traditat e helenëve". Mani, jo aq prej zemërimit, sa prej dëshirës për të frikësuar etolët dhe për t'i bërë ata që ta ndienin në ç'gjendje kishin rënë, u tha: "Si, akoma po silleni si helenë, ju doni të më jepni

[1] Pas të dërguarve të Antiohut.

mësime dhe të më diktoni detyrën time, në një kohë kur ju e keni lënë në dorën time këtë punë? Dijeni se unë mund t'ju lidh të gjithëve dhe t'ju hedh hekurat, po të më dojë qejfi"...

LIBRI XXI

11... Roma ka bërë vetë mbretër, bile disave u ka rritur fuqinë e tyre dhe zmadhuar sundimin. Ata[1] përmendnin rastin e Andobalit dhe Kolikut në Iberi, të Masinisës në Libi, të Pleuratit në Iliri; gjithë këta, nga dinastë të vegjël që ishin, Roma i bëri mbretër të dëgjuar...

21... A nuk do t'ishte e çuditshme që një Masinisë, i cili kishte qenë përpara armiku juaj dhe që përfundoi të strehohej tek ju, me disa kalorës, të ketë marrë nga ju sundimin mbi gati gjithë Libinë, pse u qendroi besnik në një luftë të vetme, në atë të Kartagës? Që një Pleurat, i cili nuk kishte bërë gjë më tepër, veçse nuk ju tradhëtoi, të jetë bërë, në saje tuaj, dinasti më i fuqishëm i gjithë Ilirisë? Kurse për mua /Eumenin/ që nëpërmjet stërgjyshërve ju kam bërë shërbimet më të mëdha e më të ndritura, ju nuk tregoni asnjë respekt...[2]

25 Amynandri, mbreti i athamanëve, duke kujtuar se e zuri për jetë fronin e tij, dërgoi dy përfaqësi, njerën në Romë dhe tjetrën tek Scipionët[3], në Azi; ai donte, njëkohësisht, të shfajësohej se kishte siguruar mbretërinë e tij me përkrahjen e etolëve, të shfaqte pakënaqësitë e tij kundër Filipit, dhe sidomos të kërkonte të pranohej përsëri në aleancën romake. Ndërkaq etolët, duke kujtuar se ishte rasti i përshtatshëm për të rimarrë Amfilohinë dhe Aperantinë, vendosën të bënin një ekspeditë në këto dy krahina. Strategu i tyre, Nikandri, mblodhi një ushtri të madhe dhe pushtoi Amfilohinë; pjesa më e madhe e vendit iu dorëzua me dëshirë; ai kaloi, pastaj në Aperanti, e cila iu nënshtrua edhe ajo, pa bërë qendresë; më pas u nis për në Dolopi. Banorët bënë sikur deshën të qendronin pak kohë, për të mos tradhëtuar Filipin, por pas pak, duke kujtuar se ç'u kishte ndodhur athamanëve dhe duke kujtuar sjelljen e Filipit në këtë rrethanë, ata ndërruan qendrim dhe u hodhën në anën e etolëve...

30... Marku hyri në Ambraki dhe i përzuri etolët pa u bërë gjë, por rrëmbeu shtatoret dhe pikturat që ishin në një numër të madh mbasi Ambrakia kishte qenë selia e Pirros. Përveç asaj, këtij i dhuruan një kurorë ari prej njëqind e pesëdhjetë talentesh...

LIBRI XXIII

1... Senati nuk dinte nga t'ia niste për të zgjidhur të gjitha çështjet e veçanta që i paraqiteshin. Kishte përfaqësues të Thesalisë, në përgjithësi dhe të çdo qyteti të saj, në veçanti; kishte nga Perrebia, Athamania, Epiri dhe Iliria. Disa kërkonin t'u ktheheshin tokat, të tjerët skllevërit ose kopetë; disa shfaqnin mendimin se ishin prekur nga që ishte shkelur ndonjë marrëveshje, të tjerë ankoheshin ose pse nuk u jepej e drejta në gjyqet, për arsye se Filipi pengonte veprimin e tyre ose pse ishin

---

[1] Më lart bëhet fjalë për një letër që vëllezërit Scipionë i drejtonin Prusisë, duke i dhënë shpresë se romakët nuk do ta hiqnin nga froni.

[2] Me këto fjalë Eumeni i drejtohet senatit.

[3] P. Kornel Scipion Afrikani dhe vëllai i tij L. Kornel Scipioni.

viktima të një vendimi të turpshëm nga që Filipi kishte korruptuar gjyqtarët. Shkurt u dëgjuan pakënaqësitë më të ndryshme; ishte një ngatërresë nga ku nuk mund të dilej.

LIBRI XXV

6 Kur arriti delegacioni i Rodit, senati e priti dhe e shtyu vendimin e tij. Njëkohësisht dardanët kishin ardhur për të tërhequr vëmendjen e senatit për bastarnët, numri, forca dhe vlera luftarake e të cilëve i shqetësonte; ata i vunë në dukje edhe aleancën e përfunduar nga Perseu me galatët; ata thoshin se kishin frikë nga mbreti i Maqedonisë akoma më shumë se sa nga bastarnët dhe kërkonin ndihmë. Thesalët që ishin me ta i vërtetuan këto thënie dhe iu lutën edhe ata për ndihmë romakëve. Senati vendosi të dërgonte një komision për të shqyrtuar në se frika e tyre ishte me vend. Kjo detyrë iu besua A. Postumit, i cili u nis i shoqëruar nga disa të rinj.

LIBRI XXVII

15 Ja në ç'rrethana Kefali la Epirin dhe u hodh në Maqedoni. Ai kishte kohë që ishte lidhur me shtëpinë mbretërore të këtij vendi; por në këtë kohë rrethanat e detyruan që të preferonte Perseun. Shkaku ishte ky: një epirot i quajtur Harop, burrë i ndershëm dhe mik i romakëve, kishte shkaktuar tërheqjen e Filipit, në kohën kur ky mbret kishte grykat e Epirit; pikërisht në saje të këtij, Titi kishte pushtuar Epirin dhe Maqedoninë. Ai kishte një djalë, Mahatën, i cili pati gjithashtu një djalë që e quajti Harop. Ky Haropi ishte pothuaj akoma fëmijë kur humbi babanë; gjyshi e dërgoi në Romë të pajisur në mënyrë të shkëlqyer për të mësuar gjuhën dhe letërsinë latine; atje ai krijoi lidhje të shumta dhe pas ca kohe u kthye në atdhe. Haropi plak vdiq. I riu, i cili ishte shumë ambicioz dhe i aftë për të gjitha poshtërsitë, filloi të sulmonte dhe diskreditonte burrat e shquar.

16 Ata që ishin me Theodotin dhe Filostratin bënë një punë të keqe dhe shumë të shëmtuar. Kur morën vesh se konsulli romak Aul Hostili po shkonte në Thesali, tek ushtria e tij, kujtuan se po t'ia dorëzonin Aulin Perseut, do t'i jepnin mbretit një provë të madhe besimi dhe në anën tjetër romakëve do t'u bënin një të keqe që aty për aty do ta ndienin shumë. I shkruan, pra, Perseut që të vinte sa më shpejt. Mbreti u nis menjëherë për t'i takuar; por molosët që kishin zënë urën e lumit Aou i prenë rrugën dhe e detyruan të luftonte me ta. Ndërkaq Auli kishte arritur në Fanotë dhe qendroi tek një farë Nestori nga Kropia, duke u dhënë kështu armiqve të tij një rast të volitshëm për t'a goditur në befasi. Me të vërtetë, po të mos e kishte ndihmuar fati, do të ishte zor të shpëtonte. Lumtërisht Nestori e parandjeu rrezikun dhe e detyroi /Aulin/ të largohej për të kaluar përmes Epirit, hipi anijeve dhe shkoi për në Antikyrë, prej nga u nis për në Thesali.

LIBRI XXVIII

8 Perseu dërgoi si përfaqësues, tek mbreti Gent, ilirin Pleurat, i cili ishte mërguar tek ai dhe Adeun nga Beroja, me detyrë që ta vinin në dijeni për ngjarjet e luftës kundër romakëve dhe dardanëve, si dhe për luftën që ai bënte tani kundër

epirotëve dhe ilirëve; përveç asaj, ata duhej t'i kërkonin që të lidhte aleancë dhe miqësi me Perseun dhe Maqedoninë.

3 Ata kaluan malin e Skardit, dhe përshkuan krahinën që quhej "Iliria e shkretuar"; këtë vend pak më parë e kishin prishur maqedonët për të penguar dardanët që të
4 dyndeshin në Iliri (dhe Maqedoni); ata që ishin me Adeun, pas shumë mundimesh, arritën në Skodra. Këtu mësuan se Genti ndodhej në Lis dhe e lajmëruan për ardhjen
5 e tyre. Genti pa humbur kohë dërgoi e i thirri dhe, në pritjen që u bëri, ata i paraqitën qëllimin e ardhjes së tyre. Genti nuk e shikonte me sy të keq idenë e një miqësie me
6 Perseun, po duke mos dashur të merrte detyrime menjëherë, paraqiti si shkak mungesën e armëve dhe pamundësinë t'u bënte luftë romakëve pa të holla. Adeu dhe
7 shokët e tij u kthyen me këtë përgjigje. Perseu ndodhej atëherë në Stubera, ku priste
8 kthimin e atyre që ishin me Pleuratin; ndërkaq ai po shiste plaçkën e luftës, kurse ushtrisë i kishte dhënë pushim. Porsa i bënë të ditur përgjigjen e Gentit, ai nxitoi t'i
9 dërgonte përsëri Adeun, bashkë me Glaukun, një nga rojet e tija personale, dhe Pleuratin, mbasi ky dinte gjuhën ilire; por u dha këtyre po ato udhëzime sikur Genti
10 të mos kishte spjeguar qartë çfarë kërkonte dhe me çfarë kushtesh pranonte të
11 ndërhynte. Pasi u nisën delegatët, edhe ai ngriti lëmin dhe u drejtua me ushtrinë e tij për në Uskanë.

1 **9** Delegatët që u dërguan tek Genti, u kthyen duke mos sjellë asgjë më shumë nga
2 radha e parë; Genti qendronte në vendimin që kishte marrë; ai dëshironte shumë të lidhej me Perseun, por përsëriste se kishte nevojë për të holla. Perseu i dërgoi edhe
3 një herë Hipinë, për t'u marrë vesh përfundimisht mbi kushtet e aleancës së tyre, por pa thënë asnjë fjalë për këtë pikë kryesore, sepse ai mendonte se Genti do të tregohej më i arsyeshëm...

LIBRI XXIX

1 **3** Hipia me shokët që kishte dërguar Perseu si përfaqësues pranë Gentit, për të lidhur aleancë me të, u kthye përpara dimrit dhe i njoftoi mbretit se Genti ishte gati të hynte
2 në luftë me romakët, nëqoftëse i jepnin treqind talente dhe gjithë siguritë e
3 domosdoshme. Perseu, duke gjykuar se bashkëpunimi me Gentin ishte për të një gjë e nevojshme, dërgoi si delegat Pantauhun, njërin nga miqtë e tij më të mirë, dhe e
4 porositi t'i premtonte Gentit shumën që kishte kërkuar, të këmbente me të betimet, pastaj të dërgonte në Maqedoni si peng ata që do të zgjidhte dhe të kërkonte nga Genti që të caktonte edhe ai ata që donte; më në fund e porositi të merrej vesh mbi
5 mënyrën e dërgimit të treqind talenteve. Pantauhu u nis menjëherë dhe arriti në Meteon të Labeatisë; këtu u takua me Gentin dhe pa mundime të mëdha ia mbushi
6 mendjen këtij djaloshi të pranojë propozimet e Perseut. Si u këmbyen betimet dhe u firmua pakti, Genti nisi menjëherë pengjet që kishte zgjedhur Pantauhu dhe bashkë me to Olympionin, i cili duhej të merrte betimin dhe pengjet e Perseut, si dhe disa të
7 tjerë që do të përkujdeseshin për të hollat. Pantauhu e bindi Gentin të dërgonte me ta edhe një përfaqësi, e cila do të bashkohej me atë të Perseut, që do të shkonte në Rod,
8 me qëllim që t'i fuste ata në aleancën e përbashkët. Nëqoftëse kjo do të realizohej dhe rodasit do të futeshin në luftë, nuk do të ishte vështirë për t'i thyer romakët.
9 Genti e pranoi dhe dërgoi si përfaqësues Parmenin me Morhon, të cilëve u dha këto udhëzime: kur të merrnin betimin e Perseut, pengjet e tij, dhe kur të binin në ujdi për paret, të shkonin si delegatë në Rod.

4 Të gjithë këta u nisën për në Maqedoni. Pantauhu, i cili qendroi pranë mbretit të ri, i kujtonte vazhdimisht dhe e nxiste që të mos vonohej në përgatitjet për të qenë gati të mbronte vendet, qytetet dhe aleatët, bile ai e shtynte të përgatitej sidomos për një luftë detare. Meqenëse romakët nuk kishin fare forca detare në brigjet e Epirit dhe të Ilirisë, ai mund të bënte pa vështirësi ç'të donte ose vetë, ose me anën e vartësve të tij. Genti u bind dhe po merrej me përgatitjet për luftë në tokë e në det. Perseu, kur mori vesh se delegatët dhe pengjet e Gentit arritën në Maqedoni, e la me gjithë kalorësinë e tij, lëmin buzë lumit Elpe dhe doli t'i priste në Dion. Këtu si u bashkuan, Perseu bëri betimin përpara gjithë kalorësve të tij; sepse ai donte me gjithë shpirt t'ua bënte të ditur maqedonëve aleancën e tij me Gentin, me shpresë se besimi i tyre do të shtohej nga ky sukses i ri. Pastaj mori në dorëzim pengjet e Gentit dhe të tijat ia dorëzoi Olympionit. Nga këta më të përmendur ishin Limneu, i biri i Polemokratit, dhe Balakri, i biri i Pantauhut. Ai nisi, pastaj, për Pela me qëllim që të merrnin të hollat, njerëzit e ngarkuar për këtë punë; për sa u takon atyre që duhej të shkonin në Rod, ai i dërgoi në Thesalonik, tek Metrodori, duke iu lutur që të ishin gati për t'u nisur. Ndërkaq bindi rodasit që të marrin pjesë në luftë. Si rregulloi këto çështje, dërgoi tek Eumeni si përfaqësues Hierofonin, i cili edhe herë tjetër e kishte kryer këtë detyrë, si edhe tek Antiohu, Telemnastin nga Kreta. Ai donte ta bindte mbretin e Sirisë, që të mos e humbiste rastin që i jepej dhe të mos i shkonte mendja se ambicja dhe krenaria e romakëve ishte e rrezikshme vetëm për Perseun, po të ishte i sigurtë se edhe atë vetë e priste po ai fat, po të mos ndërhynte në këtë kohë, ose për t'i ardhur atij në ndihmë ose, ç'ka do t'ishte më mirë, për t'i dhënë fund luftës.

11 Parmeni dhe Morhu, të dërguarit e Gentit, kishin arritur në Rod të shoqëruar nga Metrodori. Kështilli u mblodh dhe mbajti një seancë shumë të zjarrtë. Dinoni (dhe Polyarati) guxonin tani të merrnin pjesë hapët nga ana e Perseut. Theaideti, nga ana tjetër, e kishte humbur nga të gjitha këto që po ngjanin: prania e anijeve, numri i madh i kalorësve (të vrarë), qëndrimi i ri i Gentit, të gjitha këto kishin bërë që t'a humbiste guximin. Edhe rezultati i mbledhjes qe ai që mund të pritej: rodasit vendosën t'u jepnin të dy mbretërve një përgjigje të favorshme, duke u bërë të ditur se ata ishin të gatshëm t'u shërbenin si ndërmjetës dhe të përpiqeshin që romakët të mos tregoheshin të ngurtë. Pas kësaj, të dërguarit e Gentit u ftuan në gosti ku iu bë një pritje nga më të përzemërtat.

13... Genti, mbret i ilirëve, për shkak se pinte shumë – ai natë e ditë ishte i dehur – bënte veprime të padenja në jetë. Ai vrau vëllanë e tij Platorin, i cili do të martohej me bijën e Monunit[1] dhe u martua vetë me të fejuarën e viktimës së tij. Ai i trajtonte nënshtetasit e tij me ashpërsi të madhe.

LIBRI XXXII

5 (20) Vdekja e Lykiskut bëri që të rikthehet rendi në Etoli dhe t'i jepet fund grindjeve të brendshme; po kështu vdekja e Mnasipit të Koronës rivendosi qetësinë në Beoti dhe ajo e Kremës në Akarnani. Hellada, deri diku, u pastrua me zhdukjen e këtyre të poshtërve që e kishin fëlliqur.

[1] Mbret i dardanëve që tek Tit Livi e gjejmë të shkruar gabim Honun. Po ky autor bijën e tij e quan Etuta (Livi XLIV 30,4)

4 Ndodhi për çudi që edhe epiroti Harop vdiq po atë vit, në Brendis. Trubullirat dhe
5 rrëmuja mbretëruan akoma në Epir si në të kaluarën; sepse egërsia dhe tirania e Haropit nuk pushuan së vepruari që nga fundi i luftës kundër Perseut. Që kur L.
6 Anici e Emil Pauli kishin dënuar ata njerëz të shquar, kundër të cilëve kishin dyshimin më të vogël, një palë me vdekje dhe të tjerët duke i internuar në Romë,
7 Haropi fitoi një pushtet të madh; nuk kishte krime që të mos bënte ai vetë ose me
8 anën e miqve të tij; në këto krime e shtynte mosha e tij shumë e re; për më tepër ka qenë i rrethuar nga kriminelët më të këqij, të tërhequr nga shpresa për t'u pasuruar
9 duke grabitur të tjerët. Ishte krijuar bindja se çdo gjë ai e bënte me pëlqimin e romakëve. Kjo ndodhte se ai kishte lidhje të vjetra në Romë, kurse në vendin e tij me
10 plakun Myrton dhe djalin e tij Nikanor, njerëz të ndershëm, përkrahës të hapët të Romës, që deri atëherë nuk kishin bërë asnjë veprim të keq, por që nuk di se si, ishin
11 bërë ndihmës e bashkëpunëtor të Haropit në veprimet e tij të paligjshme. Herë ai vriste haptas bashkëqytetarët e tij, disa në sheshet publike, të tjerët në shtëpitë e tyre; herë i vriste me anën e vartësve të tij në fusha ose në rrugë; dhe ai merrte pasurinë e
12 gjithë viktimave. Ai përdori pastaj një dredhi tjetër: futi në listat e proskripcioneve[1)]
13 njerëzit më të pausr të të dy sekseve; dhe duke shfrytëzuar frikën që shkaktonte ky kërcënim u merrte para burrave, kurse mëma e tij, Filotida, ua merrte grave; ajo ishte
14 shumë e përshtatshme për të luajtur këtë rol dhe e pasonte me kaq përpikmëri në dhunat e tij, sikur të mos kishte asgjë femërore.

1 **6** Si i zhveshi, sa mundi, gjithë burrat e gratë, që ishin të proskriptuar nuk la pa i
2 nxjerrë edhe para gjyqit të popullit. Proçesi u zhvillua në Foinikë. Qytetarët, disa nga frika, disa të mashtruar nga Haropi, i dënuan të gjithë të akuzuarit jo me internim, por me vdekje, si tradhëtarë të çështjes romake. Por gjithë të dënuarit ikën përjashta;
3 Haropi vetë iku në Romë, i ngarkuar me të holla dhe i shoqëruar prej Myrtonit, me
7 qëllim që t'i sanksiononte, me anë të Senatit, gjithë paudhësitë që kishte bërë...
8 Senati nuk e pranoi kërkesën e Haropit e as nuk i dha ndonjë përgjigje pozitive; i tha vetëm se do të dërgonte njerëz për të bërë hetime në vend mbi ato që kishin ngjarë.
9 Po Haropi këtë përgjigje të romakëve nuk e bëri për fjalë, kur u kthye në Epir; në vend të kësaj formuloi vetë një përgjigje tjetër, ashtu si e dëshironte dhe e shpalli në të katër anët e vendit se romakët i kishin pëlqyer të gjitha veprimet e tij.

1 **9** Banorët e Isës shpesh herë kishin dërguar përfaqësues në Romë, për të njoftuar se delmatët po cënonin vendin e tyre, si edhe qytetet ku shtrihej sundimi i tyre, Epetin
2 dhe Tragyrin; edhe daorset kishin paraqitur po të njëjtat ankesa. Senati ngarkoi Gai
3 Fanin të shikonte gjendjen në Iliri dhe sidomos si silleshin delmatët. Sa ishte gjallë
4 Pleurati, këta i bindeshin atij; por si vdiq ky dhe në vend të tij hipi në fron Genti, ata shkundën zgjedhën, u shpallën luftë fqinjëve dhe nënshtruan disa prej tyre, të cilëve
5 u merrnin tribut në bagëti dhe grurë. Ky ishte qëllimi i misionit të Fanit.

13 Kur u kthye nga Iliria, Gai Fani raportoi se delmatët jo vetëm që nuk donin të
1 ndreqnin gabimet kundrejt atyre që ankoheshin se vazhdimisht pësonin prej tyre, por as që donin ta dëgjonin atë, duke thënë se s'kishin të bënin fare me Romën. Ai shtoi
2 se delmatët jo vetëm nuk i dhanë vend për të fjetur e për të ngrënë, por i vodhën edhe kuajt që i kishte marrë nga një qytet tjetër; bile ishin gati t'i bënin edhe ndonjë të keqe të madhe, po të mos kishte ikur fshehurazi.

[1)] Të nxjerrë publikisht jashtë ligjit.

4 Senati i dëgjoi këto me kujdes të madh, u zemërua me kryelartësinë dhe egërsinë e delmatëve, por mbi të gjitha mendoi se tani ishte rasti më i mirë për t'u shpallur luftë, dhe për këtë kishte shumë shkaqe. Pjesën e Ilirisë që ishte buzë Adriatikut romakët e
5 kishin lënë krejt pas dore, që prej kohës që dëbuan Demeter Farin; nga ana tjetër,
6 Senati nuk donte në asnjë mënyrë që t'i linte burrat të ftoheshin nga një paqe e gjatë,
7 se kishin kaluar dymbëdhjetë vjet që nga koha e luftës kundër Perseut dhe ekspeditës në Maqedoni. Duke ndërmarrë një fushatë kundër delmatëve, në njërën anë do të
8 nxitnin, do të ngrinin shpirtin luftarak të popullit të tyre dhe në anën tjetër do t'u jepnin një mësim ilirëve dhe do t'i detyronin t'i nënshtroheshin sundimit të Romës. Për këto arsye romakët u shpallën luftë delmatëve, po përpara popujve të tjerë
9 hiqeshin se e bënin këtë për shkak të sjelljes së keqe të delmatëve ndaj përfaqësuesve të tyre.

1 **14** Në këto e sipër, erdhën përfaqësuesit nga Epiri, të dërguar, një palë nga ata që
2 sundonin në Foinike, kurse të tjerët, nga të arratisurit. Pasi i ballafaqoi të dy palët Senati u përgjigj se do t'u jepte udhëzime, për sa i përket vendit të tyre, delegatëve që do të dërgonte në Iliri me G. Marcin[1)]

[1)] Konsull në vitin 156 para e. sonë.

SKYMNI

Skymni është gjeograf grek nga Hiosi që jetoi në shek. III-II para e.s. Këtij autori, pa të drejtë, i atribuojnë veprën e njohur me emrin "Periegesis", lat. Orbis descriptio (Përshkrimi i botës).

Autori i vërtetë i "Periegesit" i cili ka jetuar me sa duket në shek. e I para e.s. nuk njihet, prandaj zakonisht quhet Pseudo-Skymni.

"Periegesis" është një vepër e shkruar në vargje, prej së cilës janë ruajtur vetëm pak fragmente. Ajo përbëhej prej disa librash dhe ndahej, me sa duket, në dy pjesë të veçanta Evropa dhe Azia.

Hartuesi i saj ka shfrytëzuar burime të shek. IV dhe në disa raste edhe të shekujve V e VI para e.s. Autorët më të preferuar të tij kanë qenë Herodoti, Efori, Theopompi, Timeu dhe Eratostheni. Me rëndësi është fakti se në "Periegesis" nuk përmendet asnjë ngjarje pas shekullit IV para e.s.

Nga fragmentet e ruajtura nga kjo vepër gjejmë edhe të dhëna për gjeografinë dhe historinë e Ilirisë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Geographi Graeci Minores Joannes Franciscus Gail. Volumen secundum. Parisiis 1828.

SCYMNI CHII

ORBIS DESCRIPTIO

(Përshkrimi i botës)

EVROPA

Pastaj vjen një ishull i vogël që quhet
Erythea; ai nuk është shumë i gjatë,
por ka tufa gjedhësh dhe bagëtish të tjera
edhe dema si të egyptasve
dhe si ato që janë në Epir te thesprotët
.....
Fill pas Italisë ngushtica e Jonit
gjendet; dhe duke zbritur në drejtim të hyrjes
banojnë japygët. Pas tyre vijnë oinotrët
Brentesi liman i mesapëve,
kurse përkundrejt tyre janë malet Keraune
Në mbrendi banojnë ombrikët [them],
për këta thonë se bëjnë një jetë luksoze
duke jetuar njësoj me lydët.
Pastaj vjen i quajturi det Adriatik.
Theopompi përshkruan pozicionin e tij;

ai bashkohet me detin Jon
dhe ka ishuj të ngjashëm me Kykladet;
Disa prej tyre quhen Apsyrtide,
Elektride, të tjerat Liburnide.
Thonë se rreth detit Adriatik
banon një shumicë e madhe barbarësh
pothuajse njëmilion e pesëqindmijë banorë
dhe kanë një tokë shumë të mirë dhe pjellore
se aty, si thonë, edhe bagëtia pjellin binjakë.
Era që kalon nëpër detin e Pontit
ndryshohet mbi tokën e tyre, ndonëse janë afër.
Nuk fryn me dëborë, as nuk është shumë e ftohtë,
por qendron gjer në fund krejt e lagët;
është e rrëmbyer, ndryshon dhe bëhet e furishme
sidomos në verë me shkrepëtima,
rrufe dhe me ato që aty quhen
shtrëngata.
.....
Pas enetëve[1] vijnë thrakët që quhen istrë,
kundrejt këtyre ndodhen dy ishuj,

[1] Venetët

të cilët duket se nxjerrin kallaj shumë të mirë.
Mbi ta janë hymanët e mentorët
dhe Eridani që nxjerr qelibar shumë të bukur,
për të cilin thonë se është lot i ngurosur,
shumë i kulluar dhe që është një farë lëngu plepash
.....
Pastaj vjen Iliria, një tokë e gjatë
me shumë popuj brenda. Thonë se populsia e saj është shumë e madhe;
nga këta popuj disa banojnë në viset e brendshme,
duke lëruar tokën,
disa të tjerë anës së detit Adriatik.
Një palë nga këta u binden pushtetit të basilejve,
disa të tjerë monarkëve;
dhe një palë tjetër vetësundohen. Thonë se këta i nderojnë shumë perënditë,
se janë shumë të drejtë dhe mikpritës,
se e duan jetën shoqërore
dhe janë të shtënë pas një jete shumë të hijshme.
Jo larg tyre ndodhet ishulli Far
i themeluar nga banorët e ishullit Par dhe e quajtura
Kerkyra e Zezë, ku u vendosën knidas për banim.
Kjo tokë ka një liqen
të madh, të cilin ata e quajnë Lyhnid.
Shumë afër ndodhet një ishull ku thuhet
se erdhi Diomedi dhe vdiq,
prandaj ky ishull quhet Diomedea.
Sipër këtyre banojnë brygët barbarë.
Anës detit është Epidamni qytet
helen, të cilin si duket e themeloi Korkyra.
Më sipër nga brygët banojnë të quajturit enkelej
në krye të cilëve dikur pat qenë Kadmi.
Pranë këtyre është Apollonia,
e themeluar prej korinthasve dhe korkyrasve,
dhe Oriku, qytet Helen në buzë të detit
këtë e ndërtuan eubeasit,
të cilët i hodhi këtu dallga kur ktheheshin nga Troja.
Pastaj vijnë popullsitë e thesprotëve dhe të kaonëve,
barbarë të cilët nuk zënë shumë vend.
Ishulli Korkyra ndodhet kundrejt Thesprotisë.
Pas Thesprotisë janë të quajturit molosë,
të cilët dikur i solli këtu Pirrua,
i biri i Neoptolemit; aty është edhe Dodona,
faltore e Zeusit, themeluar prej pellazgëve.
Në viset e brendshme banojnë barbarë të përzier,
për të cilët thonë se edhe banojnë pranë faltores.
Pas molosëve vjen Ambrakia, koloni e korinthasve,
i pari që i vuri themelet e kësaj ka qenë djali i Kypselit
Gorgoja...

APOLLODORI

Shkrimtar grek i cili lindi në Athinë rreth vitit 180 dhe vdiq rreth vitit 109 para e. sonë. Ai qe nxënës i Aristarhut dhe një nga dijetarët më të shumanshëm të Greqisë. Ai shkroi shumë vepra e traktate në prozë e në poezi, por prej tyre kanë arritur deri në ditët tona vetëm një pjesë. Një ndër veprat më të rëndësishme të tij "Kronikat", e shkruar në vargje, paraqet një grumbullim ngjarjesh që përfshijnë kohën nga shkatërrimi i Trojës deri në pushtimin e Greqisë nga Roma. Traktati i tij "Peri theon" (Mbi perënditë) në 24 libra është ruajtur vetëm në pak fragmente, të cilat megjithatë janë një burim i dorës së parë për studimin e mitologjisë antike. Apollodorit i atribuohet edhe e ashtuquajtura "Biblioteka", vepër e formuar shumë më vonë, rreth shekujve I-II të e. sonë, në të cilën përshkruhen mitet kryesore të Greqisë së vjetër. Në këtë vepër të fundit ne gjejmë edhe disa të dhëna për Ilirinë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Mythographi Graeci vol. I *Apollodori Bibliotheca* Pediasimi Libellus de duodecim Herculis laboribus, edidit Richardus Wagner, editio altera. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1926

APOLLODORI

BIBLIOTHECA

LIBRI I

137 (9,25,3) Përsa i përket kolhëve që ishin dërguar për të ndjekur anijen[1], dhe që nuk kishin mundur ta arrinin, disa u vendosën në mallet Keraune; të tjerë të hedhur në brigjet e Ilirisë u vendosën në ishujt Apsyrtide; disa të tjerë arritën gjer te ishulli i fajakëve ku u gjetën argonautët...

LIBRI II

7 (1,3,5) ... Atëherë Hera dërgoi një zekth, i cili si iu ngjit lopës e bëri që ajo të hidhej në det dhe prej saj ky (det) mori emrin Jon[2]. Ajo përshkoi pastaj Ilirinë dhe duke kapërcyer malin Hajmon, kaloi me not ngushticën e Thrakisë, që për shkak të saj e quajnë tani Bospor...

114 (5,11,3) ... *[Herakliu]* kaloi pastaj tek ilirët dhe shkoi tek lumi Herydan, ku pa nymfet, të bijat e Zeusit e të Themidës...

149 (7,6,1) ... Herakliu bëri së bashku me kalydonët luftë kundër thesprotëve dhe pushtoi qytetin Efyra, mbret i të cilit ishte Fyla.

LIBRI III

39 (5,4,2) Kadmi bashkë me Harmoninë la Thebën dhe erdhi te enhelejt. Këtyre të fundit u kishin rënë më qafë ilirët dhe Hyu u kish thënë se do t'i mundnin ilirët nëqoftëse do të merrnin për udhëheqës Kadmin e Harmoninë. Ata iu bindën porosisë hyjnore dhe caktuan si prijës kundër ilirëve Kadmin me Harmoninë; gjatë luftës fituan enhelejt e udhëhequr nga Kadmi, të cilin e zgjodhën mbret; ky pat një djalë me emrin Ilir. Po më vonë bashkë me Harmoninë u kthye përsëri në dragua dhe u dërgua prej Zeusit në fushën Elyse.

93 (7,7,1) Pasi i treguan të gjitha këto s'ëmës, ata[3] shkuan sipas këshillave të Ahelout, të vendosnin në tempullin e Delfit brezin dhe peplosin. Prej andej shkuan në Epir dhe mblodhën banorë për të populluar një vend të cilit i dhanë emrin Akarnani...

---

[1] Anijen e argonautëve.

[2] Fjala është për Jo-në, priftëreshë e Herës; Hera e zuri Zeusin bashkë me Jonë, por Zeusi e ktheu Jonë në një lopë të bardhë.

[3] Amfoteri dhe Akarnani të bijtë e Alkmajonit dhe nymfes Kaliroe.

12 **5** Neoptolemi si qendroi dy ditë në Tened, sipas porosisë së Thetidës, u nis në këmbë bashkë me Helenin për te molosët; varrosi Foiniken e cila vdiq rrugës, dhe si fitoi betejën u bë mbret i molosëve dhe lindi nga Andromaka Molosin. Kurse Heleni ndërtoi në Molosi një qytet dhe banoi aty. Neoptolemi i dha atij për grua t'ëmën, Deidamenë. Pileu i dëbuar prej Fthias nga djemtë e Akastit vdiq, mbretërinë e babait e mori Neoptolemi...

5b ... Feidipi bashkë me koasit, i mërguar në Andron, u vendos më vonë në Qipro. Mbasi vdiq Helefenori në Trojë, ata që ishin me të, duke u fshehur buzë gjirit Jon, u vendosën në Apollonine e Epirit...

34 **7** /Odhiseu/ pasi bëri fli për nder të Hades, Persefonës dhe Theirezisë, duke kaluar më këmbë nëpër Epir arriti tek thesprotët dhe sipas orakullit të Theirezisë zbuti zemërimin e Poseidonit me flijime. Kalidika, që ishte në atë kohë mbretëresha e thesprotëve, i kërkoi atij që të qendronte, duke i premtuar mbretërinë dhe pasi erdhi tek ajo lindi Polypoitën. Ky mbretëroi me Kalidikën e thesprotëve dhe mundi me luftë ushtrinë e perioikëve...

40 ... Ka edhe nga ata që thonë se njerëzit e tij iu lutën Odiseut që të merrte si gjykatës, në emër të atyre që kishin humbur, Neoptolemin i cili mbretëronte në ishujt përkarshi Epirit.

VARRONI

Mark Terent Varroni është një nga shkrimtarët më të shumanshëm dhe më prodhimtar të kohës antike. Lindi në Reate (Rieti) në vitin 116 para e. sonë dhe vdiq në një moshë afërsisht 90 vjeçare, në vitin 27 para e. sonë. Pati si mësues L. El Stilon dhe filozofin Antioh nga Askalona. Mori pjesë aktive në jetën shoqërore dhe politike; ushtroi ofiqe të ndryshme civile dhe ushtarake. Qe mik i ngushtë i Pompeut tek i cili shërbeu dhe si kuestor dhe legat në ndërmarrjet e ndryshme luftarake; më vonë u zgjodh tribun i plebit. Gjatë luftës civile, në vitin 49 para e. sonë komandoi në Spanjë një ushtri kundër Cezarit prej të cilit u zu rob. Pas kësaj date, gjatë luftës civile, e gjejmë Varronin së bashku me Ciceronin dhe Katonin në Dyrrah. Pas betejës së Farsalës pajtohet me Cezarin, i cili e ngarkon me organizimin e bibliotekave publike në Romë. Në vitin 43, mbasi i konfiskohet shtëpia nga Antoni, emri i Varronit shënohet në listën e të ndjekurve. Ai arriti të ikë, por pjesa më e madhe e veprave dhe dorëshkrimeve të tij u zhduk.

Varroni shkroi mbi 70 punime të shpërndara afërsisht në 620 libra. Një nga veprat e tij historike të rëndësishme ishte "Antiquitates rerum humanarum et divinarum" (Vjetërsitë e gjerave njerëzore dhe hyjnore), vepër kjo e humbur, por shpesh e përmendur nga shkrimtarët e tjerë. Në veprën e tij Varroni i kushton një rëndësi të veçantë përpunimit të kronologjisë. Ai e çon themelimin e Romës në vitin e tretë të olimpiadës së gjashtë (754-753 para e. sonë).

Nga veprat e shumta të tij, plotësisht të ruajtura kanë arritur traktatet mbi ekonominë fshatare (De re rustica) në tre libra, dhe mbi gjuhën latine (De lingua latina).

Në veprën mbi ekonominë fshatare të cilën ai e shkroi në trajtë dialogu në një moshë të thyer, Varroni jep mendime të vlefshme mbi kultivimin e tokës, mbi rritjen e kafshëve shtëpiake dhe të shpendëve, të bletëve, etj. Ndonjë nga këto dialoge zhvillohet edhe në Epir ku, sikurse dihet, blegtoria kishte arritur në atë kohë një shkallë relativisht të lartë zhvillimi.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
M. Terentii Varronis, De re rustica. Romanorum scriptorum corpus Italicum, curante Hectore Romagnoli. Milano 1930.

M. TERENTII VARRONIS

DE RE RUSTICA

(Mbi ekonominë fshatare)

LIBRI I

17 ... Tani do të tregoj se me çfarë mjetesh punohen tokat. Disa, këto mjete i ndajnë në dy grupe: në njerëzit dhe në veglat e punës, pa të cilat nuk mund të punohet; të tjerët i ndajnë llojet e veglave në tre: zanorë, gjysmëzanorë dhe të heshtur. Në zanorë hyjnë skllevët, në gjysmëzanorë hyjnë qetë dhe në të heshtur – qerret. Të gjitha tokat punohen nga skllevër ose njerëz të lirë, ose nga të dy palët bashkë; nga të lirët ose kur i punojnë vetë siç bëjnë shumë të varfër me familjarët e tyre, ose me njerëz të paguar, atëherë kur me të lirët kryejnë punët më të rëndësishme siç janë vjeljet e korrjet, dhe këta quhen prej tonëve punëtorë[1]; këta edhe sot gjenden me shumicë në Azi, në Egjipt dhe në Ilirik. Mbi të gjitha këto dua të them se është më mirë që vendet e vështira të punohen me njerëz me pagesë se sa me skllevër, gjithashtu edhe në vendet e shëndosha ata të ngarkohen me punët bujqësore më të rënda siç janë tharja e frutave, vjeljet e korrjet. Dhe si duhet të jenë na e thotë Kasi; duhen gjetur punëtorë që durojnë lodhje, që nuk kanë më tepër se njëzetedy vjeç, e me prirje për bujqësi. Mund të hetohet duke e ngarkuar me punë të tjera dhe duke e pyetur njërin nga skllevërit e ri se me se merreshin tek zotëria e mëparshëm. Skllevërit nuk duhet të jenë as frikacakë, as të guximshëm. Përgjegjësit duhet të dinë shkrim e këndim, të jenë të njerëzishëm, të ndershëm dhe më të mëdhenj në moshë se sa punëtorët për të cilët fola, mbasi ata u binden atyre më me qejf se një tjetri që është më i ri. Mbi të gjitha është mirë që përgjegjësit të kenë njohuri mbi punimet bujqësore, mbasi nuk duhet vetëm të komandojnë, por edhe të punojnë, për të dhënë shembull dhe të kuptojnë të tjerët se nuk urdhërojnë kot, të dinë më shumë se ata në teori dhe në praktikë. Nuk duhet t'i urdhërojnë aq me shkop, se sa me fjalë, kur mund të arrihet i njëjti rezultat. As nuk duhet të jenë shumica nga e njëjta kombësi, se nga kjo lindin grindje të brendshme shumë të forta. Përgjegjësve u duhet shtuar zelli me anë shpërblimesh, dhe duhet bërë çmos që të kenë pekule e bashkëshorte skllave me të cilat të lindin fëmijë. Kështu bëhen më të fortë dhe lidhen më mirë me tokën. Pikërisht për këto lidhje familjet epirote janë më të përmendura dhe më të kushtueshme.

---

[1] Në tekstin latinisht quhen *oberari.*

LIBRI II

Hyrje ... Për blegtorinë do të flas shkurt dhe në mënyrë të përgjithshme, duke u mbështetur në bisedat që patëm me ata që kishin shumë bagëti në Epir, kur unë, në kohën e luftës kundër piratëve, komandoja flotën e Greqisë[1] ndërmjet ishullit Delos dhe Siqelisë.

1 ... Ne të gjitha këto do t'ua tregojmë, tha Skrofa[2], por me kusht që edhe ju epirotë, si barinj të aftë që jeni për mbajtjen e bagëtisë të na shpërbleni, duke na shtruar këtu përpara atë që dini. Sepse asnjë nuk mund t'i dijë të gjitha...

... Qé shumë të egër ka në një numër të madh edhe sot në Dardani, Medi dhe Thraki...

2 Tani që ne e paraqitëm mendimin tonë dhe çështja e blegtorisë u përcaktua, na flitni ju o epriotë ndonjë gjë tjetër që të shohim se ç'janë në gjendje të bëjnë barinjtë nga Pergami[3] dhe Maledi...

... Përsa i përket numrit [të një tufe] kush e jep më të madh, kush më të vogël. Për këtë nuk ka një rregull të caktuar. Por në Epir thuajse të gjithë veprojnë në mënyrë që për çdo njëqind dele të kenë një bari dhe dy për po kaq dhi.

5 ... Qetë e tejdetit, të Epirit, nuk janë vetëm më të mirët e gjithë Greqisë, por edhe të Italisë, megjithëse disa prej atyre italikë, të cilët thonë se janë më të mëdhenj, përdoren për flijime dhe shërbejnë për ceremonitë në nderim të perëndive...

9 ... [Qentë] duhet të jenë të racës së mirë. Prandaj sipas krahinave nga ata vijnë, marrin edhe emrin: lakonë, epirotë, salentinë...

10 ... Për ata që banojnë në bjeshkë dhe në vende pyjore dhe mbrohen nga shirat jo nëpër vila[4], por në kasollet e para që hasin, shumë vetë e quajnë më të dobishme që t'u jepen atyre me vehte gra, të cilat duke shkuar pas kopesë t'u bëjnë të hanë barinjve dhe t'i lidhin pas punës. Por duhet që këto gra të jenë të forta, të mos jenë të turpëshme dhe që në punë të mos mbeten mbrapa nga burrat, siç ndodh në shumë vende. Në Iliri ka të tilla që ruajnë dhentë ose shkojnë për dru, ose gatuajnë, ose ruajnë kasollen. Sa për rritjen e fëmijëve them se duhet të bëjnë njësoj si mëndëset ashtu edhe mëmat. Atëherë [Tremeli] u kthye nga unë e më tha: "Siç kam dëgjuar, atëherë kur ti ndodheshe tek liburnët, ke parë gra të martuara, të ngarkuara me dru dhe që në të njëjtën kohë mbanin në duar kush një, kush dy fëmijë, sikur të donin të tregonin se lehonat tona, të cilat dergjen ditë të tëra, janë të dobëta dhe për t'u përbuzur". Dhe unë ja ktheva: "Po, në Iliri ndodh diçka tjetër: shpesh një grua shtatzënë, kur i vjen për të pjellë, largohet pak nga vendi i punës dhe pasi lirohet nga fëmija, e sjell thuajse nuk e lindi por e gjeti. Gjithashtu edhe vajzave, ndonjëherë njëzet vjeçare që atje i quajnë virgjëresha, zakoni nuk ua ndalon, që para martesës të shkojnë me atë që duan, të enden vetëm dhe të kenë fëmijë..."

---

[1] Është fjala për flotën romake që vepronte në ujrat e Greqisë.
[2] Në formë dialogu Varoni jep këshilla si duhen mbajtur bagëtitë.
[3] Është fjala për krahinën në afërsitë e Butrintit. Shih edhe Verge. Aen. 336, 350.
[4] Vila antike përfshinë banesën dhe ndërtimet anekse me karakter ekonomik.

CICERONI

Mark Tul Ciceroni lindi pranë Arpinit me 3 janar të vitit 106 para e. sonë. Në Romë studjoi për drejtësi dhe retorikë. Pas një udhëtimi që bëri në Greqi dhe veçanërisht në Athinë e Rod, ai i përsosi njohuritë e tija në artin e oratorisë dhe në filozofi. Në vitin 63 para e. sonë, Ciceroni arriti të zërë postin më të lartë në shtet, të bëhet konsul. Gjatë konsulatës, ai zbuloi komplotin e Katilinës, por më vonë, në vitin 59 para e. sonë ra viktimë e intrigave të kundërshtarëve të tij, prej të cilëve u dërgua në mërgim. Pas dy vjetësh ai u kthye rishtas në Romë ku u muar kryesisht me studime retorike dhe filozofike. Gjatë luftës civile Ciceroni mbajti anën e Pompeut, pasi ai kujtonte se vetëm kështu mund të mbrohej çështja e republikës. Me vrasjen e Cezarit, Ciceroni u bë një nga krerët e partisë së senatit, që luftonte Mark Antonin, agjentët e të cilit e vranë në vitin 43 para e. sonë.

Ciceroni u dallua gjatë jetës së tij, para së gjithash, si orator. Fjalimet e tija të mbajtura me raste të ndryshme, si burrë shteti dhe si avokat, dallohen për fuqinë bindëse, si dhe forcën tërheqëse të fjalës. Korrespondenca dhe fjalimet e Ciceronit formojnë një burim të rëndësishëm historik pasi ndihmojnë jo vetëm që të njihemi me personalitetin e vetë autorit, por dhe me periudhën plot ngjarje të kohës para Augustit.

Ai shkroi edhe një seri veprash si: "De oratore" (Mbi oratorinë), "De republica" (Mbi shtetin), "De senectute" (Mbi pleqërinë), "De amicitia" (Mbi miqësinë), etj.

Gjuha e Ciceronit është e zgjedhur dhe shumë e përpunuar, stili i tij i qartë dhe i bukur, mendimet e ilustruara me figura shumë tërheqëse gjuhësore.

Në korrespondencën e Ciceronit me mikun e tij të ngushtë Pompon Atikun, i cili jetonte në atë kohë në pronën e tij të madhe në territorin fshatar të Buthrotit, mësojmë për vendosjen e ushtarëve veteranë në tokat e Atikut dhe përpjekjet e këtij të fundit për të shpëtuar pronat. Po ashtu edhe në akuzat e tij të drejtuara kundër Pizonit, sundimtarit të provincës maqedone, ne gjejmë disa të dhëna të rëndësishme për madhështinë e pasurinë e Dyrrahit dhe Apollonisë, në të cilat ai jetoi për një kohë, për praninë e latifundeve në Epir qysh në epokën republikane, për shfrytëzimin e krahinave dhe qyteteve të Ilirisë nga sundimtarët e provincës maqedone, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Ciceronis Epistulae,* Romanorum scriptorum corpus Italicum curante Hectore Romagnoli. La Santa (Milano) 1927-1928.
2) *Ciceronis in Marcum Antonium Philippicae XIV,* Romanorum scriptorum corpus Italicum curante Hectore Romagnoli. Villa Santa (Milano) 1931.
3) *Ciceronis Orationes,* Romanorum scriptorum corpus Italicum curante Hectore Romagnoli. Villa Santa (Milano) 1930-1931.

CICERO

1) EPISTOLAE

(Letrat)

Ad Familiares.

(Njerëzve të familjes)

1 **14** Unë erdha në Dyrrah për arsye se ky është edhe qytet i lirë dhe besnik ndaj meje dhe i vendosur afër Italisë. Por nëqoftëse popullsia e madhe e këtij vendi do të më shqetësojë, do të iki në një vend tjetër dhe do të shkruaj.

Ad Atticum

(Atikut)

5 **1** Gëzohem që ti je i kënaqur nga ajo që ke blerë në Epir[1]. Ti si më i mençur u
6 rregullove me shtëpi në Buthrot. Por më beso, ky qytet i antasve, ku gjendem unë, i ngjan shumë municipit tënd.

16 Më përshkruaj, të lutem, Amalteun[2] tënd: si është zbukuruar, çfarë pozicioni ka? Dërgomë po ashtu poema e tregime që ke mbledhur si dhe për vetë Amalteun. Unë dua të ndërtoj një Amalté në pronën time në Arpin. Po të dërgoj diçka nga veprat e mia. Unë nuk kam përfunduar akoma asnjë...

7 **3.** Nëqoftëse ti nxiton, sidoqoftë do të më arrish, sepse unë ose do të kem sosur në Epir, ose do të kaloj pa u ngutur nëpër Kandavi.

8 **4** ... Pra dije se Anti është për Romëni që Buthroti është për Korkyrën..

14 **14** ... Unë do të bëj çdo gjë të mundur për të nxjerrë për çështjen e Buthrotit dekretin që ti dëshiron.

17 ... Do qielli që unë të mund të takoj Antonin për të folë për çështjen e Buthrotit.

19 ... Nëqoftëse do të takoj Antonin nuk do të harroj çeshtjen e Buthrotit.

---

[1] Është fjala për blerje tokash.

[2] Amalteu ishte vila që Atiku kishte në Buthrot. Ajo kishte marrë emrin nga nymfa Amaltea që sipas mitologjisë helene kishte ushqyer Zeusin fëmijë.

20 ... Në lidhje me ankesën tënde për Buthrotin, Antoni erdhi në Misenë kur unë isha në Pompei.

2 **15** ... Lajmësi yt më dha një letër; është e tepërt të ngulësh këmbë për Buthrotin. Kjo punë s'ka qenë as ka për të qenë për ty kaq për zemër sa për mua. Unë iu vura kësaj pune qysh në fillim si një gjëje që më shqetësonte më shumë në botë.
... Jam i magjepsur me të vërtetë për rrugën që po merr çështja e Buthrotit.
12 "Ciceroni, të dashurit të tij Dolabelës, konsul".[1)]
14 Kur unë mësova nga letrat e Atikut tonë përçapjen tënde dhe shërbimin e rëndësishëm që i ke bërë atij, dhe kur ti vetë më shkrove se bëre atë që deshëm ne, po shpejtoj të të falënderoj me letër e të të them se asgjë nuk do të më kënaqte më tepër se kjo. Vetë Atiku erdhi në Tuskul apostafat për të më folur për mirënjohjen e tij, për të më thënë se sa është prekur nga zelli që ke treguar në çështjen e Buthrotit dhe nga dashuria e veçantë e jote. Nuk mundem që të mos t'i shpreh edhe një herë ndjenjat e mija dhe të tij. Nga të gjitha provat e interesimit dhe të lidhjes me mua o Dolabelë, ti e di mirë që asgjë nuk do të më pëlqente dhe nuk do të më prekte më tepër se ajo që tregon se sa unë të dua dhe sa ti më do. Në saje tënde çështja dhe qyteti i Buthrotit do të shpëtojnë, tani kjo punë duhet vazhduar. Ata janë nën mbrojtjen tënde. Ti e di, sa herë të kam porositur; nuk mbetet veçse që të lutem që të vazhdosh mbrojtjen tënde dhe për t'i mbrojtur të ushtrosh autoritetin tënd. Nëqoftëse pranon për dashuri që ke për mua dhe nëqoftëse buthrotasit mund të mbështeten tek ti, në këtë mënyrë ti bëhesh garancia e qetësisë së tyre dhe përgjithmonë liron Atikun e mua nga një kujdes e torturë e madhe.
15 ... Rafshin të gjitha të këqijat mbi L. Antonin, nëqoftëse është e vërtetë që ai ua do të keqen buthrotasve.

1 **16** ... Çështja e Buthrotit nuk është e panjohur për ta, unë ua kam thënë shpesh dhe po ju kujtoj edhe njëherë.[2)]
Qëkurse u bë e njohur se tokat e Buthrotit u ishin caktuar ushtarëve, Atiku i prekur hartoi një ankesë. M'a dha mua për t'ia dhënë Cezarit. Atë ditë unë isha për darkë tek ai. Lutjen e tij ia dhashë Cezarit, i cili e pranoi dhe iu përgjegj Atikut që ajo që kërkonte ishte e drejtë, por duhej që buthrotasit të paguanin tepricën e taksës së tyre kur të vinte afati...
... Pas kësaj unë u habita që jo vetëm Cezari i kishte lënë të mblidheshin ata që kërkonin toka në Buthrot, por ju kishte caktuar ju t'i dorëzonit ato... Pasi Cezari nxori një dekret në favor të buthrotasve, në të cilin vura emrin si dëshmitar bashkë me persona të tjerë të lartë, na premtoi se kur ushtarët veteranë të kenë kaluar detin do t'u jepte toka të tjera, por ai pas pak vdiq. Pastaj, sikurse e dini (ju ishit të pranishëm kur një dekret i senatit ngarkonte konsujt të njiheshin me veprimet e Cezarit) çështja u shty për në 1 Korrik. Ky dekret u konfirmua me datën 2 të po atij muaji nga një ligj që i ngarkonte konsujt të njihnin atë që Cezari kishte bërë, dekretuar e vendosur. Çështja e Buthrotit iu kalua konsujve. Ata lexuan dekretin dhe shumë shkresa të nxjerra nga Cezari; konsujt si u këshilluan, vendosën në favor të buthrotasve.

[1)] Ciceroni i dërgon Atikut letrën që i kishte shkruar Dolabelës. Në të gjitha letrat e dhëna këtu pasqyrohet përpjekja e Atikut dhe njëkohësisht ndërhyrja e Ciceronit për të ndaluar që në pronat e Atikut të vendosen ushtarë veteranë.
[2)] Cicerni i dërgon Tit Pompon Atikut që kishte pronat e tij pranë Buthrotit kopje të letrave të dërguara L. Plaucit, të caktuar si pretor për zgjidhjen e çështjes së Buthrotit.

2) ORATIONES
(Ligjeratat)

In M. Antonium Philippicae

(Filipiket kundër M. Antoni)

11 ... Ka akoma më, o senatorë. Gai Antoni mban edhe M. Brutin, i cili ka pushtuar Apollonin̈ë, qytet i madh e hijerëndë; besoj se ka pushtuar Bylisin ka pushtuar Amantinë, kërcënon Epirin dhe është te portat e Orikut...

In Pisonem

(Kundër Pisonit)

34 ... Ne i njohim krimet që ke bërë me arritjen tënde, kur pranove të holla nga dyrrahasit për vrasjen e mikut tënd Platorit; ti rrënove shtëpinë e atij, të cilit i kishe dhënë gjakun dhe pasi more nga ai skllevër muzikantë dhe dhurata të tjera, ti e qetësove për frikën e dyshimin e madh të tij, dhe në besë tënde e detyrove të vinte në Thesalonik. Atje ti nuk e bëre të vdesë sipas zakonit të të parëve tanë, edhe sikur ai i mjeri të kishte pranuar më parë të vdiste nga goditja e sëpatës së mikut të tij, por urdhërove mjekun, të cilin e pate marrë për vete që t'i priste damarët. Vrasjes së Platorit i shtove atë të Pleuratit, shokut të tij, të cilin e vrave me shkopinj, me gjithë moshën e kaluar të tij...

35 ... A nuk e akuzove si kreditor ndër debitorët e tij Fufidin, kalorësin romak, burrë me merita të mëdha, kur apolloniatët të dhanë në Romë 200 talenta për të larë borxhet.

40 ... Ahea e boshatisur, Thesalia e shkretuar, Athina e keqpërdorur, Dyrrahu e Apollonia të shkatërruar, Ambrakia e plaçkitur, parthinët e bylinët të gënjyer, Epiri krejt i shkatërruar, lokridasit, fokidasit e beotët të djegur, Akarnania, Amfilohia, Perrebia dhe fisi i athamanëve të shitur, Maqedonia e dorëzuar barbarëve, Etolia e humbur për ne, dolopët dhe malësorët fqinjë të dëbuar nga qytetet dhe tokat e tyre qytetarët romakë që tregtojnë në këto vise, - të gjithë kanë provuar se ti kishe ardhur vetëm për t'i vjedhur, plaçkitur, keqpërdorur dhe trajtuar si armiq...

Oratio pro P. Sextio

(Ligjëratë në mbrojtje të P. Sekstit)

43 ... *[*Pizoni*]* ka filluar t'ua shesë shtrenjtë paqën thrakëve e dardanëve dhe si pasojë, me qëllim që ata t'i paguanin atij këtë shumë, i ka lënë të plaçkisin Maqedoninë, ka ndarë me debitorët grekë pasuritë e kreditorëve, qytetarë romakë; u kërkon shuma të mëdha dyrrahasve.

De provinciis consularibus

(Mbi provincat konsulare)

3 ... Ndërkaq kush prej jush nuk e di se çdo vit ahejtë i paguajnë një shumë të madhe M. Pizonit, dhe se të gjitha taksat doganore të Dyrrahut shkojnë në përfitim të Pizonit?...

Oratio de aruspiciis responses

(Ligjëratë përgjegje aruspiceve)

... Kush nuk e di që Platori, nga Orestida – krahinë e lirë e Maqedonisë, njeri i përmendur dhe bujar në këtë vend, shkoi delegat në Thesalonik tek ky perandori ynë (kështu e quajti ai veten). Ky meqë nuk mundi t'i merrte të holla, e burgosi dhe aty futi mjekun e tij për t'i prerë damarët me një barbarizëm të tmerrshëm, një delegati, një aleatit tonë, një miku, një njeriu të lirë. Ai nuk desh të gjakoste sëpatat e tij, por njollosi emrin romak me një krim të tillë që nuk mund të lahet veçse me gjakun e fajtorit. Cilët janë ata kriminela që përdorin mjekun e tyre jo për të shëruar por për të vrarë?...

CEZAR

Gai Jul Cezari lindi në Romë në vitin 100 dhe u vra nga kundërshtarët e tij politikë në vitin 44 para e. sonë. Është një nga ushtarakët dhe burrat e shtetit më të mëdhenj të Romës.

Cezari u shqua jo vetëm për strategji e mendjemprehtësi politike, por edhe për një veprimtari letrare e historike, që e vë atë në radhën e shkrimtarëve më të mirë të kohës. Nga Cezari na janë ruajtur dy vepra të plota me përmbajtje historike, komentarët (ditarët), që nuk janë veçse kujtime apo broshura politike të shkruara në stilin e raporteve ushtarake, një farë apologjie personale e politikës së tij në Gali dhe gjatë luftës civile. Njëri nga komentarët tregon për luftën gale ("De bello Gallico") ndërsa tjetri me titullin "De bello civile" (Mbi luftën civile) përshkruan ngjarjet luftarake kundër Pompeut.

Në të dy veprat përdoret një stil që mund të quhet shembullor për thjeshtësinë e qartësinë e gjuhës. Paraqitja e lëndës është tërheqëse dhe shquhet përsa i përket përshkrimit plot gjallëri. Megjithë këtë nuk mund të thuhet se në përshkrimin e ngjarjeve është mbajtur nga autori një qendrim i paanshëm. Në përshkrimin e luftës civile Cezari i thur lëvdata tendencioze vetes. Mbi të gjitha ai kërkon të vërë në dukje urtësinë e vet dhe dashurinë për paqe. Ai përpiqet të tregojë se qe i detyruar të rrokë armët dhe, siç na e thotë Ciceroni në letrat e tij, shtrembëron edhe disa nga faktet.

Lufta civile e Cezarit ka një rëndësi të posaçme për historinë e Ilirisë, mbasi një pjesë e ngjarjeve që përshkruan në këtë vepër zhvillohet në territorin e atdheut tonë. Për fat të keq Cezari kufizohet këtu me tregimin e ngjarjeve luftarake dhe nuk bën pothuajse fare fjalë për jetën dhe zakonet e banorëve ilirë. Megjithatë ato pak të dhëna me karakter gjeografik që gjenden këtu janë me shumë interes.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *C. Juli Caesaris, Belli Gallici* libri VII, iterum recognovit B. Dinter, Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1885.
2) *C. Juli Caesaris, Belli Civilis,* libri III, iterum recognovit B. Dinter Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1899.

C. JULI CAESARIS

1. BELLI GALLICI

(Lufta Gale)

LIBRI V

1 ... Ai vetë *[*Jul Cezari*]*, mbasi mori fund kuvendi i Galisë Çisalpine, u nis për Iliri,[1)] sepse kishte dëgjuar se pjesa kufitare e kësaj province po plaçkitej nga pirustët. Si arriti atje, i urdhëroi qytetet që t'i jepnin ushtarë dhe i detyroi të mblidheshin në një vend të caktuar. Pirustët, me të marrë vesh këtë lajm, dërguan tek ai delegatë për t'i parashtruar se asnjë nga ato gjëra s'ishin bërë me vendim të popullit dhe se ishin të gatshëm t'i shpërblenin me çdo mënyrë dëmet. Si i pranoi kërkesat e tyre, Cezari urdhëroi që t'i jepeshin pengje dhe i detyroi që t'i sillnin në ditën e caktuar; dhe po të mos vepronin ashtu, u deklaroi se do ta ndëshkonte vendin e tyre me luftë. Mbasi pengjet u dorëzuan në ditën e caktuar, sikundër kishte dhënë urdhër, emëroi gjyqtarë nëpër qytete për të çmuar dëmet dhe për të caktuar dëmshpërblimet.

2. BELLI CIVILIS

(Lufta civile)

LIBRI III

5 Pompeu kishte grumbulluar sasi të mëdha ushqimesh nga Thesalia, Azia, Egjipti, Kreta, nga krahinat e Kyrenës dhe vendet e tjera. Ai kishte vendosur të kalonte dimrin në Dyrrah, në Apolloni dhe në gjithë qytetet e tjera bregdetare të fortifikuara që të pengonte Cezarin të kalojë detin; prandaj flotën e tij e kishte vendosur gjatë gjithë bregdetit...

6 Cezari, sapo arriti në Brundis mblodhi ushtarët e u tha se ishin pothuajse nga fundi i mundimeve e i rreziqeve, prandaj të linin në Itali, pa u shqetësuar, skllevërit dhe plaçkat; ata vetë, të papenguar, të hypnin ndër anije, sa më shumë vetë që të kishte mundësi dhe të shpresonin çdo gjë nga fitorja dhe nga mirësia e tij. Të gjithë brohoritën që të urdhëronte çfarë dëshironte, sepse çdo gjë që të urdhëronte ai, ata do ta zbatonin me gjithë zemër. Ditën e katërt të janarit lëshoi anijet, mbasi i pat ngarkuar me shtatë legjione, sikundër treguam më lart.

[1)] Në vitin 54 para e. sonë.

Të nesërmen doli në breg. Ndërmjet shkëmbinjve të maleve Keraune dhe të vendeve të tjera të rrezikshme, gjeti një gji të qetë dhe duke pasur frikë nga tërë limanet, që ai kujtonte se i kishin në dorë armiqtë, pa humbur asnjë anije, zbarkoi prej tyre ushtarët në atë vend që quhet Paleste.

9 Kur u larguan nga Iliria anijet liburne, M. Oktavi arriu në Salonë me anijet që kishte me vete. Këtu nxiti dalmatët e të tjerë barbarë, dhe shkëputi Isën nga miqësia me Cezarin; po meqë kolovinë e Salonës nuk mundi ta bindte as me premtime, as me kanosje, vendosi të rrethojë qytetin.

11 Vibuli, si mori nga Cezari këto udhëzime, kujtoi se ishte shumë e nevojshme ta lajmëronte Pompeun për arritjen e papandehur të Cezarit, që të merrte masat e duhura, para se të dëgjonte propozimet për paqe; prandaj udhëtoi ditë e natë dhe pasi ndërroi gjatë rrugës shpesh herë kafshët, shpejtoi të arrinte te Pompeu dhe e lajmëroi se Cezari po afrohej. Në këtë kohë Pompeu ndodhej në Kandavi dhe prej Maqedonie po udhëtonte për Apolloni dhe Dyrrah, për dimërim. Po i trubulluar nga këto lajme, filloi ta shpejtonte udhëtimin për Apolloni, që të mos i pushtonte Cezari qytetet e bregdetit. Po Cezari, si zbarkoi ushtrinë, po atë ditë u nis për Orik. Këtu Luc Torkuati, që sundonte në qytet me urdhër të Pompeut, dhe që kishte aty garnizonin e parthinëve, mbylli portat dhe u mat ta mbronte qytetin, duke urdhëruar grekët të hypnin mbi mure dhe të rroknin armët. Por këta nuk donin të luftonin kundër sundimit të popullit romak, bile qytetarët përpiqeshin ta pranonin Cezarin vullnetarisht, mbasi nuk kishin më kurrfarë shprese për ndihmë. Atëherë Torkuati çeli portat dhe u dorëzua te Cezari me gjithë qytet, dhe nuk pësoi asgjë të keqe prej tij.

12 Pas dorëzimit të Orikut, Cezari pa u vonuar fare, u nis për Apolloni. Luc Staberi, sundimtari i atjeshëm, posa mori vesh se Cezari po afrohej, urdhëroi të sillnin ujë në kështjellë, ta fortifikonin këtë dhe njëkohësisht kërkoi pengje nga apollonianët. Po këta u përgjegjën se, nuk do t'i jepnin pengjet dhe se nuk do t'ia mbyllnin portat konsulit dhe se asnjë vendim nuk do të merrnin kundër asaj që kishte caktuar mbarë Italia dhe populli romak. Staberi, si mori vesh qëllimet e tyre, iku nga Apollonia fshehurazi. Atëherë apolloniatët dërguan delegatë te Cezari dhe e pranuan në qytet. Shembullin e këtyre e ndoqën edhe bulinët dhe amantët dhe qytetet e tjera që ishin afër, si edhe gjithë Epiri, dhe dërguan delegatë te Cezari, dhe i premtuan se do të bënin si t'u urdhëronte.

13 Pompeu, si mori vesh ngjarjet që kishin ndodhur në Orik dhe në Apolloni, u tremb për Dyrrahun dhe prandaj vrapoi për këtë, duke udhëtuar ditë e natë. Ndërkaq u hap fjala se Cezari po afrohej; një panik i madh pushtoi ushtrinë e Pompeut, panik që shkaktoi një çrregullim të plotë dhe një të ecur shumë të shpejtë që s'e ndaloi dot as nata; gati gjithë ata të Epirit e të krahinave të afërme i lanë flamujt, shumë ushtarë i hodhën armët dhe marshimi dukej si një ikje. Pompeu qëndroi afër Dyrrahut, ngriti këtu lëmin, me që edhe ushtria e tij ishte akoma në tmerr të madh. Labini i pari i doli /Pompeut/ përpara dhe u betua se kurrë nuk do ta linte dhe se do të pësonte po ato rreziqe që i ruante fati atij. Kështu u betuan edhe legatët e tjerë. Meqenëse Pompeu e kishte zënë rrugën për në Dyrrah, Cezari e ndaloi marshimin dhe ngriti lëmin afër lumit Aps, në kufi të Apollonisë, me qëllim që t'i ruante me kështjella e me roje qytetet që ishin bashkuar me të; dhe vendosi të presë këtu legjionet e tjera nga Italia dhe të kalojë dimrin nën tendat. Po këtë bëri edhe Pompeu: si ngriti lëmin në anën tjetër të lumit Aps, grumbulloi atje gjithë ushtrinë e tij bashkë me ndihmat që kishte marrë.

1 **16** Në këtë kohë, Cezari, kishte shkuar për të shtënë në dorë, me një legjion, disa qytete të largëta dhe për të rregulluar furnizimin e ushtrisë; ishte ngushtë me ushqime për arsye se këto ndodheshin në Buthrot, përkundrejt Korkyrës. Këtu, me të
2 marrë vesh nga letrat e Acilit dhe të Murkos dëshirën e Libonit dhe të Bibulit, la legjionin dhe vetë u kthye në Orik...

1 **25** Kaluan, kështu, shumë muaj dhe dimri po mbaronte, por anijet dhe legjionet që priste Cezari nga Brundisi nuk po vinin. Cezari kujtonte se ishin lënë pas dore shumë raste të mira, mbasi disa herë kishin fryrë erëra të favorshme për të lundruar.
2 Sa më tepër kalonte koha aq më vigjilentë tregoheshin komandantët e ushtrive armike për të ruajtur këto vende, dhe më shumë besim kishin për ta mbajtur larg ushtrinë kundërshtare. Pompeu i qërtonte komandantët shpesh me letra, duke i nxitur (mbasi nuk qenë në gjendje të ndalonin kalimin e Cezarit), që të paktën të kujdeseshin të ndalojnë kalimin e ushtrive të tjera, që i vinin në ndihmë. Dhe kështu njerëzit e Pompeut po pritnin që të afrohej stina, në të cilën për ushtrinë e Cezarit
3 nuk do të ishte e lehtë transportimi i ushtrisë nëpër det, për arësye të erërave që vinin gjithmonë duke munguar. Për këtë arësye Cezari i shkroi një letër më të rreptë komandantëve të tij në Brundis, duke i porositur që me çastin e parë të favorshëm
4 mos të humbisnin rastin e lundrimit për në brigjet e Apollonisë apo të labeatëve, ku të zbarkonin, po të ish e mundur. Ky bregdet nuk ruhej me aq kujdes prej armikut, mbasi ky i fundit nuk guxonte të qendronte një kohë të gjatë larg limaneve të tij.

1 **26** Ata *[ushtarët]*, duke vënë në veprim guximin e trimërinë e tyre dhe duke patur në krye M. Antonin dhe F. Kalenin dhe me që po këta ushtarë vetë i nxitnin për luftë, sepse përbuznin çdo rrezik për të shpëtuar Cezarin, posa fryu veriu ngritën çengelat e anijeve dhe u nisën; të nesërmen kaluan në bregun tjetër, në Apolloni e
2 Dyrrah. Këto i pa që nga toka Kuint Koponi, i cili komandonte flotën e Rodit në Dyrrah dhe u vu në ndjekje; por ndërsa po i afrohej tanëve, duke forcuar lëvizjet e lopatave, era që ishte dobësuar pak më parë filloi të fryjë prapë me furi dhe i shpëtoi tanët nga rreziku. Megjithë këtë Koponi nuk hoqi dorë nga plani i tij, po shpresonte
3 se në sajë të mundit dhe të durimit të lundërtarëve të tij do ta mposhtte forcën e stuhisë. Pra vazhdoi t'i ndjekë tanët, megjithëse këta i kishte çuar era larg nga Dyrrahu. Lundërtarët tanë, megjithëqë patën ndihmën e fatit, kishin gjithnjë frikë, se
4 mos u sulet armiku me të rënë era. Si gjetën limanin e quajtur Nymfe, tremijë hapa larg nga Lisi, hynë këtu me gjithë anijet (ky liman ishte i mbrojtur nga era perëndimore – jugë-perëndimore (Africus) por nuk ishte siguruar nga jugu), (Auster) duke e vlerësuar rrezikun e stuhisë më të vogël se atë të flotës armike. Posa hyri flota
5 në këtë liman, me një kthim të çuditshëm të fatit, jugu që frynte dy ditë me radhë, u kthye në erë perëndimore – jugperëndimore.

1 **29** Pas kësaj, këshilli i qytetarëve romakë që kishin në dorë Lisin, të cilin qytet ua kishte besuar më parë Cezari dhe ishte kujdesur ta fortifikonte, e priti Antonin dhe e ndihmoi me të gjitha mjetet. Otacilin e zuri frika, iku nga qyteti dhe vajti te
2 Pompeu; Antoni, pasi i zbriti të gjitha trupat ushtarake, që ishin gjithësejt tre legjione veteranësh e vetëm një rekrutësh, dhe tetëqind kalorë, pjesën më të madhe të anijeve e ktheu në Itali, për të sjellë ushtarët dhe kalorët e tjerë. Pantonet që janë një lloj anijesh gale i la në Lis me qëllim që, në rast se Pompeu besonte se Italia kishte
3 mbetur e pafurnizuar dhe të transportonte ushtrinë e tij atje, sikurse ishte përhapur fjala në popull, të kishte Cezari ndonjë farë mundësi për ta ndjekur. Dhe menjëherë

dërgoi lajmëtarë tek ky, për t'i njoftuar se në ç'krahinë e kishte zbarkuar ushtrinë dhe sa ushtarë kishte transportuar.

1 **40** I biri i Pomeput, që komandonte flotën e Egjiptit, si mori vesh këto, erdhi në Orik dhe veproi kështu: së pari tërhoqi me litar anijen që ishte fundosur në të hyrë të limanit, kurse anijen tjetër që e kishte lënë Acili për roje, e sulmoi me shumë anije të pajisura me kulla të larta. Kështu duke luftuar për një vend më të lartë dhe duke dërguar vazhdimisht trupa të freskëta për të zëvendësuar ata që ishin të lodhur, me qëllim që t'i shpërndajë forcat tona, u binte mureve të qytetit edhe nga toka, duke përdorur shkallë, dhe nga deti me flotën; kështu, me përpjekje të mëdha dhe duke harxhuar shumë shigjeta, i mundi tanët dhe i shtrëngoi të ikin, duke hypur mbi barka
2 dhe në këtë mënyrë shtiu në dorë atë anije. Njëkohësisht pushtoi nga ana tjetër limanin natyral, që zgjatej në det dhe që e bënte si gadishull, dhe katër anije me dy sërë lopatash i kaloi në portin e brendshëm, duke i shtyrë me anë cilindrash e levash. Kështu si i sulmoi nga të dy anët anijet tona të luftës, që ishin lidhur në breg dhe nuk
3 kishin ushtarë, mori katër nga to dhe të tjerat i dogji. Si bëri këtë, me qëllim që të pengojë arritjen e ushqimeve që do të silleshin nga Bulisi dhe Amantia, la këtu si
4 roje D. Lelin; ai vetë u nis për në Lis, u ra të tridhjetë anijeve të transportit, që kish lënë M. Antoni brenda limanit dhe i dogji të gjitha. Pastaj u mat të pushtojë Lisin që
5 e mbronin qytetarët romakë të vendosur aty me ushtarët që kishte dërguar Cezari si garnizon. Pas tri ditësh, pa kryer asgjë, u largua prej këtej me disa humbje që pësoi gjatë këtij rrethimi.

1 **41** Cezari, kur mori vesh se Pompeu ndodhej pranë Asparagut, u nis për aty me ushtrinë; rrugës pushtoi qytetin e parthinëve, ku kishte një garnizon Pompeu, dhe të tretën ditë arriu te Pompeu, dhe ngriti lëmin afër atij. Të nesërmen nxori gjithë trupat, i radhiti dhe i dha mundësi Pompeut të nisë luftën. Por, kur pa se ai nuk po
2 tundej nga vendi që kishte zënë, e futi ushtrinë përsëri në lëmë dhe mendoi se duhej të ndërronte planin e parë. Të nesërmen pra, u nis me gjithë ushtrinë për në Dyrrah,
3 duke i rënë rreth e rreth, nëpër një udhë të ngushtë e të vështirë, duke menduar se me këtë mënyrë ose do ta detyronte Pompeun të ndryhej në Dyrrah ose do t'ia priste lidhjet me këtë qytet, ku ai kishte grumbulluar gjithë ushqimet dhe armët për luftë. Kjo me të vërtetë kështu ngjau: Pompeu në fillim nuk e kuptoi planin e Cezarit, kur
4 pa se ky mori një rrugë nga ana e kundërt me të, pandehu se Cezari u hoq nga ky vend, për mungesë ushqimesh. Por, kur të nesërmen mësoi të vërtetën nga vëzhguesit e tij, prishi lëmin dhe u nis me shpresë se do të arrinte t'ia priste Cezarit rrugën, duke marrë ai një udhë më të shkurtër. Cezari, që e priste këtë, si u foli ushtarëve dhe i porositi t'u qëndrojnë me durim lodhjeve të udhëtimit, natën bëri një
5 pushim prej disa orësh dhe në mëngjes arriti në Dyrrah, pikërisht në atë kohë kur u dukën së largu pararojet e Pompeut; Cezari me të arritur këtu ngriti lëmin dhe vendosi ushtrinë e tij.

1 **42** Pompeu, si iu pre rruga për Dyrrah, mbasi nuk mundi ta zbatonte planin e parë, si mori një vendim të dytë, e ngriti lëmin mbi një vend të lartë, të quajtur "Petra"[1)], i cili formonte një farë vendi të mbyllur, ku anijet mbroheshin kundër disa erërave.
2 Urdhëroi, pastaj, të vinin këtu disa nga anijet e tij të gjata, dhe i porositi të sillnin grurë dhe ushqime të tjera nga Azia dhe nga vendet e tjera që ishin nën urdhërin e tij.
3 Cezari, duke parashikuar se lufta do të zgjatej shumë e, në anën tjetër, duke mos

[1)] Petra – Gur, shkëmb. Këtu: Shkëmbi i Kavajës.

shpresuar fare në furnizimet nga Italia – se flota e Pomeput ruante me shumë kujdes
tërë bregdetin – e më në fund, duke parë se anijet që ishin ndërtuar gjatë dimrit në
Siqeli, në Gali e në Itali nuk po dukeshin, dërgoi në Epir Kuint Totin e Luc
4 Kanulein, zëvendësin e tij, për të marrë drithëra. Po me që këto krahina ndodheshin
mjaft larg, ndërtoi hambare në vende të caktuara dhe urdhëroi qytetet e afërme t'i
binin drithë. Gjithashtu urdhëroi Lisin, parthinët e të gjitha qytetet që të mblidhnin sa
5 grurë që kishin. Por ato kishin fare pak drithë, sepse duke qenë vende më të shumtën
malore e të ashpëra, ushqehen më tepër me drithë të ardhur nga jashtë. Përveç kësaj,
Pompeu i kishte paraparë këto, dhe disa ditë më parë kishte plaçkitur parthinët, duke
u xhveshur gjer në themel shtëpitë dhe duke u marrë me anë të kalorisë së tij gjithë
drithin që ishte grumbulluar aty.

7 **47** ... Kur u jepnin bullgur ose bishtajore ata /ushtarët/ nuk e donin; kishin qejf
shumë mishin e dhenve, që sillej me shumicë nga Epiri.

1 **48** Është një farë zhardhoku i quajtur hara[1] që u zbulua prej ushtarëve të
Valerit[2]; kjo e përzier me qumësht lehtëson shumë mungesën e ushqimeve; prej
2 kësaj bënin një farë buke, dhe kjo rrënjë gjendej me shumicë në këtë vend. Në
bisedim e sipër me ushtarët e Pompeut, kur këta të fundit ju ankuan ushtarëve tanë
për mungesë ushqimesh, u hodhën nga kjo bukë me shumicë, me qëllim që t'i
dëshirojnë edhe më shumë.

1 **49** Po afronte koha e të korrave, dhe kjo shpresë i mbante ushtarët tanë, të cilët
kishin besim se do të kishin paskëtaj ushqime më të tepërta. Shumë herë ishin
dëgjuar ushtarët të thonë, në mes tyre, gjatë kohës së rojes ose gjatë bisedave të tyre
se pranonin të hanin lëvozhgën e drunjve, më parë se ta lënë Pompeun t'u shpëtojë
2 nga dora. Nga të ikurit kishin marrë vesh se kuajt e anës kundërshtare mezi
mbaheshin në këmbë dhe se gjithë kafshët bartëse kishin ngordhur; se ata nuk
gëzonin një shëndet të mirë si nga shkaku i ngushticës së vendit, si nga era e keqe e
kufomave të shumta, si nga mundimi i përditshëm në punët që nuk shkonin mbarë,
ashtu edhe nga mungesa e madhe e ujit. Me të vërtetë Cezari i kishte kthyer ose i
3 kishte mbushur gjithë përrenjtë dhe burimet që derdheshin në det. Meqenëse ishin
vende malore dhe grykat e luginave shumë të ngushta, Cezari kishte urdhëruar të
ndërtohen penda, për të ndaluar ujin. Prandaj armiqtë u shtrënguan nga nevoja të
4 zbresin ndër toka të ulëta dhe kënetore, për të hapur këtu puse; dhe kjo punë ishte
përmbi punën e përditshme. Burimet që ishin shumë larg nga kampet e ushtarëve, i
thante shumë vapa. Përkundrazi ushtria e Cezarit plot shëndet dhe ujë, kishte dhe
5 mjaft ushqime; mungonin vetëm drithërat; po ata shihnin se dita ditës gjendja
përmirësohej, sepse afrohej koha e korrjeve të të lashtave.

1 **58** Cezari, për të mbajtur mbyllur më me lehtësi kalorinë e Pomeput në Dyrrah,
dhe për t'ia ndaluar kullotjen, fortifikoi me punime të mëdha, të dy grykat e ngushta,
për të cilat kemi folur më sipër dhe ndërtoi në to kështjella. Pompeu, duke parë se
2 kaloria s'i hynte më në punë, brenda pak ditëve e ktheu me anë të anijeve përsëri në
3 lëmë. Mungesa e kullotjes ishte aq e madhe, sa kuajt ushqeheshin me fletë të
shkoqura nga pemët dhe me rrënjë të njoma të shtypura; sepse gruri që kishin

---

[1] Kërtolla e kelikazës(?).

[2] Një tjetër version thotë: "U gjet prej ushtarëve që ishin shëruar nga plagët". Në këtë pikë teksti, në kodet e ndryshme, nuk del i njëjtë.

mbjellë brenda rrethit të mbrojtjes ishte ngrënë i gjithë, prandaj ishin shtrënguar ta
4 sjellin tagjinë me një udhëtim të gjatë nëpër det që nga Korkyra dhe nga Akarnania;
megjithëkëtë edhe këto s'mjaftonin, dhe për të plotësuar racionet shtrëngoheshin të
përdornin elb, për të mbajtur në këmbë kalorinë. Por, mbasi jo vetëm kudo u sos elbi
5 e tagjia dhe bari u pre, po edhe gjer pemët mbetën pa gjethe dhe kuajt u dobësuan
nga të pangrënit, Pomepu mendoi se duhej të dilte me sulm.

2 **63** ... Ca ditë më parë Cezari, duke patur frikë se mos rrethohej prej anijeve të
armikut, kishte urdhëruar të ndërtohen në këtë vend të dy këto fortifikime, me qëllim
që të mbrohej më mirë, në rast të një ndeshjeje. Por gjerësia e periferisë, e cila ishte
3 tetëmbëdhjetëmijë hapa megjithëse punimet vazhdonin çdo ditë, nuk lejuan të
4 mbaronin punimet. Vija që do t'i bashkonte të dy këto fortifikime e do të zgjatej anës
së detit nuk mori dot fund; këtë gjë e mësoi Pompeu nga të ikurit allobrogas dhe kjo
5 tradhëti na kushtoi shumë. Kur kohortet tona të legjionit të nëntë kishin ngrehur
6 lëmin afër detit, ushtarët e Pompeut arritën më të gdhirë dhe trupat e ardhura me det
filluan të hedhin shigjeta kundër fortifikimeve të jashtme dhe e mbushën hendekun
me dhé; njëkohësisht legjionarët po mundoheshin t'i tmerronin mbrojtësit e
fortifikimeve të brendshme me makinat e shumëllojshme. Nga të dy anët filluan
shigjetat si breshër kundër nesh. S'kishim armë të tjera përveç gurëve, por edhe këto
7 i ndalonin mjaft degët me të cilat kishin mbuluar përkrenaret. Ushtarët tanë ishin të
kapitur dhe mezi mbaheshin. Në këtë kohë, armiqtë vunë re të metat e fortifikimit
8 për të cilat folëm më sipër, zbarkuan midis të dy fortifikimeve, punimet e të cilit
kishin mbetur përgjysmë, na sulmuan, na hodhën jashtë fortifikimeve dhe na
shtrënguan të ikim.

1 **71** Në këto dy beteja[1)] që u bënë në një ditë e sipër, Cezari humbi nëntëqind e
gjashtëdhjetë ushtarë dhe shumë kalorë të shquar...

1 **73** Cezari u shtrëngua të heqë dorë nga planet e vjetra dhe të ndërrojë krejt
2 taktikën e luftës. Tërhoqi menjëherë gjithë rojet, hoqi dorë nga sulmet, mblodhi tërë
ushtrinë në një vend dhe, duke ju drejtuar ushtarëve i kështilloi të mos humbasin
guximin, nga shkaku i ngjarjeve të hidhura, dhe të mos shqetësohen nga një
fatkeqësi që është shumë e vogël, përpara fitimeve që kanë patur gjer më sot...

1 **75** Prej këndej, pa humbur kohë, si rregulloi më parë të sëmurët dhe të
plagosurit, urdhëroi që posa të ngrysej të nxirrnin nga lëmi pa zhurmë të gjitha
plaçkat e të niseshin për Apolloni, duke i porositur që në asnjë vend të mos
ndaleshin rrugës, përderisa nuk do të kryhej udhëtimi. Për t'i shoqëruar këta u dha
2 një legjion për mbrojtje. Si qe kryer kjo, mbajti në lëmë dy legjione, ndërsa të tjerat i
nxori nga portat e ndryshme, përpara se të gdhihej; këto ndoqën të njëjtën rrugë, që
përshkuan ushtarët me plaçka. Pak kohë më vonë, me qëllim që nga njëra anë të
ruhej zakoni ushtarak, dhe nga ana tjetër ikja e tij të merrej vesh sa më vonë që të
ishte e mundur, dha urdhër që të binte boria e zgjimit. Menjëherë pastaj doli, arriti
shpejt praparojën e legjioneve të sipërpërmendur, duke u larguar nga lëmi sa që më
3 s'dukej. Pompeu me të marrë vesh ikjen, pa humbur kohë vendosi të na ndjekë dhe

[1)] Beteja e parë përshkruhet nga Cezari në kap. 63. Të dytën, që përshkruhet prej tij me shumë hollësira në kapitujt që vijojnë, nuk po e japim.

me qëllim që të kapte në befasi rrugës të hutuarit dhe të tremburit, e nxori ushtrinë e tij nga lëmi dhe nisi përpara kalorinë për të kapur praparojën tonë. Por nuk mundi t'i arrijë, se Cezari, që nuk pengohej nga plaçkat, ishte larguar shumë. Kur arritëm tek
4 lumi Genus, brigjet e të cilit ishin shumë të thepisura, kaloria e armikut arriti ushtarët tanë më të rinj dhe i sulmoi. Cezari dërgoi menjëherë kalorinë e tij bashkë
5 me katërqind ushtarë të zgjedhur të armatosur lehtë. Këta bënë punë të madhe mbasi, posa e sulmuan, e vunë në ikje kalorinë e armikut, vranë shumë nga ta dhe u kthyen pastaj për t'u vënë në rresht, pa pësuar asnjë dëm.

1 **76** Cezari, si bëri atë ditë aq rrugë sa kishte parashikuar e kaloi ushtrinë përtej lumit Genus, u ndal në lëmin e tij të vjetër përkarshi Asparagut dhe i mbajti ushtarët brenda fortesës së lëmit. Dërgoi pastaj kalorinë për të kullotur kuajt, duke i porositur
2 që të kthehen në lëmë nga porta kryesore. Gjithashtu edhe Pompeu kishte bërë këtë ditë aq rrugë dhe kishte ndaluar tek lëmi i tij i vjetër në Asparag. Ushtarët e tij, me
3 që s'kishin punë, mbasi fortifikimet që kishin bërë më përpara i kishin gjetur të paprekura, disa shkuan për dru e për bar, kurse disa të tjerë (për arsye se nisja ishte bërë me nxitim dhe nga ky shkak kishin lënë shumë plaçka në vendin nga kishin ardhur), duke u tërhequr nga afërsia e lëmit të mëparshëm, dolën nga lëmi për të marrë këto, duke lënë armët nëpër tenda. Cezari, që e kishte paraparë këtë që ndodhi,
4 duke qenë se këta *[armiqtë]* ishin shpërndarë shumë dhe nuk mund, prandaj, t'i viheshin prapa, aty nga mezi i ditës urdhëroi të jepet alarmi; nxori ushtrinë jashtë dhe duke dyfishuar në këtë ditë udhëtimin u largua tetëmijë hapa nga Asparagi, gjë që nuk pati mundësi ta bëjë Pompeu, për arësye se njerëzit e tij ishin larguar.

1 **77** Të nesërmen në darkë Cezari nisi, si në Dyrrah, më parë plaçkat dhe ai vetë me ushtrinë u nis para se të gdhihej, i lirë dhe pa pengesa, për të qenë kështu i përgatitur kundër çdo të papriture nëqoftëse do të ishte i detyruar të luftonte. Kështu
2 bëri edhe në ditët e tjera. Kështu ai mundi të kalojë lumenj shumë të thellë dhe rrugë shumë të këqija pa i ngjarë asnjë e keqe. Po Pompeu nuk mundi dot të fitojë kohën,
3 që kishte humbur ditën e parë, ndonëse bëri udhëtime të gjata dhe kishte dëshirë të madhe ta ndiqte armikun. Më në fund të katërtën ditë pushoi së ndjekuri, duke gjykuar se duhej të merrej një vendim tjetër.

1 **78** Cezarit i duhej të shkonte në Apolloni për të lënë të plagosurit, për të paguar ushtarët, për t'i dhënë zemër popujve aleatë si dhe për të vendosur garnizone nëpër
2 qytetet. Por të gjitha këto i kreu në kohën më të shkurtër, që ishte e mundur dhe këtë e bëri se kishte frikë se mos Pompeu arrinte Domitin; u ngut prandaj që të shkonte sa
3 më parë pranë këtij. Cezari mbështetej në këto arsyetime: nëqoftëse Pompeu do të merrte po atë rrugë, do të largohej nga deti e Dyrrahu, ku kishte ushtrinë tjetër dhe depot e ushqimeve; në këtë rast ndeshja e të dy ushtrive do të bëhej nën kushte të njëjta; nga ana tjetër po të hidhej në Itali, Cezari së bashku me Domitin do të kalonin
4 përmes Ilirisë për t'i shkuar në ndihmë Italisë; më në fund në rast se do të guxonte të sulmonte Apollonin dhe Orikun, me qëllim që të priste lidhjet e Cezarit me detin, atëherë Cezari do të sulej kundër Scipionit e kështu do ta shtrëngonte t'i vinte në
5 ndihmë. Prandaj i dërgoi letra Domitit dhe ia spjegoi qëllimet e tij. La në Apolloni katër kohorte, një në Lis dhe tri në Orik si dhe të plagosurit, kurse ai vetë me ushtrinë tjetër u nis përmes Epirit dhe Athamanisë.
6 Po edhe Pompeu, duke e kuptuar se ç'mendonte Cezari, vendosi të vrapojë në

ndihmë të Scipionit, në rast se Cezari do të drejtohej kundër këtij. Në rast se Cezari nuk do të dëshironte të largohej nga bregu i detit dhe nga rrethet e Orikut, mbasi priste nga Italia legjione dhe kalori, do të vërsulej me tërë forcën e tij, kundër Domitit.

1 **79** Për arsyet që thamë sipër si njëri, si tjetri nxitonin sa më shumë, qoftë për t'i shkuar në ndihmë të vetëve, qoftë për të dërrmuar armikun në rastin e volitshëm. Por 2 duke qenë se Cezarin e pengoi Apollonia që të merrte rrugën e drejtë, Pompeu me anën e Kandavisë u drejtua për në Maqedoni. Ndërkaq, arriti lajmi i një ngjarjeje 3 tjetër të papritur; Domitit, si qëndroi shumë ditë përballë lëmit të Scipionit, iu desh të largohej prej këndej për mungesë të ushqimeve dhe të shkojë në Heraklea (Sintika), që është nën vartësinë e Kandavisë dhe kështu e solli fati, që të gjendet përballë Pompeut.

KORNEL NEPOTI

Kornel Nepoti, historian dhe shkrimtar romak me prejardhje nga Langobardia, lindi rreth vitit 100 dhe vdiq rreth vitit 27 para e. sonë. Jetoi në Romë, por larg jetës politike dhe administrative shtetërore. Qe mik i ngushtë i Ciceronit, i poetit të shquar Katulit dhe pronarit të madh romak Pompon Atikut. Gjithë kohën dhe kujdesin e tij Kornel Nepoti ia kushtoi studimeve letrare dhe historike. Shkroi shumë vepra, një pjesë e madhe e të cilave nuk janë ruajtur. Ndër veprat e mëdha të humbura të Nepotit janë "Chronica" (Kronikat) në tre libra, të cilat paraqesin një përmbledhje kronikale të të gjithë historisë botërore të njohur në atë kohë, që nga epoka mitologjike e deri në historinë e Greqisë dhe të Romës, si edhe një pjesë e madhe e veprës "De viris illustribus" (Mbi njerëzit e shquar) në 16 libra. Nga kjo vepër është ruajtur vetëm libri mbi prijësat e shquar të popujve të huaj (Liber de exeellentibus ducibus exterarum gentium), i cili përfshin përveç një parathënie të Atikut, biografitë e 25 komandantëve ushtarakë kryesisht grekë.

Nepoti shkroi, veç këtyre dhe biografitë e Katonit (Vita Catonis) dhe të Ciceronit (Vita Ciceronis) si dhe veprën "Exempla", një koleksion anekdotash historike dhe kuriozitetesh të vjetra, së paku në 5 libra.

Në veprën biografike të Nepotit, përshkrimet e jetës së personazheve të tij janë të përcipta, shpesh herë nuk respektohet rendi kronologjik i fakteve, mungon shpesh gjithashtu edhe saktësia dokumentare, gjëra këto që ia ulin vlerën historike veprës.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Cornelii Nepotis Vitae, post Carolum Halmium recognovit Alfred Fleckeisen, editio stereotypa. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1927.

CORNELII NEPOTIS

VITAE

(Jetët)

XXV Atticus

14 ... Ai /Pompon Atiku/ nuk kishte as kopshte, as shtëpi në fshat ose në breg të detit, dhe nuk zotëronte në Itali veçse dy prona të vogla, në territorin e Ardeatinës e Nomentanit. Të gjitha të ardhurat i vinin nga pronat në Epir e në Romë...

VERGILI

Publ Vergil Maroni, poet romak, lindi afër Mantovës në vitin 70 para e. sonë. Studjoi në Romë për retorikë dhe filozofi. Vitet e fundit të jetës i kaloi në Napoli. Vdiq në Brundisi, kur po kthehej nga një udhëtim nëpër Greqi.

Ndër veprat më të hershme të Vergilit, më e rëndësishmja është "Bucolica" (Këngë baritore) e përbërë prej 10 eklogesh. Këto këngë me një gamë ngjyrash të bukura pikturojnë botën idilike të barinjve, në përmbajtjen e së cilës dëgjohen mjaft nota realizmi të kohës së autorit. Vepra të tjera të rëndësishme të këtij poeti të shquar romak janë edhe "Eclogae" (Vjersha të zgjedhura), "Georgica" (Poemë mbi bujqësinë) dhe poema epike kushtuar Oktavian Augustit "Aeneis".

Në poemën "Georgica", të cilën e përshkon fund e krye një frymë dashurie e sinqertë për natyrën dhe bujqësinë, bëhet përpjekje për të përgjithësuar njohuritë mbi ekonominë fshatare, kurse në "Eneiden" – në "Iliadën" e "Odisenë" romake – tregohet për peripecitë e udhëtimit të heroit trojan Eneut, i cili përpara se të arrinte në Lat për të formuar gjoja mbretërinë e tij në tokën latine qendroi për pak ditë edhe në Butrint. Kjo poemë e mrekullueshme epike mbeti e papërfunduar dhe doli në dritë vetëm mbas vdekjes së autorit. Në veprën e Vergilit spikat një stil i bukur, një varg melodioz dhe një gjuhë e punuar.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

P. Vergili Maronis Opera post Ribbeckium tertium recognovit Gualtherus Janell, editio maior. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1920.

P. VERGILI MARONIS

1. AENEIDOS

(Eneida)

LIBRI III

Pas pak na humbën nga sytë kështjellat e larta të faiakëve,
dhe kaluam në brigjet e Epirit e arritëm në portin e
Kaonit dhe hymë në qytetin e lartë Buthrot.
Këtu morëm vesh një lajm, që s'ishte për t'u besuar,
Heleni, i biri i mbretit Priam, sundonte në qytete greke,
se kishte marrë gruan e skeptrin e Pirro Aiakidit
dhe se Andromaka ishte martuar prapë me një bashkatdhetar.
U habita dhe më pushtoi një dëshirë e madhe
ta shihja dhe nga ai të gjitha t'i mësoja.
Lashë anijet në port dhe zbrita në tokë;
atë ditë në pyll para qytetit dhe buzë Simoentit të rrejshëm
Andromaka bënte flijime solemne
mbi tumën e Hektorit dhe i falte dhurata të përvitshme,
thërriste shpirtin e tij pranë një varri të zbrazët të rrethuar me plisa të njomë
e qante në këmbët e dy altarëve.
.....
Pas vdekjes së Neoptolemit, nga mbretëria i ra
një pjesë Helenit, i cili këto vise i quajti Kaoni
nga emri Trojan Kaon;
Dhe në këto kodra një Pergam të ri ndërtoi bashkë me një kështjellë trojane
.....
..... kur ja, nga qyteti, heroi,
i biri i Priamit, Heleni, i shoqëruar nga një turmë, vjen;
na njohu dhe plot me gëzim na shpuri në pallat
ku për çdo fjalë, që thonim ai lëshonte lotë.
Para unë eci e shoh një Trojë ndërtuar sipas shembullit të së madhes,
një Pergam dhe një përrua të thatë me emrin e Ksanthit,
duke hyrë putha prakun e portës Skea.
Gjithashtu edhe shokët e mi teukrët u gëzuan që gjetën një qytet mik.
Mbreti i priti në portikët e gjerë të pallatit;
Në mes të sallës rreth tryezave zbraznin kupat për nder të Bahut,
pinin me enë të arta dhe bënin flijime
.....

2. GEORGICON

(Gjeorgjiket)

LIBRI I

Në fillim të pranverës nga majat e zbardhura të maleve
rrjedh lagështia dhe zefiri shkrifton tokën,
le të fillojë atëherë kau, prej parmendës së futur thellë,
të rënkojë dhe të shkëlqejë plori i fërkuar nga brazda.
Toka do t'u përgjigjet atëherë dëshirave të gjithë bujqëve
të uritur, nëqoftëse do të heqi dy vapa e dy të ftohta,
korrjet atëherë do të jenë të tilla sa do të thyhen hambarët.
Por, para se të çajmë një tokë të re,
duhet të dimë erërat dhe sjelljen e kohës
dhe mënyrat e zakonet e të parëve të atij vendi,
çfarë jep kjo tokë këtu dhe çfarë nuk i jep ajo bujkut.
Këtu gruri rritet më me bollëk, kurse atje vreshtat,
atje prodhimi i mirë nga pemët, dhe vetiu gjelbëron
bari. A nuk e sheh, se si Tmoli aromatin e safranit
na dërgon, kurse India – fildishin dhe sabejt e butë – thimjamin,
Halibët e zhveshur – hekurin, dhe Ponti lëngun me erë të fortë
të Kastorit, kurse Epiri – kuajt e fitoreve elidike?[1)]

[1)] Është fjala për lojërat olimpike.

TIT LIVI

Livi është historiani më i rëndësishëm romak i kohës së Augustit. Ai lindi në Patavium (Padova e sotme) në vitin 59 ose 69 para e. sonë dhe vdiq në vitin 17 të e. sonë. Studjoi për retorikë. Ndryshe nga shumë paraardhës të tij nuk mori pjesë në jetën politike. Gjithë jetën e tij mbeti retor dhe letrar. Shumë shpejt pas vendosjes së principatit, ai, filloi të shkruajë një histori të Romës, të cilën e titulloi "Ab urbe condita" (Nga themelimi i Qytetit). Gjithë vepra e tij përbëhej nga 142 libra. Ajo fillon, siç e tregon edhe vetë titulli, me themelimin e Romës dhe mbyllet me vdekjen e birit të adaptuar të Augustit, Druzit (viti 9 i e. sonë). Më vonë u bë zakon që këtë vepër të madhe, e cila përbënte në vetvete një bibliotekë, ta ndajnë në dekada – nga dhjetë libra për secilën. Deri tek ne kanë arritur, për fat të keq, vetëm 35 nga këta libra. Prej tyre janë ruajtur të plota: dekada e parë, që përfshin ngjarjet nga kohët më të vjetra deri në vitin 293, si dhe dekada e tretë, e katërt dhe gjysma e së pestës (librat 21-45), ku bëhet fjalë për ngjarjet e vitit 218-168 para e. sonë. Përmbajtja e librave të tjerë njihet vetëm nga përmbledhjet e shkurtëra (epitome) të autorëve të vonë. Të tilla përmbledhje ka për të gjithë librat e tjerë me përjashtim të atyre 136 e 137.

Duke qenë një retor dhe letrar, Livi nuk e studion historinë e Romës, por bën një shtjellim të sajë në bazë të të dhënave që gjen tek historianët paraardhës. Ai vetë nuk referohet asnjëherë tek burimet. Në paraqitjen e një ngjarjeje ose të një periudhe historike ai mbështetet zakonisht tek një autor i vetëm. Edhe në ato raste kur përdor ose krahason autorë të ndryshëm ai nuk jep mendimin e tij kritik. Megjithatë duke u mbështetur në historianë me autoritet si Fabi Piktor[1)], Polybi, etj., ai jep një pasqyrë në përgjithësi të saktë të ngjarjeve megjithëse këto i sheh nga pozita romake. Një meritë e tij është edhe se ai diti të paraqesë në një të tërë të plotë historinë e Romës deri në ditët e tij. Lavdërimi i së kaluarës dhe i veprave të mëdha të stërgjyshërve, parullë kjo zyrtare e Augustit, është një nga idetë themelore që përshkon veprën e tij.

Por e metë serioze e Livit është se për hir të paraqitjes së bukur dhe tërheqëse të ngjarjeve ai sakrifikon nganjëherë edhe të vërtetën historike. Anës edukative, instruktive ai i kushton, gjithashtu, më tepër kujdes se sa asaj, që është me rëndësi historike.

Megjithatë vepra e tij e shkruar me një gjuhë të përsosur e tërheqëse dhe e përshkuar nga pikëpamje politike të moderuara me një qëndrim ndaj Augustit bëri që Livi të fitojë një nam të madh që së gjalli. Edhe më vonë atë e nderonin si një historian të shquar dhe mundoheshin ta imitonin. Pas tij nuk guxonin të shkruanin në latinisht një histori të re të Romës, dhe për një kohë të gjatë u kufizuan vetëm me rrëfimin e veprës së tij të madhe.

Për ne vepra e Livit ka rëndësi të madhe se në të ruhen disa të dhëna mbi fushatat e Aleksandrit Molos dhe Pirros në Itali dhe për luftërat iliro-romake. Për këto të fundit ai plotëson në shumë drejtime ato që mungojnë ose që kanë humbur nga Polybi.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Titi Livi, Ab Urbe Condita, ed W. Weissenborn – M. Mueller, pars I-IV. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1884-1901.

[1)] Kuint Fab Pktori është historiani më i vjetër romak. Historia e tij në gjuhë greke që shkon deri tek luftërat me Hanibalin u përdor gjerësisht nga Livi.

T. LIVI

AB URBE CONDITA

(Nga themelimi i Romës)

LIBRI VIII

3 Në atë vit[1] Aleksandri, mbret i Epirit, zbriti me flotën e tij në Itali dhe sikur luftërat e tij të kishin pasur sukses do të ishte shtrirë pa dyshim deri tek romakët.

17 ... Lufta e Aleksandrit të Epirit tërhoqi samnitët në tokën e lukanëve. Këta dy popuj të bashkuar luftuan kundër këtij mbreti, i cili duke u nisur nga Pestumi kishte hyrë në këto toka; megjithëse në këtë ndeshje Aleksandri doli fitues, bëri paqe me romakët, sepse, sikurse e ka thënë ai vetë, nuk ishte i sigurtë në se punët e tjera do t'i shkonin kaq mbarë...

24 Thuhet se po në këtë vit u themelua Aleksandria[2] në Egjipt dhe se Aleksandri, mbret i Epirit, i vrarë nga një lukan i mërguar, vërtetoi me vdekjen e tij se sa të vërteta janë thëniet e orakullit të Zeusit të Dodonës. I thirrur në Itali nga tarentasit atij iu tha që të ruhej nga ujët e Aheronit dhe nga qyteti Pandosia sepse këtu do të merrte fund jeta e tij. Për këtë ai u hodh menjëherë në Itali, që të ishte, sa të qe e mundur, më larg nga qyteti Pandosia e Epirit dhe nga lumi Aheron, i cili duke buruar nga Molosia dhe duke rrjedhur nëpër lugina më të ulëta derdhet në gjiun e Thesprotisë. Por, pothuajse gjithnjë, kur njeriu do t'i shpëtojë fatit të keq, e keqja e gjen. Pasi kishte mundur dhe vënë në ikje legjionet e brutëve dhe të lukanëve, kishte pushtuar Heraklenë, koloninë e tarentasve tek lukanët, Sipontin e apulëve dhe Konsentën e Terinën e brutëve si dhe disa qytete të tjera të mesapëve e lukanëve, dhe kishte dërguar treqind familje të shquara si peng në Epir, ai pushtoi, jo shumë larg nga Pandosia, qytet pranë kufirit të lukanëve e brutëve, tri kodra të vendosura në largësi të barabarta njëra prej tjetrës. Prej këndej ai bënte inkursione në gjithë territorin e armikut. Ai mbante rreth vetes dyqind lukanë të mërguar si besnikë, por njerëz të tillë që kanë, siç ndodh zakonisht, të paqëndrueshme besën si edhe fatin.

Shirat e vazhdueshme e kishin përmbytur gjithë fushën dhe kishin ndarë ushtrinë e vendosur në tri pjesë, në një mënyrë të tillë që njëra-tjetrës nuk mund t'i vinin në ndihmë. Dy grupet ku nuk ishte mbreti u sulmuan papritur nga armiqtë dhe

---

[1] Rreth vitit 334 para e. sonë.

[2] Aleksandria është themeluar në vitin 332 para e. sonë, kurse Aleksandri i Epirit u vra rreth vitit 331 para e. sonë.

u thyen menjëherë, pastaj me forca të bashkuara këta të fundit u drejtuan kundrejt
8 vetë mbretit. Atëherë lukanët e mërguar u dërguan lajm bashkatdhetarëve të tyre dhe
u njoftuan se po t'u lejohej të ktheheshin në atdhe ata do t'u dorëzonin mbretin të
gjallë apo të vdekur. Ndërkaq ai me trupa të zgjedhura u sul me guxim, çau radhët e
9 armiqve dhe si u fut midis tyre u ndesh trup me trup me komandantin e lukanëve, të
cilin e vrau; pastaj si mblodhi ushtrinë e tij, që ishte shpartalluar e shpërndarë, arriu
10 tek një lum, ku gërmadhat e reja të një ure të shkatërruar nga forca e ujit, i tregonin
atij rrugën. Ndërsa trupat e tij kalonin këtë lum, pa ditur mirë vaun, një ushtar i
11 lodhur dhe i mërzitur nga rreziqet duke mallkuar emrin e keq të këtij lumi thirri: "Jo
më kot të quajnë Aheron". Këto fjalë arritën në veshin e mbretit dhe ai u kujtua
menjëherë për fatin e tij. Ai u ndal dhe po nguronte të kalonte. Atëherë Sotimi, njëri
nga shoqëruesit e rinj të mbretit i tha që të ruhej nga ky rrezik i madh dhe i njoftoi se
12 lukanët kërkonin rastin ta vrisnin. Mbreti u kthye dhe kur i pa që larg se po vinin në
grup kundër tij, nxori shpatën dhe u fut me kalë në mes të lumit. Ai ishte gati duke
13 dalë në va, kur një shigjetë e lëshuar prej një lukani të mërguar e goditi në trup. Ai ra
dhe trupi i tij, me shigjetën brenda, u çua nga rryma e ujit në pozitat e armikut. Këtu
14 trupin e shqyen në mënyrë të shëmtuar. Pasi e ndanë më dysh, një pjesë e dërguan në
Konsentë, kurse tjetrën e mbajtën për të dëfryer, duke e goditur së largu me shigjeta
e gurë derisa një grua u fut në mes të kësaj turme të shfrenuar që ishte pushtuar prej
15 një zemërimi çnjerëzor të pabesueshëm dhe si u lut që të ndaleshin u tha, duke qarë,
se kishte në duart e armikut burrin dhe fëmijët dhe shpresonte që me trupin e
mbretit, ashtu siç ishte i copëtuar, të rikthente familjen e saj. Ky qe fundi i masakrës
16 dhe ato që tepëruan nga gjymtyrët e tij u varrosën në Konsenta me kujdesin e një
gruaje të vetme; kockat e mbretit pasi iu dërguan armikut në Metapont u përcollën
17 prej këndej për në Epir tek e shoqja Kleopatra dhe e motra Olympia, prej të cilave
njera ishte e ëma dhe tjetra e motra e Aleksandrit të Madh.
18 Ky qe fundi i trishtueshëm i Aleksandrit epirot, të cilin, megjithëse fati nuk e
çoi në luftë kundër romakëve, m'u desh ta përmend, meqenëse ai luftoi në Itali.

LIBRI X

4 **2** ... Ai /Kleomeni i Spartës/ kaloi kepin e Brundisit dhe i shtyrë nga erërat u
gjend në mes të detit Adriatik; në të majtë kishte bregdetin pa limane të Italisë, në
krahin e djathtë ilirët, liburnët dhe istrët, popuj të egër, në shumicën e tyre me famë
të keqe për pirateri...[1)]

LIBRI XXII

3 **33** ... U dërguan delegatë tek mbreti Filip i maqedonëve për t'i kërkuar që të
dorëzonte Demetër Farin, i cili pasi u mund në luftë iku e u strehua tek ai...[2)]
5 U dërguan delegatë edhe në Iliri tek mbreti Pini për t'i kërkuar tributin, që e kishte
vonuar dhe nëqoftëse donte ta zgjaste afatin t'i merrnin pengje për siguri...

[1)] Viti 302 para e. sonë.

[2)] Viti 217 para e. sonë.

1 **40** Po atë verë[1] filloi lufta me mbretin Filip, e cila pritej prej kohësh. Nga Oriku
2 erdhën delegatë tek pretori M. Valeri, i cili komandonte flotën në brigjet e Brundisit
e të Kalabrisë, për t'i njoftuar se Filipi, pasi u fut përpjetë lumit me njëqind e njëzet
anije, u përpoq në fillim të merrte Apollorinë; por meqenëse puna këtu ishte më e
3 gjatë se sa shpresonte, e solli ushtrinë për gjithë natën fshehurazi në Orik dhe me
sulmin e parë e pushtoi, mbasi qyteti ishte në shesh dhe nuk kishte as mure, as roje,
as armë të forta . Dhe duke i treguar këto iu lutën të dërgonte ndihmë që t'i
4 kundërshtonin si nga toka ashtu edhe nga deti këtij armiku të hapët të popullit
romak; sepse ai i kishte sulmuar vetëm e vetëm se ndodheshin në pragun e Italisë.
Për këtë gjë M. Valeri, pasi la legatin e tij P. Valerin për të ruajtur këto vende me një
5 flotë të përgatitur dhe të pajisur mirë dhe si ngarkoi në anije transporti ata ushtarë, që
s'i merrnin dot anijet e gjata, arriti të nesërmen në Orik dhe e pushtoi këtë qytet pa
vështirësi të madhe, meqenëse mbrohej nga një garnizon i vogël, që kishte lënë Filipi
6 pasi ishte larguar. Në këtë e sipër erdhën delegatë nga Apollonia, të cilët thanë se
ishin rrethuar sepse nuk donin të largoheshin nga miqësia me romakët dhe se nuk do
7 të mund t'i qëndronin dot më fuqisë maqedone nëqoftëse nuk do të ndihmoheshin.
Valeri, si u premtoi se do t'ua plotësonte dëshirën, dërgoi me anijet e gjata dymijë
ushtarë të zgjedhur në grykën e lumit, me në krye prefektin G. Nev Kristën, njeri i
8 gjallë dhe ushtarak me përvojë. Ky, si nxori ushtarët në tokë, i ktheu anijet mbrapsht
për t'u bashkuar me flotën tjetër në Orik, prej nga kishte ardhur, dhe i udhëhoqi
9 ushtarët nëpër një rrugë larg lumit, e cila nuk ishte zënë nga njerëzit e mbretit dhe
natën hyri fshehurazi në qytet, pa u kuptuar fare nga armiqtë. Të nesërmen pushuan
derisa prefekti vizitoi rininë apolloniate, armët dhe forcat e qytetit. Meqenëse nga
10 kjo vizitë mbeti i kënaqur dhe në anën tjetër u njoftua nga gjurmuesit se në lëmin e
armikut mbretëronte një pakujdesi e çrregullim i madh, doli natën nga qyteti, pa bërë
as më të voglën zhurmë, hyri në lëmin e armikut, të cilin e kishin lënë të hapur dhe
braktisur kaq shumë rojet, sa që mund të thuhet me siguri se mund të kalonin ledhet
më shumë se njëmijë njerëz pa u dëgjuar fare, dhe ata mund të arrinin deri tek
11 shatorja e mbretit po të mos kishin filluar vrasjen. Vrasja e atyre që ishin afër portës
i zgjoi armiqtë; dhe kaq e madhe qe frika që i pushtoi sa që jo vetëm asnjë nuk u
ndal të merrte armët ose të përpiqej të dëbonte armikun nga lëmi, po edhe vetë
12 mbreti ashtu siç u zgjua nga gjumi, pothuajse gjysmë lakuriq dhe me një rrobë që
mund t'i përshtatej një ushtari, por jo një mbreti, iku me vrap tek lumi dhe tek anijet.
Këtu u derdh edhe turma tjetër. Në lëm mbetën diçka më pak se tremijë ushtarë të
13 zënë e të vrarë; por diçka më shumë njerëz u zunë se sa u vranë. Si u grabit lëmi,
apolloniatët morën katapultat, balistat dhe gjithë maqinat e tjera të këtij lloji, që ishin
14 grumbulluar këtu për të sulmuar qytetin, dhe i shpunë në Apolloni për të mbrojtur
muret po t'u qëllonte prapë një fat i tillë; gjithë plaçka tjetër që u gjet në lëm iu la
15 romakëve. Si shkoi ky lajm në Orik, M. Valeri pruri me të shpejt flotën tek gryka e
lumit, në mënyrë që mbreti të mos ikte dot me anijet. Kështu Filipi si humbi besimin
se mund të matej qoftë me det, qoftë me tokë /me romakët/ nxori anijet në tokë dhe
16 si i dogji iku për në Maqedoni më këmbë me një ushtri të zhveshur dhe pa armë.
17 Flota romake me M. Valerin e kaloi atë dimër në Orik.

[1] Viti 214 para e. sonë.

24 Po në këtë kohë M. Valeri Levini, i cili nëpërmjet bisedimeve të fshehta ishte përpjekur të blente mendjen e udhëheqësve kryesorë, u nis me anijet e lehta të flotës së tij për të ardhur në mbledhjen e kuvendit të etolëve, gjë të cilën e kishte shpallur që më parë.[1] Këtu ai i bëri një vlerësim pushtimit të Syrakuzës dhe Kapuas si prova të sukseseve të arritura nga romakët në Siqeli e Itali; pastaj ai shtoi se Roma e kishte traditë t'i trajtonte aleatët e saj duke i dalluar, një pale ajo u jepte të drejtat e qytetit[2], privilegj që i bënte të barabartë me romakët; ajo u kishte siguruar të tjerëve kushte të tilla që u pëlqente të ishin më mirë aleatë se sa qytetarë. Etolët, në të ardhmen do të ishin më të nderuar midis aleatëve të përtej detit, nëqoftëse do të ishin të parët që do të lidheshin me republikën: Filipi dhe maqedonët ishin për ta fqinjë të mërzitshëm; por ai tani e kishte thyer forcën dhe krenarinë e tyre, i kishte detyruar të zbraznin qytetet që u kishin marrë etolëve dhe ata tani po shqetësoheshin për vetë Maqedoninë; sa për akarnanët, të cilët u kishin shkaktuar dhimbje etolëve, duke u shkëputur, do t'i kthente nën urdhërat dhe vartësinë e tyre si më parë: këto tha dhe premtoi komandanti romak. Skopa, që atëherë ishte pretor[3] dhe Dorimahu, një prijës etol, lavdëruan fuqinë dhe madhështinë e popullit romak, për të cilën /fuqi/ kishin respekt më të vogël, por bindje më të madhe. Sidoqoftë shpresa që të bëheshin prapë zotër të Akarnanisë u bë më e madhe. Kështu u formuluan kushtet, me të cilat ata pranoheshin si miq dhe aleatë të popullit romak; u shtua edhe se po t'u pëlqejë dhe po të dëshironin mund të lidhnin miqësi me të njëjtat të drejta edhe elejt, lakedemonët, Atali, Pleurati e Skerdilaidi, Atali i Azisë, këta mbretër të thrakëve dhe ilirëve. Etolët duhej të hynin gjithashtu në luftë me Filipin nga toka, kurse romakët do t'i ndihmonin të paktën me njëzet anije të pajisura me pesë sërë lopata. Të gjitha vendet që do të pushtoheshin midis Korkyrës dhe Etolisë, qytete, shtëpi, krahina do t'u mbeteshin etolëve; gjithë plaçkën e zënë do ta merrnin romakët, të cilët merrnin përsipër t'u siguronin aleatëve të tyre zotërimin mbi Akarnaninë. Nëqoftëse etolët do të bënin paqe me Filipin, traktatin do ta nënshkruanin në atë mënyrë që paqja do të kishte vlerë vetëm nëqoftëse Filipi do të hiqte dorë nga lufta kundër romakëve dhe gjithë aleatëve që ishin nën mbrojtjen e tyre; po kështu edhe populli romak, po të lidhte traktat me mbretin, do të kujdesej që as ai të mos u bënte luftë etolëve dhe aleatëve të tyre. Kjo marrëveshje e arritur në këtë mënyrë u nënshkrua dy vjet më vonë në Olympia nga etolët dhe në Kapitol nga romakët për të patur dëshminë e godinave të shenjta. Arsyeja e kësaj vonese ishte qendrimi i gjatë i përfaqësuesve etolë në Romë. Por kjo nuk pengoi fillimin e veprimeve: etolët filluan menjëherë luftën kundër Filipit, kurse Levini pushtoi, në afërsitë e Etolisë, ishullin e vogël të Zakynthit dhe kryeqytetin e tij, që mban të njëjtin emër, pa mundur të kapte kështjellën dhe t'ua nënshtronte etolëve Eniadën dhe Nason, qytete të Akarnanisë. Filipi i ngatërruar shumë në luftën me fqinjët nuk mund të mendonte as për Italinë, as për paktin që kishte me Hanibalin, prandaj ai /Levini/ u kthye në Korkyrë.

25 Filipi u njoftua për largimin e etolëve në Pela ku ishte duke dimëruar. Prandaj, me qëllim që të gjendej në pranverë me ushtrinë në Greqi dhe që t'i siguronte qetësinë Maqedonisë, duke trembur ilirët dhe qytetet e tjera fqinje në shpinë, ndërmori një ekspeditë të papritur kundër tokave të orikasve dhe apolloniatëve dhe

[1] Viti 211 para e. sonë.
[2] Qyteti i Romës.
[3] Titull romak që i përgjigjet strategut grek.

apolloniatët që i dolën përpara i detyroi të mbyllen brenda mureve, të pushtuar nga
3 frika dhe tmerri. Pastaj, si shkretoi vendet fqinje me Ilirinë, ai u kthye me të njëjtën
shpejtësi kundër Pelagonisë; duke u nisur prej këtu, pushtoi qytetin e dardanëve
Sintia, nëpërmjet të cilit dardanët hynin në Maqedoni. Mbasi e kreu menjëherë këtë,
4 duke pasur parasysh luftën me etolët dhe bashkë me të edhe luftën me romakët zbriti
nëpërmjet Pelagonisë, Lynkosit dhe Boties në Thesali. Ai shpresonte se do të mund
të ngrinte popullsinë e këtyre vendeve, që të fillonin me të luftën kundër etolëve.
5 Dhe kështu pasi la në grykat e Thesalisë birin e tij Perseun me katërmijë ushtarë që
6 t'i pengonte etolët të hynin atje, vetë ai, para se të merrej me punë më të mëdha e
shpuri ushtrinë e tij në Maqedoni dhe prej këtu në Thraki dhe pikërisht tek medët.
Ky popull kishte zakon të hynte në Maqedoni porsa dëgjonte, se mbreti ishte i zënë
7 me luftëra të jashtme dhe se mbretëria kishte mbetur pa mbrojtje. Dhe kështu Filipi
që t'i dërrmonte forcat e tyre, shkretoi fushat e tyre dhe rrethoi qytetin Jamforina,
8 kryeqendrën e fortifikuar të medëve. Kur Skopa mësoi se mbreti kishte shkuar në
Thraki dhe se atje ishte i zënë me luftë, armatosi gjithë rininë etole dhe u përgatit t'i
9 shpallë luftë Akarnanisë. Kundër tyre populli akarnan, megjithëse me forca të
pabarabarta, megjithëse e kishte humbur Eniadën dhe Nason dhe megjithëse e dinte
10 se mbi të do të vrigëllonte edhe arma romake, u përgatit për luftë, i shtyrë më tepër
nga ndjenja e zemërimit se sa nga arsyeja e shëndoshë. Ata dërguan gratë, fëmijët
dhe pleqtë mbi gjashtëdhjetë vjeç në Epirin fqinj, kurse të gjithë banorët, që prej
11 pesëmbëdhjetë deri në gjashtëdhjetë vjeç u betuan se do të ktheheshin në atdheun e
tyre vetëm si fitues dhe se nuk do ta pranonin as në qytet, as në shtëpi, as në tryezë,
12 as në vatër atë që do të tërhiqej i mundur në luftë. Ata formuluan një mallkim të
tmerrshëm kundër atyre që do të shkelnin këtë betim, dhe u drejtuan me këtë rast
13 lutjen më të shenjtë epirotëve, të cilët u treguan kundrejt tyre mikpritës...

LIBRI XXVII

4 **30** ... Këtu /në Falara/ u mblodhën përfaqësuesit e mbretit Ptoleme të Egjiptit;
ata të Rodit, të Athinës dhe të ishullit Hio, me qëllim që t'i jepnin fund luftës midis
Filipit dhe etolëve[1]. Këta të fundit kishin si ndërmjetës, njërin prej fqinjëve të tyre,
Amynandrin, mbretin e athamanëve. Por të gjithë këta nuk ishin aq të shqetësuar për
5 etolët, që ishin njerëz shumë kryelartë në krahasim me karakterin e grekëve të tjerë,
se sa për faktin se mos Filipi dhe mbretëria e tij përzihej në të ardhmen në punët e
Greqisë, gjë që do të rëndonte mbi lirinë. Bisedimet për paqen u shtynë për në
6 kuvendin e ahejve, ku do të caktohej me saktësi mbledhja për këtë qëllim si dhe
vendi e dita;ndërkaq u arrit një armëpushim prej tridhjetë ditësh...
Ai /Filipi/ u nis për në Egion ku do të mbahej mbledhja e kuvendit të aleatëve, e cila
9 ishte thirrur prej kohësh. Këtu u bisedua për mundësitë e përfundimit të luftës me
10 etolët në mënyrë që të mos u jepej mundësia romakëve dhe Atalit të hynin në Greqi.
Por të gjitha këto plane u përmbysën nga etolët, para se të mbaronte armëpushimi,
11 sapo ata morën vesh që Atali kishte ardhur në Egine dhe që flota romake kishte
qendruar para Naupaktit. Të thirrur pra, në kuvendin e ahejve, ku kishin ardhur edhe
12 përfaqësitë që u morën në Falara me vendosjen e paqes, ata u ankuan së pari për disa
shkelje që kishin ngjarë gjatë kohës së armëpushimit, pastaj ata thanë se lufta mund

[1] Viti 208 para e. sonë.

13 të pushonte vetëm në rast se ahejt do t'u dorëznin Pylosin mesenasve, romakëve do t'u rikthenin Atintaninë dhe Skerdilaidit e Pleuratit ardianët. Por Filipi, kur dëgjoi se
14 të mundurit po i diktonin kushtet fituesit, thirri me zemërim dhe tha se: "Nëqoftëse ai u kishte vënë veshin propozimeve për një rregullim dhe nëqoftëse kishte pranuar, pastaj, një armëpushim, këtë nuk e kishte bërë aspak nga që kishte shpresë se etolët do të rrinin të qetë, por që të kishte dëshmitarë gjithë aleatët se ai donte paqen,
15 ndërsa etolët kërkonin shkak për luftë". Kështu ai shpërndau kuvendin pa përfunduar paqen...

1 **32** Ditën e parë që hynë në tokat e armikut shkretuan vendin. Të nesërmen ata iu afruan qytetit, të renditur për betejë; kalorësia e dërguar përpara duhej të afrohej deri tek portat që të provonte t'i tërhiqte jashtë mureve etolët, të cilët ishin gjithnjë gati të
2 bënin ekskursione. Nuk e dinin që Sulpici kishte kaluar nga Naupakti në Kilenë me pesëmbëdhjetë anije dhe që pasi kishte zbarkuar katër mijë njerëz, duke ecur në
3 heshtjen e natës që të mos diktohej, kishte hyrë ne Elis. Edhe aleatët i kapi frika kur
4 në mes të etolëve dhe elejve panë shenjat ushtarake dhe armët romake. Mbreti kishte
5 dashur në fillim të tërhiqej, por meqenëse veprimet luftarake kishin filluar midis etolëe dhe tralëve, fis ilir, dhe ai i pa njerëzit e tij të zënë ngushtë erdhi vetë me kalorësit e tij dhe i ra një kohorte romake... Lufta tashti nuk ishte më e barabartë;
6 shumë nga ushtarët binin përreth tij, të tjerë ishin plagosur... Po atë ditë ai ngriti lëmin pesë milje nga Elisi; të nesërmen u nis me gjithë trupat e tij kundër fortesës së
7 Elisit, të quajtur Pyrgos, ku e dinte se një shumicë e madhe fshatarësh ishin strehuar me kopetë e tyre nga frika e grabitjeve. Kjo turmë pa disiplinë dhe pa armë u dorëzua menjëherë nga frika. Kapja e tyre qe një shërbim për dështimin e turpshëm
8 që ai kishte pësuar para Elisit. Ndërsa ai ndante plaçkën e luftës dhe robërit, - katërmijë njerëz dhe njëzetmijë kokë bagëti, arriti një lajmëtar nga Maqedonia, i cili
9 solli lajmin se Eropi, pasi kishte blerë komandantin e kështjellës, kishte pushtuar qytetin Lyhnid, se ai ishte bërë zot i shumë fshatrave të Dasaretisë dhe mundohej të ngrinte dardanët. Filipi hoqi dorë nga lufta e Ahesë, por ai la dymijë e pesëqind
10 njerëz të armëve të ndryshme nën urdhërat e Menipit dhe të Polifantit për të mbrojtur aleatët e tij; ai u nis nga Dymi nëpër Ahe, Beoti dhe Eube dhe mbas dhjetë ditësh marshim arriti në Demetriadë të Thesalisë.

1 **33** Atje ai takoi lajmëtarë të tjerë që sillnin të reja edhe më shqetësuese; mësoi se dardanët të përhapur në Maqedoni ishin bërë zotër të Orestidës, se ata kishin zbritur në fushat e Argestit dhe midis barbarëve qarkullonin zëra se Filipi qe vrarë.
2 Në betejën që u zhvillua pranë Sikyonit me romakët që ishin të shumtë, kali i tij e kishte tërhequr me kaq vrull pas një peme sa që një degë i kishte thyer një copë të
3 përkrenares. Këtë copë e gjeti një etol dhe ia shpuri në Etoli Skerdilaidit, i cili e njohu që ishte një zbukurim i përkrenares (së mbretit) dhe kjo i dha shkas zhurmës mbi vdekjen e Filipit...

LIBRI XXVIII

5 **5** ... Frika mbretëronte jo vetëm në Akarnani, në Beoti, në Eube, por edhe midis ahejve dhe shqetësonte gjithashtu Mahaniden, tiranin e lakedemonëve që kishte
6 ngritur lëmin në rrethet e Argos. Të gjithë këta popuj, duke i paraqitur rreziqet, që
7 kërcënonin vendin e tyre nga deti dhe nga toka, e lutnin Filipin t'u jepte ndihmë, por

të rejat që vinin nga mbretëria nuk ishin më pak shqetësuese; Skerdilaidi dhe Pleurati ishin vënë në lëvizje[1] dhe, ndërmjet thrakëve, sidomos medët, ishin gati të sulmonin tokat e Maqedonisë sa herë që mbreti gjendej në një luftë të largët...

LIBRI XXIX

1 **12** Gjatë atyre dy vjetëve punët në Greqi kishin qenë lënë pas dore. Prandaj Filipi shtrëngoi etolët, të braktisur nga ndihma romake, të cilën ata e kishin si të vetmen mbështetje, të kërkonin e të përfundonin një paqe me ato kushte që
2 dëshironte ai vetë. Dhe sikur ai të mos ishte nxituar t'i jepte fund kësaj çështjeje me të gjitha fuqitë, prokonsulli P. Semproni, i dërguar për të zëvendësuar Sulpicin në komandë, me dhjetëmijë këmbësorë, e me njëmijë kalorës e me tridhjetepesë anije dhe për t'u sjellë aleatëve një ndihmë të rëndësishme do ta kishte shtypur atë që po luftonte kundër etolëve. Porsa ishte përfunduar paqja, mbretit i erdhi lajmi se
3 romakët kishin ardhur në Dyrrah e se parthinët edhe fiset e tjera kufitare duke shpresuar në ndryshimin e gjendjes ishin ngritur e se Dimali ishte rrethuar.[2] Prandaj romakët u kthyen shpinën etolëve, në ndihmë të të cilëve kishin ardhur, të zemëruar
4 se këta, pa pëlqimin e tyre, dhe në kundërshtim me marrëveshjen kishin bërë paqe me mbretin. Filipi i njoftuar për të gjitha këto lëvizje, duke pasur frikë një lëvizje më
5 të madhe nga ana e fiseve dhe popujve fqinjë, u nis me shpejtësi të madhe për në Apolloni, ku ishte tërhequr Semproni, i cili kishte dërguar si legat në Etoli Letorin me një pjesë të trupave dhe me pesëmbëdhjetë anije, për të hetuar gjendjen dhe po të kishte mundësi të prishte paqen. Filipi shkretoi tokat e apolloniatëve, iu afrua
6 mureve dhe i ftoi romakët në luftë; por kur pa se ata nuk e prishën qetësinë dhe u
7 mjaftuan me mbrojtjen e qytetit, shumë i dobët për të sulmuar Apolloninë, dhe nga ana tjetër duke dashur paqe edhe me romakët, sikundër me etolët, ose së paku një armëpushim, ai nuk kërkoi ta shtonte zemërimin me një përleshje të re dhe u kthye
8 në mbretërinë e vet. Në të njëjtën kohë epirotët, të lodhur nga një luftë kaq e gjatë, si hetuan më parë vullnetin e romakëve, dërguan delegatë tek Filipi, për t'i propozuar
9 një paqe të përgjithshme, duke i siguruar atij një sukses të plotë, nëqoftëse do të bënte një takim me P. Sempronin, komandantin romak. Duke qenë se mbreti nuk
10 ishte kundër këtyre propozimeve u vendos pa vështirësi të kalonte në Epir. Foinike
11 është një qytet i Epirit; atje më përpara bisedoi mbreti me Aeropin, Derdën dhe Filipin, strateg të epirotëve, pastaj u takua me P. Sempronin. Në bisedim merrnin
12 pjesë Amynandri, mbreti i athamanëve, dhe krerë të tjerë të epirotëve dhe të akarnanëve. I pari e mori fjalën strategu Filip dhe kërkoi njëkohësisht prej mbretit dhe prej komandantit romak që t'i jepnin fund luftës dhe t'ua bënin atë nder epirotëve.

P. Semproni parashtroi për paqe këto kushte: që parthinët, Dimali, Barguli dhe
13 Eugeni të jenë të romakëve, ndërsa atintanët ua linte maqedonëve, në rast se delegatët që do të dërgoheshin në Romë, merrnin pëlqimin e senatit. Si u bë paqja[3] me këto kushte, mbreti kërkoi që të përfshiheshin në marrëveshje Prusia, mbreti i
14 Bitynisë, ahejt, beotët, thesalët, akarnanët, epirotët; me kërkesën e romakëve – ilienët, mbreti Atal, Pleurati, Nabisi tiran i lakedemonëve, elejt, mesenasit, athinasit. Këto u shkruan dhe u vulosën dhe u bë armëpushimi për dy muaj, gjersa të
15 dërgoheshin delegatët në Romë në mënyrë që populli të aprovonte paqen me këto kushte. Atë e aprovuan të gjitha shtresat e vegjëlisë sepse, si u drejtua lufta nga

---

[1] Viti 207 para e. sonë.
[2] Viti 205 para e. sonë.
[3] Viti 205 para e. sonë.

Afrika, donin të shpëtonin tani për tani nga të gjitha luftërat e tjera. Mbasi u bë paqja
16 P. Semproni shkoi në Romë për konsulat.

LIBRI XXXI

9 **18** Filipi si la një garnizon në Abydo u kthye në mbretërinë e tij. Sikurse shkatërimi i Saguntës i dha zemër Hanibalit, ashtu edhe prishja e abydasve i shtoi guximin Filipit të luftonte kundër romakëve; ndërkaq i erdhi lajmi se konsulli kishte arritur në Epir dhe forcat tokësore i kishte dërguar në Apolloni për të dimëruar, kurse ato detare në Korkyrë.

1 **27** Në atë kohë[1] konsulli Sulpici kishte lëmin e tij midis Apollonisë dhe Dyrrahut pranë lumit Aps. Këtu thirri legatin e tij Luc Apustin, dhe e dërgoi me një
2 pjesë të ushtrisë për të shkretuar tokat e armikut. Apusti, pasi shkretoi kufijtë e Maqedonisë, pushtoi me sulmin e parë kështjellat e Koragut, Gerunit dhe Orgesit dhe arriti në Antipatrea, qytet që ndodhet në një grykë të ngushtë. Në fillim thirri
3 parinë për bisedime dhe u përpoq me dredhi ta bindte t'i jepej në besë romakëve, po pastaj, meqenëse ata hodhën poshtë fjalët e tij, sepse kishin besim tek madhësia e qytetit, tek muret dhe tek pozita e tij, e sulmoi qytetin me forcën e armëve dhe e shtiu në dorë. Dhe pasi vrau të gjithë, nga gjashtëmbëdhjetë vjeç e lart, e lëshoi
4 ushtrinë në plaçkë, i prishi muret dhe i vuri zjarr qytetit. Kjo frikë e shtrëngoi
5 Kodrionin, një qytet i vendosur në një pozitë mjaft të mirë dhe i fortifikuar, të dorëzohej te romakët pa luftë. Pasi la këtu roje, pushtoi me forcë Knidin më shumë i
6 njohur si emër se sa si qytet, për shkak të një qyteti tjetër që ka të njëjtin emër e që ndodhet në Azi. Kur legati po kthehej te konsulli me një plaçkë mjaft të madhe, Atenagora, një nga komandantët e mbretit, i ra praparojës kur po kalonte lumin, dhe
7 i pështjelloi radhët e fundit. Kur dëgjoi britmat e tmerruara të ushtarëve, legati ktheu shpejt kalin e tij e flamujt, vendosi në mes plaçkën e luftës dhe radhiti ushtarët për betejë; ata të mbretit nuk i qendruan dot sulmit të romakëve; shumë u vranë, më
8 shumë akoma u zunë rob. Dhe legati si ia solli konsullit ushtrinë të pacënuar, u dërgua prej tij menjëherë te flota.

1 **28** Si mori fund lufta me këtë ekspeditë mjaft të lumtur, shumë mbretër të vegjël dhe prijësa fqinjë të maqedonëve erdhën tek lëmi i romakëve: Pleurati, biri i Skerdilaidit, e Amynandri, mbreti i atamanëve, dhe prej dardanëve Batoja, i biri i
2 Longarit. Longari kishte luftuar vetë kundër Demetrit, babait të Filipit. Premtimeve të tyre për ndihmë konsulli iu përgjegj se do ta shfrytëzonte ndihmën e dardanëve dhe të Pleuratit, kur do ta fuste ushtrinë në Maqedoni; Amynandrit i caktoi të nxiste
3 etolët për luftë.

1 **33** Filipi përgatitej në mënyrë të ethshme për luftë në tokë e në det. Forcat detare i grumbulloi në Demetriadë të Thesalisë; duke menduar se Atali dhe flota
2 romake në fillim të pranverës do të largoheshin nga Egina, vuri në krye të anijeve dhe të bregdetit Heraklidin, të cilin e kishte komandant edhe më parë; ai vetë
3 përgatiste forcat tokësore dhe mendonte se u kishte shkëputur dy ndihma të mëdha romakëve, nga një anë etolët, kurse nga ana tjetër dardanët me mbylljen e grykës së Pelagonisë nga i biri i tij Perseu. Konsulli nuk e përgatiste, por e bënte luftën. Ai u
4 nis me ushtrinë e tij për në krahinën e dasaretëve dhe gjithë drithin që mori me vete

[1] Viti 200 para e. sonë.

nga kampi i tij i dimrit nuk e harxhoi, meqenëse tokat e (dasaretëve) kishin mjaft bereqet për ushtarët. Qytetet dhe fshatrat iu dorëzuan disa me dëshirë, disa prej
5 frikës; disa i pushtoi me forcë, të tjerat i gjeti të braktisura meqenëse barbarët ishin larguar në malet e afërta. Lëmin e vendosi në Lynk, pranë lumit Bevo; prej këndej
6 dërgonte për të marrë drithë në hambarët e dasaretëve. Filipi e shikonte gjithë vendin të shqetësuar dhe kudo njerëzit të frikësuar, por meqenëse nuk e dinte mirë se ku kishte shkuar konsulli dërgoi një njësi kalorësish për të hetuar se ç'rrugë kishte marrë armiku. Edhe konsulli ishte në një gjendje pasigurie; ai e dinte mirë se mbreti ishte
7 shpërngulur nga lëmi i tij i dimrit, por nuk dinte se ku po shkonte, prandaj edhe ky kishte dërguar kalorës për të ndjekur lëvizjet e tij. Këto dy njësi megjithëse kishin
8 ndjekur rrugë të ndryshme, duke u endur për një kohë të gjatë nëpër tokat e dasaretëve, u takuan më në fund me njëra-tjetrën. Edhe njëra edhe tjetra palë, pasi dëgjuan zhurmën e njerëzve dhe të kuajve e kuptuan se po afrohej armiku. Dhe kështu para se të shiheshin kishin bërë gati armët dhe kuajt. Duke qenë njëlloj të
9 fortë, si nga numri, ashtu edhe nga guximi, sepse si njëra, si tjetra palë ishin ushtarë të zgjedhur, ata luftuan për orë të tëra me të njëjtën ashpërsi. Lodhja e kalorësve dhe e kuajve bëri që të mbaronte përleshja pa u vendosur fitorja. Nga maqedonët mbetën
10 dyzet kalorës të vrarë, kurse nga romakët tridhjetë e pesë. Dhe as të parët nuk mundën t'i njoftojnë mbretit, as të dytët konsullit ndonjë gjë më të saktë për vendin
11 se ku gjendej kampi i armikut. Kjo u mor vesh nga dezertorët, mendjelhtësia e të cilëve ndihmon, siç ndodh në të gjitha luftat, për të njohur gjendjen e armikut.

5 **34** ... Mbreti u frikësua meqenëse akoma nuk kishte rënë në një luftë të vërtetë
6 me romakët; për këtë ai pasi thirri të birin dhe forcat, që ishin duke ruajtur ngushticat e Pelagonisë, për të rritur me to ushtrinë e tij, i hapi Pleuratit dhe dardanëve rrugën për në Maqedoni[1]...

1 **35** Mbreti, duke pasur frikë që të provonte fatin menjëherë në një ndeshje të përgjithshme, dërgoi për të ngacmuar kalorësinë e armikut katërqind tralë – këta sikurse e kemi thënë në një vend tjetër janë një fis ilir[2] – dhe treqind kretas; u shtoi
2 këtyre këmbësorëve dhe po kaq kalorës me në krye Atenagoren, njërin prej oborrtarëve të tij. Këto forca u rreshtuan pak më shumë se pesëqind këmbë larg nga romakët. Kundër këtyre u dërguan këmbësorë të armatosur lehtë dhe dy njësi
3 kalorësish në mënyrë që këmbësorët dhe kalorësit të ishin po aq në numër sa edhe armiqtë. Ata të mbretit mendonin se mënyra e luftimit do të ishte ajo e zakonshmja, simbas së cilës kalorësit do të sulmonin dhe do të tërhiqeshin herë duke goditur armikun me shigjeta herë duke i kthyer atyre shpinën dhe kështu shpejtësia e ilirëve do të shfrytëzohej për të sulmuar dhe për të goditur armikun papritur...

1 **40** Kështu romakët i kaluan ngushticat duke hasur në një qendresë më të dobët se sa e mendonin dhe arritën në Eordea, ku konsulli, pasi shkretoi gjithë vendin u tërhoq në Elimia. Prej këndej ai ndërmori një sulm kundër Orestidës dhe goditi
2 qytetin Celetri që gjendet në një gadishull. Muret e tij i rrethon një liqen dhe vetëm një rryp i ngushtë e lidh atë me tokën. Në fillim, duke pasur besim në pozitën e fortesës, banorët mbyllën portat dhe nuk pranuan të nënshtrohen, por më vonë pasi
3 panë flamurtarët që po vinin përpara, dhe ushtarët të mbuluar nga mburoja që po u

---

[1] Shih edhe parag. 36. -
[2] Shih më lart, libri XXVII. 32,5

afroheshin portave dhe ngushticën të mbushur me një numër të madh armiqsh, u dorëzuan nga frika para se të fillonte përleshja. Nga Celetri u drejtua për në tokat e
4 dasaretëve dhe mori me sulm qytetin Pelion. Prej këndej së bashku me plaçkën tjetër mori me vete edhe skllevërit, kurse qytetarët e lirë i lëshoi pa shpërblim dhe u ktheu qytetin mbasi la këtu një garnizon të fortë, sepse pozita e këtij qyteti ishte shumë e
5 përshtatëshme për të sulmuar Maqedoninë. Kështu, konsulli mbasi përshkoi gjithë
6 tokat armike e pruri ushtrinë në krahinën e qetësuar të Apollonisë, aty prej nga kishte filluar luftën.
7 Kurse Filipi qe detyruar të kthehej nga etolët, atamanët e dardanët dhe nga
8 shumë luftëra të tjera që i kishin plasur në vende të ndryshme. Kundër dardanëve, të cilët tani po tërhiqeshin nga Maqedonia ai dërgoi Atenagorën me këmbësorinë e lehtë dhe me pjesën më të madhe të kalorësisë me urdhër që t'i sulmonte gjatë
9 tërheqjes, të dëmtonte prapavijën e tyre dhe t'u jepte një mësim të tillë që ata të mos lëviznin më nga vendi i tyre. Sa për etolët, pretori i tyre Damoksiti, i cili i kishte këshilluar në Naupakt të përmbaheshin dhe të mos shfaqeshin në lidhje me luftën,
10 tani në mbledhjen e fundit të kuvendit, pasi kishte mësuar për fitoren e kalorësve në Otolob, për hyrjen e dardanëve dhe të Pleuratit me ilirët në Maqedoni, për arritjen e flotës romake në Ore, për ngritjen kundër maqedonasve të shumë popujve përreth dhe më në fund për bllokimin nga deti, i nxiste etolët të merrnin armët.

1 **43** Po në këto ditë Atenagora, komandant i mbretit, arriti dardanët që po tërhiqeshin nga Maqedonia dhe në fillim i shqetësoi prapavijat e tyre; por kur dardanët kthyen
2 flamujt dhe u vendosën me radhë të rregullta përballë armikut, beteja u zhvillua njëlloj si në një luftë të vërtetë. Por sapo dardanët viheshin në rrugë, njerëzit e mbretit i bezdisnin me kalorësinë e këmbësorinë e tyre të lehtë, kurse dardanët nuk
3 kishin ushtri të këtij lloji dhe ishin të ngarkuar me armë të rënda; por natyra e vendit i ndihmonte. U vranë pak, të plagosur pati më shumë, por asnjë nuk u zu, sepse në raste të ralla dalin nga radhët e tyre dhe të shtrënguar të gjithë së bashku luftojnë ose tërhiqen.
4 Kështu Filipi mbuloi dëmet që shkaktoi ufta me romakët në dy ekspedita[1] që ndërmori kundër popujve përreth.

LIBRI XXXII

8 **5** ... Pastaj ai /Filipi/ u mor më seriozisht se kurrë me përgatitjet e luftës, ushtroi në përdorimin e armëve si maqedonët, ashtu edhe ushtarët mercenarë dhe në
9 fillim të pranverës i nisi të gjitha trupat ndihmëse dhe të lehta, nën komandën e Atenagorës, për në Kaoni, nëpërmjet Epirit që të zinin ngushticat e Antigonesë, të
10 cilat grekët i quajnë Stena[2]. Mbas pak ditësh, me ushtrinë kryesore arriti atje edhe vetë dhe mbasi u njoh me krejt pozitën e vendit, mendoi se nuk mund të zinte vend më të mirë se buzë lumit Aou. Ky lum rrjedh nga një luginë e ngushtë ndërmjet dy
11 maleve, nga të cilët njërin banorët e quajnë Merop dhe tjetrin Asnau, dhe brigjet e tij nuk lejojnë veçse kalimin e një rruge të ngushtë. Filipi e urdhëroi Atenagoren të vendoset e të fortifikohet me trupat e lehta tek mali Asnau; ai vetë e ngriti lëmin tek
12 mali Merop. Për ruajtjen e majave të shkëmbinjve ai la vetëm pak ushtarë. Vendet që nuk ishin aq të sigurta i forcoi me hendeqe me ledhe dhe kulla. Në vende të

[1] Është fjala për ekspeditën tjetër të Filipit kundër etolëve dhe atamanëve.
[2] Ngushticë, grykë.

13 përshtatshme u vendosën një sasi e madhe makinash luftarake me qëllim që ta gjuanin armikun së largu. Shatorja e mbretit ngrihej para ledheve mbi një lartësi fare të dukshme për të frikësuar armikun dhe për t'u ngjallur shpresë e besim të vetëve.

1 **6** Konsulli, i njoftuar prej epirotasit Harop mbi natyrën e ngushticave të zëna
nga Filipi, në fillim të pranverës e la lëmin e tij dimëror të Korkyrës, u hodh në tokë
2 dhe mori rrugën drejt armikut. Si arriti afërsisht pesë milje nga lëmi maqedonas ai la
legjionet e veta në një vend të forcuar dhe vetëm me disa trupa të lehta shkoi edhe
më tej, me qëllim që të njihej me terrenin; të nesërmen u mbajt një këshill për të
3 vendosur nëse pa marrë parasysh lodhjet dhe rreziqet e panumërta, duhej të
përpiqeshin të kalonin në mes të ngushticave që mbante mbreti, apo t'i binin përqark
për të hyrë në Maqedoni nga e njëjta rrugë që kishte bërë konsulli Sulpici një vit më
4 parë. Ky këshill kishte ditë që po diskutonte, kur erdhi lajmi se T. Kuinkti, ishte bërë
konsull, se atij i kishte rënë për short si provincë Maqedonia dhe me një marshim të
forcuar kishte arritur në Korkyrë...

6 **9** ... Dhe T. Kuinkti, konsulli tjetër, u nis prej Brundisit në Korkyrë shumë më
shpejt se sa e kishin bërë këtë rrugë paraardhësit e tij, dhe arriti në këtë ishull me
7 tetëmijë këmbësorë e pesëqind kalorës. Nga Korkyra kaloi, në bregun më të afërt të
Epirit me një anije të pajisur me pesë sërë lopata dhe së këtejmi marshoi me
8 shpejtësi drejt lëmit romak; Vili u largua; këtu ai ndenji disa ditë për të pritur arritjen
e trupave që vinin nga Korkyra dhe mbajti një këshill për të sqaruar nëse do t'i binte
drejt armikut për të hapur një rrugë, duke përçarë kampin e tij, apo t'i shmangej një
përpjekjeje sa të vështirë aq edhe të rrezikshme dhe të merrte më mirë një rrugë të
tërthortë nëpër tokat e dasaretëve dhe Lynkut, që do ta shpinte pa rrezik në
Maqedoni.

1 **10** Kaluan kështu dyzet ditë duke ndenjur përballë armikut dhe pa ndërmarrë
asgjë. Nga kjo Filipit i lindi shpresa për të provuar arritjen e një paqe me
2 ndërmjetësinë e fisit epirot. Për këtë qëllim ai mbajti një këshill dhe Pausania, strateg
i tyre, bashkë me Aleksandrin, komandant i kalorësve, të ngarkuar prej tij për këtë
çështje, përgatitën një takim ndërmjet konsullit dhe mbretit në një vend ku lumi Aou
rrjedh në një shtrat shumë të ngushtë...[1)]

1 **11** Kështu paraqitej gjendja, kur arriti bariu i dërguar nga Haropi, një prijës i
2 epirotëve, të cilin e çuan tek konsulli. Ai tha se vazhdimisht kulloste bagëtinë në ato
male të thepisura ku ishte ngritur tani lëmi i mbretit; se i njihte këto male me të
3 gjitha rrugët dhe shtigjet e tyre. Nëqoftëse konsulli dëshironte të dërgonte me të disa
ushtarë, ai e merrte përsipër t'i udhëhiqte këta në rrugë të sigurta dhe shumë të lehta
që të shpien sipër, mbi kokën e armikut. Konsulli si dëgjoi këto fjalë e pyeti Haropin
4 nëse mendonte, që në një punë me kaq rëndësi mund t'i jepej besimi pa pësuar
ndonjë rrezik fjalëve të një bariu. Haropi i dërgoi fjalë se ai mund t'i besonte...

1 **12** Ndërkaq, mbas tri ditësh, tymi që ngrihej prej maleve lajmëronte se romakët
i kishin zënë dhe i mbanin ato. Atëherë konsulli e ndau ushtrinë e tij në tre grupe, u
vu vetë në krye të grupit më të fuqishëm dhe marshoi përmes grykës, ndërsa të dy
krahët anësorë iu afruan në të djathtë e në të majtë lëmit maqedon. Armiku paraqitej
2 po aq i sigurtë edhe kur zjarri i luftës i tërhoqi jashtë fortifikimeve, romakët u treguan

---

[1)] Për arsye se kërkesat romake ishin të rënda nuk u arrit asnjë marrëveshje. (Në vitin 198 para e. sonë)

shumë më të epër në saje të trimërisë së tyre, të përvojës dhe të armëve të tyre të mira. Si pati shumë të plagosur dhe të vrarë, mbreti u dha urdhër ushtarëve që të
3 futen në pozicionet e fortifikuara ose të mbrojtura nga natyra; i gjithë rreziku u kthye kështu kundër romakëve, që ishin future në vende jo të favorshme dhe në një grykë nga nuk ishte lehtë të dilje. Kjo marri e tyre nuk do të kishte mbetur pa u dënuar po të mos kishin shkaktuar në radhët e ushtarëve të mbretit rrëmujë e panik britmat, që
4 u dëgjuan në shpinë të maqedonasve dhe sulmi që filloi njëkohësisht. Një palë ua dhanë këmbëve me nxitim; të tjerët qëndruan akoma jo aq për trimërinë, se sa pse
5 nuk kishin se nga të iknin dhe, të sulmuar nga armiku, nga para dhe mbrapa, mbetën të rrethuar. E gjithë ushtria do të mund të shkatërrohej nëqoftëse fituesit do t'i kishin ndjekur ata që ikën; por kalorësit romakë i ndaloi ngushtica dhe vështirësia e
6 terrenit, kurse këmbësorët pesha e armëve të tyre.
7 Mbreti iku i pari pa kthyer sytë mbrapa; pastaj ai arriti në një largësi prej afërsisht pesë miljesh, dhe këtu, duke gjykuar se armiku, për arsye të pengesave që
8 paraqitnin rrugët, nuk mund ta ndiqte, u ndal në majë të një kodre dhe dërgoi disa komandantë nëpër malet e në luginat e afërme për të grumbulluar ushtarët e
9 shpërndarë. Ai nuk humbi më tepër se dymijë njerëz. Ushtria tjetër e ribashkuar si një trup i vetëm dhe nën një flamur të vetëm, arriti me një ecje të shpejtuar në Thesali....

1 **13** Të nesërmen u vu në ndjekje të armikut gjatë të njëjtës luginë të ngushtë,
2 nëpër të cilën kalonte lumi. Mbreti ditën e parë arriti në lëmin e Pyrrit, kështu quhet vendi që ndodhet në Trifylia, tokë e Molosisë; ditën tjetër i shtyrë nga frika, ai bëri një udhëtim të forcuar dhe arriti tek mali Lynk; këto janë male të Epirit dhe ndodhen
3 në kufi të tij me Thesalinë e Maqedoninë; ato janë veshur me pyje të dendura me përjashtim të majës, ku shihen fusha të gjera dhe burime të ftohta të pashterueshme...
Edhe Amynandri me atamanët nuk ndenjën të qetë, pasi morën vesh për sukseset e
15 romakëve. **14** Por me që Amynandri nuk kishte shumë besim tek ushtarët e vet, i
1 kërkoi konsullit një përforcim të vogël dhe u nis për në Gomfi; gjatë rrugës mori me sulm kështjellën e quajtur Feca që gjendet midis Gomfit dhe grykave të ngushta, që ndajnë Thesalinë nga Atamania. Prej këndej ai sulmoi Gomfin, i cili i bëri një
2 qëndresë të fortë për shumë ditë me radhë; por kur banorët panë shkallët që po vendoseshin në muret e tyre, i pushtoi frika dhe u dorëzuan. Dorëzimi i Gomfit i
3 shtiu frikën gjithë thesalëve. Kjo bëri që të dorëzohen Argenti, Ferini, Timari, Ligina, Strymona, Lampsi dhe shumë fortesa të tjera të parëndësishme. Ndërsa athamanët e etolët, pa u frikësuar nga maqedonasit po korrnin frytin e fitores së të
4 tjerëve dhe Thesalia po shkretohej prej tri ushtrish së bashku, pa mundur të dallonte armiqtë nga aleatët e saj, konsulli kaloi grykën që i kishin çelur armiqtë e vënë në
5 ikje dhe hyri në Epir: ai e dinte shumë mirë që, me përjashtim të Haropit, epirotët nuk i përkrahnin romakët; ndërkaq meqenëse shikonte se dëshira për të mbuluar
6 gabimet e tyre i bënte të përulur ndaj urdhërave të tij, duke i marrë parasysh të tashmen, ai harroi të kaluarën dhe me këtë butësi i afroi për të ardhmen. Pastaj ai
7 dërgoi në Korkyrë urdhërin që t'i sjellin anije ngarkese në gjirin e Ambrakisë dhe duke vazhduar rrugën e tij me ngadalë, ditën e katërt ngriti lëmin mbi malin Cerceti ku thirri të vijë edhe Amynandrin me trupat e tij, jo sepse ai kishte nevojë për këto
8 forca të reja, por me qëllim që të mos i mungonin udhëheqësa për në Thesali; po për këtë arsye ai pranoi midis ndihmave të tjera edhe një numër të madh vullnetarësh epirotë.

5 **32** ... I dërguari i mbretit erdhi për t'i kërkuar (konsullit) kohën dhe vendin e një takimi...

9 U zgjodh si i tillë bregu i detit pranë Nikesë në gjirin e Malesë. Këtu erdhi mbreti nga Demetriada me pesë lembe dhe një anije të pajisur me kiç me kryedash[1]. 10 Atë e shoqëronin prijës maqedonas dhe Kiliadi, një aheas i shquar që ndodhej në 11 mërgim. Konsulli kishte me vete mbretin Amynandër, përfaqësuesin e Atalit Dionisodorin, komandantin e flotës së Rodit Agesimbrotin, pretorin e etolëve Fenean, dhe dy aheas, Aristenin e Ksenofontin. Kuinkti doli nga mesi i atyre, që e 12 shoqëronin dhe iu afrua bregut të detit, ndërsa Filipi u duk në anijen e tij që kishte 13 hedhur çengelat. "Po të zbrisni në tokë, i tha Kuinkti, do ta kemi më lehtë të bisedojmë dhe të kuptohemi". Mbreti nuk pranoi...

1 **33** Pas këtyre fjalëve pati një heshtje të shkurtër, sepse romaku mendonte se ishte më e arsyeshme të fliste ai që kishte kërkuar bisedime; por mbreti i tha se fjala e parë i takonte atij që parashtronte kushtet e paqes dhe jo atij që do t'i dëgjonte. Atëherë romaku iu përgjegj se fjalët e tij ishin të thjeshta dhe pa marrë parasysh ato, 2 nuk mund të flitej për paqe. Mbreti duhej të tërhiqte garnizonet e tij nga gjithë 3 qytetet e Greqisë, ai duhej t'u kthente aleatëve të romakëve robërit dhe dezertorët e tyre, romakëve vendet e Ilirisë, që kishte pushtuar pas paqes së Epirit dhe mbretit 4 Ptoleme të Egjiptit qytetet që Filipi i kishte marrë pas vdekjes së Ptolemeut Filopator. Këto ishin kushtet që paraqiste ai në emër të vet dhe të popullit romak; por shtoi se ishte e drejtë të dëgjoheshin edhe kërkesat e aleatëve...

2 **35** ... Të nesërmen Kuinkti erdhi në Nikea në kohën e caktuar meqenëse i kishte pëlqyer vendi. Por kishin kaluar disa orë dhe nuk po dukej as Filipi, as ndonjë i dërguar i tij; dhe më në fund kur kishin humbur çdo shpresë u dukën anijet e tij. 3 Duke kërkuar të falur ai tha se meqenëse i ishin vënë kushte të rënda dhe të padenja kishte harxhuar gjithë ditën duke menduar pa mundur të vendoste. Të gjithë 4 mendonin se ai ishte vonuar me qëllim që të mos u jepte kohë ahejve dhe etolëve të 5 përgjigjeshin; dhe ai e vërtetoi këtë mendim kur kërkoi që të largoheshin të tjerët dhe t'i lejohej të bisedonte vetëm me komandantin romak për të mos harxhuar kohën kot me diskutime dhe për të arritur në një farë përfundimi. Kjo gjë në fillim nuk u 6 pranua për të mos u dukur se aleatët përjashtoheshin nga bisedimet; pastaj pa 7 kërkuar kështillën e secilit, komandanti romak për të mos harxhuar kohën kot me diskutime dhe për të arritur në një farë përfundimi. Kjo gjë në fillim nuk u pranua 8 për të mos u dukur se aleatët përjashtoheshin nga bisedimet; pastaj pa kërkuar kështillën e secilit, komandnati me Aul Klaudin, prefekt, dhe tre tribunë, duke lënë 9 gjithë të tjerët erdhi në breg të detit. Mbreti me dy të tjerë, të cilët i kishte marrë me 10 vete edhe ditën e parë, zbriti në tokë. Këtu biseduan së bashku në fshehtësi. Se ç'farë u tha Filipi të tijve nuk dihet, por Kuinkti u njoftoi aleatëve se romakëve ai u 11 lëshonte gjithë bregdetin e Ilirisë dhe u kthente të arratisurit dhe robërit; Atalit, anijet 12 bashkë me detarët e zënë rob, rodasve vendin e quajtur Perea kurse Jasin dhe Bargylin nuk e lëshonte; etolëve u kthente Farsalën dhe Larisën, por jo Tebën; ahejve u lëshonte jo vetëm Argon, por edhe Korintin.[2] Nuk i pëlqeu asnjërit që t'i lihej atij të vendoste për ato që duhej të lëshonte, sepse kështu do të humbisnin më shumë se sa do të fitonin. Kjo do të bënte që të mos zhdukeshin kurrë shkaqet e grindjeve sa kohë që ai do të mbante garnizonet e tij në Greqi.

3 **36** Bregu pranë Tronit u caktua për takimin tjetër. Këtu u mblodhën që në mëngjes herët. Aty Filipi filloi për të parën herë t'i lutet Kuinktit dhe gjithë të

---

[1] Pajisje në formën e një trau me majë metalike për të shpuar anijen e kundërshtarit.
[2] Viti 196 para e. sonë.

pranishmëve që të mos prishin shpresat e paqes. Më në fund ai kërkoi kohë që të mund të dërgonte përfaqësues në Romë dhe këtu ose të siguronte paqen me këto kushte ose të pranonte të gjitha kushtet që do t'i vinte senati...

... I dhanë një armëpushim prej dy muajsh; ndërkaq e gjetën me vend që çdo popull të dërgonte nga një përfaqësues të vetin për të sqaruar senatin në mënyrë që të mos ta mashtronin ata të mbretit si t'u pëlqente. I shtuan marrëveshjes së armëpushimit si kusht që garnizonet e mbretit të tërhiqen menjëherë nga Fokida dhe Lokrida. Nga ana e tij Kuinkti, për t'i dhënë rëndësi përfaqësisë, dërgoi bashkë me përfaqësuesit e aleatëve edhe Amynandrin, mbretin e atamanëve, si dhe M. Fabin, nipin e gruas së tij, F. Fulvin e Ap. Klaudin.

37 Kur erdhën në Romë u dërguan më parë përfaqësuesit e aleatëve se sa ata të mbretit. Fjalimet e tyre nuk ishin gjë tjetër veçse sharje të pafund kundër mbretit; por ajo që habiti më shumë senatin ishte plani figurativ i detit dhe i tokave të tyre, ku për cilindo ishte e qartë se po të mbetej mbreti zot i Demetriadës në Thesali, Halkidës në Eube dhe i Korintit në Ahe, Greqia nuk mund të ishte e lirë. Vetë Filipi, më tepër për të fyer se sa për të thënë të vërtetën, i kishte quajtur ato pranga të Greqisë. Pastaj u futën brenda përfaqësuesit e mbretit; fjalimet e tyre të gjata, u ndërprenë nga pyetja e shkurtër, nëse ishte mbreti i gatshëm t'i lëshonte këto tre qytete. Ata u përgjigjën se nuk kishin asnjë udhëzim. Kështu u përcollën përfaqësuesit e mbretit pa paqen. Kuinktit iu la e drejta të vendosë vetë mbi paqen apo luftën... Ai nuk e pranoi më Filipin për bisedime dhe i tha të mos dërgonte më përfaqësi tjetër veç asaj që do t'i njoftonte se Filipi lëshonte gjithë Greqinë.

LIBRI XXXIII

3 ... Ndërkaq Kuinkti u nis në ato ditë nga Elatia, kaloi Tronin e Skarfenë dhe arriti në Termopyla. Këtu kuvendi i fshehtë i etolëve në Herklea ishte mbledhur për të vendosur se sa forca ndihmëse do t'u jepnin romakëve për luftë. Si u njoh me vendimin e aleatëve u largua nga Heraklea; pas tri ditësh arriti në Ksinia dhe vendosi lëmin në kufi të enianëve dhe tesalëve për të pritur trupat ndihmëse të etolëve. Etolët pa humbur kohë, të komanduar nga Fenea erdhën me dymijë këmbësorë dhe katërqind kalorës. Kuinkti, si u bind se nuk kishte përse të priste më, ngriti lëmin dhe u nis menjëherë. Kur hyri në tokat e Ethiotisë u bashkuan me të pesëqind gortynas nga Kreta, të komanduar nga Kyolanti dhe treqind apolloniatë të armatosur lehtë si të parët; pas pak ditësh u bashkuan me të edhe Amynandri me njëmijë e dyqind këmbësorë atamanas...

4 Dështimeve që kishin pësuar tri herë me radhë falangat maqedonase në ngushticat e lumit Aou, ai /Filipi/ u vinte përballë mundjen e romakëve në Atraks; dhe shtonte se, nëqoftëse grykat e Epirit ishin dorëzuar, faji i parë kishte qenë i atyre që i kishin ruajtur pa farë kujdesi, dhe faji i dytë në vetë përleshjen e të armatosurve lehtë dhe të ushtarëve mercenarë; po falanga e maqedonasve kishte bërë qendresë të mirë dhe përherë do të qëndronte e pathyeshme kudo që të gjendej në pozitë të mirë dhe në një radhitje të përsosur. Ushtria e tij përbëhej nga njëmijë e gjashtëqind maqedonas, që ishin trupat më të zgjedhura të tij e të mbretërisë, nga dymijë ushtarë të armatosur me mburoja, të quajtur peltastë, nga dymijë thrakë dhe po aq ilirë të quajtur tralë, nga afro njëmijë e pesëqind mercenarë prej visesh të ndryshme dhe nga

dymijë kalorës. Kjo ishte fuqia me të cilën mbreti e priste armikun. Pothuajse të
6 njëjtin numër kishin romakët; vetëm trupa kalorësish kishin më shumë, sepse kishin ardhur etolë.

1 **12** Armikut iu dha një armëpushim prej pesëmbëdhjetë ditësh dhe u vendos që të bëhej një bisedim me mbretin[1]. Por para se të vinte dita e takimit ai /Kuinkti/ mblodhi kuvendin e aleatëve dhe u propozoi të vendosnin se në ç'kushte u pëlqente
2 të zhvilloheshin bisedimet për paqen. Amynandri, mbret i atamanëve, e shprehu pikëpamjen e tij me pak fjalë: "Paqja duhej të përfundonte në një mënyrë të tillë që
3 Greqia të mund ta mbronte atë dhe lirinë e saj edhe kur të ishin larg romakët". Por më e ashpër ishte fjala e etolëve, të cilët pasi bënë një hyrje të shkurtër, shtuan se ishte një gjë e drejtë dhe e rregullt, që komandanti romak shkëmbente mendime në
4 lidhje me paqen me ata që kishte aleatë në luftë. Po do të gabohej shumë nëqoftëse nuk do të siguronte një paqe të qëndrueshme për romakët dhe lirinë për grekët, nëqoftëse nuk do të vritej Filipi ose nuk do t'i hiqej froni, gjë që ai do të mund ta
5 rifitonte me shumë lehtësi po t'i ndihmonte fati. Këtyre fjalëve Kuinkti iu përgjegj se
10 ... për ta ishte e qartë që liria e Greqisë kërcënohej nga forca e mbretërve maqedonas, por po të shkatërrohej kjo mbretëri dhe ky popull, thrakët, ilirët, galët,[2]
11 popuj të egër dhe të shfrenuar, do të dyndeshin në Greqi dhe dëshira për të shpëtuar nga një armik fqinj do t'i çelte rrugën një armiku më të madh në numër dhe të rrezikshëm...

1 **19** Filipi pasi dëgjoi se dardanët kishin kaluar kufijtë dhe po shkatërronin krahinat e sipërme të Maqedonisë duke mos e përfillur këtë mbretëri të mundur,
2 megjithëse e shikonte se kishte kundër gjithë botën dhe që një fat i keq po e shtrëngonte atë dhe njerëzit e tij nga të gjitha anët, për më tepër, duke e quajtur më të
3 keqe se vdekjen humbjen e sundimit të tij mbi Maqedoninë, pasi zgjodhi me të shpejtë ushtarë nëpër qytete, sulmoi papritur armikun me gjashtëmijë këmbësorë dhe pesëqind kalorës pranë Stobit në Paioni, ku u vranë shumë njerëz gjatë përpjekjes,
4 por edhe më shumë pas shpartallimit, kur ishin përhapur nëpër fusha. Ata që mundën të ikin më shpejt u kthyen në vendet e tyre, pa bërë përpjekje që të luftonin. Pas
5 kësaj ekspedite, që ishte e vetmja me fat midis të tjerave dhe që u dha përsëri zemër ushtarëve të tij, u kthye në Thesali.

1 **34** Pas lojërave istmike[3] Kuinkti dhe dhjetë legatë dëgjuan të dërguarit e mbretit dhe të popujve të ndryshëm...
5 Pasi u larguan të dërguarit e mbretit, u mbajt një mbledhje e përfaqësuesve të gjithë popujve dhe qyteteve. Ajo nuk zgjati shumë, sepse këtu u kufizuan vetëm me
6 leximin e vendimeve të dhjetë legatëve për gjithë qytetet. Orestëve – këta janë fis maqedonas -, të cilët ishin të parët që u ngritën kundër mbretit, iu lanë ligjet e tyre.
7 Magnetët, perrebejt e dolopët u shpallën të lirë. Populli thesal, përveç lirisë, i dhanë Ftiotinë me përjashtim të Tebës ftiote dhe Farsalës. Kërkesën e etolëve për t'u kthyer
8 në bazë të marrëveshjes Farsalën dhe Leukadën ia përcollën senatit, por një vendim u jepte atyre të drejtat që kishin pasur edhe më parë mbi Fokidën dhe Lokridën.
9 Korinti, Trifyli dhe Erea, e cila është gjithashtu në Peloponez, iu kthyen ahejve. Të
10 dhjetë legatët i jepnin Oreun dhe Eritrenë mbretit Eumen, birit të Atalit kundër mendimit të Kuinktit, prandaj çështja iu kthye për gjykim senatit, i cili u

---

[1] Në vitin 197 para e. sonë.
[2] Galët skordiskë.
[3] Viti 196 para e. sonë.

11 dha këtyre qyteteve dhe Karistit lirinë. Pleuratit iu dhanë Lyhnidi dhe parthinët; të dy këto fise ilire ishin nën sundimin e Filipit. Amynandrit i njohën të drejtën mbi kështjellat që i kishte marrë Filipi në kohën e luftës.

LIBRI XXXV

5 **14** ... Klaudi, duke u mbështetur në librat greke të Akilianit, thotë se P. Afrikani bënte pjesë në atë përfaqësi dhe se ishte ai që shkoi në Efes për të biseduar me
6 Hanibalin[1]. Ai tregon edhe një nga bisedat që bënë: pyetjes së Afrikanit se kush
7 ishte sipas tij komandanti më i madh, Hanibali iu përgjegj: Aleksandri, mbret i Maqedonisë, i cili me një grusht ushtarësh shkatërroi ushtri të panumërta dhe kishte arritur krahinat më të largëta të botës, ku askush nga njerëzit nuk shpresonte të
8 arrinte. Kur e pyeti pastaj, se cilin vinte ai në vendin e dytë, iu përgjigj, Pirron, sepse ky ishte i pari që i mësoi të tjerët si të vendosin lëmin; përveç kësaj asnjë s'ka ditur
9 më mirë se ai të njohë dhe të zgjedhë vendin për vendosjen e rojeve dhe dinte t'i këshillonte njerëzit aq mirë, sa që popujt e Italisë deshën më mirë t'i sundonte një
10 mbret i huaj se sa populli romak, që ishte prej kohësh në krye të kësaj toke. Dhe, duke vazhduar ta pyes për komandantin e tretë, Hanibali iu përgjigj se pa dyshim ky
11 ishte ai vetë /Hanibali/. Atëherë Scipioni filloi të qeshë dhe shtoi: "Ç'do të thoshe pra, po të më kishe mundur mua?" "Po të të kisha mundur, atëherë do ta vija veten para Aleksandrit e Pirros dhe para gjithë komandantëve të tjerë". Scipioni atëherë u
12 prek nga përgjigja, sa e errët aq edhe dinake, kartagase dhe nga lëvdata e papritur, që e dallonte atë midis komandantëve të tjerë dhe e bënte gati të pakrahasueshëm.

LIBRI XXXVI

1 **5** Ndërsa në Romë bëheshin këto gjëra[2], Antiohu duke qenë në Halkidë, për të mos humbur kohë gjatë stinës së dimrit, u jepte zemër qyteteve, herë duke dërguar tek ata përfaqësues e herë duke pritur të tillë si në rastin e epirotëve, që vinin me
2 pëlqimin e përgjithshëm të popullit; edhe elejt erdhën nga Peloponezi. Ata i kërkuan ndihmë kundër ahejve, të cilët pasi i shpallën luftë Antiohut mendonin të sulmonin
3 më parë qytetin e tyre. Mbreti u dërgoi këtyre njëmijë këmbësorë nën komandën e kretasit Eufan. Përfaqësuesit epirotë nuk u treguan as të sinqertë, as të ndershëm, se
4 donin të fitonin simpatinë e mbretit pa fyer romakët. Ata i kërkuan që të mendohej mirë e të mos i gënjente meqenëse vendi i tyre ishte më afër Italisë dhe këta do të ishin të parët që do të goditeshin dhe do të prisnin për gjithë Greqinë sulmet romake.
5 Nëqoftëse mbreti do të mund të vinte vetë për të mbrojtur Epirin me forcat tokësore e detare, gjithë epirotët do ta prisnin atë me gjithë qejf dhe do t'i hapnin portat e qyteteve të tyre, por nëqoftëse ai nuk mund ta bënte këtë i luteshin të mos i vinte
6 përballë romakëve kështu të zhveshur e të paarmatosur. Qëllimi i kësaj përfaqësie ishte i qartë: në rast se mbreti nuk do të vinte në Epir, gjë që u dukej më e mundshme, t'i linte të lirë të silleshin si të donin me ushtrinë romake, pasi të kishin
7 fituar simpathinë e mbretit, duke i treguar se ishin gati ta prisnin po të vinte në Epir; dhe nëqoftëse ky do të vinte, kishin shpresë që të faleshin nga romakët, sepse duke
8 mos mundur ta prisnin ndihmën kaq të largët të tyre u detyruan t'i nënshtroheshin

---

[1] Në vitin 193 para e. sonë.
[2] Në vitin 191 para e. sonë.

forcës së armikut. Pa u shpejtuar t'i përgjegjej një përfaqësie kaq të dyshimtë /Antiohu/ u tha se do të dërgonte njerëzit e vet për të biseduar për çështjet që u përkisnin të dy palëve.

6 **16** ... Pasi bëri për vete edhe këta /beotët/, ai /Antiohu/ u kthye në Halkidë, prej nga u shkroi prijësave etolë që të mblidheshin në Demetriadë me qëllim që të vendoste me ta për veprimet e përbashkëta. Ai erdhi në këtë mbledhje nëpër det, në
7 ditën e caktuar. U thirr edhe Amynandri nga Atamania për të biseduar. Edhe Hanibali, kartagjenas, i cili prej kohësh nuk ishte thirrur mori pjesë në këtë kuvend. Do të bisedohej çështja e thesalëve...

1 **7** Meqenëse gjithë diskutimet vërtiteshin, si të thuash, rreth një çështjeje të vetme, Hanibali i thirrur të jepte mendimin e tij, tërhoqi vëmendjen e mbretit dhe të pjesëmarrësve të tjerë të kuvendit mbi luftën në përgjithësi, duke u drejtuar këto
2 fjalë: "Nëqoftëse do të më kishit pyetur që kur kaluam në Greqi për çështjen e Eubesë, ahejve dhe të Beotisë do të kisha dhënë të njëjtin mendim që jap sot kur
3 bisedohet për thesalët. Mendoj se para së gjithash duhet të bëjmë me vete në këtë luftë, me çdo kusht, Filipin dhe maqedonasit... Me një aleat të tillë, më lejoni të
7 them, si mund të dyshohet për rezultatin sidomos kur romakët do të kenë për armiq ata që i ndihmuan të triumfojnë mbi Filipin? Etolët që, siç e dinë gjithë bota e
8 mundën Filipin do të luftojnë me këtë prijës kundër romakëve; Amynandri dhe
9 atamanët, bashkëpunimi i të cilëve qe më i forti në këtë luftë do të jenë gjithashtu me ne. Filipi mbante atëherë gjithë peshën e luftës o Antioh! Tani dy mbretër të
10 fuqishëm do të luftojnë me forcat e Evropës dhe të Azisë, kundër një populli që në kohën e etërve tanë, nuk po flas këtu për frikën që u kalla si gjatë sukseseve të mia, ashtu edhe gjatë tërheqjes, nuk ishte në gjendje t'i bënte ballë një mbreti të vetëm të Epirit. Çdo të bëjë ai, pra, kundër ju të dyve?

1 **13** Ndërkaq M. Bebi dhe mbreti Filip, të cilët gjatë dimrit ishin takuar në
2 Dasareti, pasi kishin dërguar në Thesali Ap. Klaudin për të shpërndarë rrethimin e Larisës dhe pasi qenë kthyer në lëmet e tyre të dimrit, meqenëse stina nuk ishte e përshtatshme për veprime ushtarake, i bashkuan trupat e tyre në fillim të pranverës
3 dhe zbritën në Thesali. Antiohu ishte akoma në Akarnani. Me të arritur, Filipi rrethoi Malenë në Perrebi; M. Bebi pushtoi Facin pa luftë dhe Festin me të njëjtën shpejtësi.
4 Pastaj ai u kthye në Atraks, mori Kiretinë dhe Eritinë, vendosi garnizone në qytetet e pushtuara dhe shkoi të takonte Filipin, që vazhdonte të mbante të rrethuar Malenë. Kur panë ushtrinë romake banorët qoftë nga frika se nuk do të mund t'u qëndronin,
5 qoftë nga shpresa se do të faleshin, u dorëzuan. Prej këndej të dy ushtritë marshuan së bashku për të ripushtuar vendet që kishin zënë atamanët; këto vende ishin: Egini,
6 Ericini, Gomfi, Silana, Trika, Melibea, Faloria...

14 Gjatë kësaj kohe konsulli M. Acili, i cili kishte kaluar detin me njëzetmijë
1 këmbësorë, dymijë kalorës dhe pesëmbëdhjetë elefantë, zgjodhi disa nga tribunët ushtarakë të tij për të udhëhequr këmbësorinë në Larisë. Ai vetë me kalorësit erdhi të takonte Filipin para Limnesë. Me të ardhur konsulli, qyteti u dorëzua bashkë me
2 garnizonin e mbretit dhe me atamanët. Nga Limnea konsulli marshoi për në Pelinea. Atamanët u dorëzuan të parët dhe Filipi Megalopolitan ndoqi shembullin e tyre...
5 Pjesa tjetër e atamanëve dhe e ushtarëve të Antiohut që bënin pjesë në garnizonet e qyteteve të nënshtruara kohët e fundit, iu dorëzuan Filipit...
Filipi u soll me një kujdes të veçantë ndaj robërve atamanë me qëllim që me anë të
7 tyre të pajtohej me popullin, të cilin shpresonte ta nënshtronte dhe nuk e shpuri

ushtrinë e tij në Atamani para se të arrinin robërit. Ata bënë një përshtypje të madhe
8 tek njerëzit duke treguar për zemërgjërësinë e mbretit ndaj tyre. Në anën tjetër
9 Amynandri, prania e të cilit mund t'i kishte përmbajtur disa nga njerëzit e tij të mos dorëzoheshin, duke pasur frikë se mos të tjerët e zinin dhe ia dorëzonin Filipit, i cili ishte prej shumë kohësh armik i tij, ose romakëve, që në atë kohë ishin shumë të zemëruar me të, iku nga mbretëria e tij me gruan dhe me fëmijët dhe shkoi e u strehua në Ambraki. Kështu e gjithë Atamania kaloi nën pushtetin e Filipit.

7 **34** ... Por kur u kthye tek konsulli ai /Kuinkti/ i tha: "M. Acili, a nuk e ndieni rëndësinë e gjithë kësaj pune ose, nëqoftëse i parashikoni pasojat, a besoni ju se interesi i populllit romak nuk kompromentohet rëndë në këtë mes?" Këto fjalë
8 tërhoqën vëmendjen e konsullit, i cili u përgjigj: "Shprehuni më qartë". Kuinkti vazhdoi: "A nuk e shihni se që nga dështimi i Antiohut ju po humbisni kohë me rrethimin e dy qyteteve dhe po i afroheni mbarimit të vitit të komandimit tuaj, ndërsa
9 Filipi, i cili nuk ka marrë pjesë në asnjë luftim dhe nuk ka parë asnjë flamur armik, ka nënshtruar jo vetëm qytete, por edhe një numër të madh popujsh, Atamaninë, Perrebinë, Aperantinë, Doloponë? Ndërkaq interesi ynë nuk e kërkon të dobësojmë fuqinë e etolëve, por të pengojmë Filipin të zgjerohet jashtë masës dhe të mos e
10 lejojmë të marrë për vete kaq popuj të Greqisë, kur çmimi i fitores për ju dhe ushtarët tuaj përbëhet vetëm nga dy qytete".

8 **35** ... Tek konsulli erdhën delegatë epirotë, për të cilët dihej mirë se nuk kishin qëndruar besnikë në miqësinë e tyre /me Romën/; në të vërtetë ata nuk i kishin dhënë ushtri Antiohut, por akuzoheshin se e kishin ndihmuar me të holla; ata vetë
9 nuk e mohonin se kishin dërguar tek mbreti delegatë. Lutjes së tyre, që t'i lejonte të jenë miq si edhe më parë, konsulli iu përgjigj se nuk dinte akoma nëse do t'i fuste në radhën e armiqve apo të miqve, mbi këtë çështje duhej të gjykonte senati. Kërkesën
10 e tyre do t'ia përcillte Romës pa e marrë në shqyrtim dhe u jepte për këtë qëllim një afat prej nëntëdhjetë ditësh. Delegatët epirotë u nisën për në Romë dhe u paraqitën
11 në senat. Ata e quajtën si meritë faktin që nuk kishin marrë pjesë në veprimet armiqësore, por nuk u përpoqën megjithatë të shfajsohen nga akuzat që u bëheshin. Edhe përgjigja ishte e tillë, që u linte të kuptonin se romakët dëshironin me gjithë qejf t'ua falnin, porse nuk shihnin ndonjë shkak për të aprovuar qendrimin e tyre.

LIBRI XXXVIII

1 **1** Në kohën kur bëhej lufta në Azi gjendja në Etoli nuk ishte e qetë për shkak të
2 një lëvizjeje të athamanëve[1]. Që kur ishte ndjekur Amynandri, Atamania qeverisej nga mëkëmbësa të Filipit, sundimi kryelartë e tiranik i të cilit kishte bërë që të ndiehej mungesa e mbretit të parë. Amynandri i cili ishte strehuar atëherë në Etoli,
3 mori nga nënshtetasit e tij letra që i tregonin gjendjen e Atamanisë, dhe shpresonte ta shtinte përsëri në dorë mbretërinë e tij. Ai dërgoi disa njerëz të besuar pranë
4 banorëve kryesorë, për t'i paralajmëruar se posa të merrte vesh që bashkëqytetarët e tij do ta prisnin mirë ai do të kthehej në Argitë, kryeqytet i Atamanisë, me ndihmën që do t'i jepnin etolët, dhe se ai do të kishte me vete magistratët që përbëjnë këshillin
5 e populllit dhe pretorin Nikandër. Kur pa se ata ishin gati për gjithçka, ai u njoftoi ditën kur do të hynte me ushtri në Atamani...

---

[1] Në vitin 189 para e. sonë.

Ditën e caktuar, Amynandri arriti në kufi me njëmijë etolë. Përkrahësit e tij, duke vepruar bashkërisht, nxorën njëkohësisht nga të katër kështjellat garnizonet maqedonase, pastaj ata dërguan në qytetet e tjera thirrje, me anën e të cilave i ftonin banorët të çliroheshin nga sundimi tiranik i Filipit dhe të vendosnin mbretin e tyre të ligjshëm në fronin e gjyshërve të tyre. Maqedonasit u përzunë nga të gjitha anët...
Amynandri u bë atëherë zot i gjithë Atamanisë, me përjashtim të fortesës së Atenesë, që ndodhej në kufi të Maqedonisë.

3 Pasi shtiu në dorë mbretërinë, Amynandri dërgoi përfaqësues në Romë pranë senatit dhe në Azi tek Scipionët, të cilët ishin ndalur në Efes pas betejës së madhe me Antiohun. Ai kërkonte paqe dhe lutej ta falnin që kishte marrë ndihmë nga etolët për të shtënë në dorë mbretërinë e të parëve të tij. Ai akuzonte Filipin.

Etolët duke dalë nga Atamania marshuan kundër amfilohëve dhe meqenëse pjesa më e madhe e popullit iu nënshtrua vullnetarisht ata vunë nën sundimin e tyre gjithë vendin. Mbasi morën Amfilohinë, e cila u përkiste edhe më parë, ata u drejtuan me të njëjtën shpresë për në Aperanti, e cila u nënshtrua gjithashtu pothuajse pa kundërshtuar. Dolopët, që nuk u kanë përkitur kurrë etolëve dhe që vareshin nga Filipi, në fillim morën armët. Por me të marrë vesh nënshtrimin e amfilohëve, largimin e Filipit nga Atamania dhe masakrimin e forcave të tij, e braktisën atë dhe u hodhën me etolët. Këta të fundit, duke nënshtruar popujt fqinjë kujtonin se u kishin shpëtuar sulmeve maqedonase, por ndërkaq mësuan se romakët kishin mundur Antiohun në Azi. Pak kohë më vonë përfaqësuesit e tyre u kthyen nga Roma pa shpresë për paqe dhe bile njoftuan se konsulli Fulvi kishte kaluar detin me ushtrinë e tij...

M. Fulvi sapo zbriti me ushtrinë e tij në Apolloni, hyri në bisedime me krerët epirotë se nga duheshin filluar veprimet ushtarake. Epirotët ishin të mendimit që të sulmohej Ambrakia, e cila s'kishte shumë kohë që u ishte dorëzuar etolëve. Sepse thonin ata, ose etolët do t'i vinin në ndihmë, dhe në këtë rast do të luftonin në fushë të hapët, ose nuk do të guxonin t'i hynin kësaj pune dhe rrethimi nuk do të paraqiste vështirësi. Në të vërtetë romakët do të kishin përdorur materiale të shumta për kullat dhe punimet e tjera sepse lumi Areth, që rridhte mu pranë mureve /të qytetit/ do t'u lehtësonte transportimin e çdo gjëje të nevojshme. Përveç kësaj edhe stina ishte e përshtatshme për veprimin ushtarak. Këto qenë arsyet që e bënë Fulvin të niset nga Epiri.

4 Kur konsulli erdhi në Ambraki, pa se marrja e këtij qyteti kërkonte punime të mëdha. Ambrakia ndodhet mbi një kodër të thepisur, të cilën banorët e atyshëm e quajnë Perante. Qytete, muret e të cilit janë nga ana e fushës dhe lumit, është kthyer nga perëndimi, kurse akropoli i tij që kurorëzon kodrën shikon nga lindja. Lumi Areth, i cili buron nga Atamania, derdhet në detin e Ambrakisë, që e ka marrë emrin nga qyteti më i afërm. Përveç që ishte i mbrojtur nga një anë prej lumit, nga tjetra prej kodrës, qyteti ishte i rrethuar me mure të forta, që kishin një perimetër pak më shumë se katërmijë hapa. Fulvi ngriti nga ana e fushës dy lëme njërin pranë tjetrit dhe mbi një majë ngriti një kullë përballë akropolit; pastaj ai i lidhi të gjitha këto me ledhe dhe hendeqe në mënyrë që as të mbyllurit në qytet të mos dilnin dhe as ndonjë ndihmë nga jashtë të mos vinte. Me të marrë vesh për rrethimin e Ambrakisë pretori Nikandër me një shpallje të veçantë mblodhi etolët në Strat. Këtu në fillim vendosën të sulen me gjithë fuqitë e tyre dhe ta lirojnë qytetin nga rrethimi. Por pastaj kur panë se qyteti ishte rrethuar pothuajse nga të gjitha anët dhe

se epirotët kishin ngritur lëmin e tyre në atë anë të lumit, vendosën t'i ndajnë forcat e tyre. Eupolemi me njëmijë vetë të armatosur lehtë u drejtua për në Ambraki dhe, duke kaluar përmes fortifikimeve që s'ishin mbaruar akoma, hyri në qytet. Nikandri me fuqinë tjetër mendoi në fillim t'i binte natën lëmit të epirotëve, të cilët s'mund të merrnin ndihma nga romakët, mbasi i ndante në mes lumi, por pastaj ky plan iu duk i rrezikshëm, sepse po ta merrnin vesh romakët, nuk do të kishte rrugë për t'u kthyer prapa, prandaj hoqi dorë nga kjo dhe u nis në drejtim të Akarnanisë për ta shkretuar.

5 Pretori i etolëve... u dërgoi ndihmë amfilohëve, të cilët tani së fundi kishin hyrë përsëri nën pushtetin e etolëve, mbasi Perseu, i biri i Filipit, i dërguar që të ripushtonte Dolopinë dhe amfilohët po i sulmonte me forca të mëdha...

7 Perseu kur dëgjoi se etolët po afroheshin, hoqi dorë nga rrethimi i qytetit që po sulmonte, u mjaftua me shkatërrimin e fushave, u largua nga Amfilohia dhe u kthye në Maqedoni. Edhe etolët u detyruan të ktheheshin prapa, sepse bregdeti i tyre po shkretohej. Pleurati, mbret i ilirëve, kishte hyrë në gjirin e Korintit me gjashtëdhjetë anije, ishte bashkuar me flotën e aheasve që ndodhej në Patra dhe kishte filluar të prishte bregdetin e Etolisë[1]. Kundër tyre u dërgua një forcë prej njëmijë etolësh, të cilët duke ndjekur drejtimin e lundrimit të flotës armike gjatë bregdetit, merrnin rrugët më të shkurtëra, u dilnin përpara dhe ua prisnin hovin kur bëheshin gati për të zbritur në tokë. Në anën tjetër romakët që rrethonin Ambrakinë, duke rrahur dendur muret e qytetit me kryedeshë shkaktuan shumë të çara dhe vrima por megjithëkëtë s'mundën të hynin në qytet brenda...

9 ... Në këtë kohë erdhën pranë konsullit të deleguar nga Athina dhe Rodi që të ndërmjetësonin për etolët; po në këtë kohë erdhi edhe Amynandri, mbreti i atamanëve, që të kërkonte favor jo aq për etolët se sa për qytetin e Ambrakisë ku kishte kaluar më të shumtën e kohës kur gjendej në mërgim... Amynandri përpiqej me të gjitha forcat e tij t'ua mbushte mendjen ambrakasve të dorëzoheshin, por meqenëse nuk ia arriti dot këtij qëllimi me anën e bisedimeve që bëri me parinë e qytetit nën muret, kërkoi dhe mori leje nga konsulli të hynte në qytet. Këtu, si hyri, ca me këshilla, ca me lutje, mundi t'i bindte ambrakasit t'u dorëzoheshin pa kushte romakëve.

17 ... Të detyruar ta lënë atdheun e tyre për mungesë tokash *[galët]*, u vendosën në bregdetin e thepisur të Ilirisë, përshkuan Paioninë e Thrakinë, duke luftuar kundër popujve trima dhe i shtinë në dorë këto vende...

LIBRI XXXIX

23 ... Pasi mundën Antiohun në Termopile u ndanë në dy pjesë dhe në ato ditë konsulli Acili bëri rrethimin e Heraklesë, kurse Filipi atë të Lamisë; por si mori Heraklenë, Acili e urdhëroi Filipin të largohej nga muret e Lamisë dhe ky qytet iu dorëzua romakëve, gjë që e dëshpëroi shumë Filipin. Konsulli e zbuti pak zemërimin e tij, kur i nxitur për të rrethuar Naupaktin, ku ishin strehuar etolët pas dështimit të tyre, ai i lejoi Filipit ta çonte luftën në Atamani kundër Amynanrit dhe t'i shtonte

[1] Ngjarja i përket vitit 189 para e. sonë.

11 mbretërisë së tij qytetet që etolët u kishin rrëmbyer thesalëve. Atij /Filipit/ nuk iu deshën përpjekje të mëdha për të ndjekur Amynandrin nga Atamania dhe për të rimarrë mjaft qytete...

17 **24** ... Përsa u takon atamanëve ata kërkuan /në senat/ lirinë e tyre dhe fortesat e Athenesë dhe Petnesë...

3 **28** ... "Gjatë luftës së Etolisë unë /Filipi/ mora urdhër nga konsulli M. Acili të rrethoja Laminë. Pas shumë mundimesh të një rrethimi që më kushtoi luftime të shumta dhe punime të mëdha, në kohën kur po përgatitesha të kaloja muret dhe të merrja qytetin, konsulli, më thirri dhe më shtrëngoi të tërhiqem bashkë me trupat.
4 Për të më ngushëlluar për këtë padrejtësi m'u dha leja të ripushtoj disa fortesa në Thesali, Perrebi e Atamani, që ishin më shumë kështjella të thjeshta se sa qytete. Dhe këtë dëmshpërblim të vogël ti Q. Cecil ma rrëmbeve para disa ditësh..."

LIBRI XL

1 **42** Në të njëjtin vit L. Duroni, pretori i vitit të kaluar, mbasi ishte kthyer nga Iliria në Brundis me dhjetë anije i la ato këtu dhe u kthye në Romë[1]. Duke raportuar për punët që kishte kryer atje, midis të tjerave vuri në dukje se shkaku i gjithë
2 piraterive detare ishte pa dyshim mbreti i ilirëve Genti. Të gjitha anijet që grabitnin brigjet e detit të sipërm, ishin të mbretërisë së tij; për këtë çështje i kishte dërguar
3 delegatë, por ata nuk kishin mundur të takohen me të. Erdhën pastaj në Romë delegatë të Gentit për të thënë se në kohën kur delegatët e Romës kishin ardhur për të biseduar me mbretin, ai ndodhej i sëmurë në një kënd të largët të mbretërisë së tij.
4 Genti i lutej senatit të mos i besonte akuzave shpifëse të armiqve të tij. Këtyre Duroni iu përgjigj se shumë nga shtetasit romakë dhe aleatë të emrit latin kishin pësuar padrejtësi në mbretërinë e tij; thuhet edhe se në ishullin e Korkyrës[2]
5 mbaheshin shtetas romakë. Senati vendosi t'i sillte të gjithë në Romë; ngarkoi pretorin G. Klaudin të merrte njoftim për faktet dhe priti rezultatin e hetimeve për t'i kthyer përgjigje mbretit Gent dhe delegatëve të tij.

2 **57** ... Vdekja e Filipit erdhi në kohën e duhur për romakët. Lufta u la dhe forcat e tyre u çliruan prej saj. Pak ditë mbas kësaj fisi i bastarnëve, i cili për një kohë të gjatë qe nxitur nga Filipi, la vendbanimet e veta dhe kaloi lumin Istër me një këmbësori dhe kalori të madhe.
4 ... Ishin marrë vesh që Filipi t'i linte bastarnët të kalonin lirisht nëpër Thraki, dhe t'u jepte atyre ushqime. Që t'ia arrinte qëllimit ai i bëri për vete me anë dhuratash krerët e krahinave, duke i siguruar ata se bastarnët do të kalonin nëpër ato /toka/ në
5 mënyrë paqësore. Qëllimi i tij ishte që të zhdukte fisin e dardanëve dhe të vendoste në tokat e tyre bastarnët. Ai mendonte se prej kësaj do të kishte një përfitim të
6 dyfishtë, nga njëra anë do të zhdukej fisi i dardanëve, i cili gjithmonë kishte qenë armik i rrezikshëm i Maqedonisë dhe shqetësonte mbretërit e saj në çaste të vështira, kurse nga ana tjetër do të mund të dërgonte bastarnët në Itali që ta shkretonin atë
7 posa të linin në Dardani gratë dhe fëmijët e tyre. Rruga për në Adriatik dhe Itali kalonte nga skordiskët. Nëpër rrugë tjetër ishte e pamundur të kalonte ushtria. Skordiskët do t'i lejonin me lehtësi bastarnët, pasi ata nuk ndryshonin prej tyre as

---

[1] Në vitin 180 para e. sonë.
[2] Është fjala për Korkyrën e Zezë.

nga gjuha, as nga zakonet. Dhe ata vetë do të bashkoheshin me ta kur ta shihnin se
8 shkonin për të plaçkitur popullin më të pasur. Për këtë arsye planet e tij në çdo rast
ishin të përshtatshme; nëqoftëse bastarnët do asgjësoheshin nga romakët prapseprapë
dëbimi i dardanëve, plaçka nga mbeturinat e bastarnëve dhe pushtimi me lehtësi i
9 Dardanisë do t'i shërbenin atij si ngushëllim; nëqoftëse nga ana tjetër do të kishin
sukses me sulmin e tyre atëherë vëmëndja e romakëve do të tërhiqej në luftën kundër
tyre dhe ai do të mund të pushtonte përsëri në Greqi atë që pat humbur. Të tilla ishin
planet e Filipit.

LIBRI XLI

4 **19** Perseu kishte ngatërruar dardanët me bastarnët dhe i kishte hedhur në luftë
me njëri-tjetrin, dhe kur delegatët, që ishin dërguar në Maqedoni për të parë si
qendronin punët, u kthyen në Romë, njoftuan se në Dardani kishte plasur lufta...[1)]
Dardanët duke parë se bastarnët jo vetëm nuk dilnin nga vendi i tyre siç shpresonin
7 ata, por të ndihmuar nga fqinjët e tyre thrakë e skordiskë po bëheshin nga dita në ditë
më të rrezikshëm, nga dëshpërimi u grumbulluan të armatosur nga të gjitha anët nën
muret e një qyteti afër të cilit kishin ngritur lëmin bastarnët. Po fillonte dimri dhe
këta e kishin zgjedhur këtë stinë si të përshtatshme sepse thrakët e skordiskët do të
8 ktheheshin në vendin e tyre. Porsa mësuan këtë tërheqje, e cila i la bastarnët vetëm
me forcat e tyre, ata i ndanë trupat në dy grupe, njëri prej të cilëve duhej të
marshonte drejt armikut dhe ta sulmonte në ballë, ndërsa tjetri do ta sulmonte nga
9 mbrapa, pasi të sillej nëpër rrugë të fshehta. Por beteja filloi para se ky grup t'i dilte
prapa armikut dhe dardanët të mundur u tërhoqën në qytet, që nuk ishte veçse
10 dymbëdhjetë milje larg lëmit të bastarnëve. Fituesit e rrethuan menjëherë qytetin të
bindur se armiqtë do të dorëzoheshin nga frika që të nesërmen ose se do ta merrnin
11 menjëherë me anën e forcës. Ndërkaq, grupi tjetër i dardanëve që kishte bërë rrugën
e vet, duke mos ditur humbjen e grupit të parë e gjeti pa mbrojtje lëmin e bastarnëve
dhe e shtiu në dorë pa asnjë mundim.

LIBRI XLII

2 **26** Po pritej lufta e Maqedonisë, kur delegatë nga Isa bënë të lindin dyshime për
veprimet e Gentit, mbretit të ilirëve[2)]. Ata u ankuan, se ishte e dyta herë, që ai kishte
shkretuar tokat e tyre dhe lajmëronin njëkohësisht, se mbreti i Maqedonisë dhe ai i
3 Ilirisë ishin të një mendjeje, se ata po përgatisnin së bashku luftën kundër romakëve
dhe se delegatët ilirë që ndodheshin në Romë ishin spiunë të dërguar me shtytjen e
4 Perseut, për të marrë vesh se çdo të bëhej. Ilirët u thirrën në senat; këtu delegatët
thanë se ishin dërguar nga mbreti për ta larë atë nga faje që mund t'i ngarkonin isasit.
5 Atëherë u pyetën përse nuk ishin paraqitur në magistrat që t'u jepnin vend për banim
dhe për të ngrënë. A dinte ndokush se kishin ardhur dhe pse kishin ardhur? Kur ata
ngurruan të jepnin përgjigje, iu tha që të largoheshin nga senati. Nuk u gjet me vend
6 t'u jepej përgjigje delgatëve, mbasi ata nuk kishin kërkuar të paraqiteshin në senat;
por u gjet e arsyeshme të dërgoheshin delegatë për t'i thënë mbretit të Ilirisë se
aleatët ankoheshin në senat për shkretimet që kishte pësuar vendi i tyre nga ai dhe se
senati e shihte për detyrë të tij t'i mënjanonte padrejtësitë që u bëheshin aleatëve të

[1)] Viti 175 para e. sonë.
[2)] Viti 172 para e. sonë.

7 tij. Si delegatë u dërguan A. Terenc Varroni, C. Pletori dhe C. Cicerei.

11 **29** ... Genti, mbreti i ilirëve meqenëse nuk kishte vendosur ç'anë do të mbante, ishte vënë në pozitë të dyshimtë nga romakët: ai dukej sikur merrte herë njërën herë tjetrën anë, më shumë i shtyrë nga rrëmbimi, se sa nga arsyeja.

8 **36** ... Ja se ç'ndodhi në Romë para se të niseshin konsujt. Gn. Sicini, i cili para se të hiqte dorë nga detyra, pat qenë dërguar në Brundis pranë flotës dhe ushtrisë, ishte hedhur në Epir me pesëmijë këmbësorë dhe treqind kalorës dhe kishte ngritur
9 lëmin pranë Nymfeut, në tokat e Apollonisë. Prej këndej dërgoi disa komandantë me dymijë ushtarë për të pushtuar kështjellat e dasaretëve e të ilirëve, të cilët kishin kërkuar edhe vetë garnizone për të qenë më të sigurt nga sulmet e maqedonasve fqinjë.

1 **37** Disa ditë më pas K. Marci, A. Atili, P. dhe Ser. Kornel Lentuli dhe L. Decimi, që kishin mision të shkonin në Greqi, zbarkuan në Korkyrë me njëmijë këmbësorë; atje ata ndanë ndërmjet tyre edhe krahinat që duhej të përshkonin edhe
2 ushtarët që duhej të merrnin me vete. L. Decimi u ngarkua të gjente Gentin, mbretin e ilirëve dhe të përpiqej, nëqoftëse e shikonte se i kishte mbetur ndonjë skrupull për angazhimet e tij, t'i mbushte mendjen të bashkonte armët e tij me ato të romakëve...
4 Marci dhe Atili ishin caktuar të përshkonin Epirin, Etolinë dhe Thesalinë...

38 Marci dhe Atili si erdhën në Epir, shkuan në Gitanë, qytet i vendosur dhjetë
1 milje nga deti, dhe atje thirrën kuvendin e epirotëve. Ata u dëgjuan nga të gjithë anëtarët e këtij kuvendi me kënaqësi të madhe dhe katërqind ushtarë epirotë u dërguan në Oreste për t'u siguruar banorëve lirinë, që ata kishin fituar, duke shkundur zgjedhën maqedonase...

45 ... Decimi vetëm u kthye në Romë pa arritur ndonjë sukses dhe bile me
8 dyshimin poshtërues se ai ishte korruptuar me të hollat e mbretërve të Ilirisë.

48 ... Pretori C. Lukreti, i cili komandonte flotën, u nis nga Roma me dyzet
5 anije të pajisura me pesë sërë lopata. Një pjesë e anijeve u pa e arsyeshme të mbetej për nevoja të tjera. Pretori nisi vëllanë e tij M. Lukretin me një anijet të pajisur me
6 pesë sërë lopata me porosi që të merrte nga aleatët anije, që duhej t'i jepnin dhe të bashkohej me flotën në Kefaleni. Regi i dha një anije me tri sërë lopata, Lokri dy të tilla dhe Uriti katër. Me këto anije ai përshkoi gjithë bregdetin e Italisë, Kepin e
7 Kalabrisë në detin Jon dhe arriti në Dyrrah. Këtu ai gjeti dhjetë anije që u përkisnin dyrrahasve; gjeti dhe dymbëdhjetë të tjera tek banorët e Isës dhe pesëdhjetë e katër
8 tek mbreti Gent. Bëri sikur këto ishin përgatitur për t'u shërbyer romakëve, i mori që të gjitha dhe brenda tri ditëve u gjend në Korkyrë dhe së andejmi kaloi menjëherë në Kefaleni...

LIBRI XLIII

1 Po atë verë që në Thesali ndodhën këto[1)], mëkëmbësi i dërguar në Iliri nga
1 konsulli, nënshtroi, duke përdorur forcën e armëve, dy qytete shumë të pasura dhe u
2 la banorëve gjithë pasuritë e tyre, me shpresë se ky akt zemërgjerësie do t'i bënte

[1)] Në vitin 171 para e. sonë.

banorët e Karnuntit, qytet i fortifikuar, ta prisnin mirë. Por kur e pa se nuk po
3 dorëzoheshin dhe as nuk po i merrte dot me anë të rrethimit, me qëllim që ushtarëve
të mos u shkonte kot mundimi dhe lodhja, që kishin patur gjatë dy rrethimeve të
mëparshme, u dha të drejtën të plaçkitnin qytetet, që më parë i kishte lënë të
4 paprekura. Konsulli tjetër , G. Kasi nuk bëri asgjë me rëndësi në Gali, të cilën shorti
ia kishte dhënë si provincë dhe u orvat më kot të çonte legjionet e tij në Maqedoni
përmes Ilirisë. Të dërguarit e akuileasve e njoftuan senatin mbi këtë drejtim që
5 kishte marrë konsulli. Ata erdhën të ankoheshin për gjendjen e keqe të kolonisë së
tyre të porsalindur e tepër të dobët që të mund të qëndronte në këmbë ndërmjet dy
popujve armiq, istërve dhe ilirëve, dhe iu lutën senatit të merrte masa sigurimi për
6 vendin e tyre. Kur u pyetën nëse donin t'ia besonin këtë G. Kasit, ata u përgjigjën se
Kasi, pasi kishte grumbulluar ushtrinë e tij në Akuile ishte nisur për Maqedoni
7 përmes Ilirisë. Në fillim kjo u duke e pabesueshme dhe që të gjithë mendonin se ai
kishte shkuar ndoshta të luftonte kundër karnëve dhe istërve. Pasi akuileasit njoftuan
se nuk dinin dhe s'kishin ç'thoshin tjetër gjë veçse që u ishte ndarë ushtarëve bukë
8 për tridhjetë ditë dhe që kishin kërkuar dhe marrë me vete udhëheqës, që dinin udhën
që nga Italia gjer në Maqedoni, senati u zemërua shumë kundër konsullit, i cili kishte
9 guximin të linte provincën e tij për të kaluar në një tjetër dhe që, duke udhëhequr
ushtrinë në një rrugë të panjohur dhe të rrezikshme, përmes popujsh të huaj, u hapte
atyre rrugën e Italisë. U vendos me shumicë të madhe votash që pretori C. Sulpici të
10 zgjidhte menjëherë nga gjiri i senatorëve tre legatë, të cilët do të niseshin nga Roma
brenda ditës dhe të shpejtonin sa më shumë për të gjetur konsullin Kasi kudo që të
11 ndodhej dhe t'i bënin të ditur që të hiqte dorë nga lufta kundër çdo populli tjetër
përveç atij që ishte ngarkuar të luftonte në bazë të vendimit të senatit...

4 **9** ... Nuk kishte luftë gjëkundi veçse në Maqedoni[1]. Megjithatë kishte dyshime
5 mbi Gentin, mbretin e ilirëve. Senati e gjeti me vend t'i dërgonte nga Brundisi tetë
anije të pajisura mirë në Isa mëkëmbësit G. Furi, i cili mbronte këtë ishull me dy
anije, që u përkisnin banorëve të Isës. U ngarkuan në këto anije dymijë ushtarë që
6 pretori M. Reci mobilizoi në bazë të vendimit të senatit në pjesën e Italisë, që është
përballë Ilirisë. Nga ana e tij konsulli Hostili dërgoi në Iliri katërmijë këmbësorë nën
komandën e Ap. Klaudit për të mbrojtur popujt fqinjë me këtë vend. Ky meqë nuk
7 ishte i kënaqur nga trupat që kishte me vete, mblodhi tek aleatët ndihma të tjera, me
anën e të cilave krijoi një forcë tetëmijë vetësh, kombësish të ndryshme, dhe pasi
përshkoi gjithë këtë vend u vendos në Lyhnid, në Dasareti.

1 **10** Aty afër *[Lyhnidit]* gjendej qyteti Uskana, i cili përfshihej brenda kufijve të
shtetit të Perseut. Ai kishte dhjetëmijë banorë dhe një garnizon të vogël kretas.
2 Këndej erdhën fshehurazi lajmëtarë, të cilët i njoftuan Klaudit se, nëqoftëse do t'i
sillte më afër ushtritë e tij, do të kishte njerëz, të cilët do t'ishin gati t'ia dorëzonin
qytetin. Puna e tij do t'i shpërblehej, pasi jo vetëm ai dhe miqtë, por edhe ushtarët e
3 tij do të mbusheshin me plaçkë. Shpresa e tij për këtë, e diktuar nga lakmia, e verboi
aq shumë sa që nuk mbajti asnjë nga ata që erdhën tek ai, bile nuk kërkoi as peng, të
cilët ta garantonin se nuk e gënjenin nëqoftëse do të bëhej kjo punë; përveç kësaj ai
nuk dërgoi njeri që të mësonte për gjendjen dhe nuk mori një sigurim me anë të
betimit. Ditën që ishte caktuar, u nis nga Lyhnidi dhe vendosi lëmin dymbëdhjetë

[1] Në vitin 170 para e. sonë.

4 milje nga qyteti, ku ishte drejtuar.Nga ora katër mbas mesnate u drejtua për në qytet, duke lënë si roje të lëmit rreth njëmijë vetë. Me një rreshtim të parregullt dhe me një kolonë të gjatë, arritën afër qytetit një numër i vogël, mbasi marshimi i natës i kishte
5 shpërndarë edhe më tepër. Pakujdesia e tyre u rrit, mbasi nuk panë asnjë roje të armatosur në muret e qytetit. Por pasi u avitën në largësinë e heshtës armiqtë u sulën për një herë nga dy portat e qytetit. Britma e ushtarëve, që u sulën kundër romakëve u përzie me ulërimën e tmerrshme që lëshonin gratë nga muret e qytetit, me zhurmën e madhe të enëve prej bakri, që vinte nga çdo anë dhe me klithmat e ndryshme të
6 turmës së parregullt të qytetarëve të përzier me skllevërit. Të frikësuar nga kjo rrëmujë e madhe dhe e përgjithshme romakët nuk mundën t'i qëndrojnë as sulmit të
7 parë. Vetëm dymijë njerëz me legatin në krye u kthyen në lëm. Sa më e madhe ishte
8 largësia nga lëmi aq më shumë lodhja u jepte mundësi armiqve që t'i ndiqnin. Bile Api as nuk u ndal në lëm për të mbledhur ushtarët e tij të shpartalluar, dhe kjo do të shpëtonte edhe ushtarët e shpërndarë nëpër fusha, por menjëherë shkoi në Lyhnid me ata, që i kishin mbetur pas këtij dështimi.

1 **18** Perseu, në fillim të dimrit,[1] nuk guxoi të dilte jashtë kufijve të Maqedonisë nga frika se mos romakët hynin në mbretërinë, që ai do ta linte të zbrazët, por në mes të kësaj stine, kur bora e madhe i bën të pakapërcyeshme malet nga ana e Thesalisë,
2 mendoi se ishte rasti t'ua priste shpresat dhe t'i dekurajonte fqinjët, me qëllim të mos t'i dilte ndonjë rrezik për luftën e tij me romakët. Nga ana e Thrakisë kishte paqe me Kotysin, nga ana e Epirit me Kefalin, që papritmas ishte shkëputur nga romakët;
3 dardanët s'kishte shumë që i kishte nënshtruar; vetëm krahu i Maqedonisë, që shtrihej nga Iliria mund të ishte i kërcënuar prej luftës; dhe vetë ilirët nuk rrinin qetë dhe u linin shteg romakëve. Mendoi pra që sikur t'i kishte shtruar ilirët që kishte në
4 kufi, atëherë edhe Gentin, i cili prej kohësh ngurronte, do të mund ta bënte për vete. Prandaj u nis dhe erdhi në Stuberë me dhjetëmijë këmbësorë, një pjesë e të cilëve
5 ishin falangitë, dhe me dymijë ushtarë të armatosur lehtë e me pesëqind kalorës. Pastaj, mbasi mori drithë për shumë ditë dhe mbasi dha urdhër që t'i vinin pas mjetet për të sulmuar qytetet, në të tretën ditë ngriti lëmin pranë Uskanës – ky është qyteti
6 më i madh i tokës së penestëve – po megjithatë përpara se të përdorte forcën, dërgoi disa vetë, që të bënin hetime si midis komandantëve të garnizonit, ashtu edhe midis banorëve të qytetit. Atje, bashkë me rininë e ilirëve, ndodhej edhe garnizoni romak.
7 Si prunë lajmin se qëndrimi i të rrethuarve nuk ishte aspak paqësor, Perseu u përpoq ta shtinte në dorë qytetin duke e sulmuar nga të gjitha anët. Megjithëse ata që sulmonin këmbenin njëri-tjetrin natë e ditë pa pushim, një pjesë duke u përpjekur të hipnin me shkallë nga muret, pjesa tjetër duke u dhënë zjarrin portave, mbrojtësit e
8 qytetit i qëndronin kësaj furie sepse i mbante shpresa se maqedonasit as nuk do të kishin mundësi ta duronin më gjatë dimrin e fortë përjashta, as edhe lufta me Romën
9 s'do t'i linte kohë mbretit që të merrte frymë. Mirëpo, mbasi panë se po viheshin në veprim tenda[2] dhe po ngriheshin kulla, këmbëngulja u thye. Me të vërtetë, përsa u përket forcave, këto nuk ishin të barabarta, gjithashtu aty brenda nuk kishte ushqime me shumicë ose gjëra të tjera, sikundër ndodh në një rrethim të papandehur. Prandaj,
10 meqenëse s'kishte mbetur asnjë shpresë për qëndresë, K. Karvil Spoletini dhe G. Afrani u dërguan nga garnizoni romak që të kërkonin prej Perseut së pari që t'i linte të lirë të dilnin të armatosur me gjithë sendet e tyre, së dyti sikur të mos ja arrinin

---

[1] Në vitin 169 para e. sonë.

[2] Mbrojtëse kundër armëve të flakura nga armiku.

këtij qëllimi, të nxirrnin prej tij fjalën se do t'u falte jetën dhe do t'i linte të lirë. Këtë
11 premtim fisnik mbreti më tepër e dha se sa e mbajti. Dhe me të vërtetë, mbasi u dha urdhër që të dilnin me gjithçka kishin, më së pari u hoqi armët pastaj edhe lirinë. Mbasi dolën këta përtej qytetit si kohorta e ilirëve që kishte pesëqind vetë – ashtu edhe uskanasit u dorëzuan me gjithë qytetin.

1 **19** Perseu, pasi vuri roje në Uskanë, të gjithë turmën e të dorëzuarve, që në sasi
2 barazohej me një ushtri të tërë, e shpuri në Stuberë. Këtu, përveç krerëve, ushtarët romakë, që ishin katërmijë vetë, i ndau nëpër qytete për t'i mbajtur nën roje. uskanasit dhe ilirët i shiti dhe menjëherë u nis me ushtrinë e tij për në Penesti kundër
3 qytetit Oene, me qëllim që ta pushtonte. Ky qytet përveç që kishte pozitë të mirë
4 ishte edhe rrugë kalimi për në krahinat e labeatëve, ku sundonte mbreti Gent. Kur po kalonte pranë një fortese të quajtur Draudak, që ishte mjaft e populluar, një nga ata që e njihte vendin i tha se pushtimi i Oenës s'ka asnjë dobi, po të mos pushtohej edhe
5 Draudaku, i cili ka një pozitë më të përshtatshme nga çdo pikëpamje. Perseu atëherë u afrua me ushtrinë, dhe banorët u dorëzuan menjëherë. Duke marrë zemër nga ky dorëzim, i cili u krye më shpejt se sa shpresonte, dhe në anën tjetër, duke parë se
6 ushtria e tij kallte tmerrin kudo, përfitoi nga ky tmerr dhe pushtoi edhe njëmbëdhjetë kështjella të tjera. Forca u përdor për ato pak kështjella që kundërshtuan, të tjerat u dorëzuan me dashjen e tyre. Këtu u zunë njëmijë e pesëqind ushtarë romakë, të
7 vendosur aty për roje. Karvil Spoletini i dha dorë mbretit gjatë bisedimeve, duke i siguruar shokët e vet se mbreti nuk do të sillej mizorisht kundër tyre. Më në fund arriti në Oene, qytet që s'mund të merrej pa një rrethim të regullt, mbasi roja e tij ishte diçka më e fortë se e qyteteve të tjera, dhe muret e tij ishin shumë të forta;
8 mbrohej nga njëra anë prej lumit Artati dhe në anën tjetër prej një mali shumë të lartë, i cili mezi kalohej, dhe kjo ua shtonte shpresat banorëve për një qëndresë
9 kundër armikut. Perseu, pasi e rrethoi qytetin me hendek e ledhe, urdhëroi të ngrihej nga ana e sipërme një çukë dheu, me një lartësi më të madhe nga ajo e mureve. Gjatë
10 këtij punimi, të rrethuarit dilnin me sulme të shpeshta nga qyteti, me qëllim që të mbronin muret e njëkohësisht të pengonin punimet e armikut; por në këto përpjekje, humbi një numër i madh prej tyre; edhe ata që mbetën gjallë, s'ishin më të vlefshëm se ishin dobësuar shumë duke u munduar ditë e natë, dhe nga plagët që kishin marrë. Kur u ngrit çuka afër murit, kohorta[1] mbretërore me emrin "Nikatores" *[Fitimtarët]*
11 u hodh në atë anë dhe me shkallë e sulmoi qytetin nga shumë anë. Gjithë burrat u vranë; gratë e fëmijët e tyre u zunë rob, të tjerat iu lanë ushtrisë për plaçkë. Perseu
12 pas kësaj fitorje u kthye në Stuberë, dhe prej këtej i dërgoi Gentit dy delegatë: ilirin
13 Pleurat, i cili gjendej pranë tij si i mërguar dhe Adeun, maqedonas nga Beroja. Këta u porositën t'i tregonin veprat, që bëri ai kundër romakëve dhe dardanëve gjatë verës
14 e dimrit që shkoi, t'i numëronin fitoret që kish korrur gjatë fushatës së fundit në Iliri dhe më në fund ta shtynin Gentin të lidhej me miqësi me atë dhe me maqedonasit.

20 Këta *[delegatët]* kaluan qafën e malit Skord, shkuan përmes krahinave të
1 shkretuara të Ilirisë, të cilat maqedonët i kishin shkretuar me qëllim që të mos mund të hynin dardanët përmes saj në Maqedoni dhe në Iliri, dhe, pas shumë mundimesh,
2 arritën më në fund në Skodra. Mbreti Gent ndodhej në Lis. Këtu i ftoi delegatët dhe

[1] Livi përdor këtë term të ushtrisë romake edhe për njësitë e ushtrisë maqedonase.

me shumë dashamirësi dëgjoi propozimet dhe u dha atyre një përgjigje të pacaktuar, duke u thënë se atij nuk i mungonte dëshira t'u shpallte luftë romakëve, po për të
3 ndërmarrë atë që dëshironte, i mungonin sidomos të hollat. Këto fjalë delegatët ia shpunë në Stuberë Perseut pikërisht kur ky po merrej me shitjen e robërve ilirë. Me të dëgjuar këtë përgjigje, menjëherë dërgoi përsëri po këta delegatë në Iliri, duke u dhënë për shok edhe Glaukinë, një nga rojet e tij, po në përgjigjen nuk bënte fjalë
4 për të hollat, të cilat ishin i vetmi mjet që mund ta shtynin për luftë një mbret barbar dhe të vobekët. Perseu pastaj, mbasi plaçkiti Ankyrën, hyri përsëri në Penesti bashkë me ushtrinë, forcoi rojet e Uskanës dhe të fortesave rreth saj, të pushtuara më parë, dhe u kthye prapë në Maqedoni.

1 **21** Legati romak L. Celi, që ishte komandant në Iliri, duke mos pasur guxim të lëvizte, sa kohë që ndër ato vende ishte mbreti /Perseu/, më në fund, pas largimit të tij, u përpoq ta merrte përsëri Uskanën e penestëve, por u zmbraps me shumë
2 humbje nga garnizoni i maqedonasve që ishte aty, dhe i shpuri prapë trupat ushtarakë në Lyhnid. Andej, pas pak ditësh, dërgoi M. Trebel Fregelanin me një
3 njësi mjaft të fuqishme për të marrë në dorëzim pengjet prej atyre qyteteve që i kishin qëndruar në besë. I dha urdhër edhe që të shkonte ndër parthinët; edhe këta kishin premtuar se do të jepnin pengje. Nga të dy fiset i nxori pa vështirësi. Pengjet e
4 penestëve u dërguan në Apolloni, ato të parthinëve në Dyrrah, - të cilin aso kohe grekët e njihnin më tepër me emrin Epidamn. Ap Klaudi, duke dashur të mbulonte turpin që pësoi në Iliri, zuri të sulmonte Fanotën, kështjellë e Epirit. Mori me vete,
5 përveç ushtrisë romake, edhe ndihmë nga kaonët dhe thesprotët, por s'i vleu gjë kjo punë, pse Kleva, i lënë aty nga Perseu, qëndronte me një garnizon të fuqishëm. Perseu u nis për Elimi dhe, mbasi kaloi përmes saj, e udhëhoqi ushtrinë e vet për në
6 Strat meqenëse e ftonin epirotët. Strati aso kohe ishte një qytet shumë i fuqishëm i Etolisë; është i vendosur në gjirin e Ambrakisë pranë lumit Inah.

1 **23** Mbreti /Perseu/ u kthye në Maqedoni me dëme në kafshë e në njerëz jo më të pakta, se sa kur kishte ardhur. Megjithatë, lajmi se Perseu po drejtohej për në Strat
2 bëri që Api ta hiqte rrethimin e Fanotës. Kleva me një garnizon të rinjsh të shkathët, iu vu në shpinë dhe aty afër, në rrëzat e parrahura të maleve, vrau rreth njëmijë ushtarë të ngarkuar rëndë, nja dyqind i zuri. Api, mbasi kaloi ngushticat, zuri vend
3 për pak ditë në fushën e quajtur Meleona. Ndërkaq Kleva mori me vete Filostratin, i cili kishte gjashtëqind vetë nga epirotët, dhe zbriti në fushën e Antigonesë. Maqedonasit u nisën për plaçkitje, kurse Filostrati me kohortën e vet qëndroi në pritë
4 në një vend të errët. Burrat e armatosur të Antigonesë u sulën mbi plaçkitësit e shpërndarë, por të rrëmbyer nga ndjekja që u bënin atyre që iknin, shkuan e ranë në grackën e përgatitur nga armiqtë. Pasi aty u vranë gjashtëqind vetë dhe u zunë rreth
5 njëqind, dhe punët shkuan mbarë kudo, marshuan drejt lëmit të Apit me qëllim që nga ana e ushtrisë romake të mos mundte të shpërthente ndonjë sulm mbi aleatët e tyre. Api pa humbur më kohë në këto vende, i liroi kaonët, thesprotët dhe disa
6 epirotë të tjerë, që i kishte si trupa ndihmëse; ai u kthye me ushtarët italikë në Iliri, i shpërndau ata ndër kuartierët dimërore nëpër qytetet aleate të parthinëve dhe vetë shkoi në Romë për të bërë flijimet. Perseu dërgoi në Kasandré njëmijë këmbësorë
7 dhe dyqind kalorës të thirrur nga fisi i penestëve, me qëllim që të qëndronin aty si garnizon. Të dërguarit te Genti u kthyen duke sjellë po ato gjëra si më parë. Dhe nuk
8 pushoi pastaj, duke dërguar herë njërin, herë tjetrin për ta nxitur, meqenëse e kuptonte se sa e dobishme ishte mbështetja tek ai; por s'ia donte zemra të bënte

shpenzime në këtë çështje me kaq rëndësi nga çdo pikëpamje.

LIBRI XLIV

6 **11** ... Ai /pretori/ vendosi të thyente muret e dobëta dhe të hynte prej këndej në
7 qytet /Kasandre/. Garnizoni i Kasandresë, përveç rinisë guximtare të qytetit, kishte edhe tetëqind agrianë dhe dymijë penestë, ilirë të dërguar prej kohësh nga Pleurati, trupa këto që u përkisnin njëkohësisht dy popujve luftëtarë. Ndërsa ata mbronin
8 muret, që sulmoheshin me ashpërsi të madhe nga romakët, paretet e dobëta të zgavrave të tyre, të meremetuara më vonë, u thyen papritur duke lejuar kështu hyrjen për në qytet; dhe nëqoftëse ata që punonin do të kishin pasur armë do t'i kishin
9 pushtuar menjëherë. Ushtarët si morën vesh që punimet kishin mbaruar, lëshuan thirrje të forta gëzimi; ata shpresuan se do të hynin në qytet nga të gjitha anët.

1 **12** Në fillim armiqtë u habitën dhe nuk kuptuan ç'donin të thonin këto britma të
2 papritura. Në këtë zhurmë e sipër Pytoja dhe Filipi, komandantë të garnizonit, si e panë që këto punime duhet të ktheheshin në favor të atyre, që do t'i pushtonin të parët, dolën menjëherë në krye të një njësie të fortë agrianësh dhe ilirësh, sulmuan
3 në befasi romakët që po grumbulloheshin me rrëmujë për të hyrë në qytet, i vunë përpara, duke përfituar nga kjo rrëmujë dhe i ndoqën gjer në buzë të hendekut, i hodhën brenda e i mbuluan me gurë e dhe. Në këtë mënyrë humbën gjashtëqind vetë
4 dhe të gjithë ata që ndodheshin midis hendekut dhe murit u mbuluan me plagë. Kështu viktimë e mjetit që përdori vetë, pretori nuk po kërkonte më të gjente mjete të tjera. Nga ana e tij, Eumeni nuk ia arriti aspak me sulmin e kombinuar që bëri nga
5 toka dhe nga deti. Pretori dhe ai /Eumeni/ mbetën dakord që të forconin rrethimin në mënyrë që të rrethuarve të mos mund t'u vinte ndihmë nga Maqedonia...

1 **16** U lexuan pastaj lajmet e konsullit Q. Marci. Ai thoshte se pasi kishte kaluar
2 një grykë kishte hyrë në Maqedoni, se në saje të parashikimit të pretorit ai ishte furnizuar për gjithë dimrin; se përveç ushqimeve që kishte marrë pretori në vende të ndryshme ai u kishte kërkuar epirotëve njëzetmijë modie grurë dhe dhjetëmijë elb
4 dhe për këtë ai i lutej senatit t'ua paguante përfaqësuesve të tyre në Romë... Senati mori vendim... t'u paguajë përfaqësuesve të epirotëve çmimin e grurit, me të cilin ata kishin furnizuar bashkëqytetarët e tyre...

4 **21** Këtyre dy[1] udhëheqësve kryesorë iu shtua edhe i treti, pretori L. Anici, i cili ishte ngarkuar të sqaronte mosmarrëveshjet ndërmjet qytetarëve dhe të huajve. Ai duhej të shkonte në provincën e Ilirisë në afërsitë e Lyhnidit për të zëvendësuar komandantin Ap Klaudin...

1 **23** Kur po ngjisnin këto në Itali, Perseu - të cilin kopracia nuk e linte t'u jepte fund marrëveshjeve që kishte me Gentin, mbretin e Ilirisë, për ta bërë për vete - si pa
2 se romakët hynë ndër qafat e se po afrohej ora e fundit vendosi të mos e zgjaste më dhe me anë të Hipisë, delegatit të vet, i premtoi mbretit të Ilirisë treqind talente të argjendta. Pasi u morën vesh të shkëmbenin pengjet në mes tyre, dërgoi Pantauhun,
3 një nga miqtë më besnikë, për t'i dhënë fund marrëveshjes. Pantauhu u takua me mbretin e ilirëve në Meteon të labeatëve, dhe aty mbreti bëri betimin dhe i dorëzoi

[1] Është fjala për konsulin L. Emilin dhe pretorin N. C. Oktavin.

pengjet.[1] Pastaj Genti dërgoi në Maqedoni delegat Olympin për të kërkuar prej Perseut betimin dhe pengjet. Bashkë me Olympin dërgoi edhe njerëz të ngarkuar për
4 të marrë shumën e premtuar, dhe pas këshillës së Pantauhut, caktoi Parmenin dhe Morhun që të shkonin në Rod si delegatë bashkë me maqedonasit. Këta i porositi, që vetëm pasi të merrnin betimin, pengjet dhe të hollat, të niseshin për Rod; në emër të
5 dy mbretërve bashkë ata të nxitnin rodasit për luftë kundër romakëve; po të bashkohej ai qytet, i cili atëherë ishte i vetmi për lavdinë e artit detar, romakëve nuk
6 do t'u mbetej asnjë shpresë as në tokë, as në det. Perseu, me të marrë vesh se ilirët po vinin, e la lëmin që kishte pranë lumit Elpe dhe me të gjithë kalorësinë vrapoi për
7 Dium, për t'i pritur. Këtu u bë marrëveshja duke qëndruar kalorësia rreth e përqark; mbreti deshi të ndodhej në këtë ceremoni të aleancës me Gentin, se besonte që kjo
8 do t'i jepte atij pak më tepër guxim, gjithashtu edhe pengjet u morën dhe u dhanë në prani të të gjithëve. Dërgoi në Pela tek thesari mbretëror personat e caktuar për të marrë të hollat, dhe ata që do të shkonin në Rod bashkë me delegatët e Ilirisë i
9 urdhëroi t'i hipnin anijes në Thesalonik. Këtu gjetën Metrodorin, i cili posa ishte kthyer nga Rodi dhe u tha këtyre se, siç e siguruan Dinoni me Polyaratin, krerë të
10 atij qyteti, rodasit ishin gati për luftë... Metrodorit iu ngarkua kryesia e delegatëve të dy palëve.

2 **26** ... Prapë për shkak të kopracisë së tij, Perseu humbi aleancën e përgatitur më parë me mbretin Gent si dhe ndihmën që i ofronte në atë kohë një ushtri e madhe
7 galësh, të shpërndarë nëpër Ilirik... Perseu erdhi pranë qytetit Alman dhe vendosi lëmin e tij në breg të lumit Aks. Ushtria gale ishte vendosur në afërsitë e Desudabës
8 në Medike, duke pritur të merrte shpërblimin e premtuar. Ai dërgoi tek ata një nga purpuratët[2] e tij, Antigonin, që t'i urdhëronte galët që të shpërngulnin lëmin e tyre në Bylazora - një vend në Paioni - dhe krerët e tyre të vinin në një numër të madh tek ai...

8 **27** ... E njëjta kopraci e largoi pre tij mbretin Gent, dhe ja se si: Në Pela u numëroi delegatëve të Gentit treqind talente dhe u dha leje që t'i vulosnin. Pastaj i
9 dërgoi Pantauhut dhjetë talente dhe e urdhëroi që t'ia dorëzonte menjëherë mbretit; të hollat e tjera, të vulosura me vulën e ilirëve, urdhëroi të udhëtonin me ngadalë
10 dhe, kur të arrinin në kufijtë e Maqedonisë, të qëndronin aty dhe të prisnin lajmëtarët
11 e tij. Genti mori shumën e vogël të dërguar prej Perseut dhe, meqenëse Pantauhu e nxiste vazhdimisht t'i provokonte romakët me ndonjë akt armiqësor, i hodhi në burg delegatët romakë. M.Perpenen dhe L.Petilin, të cilët kishin ardhur rastësisht tek ai[3].
12 Perseu, porsa mori vesh këtë, u bind se Genti do të bënte doemos luftë me romakët dhe dha urdhër të kthehej prapa ai që kishte të hollat. Ky njeri /Perseu/ dukej sikur s'kishte tjetër kujdes veçse t'u rezervonte romakëve sa më shumë plaçkë lufte kur do të mundej nga ata...

6 **29** Në këtë kohë erdhën njëri pas tjetrit në Rod delegatët maqedonas dhe ilirë; misioni i tyre mori rëndësi të madhe jo vetëm për shkak të udhëtimit, që kishin ndërmarrë anijet e lehta rreth Kykladeve dhe në detin Egje, por edhe për shkak të vetë aleancës së mbretërve Perse e Gent si edhe të lajmit mbi udhëtimin e një numri të madh këmbësorësh dhe kalorësish galë...

---

[1] Në vitin 168 para e. sonë.
[2] Oborrtarët.
[3] Shih për këtë edhe Plutarch - Aemilius Paulus 13.

30 Po fillonte pranvera dhe prijësat e rinj erdhën në provincat e tyre: Konsulli Emil në Maqedoni, Oktavi në Ore, ku ndodhej flota, dhe Anici në Iliri për të luftuar kundër Gentit. Genti, biri i Pleuratit, mbretit të ilirëve, dhe i Eurydikës, kishte dy vëllezër, Platorin prej nëne e babe, dhe Karavantin, vetëm prej nëne. Duke mos dyshuar nga ky i fundit, sepse s'ishte fisnik nga i ati, ai vrau Platorin me dy miqtë e tij, burra trima, Etritin dhe Epikadin, me qëllim që të gëzonte fronin më me siguri. Pëshpëritej se ia pat zili të vëllait sepse ky do të merrte për grua Etutën, të bijën e Monunit, prijësit të dardanëve, dhe do të bënte për vete fisin e dardanëve. Martesa e Gentit me këtë vajzë, pas vrasjes së Platorit, i vërtetoi pothuaj këto pëshpëritje. Si i doli, pra, frika e të vëllait, filloi të bëhej i rëndë ndaj popullit, dhe shpërdorimi i verës ia ndezi më shumë egërsinë që e kishte prej natyre. Ky, pra, sikundër u tha edhe më sipër, mbasi kishte qenë nxitur për luftë kundër romakëve, mblodhi në Lis të gjitha forcat. Ishin pesëmbëdhjetë mijë të armatosur. Prej andej dërgoi të vëllanë me një mijë këmbësorë dhe pesëdhjetë kalorës për të nënshtruar me anë të forcës ose të frikës fisin e kavëve; ai vetë u nis kundër qytetit Basania, pesë milje larg nga Lisi; Basanasit ishin aleatë të romakëve; prandaj, kur provoi Genti me anë delegatësh t'i tërhiqte për vete, më parë pranuan të rrethoheshin se sa të dorëzoheshin. Të vëllanë, Karavantin, kur arriti tek kavët, qyteti Durn e priti mirë, por qyteti tjetër Karavandi, ia mbylli dyert. Atëherë ai nisi të shkretojë anë e mbanë tokat e tyre; disa ushtarë të tij që ishin të shpërndarë, u vranë nga fshatarët që rendën mbi ta. Në këtë kohë edhe Ap Klaudi, si e forcoi ushtrinë me ndihmat e ardhura nga bulinët, apolloniatët dhe dyrrahasit, e la fushimin dimëror dhe erdhi e ngriti lëmin afër lumit Genus. Këtu, kur dëgjoi se Genti kishte bërë aleancë me Perseun, u zemërua nga dhuna që u ishte bërë delegatëve dhe nuk mbeti më dyshim se do të bënte luftë kundër tij. Në anën tjetër, pretori Anici, mbasi dëgjoi në Apolloni se ç'po ngjiste në Iliri dhe mbasi i shkroi Klaudit ta priste në Genus, pas tri ditësh edhe ai ia arriti me ushtri. Këtu ushtrinë që kishte e forcoi me ndihmat e dërguara nga parthinët, që arrinin në dy mijë këmbësorë dhe dyqind kalorës (Epikadi kryesonte këmbësorët dhe Algalsi kalorësit) dhe e përgatiti ta dërgonte në Iliri, për të çliruar sidomos basanasit nga rrethimi; mirëpo këtë fushatë e penguan lajmet, që mori se anije të lehta të armikut, po plaçkitnin bregdetin. Genti, i nxitur prej Pantauhut kishte dërguar rreth tetëdhjetë anije për të plaçkitur tokat e dyrrahasve dhe të apolloniatëve. Në këtë kohë flota *romake qëndronte pranë bregdetit jo larg Apollonisë. Anici vrapoi këtu, i arriti shpejt plaçkitësit ilirë, u përlesh me ta, i theu fare lehtë dhe disa nga anijet i zuri, të tjerat i shtrëngoi të ktheheshin përsëri në Iliri. Prej këtej u kthye në lëmin e tij pranë Genusit e shkoi me vrap për të ndihmuar basanasit. Genti i tmerruar nga arritja e pretorit romak, hoqi rrethimin dhe iku në Skodra aq shpejt sa nuk mundi ta merrte të gjithë ushtrinë me vete. Atëherë një numër i madh ushtarësh, që do të mund të qëndronin, sikur kryetari i tyre t'u kishte qëndruar pranë, mbasi ai u largua*[1)], u dorëzuan.

31 Shembullin e këtyre e ndoqën edhe qytetet e kësaj krahine, dhe vrapuan të dorëzohen te pretori romak, të tërhequr sidomos nga butësia e drejtësia, që tregoi pretori kundrejt të gjithëve. Pastaj pretori arriti në Skodra, e cila ishte pika më me rëndësi e luftës, sepse Genti e kish zgjedhur këtë si fortesë të gjithë mbretërisë, duke qenë vendi më i fortë i labeatëve dhe i vështirë për t'u afruar.

[1)] Në botimin e Teubnerit rreshtat në kursiv janë lënë jashtë. Ne e kemi marrë nga Tit Live, Oeuvres complètes, avec la traduction française de la collection Panckoucke, nouvelle édition trës soigneusement revue par M.E Pessonneaux, etc. Paris Libraire Garnier Frëres. Tom. 1-6

Ky qytet rrethohet prej dy lumenjsh; prej Klausalit[1] që rrjedh nga ana lindore pranë qytetit dhe në perëndim prej Barbanës[2], lum që buron nga liqeni Labeat. Të dy këta lumenj derdhen në ujërat e lumit Oriund[3], i cili buron nga mali Skord dhe, pasi përmbledh edhe ujërat e disa lumenjve të tjerë, derdhet në detin Adriatik. Mali Skord, më i larti i këtij vendi, ka përposhtë nga lindja Dardaninë, nga jugu Maqedoninë dhe nga perëndimi Ilirinë. Megjithëse qyteti ishte i fortë prej natyre dhe e mbronte gjithë fisi i ilirëve me vetë mbretin në krye, pretori romak, meqenëse fillimi i kësaj fushate kish shkuar mbarë, besoi se edhe pas kësaj do ta ndihmonte fati si më parë, dhe se tmerri i shpejtë do të bënte efekt; rreshtoi, pra, ushtrinë dhe iu afrua mureve të qytetit. Të rrethuarit po të kishin mbyllur portat dhe të kishin qëndruar duke i ruajtur muret dhe kullat e portave, duke vendosur në ta ushtarë, do t'i kishin prapsur romakët nga muret dhe do t'i kishin bërë të dështonin. Po ata dolën nga porta dhe, në fushë të hapur, nisën luftën me romakët duke treguar më shumë guxim se sa qëndresë. Më në fund u thyen dhe, në ikje e sipër, u grumbulluan tek hyrja e ngushtë e portës, ku u vranë më shumë se dyqind vetë; atëherë kaq u hyri tmerri, sa që Genti menjëherë dërgoi si delegatë te pretori dy nga krerët e fisit, Teutikun dhe Belin për të kërkuar armëpushim në mënyrë që të kishte mundësi të vendoste për punët e veta. Pretori i dha për këtë tri ditë afat dhe ushtria qëndroi në lëmin ushtarak që ishte afërsisht pesëqind hapa larg qytetit. Në këtë kohë Genti i hipi anijes dhe, duke lundruar nëpër Barbana, hyri në liqenin Labeat, sikur të kërkonte një vend të fshehtë për t'u këshilluar, por pa dobi; atë e gënjente shpresa se i vëllai Karavanti do të vinte me shumë mijëra ushtarë, të mbledhur në ato vise ku kishte qenë dërguar. Po me që dështuan këto, pas tri ditësh u kthye në Skodra, gjithnjë nëpër rrjedhë të lumit; dhe mbasi i çoi më parë pretorit lajmëtarë për të kërkuar leje për t'u takuar dhe iu dha mundësia, erdhi në lëmin e pretorit... Pastaj, bashkë me pretorin hyri në qytet, ku hëngrën që të dy. Po më pas e mbajti nën vërejtje, duke ia dorëzuar tribunit G. Kasit...

32 Anici, mbasi shtiu në dorë Skodran, dha urdhër që të mos i sillnin asgjë më parë se legatët e kërkuar, Petilin dhe Perpenën. Si i ktheu të dy në shkëlqimin e parë, menjëherë dërgoi Perpenën për të kapur miqtë dhe farefisin e mbretit. Perpena u nis për Meteon, qytet i fisit të labeatëve, dhe solli në Skodra, tek lëmi, të shoqen e Gentit, Etlevën me dy bijtë, Skerdilaidin e Pleuratin, si dhe të vëllanë Karavantin. Anici, mbasi lufta ilire mori fund brenda tridhjetë ditëve, dërgoi në Romë, si lajmëtar të fitores, Perpenën dhe pas pak ditësh vetë mbretin Gent me të ëmën, me të shoqen dhe me fëmijët si dhe të vëllanë me krerë të tjerë të ilirëve...

LIBRI XLV

3 Në këtë kohë e sipër erdhën nga Iliria të dy legatët G. Licin Nerva dhe P. Deci, të cilët sollën lajmin se ushtria e ilirëve u shkatërrua, mbreti Gent u zu rob dhe Iliria u vu nën pushtetin romak. Për këto vepra që u bënë nën udhëheqjen e oguret e pretorit Anici, senati vendosi të bëhen lutje publike tri ditë me radhë dhe menjëherë

---

[1] Kiri.
[2] Buna.
[3] Këtu në vend të Drinit është shkruar gabimisht Oriundi.

konsulli me anë të një dekreti caktoi të katërtën, të tretën dhe të dytën ditë pas ideve të nëntorit[1].

3 Disa thonë se delegatët e Rodit, që deri atëherë nuk i kishte pranuar senati, u thirrën në senat pas lajmit të fitores, si për t'u tallur me krenarinë e tyre të çmendur...

1 **17** Senati pastaj u mor me caktimin e legatëve, sipas gjykimit të të cilëve komandantët L. Pauli dhe L. Anici duhej të rregullonin punët e vendeve të
4 pushtuara. Ai caktoi dhjetë të tillë për Maqedoni dhe pesë për Ilirik. ... Në Ilirik u emëruan ish konsulli P. Elius Ligu, C. Cicerei dhe Gn. Beb Tamfili (që të dy kishin qenë pretorë, ky i dyti një vit më parë, Cicerei shumë vjet përpara), P. Terenc Tusivikani dhe P. Manili.

1 **18** Më parë se çdo gjë tjetër, senati romak vendosi të shpallë të lirë maqedonasit dhe ilirët, me qëllim që ta shihnin qartë të gjithë popujt, se armët e popullit romak
2 nuk u sillnin robërinë popujve të lirë, po përkundrazi lirinë të shtypurve; se popujt, që ishin të lirë do ta gëzonin lirinë me siguri dhe përgjithmonë nën mbrojtjen e popullit romak, dhe se ata që rronin nën mbretër, tani do të trajtoheshin prej tyre në mënyrë më të butë e më të drejtë, për respekt ndaj popullit romak; dhe nëqoftëse ndonjëherë do të shpallet luftë në mes të mbretërve të tyre dhe popullit romak, përfundimi i saj do të ishte fitore për romakët, dhe për ta liri. U vendos pastaj që të
3 hiqej taksa mbi minierat e Maqedonisë, që ishte një tatim shumë i rëndë, të hiqej gjithashtu dhënia me qira e tokave të fshatit, sepse kjo punë mund të ushtrohej vetëm
4 me anë të sipërmarrësve, dhe atje ku ka sipërmarrës, ose interesi i shtetit do të cënohej rëndë, ose liria e aleatëve do të zhdukej. Por as maqedonasit vetë nuk mund ta ushtronin këtë sepse kur ndërhyn interesi i administratorëve, atje kurrë nuk do të
5 mungojnë shkaqet për kryengritje dhe grindje. Maqedonia nuk duhet të kishte kuvend të përbashkët me qëllim që populli i mbrapshtë të mos ta shndërronte një ditë
6 në një shthurje të rrezikshme lirinë, që i kishte dhënë senati për ta gëzuar në mënyrë të matur e për të mirën e tij. Vendosi prandaj të ndahet Maqedonia në katër krahina,
7 secila të kishte kuvendin e vet veçmas e t'i paguante popullit romak gjysmën e taksave që zakonisht u paguante mbretërve. Të tilla vendime u morën edhe për
8 Ilirinë. Hollësirat e tjera senati i la në dorën e komandantëve dhe legatëve, të cilët, duke parë punët së afërmi do të mundnin të merrnin vendime më të drejta.

1 **26** Kur po ngjisnin këto në Maqedoni dhe në Romë[2] *[në Azi]*, në Iliri L. Anici siç kemi thënë më sipër – nënshtroi mbretin Gent, dhe pasi vendosi një roje në
2 Skodra, që ishte kryeqyteti, vuri në krye të saj Gabinin dhe në qytetet e rëndësishme
3 Rizon dhe Ulcini, K Licinin. Si rregulloi kështu punët në Iliri, ai vetë me ushtrinë tjetër u nis për në Epir. Këtu Fanote qe i pari qytet që iu dorëzua, dhe banorët e tij dolën përpara me shumicë të madhe me lidhëse të bardha[3]. Anici pasi la roje në këtë
4 qytet prej këtej shkoi në Molosi, ku gjithë qytetet iu nënshtruan, përveç Pasaronit, Tekmonit, Fylakes dhe Horreas. Së pari u turr kundër Pasaronit. Aty gjendeshin
5 Antinou dhe Thodoti, që ishin krerë të këtij qyteti dhe njiheshin si miq të Perseut dhe armiq të popullit romak; këta kishin qenë shkaktarë që populli mbarë ishte shkëputur

[1] Data 10, 11, 12 nëntor të vitit 168 para e. sonë.
[2] Në vitin 167 para e. sonë.
[3] Si shenjë paqeje.

6 nga romakët. Këta të dy, duke qenë të ndërgjegjshëm për fajin e tyre, dhe pasi nuk shpresonin të merrnin falje nga romakët, vendosën të mbuloheshin me gërmadhat e atdheut të tyre. Ata i mbyllën portat e qytetit dhe e nxitën popullin të pranonte më
7 parë vdekjen, se sa robërinë. Asnjë nuk pati guxim të hapte gojën kundër këtyre burrave të fuqishëm. Më në fund, një djalosh bujar, një farë Theodoti, gjithashtu duke u trembur më tepër nga romakët se sa nga krerët e qytetit, tha: "Ç'është kjo
8 marrëzi që ju shtyn të bashkoni dënimin e fajit të këtyre të dyve me fatin e qytetit? Shpesh herë kam dëgjuar se qytetarët fisnikë kanë dhënë jetën e tyre për atdhenë, ndërsa këta të dy janë të parët që e gjykuan të drejtë të sakrifikojnë atdhenë për
9 interesin e tyre. Pse të mos i hapim portat e të pranojmë një pushtet, të cilin një botë e tërë e ka pranuar?" Theodoti dhe Antinou, kur panë se populli po ndiqte anën e
10 këtij, u turrën në vijë të parë të armikut dhe, duke ua hapur gjoksin goditjeve, u
11 vranë. Qyteti iu dorëzua romakëve. Gjithashtu nguli këmbë Kefali kryetari i Tekmonit të rrethuar, po u vra, dhe qyteti u dorëzua. Qytetet Fylaku dhe Horrea nuk pritën të rrethoheshin dhe u dorëzuan. Atëherë Anici, si e pushtoi Epirin dhe ushtrinë
12 e ndau ndër qytetet më të rëndësishme për të kaluar dimrin, u kthye në Skodra të Ilirikut, ku kishin arritur nga Roma të pesë delegatët dhe mbajti me krerët e ftuar të gjithë krahinës një mbledhje. Këtu, nga tribuna, shpalli me aprovimin e këshillit se
13 vullneti i senatit dhe i popullit romak është t'i linte të lirë ilirët dhe t'i heqë trupat nga gjithë qytetet, nga kështjellat e fortesat, se jo vetëm do të ishin të lirë por edhe do të përjashtoheshin nga taksat isasit, taulantët, pirustët e dasaretët, banorët e Rizonit dhe
14 të Ulcinit, mbasi këta u hodhën në anën e romakëve para se të humbiste fuqinë Genti. Gjithashtu të përjashtoheshin nga taksat edhe daorsët për arsye se kishin braktisur Karavantin dhe me gjithë armët ishin hedhur në anën e romakëve. Banorët
15 e Skodras, dasaretët, selepitanët dhe ilirët e tjerë do të paguanin gjysmën e taksave që i jepnin mbretit. E ndau pastaj Ilirinë në tri pjesë: pjesa e parë ishte ajo, për të cilën kemi folur më lart; e dyta përmblidhte gjithë labeatët, e treta banorët e Agravonës, të Rizonit e Ulcinit si edhe të vendeve kufitare me ta. Si e bëri këtë ndarje të re administrative në Iliri, Anici u kthye në Epir, për të kaluar dimrin në Pasaron.

3 **29** ... Kur kasneci vendosi qetësinë, Pauli njoftoi në gjuhën latine atë që kishte vendosur senati dhe atë që mendonte ai vetë me këtë rast. Këto sende pretori Gnei Oktavi, i cili ishte atje, i njoftoi duke i përkthyer në greqisht. Para së gjithash ai
4 njoftoi se maqedonasit do të ishin të lirë, do të kishin po ato qytete dhe toka, do të shfrytëzonin si edhe më parë ligjet e veta dhe do të zgjidhnin për çdo vit zyrtarë. Taksën do t'ia paguanin popullit romak në gjysmën e asaj që i jepnin mbretit. Pas
5 kësaj u tha atyre se Maqedonia ndahet në katër krahina. Njëra, e para, do të përfshinte tokat ndërmjet Strymonit dhe Nesit. Kësaj krahine do t'i shtohej nga lindja
6 toka përtej Nesit ku Perseu zotëronte fshatra, kështjella e qytete, me përjashtim të Enit, Maronesë dhe Abderës, kurse nga perëndimi përtej Strymonit gjithë Bizaltikën me Heraklenë, e cila quhej Sintikë. Krahina e dytë do të ishte ajo që kufizohej me lumin Strymon pa Heraklenë, Sintikën dhe bizaltët, kurse nga perëndimi me lumin
7 Aks, duke i shtuar asaj paionët, të cilët jetonin në bregun lindor të lumit Aks. Krahina që kufizohej nga lumenjt Aks në lindje dhe Peneit në perëndim ishte e treta;
8 në perëndim të saj ngrihej mali Bora. Me këtë krahinë bashkohej Paionia e bregut perëndimor të Aksit. Qytetet Edesa dhe Beroja hynin në të. Krahina e katërt shtrihej
9 përtej malit Bora, nga njëra anë kufi me Ilirikun, nga tjetra me Epirin. Ai caktoi vendet kryesore se ku do të bëheshin mbledhjet e krahinave të veçanta. Në krahinën

e parë caktoi për këtë qëllim Amfipolin; në të dytën Thesalonikun, në të tretën Pelën dhe në të katërtën Pelagoninë. Atje ai urdhëroi që të caktohej koha e mbledhjeve për
10 çdo krahinë, të vihen taksat dhe të zgjidhen zyrtarët. Pas kësaj shpalli se nuk i lejohej
11 asnjë njeriu të martohej ose të tregtonte përtej krahinës në të cilën jetonte. Shfrytëzimi i minierave të floririt dhe të argjendit u ndalua, kurse i atyre të hekurit dhe të bakrit u lejua. Shfrytëzuesit e minierave ngarkoheshin me gjysmën e taksave
12 të cilat ia paguanin mbretit. Importimi i kripës, gjithashtu, u ndalua. Dardanëve, të cilët kërkonin Paioninë, mbasi ishte kufitare me tokat e tyre, iu përgjigj se u jepte liri të gjithë atyre që qenë nën sundimin e Perseut. Duke mos u dhënë Paioninë e
13 kërkuar prej tyre u dha të drejtë të tregtonin kripë; krahinës së tretë i ngarkoi transportimin në qytetin paion Stobi dhe caktoi çmimin e saj. U ndaloi atyre të presin
14 ose t'u lejojnë të tjerëve të presin lëndë druri për anije. Krahinave fqinje me barbarët, siç ishin të gjitha me përjashtim të së tretës, ai u lejoi të kishin roje të armatosura për kufijtë e tyre të jashtëm.

5 **30** ... Krahina e tretë ka qytetet e shkëlqyera: Edesën e Berojen e Pelen edhe fisin luftarak të vetijve, dhe shumë e shumë banorë galë e ilirë, bujq të shkathët. Në
6 krahinën e katërt banojnë eordejtë, lynkestët dhe pelagonët; pranë këtyre është
7 Atintania, Tymfeia dhe Elimia. E gjithë kjo anë është e ftohtë, e ashpër dhe e vështirë për t'u punuar. Edhe banorët toka i ka bërë si veten. Ata bëhen edhe më të egër nga fqinjët barbarë, të cilët herë i ngacmojnë me luftë, herë i përziejnë zakonet me ta në kohë paqeje.

8 **33** ... /Paul Emili/ dërgoi P. Nasikun dhe të birin, Kv. Maksimin, me një pjesë të ushtrisë për të plaçkitur ilirët që kishin përkrahur në luftë Perseun, dhe u dha urdhër të takoheshin me të në Orik. Ai vetë u drejtua për në Epir dhe në pesëmbëdhjetë ditë arriti në Pasaron.

1 **34** Jo larg prej këtej gjendej lëmi i Anicit. Emili, që të mos shqetësohej aspak përsa do të ndodhte, i dërgoi letër, në të cilën shkruante se senati lejonte ushtrinë të plaçkiste ato qytete të Epirit, të cilat kishin kaluar në anën e Perseut. Menjëherë
2 pastaj dërgoi në çdo qytet centurionë që të shpallnin se kishte ardhur për të hequr rojet ashtu që edhe epirotët të ishin të lirë sikurse maqedonasit. Thirri pastaj nga çdo qytet nga dhjetë krerë dhe i porositi të derdhnin në arkën shtetërore tërë arin e argjendin dhe shpërndau kohortet në të gjitha qytetet. Kohortet që ishin caktuar për
3 qytetet e largëta, u nisën para atyre të caktuara për qytetet më të afërta, që të arrinin në të gjitha qytetet për një ditë. Tribunët e centurionët morën urdhër si do të
4 vepronin. Në mëngjes ari dhe argjendi ishte grumbulluar, në orën e katërt[1] iu dha shenjë ushtarëve për të plaçkitur qytetet. Plaçka e rrëmbyer qe aq e madhe sa çdo
5 kalorësi i ranë nga katërqind denarë, e këmbësorëve nga dyqind dhe numri i robërve arriti në njëqind e pesëdhjetë mijë. Pastaj u rrënuan muret e qyteteve të plaçkitura, të
6 cilat ishin afro shtatëdhjetë[2]. U shit gjithë plaçka dhe vlefta e mbledhur u nda midis ushtarëve. Pauli zbriti në bregdet në Orik duke kujtuar se me plaçkitjen në Epir do të
7 ishte ngopur lakmia e ushtarëve. Mirëpo këta ishin zemëruar se s'kishin marrë pjesë në plaçkën mbretërore, sikur nuk kishin luftuar fare në Maqedoni. Në Orik gjeti
8 ushtrinë që e kishte dërguar nën komandën e Scipion Nasikës dhe të djalit të tij,

[1] Ora e katërt – Dreka ishte zakonisht ora e gjashtë, *"hora Sexta"*, pra këtu është fjala për dy orë para drekës.
[2] Shih edhe Plutarch – Aemiluis Paulus 29.

Maksimit dhe, pasi e ngarkoi ushtrinë në anije, e nxori në Itali. Disa ditë më vonë,
9 Anici mblodhi epirotët dhe akarnanët e tjerë, u urdhëroi krerëve të shkonin me të në Itali sepse çështja e tyre varej prej senatit. Priti gjersa u kthyen anijet që kishin transportuar ushtrinë e Maqedonisë dhe u nis edhe ai për në Itali...

1 **43** Akoma nuk ishte zhdukur, jo vetëm nga shpirti, por edhe nga sytë e popullit romak kujtimi i triumfit për fitoret gjatë luftës së Maqedonisë, kur Anici gjatë festive kuirinale bëri triumfin mbi Gentin e ilirët. Ky triumf i ngjiste të parit në çdo gjë, por
2 s'ishte baras. Vetë komandanti Anici ishte më i ulët në krahasim me Emilin qoftë nga fisnikëria qoftë nga autoriteti, mbasi një pretor s'mund të krahasohet me një konsull. Pastaj nuk mund të krahasoheshin as Genti me Perseun, as ilirët me maqedonasit, as plaçka me plaçkë, as të hollat me të holla, as dhuratat me dhurata.
3 Por megjithëqë triumfi i parë errësonte këtë të dytin, prapseprapë atyre që e shikonin u dukej se ky në vetvete nuk ishte aspak për t'u përbuzur. Në pak ditë ai shtroi fisin
4 ilir, trim për tokë e det, që mbështetej në vendet e veta dhe në fortifikimet; kishte zënë rob jo vetëm mbretin, po edhe gjithë familjen mbretërore. Në triumf kishte me vete shumë flamuj ushtarakë, plaçkë tjetër dhe orenditë e mbretit; solli njëzet e shtatë ponde ari, nëntëmbëdhjetë ponde argjendi, trembëdhjetë mijë denarë dhe
5 njëqind e njëzetmijë copë monedha ilire prej argjendi. Përpara karrocës së Anicit u soll mbreti Gent bashkë me të shoqen dhe fëmijët, me të vëllanë Karavantin e me
6 disa nga paria ilire. Prej plaçkës së luftës iu dha secilit ushtar nga dyzet e pesë dinarë, dy herë aq çdo centurioni dhe tri herë aq çdo kalori. Aleatëve të emrit latin u
7 dha shumën që u kishte dhënë qytetarëve, kurse detarëve të flotës së aleatëve u dha aq sa ushtarëve. Më me gëzim e festoi këtë triumf ushtria, dhe vetë prijësi u lartësua me shumë këngë. Antias thotë se nga shitja e plaçkës u nxorën milionë sestercë, pa
8 numëruar arin e argjendin që u derdhën në thesarin publik. Meqë m'u duk e pabesuar të mbledhurit e një shume aq të madhe, prandaj e përmenda autorin që e thotë. Me vendim të senatit mbreti Gent me të shoqen, me fëmijët e me të vëllanë u dërguan në Spolet për t'i mbajtur nën vërejtje; robërit e tjerë u burgosën në Romë; po meqenëse
9 banorët e Spoletit nuk pranonin të kishin nën vërejtje familjen mbretërore, u transferua kjo në Iguv. Nga plaçka që u zu në Iliri, ishin dhe dyqind e njëzet anije.
10 Këto anije që iu morën mbretit Gent, me dekret të senatit, K. Kasi ua dha banorëve të Kerkyrës, të Apollonisë dhe të Dyrrahut.

DIODORI

Diodori lindi në Agrion të Siqelisë dhe për këtë arsye njihet edhe me emrin Diodori i Siqelisë. Jetoi dhe punoi në kohën e Cezarit dhe Augustit. Nuk dimë veçse pak gjëra nga jeta e tij dhe këto i mësojmë vetëm nëpërmjet veprës së tij. Ai thotë se i është dashur një punë përgatitore prej 30 vjetësh dhe udhëtime të gjata për të shkruar veprën e tij historike me titullin "Bibliotheca Historica" (Biblioteka historike). Por mbi këto udhëtime, për të cilat flasin zakonisht edhe historianët para tij si Herodoti, Theopompi e Polybi, nuk kemi asnjë të dhënë me përjashtim të udhëtimit në Aleksandri dhe ndoshta edhe në Romë.

"Bibloteka" e Diodorit ishte një histori e përgjithshme që përfshinte në rreshtim synkronistik dhe analistik të gjithë historinë antike qysh prej fillimit e deri në vitin 59 apo 54 para e. sonë. Nga të 40 librat e kësaj vepre na janë ruajtur plotësisht vetëm librat 1-5 (historia e Orientit të Lashtë dhe koha prehistorike) dhe 11-20 (vitet 480-302 para e. sonë). Nga librat e tjerë që trajtonin historinë e fiseve të Ballkanit, midis tyre edhe të ilirëve, ekspeditën e Pirros në Itali dhe luftërat iliro-romake e romako-maqedonase, janë ruajtur vetëm fragmente që i njohim nga autorë bizantinë si nga patriarku Foti, perandori Konstantin Porfyrogeneti dhe nga një botim i vitit 1603 i D. Hoeshelit.

Diodori nuk është i pavarur në përshkrimet e tij historike dhe prandaj vlera e të dhënave të tij varet nga burimet, mbi të cilat ato janë mbështetur. Ajo pjesë e historisë së tij, që trajton kohën e lashtë romake, dallohet për saktësi të plotë të dhënash. Mendohet se ai ka shfrytëzuar këtu historianin romak Fab Piktorin.

Vepra e Diodorit, duke përfshirë edhe fragmentet, megjithë cungimin e saj ka një tok të dhënash të vlefshme për historinë e Ilirisë dhe të Epirit që nuk na kumtohen nga burime të tjera.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Diodori, Bibliotheca Historica, editionem primam curavit Imm. Bekker, alteram Ludovicus Diodorf, recognovit Fr. Vogel (vol. I-III) et C. Th. Fischer (vol. IV-V). Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1888-1906.
Fragmentet janë marrë nga *"Bibliothèque Historique de Diodor de Sicile,* traduction nouvelle par M. Ferd. Hoefer, Paris 1885.

DIODORI

BIBLIOTHECA HISTORICA

(Biblioteka historike)

LIBRI V

1 **81** Ishulli Lesbo dikur ka qenë banuar prej shumë racash të ardhura këtu
nëpërmjet shumë imigracionesh. Ai ishte i shkretë, kur u vendosën për të parën herë
2 pellazgët dhe ja se si: Ksanthi i biri i Triopit, mbretit të pellazgëve, i dalë nga Argo,
pushtoi një pjesë të Lykisë, u vendos në fillim atje dhe mbretëroi mbi pellazgët, që
kishte sjellë me vete. Më vonë kaloi në ishullin Lesbo, e ndau tokën ndërmjet
3 njerëzve të tij dhe e ndryshuan emrin Isa, që mbante më parë ishulli, duke e emëruar
Pellazgia simbas emrit të banorëve. Shtatë breza më vonë, përmbysja e Deukalionit
që shkaktoi vdekjen e shumë njerëzve, bëri që për shkak të ujërave të shumta të
shkretohet edhe Lesbo.

LIBRI XI

1 **56** Për arsyet që treguam, Themistokliu la qytetin Argo[1] dhe shkoi si lutës në
oborrin e Admetit, mbretit të molosëve. Ky mbret në fillim e priti me dashamirësi, i
dha zemër dhe i premtoi se do të kujdesej për sigurinë e tij. Por lakedemonët
2 dërguan tek Admeti qytetarët më të njohur të Spartës për të kërkuar dorëzimin e atij
që e quanin tradhëtarin e korruptuesin e gjithë Helladës; shtuan se në rast të kundërt
ata do t'i shpallnin luftë në emrin e të gjithë helenëve. Admeti i frikësuar nga këto
kërcënime, por i prekur nga fati i lutësit të tij dhe duke dashur t'i shmanget turpit të
një tradhëtie, e këshilloi Themistokliun t'i ikte fshehurazi lakedemonëve; në të
3 njëjtën kohë i dha një shumë të hollash në ar për shpenzime. Themistokliu i rrethuar
nga të gjitha anët, e pranoi arin dhe u arratis natën prej tokës së molosëve me mjetet
që i kishte dhënë mbreti.

LIBRI XII

2 **30** ... Kur po ndodhnin këto, shpërtheu në Helladë lufta e quajtur e Korintit[2]
për shkaqet që do t'i bëjmë të ditura. Epidamnasit, të vendosur në bregdetin e Adrias,
ishin një koloni e korkyrasve dhe e korintasve. Në mes të tyre kishin shpërthyer
mosmarrëveshje[3]. Ata që fituan dënuan me dëbim shumë kundërshtarë. Të dëbuarit

---

[1] Ngjarja zhvillohet pas vitit 470 para e. sonë.
[2] Lufta e Peloponezit. Ngjarjet e këtij kapitulli Diodori i vendos në vitin e dytë të Olympiadës 85, d.m.th. në vitin 439 para e. sonë, ndërsa në të vërtetë lufta e Peloponezit fillon në vitin 431.
[3] Lufta civile e Dyrrahut që ndodhi në vitin 436 para e. sonë.

u mblodhën dhe si u bashkuan me ilirët, u drejtuan kundër Epidamnit. Ata filluan
3 luftën së bashku me një ushtri të madhe barbare, pushtuan tokat e armikut ndërsa qytetin e rrethuan. Në pamundësi t'i bënin ballë këtij sulmi, epidamnasit dërguan delegatë në Korkyrë për të kërkuar mbrojtjen e korkyrasve, nga të cilët e kishin prejardhjen. Por kur këta nuk u dhanë ndihmën, ata iu drejtuan korintasve, lidhën me
4 ta aleancë dhe e shpallën Korintin si metropolin e tyre të vetëm; në të njëjtën kohë kërkuan kolonistë të rinj. Të shtyrë nga dhëmshuria për epidamnasit dhe nga mëria kundër korkyrasve, të cilët ishin të vetmit nga të gjitha kolonitë, që nuk i kishin dërguar metropolit flitë e zakonshme, korintasit vendosën t'u shkojnë në ndihmë
5 epidamnasve. Si rrjedhim ata nisën disa kolonistë për në Epidamn dhe ia besuan ruajtjen e qytetit një garnizoni të fortë. Të zemëruar nga kjo, korkyrasit dërguan pesëdhjetë anije me tri sërë lopatash të komanduara nga një strateg. Ky me t'u afruar qytetit dërgoi urdhër dhe kërkoi nga banorët të pranonin të dëbuarit; në të njëjtën kohë u dërguan lajmëtarë tek ushtarët e garnizonit korintas, për t'ua mbushur mendjen që t'i zgidhnin çështjet e kolonisë me anë bisedimesh dhe jo me armë. Korintasit nuk e pranuan këtë propozim. Të dy palët filluan të përgatiten për luftë; mblodhën fuqi detare të konsiderueshme dhe u kujdesën për aleatë. Ky ishte shkaku i luftës së quajtur korintike.

2 **31** ... Në Helladë korinthasit ishin në luftë me korkyrasit. Të dy palët ndërluftuese, pasi kishin përqëndruar forcat e tyre detare, po përgatiteshin për një betejë në det. Korintasit me shtatëdhjetë anije të pajisura mirë e sulmuan flotën armike. Korkyrasit që u vunë përballë tetëdhjetë anije me tri sërë lopatash mbetën fitimtarë.[1] Ata arritën të pushtojnë Epidamnin, vranë gjithë robërit, me përjashtim të
3 korintasve që i vunë në pranga dhe i futën në burg. Të dëshpëruar nga humbja e tyre, korintasit u tërhoqën në Peloponez. Duke mbetur zotër të detit në këto anë korkyrasit u derdhën kundër aleatëve të korintasve dhe shkretuan tokat e tyre.

LIBRI XIV

3 **92** ... Në Maqedoni Amynta, i ati i Filipit, u dëbua nga kryeqyteti i tij prej ilirëve që ishin dyndur në Maqedoni[2]...

LIBRI XV

1 **13** Kur po ndodhnin gjithë këto [3] Dionisi, tiran i Syrakuzës, vendosi të themelonte shumë qytete gjatë brigjeve të detit Adriatik. Me këtë ai deshi të bënte të vetin gjirin e Jonit me qëllim që të siguronte lundrimin për në Epir dhe të kishte qytete të veta që t'i shërbenin si baza detare. Ai nxitohej, veç asaj, të hidhej me fuqi
2 të mëdha në Epir që të grabiste faltoren e Delfit, e cila ishte plot thesare. Për këtë ai përfundoi edhe një marrëveshje aleance me ilirët me ndërmjetësinë e Alketës Molos, i cili i dëbuar nga vendi i tij jetonte në atë kohë në Syrakuzë. Meqenëse ilirët ishin në luftë, Dionisi u dërgoi një ndihmë prej dymijë njerëzish dhe pesëqind armatime të
3 plota helene. Ilirët ua ndanë këto armë luftarëve më të mirë, dhe ushtarët që u kishin

---

[1] Viti 435/4 para e. sonë.
[2] Rreth vitit 383 para e. sonë, ndërsa Diodori e vendos këtë ngjarje në vitin 393.
[3] Në vitin 385 para e. sonë.

ardhur për ndihmë i përzien me trupat e tyre. Si mblodhën një fuqi të madhe, hynë në Epir, duke sjellë me vete Alketën për ta rivendosur në fronin e molosëve. Në fillim, meqenëse nuk gjetën ndonjë kundërshtim, shkretuan vendin, por më vonë kur u dolën përpara molosët, u përleshën me ta në një betejë të rreptë, në të cilën ilirët dolën fitues, pasi kishin vrarë më shumë se pesëmbëdhjetë mijë molosë. Kur e morën vesh lakedemonët këtë fatkeqësi të epirotëve, u dërguan molosëve përforcime për t'i ndihmuar që t'u prisnin hovin barbarëve.

4 Kur po ndodhnin këto, banorët e ishullit Paro, sipas një orakulli, dërguan kolonë në Adriatik dhe themeluan në ishullin e quajtur Far një qytet me ndihmën e tiranit Dionis. Ky i fundit, disa vjet më parë kishte dërguar në Adriatik kolonë dhe kishte themeluar qytetin e quajtur Lis.

1 **14** Në këtë kohë[1], pra, parasit që ishin vendosur në ishullin Far u kishin lejuar barbarëve, banorëve të vjetër të këtij ishulli, të zinin të qetë një vend shumë të fortë, dhe ata vetë kishin ndërtuar në buzë të detit një qytet, që e rrethuan me mure. Po më
2 vonë meqenëse banorët e vjetër të ishullit filluan ta shikonin me sy të keq nguljen e helenëve këtu, thirrën në ndihmë ilirët që banonin në bregun përkundrejt. Një numër i madh anijesh të vogla me më shumë se dhjetë mijë vetë brenda zbritën në ishullin Far, shkatërruan pasuritë e helenëve dhe vranë shumë prej tyre. Por, kur sunduesi i Lisit, që ishte emëruar aty prej Dionisit, mësoi për këtë gjë, erdhi me shumë anije me tri sërë lopatash dhe sulmoi anijet e vogla të ilirëve, disa prej tyre i mbyti, të tjerat i zuri, nga barbarët vrau më tepër se pesë mijë dhe rreth dy mijë i zuri rob...

2 **19** ... Në Maqedoni, mbreti Amynta, i mundur nga ilirët[2] pasi kishte humbur shpresën për të rivendosur pushtetin e tij, u lëshoi olynthasve një pjesë të madhe të tokave kufitare.

5 **36** ... Timotheu, pasi mori komandën e flotës u drejtua për në Kefaleni[3], bëri për vehte qytetet e saj dhe bindi qytetet e Akarnanisë që të anojnë nga athinasit. Ai u bë mik i Alketës, mbretit të molosëve, tërhoqi në anën e tij qytetet rreth e rrotull dhe i mundi lakedemonët në betejën detare pranë Leukadës.

LIBRI XVI

3 **1** ... Ai /Filipi II/ e gjeti Maqedoninë të robëruar nga ilirët...

1 **2** ... Në këtë kohë Filipi[4], i biri i Amyntës dhe babai i atij Aleksandri, që luftoi e mundi persët, hipi në fron të Maqedonisë në rrethanat që do t'i bëjmë të njohura.
2 Amynta, i mundur prej ilirëve, qe detyruar t'u paguante një tribut fituesve. Ilirët kishin marrë peng Filipin, më të voglin e djemve, dhe ua kishin dhënë tebanëve...
4 Pas vdekjes së Amyntës, Aleksandri, më i madhi i bijve të tij, trashëgoi kurorën; ky u vra pabesisht nga Ptoleme Alori, i cili i rrëmbeu fronin, por edhe ky, nga ana e tij u vra nga Perdika, i cili u shpall mbret. Perdika u mund nga ilirët në një betejë të madhe dhe ra në çastin vendimtar. Vëllai i tij Filipi, iku nga Teba, ku mbahej si peng dhe u bë mbret i Maqedonisë, mbretëri që atëherë ishte mjaft e dobësuar.

---

[1] Viti 384 para e. sonë.
[2] Viti 383 para e. sonë.
[3] Rreth vitit 376 para e. sonë.
[4] Në vitin 359 para e. sonë.

5 Maqedonët kishin humbur më shumë se katër mijë vetë në betejë. Pjesa tjetër e ushtrisë e trembur nga fuqia e ilirëve, nuk guxonte aspak të vazhdonte luftën.
6 Ndërkaq, paionët, që banonin në kufijtë e Maqedonisë shkretuan vendin, pa pyetur për maqedonasit. Ilirët mblodhën trupa të shumta dhe vendosën të nisen kundër Maqedonisë...

2 **4** ... Ai /Filipi II/ ishte kështu i lirë nga lufta me athinasit[1], kur mori vesh vdekjen e Agit, mbretit të paionëve. Filipi vendosi të përfitonte nga ky rast për të sulmuar këtë fis. U nis, pra, kundër Paionisë, i mundi barbarët në betejë dhe i
3 shtrëngoi t'u nënshtrohen maqedonasve. Nuk i mbeteshin të tjerë armiq përveç ilirëve dhe dëshironte me zjarr t'i nënshtronte edhe këta; bëri pra një mbledhje të gjerë dhe i foli ushtrisë me guxim, duke e nxitur për luftë, pastaj u turr kundër Ilirisë me jo më pak se dhjetëmijë këmbësorë dhe gjashtëqind kalorës. Atëherë Bardhyli,
4 mbreti i ilirëve, si mori vesh ardhjen e armiqve, së pari dërgoi delegatë dhe i propozoi Filipit të bënin paqe me kusht që të dy palët të mbanin qytetet që kishin në zotërim në atë kohë. Mirëpo Filipi iu përgjegj se dëshironte me të vërtetë paqe, po s'do ta bënte po qe se ilirët s'do t'i lironin të gjitha qytetet e Maqedonisë që kishin pushtuar. Delegatët u kthyen pa bërë asgjë. Bardhyli, duke patur besim në fitoret e deritanishme dhe në trimërinë e ilirëve, mori ushtrinë – dhjetë mijë këmbësorë të
5 zgjedhur e afro pesëqind kalorës – dhe i doli armikut përpara. Të dy ushtritë posa u afruan,u përleshën me britma të mëdha. Atëherë Filipi, që komandonte krahun e djathtë dhe kishte maqedonasit më të zgjedhur, urdhëroi kalorësinë t'i kthente kuajt e
6 t'u binte barbarëve nga anët, ndërsa ai vetë u ra nga balli dhe kështu nisi një betejë e fortë. Ilirët me vrap u radhitën në formë tulle[2] dhe me guxim e trimëri i bënë ballë rrezikut. Në krye, fitorja nuk anoi as nga njëra, as nga tjetra palë, dhe kështu vazhdoi për një kohë të gjatë, se të dy ushtritë luftuan me trimëri të rrallë. Nga të dy anët shumë vetë u vranë dhe ca më shumë u plagosën, dhe rreziku i kanosej herë njërës, herë tjetrës palë, duke u lëkundur vazhdimisht sepse luftohej me trimëri. Po kur kalorësia u sul nga anët dhe nga shpina, dhe kur Filipi me luftëtarët më të zgjedhur u ra nga balli me trimëri ilirëve, atëherë këta u thyen e ua dhanë këmbëve me të
7 shpejtë. Maqedonasit i ndoqën këmba-këmbës dhe për një kohë të gjatë, duke vrarë shumë ilirë gjatë kësaj ndjekje, gjersa Filipi, me anë të burisë i thirri maqedonasit të kthehen prapa. Ngriti pastaj lapidarë dhe varrosi aty gjithë luftëtarët e tij që ishin vrarë në këtë betejë. Ilirët dërguan delegatë dhe përfunduan paqen, pasi liruan të gjitha qytetet e Maqedonisë që kishin pushtuar. Ilirët humbën në këtë betejë më shumë se shtatë mijë vetë[3].

3 **5** Ai /Dionisi i Riu i Syrakuzës/ themeloi në Apulie dy qytete që duhej të shërbenin si skela të sigurta për ata, që lundronin në detin Jon; mbasi barbarët që banonin në këto brigje shkretonin detin me anijet e tyre të shumta pirate, duke e bërë të pamundur lundrimin në Adriatik për anijet tregtare.

1 **8** Në të njejtën kohë[4] Filipi, mbreti i maqedonase i mundi ilirët në një betejë të madhe, dhe pasi vuri nën zotërimin e tij gjithë banorët gjer në liqenin Lyhnid u kthye në Maqedoni. Ai bëri me ilirët një paqe fitimtare.

---

[1] Në vitin 359 Filipi kishte bërë paqe me Athinën.
[2] D.m.th. formuan një kuadrat me radhë të shtrënguara.
[3] Beteja u zhvillua në vitin 358 para e. sonë.
[4] Viti 358 para e. sonë.

1 **10** Kur Dioni /Dionisi/ arriti në kufijtë e Syrakuzës, erdhën tek ai një numër i madh njerëzish të paarmatosur që vinin nga krahinat dhe qyteti. Dionisi, që nuk u besonte syrakuzasve, shumicën e tyre e kishte pasë çarmatosur. Në këtë kohë[1] tirani ndodhej me një numër të madh trupash në qytetet porsa të themeluara në brigjet e Adriatikut.

3 **22** ... Afër Maqedonisë tre mbretër: i Thrakisë, Paionisë dhe Ilirisë ishin bashkuar për të sulmuar Filipin. Këta mbretër fqinjë e shihnin me një sy plot cmirë rritjen e fuqisë së Filipit; dhe duke qenë se nuk ishin aq të fortë për ta luftuar veçmas ishin lidhur ndërmjet tyre me shpresë që t'ia arrinin me lehtësi qëllimit. Ata ishin akoma të zënë me mbledhjen e ushtrisë së tyre, kur Filipi u vërsul mbi armiqtë, dhe si i gjeti në rrëmujë e të frikësuar i detyroi t'u nënshtrohen maqedonasve.[2]

7 **69** Filipi, që kishte trashëguar urrejtjen për ilirët nga i ati dhe s'e kishte ndryshuar, u lëshua mbi Ilirinë me një ushtri të fortë[3]. Ai plaçkiti vendin, nënshtroi shumë fortesa dhe u kthye në Maqedoni me plaçkë të madhe...

1 **72** ... Në këtë vit Arrymba[4], mbret i molosëve, vdiq mbas një sundimi prej dhjetë vjetësh; ai la një djalë të quajtur Aiakid, babanë e Pirros, por me ndërhyrjen e Filipit të Maqedonisë, mbas Arrymbës fronin e zuri Aleksandri, i vëllai i Olympisë.

3 **91** ... Sidoqoftë Filipi, duke besuar se kishte mbështetjen e perëndive gëzohej qysh më parë se Azia do të binte në duar të maqedonasve. Ai urdhëroi, prandaj, të
4 bëheshin flijime madhështore në nderim të perëndive dhe celebroi në të njejtën kohë martesën e së bijës, Kleopatrës, që e kishte me Olympinë dhe që ia dha për nuse Aleksandrit[5], mbretit të epirotëve, i cili ishte i vëllai i Olympisë. Për të tërhequr në
5 këto festa një numër sa më të madh helenësh ai organizoi shfaqej muzikore dhe festa të shkëlqyera, në të cilat ftoi edhe miqtë e vet edhe të huaj. Ai pruri të ftuar nga e
6 gjithë Hellada dhe i porositi miqtë që të ftojnë nga ana e tyre të gjithë rrethin e miqësisë; ai kishte ambicjen të fitonte zemrën e helenëve dhe t'i përgjigjej me dinjitet nderit që i kishin bërë, duke e emëruar kryekomandant të Helladës.

LIBRI XVII

113 Në këtë vit[6] erdhën në Babyloni të deleguar pothuajse nga e gjithë bota; një palë
1 përgëzonin mbretin[7] për fitoret e tij, të tjerë i ofronin kurora, shumë ndër ta i sillnin dhurata të çmuara, disa lidhnin me të marrëveshje miqësie e aleanca; më në fund disa erdhën për t'u shfajësuar për akuzat që u kishin bërë. Të gjithë popujt, qytetet e
2 sundimtarët e Azisë i paraqitën atij homazhe. Erdhën shumë dinastë nga Evropa dhe Libia. Ndërmjet atyre të Libisë shquheshin të dërguarit e Kartagës dhe të Libifinikës

---

[1] Vitin 357 para e. sonë.
[2] Në vitin 356 para e. sonë.
[3] Në vitin 344 para e. sonë.
[4] Njihet më tepër me emrin Arryba.
[5] Ngjarja ndodh rreth vitit 337 para e. sonë.
[6] Viti 324 para e. sonë.
[7] Aleksandrin e Madh.

si dhe ata të krejt popujve që banonin bregdetin deri tek shtyllat e Herakliut. Përsa i përket përfaqësuesve të Evropës, këtu dalloheshin ata të qyteteve helene, të Maqedonisë, të Ilirisë dhe të një pjese të madhe të bregdetit të Adriatikut; më në fund ata të popujve të Thrakisë të galatëve, fqinjëve të tyre, raca e të cilëve porsa kishte filluar të njihej atëherë nga helenët.

LIBRI XVIII

1 **11** Sa për helenët e tjerë, një palë anonin nga aleanca me maqedonasit, të tjerët qëndruan të paanshëm. Të gjithë etolët ndoqën, pra, të parët lidhjen e Athinës, siç u tha më parë; pas tyre erdhën të gjithë thesalët, me përjashtim të pelinëve; oitët pa herakleasit; ahejt e ftiasit pa tebanët; meliejt me përjashtim të lamiasit pastaj të gjithë dorët, lokidasit, fokidasit, ainianët, alyzejt, dolopët, atamanët, leukadasit dhe molosët, që ishin nën Arypten[1], i cili duke bërë aleancë me paramendim të keq, bashkëpunoi si tradhëtar me partinë maqedonase; kurse një pjesë e vogël e ilirëve dhe e thrakëve, për urrejtje kundër maqedonasve nuk hynë në aleancë; pastaj karystët e Eubesë; morën pjesë në luftë të fundit nga Peloponezi argasit, sikyonasit, elejt, mesenasit dhe banorët e Aktesë[2]. Pra, në aleancën e heleneve bënin pjesë këta që u përmendën.

4 **49** ... Polyperhu, i ngarkuar me regjencën, me pëlqimin e miqve të tij, prej të cilëve kishte kërkuar këshillë, thirri Olympinë, për t'i besuar asaj edukimin e djalit të Aleksandrit që ishte akoma fëmijë dhe e ftoi atë të vinte në Maqedoni, ku do të ushtronte detyrat mbretërore. Më parë Olympia kishte qenë detyruar të arratisej në Epir për t'iu larguar mërisë së Antipatrit. Kjo ishte gjendja në Maqedoni.

LIBRI XIX

1 **11** Në Maqedoni, Eurydika[3], regjente e mbretërisë, kur mori vesh se Olympia po përgatitej të kthehej[4], dërgoi në Peloponez, tek Kasandri, një lajmës me një letër, në të cilën ajo e thërriste të vinte sa më parë në ndihmë të saj. Në të njëjtën kohë, ajo u përpoq me anë dhuratash dhe me anë premtimesh të bukura t'i tërhiqte në anën e
2 vet maqedonasit më aktivë. Ndërkaq Polyperhu mblodhi një ushtri, u bashkua me epirotin Aiakid dhe e rivendosi Olympinë në mbretërinë e tij me të birin e Aleksandrit[5]. I njoftuar se Eurydika me ushtrinë e saj ndodhej në Evia të Maqedonisë, ai marshoi menjëherë kundër saj i vendosur t'i jepte fund gjendjes me anën e luftës. Të dy ushtritë ishin ndërkaq ballë për ballë, kur maqedonasit, të mbushur me respekt nga pamja e Olympisë, e cila u kujtonte të gjitha të mirat që
3 kishin pasur nga Aleksandri, ndërruan mendje. Në vend që të luftonin, kapën menjëherë mbretin Filip[6] dhe njerëzit e tij. Eurydika, që ishte tërhequr në Amfipol me Polyklin, njërin nga këshilltarët e saj, u arrestua gjithashtu. Olympia, duke shtënë kështu në dorë këta dy njerëz të shtëpisë mbretërore, hipi mbi fron pa luftë, por ajo nuk u tregua e matur në përdorimin e

---

[1] Është fjala për Arrybën, emrin e të cilit Diodori në Lib. XVI 72,1 dhe XIX 88,1 e quan Arrymba.
[2] Epidaurasit dhe trezenasit.
[3] E mbesa e Filipit të dytë të Maqedonisë.
[4] Olympia ndodhej në Epir.
[5] Është fjala për Aleksandrin, të birin e Roksanës.
[6] I njohur me emrin Arideu.

pushtetit.

2 **36** ... Kur mori vesh Kasandri se Aiakidi, mbret i epirotëve, do të vinte në ndihmë të Olympisë, dërgoi Atarhinë, një nga komandantët e tij, me ushtri të përgatitur që t'u dalë përpara epirotëve[1]. Atarhia u shpejtua të zbatonte urdhërin e
3 Kasandrit dhe mbasi zuri më parë ngushticat në kufi të Epirit, bëri të dështojë ndërmarrja e Aiakidit, sepse turmat e epirotëve marshonin pa dashje kundër maqedonasve dhe gjatë përleshjes ngritën krye. Ndërkaq Aiakidi që donte me çdo mënyrë t'i vinte në ndihmë Olympisë, lëshoi të pakënaqurit dhe mori me vete ata që
4 ishin të gatshëm të ndanin fatin e luftës; ai kishte dëshirë t'i futej rrezikut, por nuk kishte mjaft fuqi, mbasi pak ushtri kishte mbetur rreth tij. Epirotët që u ndanë, u kthyen në atdhe, ngritën krye kundër mbretit që ishte larg dhe me një vendim të popullit e dënuan me mërgim dhe u lidhën me Kasandrin. Asnjë ngjarje e tillë nuk
5 kishte ndodhur në Epir qysh nga Neoptolemi, i biri i Akilit, që kishte sunduar në këtë vend,pasi gjithmonë deri në këtë kohë djali që zëvendësonte babanë në fron, aty vdiste. Kasandri pushtoi Epirin. Dërgoi Lykiskun si qeveritar ushtarak e civil. Shumë shpejt epirotët, që deri atëherë ishin kundër aleancës me maqedonët, braktisën Olympinë, punët e së cilës ishin pa shpresë dhe u bashkuan me Kasandrin...

1 **51** ... Ai /Kasandri/ nxiti pastaj familjet e atyre që kishte vrarë Olympia dhe i shtyri ata ta akuzojnë para mbledhjes së përgjithshme të maqedonasve. Olympia e
2 cila mungonte dhe nuk pat, pra, mundësi të mbrohej, u dënua me vdekje nga gjyqi i maqedonasve. Kasandri dërgoi me një herë tek Olympia disa nga të besuarit e tij, të ngarkuar që ta këshillonin mbretëreshën që të arratisej fshehurazi dhe ta hipnin mbi
3 një anije, që shkonte për Athinë. Kasandri veproi kështu jo për të shpëtuar
4 Olympinë... Por Olympia nuk pranoi të merrte arratinë; ajo shpalli përkundrazi se ishte gati të paraqitej para gjithë maqedonasve dhe t'i nënshtrohej dënimit. Duke dyshuar në efektin, që mund të bënte mbi masën mbrojtja e mbretëreshës dhe nga frika se mos populli, duke kujtuar të mirat e Aleksandrit dhe të Filipit tërhiqej nga dënimi, Kasandri ngarkoi dyqind nga ushtarët e tij më besnikë dhe i urdhëroi ta vrisnin Olympinë në vend. Këta ushtarë, si hynë në pallat, u mbushën me respekt
5 para qëndrimit fisnik të Olympisë dhe u kthyen pa e kryer detyrën e tyre. Por njerëzit e atyre që Olympia kishte vrarë, duke pasur për të marrë gjak dhe duke dashur, në të njëjtën kohë, t'i hyjnë në qejf Kasandrit, e vranë mbretëreshën, e cila nuk lëshoi asnjë klithmë, që mund të tradhëtonte dobësinë e seksit të saj. Ky qe fundi i Olympisë, e cila gjatë jetës së saj qe mbuluar me nderime. Kështu mbaroi e bija e Neoptolemit, mbretit të epirotëve, e motra e atij Aleksandri, që bëri luftë në Itali, e shoqja e Filipit, që qe një nga mbretërit më të fortë të Evropës dhe më në fund e ëma e Aleksandrit, e këtij mbreti, që kishte kryer kaq vepra të mëdha dhe të bukura.

6 **70** ... Ai /Akrotati, biri i mbretit Kleomen/ iku /nga Sparta/ pa lejen e eforëve, mori me vete një numër të vogël anijesh dhe u drejtua për në Akragas. Një furtunë e
7 fortë e hodhi në detin Adriatik, në tokën e Apollonisë. Ky qytet ishte i rrethuar në atë kohë nga Glaukia, mbreti i ilirëve[2].

---

[1] Në vitin 316 para e. sonë.
[2] Në vitin 314 para e. sonë.

Akrotati bëri që të hiqej rrethimi i qytetit dhe ia mbushi mendjen mbretit të përfundonte një traktat paqeje me apolloniatët.

3 **74** ... Në këtë kohë[1], Filipi, i dërguar si komandant nga Kasandri për të luftuar kundër etolëve, hyri me të shpejtë me ushtrinë e tij në Akarnani dhe filloi të grabisë dhe të shkretojë tokat e etolëve. Por kur mori vesh se Aiakidi, mbreti i epirotëve, ishte kthyer në vendin e tij dhe mblidhte ushtri të madhe, vendosi të marshonte
4 kundër tij menjëherë. Ai i gjeti epirotët gati për të luftuar dhe lufta filloi menjëherë. Filipi vrau një numër të madh armiqsh dhe zuri shumë robër. Midis këtyre të fundit ishin ata të pesëdhjetët, të cilët e kishin kthyer mbretin në Epir. Filipi i dërgoi këta të lidhur tek Kasandri. Ndërkaq ushtarët e Aiakidit që kishin shpëtuar u bashkuan me
5 etolët. Filipi i sulmoi përsëri, i mundi dhe vrau një numër të madh prej tyre. Ndër të vrarët ishte edhe vetë mbreti Aiakid...

1 **78** Ndërsa ndodhnin këto gjëra, korkyrasit që kishin ardhur për t'u ndihmuar apolloniatëve dhe epidamnasve i zbrapsën me humbje të rënda forcat e Kasandrit,
2 çliruan Apollonin dhe Epidamnin ia dorëzuan Glaukisë, mbretit të ilirëve.[2]

88 Ndërsa ndodhnin këto gjëra[3], epirotët pas vdekjes së Aiakidit, mbretit të tyre, ia
3 dhanë mbretërinë Alketës, i cili ishte dëbuar nga i ati i tij Arrymba dhe që treguar gjithnjë armik i Kasandrit. Për këtë Lykisku, i emëruar nga Kasandri si komandant ushtarak i Akarnanisë, hyri me një ushtri në Epir, duke shpresuar të rrëzonte me lehtësi Alketën, pasi gjendja në mbretërinë e tij nuk ishte e qëndrueshme. Lykisku
4 vendosi lëmin në rrethet e qytetit Kasopia. Alketa, nga ana e tij dërgoi të dy djemtë e tij Aleksandrin dhe Teukrin, nëpër qytete me urdhërin që të ngrinin sa më shumë
5 ushtarë. Ai vetë u nis në krye të ushtrisë së tij, dhe pasi iu afrua armikut, qëndroi të priste kthimin e të bijve. Por, të sumuar nga Lykisku me forca të mëdha, epirotët të tmerruar, e braktisën Alketën, i cili i trembur iku të mbrohej në Eurymene, qytet i
6 Epirit. Në kohën që ky ishte i rrethuar, i biri i tij, Aleksandri, i erdhi në ndihmë. Filloi një luftë e përgjakshme, në të cilën u vranë shumë ushtarë dhe prijës, midis tyre komandanti Mikythi dhe Lysandri nga Athina, që ishte ngarkuar nga Kasandri të qeveriste Leukadën. Por shpejt pas kësaj Deinia erdhi në ndihmë të Lykiskut që qe gati të dorëzohej dhe u bë një luftë e dytë. Aleksandri dhe Teukri u mundën dhe bashkë me të atin u mbyllën në një vend të fortifikuar. Lykisku e mori me sulm qytetin Eurymene dhe si e plaçkiti e shkatërroi që nga themelet.

1 **89** Kur Kasandri mori vesh për humbjet e ushtrisë së tij, erdhi me vrap në Epir, për të ndihmuar Lykiskun meqenëse nuk dinte akoma për sukseset e luftës së dytë. Si e gjeti Lykiskun fitimtar, bëri paqe me Alketën dhe lidhi me të një traktat aleance; pastaj me një pjesë të ushtrisë së tij u drejtua për në bregun e Adriatikut, me qëllim
2 që të rrethonte qytetin e apolloniatëve, të cilët kishin dëbuar garnizonin e tij dhe ishin lidhur me ilirët. Megjithëkëtë, ata të qytetit nuk e humbën fare, po përkundrazi dërguan delegatë për të kërkuar ndihma nga aleatët e tjerë dhe menjëherë u rreshtuan përpara mureve të qytetit. Pas një beteje të fortë e të gjatë apolloniatët, duke pasur ushtri më të madhe, i thyen armiqtë dhe i shtrënguan të ikin. Kasandri vetë, mbasi humbi shumë ushtarë dhe duke mos pasur fuqi të mjaftë si edhe duke patur parasysh stinën e dimrit, u kthye në Maqedoni.

---

[1] Në vitin 313 para e. sonë.
[2] Viti 312 para e. sonë.
[3] Prapë në vitin 312 para e. sonë.

3 Me të ikur Kasandri nga Epiri, leukadasit, të ndihmuar edhe nga kerkyrasit, e nxorën jashtë qytetit rojen e Kasandrit. Sa për epirotët, këta mbetën nën sundimin e mbretit Alketa për disa kohë, por meqenëse ky ishte shumë i keq, populli e vrau atë bashkë me të dy na bijtë të quajtur Esion dhe Nison, të mitur nga mosha.

LIBRI XX

1 **19** Në Maqedoni Kasandri i kishte dërguar ndihmë Audoleonit mbretit të Paionisë, që ndodhej në luftë me autariatët. Ai e shpëtoi nga një rrezik kërcënues, duke shpërngulur për në malin Orbel njëzet mijë autariatë së bashku me gratë e fëmijët e tyre.[1)]

FRAGMENTE

Excerpt. Vatican. f. 17 e 18

Fjala e urtë "Mos e tepro" do të thotë që duhet të kesh masë në çdo gjë dhe që në çështje njerëzore nuk duhet të shkosh deri në pikën e fundit, sikurse e bënë epidamnasit. Këta banonin në brigjet e Adriatikut dhe ishin në luftë me njëri-tjetrin; ata hodhën në det një tok hekura të skuqura dhe u betuan se nuk do t'i jepnin fund armiqësive të tyre përderisa të nxirrnin nga deti akoma të nxehta hekurat. Betim i kotë dhe në kundërshtim me fjalën e urtë: "Mos e tepro". Rrethanat i detyruan më vonë epidamnasit të arrijnë në një marrëveshje dhe t'i lënë të ftohen hekurat në thelësitë e humnerës.

Excerpt. Vatican. fq. 46

Mbreti Pirro humbi shumë nga epirotët që kishin kaluar me të në Itali. Njëri nga miqtë që ishte lidhur ngushtë me të, e pyeti në se ishte i kënaqur nga suksesi i betejës. "Edhe një fitore të tillë, u përgjigj ai, të korr mbi romakët dhe mua nuk do të më mbetet asnjë nga ushtarët që më shoqëruan në Itali". Dhe me të vërtetë të gjitha fitoret e arritura ishin fitore kadmike: Të mundurit nuk ishin mposhtur plotësisht, përsa i përket fuqisë së tyre dhe ngadhënjyesit kishin pësuar kaq humbje dhe shkatërrime sa edhe të mundurit.
Kinea, i dërguar nga Pirrua për të biseduar me romakët, u tregua i shkathët në këtë detyrë dhe i ofroi personave më me influencë dhurata të çmueshme; por këta të fundit nuk i pranuan dhe iu përgjigjën atij njëzëri se nuk ishte me vend të pranonin dhurata përsa kohë vazhdonte lufta; por që nga dita e përfundimit të paqes dhe kur Pirrua të bëhej mik i romakëve do t'u pëlqenin me gjithë qejf dhuratat, të cilat do të mundnin t'i pranonin pa ngurrim.

Excerpt. Vatican. fq. 47

Pirrua, kur korri një fitore të lavdishme mbi galët, vendosi në tempullin e Athinasë Itone mburoje të armikut dhe plaçkën më të çmueshme; ai gdhëndi këtë mbishkrim:

"Pirro Molosi ia dhuron Athinasë Itone
Këto mburoja, që ua hoqi galatëve të fortë
pasi shkatërroi gjithë ushtrinë e Antigonit;
dhe nuk është kjo një çudi e madhe
sepse aiakidët janë edhe tani luftëtarë, siç kanë qenë në të kaluarën."

[1)] Ngjarja ndodh në vitin 310 para e. sonë.

Excerpt. Vatican. fq. 72-74

... Perseu, me qëllim aleance, dërgoi një delegacion tek Genti, mbreti Ilirisë, atëherë sovrani më i madh i këtyre krahinave. Ky u përgjegj se donte të bënte luftë me romakët, por nuk kishte të holla. Perseu i dërgoi një delegacion të ri por pa përmendur punën e të hollave. Kur mori të njëjtën përgjegje, Perseu i dërgoi një delegacion të tretë dhe shtoi, duke fshehur mendimet e tij, se ai i njihte mirë qëllimet e Gentit dhe se mund t'i ishte atij i dobishëm, nëqoftëse ngjarjet do të zhvilloheshin ashtu si dëshironte. Perseu, duke mos dashur të ndahej nga thesarët e tij, dërgoi rishtas delegatë tek Genti, duke mos i bërë asnjë propozim për të holla; ai i la të ushqejë shpresa të mëdha, kur t'i jepej fund kësaj ndërmarrjeje.

Excerpt. Hoesche. fq. 494-495

Epirotët e kanë për gjë të madhe jo vetëm të luftojnë për atdhenë e tyre, por edhe të japin jetën për të mbrojtur miqtë e tyre, dhe farefisin.

Excerpt. Hoeschel. fq. 495-497

Thoinioni dhe Sosistrati, pasardhës të Hiketës, e thirrën Pirron për të dytën herë që të vinte në Siqeli. Mamertinët, që kishin mbytur mesinasit, përfunduan një traktat aleance me kartagasit dhe vendosën në një mbledhje të përgjithshme, se do ta kundërshtonin hyrjen e Pirros në Siqeli. Por Tyndari, tirani i Tauromenit, mbante anën e mbretit dhe ishte gati t'i hapte portat e qytetit trupave të tij. Kartagasit si bënë aleancë me romakët ngarkuan mbi anijet e tyre pesëqind ushtarë; ata u drejtuan pastaj kundër Regit dhe e sulmuan këtë qytet; por u shtrënguan të heqin dorë nga rrethimi dhe i dhanë zjarr lëndës që kishin mbledhur për të ndërtuar anije; ata vazhduan të mbikqyrin ngushticat dhe të ruanin kalimin e Pirros.

Thoinioni që e kishte ishullin nën sundimin e tij dhe Sosistrati, bënin me shoqi-shoqin luftë me dhjetëmijë ushtarë; por të dy, të lodhur nga këto armiqësi, dërguan tek Pirrua një delegacion.

Pirrua luftoi në Itali për dy vjet e katër muaj. Kur po përgatitej për nisje, kartagasit kishin rrethuar nga toka e nga deti Syrakuzën; ata kishin përqëndruar në limanin e madh një flotë prej njëqind anijesh dhe një ushtri tokësore me pesëdhjetë mijë njerëz që ishte fushuar pranë qytetit; prej këndej ata i mbanin të mbyllur brenda mureve banorët dhe shkretonin pa pushim tokat e Syrakuzës. Syrakuzasve, të lodhur nga kjo luftë, nuk u mbeti shpresë tjetër veçse tek Pirrua, që ishte martuar me Lanasën, të bijën e Agathoklit, nga e cila kishte një djalë të quajtur Aleksandër. Ata i dërgonin atij prandaj për ditë delegatë. Pirrua hipi mbi anije ushtarë, elefantët dhe plaçkën e tij, u nis nga Tarenti dhe arriti pas dhjetë ditësh në Lokre. Prej këndej, duke përshkuar ngushticën për të dalë në Siqeli, zbriti në Tauromen. Si u lidh me aleancë me Tyndarin, sundimtarin e Tauromenit, atij iu dhanë përforcime në ushtarë dhe u nis për në Katanë. Banorët e pritën me madhështi dhe i dhuruan kurora ari. Pikërisht këtu zbriti edhe trupat nga anijet dhe i drejtoi për në Syrakuzë, ndërsa flota lundronte krahas, krejt e gatshme për një luftë detare. Në kohën kur Pirrua po i afrohej Syrakuzës, kartagasit, të cilët për nevoja shërbimi kishin larguar tridhjetë nga anijet e tyre, nuk guxuan t'ia hynin luftës me mbeturinat e flotës së tyre. Kjo ishte arsyeja që Pirrua hyri në Syrakuzë pa asnjë rrezik. Thoinioni i dorëzoi ujdhesën; syrakuzasit e Sosistrati i dorëzuan lagjet e tjera të qytetit. Sostrati ishte sunduesi i Agrigentit dhe i shumë qyteteve të tjera dhe

kishte një ushtri prej më tepër se dhjetë mijë vetë. Pirrua rivendosi bashkimin ndërmjet syrakuzasve nga njëra anë dhe Thoinionit e Sostratit nga ana tjetër; kjo paqe e ngriti shumë lart mendimin për të. Armët dhe të gjitha makinat e luftës që ndodheshin në qytet iu dorëzuan atij. Ndër të tjera ai mori njëqind e njëzet anije të mbuluara dhe njëzet të tjera të pambuluara; anija mbretërore kisht nëntë sërë lopatash. E gjithë flota e Pirros, duke përfshirë edhe anijet që kishte sjellë me vete, kapej në më shumë se dyqind copë. Po në këtë kohë, delegatë të dërguar nga Heraklidi, tirani i Leontit, erdhën t'i propozonin Pirros dorëzimin e qytetit ashtu edhe fortesa e trupat, të përbërë nga katër mijë këmbësorë dhe pesëqind kalorës. Të tjerë delegatë u paraqitën në numër të madh në Syrakuzë për t'i ofruar qytete dhe aleancë. Pirrua i priti të gjithë këta të deleguar me një dashamirësi të madhe dhe i la të kthehen në shtëpitë e tyre; atij i pëlqente të bëhej edhe zot i Libisë.

.....

Breni, mbreti i galatëve, luftoi në Maqedoni me një ushtri prej njëqind e pesëdhjetë mijë këmbësorësh të armatosur me mburoja të mëdha dhe me dhjetë mijë kalorës. Një sasi e madhe sendesh ushqimore dhe dy mijë karroca e ndiqnin këtë ushtri. Ai humbi në këtë ekspeditë shumë ushtarë dhe ushtria e tij ishte dobësuar shumë kur hyri në Helladë për të grabitur tempullin e Delfit. Këtu, në shumë beteja, ai humbi disa mijë njerëz dhe mori edhe vetë tri plagë. Duke e kuptuar se nuk i kishte mbetur veçse pak për të jetuar i mblodhi galatët e vet dhe duke u mbajtur një fjalim i këshilloi t'i vrasin të gjithë të plagosurit, t'i djegin karrocat e tyre dhe të kthehen menjëherë në vendin e tyre, ai i këshilloi, gjithashtu, të bëjnë mbret Kihorin. Pas kësaj Breni u deh dhe theri veten. Kihori e varrosi, vrau të plagosurit si dhe ata që ishin bërë të paaftë nga të ftohtit dhe uria; numri i këtyre arrinte në njëzet mijë vetë. Me pjesën tjetër të ushtrisë u kthye duke marrë të njëjtën rrugë nga kishte ardhur. Helenët të fshehur në ngushtica, hidheshin mbi prapavijat, që i masakronin dhe i merrnin të gjithë plaçkën. Kur arritën tek Termopilet, galët, të cilët nuk kishin më me se të ushqeheshin, humbën në këtë qafë edhe njëzet mijë njerëz të tjerë. më në fund u asgjësuan që të gjithë në tokën e dardanëve, nëpër të cilën donin të kalonin dhe nuk mbeti as edhe një, që të mund ta shihte përsëri vendin e vet.

Excerpt. Hoeschel. fq. 497-499

Si rregulloi punët në Syrakuzë e Leont, Pirrua u drejtua për nga Agrigenti. Në kohën që ishte në rrugë, disa lajmëtarë të hipur mbi anije, erdhën për t'i thënë, se garnizoni i kartagasve ishte dëbuar nga qyteti dhe se ishin kujdesur vetëm të ndalonin Fintinë të shpallej tiran i Agrigentit; njëkohësisht ata e lajmëruan atë që qyteti përgatitej t'i dorëzohej atij dhe të lidhte një aleancë. Me të vërtetë porsa mbreti arriti në Agrigent, Sosistrati i dorëzoi qytetin si dhe trupat që përbëheshin nga tetë mijë burra të këmbësorisë dhe tetëqind kalorës, luftëtarë, që nuk mbeteshin në asgjë pas edhe nga epirotët. Ai pranoi nënshtrimin e tridhjetë qyteteve të tjera, ku sundonte Sostrati. Mbas kësaj Pirrua dërgoi të kërkojë në Syrakuzë makina rrethimi si dhe një sasi të madhe armësh. Pastaj ai depërtoi në tokat që mbanin kartagasit me një ushtri prej tridhjetë mijë vetësh këmbësorë, një mijë e pesëqind kalorës dhe me disa elefantë. Ai nënshtroi në fillim qytetin e Heraklesë, të mbrojtur nga një garnizon kartagas. Pastaj mori Azonën. Selinuntasit u bashkuan me mbretin, ashtu edhe banorët e Halykit, të Egestës dhe të shumë qyteteve të tjera. Qyteti i Erykinës mbrohej nga një garnizon i fuqishëm kartagas dhe nga vetë pozita; ai ishte shumë i vështirë të merrej. Pirrua vendosi ta rrethonte dhe ta pushtonte me sulm. Ai i afroi, prandaj, makinat e luftës. Rrethimi që i

gjatë dhe këmbëngulës. Mbreti, që donte të mbulohej me lavdi dhe të marshonte në gjurmët e Herakliut hipi i pari mbi muret dhe atje duke luftuar trimërisht, i bëri copë të gjithë kartagasit që vërsuleshin mbi të. Miqtë e tij i erdhën në ndihmë dhe qyteti u mor me sulm. Si vendosi një garnizon u nis për në Eginë, qytet shumë i fortë dhe në pozitë shumë të mirë, pranë Panormit. Duke qenë se ietët iu nënshtruan vullnetarisht, ai u duk menjëherë para Panormit, qytet që ka limanin më të bukur në Siqeli; që këtej rrjedh edhe emri i tij. Ai e mori po ashtu me sulm dhe, duke pushtuar fortesën e Erklit, ai u bë zot i të gjitha tokave të kartagasve në Siqeli, me përjashtim të Lilybesë. Kartagasit e kishin ndërtuar këtë qytet mbasi tirani Dionis u kishte marrë Motynë. Ata vendosën në Lilybe mbeturinat e popullsisë së Motysë. Gjatë kohës që Pirrua ishte i zënë me përgatitjet e rrethimit, kartagasit sollën me det në Lilybe fuqi të mëdha; dhe duke qenë se ishin zotër të detit, sollën këtu sasira të mëdha elbi, makina lufte dhe armë të tjera. Duke qenë se një pjesë e madhe e qytetit lagej nga deti, banorët e mbronin hyrjen nga ana e tokës me një tok kullash dhe nga një hendek i gjatë. Ndërkaq ata dërguan delegatë tek mbreti për t'i propozuar një traktat paqeje dhe për t'i ofruar një shumë të madhe të hollash. Por Pirrua nuk i pranoi të hollat; ai ishte i gatshëm edhe t'ia linte Lilybenë kartagasve, por oborrtarët e tij, sikurse edhe delegatët e qyteteve, ia kthyen mendjen nga një vendim i tillë duke e këshilluar të mos u linte kartagasve asnjë hyrje në Siqeli, t'i dëbonte nga krejt ishulli dhe të mos linte kufi tjetër për vendin e tyre veçse detit. Menjëherë mbreti e ngriti lëmin afër mureve të qytetit dhe i mësyu me sulme të dyfishuara; por kartagasit i zmbrapsën me këmbëngulje, qoftë për arsye të numrit të tyre, qoftë për forcën e makinave luftarake. Në të vërtetë ata kishin një sasi aq të madhe katapultash për të hedhur shigjeta e gurë, sa që muri i qytetit nuk kishte aq vend sa t'i përmblidhte. Edhe shigjetat binin si breshër mbi rrethuesit që vriteshin apo plagoseshin, në një numër aq të madh, sa Pirros iu desh të kërrusej. Veç makinave të luftës që kishte sjellë nga Syrakuza, ai ndërtoi edhe të tjera, ai urdhëroi që të shpohen edhe muret me qëllim që t'i rrethonte. Por nga njëra anë qëndresa e kartagasve dhe nga ana tjetër natyra e një terreni shkëmbor, mbi të cilën qe ndërtuar Lilybea, e detyruan Pirron që ta quajë këtë qytet si të papushtueshëm dhe e shtrënguan të hiqte dorë nga rrethimi, i cili kishte zgjatur dy muaj. Mbreti i ktheu atëherë sytë nga bretu i detit, mbi të cilin do të bëhej zot me anën e një flote të madhe, me qëllim që të zbriste ushtri në Libi.

Excerpt. de Virt. et Vit. fq 563

Pirrua la të plaçkitej qyteti Aiga që ishte vendi ku kishte ndejën oborri i mbretërve të Maqedonisë dhe la atje një garnizon galësh. Këta mbasi kishin marrë vesh se simbas një zakoni të vjetër, bashkë me mbretërit futej në varr edhe një sasi e madhe argjëndi, i prishën varret, e ndanë argjëndin që gjetën brenda dhe i shpërndanë eshtrat andej këndej. Zëri i popullit ia mvesh këtë vepër të urryer Pirros, i cili nuk i ndëshkoi aspak barbarët, për arsye se kishte nevojë për ndihmën e tyre në luftë.

Excerpt. de Virt. et Vit. fq. 577, 578

... Epiroti Harop ishte i biri i atij që mbante të njëjtin emër dhe që gjatë luftës kundër Filipit[1)] i kishte dërguar Flaminit një kallauz, për t'i udhëhequr romakët nëpr shtigjet e maleve dhe për të gjetur mjetet se si t'i pushtonin ngushticat në befasi. I rritur në Romë, Haropi i ri u bë, për konsideratën që gëzonte i ati, shok e mik shtëpie i shumë qytetarëve nga më të përmendurit. Ishte i guximshëm nga karakteri dhe i keq; ai shpifi

[1)] Filipi V i Maqedonisë.

tek romakët kundër parisë së Epirit dhe sillej ashpër me të gjithë ata që mund t'i kundërshtonin, sikur t'ishte zot i krejt Epirit. Ky ishte shkaku që i detyroi epriotët të dërgonin delegatë në Maqedoni, tek Perseu, për t'i dorëzuar atij vendin.

Excerpt. de Virt. et Vit. fq. 587-589

Mbas shpartallimit të Perseut, romakët u kthyen kundër atyre që kishin marrë pjesë në luftë përkrah maqedonasve; disa i ndëshkuan, të tjerët i dërguan në Romë. Haropi, që njihej si mik i zjarrtë i romakëve, mori qeverisjen e Epirit. Në fillim nuk mund t'i mvishej atij veçse një numër i vogël krimesh; por më vonë ai e zbuloi shpirtin e keq të tij dhe rrënoi Epirin. Në të vërtetë ai nuk pushonte së ndjekuri, duke u bërë padira të paqena banorëve më të pasur; disa i vrau, të tjerët i dërgoi në mërgim dhe u mori pasuritë. Ai u merrte para me përdhun jo vetëm burrave, por edhe grave, dhe këtë e bënte me ndihmën e s'ëmës Filotidës që kishte një egërsi e shpirtkeqësi jo të zakonshme për seksin e saj. Ai akuzoi më në fund një numër të madh banorësh se nuk ishin partizanë të Romës dhe i dënoi të gjithë me vdekje.

Excerpt. de Virt. et Vit. fq. 589-590

Filipi, i biri i Amyntës, që e gjeti mbretërinë e tij të nënshtruar nga ilirët, e çliroi ca me anën e armëve, ca me zotësinë e tij dhe me anën e sjelljes së tij të urtë përkundrejt të mundurve e bëri shtetin më të madh të Evropës.

STRABONI

Gjeografi dhe historiani i madh grek, Straboni, lindi në Amasia të Pontit aty nga viti 63 para e. sonë dhe vdiq rreth vitit 20 të e. sonë. Një pjesë të jetës së tij Straboni e kaloi në Romë, kurse pjesën tjetër ai e kaloi duke bërë udhëtime nëpër vende të ndryshme të perandorisë romake, nëpër Greqi, Azi, Itali dhe Egjipt.

Në bazë të vrojtimeve të tij personale nga ky udhëtim, dhe në mënyrë të veçantë duke u mbështetur në veprat e autorëve të ndryshëm antikë Artemidorit, Eratosthenit, Apollodorit, etj., Straboni shkroi veprën e tij "Geographica" (Gjeografia) në 17 libra. Dy librat e parë që kanë karakterin e një hyrjeje të përgjithshme bëjnë fjalë për gjeografinë e atëhershme fiziko-matematike; librat 3-10 për gjeografinë e Evropës, librat 11-16 për gjeografinë e Azisë, kurse libri i fundit për atë të Afrikës. Në të jepen dhe të dhëna me vlerë historike. Si e tillë gjeografia e Strabonit është një burim i rëndësishëm për studimin e gjeografisë antike të tre kontinenteve të përmendur, si edhe për njohjen e disa ngjarjeve historike të zhvilluara në periudha të ndryshme po në këto pjesë të botës. Gjeografia e Strabonit ka një rëndësi të dorës së parë dhe është një burim i vyer edhe për gjeografinë dhe hsitorinë e Ilirisë. Straboni gjithashtu është dhe autor i një vepre historike për periudhën nga viti 144 (aty ku mbaron historia e Polibit) e deri në fund të luftës civile. Nga kjo vepër na janë ruajtur vetëm pak fragmente.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Strabonis Geographica recognovit Augustus Meinecke. Vol. I-III. Lipsiae in aedibus B. G. Teubneri, 1915-1925.

STRABONIS

GEOGRAPHICA

(Gjeografia)

LIBRI I

1 ... Ai /Homeri/ duhet ta ketë njohur Istrin, sepse ai flet për myzët, fis thrak i vendosur në brigjet e këtij lumi. Ka mundësi që të ketë njohur gjithë bregun, që vazhdon dhe që i takon Thrakisë deri tek Penei, kur ai përmend paionët, Athosin, Aksin dhe ishujt, që gjenden përballë këtij bregu. Prej këndej e deri tek thesprotët zgjatet bregu i helenëve...

2 Ndoshta dhe Jasoni ka qenë endur në Itali. Të paktën, në malet Keraune, në brigjet e Adrias, në gjirin e poseidonasve dhe në ishujt pranë Tyrrenit duken disa shenja, që flasin për endjen nëpër këto anë të argonautëve.

... Ose ndoshta ai /Homeri/ nuk ka ditur që Thrakia nuk zbriste përtej maleve paione e thesale. Sidoqoftë ai ka njohur mirë viset, që nga kjo anë kufizojnë thrakët dhe duke numëruar fiset që banonin në këtë vend, qoftë në bregdet, qoftë në brendi, ai nuk ka harruar të përmendë disa prej tyre si: magnetët, malët, të gjithë helenët deri tek thesprotët, dolopët fqinjë të paionëve, selët që zinin rrethet e Dodonës deri tek Ahelou...

LIBRI II

5 Nga veriu ai /deti i Siqelisë/ shkon drejt kepit japyg, drejt grykës së gjirit të Jonit dhe viseve jugore të Epirit, deri tek gjiri i Ambrakisë dhe bregu në vazhdim, i cili duke qenë përballë Peloponezit, formon bregun verior të gjirit të Korintit.

Gjiri i Jonit është një pjesë e atij, që ne tani e quajmë Adriatik, i cili djathtas kufizohet nga bregu i Ilirisë dhe majtas nga bregu i Italisë, deri në fund ku gjendet Akuilea.

Gjiri i Adriatikut drejtohet nga veriu dhe nga perëndimi, ai është i ngushtë e i gjatë; ndërsa gjatësia e tij është reth gjashtë mijë stade, gjerësia më e madhe nuk i kalon të një mijë e dyqind stadet. Ai ka një numër mjaft të madh ishujsh, në pjesën më të madhe të vendosur pranë bregut të Ilirisë, të tilla si: Apsyrtidet, Kyriktiket, Liburnidet, Isa, Traguri, Korkyra e Zezë dhe Fari...

8

6 ... Vendolikët dhe norikët zënë, në pjesën më të madhe, anën e kundërt të këtyre maleve[1], të përzierë me breunët dhe genaunët, që bëjnë pjesë në Iliri. Të gjithë këta fise kanë qenë të njohur për inkursionet, që kanë bërë pa ndërprerje në vendet e fqinjëve të tyre, qoftë në Itali, qoftë në tokat e helvetëve, sekoanëve, bojve

9 dhe germanëve...

Pas këtyre fiseve vijnë gjithë ata, që zënë brigjet e gjirit Adriatik dhe territorin e Akuilesë. Këta janë disa fise norike dhe karnët. Norikëve u përkasin edhe tauriskët. Tiberi dhe vëllai i tij Druzi shtypën, në një fushatë, guximin e këtyre fiseve dhe u dhanë fund inkursioneve të tyre të vazhdueshme, kështu që ka më se tridhjetë e tre vjet që ata jetojnë në paqe dhe paguajnë tributin e caktuar...

Në malet Apenine, mbi karnët, gjendet një liqen, nga i cili del lumi Atesin; ky lum, pasi merr me vete dhe lumin tjetër Atagin, derdhet në Adria. Po prej këtij liqeni buron një lum tjetër me emrin Isar, që derdhet në Istër. Istri vetë i ka burimet në malet[2], që ndahen në shumë vargmale me një numër të madh majash... Një tjetër vargmal shkon drejt Ilirisë e Adrias; prej këtyre janë malet Apenine, që kemi përmendur, Tuloni, Fligadia dhe malet mbi vendolikët, prej nga burojnë lumenjtë Duras, Klan dhe shumë lumenj të tjerë, që derdhen në Istër.

10

Në këto vende banojnë japodët, që tani janë ilirë e keltë të përzierë dhe pranë të cilëve gjendet mali Okra. Dikur ata kanë qenë të dëgjuar për numrin e madh të tyre, për tokën e gjerë, që zinin në të dy anët e maleve dhe për kusaritë e dendura, që bënin ndër fqinjët e tyre. Por Cezari August u dha fund këtyre dhe i nënshtroi plotësisht. Qytetet e tyre janë Metuli, Arupini, Moneti dhe Vendi.

Pas tyre vjen qyteti Segestika i vendosur në fushë. Pranë këtij qyteti kalon lumi Sao që derdhet në Istër.

LIBRI V

1

1 ... Akuilea, që është nga të gjitha qytetet e këtij vendi, më afër fundit të gjirit, ka qenë ndërtuar prej romakëve për të përmbajtur barbarët, që banonin më lart. Anijet e ngarkesës arrijnë në këtë vend nëpër Natiso, duke kaluar një largësi prej më tepër se gjashtëdhjetë stade. Kjo është qendra e tregëtisë së romakëve me ata popuj ilirë, që janë pranë Istrit. Këta të fundit eksportojnë verë, që e mbajnë në enë druri, të cilat i transportojnë me qerre; dhe përveç kësaj peshk të kripur dhe vaj: të parët /romakët/ u sillnin skllevër, kafshë dhe lëkura...

4

2 Sa për pellazgët, pothuaj të gjithë janë të mendimit se ishin një fis i vjetër i përhapur në gjithë Helladën e sidomos në vendin e eolëve afër Thesalisë. Por sipas Eforit ishin me prejardhje nga Arkadia, të dhënë pas jetës luftarake, të cilët duke u shtuar nga ata që morën anën e tyre dhe të cilëve ata u dhanë emrin e tyre, u bënë të famshëm edhe ndër helenët, edhe në gjithë vendet ku vajtën. Me të vërtetë, shohim pellazgë të vendosur në Kretë, sikurse na dëshmon Homeri, duke i vënë në gojë Odiseut këto fjalë, që ai i thotë Penelopës:

---

[1] Alpeve.
[2] Alpet.

"Në këtë ishull ku banojnë ahejt, eteokretët trima, kydonët, dorët trefish dhe pellazgët hyjnorë, secili ka gjuhën e tij".

Për më tepër Thesalia, e cila gjendet midis grykës së Peneit dhe Termopyleve dhe shtrihet gjer në malet e Pindit, quhet Argo pellazgjik, sepse pellazgët dikur këtu qenë zotër; dhe vetë poeti /Homeri/ Zeusin e Dodonës e quan pellazgjik: "Zeusi i lartë pellazgjik i Dodonës". Shumë autorë të vjetër edhe fiset epirote i kanë quajtur pellazgjike, sepse ata shtriheshin deri atje /në Epir/. Dhe me që këta autorë të vjetër kanë cilësuar si pellazgë një numër të madh heronjsh, autorët e mëvonshëm, gjithashtu u kanë dhënë emrin pellazg fiseve, që kishin udhëheqësa këta heronj: kështu është quajtur pellazgjik ishulli Lesbo dhe kështu Homeri i quan pellazgë fiset kufitare me kilikët në Trojë. "Hipothou i udhëhoqi këto fise pellazgësh, nga të cilët disa banonin në Larisën pjellore". Efori, kur mendonte se pellazgët ishin me prejardhje nga Arkadia, pason Hesiodin, që na thotë: "Nga i biri i Pellazgut, nga hyjnori Lykaon lindën gjashtë fëmijë". Por Eskili në "Iketidet"[1] dhe "Danaidet" thotë se raca e pellazgëve kishte dalë nga Argo pranë Mykenës. Efori pretendon, gjithashtu, se Peloponezi mbante dikur emrin Pellazgia dhe Euripidi në "Arhelau" thotë: "Danau, i ati i pesëdhjetë vajzave, si erdhi në Argo, u vendos në qytetin Inah dhe urdhëroi që pellazgët të linin emrin e tyre të vjetër dhe paskëtaj të quheshin danaj". Sipas Antiklidit, pellazgët qenë të parët, që populluan ishujt Lemno e Imbro dhe disa prej tyre kaluan në Itali me Tyrrenin, të birin e Atyut. Më në fund, po t'u besojmë autorëve të Atideve[2], ka pasur pellazgë, që kanë banuar në Athinë dhe për shkak se këta popuj, duke u endur në të gjithë anët shkonin me grupe në vende të ndryshme si disa zogj; banorët vendas të Atikës i quajtën me emrin "Pelargë".

8 Nga Kosoni deri në Graviski janë treqind stade; dhe midis këtyre dy qyteteve gjendet vendi i quajtur Regis-Villa. Ky vend thuhet se ka qenë dikur qendra e mbretit të pellazgëve, Maleo, i cili, siç thonë, pasi sundoi një kohë mbi pellazgët e kësaj krahine, la Italinë për të kaluar me ta në Athinë. Këta pellazgë janë të një fisi me ata që banojnë në Agyla.

LIBRI VI

5 **1** ... Pandosia është vend i fortifikuar pranë së cilës Aleksandri Molos, gjeti vdekjen e tij. Ai u gënjye nga orakulli i Dodonës, që i tha të ruhej nga Aheroni dhe Pandosia. Ai kujtoi se orakulli i tha për vendet me të njëjtin emër, që gjendeshin në Thesproti, por pikërisht këtu humbi jetën e tij. Fortesa Pandosia është në një vend me tri kodra, që i kalon afër lumi Aheron. Dhe një thënie tjetër e orakullit me dy kuptime: "Pandosia, qytet mbi tri kodra, shumë njerëz do të humbasin" e çoi Aleksandrin edhe në një gabim tjetër; ai kujtoi se ky paralajmërim fliste për humbjen e armiqve të tij dhe jo të vetën...

4 **2** ... Arhia kur u nis për në Siqeli la Kersikratin, pinjoll i fisit të Herakliut, me një pjesë të ushtrisë në ishullin, që quhej prej tyre Skeria dhe tani Kerkyra, për të themeluar këtu një koloni, gjë që ky e zbatoi duke ndjekur liburnët, që zotëronin këtë ishull..."

---

[1] "Lutëset".

[2] Titulli që i kanë dhënë punimeve të tyre shumë autorë që kanë shkruar për historinë e Atikës sikurse Filohori, Androtioni, Amelsagora, Heraniku etj.

4 **3** ... Një nga gabimet e tyre /tarentasve/ në politikë ishte se ushtrinë ua besuan të huajve. Kështu ata thirrën Aleksandrin Molos kundër mesapëve dhe leukanëve; më përpara kanë qenë shërbyer nga Arhidami, biri i Agesilaut, më vonë përdorën Agathoklin dhe Kleonymin, pastaj kur ata hynë në luftë me romakët iu drejtuan Pirros.

8 Në Brendesi njeriu mund të hipi mbi anije për të kaluar në bregun e kundërt, në dashtë në drejtim të maleve Keraune dhe brigjeve të Epirit e të Helaldës, që gjenden pas këtyre maleve, në dashtë në Epidamn. Kjo rrugë e fundit është më e gjatë se tjetra, sepse është një mijë e tetëqind stade. Megjithatë këtë rrugë e bëjnë shpesh, sepse ky qytet është vendi më i përshtatshëm për tregtinë midis popujve të Ilirisë dhe të Maqedonisë.

2 **4** ... Ilirët si edhe thrakët, fqinjë më të afërt të helenëve dhe të maqedonasve, kishin përfituar nga rasti për të hyrë në luftë me Romën. Kjo luftë nuk mbaroi veçse kur të gjithë popujt këtej Istrit dhe Alyt u mundën...

LIBRI VII

1 **1** ... Kurse në jug /të Istrit/ deri në Helladë banojnë fiset ilire dhe thrake dhe të gjithë ata prej këtyre, që janë përzier me fise kelte ose me disa fise të tjera.

11 **3** ... /Burebista/ ishte i tmerrshëm edhe për romakët sepse kalonte pa frikë Istrin dhe plaçkiste jo vetëm Thrakinë, por arrinte edhe në Maqedoni e Iliri...

1 **5** Pjesa tjetër e Evropës është ajo, që ndodhet midis Istrit e detit përreth, duke u nisur nga gjiri i Adriatikut gjer në grykën e shenjtë të Istrit; brenda në këtë pjesë ndodhet Hellada, fiset e maqedonasve e të epirotëve dhe ato që janë në veri të këtyre dhe shtrihen gjer në Ister midis dy deteve, d.m.th. Adriatikut dhe Pontit; nga ana e Adriatikut janë fiset ilire, kurse nga ana e Pontit gjer në Propont dhe Helespont, fiset thrake, megjithëse me këto janë përzier edhe disa fise skythe ose kelte. Duke folur rreth këtyre viseve, duhet të fillojmë nga Istri; këto janë ato që kufizohen me Italinë dhe me Alpet, me germanët, me dakët dhe me getët. Këto mund t'i ndajmë në dy: në vijë paralele, si të thuash, me Istrin ndodhen malet e Ilirisë, Paionisë dhe Thrakisë, që formojnë deri diku një vijë, e cila zgjatet që nga Adria gjer në Pont; vendet veriore të kësaj vije janë ato midis Istrit dhe maleve, ndërsa nga ana e jugut fillon Hellada dhe pa ndërprerje viset barbare gjer tek zonat malore. Pranë Pontit është mali Hemi, më i madhi e më i larti nga gjithë malet e kësaj pjese të Evropës. Ky në një farë mënyre e ndan Thrakinë në mes; nga ky mal, thotë Polibi, shihen që të dy detet, por nuk është e vërtetë, sepse edhe largësia gjer në Adria është e madhe, dhe ndërmjet ndodhen gjëra të shumta, që pengojnë pamjen. Buzë detit Adriatik është pothuaj e tërë Ardia, kurse në mes ndodhet Paionia, e gjithë në vende të larta. Në të dy anët e saj janë: në kufi me Thrakinë Rodopi, mal shumë i lartë pas Hemit dhe nga ana tjetër, në veri, viset ilire, d.m.th. vendi i autariatëve dhe ai i dardanëve.

Do të flasim më parë për fiset e Ilirisë, që kufizohen me Istrin e me Alpet, të cilat ndodhen midis Italisë dhe Germanisë, duke filluar që nga liqeni me viset e vendolikëve, retëve dhe helvetëve.

2 Por një pjesë të këtij vendi e shkretuan dakët, të cilët mposhtën me luftë

bojët dhe tauriskët, fise kelte nën Kritasirën, duke thënë se vendi është i tyre, megjithëse i pengonte lumi Paris, i cili buron nga malet mbi Istrin, afër skordiskëve, të quajtur galatë; edhe këta kanë banuar të përzier me fiset ilire dhe thrake; por dakët i shpartalluan të parët, kurse të dytët i trajtonin edhe si aleatë. Pjesën tjetër deri në Segestikë dhe Istër, nga veriu dhe nga lindja e kanë panonët, ndërsa nga anët e tjera shtrihen edhe më tej. Segestika është qytet i panonëve dhe gjendet në vendin ku bashkohen shumë lumenj, të gjithë të lundrueshëm, vend sulmi i përshtatshëm në luftën kundër dakëve; ndodhet në këmbë të Alpeve, të cilët shtrihen deri tek japodët, fise kelte dhe njëkohësisht ilire; prej këndej burojnë shumë lumenj, të cilët bëjnë të mundur të vijnë këtu bashkë me të tjerët edhe ngarkesat me anije prej Italisë. Prej Akuilesë deri në Nauport, duke kaluar mbi Okrën, krahinë e tauriskëve, në të cilën karrot e armatosura detyrohen të marrin tatëpjetën, janë treqind e pesëdhjetë stade; disa thonë pesëqind. Okra është vendi më i ulët i Alpeve, që shtrihen prej krahinës së retëve deri në atë të japodëve; prej këndej prapë malet fillojnë të ngrihen nga ana e japodëve dhe kjo krahinë quhet Albia. Po kështu ndodh edhe nga ana e Tergestes, fshat i Karnikës, ku kalohet përmes Okrës, në një kënetë, që quhet Luge. Afër Nauportit gjendet lumi Korkora, mbi të cilin mund të kalojnë anije të ngarkuara; ky pra derdhet në Savë, ndërsa vetë Sava në Dravë dhe ky i fundit në Noar afër Segestikës. Që prej këtej Noari, duke marrë Kolapin, i cili buron nga mali Albi dhe përshkon tokat e japodëve, derdhet në Danub, i cili nga ana e tij kalon nga tokat e skordiskëve. Lundrimi në shumicën e lumenjve është i mundshëm deri në viset veriore. Rruga nga Tergeste deri në Danub është rreth një mijë e dyqind stade. Afër Segestikës gjendet Siskia vend i fortifikuar, si edhe Sirmi dhe që të dy janë në rrugën për në Itali.

3 Fise panone janë breukët, andizetët, ditionët, peirustët, mazejt dhe desitiatët, që kanë për prijës Baton. Përveç këtyre janë edhe disa fise të tjera të vogla më pak të rëndësishme dhe që shtrihen gjer në Dalmati e gjer në krahinat e ardianëve, nga ana e jugut. I gjithë vendi që shtrihet nga gjiri i Adrias, vend malor, gjer në gjirin e Rizonit dhe tokën e ardianëve... bie midis detit dhe fiseve panone. Pothuajse prej këtej duhet të fillojmë përshkrimin me radhë, pasi të përmendim shkurtimisht ato, që janë thënë më parë. Thamë në përshkrimin e Italisë se istrët janë të parët në bregdetin ilir, që kufizojnë me Italinë dhe me karnët, dhe se udhëheqësit e sotëm të Italisë i shpunë kufijtë gjer në Pola, qytet i Istrisë. Këta janë rreth tetëqind stade larg gjirit të detit, aq janë edhe nga kepi i Polës gjer në Ankonë, për një që ka bregun e Entisë nga e djathta. I gjithë bregdeti i Istrisë është një mijë e treqind stade.

4 Pas këtyre me radhë është bregdeti i japodëve prej një mijë stadesh. Japodët janë vendosur në malin Albi, që është i fundit i Alpeve dhe shumë i lartë; këta nga njëra anë shtrihen gjer tek panonët e gjer në Istër, nga ana tjetër gjer në Adriatik; janë një popull trim e luftëtar, dhe përveç kësaj janë stërvitur në mënyrë të përsosur prej Augustit. Qytete të tyre janë Metuli, Arupini, Moneti, Vendi; toka nuk është pjellore, e prandaj ushqehen me elb e me thekër, armatimin e kanë si të keltëve; janë taman si ilirët e tjerë dhe thrakët. Pas bregdetit të japodëve vjen ai i liburnëve. Ky është (pesëqind) stade më i madh se i pari; në këtë bregdet është një lumë nëpër të cilin mund të lundrohet me ngarkesë deri në Dalmati; është dhe qyteti Liburna i skardëve.

5 Pranë gjithë këtij bregdeti gjenden ishujt Apsyrtide, në të cilët thuhet se Medea vrau të vëllanë e saj, Apsyrtin, i cili e ndiqte atë. Pastaj, para japodëve është Kyriktika; pastaj vijnë ishujt Liburnide rreth dyzet; pastaj ishuj të tjerë shumë të

njohur janë: Isa, Traguri, ngritur prej isasve, Fari, që quhej më parë Pari, ngritur prej parasve; nga ky vend është edhe Demetër Fari. Pastaj vjen bregu i dalmatëve dhe skela e tyre Salona. Kjo populisi është nga ato, që luftuan me romakët për shumë kohë; pati vendbanime të përmendura gjer në pesëdhjetë, nga të cilat disa edhe qytete si Salona, Promona, Ninia, Sinoti i Ri dhe i Vjetër; këto i dogji Augusti.

Është edhe Andetri, vend i fortifikuar, dhe Dalmi, qytet i madh, emrin e të cilit e mori edhe populisia. Por këtë qytet e zvogëloi Nasika dhe fushën e ktheu në kullotë delesh për shkak të lakmisë së njerëzve.

Është një gjë e veçantë e dalmatëve që ta ndajnë tokën çdo tetë vjet. Mospërdorimi i monedhave është një karakteristikë e veçantë në krahasim me banorët e tjerë të këtij bregdeti, kurse në lidhje me shumë barbarë të tjerë, është një gjë e përbashkët. Është dhe mali i Adrit, që e ndan Dalmatinë në mes, një pjesë nga deti dhe një pjesë nga ana tjetër. Pastaj është lumi Naron dhe rreth tij janë daorizët, ardianët dhe plerejt, afër të cilëve gjendet ishulli që quhet Korkyra e Zezë dhe qyteti me këtë emër, që është ndërtuar prej knidasve, ndërsa afër ardianëve është Fari, që quhej më parë Pari, i ndërtuar prej parasve.

6 Ardianët më vonë i quajtën uardanë. Romakët i shtynë këta nga deti në viset e brendshme, mbasi e dëmtonin detin me pirateri, dhe i shtrënguan të bëhen bujq. Vendi është i ashpër dhe shterp; as nuk është për njerëz bujq, kështu që u shkatërruan plotësisht dhe për pak u zhdukën krejt. Kjo gjë u ngjau edhe fiseve të tjera të këtyre vendeve, sepse ata që ishin më të fuqishëm më parë ranë fare dhe u zhdukën, nga galatët këtë gjë e pësuan bojët dhe skoidiskët, nga ilirët autariatët ardianët dhe dardanët, kurse nga thrakët tribalët. Sepse këto fise të cilat në fillim u dobësuan në luftë njëri me tjetrin, më vonë u shkatërruan nga maqedonasit dhe romakët.

7 Pas bregdetit të ardianëve dhe plerejve vjen gjiri i Rizonit edhe qyteti Rizon, si edhe qytete të tjera të vogla. Vjen edhe lumi Dril, i cili më thellë nga lindja arrin gjer në Dardani. Dardania kufizohet me fiset maqedonase dhe paione nga ana e jugut sikundër edhe me autariatët e dasaretët, të tjerë këta, në vise të tjera, që janë kufitare në mes të tyre dhe me autariatët. Dardanë janë edhe galabrët, tek të cilët...[1] është një qytet i vjetër, edhe thunatët, të cilët në lindje janë në kufi me medët, fis thrak. Dardanët janë aq të egër sa edhe nën pleh bagëtish rrëmijnë gropa dhe aty rrojnë; megjithëkëtë muzikën nuk e lënë mënjanë, po përkundrazi përdorin gjithmonë fyej e vegla me kordha. Këta, pra, banojnë në thellësitë e vendit; do t'i përmendim edhe më vonë.

8 Pas gjirit të Rizonit vjen qyteti Lis, Akrolisi dhe Epidamni i ndërtuar nga kerkyrasit; ky qytet sot quhet Dyrrah dhe e mori këtë emër nga gadishulli, mbi të cilin është ndërtuar. Më pas vjen lumi Aps dhe Aoo, mbi të cilin është ndërtuar Apollonia, një qytet me ligje shumë të mira, ndërtuar nga korintasit e nga kerkyrasit; ky qytet është larg lumit dhjetë stade dhe nga deti gjashtëdhjetë. Hekateu Aoon e quan Aia dhe thotë se po prej të njëjtit vend, që është rreth Lakmos, ose më mirë prej të njëjtit burim, rrjedh edhe Inahu nga jugu për në Argo, edhe nga perëndimi për në Adriatik...

Në krahinën e apolloniatëve është një vend i quajtur Nymfe, një shkëmb aty nxjerr zjarr dhe nën këtë rrjedhin burime të vakëta dhe asfalt, mbasi, siç shihet qartë, digjen plisat e asfaltit. Aty pranë ka një minierë, mbi një kodër; me kohë gropat e minierës mbushen përsëri dhe dheu, që bie në to, shndrrohet në asfalt, sikurse e thotë Poseidoni. Ai thotë se edhe dheu asfaltoz, që nxirret në Seleuki të Pierisë, është ilaç kundër morrave të vreshtave, sepse kur ky përzihet me vaj e e ngordh insektin para

[1] Mungesë në tekst.

se ky të ngjitet në degëzimet e rrënjës. Thotë se është gjetur një tokë e tillë edhe në Rod, në kohën kur ai ishte prytan aty, por ka nevojë për më shumë vaj. Pas Apollonisë vjen Bylliaka dhe Oriku me skelën e tij Panormin si dhe malet Keraune, fillim i ngushticës së gjireve Jon e Adria.

9 Të dy kanë grykë të përbashkët, por ndryshojnë në këtë pikë: Joni është emri i pjesës së parë të këtij deti, ndërsa emrin Adria e ka pjesa tjetër gjer në fund, por tani i tëri ka marrë këtë emër. Teopompi thotë se nga këta emra njëri rrjedh prej emrit të sundimtarit të këtyre vendeve, që ishte nga Isa dhe emri Adria prej lumit omonim. Që nga Liburnia e gjer tek malet Keraune janë pak më shumë se dy mijë stade. Teopompi thotë se i gjithë bregdeti që nga gjiri mban gjashtë ditë, kurse gjatësia e Ilirisë më këmbë është tridhjetë ditë; më duket se e tepëron. Ai thotë dhe gjëra të tjera të pabesueshme, si p.sh. detet janë shpuar... dhe këtë e nxjerr nga që gjendet keramikë e Hios dhe Thasos në lumin Naron dhe se të dy detet shihen nga një mal; pastaj ishujt Liburnide i vendos në mënyrë të tillë që formojnë një rreth prej pesëqind stadesh dhe që Istri me një nga grykat derdhet në Adria. Të këtilla janë dhe disa thashetheme të Aratostenit, siç thotë Polibi, për këtë dhe për disa shkrimtarë të tjerë.

10 I gjithë bregu i Ilirisë është me shumë limane të mira si në bregdetin e gjatë, ashtu edhe në ishujt e afërm, kurse përkundrazi ana e Italisë përballë s'ka limane. Gjithashtu i ngrohtë dhe frytdhënës është ky vend, se është plot me ullishta dhe me vreshta të mira përveç në disa vende të pakëta, ku toka është fare e ashpër. Po megjithëqë ka qenë kështu bregdeti i Ilirisë, nuk i jepnin më parë rëndësi, ndoshta pse nuk qe e njohur natyra e mirë e tokës, po më tepër pse njerëzit këtu kanë qenë të egër dhe kusaria ishte një gjë e zakonshme. Sa për tokën përtej bregdetit, është e gjithë malore, e ftohtë dhe shpesh bie dëborë, edhe më tepër nga veriu, aq sa vreshtat janë të ralla, si në vendet malore si dhe në ato fushore. Këto janë rrafshanalta që zotërohen nga panonët dhe nga jugu zgjaten gjer në vendin e dalmatëve dhe ardianëve, nga veriu mbarojnë afër Istrit, nga lindja kufizojnë me skordiskët... dhe nga ana tjetër me malet e maqedonasve dhe thrakëve.

11 Popullsia më e madhe dhe më trime e ilirëve kanë qenë autariatët; këta më parë luftonin pa pushim me ardianët për kriporet, që ndodhen në kufi dhe që formohen prej një uji, i cili rrjedh në pranverë nga një gurrë mali. Pasi merrnin ujë dhe e depozitonin për pesë ditë delte kripa; ishin marrë vesh që ta përdornin kriporen me radhë, dhe kur i shkelnin marrëveshjet zinin luftën.

Autariatët, duke shpartalluar dikur tribalët, të cilët banonin në kufi me agrianët deri në Istër, në një rrugë të gjatë prej 15 ditësh, u vërsulën edhe kundër thrakëve dhe ilirëve të tjerë, por u mundën më parë prej skordiskëve dhe më vonë prej romakëve, të cilët dhe vetë skordiskët i mundën mbas një qëndrese të gjatë.

12 Këta [skordiskët] banonin afër Istrit të ndarë në dy grupe, në të quajturit skordiskë të mëdhenj dhe në ata të vegjël. Të parët banonin ndërmjet lumenjve që derdhen në Istër, d.m.th. Noarit, që kalon afër Segestikës dhe Margut (disa e quajnë Barg), ndërsa të vegjëlit më tutje nga ky lum, në kufi me tribalët dhe myzët. Skordiskët kishin dhe disa prej ishujve; ndërkohë ata u shtuan dhe arritën të shtrihen deri në malet e Ilirisë, Paionisë dhe Thrakisë. Kishin nën sundimin e tyre dhe shumicën e ishujve, që ishin në Istër, si dhe qytetet Eorta dhe Kapedun. pas vendit të skordiskëve, pranë Istrit, gjendet vendi i tribalëve dhe myzëve, të cilët i përmendëm më parë, si dhe kënetat e të quajturës Skythi e Vogël në Istër; dhe këto i përmendëm. Ndërsa në viset rreth Kalatit, Tomit dhe Istrit banojnë dhe krobyzët si dhe të

quajturit troglodytë. Pastaj rreth Hemit dhe nga ana e poshtme e tij deri në Pont banojnë koralët dhe besët dhe disa nga medët e danteletët. Të gjitha këto janë fise kusarësh shumë të mëdhenj, ndërsa besët, të cilët banojnë pjesën më të madhe të Hemit, dhe disa, që jetojnë në kasolle e në varfëri në kufi me Rodopin, me paionët dhe me autariatët e dardanët e ilirëve, quhen kusarë edhe nga vetë kusarët. Ndërmjet këtyre dhe ardianëve gjenden dasaretët dhe agrianët si dhe fise të tjera të parëndësishme, të cilët i rrethuan skordiskët deri sa shkretuan vendin dhe për shumë ditë e mbushën plot me trungje lisash të pakapërcyeshme.

1 **6** Pjesa tjetër është bregdeti i Pontit, që gjendet ndërmjet Istrit dhe maleve në të dy anët e Paionisë, që prej grykës së shenjtë të Istrit deri tek pjesa malore rreth Hemit dhe deri në grykën e Byzantit. Kështu, pra, duke kaluar bregdetin e Ilirisë deri tek malet Keraune, vazhduam rrugën në viset që gjenden jashtë Ilirisë Malore e që kanë mbarimin e vet, ndamë prej këtyre fiset e brendshme, duke i konsideruar këto përshkrime si më të rëndësishmet si për të tashmen, ashtu edhe për të ardhmen.

1 **7** Pra fiset që kufizohen me Istrin dhe me malet e Ilirisë dhe të Thrakisë, janë ato që meritojnë të përmenden; këto zënë gjithë bregdetin e Adriatikut, duke filluar që nga gjiri, si dhe në anën e majtë të Pontit, që quhet vendi prej lumit Istër deri në Byzant. Të fundit janë pjesët jugore të asaj, që u quajt krahinë malore dhe në vazhdim viset, që vijnë nga poshtë, ndërmjet të cilëve është Hellada dhe vendi fqinj i barbarëve deri tek malet.

Hekateu prej Mileti thotë për Peloponezin se këtu para helenëve kanë banuar barbarë. Dhe siç mund të nënkuptohet prej atyre që janë përmendur, pothuajse e gjithë Hellada në kohë të lashta ka qënë e banuar nga barbarë. Kështu Pelopi solli popullin nga Frygia në vendin e quajtur simbas emrit të tij Peloponez; Danau erdhi nga Egjipti, kurse dryopët, kaukanët, pellazgët, lelegët dhe të tjera fise të tilla, ndanë midis tyre viset përbrenda dhe jashtë Istmit. Atikën e pushtuan thrakët që erdhën këtu me Eumolpin, Daulidën e Fokidën e zuri Tereu; Kadmenë e themeluan finikasit, që erdhën këtu me Kadmin, kurse vetë Beotinë e populluan aonët, temikët dhe hyanët. Karakteri barbar mund të dallohet edhe nga disa emra si Kekrop, Kodro, Aiklo, Kotho, Dryma dhe Krinako. Kurse thrakët, ilirët dhe epirotët edhe sot banojnë në krahinat anësore /të Helladës/; shumë më tepër më parë se tani që barbarët kanë pa dyshim pjesën më të madhe të Helladës së sotme; thrakët /kanë/ Maqedoninë dhe disa vise të Thesalisë, ndërsa viset e sipërme të Akarnanisë dhe Etolisë /i kanë/ thesprotët, kasopët, amfilohët, molosët dhe atamanët, fise epirote.

3 Ndonëse më parë këto fise kanë qenë të vogla, të shumta dhe pa famë, nuk ka qenë vështirë të përcaktoheshin kufijtë e tyre, sepse kishin burra të zotë dhe mbretër të dëgjuar. Por tani që pjesa më e madhe e vendit është shkretuar dhe banesat e sidomos qytetet janë zhdukur nuk do të mundte askush t'i përcaktonte këto. Dhe kjo do të ishte pa dobi mbasi ato s'kanë pasur ndonjë famë dhe janë zhdukur. Kjo gjë /shkretimi, zhdukja/ ka filluar prej shumë kohësh dhe në disa vise s'ka pushuar as sot e kësaj dite për shkak të kryengritjeve; dhe kështu ata vetë i bënë sundimtarë mbi vete romakët, të cilët po ngrehin lëmet në shtëpitë e tyre. Me të vërtetë Polibi thotë se Pauli[1)], pasi theu dhe rrënoi maqedonasit e Perseun, shkatërroi shtatëdhjetë qytete të epirotëve (shumica e këtyre kanë qenë të molosëve) dhe robëroi njëqind e pesëdhjetë mijë njerëz. Sidoqoftë, do të mundohemi – sa meritojnë të shkruhen e me

[1)] Konsulli romak Paul Emili.

sa do të mundemi – të flasim për secilin nga këta, duke filluar nga bregdeti i gjirit Jon. Ky është bregdeti, në të cilin merr fund lundrimi i Adriatikut.

4 Viset e para të këtij bregdeti janë ato rreth Epidamnit dhe Apollonisë. Që nga Apollonia fillon rruga Egnatia për në Maqedoni drejt lindjes; kjo rrugë është e matur në mile dhe e shënuar me shtylla gjer te Kypsela dhe te lumi Hebri; gjatësia e kësaj rruge është pesëqind e tridhjetë e pesë mile.

Po të marrim parasysh, siç bëjnë shumica, se një mile është baras me tetë stade[1)], kemi gjithsejt katër mijë e dyqind e tetëdhjetë stade; por, sipas Polibit, i cili u shton tetë stadeve një diplethrë, e cila është një e treta e stadit duhen shtuar njëqind e shatëdhjetë e tetë stade d.m.th. një të tretën e numrit të mileve.

Ata që nisen nga Apollonia dhe Epidamni, piqen në një pikë të rrugës, që ka largësi të njëjtë nga të dy këto qytete. Rruga e tërë quhet Egnatia; pjesa e parë është ajo që kalon nga Kandavia, mal i Ilirisë, dhe shkon përmes qytetit Lyhnid dhe vendit të quajtur Pylon, që shënon kufirin midis Ilirisë dhe Maqedonisë mbi këtë rrugë. Prej këtej shkon afër Barnusit përmes Heraklesë, lynkestëve dhe eordejve për në Edesë dhe Pella gjer në Thesalonik. Polibi thotë se këto janë dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mile. Ata që kalojnë këtë rrugë duke u nisur nga viset pranë Epidamnit dhe Apollonisë, në të djathtë kanë fiset e Epirit, që lagen prej detit të Siqelisë gjer në gjirin e Ambrakisë; nga ana e majtë kanë malet e Ilirisë, që përmendëm më sipër dhe fiset, që banojnë afër këtyre gjer në Maqedoni dhe në viset e paionëve. Pastaj, duke lundruar prej Gjirit të Ambrakisë e tutje, në drejtim të lindjes, vendet që janë karshi Peloponezit janë të Helladës…

5 … Teopompi thotë se fiset e Epirit janë katërmbëdhjetë, më të dëgjuar nga këta janë kaonët dhe molosët; sepse dikur kishin sunduar mbi të gjithë Epirin – kaonët më parë dhe më vonë molosët, të cilët morën fuqi më të madhe për shkak të fisit mbretëror (ishin këta Aiakidë) dhe për shkak se në vendin e tyre ishte faltorja e Dodonës, e vjetër dhe e dëgjuar. Kaonët, pra, dhe thesprotët, e pas këtyre me radhë kasopët (dhe këta janë thesprotë), banojnë në anëdetjen që nis nga malet Keraune deri tek Gjiri i Ambrakisë, një vend i begatshëm. Lundrimi nga viset e kaonëve drejt lindjes e Gjirit të Ambrakisë dhe Korintit, që ka në të djathtë detin Auson dhe në të majtë Epirin, është njëmijë e treqind stade nga Keraunet deri tek gryka e Gjirit të Ambrakisë. Në këtë largësi ndodhet Panormi liman i madh midis maleve Keraune, dhe më tutje një tjetër liman i quajtur Onhesmi, kundrejt të cilit ndodhet bregu perëndimor i Korkyrës, më poshtë ndodhet dhe limani Kasiope, që është larg Brendesit njëmijë e shtatëqind stade. Po kaq stade janë edhe midis Tarantit, një kep tjetër, që gjendet më në jug të Kasiopes, të cilin e quajnë Falakri. Pas Onkesmit vjen Poseidi, dhe Buthroti, në grykën e limanit të quajtur Pelod, i ndërtuar në një vend që është si gadishull, me kolonë romakë, si edhe ishujt Sybote. Këta të fundit janë ishuj të vegjël jo shumë larg nga Epiri dhe që ndodhen karshi Leukimës, në anën lindore të Korkyrës. Përveç këtyre janë dhe disa ishuj të tjerë gjatë bregdetit, po këta s'kanë asnjë rëndësi të veçantë. Pastaj vijnë bregdeti i Himerit dhe limani Glykut, në të cilin derdhet lumi Aheron, që buron prej liqenit Aherusia; në këtë lum derdhen shumë lumenj të tjerë të vegjël, të cilët bashkë me lumin e madh e ëmbëlsojnë ujin e gjirit ku derdhen. Afër shkon dhe lumi Thyami. Pranë këtij gjiri është qyteti i thesprotëve Kyhir, që quhej më parë Efyra, dhe pranë gjirit përballë Buthrotit është qyteti Foinike.

[1)] Stadi ishte masë gjatësie. Afro 5,5 stade bëjnë 1 km., kurse afro 8 stade përbënin 1 mile.

Afër Kyhirit ndodhet një qytet i vogël i kasopëve i quajtur Buketi, i cili nuk është shumë larg detit; më thellë në tokë ndodhen Elatria, Pandosia dhe Batia, dhe toka e tyre zbret deri tek gjiri. Pas limanit të Glykut janë me radhë dy limane të tjerë, njëri më i vogël dhe më afër quhet Komari, ky formon një ngushticë gjashtëdhjetë stadesh drejt gjirit të Ambrakisë dhe Nikopolit, ndërtuar nga Cezari August, tjetri është limani më i madh e më i mirë dhe ndodhet afër grykës së gjirit, larg nga Nikopoli dymbëdhjetë stade.

6 Më poshtë vjen gryka e Gjirit të Ambrakisë; gryka e këtij gjiri është pak më e madhe se katër stade, ndërsa rrethi i tij arrin deri në treqind stade, dhe i gjithë ka limane të mira. Kur lundron më të djathtë banojnë akarnanët, fis helen, faltorja e Apollonit të Aktit ndodhet nga kjo anë dhe afër grykës mbi një kodër, nën të cilën shtrihet një fushë me një pyll dhe me limane të vogla; kësaj faltorjeje i kushtoi Cezari një të dhjetën e pjesës më të mirë të plaçkës së luftës që nga anijet me një sërë lopatash e gjer te ato me dhjetë sërë lopatash. Thuhet se si limani ashtu edhe anijet u zhdukën nga zjarri. Nga ana e majtë ndodhet Nikopoli dhe një fis epirotësh, kasopët, që shtrihen gjer në Gjirin e Ambrakisë; Ambrakia ndodhet afër gjirit dhe u ndërtua prej Gorgut, birit të Kypselit. Pranë këtij qyteti kalon lumi Aratth, i cili nga ana e detit është pak stade nga limani, dhe buron nga mali Tymfa dhe Parorea. Ky qytet lulëzonte edhe më parë (gjiri nga ky e mori emrin), po e stolisi dhe e zbukuroi në mënyrë të veçantë mbreti Pirro.

Më vonë maqedonasit e romakët për shkakt ë mosbindjes së banorëve, prishën në luftërat e parreshtura jo vetëm këtë, po edhe qytete të tjera aq sa më në fund Augusti, duke parë se qytetet u braktisën krejt, mblodhi banorët në një qytet, që u quajt prej tij Nikopol, për kujtim të fitores që korri mbi Antonin përpara grykës së gjirit dhe kundër mbretëreshës së egjiptanëve Kleopatrës, e cila u ndodh dhe ajo në këtë betejë. Që atëherë po zmadhohet dhe përparon dita ditës në sajë të tokës së gjerë, që ka rreth e rrotull si dhe në saje të pasurisë së rrjedhur nga plaçkat e luftës...

7 Pas Ambrakisë është Argo i amfilohëve, i ndërtuar prej Alkmeonit dhe bijve të tij. Efori thotë se Alkmeoni pas ekspeditës së epigonëve kundër Tebës u ftua prej Diomedit që të vijë bashkë me të në Etoli dhe të sundojnë së bashku këtu dhe në Akarnani; kur i thirri këta Agamemnoni në luftën kundër Trojës, Diomedi shkoi, ndërsa Alkmeoni qëndroi në Akarnani dhe ndërtoi Argon, të cilin e quajti Argo i Amfilohisë, sipas emrit të vëllait të tij, kurse lumin Inah, që përshkon vendin dhe derdhet në gji e quajti sipas emrit të vendit Argeia.

Tukididi thotë se Amfilohu, pas kthimit të tij nga Troja në Argo, duke mos dashur të shkojë në Akarnani, dhe duke zënë fronin e të vëllait, ndërtoi qytetin me emrin e vet.

Epirotë janë edhe amfilohët, si edhe gjithë ata që banojnë nga veriu dhe që kufizohen me malet e Ilirisë; këta banojnë në vende të ashpra dhe quhen molosë atamanë, etikë, tymfej, orestë, parorej dhe atinanë. Një palë nga këta janë më afër maqedonasve, kurse disa të tjerë më afër gjirit të Jonit. Thuhet se Orestinë e zuri dikur Oresti, duke ikur pas vrasjes të së ëmës; i dha këtij vendi emrin e vet dhe ndërtoi një qytet të quajtur Argo i Orestisë. Me këta janë përzier fiset ilire, që banojnë në malësitë e jugut si edhe mbi gjirin e Jonit. Pas Epidamnit dhe Apollonisë gjer në malet Keraune banojnë bylinët, taulantët, parthinët e brygët; aty afër janë edhe minierat e argjëndit në Damastion, rreth të cilave dyestët vendosën sundimin e tyre, si edhe enhelejt, të cilët i quajnë edhe sesaretë. Afër këtyre vijnë: lynkestët, Deuriopa, Pelagonia triqyteteshe, eordejt, Elimia dhe Eratyra. Këta më parë sundoheshin më vete, dhe tek enhelejt pushtetin e kishin pasardhësit e Kadmit dhe Harmonisë, dhe legjendat, që fliteshin rreth tyre tregohen aty. Këta nuk sundoheshin

nga vendas, ndërsa lynkestët ishin nën sundimin e Arabeut, nga fisi i bakhiadëve. Ky pati mbesë Eurydikën, nënën e Filipit, të birit të Amyntës, dhe një vajzë të quajtur Sirra. Epirotët molosë, patën për sundues Pirron e Neoptolemit, birin e Akilit dhe pasardhësit të tij nga Thesalia. Të tjerët sundoheshin nga vendas. Më vonë disa prej tyre e shtuan sundimin, por pastaj të gjithë ranë nën sundimin maqedonas përveç disave, që banonin mbi gjirin e Jonit. Edhe vendet që ndodhen rreth Lynkut, Pelagonisë, Orestisë, dhe Elimisë i quanin Maqedoni e Sipërme dhe më vonë Maqedoni e Lirë. Edhe gjithë viset gjer në Korkyrë disa bile i quajnë Maqedoni, për arsye, siç thonë, se banorët e këtyre krahinave përdorin edhe të qethurit edhe të folurën, edhe mantelin /klamydën/ dhe gjëra të tjera në mënyrë të ngjashme, e disa janë dygjuhësh. Si ra sundimi i maqedonasve, vendi u pushtua prej romakëve.

8 Përmes këtyre fiseve shkon rruga Egnatia, që nis nga Epidamni dhe Apollonia. Buzë rrugës që shkon për në Kandavi janë liqenj rrotull Lyhnidit që kanë vende të mjaftueshme për të kripur e për të tharë peshq, gjithashtu këtu ndodhen dhe ata lumenj, që derdhen në detin Jon dhe në viset e jugut d.m.th. Inahu. Arathi, Ahelou dhe Eveni, që quhej më parë Lykorm; nga këta i pari – derdhet në Gjirin e Ambrakisë dhe tjetri në lumin Ahelou, i cili derdhet vetë në det si dhe Eveni. I pari përshkon Akarnaninë, ndërsa i dyti Etolinë. Erigoni, i cili mbledh ujërat që zbresin nga malet e Ilirisë dhe nga ana e lynkestëve, brygëve, deuriopëve dhe pelagonëve

9 derdhet në Aks. Në këto fise më parë kishte dhe qytete p.sh. Pelagonia quhe tirqytetëshe; një prej këtyre ishte Azori; gjithë qytetet e deuriopëve ndodheshin gjatë lumit Erigon; midis këtyre qyteteve ishin dhe Bryani, Alalkomena dhe Stybara. Në krahinën e brygëve ishte dhe qyteti Kydra dhe në atë të tymfejve qyteti Egini, afër Etikisë dhe Trikës. Afër Maqedonisë dhe Thesalisë, rreth malit Poion dhe Pindit, janë etikët dhe burimet e lumit Penei, për të cilat janë në grindje tymfejtë me thesalët, që banojnë nën Pind. Afër lumit Jon ndodhet qyteti Oksineia, njëqind e njëzet stade nga Azori; gjithashtu aty pranë gjenden dhe Alalkomena, Egini, Europi dhe vendi ku Joni bashkohet me Penein. Në atë kohë, pra, siç thashë, ndonëse vendi ishte i ashpër dhe plot me male-Tomari, Polyani dhe shumë të tjerë – megjithatë gjithë Epiri dhe Iliria ishin të pasura, kurse tani një pjesë e madhe e tyre është shkretuar dhe vendet e banuara janë fshatra dhe gërmadha të braktisura. Fatin e

10 këtyre e pati deri diku edhe orakulli i Dodonës. Ky orakull, sipas Eforit, është ndërtuar nga pellazgët. Për këta të fundit flitet se kanë qenë më të vjetrit nga të gjithë ata që sunduan në Helladë; dhe poeti /Homeri/ thotë kështu: "O Zeus, sundimtar dodonas, i pellazgëve" dhe Hesiodi thotë: "Dodona dhe lisi ishin qendra e pellazgëve".

Për pellazgët thamë edhe kur bëmë fjalë për tyrrenët; sa për Dodonën, që banorët rreth saj ishin barbarë, na e thotë dhe Homeri, kur flet për mënyrën e jetesës së tyre, duke i quajtur të zbathur e njerëz që flinin përdhe. Çështja se si duhet t'i quajmë helë, siç thotë Pindari, apo selë, siç lihet të kuptohet prej veprave të Homerit, kjo çështje s'mund të vërtetohet, mbasi shkrimi ka qenë i dyshimtë. Filohori thotë se edhe vetë vendi rreth Dodonës u quajt Helopia, sikundër quhej edhe Eubea. Hesiodi me të vërtetë thotë kështu: "Është një farë vendi që quhet Helopi, e begatshme dhe me shumë livadhe, në fund të këtij vendi ndodhet një e quajtur Dodonë". Siç thotë Apollodori, disa kujtojnë se kjo faltore u quajt kështu nga kënetat, që janë rreth e rrotull; por poeti thotë se nuk i quajnë helë, por selë ata që banojnë rreth faltores, duke shtuar se aty rrjedh një lum i quajtur Seleent, kur thotë: "Larg Efyrës dhe lumit Seleent". Po Skepsi thotë se nuk është fjala për Efyrën e Thesprotisë, por për atë tek elejt se këtu është lumi Seleent, ndërsa nuk ka të tillë as tek thesprotët, as tek molosët. Sa për legjendat që fliten rreth lisit dhe pëllumbave dhe për të tjera si këto,

ashtu siç flitet edhe për ato të Delfit, disa i përkasin mënyrës e shprehjes poetike, e disa të tjera janë objekt studimi i kësaj vepre. Dodona, pra, në kohët më të vjetra
11 ishte nën sundimin e thesprotëve, ashtu dhe mali Tomar ose Tmar (se të dy emrat përdoren), nën të cilin ndodhet faltorja dhe tragjikët si edhe Pindari e quajnë Dodonën thesprote, më vonë u vu nën pushtetin e molosëve. Edhe ata, që poeti i quan Hypofetë[1] të Zeusit dhe për të cilët thotë se ishin të zbathur dhe flinin përdhe, thuhet se u quajtën tomurë nga Tomari; kështu disa shkruajnë në Odise se Amfinomi, duke i këshilluar dashnorët e Penelopës që të mos i sulen Telemahut para se të pyesnin Zeusin, u thoshte: "Nëqoftëse do të japin pëlqimin tomurët e Zeusit të madh, ai do të vritet, kurse gjithë të tjerët do të shtypen, po nëqoftëse perëndia nuk do t'u lejojë, atëherë ju këshilloj të hiqni dorë". Është më mirë të shkruajmë tomurë se sa themistë, se poeti në asnjë vend nuk i quan themistë orakujt po vetëm mendimet, regjimet dhe ligjët.

Pra autorët më të rinj i quajnë tomurë; kurse Homeri, më drejtë, duhet pranuar se fjala themistë përdoret në kuptim të gjerë për urdhërat dhe vendimet e orakullit si dhe për ligjet. Këtë kuptim ka edhe thënia: "Prej lisit të lartë duhet të dëgjojmë vullnetin e Zeusit".

12 Në fillim ata, që profetizonin ishin burra; ndoshta këtë do ta thotë edhe poeti, i cili i quan hypofetë, duke vënë në një radhë me ta edhe profetët. Por më vonë u zgjodhën tri plaka, mbasi edhe Diona adhurohej bashkë me Zeusin. Por Suida, duke treguar legjenda mbi Thesalinë thotë se faltorja u soll këtu nga Pellazgjia që ndodhet rreth Skotusës (Skotusa është në krahinën Pelasgiotis të Thesalisë) dhe së bashku me faltoren erdhën gra, pasardhëse të të cilave janë profeteshat e sotme; kështu thonë se nga kjo edhe Zeusi u quajt pre Kinesë, pellazgjik.

Fragmente nga Libri VII

1,a Orakulli ishte më përpara afër Skotusë, qytet i krahinës Pellazgiotis. Mbasi lisi u dogj prej dikujt me porosinë e Apollonit, ai /orakulli/ u transferua në Dodonë. Jepte porosi jo me fjalë, por me simbole si orakulli i Amonit në Libi, duke u nisur nga fluturimet e veçanta të tre pëllumbave, sipas të cilave profetët, duke i vështruar, profetizonin. Thonë se plakat, në gjuhën e molosëve dhe të thesprotëve, i quajnë pelia, ndërsa pleqë pelii; ndoshta nuk ishin shpendë peliadet, që përmenden ndër legjendat, por tri gra plaka, të cilat kalonin kohën në faltore.

2 Si tek maqedonasit edhe tek thesprotët e molosët plakat i quanin pelia dhe pleqtë pelii. Pra ata i quajnë peligonë njerëzit e nderuar, ashtu si quajnë tek lakonët dhe masaliotët pleqtë. Prej kësaj, sipas legjendës dhe ato që shërbejnë tek lisi i Dodonës, i quajnë pelia.

3 Sipas gojëdhanës këtej mori emrin dhe "ena prej bakri e Dodonës". Kjo enë prej bakri ishte brenda në faltore dhe kishte mbi vete një shtatore që mbante në dorë një kamzhik prej bakri, dhuratë e korkyrasve. Kamzhiku ishte i trefishtë në formë zinxhiri, i përbërë prej tre vargjesh, të cilat, kur tundeshin prej erërave, goditnin enën prej bakri dhe nxirrnin tinguj të gjatë, sa që ai që numëronte mund të arrinte numrin katërqind, prej kësaj doli dhe thënia "kamzhiku i korkyrasve".

4 Paionia është në lindje të këtyre fiseve[2] dhe në perëndim të maleve thrake; nga

---

[1] Fallxhorë

[2] Me sa duket në pjesën që mungon nga ky fragment, Straboni bën fjalë për fiset ilire fqinje të paionëve.

veriu shtrihet mbi maqedonasit, duke pasur përmes qytetit Gortyn dhe Stobi, hyrjen për në...[1] nëpër të cilat /vise/ rrjedh lumi Aks dhe bën të vështirë hyrjen në Maqedoni nga Paionia, sikurs Penei, duke kaluar përmes ngushticave të Tempeve e mbron Maqedoninë nga Hellada; nga jugu[2] kufizohet me autariatët, dardanët dhe ardianët. Paionia shtrihet deri tek lumi Strymon.

6 Kurse Orestia është e banuar dendur dhe ka kufi të gjera që arrijnë deri në Korak të Etolisë dhe në Parnas. Afër saj banojnë orestët dhe tymfejt, dhe helenët që gjenden jashtë Istmit përreth Parnasit, si dhe në Oita e Pind. Në përgjithësi mali quhet me emrin e përbashkët Boion, ndërsa për pjesët e tij ka shumë emra. Thonë se nga majat e larta shikohet deti Egje, si dhe Ambrakia e Joni; më duket se janë duke folur në mënyrë të tepëruar...

10 Maqedonia kufizohet nga perëndimi me bregdetin e Adrias, nga lindja me vijën paralele me këtë, e cila kalon nëpërmjet derdhjes së lumit Hebrit dhe qytetit Kypsela, ndërsa nga veriu me vijën e drejtë të imagjinuar që kalon nëpërmjet malit Bertisk, Skardit, Orbelit, Rodopit dhe Hemit. Këto male, duke filluar prej Adrias, ndjekin drejtimin qe lindjes deri në Euksin, duke formuar një gadishull të madh në jug të tyre që përfshin Thrakinë, së bashku me Maqedoninë, Epirin dhe Ahenë; nga jugu kufizon me rrugën Egnatia që fillon prej qytetit Dyrrah dhe arrin, në lindje, deri në Thesalonik; dhe është kjo skema e Maqedonisë, që i afrohet një paralelogrami.

11 Maqedonia më përpara quhej Emathia. Emrin e mori nga një udhëheqës i vjetër që quhej Maqedon. Ishte edhe qyteti me emrin Emathia afër detit. Këtë vend e sundonin disa nga fiset epirote dhe ilire, ndërsa pjesën më të madhe – botiejt dhe thrakët. Të parët, siç thonë, janë me prejardhje nga Kreta dhe kishin udhëheqës Boton, ndërsa prej thrakëve pierejt banonin në Pieri dhe në viset rreth Olympit, kurse paionët në viset rreth lumit Aks të quajtura për këtë Amfaksite[3].

12 Ndërsa Penei ndan Maqedoninë e Poshtme dhe atë bregdetare prej Thesalisë e Magnezisë, Haliakmoni ndan Maqedoninë e Sipërme nga epirotët e paionët, sikurse e bëjnë këtë Erigoni, Aksi dhe lumenjtë e tjerë.

20 ... Mbi këtë lum /Aksin/ gjendet një fortifikatë e vetmuar, e cila tani quhet Abydon, ndërsa Homeri e quan Amydon dhe thotë se paionët erdhën që këndej në ndihmë të Trojës. "Larg nga Amydoni prej Aksit të gjerë"; u shkatërrua që nga themelet prej argeasve.

34 ... Dhe vetë mali Pange ka miniera të arit dhe të argjendit, ashtu si kanë miniera të tilla dhe viset më tutje tij si dhe lugina e lumit Strymon deri në Paioni; gjithashtu thuhet se ata që kanë punuar tokën e Paionisë kanë gjetur atje disa copa ari.

36 .. Kur njeriu ecën në drejtim të veriut prej Heraklesë dhe ngushticave nga të cilat kalon Strymoni, duke lënë në të djathtë lumin, nga e majta ka Paioninë dhe viset rreth Doberit, Rodopit dhe malit Hemi.

... Jo vetëm Aksi, por edhe Strymoni i ka burimet në Paioni...

38 Paionët disa i quajnë kolonë frygas, disa të tjerë vendas, ndërsa Paionia thonë se shtrihej deri në Pelagoni dhe Pieri; Pelagonia më përpara quhej Oresti, kurse Asteropeun, njërin prej udhëheqësve paionë, që mori pjesë në luftën kundra Ilionit, jo pa të drejtë e quajnë të birin e Pelagonit, ndërsa vetë paionët i quanin pelagonë.

---

[1] Mungesë në tekst.
[2] Duhet të jetë një gabim që i ka ndodhur ndoshta kopjuesit; fiset e përmendura ndodhen në veri të Paionisë.
[3] D.m.th. në të dy anët e lumit Aks.

39 Tek Homeri, Asteropeu përmendet si djalë i Pelegonit, nga Paionia e Maqedonisë; prandaj dhe quhej djali i Pelegonit, ndërsa paionët quheshin pelagonë.

41 ... Sikurse më parë edhe tani duket se paionët zënë një pjesë të madhe të Maqedonisë së sotme, sundonin Perinthin, Krestoninë, gjithë Mygdoninë si dhe vendin e agrianëve deri në malin Pange...

48 ... Pauli, pra, i cili mundi Perseun, mbasi bashkoi me Maqedoninë edhe fiset epirote, e ndau vendin në katër pjesë, njërën ia dha Amfipolit, tjetrën Thesalonikut, të tretën Pelas dhe të fundit pelagonëve.

57 ... Gjatësia e përgjithshme që nga gjiri i Jonit, afër Apollonisë, e deri në Byzant është rreth shtatë mijë e treqind e njëzet stade. Polibi shton edhe njëqind e tetëdhjetë të tjera.

LIBRI VIII

1 **1** ... Tregimi ynë mbaron, përsa i përket anës perëndimore dhe veriore, me fiset epirote dhe ilire, ndërsa nga ana lindore me fiset maqedonase deri në Byzant. Pas epirotëve dhe ilirëve prej helenëve janë akarnanët, etolët, lokridasit dhe ozolët...

3 Efori totë se fillimi i Helladës është Akarnania nga ana e perëndimit, sepse kjo takon e para me fiset epirote.

32 **3** ... Këtu /pranë Arpinës/ gjendet Kikysi, një nga të tetët dhe Dysponti,në rrugën e cila të shpie që nga Ilida në Olympia që ndodhet në fushë; u braktis dhe më të shumtët /e banorëve/ ngritën ankorat /e shkuan/ në Epidamn e Apolloni.

18 **6** ... Argasit nuk e pranuan Pirron (por ai, siç duket, u vra para murit se një plakë i lëshoi nga sipër mbi kokë një tjegull).

1 **7** ... Kur Pirrua filloi ekspeditën në Itali, me të u bashkuan katër qytete, ndërmjet të cilave ishin Patra dhe Dyme. Pastaj u përfshinë edhe disa nga të dymbëdhjetët përveç Olenës dhe Helikës, nga të cilët i pari nuk u bashkua, ndërsa i dyti u zhduk prej dallgëve.

LIBRI IX

11 **4** ... Atamanët janë të fundit nga epirotët që morën famë; tani të tjerët nuk përmenden; ata me mbretin Amynander u bënë të fuqishëm; këta zotëronin Oitën...

1 **5** ... Nga të dy anët që prej Pelit dhe Peneit në drejtim të viseve të brendshme janë maqedonasit, që shtrihen deri në Paioni, dhe fiset epirote...

Faqja e malit nga Maqedonia duhet quajtur veriore, ndërsa ana e kundërt jugore. Pjesa tjetër është ajo perëndimore, të cilën etolët, akarnanët dhe amfilohët dhe prej epirotëve atamanët dhe molosët, si dhe toka e quajtur dikur e etikëve, e gjithë rreth Pindit...[1] me përjashtim të Pelit dhe Oses...

11 Përsa i përket shtrirjes territoriale dhe vendeve të sunduara prej thesalëve dhe maqedonasve, ata që gjendeshin pranë tyre, veçanërisht disa fise epirote me dashje ose pa dashje ishin nën sundimin e thesalëve ose të maqedonasve, si p.sh. atamanët, ethikët dhe talarët nën thesalët, ndërsa orestët, pelagonët dhe elimiotët nën maqedonasit.

---

[1] Mungesë në tekst.

12 Pindi është mal i madh, nga veriu ka Maqedoninë nga perëndimi perrebejt, njerëz nomadë, nga jugu dolopët, ndërsa nga lindja...[1] ajo është e Thesalisë. Mbi vetë Pindin banonin talarët, fis molos, një pjesë prej atyre të Tomarit dhe etikët tek të cilët poeti thotë se u shpunë kentaurët prej Peirithit.

LIBRI X

16 **1** Afër thesalëve dhe oitëve nga perëndimi janë etolët, akarnanët dhe atamanët, nëqoftëse duhe t 'i quajmë dhe këta helenë. Këtej e tutje do të japim spjegime për këta për ta pasur të plotë udhëtimin mbi Helladën.

1 **2** ... Në brendësi dhe në pjesën veriore mbi akarnanët gjenden amfilohët, mbi këta dolopët dhe Pindi, ndërsa mbi etolët perrebejt dhe atamanët...

10 Me fjalën Epir /Homeri/ nënkupton vendet përkarshi ishujve, duke dashur të përfshijë pas Leukadës edhe Akarnaninë tjetër, për të cilën thotë kështu: "Dymbëdhjetë kope në Epir, kaq shumë dhen kullosin". Ndoshta në kohë të lashta toka epirote shtrihej deri këtu dhe quhej me emrin e zakonshëm të Epirit.

[1] Mungesë në tekst.

DIONISI I HALIKARNASIT

Dijetar grek nga Halikarnasi i Karisë. U vendos dhe jetoi në Romë në kohën e Augustit. Në vitet e fundit para e. sonë shkroi veprën "Romaiki arheologia" lat: Antiquitatum Romanarum, (Historia e vjetër e Romës) në 20 libra. Historia e Dionisit fillon nga kohët më të lashta dhe arrin deri në luftën e parë punike (viti 264 para e. sonë). Duke dashur të plotësojë Polibin për periudhën më të lashtë ai nukbia arrin atij as nga metoda e gjurmimit, as nga fuqia e mendimit. Vepra e tij me karakter retorik është e përciptë dhe me shumë pasaktësira. Nga kjo vepër janë ruajtur të plota vetëm 10 librat e para, i njëmbëdhjeti – me shumë boshllëqe, kurse prej të tjerave kemi vetëm disa pjesë të shkëputura. Nga Dionisi kemi edhe shkrime me karakter retoriko-letrar të titulluara "Opuscula".

Në historinë e Dionisit gjejmë disa të dhëna me interes për pellazgët dhe fushatën e Pirros në Itali.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Dionysi Halicarnassensis Antiquitatum Romanarum edidit Carolus Jacoby. Vol. I-IV. Lipsiae in aedibus B.G.Teubneri 1858-1905.

DIONYSI HALICARNASSENSIS ANTIQUITATUM ROMANARUM

(Historia e vjetër e Romës)

LIBRI I

1 **17** Pastaj disa nga pellazgët, që banonin në të quajturën tani Thesali, të detyruar të lënë vendin e tyre u vendosën pranë aborigëve dhe së bashku me këta luftonin kundër sikeliotëve. Aborigët i pranuan ata, ndoshta, me shpresë se do të përfitonin
2 prej tyre, por simbas mendimit tim i pranuan më tepër se ishin të afërt. Edhe raca e lashtë e pellazgëve ishte helene nga Peloponezi; në fillim banonin pranë qytetit të quajtur tani Argo i Ahesë dhe ishin autoktonë, siç thonë shumica /e shkrimtarëve/; ata kanë qenë të pafat në shumë gjëra, veçanërisht për jetën endacake dhe për mungesën e një vendbanimi të qëndrueshëm. Kurse emrin e morën që në fillim prej
3 mbretit Pellazg. Siç thuhet, Pellazgu ishte i biri i Zeusit dhe Niobës së Foronit, që është gruaja e parë e vdekshme, me të cilën, sipas legjendës, Zeusi u martua. Më vonë, në brezin e gjashtë, ata /pellazgët/ lanë Peloponezin dhe emigruan në Hajmoni, që sot quhet Thesali. Në krye të kolonisë ishin Ftiu dhe Pellazgu, të bijtë e Larisës dhe Poseidonit. Si mbërritën në Hajmoni dëbuan barbarët që banonin aty dhe e ndanë vendin në tri pjesë, duke e quajtur çdo pjesë me emrin e sunduesit: Ftioti, Ahe dhe Pellazgi. Këtu qëndruan për pesë breza, gjatë të cilëve kaluan në lumturi të plotë, duke shijuar të mirat e të mirave të fushave thesale; në brezin e gjashtë u dëbuan nga Thesalia prej kuretëve dhe lelegëve, të cilët tani quhe etolë dhe lokridas si dhe shumë të tjerë, që banonin rreth Parnasit; armiqtë udhëhiqeshin nga Deukalioni i Prometeut dhe Klymenës së Oqeanit.

1 **18** Duke u shpërndarë gjatë ikjes, një pjesë e pellazgëve shkuan në Kretë, të tjerë pushtuan disa nga ishujt Kyklade një pjesë zunë vend rreth Olympit dhe Osës, në krahinën e quajtur Hestioti, të tjerët shkuan në Beoti, Fokidë dhe Eube; kurse ata që u hodhën në Azi zunë shumë vende në brigjet e Helespontit dhe në ishujt pranë,
2 midis të tjerëve dhe në ishullin që tani quhet Lesbo, ku së bashku me ata të Helladës dërguan kolonët e parë të udhëhequr nga Makar Kriasi. Pjesa e tyre më e madhe, duke kaluar Mesdheun, shkoi tek të afërmit e tyre që banonin në Dodonë, kundër të cilëve askush nuk mendonte të bënte luftë se ishin të shenjtë; këtu qëndruan pak kohë, sepse të mërzitur nga që toka nuk ishte në gjendje t'i ushqente të gjithë, e lanë këtë vend duke iu bindur porosisë së orakullit, që të lundronin në Itali, e cila në atë
3 kohë quhej Satornia. Si ndërtuan shumë anije, kaluan Jonin, duke u nxituar që të arrinin bregun më të afërt të Italisë, por nga që nuk e njihnin vendin dhe nga era e

jugut që i shoqëroi u endën nëpër det dhe arritën në një nga grykat e lumit Pad, që
4 quhej Spine; atje ata lanë anijet dhe filluan të mundojnë turmën e pafuqishme, duke
vënë roje mbi ta. Ata që qëndruan në këtë vend, rrethuan lëmin me mur dhe me anë
të anijeve sollën bollëkun për jetesë. Meqenëse u duhej vend për të siguruar
materialet, ndërtuan një qytet me emrin e grykës së lumit; më tepër u bënë të pasur
ata që banonin në brigjet e Jonit, se për një kohë të gjatë ishin sundues të detit dhe i
çonin perëndisë në Delf dhuratat më të mira, si të dhjetë nga fitimet që kishin prej
5 detit. Por më vonë e lanë qytetin, pasi u sulmuan me forca të mëdha nga barbarët
fqinjë, kurse barbarët pas ca kohe u shpërndanë prej romakëve. Kështu u shkatërrua
ai fis i pellazgëve që u vendos në Spine.

1 **19** Ata që kaluan Mesdheun, si kapërcyen pjesën malore të Italisë, arritën në
vendin e ombërve, që janë fqinjë me aborigët. Ombrët banonin edhe në vise të tjera
të Italisë, dhe ishte ky fis nga më të mëdhenjtë dhe më të lashtët. Pra në fillim
pellazgët pushtuan disa nga viset e ombërve, ku ndërtuan dhe qytete të vegjël, të
fortifikuar; por të trembur nga ushtria e madhe armike, që erdhi kundër tyre, ikën
këtej dhe shkuan në vendin e aborigëve...

1 **20** Pellazgët erdhën tek aborigët me një ushtri të madhe të paarmatosur, dhe
duke u treguar atyre fatin u kërkuan që t'u lëshonin vend edhe u lutën që t'i pranonin
si miq, duke u premtuar se nuk do t'i shqetësonin, mbasi dhe perëndia simbas
2 orakullit, i kishte porositur që të vinin këtu... Aborigët bënë marrëveshje me
pellazgët dhe u dhanë atyre tokat përreth Liqenit të Shenjtë, shumica e të cilave ishin
moçale, dhe që tani, sipas dialektit të vjetër quhen Uelia...

... Pellazgët së bashku me aborigët banonin në shumë qytete, që ishin banuar
5 më parë prej sikeliotëve si dhe në qytetet, që i kishin ndërtuar ata vetë; ndërmjet
qyteteve janë ai i keretanëve që atëherë quhej Agylla, Pisa, Satornia, Alsi, si dhe disa
të tjera, të cilat u qenë marrë tyrrenëve.

1 **23** Pellazgët sunduan në një vend të gjerë dhe të pasur, pushtuan shumë qytete
dhe ndërtuan të tjera vetë. Ata patën, brenda një kohe të shkurtër një shtesë të madhe
në burra trima, në pasuri dhe në begati. Por kur të gjitha dukeshin se po lulëzonin u
goditën nga zemërimi i disa perëndive; një pjesë prej tyre u shkatërruan nga të
këqijat hyjnore, pjesa më e madhe u shpërnda në Helladë dhe në tokën barbare (rreth
të cilëve duhet folur shumë, nëqoftëse dëshiroj të shkruaj me saktësi), kurse një pjesë
e vogël e tyre me kujdesin e aborigëve mbeti në Itai...

24 ... Pra ata *[prej pellazgëve]* që emigruan të parët nga Italia, u endën në
4 pjesën më të madhe të Helladës dhe në tokën barbare. Pas të parëve dhe të tjerët po
të njëjtën gjë pësuan, dhe kjo ndodhte çdo vit...

25 Vetë tyrrenët quheshin prej njerëzve të tjerë dhe pellazgë si nga emri i vendit
2 nga i cili u larguan, si dhe për kujtim të fisit të vjetër. Unë e përmend këtë me qëllim
që të mos çuditet ndokush, kur të dëgjojë që poetët dhe shkrimtarët i quajnë
pellazgët edhe tyrrenë, mbasi ata i kishin të dy këta emra. Këtë e përmend qartë dhe
Tukididi, që thotë se në bregdetin e Thrakisë dhe në qytetet që ndodhen aty, banojnë
3 njerëz që flasin dy gjuhë.

26 Koha, në të cilën filluan të shkatërrohen pellazgët është afërsisht brezi i dytë
1 pas luftërave trojane dhe vazhdoi edhe mbas këtyre luftërave derisa fisi i pellazgëve
u pakësua fare. Me përjashtim të qytetit të rëndësishëm Kroton, që gjendej në vendin
e ombërve si dhe ndonjë vendbanim tjetër në vendin e aborigëve, qytetet e tjera të
pellazgëve u shkatërruan...

3 **28** ... Hellaniku prej Lesbos thotë se tyrrenët më përpara quheshin pellazgë dhe meqenëse banonin në Itali morën emrin që kanë tani. Sipas tij Foronidi thuhet se prej Pellazgut, mbretit të tyre dhe Menipës, së bijës së Peneut, lindi Frastori, prej këtij Amyntori, prej Amyntorit Teutamidi dhe prej këtij Nani. Në kohën e këtij pellazgët u dëbuan prej helenëve dhe si lanë anijet e tyre në lumin Spine, në gjirin e Jonit, pushtuan në viset e brendshme Krotonin dhe duke u nisur prej këndej ndërtuan
4 qytetin që tani quhet Tyrsena. Myrsili, në kundërshtim me Hellanikun, thotë se tyrrenët gabimisht morën emrin pelargë. Kjo ndodhi se ata lanë vendin e tyre dhe, si shpendët pelargi[1] silleshin poshtë e lart në Helladë dhe në tokën barbare; dhe muri rrethues i akropolit të Athinës që quhet pellazgjik, u përket këtyre.

1 **29** Por mua më duket se të gjithë ata që besojnë se tyrrenët dhe pellazgët janë po i njëjti popull, gabojnë. Sa për çështjen se dikur që të dy kanë patur të njëjtin emër, kjo nuk është aspak për t'u çuditur, mbasi kjo ka ndodhur dhe me disa fise të tjera greke e barbare, pikërisht kështu ka ndodhur ndërmjet fisit të trojanëve dhe atij të frygëve që banonin afër njëri-tjetrit. Kjo ka ndodhur dhe me fise të tjera në Itali. Ka qenë një kohë që latinët, ombrët dhe ausonët si dhe shumë të tjerë quheshin prej helenëve tyrrenë; kjo ndodh për shkak të banimit të gjatë të fiseve në të njëjtin vend. Gjithashtu shumë prej shkrimtarëve edhe vetë Romën e kanë quajtur qytet tyrren. Pra, unë bindem për ndryshimin e emrave të poujve, por nuk bindem që ata të jenë një fis bashkë me të tjerët, veçanërisht për gjuhët e ndryshme që kanë dhe që nuk ruajnë asnjë ngjashmëri njëra me tjetrën.

1 **30** Duke përdorur këtë si argument (mosngjashmërinë e gjuhëve), jam i bindur se pellazgët nuk janë tyrrenët.
5 ... Pra, ajo pjesë prej fisit të pellazgëve, që nuk u shkatërrua, por u shpërnda nëpër kolonitë, mbeti për një kohë dhe duke sunduar së basku me aborigët u përfshi në viset e këtyre, ku me kalimin e kohës nipërit e tyre bashkë me të tjerët ndërtuan qytetin e Romës. Këto janë legjendat rreth fisit të pellazgëve...

LIBRI II

3 **1** Në vendet që i kishin më parë aborigët u vendosën dhe bashkëjetuan me ta edhe pellazgët, një popull endacak që erdhën nga krahina e quajtur dikur Hajmoni, kurse tani Thesali, ku ata kanë banuar një herë e një kohë.

1 **51** Anhisi me anijet, u nis nga Ambrakia dhe duke lundruar pranë bregdetit, arriti në Buthrot, liman i Epirit. Enea, në anë tjetër, me ushtarët më të zgjedhur, pas një udhëtimi që mbajti dy ditë, arriti në Dodonë, me qëllim që të kërkonin mendimin e perëndisë; këtu gjetën edhe ata trojanë që kishin ikur bashkë me Helenin. Si morën përgjigjen hyjnore mbi punën e kolonisë, i dhuruan zotit, bashkë me dhuratat e tjera trojane edhe kratere bakri, disa nga të cilat ndodhen edhe sot akoma me mbishkrime shumë të vjetra, që tregojnë emrat e dhuruesve; së këtejmi pastaj arritën te anijet pas një udhëtimi që zgjati më se katër ditë. Ardhjen e trojanëve në Buthrot e tregon edhe një kodër e quajtur Troja, të cilën ata e përdorën atëherë për të ngritur lëmin. Prej
2 Buthrotit, duke ndjekur anën e detit ata arritën deri tek limani që atëherë quhej Anhisi e që sot ka një emër më të paqartë[2]; prej këtej, pasi ndërtuan faltoren për nder të Afroditës, çanë detin Jon...

---

[1] Lejlekët.
[2] Me sa duket është fjala për limanin Onkesm, që gjendej aty ku është Saranda e sotme.

2 **72** ... Thonë se Enea i ardhur nga Molosia në Itali ndërtoi bashkë me Odisenë qytetin, të cilën e quajti Romë me emrin e njerës prej Iliadave...

EXCERPTA

LIBRI XIX

1 **9** Mbreti i epirotëve Pirrua, biri i mbretit Aiakid, i dërgon përshëndetje konsullit të Romës, Publël Valerit[1]: Është e natyrshme që ti të kesh marrë vesh nga të tjerët, se unë po vij me ushtri, për t'u ndihmuar tarantasve dhe italikëve të tjerë që kërkuan ndihmën time; gjithashtu është e natyrshme të mos lësh në harresë edhe se nga ç'burra e kam prejardhjen time, me çfarë veprash unë vetë e kam vërtetuar këtë dhe sa fuqi të madhe dhe trime për luftë po sjell me vete.

2 Mendoj se ti do t'i marrësh këto parasysh dhe nuk do të presësh të provosh në praktikë trimërinë tonë në luftë, po do të heqësh dorë nga armët e do të pëlqesh zgjidhjen e çështjes me anë të bisedimeve. Prandaj të këshilloj që grindjet, të cilat keni ju romakët me tarantasit, me lukanët ose me saunitët, të m'i ngarkoni mua t'i zgjidh, e do t'i zgjidh si një gjyqtar plotësisht i drejtë, në mënyrë që edhe miqtë e mi, në se kanë bërë dëme, do t'i detyroj të paguajnë gjithë dëmet, që unë do të vendos.

3 Dhe ju do të bëni mirë sikur të emëroni njerëz të cilët të më sigurojnë se vendimet e mia do t'i respektoni plotësisht. Nëqoftëse do t'i bëni këto, ju zotohem se do t'ju siguroj paqën dhe se do të jem mik i juaj e do t'ju ndihmoj me gadishmëri në çdo luftë që do të më thërrisni për ndihmë, po në rast se nuk i bëni këto, po të them se s'do të lejoj të shkatërroni vendin e aleatëve të mi, as të grabitni e të shkretoni qytetet helene[2] dhe të robëroni njerëz të lirë; po do t'ju ndaloj me armë në mënyrë që të pushoni këndej e tutje së plaçkituri e së shkretuari Italinë dhe së kënaquri duke i kthyer e duke i përdorur të gjithë njerëzit si skllevër. Do të pres përgjigjen tënde gjersa të kalojnë dhjetë ditë, më tepër s'mund të pres.

EXCERPTA

LIBRI XX

1 **1** Si caktuan me anë kasnecësh kohën kur do të luftonin, po dilnin nga lëmet dhe po rreshtoheshin në këtë mënyrë: mbreti Pirro rreshtoi falangën e parë maqedonase në krahun e djathtë dhe pas kësaj vuri italikët mercenarë nga Taranti; pastaj vuri ata

2 nga Ambrakia, pas këtyre falangën e Tarantit me mburoje të bardha dhe më pas aleatët bretë dhe leukanë. Në mes të falangës vuri thesprotët e kaonët, dhe në vazhdim me këta, mercenarët etolë, akarnanë e atamanë, në fund vuri saunitët, të

3 cilët plotësuan, krahun e majtë. Sa për kalorësinë e rreshtoi kështu: kalorësinë saunite, thesalike, brete dhe mercenarët e Tarantit i vendosi në krahun e djathtë, ata nga Ambrakia, Leukania, nga Taranti dhe kalorësinë e mercenarëve helenë, të cilën e përbënin akarnanë, etolë, maqedonas e atamanë, e rreshtoi në krahun e majtë.

4 Ushtarët me armatim të lehtë si dhe elefantët i ndau më dysh dhe i vuri prapa të dy krahëve, në një largësi simetrike mbi një vend pak të ngritur mbi fushë. Ai vetë me një forcë prej afro dy mijë kalorësish, që ishin të zgjedhur e që quheshin ushtria mbretërore, qëndroi

---

[1] Letër e Pirros.

[2] Është fjala për kolonitë greke të Italisë.

jashtë rreshtave, me qëllim që të sulej menjëherë për ndihmë, atje ku do të shfaqej rreziku.

Nga ana tjetër, konsujt e Romës e rreshtuan ushtrinë e tyre kështu: Në krahun e majtë vunë legjionin e parë kundrejt falangës së Maqedonisë e të Ambrakisë, si edhe kundrejt mercenarëve tarantas. Pas legjionit të parë vinte legjioni i tretë përballë
2* vendit ku ishte rreshtuar falanga tarantase me mburojet e bardha dhe ushtria aleate e bretëve dhe e leukanëvet. Ngjitur me legjionin e tretë, vunë legjionin e katërt, kundrejt vendit ku ishin rreshtuar molosët, kaonët e thesprotët, kurse legjionin e dytë e vunë në krahun e djathtë kundrejt mercenarëve nga Hellada (etolë, akarnanë dhe atamanë) dhe kundrejt falangës së saunitëve me mburoje të gjata. Latinët pastaj, kampanët, sabinët, ombrët, volskët, marunginët, pelignët, frentanët e të nënshtruarit e tjerë i ndanë në katër pjesë dhe i vunë ndërmjet legjioneve romake, me qëllim që të
3 mos mbetej e dobët ndonjë pjesë e ushtrisë së tyre. Kalorësinë, si të tyren si edhe atë të aleatëve të tyre, e ndanë më dysh dhe e vunë në të dy krahët; më në fund, ushtarët me armatim të lehtë i lanë jashtë rreshtave bashkë me treqind karrocat, të cilat i kishin përgatitur për t'i përdorur në luftën kundër elefantëve...

5 Ky ka qenë rreshtimi i të dy ushtrive kundërshtare. Ushtria e mbretit përbëhej nga shtatëdhjetë mijë këmbësorë, ndër të cilët helenë, që kaluan bashkë detin Jon ishin gjashtë mijë mbi çdo dhjetë mijë. Ushtria romake kishte më shumë se shtatëdhjetë mijë, nga Roma brenda ishin afro njëzet mijë. Kalorësia e romakëve përfshinte rreth tetë mijë vetë dhe ajo e Pirros pak më shumë; ky i fundit kishte edhe nëntëmbëdhjetë elefantë.

1 **2** Si u dhanë shenjat e betejës, ushtarët duke kënduar pajanin dhe duke bërtitur për nder të Enyalit, po marshonin të pashpërndarë dhe si u përleshën, po luftonin duke treguar secili gjithë artin e vet ushtarak. Kështu, kalorësit që ishin rreshtuar në të dy krahët, përdornin ato mënyra taktike luftarake, në të cilat e dinin se ua kalonin armiqve. Për shembull, kalorësit romakë përdornin luftimet së afërmi dhe ato me qëndrim në vend, kurse kalorësia helene përdorte rrethimet me manovrimin, prandaj
2 romakët sa herë ndiqeshin prej helenëve i kthenin kuajt, i ndalonin, zbrisnin në tokë dhe luftonin si këmbësorë; kurse helenët, sa herë shikonin se romakët po rreshtoheshin përballë tyre për luftë, i kthenin kuajt nga e djathta dhe, si largoheshin në varg njëri pas tjetrit, ktheheshin përsëri dhe rrethonin radhët e kundërshtarit me kuajt, dhe kështu sulmonin të bashkuar duke goditur përballë dhe në qendër.

3 E tillë, pra, ka qenë pak a shumë lufta e kalorësve, kurse lufta e këmbësorëve pjesërisht i ngjante së parës, pjesërisht ndryshonte nga ajo; i ngjante në tërësi dhe ndryshonte në hollësirat. Kështu, krahu i djathtë i të dy ushtrive ishte më i fortë, kurse i majti më i dobët. Por megjithëkëtë as njëra, as tjetra palë nuk ua kthente kurrizin kundërshtarëve pa rregull, por përkundrazi që të dy palët zmbrapseshin në mënyrë të rregullt, duke qëndruar pranë flamujve dhe duke mbrojtur pozitat e tyre.

4 Nga ushtria e mbretit u shquan maqedonasit – se këta ishin të parët që e gozhduan ushtrinë e romakëve dhe latinëve të rreshtuar bashkë me ta, kurse nga ushtria romake, ata të legjionit të dytë që ishte rreshtuar kundër molosëve, thesprotëve dhe kaonëve. Kur mbreti urdhëroi që t'i shpien elefantët në pjesën e lodhur të ushtrisë, romakët, që kishin hipur në karrocat luftarake me sqep, si vunë re sulmin e egërsirave, u lëshuan të gjithë së bashku. Këta në fillim e ndaluan vrullin e egërsirave, duke i goditur me makinat luftarake dhe duke ua prishur sytë me zjarre

* Në numërimin e paragrafeve të këtij kapitulli, me sa duket, ka një ngatërresë në botimin që kemi përdorur, megjithatë ne nuk po i ndryshojmë.

që u hidhnin përpara. Po pastaj ata që kishin hipur në pyrgjet e ndërtuara mbi kurrizin e egërsirave nuk i ngisnin më këta /elefantët/ përpara po, që sipër, u binin me shtiza atyre të karrocave, ndërsa të armatosurit lehtë i prisnin dhe i shkatërronin mburojat që kishin përqark karrocat, duke goditur njëkohësisht qetë me fshikull prej zorrësh; nga ky shkak ata që ishin mbi karrocat luftarake zbritnin në tokë, shkonin me vrap tek ushtarët këmbësorë më të afërmit dhe përziheshin me këta duke shkaktuar kështu një rrëmujë të madhe. Leukanët dhe bretët, që ishin rreshtuar në mes të falangës mbretërore, pasi luftuan për një kohë jo të gjatë, u gozhduan dhe më në fund u vunë në ikje prej legjionit të katërt të romakëve. Posa u përkulën këta dhe u ça falanga në këtë pjesë, s'qëndronin dot as tarantasit, që ishin rreshtuar pranë tyre, po u thyen dhe ikën edhe këta.

1 **3** Mbreti Pirro, kur u njoftua se leukanët, bretët dhe tarantasit ikën duke ia mbathur këmbëve dhe se falanga u dëmtua në këtë krah të mbajtur prej tyre, u dha komandantëve të tjerë një pjesë të repartit, që kishte me vete, gjithashtu hoqi, aq sa ishte nevoja, kalorës të tjerë nga krahu i djathtë dhe i dërgoi në ndihmë të atyre që
2 ndiqeshin prej romakëve. Disa nga daunët prej qytetit Argyrip, të cilin sot e quajnë Arpa, u dërguan në ndihmë të konsujve; këta ishin katër mijë këmbësorë dhe rreth katërqind kalorës. Duke marrë rrugën që kalonte në shpinë të armiqve, ata arritën tek një lartësi afër lëmit mbretëror; si panë fushën plot me njerëz, qëndruan pak kohë këtu dhe si bënë gjithëfarë arsyetimesh hoqën dorë nga mendimi për të zbritur nga lartësitë dhe për të filluar betejën, mbasi panë se nuk kishte mundësi të dallohej miku nga armiku, as edhe në vendin ku ndodheshin nuk do të kishin ndonjë përfitim për forcat e tyre; kujtuan prandaj se do të ishte më mirë të qëndronin rreth lëmit të armiqve mbasi, si t'i dëbonin ata prej këndej do të kishin përfitime të shumta dhe të mira, nëqoftëse do të kapnin pajisjet dhe të shkaktonin rrëmujë të madhe në radhët e armiqve, kur këta të shikonin të digjesh gardhi përreth lëmit, i cili ishte larg nga
3 fusha e betejës vetëm njëzet stade. Kështu, të njoftuar nga disa robër, të cilët i kapën, kur kishin ardhur për të prerë dru, se gardhin e lëmit e ruajnë shumë pak, vendosën ta sulmojnë lëmin nga të gjitha anët. Pirrua i mori vesh këto nga një kalorës, i cili sapo filloi rrethimi i lëmit kishte çarë rrethimin dhe duke luftuar kishte arritur tek ai. Pirrua me shpejtësi dërgoi në ndihmë të gardhit të lëmit elefantët dhe nga kalorësit
4 ata që ishin më të guximshmit, kurse forcat e tjera që ishin në fushë mendoi që të mos i tërhiqte, as të lëvizte falangën. Kur ata ishin në rrugë gardhi i lëmit ishte pushtuar dhe papritur i ishte vënë zjarri. Dhe ata që kryen aktin, siç u mësua nga të deleguarit e mbretit, që kishin zbritur nga lartësirat, ikën në majën e një mali, mbi të
5 cilën nuk ishte e lehtë të ngjiteshin as egërsirat, as kuajt. Ata të mbretit, meqenëse vonuan të shkojnë në ndihmë, u drejtuan kundër legjionit të tretë dhe të katërt romak, që kishte përparuar më shumë se të tjerët dhe filluan t'i sulmonin. Romakët që e kishin parashikuar këtë sulm shkuan në një vend të lartë dhe të pyllëzuar shumë
6 dhe u rreshtuan për luftim. Pra elefantët, meqenëse nuk mundnin t'i ngjiteshin kodrës nuk i dëmtonin ata aspak, gjithashtu nuk mund të ngjiteshin dhe njësitë e kalorësisë. Kurse shigjetarët dhe hobetarët, duke i goditur nga të gjitha anët, zbmrapnin dhe vrisnin shumë nga ata. Kur i morën vesh komandantët se ç'po ndodhte atje, Pirrua dërgoi nga falanga e parzmorëve atamanët dhe akarnanët si dhe disa prej saunitëve, kurse konsulli romak dërgoi disa njësi kalorësish, sepse për këto kishte nevojë në luftën kundër këmbësorëve. Dhe në këtë kohë atje u zhvillua prapë një betejë këmbësorësh e kalorësish ku u vranë shumë.

7 Si filloi të largohet mbreti, edhe konsujt romakë, me perëndimin e diellit, i tërhoqën forcat e tyre dhe si kaluan lumin, arritën te gardhi i lëmit në të ngrysur, kurse ushtarët e Pirros humbën çadrat, kafshët e transportit, dhe robërit e gjithë pajisejt i lanë në një kodër; atë natë e kaluan jashtë pa pajisje, pa mbrojtje, pa ushqimin e nevojshëm, dhe si rezultat vdiqën shumë të plagosur, të cilët mund të kishin shpëtuar nëqoftëse do të ndihmoheshin dhe do të tregohej kujdes për ta. Ky ishte përfundimi i betejës së dytë të romakëve kundër Pirros, pranë qytetit Askul.

4 **4** ... Kur morën vesh se Pirrua kishte kaluar detin, dërguan tek ai në mënyrë të fshehtë më të shquarit e regionasve, të cilët i premtuan se do të thernin rojen
5 [romake] dhe do t'i dorëzonin atij qytetin. Në kohën kur po i thuheshin këto, arriti një spiun, i ndotur siç ishte nga rruga, që sillte letra të shkruara nga vetë Deci, sikur të ishin të shkruara nga ndonjë miku i tij në këto letra kërkohej që mbreti të dërgonte në Region pesëqind ushtarë për të pushtuar qytetin, dhe se regionasit u kishin
6 premtuar se do t'u hapnin portat. Disa thonë se letërprurësi u dërgua me nxitim nga konsulli Fabrici, kurse letra kishte atë përmbajtje, të cilën e përmendëm pak më përpara.

1 **8** Pirrua u kthye për të dytën herë në Itali se punët e tij nuk shkonin mbarë në Siqeli, sepse sundimi i tij mbi qytetet më të përmendura nuk qe mbretëror, por despotik. Si hyri në Syrakuzë me ndihmën e sundimtarit të atëhershëm të qytetit, Sosistratit, si dhe të komandantit të garnizonit, Toinonit, si mori prej tyre pare dhe dyqind anije të pajisura në kiç me kryedash dhe bëri për vete krejt Siqelinë përveç qytetit Lilibe, të vetmin që mbanin kartagasit, kaloi në veprime tiranike e arbitrare.

Pasuritë që mori nga farefisi dhe miqtë e Agathokliut, ia fali miqve të tij, ofiqet më të larta i ndau ndërmjet ndihmësve dhe komandantëve dhe filloi të qeveriste jo
2 sipas ligjeve të çdo qyteti, as sipas zakonit, por ashtu si i dukej atij më mirë, gjyqet dhe grindjet si dhe çështjet e tjera politike dhe ekonomike disa i rregullonte vetë, të tjerat ia ngarkonte t'i zgjidhnin njerëzve të oborrit, të cilët nuk shikonin gjë tjetër
3 veçse të fitonin dhe të grumbullonin pasuri. Për të gjitha këto u bë i mërzitshëm dhe i urryer nga qytetet që e pranuan. Duke dyshuar shumë për njerëzit që kishte rreth vetes, vendosi roje nëpër qytetet, me pretekst që t'i mbronte nga kartagasit; gjithashtu me komplote dhe tradhëti arrestoi dhe vrau burrat më të shquar të
4 qyteteve. Ndërmjet tyre ishte dhe Thoinoni, komandanti i garnizonit, i cili, siç provohet prej të gjithëve, ka treguar kujdes, dhe vullnet të madh në pushtimin e ishullit nga ana e Pirros. U përpoq të arrestonte edhe Sositratin, por ai e kuptoi komplotin dhe iku nga qyteti. Meqenëse gjendja filloi të trubullohej, qyteti i kartagasve duke kujtuar se gjeti kohën e përshtatshme për të ripushtuar viset e humbura, dërgoi ushtri në ishull.

1 **9** Miqtë më të këqij dhe më të pandershëm të Pirros, Evegori, i biri i Theodorit, Balakri, i biri i Nikandrit, dhe Deinarhu, i biri i Nikisë, pasonjës të dogmave ateiste dhe jo të shenjta, duke parë Pirron në gjendje të vështirë dhe pa të holla, i këshilluan atij të hapi thesaret e shënjta të Persefonës. Gjendej në këtë qytet një tempull i shenjtë, që kishte prej kohësh në ruajtje shumë flori. I gënjyer prej këtyre lajkatarëve dhe nga nevoja e madhe që kishte, i përdori këta për vjedhjen e arit, të cilin bashkë me të hollat e tjera e çoi në Tarant me anije; nga kjo ai u kënaq shumë.

Kurse drejtësia hyjnore tregoi forcën e saj. Sapo anijet u larguan nga limani, filloi një stuhi e madhe dhe duke vazhduar tërë natën, disa prej tyre i mbyti, të tjerat i shtyu në gjirin e Siqelisë kurse ato anije, me të cilat transportoheshin ari dhe dhuratat

e marrura prej tempullit, i përplasi në brigjet e lokridasve. Ata që lundronin në këto anije i mbyti në valët e baticës; kurse thesaret e shenjta, mbas shkatërrimit të anijeve
2 i nxori në ranishtet e lokrëve. Mbreti i trembur nga kjo, ia ktheu gjithë dhuratat dhe thesarin perëndeshës, duke iu lutur që ta zbuste këtë zemërim...

1 **10** Pirrua dështoi me romakët, jo sepse kishte një ushtri të keqe dhe të pastërvitur mirë, përkundrazi ushtria e tij ishte më e mira nga të gjitha ushtritë e atëhershme të helenëve, dhe kishte bërë shumë luftëra; as nga numri i vogël i burrave që bënin pjesë në këtë ushtri, mbasi ka qenë tri herë më e madhe se ajo e romakëve, as Pirrua nuk ka qenë ndonjë komandant i zakonshëm, përkundrazi siç e pranojnë të gjithë, ai ishte më i famshmi ndër ata që u dalluan në atë kohë; as natyra e vendit ishte e pabarabartë, as ndonjë ndihmë e papritur nuk iu erdhi kundërshtarëve
2 të tij, as edhe ndonjë katastrofë ose ndodhinë e papritur nuk ra dhe i prishi punët e Pirros, por ky e pësoi nga zemërimi i perëndeshës që kishte fyer, siç e tregon shkrimtari Proksen. Këtë Pirrua e ka patur edhe vetë parasysh dhe e shkruan në kujtimet e tij.

1 **12** Pirrua, natën kur do të tërhiqte ushtrinë, vendosi fshehurazi lëmin e tij mbi malin e romakëve; në gjumë pa ëndërr sikur i ranë pjesa më e madhe e dhëmbëve
2 dhe nga goja i dilte shumë gjak. I tronditur nga ëndërra që pa, i shkoi ndërmend se kishte për të pësuar një katastrofë të madhe mbasi, kur në të kaluarën se kishte parë një ëndërr të tillë kishte pësuar një fatkeqësi të tmerrshme; mendoi prandaj që të qëndronte në pritje atë ditë, por nuk mundi t'i shmangej fatit, sepse miqtë e tij e kundërshtonin shtytjen e nisjes dhe kërkonin që të mos lihej rasti t'u shpëtonte nga dora.

3 Kur Pirrua ishte duke marshuar me ushtrinë e tij dhe elefantët, romakët e diktuan atë dhe plagosën një këlysh elefanti, i cili shkaktoi në radhët e helenëve një çrregullim të madh dhe i bëri që t'ua mbathnin këmbëve me shpejtësi. Romakët vranë dy elefantë, 8 të tjerë i mbyllën në një vend dhe ua dorëzuan hindasve që t'i mbajnë gjallë, kurse ushtarë vranë shumë.

NIKOLLA I DAMASKUT

Nikolla i Damaskut me prejardhje nga Siria jetoi për një kohë në oborrin perandorak të Augustit. Ai shkroi një histori botërore në 144 libra, në të cilën qe përfshirë dhe historia e Romës. Përveç kësaj është autori i një biografie të Augustit e shkruar me një ton apologjetik. Të dy këto vepra kanë arritur tek ne në fragmente. Ai është gjithashtu edhe autori i një materiali që përshkruan zakone të çuditshme. Në një nga fragmentet e ruajtura të Nikollës së Damaskut njoftohemi se në kohën e vrasjes së Cezarit, Augusti gjendej në Apolloni. Nga ky fragment mësojmë gjithashtu se kur arriti të marrë në dorë pushtetin perandorak u dha apolloniatëve liri dhe i përjashtoi nga detyrimet.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Historici Graeci Minores edidit Ludovicus Dindorfius. Vol. I. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1870.

NICOLAI DAMASCENSI FRAGMENTA

1) Jeta e Cezarit[1)]

(Mbi edukimin e Cezarit)

fq. 105 **17** Apolloniatët të mbledhur që të gjithë i luteshin Cezarit, me dashamirësi që të qëndronte pranë tyre gjer në një farë kohe, duke i premtuar t'i vinin në shërbim qytetin e tyre për çdo gjë, si nga dashuria për të, ashtu edhe nga nderimi për të vdekurin[2)]; se duke qenë para kaq armiqve, për të ishte më mirë t'i ndiqte me vëmendje ngjarjet nga një qytet mik. Por Cezari që dëshironte ta përgjonte rastin, duke qenë pranë ngjarjeve, nuk hoqi dorë nga mendimi i tij dhe tha se ishte nevoja të nisej me det. Atëherë i lavdëroi apolloniatët dhe kur erdhi në fuqi u dha liri dhe i përjashtoi nga detyrimet. Përveç këtyre, shumë mirësi të tjera u solli dhe qytetin e tyre e bëri nga më të lumturit. Atëherë, kur po ndahej, i gjithë populli e përcolli me lot në sy, duke admiruar sjelljen e mirë dhe urtësinë e tij, gjatë këtij qëndrimi të shkurtër në qytetin e tyre, duke mallkuar njëkohësisht edhe për fatin.

2) Mbledhje zakonesh

fq. 145 **2** Dardanët, fis ilir, lahen vetëm tri herë në jetë, kur lindin, kur martohen dhe kur vdesin.

fq. 147 **14** Liburnët gratë i kanë të përbashkëta dhe fëmijët i ushqejnë bashkërisht deri në moshën 5 vjeç; pastaj në vitin e gjashtë mbasi i mbledhin të gjithë fëmijët shquajnë ngjasimet që kanë me burrat dhe secilin ia dorëzojnë babait të vet; secili fq. 152 baba që nga koha që merr fëmijën e quan si djalin e tij.

37 Autariatët nuk i braktisin kurrë të gjallë gjatë udhëtimit, ushtarët e ligështuar.

[1)] Oktavian Augustit

[2)] Është fjala për G.J.Cezarin.

LUKANI

Lukani, i nipi i filozofit të shquar romak, Seneka, lindi në Kordovë me 3 Nëntor të vitit 39 të e. sonë. Që në fëmijëri Lukani u dallua për një pjekuri të parakohshme intelektuale. Mësoi tek mësuesit më të mirë të kohës. Që në moshë të re thuri poemën "Iliaca", mbi luftën e Trojës, dhe një vjershë "Catachtonion" ku këndon zbritjen e një heroi të panjohur në botën tjetër. Në Athinë kaloi siç ishte zakon atëherë, një kurs perfeksionimi. U ftua pastaj nga Neroni, i cili e donte ta kishte në rrethin e miqve të tij. Por më vonë kjo miqësi u shndërrua në armiqësi. Pjesëmarrja në komplotin e Pisonit kundër Neronit i kushtoi Lukanit jetën; ai u dënua me vdekje më 30 Prill të vitit 65 të e. sonë.

Vepra kryesore e Lukanit "Pharsalia", e vetmja vepër e ruajtur por e papërfunduar nga shkaku i vdekjes së tij tragjike, është një poemë e madhe e ndarë në 10 libra. Subjekti i saj është lufta në mes Cezarit dhe Pompeut, por pas Farsalës dhe pas vdekjes së Pompeut të kënduar në librin e tij të VIII, fillon tregimi i ndërmarrjeve të reja ushtarake. Kjo vepër ka më tepër rëndësi letrare se sa historike.

Gjatë përshkrimit poetik të ngjarjeve të luftës civile, një pjesë e të cilave u zhvillua edhe në vendin tonë, Lukani u këndon megjithëse kalimthi edhe vendeve ku u fortifikuan ushtritë e dy pretendentëve romakë para se Cezari të sulmonte Dyrrahin.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Collection des auteurs, Lucain etc. avec la traduction en français publiées sous la direction de M. Nisard. Paris 1871.

M. ANNAEI LUCANI

PHARSALIA

(Farsala)

LIBRI II

Përtej deti i gjerë shtrihet, qoftë kur anijet me vela
shkojnë drejt skelave të tua o Kerkyrë, qoftë kur majtas synohet
Epidamni ilir, duke u drejtuar drejt valëve të Jonit.
Këtu strehohen varkëtarët, kur Adriatiku të gjitha fuqitë e veta
i vë në lëvizje, dhe kur Keraunia fshihet ndërmjet reve, dhe kur
Sasoni kalabrik, zhduket nën valët shkumbëzuese (fq.45).

LIBRI V

.....Por kur nata iku
Një re ia mori shkëlqimin ditës dhe detrat pak nga pak
u tronditën deri në thellësi, dhe ua lëvizi Kerauninë varkëtarëve.
Prandaj anijet filluan të rrëmbehen dhe deti i shqetësuar flotën
e vuri në lëvizje; dhe me erë dhe përkrahjen e valëve
u avit dhe çengelat në rërën e Palestës hodhi[1].
Fusha e parë pa se prijësat zunë vend në shatore afër njëri-tjetrit
dhe këtë /tokë/ i shpejti Genus dhe Apsi i qetë
e rrethojnë me brigje. Që të kalojnë anijet në Aps
bëhet shkaktare një baticë të cilën me pabesi e tërheq një valë e lehtë.
Por në Genus, bornat herë të shkrira prej diellit, herë prej shiut
derdhen: As njëri, as tjetri nuk lodhen me një rrjedhje të gjatë,
por kur i afrohen bregut nuk shohin veçse fare pak vende (fq. 93).

LIBRI VI

Ai /Cezari/ porsa pa se dhëndërri /Pompeu/ nuk mund të tërhiqej në luftë,
se i shmangej çdo luftimi, duke pasur besim vetëm në ledhin e mbyllur
lëvizi ushtrinë dhe fshehurazi nëpër rrugë plot shkurre dhe nëpër ara të
Dyrrahut, i pari kërkoi të zinte majat.
I madhi /Pompeu/ i doli përpara nëpër rrugën bregdetare

---

[1] Është fjala për zbarkimin e G. J. Cesarit në Paleste (Palasa e sotme e Himarës) në vitin 48 para e. sonë.

dhe në kodrën, të cilën banori taulantas e quan Petra.[1)]
ngriti lëmin. Ai i ruan muret e Efyrës,[2)] duke e mbrojtur qytetin,
që do të ishte i sigurtë edhe vetëm me kullat e tij.
Ajo që mbrohet këtu nuk është një punë e natyrës, por një mur i ndërtuar.
Sado lart që të ngrihen në ajër këto ndërtime të bëra me punë njerëzore
i përkulen pa vështirësi rrebeshit të luftës dhe viteve, që shkatërrojnë çdo gjë
Por atë që e forcon këtë vend, /d.m.th./ natyrën dhe pozicionin e vendit,
asnjë hekur nuk mund ta shkatërrojë. I rrethuar nga një humnerë e pafund
në çdo anë dhe nga një det që vjell shkrepa,
/Dyrrahu/ do të ishte ishull, pa kodrën[3)] e vogël.
Mbi thepat e tmerrshme për anijet mbështeten muret
dhe kur fryn era e vrullshme e jugut ngrihen dallgët e Jonit,
lëkunden tempujt dhe shtëpitë dhe deti shkumëzon deri në çatitë (fq. 101-102)

[1)] Shkëmbi i Kavajës.
[2)] Emri i vjetër i Kerkyrës, koloni e së cilës ishte Dyrrahu
[3)] Është fjala për ngushticën tek ura e Dajlanit.

PATERKULI

Vellej Paterkuli është një nga përfaqësuesit e literaturës së oborrit perandorak, literaturë e cila në atë kohë nuk gëzonte ndonjë popullaritet të madh. Lindi në Kapua rreth vitit 19 para e. sonë dhe vdiq pas vitit 31 të e. sonë. Për një kohë të gjatë shërbeu në ushtri, pastaj u zgjodh senator dhe arriti të marrë edhe titullin e pretorit. Si ushtarak mori pjesë në ekspeditat luftarake të komanduara kryesisht nga Tiberi. Në kohën e sundimit të këtij të fundit si perandor, shkroi veprën "Historia Romana" (Historia e Romës) në dy libra, e cila përshkruan ngjarjet e gjithë historisë së Romës deri në vitet 30. Libri i parë, të cilit i mungon fillimi trajton shkurtimisht historinë e Romës që nga lindja e saj e deri tek shkatërrimi i Kartagjenës dhe i Korinthit, kurse në librin e dytë përshkruhet më gjerësisht historia e Romës deri në vitin 30 të e. sonë.

Në veprën e Paterkulit gjejmë të dhëna të rëndësishme mbi luftën e ilirëve të veriut kundër pushtimit romak dhe në mënyrë të veçantë për kryengritjen e madhe ilire të viteve 6-9 të e. sonë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

C. Vellei Paterculi ex Historiae Romane libris duobus quae supersunt, apparatu critico adiecto edidit Carolus Halm. Lipsiae in aedibus B.G.Teubneri 1909.

C. VELLEI PATERCULI

HISTORIAE ROMANAE

(Historia romake)

LIBRI I

9 Kështu Pauli[1] e shpuri në triumf mbretin shumë të madh dhe shumë fisnik[2]. Në këtë vit madhështor u bë edhe triumfi detar i pretorit Oktav dhe ai i Anicit, i cili bëri të marshojë para karrocës së tij Gentin, mbretin e ilirëve.

LIBRI II

49 ... Atëherë ky komandant i madh[3], pasi iu mbush mendja se çasti për të marrë armët kishte arritur, kaloi Rubikonin me ushtrinë e tij. Gjithashtu Pompeu, konsujt dhe pjesa më e madhe e senatit, pasi lanë Romën dhe prej këtej Italinë, u drejtuan për në Dyrrah.

59 Më në fund u hap testamenti i Cezarit, me të cilin ai bënte bir në shpirt G. Oktavianin, birin e vogël të motrës së tij Julisë, mbi prejardhjen e të cilit dhe se si shkëlqeu do të themi pak fjalë...

Filipi, burri i dytë i Aties, u ngarkua me edukimin e kësaj fëmije. G. Cezari, ungji i tij i madh, e deshi si birin e tij; kur mbushi 18 vjeç ai e mori me vete në luftën e Hispanjës dhe prej këtij çasti ai ndau me të çadrën dhe shtratin; ai e ngriti atë, megjithëse shumë i ri, në shkallën e pontifeksit[4]. Pasi mbaruan luftërat civile ai e dërgoi në shkollat e Apollonisë, me qëllim që studimet të zhvillonin prirjen e mrekullueshme që vërehej tek ai.

90 ... Dalmatia e cila ishte vatër kryengritjesh për 220 vjet, ishte nënshtruar në një farë mënyre...

96 ... Për t'i qëndruar besnik planit të këtij tregimi, ne do të flasim në një vend tjetër (më vonë) me hollësi mbi panonët, dalmatët, mbi pozitën e vendeve të tyre, mbi fitoret e shkëlqyeshme dhe të shumta që kryekomandanti[5] ynë korri në këtë luftë...

110 Fati i përmbys dhe ngandonjëherë i vonon planet e njerëzve. Cezari[6] kishte përgatitur lëmin e dimërimit pranë Danubit dhe duke e avitur ushtrinë e tij jo më

---

[1] L.Emil Pàuli.
[2] Perseun, mbretin e Maqedonisë.
[3] G.J.Cezari.
[4] Kryeprifti.
[5] Tiberi.
[6] Prapë Tiberi.

shumë se pesë ditë rrugë larg trupave të para armike, kishte urdhëruar edhe
2 Saturninin që të afronte legjionet, të cilat të ndara prej armikut me një largësi pothuaj të njëjtë, duhej të bashkoheshin në pak ditë me Cezarin në një vend të caktuar. Në këtë kohë e gjithë Panonia, kryelartë nga të mirat që i kishte sjellë një paqe e gjatë si edhe Dalmatia që kishte arritur atëherë kulmin e fuqisë së vet, i bashkuan tërë fiset e këtyre krahinave në një besëlidhje të përgjithshme dhe të gjithë bashkë rrokën armët.
3 Atëherë u desh të merreshin masat e nevojshme dhe të mos mendohej për lavdinë personale; nuk u duk, prandaj, gjë e sigurtë të futej ushtria përbrenda vendit e të braktisej Italia sa kohë që armiku ishte aq afër. I gjithë numri i popujve dhe i fiseve që kishin ngritur krye ishte më se tetëqind mijë vetë; ushtria e rregullt përfshinte pothuaj dyqindmijë këmbësorë të aftë për armë dhe nëntë mijë kalorës. Nga kjo
4 shumicë e madhe që udhëhiqej nga komandantë shumë të guximshëm e shumë të stërvitur, një pjesë do të sulmonte Italinë, e cila me anë të Nauportit dhe të Tergestit lidhej me viset e tyre, një pjesë tjetër u lëshua mbi Maqedoninë dhe pjesa e fundit ishte e caktuar për të ruajtur vendin. Drejtimi i përgjithshëm iu ngarkua të dy udhëheqësve, Batos dhe Pinit. Të gjithë panonët njihnin jo vetëm disiplinën, por edhe gjuhën romake; më të shumtët ishin dhënë pas letërsisë dhe ishin familiarizuar
5 me ushtrimet e mendjes. Kështu, për Herkulin, asnjë popull nuk e lidhi ndonjëherë aq shpejt vendimin e luftës me shpalljen e menjëhershme të saj dhe nuk i shpuri deri në fund aq shpejt vendimet që mori. Qytetarët romakë u shtypën, tregtarët u vranë,
6 një numër i madh ushtarësh u masakruan në atë krahinë që ishte shumë larg nga perandoria. U pushtua ushtarakisht Maqedonia, kudo çdo gjë u shkretua me zjarr dhe me hekur. Kjo luftë kalli aq tmerr, sa që edhe shpirti i Cezarit August[1], ai shpirt i fortë prej natyre dhe i forcuar nga përvoja e shumë luftërave të egra, u trondit dhe u tmerrua.

1 **111** U shpall mobilizimi dhe nga të gjitha anët u thirrën edhe veteranët. Burra e gra, sipas pasurisë, u detyruan të jepnin një sasi ushtarësh nga skllevërit e liruar që kishin. Në senat u dëgjua zëri i prijësit[2]: "Në dhjetë ditë, tha, po të mos merren masa mbrojtjeje, armiku mund të hyjë brenda në Romë". U caktuan detyrat dhe ndihmat që duhej të jepnin senatorët dhe kalorësit romakë në këtë luftë; po të gjitha këto do të përgatiteshin kot, po mos të kishte qenë ai që i drejtonte. Prandaj Republika kërkoi nga Augusti në krye të ushtrisë dhe si prijës në këtë luftë, Tiberin... Edhe unë si
3 njeri i thjeshtë solla në këtë luftë një shërbim të dukshëm. Si mbarova shërbimin tim në kalorësi u emërova kuestor dhe pa qenë akoma senator u vura në një shkallë me senatorët. Mbasi u shënova ndër tribunët e popullit, mora komandën e një pjesë të ushtrisë së dorëzuar nga Augusti dhe e shpura prej Rome tek i biri i tij. Më vonë
4 gjatë kuesturës sime, mbasi kundërshtova të marrë me short një provincë, u dërgova po tek ai si legat i tij. Në vitin e parë sa ushtri armiqsh pamë! Me çfarë manovrash, që i detyroheshin mënçurisë së prijësit, duke i sulmuar veçmas, iu shmangëm sulmeve të përgjithëshme të tyre!...

4 **114** Dimri i dha fund armiqësive. Në verën e ardhshme e gjithë Panonia kërkoi paqe dhe lufta u përqëndrua në Dalmati. U pa atëherë kjo shumicë e madhe ushtarësh krenarë, që më parë kërcënonte Italinë, duke çuar në breg të lumit Batin armët, me të

---

[1] Oktaviani.
[2] Princeps, ky ishte titulli që mbante në fillim Oktavian Augusti.

cilat luftoi kundër nesh, dhe duke rënë në këmbët e kryekomandantit tonë; nga dy udhëheqësit kryesorë Batua dhe Pini, njëri u kap, tjetri u dorëzua. Por këto janë hollësi që i ruaj për një histori më të gjatë.

1 **115** Pastaj Cezari i ktheu sytë dhe armët tek lufta tjetër e madhe, lufta dalmatine...

2 Në fillim të verës Lepidi, si e nxori ushtrinë nga lëmi i dimërimit, duke kaluar nëpër fise që ishin të pacënuara gjer tani dhe që s'kishin pësuar akoma nga shkatërrimet e luftës, gjë që i kishte bërë më krenarë dhe më të egër, u nis për të vajtur te kmandanti Tiber. Pasi luftoi me vështirësitë e viseve si dhe me forcat e
3 armiqve që qëndronin, por me humbje të mëdha për ta, arriti te Cezari i gëzuar për fitoret që korri dhe i ngarkuar me plaçkë lufte, pasi më parë kishte shkatërruar fushat, kishte djegur shtëpitë dhe kishte vrarë burrat. Për këto vepra, të cilat po t'i kishte bërë me emrin e tij do të kishte të drejtë për tirumf, u nderua me stolitë e triumfit pas marrëveshjes që patën në mes tyre senati dhe komandantët. Ajo verë e
4 uli tensionin shumë të madh të luftës. Atëherë pirustët e desidiatët dalmatë, pothuaj të pathyeshëm, në saje të pozitës së vendeve dhe të maleve, të natyrës së tyre të egër, të zotësisë së tyre të çuditshme për të luftuar dhe sidomos në saje të grykave të ngushta, u qetësuan më në fund jo me urdhër, por me duart dhe armët e Cezarit vetë, atëherë kur ata u shkatërruan pothuaj plotësisht.

2 **121** ... Me kthimin e tij në Romë, /Tiberi/ festoi triumfin mbi panonët dhe dalmatët, nderim që e meritonte që më parë, por që ekspeditat e pandërprera e kishin penguar...

1 **123** Ne arritëm në një epokë zije dhe alarmesh. Cezari August dërgoi Germanikun, nipin e tij, në Germani për të përfunduar atje luftën. Tiberi shkoi në Ilirik për të rregullaur organizimin e provincave që kishte pushtuar.

VALER MAKSIMI

Për jetën e shkrimtarit romak të kohës së Tiberit, Valer Maksimit, dihen pak gjëra, dhe këto nga sa na njofton ai vetë në veprën e tij të titulluar "Factorum et dictorum memorabilium" (Ngjarje dhe thënie të shënuara), kushtuar perandorit Tiber. Nuk dihet se ku dhe kur ka lindur ky shkrimtar dhe data e vdekjes së tij. Siç del nga thëniet e tij një pjesë të jetës duhet ta ketë kaluar në varfëri. Më vonë ai u ndihmua nga Sekst Pompeu, konsull i vitit 14, të cilin e ndoqi edhe në Azi në kohën e prokunsullatës së tij në vitin 27 të e. sonë. Pas kthimit nga Azia u vu të shkruajë veprën e tij të përmendur më sipër, të cilën e përfundoi në vitin 31 të e. sonë. Në këtë vepër me karakter kompilativ ai ka përmbledhur ngjarje dhe thënie të shënuara të nxjerra nga historishkruesit më të përmendur latinë e grekë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Valerii Maximi Factorum et dictorum memorabilium libri novem cum Iulii Paridis et Jannuarii Nepotiani epitomis interum recensuit Carolus Kempf. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1888.

VALERII MAXIMI

FACTORUM ET DICTORUM MEMORABILIUM

(Ngjarje e thënie të shënuara)

LIBRI I

V. MBI FALLET

2 Apolloniatët nuk u penduan pse në një luftë të vështirë me ilirët kërkuan ndihmën e epidamnasve. Këta të fundit u thanë se po u dërgojnë për ndihmë lumin Aea, që rrjedh pranë mureve të tyre. "Ne pranojmë ç'të na jepni", u përgjigjën ata, dhe lumit Aea i caktuan radhën e parë në ushtri, si komandantit të tyre. Megjithëse nuk kishin shpresë, ata i mundën armiqtë e tyre, duke ia mveshur këtë triumf besimit të këtij falli; ata i bënë fli lumit Aea, sikurse një Hyu, dhe pas kësaj vendosën ta vënë në krye *[të ushtrisë]* në të gjitha betejat.

KURT RUFI

Kurt Rufi, historian romak, jetoi dhe punoi në shek. I të e. sonë. Mbi jetën e tij ka shumë supozime, por asnjë lajm nuk është i sigurt. Në kohën e perandorit Klaud I (41-44) ai shkroi historinë e Aleksandrit të Madh në 10 libra (Historiarum Alexandri Magni Macedonis) të mbështetur në burime greke të zhdukura. Dy librat e para mungojnë, kurse të tjerët kanë mjaft boshllëqe. Në paraqitjen e fakteve Rufi përdor forma të theksuara retorike. Vepra e tij është e vlefshme për studimin e periudhës së Aleksandrit të Madh. Në këtë vepër ne gjejmë të dhëna të pakta, por të rëndësishme edhe për luftërat iliro-maqedonase në kohën e këtij sundimtari të madh të Maqedonisë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Q. Curti Rufi Historiarum Alexandri Magni Macedonis libri qui supersunt iterum recensuit Edmundus Heidicke, editio maior. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1908.

Q. CURTI RUFI

Historiarum

ALEXANDRI MAGNI

Macedonis

(Historia e Aleksandrit të Madh Maqedonas)

Suplemente të LIBRIT I

... Kur lindi Aleksandri[1], Filipi nënshtroi Potidenë, koloni e athinasve, mori lajmin se kishte dalë fitues në lojërat olimpike ku kishte dërguar katër karroca dhe i erdhi një lajmëtar nga ana e Parmenionit, të cilin e kishte dërguar në Iliri, që i njoftonte për një fitore shumë më të rëndësishme, se maqedonasit kishin mundur barbarët në një betejë të madhe...

... Filipi kishte fituar mjaft lavdi e fuqi, ai kishte marrë mjaft plagë dhe kishte kaluar plot rreziqe dhe shpirti i tij i verbuar nga ambicja nuk mund të rrinte i qetë.

Maqedonasit më parë u paguanin haraç ilirëve; ai i kishte bërë ata (maqedonasit) zotër jo vetëm të popujve fqinjë, por edhe të atyre më të largët...

Ai *[Filipi]* po i rregullonte fshehurazi të gjitha punët, me qëllim që të zinte në befasi athinasit, dhe po e mbante ushtrinë e vet në gatishmëri, sepse fiset e Ilirisë, që kishin një natyrë të egër dhe nuk mund të mësoheshin të qëndronin në robëri, po kryenin tani veprime me qëllim që të shkundnin zgjedhën. Në këtë kohë Aleksandri u dërgua kundër këtyre barbarëve, i mundi dhe i vuri në ikje...

"Dhe është e sigurt që thesalët, prej të cilëve Filipi merr sot pjesën më të madhe të kalorësisë, kurrë nuk kanë ndjekur për një kohë të gjatë një parti; dhe ilirët e barbarët e tjerë që janë fqinjë të Maqedonisë, popuj prej natyre kryelartë dhe të egërsuar nga robëria e re, në të cilën gjenden sot, do të fillojnë për ne luftën nëqoftëse Filipi do të dështojë në fillim të betejës[2]..."

... Pastaj duke pasur frikë për të ëmën dhe për vete, ai *[Aleksandri]* vajti te mbreti i Ilirisë[3] dhe e la të ëmën në Epir, ku ishte mbret i vëllai i saj...

... Filipi nuk kishte lënë pas dore asgjë për të forcuar fuqinë e tij dhe pa vështirësi ishte martuar me gra me prejardhje barbare nga vendi i ilirëve dhe i getëve, megjithëse kishte plot fëmijë nga shumë gra...

... Ajo *[Olympia]* kishte nxitur vëllanë e saj, Aleksandrin, të luftonte kundër Filipit, por ky mbret dinak, që kishte frikë të kapte armët në kohë jo të

---

[1] Në vitin 356 para e. sonë. Shih edhe Plutarch, Alexander, 3.

[2] Kjo është një pjesë nga fjalimi i të dërguarit të athinasve. Demostenit, mbajtur në kuvendin e beotasve.

[3] Në vitin 337 para e. sonë.

përshtatshme,megjithëse ishte më i fuqishëm, veproi në atë mënyrë që t'i dilte përpara punës me një aleancë të re; për të bërë për vete mbretin e Epirit[1] i dha për grua Kleopatrën, të motrën e Aleksandrit[2]

12 ... Kur ai /Aleksandri/ po kthehej në Maqedoni, duke kaluar nëpër vendet e agrianëve dhe të paionëve, i sollën lajmin e lëvizjeve në Iliri. Bardhyli, i cili nga qymyrxhi kishte arritur të bëhej mbret i shumë fiseve të asaj krahine, e kishte trazuar Maqedoninë gjersa qe mundur në betejë nga Filipi dhe, pasi kishte rifilluar luftën, në të cilën kishte humbur të gjitha forcat ushtarake të tij, më në fund i ishte bindur fituesit. Ky mbret kishte vdekur, pasi kishte jetuar nëntëdhjetë vjet; i biri i tij i quajtur Klit, duke menduar se kishte ardhur koha për të rifituar lirinë, atëherë kur Aleksandri ishte i zënë në një luftë përtej Istrit me popuj të fuqishëm, i bëri fiset e tij të rrokin armët[3] dhe lidhi aleancë me Glaukinë, mbretin e ilirëve që quhen taumantë[4].

Autariatët, që janë një fis tjetër, kishin vendosur që të sulmonin rrugës maqedonasit, por Longari, mbreti i agrianëve, që ishte mik i Aleksandrit, i kërkoi që të ngarkohej me shtypjen e tyre dhe i tha se do t'ua punonte atyre në atë mënyrë saqë nuk do t'u shkonte mendja më të trazonin maqedonasit, por vetëm të ruanin vetveten.

Mbreti duke lavdëruar dashurinë e këtij prijësi të ri e përcolli me dhurata dhe i premtoi se do ta martonte me të motrën Kyna, që i ati i tij e kishte nga një grua ilire, e cila ishte martuar me Amyntën. Me të vërtetë agrianasi e mbajti fjalën që i kishte dhënë Aleksandrit dhe e plotësoi atë që i kishte premtuar, por papritur u sëmur dhe vdiq shpejt, pa arritur të marrë çmimin që i ishte premtuar. Kështu pasi autariatët ishin rregulluar, pa qenë nevoja për të luftuar me ta, ai arriti në Pelion, që është një qytet i Desaretisë, mbi lumin Eorde. Armiqtë u dukën sikur do të luftonin dhe nxorën me furi garnizonin gadi për të filluar betejën, por para se sa të ndesheshin u tërhoqën megjithëse kishin zënë vende të përshtatshme, pyje e rrugë. Maqedonasit panë një gjë të tmerrshme në këtë vend: tre djem të rinj dhe tri çupa të reja të shtrirë të vdekur në tokë, bashkë me tre desh të zi, gjaku e trupat e të cilëve ishin përzier. Barbarët u kishin bërë fli perëndive të tyre sipas një besimi të shenjtë, për t'u dhënë guxim njerëzve të tyre që do të luftonin; por një perëndi, hakmarrës për këtë krim, nuk u frymëzoi veçse dobësi në vend të forcës që pritnin.

Mbreti, pasi i përzuri deri te qyteti i tyre, kishte vendosur t'i pengonte të dilnin, duke ndërtuar përjashta një mur, por të nesërmen pasi erdhi Glaukia me një ushtri të madhe taumantësh bëri të humbiste shpresën e pushtimit të qytetit dhe e detyroi të merrte masa për të siguruar tërheqjen. Ndërsa Filota, i përcjellë nga kalorës, ishte dërguar për të siguruar ushqime për kafshët e lëmit, mbreti u njoftua se këta njerëz ishin në rrezik pasi Glaukia kishte zënë disa kodra përreth një fushe dhe ruante rastin të bënte ndonjë send. Atëherë, duke lënë në lëm një pjesë të ushtrisë për të ndaluar daljen e të rrethuarve, me pjesën tjetër të trupave të tij, pasi frikësoi ilirët, tërhoqi të tijët pa rrezik.

Por nga ana tjetër ai nuk mundi t'i shmangej pengesave të forta që ndeshi gjatë rrugës pasi, nga njëra anë lumi dhe nga ana tjetër shkëmbenjt, ngushtonin rrugën në një mënyrë të tillë sa që në shumë vende mezi mund të kalonin së bashku katër burra të armatosur; Kliti e Glaukia kishin vënë në malet grupe shigjetarësh

---

[1] Aleksandri Molos.
[2] Kleopatra ishte e bija e Filipit të II me Olympinë d.m.th. e motra e Aleksandrit të Madh.
[3] Viti 335 para e. sonë.
[4] Është fjala për taulantët.

e hobetarësh dhe një numër të madh luftëtarësh të armatosur rëndë. Atëherë Aleksandri, që kishte urdhëruar të qëndronin dyqind kalorës në krye të falangës së tij, i komandoi që t'i ngrinin heshtat, pastaj t'i ulnin në drejtim të armikut sikurse donin t'i hidhnin dhe të silleshin herë djathtas, herë majtas.

Ndërsa kjo lojë i mbante armiqtë si të varur, nganjëherë ai e ndante falangën që kishte përparuar me shpejtësi, herë të tjera ai e bashkonte si një trup; më në fund pasi e radhiti në trajtë pyke e nisi kundër ilirëve, që ishin në krahun e majtë. Ata u frikësuan aq shumë nga shpejtësia e maqedonasve, sa që lanë malet që kishin zënë dhe ikën nga qyteti. Në majën e malit, në të cilën kishin hipur maqedonasit, kishin mbetur pak ilirë dhe pasi i dëboi nga ky vend, Aleksandri zuri vendin e agrianëve për t'i dhënë ndihmë prej andej falangës së tij, të cilën e kishte urdhëruar të kalonte lumin.

Armiqtë, të cilët e panë këtë, morën po ashtu rrugën nga malet për të sulmuar praparojën, me të cilën Aleksandri do të kalonte atëhere kur ushtarët e armatosur rëndë do të gjendeshin në atë anë të lumit. Por mbreti nuk u çudit kur i pa ata që po vinin, por me guxim i përballoi sulmet e tyre dhe në të njëjtën kohë falanga lëshoi një britmë të madhe gjoja se po bëhej gati të rikalonte lumin për t'i ardhur në ndihmë mbretit, gjë që e frikësoi armikun. Nga ana tjetër mbreti, duke e paraparë këtë që do të ndodhte u kishte dhënë urdhër atyre që kishin kaluar të parët, që të radhiteshin për luftim menjëherë sa të arrinin bregun tjetër, duke përhapur sa më tepër krahun e majtë, i cili ishte më afër lumit dhe armiqve, për t'u dukur se kishte më shumë njerëz se sa ishin në të vërtetë.

Prandaj taumantët, duke kujtuar se gjithë ushtria po sulmonte në drejtim të tyre, u tërhoqën pak, dhe Aleksandri duke përfituar nga kjo i çoi ushtarët e tij me shpejtësi në drejtim të lumit dhe posa arriti e kaloi atë bashkë me ushtarët e parë. Por meqenëse armiqtë u kthyen në vendin e tyre dhe po u binin ushtarëve të fundit që do të kalonin lumin, ai i zmbrapsi me anë të disa makinave të vendosura përtej lumit, të cilat ishin të afta për të hedhur gurë larg ndërsa ata që kishin hyrë në lum u hidhnin shigjetat nga mesi i lumit. Kishin kaluar tri ditë që Aleksandri ishte tërhequr, kur u lajmërua se armiqtë, që nuk ishin më të shqetësuar dhe të frikësuar, bridhnin sa andej këndej pa ndonjë urdhër dhe të shkujdesur; lëmi i tyre nuk kishte as llogore as fortifikime, dhe ata nuk kujdeseshin as për të vënë roje.

Kështu, duke marrë me vete hobetarët me agrianët dhe maqedonasit e komanduar nga Perdika e Keno, kaloi natën lumin dhe marshoi me kujdes nga ana e armiqve, pasi i kishte dhënë urdhër pjesës tjetër të ushtrisë që ta ndiqte atë. Por papritur që ajo ta arrinte, ai dërgoi përpara luftëtarë të armatosur lehtë dhe vetë me të tjerë i sulmoi në gjumë armiqtë e paarmatosur. U bë një gjakderdhje e madhe. Ai zuri shumë robër dhe vuri në ikje të gjithë të tjerët, duke i ndjekur deri te malet e taumantëve. Kliti shpëtoi nga kjo humbje, duke u mbyllur në Pelion, por pastaj, ose pse nuk kishte besim në fuqinë e këtij qyteti, ose në guximin e njerëzve të tij, i vuri zjarrin dhe u mërgua në vendin e taumantëve.

Suplement i LIBRIT II

3 Në fillim të pranverës[1)], Aleksandri mblodhi ushtarë nga të gjitha anët dhe kaloi në Azi me një ushtri më të fortë nga guximi se nga numri. Parmenioni udhëhiqte tridhjetë mijë këmbësorë, prej të cilëve trembëdhjetë mijë maqedonas, pesë mijë grekë

[1)] Në vitin 334 para e. sonë.

dhe pjesa tjetër ishin nga ata që i kishin dërguar aleatët për këtë luftë. Ilirët, thrakët e tribalët vinin pas tyre me pesë mijë njerëz dhe përveç tyre kishte edhe një mijë shigjetarë agrianë...

LIBRI VI

3 "Unë nuk çuditem aspak, o ushtarë, nëqoftëse ju i quani të mëdha ato që keni bërë; ju jeni mbushur me lavdi dhe nuk kërkoni tjetër veçse pushim. Pa numëruar ilirët, tribalët, Beotinë, Thrakinë, Spartën, ahejt e Peloponezin, të cilët i kam nënshtruar, disa prej tyre vetë, e disa me anën e mëkëmbësve të mi[1]"...

LIBRI VIII

1 ... Si u dha urdhëri për t'u nisur, të nesërmen u bë një darkë, ku mbreti[2], mbasi kishte pirë shumë, filloi të lëvdohej për trimëritë e tij duke u bërë i mërzitshëm edhe për ata që e dinin se thoshte të vërtetën. Më pleqtë megjithatë heshtën deri atëherë kur ai filloi të përflasë veprat e Filipit dhe të thoshte se fitorja e famshme e Keronesë ishte vepër e tij dhe se lavdia e një veprimi kaq të madh i kishte humbur nga zemërngushtësia dhe zilia e të atit; se gjatë grindjes që kishte ndodhur midis ushtarëve maqedonas dhe mercenarëve grekë, Filipi i dobësuar nga plaga që kishte marrë në këtë rrëmujë, ishte shtrirë për tokë dhe nuk kishte gjetur mjet tjetër për të shpëtuar veçse të bëhej si i vdekur, kurse atëherë ai /Aleksandri/ e kishte mbuluar me mburojen e tij dhe kishte vrarë me duart e tij ata që donin të hidheshin mbi Filipin, por i ati nuk kishte dashur kurrë ta pranonte këtë me zemër të hapët dhe i vinte keq që i detyronte jetën të birit. Edhe ekspeditën kundër ilirëve ai e kishte bërë vetë dhe për fitoren e vënien në ikje të armiqve /Filipi/ mësoi nga letrat e tij, ndërsa vetë Filipi nuk kishte marrë pjesë fare në të...

LIBRI IX

... Por unë, që numëroj fitoret e mia dhe jo vitet, po të kem parasysh fatin që më ka
6 ndihmuar, mendoj se kam jetuar shumë. Duke filluar të sundoj në Maqedoni, u bëra zot i Greqisë, nënshtrova Thrakinë e Ilirinë, sundova tribalët e medët dhe tani jam zot i gjithë Azisë nga Helesponti deri në Detin e Kuq[3]...

---

[1] Këto fjalë Aleksandri ua thotë ushtarëve para luftës me parthët.
[2] Aleksandri i Madh.
[3] Fjalët e Aleksandrit pasi u plagos në qytetin e oksydrakëve.

MELA

Pompon Mela, gjeograf romak nga Tingenterea e Spanjës. Nuk njihet data e lindjes dhe e vdekjes së tij. Dihet vetëm se ai punoi në gjysmën e parë të shek. I të e. sonë. Nga veprat e tij me karakter gjeografik është ruajtur vetëm "Chorographia" e shkruar në vitet 43-44 në tre libra, ku jepet një përshkrim i përgjithshëm gjeografik dhe etnografik i botës antike. Korografia e Melës është vepra më e vjetër gjeografike e ruajtur në gjuhën latine. Për punimin e kësaj vepre ai grumbulloi një sasi të madhe të dhënash nga burime të mira dhe i dha ato në formë të qartë dhe të shkurtër. Ai kishte në mend, siç na thotë vetë në fillim të veprës së tij, që më vonë t'i jepte këto materiale në një formë më të plotë dhe të përpunuar, por një vepër të tillë me sa duket nuk arriti ta shkruajë.

Në Korografinë e tij Mela jep dhe një përshkrim të shkurtër të Ilirisë dhe të Epirit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Pomponii Melae De Chorographia lib. III, recensuit C. Frick. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1880.

POMPONII MELAE

DE CHOROGRAPHIA

(Mbi ndërtimin e botës)

LIBRI II

54 **3** ... Në Epir asgjë s'është më i përmendur se sa gjiri i Ambrakisë, qoftë sepse duke pasur një grykë të ngushtë më pak se një mijë hapa gjerësi përbën megjithatë një det të hapët midis tokave, qoftë sepse në brigjet e tij gjenden Akti, Argosi i Amfilohisë dhe Ambrakia, të gjitha këto qytete të përmendura gjatë sundimit të aiakidëve dhe Pirros. Më tutje është Buthroti, pastaj malet Keraune,prej këtej nis Adriatiku.
Ky det i madh ka shumë brigje të thella, është rrethuar nga fise ilire deri në Tergeste,
55 dhe në anën tjetër nga fiset gale e italike. Ndeshen së pari parthinët e dasaretët, pastaj taulantët, enhelejt, feakët. Pastaj vijnë ata që i quajnë ilirë të vërtetë, pyrët, më
56 tej liburnët dhe Istria. Qyteti i parë është Oriku, i dyti Dyrrahu, i cili më parë quhej Epidamn dhe që romakët ia ndryshuan emrin për arsye se u dukej se u ndillte të
57 keqen. Më tutje janë Apollonia, Salona, Jadera, Narona, Traguri, gjiri i Polës dhe Pola vetë, e cila, si thonë, ka qenë banuar dikur nga kolkasit dhe tani është një koloni romake; kështu ndryshojnë punët. Lumenjtë janë Aea, Nari e Danubi, që tani quhet Ister. Aea lag muret e Apollonisë. Nari ndan pyrët nga liburnët, Istri del nga Istria. Në fund të detit Adriatik, ku mbaron bregu i Ilirisë, është Tergeste.

PLINI

Gai Plin Sekundi, i mbiquajtur i Vjetër, për ta dalluar nga nipi i tij Gai Plini Sekundi, i Riu, shkrimtar dhe burrë shteti, lindi në Novum Komum, të Italisë së Veriut në vitin 23 ose 24 të e. sonë. Ushtroi ofiqe të ndryshme të larta civile dhe ushtarake në perandorinë romake, veçanërisht në kohën e Flavëve. Shërbeu si procurator perandorak në Spanjë dhe në provinca të tjera. Në vitin 79 ai komandonte flotën romake në Mizenum të Kampanjës. Në gushtin e po këtij viti ra viktimë e katastrofës së madhe të shkaktuar nga shpërthimi i Vezuvit.

Plini është autor i së njërë punimesh me karater shumë të ndryshëm. Veprat e tij mbi retorikën, mbi artin ushtarak, mbi historinë dhe filologjinë kanë humbur. Na është ruajtur vetëm vepra e tij e fundit dhe më e madhja "Naturalis Historia" (Historia e natyrës) prej 37 librash. Kjo vepër është një enciklopedi njohurish të asaj kohe mbi natyrën. Ajo përmban të dhëna mbi astronominë, gjeografinë, fizikën, zoologjinë, botanikën, mineralogjinë, antropologjinë, dhe shkenca të tjera. Në përpilimin e historisë së tij mbi natyrën ai shfrytëzon, megjithëse në mënyrë jo kritike, shumë vepra të autorëve të ndryshëm antikë si p.sh. Posidonin, Hiparhun Teofrastin, Ksenokratin, Katonin, Varronin etj. Krahas këtyre burimeve të pasura Plini natyrisht shfrytëzon edhe vrojtimet e tija personale.

"Naturalis Historia" e Plinit përmban edhe shumë të dhëna të rëndësishme mbi gjeografinë dhe ekonominë e Ilirisë, mbi pasuritë e saj si dhe mbi florën dhe faunën. Në të gjejmë gjithashtu dhe njoftime me vlerë të madhe mbi pasojat e luftëtave iliro-romake, mbi organizimin administrativ të veçantë të Ilirisë pas pushtimit romak, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

C. Plini Secundi Naturalis Historiae post Ludovici Iani Obitum, recognovit et scripturae discrepantia adiccta, edidit Carolus Mayhoff. Vol. I-III. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1892-1909.

C. PLINI SECUNDI

NATURALIS HISTORIAE

(Historia e Natyrës)

LIBRI II

103(106) Në tokat e Ilirisë ka një burim të ftohtë, që i djeg veshjet e ndera mbi të...
Në Lynkesti ka një ujë të tharptë, i cili të deh sikur të ishte verë.

106(110) Por ky zjarr [i Nymfeut], megjithëse ndodhet në mes të një pylli të dendur, është i këndshëm dhe nuk dëmton gjelbërimin që e rrethon; dhe krateri gjithmonë i ndezur i Nymfeut, që gjendet afër një burimi shumë të ftohtë, i paralajmëron apolloniatët fqinjë; këto i thotë Teopompi. Zjarri shtohet nga shirat dhe nxjerr serë, që duhet përzier me ujin e burimit të papijshëm, përndryshe është më e lëngshme nga të gjitha serat...

102(111) Në Nymfe nga shkëmbi del një flakë që ndizet nga shirat...

LIBRI III

5(6) Përsa i përket largësisë së vendeve fqinje Italia ndodhet nga Istria e Liburnia, në disa pika, njëqind mijë këmbë larg; nga Epiri e Iliria pesëdhjetë mijë...

(8) Pastaj vjen, duke filluar nga lumi Makra, krahina e shtatë, që përfshin Etrurinë, e cila gjithashtu ka ndryshuar shpesh herë emrin. Umbrët kanë qenë përzënë së këtejmi prej pellazgëve, këta prej lydëve të quajtur tyrrenë nga emri i mbretit të tyre, të cilët pak më vonë në gjuhën greke u thirrën tuskë, simbas riteve të tyre të flijimit...
... Shtatë mijë këmbë më tej është lumi Ceretan dhe më brenda vetë Cere, e cila quhej Agyla nga pellazgët, që e themeluan...

(9) Lati i vjetër i ruante kufijtë prej Tiberit deri në Cercej në një gjatësi prej pesëdhjetë mijë këmbësh; kështu rrënjët e perandorisë në fillim ishin të dobëta. Banorët kanë qenë të tjerë në kohë të ndryshme, aboriginët[1], pellazgët, arkadët, sikulët, aurunkët, rutulët dhe përtej cercejve, volskët, oskët, ausonët prej nga u shtri emri i Latit deri tek lumi Lir.

(10) Nga Sileri fillon krahina e tretë, tokat e lukanëve dhe brutëve, ku gjithashtu nuk ka qenë i rrallë ndryshimi i popullsisë. E mbanin atë pellazgët, oenotrët, italët, morgetët, sikulët, sidomos grekët dhe më në fund

[1] Aboriginët, popul i lashtë i Latit.

lukanët, që rrjedhin nga samnitët dhe që udhëhiqeshin nga Luci. Pandosia
11 (15) thotë Teopompi, ku u vra Aleksandër Epiroti, ishte një qytet i lukanëve.

(16) ... Tridhjetë e tre mijë këmbë më tej vjen kepi i quajtur Akra Japygia, pika ku Italia zgjatet më shumë në det; pastaj vijnë qytetet Basta e Hydrunt, nëntëmbëdhjetë mijë këmbë larg, atje ku ndahen deti Jon dhe Adriatiku dhe prej ku kalimi për në Greqi është më i shkurtër; përballë është qyteti i apolloniatëve dhe ngushtica nuk është më tepër se pesëdhjetë mijë këmbë. Për të kaluar këtë largësi me këmbë duke hedhur një urë mendoi për herë të parë mbreti Pirro, mbas këtij Mark Varroni, kur në luftën kundër piratëve komandonte flotën e Pompeut; që të dy u penguan në këtë ndërmarrje nga punë të tjera... Brundisi, pesëdhjetë mijë këmbë nga Hydrunti, është një nga limanet më të mira të Italisë; kalimi prej këndej në bregun e përtejmë është më i sigurtë edhe pse është më i gjatë; këtu zbritet në Dyrrah, qytet i Ilirisë; largësia është dyqind e njëzet e pesë mijë këmbë. Kufi të përbashkët me Brundisin kanë tokat e poedikulëve: nëntë të rinj dhe po aq virgjina të ardhur nga Iliria bënë që të lindin 12 popuj.

Nga /lumi/ Arsia fillon fisi i liburnëve që shtrihet deri tek lumi Tit; ai përfshin
21(25) mentorët, hymanët, enhelejt, bulinët dhe ata që Kalimahu i quan peuketët: tani e gjithë kjo njihet me emrin e përbashkët Ilirik, dhe vetëm pak nga këto fise kanë emra, që meritojnë të përmenden, ose janë të lehtë /për t'u shqiptuar/. Në kuvendin e skardonasve dallohen japudët, 14 civitates[1] të liburnëve, midis të cilëve mund të përmendim lacinienët, stulpinët, burnistët dhe olbonensët. Në këtë kuvend gëzojnë të drejtën italike: alutët, flanatët, që i kanë dhënë emrin e tyre gjirit, lopsët, varvarinët, aseriatët, që nuk paguajnë detyrime dhe nga ishullarët, fertinatët dhe kuriktët.
Më tutje në bregdet, duke filluar nga Nesakti, gjenden qytetet e fortifikuara Alvona, Flanona, Tarsatika, Senia, Lopsika, Ortoplimia, Vegi, Argyrunti, Korini, Aenona dhe qendra e Pasinit: lumi Telavi i ndan nga Japudia. Ishujt e këtij gjiri me qytetet e tyre, veç atyre që përmendëm më sipër, janë Absorti, Arba, Kreksi, Gisa dhe Portunata. Në tokë kolonia Jadera, që është njëqind e gjashtëdhjetë mijë këmbë larg Polës, pastaj tridhjetë mijë këmbë ishulli Kolent; më në fund dyzet e tre mijë këmbë më tej gryka e lumit Tit.

22(26) Fundi i Liburnisë dhe fillimi i Delmatisë është Skardona mbi lumin e përmendur, dymbëdhjetë mijë hapa nga deti; pastaj vjen krahina e vjetër e tariotëve, kështjella Tariona, kepi i Diomedit ose sipas të tjerëve gadishulli Hyll, që ka një rreth prej njëqind mijë këmbësh; Traguri i njohur për mermerin e tij e që gëzon të drejtën romake; Sikuli ku Klaudi i hyjnueshëm kishte dërguar një koloni veteranësh; Salona, koloni që është nga Jadera njëqind e dymbëdhjetë mijë hapa larg. Në juridiksionin e këtij qyteti dallohen delmatët të ndarë në treqind e dyzet e dy dekurie, deurët në njëzet e pesë, ditionët në dyqind e tridhjetë e nëntë, mezejt në gjashtëdhjetë e nëntë, sardeatët në pesëdhjetë e tre. Në këtë krahinë janë Burni, Andetri, Tribuli, kështjella këto të përmendura në luftërat /e ndryshme/. Edhe prej ishullarve dallohen isasit, solentinët, separët, epetinët.
Pastaj vijnë kështjellat e Petuntit, Narestit, Oeneut, Narona, koloni e kuvendit

[1] Nëndarje e fisit me qendrën e tij.

të tretë, larg nga Salona tetëdhjetë e pesë mijë hapa e vendosur mbi lumin me të njëjtin emër dhe njëzet mijë hapa nga deti. Autori M.Varroni na thotë se këtij kuvendi i përkasin tetëdhjetë e nëntë civitates; sot nuk njihen veçse keraunët, të ndarë në njëzet e katër dekurie, daversët në shtatëmbëdhjetë, desidiatët në njëqind e tre, dokleatët në tridhjetë e tre, deretinët në katërmbëdhjetë, deraemistët në tridhjetë, dindarët në tridhjetë e tre, glinditionët në dyzet e katër, melkumanët në njëzet e katër, naresët në njëqind e dy, skirtarët në shtatëdhjetë e dy, sikulotët në njëzet e katër, dhe vardejtë, dikur shkretues të Italisë, me jo më tepër se njëzet dekurie. Përveç këtyre në këtë krahinë banonin edhe ozuejt, partenët, kavët, hemasët, mastitët, aristët. Kolonia e Epidaurit është larg nga lumi Narona njëqind mijë hapa. Pas Epidaurit janë qytetet që gëzojnë të drejtën romake: Rizini, Akrui, Butua, Olcini, më parë i quajtur Kolkin, sepse u themelua prej kolkasve; lumi Drin, dhe mbi brigjet e tij, një qytet që gëzon të drejtën romake, Skodra, tetëmbëdhjetë mijë hapa larg detit. Përveç asaj po zhduket kujtimi i shumë qyteteve greke dhe shumë qendrave të fuqishme. Dhe në të vërtetë, në këtë krahinë qenë labeatët, enedët, rudinët, sasët, grabejt; ruajnë emrin e tyre edhe ilirët e vërtetë, taulantët e pyrejt. Në bregdet është Kepi i Nymfeut, qyteti i fortifikuar Lis, me të drejtën romake, që është larg njëqind mijë hapa nga Epidauri.

23(26)

Prej Lisit nis provinca maqedonase: fiset e parteneve dhe në shpinë të tyre dasaretët, malet e Kandavisë, shtatëdhjetë e tetë mijë hapa nga Dyrrahu. Në bregdet është Denda që gëzon të drejtën romake; Epidamni, koloni, emër ugurzi që romakët e shndërruan dhe e bënë Dyrrah; lumi Aou, i quajtur prej disave Aea; Apollonia, dikur koloni e korintasve, katër mijë hapa larg detit; në kufi të saj gjendet Nymfeu i famshëm, ku banojnë barbarët amantë dhe bulionë. Në bregdet gjendet qyteti Orik, themeluar nga kolkasit. Prej këtej fillon Epiri, malet Akrokeraune, tek të cilat ne kemi vendosur mbarimin e këtij gjiri të Evropës. Oriku gjendet tetëdhjetë mijë hapa nga Kepi i Salentit në Itali.

26(29)

Pas Panonisë vjen provinca e quajtur Myzia, e cila zgjatet me rrjedhjen e Danubit deri në Pont. Fillon me lumin /Sava/ që përmendëm më sipër. Në të përfshihen dardanët, kelegerët, tribalët, timahët, myzët dhe thrakët e Pontit deri në Skythi.

Lumenjtë e përmendur që vijnë nga Dardania janë Margu, Pingu, Timahu nga Rodopi, Oesku, nga Hemi, Uti, Asami, Jeteri.

Iliria, në gjerësinë më të madhe, ka treqind e njëzet e pesë mijë hapa; gjatësia e saj, që nga lumi Arsia deri te lumi Drin, arrin në tetëqind mijë hapa. Nga Drini gjer te kepi Akrokeraun janë njëqind e shtatëdhjetë e dymijë hapa. Agripa e ka matur të gjithë këtë gji të Italisë dhe të Ilirisë me një milion e shtatëqind mijë hapa. Ky gji, në kufijtë që ne i kemi dhënë, përfshin dy dete: detin Jon në pjesën e parë, më brenda Adriatiku, që e quajnë të epërm.

(30)

.. Bregu i Ilirisë ka më shumë se një mijë ishuj; deti është këtu i cekët dhe me kanale të ngushta që ndajnë /ishujt/ midis tyre. Më të përmendurit para grykës së Timavit janë ishujt me burime të nxehta, ujërat e të cilave bashkohen me valët e detit, pranë tokës së histërve – Cisa, Pularia e Apsyrtidet, të quajtura kështu prej grekëve nga vëllai i Medesë që u vra këtu. Pranë tyre janë ata që quhen Elektride ku del qelibari, të cilin ata /grekët/ e quajnë elektron, gjë që

tregon se sa pak besim meritojnë grekët; mbasi nuk dihet se cilët ishuj kanë qenë quajtur kështu. Përballë Jaderit është Lisa dhe ata që kam përmendur më larg. Përballë liburnëve janë disa ishuj që quhen Krate, pastaj ato Liburnike edhe Keladuset që nuk janë më pak në numër, përballë Tragurit Bova dhe Bratja e famshme për dhitë e saja, Isa, që gëzon të drejtën romake bashkë me qytetin Far. Kerkyra e mbiquajtur Melaena, me qytetin e fortifikuar të knidëve, larg njëzet e pesë mijë hapa; ndërmjet Kerkyrës dhe Ilirisë, Melita, nga i cili ishull vjen, sipas Kalimahut, emri i qenve melitas, pesëmbëdhjetë mijë hapa më larg, tre ishuj Elafite. Në detin Jon, tre mijë hapa nga Oriku, gjendet ishulli i Sasonit i përmendur si qendër piratësh.

LIBRI IV

(1) Epiri i marë në përgjithësi fillon tek malet Keraune. Ai përfshin në fillim kaonët, prej nga vjen emri Kaoni, thesprotët, antigonasit, vendin Aorn me gazrat e këqija për zogjtë, kestrinët, perrebejt, tek të cilët është Pindi, kasopët, dryopët, selët, helopët, molosët ku ndodhet tempulli i Zeusit të Dodonës, i përmendur për orakullin e tij, mali Talar[1] me njëqind burimet që gurgullojnë në këmbët e tij, mal i lavdëruar nga Teopompi.

1 Epiri i vërtetë, duke u zgjatur në drejtim të Magnezisë e të Maqedonisë, ka në shpinë të tij dasaretët, fis i lirë që përmendëm më sipër, dhe dardanët, fis i egër; në krahun e majtë të dardanëve shtrihen tribalët dhe fiset e Myzisë...
Në bregdetin e Epirit kështjella e Himerës, mbi malet e Akrokeraunit. Nën të burimi i Ujit Mbretëror, fortesa Meandria, Kestria. Thyami, lum i Thesprotisë; Buthroti koloni; Gjiri i Ambrakisë, kaq i përmendur një pellg i gjerë uji që ka tridhjetë e shtatë mijë hapa gjatësi dhe pesëmbëdhjetë mijë hapa gjerësi dhe që lidhet me detin me anë të një gryke të ngushtë prej pesëqind hapash. Këtu derdhet lumi Aheron, i cili mbasi lë liqenin Aherusia në Thesproti, prej ku del, ka një gjatësi prej tridhjetë e pesë mijë këmbë dhe një urë prej një mijë këmbë, e admirueshme për njerëzit që duan shumë vendin e tyre; brenda në gji ndodhet qyteti i Ambrakisë; Afa dhe Aratthi janë lumenj të molosëve; gjithashtu qyteti Anaktor dhe vendi që quhet Pandosi.

4(5) Peloponezin e quanin më parë Apia dhe Pelasgia, është një gadishull...

6(10) Brendinë e Peloponezit e mbulon në pjesën më të madhe Arkadia, e cila më parë quhej Drymode dhe pastaj Pelasgis.

7(14) Vjen pastaj Haimonia, që ka ndryshuar shpesh emrin duke u quajtur Pelasgis dhe Argo Pelasgjike, Hellas, gjithashtu Thesali e Dryopide, që të gjithë emra të dhënë nga mbretër.

10(17) Më tej vjen Maqedonia, që përfshin njëqind e pesëdhjetë fise. Ajo ka qenë e përmendur nga dy mbretër dhe për ngritjen dikur të perandorisë në tokat e pushtuara prej saj; ajo quhej më parë Emathia. Shtrihet në drejtim të fiseve epirote dhe në shpinë të Magnezisë e Thesalisë; i binin më qafë dardanët. Nga ana e veriut Paionia dhe Pelagonia e mbrojnë kundër

[1] Është fjala për malin Tomar.

tribalëve. Qytetet e saj janë: Egea ku varrosnin mbretërit, Beroea dhe në krahinën që quhet Pieria, nga një pyll, Egini. Në bregdet Heraklea, lumi Apilas, fortesat Pydna, Alori, lumi Haliakmon. Në brendi aloritët, valejt, fylakejt, kyrestët, tyrisejt, kolonia Pela, fortesa Stobi me të drejtën romake, pastaj Antigoneia, Europi mbi lumin Aksi, një tjetër me këtë emër, nëpër të cilin kalon lumi Roedia, Skydra, Eorda, Mieza, Gordynia. Pastaj në bregdet Ihna, lumi Aksi. Në këtë krah në kufi, Maqedoninë e banojnë dardanët, trerët e pierët. Duke filluar nga ky lum vijnë fiset e Paionisë, paraksiajt, eordensët, almopët, pelagonët, mygdonët, malet e Rodopit, Skopit dhe Orbelit. Më tej në krahinat që shtrihen rrëzë këtyre maleve, arethusët, antiohët, idomensët, doberët, aestreasit, alantensët, audaristët, morylët, gareskët, lynkestët, othryonejt dhe amantinët e lirë si dhe orestët, kolonia e Bylisit dhe e Diumit, Ksylopolitët, skotusejt e lirë, Heraklea e Sintikës, tymfejt e toronejt.

LIBRI VII

2(2) ... Po në Afrikë, sipas Isigonit dhe Nymfodorit, kishte familje magistare, të cilat me magjitë e tyre bënin që të ngordhnin delet, të thaheshin pemët dhe të vdisnin fëmijët. Isigoni shton se tek tribalët dhe ilirët ka gjithashtu njerëz të këtij lloji, të cilët me vështrimin e tyre magjepsin dhe bëjnë të vdesin ata, të cilëve për një kohë të gjatë ua ngulin sytë, mbi të gjitha, sytë e tyre të inatosur. Të keqen e tyre e vuajnë më lehtë fëmijët. Është për t'u shënuar se këta në çdo sy kishin dy bebe. Apollonidi thotë se në Skythi ka gra të këtij lloji, që quhen Bitia...
Disa i kanë gjymtyrët e trupit të pajisura me cilësi mrekullibërëse; i tillë ishte gishti i madh i këmbës së djathtë të Pirros, që shëronte me prekje shpretkën. Thuhet se ky gisht nuk u dogj me trupin tjetër dhe u vendos në një kamare në tempull.

37(37) Hipokrati, në librin mbi mjekësinë, parapa një murtajë që vinte nga Iliria dhe i dërgoi nxënësit e tij nëpër qytete për t'u ardhur në ndihmë të sëmurëve, shërbim ky për të cilin Greqia e nderoi po ashtu si Herkulin.

45(46) Këtyre[1] mund t'u shtonim edhe shumë të këqija të tjera; mungesa e të hollave për të paguar rrogat, kryengritja në Iliri, nevoja e marrjes në shërbim të skllevërve për shkak se mungonte mosha e re, murtaja në Romë, uria dhe mungesa e ujit në Itali.

48(49) Sipas Aleksandër Kornelit një i quajtur Dandon nga Iliria, jetoi pesëqind vjet.

56(57) Germat e alfabetit i sollën në Lat pellazgët.

LIBRI VIII

45(7) Thuhet se gjedhët e Indisë kanë lartësinë e deveve; brirët e tyre arrijnë një gjerësi prej katër këmbësh. Në hemisferën tonë gjedhët epirote lëvdohen së tepërmi. Kjo racë, sikurse thonë, i detyrohet kujdesit të Pirros; ai ia arriti

[1] Më sipër numërohen edhe një sërë vështirësish të tjera që i lindën shtetit romak gjatë sundimit të Augustit, megjithëse koha e tij u quajt koha e artë.

kësaj duke mos lejuar ndërzimin e femrave para se të mbushnin katër vjeç. Kështu pra, ato u rritën shumë dhe nga kjo racë kanë mbetur edhe sot e kësaj dite. Por tani kërkohet një ndërzim njëvjeçar ose të paktën mbasi të kenë mbushur dy vjet, ndërsa demat duhet të jenë katër vjeç. Disa nga demat brenda një viti bëjnë deri në dhjetë ndërzime. Thuhet se në rast se mbas ndërzimit demi merr rrugën nga e djathta, del mashkull; femër kur ai shkon nga e majta. Mbarsja bëhet me një ndërzim të vetëm; nëqoftëse takon të mos mbarset, lopa kthehet mbas 20 ditësh edhe një herë tek demi. Lopët pjellin në muajin e dhjetë. Viçi që lind para kësaj kohe nuk ngrihet dot në këmbë.

48 (73) Leshi i Histrisë dhe Liburnisë i përngjan më tepër flokut; ai nuk mund të shërbejë për thurjen e rrobeve me fije të gjata, sikurse edhe leshi i Salacisë në Lusitani.

LIBRI XI

37 (77) Organet e brendshme tek gjarpërinjtë e zhapinjtë janë të zgjatura. Thuhet se kur shenjat nuk ishin të mbara në një flijim, nga të brendshmet e kafshëve të therura dilnin dragonj; këtu nuk ka asgjë të pabesueshme, kur marrim parasysh se Pirrua kur flijoi ditën që u vra, krerët e bagëtive të therura u tërhoqën zvarrë dhe lëpinë gjakun e tyre.

42 (97) Kullotat e Alpeve dallohen për dy lloje djathi. Alpet e Dalmacisë dërgojnë /djathin e quajtur/ dokleat; Alpet Keutrone /djathin/ vetusik.

46 (106) Në disa vende të Ilirisë derrat janë njëthundrakë.

LIBRI XII

13 (27) Asari[1] më i mirë është ai i Pontit, në radhë të dytë vjen ai i Frygisë, i treti ai i Ilirisë.

LIBRI XIII

1 (2) Disa esenca të veçanta japin gjithashtu parfume të përmendura; në radhën e parë malabathri[2], pastaj irisi[3] i Ilirisë dhe amaraku[4] i Kyzikut: këto dy bimë të fundit janë barishte; u shtohen edhe pak sende të tjera, gjë që ndryshon sipas përgatitësit; ata që i shtojnë edhe më shumë, i fusin edhe mjaltë, lule kripe[5], omfak[6], lule deleje, panaks[7], që të gjitha të ardhura nga jashtë...

---

[1] Asarum europaeum, L. Në Shqipëri kjo bimë gjendet, por është e rrallë. Siç duket është më e dendur në Ilirinë e Veriut.

[2] Një shkurre (Cinnamomum nitidum) që rritet në Azinë e Vogël, gjethet e së cilës japin një vaj eterik që përdorej për përgatitje melhemesh.

[3] Në popull quhet shpatëz. Në Shqipëri gjenden disa lloje irisi, por më të njohurat janë: Iris palida Lam., Iris aphylla L. dhe Iris florentiana L.

[4] Një bimë e përngjashme me manxuranën, mbase rigoni.

[5] Lule e panjohur. Plini e quan Salisflorem.

[6] Është një lëng, që nxirret nga ullinjtë dhe rrushi i papjekur.

[7] Pastinaca opopanax L. Në popull nuk njihet.

2 (3) As Italia, pushtuesja e gjithë popujve, as edhe krejt Evropa nuk furnizojnë asnjë nga prodhimet, që përdoren për fabrikimin e parfumeve, me përjashtim të iris-it të Ilirisë dhe të nardit[1] të Galisë.

LIBRI XIV

2 (4) Rrushi helvola[2] shquhet për ngjyrën e tij ndërmjet purpurit dhe të zezës, ngjyrë kjo që, duke u ndryshuar shpesh, bëri që nga disa ky rrush të quhet variana[3]. Nga të dy llojet kërkohet i ziu. Që të dy janë prodhim një herë në dy vjet, por vera del më e mirë kur vjelja është më e pakët. Edhe rrushi precia[4] përbëhet nga dy lloje, që dallohen nga madhësia e kokrrave të tyre; është shumë i degëzuar dhe kokrrat e tij janë shumë të dobishme, kur ruhen në qypa balte; gjethja e tij i përngjan gjethit të selinës[5]. Qytetarët e Dyrrahut lëvdojnë baliskun[6], të cilin në Spanjë e quajnë kokolob. Kokrrat i ka më të rralla dhe nuk do t'ia dijë as nga vapa, as nga era e jugut; është armiku i kokës[7], jep prodhim shumë.

LIBRI XVI

12 (23) Teopompi shkruan se në tokën e Apollonisë gjendet mineral sere jo më i dobët se ai i Maqedonisë.

LIBRI XIX

8 (41) Është edhe një tjetër bimë e egër, lapsana[8] e cila u bë e përmendur sidomos nga këngët e shakatë ushtarake gjatë triumfit që mbajti i hyjnueshmi Jul[9]. Në vargje të ndryshme ai qortohej se pranë Dyrrahut i bëri /ushtarët/ që të rronin me lapsanë, duke u tallur me të, se ishte treguar koprac në shpërblimet. Lapsana është dhe një bimë e egër me erë.

LIBRI XXI

7 (19) Është edhe një dallim për t'u bërë, i cili nuk duhet të lihet pas dore: që shumë bimë me erë nuk përdoren për kurora, kështu p.sh. irisi dhe saliunka[10] megjithëse që të dyja mbajnë një erë të mirë shumë të kërkuar. Tek irisi nuk ka erë veçse rrënja, që përdoret për parfumeri dhe mjekësi. Irisi që vlerësohet më shumë është ai i Ilirisë dhe bile jo ai i krahinave bregdetare, por ai që rritet në pyjet e brigjeve të Drinit e të Naronës; në radhë të dytë vjen ai i Maqedonisë, që është shumë i gjatë, vjen në të bardhë edhe i pinjtë; në radhë të tretë vjen ai i Afrikës, më i

---

[1] Emër bimësh të ndryshme që mbajnë erë të këndshme. Në rastin tonë: lavandula angustifolia Milli; shqip lëvanda.
[2] Lloj rrushi që nuk njihet.
[3] I ndryshueshëm.
[4] Rrush që piqet shpejt, por që nuk ia dimë emrin.
[5] Apium graveolens L.
[6] Ka të ngjarë që ky emër të ketë lidhje me fjalën shqipe baliskë, balikë=a, e bardhë. Në bregdetin tonë rritet një lloj rrushi me të gjitha karakteristikat e baliskut dhe që në popull e quajnë vlosh.
[7] Vera e tij të bie në kokë.
[8] Sinapis alba L. – Në popull quhet sinap ose llapsanë.
[9] G.J.Cezari.
[10] Valeriana celtica L. – Në popull quhet haraçinë.

madhi i të gjithëve dhe me një shije të hidhët. Irisi i Ilirisë është dy llojesh: ai që i ngjan rafanetit[1] dhe rizotomi[2] i kuqërremtë që është më i miri. Irisi më i mirë është ai që po ta trazosh, të bën të teshtitësh. Kërcyelli i irisit është i gjatë me një bisk, dhe i drejtë. Lulja e tij ka ngjyra të ndryshme, si ylberi, prej ku ka marrë edhe emrin...

LIBRI XXIV

7 (25) Ka edhe një përzierje natyrale pisë-asfalt, prej pisës dhe asfaltit që del në tokat e Apollonisë. Këtë përzierje disa e bëjnë vetë. Ky është një ilaç shumë i mirë kundër zgjebes së berrave dhe kundër plagëve që u shkaktohen memtheve nga lindja. Më e mirë është ajo që del sipër kur përzierja është duke vluar.

LIBRI XXV

7 (34) Genti, mbret i ilirëve, ka zbuluar Gentianën[3]; ajo rritet kudo, por çmohet më tepër ajo e Ilirisë. Ajo ka gjethen e frashërit, por me madhësi si të marules, kërcyellin e ka të njomë dhe të trashë sa gishti i madh, fyell përbrenda, dhe të pajisura me gjethe që shkëmbehen, rrënjën e përkulur, në ngjyrë gati si të zezë dhe pa erë. Gjendet me shumicë në këmbë të maleve subalpine, në vende me lagështi. Përdoret lëngu dhe rrënja. Rrënja ka veti ngrohëse; nuk duhet ta përdorin gratë me barrë.

LIBRI XXVI

8 (55) Gjithashtu perpresa[4] që rritet në Aret dhe Iliri, të cilin e bënin të ziente në ujë deri sa të mbetej 1/3-ta dhe pastaj e pinin.

LIBRI XXXI

7 (39) Në Kaoni e ziejnë ujët e një burimi dhe duke e ftohur nxjerrin nga ky një kripë të dobët jo të bardhë.

8 (43) Quhet garum një lloj tjetër salce e pëlqyer shumë, e cila përgatitet nga zorrët e peshkut dhe pjesë të tjera që në raste të tjera hidhen... Për garum janë të përmendura edhe Klazomeni, Pomepi, Leptis, sikurse për shëllirën Antipoli, Thuri dhe bile edhe Delmatia.

LIBRI XXXIII

3 (12) Bile edhe burrat mbajnë në llërën e sipërme të dorës *[rrathë ari]*, që vinin nga Dardania, dhe prandaj quheshin dardane...

(13) Populli romak nuk e përdori monedhën prej argjendi përpara se të mundte mbretin Pirro. Ajo *[monedhë]* që tani quhet Victoriat, qe prerë sipas ligjit Klodia. Më përpara, kjo *[monedhë]* vinte nga Iliria, dhe pranohej në vend të mallit. Emri vjen nga figura që paraqet një Victoria[5].

---

[1] Raphanus sativus, L. – rrepa.
[2] Shpatëza e vërtetë.
[3] Gentiana Lutea, L. Në popull kjo bimë quhet sanëz ose bar zemre.
[4] Është bimë ende e papërcaktuar për të cilën thuhet se shërbente për të mjekuar mëshikëzën e urinës.
[5] Perëndesha e fitores.

4 (21) Nganjëherë /ari/ gjendet mbi sipërfaqe të tokës, fat i rrallë ky që ndodhi tani së fundi në Dalmati në kohën e sundimit të Neronit; ky rrem /ari/ jepte ditë-ditë deri në 50 libra.

LIBRI XXXV

15 (51) Edhe ai /asfalti/ i Apollonisë është i lëngshëm; të gjitha këto /lloje asfaltesh/ grekët i quajnë pisasfalton, sikur të donin të thonin se janë të përbërë nga pisa e asfalti.

LIBRI XXXVII

7 (27) Në Thesproti ka një mineral që quhet anthracit e që është i përngjashëm me qymyrin. Ata që kanë shkruar se ndodhet edhe në Liguri, janë gënjyer, ndoshta ka pasë në kohën e tyre.
Thuhet se është e pajisur me një rrem të bardhë, që e rrethon. Ka një ngjyrë të kuqe si gurët që thamë sipër; por është për t'u çuditur, që kur hidhet në zjarr shuhet, përkundrazi kur laget me ujë ndizet.

FRONTINI

Sekst Jul Frontini lindi aty nga viti 40 i e. sonë. Në Romë ai ushtroi ofiqe të larta shtetërore. Në vitin 70 qe pretor. Pas konsullatës, të cilën e arriti për të parën herë në kohën e Vespasianit u dërgua në Britani (në vitet 76-78) si sundimtar i saj. Në kohën e sundimit të Nervës u bë rishtas konsull dhe në vitin 97 inspektor i ujsjellësve në Romë. Për të tretën herë u bë konsull në vitin 100. Me sa duket vdiq aty nga viti 103 i e. sonë.

Nga veprat e tij janë ruajtur vetëm dy: "De aquis urbis Romanae" (Mbi ujësjellësit e qytetit të Romës) e shkruar në vitin 97, ku bëhet fjalë për furnizimin me ujë të Romës, dhe "Strategematon" (Dinakëritë luftarake) në katër libra, në të cilën flitet për disa dredhi dhe manovra luftarake para luftës, gjatë betejës, pas saj dhe në rrethimet.

Nga stratagemat e Frontinit ndeshim në mes të tjerash të dhëna edhe për manovrimin luftarak të mbretit të molosëve Arrybës, si dhe të Aleksandrit dhe Pirros së Epirit, në luftërat e tyre kundër ilirëve dhe romakëve.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Juli Frontini, Strategematon, lib. quatuor, edidit G. Gunderman. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1888.

JULII FRONTINI

STRATA GEMATON

(Dinakëritë luftarake)

LIBRI II

2. Zgjedhja e fushës së betejës

1 M. Kuri duke parë se nuk mund t'i qëndronte falangës së hapur të mbretit Pirro, u përpoq të luftonte në ngushtica, ku ajo duke qenë e mbledhur, bëhej pengesë për veten e saj.

3. Rreshtimi i ushtrisë

21 Pirrua duke luftuar në ndihmë të Tarentit në Auskuli, i udhëhequr nga një varg homerik sipas të cilit të dobëtit duhen vënë në mes, vendosi në krahun e djathtë samnitët e epirotët, në të majtin brutët dhe lukanët me salentasit, kurse në mes vendosi tarentasit. Kalorësit dhe elefantët urdhëroi të mbahen si rezervë. Konsujt përkundrazi, pasi ndanë si duhet kalorësinë në të dy krahët, vendosën në vijë të parë dhe në rezervë legjionet dhe u shtuan atyre trupat ndihmëse. Është e sigurtë se nga dy ushtritë qenë dyzet mijë vetë. Pirrua humbi gjysmën e ushtrisë së tij, tek romakët munguan pesë mijë vetë.

4. Si të trubullohen radhët e armikut

9 Valer Levini, duke luftuar kundër Pirros, vrau një ushtar dhe duke mbajtur shpatën e gjakosur në dorë u mbushi mendjen të dy ushtrive se Pirrua ishte vrarë. Kështu armiqtë, duke kujtuar se kishin mbetur pa komandant u trubulluan nga kjo gënjeshtër dhe të tmerruar u tërhoqën në lëmin e tyre.

12 Përballë kalorësisë shumë të fortë të armikut, Krezi vuri një kope me deve. Kuajt të trembur nga këto kafshë të çuditshme dhe nga era e tyre, jo vetëm që i rrëzuan kalorësit, por edhe pështjelluan radhët e këmbësorisë së tyre, duke i dhënë kështu mundësinë armikut që t'i dërrmojë.

13 Pirrua, mbreti i epirotëve, duke luftuar në ndihmë të Tarentit, përdori po në këtë mënyrë elefantët për të prishur radhët e romakëve.

5. Pritat

10 Epiroti Aleksandër, pasi u ngriti një pritë ilirëve, veshi disa nga ushtarët e tij si ilirë dhe u dha urdhër të shkretonin viset e tij /epirote/. Kur e panë këtë, ilirët u lëshuan më me guxim në grabitje duke i marrë ata që kishin përpara si zbulues të tyre.

Të tërhequr kështu në vendin e pritës u thyen dhe u vunë në ikje.

19 Arryba, mbreti i molosëve, i sulmuar nga iliri Bardhyl, që kishte një ushtri pak më të madhe se ajo e tij, i largoi njerëzit e paaftë për armë në krahinën fqinje, në Etoli, dhe përhapi lajmin se kishte vënë veten dhe qytetet e tij nën vartësinë e etolëve. Ai me ata që mund të mbanin armë ngriti prita në male e në vende të vështira. Ilirët, duke pasur frikë se etolët do të pushtonin gjithçka kishte qenë e molosëve, u lëshuan me shpejtësi për të plaçkitur me radhë të çrregullta. Kur përparonin të shkujdesur dhe pa dyshuar për asgjë, Arryba doli nga prita dhe i shpartalloi.

43 Liburnët, pasi ishin tërhequr në një vend me ujë të pakët, duke mbajtur vetëm kokën jashtë, bënë që armiqtë të kujtonin se vendi ishte i thellë dhe anija me tri sërë lopatash që i ndiqte, mbeti në baltë dhe u kap.

6. Si duhet lënë armiku të iki në mënyrë që duke qenë i rrethuar të mos e rifillojë luftën nga dëshpërimi.

9 Pirrua, mbret i epirotëve, pasi kishte pushtuar një qytet, i mbylli portat, por duke parë se nga nevoja e domosdoshme ata që ishin mbyllur brenda luftonin trimërisht, u dha mundësi të iknin.

10 Po ky, midis udhëzimeve të tjera për komandantët, i porosiste të mos e ndiqnin me këmbëngulje armikun që ishte duke ikur, në mënyrë që ai jo vetëm të mos detyrohet të bëjë qëndresë më të fortë, por edhe që pastaj të vendosë më lehtë për tërheqje, duke ditur se fituesit nuk do t'i ndjekin të mundurit deri në shkatërrimin e plotë të tyre.

LIBRI III

6. Si t'u pritet ndihma armiqve

2 P. Kornel Scipioni, si u bind për vështirësinë e pushtimit të Delminit, që mbrohej prej forcash të ardhura nga të gjitha anët, sulmoi më parë qytete të tjera; duke detyruar forcat të mbronin këto qytete, ai pushtoi Delminin që kishte mbetur pa ndihma.

3 Pirrua, mbreti i epirotëve, në luftë kundër ilirëve donte të pushtonte qytetin që kishte qenë qendra e tyre; si humbi shpresën për këtë, filloi të sulmojë qytete të tjera. Si rrjedhim armiqtë, duke patur besim se qyteti i tyre ishte mjaft i fortifikuar, u shpërndanë për të ndihmuar qytetet e tjera. Si i tërhoqi ata në këtë mënyrë Pirrua e sulmoi me gjithë ushtrinë dhe e pushtoi qytetin që kishte mbetur pa mbrojtës.

LIBRI IV

1. Mbi disiplinën

14 Qëmoti romakët dhe popujt e tjerë zakonisht e ngrehnin lëmin thuajse me kasolle të shpërndara aty-këtu sipas kohorteve, pasi atëherë dinin vetëm të fortifkonin muret e qyteteve. Pirrua, mbreti i epirotëve, qe i pari që filloi ta mbante gjithë ushtrinë brenda të njëjtit ledh. Pastaj romakët, si e thyen atë ndër fushat aruzine në Malevent dhe si e shtinë në dorë lëmin e tij, panë vendosjen e atij lëmi dhe arritën pak nga pak gjer në atë që është sot në përdorim.

42 Konsulli K. Kurioni në luftën e Dardanisë në rrethet e Dyrrahut, kur njeri nga pesë legjionet, duke ngritur krye, iu shmang shërbimit ushtarak dhe tha se nuk kishte ndërmend të ndiqte komandantin e paarsyeshëm në një ekspeditë të vështirë e të rrezikshme, urdhëroi katër legjionet të dilnin të armatosur, të radhiteshin në formacion luftarak me armë të zhveshura. Pastaj i dha urdhër ushtarëve të legjionit kryengritës të dilnin të paarmatosur dhe të zbërthyer dhe në prani të ushtrisë së armatosur i vuri të presin kashtë. Pa u prekur deri në fund nga lutjet e këtij legjion ai u tërhoqi flamujt, u hoqi emrin dhe i shpërndau ushtarët në legjionet e tjera.

TACITI

M. Kornel Taciti, shkrimtar dhe magistrat, kaloi gati gjithë jetën e tij në Romë (vitet 55-120 e. sonë). Ai shkroi një sërë veprash, më të përmendurat e të cilave janë: "Dialogus de oratoribus" (Dialogu mbi oratorët); një jeëshkrim i Agrikolës; "Germania", vepër me të dhëna të çmueshme për germanët, për forcën, natyrën dhe zakonet e tyre; "Historitë" dhe "Analet". Historitë e Tacitit në 14 libra tregonin ngjarjet e principatit nga Galba te Domitiani (viti 69-96). Tek ne kanë arritur vetëm 4 libra të plotë dhe fillimi i të pestit; kurse nga "Analet" kanë arritur 6 librat e parë mbi sundimin e Tiberit.

Veprat e fundit, më të mëdhatë, të Tacitit kanë arritur në një gjendje shumë të fragmentuar, megjithatë shihet se ai ka zgjedhur një lëndë të gjerë për historinë e Romës me ngjarje të shumta, lufta civile, fitore e humbje, skandale e intriga. Skema e këtyre veprave ndjek një rend kronologjik, kurse faktet grupohen sipas skenave të provokuara nga personalitetet.

Duke përshkruar ngjarje të ndryshme, Taciti tregon për pjesëmarrjen në to të legjioneve dhe të funksionarëve të Ilirikut.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Oeuvres Complètes de Tacite avec la traduction en français publiées sous la direction de M. Nisard, Paris 1883.

CORNELII TACITI

ANALES

(Analet)

LIBRI I

5 ... Si do që të jetë, Tiberi po hynte me vështirësi në Iliri, kur letra të ngutshme nga e ëma e ftonin në Nola. Ai nuk dinte a do ta gjente Augustin akoma gjallë apo vdekur...

16 E tillë ishte gjendja në Romë, kur legjionet e Panonisë ngritën krye, pa asnjë arsye tjetër përveç lehtësisë për të bërë trubullira nën një prijës të ri dhe shpresës për t'u pasuruar në një luftë civile.

46 Ndërkaq Roma, e cila nuk dinte akoma rezultatin e trubullirave të Ilirisë, duke mësuar për kryengritjen e legjioneve të Germanisë, u alarmua dhe përshpëriste se Tiberi me pavendosmërinë e rremtë nuk merrej me asgjë tjetër veçse tallej me një senat dhe një popull të pafuqishëm dhe pa armë...

LIBRI II

44 Pak kohë më vonë u dërgua Druzi në Iliri, me qëllim që të mësonte artin luftarak dhe të fitonte dashurinë e ushtarëve...

53 Vitin në vazhdim qenë konsuj Tiberi e Germaniku. Tiberi ishte për të tretën herë, Germaniku për të dytën. Por, kur ky i fundit mori në dorëzim detyrën, gjendej në Nikopol, qytet i Ahesë ku kishte vajtur gjatë bregut të Ilirisë, pasi kishte parë vëllanë e tij Druzin, që gjendej atëherë në Dalmati. Shtrëngatat e mëdha, që zunë në detin Adriatik dhe pastaj në Jon, e detyruan të qëndronte disa ditë në Nikopol...

LIBRI III

7 Atëherë gjyqet u rihapën, çdo njeri rimori detyrat e tij, dhe Druzi u nis për në ushtrinë e Ilirikut...

9 Pisoni, pasi kaloi detin Dalmatik dhe la anijet në Ankonë, arriti nëpër Picen rrugën Flaminia, ku u bashkua me një legjion, i cili nga Panonia shkonte në Romë për të kaluar në Afrikë...

11 Në këtë ndërkohë, Druzi kishte ardhur nga Iliriku. Senati i kishte bërë nderime për veprimet e viteve të kaluara...

LIBRI IV

5 ... Remetalku e djemtë e Kotysit ishin ngarkuar për Thrakinë. Dy legjione në Panoni e dy në Myzi, mbronin bregun e Danubit. Dy të tjerë të vendosura në Dalmati ishin, nga pozita e kësaj province, të gatshëm për të ndihmuar të parat dhe për të mbrojtur

bile Italinë, në rast të një sulmi të papritur...

LIBRI VI

37 ... Fill pasi ushtria kaloi lumin mbi një urë anijesh, erdhi menjëherë në lëm Ornopsadi, me një grup të madh kalorësish. Ky parth, dikur i internuar, kishte shërbyer në trupat ndihmëse në kohën kur Tiberi po përfundonte shtypjen e kryengritjes dalmate dhe ishte dalluar sa që meritoi titullin e qytetarit romak.

LIBRI XVI

13 ... Po këtë vit u morën ushtarë rekrutë në Galinë narboneze, në Afrikë, për ushtrinë e Ilirikut ushtarët e të cilës, pleq e të sëmurë, u liruan...

2. HISTORIARUM

(Historitë)

LIBRI I

76 Ngjarja e parë që i dha shpresë Otonit, qe lajmi i ardhur nga Iliriku se legjionet e Dalmatisë, Panonisë e Myzisë i ishin betuar atij...

LIBRI II

11 Ndërkaq lufta po fillonte në favor të Otonit, sepse ushtritë e Dalmatisë e të Panonisë ishin vënë nën komandën e tij. Ishin katër legjione dhe secili dërgoi nga dymijë vetë.
... Ne /otonasit/ përkundrazi i kemi të gjitha me bollëk e të sigurta; Panoninë,
32 Myzinë, Dalmatinë, Lindjen me ushtri të shumta...
... Legjionin e tretë, pasi kishte kaluar nga Siria në Myzi, ai /Vespasiani/ e
74 konsideronte si të vetin; ai shpresonte se legjionet e tjera të Ilirikut do të bashkoheshin me të, sepse gjithë ushtritë ishin të fyera nga arroganca e ushtarëve, që vinin nga Viteli.
... Muci kishte urdhëruar flotën që shkonte nga Ponti në Byzant, i pasigurtë në se do
83 të linte rrugën e Myzisë për të vajtur me ushtrinë tokësore të tij kundër Dyrrahut dhe për të mbyllur në të njëjtën kohë me anijet e mëdha detin për në Itali...

FLORI

Luc An Flori, historian romak me prejardhje nga Afrika, jetoi në gjysmën e dytë të shek. I dhe në gjysmën e parë të shek. II të e. sonë. ËShtë i njohur edhe si gojëtar e poet. Në kohën e Hadrianit shkroi një histori shumë të shkurtër të Romës, e cila paraqet në vetvete një kompilim të veprave të historianëve më të vjetër dhe kryesisht të Tit Livit, ku në mënyrë retorike hiperbolizohen heroizmat e popullit romak. Në këtë vepër përshkruhet historia e luftërave romake që nga themelimi i Romës e deri tek sundimi i Augustit. Në historinë e tij ka shumë gabime, megjithatë ajo ka në vetvete një farë vlere në ato pjesë që plotësojnë librat e humbur të Tit Livit.

Vepra e Florit ka rëndësi për historinë tonë të lashtë pasi në të përshkruhen disa ngjarje luftarake të Romës kundër Pirros, kundër ilirëve si edhe ngjarjet e luftës civile të zhvilluara në Iliri, luftë e cila siç dihet solli shkatërrimin e republikës romake dhe vendosjen e principatit të Oktavianit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Collection des Auteurs latins, Salluste, Jules César, C. Velléius Peterculus et A. Flours avec la traduction en français publiées sous la direction de M. Nisard. Paris 1874.

L. ANNAEI FLORI

EPITOME

(Përmbledhje)

LIBRI I

18 – Lufta kundër Tarentit dhe mbretit Pirro.

Vjen pastaj lufta e Tarentit që nga titulli dhe emri kujtojnë se është drejtuar kundër një populli të vetëm, por që nga fitorja kap shumë popuj. Në fakt kampanët, apulët, lukanët dhe krerët e kësaj lufte tarentasit s.m.th. gjithë Italia dhe bashkë me ta Pirrua, mbreti më i famshëm i Greqisë, u përfshinë në një rrënim të përbashkët; kështu që në të njëjtën kohë me këtë luftë, përfundonte pushtimi i Italisë dhe fillonte preludi i triumfeve të përtejdetit.

Tarenti i ndërtuar nga lakedemonët, njëkohësisht kryeqytet i Kalabrisë, Apulisë e gjithë Lukanisë, është i përmendur për madhështinë e tij, për muret dhe limanin e vendosur në ngushticën e detit Adriatik, që admirohej për pozicionin që kishte. Anijet e tij vozisin në të gjitha tokat, në Istri, Iliri, Epir, Ahe, Afrikë, Siqeli. Mbi skelë, përballë detit, ngrihet një teatër i madh, i cili qe burimi i të gjitha shkatërrimeve të këtij qyeti fatkeq. Tarentasit zhvillonin lojëra, kur panë rastësisht një flotë romake që lundronte gjatë brigjeve; të bindur se ishin armiq, u ngritën menjëherë pa menduar dhe u shpërndanë duke sharë: "Kush janë, thonin ata, nga vijnë këta romakë?" Nuk mjaftonte kjo, të dërguarit që kishin ardhur për t'u ankuar, i shanë me fyerje të rënda, të cilat është turp të thuhen; ky qe fillimi i luftës. Pjesëmarrja në këtë luftë qe për t'u çuditur; një numër shumë i madh popujsh u ngritën në përkrahje të tarentasve; Pirrua, më i zjarrti ndër të gjithë, që digjej për të hakmarrë një qytet gjysmë grek, të themeluar nga lakedomnët, erdhi nëpër det e nëpër tokë me të gjitha forcat e Epirit, Thesalisë, Maqedonisë dhe elefantët, deri atëherë të panjohur. Fuqisë së luftëtarëve, kuajve dhe armëve i shtohej akoma tmerri që kallnin këto kafshë.

Beteja e parë pranë Heraklesë, në brigjet e Lirit, lum i Kampanisë, që u bë kur ishte konsull Levini, qe aq e tmerrshme, sa që prefekti i kalorisë ferentase, Obsidi, duke sulmuar mbretin e turbulloi dhe e detyroi të tërhiqej nga kjo përleshje, i zhveshur nga shënjat dalluese. Pirrua do të kishte mbaruar sikur elefantët, duke kthyer luftën në shfaqje, me madhësinë e trupit të tyre, me erën e tyre të panjohur dhe britmën e hollë, të mos kishin trembur kuajt, të cilët i kujtuan armiqtë më të tmerrshëm se sa ishin në të vërtetë dhe shkaktuan me ikjen e tyre një shkatërrim të madh e të përgjakshëm.

Pastaj u luftua më me sukses në Askuli, në Apuli, kur ishin konsuj Kuri e Fabrici. Tani tmerri i shkaktuar nga elefantët ishte zhdukur dhe Gai Minuci, heshtëmbajtës i legjionit të katërt, duke prerë feçkën e një elefanti, kishte treguar se këto kafshë mund të ngordhnin. Kështu /elefantëve/ ata u hodhën majat e heshtave, kurse urat e zjarrit të

hedhura kundër kullave mbuluan trupat armike me zjarr e flakë. Kjo përleshje e përgjakshme mori fund vetëm atëherë kur nata i ndau luftëtarët dhe vetë mbreti, i plagosur në shpatull dhe i bartur nga roja e tij mbi mburojë, iku i fundit.

Beteja e fundit u bë në Lukani, në fushat e quajtura Arusine, nga po ata komandantë që përmenda më lart, por këtu fitorja qe e plotë dhe rasti e solli atë që duhej ta bënte virtyti. Elefantët ishin vendosur përsëri në ballë të ushtrisë; njëri prej tyre, akoma i ri, u plagos rëndë nga një heshtë që iu fut në kokë dhe, duke u kthyer pas, shpartalloi ushtarët; nga britmat e tij e ëma e njohu dhe u lëshua të hakmerrej dhe duke iu dukur çdo gjë armike solli çrregullime përreth. Kështu po ato kafshë, që në betejën e parë sollën fitoren, në të dytën sollën barazim, kurse në të tretën na e dhanë pa u ndeshur.

Mbretin Pirro e luftuam jo vetëm me armët tona dhe në fushat e betejës por edhe në kuvendet që u mbajtën në Romë. Ky mbret dinak, duke njohur qysh në betejën e parë trimërinë e romakëve, humbi shpresën e triumfit me armë dhe përdori dredhitë. Kështu i dogji të vdekurit, i trajtoi me butësi robërit dhe i ktheu pa ndonjë çmim; duke dërguar pastaj në Romë të deleguar, u mundua me çdo mënyrë të përfundonte një marrëveshje dhe të fitonte miqësinë tonë. Por si në paq ashtu dhe në luftë, si brenda ashtu edhe jashtë, kudo njohu virtytin romak; dhe më tepër se të gjitha, fitorja mbi Tarentin tregoi energjinë e popullit romak, urtësinë e senatit, madhështinë e prijësave.

LIBRI II

5 Lufta kundër ilirëve

Ilirët ose liburnët banonin në fund të vargmaleve të Alpeve, midis lumenjve Arsia e Titi, duke u shtrirë gjatë gjithë bregut të detit Adriatik. Këta popuj të sunduar nga një grua, Teutana, të pakënaqur nga plaçkitjet, i shtuan krimet sa deshën. Të dërguarit tanë, që kërkonin drejtësi për fajet e bëra, u goditën si viktima jo me shpata, por me sëpata. Prefektët e anijeve i dogjën në zjarr dhe më e keqja është se urdhëronte një grua. Prandaj nën komandën e Gnej Fulv Kentimalit ata u nënshtruan krejtësisht. Kokat e të parëve ranë nën sëpatat, si flijime të bëra nga të deleguarit e perëndive Manë.

7 Lufta e parë maqedonase

Menjëherë, nën komandën e Flaminit kaluam malet e kaonëve, të pakapërcyeshme deri atëherë, dhe lumin Aoo, që rrjedh midis shkëmbinjve, d.m.th., pengesat për kalim në Maqedoni...

13 Lufta ilire

Lufta maqedonase ndikoi tek ilirët. Këta ishin nxitur me të holla nga mbreti Perseu për të goditur romakët nga prapa. Pa humbur kohë ata u nënshtruan nga pretori Anici. Mjaftonte të shkatërrohej Scorda[1)], kryeqyteti i tyre për t'i detyruar që të dorëzoheshin...

[1)] Për Scodra = Shkodra.

2 Lufta e Cezarit kundër Pompeut.

Pompeu kishte zgjedhur Epirin për luftë. Por Cezari nuk e la të presë. Vuri rregull ndër ata që la pas dhe, duke kaluar pengesat e shkaktuara nga ashpërsia e dimrit, lundroi për në luftë nëpër shtrëngatë. Lëmin e tij e vendosi pranë Orikut. Një pjesë e ushtrisë, e cila për mungesë të anijeve kishte mbetur me Antonin në Brundis, po vononte të bashkohej me të; duke mos duruar ai guxoi për të nxitur arritjen e ushtarëve të tij, të lëshohej i vetëm në mes një nate të errtë në një det të egërsuar nga erërat. Njihen fjalët që i tha timonierit të tmerruar nga rreziku i afërt: "Pse frigohesh? Ti po shpije Cezarin".
Të gjitha forcat ishin mbledhur, nga njëra dhe tjetra anë, të dy lëmet ishin përballë njëri-tjetrit, por pikëpamjet e komandantëve ishin të ndryshme. Cezari, prej natyre i zjarrtë digjej për të përfunduar luftën dhe nuk pushonte së dhëni shkak Pompeut për betejë, duke provokuar dhe nxitur. Një herë, duke rrethuar lëmin e tij, ai hapi rreth e përqak një llogore gjashtëmbëdhjetë mile të gjatë (por si do ta dëmtonin këta një ushtri për të cilën deti ishte i hapët dhe i sillte asaj të gjitha furnizimet me shumicë?). Një herë tjetër provoi, por pa sukses, të pushtojë Dyrrahun (që vetë pozita e tij e bënte të papushtuar). Përveç kësaj çdo dalje e armiqve ishte një rast për të luftuar (ku njëherë shkëlqeu trimëria e pakrahasuar e centurionit Skevë, mburoja e të cilit u përshkua nga njëqind e njëzet maja heshtash); herë të tjera ai plaçkiti e shkatërroi qytetet aleate të Pompeut, Orikun, Gomfin e kështjella të tjera të Thesalisë...

12. Lufta kundër fiseve të huaja.

Ata që banonin nga veriu u treguan më të panënshtruar. Të tillë ishin norikët, ilirët, panonët, dalmatët, myzëthrakët, dakët, sarmatët e germanët...
... Ilirët banonin edhe në rrëzë të Alpeve, ku i ruajnë grykat e thella të vendit të tyre dhe përrenjtë e rrëmbyeshëm që i rrethojnë. Vetë Cezari drejtoi një ekspeditë kundër tyre dhe ndërtoi ura mbi këta përrenj. Vrulli i ujërave dhe përpjekjet e armiqve sollën pështjellim në ushtrinë e tij. Duke rrëmbyer mburojën e një ushtari, që ngurronte të hipte, ai eci i pari; ushtarët e ndoqën, ura u lëkund dhe ra nën këtë ngarkesë kaq të rëndë. Ai u plagos në duar e në kofshë; gjaku me të cilin u mbulua dhe rreziku që përballoi e bënë më të nderuar e më august dhe armikun që i doli përpara ai e copëtoi.
Panonët kishin si mbrojtje dy pyje e tre lumenj: Dravën, Savën e Istrin. Pasi shkretonin vendet fqinje ata tërhiqeshin midis këtyre brigjeve, për t'i nënshtruar /Oktaviani/ dërgoi Tiberin; ata u mundën në brigjet e lumenjve të tyre. Armët e të mundurve nuk u dogjën, sipas zakonit të luftës, por u hodhën në ujërat, për t'u lajmëruar fitoren atyre që qëndronin akoma.
Dalmatët banonin zakonisht në pyje, kështu që merreshin vetëm me kusari. Marci duke djegur Delminin, kryqytetin e tyre, u kishte marrë forcën kryesore të tyre. Pas tij Asin Polioni (ky është oratori i dytë) u mori tufat, armët dhe tokat e tyre; por qe Tiberi ai i cili, me urdhër të Augustit, i dha fund nënshtrimit të tyre. Ai e detyroi këtë fis të egër të gërmojë tokën dhe të nxjerrë ar prej saj, kërkime që ky fis, më lakmues se të gjithë, i bëri me kaq kujdes e zotësi, sikur arin do ta mbante për nevojat e tij...

SUETONI

Gai Sueton Trankuili lindi rreth vitit 70 dhe vdiq aty nga viti 160 i e. sonë. Pak gjëra dimë mbi jetën e këtij shkrimtari romak, i cili u dallua për dituritë e tij enciklopedike. Arriti poste të larta në administratën perandorake gjatë sundimit të Trajanit dhe u bë për një kohë sekretar i perandorit Hadrian. Gjatë qëndrimit të tij në oborrin perandorak ai nxori nga arkivi i perandorit shumë dokumente, të cilat i shërbyen në hartimin e njërës nga veprat e tij më të mëdha "De vita Caesarum" (Mbi jetën e Cezarëve) ku janë ruajtur të plota biografitë e 12 perandorëve të parë, duke filluar që nga Cezari e deri tek Domitiani. Jo të plota janë ruajtur biografitë e njerëzve të shquar "De viris illustribus". Këto biografi nuk paraqesin vepra historike në kuptimin e vërtetë të fjalës, pasi u mungon renditja kronologjike e fakteve; megjithatë ato formojnë së bashku me veprat e tjera të tija një burim të pasur për historinë e kulturës dhe të literaturës romake.

Për historinë e Ilirisë biografitë e Suetonit kanë rëndësi përderisa në to gjenden të dhëna mjaft të vlefshme për ngjarjet e luftërave civile, për luftërat pushtuese të Augustit në Ilirinë e Veriut, për kryengritjen e madhe të viteve 6-9 të e. sonë, për Apollorinë si qendër e madhe arsimore-shkencore në botën antike, për ndryshimet organizative provinciale, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Suetoni Tranquilii Opera. Vol. I, *De Vita Caesarum* recensuit Maximilianus Ihm editio minor Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1927.

C. SUETONI TRANQUILLI

DE VITA CAESARUM

(Mbi jetën e perandorëve)

LIBRI I

Divus Julius

(I hyjnueshmi Jul)

1 **22** *[*Cezari*]* i ndihmuar nga i vjehrri dhe dhëndëri, zgjodhi për vete nga provincat e shumta, në radhë të parë Galinë, për arsye se rrethanat dhe gjendja e saj jepnin, me sa i dukej atij, mundësi për të festuar një triumf.

Në fillim atij iu dha vetëm Galia Cisalpine dhe me propozimin e Vatinit iu shtua edhe Iliriku; por nuk shkoi shumë dhe me vendim të senatit iu ngarkua dhe Galia Komata[1)], mbasi senatorët kishin frikë se po të mos ia jepnin vetë, populli do ta daroviste edhe me këtë provincë.

2 **29** ... Sikurse mendohet, ai ishte plotësisht i bindur, se kur të donte mund t'i mblidhte veteranët e tij më lehtë, se sa Pompeu ushtarët e tij të rinj. Por me kundërshtarët e tij kërkonte të bisedonte duke vënë si kusht se mund të hiqte dorë nga tetë legjione dhe nga Galia Transalpine, nëqoftëse i liheshin dy legjione dhe Galia Cisalpine ose edhe vetëm një legjion dhe Iliriku, derisa të bëheshin zgjedhjet e konsujve.

1 **36** Në gjithë luftën civile, ai vetë nuk pësoi as edhe një humbje, vetëm legatët e tij, nga të cilët Gaj Kuri u vra në Afrikë, Gaj Antoni ra në duart e armiqve në Iliri, Publ Dolabella humbi një flotë po në Iliri dhe Gne Domi Kalvini humbi një ushtri në Pont. Ai vetë luftoi gjithnjë me fat, mund të themi se kurrë me një sukses të pasigurtë, po të përjashtojmë dy raste: një herë pranë Dyrrahit ku u mund, por nuk u ndoq nga Pompeu. Ai thoshte prandaj se *[*Pompeu*]* nuk dinte të fitonte; në rastin e dytë në Hispani në betejën e fundit, në të cilën gjendja e tij paraqitej aq e dëshpëruar, saqë mendoi të vriste edhe veten.

2 **58** Nga Brundisi kaloi, në kohë dimri, përmes flotës armike për në Dyrrah. Kur trupat e tij, të cilave u kishte dhënë urdhër të niseshin menjëherë pas tij, nuk po dukeshin për një kohë të gjatë, megjithëse u kishte dërguar kasneca mbas kasnecësh për të shpejtuar ardhjen e tyre, hipi më në fund vetë fshehurazi dhe pa asnjë shoqërues, me kokë të mbuluar, mbi një barkë të vogël. Vetëm kur valët ishin pothuajse duke e përpirë, i tregoi varkëtarit se kush ishte dhe e lejoi atë të kthehej meqenëse koha ishte e keqe.

[1)] Kjo pjesë e Galisë quhej kështu, për arsye se banorët mbanin flokë të gjatë.

LIBRI II

Divus Augustus

(I hyjnueshmi August)

2 **8** Cezari, i cili kishte ndërmend, pas nënshtrimit të hispanëve, të fillonte fushatën kundër dakëve dhe më vonë kundër parthëve[1], e dërgoi /Oktavianin/ qysh më parë në Apolloni që të jepej pas studimeve. Kur mori vesh /Oktaviani/ këtu se Cezari u vra dhe se e kishte lënë trashëgimtar, u mendua për një kohë të gjatë, nëse duhej kërkuar ndihma e legjioneve që ishin aty afër; por shpejt hoqi dorë nga ky mendim, të cilin e gjeti si të shpejtuar dhe të pamatur mirë. Nga ana tjetër u nis për Romë për të kërkuar trashëgimin...

2 **17** Jo shumë mbas kësaj doli fitues në betejën detare pranë Aktit. Luftimet vazhduan deri natën, kështu që ngadhnjyesit iu desh të flejë mbi anije. Posa u nis
3 prej Aktit, për të dimëruar në Samo, i erdhi lajmi se ushtarët, të cilët mbas fitores i kishte nisur nga të gjitha legjionet që më parë për në Brundis, kishin ngritur krye dhe kërkonin shpërblime dhe lirim. Menjëherë vrapoi për Itali, ndërsa iu desh dy herë të luftonte me shtrëgata të forta: së pari ndërmjet maleve bregdetare të Peloponezit dhe të Etolisë, dhe pastaj rishtas pranë maleve Keraune – që të dy herët iu mbytën një pjesë e anijeve liburne dhe anija mbi të cilën kishte hipur humbi të gjitha pajisjet dhe iu thye edhe timoni...

1 **19** Ai shtypi në kohë të ndryshme, para se të merrnin fuqi turbullirat, kryengritjet dhe komplotet e zbuluara me tradhëti: të Lepidit të ri, pastaj atë të Varron Murenes dhe të Fan Cepit... Veç këtyre komplotin e Luc Audasit... gjithashtu atë të Asin Epikadit, nga fisi i parthinëve, por i përzier me gjak romak; më në fund ndërmarrjen e Telefit, një skllavi që shërbente si shoqërues i një zonje të lartë, mbasi nuk mungonin edhe komplotet e rrezikshme të kurdisura nga njerëz të
2 klasave të ulëta. Audasi dhe Epikadi donin të rrëmbenin me forcë e t'i dërgonin tek ushtritë vajzën e tij Julinë dhe të nipin, Agripën, që ndodheshin të internuar e të ruajtur në ishuj.

1 **20** Ai vetë ndërmori vetëm dy luftëra të jashtme: të Dalmatisë, kur ishte akoma i ri, dhe luftën kundër kantabërve, mbasi shpartalloi Antonin. Në luftën dalmatine ai bile u plagos; në njërën betejë me një gur të hedhur me sabe mu në gjurin e djathtë, dhe në një betejë të dytë u plagos në njërën kofshë dhe në të dy krahët, nga shëmbja e një ure.

1 **21** Ai nënshtroi pjesërisht vetë, pjesërisht me anën e komandantëve të tij Kantabrinë, Akuitaninë, Panoninë, Dalmatinë, duke përfshirë krejt Ilirinë, Retinë si dhe vindelikët e salasët, dy popuj të Alpeve...

1 **22** ... Duke festuar triumfin e vogël, ai hyri dy herë në Romë, të parën herë mbas luftës pranë Filipit dhe të dytën mbas asaj të Siqelisë. Festoi tre triumfe të mëdhenj: triumfin dalmatin, të Aktit dhe atë të Aleksandrisë, secili prej tyre zgjati tri ditë rresht.

1 **25** ... Në radhët e ushtrisë ai futi skllevër të liruar vetëm dy herë në jetën e tij: përveç shërbimit në Romë, kur binte zjarr dhe kur kishte frikë se mos plasnin turbullira për arsye të shtrenjtimit të drithit – një herë për t'i vendosur si garnizon në kolonitë kufitare me Ilirikun dhe herën e dytë për të mbrojtur brigjet e Renit...

1 **89** Edhe gjuhës e letërsisë greke i kushtoi një kujdes jo të vogël, duke arritur

---

[1] Popull aziatik që banonte krahinën në lindje të lumit Tiger dhe Eufrat dhe në jug të detit Kaspik.

bile edhe këtu suksese me rëndësi. Mësuesi i tij i stilistikës dhe i gojëtarisë greke ka qenë Apollodori nga Pergami, të cilin ai, kur ishte akoma djalosh, megjithëqë Apollodor, ishte i thyer nga mosha, e mori me vete, kur u nis prej Rome në Apolloni...

12 **94** Gjatë qëndrimit të vetmuar në Apolloni, një ditë i shoqëruar nga Agripa, hipi në observatorin e astrologut Teogen. Agripës, i cili e pyeti i pari astrologun, iu fallxhuan gjëra të mëdha e pothuajse të pabesueshme. Nga frika dhe turpi se ora e lindjes së tij do të paraqitej më pak e rëndësishme, ai e vuri në heshtje këtë dhe me këmbëngulje nuk dëgjonte të tregohej. Por kur, pas përpjekjesh të shumta, më në fund me ngurrim e nxori nga goja, Teogeni, u ngrit dhe i ra në këmbë në shenjë nderimi. Qysh prej asaj dite Augusti kishte besim të plotë në yllin e tij dhe shenjën në të cilën kishte lindur e shpalli publikisht, dhe preu një monetë argjendi me figurën e dhisë së egër.

LIBRI III

Tiberius

1 **9** Më vonë ai luftoi në Reti dhe Vindeliki, pastaj kundër Panonisë dhe më në
2 fund kundër Germanisë. Në luftën kundër Retisë dhe Vindelikisë nënshtroi popujt e alpeve, në luftën e Panonisë breukët dhe dalmatët. Nga Germania shpërnguli në Gali dyzet mijë të nënshtruar dhe i dha atyre vendbanime afër brigjeve të Renit. Për këto veprime atij iu njoh triumfi i vogël dhe hyri në Romë hipur mbi karrocë me veshje e zbukurime triumfale; ky nderim, siç thuhet, nuk i qe njohur më parë askujt.

1 **16** ... Por si u dha lajmi i kryengritjes së Ilirisë, /Tiberi/ mori përsipër luftën e
re, e cila ishte më e tmerrshme nga të gjitha luftërat e jashtme, pas luftës punike, dhe për tri vjet e bëri këtë luftë me pesëmbëdhjetë legjione dhe aq trupa ndihmëse në mes të vështirësive më të mëdha dhe me mungesën më të madhe të ushqimeve. Dhe,
2 megjithëse më se një herë i thanë të kthehej, ai nguli këmbë, sepse kishte frikë se nga tërheqja e vullnetshme armiqtë e afërm, më të shumtë në numër, do ta ndiqnin këmba këmbës. Kjo qëndresë e tij pati shpërblim të madh, sepse shtroi dhe ktheu në bindje gjithë Ilirinë që shtrihet në mes të Italisë dhe mbretërisë Norike, Thrakisë e Maqedonisë dhe ndërmjet lumit Danub dhe të gjirit të detit Adriatik.

1 **17** Rëndësia e këtij suksesi u rrit edhe më tepër nga koha në të cilën u arrit. Afërsisht në të njëjtën kohë Kuintil Vari u asgjësua në Germani me tre legjione dhe askush nuk dyshonte në faktin se germanët ngadhnjimtarë do të ishin bashkuar me panonët, në rast se nuk do të kishte qenë nënshtruar më parë Iliriku. Për këto
2 veprime Tiberit iu njoh e drejta e triumfit dhe veç kësaj iu bënë edhe një tok nderime të mëdha. Disa shfaqën mendimin bile, që t'i jepej mbiemri pannonicus, të tjerë ishin për invictus[1)] kurse të tjerë për pius[2)]...

1 **20** Me t'u kthyer nga Germania, ku kishte qëndruar dy vjet, ai festoi triumfin që e kishte pas shtyrë. Atë e pasonin komandantët e tij, për të cilët ai kishte mundur të nxirrte shenjat triumfale. Para se të ngjitej mbi Kapitol ai zbriti nga karroca dhe i ra

---

[1)] I pamposhtur.
[2)] I shenjtë.

në gjunjë të atit /Oktavianit/ që kryesonte këtë ceremoni. Ai vendosi në Ravenë, duke i dhënë dhurata të çmueshme, një prijës të panoneve të quajtur Bato, i cili dikur e kishte lënë të shpëtojë nga një grykë e ngushtë, ku ndodhej i rrethuar me gjithë
1 legjionet e tij[1]. 21 Disa kohë më vonë, një ligj i nxjerrë nga konsujt i besoi atij, së bashku me Augustin, qeverisjen e provincave dhe kujdesin për të caktuar censin. Si kreu këtë të fundit u nis për Iliri. Por u thirr shpejt dhe gjeti Augustinin shumë të sëmurë, por akoma të gjallë dhe mbeti me të i mbyllur një ditë të tërë.

1 **25** Shkaku i ngurrimit të tij rridhte nga frika e rreziqeve, që po i kërcënoheshin nga të gjitha anët; ai shprehej prandaj shpesh herë kështu: ishte duke mbajtur një ujk nga veshët. Një skllav i Agripës me emrin Klemens, kish mundur të grumbullonte në këtë kohë një turmë, jo për t'u nënçmuar, me qëllim që të merrte gjakun e patronit të vrarë. Në të njëjtën kohë Luc Skribon Liboni, një burrë fisnik, ishte vënë në krye të
2 një komploti dhe në Ilirik e Germani kishin shpërthyer dy kryengritje ushtarake. Të dy ushtritë kishin paraqitur kërkesa të shumta e të jashtzakonshme, por mbi të gjitha kërkonin unjisimin e pagesës me pretorianët...

LIBRI IV

C. Caligula

2 **37** Ai urdhëroi të ndërtoheshin anije liburne me dhjetë sërë lopatash, pëlhura e të cilave të kishte ngjyra të ndryshme dhe pupi i tyre të ishte zbukuruar me gurë të çmueshëm...

LIBRI V

Divus Claudius

(I hyjnueshmi Klaud)

2 **13** ... Kur Kamil Skriboniani, komandanti i tij në Dalmati, arriti të ndezë një luftë civile, por kjo u shua për më pak se në pesë ditë...

3 **25** .. Provincat Ahea dhe Maqedonia, të cilat Tiberi i pat marrë nën kujdesin e tij, Klaudi ia ktheu senatit...

[1] Zakonisht robërit, që nxirreshin në triumf, futeshin në burg, ku pastaj i vritnin, kurse Batos për arsyet që përmenden në tekst i fali jetën.

PLUTARHU

Plutarhu, historian dhe filozof grek, moralist i shquar dhe një nga njerëzit më të ditur të kohës së tij, lindi në Herone të Beotisë aty nga viti 46 i e. sonë dhe vdiq rreth vitit 120. Studjoi dhe u edukua në Athinë në frymën e shkollës filozofike të Platonit, më vonë vizitoi Aleksandrinë dhe disa herë me radhë Romën, ku u njoh dhe me perandorin Trajan, i cili e përkrahu shumë në karrierën e tij politike ashtu sikurse më vonë dhe Hadriani.

Nga Trajani u emërua këshilltar i prokonsullit të Ahesë, kurse nga Hadriani prokurator i taksave. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në qytetin e lindjes ku qe zgjedhur dhe arhont. Për një kohë ai ushtroi dhe funksionet e priftit në tempullin e Delfit.

Krahas këtij aktiviteti të gjerë politik, Plutarhu një pjesë të madhe të kohës ia kushtoi studimeve. Ai prodhoi shumë, por mjerisht jo të gjitha veprat e tij kanë arritur deri në ditët tona. Janë ruajtur prej tyre rreth 50 biografi të njerëzve të shquar të kohës antike greko-romake të titulluara "Vitae parallelae" (Jetët paralele). Në radhën e këtyre njerëzve të shquar, të cilët Plutarhu bën përpjekje t'i idealizojë, regjistron edhe mbretin e njohur të Epirit, Pirron, biografia e të cilit paraqet një burim me shumë rëndësi jo vetëm për njohjen e jetës dhe veprimtarisë së Pirros si burrë shteti dhe komandant i shquar luftarak, por edhe për vetë ngjarjet historike që zhvillohen në kohën e tij në Epir dhe Iliri. Shtjellimi i tregimit biografik të Plutarhut është i qartë dhe i gjallë.

Përveç kësaj vepre të madhe biografike, nga Plutarhu na janë ruajtur dhe punime të tjera me tematikë të ndryshme filozofike, politike, etj. të përmbledhura nën një titull të përbashkët "Moralia" (Vepra morale). Në këtë vepër pasqyrohet mirë dhe qartë gjendja e filozofisë, e literaturës dhe e historisë në periudhën e fundit të Helenizmit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Plutarchi vitae Parallelae, Pyrrhi et Marii* recognovit K. Ziegler. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1915.
2) *Plutarchi Chaeronensis, Scripta moralia grecae et latinae.*Tomus primus, Parisiis, Editore Ambrosio Firmin Didot 1841.

PLUTARCHI

1. VITAE PARALLELAE

(Jetët Paralele)

Pyrrhus

(Pirrua)

1 **1** Thonë se i pari që u bë mbret i thesprotëve dhe i molosëve, pas përmbytjes[1], qe Faetoni, i cili ishte njëri prej atyre që erdhën në Epir bashkë me Pellazgun dhe
2 disa thonë se aty në mes të molosëve banuan Deukalioni e Pirrua, pasi ndërtuan tempullin e Dodonës. Me kalimin e kohës pastaj, Neoptolemi, bir i Akilit, me njerëzit që kishte sjellë me vete pushtoi vendin dhe la pas tij një dinasti mbretërish, që u quajtën pirridë sepse ai, kur qe fëmijë që mbiquajtur Pirro, dhe Pirro quajti
3 njërin nga djemtë e tij të ligjshëm, që e kishte me Lanasën, të bijën e Kleodaut, birit të Hyllit. Dhe prandaj edhe Akili në Epir nderohej si hyjni dhe në gjuhën e atij vendi u quajt Aspet[2].

4 Pas mbretërve të parë, ndër ata të mesit, të cilët ishin gati barbarë dhe të parëndësishëm për fuqinë dhe ndërmarrjet e tyre, i pari që u dallua, pse zbukuroi qytetet sipas zakoneve greke, u dha dituri dhe me ligj të mira, thonë se qe Tarrypa.

Biri i Tarrypës ishte Alketa, i Alketës Aryba, dhe nga Arryba e Troa lindi
5 Aiakidi. Ky u martua me Ftien, bijën e Menonit thesal, i cili u bë i përmendur për
6 luftën e Lamisë, në të cilën u bë njeriu më në zë pas Leostenit[3]. Nga Ftia Aiakidi pati Deidamenë, Troen dhe Pirron.

1 **2** Kur pastaj molosët ngritën krye[4], dëbuan Aiakidin dhe thirrën në fuqi të bijtë e Neoptolemit; miqtë e aiakidëve i zunë dhe i vranë, por Androklidi dhe Angeli, me disa të tjerë, mundën ta fshehin Pirron e vogël, që e kërkonin armiqtë dhe të ikin...

3 Pasi shpëtuan kështu nga ndjekësit, arritën në Iliri tek mbreti Glaukia dhe, si e
2 gjetën në shtëpi së bashku me të shoqen, e vendosën fëmijën përdhe në mes të tyre. Mbreti atëherë ra në mendim sepse kishte frikë nga Kasandri, që ishte armik i Aiakidit dhe për një kohë të gjatë po mendohej në heshtje. Në këtë kohë, Pirrua
3 vetvetiu u afrua këmbadoras gjer te mbreti dhe si i kapi me dorë rrobën dhe u ngrit

---

[1] Bën fjalë për përmbytjen e përgjithshme, nga e cila sipas mitologjisë greke, shpëtuan vetëm Deukalioni dhe Pirrua.

[2] Aspet – me sa duket ka lidhje me fjalën shqipe – i shpejtë, që i përgjigjet plotësisht cilësisë kryesore të Akilit.

[3] Komandant i ushtrisë greke që mundi Antipatrin e Maqedonisë, duke e detyruar të mbyllet në qytetin Lamia në vitin 323 para e. sonë.

[4] Në vitin 317 para e. sonë.

në këmbë, duke u mbajtur në gjunjët e tij, e bëri të qeshë një herë, po pastaj i
4 shkaktoi dhimbje, duke qëndruar si një lutës që derdh lot. Disa thonë se ai nuk i ra
ndër këmbë Glaukisë, por duke zënë me dorë altarin e perëndive qëndroi pranë tij
dhe e pushtoi dhe kjo iu duk Glaukisë se ishte diçka hyjnore. Prandaj ia dorëzoi
5 Pirron menjëherë të shoqes me urdhër që ta rriste së bashku me bijtë e tjerë dhe, pak
më vonë, megjithëse fëmija u kërkua nga armiqtë e tij e megjithëse Kasandri i
premtoi dyqind talente, mbreti nuk ia dorëzoi; por kur arriti në moshën dymbëdhjetë
vjeç, pasi e dërgoi me një ushtri të madhe në Epir, e vendosi aty në fron...[1)]

1 **4** Kur ishte afërsisht shtatëmbëdhjetë vjeç dhe kujtonte se e kishte siguruar
fronin, iu desh të bënte një udhëtim mbasi, njëri nga djemtë e Glaukisë, me të cilin
2 ishte rritur së bashku, do të martohej. Atëherë molosët u ngritën[2)] për të dytën herë,
dëbuan miqtë e tij, i rrëmbyen pasurinë dhe thirrën në fron Neoptolemin. Duke
3 humbur kështu mbretërinë dhe i braktisur nga të gjithë, Pirrua shkoi pranë Demetrit,
të birit të Antigonit[3)], që ishte martuar me të motrën e tij Deidamenë...
Duke marrë pjesë në betejën e madhe të Ipsos[4)], në të cilën luftuan të gjithë
4 mbretërit[5)], Pirua që ishte akoma i ri luftoi së bashku me ushtarët e Demetrit, i vuri
përpara ata që ishin drejtuar kundër tij dhe u bë i shquar midis luftëtarëve. Nuk e
braktisi Demetrin as edhe kur u mund; përkundrazi i bëri që t'i mbeten besnike
5 qytetet e Helladës dhe kur ai /Demetri/ lidhi marrëveshje me Ptolemeun, Pirrua
shkoi në Egjipt si peng. Këtu i dha Ptolemeut prova të mëdha të forcës dhe guximit
6 të tij në gjueti dhe në ushtrimet gimnastikore dhe si e pa që Berenika kishte fuqi të
madhe dhe, nga vyrtyti e urtësia, ua kalonte grave të tjera të Ptolemeut, iu tregua
shumë i respektueshëm. Meqenëse ishte i shkathët për të bërë për vete më të fortët,
7 ashtu sikurse urrente frikacakët dhe ishte mbi të gjitha i sjellshëm e i urtë në jetë, u
zgjodh midis princave të tjerë të rinj për t'u martuar me Antigonën, njërën prej
vajzave të Berenikës, që e kishte me Filipin, para se të martohej me Ptolemeun.

1 **5** Kjo martesë e rriti më tepër emrin e Pirros; duke patur edhe ndihmën e gruas
së tij të mençur, Antigonës, ia arriti të mbledhë të holla dhe ushtri dhe u nis për në
2 Epir, për t'u rivendosur në fron. Këtu u prit me gëzim nga një shumicë e madhe
populli, që e urrenin Neoptolemin, i cili sundonte në mënyrë mizore dhe të egër.
Megjithatë, nga frika se mos Neoptolemi kërkonte ndihmën e ndonjë mbreti tjetër, i
3 propozoi paqe dhe miqësi, duke e bërë shok në pushtet.
Por me kalimin e kohës disa njerëz, që dëshironin të ngjallnin ndërmjet tyre
4 dyshime, zunë të intrigonin fshehurazi, duke i nxitur njërin kundër tjetrit. Sidoqoftë
shkaku që e shtyu Pirron të vepronte, thuhet se ishte ky: Mbretërit, mbasi i bënin fli
5 Zotit të luftës në Pasaron të Molosisë, e kishin për zakon të betoheshin para
epirotëve se do të sundonin sipas ligjeve, kurse epirotët u betoheshin atyre se do të
6 mbronin mbretërinë sipas ligjeve. Kjo ceremoni zhvillohej në praninë e të dy
mbretërve, të rrethuar nga miqtë e tyre, që shkëmbenin me këtë rast shumë
7 peshqeshe. Me këtë rast Geloni, besnik i Neoptolemit, pasi përshëndeti në mënyrë
miqësore Pirron, i bëri peshqesh dy pendë qe.

[1)] Në vitin 307 para e. sonë.
[2)] Në vitin 302 para e. sonë.
[3)] Demetri i mbiquajtur "Poliorket" (307-283).
[4)] Qytet i Frygisë. Beteja u zhvillua në vitin 301 para e. sonë prej Kasandrit, Seleukut, Lysimahut, Ptolemeut të bashkuar kundër Antigonit I dhe Demetrit, të birit të tij.
[5)] Komandantët e Aleksandrit të Madh, të cilët pas vdekjes së tij kishin ndarë perandorinë.

Myrtili, njëri nga shërbëtorët e Pirros, ia kërkoi; por meqenëse ai ia dha një tjetri, në vend të tij, Geloni kujtoi se Myrtili ishte fyer. E thirri prandaj për darkë dhe në mes
8 të verës, siç thonin disa, pasi kishte përfituar prej tij, që ishte në lule të rinisë, e pruri fjalën atje ku i duhej, duke e ftuar të hidhej nga ana e Neoptolemit dhe të helmonte
9 Pirron. Myrtili e pranoi propozimin, duke u hequr se u bind dhe i pëlqente kjo punë, kurse nga ana tjetër i njoftoi Pirros...

14 Kur mori vesh këtë Pirrua, aty për aty e mbajti veten, por më vonë, duke u sugiruar se epirotët më të fuqishëm i kishte në anën e tij dhe e shtynin që ta zhdukte Neoptolemin e të mos kënaqej me një pjesë të vogël të pushtetit, por të vlerësonte virtytet e tija të larta për të kryer vepra të mëdha, dhe përveç kësaj i shtyrë nga dyshimi se Neoptolemi mund ta vriste më parë, në ditën e flijimit e thirri për drekë dhe e vrau.

1 **6** Në kujtim gjithmonë të Berenikës dhe të Ptolemeut, kur i lindi një fëmijë nga Antigona e quajti Ptoleme dhe kur themeloi një qytet në gadishullin e Epirit e quajti Berenika.

2 Pas kësaj, duke menduar për ndërmarrje të shumta e të mëdha dhe duke shpresuar të pushtonte të gjitha tokat fqinje, gjeti mënyrën se si të përzihet në punët
3 e Maqedonisë me këtë shkak: djali i madh i Kasandrit, Antipatri, kishte vrarë të ëmën Thesalonikën dhe dëbuar të vëllanë Aleksandrin. Ky dërgoi njerëz tek Demetri, për t'iu lutur që ta ndihmonte dhe ftoi Pirron. Meqenëse Demetri po
4 vononte, i zënë me punë të tjera, Pirrua duke u nisur për ndihmë i kërkoi si shpërblim për aleancën Stymfenë dhe Prauenë që ishin pjesë të Maqedonisë, kurse nga popujt e pushtuar Ambrakinë, Akarnaninë dhe Amfilohinë. Djaloshi ia dha dhe
5 ky, pasi i zuri dhe vendosi në to garnizone, po i shkëputse Antipatrit pjesën tjetër të Maqedonisë për t'ia dhënë aleatit të tij. Mbreti Lysimah[1] ishte gjithashtu i zënë me
6 punë, por duke dashur t'i vinte në ndihmë Antipatrit dhe duke ditur se Pirros nuk i shkonte kurrë ndërmend të tregohej mosmirënjohës ndaj Ptolemeut dhe nuk ia prishte atij për agjë, i dërgoi një letër të rreme në të cilën i thoshte se Ptolemeu e ftonte të hiqte dorë nga kjo ndërmarrje dhe të pranonte nga Antipatri treqind talente.
7 Pirrua si e hapi letrën e kuptoi menjëherë dinakërinë e Lysimahut: përshëndetja me të cilën fillonte letra nuk ishte ajo e zakonshmja: "Babai i dërgon përshëndetje të birit", por "Mbreti Ptoleme përshëndet mbretin Pirro". Megjithëse u zemërua me
8 Lysimahun, prapseprapë ishte i prirur të bënte paqe dhe u takua për të bërë betimin dhe për ta përforcuar atë me flijime. Por kur shkuan për të bërë fli një dem, një cjap
9 dhe një dash, ky i fundit ra përdhe i ngordhur, pa e prekur fare, dhe ndërsa të tjerët filluan të qeshin nga kjo ndodhi, prifti Teodor e këshilloi Pirron të mos betohet, duke i thënë se hyjnitë paralajmëronin me këtë vdekjen e njërit prej tre mbretërve. Kështu, pra, Pirrua nuk bëri paqe.

1 **7** Megjithëse interesat e Aleksandrit ishin rregulluar disi, prapseprapë Demetri erdhi; dhe u duk e qartë menjëherë se ai vinte në ndihmë të një njeriu, që nuk kishte më nevojë për të dhe që përkundrazi kishte frikë. Në fakt pasi qëndruan së bashku
2 pak ditë me një mosbesim, filluan t'i ngrehin kurthe njëri-tjetrit, por Demetri, duke zgjedhur kohën më të përshtatshme, ia kaloi kundërshtarit, vrau djaloshin dhe shpalli veten mbret të Maqedonisë.

3 Ai edhe më përpara kishte urrejtje dhe donte të hakmerrej me Pirron, mbasi ky i fundit kishte bërë shumë inkursione në Thesali; përveç kësaj lakmia, sëmundje që e

[1] Sundues i Thrakisë dhe i një pjese të Azisë së Vogël deri në Frygi.

kanë mbretërit, prej natyre e bënë që këta të dy fqinjë të mos mundnin të jetonin në besim e pa u ndrojtur njëri prej tjetrit dhe sidomos pas vdekjes së Deidamesë. Tani
4 që kishin pushtuar që të dy një pjesë të Maqedonisë dhe interesat e tyre takoheshin, rivaliteti i tyre kishte shkaqe më të rëndësishme. Prandaj Demetri, pasi kishte bërë një ekspeditë fitimtare kundër etolëve, la këtu Pantauhun me një ushtri të madhe dhe vetë u nis kundër Pirros, i cili nga ana e tij, si mori vesh, u nis kundër të parit. Po për shkak të një gabimi në zgjedhjen e rrugës, nuk u takuan dhe Demetri pasi hyri në
5 Epir, filloi ta plaçkisë. Pirrua iu vu prapa Pantauhut dhe e detyroi të pranojë betejë. Si u përleshën ushtarët, lufta u zgjerua dhe u bë e tmerrshme sidomos midis
6 komandantëve. Pantauhu, i cili për triməri, shkathtësi dhe forcë fizike ishte
7 padyshim komandanti më i mirë i mbretit, duke e ndjerë veten të fortë dhe të guximshëm e ngacmonte Pirron, duke e thirrur në dyluftim; dhe Pirrua, të cilit nuk ia kalonte asnjë nga mbretërit për forcë dhe guxim dhe që donte ta bënte familjare famën e Akilit, më tepër për triməri se sa për farefisni, shkonte drejt Pantahut në radhët e para të ushtrisë. Në fillim luftuan me heshta pastaj, si u përleshën, përdorën
8 shpatat me mjeshtri dhe forcë. Pirrua mori një plagë, por i shkaktoi armikut dy, një
9 në kofshë dhe tjetrën në qafë dhe e rrëzoi atë poshtë, por nuk mundi ta vrasë se miqtë e tij ia hoqën nga duart. Epirotët, krenarë për fitoren e mbretit të tyre dhe me
10 admirim të madh për trimërinë e tij, u sulën kundër këmbësorisë maqedonase, e thyen, dhe duke i ndjekur ata që po iknin vranë shumë prej tyre dhe zunë të gjallë pesëmijë vetë.

1 **8** Kjo betejë nuk u shkaktoi maqedonasve aq inat për humbjen që pësuan dhe as aq shumë urrejtje për Pirron, sa ishte përkundrazi e madhe fama dhe admirimi që
2 fitoi Pirrua për trimërinë dhe lëvdatat e gjithë atyre, që kishin parë gjestin e tij dhe kishin marrë pjesë në betejë. Në fakt pamjen, shpejtësinë dhe shkathtësinë e tij e gjykonin të ngjashme me atë të Aleksandrit dhe u dukej sikur shikonin tek ai pothuajse hijen dhe një përsëritje të gjallë të sjelljes dhe fuqisë së tij në luftë dhe, ndërsa mbretërit e tjerë kërkonin ta ngjasonin në veshjen e purpurtë, në gardën personale dhe në qafën e mënjanuar, vetëm Pirrua i afrohej në luftë dhe në trimërinë personale.
3 Për aftësinë e tij të madhe në rreshtimin e ushtrisë dhe dijet strategjike mund të
4 shërbejnë si provë shkrimet që ai ka lënë mbi këtë çështje. Thuhet se kur u pyet njëherë Antigoni se kush ishte komandanti më i mirë u përgjigj: "Pirrua, po t'ia arrijë
5 të plaket", duke dalluar kështu vetëm këtë, midis të gjithë bashkëkohësve. Hanibali, sikur se mund të lexohet edhe në jetën e Scipionit, të parin midis gjithë
6 komandantëve për përvojë dhe shkathtësi quajti Pirron, të dytin Scipionin dhe të tretin veten. Duket tamam sikur Pirrua i ishte kushtuar plotësisht dhe thellohej gjithmonë në këtë dije, të cilën e quante më të denjën për mbretërit dhe nuk kujdesej aspak për
7 gjëra të tjera. Thuhet se kur e pyetën në një gosti se cili prej të dyve, që i binin fyellit, Pitoni apo Kafisia, i dukej më i mirë, u përgjegj: "Komandanti Polyperh[1]", duke pohuar me këtë se për mbretin është më mirë të kujdeset dhe të njohi vetëm këto gjëra...

1 **9** Pas vdekjes së Antigonës, ai u martua me shumë gra për arsye shtetërore dhe
2 për të rritur fuqinë e tij. Në fakt mori për grua të bijën e Audoleonit, mbretit të paionëve; Birkenën të bijën e Bardhylit[2], mbretit të ilirëve dhe

[1] Një prej komandantëve më në zë të Maqedonisë.
[2] Bardhyli i Ri, mbreti i enhelejve.

Lanasën, të bijën e Agathoklit të Syrakuzës, që i pruri si prikë qytetin Korkyra të pushtuar prej Agathoklit. Nga Antigona pati pra të birin Ptolemeun, nga Lanasa
3 Aleksandrin dhe nga Birkena Helenin, më të riun. I rriti të gjithë trima dhe të
4 guximshëm për armë, duke i edukuar që në fëmini me ndjenja fisnike.
5 Thuhet se kur u pyet nga njëri prej tyre, që ishte akoma fëmijë, se kujt do ia linte mbretërinë iu përgjegj: "Atij midis jush, që do të ketë shpatën më të mprehtë". Kjo
6 përgjigje nuk ndryshon shumë nga mallkimi i njohur tragjik: "Me hekur të mprehtë ta ndajnë shtëpinë vëllezërit[1]". Kështu ziliqar dhe i egër është parimi i sundimit.

1 **10** Pas kësaj beteje Pirrua u kthye në atdhe plot lavdi e plane, i kënaqur në vetvete. Epirotët e pritën duke e përshëndetur me mbiemrin "shqiponjë". "Është merita juaj, u tha ai, që unë jam shqiponjë, dhe si të mos jem kur ju me armët tuaja më keni ngritur lart si me krahë të shpejta?".
2 Pak kohë më vonë, ai kishte marrë vesh se Demetri ishte i sëmurë rëndë, hyri papritmas në Maqedoni vetëm për të grabitur e për të bërë plaçkë. Edhe përpak e pushtoi të gjithë pa luftuar dhe desh u bë zot i gjithë mbretërisë; ai arriti deri në
3 Edesë pa gjetur asnjë kundërshtim dhe shumë u hodhën nga ana e tij dhe luftuan bashkë me të. Rreziku që po e kërcënonte e tronditi Demetrin, i cili nuk ishte shëruar
4 akoma mirë dhe, pasi miqtë e komandantët e tij mblodhën në një kohë të shkurtër një ushtri të madhe, u nisën me guxim e trimëri kundër Pirros. Por meqenëse ai kishte
5 ardhur vetëm për plaçkë nuk i priti; në tërheqje humbi një pjesë të ushtrisë, mbasi gjatë rrugës u sulmua nga maqedonët. Demetri megjithëse e kishte dëbuar Pirron nga vendi i tij shpejt dhe me lehtësi nuk e ngau më tej; duke menduar për ndërmarrje të mëdha dhe për rifitimin e zotërimeve, që kishin patur të parët e tij, me ushtrinë prej njëqind mijë vetësh dhe flotën prej pesëqind anijesh (që kishte përgatitur) nuk donte të përleshej me Pirron; ai as nuk donte t'u linte maqedonasve një fqinj të rrezikshëm që nuk rrinte kurrë i qetë, por meqenëse nuk kishte kohë të luftonte me të, vendosi të bëjë paqe dhe u drejtua kundër mbretërve të tjerë.
6 Si përfundoi kjo marrëveshje, bashkë me përgatitjet e mëdha doli i qartë edhe qëllimi i Demetrit. Mbretërit, të trembur, i dërguan Pirros letra, me anën e të cilave shprehnin habinë se si ai, duke lënë të kalonte këtë rast të përshtatshëm, priste të luftonte me Demetrin atëherë kur t'i vinte mbarë këtij të fundit. Ndërsa ai do të mund ta dëbonte nga Maqedonia vetëm tani që Demetri kishte një mijë telashe dhe ishte në rrëmujë, pa pritur që të detyrohej të luftonte kundër tij për të mbrojtur tempujt dhe varret e molosëve, kur Demetri të ishte i lirë dhe i fuqishëm, aq më tepër tani shpejt ai i kishte marrë Korkyrën dhe gruan. Me të vërtetë Lanasa, e zemëruar pse Pirrua
7 kujdesej më shumë për gruan barbare, ishte larguar në Korkyrë dhe, duke dashur të martohet prapë me mbret, thirri Demetrin, të cilin e dinte se ishte më i gatshëm nga mbretërit për të bërë të *[këtillë]* martesa. Ai erdhi atëherë në Korkyrë, u martua me Lanasën dhe la një garnizon në qytet.

1 **11** Mbretërit, ndërsa i shkruanin këto Pirros, kërkonin që edhe vetë të mos ta linin të qetë Demetrin, që merrej akoma me përgatitje. Kështu Ptolemeu u nis me një
2 flotë të madhe dhe ngriti kundër tij qytetet e Heladës; Lysimahu hyri nga Thrakia në Maqedoninë Veriore dhe e shkretoi. Pirrua, që u vu në lëvizje bashkë me ta, u
3 drejtua kundër Berojës, duke menduar, si ndodhi në të vërtetë, se

[1] Marrë nga Euripidi. Phoen. 68.

Demetri për t'i bërë ballë Lysimahut, do të linte pa mbrojtje Maqedoninë Jugore...
6 përshkoi me shpejtësi të madhe rrugën, që akoma i kishte mbetur, pushtoi Berojën
dhe pasi vendosi aty pjesën më të madhe të ushtrisë, zuri me anë të komandantëve të
7 tij edhe pjesën tjetër të vendit. Kur Demetri e mori vesh këtë gjë dhe vuri re se në
lëmin e maqedonasve kishte filluar një lëvizje që paralajmëronte diçka të keqe, nuk
deshi ta çonte ushtrinë më tej, pse kishte frikë se mos ushtarët, kur të ndodheshin
8 pranë mbretit Lysimah, që ishte maqedonas dhe gëzonte famë të madhe, kalonin në
anën e tij. Prandaj u kthye mbrapa, u drejtua kundër Pirros, që ishte i huaj dhe
prandaj i urryer nga maqedonasit. Por, kur vendosi lëmin afër tij, shumë nga ata që
vinin nga Beroja e lëvdonin Pirron si të pathyeshëm në luftë, të shkëlqyeshëm, të
9 urtë dhe shpirtgjerë kundër armiqve të zënë rob.
Kishte edhe të tjerë të dërguar nga vetë Pirrua, të cilët shtyheshin sikur të ishin
maqedonas dhe shkonin duke thënë se ky ishte rasti më i mirë për të shpëtuar nga
10 zgjedha e rëndë e Demetrit dhe për të kaluar tek Pirrua, njeri ky më i sjellshëm dhe
mik i ushtarëve. Pjesa më e madhe e njerëzve e nxitur në këtë mënyrë shikonte rreth
11 e rrotull dhe kërkonte të shikonte Pirron. Në fillim nuk e dallonin dot pse nuk kishte
përkrenare, por pastaj kur e kuptoi këtë gjë dhe vuri përkrenaren u njoh nga pupza e
lartë dhe nga briri i cjapit. Atëherë disa nga maqedonasit vrapuan tek ai dhe i
kërkuan urdhër, të tjerët rrethuan kokën me dega lisi sepse kështu ishin të kurorëzuar
12 edhe ushtarët e tij. Pati dhe të tillë që guxuan t'i thonë Demetrit vetë se do të bënte
13 mirë po të tërhiqej dhe t'i lëshonte Pirros çdo gjë. Ai atëherë kur pa se këto fjalë i
përgjigjeshin qëndrimit të ushtrisë u tremb, iku fshehurazi i veshur me një "kausia"
dhe një këmishë të thjeshtë. Pirrua përparoi pa luftë dhe u bë zot i lëmit dhe u shpall
mbret i maqedonasve.

1 **12** Pastaj arriti Lysimahu, i cili tha se rënia e Demetrit ishte edhe vepa e tij dhe
kërkoi pra, që zotërimi të ndahej; Pirrua, që nuk kishte besim të plotë tek
maqedonasit dhe ushqente dyshime kundër tyre e pranoi kërkesën e Lysimahut dhe i
ndanë ndërmjet tyre qytetet dhe vendin. Ky vendim qe i dobishëm për atë çast, sepse
2 bëri që të pushonte lufta midis tyre, por pak më vonë u desh ta pranonin se me
ndarjen ata nuk kishin larguar armiqësinë.
6 ... Për t'i krijuar pengesa të reja Demetrit, që kishte filluar të merrte prapë guxim dhe
për të penguar rritjen e forcës së tij, që po rringjallej si prej një sëmundjeje të rëndë,
Pirrua u shkoi në ndihmë helenëve dhe arriti në Athinë. Këtu u ngjit në Akropol dhe
7 pasi bëri flijime për Athinanë, zbriti po atë ditë në qytet dhe tha se dashuria dhe
besimi që kishte treguar populli për të e kishin kënaqur, por shtoi se po të ishn të
arsyeshëm nuk duhet t'i lejonin asnjë mbreti që t'i avitej qytetit dhe nuk duhet t'i
8 hapnin portat më askujt. Bëri pastaj paqe me Demetrin, por pak më vonë, kur ky
kaloi në Azi, Pirrua, i bindur prej Lysimahut, ngriti kundër tij /Demetrit/ Thesalinë
dhe filloi të luftojë kundër garnizoneve helene, sepe maqedonasit e tij ishin më të
mirë në luftë se sa në paqe dhe ai nuk ishte i lindur aspak për të qëndruar i qetë. Më
9 në fund kur Demetri u shpartallua në Siri, Lysimahu duke e ndjerë veten të sigurtë
10 dhe të lirë, u drejtua menjëherë kundër Pirros. Dhe kur ky e kishte vendosur lëmin në
rrethet e Edesës i zuri karvanin e ushqimeve; e vuri në fillim në një gjendje shumë të
vështirë, pastaj me letra e me fjalë kërkoi të bënte për vete maqedonasit më me
influencë, duke i qortuar që kishin zgjedhur si zot një të huaj, të parët e të cilit i
kishin shërbyer gjithnjë maqedonasve dhe kishin dëbuar veç asaj miqtë dhe farefisin
11 e Aleksandrit. Duke parë se shumicës së ushtarëve po i kthehej mendja, Pirrua u tremb

dhe u largua me epirotët dhe aleatët e tij, duke humbur Maqedoninë, ashtu sikurse e kishte fituar...

4 **13** Romakët luftonin me tarantasit. Këta duke mos qenë në gjendje t'i bënin ballë luftës dhe as të bënin paqe për shkak të guximit dhe shpirtkeqësisë së demagogëve, vendosën të thërrasin Pirron dhe t'i besojnë atij drejtimin e saj, meqenëse ky ishte mbreti më i lirë dhe komandanti më i aftë...

12 Dërguan menjëherë në Epir përfaqësues dhe jo vetëm në emrin e tyre, por edhe në emrin e italikëve, me dhurata për Pirron, duke i thënë se ata kishin nevojë për një prijës trim e në zë, sepse në Itali kishin mbledhur shumë luftëtarë leukanë, mesapë,
13 saunitë dhe tarantas, rreth njëzet mijë kalorës dhe treqind mijë këmbësorë. Kjo ftesë jo vetëm që gëzoi Pirron, por ngjalli edhe midis epirotëve një entuziazëm dhe dëshirë të madhe për ekspeditën.

1 **15** Në fillim dërgoi në Tarant Kinenë me tre mijë ushtarë; pastaj, pasi tarantasit
2 dërguan shumë anije për transportimin e kuajve, anije të tjera të mbuluara dhe shumë të tjera me ngarkesë të çdo lloji, ngarkoi mbi to njëzet elefantë, tre mijë kalorës, njëzet mijë këmbësorë, dy mijë harkëtarë dhe peqësind hobetarë. Kur u bënë të
3 gjitha gati u nis[1]. Në mes të detit Jon flotën e zuri një erë e fortë, që vinte nga veriu, gjë që ishte e parakohshme për stinën. Megjithëse i goditur nga dallgët, në saje të
4 guximit dhe shkathtësisë së detarëve dhe të atyre që drejtonin anijet, ai, mbas shumë mundimesh dhe rreziqesh, mundi të shpëtojë dhe t'i avitet tokës. Nga pjesa tjetër e
5 flotës mbeti një pakicë dhe anijet u shpërndanë gjithandej. Kështu një palë nga këto i hodhi era larg Italisë dhe i shpuri në detin e Libisë dhe Siqelisë; të tjerat, që nuk mundën të kalonin Kepin e Japygisë, i zuri nata dhe një furtunë e egër dhe e tmerrshme, që i përplasi në brigjet shkëmbore pa porte, i shaktërroi të gjitha me përjashtim të asaj të mbretit...

9 Mesapët, në tokën e të cilëve atë /Pirron/ e kishin nxjerrë valët, i erdhën me të shpejtë në ndihmë, ashtu sikurse e kërkonte rasti; ndërkaq të shtyra nga dallgët iu avitën bregut disa nga anijet që kishin shpëtuar, në të cilat ishin pak kalorë, më pak se dymijë këmbësorë dhe dy elefantë.

1 **16** Si mblodhi këto forca, Pirrua u drejtua për në Tarant. Kinea kur mori vesh për këtë, doli për ta pritur bashkë me ushtarët e tij. Si hyri në qytet ai nuk bëri asgjë kundër vullnetit të tarantasve dhe nuk përdori forcën derisa nuk i ishin kthyer nga
2 deti anijet e tij dhe nuk ishte grumbulluar pjesa më e madhe e ushtrisë. Atëherë, kur pa se pa marrë masa të rrepta, populli nuk do të ishte në gjendje jo vetëm të shpëtonte veten, por as të ndihmonte të tjerët, kur pa se, ndërsa ai po luftonte për ta, ata rrinin në shtëpitë, në banjat dhe në kuvendet duke biseduar, urdhëroi të mbyllen gjimnazet dhe shetitoret publike, në të cilat njerëzit humbisnin kohën mbas
3 komenteve mbi ngjarjet dhe grindeshin me fjalë, ndaloi gostitë, festat dhe dëfrimet e tjera që s'pajtoheshin aspak me kohën. Më në fund i thirri nën armë dhe në përpilimin e listave të atyre, që do të shkonin ushtarë, u tregua aq i rreptë dhe i pamëshirshëm saqë shumë ikën nga qyteti, meqenëse nuk ishin mësuar të qëndronin të nënshtruar dhe e quanin si skllavëri, kur nuk mund të jetonin sipas qejfit të tyre.

Kur i njoftuan se konsulli Levin ishte nisur kundër tij me një ushtri të madhe
4 dhe po shkretonte Leukaninë, Pirros nuk i kishin arritur akoma aleatët e tij; por e quajti të turpshme të rrinte i qetë dhe t'i linte armiqtë të aviteshin edhe më tepër, prandaj

[1] Në vitin 280 para e. sonë.

u nis me forcat e tij dhe para se të fillonte lufta u dërgoi romakëve një lajmëtar që t'i propozonte ta bënin atë, nëse dëshironin, pajtues dhe gjykatës për të zgjidhur grindjet që kishin me italikët. Por me që Levini iu përgjegj se romakët nuk e donin Pirron si gjykatës dhe as që i trembeshin si armik, ai shkoi përpara me ushtrinë e tij dhe e vendosi lëmin në fushën midis Pandosisë dhe Heraklesë. Pastaj si mësoi se romakët ishin aty pranë dhe kishin vendosur lëmin e tyre përtej lumit Siri, i hipi kalit dhe shkoi gjer në breg të lumit për të parë vendin (që kishin zënë armiqtë); si pa mirë rreshtimin e trupave, rojet, rregullin dhe vendosjen e lëmit u habit dhe duke iu drejtuar njërit prej miqve të tij që kishte më afër i tha: "Ky rreshtim i barbarëve o Megakli nuk është aspak barbar; se si janë në punë, kemi për ta parë së shpejti". Pirrua, i shqetësuar për të ardhmen, vendosi t'i priste aleatët dhe vuri anës lumit një roje për t'i penguar romakët në qoftë se ata do të përpiqeshin të kalonin para se të vinin aleatët. Por romakët, duke dashur që të bënin diçka përpara se Pirros t'i vinin ndihmat që priste, filluan të kalonin lumin: këmbësoria nëpër va, kurse kalorësit në shumë pika, kështu që helenët të trembur se mos rrethoheshin, u tërhoqën. Kur mësoi për këtë Pirrua, i zemëruar, urdhëroi komandantët e këmbësorisë të rreshtonin me të shpejtë ushtrinë dhe të qëndronin të gatshëm për luftë, ndërsa vetë u sul përpara me tre mijë kalorës me shpresë që t'i zinte romakët gjatë kalimit të shpërndarë dhe të çrregulluar.

Mirëpo kur pa se në këtë anë të lumit po ndrisnin shumë mburoja dhe se kalorësit romakë po përparonin të rreshtuar e me rregull, i mblodhi forcat e tij dhe sulmoi i pari. Këtu ai binte në sy menjëherë jo vetëm nga armët e tij që kishin një zbukurim e shkëlqim të veçantë, por edhe nga trimëria, të cilën me vepra e tregoi se nuk ishte aspak më e vogël se fama e tij. Dhe megjithëse i kushtoi luftës gjithë fuqinë e krahut dhe të trupit të tij, duke zmbrapsur me forcë të gjithë ata që i vinin kundër, nuk humbi as gjakftohtësinë as arsyen, por sikur ishte një vëzhgues i jashtëm e drejtoi luftën duke vrapuar herë në një vend e herë në një tjetër dhe duke u ardhur në ndihmë atyre që ndodheshin në rrezik.

17 ... Duke parë se kalorësia e tij po thyhej, urdhëroi falangën të avitej dhe e rreshtoi për luftë, pastaj ... u sul kundër romakëve. Këta e pritën pa luajtur nga vendi dhe si u ndez lufta rezultatet e përleshjes mbetën për një kohë të gjatë të pasigurta dhe thuhet se shtatë herë me radhë të dy palët u thyen dhe u rikthyen në vendet e tyre...

Më në fund, ndërsa elefantët shkaktuan rrëmujë midis romakëve dhe kuajt pa u afruar akoma u shpërndanë dhe nuk u bindeshin kalorësve, Pirrua dërgoi kundër tyre, sa ishin në rrëmujë, kalorësinë thesale dhe i vuri në ikje duke u shkaktuar dëme të rënda. Dionisi na tregon se në këtë betejë u vranë afro pesëmbëdhjetë mijë romakë, ndërsa Hieronymi[1] thotë se vetëm shtatë mijë; prej ushtarëve të Pirros, sipas Dionisit, mbetën trembëdhjetë mijë, sipas Hieronymit, më pak se katër mijë. Por këta ishin të gjithë më të mirët dhe Pirrua humbi miqtë dhe komandantët që i çmonte më shumë dhe tek të cilët kishte besim të plotë. Megjithatë Pirrua u bë zot i lëmit të braktisur nga romakët, tërhoqi me vete qytetet që ishin aleatë të tyre, grabiti gjithë krahinën dhe shkoi kaq përpara sa që nuk e ndanin nga Roma veçse treqind stade. Pas betejës i erdhën atij shumë ndihma nga leukanët dhe saunitët dhe ai i qortoi që erdhën shumë vonë; por kuptohej megjithatë se ishte i kënaqur e kryelartë, që kishte

[1] Hieronymi nga Kardia, ka shkruar historinë e diadokëve deri në fund të vitit 272 para e. sonë.

mundur ushtrinë romake më të madhe në numër, vetëm me ushtarët e tij dhe tarantasit.

1 **21** Pas kësaj, kur Fabrici mori komandën, në lëmin e tij erdhi një njeri dhe i
pruri një letër nga mjeku i Pirros, në të cilën ai shkruante se ishte gati ta helmonte
Pirron në qoftë se romakët i premtonin një shpërblim të mirë, sepse kështu lufta do
2 të merrte fund pa ndonjë rrezik për romakët. Por Fabrici i zemëruar për pabesinë e
këtij njeriu, në marrëveshje me kolegun tjetër, i cili ushqente të nëjjtat ndjenja, ia
3 dërgoi letrën Pirros, duke e këshilluar që të merrte menjëherë masa për t'u ruajtur
nga ky komplot. Në letër ishte shkruar kështu: "Gai Fabrici dhe Kuint Emili, konsuj
romakë, i dërgojnë përshëndetje mbretit Pirro. Duket se nuk ke patur fat as në
4 zgjedhjen e miqve, as të armiqve. Kur të lexosh këtë letër, që na u dërgua ne, do të
kuptosh se ti po lufton kundër njerëzve të ndershëm e të drejtë dhe u beson miqve të
liq e të pandershëm. Ne të vëmë në dijeni, jo pse të duam të mirën, por që në qoftë se
ti do të pësosh ndonjë gjë, të mos thonë se ne *[romakët]*, duke mos qenë në gjendje
ta fitojmë luftën me trimëri, përdorëm dredhinë". Pirrua pasi lexoi letrat dhe u
5 sigurua për komplotin e dënoi me rreptësi mjekun, kurse Fabricit dhe romakëve, si
shpërblim për të mirën që i kishin bërë, u ktheu robërit pa të holla dhe dërgoi edhe
njëherë Kinenë që të bisedonte për paqen. Por romakët, duke mos e quajtur të
6 ndershme që të pranonin robërit pa shpërblim, qoftë në shenjë mirënjohjeje nga
armiku, qoftë si shpërblim që nuk kishin lejuar një veprim të pabesë, i kthyen po aq
tarantas e saunitë. Por për miqësi e paqe as që nuk deshën të flitej, pa u larguar ai më
parë nga Italia me armët, me ushtrinë dhe anijet e tij, me të cilat kishte ardhur, dhe
pa u kthyer prapë në Epir.

7 Pas kësaj, meqenëse rrethanat kërkonin një betejë tjetër, vuri në lëvizje ushtrinë
dhe arriti deri në afërsitë e Askulit, ku u përpoq me romakët. Por i tërhequr në vende
të papërshtatshme për kuajt e drejt një lumi të rrëmbyeshëm me brigje të pyllëzuara,
i cili u bë pengesë që elefantët të bashkoheshin me falangën, pas plagosjesh dhe
8 humbjesh të shumta, ndërpreu më në fund betejën, pasi kishte luftuar derisa u ngrys.
Të nesërmen, duke dashur që ta zhvillonte betejën në një vend të sheshtë dhe të fuste
elefantët në radhët e armiqve, vendosi roje në vendet më të rrezikshme; vuri në mes
të elefantëve një numër të madh ushtarësh, të armatosur me heshta dhe harqe dhe u
9 sul përpara me vrull me radhë të shtrënguara. Romakët, të cilët nuk mundën të
tërhiqeshin më, sikurse kishin bërë një ditë më parë për ta goditur pastaj armikun nga
10 krahët, u gjetën me të në fushë ballë për ballë. E meqenëse donin të thyenin hoplitët
para se të mbërrinin elefantët, luftuan me tërbim me shpatat e tyre kundër sarisave të
maqedonasve, pa kursyer jetën e tyre, duke mos pasur rrugë tjetër, veçse të vrisnin e
të plagosnin pa u kujdesur për plagët që merrnin.

Pas një luftimi të gjatë filluan të thyhen, të paktën kështu thuhet, radhët që ishin
11 kundër Pirros, i cili kishte bërë kërdinë në radhët e kundërshtarëve. Por mbi të gjitha
ai fitoi në saj të forcës dhe të sulmit të elefantëve, kundrejt të cilëve romakët nuk
mund të përdornin trimërinë e tyre. Nga ana tjetër ata menduan se do të ishte e
nevojshme të tërhiqeshin si prej një dallge të furishme ose lëkundjes së një tërmeti
shkatërrues dhe të mos prisnin të vdisnin kot, pas lodhjesh kaq të mëdha, pa i prurë
ndonjë dobi punës. Gjatë tërheqjes së shkurtër drejt lëmit, sipas Hieronymit, ranë
12 gjashtë mijë romakë; nga ana e Pirros, sikurse shkruan ai vetë në "Kujtimet" e tij, u
mblodhën tre mijë e pesëqind e pesë të vrarë. Dionisi, megjithatë nuk thotë që në
13 Auskul u zhvilluan dy beteja dhe që disfata e romakëve qe e plotë. Por thotë që
mbasi u luftua vetëm një herë derisa perëndoi dielli, më në fund u tërhoqën duke

mbetur i plagosur Pirrua nga një heshtë në krah, kurse ndërkohë daunët i kishin grabitur plaçkat; dhe se ndërmjet ushtarëve të Pirros e të romakëve kishin mbetur të
14 vrarë gjithsej më tepër se pesëmbëdhjetë mijë njerëz. Të dy palët pastaj u tërhoqën. Dhe tregohet se Pirrua njërit që e uroi për fitoren, iu përgjegj: "Në qoftë se do t'i mundim romakët edhe në një betejë të dytë si kjo, do të humbasim plotësisht". Në të
15 vërtetë kishte humbur pjesën më të madhe të ushtarëve që kishte sjellë me vete dhe pothuajse të gjithë miqtë më të dashur dhe komandantët e tij, me përjashtim të një pakice. Dhe as kishte mundësi, nga ana tjetër, të sillte të tjerë dhe i shihte aleatët e Italisë shumë të dobësuar; përkundrazi romakët i plotësonin radhët e tyre me lehtësi e me shpejtësi...

1 **22** Ndërsa ndodhej në rrethana të tilla të vështira i erdhën propozime që e bënë t'i lindin shpresa të reja për ndërmarrje të kota, të cilat nuk pajtoheshin njëra me
2 tjetrën. Kështu në këtë kohë i erdhën delegatë nga Siqelia që i dorëzonin Akragasin, Syrakuzën dhe Leontinin dhe e lutnin të dëbonte kartagasit dhe të çlironte ishullin nga tiranët; në të njëjtën kohë lajmëtarë nga Hellada e vunë në dijeni se Ptoleme Kerauni[1] ishte vrarë në një luftim kundër galëve dhe tani kishte ardhur një çast
3 shumë i volitshëm për të, mbasi maqedonasit kishin nevojë për një mbret. Duke u ankuar për fatin që i sillte njëkohësisht dy propozime për ndërmarrje të mëdha dhe, duke menduar se po të varej çdo gjë nga ai njëra nga të dy ndërmarrjet do të ishte e
4 humbur, mbeti për shumë kohë i pavendosur. Pastaj duke shpresuar se në Siqeli do të kishte suksese më të mëdha, pse ishte edhe më afër Libisë, i drejtoi sytë nga kjo, dërgoi pa vonesë Kinenë, si zakonisht, për të bërë marrëveshjet e para me qytetet...
6 Sa zbriti në Siqeli[2] vuri re me kënaqësi se po i realizoheshin shpresat e tij; qytetet iu dorëzuan vullnetarisht dhe, megjithëse me disa iu desh të përdorë forcën dhe armët, që në fillim nuk gjeti asnjë pengesë serioze. Mbasi erdhi me dyqind anije, tridhjetë mijë këmbësorë dhe dy mijë e pesëqind kalorës, i mundi kartagasit dhe e shkatërroi fuqinë e tyre...

1 **23** Në rrethet e Mesenës banonin barbarë që quheshin mamertinë. Këta u binin shumë në qafë helenëve dhe disave prej tyre u merrnin edhe tribute; ishin të shumtë dhe luftarakë aq sa latinët i kishin quajtur marsas[3]. Pirrua zuri ata që kishin ardhur të vilnin tributet, i vrau dhe pasi i mundi pastaj të tjerët në luftë, shkatërroi shumë prej fortesave të tyre.
2 Ndërkaq kartagasve, që dëshironin të merreshin vesh dhe që premtuan t'i japin shumë të holla dhe ndihmë në anije, nëqoftëse do të lidhej me ta, ky që kishte aspirata më të mëdha, iu përgjegj se kishte vetëm një rrugë për të bërë paqe e
3 aleancë: të linin krejtësisht Siqelinë dhe të pranonin si kufi në mes të tyre dhe helenëve detin e Libisë. I dehur nga fati që i nënqeshte dhe nga fuqia që kishte, kërkonte të vinte në jetë ato shpresa që e vunë në lëvizje kur u nis dhe mendonte më parë se çdo gjë të pushtonte Libinë. Por meqenëse në krahasim me anijet kishte
5 mungesë detarësh filloi të mblidhte vozitës, pa i trajtuar qytetet me urtësi ashtu si e kërkonte puna, bile duke u sjellur si zot, me kryelartësi dhe ashpërsi... por kundër tij
6 lindi një urrejtje e madhe dhe disa qytete u afruan me kartagasit, kurse të tjerët ia besuan veten mamertinëve. Ndërsa pra Pirrua shihte kudo mosbesim, kryengritje e komplote të fuqishme kundër tij, mësoi me anë të një letre nga saunitët dhe tarantasit

---

[1] I biri i Ptolemeut I të Egjiptit.
[2] Në vitin 278 para e. sonë.
[3] Nga Marsi, zoti i luftës.

se ata me vështirësi po u qëndronin armiqve në qytetet pasi ishin dëbuar nga gjithë
7 vendi dhe i luteshin për ndihmë. Ky ishte një pretekst i mirë që kthimi të mos dukej një ikje ose një dështim i ndërmarrjes së tij; por në të vërtetë ky, duke mos qenë në gjendje të mbante Siqelinë, e cila tani i ngjante një anijeje që po mbytej, kërkonte një
8 rrugëdalje, prandaj u kthye me gjithë qejf në Itali. Thuhet se kur ishte larguar mjaft nga bregu, duke i kthyer sytë nga ishulli u tha atyre që e rrethonin: "Çfarë palestre, o miq, po u lemë kartagasve dhe romakëve!" Dhe me të vërtetë pas një kohe të shkurtër ndodhi ashtu sikurse ai e parashikoi.

1 **24** Por edhe ndërsa po largohesh, barbarët deshën t'i krijonin pengesa dhe, duke u përleshur me kartagasit në ngushticë, humbi shumë anije, por megjithatë arriti me
7 të tjerat brigjet e Italisë[1]...
Kështu Pirrua, duke vazhduar i qetë rrugën më tej, arriti në Tarant me njëzet mijë
8 këmbësorë e tre mijë kalorës dhe, pasi futi në ushtrinë e vet edhe tarantasit më të fortë, u drejtua menjëherë kundër romakëve, që ishin fushuar në tokën e saunitëve.
1 **25** Saunitët ishin në një gjendje të keqe dhe të frikësuar pas humbjeve të shumta që kishin pësuar me romakët. Përveç kësaj ata ishin zemëruar nga Pirrua për ekspeditën e tij në Siqeli. Prandaj thirrjes së tij iu përgjegjën shumë pak njerëz.
2 Megjithatë ai i ndau të gjitha forcat e tij në dy pjesë, njërën e çoi në Leukani për të mbajtur në vend njërin nga konsujt, që të mos i vinte në ndihmë shokut të tij dhe tjetrën e mori me vete dhe shkoi kundër Man Kurit, që e kishte ngritur lëmin në një vend të sigurtë afër Beneventit, duke pritur këtu ndihma nga Leukania. Në fakt ai
3 nuk lëvizte këndej sepse shenjat e augurëve dhe të flijimeve nuk kështillonin një gjë
4 të tillë. Pirrua atëherë, duke dashur që ta thyejë atë para se të arrinin të tjerët, zgjodhi më trimat nga njerëzit e tij dhe elefantët më të furishëm dhe u nis natën drejt
5 fushimit romak. Por ndërsa po kalonte një rrugë të gjatë në mes të një pylli të pafund iu mbaruan flakset dhe ushtarëve iu desh të enden andej këndej pa ndonjë drejtim. Duke humbur kështu shumë kohë kaloi nata dhe në agim u doli papritur e pakujtuar
6 nga sipër armiqve, duke u shkaktuar atyre zhurmë dhe rrëmujë. Megjithatë, meqenëse shenjat ishin të mira, Mani i shtrënguar nga rrethanat për t'i shkuar në ndihmë shokut, doli nga lëmi, sulmoi pararojen e armikut, e vuri në ikje dhe u kalli tmerrin të gjithë të tjerëve sa që shumë nga armiqtë u vranë dhe disa elefantë të lënë
7 mbrapa në rrëmujë e sipër u zunë. Kjo fitore e shtyu Manin ta shpërngul betejën në fushë; sulmoi kështu haptazi dhe që në fillim arriti të vërë në ikje një pjesë të armiqve; por pastaj i zënë në befasi nga elefantët dhe i shtyrë drejt lëmit, thirri në ndihmë rezervat, të cilat në numër të madh dhe të freskëta, ishin të gatshme me
8 armët e tyre brenda ledheve. Këta dolën nga pozicionet e tyre të forta dhe me goditje të matura mirë bënë që të kthehen elefantët, të cilët në tërheqjen e tyre të çrregullt shkaktuan në radhët e ushtarëve rrëmujë, që u dha romakëve fitoren...
1 **26** Kështu, pra, u zhdukën shpresat që Pirrua ushqente më kot me Italinë e Siqelinë, mbasi humbi këtu gjashtë vjet në luftëra të vazhdueshme. Me gjithëse fuqia e tij ushtarake u dobësua, guximi i mbeti i patundur dhe për aftësinë e tij ushtarake, për trimërinë dhe vlerën personale u quajt për një kohë të gjatë i pari midis mbretërve të kohës së tij...
3 Mbasi u kthye pra në Epir me tetë mijë këmbësorë dhe pesëqind kalorë, duke mos pasur mjete të mjaftueshme për t'i ushqyer, kërkonte shkak për luftë, që të mund t'i

[1] Në vitin 275 para e. sonë.

siguronte këto. Dhe pasi u bashkuan me të disa galatë, hyri në Maqedoni ku sundonte Antigoni, i biri i Demetrit[1] për të grabitur e plaçkitur. Mbasi kishte pushtuar disa qytete kaluan në anën e tij afro dy mijë ushtarë; kështu, duke i lindur shpresa edhe me të mëdha, u drejtua kundër Antigonit dhe pasi e sulmoi në një vend të ngushtë futi panik në gjithë ushtrinë. Galatët, që formonin praparojen e Antigonit e që ishin në një numër të madh, i bënë qëndresë të madhe; por më vonë, mbasi lufta u bë e tmerrshme, pjesa më e madhe u vranë, kurse drejtuesit e elefantëve, të rrethuar u dorëzuan bashkë me kafshët. Pirrua, pasi korri një sukses të tillë të shkëlqyeshëm, duke pasur më shumë besim në fatin se sa një plan të caktuar që më parë, u drejtua kundër falangës së maqedonasve, e cila ishte në rrëmujë të plotë dhe në frikë nga humbja që kishin pasur galatët. Pikërisht për këtë arsye maqedonasit kërkonin t'i shmangeshin përpjekjes dhe luftës me të, dhe ai atëherë duke ngritur dorën e djathtë dhe duke i thirrur komandantët dhe oficerët me emër, tërhoqi pak nga pak me vete të gjithë këmbësorët e Antigonit, i cili iku, mbasi ishte siguruar më parë për besnikërinë e disa qyteteve të vendosura në bregdet. Pirrua në këto rrethana fatlume, duke e quajtur fitoren mbi ushtrinë e galatëve si ndërmarrjen më të madhe të tij, prej plaçkave të armikut, që i ranë në dorë, zgjodhi ato që ishin më të bukura e më të vyera dhe ia kushtoi faltores së Athinasë Itone me këtë mbishkrim elegjik:

"Pirro Molosi ia dhuron Athinasë Itone
këto mburoja, që ua hoqi galatëve të fortë,
pasi shkatërroi gjithë ushtrinë e Antigonit;
dhe nuk është kjo një çudi e madhe
sepe aiakidët janë edhe tani luftëtarë,
siç kanë qenë në të kaluarën".

Menjëherë pas betejës u bë zot i qyteteve, një nga të cilët ishte edhe Egea...

Nuk kishte siguruar akoma mirë pozitat e tij /në Maqedoni/ kur në mendjen e tij po ushqente shpresa të tjera të reja...

Dhe kur spartani Kleonym e thirri në Spartë ai e pranoi me gjithë qejf... Erdhi këtu me njëzet e pesë mijë këmbësorë, dy mijë kalorës dhe njëzet e katër elefantë. Kjo fuqi kaq e madhe, bëri menjëherë të qartë se qëllimi i Pirros nuk ishte që të sillte Kleonymin në fronin e Spartës, por të bëhej ai vetë zot i Peloponezit. Megjithatë me fjalë ai e mohoi këtë qëllim para spartanëve, që kishin ardhur si përfaqësues në Megalopol dhe u tha se ai kishte ardhur për të çliruar qytetin nga zgjedha e Antigonit...

Me këto fjalë përpiqej të fshihte qëllimet e tij të vërteta dhe të gënjente çdo njeri që gjente rrugës, por sapo zbriti në Lakoni zuri të rrëmbejë e të plaçkisë...[2]

34 Pirrua, duke parë rrezikun dhe rrëmujën që e rrethonte, hoqi diademën që shquante përkrenaren e tij nga ato të të tjerëve dhe ia dha njërit prej shoqëruesve; pastaj me besim tek forca e kalit të tij u vërsul kundër armiqve që po e ndiqnin. I goditur nga një heshtë që i shpoi këmishën e hekurt, por që nuk i shkaktoi ndonjë plagë vdekjeprurëse e as të rëndë, u vërsul kundër atij që e plagosi, i cili ishte një banor i qytetit Argo, jo nga një familje e shquar, por bir i një plake të varfër. Kjo, sikurse

[1] Antigon Gonata (283-239 para e. sonë).
[2] Edhe kjo fushatë e Pirros i dështoi. Në paragrafet 27-33 përshkruhen me hollësi luftimet pa sukses, që zhvilloi ai për pushtimin e qyteteve Sparta e Argo, ku gjeti edhe vdekjen në 272 para e. sonë.

edhe gratë e tjera, po shikonte në atë kohë betejën nga çatia e shtëpisë; kur pa të birin në përleshje me Pirron, e tronditur nga rreziku që i kërcënohej, rrëmbeu me të dy
2 duart një tjegull dhe ia lëshoi armikut. E goditi në kokë, nën përkrenare, duke i thyer
3 boshtin e qafës; iu errën sytë, frenat i shpëtuan nga dora, dhe i tërhequr nga kali i tij
4 deri tek muri i Licinit, u rrëzua, i panjohur prej shumëkujt. Por Zopyri, që shërbente nën Antigonin dhe dy apo tre të tjerë e panë menjëherë, dhe pasi e njohën e tërhoqën
5 në një oborr, ku ai filloi të përmendet nga goditja që kishte marrë. Atëherë kur Zopyri kishte nxjerrë shpatën ilire për t'i prerë kokën, Pirrua i hodhi një shikim
6 kërcënues. Ai u tmerrua dhe iu drodhën duart. Megjithatë, nga që donte ta kryente këtë akt, e goditi, por, duke qenë shumë i turbulluar dhe i shqetësuar e qëlloi keq dhe me vështirësi të mëdha mundi ta shkëpusë kokën nga trupi, duke kaluar shpatën midis gojës dhe mjekrës.

7 Kur u përhap lajmi i vdekjes së Pirros, Alkinou, i biri i Antigonit erdhi dhe i kërkoi kokën e Pirros që ta shihte me sytë e vet. Porsa e mori në dorë vrapoi tek i ati,
8 i cili në atë kohë po fjalosej me disa nga miqtë e tij, dhe ia hodhi përpara. Antigoni, pasi e pa dhe e njohu, e largoi të birin duke e quajtur të egër e barbar...
9 Pastaj, si e stolisi kokën dhe trupin e Pirros urdhëroi ta djegin... dhe Helenin si e
11 trajtoi me respekt dhe nder e dërgoi në Epir...

2) MORALIA

(Vepra morale)

a) DE SERA NUMINIS VINDICTA

"Mbi të dënuarit vonë nga perënditë"

7 As Apollonia, as Anaktori, as gadishulli i Leukadës nuk do të ishin banuar nga helenët nëqoftëse dënimi i Periandrit nuk do t'ishte shtyrë në një kohë më të gjatë.[1)]

b) QUAESTIONES GRAECAE

"Çështjet Greke"

29 Kush quhet poletes tek epidamnasit? Epidamnasit, fqinjë të ilirëve, meqenëse shikonin që qytetarët e tyre, duke bërë tregti me ta bëheshin të këqij dhe meqë kishin frikë nga ndonjë lëvizje, zgjidhnin çdo vit një nga qytetarët më të njohur që të shkonte tek barbarët në emër të gjithë qytetarëve, dhe të tregtonte me ta. Ky quhej poletes (për shkak të vajtjes së tij atje).

[1)] Periandri, tiran i Korintit, që sundoi në fund të shekullit VII e në fillim të shekullit VI para e. sonë.

LUKIANI

Lukiani është shkrimtar grek i shek. II të e. sonë. Veprimtaria e tij më e madhe zhvillohet në kohën e Antoninëve. Lindi në Samosatë të Komagjenës, në breg të Eufratit, afërsisht midis viteve 120-125. Megjithëse në fëmini qe dhënë mbas artit të skulpturës, prindërit e dërguan të studiojë letërsi, ku u dallua shumë në satirë dhe retorikë sofistike. Ai u bë një nga personalitetet më të ditura dhe më me kulturë të kohës së tij.

Lukiani ushtroi ofiqe administrative në Antiohi, brodhi, duke mbajtur konferenca nëpër vende të ndryshme të Azisë, Greqisë, Italisë dhe Galisë, dhe u vendos pastaj përgjithnjë në Athinë. Këtu u mor edhe me filozofi. Në pleqëri u bë sekretar perandorak në Egjipt.

Ai dallohet si një shkrimtar shumë prodhues. Nga prodhimtaria e tij janë ruajtur 82 vepra të shkruara pjesërisht në formë dialogësh, pjesërisht në formë tregimesh. Në këto vepra, Lukiani, me një humor të lehtë përshkruan teoritë filozofike të kohës së tij dhe kritikon në mënyrë të hapur dhe pa u trembur kontradiktat dhe anët qesharake në legjendat për perënditë, sektet fetare, të metat dhe dëshirat e kota të njerëzve, etj.

Nga veprat e tij janë për t'u përmendur dialogët e përmbledhur në dialogët e perëndive, dialogët e detit dhe dialogët e të vdekurve.

Te Lukiani gjejmë disa të dhëna me interes mbi Bardhylin dhe Pirron.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Luciani Samosatensis opera ex recognitione Caroli Iacobitz. Vol. III. Editio stereotypa. Lipsial in aedibus B.G. Teubneri 1913.

LUCIANI SAMOSATENSIS

OPERA

"Veprat"

Adv. Ind. 21 (III 149)
Thonë edhe për Pirro Epirotin, burrë për të tjera i admirueshëm, se u prish në një mënyrë të tillë nga lajkatarët, sa që besonte se ishte i ngjashëm me Aleksandrin...
Macr. 10 (III 196)
Bardhyli, mbreti ilir, thuhet se luftoi mbi kalë në luftën kundër Filipit, kur ishte 90 vjeç.
Nav. 7 (III 216)
Timolau: Varkëtari, burrë i mirë dhe i zoti për të biseduar, më tha se mbasi u nisëm nga Fari me një erë jo shumë të fuqishme, ditën e shtatë arritëm në Akamantë, pastaj me erën e Zefirit që na kundërfrynte u sollëm tërthorazi gjer në Sidon dhe së andejmi, duke rënë në një shtrëngatë të fortë, ditën e 10 erdhëm tek helidonët përmes Aulonës, ku për pak të gjithë do të ishin mbytur në ujë. Dikur e kam provuar edhe vetë, duke lundruar pranë helidonëve sa lart ngrihej dallga në këtë vend dhe sidomos kur fryn era Liva, e përzier me jugun.
Amor. 6 (II 210)
Likynos: Kur po mendoja për të lundruar për në Itali, m'u sigurua një anije e shpejtë nga ato me dy sërë lopatash, të cilat duket se i përdorin sidomos liburnët, fis që ka ndejen në gjirin e Jonit...
Laps. 11 (I 332)
Meriton të përmendet edhe Pirro Epiroti, burrë i cili pas Aleksandrit, në çështje ushtarake zinte vendin e dytë dhe që i ka sjellë mijëra ndryshime fatit. Ky, pra, i lutej perëndive, u bënte fli dhe u bënte dhurata, por kurrë nuk kërkoi prej tyre fitore ose dinjitet më të madh mbretëror, lavdi dhe pasuri të tepëruar; lutej vetëm për një gjë: të ishte i shëndoshë, sepse po të kishte këtë, të tjerat do t'i kishte vetë me lehtësi, dhe kujtoj se ai mendonte shumë mirë, duke arsyetuar kështu, se asnjë dobi nga të mirat e tjera nuk ka përderisa mungon shëndeti.

ARRIANI

Flav Arriani, shkrimtar grek nga Nikomedia e Bitynisë, lindi rreth vitit 95 dhe vdiq nga viti 175 i e. sonë. Studioi për një kohë në Athinë dhe pastaj shkoi në Nikopol ku nga fillimi i shek. II u bë nxënës i zellshëm i fillozofit Epiktet. Në vitin 130 Arriani shërbeu si zevëndës konsull, kurse që nga viti 131 e deri në vitin 137 shërbeu si sundimtar i provincës së Kapadokisë në rangun e legatit perandorak. Ka mundësi që ai të ketë shërbyer në ofiqet administrative romake edhe në Norik e Panoni. Në vitin 147 Arrianin e gjejmë arhont në Athinë. Si në jetën ashtu edhe në veprimtarinë e tij letrare ai ndjek shembullin e Ksenofonit.

Arriani shkroi shumë vepra historike, filozofike dhe ushtarake. Më të rëndësishmet janë: "Anabasis Aleksandru" (Fushata e Aleksandrit) në 7 libra, burimi kryesor për historinë e Aleksandrit të Maqedonisë; "Indike Syngrafe" (Historia e Indisë) dhe "Bithyniaka" (Historia e Bitynisë) e ruajtur në fragmente. Nga veprat gjeografike, më e rëndësishmja është "Periplus Eukseniu Pontu" (Lundrimi gjatë brigjeve të Detit të Zi). Kjo vepër është një raport që Arriani i dërgon perandorit Hadrian mbi udhëtimin e tij gjatë brigjeve të Detit të Zi me rastin e dërgimit si legat perandorak në vitin 131 në Kapadoki. Përveç këtyre ai shkroi dhe vepra të tjera.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Flavii Arriani* quae exstant omnia edidit A. G. Roos. Volumen I, *Alexandri anabasin continens.* Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1907.
2) *Flavii Arriani* quae extant omnia edidit A. G. Roos. Volumen II. *Scripta minora et fragmenta.* Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1928.

FLAVII ARRIANI

I. ALEXANDRI ANABASIS

(Fushata e Aleksandrit)

LIBRI I

4 **1** Sa hyri pranvera[1], ai /Aleksandri/ u nis për në Thraki kundër tribalëve dhe ilirëve, sepse kishte mësuar se ilirët dhe tribalët kishin ngritur krye dhe përveç kësaj, ai mendonte se duke u nisur për një rrugë kaq të largët nga atdheu[2] nuk duhej të linte në shpinë të vet fqinjë të panënshtruar plotësisht.

1 **2** ... Vetë ai /Aleksandri/, si kaloi Hemin, shkoi më tej kundër tribalëve dhe arriti tek lumi Lygin... Ky lum ndodhet tri ditë larg nga Istri po të udhëtosh në
2 drejtim të Hemit. Sirmi, mbret i tribalëve, meqenëse kishte marrë vesh prej kohësh për fushatën e Aleksandrit, i kishte nisur që më parë gratë dhe fëmijët e tribalëve për në Ister dhe i kishte urdhëruar që të hidheshin në një nga ishujt e këtij lumi. Ky
3 ishull quhej Peuke. Në këtë ishull ishin fshehur, shumë më parë se të afrohej Aleksandri, disa prej thrakëve, që ishin fqinj të tribalëve. Këtu erdhi edhe vetë Sirmi me të tijët. Shumica e tribalëve u kthye prapë tek ai lum prej nga ishte nisur Aleksandri një ditë më parë.
4 Kur e mori vesh Aleksandri se ku kishin vajtur tribalët u kthye prapë dhe u drejtua kundër tyre; ai i gjeti ata duke rregulluar lemin. Të zënë në befasi ata u rreshtuan në pyllin që ishte aty afër lumit. Aleksandri e udhëhoqi vetë falangën, duke e rreshtuar në thellësi; shigjetarët dhe hobetarët ai i dërgoi përpara dhe i urdhëroi që t'i mbulojnë barbarët me shigjeta dhe gurë; ai mendonte se kështu do t'i tërhiqte nga pylli në vend të hapët.
5 Dhe me të vërtetë, duke u gjendur nën breshërin e shigjetave, ata vendosën të dalin dhe u sulën me të shpejtë mbi shigjetarët me qëllim që të përlesheshin me ta, meqenëse shigjetarët nuk kishin edhe mburoja. Aleksandri si i kishte mashtruar të dilnin nga pylli, urdhëroi Filotën të merrte kalorësit që kishte rekrutuar në Maqedoninë e Sipërme dhe të sulmonte krahun e djathtë të kundërshtarëve që kishin
6 përparuar më shumë gjatë sulmit. Heraklidin dhe Sopolin i urdhëroi të çonin në krahun e majtë kalorësit nga Botiaia dhe Amfipoli. Falangën këmbësore dhe pjesën tjetër të kalorësisë, që e kishte rreshtuar para falangës ai e drejtoi në qendër të armikut. Sa kohë që të dy palët qëllonin nga pozicionet, tribalët nuk ishin më të dobët, por kur kundër tyre u lëshua falanga e dëndur dhe e fuqishme dhe nga të dy anët sulmuan kalorësit, duke vepruar jo më me heshta, por duke i shtypur me kuaj, tribalët u kthyen dhe duke u futur në pyll u drejtuan për tek lumi. Gjatë tërheqjes u
7 vranë tre mijë vetë; të gjallë edhe këtë radhë u zunë pak, sepse pylli pranë lumit ishte i dendur,

kurse nata nuk u lejoi maqedonasve t'i ndiqnin kundërshtarët; maqedonasit,

---

[1] Në vitin 335 para e. sonë.
[2] Fushata kundër Persisë.

6 sipas Ptolemeut, humbën 11 kalorës dhe rreth 40 këmbësorë.

4 Këtu *[* në lemë*]* i erdhën Aleksandrit përfaqësues nga fise të tjera të pavarura, që jetonin buzë Istrit si edhe nga Sirmi, mbret i tribalëve. Erdhën përfaqësues edhe nga keltët, që jetojnë në gjirin e Jonit. Keltët janë një popull trupmadh dhe kryelartë. Të gjithë thanë se kishin ardhur të kërkonin miqësi me Aleksandrin; të gjithë ata lidhën me të aleancë.

1

5 Nërsa po vazhdonte fushatën kundër agrianëve dhe paionëve, Aleksandri mori vesh nga lajmëtarë se Kliti, i biri i Bardhylit ishte shkëputur prej tij dhe se me këtë ishte bashkuar edhe Glaukia, mbreti i taulantëve. Po këta lajmëtarë i thanë se edhe
2 autariatët kishin ndërmend t'i binin kur do të shkonte rrugës. Për këto arsye e pa të udhës të kthehej sa më shpejt. Në këtë kohë Langari, mbreti i agrianëve, i cili edhe kur ishte gjallë Filipi e shfaqte hapur dashurinë që kishte për Aleksandrin, duke dërguar bile edhe delegatë të veçantë te ky i fundit erdhi pranë Aleksandrit bashkë
3 me besnikët e tij dhe me ushtarët më të mirë e më të armatosur që kishte rreth vetes. Ky pra, kur e pyeti Aleksandri për autariatët si edhe sa ishin, iu përgjegj se as duhej t'i llogariste fare, pasi këta ishin më të paaftët për luftë, nga ata që banonin në këto vende; shtoi se ai ishte gati të hynte në krahinat e tyre dhe t'i bënte të mendonin më shumë për punët e tyre se sa për luftë. Me urdhër të Aleksandrit ai hyri në tokën e
4 tyre dhe shkretoi vendin.

Autariatëve iu desh të merren me punët e veta, kurse Langari përveç të tjerave u nderua shumë nga Aleksandri dhe mori dhurata nga ato që mbreti i Maqedonisë i quan më të mëdhatë, dhe më në fund i premtoi t'i japë për grua edhe motrën e tij,
5 Kynën, kur Aleksandri do të kthehej në Pela.

Po Langari, me t'u kthyer në shtëpi, u sëmur dhe vdiq. Aleksandri, atëherë, duke ecur anës lumit Erigon u drejtua kundër qytetit Pelion, se këtë e kishte pushtuar
6 Kliti, si qytetin më të fortë në këtë vend. Sapo Aleksandri erdhi afër këtij qyteti, ngriti lëmin e tij pranë lumit Eordai dhe vendosi të nesërmen të sulmojë muret e qytetit. Kliti me ushtarët e tij kishte zënë dhe mbante malet rreth e rrotull qytetit, që ishin më të lartat dhe të pyllëzuara dëndur, me qëllim që t'u binte nga të gjitha anët
7 maqedonasve, në rast se këta do ta sulmonin qytetin; sa për Glaukinë, mbretin e taulantëve, ky akoma s'kishte ardhur këtu. Aleksandri, pra, po marshonte kundër qytetit; armiqtë atëherë bënë fli tre djem, tri vajza dhe tre desh të zinj dhe vendosën t'i presin maqedonasit e të përleshen me ta. Po me të filluar beteja, i lanë viset që kishin zënë, megjithëse ishin të forta, dhe iknin aq shpejt sa edhe kufomat e flive u
8 gjetën të shtrira e të paprekura.

Atë ditë, Aleksandri i mbylli armiqtë brenda në qytet dhe ngriti lëmin pranë murit; pastaj vendosi t'i bllokonte ata rreth e përqark me anë të një muri. Të nesërmen arriti me një forcë të madhe Glaukia, mbreti i taulantëve. Atëherë
9 Aleksandri e humbi shpresën për të pushtuar qytetin me fuqitë që kishte, mbasi në një anë në qytet ishin futur shumë luftëtarë të zotë dhe në anën tjetër ushtria e shumtë e Glaukisë do të turrej, në rast se beteja do të ndizej afër murit. Dërgoi Filotën për të kërkuar ushqime dhe e urdhëroi të merte nga lëmi aq sa kalorës i duheshin për ta ruajtur dhe kafshët bartëse. Po Glaukia, me të marrë vesh lëvizjen e Filotës, u sul kundër këtij dhe zuri malet rreth e rrotull fushës, ku do të kërkonte
10 ushqime Filota.

Aleksandri, si mori vesh se kalorësit dhe karvani ishin në rrezik po t'i zinte nata, mori me vete besnikët, shigjetarët, agrianët dhe pothuaj nja katërqind kalorës dhe vrapoi në ndihmë të tyre; pjesën tjetër të ushtrisë e la afër qytetit, nga frika se mos

ata të qytetit përfitonin nga largimi i gjithë ushtrisë, dilnin nga qyteti, dhe
11 bashkoheshin me fuqinë e Glaukisë. Po Glaukia, porsa mori vesh se Aleksandri po
afrohej, i la malet e kështu Filota, me njërëzit e tij, u kthye në lëm mirë e shëndoshë.
Megjithëkëtë Kliti me Glaukinë, akoma besonin se e kishin zënë ngushtë
Aleksandrin, sepse në njërën anë kishin zënë malet më të larta më shumë kalorës,
12 shigjetarë, hobetarë dhe hoplitë jo të pakët, në anën tjetër, pastaj, kishin shpresë se
ushtria që ishte brenda në qytet do t'i binte që prapa, kur do të vendoste të largohej
nga ky vend. Vendi nga do të kalonte Aleksandri ishte i ngushtë dhe shumë i veshur;
nga një anë pengonte lumi, kurse nga ana tjetër ngrihej një mal i lartë e i thepisur,
kështu që as katër ushtarë me radhë nuk ishte e mundur të kalonin.

1 **6** Atëherë, pra, Aleksandri e radhiti ushtrinë së gjeri në mënyrë që thellësia e
falangës të ishte gjer në njëqind e njëzet vetë. Si vuri pastaj nga dyqind kalorës në
secilin nga të dy krahët, po jepte këshilla, duke porositur që çdo urdhër, pasi ta
2 dëgjonin, duke i bërë veshët katër, ta mbanin të fshehur. Së pari urdhëroi hoplitët t'i
ngrenin lart heshtat, pastaj sipas parullës t'i hidhnin si për t'u mbrojtur, dhe herë t'i
drejtonin nga ana e djathtë, herë nga e majta. Dhe falangën vetë me shpejtësi të
madhe e shtyu përpara dhe e radhiti në të dy krahët, duke e lëvizur herë këndej, herë
3 andej. Dhe kështu, si formoi shumë radhë dhe i rregulloi në një kohë të shkurtër,
formoi në krahun e majtë të falangës një si pykë dhe e lëshoi kundër armiqve. Këta
edhe më parë po çuditeshin, duke parë shpejtësinë e mprehtë dhe rregullin e këtyre
4 veprimeve, dhe atëherë si panë ushtrinë e Aleksandrit se u afrua, nuk i qëndruan po i
lanë kodrat e para. Atëherë Aleksandri u dha urdhër maqedonasve të bërtasin dhe t'i
përpjekin heshtat me mburojet; nga zhurma që u bë, taulantët u trembën edhe më
shumë dhe e futën ushtrinë me të shpejtë në qytet.
Aleksandri, kur pa se një numër i vogël armiqsh kishin zënë një kodër, pranë së cilës
5 duhej të kalonte, urdhëroi rojen e tij dhe "miqtë" të merrnin mburojat dhe t'u hypnin
kuajve, e të suleshin kundër kësaj kodre. Në rast se armiqtë që kishin zënë kodrën do
t'u qëndronin, të zbrisnin gjysma nga kuajt dhe të përzierë me kalorësit, të luftonin si
këmbësorë. Po armiqtë, si e panë që Aleksandri po i sulmonte, e lanë kodrën dhe u
6 fshehtën majtas e djathtas në male. Aleksandri, si mori bashkë me "miqtë" kodrën
dërgoi këtu edhe agrianët e shigjetarët që ishin nja dy mijë; luftëtarëve besnikë të tij
u dha urdhër të kalonin lumin, e pas këtyre edhe ushtrisë tjetër maqedonase; me të
kaluar lumin, i porositi të rreshtoheshin menjëherë nga ana e majtë, me qëllim që të
dukej falanga e dendur; ai vetë qëndroi në vijë të parë që të shikonte nga kodra
7 lëvizjet e armiqve. Këta, kur panë se ushtria e maqedonasve filloi të kalojë lumin, u
larguan në malet për t'i rënë praparojës që ishte shkëputur bashkë me Aleksandrin.
Kur ata zunë të afrohen, ai u sul kundër tyre me ushtrinë që kishte me vete, kurse
falanga lëshoi britmën sikur po kalonte lumin. Armiqtë filluan të ikin, duke iu
8 mënjanuar sulmit. Në këtë kohë Aleksandri dërgoi agrianët e shigjetarët me vrap për
në lum. Ai vetë ua kaloi atyre dhe e hodhi i pari lumin. Kur pa se armiqtë u lëshuan
mbi praparojën e tij, urdhëroi të vendoseshin makinat luftarake në buzë të lumit dhe
me anën e këtyre të hidheshin shigjeta sa ishte e mundur më larg; njëkohësisht
urdhëroi edhe shigjetarët të ndaleshin në mes të lumit dhe prej këndej të qëllonin.
Ushtarët e Glaukisë nuk guxuan t'i aviteshin vendit ku arrinin shigjetat; maqedonasit
e kaluan lumin të sigurtë dhe gjatë tërheqjes nuk humbën asnjë.
9 Tri ditë më vonë, Aleksandri mori vesh se ushtria e Klitit dhe e Glaukisë ishte

fushuar keq dhe se as roje të rregulltë për t'i ruajtur ata nuk vinin, as ledhe ose hendek nuk kishte bërë duke kujtuar se Aleksandri ishte larguar nga frika; gjithashtu si mori vesh se ata ishin rreshtuar në një gjatësi që i dëmtonte, prandaj që pa u gdhirë mirë, kaloi lumin pa rënë në sy, duke pasur me vete rojen e tij, agrianët, shigjetarët si
10 dhe trupat e Perdikës edhe të Koinit; njëkohësisht kishte dhënë urdhër që ta ndiqte edhe ushtria tjetër. Si zgjodhi kohën më të përshtatshme për sulm, nuk priti gjersa të mblidhet e gjithë ushtria, po lëshoi kundër armikut shigjetarët e agrianët; këta meqenëse i ranë papandehur lëmit në atë krah ku fuqitë ishin shumë të dobëta, sollën një trubullim të madh në ushtrinë e armiqve, aq sa disa i vranë në gjumë, disa i zunë me lehtësi në ikje e sipër, kështu shumë u zunë dhe u vranë aty, shumë të tjerë në ikje që u bë në një mënyrë shumë të parregullt dhe me panik, një palë tjetër jo e vogël, u zunë të gjallë. Ushtarët e Aleksandrit e ndoqën armikun deri tek malet e
11 taulantëve; po edhe ata që shpëtuan, mbetën pa armë, se i kishin hedhur në ikje e sipër. Kliti, në fillim shkoi në qytetin e vet dhe pasi i vuri zjarrin, iku te Glaukia, në mbretërinë e taulantëve.

1 **7** Në këtë kohë disa prej tebanëve të mërguar u kthyen natën në Tebë; dikush në qytet i nxiste ata për kryengritje. Nga garnizoni i Kadmesë ata thirrën Amyntën dhe Timoleun dhe i vranë jashtë mureve të qytetit, ndërsa ata nuk dyshonin për asgjë të tillë. Pastaj shkuan në mbledhjen e popullit dhe nxisnin tebanët që të shkëputen nga
2 Aleksandri dhe u thanë se si të shpëtonin nga shtypja maqedonase do të ishin të lirë dhe do të gëzonin famën e vjetër. Populli u besonte më tepër atyre që ngulnin këmbë se Aleksandri kishte vdekur në Iliri; me të vërtetë kjo fjalë ishte përhapur mjaft,
3 sepse koha e mungesës kishte qenë e gjatë dhe asnjë lajm nuk vinte prej tij. Dhe ashtu sikurse ndodh zakonisht në këto raste, njerëzit, duke mos ditur si qëndrojnë punët në të vërtetë, i mendojnë ato ashtu si u pëlqen.

LIBRI II

3 **7** Aleksandri thirri strategët, ilarhët dhe udhëheqësit e ushtrive aleate. Ai u tha atyre se përfundimi me lavdi i betejave të kaluara duhet t'iu ngjallë atyre burrëri; se ata që kanë qenë gjithmonë fitues, do të luftojnë me ata që gjithmonë kanë qenë mundur; se ata i udhëheq vetë perëndia, që i mbushi mendjen Darit ta mbylli ushtrinë në një vend të ngushtë, ku maqedonasve u mjafton plotësisht vendi për të manovruar falangën, kurse persëve ushtria e madhe do t'u jetë e padobishme; se
4 armiku nuk mund të krahasohet me ta as nga pikëpamja fizike e as nga ajo morale: maqedonasit të kalitur prej kohësh në luftëra dhe në rreziqe do të ndeshen me persët dhe medët, që kishin rënë me kohë në llumin e luksit-këta ishin njerëz të lirë, kurse ata skllevër. Përsa i përket helenëve që këtu do të ndeshen me helenët, ata nuk luftojnë për të njëjtën gjë: ata janë rekrutuar nga Dari për para dhe bile për një
5 shumë të vogël; të tjerët – që kanë ata në ushtrinë e tyre – janë ngritur vullnetarisht në mbrojtje të Helladës. Kurse barbarët, thrakë, paionë, ilirë dhe agrianë që janë më të fortët dhe më trimat midis barbarëve të tjerë të Evropës, do të luftojnë me popuj më të dobët dhe më delikatë të Azisë.

5 **16** Logografi Hekateu thotë se Herakliu, prej Argosi, i dërguar nga Eurystheu për të grabitur dhe për t'i dërguar lopët e Geryonit në Mikenë, nuk zbriti as tek iberët, as mbi një ishull të quajtur Erythi, të vendosur në Oqean; ai thotë se Geryoni ishte një mbret i kontinentit që jetonte midis Ambrakisë e Amfilohisë dhe se ishte pikërisht ky vend ku Herakliu i grabiti gjedhët, duke i dhënë fund ndërmarrjes së tij

6 të vështirë. Unë di edhe që kjo krahinë është e pasur në kullota dhe ushqen lopë shumë të bukura. Lavdia e lopëve të Epirit rrjedh ndoshta nga një kohë më e vjetër se Erystheu dhe nuk është aspak e paarsyeshme të besohet se mbreti i Epirit quhej Geryon.

6 **27** Shkallët u afruan tek muri[1] dhe një grindje e madhe u shkaktua ndërmjet maqedonasve, se kush do të ishte i pari që do të pushtonte murin; e zaptoi i pari Neoptolemi, një nga "miqtë" *[*e Aleksandrit*]*, që ishte nga fisi i aiakidëve.

LIBRI III

2 **12**... Ishin vendosur në formë patkoi, nga e djathta, pranë eskadronit mbretëror, gjysma e agrianëve të komanduar nga Atali, pastaj vinin harkëtarët maqedonas të
3 udhëhequr nga Brisoni, të forcuar nga të ashtuquajturit "veteranë të huaj" të komanduar nga Kleandri. Përpara agrianëve dhe harkëtarëve ishte rreshtuar kalorësia e lehtë dhe paionët që kishin për të parë Aretin dhe Aristonin dhe përpara fare ndodhej kalorësia mercenare nën komandën e Menidës. Kurse para rojes mbretërore dhe gjithë "miqëve" ishte gjysma tjetër e agrianëve dhe shigjetarëve si edhe hobetarët e Balakrit...

3 **13** Aleksandri dha urdhër që të sulmojnë kundër tyre kalorësit mercenarë nën komandën e Krenidës. Duke u hedhur kundër tyre kalorësit skythë, si dhe ata të baktrianëve që ishin bashkërreshtuar me skythët i detyruan ata të tërhiqen, mbasi ishin të pakët, përballë një shumice të madhe. Aleksandri pastaj urdhëroi paionët e
4 komanduar nga Areti dhe të huajt, që të sulmojnë skythët, dhe barbarët u shpartalluan; ndërsa baktrianët e tjerë ose u shpartalluan në ikje e sipër prej paionëve e të huajve ose u detyruan të përleshen në betejë me kalorësinë.

LIBRI VI

4 **28** Deri atëherë ai *[*Aleksandri*]* kishte shtatë roje personale: Leonatin të birin e Anteut; Hefestionin, të birin e Amyntorit; Lysimahun, të birin e Agathoklit; Aristonin, të birin e Peisait; që të gjithë nga Pella. Perdikën, të birin e Orontit, nga Orestida; Ptolemeun, të birin e Lagit dhe Peitonin, të birin e Kratevës, që të dy nga Eordaia, i teti u bë Peukesti që e kishte mbuluar Aleksandrin me mburojën e tij.

LIBRI VII

1 **9** Jo për t'u mbajtur që të ktheheni në atdhe do t'u them, o maqedonas, këto fjalë (për mua ju mund të shkoni ku të doni), por që ta kuptoni se ku keni arritur dhe nga kush po ndaleni.

2 Do ta filloj, ashtu sikurse duhet, me Filipin, tim atë. Filipi ju gjeti si endacakë, pa një vendbanim të përhershëm, pa laçkë e plaçkë dhe pa asgjë, të veshur me lëkura të thjeshta, duke kullotur nëpër male bagëti të pakëta që i mbronit me pak sukses kundër ilirëve, tribalëve dhe thrakëve fqinjë; ju veshi me rroba, ju bëri të zbritni nga mali në fushë dhe ju bëri të tmerrshëm kundër barbarëve fqinjë..."

---

[1] Është fjala për muret e qytetit Gaza në Palestinë.

2. SCRIPTA MINORA ET FRAGMENTA

"Vepra të vogla e fragmente"

Bithynica

(Historia e Bitynisë)

B 16[1] Makrinë, që është në Eube, *[*Dionisi*]* e quan Abantiada, prej fisit të abantëve një fisi thrak që banon atje, sikurse thotë Arriani, dhe e ka marrë këtë emër prej njërit që quhej Argeios, i biri i Posidonit Abant.

B 63 Nikomedi[2] që përmendëm kishte një qen të madh të racës molose, i cili i ishte shumë besnik.

Historia Successorum Alexandri

(Historia e pasardhësve të Aleksandrit)

S_1a,7 *[*Fiset*]* përtej Thrakisë si ilirët, tribalët, agrianët si dhe Maqedonia e Epiri që arrin deri tek malet e Keraunit, si dhe gjithë helenët iu dhanë për pjesë Kraterit dhe Antipatrit.

S_1b,3 Antipatri, gjenerali i Aleksandrit, u bë mbret mbi krejt maqedonasit, helenët, ilirët, triballët dhe agrianët, si dhe mbi gjithë Epirin.

Indica

(Mbi Indinë)

I 18,5 Nga Eordaia[3] ishin Ptolemeu, i biri i Lagit, dhe Aristoni, i biri i Peisait.

Cynegeticus

(Mbi gjuetinë)

C 23,2 Atje ku fushat janë të përshtatshme si në Myzi, Geti, Skythi dhe Iliri, gjuetia e drerëve bëhet me kuaj të racës skythe dhe ilire. Këta *[*kuajt*]* për vrapim garash nuk janë të mirë, por megjithatë nuk janë për t'u përbuzur, duke i krahasuar me kuajt e Thesalisë, të Siqelisë apo të Peloponezit, pasi i qëndrojnë lodhjes.

---

[1] Shkurtimisht B, C, J dhe S i përgjigjen këtyre librave të Arrianit: B-Bithynica; C-Cynegeticus, I-Indica; S-Historia successorum Alexandri.

[2] Është fjala për Nikomedin I të Bitynisë, që sundoi afërsisht nga 279-255 para e. sonë.

[3] Më sipër bëhet fjalë për komandantët e ushtrisë së Aleksandrit në ekspeditën aziatike.

PAUSANIA

Pausania, shkrimtar grek, jetoi dhe punoi në shek. II të e. sonë. Data e lindjes dhe e vdekjes së tij nuk dihet. Lindi me sa duket në Lydi. Në kohën e Antoninëve bëri një udhëtim të gjatë nëpër Greqi, Azi të Vogël, Egjipt, Lybi dhe Itali. Shkroi në vitet 160-180 veprën e tij "Periegesis tes Helladhos", lat. Descriptio Graeciae (Përshkrimi i Helladës) në 10 libra. Kjo vepër paraqet në vetvete një lloj guide ku përshkruhen qytete dhe vendbanime të ndryshme të Greqisë, si dhe monumentet e tyre më të rëndësishme të arkitekturës, skulpturës, pikturës etj. Vepra është e mbështetur në vrojtimet e tij personale si edhe në veprat e shkrimtarëve të tjerë të vjetër. Ajo është një burim i rëndësishëm, në radhë të parë, për historinë e artit të vjetër grek si edhe për historinë, topografinë mitologjinë greke etj.

Në veprën e Pausanias bëhet fjalë edh për ajakidët e Epirit si edhe për vetë Pirron. Në të ne njoftohemi gjithashtu edhe për disa monumente përkujtimore të Greqisë të ngritur nga qytetarët e Apollonisë dhe të Dyrrahut.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Pausaniae Descriptio Graeciae, recognovit Joannes Henricus Christianus Schubart. Vol. I-II Lipsiae sumptibus et typis B.G. Teubneri 1870.

PAUSANIAE

DESCRIPTIO GRAECIAE

(Përshkrimi i Greqisë)

LIBRI I

Atika

1 **4** Ushtria e tyre[1] marshoi në tokat gjatë detit Jon dhe shkatërroi popullin ilir dhe gjithë të tjerët që banojnë deri në Maqedoni, me gjithë vetë maqedonasit, dhe përshkoi të gjithë Thesalinë...

8 **6** Ptolemeu, pas vdekjes së Antigonit ripushtoi Sirinë, Qipron dhe çoi Pirron në Thesprotinë e Epirit...

7 **9** Lysimahu filloi luftën me Pirro Aiakidin. Duke ruajtur atë kur largohej nga Epiri, me që zakonisht dilte jashtë shpesh, shkatërroi krahinat e tjera dhe arriti deri te
8 varret e mbretërve. Unë i besoj shumë pak asaj që shkruan Hieronymi nga Kardia se prishi varret e të vdekurve dhe nxori jashtë eshtrat. Pra ky Hieronymi njihet edhe në vende të tjera që ka shkruar në mënyrë armiqësore kundër gjithë mbretërve, me përjashtim të Antigonit, edhe se nuk ka qenë aq i drejtë edhe kundrejt tij; është pra e qartë që në lidhje me varret e epirotëve kemi një shpifje të trilluar, që një maqedonas të ketë prishur varret e të vdekurve. Edhe sikur Lysimahu të mos e dinte se të parët e Pirros ishin edhe të parët e Aleksandrit – Aleksandri pra ishte epirot dhe nga ana e nënës prej aiakidëve – lidhja midis Pirros e Lysimahut tregon se megjithëse kishin luftuar njëri kundër tjetrit, asgjë nuk i pengoi që midis tyre të kishte një pajtim...

2 **10** Për këto arësye /Lysimahu/ duke u ndeshur me Demetrin afër Amfipolit për pak e humbi Thrakinë, por e mbajti i mbrojtur nga Pirrua; pastaj futi nën zotërimin e tij nestët e maqedonasit. Vetë Pirrua, pasi ishte nisur nga Epiri dhe kishte ndihmuar Lysimahun, mori një pjesë të Maqedonisë. Demetri kaloi pastaj në Azi për të luftuar kundër Seleukut dhe përderisa qe në gjendje të qëndronte u mbajt edhe lidhja midis Pirros e Lysimahut; por kur u mund, lidhja u prish dhe u bënë armiq; Lysimahu sulmoi Antigonin e Demetrit dhe vetë Pirron. Duke pasur për një kohë të gjatë epërsi, Lysimahu pushtoi të gjithë Maqedoninë dhe detyroi Pirron të tërhiqej në Epir...

1 **11** Në Athinë gjendet portreti i Pirros. Ky nuk i ngjante fare Aleksandrit me të cilin ishte fis. Në të vërtetë Pirrua ishte i biri i Aiakidit, të birit të Arrybës, dhe Aleksandri ishte djali i Olympisë, së bijës së Neoptolemit.

---

[1] Ushtria e galatëve

Neptolemi dhe Arryba kishin baba Alketën, të birin e Tarypës. Prej Tarypës deri te Pirrua i Akilit janë pesëmbëdhjetë breza. I pari, si ra Ilioni, nuk u kthye në Thesali, por u ndal në Epir ku u vendos atje simbas profetisë së Helenit. Me Hermionën ai nuk pati fëmijë; me Andromakën lindi Molosin, Pielin dhe të fundit Pergamin.

2 Helenit i lindi Kestrini, i cili u martua me Andromakën, pas vdekjes së Pirros në Delfi. Meqenëse Heleni pas vdekjes ia la fronin Molosit të Pirros, Kestrini me disa vullnetarë epirotë pushtoi tokat përtej lumit Tyamis. Pergami u hodh në Azi ku në një dyluftim për pushtetin vrau Areun, sunduesin e Teutramsit dhe qytetit i dha emrin e tij, të cilin e ka edhe sot e kësaj dite. Në qytet ndodhet një tempull i Andromakës e cila e shoqëroi atë deri atje. Pieli qëndroi në Epir dhe këtë /Pielin/ patën si të parë dhe stërgjysh Pirrua e Aiakidit dhe etërit e tij, e jo Molosin. Epirotët

3 deri në kohën e Alketës, të birit të Tarypës, kishin një mbret. Djemtë e Alketës pas një grindjeje vendosën të sundonin së bashku, duke pasur harmoni njëri me tjetrin, por më vonë Aleksandri i Neoptolemit vdiq në Lukani dhe Olympia u kthye në Epir nga frika e Antipatrit; Aiakidi, i biri i Arrybës, i cili i kishte mbetur besnik, u bashkua me të në luftë me Arideun e maqedonasit, megjithëse epirotët nuk deshën t'i

4 shkojnë pas. Olympia fitoi dhe përgatiti vdekjen e Arideut, bëri krime edhe më të mëdha ndër maqedonasit, për të cilat askush nuk u çudit më vonë kur u vra nga Kasandri. Epirotët nuk deshën ta pranonin Aiakidin për shkak të urrejtjes që kishin për Olympinë dhe kur më vonë epirotët ia falën, ai gjeti kundërshtim nga Kasandri, që nuk donte kthimin e tij në Epir. Në një luftë që u bë midis Filipit, të vëllait të Kasandrit dhe Aiakidit pranë Oniniadës, Aiakidi u plagos dhe pak kohë më vonë

5 vdiq. Atëherë epirotët zgjodhën mbret Alketën, të birin e Arrybës dhe vëllanë e madh të Aiakidit, që ishte i papërmbajtur e nervoz dhe për këtë arsye ishte dëbuar nga i ati; ai me t'u kthyer zuri të sillej si i tërbuar kundër epirotëve derisa një natë ata ngritën krye dhe e vranë bashkë me fëmijët. Pasi e vranë sollën Pirron e Aiakidit. Kundër tij që nuk ishte forcuar mirë në fron, marshoi Kasandri. Pirrua për shkak të sulmit të maqedonasve iku në Egjipt te Ptolemeu i Lagut. Ptolemeu i dha për grua thjeshtrën[1] dhe me një ushtri të Egjiptit e solli përsëri në vend. Me t'u bërë mbret Pirrua, helenët e parë që sulmoi qenë korkyrasit, ishulli i të cilëve gjendej përballë

6 tokave të tij, pasi nuk donte që ai t'u shërbente të tjerëve si bazë kundër tij. Atë që pësoi Pirrua në luftë kundër Lysimahut, pas pushtimit të Korkyrës, dhe pasi dëboi Demetrin, kur sundoi në Maqedoni, derisa e përzunë, të gjitha këto ngjarje shumë të rëndësishme të jetës së Pirros i kam treguar kur fola për Lysimahun. Nuk dimë ndonjë Helen tjetër të ketë bërë luftë me romakët para Pirros. As Diomedi, as argasit

7 që ishin me të nuk patën luftuar ndonjë herë me Eneun. Sa për athinasit, që midis tjerash kishin shpresë të pushtonin Italinë, dështimi që pësuan në Syrakuzë nuk u dha rast të provojnë romakët. Aleksandri i Neoptolemit, i të njëjtit fis me Pirron, më i madh në moshë, vdiq në Lukani, pa luftuar fare me romakët.

1 **12** Kështu Pirrua qe i pari që u hodh nga Hellada përtej detit Jon kundër romakëve, dhe këtë e bëri i ftuar nga tarantasit, të cilët në fakt qysh më parë ishin në luftë me romakët. Të pafuqishëm për të qëndruar me forcat e tyre, duke pas dhënë shembullin e një mirësie me anije në luftën kundër Korkyrës, të dërguarit e Tarantit ia mbushën më tepër mendjen duke i treguar për begatinë e Italisë, që ishte më e madhe se ajo e gjithë Helladës dhe se nuk ishte e drejtë t'i kthente bosh këta miq të vjetër të tij, që

[1] Të bijën e gruas Berenikës, që kishte me burrë tjetër.

kishin ardhur tani për t'i kërkuar ndihmë.
Fjalët e të dërguarve i kujtuan Pirros pushtimin e Ilionit dhe i dhanë shpresë se do të luftonte si pasardhës i Akilit kunër një kolonie të trojanëve. Pasi i pëlqeu ky mendim, duke mos e pasur zakon të zgjatej rreth vendimeve të marra, përgatiti me
2 shpejtësi anije të gjata si edhe anije të rrumbullakta për të ngarkuar kalorës dhe këmbësorë hoplitë. Ka libra autorësh jo aq të njohur me tituj, kujtime e vepra të përmendura, të cilat duke i lexuar u çudita për guximin e Pirros në luftë e sipër dhe për zotësinë për të parashikuar çdo nevojë për luftërat e ardhshme. Ai erdhi aq fshehurazi në Itali sa që romakët s'e morën vesh dhe e panë vetëm atëherë kur gjatë betejës midis tyre dhe tarantasve u vërsul kundër romakëve papritmas dhe sikurse është e natyrshme i turbulloi. Dhe meqenëse e dinte mirë që nuk mund të matej me ta mendoi t'u lëshonte elefantët. I pari nga Evropa që përdori elefantë ka qenë
3 Aleksandri, pasi mundi Porin dhe ushtrinë indiane. Pas vdekjes së Aleksandrit i përdorën edhe mbretër të tjerë dhe numrin më të madh e pati Antigoni. Pirrua i mori pas fitores mbi Demetrin. Kur i panë romakët u trembën shumë se i morën jo për kafshë, por për diçka tjetër. Është e vërtetë se njerëzit e njihnin dhëmbin e elefantit dhe dinin sa i madh ishte, se ç'fuqi kishte, por vetë kafshët asnjëri nuk i kishte parë para kalimit të maqedonasve në Azi, përveç indianëve, libiasve dhe fqinjëve të tyre.
4 Këtë e tregon edhe Homeri, i cili thotë se mbretërit më të pasur kishin stolisur shtretërit e pallatet me dhëmbë elefanti, por elefantin vetë asgjëkundi nuk e zë në gojë. Se po ta kishte parë ose ta kishte dëgjuar më duket se do t'i kishte përmendur më parë ata se sa pygmejt ose betejën e kurilave. Pirron e thirri në Siqeli një delegacion nga Syrakuza, pasi ajo ishte rrethuar nga kartagasit, të cilët kishin prishur qytetet helene. Pasi dëgjoi të dërguarit, Pirrua la Tarantin dhe qytetet e tjera të
5 bregdetit të Italisë, kaloi në Siqeli dhe shtrëngoi kartagasit të hiqnin rrethimin e Syrakuzës. Vendosi të luftojë në det me kartagasit, që rridhnin nga tyrët dhe fenikasit dhe që ishin midis barbarëve detarët më të sprovuar, duke përdorur kundër tyre epirotët, të cilët pas rënies së Ilionit nuk dinin ç'ishte deti dhe as kripën s'dinin ta përdornin. Këtë dëshmon edhe Homeri në eposin e Odisesë kur thotë:

"Njerëz që s'dinë ç'është deti
dhe ushqimet i gatuajnë me kripë"

1 **13** Pirrua si u mund në det, u kthye në Tarant me anijet që i mbetën. Atje e gjeti edhe më keq dhe duke e ditur se romakët nuk do ta linin të ikte pa luftë, gjeti një mënyrë ikjeje të tillë. Me t'u kthyer i mundur nga Siqelia dërgoi letra në Azi dhe Antigonit, duke i kërkuar njërit mbret ushtarë, tjetrit të holla, kurse Antigonit edhe njërën edhe tjetrën. Si u kthyen lajmëtarët dhe sollën letra, mblodhi parinë e epirotëve dhe të tarantasve dhe pa u treguar përmbajtjen e letrave u tha se aleatët do t'i dërgojnë ndihmë. Me të shpejtë shkoi lajmi tek romakët se maqedonas e popuj të tjerë aziatikë po i vinin në ndihmë Pirros. Romakët pasi dëgjuan të gjitha këto ndenjën të qetë, kurse Pirrua natën tjetër kaloi detin deri te malet e quajtura Keraune.
2 Pas dështimit në Itali dhe pasi shlodhi ushtrinë i shpalli luftë Antigonit, duke e akuzuar se nuk i kishte dërguar ndihmë në Itali. Në betejat që u bënë e theu Antigonin dhe e shtyri bashkë me trupat mercenare galate të tij deri te qytetet bregdetare dhe pushtoi Maqedoninë e sipërme dhe Thesalinë. Rëndësinë e kësaj beteje dhe fitores së Pirros e dëshmojnë armët e marra keltëve, të kushtuara faltores së Athinasë Itone, midis Ferës e Larisës, në këtë mbishkrim:

3 "Pirro Molosi ia dhuron Athinasë Itone
këto mburoja, që ua hoqi galatëve të fortë,
pasi shkatërroi gjithë ushtrinë e Antigonit;
dhe nuk është kjo një çudi e madhe
sepse aiakidët janë edhe tani luftëtarë, siç kanë qenë
edhe në të kaluarën"

Edhe Zeusit të Dodonës i kushtoi mburojat e marra maqedonasve ku qe shkruar:

"Këta dikur plaçkitën Azinë plot ar
Këta dhe Helladën deshën ta robërojnë;
tani pranë shtyllave të tempullit të Zeusit si
jetime varet
plaçka e Maqedonisë mburracake"

4 Që Pirrua nuk pushtoi krejt Maqedoninë, megjithëse i gatshëm ta bënte posa ta kishte në dorë, ka qenë shkaktar Kleonymi. Kleonymi ia mbushi mendjen që ta linte Maqedoninë dhe të niste fushatën kundër Peloponezit. Këtë e bëri se ishte vetë lakedemon dhe deshi të çonte ushtrinë në Lakedemoni, për arsyet që do të them më poshtë, pasi të tregojë nga rrjedh Kleonymi. Pausania, që udhëhoqi helenët në betejën e Platesë, pati një djalë të quajtur Preistonah dhe ky pati bir Kleombrotin, i cili u vra në Leuktra, duke luftuar me Epaminondën e me tebanët. Kleombroti la Kleomenin dhe Agesipolin, dhe me që ky i fundit vdiq pa fëmijë, fronin e mori
5 Kleomeni. Kleomeni kishte dy djem: Akrotatin, të madhin, dhe Kleonymin, të voglin. Pas vdekjes së Akrotatit dhe Kleomenit, i cili vdiq pas të birit, Areu, i biri i Akrotatit, kishte kërkuar fronin. Prandaj Kleonymi duke dashur të siguronte për vete fronin në çdo mënyrë, e bindi Pirron të shkojë në vend të tij. Lakedemonët deri në betejën e Leuktras nuk kishin pësuar asnjë humbje, kështu deri më sot s'kishin pranuar se ishin mundur ndonjëherë në luftë tokësore. Sipas tyre Leonidha doli fitues kundër medëve megjithëse nuk arriti t'i shkatërronte plotësisht. Sa për çështjen me athinasit e Demostenin në ishullin e Sfakterisë, për këtë thoshin se ka qenë një
6 vjedhje e luftës dhe jo fitores. Humbjen e parë e pësuan prej beotëve; më vonë e pësuan edhe më tepër nga Antipatri dhe maqedonsit.
Në luftën e tretë me Demetrin pësuan fatkeqësinë e papritur, që shkatërroi tokat e tyre. Kur panë ushtrinë e Pirros që shkretoi tokën e tyre, i dolën përballë së bashku me ushtrinë e ardhur të aleatëve argas e mesenas. Në betejën që u bë, Pirrua fitoi dhe për pak e pushtoi qytetin në sulmin e parë, por preferoi më parë të prishë fushat rreth e rrotull, të plaçkisë e të çlodhet pak. Lakedemonët menjëherë nisën të bëhen gati për një rrethim meqenëse Sparta edhe më parë gjatë luftës me Demetrin ishte rrethuar me hendeqe të thella dhe gardhe të forta, dhe në disa vende më të dobëta edhe me mure. Në këtë kohë kur po zgjatej lufta me lakonët, Antigoni si ripushtoi
7 qytetet e Maqedonisë vrapoi në Peloponez, se e dinte mirë që Pirrua pas pushtimit të kësaj nuk do të kthehej në Epir, por do të turrej kundër Maqedonisë, ku do të ndizte luftën përsëri. Në kohën kur Antigoni po çonte ushtrinë nga Argo në Lakoni, në Argo erdhi Pirrua. Në betejën midis dy ushtrive ai e theu armikun dhe e ndoqi deri në qytet ku hyri i dërrmuar dhe i çrregullt. Këtu vazhdoi lufta pranë faltoreve, shtëpive, nëpër rrugët e në çdo vend tjetër të qytetit. Në mes të zjarrit të betejës Pirrua u nda nga shokët dhe mori një rrugicë për të ndjekur armiqtë, mirëpo kur po shkonte kaluar thonë se një grua i ra Pirros me një tjegull në kokë dhe e rrëzoi të vdekur nga kali. Banorët e Argos thonë se nuk e vrau një grua, por perëndesha
8 Demetra e shndëruar në grua. Kështu thonë rreth vdekjes së Pirros argasit dhe

shkruesi i ngjarjeve të vendit, Lykeu. Në vendin ku ra Pirrua ndodhet një faltore e Demetrës që e ndërtuan qytetarët pas një orakulli hyjnor, po aty u varros edhe Pirrua.
9 Unë çuditem se si aiakidët të gjithë kanë vdekur në të njëjtën mënyrë sipas një vendimi hyjnor. Në fakt Homeri shkruan se Akili u vra prej Aleksandrit, të birit të Priamit, dhe prej Apollonit; Pirrua i biri i Akilit u vra në Delfi me urdhër të Pythias dhe Aiakidi tjetër u vra ashtu si tregojnë argasit dhe shkroi Lykeu. Ndryshe shkruan Heronymi nga Kardia, pasi një njeri që jeton me mbretin duhet të shkruajë gjithmonë në favor të tij. Në se Filistit iu dha e drejta të fshehë veprat kriminale të Dionisit vetëm se shpresonte të kthehej përsëri në Sirakuzë, pa dyshim duhet të falet edhe Hieronymi, që shkruan për t'i bërë qejfin Antigonit. Ja ku mbaroi apogjeu i epirotëve.

LIBRI IV

Mesenia

3 **35** ... Gjendja në Thesproti të Epirit u turbullua për shkak të anarkisë. Meqenëse Deidamea, gruaja e Pirros, nuk pati fëmijë, kur i erdhi koha e vdekjes,
4 drejtimin e punëve ia besoi popullit. Kjo ishte e bija e Pirros, të birit të Ptolemeut, birit të Aleksandrit të Pirros. Ngjarjet e Pirro Aiakidit i tregova në librin mbi Atikën. Prokli kartagas i dha epërsi Aleksandrit të Filipit për shkak të fatit të madh dhe qartësisë së veprave të tij, por përsa i përket radhitjes së kalorësve dhe taktikës
5 strategjike kundër armikut quajti më të aftë Pirron. Pasi epirotët s'patën më mbretër, populli edhe në gjërat e tjera sillej me përbuzje, dhe zuri të mos u bindej autoriteteve të vendit. Atëherë ilirët që banonin sipër Epirit nga ana e Jonit, i nënshtruan me sulm. Sepse gjer më sot, nuk dimë të kenë përparuar të tjerë me anë të demokracisë përveç athinasve; këta përparuan shumë me anë të kësaj, mbasi me urtinë e tyre i kaluan helenët e tjerë dhe ligjeve në fuqi u bindeshin fort. Ilirët, mbasi e shijuan
6 sundimin dhe gjithmonë dëshironin gjëra më të shumta, ndërtuan anije dhe plaçkisnin të tjerë si të qëllonte; ata hynë në limanin e Motonit si miq, dhe pasi dërguan lajmëtarë në qytet, kërkuan t'u sillnin verë në anijet. Pasi erdhën disa burra të pakët, duke sjellë verë, edhe verën e blenë ilirët me çmimin që caktonin motonasit, edhe atyre u shitën nga ato që kishin me vete. Kur të nesërmen erdhën
7 nga qyteti më shumë njerëz, u dhanë mundësi që edhe këta të fitojnë. Më në fund, gra edhe burra u derdhën në anijet për të shitur verë dhe për të blerë sende nga barbarët. Atëherë ilirët, duke marrë guxim, rrëmbyen edhe burra shumë, edhe gra ca më shumë dhe si i vunë në anijet, u drejtuan për në Jon, duke shkretuar qytetin e motanasve...

LIBRI V

Elida

2 **22** Pranë të ashtuquajturit Hipodam është vendosur një bazament tjetër prej mermeri në trajtë gjysmërrethi, në të cilin gjenden Zeusi dhe Tetis e Himera që i luten atij për të bijtë. Të gjitha këto janë në mes të bazamentit. Në njërin dhe në tjetrin skaj janë përfytyruar me paraqitje luftarake Akili e Memnoni. Aty gjenden po ashtu përballë njëri-tjetrit barbarë e helenë, Odiseu me Helenin, pasi të dy fituan famë në ushtritë e tyre për dituri; Menelau me Aleksandrin për armiqësinë që kishte

3 njëri kundër tjetrit, Aiasi i Telamonit me Deifobin. Të gjitha këto janë punuar nga Lyki, i biri i Myronit. Ia kushtuan apolloniatët e Jonit. Në këmbët e Zeusit me shkronja të vjetra është shkruar:

"Këtu gjendemi si dhuratë e Apollonisë
të ndërtuar pranë Jonit nga Foibi flokëgjatë;
fituesit kundër abantëve Zeusit ia kushtojnë
një të dhjetën e plaçkës të marrë në Tronion"

Krahina e Abantisë dhe qyteti që gjendet atje, Troni, ndodhen në Thesprotinë e
4 Epirit, pranë maleve Keraune. Duke u kthyer nga Ilioni anijet e helenëve u shpërndanë; lokridasit e Tronit në breg të lumit Boagr dhe abantët e Eubesë me tetë anije erdhën te malet Keraune. Atje zunë vend dhe ndërtuan një qytet me emër Troni dhe në marrëveshje të përbashkët e quajtën Abantidë gjithë krahinën që banonin, por luftuan dhe u dëbuan nga fqinjët e tyre apolloniatë. Apollonia ishte një koloni e Korkyrës dhe korintasit morën një pjesë nga plaçka...

5 **23** Një tjetër shtatore e Zeusit është vendosur pranë karrocës së Kleostenit. Për këtë do të flas më poshtë...

LIBRI VI

Elida (II)

6 **10** Sipër Pantarkut është një karrocë e Kleostenit, një burrë nga Epidamni. Është punuar nga Ageladi dhe gjendet prapa Zeusit, të cilin helenët e ngritën pas betejës së Platesë. Kleosteni i përmendur më lart fitoi në olimpiadën e 66-të dhe /me këtë rast/
7 i kushtoi /Zeusit/ edhe portretin e tij dhe karrocierin. Janë shkruar edhe emrat e kuajve, Foiniks dhe Koraks, kurse nga të dy anët, afër zgjedhës /emrat/ Knakias, nga e djathta, dhe Samo nga e majta. Mbi karrocën lexohet:

"Detari Kleosten nga Epidamni
më vuri këtu, pasi fitoi me kuaj
garën fisnike të Zeusit".

8 Kleosteni qe nga ata helenë që mbanin kuaj dhe i pari që dhuroi portretin e tij në Olympia...
Epidamnasit, në kohën tonë, banojnë në tokën ku banonin që në fillim, por jo edhe në qytetin e vjetër, po në një qytet që është pak larg të parit; qyteti i sotshëm quhet Dyrrah nga emri i themeluesit...

3 **12** Mbas vdekjes së Agathoklit, që kishte qenë më parë tiran i Syrakuzës, doli një tiran tjetër. Ky qe Hieroni, që sundoi në vitin e dytë të olimpiadës 120, në të cilën fitoi garën Idai nga Kirena. Ky Hieroni kishte ardhur mik te Pirro Aiakidi dhe së bashku celebroi martesën e të birit Gelonit me Nereidën, të bijën e Pirros.

9 **14** Pirro Aiakidit, mbretit të Thesprotisë epirote, i cili tregoi shumë triměri, që do të kujtohen përherë, dhe që unë i kam shpjeguar në tregimet athinase, ia kushtoi në Altis Thrasibuli nga Eleioni...

Gjenden po ashtu fituesit e vrapimit të fëmijëve, Meneptolemi, nga Apollonia e bregut të Jonit dhe Filoni korkyras...

8 **19** Thesarurët e tretë e të katërt janë dhuruar nga epidamnasit dhe byzantasit; ai i të parëve ka botën e mbajtur nga Atlasi dhe Herakliu dhe pemën e

Hesperideve, mollën me gjarpërin të përdredhur rreth saj. Të gjitha këto janë punuar prej kedri, nga Teokleu, i biri i Hegylit. Që botën e bëri bashkë me të birin e tregon mbishkrimi që gjendet aty. Hesperidet, të bartura më pas nga banorët e Elidës, janë po ato që në kohën time ishin në Heraion. Thesaurin e epidamnasve e bënë Pirrua dhe djemtë e tij Lakrati e Hermoni...

LIBRI VIII

Arkadia

3 **40** Unë e di mirë gjithashtu se si argasit vepruan me Kreugun prej Epidamnit; megjithëse Kreugu vdiq, argasit ia dhanë atij kurorën e Nemejve, për arsye se Damokseni prej Srakuze, i cili u ndesh me të shkeli marrëveshjet e pranuara prej tyre...

5 ... Ata fitoren ia dhanë Kreugut të vdekur të cilit i ngritën një monument në Argo, që gjendet në tempullin e Apollon Lykeut.

LIBRI IX

Beotla

3 **5** Kadmi emigroi tek ilirët, tek ata ilirë që quhen enhelej, atë e pasoi i biri Polidori...

6 **8** Kur tebanët u mundën në luftë nga argasit, afër Glisës, shumë prej tyre shkuan me Laodamin, të birin e Eteoklit, një pjesë e tyre ikën nëpër tokë tek ilirët...

21 Pashë në Romë edhe qé nga Paionia. Ata kanë qime të dendura në të gjithë
2 trupin, por më tepër në gjoks dhe në mjekër.

LIBRI X

Fokea

7 **19** Udhëheqësit[1] e ndanë ushtrinë në tri pjesë dhe vendosën që secili prej tyre të shkonte në drejtime të ndryshme. Kundër thrakëve dhe tribalëve u përgatit t'i udhëhiqte Kerethri, kurse ata që u drejtuan kundër Paionisë i udhëhiqte Breni dhe
8 Akihori. Bolgi u nis kundër maqedonasve dhe ilirëve. Ai u përlesh me Ptolemeun, i cili sundonte atëherë mbi maqedonasit. Ptolemeu ishte ai që vrau me tradhëti Seleukun, të birin e Antiohut, megjithëse ai shkoi tek Seleuki si lutës. Mori emrin Keraunos për shkak të guximit të tij të madh. Po ky Ptoleme u vra në betejë dhe
9 maqedonasit pësuan një humbje të tmershme[2]. Por keltët nuk guxuan të shtyhen deri në Helladë dhe luftëtarët u kthyen pas kësaj fushate të dytë në tokat e tyre...

---

[1] Prijësat ushtarakë keltë.
[2] Viti 280 para e. sonë.

APIANI

Historian grek, lindur në Aleksandri të Egjiptit aty nga fundi i shekullit të I dhe jetoi deri në vitet 70 të shek. II të e. sonë. Në Aleksandri ai kishte detyra të larta në administratën e qytetit. Në kohën e Hadrianit atij iu dha qytetaria romake dhe u fut në rendin e kalorësve. Në këtë kohë ai u vendos në Romë ku ushtronte detyrën e avokatit. Më vonë u emërua prokurator perandorak në Egjipt.

Apiani shkroi Historinë e Romës në 24 libra. Veprën e tij ai e shkroi në moshë të thyer, mbase aty nga viti 160 i e. sonë dhe me sa duket nuk arriti ta përfundonte. Prej saj janë ruajtur 11 libra të plotë bashkë me parathënien, dhe 4 të fragmentuar. Ndryshe nga paraardhësit e tij, Apiani e shkroi Historinë e Romës jo sipas kriterit analistik apo kronologjik, sikurse e bën këtë Polibi, por sipas kriterit territorial apo etnik, duke dhënë kështu një seri monografish të veçanta, brenda të cilave ai i përmbahet parimit kronologjik. Ç'është e vërteta në një sistem të tillë, zhvillimi i përgjithshëm i ngjarjeve të historisë romake pa dyshim shkelej; por ndjekjen në mënyrë rigoroze të parimit të kronologjisë, Apiani vetë e quante të tepërt. Nga parimi etnik që vuri në bazë të "Historisë së Romës", Apianit iu desh të tërhiqet vetëm në veprën e tij "Luftërat Civile", e cila si nga përmbajtja ashtu edhe nga trajtimi i çështjeve përbën trashëgimin më të mirë të këtij autori.

Burimet që ka përdorur Apiani për veprën e tij në pjesën më të madhe janë romake; ai ka shfrytëzuar gjerësisht edhe trashëgimin letrar të paraardhësve të tij e në radhë të parë veprat e Timagenit, Polibit, Livit, etj.

Në shtjellimin e historisë së tij, Apiani ka edhe disa pasaktësi, por kjo nuk e ul aspak vlerën e përgjithshme të veprës.

Me interes të madh për ne, është libri kushtuar luftërave ilire ("Ilirike"). Në të përmbahen të dhëna për historinë e ilirëve që nga prejardhja deri në pushtimin e tyre të plotë nga Roma, duke përfshirë këtu edhe fushatat e fundit të Augustit e Tiberit për nënshtrimin e ilirëve të Veriut. Por për fat të keq, në krahasim me librat e tjera, ky libër i Apianit është i një niveli të ulët. Vepra nuk ka një strukturë të shëndoshë e të rrjedhshme dhe ngjarjet janë shtjelluar kalimthi e shpesh në mënyrë të pështjelluar, kështu që libri nuk jep historinë e ilirëve pa ndërprerje, por vetëm një përmbledhje fragmentesh, të shpërndara jo vetëm nga ana kronologjike në episode pa lidhje midis tyre, por mbi të gjitha të shpërndara akoma më shumë nga parimi etnologjik i Apianit. Arsyeja është siç e thotë edhe vetë autori, se historinë e ilirëve ai nuk e ka njohur mirë dhe nuk ka mundur të grumbullojë për ta materiale të mjaftueshme (Bell. Civ.I, 145).

Megjithatë në veprën e Apianit gjejmë të dhëna mjaft të vlefshme, siç janë përcaktimi i kufijve gjeografikë të Ilirisë në kuptimin grek e romak, përshkrimet e gjalla të luftërave të ilirëve të Veriut kundër pushtuesve romakë me të cilat ai plotëson Livin përsa ka humbur nga vepra e tij, etj. Të dhëna të tjera të shkëputura, por me interes gjejmë edhe tek libri mbi luftërat samnite, maqedonase, sirike e ato civile.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Appiani Alexandrii, Historia Romana, ed. Viereck, Roos et Mendelssohn. Lisiae in aedibug B.G. Teubneri 1939 et 1915.

APPIANI ALEXANDRINI

HISTORIA ROMANA

(Historia e Romës)

1. **Samnitike**

7 "Nëqoftëse duam që lirinë ta kemi të siguruar dhe të luftojmë në mënyrë të barabartë, të thërresim nga Epiri mbretin Pirro dhe ta shpallim atë komandant të kësaj lufte; gjë që u bë[1].

8 Pirrua, mbret i Epirit, mbas katastrofës detare që pësoi shkoi në Tarant dhe tarantasit atëherë u rënduan shumë nga taksat mbretërore, të mbledhura me forcë dhe nga fyerjet që u bënte grave dhe fëmijëve të tyre. Gjithashtu Pirrua shpërndau mensat popullore dhe /ndaloi/ mbledhjet e dëfrimet, të cilat i quante të papajtueshme me luftën, ndërsa qytetarët i futi në stërvitje ushtarake dhe ata që i shmangeshin, i dënonte me vdekje. Pra kështu të gjithë tarantasit, të lodhur nga punët e papritura dhe taksat, filluan ta konsiderojnë qytetin si të huaj dhe të largoheshin nëpër fushat. Mbreti /për këtë/ mbylli portat dhe vendosi roje.

10 Pirrua, mbreti i Epirit, si mundi romakët dhe duke dashur të largojë ushtrinë nga beteja e ashpër, dhe me shpresë se romakët do të shpërndaheshin, dërgoi në Romë Kinea Thesaliotin, të famshëm për fjalime se imitonte Demostenin. Kinea shkoi në senat dhe atje mburri shumë mbretin, duke vënë në dukje modestinë e tij në betejë dhe faktin që nuk marshoi drejt qytetit[2] as drejt lëmit më të afërm; nga ana tjetër atyre u ofroj paqe, miqësi dhe aleancë me Pirron nëqoftëse pranonin në këtë /aleancë/ edhe tarantasit, kurse helenët e tjerë që banonin në Itali t'i linin të lirë dhe të pavarur dhe leukanëve, samnitëve, daunëve e bretëve t'u kthenin të gjitha ato që u kishin marrë gjatë luftës. Dhe tha: "Si të bëhen të gjitha këto, Pirrua do t'u dorëzonte robërit pa shpërblim..."
Pasi nuk mori ndonjë përgjigje për paqe nga senati, Pirrua u drejtua për në Romë, duke plaçkitur /rrugës/ gjithçka. Arriti në qytetin Anagnia, duke pasur tani ushtarët të rënduar nga plaçka e madhe dhe robërit e shumtë, hoqi dorë nga beteja dhe u kthye në Kampania me elefantët në krye, ndërsa ushtrinë e ndau në qytete për të dimëruar.

2. **Makedonike**

18 Genti, mbreti i ilirëve, një popull fqinj me maqedonasit, mbasi bëri aleancë me Perseun kundrejt treqind talentëve, një pjesë të të cilave i mori që më parë, hyri në Ilirinë e pushtuar prej romakëve dhe delegatët Perpenën e Petilin, që erdhën për këtë /ngjarje/ tek ai, i lidhi. I njoftuar për këto, Perseu nuk dërgoi më pjesën tjetër të të hollave si më përpara, kur ai /Genti/ luftonte për atë kundër romakëve.

---

[1] Këto fjalë u thanë nga një tarantas në mbledhjen e popullit, kur po shqyrtohej gjendja e krijuar në marrëdhëniet me romakët.
[2] Romës

3. Syriake

10 Thonë se në kohën e këtyre bisedimeve, në gymanz, Scipioni me Hanibalin hapën, në praninë e shumë të tjerëve, bisedën mbi artin e udhëheqësit. Scipioni e pyeti Hanibalin se cilin quan ai si udhëheqës më të shkëlqyer. Hanibali iu përgjegj: "Aleksandrin Maqedon". Scipioni e priti me qetësi këtë thënie, që e vinte Aleksandrin mbi të dhe pyeti se cilin quan ai të dytë pas Aleksandrit. Hanibali atëherë tha: "Pirron, mbretin e Epirit". Me sa duket trimërinë e udhëheqësit ai e maste me guximin dhe mbretër, që të kenë vepruar më me guxim se këta, nuk mund të gjenden. Scipioni megjithëse e ndjeu veten të fyer, prapë e pyeti se kujt i jepte ai vendin e tretë. Sigurisht ai ishte shumë i sigurtë se do të zinte vendin e tretë. Por Hanibali iu përgjegj: "Vetes; kur isha akoma i ri, unë pushtova Iberinë dhe qeshë i pari, pas Herakliut, që kalova Alpet me ushtri dhe u futa në Itali. Një guxim të tillë asnjë nga ju nuk e ka treguar asnjëherë. Unë pushtova katërqind qytete dhe më se një herë ju detyrova juve të frikësoheshit për qytetin tuaj, kurse nga Kartaga mua nuk më dërgonin as pare, as ushtri". Kur Scipioni e pa se ai kishte qejf të vazhdonte të lavdërohej, i tha duke qeshur: "Në ç'vend do ta vije veten ti, Hanibal, po të mos ishte mundur prej meje?". Thonë se Hanibali, duke vënë re zilinë /e Scipionit/, aty për aty i tha: "Atëherë unë do ta vija veten përmbi Aleksandrin". Kështu Hanibali, duke qëndruar gjithnjë kryelartë, pa e treguar, i bëri qejfin Scipionit, duke i lënë të kuptojë se ai mundi atë që qëndron më lart se Aleksandri.

4. Illyrike

1 Helenët quajnë ilirë ata që banojnë mbi Maqedoninë dhe Thrakinë, që nga kaonët dhe thesprotët deri tek lumi Ister. Dhe kjo është gjatësia e vendit, ndërsa gjerësia prej maqedonasve dhe thrakëve malorë tek paionët deri në Jon dhe në rrëzë të Alpeve. Gjerësia mban pesë ditë rrugë, kurse gjatësia tridhjetë ditë, siç thonë helenët. Sipas matjes që bënë romakët, gjatësia kalon të gjashtë mijë stadet, kurse gjerësia është rreth një mijë e dyqind stade.

2 Këtë emër e mori ky vend, siç thonë, nga Iliri, i biri i Polifemit. Bijtë e qiklopit Polifem dhe Galatës, të quajtur Kelt, Ilir dhe Gal, lanë Siqelinë dhe u bënë sundimtarë mbi fise, të cilët nga emrat e tyre u quajtën keltë, ilirë dhe galë. Nga shumë legjenda që tregohen, kjo më pëlqen më tepër. Bijtë e Ilirit kanë qenë Enheleu, Autari, Dardani, Medi, Taulanti dhe Perrebi; vajzat e tij ishin Parta, Daorta, Dasara dhe të tjera, nga kanë rrjedhur taulantët, perrebejt, enhelejt, autariatët, dardanët, parthinët, dasaretët dhe darsejt. Thonë se Autari pati për bir Panonin ose Paionin[1], dhe ky i fundit pati për bij Skordiskun dhe Tribalin, nga të cilët morën

3 emrin dhe fiset. Po këto probleme le t'ua lëmë arkeologëve. Sa për fiset ilire, këta janë akoma tani të shumta dhe të dëgjura, siç është e natyrshme në një vend aq të gjerë; këta banojnë ndër krahinat e gjera të skordiskëve edhe tribalëve, të cilët nga luftat që patën midis tyre u shkatërruan aq shumë, sa që nga tribalët mbeti një pakicë fare e vogël, e cila më në fund iku dhe vajti përtej Istrit në viset e getëve; kështu pra ky fis, që ishte në lulëzim gjer në kohët e Filipit dhe të Aleksandrit, tani

[1] Apiani përzien panonët me paionët, përderisa pranon se Panon e Paion është i njëjti themelues i një fisi të vetëm.

është i shkretë dhe pa emër. Në anën tjetër edhe skordiskët, të dobësuar shumë nga këto luftëra, pësuan të njëjtat mjerime nga romakët dhe ikën e shkuan në ishujt e të njëjtit lum e me kohë pastaj disa u kthyen dhe zunë vend në kufijtë e paionëve; prandaj edhe sot ndodhet një fis skordiskësh ndër paionët. Kështu e pësuan edhe ardianët, të cilët, duke qenë të shkëlqyer në /luftërat/ në det, si u ndeshën me autariatët, të cilët ishin të shkëlqyer për luftërat në tokë, u shkaktuan këtyre shumë dëme, por përfundimisht ata u shkatërruan edhe vetë. Pas ardianëve ishin liburnët, fis tjetër ilir, të cilët grabitnin detin Jon dhe ishujt me anije të lehta dhe të shpejta. Prandaj akoma dhe tani dikrotet[1] e lehta dhe të shpejta romakët i quajnë liburnide...

4 Të dënuar nga Apolloni, autariatët pësuan një fatkeqësi shumë të madhe. Këta bashkë me Molistomin e me keltët, që quheshin kimbër[2], nisën fushatën kundër Delfit[3], por menjëherë, pa filluar akoma veprimet, më të shumtët e tyre vdiqën nga që ranë mbi ta shira me rrebesh dhe rrufé. Ata që u kthyen e pësuan nga një numër i madh bretkosash, të cilat u qelbën dhe prishën ujin. Përveç kësaj toka lëshoi avuj të jashtëzakonshëm, që sollën një murtajë tek ilirët, por më shumë vdiqën autariatët, të cilët u shtrënguan të lënë vendet e tyre. Mirëpo mbasi murtajën e kishin me vete, asnjeri nuk i pranonte nga frika dhe si u endën për më se njëzet e tri ditë, u vendosën në një vend moçalor dhe të pabanuar të getëve afër fisit të bastarnëve. Ndërsa tek keltët perëndia, me një tërmet të fortë, rafshoi qytetet e tyre dhe e keqja s'pushoi derisa sa edhe këta lanë vendin e vet dhe u lëshuan kundër ilirëve, bashkë-mëkatarë të tyre të dobësuar nga murtaja, dhe shkretuan tokat e këtyre, por të infektuar nga murtaja ikën prej këndej dhe aritën deri në Pirene duke plaçkitur.

5 Ja se ç'dënim u dha perëndia ilirëve dhe keltëve për mungesë respekti ndaj gjërave hyjnore. Megjithatë prapë nuk hoqën dorë nga sakrilegjet; të bashkuar përsëri me keltët, fiset ilire, dhe sidomos skordiskët[4], medët[5] dhe dardanët u sulën kundër Maqedonisë dhe Helladës dhe grabitën shumë tempuj si dhe atë të Delfit; mirëpo edhe këto sakrilegje i paguan shumë shtrenjtë[6], mbasi humbën shumë ushtarë gjatë këtij sulmi. Romakët atëherë, tridhjetë e dy vjet pas luftës së parë me keltët[7] dhe pas shumë përleshjeve të tjera që kanë bërë me ata herë pas here, dërguan ushtri kundër ilirëve[8] nën komandën e Leuk Scipionit[9] duke marrë për shkak këtë sakrilegj të tyre dhe si mbrojtës të heleneve dhe maqedonasve. Thonë se fqinjët nuk u ndihmuan atyre që kryen këto sakrilegje, po i lanë me dashje, pa ndihmë fare dhe në mëshirë të Scipionit; në këtë i shtyri edhe kujtimi i gjithë atyre të këqijave që u ngjanë ilirëve për shkak të sjelljes së autariatëve. Scipioni i dëboi skordiskët dhe një pakicë e vogël që mbeti iku dhe u vendos pranë Istrit e ndër ishujt e këtij lumi; sa për medët e dardanët, thuhet se bëri marrëveshje dhe u pajtua me ta pasi i dhanë një sasi nga ari i grabitur në faltoret. Për këtë shkak, siç thotë një nga shkrimtarët italikë, pas Leukut filluan në Romë me tërbim më të madh luftërat civile deri në kohën e

6 monarkisë. Thashë pra gjer këtu se cilët konsiderohen ilirë prej heleneve. Ndërsa

---

[1] Dikrote, anije me dy sërë lopatash.

[2] Apiani gabimisht e ngatërron dyndjen e keltëve në Greqi me kimbrët.

[3] Apiani ka parasysh përvojën e hidhur të keltëve në vitin 279 para e. sonë për marrjen e Delfit. Përshkrimi i kësaj ngjarjeje është nxjerrë nga një fragment i Pompe Trogut. Molistomi ishte, me sa duket, prijës i autariatëve që u bashkuan me keltët.

[4] Në të vërtetë skordiskët janë një fis kelt.

[5] Medët janë fis thrak në Strumën e mesme; Apiani i përzien gabimisht me ilirët.

[6] Është fjala për grabitjen e tempullit të Zeusit në Dodonë në vitin 88 para e. sonë, dhe të tempullit të Apollonit në Delfi në vitin 83 para e. sonë.

[7] D.m.th. me skordiskët në vitin 113 para e. sonë.

[8] Në fakt kundër skordiskëve.

[9] Fushata ndëshkuese e L. Scipionit në vitin 81 para e. sonë.

romakët, jo vetëm ilirët, po edhe paionët[1], që janë afër tyre edhe retët edhe norikët edhe myzët, që janë në Evropë, edhe tërë ata fise që janë kufitarë me këta dhe që banojnë nga e djathta e atij që lundron nëpër Istër nga lart poshtë, i dallojnë nga helenët, sikundër bëjnë edhe helenët vetë, dhe i quajnë secilin me emra të veçantë, po viset e gjithë këtyre i quajnë me emrin e përbashkët Iliri. Nga u nisën që e formuan këtë mendim, unë s'mund ta gjej, por edhe sot ata /romakët/ këtë emër përdorin; edhe taksën që marrin nga të gjithë këta popuj, që prej Istrit të sipërm gjer në detin e Pontit, e lëshojnë me qira nën këtë emër, dhe e quajnë "taksë ilirike"...

7 Agroni ka qenë mbret i atij vendi të ilirëve që është buzë gjirit të detit Jon dhe që e zotëronte Pirrua, mbret i Epirit, dhe trashëgimtarët e tij. Agroni pra pushtoi disa vise të Epirit dhe Korkyrën, pastaj Epidamnin dhe Farin dhe vendosi garnizone në to. Por meqenëse zuri të sulmojë me flotën e tij edhe vise të tjera të Jonit, ishulli Isa kërkoi ndihmë nga romakët. Këta atëherë dërguan delegatë së bashku me isasit për të parë se ç'të këqija u kishte bërë atyre Agroni. Por delegatëve u dolën përpara në det anijet ilire dhe vranë Kleemporin nga Isa dhe romakun Koronganin, ndërsa të tjerët ikën dhe shpëtuan. Për këtë shkak, romakët dërguan kundër ilirëve flotën bashkë me ushtrinë.

Në këtë kohë Agroni vdiq dhe sundimin ia la të shoqes që u bë kujdestare e të birit të tij të mitur të quajtur Pini, megjithëse kjo nuk ishte e ëma e këtij djali; në anën tjetër Demetri, komandant i Agronit në Far (në fillim i Farit pastaj dhe i Korkyrës), ua dorëzoi me tradhëti romakëve që të dyja këto. Përveç këtyre edhe Epidamnin e detyruan të lidhë miqësi me ta dhe njëkohësisht dërguan fuqi për t'u ndihmuar isasve dhe epidamnasve, të cilët ishin rrethuar prej ilirëve. Ilirët atëherë hoqën dorë nga rrethimi dhe u kthyen në vendet e tyre, bile disa prej tyre, ata që quheshin atintanë shkuan tek romakët. Më pas gruaja e Agronit dërgoi delegatë në Romë, të cilët u kthyen romakëve robërit dhe dorëzuan dezertorët duke kërkuar njëkohësisht ndjesë, mbasi ato që ndodhën nuk u bënë në kohën e saj, por në kohën e Agronit. Romakët u përgjigjën se Korkyra, Fari, Isa, Epidamni dhe ilirët atintanë janë të gjithë të nënshtruar të romakëve; sa për Pinin, i cili do të sundonte mbi pjesën tjetër të mbretërisë së Agronit, do të ishte miku i romakëve nëqoftëse do të hiqte dorë nga viset e përmendura më sipër dhe pranë Lisit të mos lundronin më shumë se dy anije ilire dhe këto të paarmatosura. Ajo pra i pranoi të gjitha këto dhe kështu u

8 bënë të parat marrëveshje dhe traktate midis romakëve dhe ilirëve. Romakët pas këtyre lanë të lirë Korkyrën dhe Apolloninë, kurse Demetrit i dhanë disa vende si shpërblim për tradhëtinë dhe i thanë se i jepnin mjaft, mbasi s'kishin besim tek ky njeri. Dhe me të vërtetë pas pak kohe doli në shesh pabesia e tij: kur romakët po luftonin për tre vjet me radhë kundër keltëve, që banonin pranë Eridanit, Demetri, duke përfituar nga që ata ishin të zënë, grabiste anijet që lundronin në det bashkë me istrët, një fis tjetër ilir, që e kishte bërë për vete; përveç kësaj edhe atintanët i largoi nga romakët. Këta /romakët/, pasi rregulluan punët me keltët, dërguan menjëherë fuqi detare, e cila i ndoqi kusarët e detit dhe i shtiu në dorë. Pastaj vitin tjetër u lëshuan kundër Demetrit dhe ilirëve bashkëfajtorë. Demetrin, i cili në këtë kohë kishte shkuar tek Filipi, mbreti i maqedonasve, dhe duke u nisur së këtejmi plaçkiste përsëri anijet në detin Jon, e vranë dhe atdheun e tij Farin, si bashkëfajtor, e prishën. Por ilirëve të tjerë nuk u bënë asnjë të keqe, mbasi u ishte lutur për ta Pini. Pas këtyre u bënë marrëveshjet dhe traktatet e dyta midis romakëve dhe ilirëve.

9 Sa për të tjerat, këto sa munda të gjej i shkrova jo sipas rendit kronologjik, por më tepër duke marrë çdo fis ilir veç e veç.

---

[1] Nënkuptohet panonët.

Romakët ishin në luftë me maqedonasit kur mbretëronte Perseu pas Filipit. Me Perseun u bë aleat Genti, mbret i një fisi tjetër ilir, kundrejt një shume të hollash dhe sulmoi ilirët që ishin nën romakët dhe lidhi delegatët romakë, që erdhën tek ai duke i akuzuar si spiunë. Atëherë Anici, komandant romak, zuri disa anije të Gentit, u përlesh me të në tokë, e mundi dhe e mbylli në një vend të fortifikuar, prej nga ai kërkoi të merrej vesh me Anicin; por ky e urdhëroi të dorëzohej tek romakët dhe meqenëse Genti kërkoi tri ditë afat për t'u menduar /Anici/ ia dha. Gjatë këtyre tri ditëve nënshtetasit e tij e lanë dhe u bashkuan me romakët; kjo gjë e detyroi mbretin ilir të kërkojë takim me komandantin romak... i cili e thirri për darkë dhe kur mbaroi darka e Genti u nis të iki u dha urdhër shërbëtorëve, që ta zënë e ta burgosin. Dhe më pas Anici,në kohën kur bëri triumfin, e solli bashkë me fëmijët e tij në Romë dhe kështu gjithë lufta me Gentin mori fund brenda njëzet ditëve. Shtatëdhjetë qytete të atjeshme Emil Pauli i përshkoi, sipas urdhërit të fshehtë të senatit dhe qytetarëve të këtyre, që ishin të tmerruar, u premtoi se do t'u jepte falje për çdo gjë që kishte ngjarë, nëqoftëse do të dorëzonin argjendin e arin që kishin. Mbasi ata pranuan, dërgoi në çdo qytet pjesë të ushtrisë, dhe komandatëve u dha urdhër që në mëngjes të një dite të caktuar të ftonin me anë kasnecësh qytetarët e çdo qyteti që t'i sillnin në sheshin publik, brenda tri orëve, të hollat që kishin premtuar; pasi t'i binin këto, të tjerat i grabisnin[1]. Kështu pra Pauli grabiti shtatëdhjetë qytete brenda një ore. Në anën tjetër ardianët dhe palarët fise ilire edhe këto, shkretonin Ilirinë që ishte nën
10 romakët, e prandaj këta, mbasi ishin zënë gjetiu, u mjaftuan të dërgojnë vetëm delegatë për t'i qortuar për këto grabitje. Po meqenëse këta nuk e ndryshuan qëndrimin, romakët i sulmuan me dhjetë mijë këmbësorë dhe gjashtëqind kalorës[2]. Atëherë ata /fiset ilire/, sapo morën vesh fushatën e romakëve, dhe meqenëse ishin akoma të papërgatitur për luftë, dërguan delegatë për t'u thënë se ishin të penduar dhe kërkonin ndjesë. Senati i Romës i pranoi kërkesat e tyre, por u dha urdhër që t'i shpërblejnë banorët e atyre viseve që ata kishin dëmtuar; dhe meqenëse ata nuk e pranuan këtë kusht, Fulv Flaku mori urdhër të sulet kundër tyre me ushtri. Por kjo luftë mori fund vetëm me anë të një sulmi, sepse romakët nuk gjetën aty ndonjë ushtri të rregullt.

Kundër japodëve që banonin përbrenda alpeve u dërgua me ushtri Semproni, i mbiquajtur Tuditani, bashkë me Pandus Tiberin. Dhe u duk sikur japodët u nënshtruan; edhe segestasit u duk se iu bindën Leuk Kotës dhe Metelit, po pa kaluar shumë kohë të dy këta fise ngritën krye[3].

11 Një tjetër fis, dalmatët, jo vetëm sulmonin ilirët që ishin nën romakët, po edhe delegatët e romakëve për këtë çështje nuk deshën t'i pranonin. Prandaj romakët dërguan kundër tyre ushtri nën komandën e konsullit të tyre Mark Figulit[4]. Kur po rregullonte ky lëmin e luftës aty pranë, dalmatët u ranë rojeve të tij dhe i mundën, kurse atë e nxorën nga lëmi, e shtrënguan të zbresë në një fushë të tatëpjetë dhe të arrijë gjer te lumi Naron. Figuli, kur pa se dalmatët u kthyen prapa, për shkak se kishe filluar dimri, duke shpresuar se do t'i gjente të papërgatitur i sulmoi befas, por gjatë ndjekjes u gjend përballë forcash të ardhura nga qytetet për t'i dalë përpara sulmit të tij. Atëherë u kthye dhe i ra qytetit Delmin, prej të cilit ndoshta rrjedh emri i tyre dalmatë, që pastaj u kthye në dalmatë. Mirëpo, meqenëse nuk mundi në asnjë mënyrë ta pushtonte qytetin e fortifikuar me anë të sulmit dhe nga ana tjetër edhe makinat nuk mund t'i përdorte, për shkak se muret e qytetit ishin shumë të larta, hoqi

---

[1] Në vitin 168 para e. sonë.
[2] Në vitin 135 para e. sonë.
[3] Në vitin 129 para e. sonë.
[4] Në vitin 156 para e. sonë.

dorë dhe u drejtua kundër qyteteve të tjera, të cilat kishin më pak forca, mbasi shumica e tyre ishte grumbulluar në Delmin. Pastaj u kthye përsëri kundër Delminit dhe urdhëroi të hidhen në qytet me anë hobesh topuze të gjata dy kutëshe të mbështjella me serë, squfur e kashtë liri. Këto nga shpejtësia ndizeshin dhe digjnin çdo gjë që gjenin përpara; kështu pra u dogjën shumë pjesë të qytetit dhe me këtë mori fund lufta e Figulit me dalmatët. Pak më vonë, kur Cecil Meteli ishte konsull, vendosi t'u shpallë luftë dalmatëve, jo sepse ata kishin bërë ndonjë veprim të kundërligjshëm, por vetëm e vetëm se dëshironte të bënte triumf. Mirëpo dalmatët e pritën si mik Metelin, i cili atë dimër e kaloi në qytetin e tyre Salona; pastaj u kthye në Romë dhe hyri me triumf[1].

12 Ndërsa Cezari merrej me rregullimin e punëve me keltët, dalmatët dhe ilirët e tjerë që ishin atëherë të fuqishëm, morën me forcë qytetin Promona të liburnëve, një tjetër fis ilir[2]. Këta *[liburnët]* atëherë e lanë fatin e tyre në duart e romakëve dhe kërkonin strehë tek Cezari që ishte afër. Ky dërgoi delegatë dhe urdhëroi pushtuesit t'u kthejnë qytetin liburnëve; por këta nuk dëgjuan, prandaj Cezari dërgoi kundër tyre ushtri të fortë, po këtë ilirët e shfarosën krejt. Megjithatë Cezari nuk u ra prapë, mbasi në këtë kohë grindej me Pompeun, dhe kur kjo grindje përfundoi me luftë, Cezari me gjithë forcat që kishte u nis nga Brendesi, kaloi detin Jon në dimër dhe u hodh në Maqedoni[3] kundër Pompeut. Nga ushtria tjetër një pjesë e mori Antoni dhe ia shpuri Cezarit në Maqedoni, duke kaluar edhe ky detin Jon në kohë dimri, kurse pesëmbëdhjetë kohorte këmbësorësh dhe tre mijë kalorës Gabini i nisi për te Cezari, nëpërmjet Ilirisë, duke i ardhur rreth detit Jon. Ilirët nga frika e hakmarrjes për ato që i kishin bërë shumë kohë përpara Cezarit, dhe duke kujtuar se fitorja e tij do të ishte katastrofë për ta, shfarosën pas një sulmi të gjithë ushtrinë që ishte nën komandën e Gabinit, përveç këtij të fundit dhe disa të tjerëve që mundën të ikin e të shpëtojnë. Dhe me këtë rast, nga plaçkat e shumta që zunë jo vetëm u pasuruan me të holla, por rritën edhe fuqinë e tyre ushtarake. Në këtë kohë Cezari ishte i shtrënguar të merrej
13 me Pomepun dhe pas vrasjes së tij me mbeturinat e kryengritjes së tij që ishte përhapur në shumë vise. Po, pasi i rregulloi të gjitha punët, u kthye në Romë dhe menjëherë unis me ushtri kundër getëve dhe parthëve[4]. Atëherë u trembën ilirët se mos, në udhëtim e sipër, sulej kundër tyre dhe prandaj dërguan delegatë në Romë e kërkuan ndjesë për ato që kishin ngjarë dhe u propozuan romakëve të bëheshin miq e aleatë, duke u mburrur se ishte puna për një popull shumë trim. Cezari ndonëse ngutej të arrinte sa më parë te parthët, megjithëkëtë u dha një përgjigje më të urtë; u tha se s'mund të bënte miq njerëz që kanë bërë të këtilla gjëra, po mund t'ua falte gabimet, nëqoftëse ata do të pranonin taksa dhe do të dorëzonin pengje. Pasi këta i premtuan të dyja këto, Cezari dërgoi Vatinin me tri njësi të vogla këmbësorësh dhe me shumë kalorësi për të caktuar disa taksa dhe për të marrë pengjet. Por, si u vra Cezari[5], duke kujtuar ata se fuqia romake lindi dhe mbaroi me Cezarin, nuk e dëgjuan më Vatinin as për taksa, as për të tjera dhe, kur u mat ky të përdorte forcën kundër atyre, i ranë dhe shkatërruan pesë njësi të ushtrisë së tij, duke vrarë edhe komandantin e tyre, Bebin, senator. Vatini atëherë me ushtarët që i mbetën, u kthye në Epidamn. Senati i Romës këtë ushtri maqedonase dhe atë pjesë

---

[1] Në vitin 118-117 para e. sonë.
[2] Në vitin 51 para e. sonë.
[3] Zbarkimi u bë më 5 janar të vitit 48.
[4] Persëve.
[5] Me 15 Mars 44.

të ilirëve, që e kishin nën sundim, ia dorëzoi Brut Kepionit, vrasësit të Gait[1], kurse Sirinë ia dorëzoi njëkohësisht Kasit, i cili gjithashtu kishte marrë pjesë në vrasjen e Gait. Por edhe këta, meqenëse u ngatërruan në luftë me Antonin dhe me Cezarin e dytë, që u quajt "August", s'patën kohë të merren me ilirët.

14 Paionët janë një fis i madh pranë Istrit dhe shtrihen për së gjati që nga japodët deri tek dardanët. Prej helenëve ata quhen paionë, kurse prej romakëve panonë, të cilët i përfshinë në Iliri, sikurse kam thënë më sipër. Për këtë arsye më duhet të flas mbi këta në kapitujt e Ilirisë. Agrianët që janë fis i paionëve të poshtëm dhe ilirë të ardhur, fituan lavdi të madhe për veprat heroike që bënë në kohën e Filipit dhe Aleksandrit, mbretërve të maqedonëve. Kundër paionëve nisi fushatë Korneli, mirëpo ky aq keq e pësoi gjatë kësaj fushate saqë kur u kthye në Itali u kalli tmerr gjithë italikëve, duke treguar trimërinë e paionëve; për këtë arsye edhe më vonë konsujt ngurronin të fillonin fushata kundër paionëve.

Nga e kaluara e ilirëve dhe e paionëve vetëm këto munda të gjej. Ndërsa në kujtimet e Cezarit të dytë, që u quajt August, nuk gjeta ndonjë gjë më të vjetër mbi paionët dhe ilirët.

15 Po më duket se përveç fiseve të sipërpërmendura, prej romakëve kanë qenë nënshtruar edhe të tjera fise ilire; por nuk munda ta marr vesh se si u pushtuan, si i shtypi dhe i detyroi /Augusti/ të paguajnë taksa, si pushtoi të tjerë që ishin më parë të pavarur, si mundi gjithë ata fise barbare dhe luftëtarë që banojnë në majat e Alpeve dhe grabitnin Italinë si fqinjë që ishin. Për mua është akoma një habi se si ushtritë e shumta dhe të mëdha romake, që shkuan kundër keltëve dhe iberëve duke kaluar përmes Alpeve, nuk i vunë re këta fise. Bile as edhe Gai Cezari, burrë i shquar në luftë nuk i zbuloi ata kur luftoi dhjetë vjet me radhë kundër keltëve dhe dimëroi në këtë vend. Por mua më duket se ata janë kujdesur vetëm për kalimin nëpërmjet Alpeve që të shkonin tek fiset që përmendëm, kurse Gai, i cili shkoi në tokat e keltëve, pasi shtypi kryengritjen e Pompeut në këto anë më në fund i nënshtroi edhe keltët. Por duket se Cezari u ngarkua të sundojë njëkohësisht mbi keltët dhe Ilirinë[2], jo mbi gjithë Ilirinë, po vetëm mbi atë që ishte atëherë nën sundimin e romakëve.

16 Augusti i nënshtroi të gjithë dhe, në krahasim me Antonin e plogësht, ai mendoi t'i sjellë Italisë qetësi nga popujt që e shqetësonin vazhdimisht dhe që ishin të fortë në luftë. Me një operacion të përgjithshëm pushtoi oksiejt, parthenët, batiatët, taulantët, kambeasit, kinamorët, meromenët dhe pyrisejt; me mundim të madh i pushtoi dhe i shtrëngoi të paguajnë taksat e prapambetura dokleatët, karnët, interfrurinët, naresët, glinditionët dhe tauriskët. Sapo u pushtuan këta, fqinjët e tyre hipasinët dhe besët nga frika iu dorëzuan. Ndërsa të tjerët që ngritën kryc si melitasit, korkyrasit, të cilët banonin ndër ishuj, i prishi krejt, mbasi grabitnin në det dhe ata, që ishin në moshë të re i vrau ndërsa të tjerët i shiti si skllevër. Gjithashtu edhe liburnëve ua mori anijet, sepse edhe këta grabisnin. Nga japodët që janë brenda Alpeve, moentinët dhe avendeatët iu dorëzuan atij sapo u afrua, po aurupinët, të cilët ishin më të shumtit dhe më luftëtarët midis japodëve, lanë fshatrat dhe u mblodhën në qytet dhe, kur u afrua ai, shkuan nëpër pyje. Cezari atëherë pushtoi qytetin, po nuk e dogji mbasi pati shpresë se ata do të dorëzoheshin dhe me të vërtetë u dorëzuan dhe morën leje të

17 kthehen në banesat e tyre.

Po më tepër e mërzitën atë salasët dhe japodët e përtej Alpeve si dhe segestasit, dalmatët, desitiatët e paionët, që ishin larg salasëve, të cilët banojnë në majat e

---

[1] G.J. Cezarit.

[2] Në vitin 56 para e. sonë.

Alpeve, në male të pakapërcyeshme dhe kalimi ndër ta ishte i ngushtë dhe i vështirë; për këtë arsye ishin të pavarur dhe nga udhëtarët, që kalonin aty pranë, merrnin taksa. Kundër tyre u lëshua befas Veteri, i shtiu në dorë ngushticat duke zënë pusi dhe i rrethoi dy vjet me radhë. Atëherë ata, meqenëse u mungoi kripa, për të cilën kanë shumë nevojë, pranuan një garnizon, por me t'u larguar Veteri, menjëherë e dëbuan garnizonin i forcuan ngushticat dhe talleshin me ushtarët, që dërgonte Cezari kundër tyre, mbasi s'mundnin të bënin ndonjë gjë të madhe. Për këtë arsye, po edhe pse pritej të ndizej lufta me Antonin, Cezari vendosi të bëjë marrëveshje me ta, duke i lënë të vetësundonin dhe duke mos i dënuar për ato që kishin bërë në kohën e Veterit. Po ata ishin gjithmonë në dyshim, e prandaj në njërën anë grumbullonin sasi të mëdha kripe dhe në anën tjetër e mësynin vendin e romakëve, gjersa Mesal Korvini, që u dërgua prej romakëve kundër tyre i shtrëngoi me anë të urisë të dorëzohen.

18 Në këtë mënyrë, pra, i pushtuan salasët; sa për japodët që banonin përtej Alpeve, një popull i fortë e i egër, këta dy herë i zmbrapsën romakët brenda pothuaj njëzet vjetëve; përveç kësaj sulmuan Akuilenë dhe plaçkitën Tergestin, koloni romake. Kundër këtyre u lëshua Cezari, mirëpo rruga ishte e përpjetë dhe e keqe dhe akoma më të vështirë e bënin armiqtë duke prerë drurët. Kur më në fund u ngjit, ata shkuan të gjithë në pyllin tjetër dhe së këtejmi, duke zënë pusi, u binin romakëve, që afroheshin. Po Cezari (i cili gjithmonë kishte frikë nga një gjë e tillë) dërgoi një sasi të vogël ushtarësh nëpër majat, me qëllim që këta të ecnin nga të dy anët paralelisht me atë, që shkonte nëpër tokë të sheshtë, duke prerë pyllin. Japodët dilnin nga pusitë që kishin zënë shpesh dhe u binin romakëve duke plagosur shumë; mirëpo edhe nga ata vriteshin më të shumtët duke u goditur prej ushtarëve romakë që kishin zënë majat. Më në fund ata që kishin mbetur në qytetin e quajtur Terpone, e lanë këtë dhe ikën nëpër pyje. Cezari e pushtoi këtë qytet po nuk e dogji, duke shpresuar se do të dorëzoheshin, sikundër me të vërtetë u dorëzuan. Pastaj u nis kundër një qyteti tjetër që quhej Metul. Ky ishte kryeqyteti i japodëve dhe gjendej në një mal shumë të
19 pyllëzuar, mbi dy kodra, të cilat i ndante një luginë e ngushtë. Ishin rreth tre mijë luftëtarë të rinj të armatosur shumë mirë, që zmbrapnin me lehtësi sulmet e romakëve, të cilët kishin rrethuar muret e qytetit dhe kishin bërë llogore, po këto i prishnin metulasit duke bërë sulme ditë e natë; edhe ushtarët i lodhnin së tepërmi duke u rënë nga muret me makina, të cilat i kishin që nga koha e luftës, që kishte bërë këtu Dekim Bruti me Antonin e Augustin. Po meqenëse edhe romakët i binin murit dhe e dëmtonin papushim, ngritën një mur tjetër përmbrenda, e lanë të vjetrin që ishte dëmtuar dhe u hodhën në murin e rindërtuar. Romakët e zunë murin e braktisur dhe e dogjën[1], pastaj kundër murit të ri grumbulluan forca dhe në dy pika zgjatën katër ura gjer tek muri. Në këtë e sipër Cezari dërgoi prapa qytetit disa ushtarë me qëllim që t'i përçajnë metulasit, kurse ushtarëve të tjerë u dha urdhër që të kalojnë murin me anë të urave; ai vetë hipi në një kullë të lartë dhe së këtejmi shikonte përleshjet e ushtrisë së tij me barbarët. Një pjesë e barbarëve përballonte ata që drejtoheshin kundër murit, kurse pjesa tjetër, duke zënë pusi, qëllonin me heshta
20 të gjata; dhe morën guxim shumë kur rrëzuan urën e parë dhe pas kësaj të dytën. Kur ra dhe ura e tretë romakët i kapi një tmerr aq i madh saqë asnjë nuk guxonte të hipte në urën e katërt, megjithëse Cezari, që i shikonte që nga kulla, i qortonte. Por meqenëse as nga qortimet nuk shtyheshin, Cezari mori një mburojë dhe erdhi me vrap pranë urës. Bashkë me të shkuan komandantët Agripa dhe Ieroni, dhe rojet personale

[1] Muri ka qenë ndërtuar me lëndë druri.

Luti e Vola, të cilët ishin vetëm katër dhe disa nga të besuarit e tij. Kur po e kalonte urën, ushtria nga turpi u sul dhe ajo e tëra. Po atëherë ura u rrëzua nga pesha e rëndë dhe ushtarët, që ishin mbi të u fundosën që të gjithë dhe një pjesë prej tyre vdiqën, ndërsa të tjerë u plagosën. Edhe Cezari vetë u plagos në këmbën e djathtë dhe në të dy krahët, megjithatë rendi dhe hipi në kullë, duke i mbajtur shenjat dalluese; këtë e bëri që të tregojë veten të shëndoshë dhe kështu të mos turbullohej ushtria, duke kujtuar se kish vdekur. Që të mos kujtonin dhe armiqtë se ai u thye dhe se do të dorëzohej, menjëherë dha urdhër që të ndërtohen të tjera ura. Kjo gjë u kalli tmerr metulasve, të cilët panë se po luftonin me njerëz, që s'munden dot. Të nesërmen
21 dërguan delegatë tek ai dhe i propozuan t'i dorëzojnë pesëdhjetë vetë si peng nga ata që do të zgjidhte vetë Cezari dhe premtuan të pranojnë një garnizon, të cilit do t'i dorëzonin kodrën më të lartë, ndërsa vetë të mbajnë kodrën tjetër. Garnizoni sapo hyri në qytet kërkoi nga banorët t'i dorëzojnë armët, mirëpo këta jo vetëm që u zemëruan me këtë sjellje të armikut, po në zemërim e sipër bënë edhe këtë: gratë e tyre dhe fëmijët i mblodhën dhe i mbyllën në ndërtesën e kuvendit; rreth kësaj vune roje, të cilat i urdhëruan t'i vënë zjarr ndërtesës, po qe se ata do të pësonin ndonjë të keqe. Pas këtyre masave, u lëshuan të dëshpëruar kundër romakëve. Po, meqenëse ata ishin poshtë dhe romakët më lart, u thyen keq dhe u vranë të gjithë; atëherë rojet e kuvendit, sipas urdhërit që kishin marrë, i vunë zjarr ndërtesës së kuvendit, kështu që shumë gra bashkë me fëmijët u dogjën, kurse një pjesë tjetër u hodhën bashkë me fëmijët të gjalla në zjarr. Bashkë me këta u dogj edhe qyteti, aq sa, ndonëse ishte një qytet shumë i madh, s'mbeti asnjë gjurmë e tij. Pas rënies dhe shkatërrimit të Metulit, japodët e tjerë të tmerruar iu dorëzuan Cezarit. Atëherë pra për herën e parë iu nënshtruan romakëve japodët, që ishin përtej Alpeve. Posenët, një fis i këtyre [japodëve], sapo u largua Cezari, bënë kryengritje. Por atëherë u dërgua kundër tyre Mark Elvi, i cili i ripushtoi dhe shkaktarët e kryengritjes i vrau, ndërsa të tjerët i shiti. Romakët kishin hyrë në tokën e segestasve dy herë më parë, po nuk kishin
22 marrë as peng, as ndonjë gjë tjetër. Për këtë arsye segestasit e kishin marrë përsipër dhe mburreshin. Cezari u nis kundër këtyre përmes tokës së paionëve, të cilët gjithashtu nuk u ishin nënshtruar ende romakëve. Toka e paionëve është plot me pyje dhe e gjatë që nga japodët gjer tek dardanët. Paionët në fjalë nuk banonin në qytete, por nëpër fusha e nëpër katunde sipas farefisit; këta nuk mblidheshin në kuvende të përbashkëta, as krerë kishin të gjithë. Ata që ishin në moshën ushtarake arrinin në njëqind mijë vetë, por as këta nuk mblidheshin tok nga shkaku i anarkisë. Kur u afrua Cezari, ata ikën nëpër pyje dhe vrisnin ushtarët që ishin shpërndarë. Cezari, gjersa kishte shpresë se do të ktheheshin, nuk ua prishi as arat, as katundet. Po, kur pa se ata nuk po afroheshin tetë ditë me radhë, i dogji dhe i shkretoi të gjitha gjersa kaloi në viset e segestasve, që ishin edhe këta paionë mbi lumin Sao. Këtu ndodhet një qytet i fortifikuar dhe i veçuar prej lumit prej një hendeku shumë të madh, dhe për këtë ky qytet i nevojitej shumë Cezarit, mbasi mendonte ta përdorte si qendër furnizimesh e ushqimesh për luftën kundër dakëve dhe bastarnëve, të cilët banojnë përtej Istrit. Ky quhej këtu Danub dhe më pas mori emrin Ister. Në Ister derdhet lumi Sao, ku ishin anijet e Cezarit, që i transportonin sendet ushqimore në Danub.

23 Për këto arsye i nevojitej Cezarit Segesta. Segestasit, kur morën vesh se ai po afrohej, dërguan delegatët për ta pyetur se çfarë kërkonte. Ai u përgjigj se kërkonte të sillte aty në qytet një garnizon dhe të merrte nga ata njëqind pengje, në mënyrë që ta përdorte pa frikë qytetin si qendër furnizimesh për luftën kundër dakëve. Përveç

këtyre kërkoi t'i sjellin sipas fuqisë së tyre edhe grurë.Paria e qytetit i pranoi këto propozime dhe ishte e mendimit t'ia jepte këto Cezarit; mirëpo populli u egërsua dhe sa për pengjet nuk shqetësohej se këta do të ishin nga bijtë e parisë, po kur pa garnizonin romak, që po afrohej nuk e duroi dot, po si i tërbuar u sul, i mbylli përsëri portat dhe zuri vend mbi muret. Cezari atëherë dha urdhër të ngrihen ura mbi lumin dhe të bëhen fortifikata rreth e rrotull. Kështu e mbylli qytetin dhe ngriti dy fortifikime të mëdha. Kundër këtyre shpesh herë u lëshuan segestasit, po meqë s'mundën të bëjnë gjë, zunë të hedhin që sipër flakse dhe zjarre shumë. Në kohën që po u vinte këtyre ndihma e dërguar nga paionët e tjerë, Cezari u doli përpara dhe disa
24 i vrau disa i detyroi të ikin; pas kësaj asnjë fis nga paionët nuk u dërgoi më ndihmë. Segestasit i qëndruan rrethimit, por në të tridhjetën ditë u thyen plotësisht dhe atëherë, për të parën herë filluan t'i luten Cezarit. Ky i prekur nga trimëria e tyre në njërën anë dhe nga lutjet në anën tjetër as i vrau, as shtëpitë ua prishi, po vetëm i detyroi të paguajnë të holla dhe të pranojnë garnizon, për të cilin ndau në qytet një vend të veçantë; ky garnizon përbëhej prej njëzet e pesë njësish. Cezari si bëri këto u kthye në Romë, me mendimin që të kthehej në Iliri në pranverën që vinte; po meqenëse u përhap fjala se segestasit i ranë garnizonit dhe e shkatërruan, u nis në dimër. Dhe ndërsa rezultati nuk qe ashtu siç u fol, shkaku ishte i vërtetë; garnizoni kaloi një rrezik të madh; sulmi i papritur që bënë segestasit bëri që të vriten shumë nga burrat e garnizonit, po të nesërmen ai kundërsulmoi dhe i theu segestasit[1]. Atëherë Cezari u nis kundër dalmatëve, që ishin një fis ilir fqinj me taulantët.

25 Dalmatët, që kur kishin shkatërruar të pesë njësitë e Gabinit dhe u kishin marrë flamujt, e kishin marrë përsipër dhe jo vetëm që nuk po i lëshonin armët dhjetë vjet me radhë, por edhe kur morën vesh se Cezari po marshonte kundër tyre u lidhën me njëritjetrin në aleancë. Ushtria e tyre përbëhej nga dymbëdhjetë mijë vetë, luftëtarë shumë të zotë; si komandant zgjodhën Versin. Ky pushtoi përsëri Promonën, qytetin e liburnëve dhe ndonëse ishte i fortë prej natyre, zuri ta fortifikojë edhe më shumë; me të vërtetë vendi këtu është malor dhe rreth e rrotull tij, nga të gjitha anët ka kodra të mprehta si dhëmbët e sharrës. Ushtrinë më të shumtë Versi e mbajti në qytet dhe në kodrat përreth vuri vetëm roje, në mënyrë që nga këto shiheshin prej së larti tërë lëvizjet e romakëve. Cezari nga një anë filloi haptazi t'i rrethojë me mure, nga ana tjetër dërgoi fshehurazi ushtarët më të guximshëm që të kërkojnë rrugë për t'u ngjitur në majën e kodrës më të lartë. Këta duke u fshehur brenda në pyll, u ranë rojeve që po flinin dhe i vranë; menjëherë pastaj natën i bënë shenjë Cezarit, i cili në njërën anë i ra qytetit me pjesën më të madhe të ushtrisë dhe në anën tjetër atyre që kishin zënë majën u dërgoi ndihma, njërën pas tjetrës, të cilat më në fund zbritën edhe në kodrat e tjera. U trembën dhe u turbulluan shumë barbarët, kur panë se po i qëllonin nga të gjitha anët; po më tepër u hyri frika atyre që ishin në kodra, mbasi ishte rrezik të mbeteshin pa ujë në rast se do të ziheshin rrugët, prandaj, pra, të gjithë bashkë ikën dhe u futën në Promonë. Cezari urdhëroi të mbyllen me mure si qyteti ashtu edhe të dy kodrat që ndodheshin akoma në duart e armiqve; perimetri i këtyr mureve
26 do të ishte dyzet stade. Po në këtë e sipër, kur mori vesh se dalmatasi Testimi i vinte në ndihmë Promonës me ushtri, i doli përpara i ra dhe e ndoqi ndonëse akoma s'kishte marrë fund rrethimi me anë të mureve – në sy të Testimit, i cili nga malet po

[1] Qysh nga paragrafi 16 deri në 25 Apiani përshkruan ngjarjet që kanë të bëjnë me fushatën e parë të Oktavian Augustit, në vitin 35 para e. sonë, kundër japodëve, panonëve dhe ilirëve të tjerë të veriut.

e shikonte rënien e qytetit. Se ata që ishin brenda në qytet dolën dhe u lëshuan kundër romakëve, me të cilët u përleshën me tërbim të madh; mirëpo u thyen prej ushtrisë së Cezarit, e cila duke i ndjekur hyri bashkë me ta në qytet dhe vrau brenda një të tretën e fuqisë së tyre, ndërsa pjesa tjetër iku dhe u mbyll në kështjellën, portat e së cilës i ruante një njësi romake. Mirëpo kjo njësi, e goditur befas prej barbarëve natën e katërt, u tremb aq shumë saqë nga frika iku dhe i la portat. Cezari vrapoi dhe ua preu hovin e sulmit armiqve, të cilët të nesërmen u dorëzuan vetë. Sa për njësinë, që i la portat, dënoi me vdekje një të dhjetën e saj, duke i marrë me short; përveç këtyre dënoi me vdekje dhe dy për çdo dhjetë komandantë. Për pjesën tjetër të kësaj njësie dha urdhër që të ushqehet atë verë jo me grurë po me elb.

27 Në këtë mënyrë, pra, u pushtua Promona. Testimi atëherë duke parë këto e shpërndau ushtrinë andej e këndej dhe pikërisht për këtë arsye romakët nuk mundën t'i ndjekin shumë larg, mbasi kishin frikë nga armiqtë e shpërndarë në shumë vise dhe përveç kësaj nuk i dinin edhe rrugët në ato vise; këtyre u duhet shtuar edhe fakti se as gjurmët e të ikurve s'i gjenin dot, sepse ato ishin të ngatërruara. Në këtë kohë pushtuan Sinodin, qytetin që ndodhej në krye të pyllit, ku dalmatët i kishin zënë pritë ushtrisë së Gabinit, në një grykë të thellë e të gjatë midis dy malesh; po në këtë vend edhe tani i vunë pritë Cezarit. Ky përveç që e dogji Sinodin, dërgoi edhe në të dy malet ushtri, në mënyrë që kjo nga sipër të mund ta ndihmonte në rast nevoje. Ai vetë shkoi përmes grykës duke prerë pyllin, duke pushtuar qytetet dhe duke djegur çdo gjë që gjente përpara. Në kohën kur rrethoi qytetin Setovia, barbarët i dërguan ndihmë, por kësaj ia preu rrugën Cezari dhe e ndaloi të hyjë në Setovia. Gjatë këtyre luftimeve u godit në gju me gurë dhe u desh ta mjekojë për shumë ditë me radhë. Pasi u shërua u kthye në Romë, që të ushtronte detyrat e konsullit bashkë me Volkat Tulin, duke lenë Statil Taurin që të vazhdojë luftën.

28 Kur doli hëna e re e vitit filloi të ushtrojë funksionet e konsullit, po në të njëjtën ditë ia dorëzoi pushtetin Autron Paitit dhe menjëherë u sul përsëri kundër dalmatëve, duke gëzuar akoma pushtetin e të treve; se dy vjet mbeteshin nga pesëvjeçari i dytë i këtij pushteti, të cilin bashkë me të parin [Autron Paitin] e morën për vete dhe populli e kishte aprovuar këtë vendim të tyre. Dalmatët atëherë të kapitur prej urisë, mbasi tregjet e jashtme ishin mbyllur për ta, dolën për ta pritur Cezarin, që po vinte dhe iu dorëzuan si lutës, duke i dhënë sipas kërkesës së tij shtatëqind fëmijë si peng dhe duke i kthyer flamujt romakë të Gabinit[1]; përveç kësaj, morën përsipër të paguanin edhe taksën që kishte mbetur pa u paguar që nga koha e Gaj Cezarit dhe paskëtaj qëndruan të bindur. Sa për flamujt, Cezari i vuri këta në portikun e quajtur "Oktavia". Pas pushtimit të dalmatëve edhe dervanët kur u afrua Cezari, i kërkuan ndjesë si lutës, duke i dorëzuar pengje dhe duke i premtuar t'ia paguanin taksat e prapambetura...[2] atyre që iu afrua Cezari, përveç traktateve që bënë i dorëzuan edhe pengje, atyre që s'u vajti afër për shkak të sëmundjes as pengje nuk dorëzuan, as traktate s'bënë. Po më vonë duket se edhe këta u nënshtruan.

Kështu pra, Cezari sundoi gjithë tokën ilire, si atë që ishte shkëputur nga romakët, ashtu edhe atë që s'ishte nënshtruar më parë. Prandaj senati i dha leje të bëjë "triumfin ilir", të cilin e bëri ai më vonë bashkë me atë të fitores kundër Antonit[3].

29 Në atë që romakët e quajnë Iliri, të tjerë janë: para paionëve, retët dhe

---

[1] Në vitin 33 para e. sonë.
[2] Mungesë në tekst.
[3] Triumfi u festua me 13 gusht të viti 29 para e. sonë.

norikët, pas paionëve deri në Pontin Euksin myzët. Pra jam i mendimit se Gaj Cezari, duke luftuar kundër keltëve, vuri nën sundimin e tij retët dhe norikët ose paionët ia dorëzoi Augustit; paionët gjenden ndërmjet të dyve dhe nuk gjeta të jetë bërë asgjë e veçantë tek retët dhe norikët; prandaj më duket se janë nënshtruar bashkë me fqinjët e tjerë. Myzët i mundi Mark Leukoli, i vëllai i Licin Leukolit, i cili luftoi me Mitridatin dhe si kaloi lumin[1] ku gjenden gjashtë qytete helene, fqinjë të myzëve: Istria, Kalati, Dionispoli, Odesos, Mesembria dhe Apollonia. Prej këtij qyteti të fundit ai pruri në Romë shtatoren e madhe të Apollonit, e cila u vendos në kodrën Palatino. Unë nuk gjeta që të jetë bërë ndonjë gjë më tepër tek myzët në kohën e republikës romake; ata nuk paguanin as taksa dhe as Augustit nuk i ishin nënshtruar. U nënshtruan prej Tiberit, i cili u bë perandor i romakëve pas Augustit. Për gjithë ato që janë bërë para pushtimit të Egjiptit dhe me aprovimin e popullit është shkruar, kurse për ato që janë bërë pas pushtimit të Egjiptit dhe që perandorët i kanë quajtur vepra të tyre, do të bëhet fjalë pas çështjeve të përgjithshme; atje do të them dhe për myzët më tepër. Tani, meqenëse romakët i konsiderojnë dhe myzët popullsi të Ilirisë[2] dhe kjo, vepra ime, është mbi Ilirinë, e që të ishte vepra e plotë e pashë të arsyeshme ta them më përpara se myzët i mundi Leukoli, kur ishte në krye të popullit dhe Tiberi i vuri nën sundimin e tij në kohën e pushtetit monarkik.

5. **Bella civilia**

(Lufta civile)

LIBRI II

38 ... Meqenëse gjithë kjo ndodhi papritur, atëherë Pompeu, shpejtoi prej Kapuas në Nukeri dhe nga Nukeria në Brendesi, me qëllim që prej këtej, nëpërmjet Jonit të hidhej në Epir dhe këtu të bënte përgatitjet për luftë. Ndërkaq njoftoi me të shpejtë gjithë provincat, u shkroi mbretërve, qyteteve, strategëve, dinastëve, që secili ta ndihmonte në luftë me sa kishte mundësi. Ushtrinë e tij Pompeu e kishte në Iberi dhe ajo ishte gati të nisej për aty ku do të ishte nevoja. Një pjesë të legjioneve, që kishte
39 me vete, ua dha konsujve që t'i çonin nga Brendesi për në Epir, dhe ata menjëherë kaluan detin dhe arritën të sigurt në Dyrrah. Disa e quajnë këtë qytet Epidamn për këtë keqkuptim: mbreti i barbarëve të këtij vendi, Epidamni, ndërtoi pranë detit një qytet, dhe e quajti sipas emrit të tij Epidamn. I biri i së bijës së tij, Dyrrahu, të cilin e konsiderojnë se rrjedh nga Poseidoni, ndërtoi pranë qytetit një liman dhe i dha emrin Dyrrah. Me Dyrrahun, në luftën që i bënë vëllezërit, u bashkua Herakliu kur po kthehej nga Eruthea, me kusht që të merrte një pjesë të tokës. Prandaj dyrrahasit e quanin Herakliun si themelues të kolonisë dhe pjesëtar në tokë. Ata nuk e mohonin Dyrrahun, por krenoheshin më shumë me prejardhjen prej Herakliut, si përëndi që është. Thuhet se në këtë betejë Herakliu vrau pa dashur Jonin, të birin e Dyrrahut, dhe se vetë Herakliu e hodhi trupin e të vrarit në det, me qëllim që Joni të bëhej eponim i këtij të fundit. Pas ca kohe këtë vend dhe qytetin e pushtuan brygët, që erdhën nga Frygia, pas këtyre taulantët, fis ilir, dhe pas taulantëve liburnët, tjetër fis ilir, të cilët i grabitnin ato anë me anijet e tyre të shpejta. Prej kësaj romakët i quajnë liburnide anijet e tyre të shpejta, të cilat i njohën për herë të parë nga liburnët. Ata që u dëbuan prej liburnëve nga Dyrrahu thirrën në ndihmë korkyrasit, të cilët ishin

---

[1] Ister.

[2] Në të vërtetë ata nuk janë ilirë.

sundues në det dhe i dëbuarn liburnët. Pas kësaj korkyrasit përzien me dyrrahasit kolonët e vet, prandaj limani konsiderohet si Helen, kurse emrin e tij korkyrasit e ndryshuan si ugurzi dhe e quajtën qytetin Epidamn, sipas emrit të qytetit të sipërm. Edhe Tukididi kështu e quan. Porse emri i parë fitoi dhe porti quhet tani si më parë Dyrrah.

54 ... Meqenëse stuhia e nxori në malet Keraune[1], ai /Cezari/ ktheu anijet për në Brendes për të marrë pjesën tjetër të ushtrisë, kurse vetë u nis natën për në qytetin Orik, nëpër një rrugë të ngushtë malore dhe për shkak të vendit të keq ushtria u nda në shumë njësi të vogla, kështu që mund të sulmohej lehtë po ta kishte diktuar njeri. Në mëngjes gjithë këto njësi u grumbulluan me vështirësi tek ai /Cezari/ dhe komandanti i garnizonit të Orikut, pasi ata që ishin me të në qytet e shpallën se nuk do t'i kundërshtonin konsulit romak që po vjen, i dorëzoi çelsat e qytetit Cezarit ndërsa ai vetë mbeti pranë tij i nderuar me ofiqe. Kurse Lukreti dhe Minuci, që ruanin në anën tjetër të Orikut me tetëmbëdhjetë anije lufte grurin e Pompeut, që ishte brenda në anije të mëdha transporti, i fundosën këto anije në mënyrë që ato të mos binin në duart e Cezarit dhe vetë ikën për në Dyrrah. Nga Oriku Cezari shpejtoi për në Apolloni. Apolloniatët e pranuan, kurse komandanti i garnizonit Staberi u
55 largua nga qyteti. Dhe Cezari, pasi mblodhi ushtrinë e tij, u kujtoi atyre se, në saje të veprimit të shpejtë, ata kapërcyen me fat edhe fortunën, edhe detin e zotëruan pa anije, edhe Orikun e Apollonin e morën pa luftë dhe tani kanë në dorë atë që i përkiste armikut dhe gjithë kjo u bë sikurse u tha ai, në një kohë kur Pompeu këtë nuk e dinte akoma. "Nëqoftëse, tha ai, ne do të kapim edhe Dyrrahun, këtë depo të Pompeut, atëherë do të bëhen tonat të gjitha ato që kanë grumbulluar ata gjatë verës". Pasi u tha këto ai i udhëhoqi ata nëpër një rrugë të gjatë për në Dyrrah pa pushuar as ditë as natë. Por Pompeu i paralajmëruar për këtë u nis gjithashtu me shpejtësi të madhe nga Maqedonia...

56 ... Pompeu arriti më parë se Cezari në Dyrrah dhe vendosi në afërsitë e tij lëmin e vet, pastaj dërgoi anijet dhe zuri menjëherë Orikun, ndërsa detin filloi ta ruante me roje më të sigurta. Kurse Cezari, duke vënë si kufi ndërmjet tij dhe Pompeut lumin Aps, ngriti lëmin e vet në këtë anë të këtij lumi. Ndërkaq njësitë e kalorësisë nga njëra dhe tjetra anë kalonin lumin dhe binin në përpjekje. Porse e gjithë ushtria nuk përleshej, sepse Pompeu ishte duke stërvitur të rekrutuarit rishtas, kurse Cezari ishte duke pritur ata që do të vinin nga Brendesi...

58 ... Nisi Postumin me urdhër për Gabinin që të transportonte ushtrinë me anë të detit. Nëqoftëse Gabini nuk do të dëgjonte, atëherë t'i besohej kjo Antonit, dhe nëqoftëse edhe ky nuk do të pranonte atëherë – Kalenit. Në rast se që të tre uk do të vendosnin, Cezari u shkroi letër vetë ushtarëve që kush të dëshironte prej tyre të ndiqte Postumin me anije dhe që ata, që do të niseshin të dilnin aty ku t'i nxirrte era. Anijet mos t'u dhimseshin se Cezari ka nevojë për njerëz e jo për to...

59 ... Kur Postumi çau detin e arriti në Brendes, Gabini, duke mos iu bindur urdhërit të Cezarit, mori ata që deshën dhe kaloi përmes Ilirisë, pa bërë pushim në asnjë vend. Këta u asgjësuan pothuajse të gjithë prej ilirëve, dhe Cezari qe i detyruar ta duronte këtë, sepse ishte tepër i zënë. Kurse Antoni, pasi hipi të tjerët në anije, arriti pranë Apollonisë, duke shfrytëzuar rrymën e erës. Por kur nga mesdita era u dobësua, njëzet anije të Pompeut, që kishin dalë për të kontrolluar detin, e diktuan armikun dhe filluan ta ndjekin. Dhe meqenëse në det u ndal era fare ata i zuri një frikë e madhe se mos anijet luftarake i shponin me kryedeshtë e tyre prej bakri dhe i

[1] Në vitin 48 para e. sonë.

mbytnin.Bile anijet e Pompeut u bënë gati dhe filluan t'i goditnin me gurë e shigjeta, por papritur filloi një erë më e madhe se e para dhe ata pasi ngritën menjëherë velat e mëdha në drejtim të saj lundruan pa frikë. Anijet armike mbetën, duke pësuar dëme të rënda nga furtuna, era dhe valët e mëdha dhe mezi u futën në një vend shkëmbor pa gji, duke kapur nga anijet e Cezarit vetëm dy që ngecën në vend të cekët. Antoni me të tjerët doli në vendin e quajtur Nymfe.

... Ai /Cezari/ vetë, meqenëse dikush prej Dyrrahut po përgatiste dorëzimin me tradhëti të qytetit, u nis me pak njerëz dhe, sipas marrëveshjes, erdhi natën deri afër portave dhe tempullit të Artemidës...

Pasi Cezari e shkrehu lëmin e vet, Pompeu mblodhi këshillin. Në këtë mbledhje Afrani shprehu mendimin, që forcat detare, të cilat janë shumë më të mëdha se të Cezarit duhen dërguar kundër tij /Cezarit/ dhe pasi të zotërojnë detin ta shqetësojnë atë që është i hutuar, kurse forcat tokësore t'i udhëheqë vetë Pompeu për në Itali, ku ai gëzon simpatinë dhe nuk ka armiq, në mënyrë që pasi të zotërojë Italinë, Galatinë dhe Iberinë ta sulmojë përsëri Cezarin nga toka mëmë që qëndron në krye të tjerave. Por këto këshilla, të cilat do të ishin për të më të mirat, Pompeu i përbuzi dhe dëgjoi ata që i thanë se ushtria e Cezarit, e shtrënguar nga uria, do të kalojë menjëherë në anën e tij dhe që në përgjithësi i mbetet pak për të bërë pas fitores së korrur në Dyrrah... Prandaj ai e vazhdoi marshimin dhe e ngriti lëmin në Farsalë, kundrejt Cezarit[1].

LIBRI V

Atëherë Cezari[2] dhe Antoni e ndanë midis tyre gjithë shtetin romak, duke caktuar si kufi qytetin e Ilirisë, Skodrën[3], e cila duket se ndodhej pikërisht në mes të gjirit Jon. Antoni do të merrte gjithë popujt e ishujt që ndodheshin nga lindja deri te lumi Eufrat, kurse Cezari ato nga ana e perëndimit deri te oqeani...

Pas kësaj Cezari u nis për në Keltikë, ku vazhdonin trazirat, kurse Antoni kundër parthëve. Kur senati me anë të votimit aprovoi gjithçka që ai kishte bërë dhe kishte ndërmend të ndërmerrte, Antoni dërgoi kudo legatë dhe rregulloi çdo gjë sipas qëllimeve të tij... Kështu në vende të ndryshme vuri mbretërit që i pëlqenin, me kusht që ata t'i paguanin tributin... Ushtrinë, që do të dimëronte bashkë me të, me qëllim që ta pasuronte dhe njëkohësisht ta stërviste, ai e dërgoi kundër parthinëve[4], fis ilir pranë Epidamnit, që ishte treguar përkrahës i Brutit, të tjerët kundër dardanëve, gjithashtu fis ilir, që invadonte vazhdimisht Maqedoninë, të tretët i urdhëroi të qëndronin në Epir me qëllim që Antoni, i cili kishte ndërmend të dimëronte në Athinë, t'i kishte rreth vetes.

Pompeu[5] i dha fund jetës, Antoni filloi një fushatë të re kundër Armenisë, Cezari kundër ilirëve, që grabitnin Italinë. Disa prej tyre nuk iu nënshtruan kurrë romakëve, disa të tjerë u shkëputën gjatë luftës civile. Për shkak se historinë ilire nuk e njoh mirë dhe nga madhësia ajo nuk mund të përbëjë objekt të një studimi të veçantë dhe meqenëse nuk më takoi të flas për të në një vend tjetër, m'u duk me vend të shkruaj për të së bashku me historinë e Maqedonisë, fqinjë të Ilirisë, duke filluar që nga koha kur ajo u pushtua nga romakët.

---

[1] Në betejën që u zhvillua këtu Cezari korri fitoren vendimtare, duke e shpartalluar krejtësisht Pompeun.
[2] Oktavian Augusti.
[3] Në vitin 42 para e. sonë.
[4] Në vitin 36 para e. sonë.
[5] Sekst Pompeu, i biri i Pompeut të Madh.

PTOLEMEU

Gjeografi Klaud Ptolemeu lindi në qytetin Ptolemais të Egjiptit. Jetoi dhe punoi në Aleksandri në shek. II të e. sonë. U mor me astronomi, matematikë e gjeografi për të cilat na ka lënë edhe një tok vepra. Merita e tij kryesore qëndron tek përmbledhja dhe renditja sistematike e vrojtimeve dhe zbulimeve të autorëve të mëparshëm, kryesisht të Hiparhut, si dhe paraqitja e tyre në një vepër, që njihet zakonisht me titullin latin "Syntaxis mathematica" ose "Constructio mathematica". Kjo vepër e cila në fillim mbante emrin greqisht "Megale syntaksis tes astronomies" (Sistemi i madh i astronomisë) u përkthye në vitin 827 në gjuhën arabe me titull "Qitab al magisti", (nga arabishtja qitab – libër, dhe greqishtja magiste – shumë i madh); latinisht për herë të parë u përkthye në shek. XII.

Një vepër tjetër që bëri bujë të madhe ka qenë "Tetrabiblos" (Katër librat), që paraqet një dokumentim shkencor të astrologjisë.

Një vlerë edhe më të madhe ka vepra e tij "Geographia" (Gjeografia), që përbëhet kryesisht nga tabela, ku shënohen dhe përcaktohen pozitat e vendbanimeve të botës antike simbas gradave të gjatësisë e të gjerësisë gjeografike. Duhet thënë se numri i atyre vendeve me pozicion të llogaritur është shumë i vogël. Gjeografia e Ptolemeut ka qenë ilustruar edhe me harta.

Në veprën e Ptolemeut citohen edhe shumë qytete dhe vendbanime të Ilirisë, Maqedonisë dhe të Epirit. Ndër to ka edhe emra të tillë që i hasim për herë të parë tek Ptolemeu, siç është p.sh. emri i fisit ilir Albanoi dhe i qytetit Albanopolis. Pozicioni gjeografik që jepet për to na e lehtëson të përcaktojmë më afërsisht se ku duhen lokalizuar këto vendbanime apo qytete.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Cuniz O., Die Geographie des Ptolemaeus,* Galiae Germania, Raetia Noricum, Panoniae, Illyricum, Italia; Berlin 1923.

2) *C. Muller, Claudi Ptolemaet, Geographia* vol. I. Didot Parisiis 1883.

PTOLEMAEI

GEOGRAPHIA

(Gjeografia)

LIBRI II

14 Vendi që zë Panonia e Sipërme

1 Panonia e Sipërme kufizohet nga mali Ketion dhe nga një pjesë e Karugas, kurse nga jugu prej Istrisë dhe një pjese të Ilirisë në një vijë paralele që kalon prej fundit perëndimor të përmendur, përmes malit Albanon deri tek malet Biblia dhe kufirit të Panonisë së Poshtme, i cili është 41°50' – 45°20'.
Kurse nga veriu me pjesën e përmendur të Norikut si dhe pjesën e Danubit, prej malit Ketion deri në kthesën e lumit Narabona, shtrirja e së cilës është 41° – 47°40'. Nga lindja me Panoninë e Poshtme në vijën sipas kufive të përmendura.

2 Në viset veriore të kësaj krahine nga perëndimi banojnë azalojtë (azaloi), ndërsa nga lindja kutnët (kutnoi). Në viset jugore banojnë latovikët (latovikoi) që janë nën Norikun, varkainët (varkainoi) zënë anën lindor; në mes nga perëndimi banojnë bojët (boioi) dhe nën ta kolanianët (kolanianoi), kurse nga lindja jasët (jasioi) dhe nën ta oseriatët (oseriates).

3 Qytete nën lumin Danub (Danubios) janë:

Valiobona	37° 45'	46° 50'
Legioni X germanik		
Karnus	39°	47°
Flekson	40°	47° 15'
Legioni XIV germanik		
Kertobalos	40° 30'	47° 30'
Brigaiton	41°	46° 40'
Legioni I ndihmës		

4 Nga lumi janë këto qytete:

Sala	38° 30'	46° 15'
Potobion	37° 40'	45° 30'
Sabaria	38° 50'	46° 40'
Rispia	38° 40'	46° 30'
Abiundria	38° 20'	45° 50'
Bononia	38° 40'	45° 40'
Andautonion	38° 10'	45° 30'
Noviodunon	37° 50'	45° 20'
Skarbontia	39° 30'	47°
Mursela	39° 15'	46° 10'
Lentulon	39° 10'	45° 45'
Karrodunon	39° 40'	46°
Siskia	39°	45°

Olimakon	39° 50'	45° 20'
Valina	40° 30'	46° 45'
Bolention	40° 30'	46°
Siroga	40° 10'	46°
Sisopa	40°	45° 15'
Visontion	40° 45'	46° 10'
Praitorion	40° 45'	46° 15'
5 Magniana	41°	46°
Ndërmjet Italisë, nën Norikun, prapë qyteti i Panonisë		
Emona	36°	45° 20'

15 Vendi që zë Panonia e Poshtme

1 Panonia e Poshtme kufizohet nga perëndimi me Panoninë e Sipërme që nga kthesa e lumit Narabona, sipas kufijve të përmendur; nga jugu me pjesën e Ilirisë që prej kufirit të përmendur dhe deri tek kthesa e Danubit ku derdhet lumi Savo, shtrirja e së cilës është 45° 10' – 44° 30'.

Kurse nga veriu dhe nga lindja kufizohet me pjesën e lumit Danub që nga derdhja e lumit Narabona deri tek derdhja e lumit Savo që përfshin një pozicion të tillë. Pas lumit Narabona

Kthesa në Kurta është 42° – 47° dhe pjesa më veriore e lumit Danub.

Pjesa ku bën kthesë lumi i cili zgjatet nga perëndimi, duke kaluar përmes dy Panonive dhe që në Karrodunon, afër malit Ketion, ndahet në pjesën veriore që quhet Savaria dhe në atë jugore – Daros, është 44° 20' – 45° 40'.

Kthesa e lumit Danub me Kornakon është 44° 20' – 45° 40'.

Kthesa në Akuminkon është 45° – 45° 20'.

Kthesa në Riton është 45° 30' – 45°.

Në kthesën e lumit Savo i cili edhe ai zgjatet përmes dy Panonive dhe i afrohet malit Ketion më përpara, duke bërë kthesë nga veriu, pastaj nga perëndimi janë 45° 10' – 44° 30'.

2 Këtë krahinë e zotërojnë në viset perëndimore amantinët (amantinoi) veriorë, nën këta herkuniatët (herkuniates), pastaj andizetët (andizetes) dhe breukët (breukoi), kurse në viset lindore pjesën veriore e kanë araviskët (araviskoi) ndërsa
3 atë jugore skordiskët (skordiskoi).

Në lumin Danub janë qytetet:

Kurta	42°	47°
Solua	42° 30'	47° 30'
Karpis	42° 30'	47° 50'
Akuinkon	42°	47° 30'
Salinon	43° 30'	47°
Lussonion	43° 45'	46° 45'
Lugionon	44°	46° 30'
Teutoburgion	44° 15'	45° 30'
Kornakon	44° 20	45° 15'
Akuminkon	45°	45° 20'
Rittion	45° 30'	45°
Taurunion	45°	44° 30'
4 Që nga lumi janë këto qytete:		
Berbis	42°	46°
Serbition	41° 20'	46° 30'
Jubalon	42° 20'	46°

Kertisa	42° 20'	45°
Mursela	43°	46°
Kivalis	43°	45° 30'
Marsonia	43°	45°
Vakontion	43° 30'	46° 20'
Mursia kolonia	43° 30'	45° 45'
Saldis	44°	44° 50'
Bassiana	43° 30'	44° 50'
Parsion	44° 30'	44° 45'
Sirmion	44° 50'	45°

1 **16 Vendi që zë Iliria**

Iliria (Illyris) kufizohet nga veriu me të dy Panonitë sipas kufijve që parashtruam, nga perëndimi me Istrinë sipas një vije, fundi i së cilës nga ana e Panonisë së Sipërme përfundon në gradat 36° 30' – 45° 10', kurse fundi i saj mbi gjirin Adriatik (Adrias) 36° 30' – 44° 50', nga lindja me Myzinë e Sipërme sipas vijës prej vendit ku lumi Savo (Savos) ndërron drejtimin e tij, gjer në fundin e saj tek mali Skard (Skardos) gradat e së cilit janë 47° – 41° 40'; nga jugu me një pjesë të Maqedonisë sipas vijës që arrin prej pikëmbarimit të lartpërmendur gjer në Adriatik, gradat e së cilës janë 45° – 41° dhe me bregun këtej Adriatikut gjer në pikëmbarimin e larpërmendur pranë Istrisë. Rrethi i këtij bregu është kështu; pas Istrisë së Italisë vjen bregdeti i Liburnisë së Ilirisë.

2 Bregdeti i Liburnisë së Ilirisë

Alvona	36° 50'	44° 50'
Flavona	37°	44° 50'
Tarsatika	37° 40'	44° 50'
Gryka e lumit Oineus	38°	44° 45'
Volkera	38° 30'	44° 50'
Senia	39°	44° 50'
Lopsika	39° 15'	44° 50'
Gryka e lumit Tedavios	39° 20'	44° 30'
Ortopla	40°	44° 30'
Vetia	44° 20'	44° 30'
Argyrunton	40° 45'	44° 10'
Korinion	41° 10'	44°
Ainona	41° 30'	44°
Jadera kolonia	42°	43° 45'
Gryka e lumit Titos	42° 20'	43° 40'
Skardona	42° 40'	43° 30'

3 Bregdeti i Dalmatisë

Sikun	43°	43° 20'
Salonai kolonia	43° 30'	43° 10'
Epetion	43° 40'	43° 20'
Petuntion	44°	42° 45'
Onaion	44°	42° 30'
Gryka e lumit Naron	44° 10'	42° 20'
Epidauros	44° 40'	42° 20'
Risinon	44° 40'	42° 15'
Akruion	44° 45'	42° 0'

Gjiri Rizon	45°	42° 0'
Bulua	45°	41° 45'
Ulkinion	45°	41° 30'
Gryka e lumit Drilon	45°	41° 20'
Lissos	45°	41° 10'

4 Lumi Dril rrjedh edhe nga mali Skard edhe nga një mal tjetër që ndodhet pranë mezit të Myzisë së Sipërme, shtrirja e të cilit është 45° 40' – 42° 40'.

Po prej atij zbret edhe një lum tjetër me emrin Drin (Drinos) që derdhet në lumin Sao (Saos) në perëndim të qytetit Taurun (Taurunon).

5 Zotërojnë krahinën <Liburnia> në Istri japydrët (japydres) mbi këtë /Liburninë/ maizajt (maizaioi) perëndimorë, pastaj derriopët (derriopes) e derrët (derrioi) dhe mbi derriopët dindarët (dindaroi), mbi këta ditionët (ditiones), ndërsa mbi derrët keraunët (keraunioi); kurse brenda në Dalmati daursët (daursioi), nën këta melkomenët – (melkomenioi) dhe vardejt (vardeoi), nën këta narensët (narensioi) dhe sardiatët (sardiatoi) dhe akoma nën këta sikulotët (sikulotai) dhe dukleatët (dukleatai) dhe pirustët (pirustai) e skyrtonë (skyrtones) nga ana e Maqedonisë.

6 Qytete të brendshme të Liburnisë janë:

Teliason	39° 00'	44° 50'
Arukkia	39° 30'	44° 45'
Ardotion	40° 00'	44° 50'
Stulpi	39° 30'	44° 40'
Korkum	40° 30'	44° 30'
Ausankalei	41° 30'	44° 45'
Varvaria	41° 10'	44° 30'
Salvia	41° 20'	44° 20'
Adra	42° 30'	44° 40'
Arauzona	42° 10'	44° 40'
Assesia	42° 15'	44° 20'
Bumon	42° 45'	44° 20'
Sidronia	43° 30'	44° 30'
Blanona	42° 10'	44° 10'
Voporu	43° 00'	44° 00'
Nedinon	44° 30'	44° 15'

7 Qytete të brendshme të Dalmatisë:

Andekrion	43° 30'	43° 30'
Aleta	44° 00'	44° 10'
Herona	44° 20'	44° 45'
Delminion	44° 45'	43° 50'
Aikuon kolonia	44° 40'	43° 20'
Saloniana	45° 00'	43° 30'
Narbona kolonia	44° 20'	42° 45'
Enderon	45° 30'	42° 50'
Kinna	45° 40'	42° 30'
Doklea	45° 20'	42° 15'
Rizana	45° 15'	42° 00'
Skodra	45° 30'	41° 30'
Thermidava	46° 00'	41° 45'
Siparunton	46° 30'	42° 10'
Apikaria	45° 30'	41° 15'
Oiminakion	46°	41° 30'

8	Pranë liburnëve gjenden ishujt: Apsor (Asporos), ku ka dy qytete:		
	Krepsa	36° 40'	44° 30'
	Apsoros	36° 50'	44° 30'
	dhe Kurikta, në të cilin janë dy qytete:		
	Fulfinion	38° 10'	44° 20'
	dhe Kurikon	38° 50'	44° 15'
	dhe ishulli Skardona në të cilin janë dy qytete:		
	Arba	40° 40'	43° 40'
	dhe Kollenton	41° 20'	43° 30'
9	Afër Dalmatisë gjenden ishujt:		
	Issa dhe qyteti	42° 20'	43° 10'
	Tragurion dhe qyteti	43° 00'	42° 45'
	Faria dhe qyteti	43° 00'	42° 20'
	Korkura Melaina	44° 00'	41° 45'
	Ishulli Melitine	44° 10'	41° 20'

LIBRI III

12 Vendi që zë Maqedonia

Maqedonia kufizohet nga veriu me kufitë e përmendur të Dalmatisë, Myzinë e Sipërme dhe Thrakinë, kurse nga perëndimi me detin Jon, që prej Dyrrahut ose
1 Epidamnit dhe deri tek lumi Kelydin, sambas përshkrimit që ndjek.

2	Në tokën e taulantëve (taulantioi)		
	Dyrrahion	45°	40° 55'
	Gryka e lumit Panyasos	45° 5'	40° 40'
	Gryka e lumit Apsos	45° 5'	40° 30'
	Apollonia	45° 5'	40° 10'
	Gryka e lumit Aoos	45° 50'	40°
	Aulon, qytet dhe skele	44° 45'	39° 55'
3	Në krahinën e climiotëve (climiotai)		
	Bullis	45°	39° 35'
4	Në Orestidë:		
	Amantia	44° 55'	39° 30'
	Gryka e lumit Kelydnos	45°	30° 20'
17	Qytetet e mbrendëshme në Maqedoni janë:		
	Në tokën e taulantëve:		
	Arnissa	45° 20'	40° 40'
18	Në tokën e climiotëve:		
	Elimia	45° 40'	30° 40'
19	Në Orestidë:		
	Amantia	46°	39° 20'
20	Në tokën e albanëve (albanoi):		
	Albanopolis	46°	41° 5'
23	Në tokën e eordejve (eordaioi):		
	Skampis	45° 45'	40° 20'
	Dibolis	45° 45'	40° 10'
	Daulia	45° 30'	40°
25	Në Paioni:		
	Doberos	46° 40'	40° 45'
	Aloros	47° 15'	41° 10'
29	Në tokën e dasaretëve (dasaretioi):		
	Evia	46° 5'	40° 15'
	Lyhnidos	47° 40'	40° 20'

30	Në Lynkesti		
	Heraklea	47° 40'	40° 40'
38	Në tokën e parauejve (parauaioi):		
	Eriboia	46° 40'	30° 45'
44	Ishujt të cilët gjenden në Maqedoni janë këta:		
	Në detin Jon		
	ishulli Sason		
		44° 10'	30° 30'

13 Vendi që zë Epiri

1 Epiri në pjesën më veriore ka kufi atë pjesë të Maqedonisë që vjen tutje vijës që përmendëm më parë.

Nga lindja kufizohet pastaj me anë të vijës që kalon pranë Ahesë gjer te gryka e lumit Ahelo, gradat e së cilës janë 48° 25' – 37° 30'.

2 Pjesa perëndimore e tij /Epirit/ mbaron me malet Akrokeraune të bregdetit Jon; përshkrimi i tij është ky:

Në Kaoni (kaonia):		
Orikon	45°	39° 15'
Maja e maleve Akrokeraune (Akrokeraunion)	44° 25'	39° 10'
Limani Panormos	45°	38° 40'
Limani Onhesmos	45° 20'	38° 35'
Limani Kassiope	45° 30'	38° 25'

Pastaj pjesa jugore kufizohet me detin Adriatik, gjer tek lumi Ahelo, sipas këtij përshkrimi bregdetar:

3 Ndër thesprotët (thesprotoi):		
Kepi Poseidion	45° 35'	38° 10'
Gjiri Buthrotos	45° 45'	38° 20'
Limani Pelodes	46° 10'	38° 20'
Kepet Thyamis dhe Almines	46° 30'	38°
Gryka e lumit Thyamis	46° 30'	38° 5'
Limani Sybota	46° 45'	38° 0'
Toryne	46° 56'	38° 0'
Gryka e lumit Aheron	47° 10'	38° 0'
Limani Elaia	47° 15'	37° 55'
Nikopolis në gjirin e Ambrakisë	47° 35'	37° 55'
7 Qytetet brenda në tokë të Epirit janë këto:		
Antigonea	45° 15'	39° 10'
Hekatonpedon	45° 40'	39° 0'
Omfalion	45° 40'	38° 40'
Helaon	45° 40'	38° 30'
8 Të kasapëve (kassopes) mbi të cilët janë dolopët (dolopes):		
Kassiope	47°	38° 45'
9 Të amfilohëve (amfilohoi), ndër të cilët atamanët (athamanes) janë më lindorët:		
Argos i Amfilohisë	48° 20'	38° 30'
Akarananon	48° 15'	37° 45'
Astahon	47° 15'	38° 15'

DION KASI

Dion Kasi Koceiani, historiani më i madh grek i epokës perandorake, lindi në Nike të Bitynisë rreth vitit 155 të e. sonë dhe vdiq në 235 e. sonë. Mori pjesë aktive në jetën politike dhe administrative të asaj kohe. Dy herë u zgjodh konsull. Si i tillë ai drejtoi dhe provincat e Afrikës, Dalmatisë dhe Panonisë. Dion Kasi shkroi një vepër të madhe historike të titulluar "Historia romake" në 80 libra prej të cilëve kanë arritur tek ne të plotë librat 36-60. Nga librat e tjerë kemi trashëguar vetëm ekstrakte të ruajtura tek autorë të vonë si Zonara, etj. Në këtë vepër përshkruhen ngjarjet historike që nga arritja e Eneut në Itali dhe deri në vitin 229 të e. sonë. Dion Kasi interesohet edhe për organizimin politik e administrativ të cilin historianët romakë nuk e kanë përfillur edhe aq, duke dhënë kështu një sërë lajmesh interesante. Vepra e Dion Kasit dallohet për pasuri faktesh dhe për përshkrimin e gjerë të tyre. Ajo formon një burim të rëndësishëm për njohjen e historisë së Romës, veçanërisht për periudhën e fundit të republikës dhe atë të shekujve të parë të e. sonë. Për historinë e Ilirisë vepra e Dion Kasit gjithashtu ka rëndësi të madhe sepse në të ne ndeshim shumë të dhëna mbi fushatën e Pirros në Itali, mbi luftërat iliro-romake, mbi qëndresën e ilirëve kundër pushtimit romak, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Dionis Cassii Cocceiani Historia Romana editionem primam curavit Ludovicus Dindorf, recognovit Ioannes Melber. Vol. I-III. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1890-1928.

DIONIS CASSII COCCEIANI

HISTORIA ROMANA

(Historia romake)

Fragmenta

1 40 Pirrua, mbreti i të quajturit Epir, mbretëroi edhe në pjesën më të madhe të tokave helene, këtë gjë e bënte herë me mirëbërësi, herë me anë të frikës. Në atë kohë atij i shërbenin etolët që ishin të fuqishëm, Filipi maqedonas[1] dhe dinastët e Ilirisë. Ai dallohej shumë nga të tjerët, nga natyra e tij e shkëlqyer, nga arsimi i lartë, nga përvoja për çështjet shtetërore, kështu që ai mbivlerësonte forcat e tij kundrejt aleatëve, megjithëse edhe ato ishin shumë të mëdha.

3 Kinea thoshte se shumica e qyteteve u shkatërruan nga arma e mbretit Pirro, kurse Plutarku thotë se ishte i fortë në të folur dhe i vetmi që mund të krahasohej për këtë me Demostenin.

4 Pirrua dërgoi në Dodonë dhe mori përgjigjen për ekspeditën; orakulli i tha se nëqoftëse do të kalonte në Itali do t'i mundte romakët dhe, duke e lidhur këtë me vendimin (ndonjë ka dëshirë të madhe të gënjejë), nuk priti as pranverën.

11 Romakët, kur morën vesh se Pirrua arriti, u frikësuan nga ai, mbasi ishte luftëtar i zoti dhe mësuan se sillte me vete një ushtri të madhe, të pamposhtur...

17 Kjo fitore e bëri Pirron të shkëlqyer dhe i dha emër të madh, kështu që ata të cilët qëndronin midis tij e romakëve u bashkuan me të, ndërsa të gjithë aleatët erdhën tek ai. Në këtë rast ai as nuk shfaqi haptas zemërimin e tij kundrejt tyre as nuk e fshehu krejtësisht dyshimin e tij. Por, mbasi u hoqi atyre vërrejtjen pse ishin ndarë (në përgjithësi i priti mirë duke i afruar shumë), i trembi me qëllim që të mos kishte një përçarje, nga ana tjetër, e bëri këtë për të mos u dhënë ndonjë shenjë që ata të kujtonin me naivitet se ai nuk ishte në dijeni mbi atë që ata kishin bërë ose që të mos u linte dyshimin se ai ka një zemërim të fshehur, mospërfillje apo urrejtje me qëllim të keq dhe të mos ndodhte ndonjë gjë e papritur. Të gjitha këto ai i bisedoi me ta në mënyrë të qetë dhe u dha atyre diçka nga plaçka.

19 Pirrua u mundua në fillim t'i bindte robërit romakë, që ishin të shumtë, të luftonin bashkë me të kundër Romës. Kur ata nuk pranuan, ai tregoi kujdes të madh për ta dhe as lidhi njeri prej tyre, as u bëri ndonjë të keqe tjetër, por i ktheu falas dhe në këtë mënyrë mori pa luftë Romën.

20 Romakët u habitën nga elefantët, mbasi nuk kishin parë asnjëherë bisha të tilla, por duke ditur se bishat prej natyre janë të vdekshme dhe se ato në asnjë mënyrë nuk janë më të përsosura se njeriu, aq më tepër edhe nga forca nuk u habitën më dhe morën guxim.

21 Ushtarët e Pirros, si ata që kishte sjellë nga vendi i tij ashtu edhe aleatët, u dhanë tmerrësisht pas plaçkitjes, mbasi ata nuk paraqisnin ndonjë vështirësi e rrezik.

---

[1] Është fjala për Filipin e IV, të birin e Kasandrit.

22 Epirotët e shkelën miqësinë, për shkak se ata ishin zemëruar shumë, mbasi, megjithëse ekspeditën e kishin ndërmarrë me shpresa të mëdha, asgjë nuk kishin përfituar nga gjendja e krijuar, ndonëse në këtë kohë shumë gjëra ndodhën te romakët; kurse ata që banonin në Itali dhe që ishin me ta u shkëputën prej tij, mbasi panë se ai po pushtonte njëlloj si vendet e armiqve, ashtu edhe të aleatëve. Ata
25 shikonin më tepër veprat e tij se sa premtimet. Pirrua, si mori vesh se për çështjen e robërve vinin delegatë të tjerë bashkë me Fabricin, dërgoi një roje për ta në kufi, me qëllim që të mos u ndodhte ndonjë gjë e papritur prej tarantasve dhe mbas kësaj çoi e i priti dhe i futi në qytet, ku i gostiti në mënyrë të shkëlqyer, dke iu bërë të gjitha rregullat e tjera të pritjes. Ai shpresonte se, meqenëse ata ishin të mundur, do të arrinte në marrëveshje.
28 Dhe Pirrua, duke menduar kështu, u tha delegatëve: "O romakë, as në të kaluarën unë nuk luftova kundër jush me dëshirë, as edhe tani dëshiroj të luftoj; do të bëj gjithshka që të jem mik i juaj, për këtë do të liroj të gjithë robërit pa shpërblim dhe do të bëj marrëveshje për paqen"...
29 Pirrua kërkoi edhe të tjera dhe për këtë bisedoi edhe me Fabricin. "Unë o Fabric akoma dhe tani nuk kam nevojë që të luftoj kundër jush, por duke u përgjegjur thirrjes së tarantasve u binda dhe erdha këtu, megjithëse pastaj m'u ndryshua mendja. Sidoqoftë unë ju munda në betejë. Me kënaqësi do të bëhesha mik i të gjithë romakëve, veçanërisht i yti, sepse unë po e shoh se je burrë i mirë <dhe i logjikshëm>. Dua që të përfundojmë bashkë paqen dhe të kthehem shpejt në shtëpi /në Epir/. Meqenëse do të bëj një ekspeditë në Heladë, kam nevojë të të kem si këshilltar ushtarak".

1 **42** Dhe duke bërë këto, romakët megjithëse përherë fitonin, asnjëherë nuk u rritej mendja, dhe senatorin Kuint Fabin ia dorëzuan apolloniatëve të gjiut të Jonit, koloni e korinthasve, meqenëse ai shau disa delegatë të tyre. Ata nuk i bënë asgjë të keqe, por e dërguan në shtëpi.

1 **47** Ishulli Isa iu dorëzua vullnetarisht romakëve. Këtë e bënë, së pari, që të provonin ata, të cilët i kujtonin se ishin më të dashur dhe më besnik se të tjerët; prandaj menduan se do të ishin më mirë në një gjendje, që nuk e njihnin, se sa në gjendjen e tanishme, se nga njëra anë do të shpëtonin nga vuajtjet, dhe nga ana tjetër shpresonin
2 se kjo do të ishte më mirë për ta. Romakët deshën që nga njera anë isasve, të cilët kishin kaluar në anën e tyre, t'ua shpërblenin në një farë mënyre këtë të mirë shpejt e me gatishmëri, me qëllim që të dukeshin se i ndihmonin ata, që ishin treguar të gatshëm ndaj tyre, nga ana tjetër deshën të mbroheshin nga ardianët, sepse këta i keqpërdornin të gjithë ata, që lundronin duke u nisur nga Brendesi. Prandaj dërguan njerëz te Agroni, për të kërkuar që ardianët të hiqnin dorë dhe e akuzuan atë vetë se,
3 megjithëse s'kishte pësuar ndonjë të keqe më parë nga ana e tyre, po u binte më qafë. Po delegatët nuk e gjetën të gjallë se ai kishte vdekur duke lënë një djalë, të quajturin Pin. E shoqja, Teuta, njerka e Pinit, sundonte mbi ardianët... Nga zemërimi ajo nuk iu përgjigj atyre në mënyrë të matur, po përkundrazi e shtyrë nga krenaria që gruaja e ka prej natyre dhe nga fuqia që kishte atëherë në dorë, disa nga delegatët i lidhi e disa të tjerë i vrau, për të vetmen arsye se këta kishin folur hapur. Dhe atëherë, aty për aty, iu rrit mendja, duke pandehur se vepra e saj kriminale dhe e pashpirt i dha
4 një farë fuqije, por pa kaluar shumë kohë e nxori në shesh dobësinë e saj prej gruaje mendje shkurtër, që zemërohet shpejt, po edhe që kapet shpejt prej frikës. Meqenëse shpejt mori vesh që romakët kishin vendosur të bënin luftë, u tmerrua dhe u premtoi
5 t'ua kthente burrat, që mbante rob; sa për ata që ishin vrarë u përgjigj, duke thënë se vrasja e tyre ishte bërë nga kusarët. Romakët atëherë pezulluan pregatitjet e fushës

dhe kërkuan t'u dorëzoheshin vrasësit e tyre, por atëherë meqë pa se rreziku akoma nuk ishte afruar, filloi t'i përbuzte dhe jo vetëm vrasësit nuk i dorëzoi, por dërgoi
6 ushtrinë kundër Isës. Vetëm kur dëgjoi se konsujt e Romës po afroheshin, vetëm atëherë u tremb përsëri, e la më një anë inatin dhe u tha se ishte gati të pranonte çdo kërkesë të tyre. Por prap s'vuri mend. Me të marrë vesh se konsujt kaluan në Kerkyrë, mori përsëri guxim e dërgoi ushtri kundër Epidamnit (dhe Apollonisë). Edhe atëherë kur romakët i shpëtuan këto qytete dhe kapën anijet e saj që sillnin të
7 holla, edhe atëherë nuk deshi të bindej. Edhe kur zbarkuan nga deti në tokë dhe pushtuan kodrën Atyri, edhe në këtë rast nuk u përkul (mbasi akoma ishte dimër) dhe shpresonte se do të largoheshin përsëri nga ato vende. Por kur mori vesh se Albini po qëndronte aty edhe se Demetri nga marrëzia e saj e nga frika e romakëve kaloi nga ana e tyre dhe bindi disa të tjerë që të dezertojnë, u tremb shumë dhe e la pushtetin.

1 **51** Demetri, si kujdestar i Pinit, u martua me të ëmën e tij, Triteutën – se Teuta kishte vdekur – dhe nga ky shkak u bë kryelartë dhe i rëndë me vendasit, e përveç kësaj edhe fqinjët i keqpërdorte. Romakët atëherë, e thirrën atë në Romë (mbasi dukej se duke spekulluar miqësinë e romakëve u bënte atyr padrejtësi); po ky, jo vetëm nuk dëgjoi të shkonte, po vuri dorë edhe mbi aleatët e tyre. Prandaj romakët dërguan ushtri kundër tij, që ndodhej në Isa...

1 **65** Perseu shpresonte se do t'i dëbonte plotësisht romakët nga Hellada, por për shkak të tërheqjes së parakohëshme, që pati si rezultat ngurrimin e aleatëve, ai u dobësua menjëherë... Dhe as Eumenit, as Gentit nuk u dha të hollat që u kishte premtuar, duke kujtuar se ata kishin një shkak të përbashkët për armiqësi me romakët...

LIBRI XXXVIII

1 **10** ... Ky /Antoni/ punoi shumë gjëra të tmerëshme tek nënshtetasit e Maqedonisë,
2 të cilën e sundoi si edhe tek aleatët, por edhe vetë pësoi shumë. Megjithëse i shkretoi viset e dardanëve dhe të fqinjëve të tyre, ai nuk guxoi të pengonte kalimin e tyre, dhe në një rast tjetër kur ai u tërhoq me kalorët, ata i dëbuan me forcë prej vendit këmbësorët e rrethuar, duke u marrë edhe plaçkën[1].

LIBRI XLI

2 **44** ... Cezari gjendej në Brendes, duke pritur pranverën, por kur mendoi se ai /Bibuli/ gjendej larg, se bregdeti i Epirit përkarshi ishte i mbrojtur pa kujdes, dhe se kishte ardhur koha, sulmoi. Meqenëse ishte mesi i dimrit, një pjesë të ushtrisë e
3 tërhoqi (sepse anijet nuk ishin në gjendje t'i kalonin menjëherë që të gjithë ata). Duke i ikur fshehurazi Mark Bibulit, të cilit i ishte ngarkuar ruajtja e detit, kaloi në malet e quajtura Keraune; këtu është fundi i Epirit afër ngushticës së detit Jon. **45**
1 Ndërsa, pra, /Cezari/ e kalonte kohën këtu nënshtroi edhe Orikun dhe Apollorinë, edhe vende të tjera atje, të braktisura nga rojet e Pompeut[2]. Kjo Apolloni e quajtur korinthase ndodhet në një vend të bukur të tokës dhe të detit, dhe në një vend shumë
2 të bukur lumenjsh. Por ajo që më çuditi më shumë se çdo gjë tjetër është zjarri i madh[3] që del pranë lumit Ana[4] dhe që nuk përhapet më tepër në tokën rreth e rrotull
3 dhe as atë, në të cilën del e qëndron, nuk e djeg as nuk e than në një farë mënyre, por

---

[1] Në vitin 59 para e. sonë.
[2] Në vitin 48 para e. sonë.
[3] Bëhet fjalë për burime të naftës që dilnin tek vendi Nymfe, të cilin arkeologët e vendosin pranë fshatit të sotëm Frakulla në Myzeqe.
[4] Ana-Aou – Vjosa e sotme.

përkundrazi atje, bile shumë afër tij, ka edhe gjelbërim dhe pemë që lulëzojnë; përveç kësaj, kur bie shi, ky zjarr shtohet edhe ngrihet më lart. Për këtë ky vend quhet Nymfe dhe bile këtu ka patur edhe një orakull.

2 **49** ... Dyrrahu ndodhet në atë tokë, e cila u përkiste më përpara ilirëve parthinë, kurse tani dhe atëherë sigurisht ka qenë dhe është tokë e Maqedonisë, dhe është qytet shumë i rëndësishëm, qoftë ky Epidamni i kerkyrasve, qoftë i ndonjë tjetri. Ata që shkruan për të, edhe themelimin, edhe emrin e tij e lidhin me heroin Dyrrah. Por të
3 tjerë thonë se vendi u quajt Dyrrachium prej romakëve, për shkak të vështirësisë që paraqet bregu i tij, sepse fjala Epidamnus, në gjuhën latine, ka kuptimin e dëmit[1] dhe kështu e quanin se është një shenjë e keqe për zbarkimin e tyre këtu.

LIBRI XLII

1 **10** Çështja pra ka qenë kështu: Katoni në Dyrrah ishte ngarkuar pranë Pompeut për të shikuar anën e Italisë se mos kalonte njeri dhe të ndalonte parthinët, nëqoftëse bënin ndonjë veprim, por duke qenë i detyruar të bënte luftë, së pari luftoi kundër
2 parthinëve, më pas, meqenëse Pompeu u mund, la Epirin dhe kaloi në Kerkyrë, së bashku me ata që isin të një mendimi me të[2]. **12** Dhe Gne Pompeu, duke lundruar
1 me anijet egjyptiane, sulmoi më përpara të quajturin Epir dhe pas pak mori Orikun që e mbante Mani i Akilit, i cili në hyrje të limanit kishte vënë anije të mbushura me gurë dhe në të dy anët e grykës kishte ndërtuar kulla në stere dhe mbi anije
2 transporti. Gurët që ishin në anijet i hoqi me notarë që u zhytën në ujë, ndërsa anijet i rimorkjoi duke liruar kështu rrugën e lundrimit; pas kësaj zbarkoi ushtarë në të dy anët e grykës dhe dogji anijet e pjesën më të madhe të qytetit. Pushtoi edhe pjesën
3 tjetër të qytetit, por nga frika se mos vdiste nga një plagë që kishte marrë ua la këtë egjyptasve. Pasi u shërua, Orikun nuk e sulmoi më, por rrethoi vende të tjera të cilat i forcoi, ashtu si kishte bërë një herë kot në Brendes.

LIBRI XLVII

6 **21** Në këtë kohë Vatini sundonte tek ilirët kufitarë dhe prej këtej, duke sulmuar Dyrrahun, e pushtoi atë; ai ishte indifferent kundrejt kryengritjes dhe s'mundi t'i bëjë ndonjë të keqe, se ushtarët e tij që ishin zemëruar edhe më parë, përfituan tashti nga sëmundja e tij, e lanë dhe u hodhën në lëmin e Brutit, /Bruti/ i futi, pra, edhe këta në
7 radhët e ushtrisë së vet, dhe u nis kundër Antonit që ishte në Apolloni, dhe posa i takoi forcat e tij, i bëri ushtarët ta braktisnin dhe Antonin, që u mbyll në fortesë, e kapi të gjallë me anë të tradhëtisë, por nuk i bëri ndonjë gjë të keqe. Si kreu këto veprime dhe si bëri për vete gjithë Maqedoninë dhe Epirin, njoftoi senatin mbi sa kishte vepruar...[3]

LIBRI XLVIII

7 **41** ... Në të njëjtën kohë u bë një lëvizje edhe tek parthinët në Iliri, dhe këtë lëvizje e shoi me luftë Polioni.

---

[1] Damnum – dëm, humbje.
[2] Në vitin 44 para e. sonë.
[3] Në vitin 39 para e. sonë.

1 **35** Më vonë[1] ngjau kjo: "Antoni atëherë ngarkoi disa që t'i shkatërronin ata /ushtarët e Oktavianit/, ndërsa vetë marshoi kundër japydëve. Ata që ishin pranë
2 detit i bëri për vete, ndërsa të tjerët që banonin në male e vende të thella i shtiu në dorë me shumë mundime. Ata duke mbrojtur Metulin, qytetin e tyre më të madh, zmbrapsën shumë sulme të romakëve, dogjën shumë maqina, kurse Antonin që
3 kishte hypur mbi një kullë prej druri e plagosën. Ai jo vetëm që nuk u largua, por
4 dërgoi edhe forca të tjera. Pastaj vrau të gjitha rojet në kullat e qytetit, dogji shtëpitë dhe vrau gra e fëmijë, në mënyrë që asnjë prej tyre të mos i mbetej Cezarit. Edhe ata
2 që shpëtuan u vranë më vonë si të parët.

36 Panonët banojnë afër Delmatisë, pikërisht afër Istrit që prej Norikut deri në
3 Myzinë europiane. Bëjnë jetë më të keqe nga të gjithë njerëzit (nuk kanë as ajër, as tokë të mirë, as vaj, as verë, vetëm shumë pak verë, të cilën e përpunojnë keq dhe ushqehen në dimër keq, gjithashtu elbin dhe thekrën e hanë dhe e pijnë njësoj), por
4 janë më të fuqishëm se sa mendohet prej të tjerëve; kanë qenë të vrullshëm dhe të arsyeshëm, por nuk kishin asnjë mundësi të rronin më mirë edhe po të donin. Këto jo vetëm që i kam dëgjuar dhe lexuar, por edhe i kam mësuar me fakte, prandaj sa po
5 fillova i dinja këto; pas Afrikës dhe Delmatisë, sundimtar i së cilës dikur, për një kohë, ka qenë babai im, vura në radhë të parë Panoninë e quajtur të Sipërme,
6 pikërisht sepse duke i njohur të gjitha mund të shkruaj. Quhen kështu panonë për shkak se këmishat prej cohe i presin dhe i qepin duke e quajtur këtë veprim me emrin pannus. Vetëm për këtë dhe për asgjë tjetër quhen me këtë emër, ndërsa disa prej heleneve, duke mos ditur të vërtetën, i quajtën këta paionë. Ky emër është i vjetër, por jo vetëm atje, po edhe në Rodop, në Maqedoninë e sotme gjer në det. Pikërisht për këtë unë ata i quaj paionë dhe këta panonë.
3 **37** ... Lumi që prej tyre quhet Kolops, duke rrjedhur rreth e përqark derdhet në Sau, që është pak larg tij dhe që tani rrethon gjithë qytetin[2]. Tiberi bëri një kanal të madh, nëpërmjet të cilit uji u kthye në rrjedjen e mëparshme. Atëherë meqenëse Kolopsi i
4 kalon afër murit dhe Sau pak larg tij, dhe midis tyre mbetet një boshllëk, këtë hapsirë e fortifikuan me gardhe e hendeqe. Cezari, pra, duke marrë prej aleatëve anije dhe
5 duke kaluar prej Istrit në Sau, dhe prej kësaj në Kolops, e goditi njëkohësisht me këmbësori dhe me anije; disa prej këtyre të fundit bënë edhe luftë detare. Barbarët
6 duke ndërtuar lundra nga një dru rrezikonin edhe në lum; edhe Menin të birin e Sekstit e vranë dhe kundra tij në tokë qëndruan me forcë, deri sa u njoftuan se disa prej aleatëve të tyre ishin sulmuar befas dhe ishin shkatërruar; atëherë duke humbur durimin i lanë romakët të lirë. Kështu romakët, duke pushtuar edhe pjesën tjetër të
8 Panonisë bënë një marrëveshje me ta.

43 ... Meqenëse delmatët u nënshtruan plotësisht, nga plaçka e marrë prej tyre ndërtoi[3] portikët dhe depot e librave, të cilat në kohën e së motrës u quajtën oktaviane...

LIBRI L

4 **28** ... Ose kundër tauriskëve, japydëve, delmatëve, panonëve, ju që jeni të pranishëm keni luftuar me vullnet për disa fortifikime dhe për një tokë shpesh të shkretë dhe të gjithë, megjithëse njihen si më luftarakë, i nënshtruat...[4].

---

[1] Në vitin 35 para e. sonë.
[2] Qytetin Siskia.
[3] Oktavian Augusti.
[4] Nga fjalët që Oktaviani tha para ushtarëve të tij për t'i nxitur në luftë kundër Antonit.

LIBRI LI

5 **21** ... Ditën e parë festoi triumfin mbi panonët, mbi delmatët, japydët dhe krahinat e tyre, mbi keltët dhe disa nga galatët[1].

LIBRI LIII

1 **12** Pushtetin e tij personal Augusti e forcoi në këtë mënyrë në kurriz të senatit e të popullit, duke dashur megjithatë të tregohej si populloi dhe pikërisht ai mori përsipër kujdesin dhe administrimin e gjithë punëve shoqërore, që kërkonin një mbikqyrje të veçantë. Ai tha se nuk do të administrojë të gjitha provincat[2], bile edhe në ato raste,
2 të cilat do t'i administrojë vetë, nuk do t'i zgjidhë plotësisht të gjitha çështjet administrative; ato më të thjeshtat që i përkasin kohës së paqes dhe nuk kanë të bëjnë me punët e luftës, ai ia kaloi senatit, kurse punët më të ndërlikuara, më delicate dhe të rrezikshme, që shkaktonin një qëndrim armiqësor tek disa fqinjë ose që mund të çonin në ndonjë tronditje serioze në shtet, ai i mori përsipër vetë. Në dukje ai e bëri
3 këtë me qëllim që senati të gëzonte pa asnjë rrezik frutet e administrimit, kurse mbi të të binin të gjithë vështirësitë dhe rreziqet; në të vërtetë e bëri këtë që senatorët me këtë shkak të mbeteshin të çarmatosur dhe të paaftë për të luftuar, dhe që vetëm ai të ishte i armatosur dhe të mund të mbante forca ushtarake. Prandaj ai vendosi të kalonte nën administrimin e popullit Afrikën, Numidinë, Azinë, Helladën me Epirin,
4 Delmatinë dhe Maqedoninë, si edhe Siqelinë, Kretën së bashku me Libinë, që është afër Kyrenës dhe Bityninë së bashku me Pontin që lidhet me të, Sardën dhe Betikën, kurse në administrimin e Cezarit mbetën pjesa tjetër e Iberisë pas Tarrakonës,
5 Lusitania dhe gjithë galatët; narbonezët, lugdunasit, akuitanët dhe keltët, si ata vetë, ashtu edhe kolonët e tyre; sepse disa keltë, të cilët tani i quajmë germanë, duke zënë
6 gjithë Keltikën gjatë lumit Ren, i kanë dhënë asaj emrin Germania, si asaj në rrjedhjen e poshtme deri te oqeani Britanik. Po kështu i mbetën edhe Siria e quajtur Koile Siria[3], Fenikia, Kilikia, Kyprua dhe Egypti. Më vonë ai kaloi në administrim
7 të popullit Kypriot dhe Galinë narboneze, kurse mori për vete në vend të tyre Delmatinë. Kjo masë u mor pastaj edhe për provincat e tjera, siç do të dalë nga
8 tregimi i mëposhtëm. Këtu unë numrova të gjitha provincat, sepse që nga kjo kohë ai filloi të administrojë çdo provincë më vete, kurse më parë, dhe për një kohë të gjatë, ato administroheshin nga dy e nga tre së bashku. Të tjerat unë nuk i përmenda, sepse disa prej tyre u bashkuan më vonë, kurse të tjerat edhe nëqoftëse ishin atëherë në
9 përbërjen e shtetit romak, nuk administroheshin nga romakët, por ose u ishte dhënë autonomia, ose administroheshin nga pushteti mbretëror /vendas/; kurse të gjitha provincat që ranë nën pushtetin e Romës, pas kësaj u gjendën nën administrimin e atij që kishte në dorë gjithmonë pushtetin.

1 **13** Kështu u nda administrimi i të gjithë provincave...

LIBRI LIV

1 **20** Në atë kohë, pra, u bënë shumë trazira[4]. Dhe kamunët e venët, fise alpine, morën armët kundër romakëve, por u mundën dhe u nënshtruan prej Publ

---

[1] Oktavian Augusti.
[2] Dion Kasi në vend të emrit provincë përdor fjalën popull.
[3] Me këtë emër kuptohej gjithë Siria bregdetare, prej lumit Oront deri tek qyteti Askalono, bashkë me hinterlandin.
[4] Viti 16 para e. sonë.

Silit. Edhe panonët së bashku me norikët u sulën kundër Istrisë, por edhe ata u mundën prej Silit dhe komandantëve të tij, dhe përsëri bënë marrëveshje, duke u bërë shkaktarë që norikët të hynin në të nëjtën robëri. Gjithashtu edhe punët që u turbulluan në Delmati dhe Iberi, në një kohë të shkurtër u rregulluan, kurse Maqedonia u shkatërrua nga dentheletët e skordiskët.

31 Si vdiq Agripa, të cilin siç kujtoj unë, *[Oktaviani]* e donte për virtytet e tij dhe jo për nevojë, e ndjeu se i duhej një bashkëpunëtor i zoti që t'i kalonte të tjerët si për autoritet, ashtu për fuqi... dhe për sa dëshironte mori si bashkëpunëtor Tiberin... i dha për grua Julinë dhe menjëher e dërgoi kundër panonëve, të cilët deri atëherë rrinin të qetë nga frika e Agripës, po me të vdekur ky, ngritën krye. Tiberi erdhi kundër tyre dhe pasi shkatërroi një pjesë të madhe të vendit të tyre, dhe u bëri të këqia shumë njerëzve, i shtiu në duar, duke pasur si aleat sidomos skordiskët, të cilët ishin fqinjë dhe kishin të njëjtën paisje. Armët ua mori dhe pjesën më të madhe të atyre që ishin në moshë i shiti, duke i nxjerrë jashtë...

34 Ndërsa Druzi bënte këto, u zhvillua me madhështi festa që i përkiste ofiqit të tij; po ashtu u festua edhe përvjetori i lindjes së Augustit me flijime egërsirash në hipodrom dhe vende të tjera të qytetit[1]. E para, ndonëse nuk ishte caktuar me dekret, festohej çdo vit prej atyre që mirrnin këtë titull, sa për augustalet që festohen edhe sot, në atë kohë për të parën herë u festua me dekret. Në atë kohë Tiberi shtiu në dorë delmatët që zunë të lëvizin dhe më pas edhe panonët, të cilët duke shfrytëzuar mungesën e pjesës më të madhe të ushtrisë, deshën të përmbysnin pushtetin. Ia nisi luftës njëkohësisht kundër të dyve dhe duke u rënë herë në një vend, herë në një tjetër, arriti të fitojë të njëjtat çmime lufte si Druzi. Edhe Delmatia iu dorëzua garnizonit të Augustit, pasi kishte nevojë për ushtri, si për vete, si edhe pse ishte fqinj me panonët.

36 ... Dakët duke kaluar Istrin, që atëherë kishte ngrirë, e plaçkitën Panoninë, ndërsa delmatët për shkak të mbledhjes së të hollave bënë kryengritje. Por kundër këtyre u dërgua Tiberi nga Galatia, ku gjendej bashkë me Augustin, dhe i pushtoi përsëri.

LIBRI LV

28 ... Shkak që atyre t'u jepet përsëri paqa, megjithëse brenda pak kohe i kishin shkelur marrëveshjet, u bë gjendja e delmatëve dhe e panonëve, e cila ishte shumë e turbullt dhe kërkonte një ndërhyrje të shpejtë.

29 Delmatët, të rënduar nga pagesa e taksave, më përpara qëndronin të qetë kundër dëshirës së tyre. Por kur Tiberi ndërmori për herën e dytë fushatën kundër keltëve, dhe bashkë me të u dërgua Valer Mesalini, që ishte atëherë në krye të Delmatisë e të Panonisë, i cili mori me vete pjesën më të madhe të ushtrisë, dhe nga ana tjetër edhe ata vetë *[delmatët]* qenë urdhëruar të dërgonin një farë ndihme; këta u mblodhën për këtë qëllim dhe, mbasi panë ushtarët në lulen e rinisë, nuk vonuan më, por të shtyrë sidomos nga një farë Bato, nga fisi i desidiatëve, ngritën krye, së pari disa vetë; romakët që erdhën kundër tyre i mposhtën. Pas kësaj ngritën krye edhe të tjerë. Pastaj edhe breukët, fis panon, duke vënë në krye një tjetër Bato, u vërsulën kundër Sirmit dhe kundër romakëve që ndodheshin atje. Por atë nuk e pushtuan, (sepse, kur mori vesh kryengritjen e tyre, Sever Kekina që ishte komandant i Myzisë kufitare, u lëshua me të shpejtë kundër atyre, që ndodheshin pranë lumit Drau dhe, si u ndesh

[1] Në vitin 11 para e. sonë.

me ta, i mundi). Ata. duke pasur shpresë se së shpejti do të luftonin përsëri, sepse edhe nga romakët kishin rënë në luftë shumë, u drejtuan për të kërkuar aleatë. Dhe,
4 ndërsa këta po mblidhnin sa mundnin, Batua i delmatëve bëri një fushatë kundër Salonës. Ai vetë u plagos rëndë me një gur e s'bëri gjë, por dërgoi disa të tjerë dhe dëmtoi gjithë bregdetin deri në Apolloni, dhe këtu fitoi në një betejë me ata që u bashkuan me romakët, megjithëse më parë ishte mundur prej romakëve.

1 **30** Mbasi, pra, Tiberi u informua për këto, dhe duke pasur frikë se mos sulmonin edhe Italinë, u kthye nga fushata kundër keltëve, duke dërguar më parë Mesalinin, dhe ai vetë vinte pas me pjesën më të madhe të ushtrisë[1]. Kur Batua mori
2 vesh afrimin e tyre, i doli përpara Mesalinit, megjithëse nuk ishte shëruar akoma mirë, dhe e mundi në luftë frontale, por pastaj u mund në pusi. Pas kësaj shkoi te Batua i breukëve dhe si e bëri shok të luftës, zuri një farë mali Alma. Këtu u mundën
3 në një betejë të shkurtër nga Rymetalku, thrakasi, që Severi kishte dërguar para tij kundër tyre, por kundër këtij /Severit/ vetë qëndruan me fuqi. Pas këtyre ngjarjeve,
4 mbasi Severi u nis për Myzi, të cilën e plaçkitnin dakët dhe sauromatët dhe Tiberi e Mesalini, po vonoheshin në Siskia, ata sulmuan aleatët e romakëve dhe i nxitën
5 shumë për kryengritje[2]. Sado që Tiberi iu afrua këtyre, ata nuk u ndeshën me të, por, duke kaluar nga një vend në tjetrin, plaçkitnin shumë. Sepse, nga që e njihnin mirë vendin dhe ishin të armatosur lehtë, kalonin me lehtësi ku të donin. Kur erdhi dimri, bënë më shumë dëme dhe menjëherë u futën në Maqedoni. Dhe këta i kapën në një
6 betejë Rymetalku dhe i vëllai Raskupori, kurse të tjerët nuk shkuan në ndihmë të vendit të tyre, që u shkretohej. Pas kësaj, në kohën e konsujve Cecil Metelit dhe
7 Likin Silvanit, u tërhoqën në vendet e forta, nga ku bënin sulme, si ta shihnin të arsyeshme.

1 **33** Këto ndodhën, pra, në atë vit[3], kur ishin konsuj Mark Furi dhe Sekst Noni. Delmatët e panonët deshën të hynin në marrëveshje, së pari nga shkaku i urisë, pastaj edhe i sëmundjes që u shkaktua prej urisë, mbasi ushqeheshin me disa rrënjë dhe barishte të çuditëshme. Megjithëkëtë nuk dërguan delegatë, meqenëse i ndaluan
2 ata, që nuk shpresonin të gjenin shpëtim nga romakët; kështu pra duronin. Atëherë një i quajtur Skenobarb, duke bërë sikur hidhej nga ana e romakëve, i dërgoi lajm Man Enit, komandantit të garnizonit të Siskisë, se ishte gati të dezertonte tek ai, por kishte frikë se mos e pësonte, para se të ikte...
3 **34** ... Nga drejtimi i luftave, pra, ishte bërë /Tiberi/ aq i zoti sa që mund të jepte për së afërmi çdo këshillë që ishte e nevojshme kundër delmatëve dhe panonëve. Ai u nis për në Arimin dhe me rastin e nisjes së tij u bënë lutje, kurse me rastin e kthimit të tij u bënë flijime, sikur të kthehej nga ndonjë vend armik.
4 Këtu u ndodhën në Romë. Në këtë kohë Batua i breukëve, i cili pat tradhëtuar Pinin, dhe si shpërblim të kësaj pati marë sundimin mbi breukët, u kap nga Batua
5 tjetër dhe u vra; sepse nga që kishte dyshime për njerëzit e tij, shkonte e kërkonte pengje nga çdo kështjellë. Kur e mori vesh këtë ai /Batua i delmatëve/, i ngriti pusi dhe, si e mundi në betejë, e detyroi të mbyllet në një kështjellë; pastaj ata nga brenda
6 ia dorëzua e ky, pasi e mori, e solli në ushtri e dënoi me vdekje dhe e vrau aty për aty. Si u bë kjo, shumë panonë ngritën kryq. Kundër këtyre u dërgua Silvani, i cili i mundi breukët edhe disa nga të tjerët i bëri për vete pa luftë. Batua, duke parë këto,

---

[1] Në vitin 12 para e. sonë.
[2] Në vitin 6 të e. sonë.
[3] Në vitin 6 të e. sonë.

humbi çdo shpresë për Panoninë dhe, pasi zuri me roje të gjitha hyrjet prej saj në Delmati, e plaçkiste atë. Dhe kështu edhe panonët e tjerë erdhën në marrëveshje, sidomos sepse vendi i tyre keqpërdorej nga Silvani; disa plaçkitës, duke përfituar nga një trubullirë kaq e madhe, dëmtonin edhe më tepër, gjë që, si të themi, ndodh gjithmonë edhe ndër të tjerë, por sidomos ndër ata [panonët].

LIBRI LVI

12 ... Në anën tjetër lufta po zgjatej dhe një uri ra në Itali si rrjedhim i luftës; për këto arsye Augusti e dërgoi Tiberin përsëri në Delmati[1]. Këtu kur pa se ushtarët nuk duronin më të kalonte koha pa bërë gjë, po përkundrazi ishin gati të luftonin qoftë edhe me rrezik, u tremb se mos bënin ndonjë lëvizje po të liheshin të bashkuar dhe prandaj i ndau trish: një pjesë ia dorëzoi Silvanit, një tjetër Mark Lepidit dhe me pjesën tjetër ai bashkë me Germanikun u turr kundër Batos. Të tjerët i mundën fare lehtë armiqtë që u dolën para dhe u kundërshtuan; po ai vetë u soll pothuajse nëpër tërë vendin, i shtrënguar nga Batua, i cili hidhej herë këtu, herë atje dhe më së fundi iku në kështjellën Anderi, pranë Salonës, rrethimi i së cilës e lodhi shumë. Kështjella ishte rrethuar me mure dhe ndërtuar mbi një shkëmb shumë të fortë, të vështirë për t'u kaluar; rreth e rrotull kishte gryka të thella ku kalonin lumenj të rrëmbyeshëm. Përveç kësaj njerëzit, nga të gjitha ato sende që kishin nevojë, disa i kishin sjellë, disa të tjera i sillnin nga majat e maleve që kishin zënë; më në fund duke vënë edhe prita, ata pengonin karvanin e furnizimit t'u vinte romakëve, saqë Tiberi në dukje ishte rrethues, kurse në të vërtetë pësonte tërë të këqijat e të rrethuarit.

13 Pra një ditë, kur Tiberi ishte fort i mërzitur, mbasi s'dinte se ç'të bënte (se edhe rrethimi dukej i kotë dhe i rrezikshëm, po edhe largimi i tij ishte një gjë e turpshme për atë), ushtarët e tij bënë një zhurmë dhe lëshuan një britmë të tillë, saqë armiqtë që ndodheshin në atë kohë nën muret, u habitën dhe u larguan. Nga kjo ngjarje pak i zemëruar dhe pak edhe i kënaqur, i mblodhi ushtarët dhe i qortoi, duke u dhënë dhe njëkohësisht këshilla. Megjithatë as guxim më të madh nuk mori, po edhe as u largua dhe nuk hoqi dorë prej planit të tij, por vazhdoi të qëndronte aty me qetësi, derisa Batua i dëshpëruar për fitoren, meqenëse një pjesë kishte rënë dhe fuqia zuri t'i pakësohej, dhe meqenëse shokët e tjerë nuk e ndihmonin, ndonëse shumë kërkonin ndihmën e tij, i braktisi ata. Tiberi atëherë përbuzi të tjerët që ishin brenda në kështjellë se kujtoi se do t'i detyronte të dorëzoheshin pa gjak; prandaj; duke mos pasur dyshim e frikë, zbriti më poshtë afër viseve të pakalueshme. Po mqenëse armiqtë nuk zbrisnin, ai hipi mbi një tribunë të ngritur në një vend që dukej nga të gjitha anët, që të shikonte ç'bëhej dhe u jepte guxim ushtarëve për të luftuar më me trimëri, dhe në rast se e kërkonte nevoja t'u ndihmonte në kohën e duhur (sepse mbi vendin ku ishte ushtria ishte një pozicion nga i cili mund të shikohej tërë masa); të tjerët në fillim të radhitur në radhë të dendura marshonin ngadalë, por pastaj nga shkaku se mali ishte i përjetë dhe i vështirë (kishte humnera dhe ndahej në shumë gryka) ata u përçanë, kështu që disa ngjiteshin ngadalë dhe disa të tjerë më shpejt.

14 Delmatët, duke e parë këtë, u radhitën jashtë kështjellës, në anën ku ajo binte thikë dhe qëllonin kundër tyre me gurë të shumtë, një pjesë prej të cilëve i hidhnin me hobe dhe një pjesë i rrokulisnin. Të tjerët lëshonin rrota, karroca plot me gurë dhe disa të tjerë arka të rrumbullakta të bëra në vend dhe të mbushura plot me gurë. Të gjitha këto, të sjella njëkohësisht, lëshoheshin me shpejtësi të madhe dhe i përçanë

[1] Në vitin 9 të e. sonë.

në mes romakët, duke i dëmtuar. Të tjerët vranë shumë prej tyre duke i goditur edhe
3 me shigjeta edhe me heshta. Dhe kjo u bë një nxitje e madhe për ata që luftonin, kështu që disa ngjiteshin e zinin majat, kurse të tjerët përpiqeshin të përballonin dhe
4 të dëbonin romakët; shembullin e tyre e ndiqnin edhe ata që shikonin ngjarjet nga kështjella si edhe ata që ishin afër Tiberit. Që të dy palët nxitnin njerëzit e tyre; ata që tregoheshin të gatshëm u shtonin guximin, kurse ata që ishin të përmbajtur i shanin, të gjithë bashkë ose një nga një dhe të gjithë ata që bërtisnin mbi të tjerët,
5 thërrisnin njëkohësisht perënditë për shpëtimin e tyre që luftonin dhe pastaj edhe për spëtimin e vetes; një palë bërtisnin për liri, kurse pala tjetër për paqe. Dhe në qoftë se romakët u rrezikuan më kot, duke luftuar, kjo ndodhi për dy gjëra: për shkak të natyrës së vendit dhe mënyrës së radhitjes së kundërshtarëve. Në qoftë se Tiberi nuk
6 do ta kishte penguar ikjen e tyre me forca të freskëta dhe nuk do të kishte dërguar në të gjitha anët ushtarët e tij për t'i shqetësuar, armiq të tjerë do të kishin hyrë në pozicionet që në mëngjes nga shumë drejtime. Kështu ata duke ikur nuk patën mundësi të hyjnë në kështjellë, por u shpërndanë nëpër male duke lëshuar armët që
7 të ishin më të lehtë; kurse ata që i ndiqnin (dëshironin shumë të luftonin dhe nuk donin të grumbulloheshin mbasi kështu e vinin veten në një gjendje të vështirë). Ata i sulmuan dhe shumica e atyre që ishin fshehur nëpër pyjet, si i gjetën i vranë si egërsirat dhe mbas kësaj kapën edhe ata që ishin tërhequr në kështjellë.

1 **15** Germaniku u kthye kundër atyre që qëndronin akoma; sepse dezertorët[1], të cilët ishin të shumtë pranë tyre, nuk i linin këta të binin në marrëveshje. Dhe ai nënshtroi një vend të fortifikuar të quajtur Arduba, por këtë nuk mundi ta bëjë me ushtritë e veta, megjithëse ishin më të shumta se të kundërshtarëve; sepse ky vend vetë ishte shumë i fortifikuar dhe një lumë i rrëmbyeshëm, me përjashtim të një pjese të vogël,
2 ia lagte rreth e rotull rrëzët e tij. Por dezertorët, pasi ngritën krye kundër vendasve, të cilët dëshironin paqen, u ndeshën me ta[2], të ndihmuar edhe nga gratë që ishin në kështjellë (sepse këto donin lirinë edhe kundër mendimit të burrave, dhe pranonin të
3 pësonin çdo gjë përpara skllavërimit) dhe bënë një betejë të ashpër. Mbasi u mundën, ata vetë u dorëzuan, por disa prej tyre edhe shpëtuan, kurse gratë, pasi rrëmbyen fëmijët, disa u hodhën në zjarr, disa të tjera në lumë. Kështu, si u pushtua edhe ajo kështjellë dhe të tjerat pranë saj, ranë me dëshirën e tyre në marrëveshje me Germanikun. Si kreu këto, Germaniku u nis për tek Tiberi, kurse Postumi u dha fund të tjerëve.

1 **16** Në këtë kohë edhe Batua dërgoi të birin, Skeva, te Tiberi dhe i premtoi të dorëzohet, ai vetë bashkë me gjithë ata që kishte me vete, në qoftë se do t'i jepte sigurim.
2 Pastaj si u sigurua, hyri natën në lëmin e atij, dhe të nesërmen u paraqit përpara Tiberit, i cili rrinte mbi një tribunë. Batua atëherë nuk kërkoi asgjë për veten e tij, bile edhe kokën ia zgjati që t'ia priste, por për të tjerët foli duke i mbrojtur me shumë
3 fuqi. Më në fund Tiberi e pyet: "Pse vendosët të ngrini krye dhe të luftoni me ne për një kohë aq të gjatë?" Ai, atëherë, iu përgjegj: "Ju vetë jini shkaktarë, se për të ruajtur kopetë tuaja nuk dërgoni qen dhe barinj, po ujqër".
Pra këtë fund pati lufta, gjatë së cilës shumë njerëz humbën dhe u shpenzua një sasi shumë e madhe të hollash. Sepse gjatë kësaj lufte u desh të mblidhet shumë ushtri, ndërsa plaçka e luftës ka qenë shumë e paktë.

---

[1] Fjala është për ilirë, që kishin dezertuar nga radhët e ushtrisë romake.
[2] D.m.th. me romakët.

ELIANI

Klaud Eliani lindi në Prenestë të Latit rreth vitit 170 të e. sonë dhe vdiq rreth vitit 235. Simbas bashkëkohësit të tij Flav Filostratit, ai jetoi më tepër se 60 vjet. Në Preneste pati ofiqin e arhiereut (kryepriftit). Megjithëse lindi dhe jetoi në Lat, Eliani e njohu dhe e shkroi shumë mirë gjuhën greke.

Nga vepra më e madhe e tij "Peri zoon idiotetos", lat. De animalium natura, (Mbi natyrën e kafshëve) kanë mbetur 17 libra të plotë, një parathënie dhe një epilog. Në këtë vepër Eliani kërkon të tregojë se edhe kafshët duan, urrejnë, tmerrohen dhe gëzohen si njeriu. Vepra tjetër e tij është "Poikile historia", lat. Varia Historia, (Histori të ndryshme). Që të dyja këto vepra të Elianit përbëhen nga ekstrakte të grumbulluara në mënyrë jo kritike prej burimesh të ndryshme, shumica e të cilave nuk na janë ruajtur.

Veprat e përmendura të Elianit kanë rëndësi për ne, mbasi ato përmbajnë të dhëna mjaft interesante mbi faunën e Ilirisë, mbi pjellorinë e gjedhit, mbi pasurinë me asfalt të rretheve të Apollonisë, mbi disa zakone të ilirëve, etj.

Përkthimi është mbështetur

Claudii Aeliani De animalium natura libri XVII; Varia Historia, epistolae, fragmente ex recognitione Rudolphi Hercheri. Vol. I-II. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1864, 1866.

CLAUDII AELIANI

1. DE ANIMALIUM NATURA

(Mbi natyrën e kafshëve)

LIBRI I

38 Elefanti e ka frikë dashin me brirë dhe zërin e derrit. Thonë se edhe romakët kështu i vunë në ikje elefantët që kishte me vete Pirro Epiroti dhe patën një fitore të shkëlqyer.

LIBRI II

40 Ka një lloj shqiponje, që i duan ata që i ushqejnë, siç ishte edhe shqiponja e Pirros.

LIBRI III

2 Më i guximshmi nga qentë është qeni molos, meqenëse edhe burrat /molosë/ janë të tillë.

12 Stërqokat i quajnë të dobishme edhe thesalët, edhe ilirët, edhe lemnasit dhe përgatisin për to ushqim publik, meqenëse zhdukin vezët dhe pengojnë shtimin e karkalecav të cilët u shkaktojnë dëme prodhimeve bujqësore.

34 Thuhet se lopët epirote japin shumë qumësht dhe dhitë e Skyrës japin qumësht me bollëk, sa asnjë dhi tjetër.

LIBRI V

56 Drerët e Epirit notojnë për në Kerkyrë dhe këta, d.m.th., Epiri dhe Kerkyra, ndodhen ballë për ballë njera tjetrës në ngushticë.

LIBRI VII

3 Është një kafshë e Paionisë që thirret monop dhe që nga madhësia i përngjet një demi leshtor.

12 Gratë e Paionisë janë shumë të mençura dhe gërthasin fort, kur janë duke bërë fli. Ndodhin edhe këto: mbi kokë mbajnë një shtamë me ujë dhe qafën e mbajnë drejt në mënyrë që kur janë duke ecur, shtama qëndron pa lëvizur dhe pa u lëkundur. Në të njëjtën kohë fëmijëve u japin të pijnë, duke i mbajtur varur në gji, kalin e të shoqit e tërheqin për kapistre dhe e shpien për t'i dhënë ujë, kurse me duar thurin sende për të veshur. Për këto u çudit edhe Dari, kur disa të rinj paionë motrën e tyre e nisën në këtë mënyrë.

45 Pirro Epiroti gëzohej kur dëgjonte që i thonin shqiponjë, sikurse thuhet për Antiohun – skyfteri.

LIBRI XII

11 Ky /kau që nderonin egjiptianët/ ishte më i madhi i qeve edhe nga ata të Kaonisë, të cilët thesprotët dhe epirotët i quajnë larinos, të rrjedhur nga raca e gjedhit të Geryonit.

LIBRI XIII

19 Në pellgun e Jonit, afër ishullit Leukas dhe detit pranë Aktit, ku edhe vendin e quajnë Epir, ka qefuj të shumtë që notojnë në tufa të mëdha.

LIBRI XIV

1 Në pellgun e Jonit, afër Epidamnit, ku banojnë edhe taulantët është një ishull që quhet i Athinasë dhe këtu banojnë peshkatarë. Atje është edhe një liqen ku ushqehen tufa skombrësh të mësuar.

LIBRI XVII

40 Shumë bretkosa të pazhvilluara mirë ranë prej qielli dhe bënë që autariatët të vendosen në një vend tjetër.

2. VARIA HISTORIA

(Tregime të ndryshme)

LIBRI II

4 ... Dhe Agronin mbretin e ilirëve e mori në qafë dëshira e pafrenuar për verën dhe i shkaktoi atij pleuritin. Edhe një mbret tjetër i ilirëve, Genti, kishte zakon të pinte pa u përmbajtur.

LIBRI III

15 ... Kësaj të keqeje /për pije të tepruar/ nuk i kanë shpëtuar as ilirët, përkundrazi, për ta thuhet edhe kjo, se u lejohej të huajve, të pranishëm në tryezë, të pinë bashkë me gratë, secili me atë grua që dëshiron edhe pse gruaja nuk i përket atij.

LIBRI IV

1 Kam dëgjuar se dardanët e Ilirisë lahen vetëm tri herë gjatë gjithë jetës së tyre... kur lindin, kur martohen dhe kur vdesin.

LIBRI XIII

16 Apolloniatët banojnë në një qytet fqinj me Epidamnin, në gjirin e Jonit. Dhe afër saj /Apollonisë/ ka asfalt që nxirret duke gërmuar dhe pisë që del nga toka, po ashtu si shumë burime uji. Dhe flitet se jo larg është një zjarr i përjetshëm. Vendi që digjet është i vogël; ai nuk zë një hapësirë të madhe dhe ka një rreth të ngushtë; mban erë squfuri dhe çemçekëzi dhe rreth tij ka bimë që lulëzojnë plotësisht dhe gjelbërim dhe zjarri, që del me vrull aty pranë, nuk dëmton aspak mbirjen e bimëve as gjelbërimin. Zjarri digjet natë e ditë dhe s'kishte pushuar kurrë, siç thonë apolloniatët, para luftës që u ndodhi atyre me ilirët.
Apolloniatët i dëbonin të huajt sipas ligjit të lakedemonëve, kurse epidamnasit, atij që dëshironte, i jepnin të drejtë të vinte në qytet edhe të banonte.

ATHENEU

Atheneu, retor dhe gramatik nga Naukrati i Egjiptit, jetoi rreth viteve 200 të e. sonë. Një pjesë të kohës ai e kaloi në Aleksandri dhe Romë. Shkroi një vepër shumë të madhe të titulluar "Deipnosophistae" që do të thotë "Gostia e dijetarëve". Vepra përmblidhet në 30 libra, prej të cilëve na janë ruajtur vetëm 15. Në këtë vepër jepen bisedat e disa burrave të ditur, si filozofë të shkollave të ndryshme, mjekë, gramatikë, juristë, etj., në një gosti të organizuar nga romaku i pasur Laurenti. Në këtë vepër, e cila paraqet një përmbledhje shënimesh të dijetarëve për antikitetet, historinë, literaturën, artin, zakonet etj. citohen edhe shumë pasazhe nga vepra të humbura të shkrimtarëve të ndryshëm antikë.

Tek Atheneu ne gjejmë të dhëna shumë të vlefshme për marrëdhëniet ekonomike shoqërore tek ilirët, të nxjerra nga vepra të zhdukura të Teopompit dhe të Agatarhidit, si dhe mbi zakonet e ilirëve etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Athenaei Deipnosophistae Ex recognitione Augusti Meinecke. Vol. I-III Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1858-59.

ATHENAEI

DEIPNOSOPHISTAE

(Gostia e dijetarëve)

LIBRI I

28d **51** Në Isa, ishull në Adriatik, bëhet thotë Agatarhidi, verë, e cila po të krahasohet me të tjerat, është më e mirë.

LIBRI II

18d **18** Theopompi thotë se rreth lumit Erigon ndodhet një ujë i tharptë; ata që pijnë nga ky, dehen sikurse ata që pijnë verë.

LIBRI III

73b **3** Fylarhu thotë se kurrë më parë, në asnjë vend, bathët egjiptiane nuk janë mbjellë dhe ato të mbjellura nuk janë rritur veçse në Egjipt; në kohën e mbretit Aleksandër, djalit të Pirros, ndodhi që të mbijnë bathë në një vend moçalor, pranë lumit Tyam të Thesprotisë, në Epir.

114b **80** Tek athamanët një lloj buke quhet dhramikes e araksis.

LIBRI VI

264b **85** Thesalët quajnë penestë jo ata që lindin skllevër, por ata që shtihen në dorë me anë të luftës.

271e **101** "Ardianët, thotë /Teopompi/" kanë treqind mijë prospelatë si helotë[1], çdo ditë pijnë e dehen dhe bëjnë gostira dhe nuk e mbajnë dot veten sa duhet në punën e të ngrënit e të pirit. Prandaj edhe keltët, kur luftuan kundër tyre, duke ua ditur këtë dobësi, porositën të gjithë ushtarët që të përgatitnin nëpër çadrat një darkë sa më të mirë dhe të vinin nëpër ushqimet një farë bari të njomë helmonjës i cili të shkaktonte të prerët e barkut... Kjo u bë, dhe atëherë disa prej tyre u kapën nga keltët dhe u vranë, kurse të tjerët u hodhën në lum duke mos mundur të zotërojnë barqet e tyre.

272d **103** Agatarhidi, nga Knidi, në librin e tridhjetë e tetë të veprës "Europaikon" thotë se dardanët kanë kaq shumë skllevër[2] sa dikush kishte një mijë... kurse të tjerë edhe më shumë. Secili nga këta /skllevër/ në kohë paqeje punon tokën, kurse në kohë lufte merr pjesë në ushtri, duke pasur si prijës të zotin e vet.

LIBRI VIII

333A **6** Heraklidi, nga Lembo, në librin 21 të Historisë thotë se përëndia hodhi prej qielli në Paioni dhe Dardani bretkosa. Sasia e tyre ishte aq e madhe sa u mbushën shtëpitë dhe rrugët plot.

LIBRI IX

369D **8** Posidoni, stoiku, në librin 27 të historisë së tij thotë se në Dalmati ka rrepa fushe dhe rrush të egër.

LIBRI X

443ab **60** Në librin e dytë të "Filipika" /Teopompi/ thotë: "Ilirët hanë dhe pijnë duke ndenjur; nga ana tjetër, nëpër gosti marrin edhe gratë me vete, për të cilat është një gjë e mirë që të pijnë për shëndetin e cilitdo nga të pranishmit... Kur pijnë, (ilirët) i mbështjellin barqet e tyre me breza të gjerë; dhe këtë gjë në fillim e bëjnë me masë, por sa më tepër që pijnë, aq më tepër e shtrëngojnë brezin".

447cd Në përshkrimin e Evropës /Hekateu/ thotë se paionët pinin një pije bryton prej elbi dhe parabije[3] prej meli e konyzi[4]; thotë gjithashtu se lyhen me lyrë.

LIBRI XI

468d **34** Gjedhët e Molosisë thuhet se kishin brirë shumë të mëdhenj. Për trupin e tyre flet Teopompi. Afër Molosisë është Jolko, në të cilën u bë ndeshja e Peleut.

476d **51** Teopompi në librin e dytë të "Filipika", duke folur për mbretërit e paionëve,

---

[1] Helotë quheshin skllevërit e Spartës. Ata ndryshonin nga skllevërit e shteteve të tjera se ishin pronë e gjithë shtetit; megjithëse ishin shpronësuar krejtësisht nga toka, ata e punonin këtë me mjetet e tyre edhe u paguanin të zotërve të tyre një taksë në natyrë. Mbi ta rëndonte edhe detyrimi ushtarak për shërbime ndihmëse.

[2] Në tekstin grekisht këta skllevër quhen dullë (δουλοι)

[3] Një lloj boze.

[4] Bimë konifere e cila dallohet për erën e saj të fortë.

thotë se brirët e qeve, që rriteshin në tokat e tyre, ishin aq të mëdhenj sa zinin 3-4 koe dhe prej tyre bënin kupa, buzët e të cilave i vishnin në argjend ose ar.

500b **101** Skyfosi[1] tek epirotët quhet lytros, sikurse e thotë Seleuku.

LIBRI XII

540d **57** Klitua aristotelian, në veprën e tij mbi Miletin, thotë se Polykrati, tiran i banorëve të ishullit Samo, i grumbullonte gjërat e qejfit nga çdo anë, nga Epiri qentë, nga Skyro dhitë, nga Mileti dhentë dhe nga Siqelia derrat.

LIBRI XIII

557e **5** Filipi martohej gjithmonë në kohë lufte. Gjatë sundimit të tij 22 vjeçar ai u martua sikurse thotë Satyri në veprën e tij "Jeta e Filipit", së pari me iliren Audata, dhe pati me të të bijën Kynën. Filipi mori si prikë edhe mbretërinë e molosëve, kur u martua me Olympinë, e cila i lindi Aleksandrin dhe Kleopatrën... Mbas gjithë këtyre martesave u martua më në fund me dashuri me Kleopatrën, të motrën e Hipostratit dhe mbesën e Atalit. Këtë e mori për grua krahas Olympisë. Por kjo *[martesë]* ia shkatërroi jetën, mbasi menjëherë mbas dasmës Atali tha: "Tani padyshim do të lindin mbretër të vërtetë dhe jo dobiça". Aleksandri kur i dëgjoi këto, dërgoi tek Atali kupën që mbante në duart e veta dhe pastaj Atali ia ktheu në të njëjtën mënyrë. Olympia atëherë shkoi tek molosët, kurse Aleksandri tek ilirët.

560f **10** Duri, nga Samo, thotë se u bë edhe lufta e parë ndërmjet dy grave: Olympisë e Eurydikes. Në këtë luftë ajo u lëshua në mënyrën më bakhike, me daulle, kurse Eurydika ishte armatosur maqedonçe, duke qenë ushtruar në punë të luftës prej Kynës me prejardhje ilire.

623d **27** Quhen dactyl ata që e kanë kërcimin më të thjeshtë, më të ngadalshëm dhe më të ndryshueshëm, si kërcimi jambik molos...

[1] Gotë balte me trup konik dhe dy vegjëza horizontale nën buzë.

HERODIANI

Mbi jetën e Herodianit, autorit të historisë së perandorisë romake pas vdekjes së Mark Aurelit, nuk dimë pothuaj asgjë. Të vetmin burim mbi jetën e Herodianit e gjejmë tek vepra e tij, megjithëse edhe këu ai flet shumë pak për veten e vet. Me sa duket Herodiani ishte me prejardhje nga Siria. Disa përcaktojnë si vendlindje të tij Antiohinë, duke e argumentuar këtë mendim, jo në mënyrë bindëse, me faktin se ai shkruan gjerë e gjatë për këtë qytet. Për një kohë Herodiani ushtroi funksione të caktuara në administratën civile. Në vitet 192 dhe 204 gjendet në Romë, ku mori pjesë edhe në shfaqjet e organizuara në këto vite prej perandorëve Komod dhe Septim Severit.

Në historinë e tij të Romës, të ndarë në tetë libra, të cilën e shkroi në vitet 240-250, Herodiani përshkruan ngjarjet në mes viteve 180-238 të cilat ai dhe i jetoi. Për këtë vepër ai grumbulloi një material faktik të jashtëzakonshëm, por në shtjellimin e tij ai tregohet jo i aftë dhe i pafrymëzuar.

Stili i tij nuk është i qartë dhe i saktë, ka shprehje të rënda dhe vende-vende të pështjelluara e me plot përsëritje.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Herodiani ab excessu Divi Marci libri octo edidit K. Stavenhagen. Lipsiae et Berolini in aedibus B.G. Teubneri 1922.

HERODIANI

AB EXCESSU DIVI MARCI

(Historia e perandorisë romake pas vdekjes së Mark Aurelit)

LIBRI II

1 **9** Ndërsa (Nigri) mendonte këto gjëra dhe ushqente shpresa të kota, u njoftoi ilirëve dhe gjithë ushtrisë, që gjendej përtej brigjeve të Istrit dhe Rinit, ngjarjet, me qëllim që të pengonin barbarët që gjendeshin në atë anë dhe të ruanin kështu kufijtë e shtetit
2 romak. Komandant i gjithë forcave panone ishte Severi, burrë, me prejardhje nga Libia...
9 Severi e dinte se ushtarët, që ishin në Iliri, ruanin akoma gjallë kujtimin e sundimit të Pertinaksit. Në të vërtetë në kohën e sundimit të Mark Aurelit, Pertinaksi, i cili ishte atëherë komandanti i tyre i përgjithshëm dhe sundimtar i Ilirisë, kishte korrur bashkë me ta fitore të shumta mbi germanët, duke dhënë shembuj trimërie në luftë kundër armiqve.

1 **10** Duke i nxitur, pra me letra të gjithë ilirët... si edhe krerët, i bëri për vete. Pas kësaj duke mbledhur ushtarët nga të gjitha vendet, Severi, pasi i shtoi emrit të tij atë të Pertinaksit, (me këtë ai synonte t'u bënte përshtypje jo vetëm legjioneve të Ilirisë, por edhe popullit romak, i cili ruante kujtimin për Pertinaksin), i mblodhi në një fushë të hapur, hipi mbi një tribunë të përgatitur posaçërisht për të dhe u foli...
9 **11** Juliani nuk guxonte as të dilte jashtë qytetit, por u tha, duke u lutur, ushtarëve të tij të armatosen, të bëjnë ushtrime të rregullta dhe të hapin hendeqe përpara qytetit /Romës/, por përgatitjet e tij kundër Severit ishin bërë në mënyrë të tillë që lufta të zhvillohej brenda qytetit; të gjithë elefantët që nuk u shërbenin romakëve, vetëm se për kortezhe, i stërviste që të mbanin mbi shpinë kulla dhe njerëz, duke menduar se kështu ilirët do të frikësoheshin dhe kuajt e armiqve do të trembeshin nga pamja dhe madhësia e jashtëzakonshme e këtyre kafshëve që nuk i kishin parë deri atëherë. Në të njëjtën kohë i tërë qyteti përgatitej për luftë dhe farkëtonte armë.
10 **13** Pasi mbaroi së dhëni urdhëra[1], ushtarët ilirë hynë në mes tyre dhe i kapën, u hoqën shpatat e shkurtëra të paradës të zbukurura me ar e argjend, që i mbanin të ngjeshura në brez, rripat, rrobet dhe plaçkat e tjera ushtarake, që kishin me vete, dhe i përcollën prej atje të zhveshur...

---

[1] Septim Severi, pas vdekjes së Julianit, thirri me dinakëri para mureve të Romës ata që kishin marrë pjesë në vrasjen e Pertinaksit dhe u mbajti një fjalim, ku i urdhëroi që ata të largohen nga Roma.

LIBRI III

1 **1** Nigri[1], kur mori vesh se Severi u bë zot i gjendjes në Romë – gjë të cilën nuk e priste fare – dhe që ai ishte shpallur nga senati pernador e ishte nisur kundër tij me gjithë ushtrinë tokësore të Ilirisë dhe me gjithë flotën që kishte, u frikësua shumë dhe dërgoi lajmëtarë tek gjithë sundimtarët e popujve, duke i urdhëruar që të merrnin masat e nevojshme për të ruajtur gjithë hyrjet dhe limanet.

LIBRI VI

3 **4** Përshkoi rrugën me nxitim të madh dhe duke kaluar nga fiset dhe lëmet, Aleksandri[2] vizitoi Ilirinë dhe pasi mblodhi në këto vende një ushtri të madhe arriti më në fund në Antiohi.

2 **7** ... Por papritur aritën lajmëtarë dhe letra nga komandantët, të cilëve u kishte besuar sundimin e Ilirisë, që e tronditën Aleksandrin dhe e futën në telashe edhe më të mëdha. Ata i shkruanin /perandorit/ se germanët kishin kaluar Rinin dhe Istrin, se shkretonin shtetin romak, duke sulmuar me forca të shumta lëmet që gjendeshin në brigjet e lumenjve dhe qytetet e fshatrat i keqpërdornin.

Gjithashtu nuk ishin më pak të rrezikuara edhe fiset ilire, që ishin kufitare dhe fqinje
3 të Italisë, dhe shtonin se ishte e nevojshme prania e tij në krye të gjithë ushtrisë që kishte. Lajmet e turbulluan Aleksandrin dhe zemëruan ushtarët ilirë, të cilëve u dukej se i plakosi një fatkeqësi e dyfishtë. Së pari vuajtjet në luftërat me persët, dhe së dyti për ato që mësuan mbi humbjet e të afërmëve të tyre nga germanët, prandaj filluan të ngrenë krye, duke e fajësuar Aleksandrin se pasi humbi luftën në Orient vetëm e vetëm nga moskujdesia dhe frika e tij, tashti kishte plot dyshime dhe
4 lëkundje përpara ngjarjeve që do të ndodhnin në pjesën veriore të perandorisë. Porse Aleksandri dhe oborrtarët e tij filluan të shqetësoheshin për fatin e vetë Italisë.

Kërcënimi i germanëve i dukej shumë më i rrezikshëm se ai që vinte nga ana e persëve. Këta të fundit jetojnë diku në lindje, të ndarë me tokë të gjatë dhe det të hapët dhe vendin e italikëve mezi e dëgjojnë, ndërsa fiset ilire, të cilat jetonin të grumbulluara në një rrip të ngushtë toke dhe nuk zinin veçse një pjesë të vogël të territorit romak, bënin që germanët të ishin shumë afër italikëve.

---

[1] Nigri në këtë kohë gjendej në Antiohi.
[2] Aleksandër Severi i cili u nis nga Roma.

JUSTINI

Në vitin 9 para e. sonë, gjatë sundimit të Augustit, në Romë doli një histori prej 44 librash me titull "Historiae Philippicae" (Historitë e Filipit). Autori i saj ishte Pompe Trogu, bashkëkohës i Tit Livit, me prejardhje nga Narbona e Galisë. Në këtë vepër jepet historia e Maqedonisë, duke filluar nga koha para Filipit II deri në rënien e shtetit maqedonas. Në kundërshtim me qëndrimin e autorëve të tjerë latinë, përkrahës të politikës tradicionale agresive romake, Pompe Trogu mban një qëndrim të kundërt antiromak, duke lëvduar në veprën e tij Filipin, themelues të fuqisë së Maqedonisë.

Vepra e Pompe Trogut u zhduk; ne njohim vetëm një përmbledhje të përgjithshme, epitomet e saja të shkruara në shekullin e II të e. sonë nga M. Junian Justini. Për Justinin dihet shumë pak. Ai si epitomator, duke përmbledhur veprën e gjerë e me përmbajtje të pasur të Trogut, ka lënë jashtë shënime të çmueshme me karakter etnografik e gjeografik. Ai u kufizua, duke mos patur cilësitë e një shkrimtari të vërtetë, të japë vetëm disa momente nga përmbajtja e çdo libri, por ruajti numrin dhe radhën e tyre. Megjithë boshllëqet e mëdha, Justini ka lënë mundësinë të njihemi me kompozicionin e veprës së Trogut dhe konceptin historik të tij. Vepra e Justinit ka rëndësi të posaçme për historinë e Ilirisë, veçanërisht për marrëdhëniet dhe luftërat e ilirëve të jugut me maqedonasit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

M. Juniani Justini, Epitoma Historiarum Philippicarum Pompei Trogu, recens. F. Ruchl, Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1915.

M. IUNIANI IUSTINI

EPITOMA

HISTORIARUM PHILIPPICARUM

POMPEI TROGI

(Përmbledhje e historisë së Filipit)
të Pompei Trogut

LIBRI VII

1 Maqedonia quhej më parë Emathi[1)], sipas emrit të Emathit, i cili qe i pari që dha shembull trimërie në këtë vend. Territori i saj rritej shumë me ngadalë dhe kufijtë e saj ishin shumë të ngushtë. Populli quhej pellazg, kurse krahina Botia. Por me kalimin e kohës, në saje të guximit të mbretërve dhe energjisë së popullit, Emathia, pasi nënshtroi në fillim fqinjët e saj, dhe më vonë dhe shumë fise e popuj të tjerë, u zgjerua deri në kufijtë më të largët lindorë. Në Paioni, që është tani një pjesë e Maqedonisë, thonë se ka sunduar Telegoni[2)], i ati i Asteropeut, emri i të cilit ka arritur deri tek ne midis emrave të mbrojtësve më të lavdishëm të qytetit *[Trojë]* në kohën e luftës trojane. Në anën tjetër, në Evropë, ishte mbret Europi. Por papritur erdhën në Emathi Karani me shumë grekë, i cili ishte lejuar nga orakulli që të kërkonte në Maqedoni vend për t'u vendosur.

2 Pas Karanit sundoi Perdika. Edhe jeta e tij ka qenë e lavdishme dhe e përmendur porosia e tij para vdekjes, që i ngjan fjalëve të një orakulli. Dhe pikërisht, kur po vdiste, në moshë shumë të thyer, ai i tregoi të birit, Argeut, vendin ku dëshironte të varrosej. Ai urdhëroi që po këtu të varrosen pasardhësit e tij dhe paralajmëroi se sa kohë që pasardhësit e tij do të varrosen këtu, fisi i tij do ta ruajë pushtetin mbretëror. Ata, duke i besuar kësaj legjende, mendojnë se fisi i Perdikës u shua me Aleksandrin, sepse ai ndërroi vendin e varrezës mbretërore. Argeu, i cili sundoi me butësi dhe gëzonte dashurinë e popullit, la si pasardhës Filipin, i cili përpara vdekjes së tij të parakohshme caktoi si pasardhës Aeropin që ishte akoma i mitur. Por në këtë kohë maqedonasit ishin në luftëra të pandërprera me thrakët dhe ilirët. Të kalitur në këto lufta, si në stërvitje të përditshme ushtarake, maqedonasit u kallnin frikën fqinjëve me lavdinë e trimërisë së tyre. Dhe ja tani që në Maqedoni mbret ishte një i mitur, ilirët vendosën të shfrytëzonin rastin dhe u hapën luftë maqedonasve. Pasi u mundën *[në një betejë]* ata *[maqedonasit]* morën me vete mbretin në djep, e vunë mbas rreshtave të ushtrisë dhe rifilluan luftën, duke menduar se kishin humbur, sepse kishin luftuar jo para syve të mbretit të tyre, kurse tani do të

[1)] Më vonë u quajt kështu vetëm një krahinë e Maqedonisë.
[2)] Në dorëshkrimet e tjera Pelagoni.

11 fitonin sepse besimi do ta forconte vullnetin për fitore. Në të njëjtën kohë u vinte
edhe keq për fëmijën, i cili siç u dukej atyre, për fajin e tyre do të kthehej nga mbret
12 në rob, në qoftë se ata do të mundeshin. Dhe kështu, duke e rifilluar luftën, ata i
thyen ilirët pa një përleshje të ashpër dhe u treguan armiqve se në luftën e parë,
maqedonasve, nuk u mungonte burrëria, por mbreti.

13 Pasardhësi i Aeropit ishte Amynta[1]...

6 **4**... Edhe Amynta[2] luftoi me ilirët e olynthasit.

1 **5** Në fillim të sundimit të tij Aleksandri[3] mundi të shpëtojë nga luftërat me
ilirët, pasi u mor vesh me ta për sasinë e tributit që do t'u paguante dhe si u dha peng
vëllanë e tij, Filipin[4].

1 **6** Kur /Filipi/ mori pushtetin[5], të gjithëve filluan t'u ngjallen shpresa të mëdha,
si për shkak të cilësive të tij të ralla, të cilat tregonin për një njeri të madh, ashtu
2 edhe pse një profeci e vjetër thoshte se gjatë sundimit të njërit prej bijve të Amyntës,
mbretëria maqedonase do të lulëzojë. Në fillim të sundimit të tij, këtë djalë të ri e
3 mundonin shumë mendime; vrasja kriminale e vëllezërve, armiqtë e shumtë, frika
nga intrigat dhe varfërimi i mbretërisë së cfilitur në luftërat e vazhdueshme. Popuj të
4 shumtë u sulën nga të gjitha anët dhe në të njëjtën kohë kundër Maqedonisë, sikur të
kishin bërë kundër saj një komplot. Meqenëse nuk mund t'ua dilte të gjithëve
përnjëherë, Filipi vendosi të çlirohej prej tyre veçmas; disa nga armiqtë ai i qetësoi
5 duke lidhur me ta marrëveshje, të tjerëve u dha të holla, më të dobëtit i sulmoi dhe
me këtë u dha zemër ushtarëve të demoralizuar, kurse armiqtë i detyroi të
ndryshojnë qëndrimin e tyre përbuzës ndaj tij. Para së gjithash ai luftoi me athinasit,
6 i mundi ata me dinakëri dhe megjithëse mund t'i vriste që të gjithë, nuk i preku as
nuk u mori tribut, nga frika se mos shkaktonte ndonjë luftë më të tmerrshme. Pas
kësaj Filipi u hodh në Iliri dhe vrau këtu me mijëra armiq. Prej këndej ai sulmoi
7 papritur Thesalinë, ku nuk e prisnin fare luftën dhe i sulmoi jo për të bërë plaçkë, por
8 se kishte dëshirë të madhe të bashkonte me ushtrinë e vet kalorësinë e fuqishme
9 thesale; *këtu ai mori qytetin e përmendur Larisa*[6] dhe krijoi një ushtri të bashkuar e
10 të pathyeshme me njësi këmbësorësh e kalorësie. Pasi punët i shkonin mbarë, ai u
11 martua me Olympinë, bijën e Neoptolemit, mbret të molosëve. E bëri këtë krushqi
tutori i vajzës, kushëriri i parë i saj nga babai, mbreti i molosëve Arryba, që ishte martuar
me motrën e Olympisë, Troan. Për Arrybën kjo u bë shkaku i rënies dhe i gjithë
12 fatkeqësive të tij. Arryba mendonte se në saje të krushqisë me Filipin do ta rriste shtetin e
tij, por po nga ky Filip ai humbi mbretërinë e tij dhe u plak në mërgim.

13 Pasi i pruri punët deri këtu, Filipin nuk e kënaqte më mbrojtja nga sulmet e
armiqve dhe filloi vetë të sulmojë të tjerët.

LIBRI VIII

3 **6** Pasi i rregulloi punët dhe vendosi rendin në Maqedoni, Filipi pushtoi, me anë
4 të djallëzisë dhe dinakërisë, tokat e dardanëve dhe të fiqnjëve të tjerë; por edhe
njerëzit e tij më të afërm nuk i mëshiroi; kështu ai vendosi të rrëzojë nga froni

---

[1] Fjala është për Amyntën e I, që vdiq rreth vitit 495 para e. sonë.
[2] Pas Amyntës I, në Maqedoni sunduan Aleksandri I (495-450), Perdika II (450-413) dhe Arhelau (413-399). Pas vdekjes së këtij të fundit, në Maqedoni plasën luftëra të përgjakshme për fronin, të cilat zgjatën shtatëmbëdhjetë vjet, derisa erdhi në fuqi Amynta III (382-370) për të cilin bëhet fjalë në këtë rast.
[3] I biri i Amyntes III, vëllai i Filipit II.
[4] Aleksandri II sundoi në vitet 369-365 para e. sonë.
[5] Në vitin 359 para e. sonë.
[6] Në vitin 358 para e. sonë.

mbretin e Epirit Arrybën, që kishte lidhje të ngushta farefisnie me gruan e Filipit,
5 Olympinë, kurse Aleksandrin, thjeshtrin e Arrybës, vëllanë e gruas së vet, Olympisë djalë i ri e me karakter të pastër, Filipi e thirri në Maqedoni, gjoja me kërkesën e
6 motrës së tij. Ai përdori të gjitha mjetet për ta përzier në veprimet e tij të këqija herë duke i premtuar kurorën mbretërore, herë duke iu shitur se e donte; Filipi mendonte se më vonë Aleksandri do t'i bindej plotësisht, qoftë prej turpit, qoftë i shtyrë nga ndjenja e mirënjohjes për të mirën /e premtuar/ d.m.th. pushtetin mbretëror. Prandaj,
7 kur Aleksandri mbushi njëzet vjeç, Filipi, me gjithë moshën e tij të njomë, i dha atij mbretërinë[1] që ia kishte rrëmbyer Arrybës, duke kryer kështu një krim ndaj të dyve.
8 Sepe ndaj atij që i rrëmbeu fronin ai shkeli zakonin e farefisnisë, kurse atë, të cilit i dha mbretërinë, e korruptoi para se ta bënte mbret.

LIBRI IX

1 **6** Ndërsa po mblidheshin ushtritë ndihmëse në Greqi[2], Filipi po festonte dasmën e vajzës së tij Kleopatrës me Aleksandrin, të cilin e bëri mbret të Epirit...

1 **7** Mendonin edhe se Pausania[3] qe shtyrë nga Olympia, e ëma e Aleksandrit, por edhe vetë Aleksandri, me sa duket, kishte dijeni për kurthin që po kurdisej, për
2 vrasjen e të atit, sepse Olympia vuante jo më pak nga që ishte braktisur dhe në vend të saj ishte preferuar Kleopatra, se sa Pausania nga poshtërimi që i ishte bërë.
3 Aleksandri, nga ana e tij, kishte frikë se vëllai lindur nga njerka do t'i bëhej rival; për këtë ai bile një ditë u grind gjatë pijes në fillim me Atalin dhe pastaj edhe me të
4 atin; puna arriti deri atje sa që Filipi iu lëshua mbrapa Aleksandrit me shpatë të shpërveshur dhe vetëm miqtë mezi e përmbajtën mbretin që të mos vrasë të birin.
5 Për këtë shkak Aleksandri, së bashku me të ëmën, u largua në fillim tek daja, në Epir, dhe prej këndej tek mbreti i ilirëve[4]. Me të atin, i cili e thirri të kthehej, u
6 pajtua jo me qejf dhe u kthye kundër vullnetit të tij, vetëm për të mos u a prishur farefisit të tij që e lutën shumë. Olympia nga ana e saj, e nxiste të vëllanë
7 Aleksandrin, mbretin e Epirit, në luftë kundër Filipit dhe do t'ia kishte arritur qëllimit, sikur Filipi të mos e kishte bërë Aleksanrin dhëndër, duke i dhënë të bijën. Mendonin se si njëri, si tjetra /Aleksandri dhe Olympia/ prej zemërimit e shtynë
8 Pausanien e pakënaqur, nga që ai që e kishte poshtëruar nuk po dënohej, të kryente këtë krim të shëmtuar. Olympia me sa duket, mbante të gatshëm kuajt për vrasësin,
9 në qoftë se ai do të arratisej. Kur mori vesh për vrasjen e mbretit shpejtoi në
10 varrosjen e tij, me pretekstin se kryente detyrën e fundit, por po atë natë i vuri në kokë Pausanies së kryqëzuar një kurorë të artë. Askush tjetër veç saj s'mund ta merrte këtë guxim, kur pas Filipit mbeti i biri. Pas disa ditësh, ajo e dogji trupin e
11 vrasësit mbi mbeturinat e burrit të saj dhe urdhëroi që në atë vend të ngrihej një tumë; ajo u kujdes edhe që të vdekurit t'i bëheshin flijime çdo vit, sipas zakonit të popullit. Pastaj Olympia e detyroi Kleopatrën, për shkak të së cilës Filipi u nda me
12 të, të varet, pasi i vrau, në duart e saj, të bijën. Me vrasjen e shemrës së saj ajo e shoi
13 etjen që kishte për hakmarrje, të cilën u shpejtua ta kryente me vrasjen e të shoqit. Më në

---

[1] Në vitin 342 para e. sonë.
[2] Këtë ushtri Filipi i II-të e mblidhte për fushatën që përgatiste kundër persëve.
[3] Në kapitullin më lart flitet se Pausania e vrau Filipin në kohën e dasmës, për t'u hakmarrë me vëllanë e gruas së dytë të Filipit (pas Olympisë) Atalin, i cili dikur e kishte poshtëruar keq, gjatë pijes, kurse tani Filipi atë e përkrahte pa marrë parasysh ankesat e Pausanies.
[4] Rreth vitit 338 para e. sonë.

fund ajo i kushtoi Apollonit në emrin e Myrtales, shpatën, me të cilën u vra mbreti;
14 këtë emër Olympia e mbante kur ishte e mitur. Të gjitha këto ajo i bënte kaq hapur, sikur të kishte frikë se mos krimin e kryer nuk do t'ia vishnin asaj.

LIBRI XI

1 **1** Meqenëse në ushtrinë e Filipit bënin pjesë njerëz nga popuj të ndryshëm,
2 atëherë kur ai u vra të gjithë e kuptuan atë sipas mënyrës së tyre. Ata që ishin të skllavëruar padrejtësisht filluan, sigurisht, të shpresojnë se do të fitonin lirinë, të
3 tjerët i kishte mërzitur shërbimi ushtarak dhe ishin të gëzuar se shpëtuan nga fushata
4 e Azisë, disa i kishte pikëlluar fakti se me flaksen që u ndez për dasmën e së bijës, u takoi të ndezin zjarrin e përmortshëm të të atit; kurse miqtë /e mbretit/, pas këtij
5 ndryshimi të papritur, i kapi frika e madhe. Ata herë parafytyronin Azinë e thirrur në luftë, herë Evropën akoma të panënshtruar, herë ilirët, thrakët, dardanët dhe fiset e
6 tjera barbare, besnikëria e të cilëve ishte e dyshimtë dhe që në shpirt ishin tradhëtarë; në qoftë se të gjithë këta popuj do të shkëputeshin nga Maqedonia, atëherë do të ishte e pamundur t'u bëhej ballë.

1 **9** Ndërkaq Dari doli në fushë të betejës me katërqind mijë këmbësorë dhe
2 njëqind mijë kalorës. Numri i madh i ushtrisë armike, në krahasim me ushtrinë e vogël të tij, filloi ta shqetësonte pak Aleksandrin. Por ai u kujtua, në të njëjtën kohë, se çfarë heroizmash kishte bërë me atë grusht ushtarësh dhe sa popuj kishte thyer në
3 beteja. Dhe ja kur shpresa fitoi mbi frikën, Aleksandri vendosi se ishte shumë e rrezikshme ta shtynte përleshjen, sepse ushtria mund të demoralizohej. Ai vizitoi
4 gjithë ushtrinë dhe popujve të ndryshëm iu drejtua me fjalë të ndryshme. Ilirët dhe thrakët ai i gaboi me pasuritë e mëdha /të persëve/, grekët i ndezi duke u sjellë ndërmend luftërat e mëparshme dhe urrejtjen e madhe ndaj persëve, kurse maqedonasve u kujtonte herë Evropën e nënshtruar, herë Azinë që duhej ta pushtonin, dhe i lëvdoi si ushtarë që s'e kanë shokun në botë.

LIBRI XII

4 **1** ... Aleksandrit i erdhi një letër nga Maqedonia, me të cilën Antipatri e njoftonte mbi rezultatin e luftës së mbretit Agis të Spartës në Greqi, të mbretit të Epirit Aleksandër në Itali dhe të mëkëmbësit /të Aleksandrit/ Zopyrit në Skythi. Këto lajme i ngjallën
5 Aleksandrit ndjenja të kundërta; por sidoqoftë atë e gëzoi më tepër vdekja e dy mbretërve që ishin rivalë të tij, se sa e hidhëroi humbja e ushtrive të Zopyrit.

1 **2** Aleksandri, mbreti i Epirit, u nis për në Itali i ftuar nga tarentasit, të cilët i kërkuan ndihmë kundër brutëve. Ai u hodh me kaq passion në këtë fushatë, sikur, në ndarjen e botës, fati t'i kishte caktuar Aleksandrit, birit të motrës së tij Olympisë,
2 Lindjen, kurse këtij Perëndimin, dhe shpresonte të tregonte në Itali, Afrikë dhe Siqeli jo më pak heroizma se Aleksandri në Azi e Persi. Këtu e shtyu edhe një rrethanë
3 tjetër; ashtu sikurse Aleksandrin e Madh, orakulli i Delfit e paralajmëroi që duhet t'u ruhet intrigave në Maqedoni, ashtu edhe këto /Aleksandrin e Epirit/ Zeusi i Dodonës e paralajmëroi që qyteti Pandosia dhe rryma e Aheronit janë për të fatale. Edhe ky
4 lum edhe qyteti ishin në Epir, por Aleksandri nuk e dinte se në Itali kishte një qytet dhe një lum me po këto emra dhe që t'i largohej rrezikut që i kishte paralajmëruar fati, ai edhe më me pasion e ndërmori këtë fushatë në një vend të huaj. Kur arriti në Itali, në fillim luftoi me apulët, por si mori vesh për fatin që i ishte caktuar qytetit të

tyre të parë, bëri shpejt lidhje miqësore me mbretin e tyre...

12 Ai luftoi edhe me brutët e lukanët dhe u mori shumë qytete; me banorët e Metapontit, me pedikulët dhe me romakët ai hyri në marrëdhënie miqësore dhe lidhi
13 me ta aleancë. Por brutët dhe lukanët, si morën ndihmë nga fqinjët, e rifilluan luftën
14 me një ashpërsi edhe më të madhe. Kështu mbreti edhe u vra afër qytetit Pandosia[1], tek lumi Aheron, duke marrë vesh vetëm para vdekjes emrin e vendit fatal për të; duke vdekur ai e kuptoi se vdekja nuk e kërcënonte në atdhe prej nga ai u largua.
15 Trupin e Aleksandrit e varrosën banorët e Turit, të cilët e blenë me shpenzime të shtetit.

1 **15** Kur ditën e katërt Aleksandri e ndjeu se padyshim i kishte ardhur fundi, tha se sheh në këtë /vdekje/ fatin e fisit të tij, sepse shumica e aiakidëve ka vdekur në një moshë më të vogël se tridhjet vjeç.

LIBRI XIII

13 **2** ... Fitoi mendimi i Perdikës[2] dhe me të u bashkuan edhe të tjerët. Kështu u
14 vendos të pritej lindja e Roksanës dhe në qoftë se do të ishte djalë, t'i jepeshin atij si tutorë Leonati, Perdika, Krateri dhe Antipatri; që të gjithë u betuan menjëherë se do t'u binden këtyre tutorëve.

1 **3** Ndërsa kalorësit u bashkuan me këtë vendim, këmbësorët ishin të zemëruar që nuk i thirrën të merrnin pjesë në këtë mbledhje; ata shpallën mbret Arideun, vëllanë e Aleksandrit, zgjodhën nga radhët e tyre gardën e mbretit dhe i urdhëruan atij të
2 quhet sipas emrit të të atit Filip. Kur u thanë për këtë kalorësve, ata dërguan tek këmbësorët dy komandantët e tyre, Meleagrin dhe Atalin, për t'i qetësuar...

2 **4** ... Pastaj edhe me kalorësit u arrit një marrëveshje dhe ata pranuan të njohin
3 si mbret Arideun. Një pjesë e shtetit iu caktua edhe të birit të Aleksandrit, po qe se
4 do të lindte. Të gjitha këto bisedime u zhvilluan rreth trupit të Aleksandrit, që ishte vendosur midis një salle, në mënyrë që me madhështinë e tij mbretërore të ishte, si të
5 thuash, dëshmitar i gjithë këtyre vendimeve. Kur të gjitha këto vendime u pranuan, në krye të Maqedonisë e të Greqisë u vu Antipatri; administrimi i arkës mbretërore
9 iu la Kraterit, kujdesi për lëmet, ushtrinë dhe mbretërit iu besuan Melegrit dhe Perdikës. Pastaj /Perdika/ ndau midis komandantëve kryesorë provincat, me qëllim
10 që t'i largonte rivalët dhe që ata, në të njëjtën kohë, ta quanin këtë si një dhuratë të tij. Egjiptin me një pjesë të Afrikës dhe Arabisë, i pari e mori Ptolemeu, të cilin
11 Aleksandri, për trimëri, e kishte bërë nga ushtar i thjeshtë komandant. Si ndihmës
12 për administrimin e provincave atij i dhanë Kleomenin që kishte ndërtuar
13 Aleksandrinë. Krahinën fqinje, Sirinë, e mori Laomedoni prej Mytilene, Kilikinë –
14 Filota. Iliri Pito u vu në krye të Medisë së Madhe, Artopati, vjehërri i Perdikës, në
15 krye të Medisë së Vogël. Kenit iu caktua Suziana, kurse Frygia e Madhe Antigonit,
16 birit të Filipit. Lykinë dhe Pamfilinë e mori me short Nearhu, Karinë - Kasandri, Lydinë – Menandri. Leonatit i ra Frygia e Vogël, Thrakia dhe krahinat e bregut të
17 Detit të Zi – Lysimahut, Kapadokia me Paflagoninë – Eumenit. Kryekomandant i lëmeve u bë Seleuku, i biri i Antiohut. Në krye të gardës mbretërore u vu Kasandri, i
18 biri i Antipatrit...

---

[1] Rreth viteve 331-330 para e. sonë.

[2] Është fjala për grindjet që filluan pas vdekjes së Aleksandrit midis pasonjësve të tij për fronin.

8 **5** ... Gjendja shqetësuese në Maqedoni e detyroi Kasandrin të kthehet nga
9 Greqia në atdhe. Puna ishte se kur e ëma e Aleksandrit, Olympia, u nis për në
Maqedoni e shoqëruar nga Aiakidi, mbreti i molosëve, Eurydika[1] dhe mbreti
10 Adrideu u munduan ta pengojnë të hyjë në Maqedoni. Por maqedonasit kaluan në
anën e saj, qoftë për nderim të kujtimit të burrit të saj dhe madhështisë së të birit,
qoftë të zemëruar nga sjellja e keqe /e Eurydikës dhe Arideut/; atëherë, me urdhër të
Olympisë, Eurydika dhe vetë mbreti, që kishte sunduar për gjashtë vjet pas vdekjes
së Aleksandrit, u vranë.

1 **6** Por Olympia nuk sundoi gjatë. Sepse ajo, duke vepruar jo si një sunduese /e
arsyeshme/, por si grua /hakmarrëse/, dënoi gjithë njerëzit e shquar të shtetit, njërin
pas tjetrit dhe gjithë simpatinë që gëzonte e ktheu në urrejtje. Prandaj, kur dëgjoi për
2 afrimin e Kasandrit, meqenëse nuk u besonte maqedonasve u largua bashkë me të
renë e djalit Roksanën dhe nipin, Herkulin, për në Pydna. Në këtë rrugë atë e ndoqi
3 Deidamea, e bija e mbretit Aiakid dhe thjeshtra Thesalonika, që ishte bërë e njohur
në saje të të atit të saj, Filipit, si edhe shumë gra të parisë – një suitë më tepër e
shkëlqyer se sa e dobishme. Kur ky lajm arriti tek Kasandri, ai shpejtoi menjëherë në
4 Pydna dhe e rrethoi qytetin. E lodhur nga rrethimi i gjatë, uria dhe sulmet armike,
5 Olympia iu dorëzua fituesit, duke i kërkuar t'i falte jetën. Por Kasandri mblodhi
6 popullin me qëllim që të sqaronte se çfarë vendimi ishte i prirur të merrte ai ndaj
Olympisë, kurse vetë shtyri farefisin e atyre që kishte dënuar Olympia, që të vishen
me rrobe zije dhe të ankohen për ashpërsinë e saj. Maqedonasit të zemëruar, pa
7 nderim ndaj madhështisë së dikurshme, e dënuan me vdekje, duke harruar kështu se
8 në saje të birit dhe të burrit të saj ata jo vetëm kishin jetuar të sigurtë nga fqinjët e
tyre, por kishin fituar pasuri të madhe dhe sundimin mbi gjithë botën. Kur Olympia e
9 pa se drejt saj po vinin ushtarët e armatosur, ajo vetë u doli përpara e veshur me
rroben mbretërore dhe e mbështetur tek dy shërbyeset. Vrasësit, kur e panë, të
10 mahnitur prj fatit të madhështisë së dikurshme, pasi shkuan nëpër mend emrat e kaq
11 mbretërve të tyre, u ndalën, gjersa Kasandri dërgoi të tjerë, të cilët edhe e vranë. Ajo
nuk iu largua shpatës dhe nuk lëshoi klithmën, siç bëjnë zakonisht gratë, por vdiq si
vdesin burrat trima, duke ruajtur me dinjitet lavdinë e fisit të saj të vjetër, kështu që
dukej sikur të ishte vetë Aleksandri në personin e së ëmës, që ishte duke vdekur.
12 Përveç kësaj, thonë se, duke dhënë shpirt, ajo rregulloi flokët dhe mbuloi këmbët me
veshjen, në mënyrë që trupi i saj edhe i vdekur të kishte pamje të denjë[2].

Pas kësaj, Kasandri u martua me bijën e Arideut, Thesalonikën, kurse të birin e
13 Aleksandrit, bashkë me të ëmën e çoi në kështjellën e Amfilopolit për ta mbajtur nën
vërejtje.

LIBRI XV

1 **2** Ndërsa po ndodhnin këto[3] Kasandri, duke u kthyer nga Apollonia, ndeshi në
fisin e audariatëve[4], të cilët kërkonin toka të reja për t'u vendosur, pasi kishin lënë
2 tokat e tyre, ku kishin dalë shumë bretkosa e minj. Nga frika se mos audariatët
pushtonin Maqedoninë, Kasandri, pasi përfundoi me ta një marrëveshje, i pranoi si

---

[1] E shoqja e Arideut.
[2] Në vitin 316 para e. sonë.
[3] Autori ka parasysh grindjen që lindi në këtë kohë midis Antigonit, në një anë, dhe Kasandrit, Ptolemeut, Lysimahut dhe Seleukut, të lidhur së bashku, më anën tjetër, si edhe ndeshjen e parë midis Ptolemeut e Demetrit, birit të Antigonit.
[4] Autariatët.

besëlidhës dhe u dha për të banuar krahinat më të largëta të shtetit maqedonas[1].

LIBRI XVI

1 **2** Dhe kështu, kur Demetri kishte në dorë forcat e gjithë shtetit maqedonas dhe vendosi të pushtojë Azinë, Ptolemeu, Seleuku dhe Lysimahu, duke kuptuar nga përvoja e luftës së mëparshme se ç'forcë përbën bashkimi, u lidhën prapë me aleancë, bashkuan forcat e tyre ushtarake dhe e shpërngulën luftën në Evropë. Me ta
2 u bashkua si shok dhe aleat lufte, Pirrua, mbret i Epirit, i cili shpresonte se Demetri do ta humbiste Maqedoninë me po aq lehtësi sa edhe e fitoi. Dhe kjo shpresë nuk
3 ishte e kotë; Pirrua e asgjësoi ushtrinë e Demetrit, atë e detyroi të ikë, kurse vetë zuri
4 mbretërinë e Maqedonisë. Ndërsa po ndodhnin këto, Lysimahu vrau dhëndërin e tij Antipatrin, i cili e akuzonte vjehërrin se në saj të dinakërisë së tij, ai kishte humbur fronin mbretëror të Maqedonisë. Vajzën e tij Eurydikën, që i mbështeste këto akuza, Lysimahu e burgosi...

1 **3** Por ja, midis Lysimahut dhe mbretit Pirro, të cilët pak më parë vepruan si aleatë kundër Demetrit, filluan grindjet, një e keqe e zakonshme midis dy barbarëve,
2 dhe plasi lufta. Lysimahu e mundi Pirron dhe pushtoi Maqedoninë...

LIBRI XVII

11 **2** Ptolemeu nuk e la pa i kushtuar vëmendje edhe Pirros, mbretit të Epirit, i cili mund t'i jepte një ndihmë të madhe palës me të cilën do të bashkohej; kurse ky
12 mbret, duke dashur që të grabiste secilin prej tyre, u ofronte të gjithëve shërbimet e
13 tij. Kështu, duke dashur të ndihmonte tarentasit kundër romakëve, i kërkoi hua Antigonit tridhjetë anije për të transportuar ushtrinë në Itali; Antiohut që kishte më shumë para se ushtri, ai i kërkoi para; Ptolemeut – njësi ndihmëse maqedonase.
14 Ptolemeu, duke ndjerë dobësinë e vet, nuk mundi t'i kundërshtojë Pirros dhe i dha pesë mijë këmbësorë, katër mijë kalorës dhe pesëdhjetë elefantë, me një afat jo më të gjatë se dy vjet. Për këtë Pirrua mori për grua të bijën e Ptolemeut dhe, pasi bëri
15 paqe me të gjitha fiset fqinje, la vjehërrin si ruajtës të shtetit të tij, në mënyrë që ai të mos bëhej pre e armiqve, sepse gjithë burrat e moshës më të mirë ishin dërguar në Itali.

1 **3** Por meqenëse u përmend këtu Epiri, duhet treguar diçka mbi prejardhjen e
2 kësaj mbretërie. Si mbretëri e parë në atë krahinë qe ajo e molosve. Pastaj Pirrua, i
3 biri i Akilit, pasi kishte humbur mbretërinë e trashëguar nga i ati, për shkak të mungesës së gjatë në kohën e luftës së Trojës, u vendos në këto vende, banorët e të cilave u quajtën në fillim pirridë pastaj epirotë. Më vonë, kur Pirrua erdhi për të
4 pyetur orakullin në tempullin e Dodonës, rrëmbeu këtu Lanasën, të bijën e Herkulit.
5 Nga kjo martesë ai pati tetë fëmijë. Nga këta, disa vajza i martoi me mbretërit kufitarë dhe me ndihmën e këtyre krushqive arriti të forcohet shumë. Edhe Helenit,
6 birit të mbretit Priam, për merita të veçanta i dha mbretërinë e kaonëve dhe për grua Andromakën, të venë e Hektorit, të cilën e kishte marrë për vete kur ishte ndarë plaçka e Trojës.

---

[1] Pushtimi i Apollonisë nga Kasandri dhe vendosja prej tij e fisit ilir të autariatëve në kufirin maqedonothrak ndodhën, sipas Diodorit (XIX 67, 6; XX 19,1), në kohë të ndryshme (në vitet 314 dhe 310 para e. sonë). Për sulmin e bretkosave shih Diodor. III 30,3; Appian. Illyr. 4.

7 Pas pak kohe Pirrua u vra nga Oresti, i biri i Agamemnonit, në Delf, në mes të
8 altarëve të perëndisë. Pas tij erdhi i biri, Piali. Pastaj, sipas radhës, mbretëria zbriti
9 gjer te Tarypa dhe meqenëse nga kjo familje fisnike ky kishte mbetur i vetmi pinjoll,
10 me kujdesin më të madh të gjithëve, u caktuan për të kujdestarë për ta rritur dhe
11 për ta edukuar me shpenzime publike. E dërguan edhe në Athinë për studime. Sa që i
ditur më shumë se të parët e tij, aq edhe populli e pati për zemër. Ai që i pari që
12 rregulloi ligjet, kuvendin e magjistratët e përvitshëm dhe formën e qeverisjes.
13 Kështu që nga Pirrua ata fituan vendin për të banuar, kurse me Tarypën populli fitoi
një jetë më të ngritur. Djali i tij që Neoptolemi, prej të cilit lindi Olympia, e ëma e
14 Aleksandrit të Madh dhe Aleksandri që sundoi mbi mbretërinë e Epirit pas
15 Neoptolemit dhe që vdiq duke luftuar në Itali në krahinën e brutëve. Pas vdekjes
16 së tij fronin e trashëgoi i vëllai, Aiakidi, i cili me përleshje të parreshtura e në
luftë kundër maqedonasve, e lodhi popullin dhe meritoi përbuzjen e qytetarëve;
17 për këtë arsye u hodh në mërgim dhe la në mbretëri djalin e vetëm të tij, Pirron e
vogël dyvjeçar. Meqë populli, nga urrejtja kundrejt të atit kërkonte vdekjen e tij,
18 atëherë këtë e morën fshehurazi dhe e shpunë tek ilirët e ia dorëzuan Berojës,
19 bashkëshortes së mbretit Glaukia, për ta mbajtur, se edhe ajo ishte nga familja e
aiakidëve. Atje mbreti, për mëshirë të fatit të djalit, apo i tërhequr nga
20 përkëdheljet fëminore, e mbrojti për shumë kohë nga Kasandri, mbreti i
Maqedonisë, i cili e kërkonte duke e kërcënuar edhe me luftë; përveç kësaj,
21 Glaukia e ndihmoi Pirron edhe duke e bërë bir në shpirt. Epirotët, të prekur në
zemër nga këto gjëra, e kthyen urrejtjen në mëshirë dhe atë djalë, në moshën
22 njëmbëdhjetë vjeçare, e ftuan rishtazi në mbretëri dhe i vunë kujdestarë, që të
qeverisnin, gjersa ai të vinte në moshë. Pastaj ai, që në moshë të re, bëri shumë
luftëra dhe aq shumë zuri të çmohej kur i shkuan punët mbarë, sa që e pa se edhe i
vetëm mund t'i mbronte tarentasit kundër romakëve.

LIBRI XVIII

1 **1** Pirrua, mbreti i Epirit, të cilin e mbuluan me lutjet e tyre tarentasit, duke dërguar për së
dyti delegatë së bashku me samnitët dhe lukanët, që kishin gjithashtu nevojë për ndihmën
e tij kundër romakëve, u premtoi se do t'u shkonte me ushtrinë /e tij në ndihmë/. E
shtynin atë në këto punë jo aq lutjet e tyre për ndihmë, sa shpresa për të sunduar mbi
Italinë; dhe sapo i lindi ky mendim, shpirtin e tij të pamposhtur filloi ta brejë dëshira për
2 të imituar paraardhësit e tij ai nuk donte që të dukej më i ulët se xhaxhai i tij Aleksandri, i
cili kishte qenë mbrojtës i po atyre tarentasve kundër brutëve, ose të mbetej prapa nga
burëria, në krahasim me Aleksandrin e Madh, i cili duke u larguar kaq shumë nga
atdheu, pushtoi Lindjen. Për të ruajtur shtetin, ai la të birin e tij pesëmbëdhjetë vjeçar,
3 Ptolemeun; dy bijtë më të vegjël, Aleksandrin dhe Helenin, që të mos i merrte malli gjatë
kësaj fushate të gjatë /që do të bënte/, i mori me vete, zbarkoi me ushtrinë e tij në portin
e Tarentit. Kur mori vesh për ardhjen e Pirros, konsuli romak Valer Levini u nis me të
shpejtë me ushtrinë e tij që të përleshej me Pirron, para se atij t'i vinin përforcime nga
4 aleatët. Por edhe mbreti, megjithëse kishte një ushtri më të vogël nga numri, nuk e shtyu
fillimin e betejës. Romakët ishin gati duke fituar, por elefantët që nuk i kishin parë kurrë
ndonjëherë, në fillim i tmerruan dhe pastaj i bënë të tërhiqen. Kështu ata që pothuajse
kishin fituar, u mundën nga përbindëshat e panjohur maqedonas. Por edhe për armikun
fitorja s'qe pa dëme: Pirrua vetë u plagos, pjesa më e madhe e ushtrisë së tij u vra, kurse
nga fitorja e tij Pirrua pati më tepër lavdi, se gëzim. Prej përfundimit të kësaj lufte

shumë fise kaluan në anën e Pirros. Midis të tjerëve u shkëputën /nga romakët/ edhe lokridasit të cilët e tradhtuan garnizonin romak. Prej plaçkës së kapur Pirrua liroi pa shpërblim dyqind robër, me qëllim që romakët, të cilët kishin njohur trimërinë e tij, të mësonin edhe për shpirtmadhësinë e tij. Pas disa ditësh, kur me Pirron u bashkuan edhe njësitë e aleatëve, ai u përlesh prapë me romakët dhe në këtë betejë fati i buzëqeshi, po ashtu si në të parën.

2 Ndërkaq, para senatit romak u paraqit strategu kartagas Magon, i dërguar me njëqind e njëzet anije në ndihmë të romakëve dhe filloi t'i bindë ata se kartagasit janë gjoja shumë të hidhëruar që Italia vuan nga lufta me një mbret të huaj; prandaj e dërguan atë me qëllim që romakëve t'u vijë në ndihmë ushtria e tyre, meqenëse ata i kishte goditur një armik i jashtëm. Senati u shprehu kartagasve falënderimet, por ndihmën e tyre nuk e pranoi. Por Magoni, me dinakërinë kartagase, pas pak kohësh shkoi fshehtas tek Pirrua, nën maskën e ndërmjetësit paqësor kartagas, me qëllim që të zbulonte planet e tij ndaj Siqelisë, ku siç kishte dëgjuar ai, Pirron e kishin thirrur. Sepse shkaku i vërtetë për dërgimin e ndihmës romakëve ishte dëshira e kartagasve për ta mbajtur Pirron në luftë me Romën, në Itali, në mënyrë që ai të mos kishte mundësi të hidhej në Siqeli. Ndërsa po ndodhnin këto, delegati i dërguar nga senati i Romës, Fabric Luscini, u mor vesh me Pirron për paqe. Për ta konfirmuar këtë, Pirrua dërgoi në Romë Kinean me dhurata të mëdha, por Kinea nuk gjeti asnjeri që t'i pranonte këto dhurata. Pothuajse në këtë kohë ndodhi edhe një shembull tjetër i tillë. Delegatët e dërguar nga senati në Egjipt nuk pranuan dhuratat e çmueshme që u dërgoi atyre mbreti Ptoleme, dhe kur pas disa ditësh i thirrën në gosti, kurorat e arta që u kishin dërguar i pranuan si dhurata nderi, por të nesërmen ua vunë në kokë shtatoreve të mbretit.

Prandaj, kur Kinea i njoftoi Pirros se përfundimin e paqes me romakët e pengoi Ap Klaudi, i pyetur nga mbreti: "Po Roma si ishte?" – u përgjigj: "Pashë qytetin e mbretërve". Pas kësaj tek Pirrua erdhën delegatë nga Siqelia, që t'i dorëzojnë atij pushtetin mbi gjithë ishullin, i cili po vuante nga luftërat e vazhdueshme me kartagasit. Për këtë arsye Pirrua, pasi la tek lokridasit birin e tij, Aleksandrin, dhe si i siguroi qytetet aleate me garnizone të forta, e hodhi ushtrinë në Siqeli.

LIBRI XXIII

3 Po në këtë kohë Pirrua luftonte kundër romakëve. Kur sikulët, sikurse thamë më sipër, i kërkuan ndihmë, ai erdhi në Syrakuzë dhe u quajt mbret i Siqelisë dhe Epirit. I gëzuar nga ky sukses, ai ia caktoi mbretërinë e Siqelisë birit të tij Helenit, si trashëgim nga gjyshi (sepse Helenin e kishte nga e bija e mbretit Agathokl), kurse mbretërinë e Italisë, Aleksandrit[1]. Pas kësaj ai bëri shumë luftëra me sukses kundër kartagasve. Si kaloi një kohë, tek Pirua erdhën delegatë nga aleatët e tij italikë me lajmin se ata nuk munden t'u qëndrojnë më romakëve dhe në qoftë se ai nuk arrin t'u vijë në ndihmë, do të dorëzohen. Pirrua u shqetësua nga rreziku që e kërcënonte nga të dy anët. Ai nuk dinte ç'të bënte dhe kujt t'i ndihmonte më parë, por lëkundej dhe nuk dinte çfarë vendimi të merrte, duke anuar herë nga një vendim, herë nga tjetri; meqenëse nga një anë e kërcënonin kartagasit, kurse nga ana tjetër romakët, i dukej se po të mos dërgonte ushtri në Itali ishte rrezik, kurse po të largonte ushtrinë nga Siqelia ishte edhe më rrezik; të mos u ndihmonte aleatëve do të thoshte t'i humbiste

[1] Djali tjetër i Pirros.

ata, kurse të braktiste Siqelinë do të thoshte ta humbte atë. Në këtë furtunë rreziqesh
8 Pirros iu duk se më i sigurtë do të ishte ky vendim; të vinte në veprim të gjitha forcat
e veta në Siqeli dhe, pasi të shkatërronte kargatasit, të transferonte ushtrinë fitimtare
9 në Itali. Dhe kështu Pirrua u përlesh me kargatasit dhe i mundi ata; por meqenëse
/pas kësaj/ ai u largua nga Siqelia, u duk sikur u mund dhe u dëbua; prandaj aleatët
10 u shkëputën prej tij dhe ai e humbi pushtetin mbi Siqelinë po aq shpejt sa edhe e
11 kishte fituar. Në Itali ai nuk pati fat më të mirë dhe u kthye në Epir. Të dy rastet
mund të shërbejnë si një shembull për t'u admiruar. Në fillim fati e ndihmoi Pirron
12 dhe në mënyrë krejt të papritur i dha pushtetin mbi Italinë e Siqelinë dhe një sërë
fitoresh mbi romakët, kurse pastaj, sikur të donte të tregonte se sa delikat është fati i
njeriut, u kthye /kundër tij/ dhe i shkatërroi të gjitha ato që kishte arritur, duke i
shtuar katastrofës së Siqelisë shkatërrimin e anijeve në det, turpin e luftës pa sukses
kundër romakëve dhe tërheqjen e turpshme nga Italia.

LIBRI XXIV

1 **4** Galët u shtuan kaq shumë sa që nuk i nxinte më toka ku kishin lindur. Sipas
zakonit të "pranverës së shenjtë" ata dërguan treqind mijë vetë për të kërkuar vende
2 të reja për t'u vendosur. Një pjesë prej këtyre trenqind mijëve u ngul në Itali; ata
edhe e dogjën kryeqytetin romak. Pjesa tjetër hyri në gjirin ilirik, duke ndjekur
3 fluturimin e zogjve, (sepse galët janë më të zotët se gjithë të tjerët për të paraparë
fatin me anën e fluturimit të zogjve) dhe pasi përshkuan tokat e fiseve barbare, u
vendosën në Panoni. Ata janë një popull i ashpër, trim dhe luftëtar. Pasi nënshtruan
4 banorët e Panonisë, ata për shumë vjet me radhë luftuan kundër fqinjëve. Pastaj,
5 duke marrë guxim nga sukseset e tyre, u ndanë në grupe. Një pjesë sulmoi Greqinë,
6 të tjerët Maqedoninë të cilën e shkatërruan me armët e tyre. Emri i galëve kalli kaq
tmerr sa që edhe ata mbretër që nuk ishin sulmuar akoma e blenin paqen me shuma
7 të mëdha të hollash. Vetëm mbreti i Maqedonisë, Ptolemeu, e priti i çkujdesur lajmin
8 e afrimit të galëve... Ai u soll me përbuzje ndaj propozimeve të dardanëve, të cilët i
9 çuan fjalë me anë të delegatëve, se mund t'i jepnin njëzet mijë luftëtarë në ndihmë
dhe ai në mënyrë fyese u tha se kjo është punë e Maqedonisë; maqedonasit /shtoi ai/
që nënshtruan gjithë Lindjen, nuk kanë nevojë që dardanët t'u mbrojnë kufijtë e tyre.
10 Ushtarët e tij janë bijtë e atyre që me Aleksandrin pushtuan botën dhe i bënë të gjithë
11 tributarë të tyre. Kur ia thanë këto fjalë mbretit të dardanëve, ai u përgjigj se së
shpejti mbretëria e lavdishme maqedonase do të bjerë nga papjekuria e një të riu të
prapë.

5 **5** ... Pas disa ditësh u bë lufta. Maqedonasit u mundën e u shpartalluan. Ptolemeu, i
6 mbuluar në gjak, ra rob... Kur ky lajm u përhap, në gjithë Maqedoninë filluan të
8 mbyllin portat e qyteteve; kudo ndiheshin vajtime; në një anë qanin bijtë e vrarë, në
anën tjetër kishin frikë nga shkatërrimi i qyteteve... Por kur të gjithë ishin në
12 dëshpërim, vetëm njëri nga prijësit maqedon Sostheni... mblodhi të rinjtë, frenoi
galët e harbuar nga fitimet dhe mbrojti Maqedoninë nga armiqtë.

LIBRI XXV

1 **3** Ndërsa po ndodhnin këto në Azi[1)], Pirrua dështoi në Siqeli në një betejë detare me
2 kartagasit dhe, nëpërmjet delegatëve, i kërkoi Antigonit, mbretit të Maqedonisë,

[1)] Dyndja e galëve në Azinë e Vogël, në vitin 276 para e. sonë.

përforcime, duke e kërcënuar se në qoftë se nuk do t'i dërgonte, atëherë Pirrua do të detyrohej të kthehej dhe do ta zgjeronte mbretërinë e tij në kurriz të Antigonit, gjë që
3 më parë donte ta bënte me romakët. Kur delegatët u kthyen dhe i prunë përgjigje
4 negative, Pirrua, nën pretekste të ndryshme, u largua me të shpejtë nga Siqelia. Ndërkaq ai i urdhëroi aleatët e tij të përgatiteshin për luftë. Mbrojtjen e fortesës në
5 Tarent ia besoi të birit, Helenit dhe mikut të tij Milonit. Me t'u kthyer në Epir[1] sulmoi Maqedoninë. Antigoni i doli me ushtri përpara, por u thye dhe iku në
6 rrëmujë. Kështu Pirrua zuri Maqedoninë, e cila iu dorëzua, dhe me këtë zëvendësoi humbjet që pësoi në Siqeli e Itali. Ai thirri edhe djalin e mikun që kishte lënë në
7 Tarent. Kurse Antigoni me një njësi të vogël kalorësish, që e shoqëronin në tërheqje, pasi kishte humbur papritur të gjitha dhuratat e fatit, shkoi në Thesalonik me qëllim që të vëzhgonte që këndej, se si do të zhvilloheshin ngjarjet në mbretërinë e humbur
8 dhe të rifillonte luftën me ndihmën e një ushtrie të mbledhur rishtas prej merenarësh galë. I thyer përsëri keqas nga i biri i Pirros, Ptolemeu, Antigoni, pas disfatës iku bashkë me shtatë shoqërues, pa ushqyer më shpresa për të rifituar mbretërinë e tij, duke kërkuar strehë që të fshihte kokën, si një i arratisur i vetmuar.

1 **4** Kurse Pirros, pushteti i të cilit ishte rritur kaq shumë, pa u kënaqur me atë që i kishte caktuar fati, iu ngrit mendja të pushtonte Greqinë dhe Azinë. Dhe ai nuk dehej
2 më pak nga lufta, se sa nga pushteti, dhe askush prej atyre që ai sulmonte nuk ishte
3 në gjendje t'i qëndronte Pirros. Por aq sa ishte i pathyeshëm, kur i mundte mbretëritë, po aq shpejt i humbiste ato që kishte fituar; ai kujdesej më shumë për të marrë pushtetin, se sa për ta mbajtur atë. Dhe ja, kur Pirrua i shpuri ushtritë e tij në
4 Peloponez, atë e pritën delegacionet e athinasve, ahejve, mesenasve; dhe gjithë
5 Greqia priste ardhjen e tij, me një admirim të thellë ndaj emrit dhe heroizmave që ai kishte bërë kundër romakëve dhe kartagasve. Veprimet e para ushtarake i drejtoi
6 kundër spartanëve. Këtu e pritën me një triměri më të madhe gratë, se sa burrat dhe ai humbi të birin e tij Ptolemeun, bashkë me pjesën më të fortë të ushtrisë. Kur Pirrua filloi rrethimin e qytetit, për mbrojtjen e atdheut u mblodhën aq shumë gra,
7 saqë ai u detyrua të tërhiqej, jo pse u mund, por prej turpit. Pastaj, thonë se i biri i
8 Pirros, Ptolemeu, ishte kaq i rrëmbyer sa që qytetin Korkyra e mori me gjashtëdhjetë ushtarë; po ky, në një luftë detare, u hodh nga një varkë në një anije me pesë sërë lopatash vetëm me shtatë ushtarë dhe e kapi këtë anije. Në kohën e sulmit kundër spartanëve ai u fut me kalin e tij në mes të qytetit dhe u vra nga turma që u grumbullua atje. Kur trupin e tij ia prunë të atit, thonë se Pirrua tha që Ptolemeu vdiq më vonë se ç'kishte frikë ai dhe më vonë se sa pritej, po të gjykojmë nga triměria e ti e papërmbajtur.

1 **5** Pirrua i zmbrapsur nga spartanët iu sul Argos. Këtu, duke u munduar të kapte Antigonin, që ishte mbyllur në qytet, ra i goditur nga një gur që ia hodhën nga muri, kur po luftonte aty ku përleshja ishte ndezur më shumë. Kokën e tij ia prunë
2 Antigonit, i cili e shfrytëzoi fitoren në mënyrë shumë të matur; të birin e Pirros, Helenin, që iu dorëzua së bashku me epirotët, ai e lejoi të kthehet në mbretërinë e tij dhe i dha me vete eshtrat e të atit që t'i çonte në atdhe. Të gjithë shkrimtarët janë
3 thuajse njëzëri të mendimit se asnjë mbret, qoftë nga bashkëkohësit e Pirros, qoftë nga ata që kanë jetuar më përpara, nuk mund të krahasohet me të; rrallë mund të
4 shihej, jo vetëm midis mbretërve, por edhe midis burrave të shquar, një njeri kaq pa

[1] Në vitin 275 para e. sonë.

të meta dhe kaq i drejtë. Aq mirë e njihte ai artin ushtarak saqë, duke luftuar me
5 Lysimahun, Demetrin, Antigonin, me këta mbretër të mëdhenj, ai dilte gjithmonë
fitues, kurse në luftërat me ilirët, sikulët, romakët dhe kartagasit ai kurrë nuk u
6 mund, por në pjesën më të madhe doli fitues. Atdheun e tij, një vend të vobektë dhe
të padëgjuar, ai me lavdinë e heroizmave të tij dhe me shkëlqimin e emrit të tij, e
bëri me të vërtetë të përmendur në të gjithë botën.

LIBRI XXVI

9 **2** Por në kohën kur Antigoni ishte i zënë me këtë luftë[1], mbreti i Epirit
Aleksandri, duke dashur të hakmerret për të atin e tij, Pirron, filloi të shkretonte
10 krahinat maqedonase. Kur Antigoni u kthye nga Greqia dhe filloi luftën kundër
Aleksandrit, ushtarët e Antigonit kaluan në anën e armiqve dhe, së bashku me
11 ushtrinë, ai humbi edhe mbretërinë maqedonase. I biri i tij Demetri, akoma i mitur,
në mungesë të të atit mblodhi përsëri ushtri dhe jo vetëm rifitoi Maqedoninë, por i
12 mori Aleksandrit dhe mbretërinë e Epirit. Kaq e madhe ishte paqëndrueshmëria e
ushtarëve apo e fatit, sa që mbretërit aty i shihje të dëbuar e aty prapë mbretër. **3**
1 Kështu Aleksandri që u arratis në Akarnani u kthye përsëri në mbretëri *[*i ndihmuar*]*,
jo më pak nga dëshira e epirotëve, se sa nga ndihma e aleatëve.

LIBRI XXVIII

1 **1** Kur Olympia, e bija e Pirros, mbretit të Epirit, humbi burrin e saj,
Aleksandrin[2], i cili në të njëjtën kohë ishte edhe vëllai i saj, ajo u bë tutore mbi dy
bijtë që kishte prej tij, Pirron dhe Ptolemeun dhe mori përsipër drejtimin e shtetit. Në
këtë kohë etolët donin të merrnin një pjesë të Akarnanisë, të cilën i ati i fëmijëve e
kishte marrë më parë si pjesë të plaçkës së luftës[3]. Olympia iu drejtua për ndihmë
2 mbretit të Maqedonisë Demetrit[4]. Demetri kishte për grua motrën e Antiohut,
mbretit të Sirisë, por Olympia i dha atij për grua të bijën Ftian, që me anë të
krushqisë të merrte nga Demetri, për keqardhje, atë ndihmë që ai nuk kishte mundur
ta merrte më parë...

Akarnanët nga ana e tyre, duke mos pasur besim tek epirotët, kërkuan kundër
etolëve ndihmën e romakëve. Ata arritën ta bindin senatin romak që të dërgonte
6 delegatë për t'u thënë etolëve që të largojnë garnizonet e tyre nga qytetet e
Akarnanisë dhe t'i lënë të lirë ata, të cilët qenë të vetmit që nuk u dhanë ndihmë
grekëve kundër trojanëve, prej nga rrjedhin romakët.

14 **2** Ata *[*etolët*]* i kthyen mbrapsht delegatët romakë... dhe filluan të shkretojnë
tokat e Epirit dhe të Akarnanisë.

1 **3** Në këtë kohë Olympia ua kaloi drejtimin e punëve të shtetit të bijve; vëllanë
2 që vdiq, Pirron, e pasoi në fron Ptolemeu. Në krye të një ushtrie të armatosur mirë, ai
luftoi kundër armiqve, por i goditur nga një sëmundje, vdiq në kohën e fushatës[5].
3 Edhe Olympia, e pikëlluar në shpirt nga dy vdekje, jetoi e mjeruar vetëm pak
4 kohë pas vdekjes së të bijve. Prej gjithë fisit mbretëror mbetën vetëm dy vajza

---

[1] Me luftën kundër athinasve, Antigoni luftoi për të vendosur hegjemoninë në Greqi gjatë viteve 270-263 para e. sonë.

[2] Është fjala për Aleksandrin II që vdiq në vitin 255 para e. sonë.

[3] Aleksandri mori pjesë bashkë me etolët në luftën kundër Akarnanisë. Si rezultat i fitores atij i ra Akarnania Perëndimore, kurse etolëve, ajo Lindore.

[4] Demetri II, i biri i Antigon Gonatës, sundoi në vitet 239-229 para e. sonë, prandaj ose ngjarja ka ndodhur pas vitit 239 para e. sonë, ose Demetri nuk ishte akoma mbret kur iu drejtua Olympia për ndihmë.

[5] Ptolemeu vdiq në vitin 231 para e. sonë.

– Nereida me motrën e saj Laodamenë[1]. Nereida u martua me Gelonin, birin e tiranit
5 të Siqelisë, kurse Laodamea u vra nga populli tek altari i Dianës ku kishte vajtur për
6 të shpëtuar. Perënditë e pavdekshme u hakmorën për këtë krim; fatkeqësi të
njëpasnjëshme ranë mbi popullin /e Epirit/ dhe ai pothuajse u shfaros krejt; ata
7 /epirotët/ vuajtën nga thatësira dhe uria, i brejtën grindjet e brendshme dhe, më në
fund, thuajse u vranë krejt ndër luftërat me armiqtë e jashtëm. Kurse Miloni, vrasësi
8 i Laodamesë, u bë si i çmendur dhe duke torturuar trupin e tij me hekur, me gurë dhe
më në fund me dhëmbë, vdiq pas dymbëdhjetë ditësh.
Ndërkaq vdiq mbreti i Maqeodnisë Demetri, i cili la mbrapa një djalë të mitur,
9 Filipin[2]. Si tutor atij iu caktua Antigoni[3]. Si u martua me të ëmën e fëmijës jetim, ai
10 filloi të synonte për të marrë pushtetin mbretëror. Pas disa kohësh, kur ndodhi një
11 kryengritje e madhe dhe Antigoni u rrethua në pallat nga kryengritësit, ai doli pa
besnikët e tij në popull dhe si hodhi para turmës diademën dhe veshjen e purpurt,
kërkoi që populli t'ia jepte ato një tjetri, i cili nuk do t'i urdhëronte për asgjë, ose
njërit të cilit mund t'i bindeshin. Kurse ai, nga ky pushtet i urryer mbretëror, nuk
12 gjente ndonjë kënaqësi, por kishte vetëm mundime e rreziqe. Pastaj u kujtoi të mirat
13 që kishte bërë dhe se si kishte nënshtruar aleatët që ishin shkëputur, si qetësoi
14 dardanët e thesalët, të cilët u gëzuan nga vdekja e Demetrit, se si ai jo vetëm mbrojti
dinjitetin e maqedonëve, por e ngriti këtë edhe më lart. Në qoftë se ata nuk ishin të
15 kënaqur prej gjithë këtyre, ai jepte dorëheqjen, sepse me sa duket, ata kërkonin një
mbret, mbi të cilin do të mund të sundonin /dhe jo t'i sundonte/. Kur populli i
16 turpëruar vendosi që Antigoni ta merrte prapë pushtetin, ai kundërshtoi derisa i
dorëzuan shkaktarët e kryengritjes, për t'i dënuar.

LIBRI XXIX

10 **1** Filipin[4] e shqetësonin gjithnjë me sulmet e tyre dardanët dhe gjithë popujt e
tjerë fqinjë; midis këtyre /popujve/ dhe mbretërve maqedonas ekzistonte, si të
11 thuash, një urrejtje e pashuar, kurse Filipin ata /përveç kësaj/ e përbuznin për
moshën e tij të re. Por Filipi pasi i dëboi armiqtë, nuk u mjaftua vetëm me mbrojtjen
e tokës së vet por përpiqej të fillonte luftën me etolët.

1 **2** Ndërsa Filipi po mendonte për këtë luftë, tek ai erdhi dhe filloi t'i lutej mbreti
i ilirëve Demetri[5], i cili pak kohë më parë kishte pësuar disfatë nga konsulli romak
2 Pauli. Demetri iu ankua për padrejtësitë e romakëe të cilët nuk kënaqeshin me Italinë
por, të pushtuar nga një shpresë e paturpshme për të zotëruar gjithë botën, luftonin
3 kundër të gjithë mbretërve. Kështu, pasi vendosën me çdo kusht sundimin mbi
Siqelinë, Sardinien, Spanjën, më në fund mbi gjithë Afrikën, ata filluan luftën me
4 punët[6] dhe Hanibalin. Edhe atë /Demetrin/ romakët e sulmuan vetëm sepse tokat e
tij kufizoheshin me Italinë dhe me pretekstin se asnjë mbret tjetër s'kishte të drejtë të
5 ekzistonte pranë kufijve të shtetit të tyre. Por edhe vetë Filipi duhej të shqetësohej
për këtë sepse sa më e fortë dhe e nderuar të bëhej mbretëria e tij, aq më armiq të
6 egër do të bëheshin për të romakët. Përveç kësaj Demetri i premtoi Filipit t'i linte
mbretërinë e vet, të cilën e kishin pushtuar romakët, sepse atij do t'i vinte më mirë

---

[1] Sipas burimeve të tjera emri i përfaqësueses së fundit të fisit mbretëror në Epir ishte Deidameia.
[2] Filipi V i ardhshëm.
[3] Antigoni II Dosoni që sundoi prej vitit 229-221 para e. sonë.
[4] Filipin e V.
[5] Demetër Fari.
[6] Kartagasit.

që atë ta zotëronte aleati i tij, se sa armiqtë. Me fjalë të tilla Demetri e shtynte Filipin
7 të linte të qetë etolët dhe të fillonte luftën me romakët; ai mendonte se kjo do t'i
kushtonte më pak telashe, sepse ai kishte dëgjuar se romakët ishin mundur nga
Hanibali në liqenin e Trazimenit. Prandaj, që të mos i takonte të bënte njëkohësisht
8 shumë luftëra, Filipi bëri paqe me etolët, pa lënë të kuptohet se do ta shpinte luftën
në një vend tjetër, por gjoja nga kujdesi për t'i siguruar paqen gjithë Greqisë. /Filipi/
pohonte se Greqinë nuk e ka kërcënuar kurrë një rrezik i tillë /si tani/, sepse në
9 perëndim janë ngritur dy fuqi të mëdha të reja, punët dhe romakët, të cilët vetëm një
gjë i mban nga sulmi kundër Greqisë dhe Azisë, lufta që bëjnë midis tyre për
sundim. Ai që do të fitonte në këtë luftë do të nisej menjëherë për në Lindje.

5 **3** ... Filipi e dinte se ata që tani haheshin midis tyre me një forcë kaq të madhe, nuk
do të kënaqeshin vetëm me fitoren dhe se atë e kërcënonte lufta me atë që do të
6 fitonte. Për këtë arsye Filipi, si mbaroi luftën me etolët, nuk mendonte për asgjë
tjetër veç për luftën midis punëve dhe romakëve dhe peshonte forcat e secilit prej
7 këtyre popujve veçmas. Por edhe romakët, megjithëse punët dhe Hanibali i
kërcënonin drejtpërsëdrejti, nuk e ndjenin veten të qetë nga Maqedonia. Ata i
8 frikësonte edhe lavdia e dikurshme e maqedonasve që nënshtruan Lindjen, edhe vetë
Filipi që digjej nga dëshira për t'ia kaluar heroizmave të Aleksandrit dhe që ata
/romakët/ e njihnin si luftëtar të zotin dhe njeri të veprimit.

1 **4** Për të gjitha këto arsye Filipi, me ta marë vesh se romakët u thyen nga kartagasit[1], u shpall si armik i romakëve dhe filloi të ndërtojë anije, për të hedhur me to ushtrinë
2 në Itali. Pastaj ai dërgoi tek Hanibali një delegat me një letër, për të lidhur aleancë.
3 Ky njeri u kap dhe u pru para senatit, i cili e liroi pa i bërë asnjë dëm, /sigurisht/ jo prej nderimit ndaj mbretit Filip, por me qëllim që armiku, akoma i lëkundshëm, të mos bëhej armik i padyshimtë. Por pas disa kohësh, kur romakët mësuan se Filipi
4 kishte ndërmend të dërgonte ushtri në Itali, nisën pretorion Levin, me anije të armatosura mirë që të pengonte këtë gjë. Levini si u hodh në Greqi i shtyu etolët, me
5 premtime të shumta, të fillonin luftën kundër Filipit; Filipi, nga ana e tij, ngriti ahejt në luftë kundër romakëve. Ndërkaq dardanët filluan të shkretojnë tokat maqedonase
6 dhe morën me vete njëzet mijë robër, gjë që e detyroi Filipin të tërhiqej nga lufta kundër romakëve dhe e vuri përpara domosdoshmërisë që të mbronte mbretërinë e vet. Ndërsa po ndodhnin këto ngjarje, pretori Levin bëri aleancë me mbretin Atal
7 dhe filloi të shkretojë Greqinë. Të turbulluar nga këto fatkeqësi, shtetet greke filluan të dërgojnë tek Filipi delegacione pas delegacionesh, me lutje që t'i ndihmonte. Edhe mbretër ilirë nuk i pushonin lutjet e tyre dhe kërkonin pa u lodhur plotësimin e
8 premtimeve. Duke u ndodhur në një gjendje të tillë të vështirë e të ndërlikuar, Filipi
9 lëkundej kundër kujt të luftonte më parë. Megjithatë, ai u premtoi të gjithëve t'u dërgonte ndihmë së shpejti dhe këtë jo sepse ishte në gjendje ta plotësonte, por që t'i mbante me shpresë dhe t'i ruante si aleatë. Fushata e parë e tij, megjithatë, ishte ajo
10 kundër dardanëve të cilët, duke pritur kohën kur Filipi do të mungonte, i kërcënonin maqedonasit se do t'u binin me forca të mëdha. Me romakët, të cilët u kënaqën që
11 mundën ta largonin luftën me maqedonasit, ai bëri paqe.

[1] Lufta në Kana, në vitin 216 para e. sonë.

11 **4** Tani luftën ne nuk e bëjmë me Aleksandrin e Madh, për pathyshmërinë e të cilit kushdo ka dëgjuar, dhe as me ushtrinë e tij që mundi gjithë Lindjen, por me Filipin
12 që është një çunak i papjekur dhe që mezi mbron nga armiqtë kufijtë e mbretërisë së tij, dhe me ata maqedonas, të cilët s'ka shumë kohë që i grabitën dardanët[1].

PROLOGI

HISTORIARUM PHILIPPICARUM

POMPEI TROGI

Prologu i LIBRIT VIII

Volumi i tetë përmban ... se si u mundën nga Filipi mbretërit ilirë, se si u nënshtrua Thrakia e Thesalia dhe si u vendos në Epir mbreti Aleksandër, pasi u rrëzua Arryba...

Prologu i LIBRIT XII

... Për veprimtarinë e Arhidamit mbreti të Lakedemonisë dhe Aleksandrit Molos në Itali, të cilët që të dy u asgjësuan këtu, bashkë me ushtritë e tyre.

Prologu i LIBRIT XVI

... Se si pas vdekjes së Kasandrit, kur filloi lufta midis të bijve, Demetri, i thirrur nga njëri prej tyre në ndihmë, e vrau atë dhe zuri mbretërinë maqedonase. I dëbuar prej këndej pas pak kohësh nga mbreti i Epirit, Pirrua, ai i transferoi veprimet ushtarake në Azi.

Prologu i LIBRIT XVIII

... Mbi heroizmat e mbretit të Epirit, Pirros, në luftën kundër romakëve dhe pas kësaj lufte mbi kalimin e Pirros në Siqeli, për të luftuar kundër kartagasve...

Prologu i LIBRIT XXIII

... Pastaj filloi lufta midis ushtarëve të tij[2] të huaj mercenarë dhe sikulëve. Kjo shkaktoi ardhjen e Pirros, mbretit të Epirit në Siqeli dhe ky luftoi me punët dhe mamertinët, por kur u kthye nga Siqelia në Itali u mund në një betejë nga romakët dhe u kthye në Epir.

---

[1] Këto janë fjalët, me të cilat konsulli romak Flamini iu drejtua ushtarëve të tij për t'u dhënë zemër para se të ndeshej me Filipin V.

[2] Të Agothoklit, tiranit të Syrakuzës.

Prologu i LIBRIT XXV

... Se si Pirrua, pasi u kthye nga Italia, i mori Antigonit mbretërinë maqedonase, rrethoi Lakedemoninë, vdiq në Argo dhe se si i biri i Pirros Aleksandri, bëri me mbretin Mytil luftën ilire.

Prologu i LIBRIT XXVIII

... Se si pas vdekjes së mbretit të Epirit, Aleksandrit, epirotët vranë Laodamenë... Se si mbreti i Maqedonisë, Demetri, u thye nga dardanët... Duke u larguar pak nga tema, flitet për luftën ilire që romakët bënë kundër Teutës.

Prologu i LIBRIT XXIX

... Lufta e mbretit Filip kundër dardanëve dhe etolëve. Filipi luftoi kundër ilirëve, dardanëve dhe prapë kundër etolëve, të cilëve u ndihmonin romakët...

Prologu i LIBRIT XXXII

... Këtu, duke u larguar nga tema, tregohet për ngjarjet në Iliri; se si galët që pushtuan Ilirinë, u kthyen përsëri në Gali. *[Vazhdon tregimin]* për historinë e vjetër të Panonisë...

Prologu i LIBRIT XXXIII

... Se si romakët luftuan me mbretin e Maqedonisë Perseun, të birin e Filipit dhe, pasi e zunë rob, shkretuan Epirin.

ITINERARET

Një burim i rëndësishëm për studimin e rrugëve antike janë të ashtuquajturit itinerarë (nga lat. iter-itineris = rrugë). Këto paraqesin në vetvete lista rrugësh dhe harta grafike, në të cilat janë të shënuara drejtimet që ndiqnin rrugët, stacionet e tyre dhe largësitë midis tyre (për rrugë detare me stade, kurse për rrugë tokësore me mile). Këto itinerare, të cilat qenë përpiluar për qëllime praktike, qoftë ekonomiko-tregtare, postare, etj., qoftë edhe për qëllime strategjiko-ushtarake, gjetën një përhapje dhe përdorim shumë të gjerë veçanërisht në periudhën perandorake me zgjerimin dhe organizimin e mirë të sistemit rrugor. Ndër itineraret e shumta të shkruar të kësaj kohe na janë ruajtur: Itinerari i Antoninit (Itinerarium Antonin Augusti), Itinerari i Burdigalës ose Hierosolymitani (Itinerarium Burdigalensis-Hierosolymitanum) dhe nga një kohë më e vonë Kosmografia kompilative e njohur me emrin Ravenatis Anonymi Cosmografia për të cilën do bëhet fjalë më poshtë.

Itinerari i Antoninit ka qenë përpiluar në bazë të një harte të kohës së Antoninëve, me sa duket të kohës së sundimit të Karakallës (212-218); kurse itinerari i Burdigalës ose Hierosolymitani në vitin 333 nga një njeri me prejardhje nga Akuitania (Franca e Jugut); Në këtë intierar përshkruhet rruga nga Burdigala (Bordo e sotme) në Jerusalem dhe kthim.

Një rëndësi të madhe midis itinerareve të ruajtura ka edhe Tabula Peutingeriana, e cila hyn në grupin e të ashtuquajturve "tabela grafike" (tabulae pictae). Këto lloj hartash rrugore i shërbenin më mirë qëllimit të tyre, mbasi në to jepeshin jo vetëm largësitë midis stacioneve rrugore, gjendja dhe madhësia e tyre, por dhe bregdeti, lumenjtë dhe malet. Tabula Peutingeriana është një rolet pergameni i shek. XII ose XIII, ku jepen rrugët e botës antike të ndarë në 12 pjesë, nga të cilat pjesa për krahinat e largëta të perëndimit ka humbur. Quhet Peutingeriana nga emri Konrad Peutingeri (shek. XVI), pronar i bibliotekës, ku gjendej kjo hartë para se të bëhej pronë e Bibliotekës së Vjenës, në të cilën ruhet edhe sot. Kompilimi i kësaj harte është bërë, me sa duket, në gjysmën e parë të shek. III, kurse redaktimi përfundimtar i saj në shek. IV.

Përkthimi është mbështetur në botimet:

1) *Itineraria Romana* Römische Reisewege an der Hand der Tabula Peutingeriana. Dargestellt von Konrad Miller. Stuttgart 1916.

2) *Itineraria Romana* volumen prius. Itineraria Antonini Augusti et Burdigalense. Ed Otto Cuntz. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1929.

1) TABULA PEUTINGERIANA

(Tabela Peutingeriane)

Rruga nga lumi Arsia nëpër Salonë në Dyrrah

Miller. IR, col. 462-471.

Arsia fl.	(Lumi Arsa, pranë Kastelnovos)[1]	XII
Alvona	(Albona)	XX
[Lauriana]	(Lovrana)	*[XIV]*
Tarsatica	(Tersati)	XX
Ad turres	(Cerkvenica)	XX
Senia	(Senja)	XX
Avendone	(Berlog Crëkvina)	X
Arypio	(pranë Vitalit)	X
Epidotio	Leshçe)	XVI
Ancus	(Verbaçi)	XV
Ausancalione	Lovinaçi)	XVI
Clambetis	(Starigradi)	XIII
Hadre	(Medvidje)	XIII
Burno	(Suplaja Crëkva)	XVI
Promona	(Teplju afër Dernishit)	VIII
Magno	(Baljina Glavica)	XIV
Andretio	(Muçi)	XVI
Salona	(Salona, Solini)	XVI
Tilurio	(Trilji)	XII
[Trono]	(pranë Maljiqit)	*[XIII]*
Billubio	(Lokviçiçi)	IX
Andovas	(Runoviçi)	IX
Ad fusciana	(pranë Tihaljinës)	XIII
Bigeste	(Humaqi)	XIII
Narona	(Vidi)	XXII
Ad turres	(pranë Utovos)	XIII
Dillunto	(pranë Kotesit)	XIV
Pardua	(pranë Jakovos)	XVI
Ad zizio	(Trebinje)	VIII
Leusino	(Grançarevo)	XII
Sallunto	(Podbozuri)	XVII
Sanderva	(Nikshiqi)	VI
Varis	(Povije)	XI
Sallunto	(Danilogradi)	XVIII
Nalata	(Afër Çliesopoljes)	X

[1] Në kllapa janë dhënë emrat e sotshëm të qyteteve ose lokaliteteve.

Bersumno	(Brica)	XVI
Sinna	(Marshenji)	XX
Scobre	(Shkodra)	XXX
Lissum	(Lezha)	XXV
Pistum	(Ishmi)	XXX
Dyrratio	(Durrësi)	

Rruga nga Sirmi deri në Salonë

Miller IR, col. 471-474

Sirmium	(Sremska Mitrovica)	XXX
Gensis	(Në jug të Leshnicës, në lumin Jadar)	XV
Ad Drinum	(Zvorniku, në vaun e Drinës)	*[X]*
Argentaria	(Srebernica?)	*[XXXIV]*
Mungon emri i stacionit		*[XXIV]*
Stanecli	(Luzhani)	*[XIV]*
Mungon emri i stacionit		XXIV
Bistue Nova	(Zenica)	XX
Ad matricem	(Travniku)	XXV
Bistue Vetus	(Kupresh?)	VI
In monte Bulsinio	(Në mes të Malovanit e Shuicës)	IX
Ad Libros	(Vidosi)	XXII
Tilurio	(Trilji)	XVI
Salona	(Salona, Solini)	

Rruga nga Salona nëpër Tragur në Iader dhe Burn

Miller, IR, col. 474-476

Salona	(Salona, Solini)	IX
Sielis	(Stafileo)	V
[T] Ragurio	(Trogiri)	XV
Lorano	(Verhpolje)	XI
Sardona	(Skradini)	*[X]*
[Arausa]	(Bribiri)	*[XX]*
[Blandona]	(Vrana)	*[XX]*
Jadera	(Zadari)	XII
Nedino	(Gradino)	XII
Aserie	(Podgradje)	XII
Burno	(Supljaja Crëkva)	

Rruga nga Sardona në Tragur

Miller, IR., col. 476

Sardona	(Skradin)	XX
Ad Praetorum	(Afër Umilianoviçit)	XX
Tragurio	(Trogir)	

Rruga nga Salona në Naronë

Miller, IR., col 481-482

Salona	(Salona, Solin)	IV
Epetio	(Pranë Stobrecit)	
Spalato[1]	(Split)	
Ad Diana	(Punta Jurja)	
Epetio		VII
Oneo	(Almissa)	*[XII]*
mungon një stacion		VII
Inaronia	(Macarska)	VII
[Biston]	(Podgorac)	*[XXXIII]*
Narona	(Vid)	

Rruga nga Ad zizio në Skodra

Miller, IR., col. 482-484

Ad zizio	(Trebinje)	XXVIII
Asamo	(Slano)	XXII
Epitauro	(Dubrovnik)	XX
mungon emri i stacionit		XII
Resinum	(Kotorri)	XX
Batua	(Budua)	*[XX]*
mungon emri i stacionit		*[XV]*
Vicinium	(Ulqini)	XX
Scobre	(Shkodra)	

Rruga nga Singiduni në Konstantinopol nëpër breg të Danubit

Miller, IR., col. 495-516

Singiduno	(Beograd)	XIV
Tricornio	(Ritopek)	XII
Monte aureo	(Oreshac)	XIV
Margum fl.	(Orashe, afër Dudravicës)	X
Viminatio	(Kostolac)	XIII
Punicum	(Gradishte)	XI
Vico cuppe	(Golubac)	XII
Ad novas	(Brnica)	X
Ad scrofulas	(pranë Dobres)	XV
Faliatis	(Milanovac)	VIII
Gerulatis	(Miroç)	VI
Unam	(Në lumin Rjeçka)	VI
Egeta	(Brëza Palanka)	IX
Cleuora	(Kamenica?)	IX
Ad aquas	(Vidrovac)	XXIV[2]
.....		
Constantinopolis		
.....		

[1] Nga Salona në Spalato IV.

[2] Nga Ad akuas deri në Konstantinopol ka akoma 57 stacione.

Rruga Egnatia nga Dyrrahi në Konstantinopol

Miller, IR., col. 516-527

Dyrratio	(Durrës)	XXVI
Clodiana	(Peqini)	XX
Scampis	(Elbasani)	IX
Genesis fl.	(Ura Haxhi Beqarit)	VII
Addianam	(Babja)	IX
in candabia	(Qukës)	IX
Pons Seruili	(Uraka)	XIX
Lignido	(Ohri)	XVI
mungon emri i stacionit		*[XVI]*
Nicea	(Velushina?, rrethi Bitolje)	XI
Heraclea[1)]	(Bitolje)	XXXII
.....		
Constantinopolis[2)]		

Rruga nga Singiduni në Konstantinopol

Miller IR., col. 528-540

Singiduno	(Beograd[3)]	
.....	.....	
Viminatio	(Kostolac)	XVIII
Municipio	(Kalishte)	X
Jouis pago	(Venqanica, në veri të Petrovacit)	XII
Idimo	(Medvexhe, afër Popoviqit)	XVI
Horrea Margi	(Kypria)	XVII
Presidio dasmini	(Pranë Jovanovac, në veri të Razhanit)	XV
Presidio pompei	(Nericev han, pranë Aleksinacit)	XII
Gramrianis	(Ndoshta kalaja Lipovac, pranë manastirit të shën Stefanit)	XIII
Naisso	(Nish)	
.....		
Constantinopolis[4)]		

Rruga nga Lisi nëpër Nais në Ratiaria

Miller, IR., col. 555-559

Scobre	(Shkodra)	XXX
Lissum	(Lezha)	XXX
Adpicaria	(Puka)	XXX
Greueni	(Vau Spas mbi lumin Drin)	XVII
Gabures	(Pranë Kusnenit?)	XXX

[1)] Heraclea ndeshet edhe me emrin Pelagonia.
[2)] Nga Heraklea e deri në Konstantinopol ka 28 stacione rrugore të tjera.
[4)] Në mes të Naisit dhe Konstantinopolit gjenden dhe 24 stacione të tjera.
[3)] Nga Singidum në Viminac ka edhe tre stacione, të cilat shënohen në rrugën nga Beogradi në Konstantinopol, nëpër breg të Danubit.
[4)] Në mes të Naisit dhe Konstantinopolit gjenden dhe 24 stacione të tjera.



Pjesë nga tabula Peutingeriana

Theranda	(Dule afër Prizrenit)	XXV
Viciano	(Liplian)	*[XII]*
[Veclanum]	(Pranë Prishtinës)	XIX
Vindenis	(Poduevo)	XX
Ad fines	(Kurshumlje)	XX
Hammeo	(Afër Prokupljes)	VI
Ad herculem	(Brestovica)	XIV
Naisso	(Nish)	XXVII
Timacc Maiori	(Knjazhevac)	X
Timaco Minori	(Ravna)	XXVII
Conbustica	(Afër Kladorupit, në luginën e lumit Arçar)	XXVII
Ratiaris	(Arçar)	

Rruga nga Dyrrahi nëpër Aktia Nikopoli Korinth, Argo, Spartë deri në ishullin Kythera

Miller. IR., col. 559-569

Dyrratio	(Durrësi)	XV
Genesis fl.	(Bashtova)	XX
Hapsum fl.	(Babunja e Re)	XVIII
Apollonia	(Pojani)	XVI
Aulona	(Vlora)	XXXIII
Ocrocenaurio[1)]	(Llogaraja)	XLI
Phenice	(Finiqi)	LVI
Rutharoto	(Butrinti)	*[XXIV]*
mungon një stacion		VIII
Ad dianam	(Në jug të Nistës)	XIII
Ciclis limen	(Limani i shën Jovanit)	XX
Acta nicopoli[2)]	(Preveza)	
.....		
Traiectus Stadiorum cc	(Kalimi për ishullin Cerigo)	

Rruga nga Apollonia nëpër Aktia Nikopoli në Larissa

Miller. IR., col. 570-571

Apollonia	(Pojani)	XXX
Amatria[3)]	(Ploça)	LV
Hadrianopoli	(Jermë?)	XXIV
Ilio	(Vela)	XX
[-------]	(Janina?)	XII
[Dodona]	(Zarakovistë)	XLV
Acta nicopoli	(Preveza)	LXX
[Tricca]	(Trikala)	XL
Larissa	(Larisa)	

[1)] Akrokeraunia.
[2)] Nga Aktia nikopoli deri në Traiektus stadiorum në jug të Peloponezit ka 24 stacione të tjera.
[3)] Amantia.

Rruga nga Naisi në Thesalonik

Miller. IR., col. 571-573

Naisso	(Nish)		XIV
Ad Herculem	(Brestovica)		VIII
mungon një stacion			*[XXX]*
Ad fines	(Lepenica)		XXXV
Anausaro	(Bukovaci i vogël ose Han Kukarka)		XII
[Aquas]	(Kumanova)		XXI
Scupis	(Zlokuçan, afër Shkupit)		
.....			
Tessalonice[1]	(Selaniku)		

2) ITINERARIUM ANTONINI AUGUSTI

(Itinerari i Antonin Augustit)

Rruga nga Roma nëpër Akuilea deri në Konstantinopol

Cuntz. IR., fq. 18-20

123,	8 Ad urbe	(Roma)		
	9 Mediolanum	(Milano)	m.p.[2]	CCCCXXXIII
124	1 inde Aquileia	(Akuilea)	m.p.	CCLX
	2 inde Sirmium	(Sremska Mitrovica)	m.p.	CCCCI
	---	---		
128	6 Aquileia civitas[3]	(Qyteti Akuilea)		
	---	---		
131	1 Mursa civitas	(Osjek)		
	2 Cibalas civitas	(Vinkovci)	m.p.	XXIII
	3 Ulmos vicus	(Tovarnik)	m.p.	XXII
	4 Sirmi civitas	(Sremska Mitrovica)	m.p.	XXVI
	5 Bassianis civitas	(Pranë Petrovcit)	m.p.	XVIII
	6 Tauruno classis	(Zemun)	m.p.	XXX
132	1 Singiduno castra	(Beograd)	m.p.	IIII
	2 Aureo Monte	(Oreshac, pranë Grockës)	m.p.	XXIII
	3 Ab Aureo Monte	(Oreshac)		
	Vinceia	(Smederevo)	m.p.	VI
	4 Margo	(Orashe, pranë Dubravicës)	m.p.	VIII
133	1 et leg.		m.p.	VIII
	2 inde Euminacio	(Kostolac)	m.p.	X
	3 Viminacio	(Kostolac)	m.p.	XXIIII
134	1 Municipio	(Kalishte)	m.p.	XVIII
	2 Idimo	(Medvexhe)	m.p.	XXVII
	3 Horreo Margi	(Kjupria)	m.p.	XVI
	4 Pompeis	(Neriçev han, pranë Aleksinacit)	m.p.	XXXIII

[1] Në mes të Skupit dhe Thesalonikut ka edhe 10 stacione të tjera rrugore.
[2] Mille passum – njëmijë hapa (rreth km. 1,5).
[3] Nga qyteti Akuile deri në Mursa ka 13 stacione rrugore.

	5 Naissi	(Nish)	m.p.	XXIIII
135,	1 Remisiana	(Bela Palanka)	m.p.	XXV
	2 Turribus	(Pirot)	m.p.	XVIII
	3 Meldia[1)]	(Në mes Dragomanit dhe Slivnicës)	m.p.	XXX
	---	---		
138,	5 Bizantio /qui et Constantinopoli/	(Bizanti i quajtur Konstantinopol)		

Rruga nga Viminaci në Konstantinopol

Cuntz. IR., fq. 32

217,5	Item per ripam a Viminacio	(Përsëri nëpër breg nga Viminaci (Kostolac)		
6	Nicomediam	deri në Nikomedia)	m.p.	
		në këtë mënyrë:		sic:
7	Cuppe	(Golubac)	m.p.	XILXII
218,1	Novas	(Pranë Brenicës)	m.p.	XXIIII
2	Talia	(Dolni Milanovac)	m.p.	XXIIII
3	Egeta	(Breza Palanka)	m.p.	XII
4	Aquis	(Vidrovac)	m.p.	XXI
219,1	Dortico	(Pranë Rakovicës)	m.p.	XVI
2	Bononia[2)]	(Vidin)	m.p.	X
	---	---		XVII
230,11	Bizantio	(Konstantinopol)		
	---	---		
231, 3	Nicomedia[3)]			

Rruga nga Dyrrahi nëpër Maqedoni e Thraki në Konstantinopol

Cuntz. I.R., fq. 48

317,3	Iter quod ducit a Durrachio	(Rruga që të shpie nga		
	PER MACEDONIAM ET	Dyrrahi nëpërmjet		
4	TRACHIAM Bizantium	Maqedonisë dhe		
	usque:	Thrakisë në Bizant)		
5	A Brundisio traiectus	(Kalimi nga Brundisi në		
6	Durachium usque	Dyrrah)		
			stadia	
7	A Dyrrachio Bizantium	(Nga Dyrrahi në Bizant)	num.	I CCCC
		në këtë mënyrë:	m.p.	DCCLIIII
			m.p.	sic
318,1	Clodiana	(Peqin)		XXXIII

[1)] Nga Meldia e deri në Konstantinopol ka 20 stacione rrugore.
[2)] Nga Bononia e deri në Bizant ka 56 stacione rrugore.
[3)] Nga Bizanti në Nikomedi ka dy stacione rrugore.

2	Scampis	(Elbasan)	m.p.	XX
3	Tres Tabernas	(Qukës)	m.p.	XXVII
4	Licnido	(Ohri)	m.p.	XXVII
5	Nicia	(Velushina, rrethi Bitoljes)	m.p.	XXXIIII
319,1	Heraclea	(Bitolje)	m.p.	XI
2	Cellis	(E paidentifikuar)	m.p.	XXXIIII
3	Edessa	(Vodena)	m.p.	XXVIII
4	Pella	(Postoli)	m.p.	XXVIII
320,1	Thesalonice	(Selaniku)		

323,8	Bizantio[1)]			

Rruga nga Brundisi nëpër Aulon dhe nga këtu nëpër Epir, Thesali dhe Maqedoni në Melisurgion.

323,9	Item a Brundisio sive ab Hydrunto	(Përsëri nga Brundisi ose nga Hydrunti (Otranto) në		
10	traiectus Aulonam	(Aulon)	staid	num. I
324,1	Inde per loca maritima IN EPIRUM ET THESSALIAM	(Dhe prej atje nëpër bregdet në Epir dhe Thesali dhe në Maqedoni)		
2	ET IN MACEDONIAM, sic:	në këtë mënyrë:		
	Acroceraunia	(Llogaraja)	m.p.	XXXIII
3	Phoenice	(Finiqi)	m.p.	XLI
4	Butroto	(Butrinti)	m.p.	LVI
5	Clvis Limen	(Limani i Shën Jonit)	m.p.	XXX
325,1	Actia Nicopoli	(Preveza)		
2	---			
328,5	Mellissurgin[2)]	(Melisurgion)		

Rruga nga Hydrunti nëpër Aulon dhe prej këtej nëpër Maqedoni në Konsantinopol

Cuntz. I.R., fq. 49-50

329,1	Item recto itinere ab	(Përsëri nëpër rrugë të drejtë nga		
2	Hydrunti Aulonam	Hydrunti (Otranto) në Vlorë)	stadia	I.
3,4	Inde PER MACE-DONIAM:	(Dhe prej atje nëpër Maqedoni)		
5	Apollonia	(Pojan)	m.p.	XXV
6	Ad Novas	(Nova e Lushjës)	m.p.	XXIIII
7	Clodianis	(Peqin)	m.p.	XXV

[1)] Nga Thesaloniku në Bizant ka 25 stacione rrugore të tjera.
[2)] Nga Aktia Nikopoli në Melisurgion ka 18 stacione rrugore.

8	Scampis	(Elbasan)	m.p.	XXII
9	Tribus Tabernis	(Qukës)	m.p.	XXX
10	Lignido	(Ohri)	m.p.	XXVII
330,1	Scirtiana	(E paidentifikuar)	m.p.	XXVII
2	Castra	(" ")	m.p.	VI
3	Heraclia	(Bitolje)	m.p.	XII

332,9	Bizantio[1)]			

Rruga nga Salona në Dyrrah

Cuntz. IR., fq. 51-50

337,3	Item DE DALMATIA IN MACEDONIAM, id	(Përsëri nga Dalmatia në Maqedoni d.m.th. nga		
4	est a Salonis Durrachium	Salona në Dyrrah) në këtë mënyrë:	m.p. sic:	CCCIII
5	Ponte Tiluri	(Trili)	m.p.	XVI
338,1	Trono		m.p.	XII
2	Bilubio		m.p.	XIII
3	Aufustianis		m.p.	XVIII
4	Narona		m.p.	XXV
5	Dallunto		m.p.	XXV
6	Leusinio		m.p.	XL
7	Andarva		m.p.	XXVIIII
8	Sallunto		m.p.	XVIII
339,1	Alata		m.p.	XVII
2	Birziminio		m.p.	X
3	Cinna	(Marshej i Koplikut)	m.p.	XVIII
4	Scodra	(Shkodra)	m.p.	XII
5	Durrachio	(Durrësi)	m.p.	L

3) ITINERARIUM BURDIGALENSE

(Itinerari i Burdigalës)

Rruga nga Akuilea deri në Sirm dhe prej atje në Konstantinopol

Cuntz. I.R., fq.89-91

563,8	fit ab Aquileia Sirmium usque milia CCCCXII,	(Nga Akuilea deri në Sirm (Sremaka Mitrovica) janë 412 mile.		
9	mansiones XVII, mutationes XXXVIIII	17 lokalitete me bujtina dhe 39 stacione për këmbime kuajsh).		
10	mutatio Fossis	(Jarak)	mil.	VIIII
11	civitas Bassianis	(Afër Petrovcit)	mil.	X

[1)] Nga Heraklea e deri në Bizant ka akoma 20 stacione të tjera rrugore.

12	MUTATIO Noviciani	(Pranë Stara Pazova)	mil.	XII
13	Mutatio Altina	Batainica)	mil.	XI
14	civitas Singiduno	(Beograd)	mil.	VIII
564,1	fines Pannoniae et Misiae	(Kufiri midis Panonisë dhe Myzisë)		
2	mutatio Ad Sextum	(E paidentifikuar)	mil.	VI
3	mutatio Tricornia Castra	(Pranë Ritopekut)	mil.	VI
4	Mutatio Ad Sextum Miliarem	(E paidentifikuar)	mil.	VII
5	civitas Aureo Monte	(Oreshac)	mil.	VI
6	mutatio Vingeio	(Smederovo)	mil.	VI
7	civitas Margo	(Orashe)	mil.	VIIII
8	civitas Viminacio	(Kostolac)	mil.	X
9	ubi Diocletianus occidit Carinum	(Ku Diokletiani vrau Karinin)		

567,1	civitas Serdica[1)]	(Sofia)		
2	fit a Sirmium Serdica uque milia CCCXIIII,	(Nga Sirmi në Serdikë janë 314 mile, 24 stacione për		
3	mutationes XXIIII mansiones XIII,	ndërrim kuajsh dhe 13 lokalitete me bujtina).		

570,8	civitas Constantinopoli			

Rruga nga Heraklea nëpër Maqedoni në Aulon

Cuntz I.R. fq. 99-100

601,6	Item ab Heraclea per Machedoniam[2)]:	(Përsëri nga Heraklea (Eregli) nëpër Maqedoni)		

607,3	finis Macedoniae et Ephyri[3)]	(kufiri mes Maqedonisë dhe Epirit)		
4	civitas Cledo	(Ohri)	mil.	XIII
5	mutatio Patras	(Kalishte)	mil.	XII
6	mansio Claudanon	(Në anën perëndimore të Ohrit)	mil.	IIII
7	mutatio in Tabernas	(Qukës)	mil.	VIIII
8	mansio Grandavia	(Babja)	mil.	VIIII
608,1	mutatio Treiecto	(Ura e Haxhi Beqarit, afër Polisit)	mil.	VIIII
2	mansio Hiscampis	(Elbasan)	mil.	VIIII
3	mutatio Ad Quintum	(Fikas)	mil.	VI
4	mansio Coladiana	(Peqin)	mil.	XV
5	mansio Marusio	(Golemi i Lushnjës)	mil.	XIII

[1)] Nga vendi ku Diokletiani vrau Karinin e deri në Serdikë ka 1 qytet, 7 lokalitete me bujtina dhe 14 stacione për ndrrim kuajsh.
[2)] Nga Heraklea e deri tek Efyri ka 49 stacione rrugore.
[3)] Duhet lexuar Epiri.

6	mansio Absos	(Kuçi)	mil.	XIIII
7	mutatio Stefanaphana	(Roskovec)	mil.	XII
8	civitas Apollonia	(Pojani)	mil.	XVIII
9	mutatio Stefana	(Levan)	mil.	XII
10	mansio Aulona treiectum	(Vlora)	mil.	XII
609,1	fit omnis summa ab Heraclea per Machedoniam Aulona usque milia	(E gjithë largësia nga Heraklea nëpër Maqedoni në Vlorë është		
2	DCLXXXVIII,	688 milje		
	mutationes LVIII,	58 stacione për ndërrim kuajsh		
3	mansions XXV.	dhe 25 lokalitete me bujtina).		

HISTORIA E PERANDORËVE

Në këtë korpus biografish të perandorëve romakë, që i përket fundit të shek. IV, trajtohet një periudhë që shkon nga Hadriani (117-138) deri tek Numeriani (284). Si përpilues të biografive të veçanta kujtohen të jenë gjashtë autorë të ndryshëm, që kanë jetuar në kohën e perandorëve Diokletian dhe Konstantin. Këta biografë janë El Spartiani (Aelius Spartianus), Vulkac Galikani (Vulcacius Gallicanus), Trebel Polioni (Trebellius Pollio) dhe Flav Vopisku (Flavius Vopiscus). Por disa anakronizma dhe aluzione që gjejmë në tekst, vërtetojnë se këto biografi janë shkruar apo ripunuar në kohën e Teodosit I (vitet 379-395). Vepra ka shumë boshllëqe; kanë humbur sidomos ato pjesë që trajtojnë biografitë e perandorëve të viteve 244-260.

Si burim mbi të cilin është mbështetur vepra, duhet përmendur në radhë të parë Mar Maksimi (gjysma e parë e shek. III), por nuk mungojnë as citate nga Deksipi (gjysma e dytë e shek. III) e Herodiani. Vepra përmban edhe shumë pasaktësira, bile edhe trillime e falsifikime të dobëta sidomos në biografitë e perandorëve të vonë, të pretendentëve apo tiranëve. Por megjithatë në këtë vepër ka gjëra të vlefshme. Sidoqoftë të dhënave të "Historisë së Perandorëve" nuk duhet t'u jepet shumë besim dhe duhet të përdoren gjithnjë me një vështrim kritik.

Në këtë vepër gjejmë edhe të dhëna për historinë e Ilirikut; aty flitet për ngjarjet që ndodhin në Gadishullin Ballkanik në shek. III dhe në fillimin e shek. IV, për sulmet e gotëve dhe për vendosjen në masë të barbarëve në Ballkan etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Scriptores Historiae Augustae, recensuit Hermannus Peter, Vol. I-II. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1865.

SCRIPTORES

HISTORIAE AUGUSTAE

(Shkrimtarët e historisë së perandorëve)

LIBRI IV

6 **21** Në të vërtetë përderisa vazhdonte murtaja ai *[*Mark Aureli*]* i bëri nderimet e duhura perëndive me kujdesin më të madh dhe skllevërit i përgatiti për luftë në atë mënyrë siç ishte vepruar në luftën punike; ai i quajti vullnetarë sipas shembullit të volonëve[1]. Armatosi edhe gladiatorët, të cilët i quajti të denjë. Bëri ushtarë edhe latronët e Dalmatisë dhe të Dardanisë. Armatosi edhe diokmitët dhe rekrutoi germanë kundër germanëve. Përveç kësaj me kujdes të madh përgatiti legjionet për luftën germane dhe markomane.

LIBRI XIX

3 **13** Pasi qetësoi Germaninë *[*Maksimini*]*[2] erdhi në Sirm që të përgatitej për luftë kundër sarmatëve dhe me mendimin që të vinte nën pushtetin romak krahinat e veriut deri në Oqean.

LIBRI XX

1 **14** Kur u mësua kjo[3], Maksimini menjëherë u dha zemër ushtarëve me këto fjalë: "Shokë të betuar të luftës, dhe beslidhës të mi! Shumica prej jush luftuat si duhet së bashku me mua; kur ne mbronim madhështinë e Romës kundër Germanisë dhe kur shpëtonim Ilirikun nga barbarët, afrikanët u treguan të pabesë".

LIBRI XXI

9 **5** Përveç kësaj Maksimi[5] i dërguar si legat, theu sarmatët në Ilirik. I shpërngulur prej këndej në Ren ai i udhëhoqi me shumë sukses veprimet kundër germanëve.

---

[1] Volonë ishte emër i dhënë skllevërve që morën vullnetarisht armët në mbrojtje të Romës pas disfatës së Kanës.

[2] I njohur me emrin Maksimin Thraku, perandor që nga viti 235 deri në vitin 238.

[3] Në vitin 238 në Afrikë shpërtheu një kryengritje dhe prokonsulli i saj Mark Anton Gordiani u shpall perandor. Pas pak kohe ai u vra së bashku me të birin e tij. I nipi i tij është perandori i mëvonshëm Gordiani III.

[5] Maksimi dhe Balbini qenë shpallur si perandorë nga senati në Romë në vitin 238 dhe qenë dërguar kundër Maksimin Thrakut që po marshonte drejt Romës. Ata sunduan vetëm 99 ditë. Maksimi i njohur edhe si Pupieni, para se të bëhej perandor ishte sundimtar i provincës Dalmate dhe si i tillë luftoi kundër sarmatëve që kishin depërtuar këtu.

LIBRI XXII

1 **3** Artabasdi, mbreti i armenëve, i dërgoi një letër të tillë Saporit[1]: "Gëzohem për
lavdinë, por kam frikë se ti nuk ke fituar aq sa ke mbjellë luftëra. Kërkojnë përsëri
2 Valerianin, të birin e tij, nipin e tij dhe komandantët romakë gjithë Galia, gjithë
Afrika, gjithë Hispania, gjithë Italia, dhe gjithë fiset që gjenden në Ilirik, në Orient
dhe në Pont, të cilët janë me anën e romakëve ose janë romakë[2]. Ti kape një plak[3],
por i bëre të gjitha fiset e botës armiqtë më të mëdhenj të tu, dhe ndoshta dhe tanët,
pasi ne që jemi fqinjë dhe gjithmonë mundohemi për ju, kur luftonit midis jush, të
dërguam ushtri në ndihmë.

LIBRI XXIII

5 **2** Por Makriani[4], pasi la në Orient një nga bijtë e tij dhe pasi vendosi paqen,
6 erdhi së pari në Azi /dhe pastaj/ u drejtua për në Ilirik. Në Ilirik, duke pasur me vete
njërin nga bijtë e tij dhe duke udhëhequr tridhjetë mijë ushtarë, u fut në luftim me
Domitianin, komandant i perandorit Aureol, i cili ishte ngritur kundër Galienit.

Por Makriani u mund së bashku me të birin e tij, të quajtur gjithashtu Makrian
7 dhe gjithë ushtria iu dorëzua perandorit Aureol.

3 Dhe kështu Odenati u bë perandor pothuaj i gjithë Orientit dhe ndërsa Aureoli
3 mbajti Ilirikun, Galieni – Romën.

5 Në kohën e fatkeqësisë së tmerrshme, kur perandoria roamke qe shkretuar në
6 disa vende nga tërmetet, në disa tjera nga rrëshqitjet e tokës dhe në vende të
ndryshme nga epidemitë, kur qe kapur rob Valeriani, kur Galia në pjesën e saj më të
madhe ishte pushtuar, kur Odenati shpalli luftën, kur Aureoli bënte shumë presion...
dhe kur Emiliani pushtoi Egjiptin, gotët ose skythët, emër i cili, siç kemi thënë më
sipër, i qe dhënë gotëve, pushtuan tokët e thrakëve, shkretuan Maqedoninë, rrethuan
Thesalonikun dhe asgjëkundi nuk mund të gjendej qoftë edhe pak qetësi.

6 **13** Në këtë ndërkohë skythët, duke lundruar nëpër Euksin, sulmuan Histrin dhe
bënë shumë shkatërrime të rënda në truallin romak. Kur mori vesh këtë Galieni i
urdhëroi byzantasit Kleodam dhe Athene të rindërtojnë dhe të forcojnë qytetet. Lufta
u zhvillua rreth Pontit dhe komandantët bizantinë i mundën barbarët. Gotët u
7 mundën dhe nga komandanti Venerian në betejën detare, kurse vetë Veneriani vdiq
8 nga vdekja ushtarake. Dhe pas kësaj ata shkretuan Kyzikun dhe Azinë, më vonë
gjithë Ahenë dhe u mundën nga athinasit nën udhëheqjen e Deksipit, historian i
këtyre kohëve. Të përzënë prej këndej, ata kaluan nëpër Epir, Maqedoni dhe Myzi.
9 Në këtë gjendje Galieni, i shqetësuar më në fund nga fatkeqësia e shtetit, u ra gotëve
që bridhnin nëpër Ilirik dhe papritmas vrau shumë nga ata.

---

[1] Sapori ishte sundimtar Persian i cili në vitin 260 zuri rob perandorin romak Valerianin (253-260).
[2] Me emrin Ilirik në këtë kohë kuptohej gjysma perëndimore e Gadishullit Ballkanik, por nga fundi i shek. II nganjëherë në burime kuptohet me Ilirik i gjithë Gadishulli Ballkanik.
[3] Është fjala për perandorin romak Valerianin.
[4] Makriani, komandant ushtarak romak i cili pasi mundi persët së bashku me Balistën dhe me ndihmën e Odenatit (sundimtar i Palmirës, dhe bashkëpunëtor i perandorit Galien kundër persëve dhe uzurpatorëve) u bind nga Balista që të shpalleshin si perandorë në vitin 260 të dy bijtë e tij.

1 **9** Në kohën e konsujve Tusk dhe Bas[1], kur Galieni kalonte kohën pas verës dhe pijetoreve, pas ndërmjetësve, artistëve dhe femrave imorale dhe me shpenzimet e tij të vazhdueshme prishte dhuratat e natyrës, legjionet myze, në marrëveshje me legjionet e tjera në Panoni, shpallën si perandor Ingenin, i cili deri atëherë sundonte tokat panone. Dhe duket se ushtarët qenë kujdesur shumë mirë për shtetin, përderisa në kohën e sulmit të sarmatëve, zgjodhën për perandor njeriun që me guximin e tij mundi të ndihmojë shtetin e dobësuar.

1 **10** Pjesëmarrja në punët e shtetit ka qenë e tillë që në kohën e Galienit, çdo njeri mund të arrinte në pushtetin perandorak. Më në fund perandor u bë Regaliani[2] i cili qe duks i Ilirikut. Ata që i dhanë pushtetin perandorak qenë myzët, të cilët më përpara qenë mundur së bashku me Ingenin, kundër prindërve të të cilit Galieni qe sjellur egërsisht.

2 Ai kreu shumë vepra të guximshme kundër sarmatëve, por u vra me shtytjen e roksolanëve, me pëlqimin e ushtarëve dhe për shkak të frikës që kishin banorët e provincës se mos vallë Galieni do të kryente përsëri vepra akoma më të egra...

9 Është ruajtur një letër e Klaudit të hyjnizuar, i cili atëherë nuk ishte akoma zyrtar. Me këtë ai falënderonte duksin e Ilirikut[3], Regalianin, për kthimin e Ilirikut në një kohë, kur çdo gjë ishte prishur për shkak të pakujdesisë së Galienit. Unë e gjeta këtë

10 letër dhe vendosa që ta jap fjalë për fjalë, pasi paraqet interes publik: "Klaudi i dërgon shumë shëndet Regalianit. I lumtur, është shteti që meritoi të ketë në radhët e ushtrisë së tij një burrë të tillë si ti, i lumtur është Galieni megjithëse nuk i kanë treguar të vërtetën as për gjërat e mira, as edhe për të këqijat.

Boniti dhe Celsi, nga suita e peandorit tonë, më thanë se si kishte luftuar pranë

11 Skupit, me çfarë shpejtësie dhe sa beteja kishte bërë në një ditë. Ti do të ishe i denjë për triumf, po të ishin kohët e vjetra..."

1 **11** Dhe ai /Aureoli/ i cili komandonte ushtritë ilirike, duke mos përfillur Galienin, mori pushtetin që ia dhanë ushtarët, po ashtu sikurse /ua jepnin/ të gjithëve në atë kohë.

12 **12** Dhe kështu, sipas dëshirës së gjithë ushtarëve, /Makriani/ u zgjodh si perandor së bashku me të dy bijtë, Makrianin dhe Kvietin dhe menjëherë filloi

13 marshimin kundër Galienit, meqenëse punët në Lindje sikur ishin lënë disi pas dore. Por edhe pse kishte me vete dyzet e pesë mijë ushtarë kur nisi betejën me Aureolin

14 në Ilirik, ose në tokat më të largëta thrake, u thye dhe u vra bashkë me të bijtë e tij. Më në fund tridhjetë mijë ushtarë kaluan nën pushtetin e Aureolit. Aureoli nga ana e tij u mund nga Domitiani, komandanti i tij më i fuqishëm dhe më i përmenduri i cili thoshte se rridhte nga Domitiani dhe Domitila.

15 Më duket se nuk duhet lënë pa përmendur vlerësimi i Valerianit për Makrianin, që ai e bëri në falimin e tij dërguar senatit nga kufijtë e Persisë... "Dhe për ne senatorë,

17 nuk ka asgjë të re ose të papritur; guximi i tij, si fëmijë, u provua në Itali, si djalosh në Gali, si i ri në Thraki, si i rritur në Afrikë, më në fund në pleqëri, në Ilirik dhe Dalmati, kur në beteja të ndryshme jepte shembull për guximin etij..."

---

[1] D.m.th. në vitin 258.

[2] Regaliani u shpall si perandor, kur Galieni gjendej në Lindje.

[3] Këtu bëhet fjalë për thyerjen e gotëve dhe sarmatëve pranë Skupit, nga Regaliani, në vitin 262.

18 "Valeriani përshëndet Ragon Klarin, prefekt të Ilirikut dhe të Galisë. Në qoftë se ti o kushëri, Klar ke cilësi të mira, të cilat unë i di se i ke, duhet të ndjekësh urdhërat e Balistës[1]. Drejtoje shtetin me ndihmën e tij. A e sheh se ai nuk i rëndon provincialit[2], pasi ai mban kuajt atje ku ka kullota, kërkon anonën e ushtarëve atje ku ka drithë, dhe nuk e detyron provincialin dhe bujkun të japë drithë atje ku nuk ka, të kullosë kuaj atje ku nuk ka mundësi.
Dhe nuk ka një orientim tjetër më të mirë se ky që të shpenzohet në vendin e vet ajo që prodhohet dhe të mos ngarkohet shteti me shpenzime për qerret. Galatia ka drithë me bollëk, Thrakia është plot, Iliriku mbushur: le të vendoset atje këmbësoria, megjithëse në Thraki mund të dimërojë dhe kalorësia pa dëmtuar provincialët, pasi nga fushat mblidhet shumë bar i thatë. Përveç kësaj vera, dhjami dhe llojet e tjera të ushqimeve, duhet të merren nga ato vende ku ato gjenden me bollëk..."

29 Ndërsa Galieni po dëfrehej dhe e kalonte jetën e tij nëpër banja dhe midis grave të këqija, u shkretuan krahinat gale dhe të Lindjes, gjithashtu ato të Pontit, Thrakisë dhe Ilirikut...

LIBRI XXV

6 Por le të kthehemi te Klaudi[3]. Me të vërtetë, siç thamë më lart, këta gotë që qenë shpërndarë në atë kohë kur i ndoqi Marciani dhe që Klaudi nuk i kishte lejuar që të futeshin, për të mos ngjarë ajo që ngjau, i nxitën gjithë fiset e tyre që të plaçkisnin tokat romake. Më në fund popuj të ndryshëm skythë: peukët, grutungët, austrogotët, tervigët, visët, gypedët, keltët dhe erulët, nga dëshira e madhe për plaçkitje, u futën në tokën romake dhe shkretuan pjesën më të madhe, në kohën kur Klaudi ishte i zënë me punë të tjera... Ushtarë qenë tridhjetë e dy mijë vetë. Shtoni këtyre edhe skllevërit, shtoni familjet, shtoni karrot dhe lumenjtë e shteruar e pyjet e prishura dhe më në fund dhe vuajtjen e vetë tokës, e cila pranoi aq shumë barbarë kryelartë.

8 Dhe kështu ne shkrimtarët përulemi përpara Klaudit, i cili shkatërroi, shtypi, zhduku dy mijë anije barbare, treqind e njëzet mijë ushtarë të armatosur,... siç mësojmë nga vetë letra e tij që i shkroi Jun Brokut, i cili mbronte Ilirikun: "Klaudi përshëndet Brokun. Zhdukëm treqind e njëzet mijë gotë. Mbytëm dy mijë anije. Lumenjtë janë mbuluar me mburoja, të gjitha brigjet janë mbushur me shpata dhe heshta. Fushat janë të mbuluara me kocka, asnjë rrugë nuk është e pastër, kanë mbetur një numër i madh karrosh. Zumë aq gra saqë ushtari triumfues mund të marrë nga dy-tri gra".

9 Me të vërtetë lufta u zhvillua në Myzi dhe shumë beteja u bënë pranë Marcianopolit. Shumë gjetën vdekjen nga mbytja e anijeve; u zunë rob shumë prijësa; u zunë rob dhe gra fisnike nga fise të ndryshme, provincat romake u mbushën me robër barbarë dhe me bujqër skythë. Goti qe bërë kolon në limesin barbar. Dhe nuk ka asnjë krahinë, në të cilën të mos ketë skllevër gotë nga robërit [e zënë] si rrjedhim i ndonjë fitoreje. Sa qe barbarësh kanë parë gjyshërit tanë? Sa dele? Sa pela kelte që njerëzit aq tepër i lavdërojnë? Të gjitha këto i përkasin lavdisë së Klaudit. Klaudi i dhuroi shtetit sigurinë dhe pasuri shumë të madhe. Përveç kësaj lufta u bë pranë Byzantit dhe bizantinët që kishin mbetur luftuan me guxim. Lufta u bë dhe pranë Thesalonikut, i cili u rrethua nga barbarët në mungesë të

---

[1] Balista ishte komandant i gardës perandorake, pranë Valerianit.
[2] Banor i provincës.
[3] Pasi theu gotët, pranë Naisit, Klaudi vendosi një pjesë të robërve si kolonë në tokat e Ballkanit, kurse pjesën tjetër e futi në ushtri.

9 Klaudit. Lufta u bë në vende të ndryshme, dhe gjithkund gotët u mundën nën udhëheqjen e Klaudit, kështu që me të vërtetë që atëherë dukej se Klaudi përgatiste një shtet të qetë; për nipin e tij të ardhshëm cezar Kostantin[1].

6 **11** Në kohën, kur u arrit fitorja e plotë, pjesa më e madhe e ushtarëve të Klaudit të dehur nga suksesi i cili verbon edhe të urtit, u dhanë aq tepër pas plaçkitjes saqë harruan se mund të viheshin në ikje nga një pakicë shumë e vogël, në kohën kur ata
7 të dhënë me mish e shpirt do kërkonin për të grabitur plaçkën. Me të vërtetë, në kohën e vetë fitores, u vranë nga një pakicë barbarësh, dhe pikërisht nga ata të cilët
8 kishin ikur, pothuaj dy mijë nga ushtarët tanë. Por kur Klaudi dëgjoi këtë, pasi mblodhi ushtrinë, i kapi të gjithë ata që ishin treguar të pabindur dhe i dërgoi bile të
9 lidhur në Romë, që të shfrytëzoheshin në lojnat publike. Në këtë luftë që udhëhiqte Klaudi u dallua jashtëzakonisht shumë guximi i kalorësisë së dalmatëve, pasi Klaudi linte të kuptohej, se ishte me prejardhje nga kjo provincë, megjithëse të tjerë thonë se ishte dardan dhe që rridhte nga mbreti i trojanëve Ili[2] dhe nga Dardani[3] vetë.

2 **14** Letër e Valerianit dërguar Zosimit, prokurator i Sirisë: "Caktuam për tribun të legjionit V të Marsit një njeri shumë të guximshëm dhe besnik, Klaudin, me prejardhje ilire, i cili mund të preferohet përpara të vjetërve më besnikë dhe guximtarë".

1 **15** Prapë në një letër tjetër dërguar nga po ai, prefektit të prefekturës Ablav Murenës në mes të tjerave thuhet: "Pusho së ankuari, se Klaudi është akoma tribun dhe se nuk merr si duks ushtri, për të cilën gjë ti thoshe se ankoheshin edhe senati e
2 populli. Ai u bë duks, dhe bile duks i gjithë Ilirikut; ka nën pushtetin e tij ushtritë thrake,myze, dalmate, panone dhe dake. Dhe sipas vlerësimit tonë, ky burrë shumë i
3 përmendur mund të shpresojë për në konsullatë, dhe në qoftë se i pëlqen mund të marrë, kur të dëshirojë, prefekturën pretoriane. Por dije se ne i kemi caktuar atij një
4 rrogë të tillë si atë të prefektit Egjptian, aq veshje sa i dhamë prokonsullatës afrikane, aq argjend sa merr sundimtari i minierave në Ilirik, aq nëpunës sa caktohen nga ne veçmas për gjithë qytetet që ta dinë të gjithë se cili është mendimi ynë për një njeri të tillë.

LIBRI XXVI

1 **3** Dhe që të mos fus në parathënie në mënyrë të mërzitshme shumë sende dhe të parëndësishme, Aureliani i hyjnizuar lindi, siç thonë shumica,në Sirm nga një familje shumë e parëndësishme ose, siç vërtetojnë disa, në Dakinë Analumase[4].
Por mua më kujtohet se kam lexuar një autor që thotë se ai ka lindur në Myzi. Dhe
2 me të vërtetë del se nuk dihet vendlindja e atyre njerëzve që janë nga një prejardhje e ulët dhe të cilët zakonisht vetë e trillojnë vendin e tyre të lindjes, që të shkëlqejnë në të ardhmen me prejardhjen e tyre. **6** Të njohura janë shumë heroizmat e shkëlqyera, të kryera nga ai /Aureliani/ para se të bëhej perandor. Me të vërtetë ai vetë me
3 treqind ushtarë nga garnizoni zhduku sarmatët që sulmonin Ilirikun.

---

[1] Konstant Klori, perandor romak (305-306).
[2] Ili, sipas legjendës, ka qenë i biri i Trojës dhe themelues i qytetit Ilion, një emër tjetër i qytetit të njohur të Trojës.
[3] Dardani, sipas legjendës, ishte themelues i Dardanisë në Troadë dhe themelues i fisit të trojanëve.
[4] Dakia Analumase, shih shënimin tek Eutropi IX 15, 1.

1 **17** Gjendet një letër e cila, si për zakon, mendoj se duhet të futet për shkak të së
2 vërtetës, siç kanë vepruar shkrimtarët e tjerë të historisë: "Flav Klaudi përshëndet Aurelianin e tij. Shteti kërkon me ngulm nga ti që të plotësosh detyrën tënde të zakonshme: sulmo! Përse vonohesh? Unë dua që ushtarët të jenë nën komandën tënde, tribunët nën udhëheqjen tënde. Gotët duhet të ndiqen nga toka thrake. Në të
3 vërtetë pjesa më e madhe e tyre që ikën kur ti luftoje shkretuan Hemimontin dhe Evropën. Unë po vë nën pushtetin tënd gjithë ushtritë thrake, gjithë ushtritë ilire dhe gjithë limesin...

1 **22** Dhe kështu, pasi rregulloi çështjet që kishin të bënin me zgjerimin e mureve të qytetit, me gjendjen e qytetit dhe me punët shoqërore, *[Aureliani]* u drejtua[1] kundër palmyrasve, d.m.th. kundër Zenobisë[2] që mbante pjesën lindore të
2 perandorisë në emër të bijve të saj. Rrugës bëri luftime të mëdha e të shumta. Vërtet ai mundi në Thraki dhe Ilirik barbarët që i dolën përpara dhe bile vrau përtej Danubit edhe prijësin e gotëve Kanabën ose Kanabaudin bashkë me pesë mijë burra.

4 **35** Pasi kreu këtë, ai u nis për Gali dhe çliroi vindelikët nga rrethimi barbar. Pastaj u kthye në Ilirik dhe, pasi përgatiti një ushtri më tepër të madhe se sa të pamasë, i shpalli luftë persëve, të cilët i mundi në mënyrën më të lavdishme në të
5 njëjtën kohë kur mundi Zenobinë. Por kur udhëtonte u vra nga tradhtia e notarit të tij dhe nga dora e Mukaporit në mansion Kenofrurion që gjendet në mes të Heraklesë dhe Byzantit.

7 **39** Kur pa se Iliriku ishte i shkretuar dhe Myzia e humbur *[Aureliani]* la provincën e Dakisë përtej Danubit të organizuar nga Trajani, pasi nuk kishte shpresë se mund ta mbante atë, dhe hoqi ushtrinë dhe banorët e saj. Populllsinë e shpërngulur prej këndej, ai e vendosi në Myzi dhe e quajti atë Dakinë e tij[3] e cila tani ndan dy Myzitë[4].

7 **41** Shteti ynë pas fatkeqësisë së Valerianit[5] dhe pas të këqijave të Galienit, pati filluar me të vërtetë të marrë veten gjatë sundimit të Klaudit. Por ai u rimëkëmb, kur Aureliani korrte fitore në të gjithë botën. Ai na dha Galinë. Ai çliroi Italinë, ai i
8 sphëtoi vindelikët nga zgjedha e robërisë barbare. Në saje të fitores së tij u rivendos pushteti në Ilirik dhe Thrakia u kthye prapë nën ligjet romake.

LIBRI XXVIII

1 **16** Pas kësaj *[Probi]* u drejtua për në Ilirik[6]. Para se të arrinte, e la Retinë aq të qetësuar, sa nuk mbeti atje as më i vogli dyshim për ndonjë frikë. Në Ilirik ai i
2 shpartalloi sarmatët dhe fiset e tjera në atë mënyrë, saqë i riktheu pothuaj pa luftë gjithë ato që kishin grabitur...

1 **18** Dhe kështu pasi bëri paqe me persët, ai u kthye në Thraki dhe vendosi në tokën romake njëqind mijë bastarnë dhe që të gjithë ata e mbajtën fjalën e dhënë për
2 besnikëri. Por kur shpërnguli po në këtë mënyrë shumë nga fiset e tjera d.m.th. gipedët[7], grautungët dhe vandulët[8], të gjithë këta s'e mbajtën fjalën, dhe kur Probi

---

[1] Në vitin 272.
[2] Zenobia është e shoqja e Odenatit, sundimtar i Palmyrës.
[3] Dakinë e Aurelianit.
[4] D.m.th. Myzia e Sipërme dhe e Ulët.
[5] Pas zënies rob të Valerianit nga persët në vitin 260.
[6] Pasi kreu punët me alamanët në Germani, Probi u nis në vitin 278 për Reti, Ilirik dhe Myzi që të luftonte kundër fiseve të ndryshme barbare.
[7] Gepidët.
[8] Vandalët.

ishte i zënë në luftë me uzurpatorët, ata i ranë kryq e tërthor nëpër tokë e det pothuaj gjithë perandorisë dhe i shkaktuan jo pak dëme lavdisë romake.

8 Pas kësaj ai *[Probi]* u lejoi gjithë galëve, hispanëve dhe britanëve që të mbanin hardhi dhe të bënin verë. Vetë ai mbolli me hardhi të zgjedhura malin Alma në Ilirik, rreth Sirmit, i cili u punua nga duart e ushtarëve.

1 **20** Pasi kreu këtë, ai u zhduk me anë të një pusie[1)], që i vunë ushtarët e tij, kur, duke u përgatitur për luftën persiane, po udhëtonte nëpër Ilirik.

1 **21** ... Për këtë arsye le të shtoj atë që e shpejtoi më tepër vdekjen e një njeriu kaq të madh.

2 Në të vërtetë, kur erdhi në Sirm dhe deshi ta zgjeronte dhe ta bënte pjellore tokën amtare, ai vendosi menjëherë shumë mijëra ushtarë që të thanin një kënetë dhe hapi një kanal të pamasë, të cilin duke e çuar deri në Savë, do të thante vendet që do të ishin në dobi të banorëve të Sirmit.

3 Ushtarët, të tronditur nga kjo, e vranë në të pestin vit të sundimit të tij, kur deshi të strehohej në kullën e hekurt, të cilën vetë e kishte ndërtuar shumë të lartë për vrojtim.

LIBRI XXX

1 **4** Shumica e japin vendlindjen e Karusit në mënyrë aq të ndryshme, saqë për arsye të mendimeve të shumta nuk guxoj të them se cili është i vërtetë. Onesimi, i
2 cili e ka përshkruar me shumë zell jetën e Probit, thotë se ai ka lindur dhe është edukuar në Romë, por prejardhjen e ka nga prindër ilirë, kurse Fab Ceryliani, i cili e
3 ka ndjekur me shumë kujdes periudhën e Karusit, Karinit dhe Numerianit thotë se ai ka lindur jo në Romë, por në Ilirik dhe jo nga prindër panonas, por kartagas.

4 **9** Shumë gjëra tregojnë se Karusi ka qenë perandor i mirë, dhe veçanërisht kjo se menjëherë pasi mori pushtetin, ai drejtoi me plotë zotësi veprimet luftarake dhe shpartalloi sarmatët[2)]. Ata qenë egërsuar shumë pas vdekjes së Probit dhe kërkonin të pushtonin jo vetëm Ilirikun, por edhe Thrakinë e Italinë. Brenda pak ditëve Karusi vrau gjashtëmbëdhjetë mijë sarmatë, zuri robër njëzet mijë vetë nga të dy sekset dhe kështu siguroi Panoninë.

[1)] Probi u vra në vitin 282.

[2)] Këto luftëra u bënë në vitin 282.

PËRSHKRIM I GJITHË BOTËS DHE I POPUJVE

Vepra "Descriptio totius mundi et gentium" (Përshkrim i gjithë botës dhe popujve) është një traktat anonim i mesit të shek. IV të e. sonë që përmban të dhëna të rëndësishme mbi jetën ekonomike, politike e kulturore të perandorisë së vonë romake. Autori i panjohur i kësaj vepre jep një përshkrim sistematik të tokave që gjendeshin nën sundimin romak, duke trajtuar në mënyrë të veçantë jetën ekonomike të tyre. Autori i traktatit ndalet sidomos në çështjet që kanë të bëjnë me veçantitë ekonomike të krahinave të ndryshme të perandorisë. Midis të dhënave të tjera, këtu gjejmë edhe njoftime të vlefshme për tokat e Ilirisë, për pasuritë e saj në minerale, në prodhime blegtorale dhe për lidhjet e saj tregtare me botën që e rrethon.

Ky traktat ka arritur deri te ne në dy versione latine. I pari më pak korrekt nga pikëpamja gjuhësore: "Expozitio totius mundi et gentium" përfaqësohet nga një dorëshkrim i fragmentuar, që nuk gjendet më; kopja e tij është botuar në shek. e XVII nga Gotofred. I dyti është shkruar në një latinishte më të mirë dhe është ruajtur i plotë me titullin: "Liber Junioris philosophi in quo continetur totius orbis descriptio".

Krahasimi i dy versioneve i ka prurë studiuesit në përfundimin se versioni me një gjuhë më pak korrekte është diçka më i vjetër se versioni me një latinishte më të mirë. Versioni i parë ka shërbyer si material për të dytin më të përpunuar. Në procesin e këtij përpunimi të gjitha vendet e paqarta janë lënë, kurse përmbajtja i është përshtatur (në kuptimin që çdo gjë e vjetëruar është lënë mënjëanë) gjendjes që ishte në kohën kur lindi vepra, gjë që u pasqyrua në heqjen e elementit pagan.

Në botimin e tij Müller, tekstin e marrë nga Gotofredi e ka shënuar me gërmën B, kurse atë të botuar prej tij me gërmën A.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Geographi Graeci Minors edidit G. Müllerus. Vol. II. Parisiis 1861.

DESCRIPTIO TOTIUS MUNDI ET GENTIUM

(Përshkrim i gjithë botës dhe i popujve)

A51 Mbas Thrakisë do ndeshësh Maqedoninë. Ajo ka gjithë të mirat dhe eksporton hekur, plumb, dhjamë derri dhe djathë dardan; pranë saj gjendet Dardania. Maqedonia ka një qytet shumë të shkëlqyeshëm, që është një nga të përmendurit në botë dhe që quhet Thesalonik.

A53 Pas Ahesë vijnë tokat e Epirit dhe qyteti Efyra. Pas tij Nikopoli, në të cilin gjendet një sasi e madhe peshk deti. Pak më sipër këtij qyteti është Dalmatia, e cila bën një tregti të zhvilluar dhe eksporton tre produkte të dobishme: djathë, lëndë druri dhe hekur. Ka një qytet të shkëlqyeshëm, i cili quhet Salona. Por Dyrrahu, për arsye të veseve të këqija të banorëve të tij, u shkatërrua nga perëndia i zemëruar, u fundos dhe nuk u duk më.

B53 Mbas Ahesë gjenden tokat e Epirit dhe qyteti i cili quhet Efyra. Disa e quajnë provincën Epir, kurse të tjerët Etoli. Qyteti Nikopol është plot me peshk deti, kështu që ai që shikon mund të mësojë ndonjë lloj të ri peshku. Pak më lart nga ky gjendet Dalmatia e cila është e përmendur për tregtinë e saj. Ajo eksporton tre produkte, që gjenden me shumicë dhe janë shumë të dobishme: djathin dalmat, lëndë druri të përshtatshme për ndërtime, dhe hekur. Ajo ka një qytet të shkëlqyeshëm Salonën. Dyrrahu, me vullnet të zotit, u zhduk nga faqja e dheut prej veseve të këqija të njerëzve, siç thonë me të drejtë, dhe nuk u rimëkëmb më.

A57 Pas Italisë le të flasim për provincat që i lamë pa përmendur, duke kaluar më lart, pikërisht në provincat e Myzisë dhe Dakisë; ato i sigurojnë plotësisht nevojat e tyre dhe dallohen për klimën e ftohtë. Në këto gjendet qyteti i pasur Naisi. Më tej shtrihet krahina e Panonisë, tokë e pasur me të gjitha, jo vetëm me fruta dhe gjedhe, por edhe me tregti dhe skllevër. Këtu është gjithmonë vend i zgjedhur për banimin e perandorëve. Kjo ka qytete të mëdha: Sirmin dhe Norikun, prej nga thonë se del veshja norike. Kjo është krahina e Panonisë. Në fqinjësi me të, në anën tjetër të Danubit, gjendet fisi barbar i sarmatëve.

EUTROPI

Eutropi lindi në fillim të shek. IV dhe vdiq mbas vitit 370 të e. sonë. Ai është ndër të paktët historianë të kohës, që nuk u pajtua me krishterimin dhe mbeti pagan gjithë jetën e tij. Nga veprat e Eutropit kemi trashëguar vetëm një histori të shkurtër të Romës që njihet me emrin "Breviarium ab urbe condita" (Histori e shkurtër që nga themelimi i Romës). Kjo histori përfshin kohën që nga themelimi i Romës e deri në vdekjen e perandorit Jovian (viti 364). Ajo që shquan këtë vepër, në të cilën trajtohen vetëm ngjarjet më të rëndësishme historike të shtetit romak, është gjuha e qartë dhe e kuptueshme. Më vonë kjo vepër, e cila për një kohë të gjatë shërbeu si manual i historisë romake, u përkthye edhe greqisht. Mbi historinë e Eutropit mbështeten kryesisht të gjithë historianët e mëvonshëm të kohës antike si Pal Orosi, Aurel Viktori, etj.

Në veprën e Eutropit gjejmë të dhëna të rëndësishme edhe mbi historinë e Ilirikut në periudhën që nga fundi i shek. III e deri në gjysmën e parë të shek. IV. Të dhënat e tij mbështeten në një histori perandorake të zhdukur ose në një kronikë të kohës së Konstantinit. Disa nga ngjarjet e përshkruara i ka jetuar edhe vetë autori.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Eutropi, Breviarium ab urbe condita, recognovit Franciscus Ruehl, editio Stereotypa. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1909.

EUTROPII

BREVIARUM AB URBE CONDITA

(Histori e shkurtër e Romës qysh nga themelimi i saj)

LIBRI II

11 Po në atë kohë[1] romakët u shpallën luftë tarentasve, të cilët banonin në pjesën më të fundit të Italisë, sepse i kishin fyer keq të deleguarit romakë. Ata thirrën në ndihmë kundër romakëve Pirron, mbretin e Epirit, i cili e mbante veten se rridhte nga fisi i Akilit. Ai menjëherë erdhi në Itali[2], dhe ishte e para herë që romakët luftuan me një armik të përtej detit. Kundër tij u dërgua konsulli P. Valer Levini, i cili si kapi zbuluesit e Pirros, urdhëroi t'i shpinin në lëm për t'u treguar ushtrinë dhe pastaj t'i linte të shkonin, që t'i tregonin Pirros gjithçka që bënin romakët. Nuk shkoi shumë e në betejën që u bë, Pirrua në çastin kur desh të tërhiqej korri një fitore kundër romakëve në saje të elefantëve të tij, të cilët u futën tmerrin, sepse nuk i kishin parë deri atëherë. Po nata i dha fund luftës. Ndërkaq Levini, duke përfituar nga nata iku; Pirrua zuri robër një mijë e tetëqind romakë, të cilët i trajtoi shumë mirë, kurse të vrarët i varrosi. Kur i pa të shtrirë me plagë në gjoks dhe me fytyra të zymta edhe ashtu të vdekur, thuhet se ngriti duart nga qielli duke shqiptuar këto fjalë: "Do të mund të bëhesha zot i gjithë botës, po të më kishin takuar të këtillë ushtarë"!

12 Pastaj Pirrua, si bashkoi rreth vetes samnitët, lukanët, brutët, u drejtua për në Romë dhe shkatërroi me zjarr e hekur gjithçka; shkretoi Kampanjën, erdhi në Preneste, që ishte larg nga qyteti tetëmbëdhjetë mile. Pastaj, ushtria e tmerruar u tërhoq me konsullin e saj në Kampanjë. Të deleguarit që u dërguan tek Pirrua për të kërkuar kthimin e robërve, u pritën me nderime nga ai. Robërit e zënë i dërgoi në Romë pa shpërblim. Fabricin, njërin nga të deleguarit romakë aq e pëlqeu sa, kur mori vesh se ishte i varfër, deshi t'ia mbushte mendjen të hidhej nga ana e tij, duke i premtuar një të katërtën e mbretërisë, po ai ngjalli urrejtje tek Fabrici. Duke pasur Pirrua një nderim të pamasë për romakët, dërgoi si të deleguar të vetin një burrë të shquar, me emrin Kinea, që të kërkonte paqe me kushte të drejta, d.m.th. që Pirrua të merrte për vete atë pjesë të Italisë, që e kishte pushtuar me armë.

13 Kjo paqe nuk u pëlqeu romakëve dhe senati iu përgjegj Pirros se ai nuk do të mund të bënte paqe me romakët derisa të mos ikte fare nga Italia. Atëherë romakët urdhëruan që të gjithë robërit, të cilët Pirrua i kishte kthyer, të njolloseshin me vulën

---

[1] Në vitin 281 para e. sonë.
[2] Në vitin 280 para e. sonë.

e turpit, sepse ishin kapur me armë në dorë dhe nuk do të ktheheshin në gjendjen e lirë të mëparshme, në qoftë se secili prej tyre nuk do të sillte me vete plaçkat e dy armiqve të vrarë. Kështu legati i Pirros u kthye. E kur Pirrua e pyeti se si i ishte
3 dukur Roma, Kinea tha se i ishte dukur sikur qe atdheu i mbretërve; d.m.th. se atje ishin pothuaj të gjithë ashtu si mbahej vetëm Pirrua në Epir e në gjithë Greqinë tjetër.
4 U dërguan kundër Pirros konsujt P.Sulpici e Dec Musi. Gjatë luftimit Pirrua u plagos, elefantët u vranë, njëzet mijë armiq mbetën të vdekur, por nga romakët vetëm pesë mijë. Pirrua iku për në Tarent.

1 **14** Vitin tjetër u dërgua kundër Pirros Fabrici, të cilin nuk e kishte bërë për vete, megjithëse i kishte premtuar një të katërtën e mbretërisë. Në atë kohë, kur ai dhe mbreti i kishin lëmet shumë afër njëri tjetrit, mjeku i Pirros, natën erdhi tek ai dhe i premtoi se do ta helmonte Pirron në qoftë se i premtonte ndonjë shpërblim. Fabrici urdhëroi ta shpinin të lidhur tek zotëria e tij dhe t'i tregonin ato që doktori kishte kurdisur kundër jetë së tij. Atëherë mbreti i çuditur thuhet se u shpreh kështu: "Ai
2 është Fabrici, i cili më vështirë mund të largohet nga nderi, se sa dielli nga rruga e tij". Atëherë mbreti u nis për në Siqeli. Fabrici, si shtroi lukanët e samnitët festoi triumfin. Pastaj u dërguan kundër Pirros konsujt Man Kur Dentati dhe Kornel
3 Lentuli. Kuri luftoi kundër tij[1)], shpartalloi ushtrinë e tij, atë vetë e detyroi të ikte në Tarent dhe i pushtoi lëmin. Atë ditë u vranë njëzet e tre mijë armiq. Kuri festoi triumfin gjatë konsullatës. Ai qe i pari që solli në Romë katër elefantë. Po edhe Pirrua e la më vonë Tarentin dhe u vra në Argo, qytet i Greqisë[2)].

LIBRI III

1 **4** Konsujt L.Postum Albini e Gn.Fulv Centumali luftuan kundër ilirëve dhe mbasi pushtuan shumë qytete detyruan të dorëzoheshin edhe mbretërit. Dhe në atë kohë për të parën herë u festua triumfi mbi ilirët.

LIBRI IV

1 **6** Mbas vdekjes së Filipit[3)], mbretit të Maqedonisë, i cili kishte luftuar kundër romakëve dhe që u kishte dhënë pastaj ndihma atyre kundër Antiohut, i biri i tij, Perseu, ngriti krye në Maqedoni pasi përgatiti ushtri të ëmdha për luftë. Ai kishte
2 bërë për vete Kotyun, mbretin e Thrakisë, dhe mbretin e Ilirisë që quhej Gent. Nga ana tjetër në ndihmë të romakëve ishin Eumeni, mbreti i Azisë, Ariarati i Kapadokisë, Antiohu i Sirisë, Ptolemeu i Egjiptit, Masinisa i Numidisë. Sa për
3 Prusinë e Bitynisë, megjithëse kishte për grua motrën e Perseut, u tregua njëlloj me të dy palët. Konsuli P.Licini, i dërguar si komandant i romakëve kundër Perseut, u mund prej mbretit /Perseut/ në një betejë të madhe. Por megjithëse romakët u mundën, ata nuk pranuan të bënin paqe, siç kërkonte mbreti, por vunë këto kushte: që t'i dorëzoheshin ai dhe njerëzit e tij senatit dhe popullit romak.
4 Menjëherë u dërgua kundër tij konsulli L.Emil Pauli, kurse kundër Gentit në Iliri

---

[1)] Në vitin 275 para e. sonë.
[2)] Në vitin 272 para e. sonë.
[3)] D.m.th. mbas vitit 179 para e. sonë.

pretori G.Anici[1]. Por Genti, i mundur lehtë në një betejë të vetme, u dorëzua menjëherë. Së bashku me të në duart e romakëve ranë edhe nëna e tij, gruaja, dy bijtë dhe i vëllai.
Kështu mbaroi kjo luftë në 30 ditë...

1 **7** Konsulli Emil Pauli u ndesh në luftë me Perseun, në nonën[2] e tretë të Shtatorit dhe e mundi atë, mbasi la të vrarë në fushën e betejës njëzet mijë këmbësorë të tij. E tërë kolona u vu në ikje me mbretin bashkë. Nga romakët mbetën
2 të vrarë njëqind ushtarë. Të gjitha qytetet e Maqedonisë, të cilat i kishte sunduar mbreti, iu dorëzuan romakëve; vetë mbreti i braktisur nga miqtë e tij iu dorëzua Paulit. Por konsulli e priti me nderime e jo si të mundur. Bile nuk lejoi që t'i binte
3 ndër këmbë, siç donte ai, po e aviti pranë vetes në tryezë. Maqedonasve dhe ilirëve iu njoftuan këto vendime nga romakët: se ata i quanin të lirë dhe se do të jepnin gjysmën e atyre taksave që u kishin dhënë mbretërve, që të dukej se populli romak kishte luftuar më tepër për drejtësi, se sa për kopraci. Dhe këtë Pauli e shpalli në kuvendin e një mori popujsh...

1 **8** Pa shkuar shumë kohë, shtatëdhjetë qytete të Epirit që kishin ngritur krye i pushtoi, plaçkën ua ndau ushtarëve. U kthye në Romë me një shkëlqim të paparë në anijen e Perseut e cila thonë se ishte jashtëzakonisht e madhe aq sa, siç tregojnë, ishte e pajisur me shtatëmbëdhjetë sërë lopatash. Hyri me një triumf madhështor mbi një karro ari me dy djemtë e tij, që i rrinin përkrah nga të dy anët. Ecnin përpara dy fëmijët e mbretit dhe vetë Perseu, dyzet e pesë vjeçar. Pas tij edhe Anici festoi
2 triumfin e tij mbi ilirët. Përpara karros ecte Genti me të vëllanë e të bijtë e tij.
3 Mbretër të shumë popujve erdhën në Romë, për të marrë pjesë në këto festa
4 madhështore. Ndër të tjerë erdhën edhe Atali dhe Eumeni, mbretër të Azisë, dhe Prusia i Bitynisë. U pritën me nderime të mëdha, dhe me lejen e senatit, dhuratat që kishin sjellë me vete, i vendosën në Kapitol.

1 **23** Në kohën e konsullatit të M.Porc Katonit dhe Kuint Mark Regit, gjashtëqind e tridhjetë e tre vjet pas themelimit të Romës u dërgua një kalorës në Narbonë të Galisë dhe një vit më vonë[3] konsujt L.Cecil Meteli dhe Kuint Muc Skevola festuan një triumf mbi Dalmatinë.

LIBRI V

1 **7** Në këtë kohë[4] Sula mundi pjesërisht edhe dardanët, skordiskët, dalmatët dhe
2 medët; të tjerët i mori në besë. Po kur erdhën të deleguarit e Mitridatit, i cili i kërkonte paqe, Sula u përgjigj se ai nuk do të bënte paqe, në qoftë se mbreti nuk do të kthehej prapë brenda kufijve të mbretërisë së tij, mbasi të linte të gjitha ato vende që kishte pushtuar.

LIBRI VI

1 **1** Në kohën e konsullatës së M.Elim Lepidit e Kuint Katulit, ndërsa Sula po rregullonte e qetësonte shtetin, u ndezën luftëra të reja, një në Hispanjë, një tjetër në Pamfyli dhe Kiliki, një e tretë në Maqedoni dhe një e katërt në Dalmati...

---

[1] Kjo ngjau në vitin 168 para e. sonë.
[2] Në datën 15 shtator.
[3] Në vitin 120 para e. sonë.
[4] Në vitin 98 para e. sonë.

1 **2** Në Maqedoni u dërgua Ap.Klaudi[1] mbasi mbaroi konsullatin e tij. Ai bëri luftëra të lehta me fise të ndryshme, të cilat banonin në provincën e Rodopit, dhe aty
2 vdiq nga një sëmundje. Si pasardhës i tij u dërgua G.Skribon Kuri, mbasi mbaroi konsullatin e tij. Ai shtroi dardanët dhe u fut deri në Danub, duke meritùar një triumf, dhe brenda tre vjetësh i dha fund luftës.

1 **4** Në Ilirik u dërgua si prokonsul G.Koskoni[2]. Ai nënshtroi një pjesë të madhe të Dalmatisë, pushtoi Salonën dhe si i dha fund luftës, u kthye në Romë mbas dy vjetësh.

1 **17** G.Jul Cezari, i cili pastaj mori pushtetin në dorë, u bë konsull me L.Bibulin, në vitin gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre pas themelimit të Romës[3]. Iu dha me ligj
2 Galia dhe Iliria me dhjetë legjione. Ai së pari mundi helvetët që tashti quhen sekuanë, pastaj, duke dalë fitimtar në luftëra shumë të rënda, vazhdoi udhën e tij deri në Oqeanin Britanik.

2 **19** ... Për këtë padrejtësi, ai u nis kundër atdheut me një ushtri nga Arimini, ku
3 kishte grumbulluar forcat e tij. Konsujt bashkë me Pompeun dhe gjithë senatin dhe me tërë fisnikët ikën nga Roma dhe erdhën në Greqi[4]. Në Epir, Maqedoni dhe Ahe, nën udhëheqjen e Pompeut, senati u përgatit për luftë kundër Cezarit.

LIBRI VII

1 **7** Ky /Antoni/ ndezi edhe një luftë të madhe civile, i shtyrë nga Kleopatra, e cila dëshironte të sundonte edhe në Romë me të gjitha epshet e një femre. Ai u mund nga Augusti në luftën e famshme e të shkëlqyer detare të Aktit[5] që është një vend i Epirit; që këtej mori arratinë për në Egjipt dhe duke mos i mbetur asnjë shpresë, kur të gjithë u hodhën në anën e Augustit, vrau veten...

1 **9** Në asnjë kohë, përpara tij /Oktavianit/, nuk lulëzoi aq shumë shteti romak. Sepse, mbasi u bëri ballë luftërave qytetare, në të cilat doli i pamundur, i shtoi perandorisë romake Egjiptin, Kantabrinë, Dalmatinë e mundur shpesh herë më përpara, por mezi e nënshtruar plotësisht deri atëherë, Panoninë si edhe Akuitaninë, Ilirikun, Retinë, vindelikët e salasët në Alpe, të gjitha qytetet detare të Pontit, dhe më të shkëlqyeshmet ndër to Bosporin e Pantikapenë. Mundi edhe pas shumë luftimesh dakët...

LIBRI IX

1 **4** Mbas tyre[6] pushtetin e mori Deci i lindur në Budalie, në Panoninë e Ulët. Ai shtypi luftën civile që plasi në Gali[7]. E bëri të birin e ti cezar[8]. Ndërtoi një banjë në Romë. Mbasi ai dhe i biri i tij sunduan dy vjet, që të dy u vranë në tokën barbare[9]. I

---

[1] Klaudi u dërgua për të shtypur kryengritjen e fiseve të ndryshme në vitin 78 para e. sonë.
[2] Po në këtë vit qe dërguar në Iliri për të shtypur kryengritjen e dalmatëve prokonsulli G.Koskoni.
[3] Në vitin 60 p. e. sonë.
[4] Kjo ngjau në vitin 49 para e. sonë.
[5] Kjo fitore e madhe u bë në vitin 31 para e. sonë.
[6] D.m.th. mbas Filip Arabit dhe birit të tij, perandorë romakë që sunduan në vitet 244-249.
[7] Galia përfshinte tokat e sotme të Francës dhe të Belgjikës.
[8] D.m.th. bashkësundimtar. Emri i tij i plotë ishte Q.Herennius Etruscus Messius Decius.
[9] Deci dhe i biri i tij u vranë në luftim me gotët, në vitin 251, në Myzinë e Ulët.

ati e meritoi të hyjnizohet. **8** Galieni, megjithëse i ri, u bë perandor, në fillim sundoi i lumtur, pastaj mirë, kurse në fund me humbje... Atëherë humbi provinca Dake, që qe krijuar nga Trajani përtej Danubit. Greqia, Maqedonia, Ponti dhe Azia u shkretuan nga gotët. Panonia u plaçkit nga sarmatët dhe kuadët. Gernanët u futën deri në provincat Hispanike dhe pushtuan qytetin e njohur Tarakon. Parthët pushtuan Mesopotaminë dhe filluan të kenë kërkesa mbi Sirinë.

11 Ndërkaq Galieni u vra së bashku me vëllanë e tij në Mediolan, në vitin e nëntë të sundimit të tij. Pas tij erdhi Klaudi, i zgjedhur nga ushtarët dhe i emëruar nga senati perandor. Ai i mundi në një betejë të madhe gotët, të cilët shkretuan Ilirikun dhe Maqedoninë[1]. Ai qe kursimtar, i matur, burrë i drejtë dhe i përshtatshëm për të drejtuar shtetin, por vdiq nga sëmundja mbas dy vjetësh sundimi. Qe shpallur "hyjnor". Senati e vlerësoi atë me një nder të madh, duke urdhëruar që të vendoset një bust në kurie edhe një shtatore e artë në Kapitol.

13 Mbas tij /Klaudit/ e mori sundimin Aureliani, i lindur në Dakinë Ripense[2]. Ai qe ushtarak i zoti, porse me një shpirt jo të qetë, dhe i prirur për mizori.

15 Aureliani e rrethoi qytetin e Romës me mure akoma më të forta. Ndërtoi tempullin e Diellit, në të cilin vendosi një sasi të pamasë ari dhe gurësh të çmuar. Ai la provincën e Dakisë, që Trajani e pati krijuar përtej Danubit, pasi e humbi shpresën se mund ta mbante, meqenëse i gjithë Iliriku dhe Myzia[3] qenë shkretuar. Duke i tërhequr romakët nga qytetet dhe fushat e Dakisë, ai i vendosi në mes të Myzisë dhe e quajti këtë krahinë Daki[4]. Tani ajo ndan dy Myzitë dhe është në të djathtë të rrjedhës së Danubit, kurse më parë ishte në të majtë. Ai u vra nga mashtrimi i një skllavi të tij, i cili, duke imituar shkrimin e tij, përpiloi një listë të rreme për disa ushtarë, shokë të tij, të cilët gjoja Aureliani përgatitej t'i vriste, dhe ua dërgoi atyre. Dhe kështu, që t'i dilnin punës përpara, ata e vranë gjatë udhëtimit të tij në rrugën e vjetër midis Konstantinopolit dhe Heraklesë. Vendi quhet Kenofrurion. Por vdekja e tij nuk mbeti pa u hakmarrë. Dhe ai, gjithashtu, meritoi të hyjnizohet.

17 /Probi/ u lejoi galëve dhe panonëve që të mbajnë vreshta, dhe me ndihmën e ushtrisë mbolli me hardhi malin Alma, pranë Sirmit, dhe Aureun, pranë Myzisë së Sipërme, dhe ua dha provincialëve që t'i kultivojnë... Por ai u vra në Sirm gjatë një kryengritjeje ushtarësh, në një kullë hekuri.

22 Dhe kështu, kur në të gjithë botën gjendja ishte e ngatërruar, kur Karausi[5] ngriti krye në Britani, Akili[6] në Egjipt, kuinkuegentianët[7] kërcënonin Afrikën,

---

[1] Me Maqedoni autori, me sa duket, ka parasysh dioqezën e mëvonshme të Maqedonisë, e cila përfshinte gjithë Greqinë e sotme, Shqipërinë dhe pjesë nga Maqedonia e jugut.

[2] Dakia Analumase (buzë Danubit).

[3] Me Myzi këtu kuptohet me sa duket Myzia e Ulët.

[4] Është fjala për lënien e Dakisë përtej Danubit, dhe krijimin e një province të re të Dakisë nga perandori Aurelian, me sa duket në vitin 270. Ajo përfshinte tokat që shtriheshin në provincat e deriatëhershme, Myzia e Sipërme, Myzia e Ulët dhe Thrakia. Menjëherë pas kësaj, kjo Daki u nda në dy provinca: Dacia Ripensis (Analumase) dhe Dacia Mediterranea (E brendshme). Dihet me siguri se këto dy Daki në vitin 282 ishin si dy provinca të veçanta.

[5] Karausi është pretendent për perandor në Britani (286-293). Ka qenë kundërshtar i Konstanc Klorit.

[6] Akili, komandant ushtarak në Egjipt, i cili ngriti krye kundër Diokletianit. Kryengritja qe shtypur në vitin 296.

[7] Me emrin "kuinkuegentianë" quheshin disa fise numide.

Narseu[1] luftonte kundër provincave lindore, atëherë Diokletiani e bëri Maksimian Herkulin nga cezar august, kurse Konstantinin[2] dhe Maksimianin – cezarë. Konstanti, siç thuhet, qe nip nga motra e Klaudit[3], kurse Maksimian Galeri lindi në Daki, jo larg nga Serdika.

1 **24** Dhe kështu, pasi u mund[4], /Galer Maksimiani/ u drejtua tek Diokletiani. Thonë se kur e ndeshi në rrugë, Diokletiani e priti aq me kryelartësi, saqë ai, edhe pse i veshur me rroba të purpurta, ngiste disa mile pas karrocës. Por menjëherë, pasi mblodhi ushtri nga Iliriku dhe Myzia, ai përsëri nisi luftën në Armeni me Narseun, gjyshin e Hormisdës[5], dhe Saporin[6], dhe këtë me një sukses të madh dhe me një pjekuri jo më të vogël, gjithashtu edhe me guxim...

2 Dhe pastaj /Diokletiani dhe Maksimiani/ ndërmorën, së bashku dhe me guxim, disa luftime[7] dhe pasi nënshtruan karpët dhe bastarnët dhe mundën sarmatët, vendosën në krahinat[8] romake një numër të madh roberish të zënë nga këta pouj.

LIBRI X

1 **1** Dhe kështu, pas tërheqjes së tyre nga drejtimi i shtetit, u zgjodhën si augustë Konstanti dhe Galeri dhe tokat romake u ndanë në mes tyre; kështu që Konstanti mori Galinë, Italinë, Afrikën, kurse Galeri - Ilirikun, Azinë dhe Orientin[9]. Ata zgjodhën dhe dy cezarë.

1 **2** Galeri, burrë i drejtë dhe i zoti në punët e luftës, kur mori vesh se me lejen e Konstantit, pjesës së perandorisë që ai administronte po i shtohej edhe Italia, zgjodhi dy cezarë: Maksimianin, të cilin e vuri në krye të Orientit, dhe Severin të cilit i dha Italinë[10]. Ai vetë qëndroi në Ilirik.

1 **5** Kurse Konstantini[11], burrë i madh dhe i aftë për të arritur çdo gjë që i shkonte ndërmend, duke dashur të arrijë pushtetin mbi gjithë botën, filloi luftën me Licinin, megjithëse ishte i afërt me të: motra e tij Konstantia ishte martuar me Licinin. Dhe kështu, së pari ai sulmoi menjëherë dhe mundi Licinin, i cili me përgatitje të mëdha ishte bërë gati për luftë në Panoninë e Dytë, pranë Cibalit, dhe zaptoi provinca të shumta, gjithë Dardaninë, Myzinë, Maqedoninë.

1 **6** Pas kësaj, në mes tyre u zhvilluan disa luftime dhe paqja herë vendosej, herë prishej. Më në fund Licini, i mundur në tokë e në det u dorëzua në Nikomedi dhe megjithë shenjtërinë e betimit, u vra si një njeri privat në Thesalonik.

---

[1] Narseu është sundimtar i Persisë, i mundur nga Galeri në vitin 297.
[2] Konstant Klori dhe Galeri u shpallën si cezarë më 1 mars 293.
[3] Klaudi II got (268-270).
[4] Në vitin 296 Galeri u mund nga sundimtari persian Narseu në Mesopotami dhe mezi shpëtoi.
[5] Hormisda është sundimtar persian nga fundi i shek. III.
[6] Sapori II është sundimtar i shquar persian, i cili sundoi nga vitit 310-379.
[7] Këto luftime u zhvilluan në vitet 295-296.
[8] Një numër i madh i tyre qenë vendosur në tokat e Gadishullit Ballkanik.
[9] Është fjala për dioqezet Azia dhe Orienti, të cilat përfshinin Azinë e Vogël të sotme, Sirinë, Palestinën etj.
[10] Maksimin Daja (305-313) mori Orientin, kurse Flav Valer Severi (305-307) mori Panoninë, Italinë dhe Afrikën.
[11] Konstantini I, i njohur si Konstantini i Madh, perandor që nga vitit 305 e deri në vitin 337.

2 **10** Pas vrasjes së Konstansit[1], kur Magnenti[2] sundonte në Itali, Afrikë dhe në provincat gale, në Ilirik shpërthyen turbullira për shkak se Vetrani[3], me pëlqimin e ushtarëve u zgjodh perandor. Ata e zgjodhën për perandor që të mbronte Ilirikun, meqenëse ishte i vjetër dhe i dashur prej të gjithëve, për shkak të shërbimit të tij të vazhdueshëm dhe të lumtur. Ai qe i ndershëm, me veti morale të mira dhe me sjellje të këndshme, por aq i paditur, saqë edhe gërmat e alfabetit mezi i mësoi në pleqëri, dhe këto më tepër si perandor.

1 **15** Më vonë pasi u hoqën nga roja e Galisë ushtritë germane, Juliani, me pëlqimin e ushtarëve u bë August, dhe vitin tjetër, kur Konstanti[4] u nis për të marrë në dorëzim Ilirikun ishte i zënë me luftën kundër parthëve.

---

[1] Konstansi, perandor romak (337-350).
[2] Magnenti, perandor romak (350-353).
[3] Vetrani, pretendent për perandor në vitin 350.
[4] Konstant Gali (351-354)

AUREL VIKTORI

Aurel Viktori, me prejardhje fshatare, lindi në Afrikë aty nga fillimi i shek. IV të e. sonë. Në vitin 361 ai u emërua sundimtar i provincës së Panonisë së Ulët, ndërsa në kohën e perandorit Teodos I u bë prefekt i Romës. Pak kohë mbas këtij emërimi ai ngjan të ketë vdekur.

Vepra e tij "Liber de Caesaribus" (Libër mbi perandorët), fillon aty ku mbaron historia e Tit Livit dhe përshkruan ngjarjet që nga Augusti deri tek Konstanti II (viti 360). Në këtë vepër midis të tjerash gjejmë edhe disa të dhëna të rëndësishme për historinë e Ilirisë në periudhën perandorake. Për kohën para tij, Aurel Viktori mbështetet kryesisht tek Eutropi, të cilin shpesh herë e kopjon fjalë për fjalë.

Aurel Viktori konsiderohet gjithashtu edhe si autor i dy veprave të tjera "Liber de viris illustribus urbis Romae" (Libër mbi njerëzit e shquar të qytetit të Romës) dhe "Origo gentis Romanae" (Prejardhja e popullit romak). Nga një autor i panjohur kemi një përmbledhje të librit të tij mbi perandorët, shkurtim ky që mban titullin "Epitome de Caesaribus". Në të përfshihen edhe disa materiale të reja, që trajtojnë periudhën mbas vitit 360 e deri në kohën e Teodosit I (379-395).

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Sexti Aurelii Victoris Liber de Caesaribus, Praecedunt *Origo gentis Romanae et Liber de viris illustribus urbis Romae*, subsequitar *Epitome de Caesaribus*, recensuit Franciscus Pichlmayr. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1911.

SEXTI AURELII VICTORIS

LIBER DE CAESARIBUS

(Libër mbi perandorët)

1) LIBER DE VIRIS ILLUSTRIBUS URBIS ROMAE

(Mbi njerëzit e shquar të qytetit të Romës)

35 Pirrua, mbret i epirotëve, nga e ëma me prejardhje prej Akilit, kurse nga i ati prej Herkulit, duke dashur të sundonte botën dhe duke parë romakët e fuqishëm, u kështillua me Apollonin për çështjen e luftës. Ai iu përgjigj me dy kuptime: "Të them o Aiakid, se romakët mund t'i mundësh". Ai pasi i shpjegoi këto fjalë ashtu si i pëlqeu, me ndihmën e tarentasve u shpalli luftë romakëve. Konsullin Levin ai e çorientoi pranë Heraklesë me futjen në luftë të elefantëve. Ai /Pirrua/ kur pa romakët e vrarë me plagë në gjoks tha: "Unë me ushtarë të tillë do mund të nënshtroja botën brenda pak kohe". Miqve që po e përgëzonin u tha: "Çfarë fitore do të kem unë në qoftë se humbas fuqinë ushtarake?" Lëmin e vendosi te guri i 20-të larg Romës[1]; Fabricit ia ktheu robërit pa shpërblim... I mundur nga Kuri dhe Fabrici iku në Tarent dhe doli në Siqeli... Atëherë u tërhoq në Greqi dhe ndërsa po sulmonte Argon u vra nga një tjegull. Trupi i tij, pasi u dërgua tek Antigoni, mbreti i Maqedonisë, u varros me nderime.

75 Si konsull /Kornel/ Sula mori me short Azinë dhe në një betejë shpartalloi Mitridatin pranë Orhomenit dhe Keronesë[2], në Athinë mundi prefektin e tij Arhelaun, pushtoi limanin e Pireut dhe gjatë rrugës theu medët dhe dardanët.

2) LIBER DE CAESARIBUS

(Libri mbi perandorët)

1 Dhe në këtë mënyrë Oktaviani, afërsisht mbas 44 vjetësh vdiq në Nola, pasi shtriu sundimin mbi banorët e Retisë dhe Ilirikut dhe ndaloi sulmet e fiseve të jashtme, përveç atyre të Germanisë; ai që i treti pas Numës, që pasi mundi Antonin, mbylli tempullin e Janit[3], gjë që sipas së drejtës romake bëhej mbas mbarimit të luftërave.

---

[1] Gur milje.
[2] Në vitin 86 para e. sonë.
[3] Simbas traditës së vjetër, kur shpallej lufta, në Romë hapeshin dyert e tempullit të Janit, përëndi me dy fytyra.

1 **29** Deci i lindur në një fshat të Sirmit, filloi karrierën si ushtar dhe arriti deri tek pushteti perandorak. Shumë i kënaqur nga vrasja e armiqve të tij[1], ai bëri cezar të birin e tij të quajtur Etrusk. Pas kësaj e dërgoi /atë/ menjëherë në Ilirik, kurse vetë qëndroi për një farë kohe në Romë që të inauguronte muret që ndërtoi.

3 **33** Meqenëse këto ngjarje[2] u zhvilluan në mënyrë të favorshme dhe papritmas, Galieni, siç ndodh zakonisht tek njerëzit, ra në shkujdesje për shkak të suksesit të tij dhe së bashku me të birin Saloninin, të cilin e bëri cezar, e shtyu shtetin romak në mbytjen e anijeve. Gjendja arriti deri atje saqë gotët kaluan lirisht Thrakinë dhe pushtuan Maqedoninë, Ahenë dhe krahinat aziatike fqinje me to[3]; parthët pushtuan Mespotaminë, kurse në Orient sundonin kusarë dhe bile një grua[4]... humbën edhe tokat përtej Istrit që i kishte pushtuar dikur Trajani.

1 **37** Akoma s'kishte një ose dy muaj që mbante pushtetin[5] dhe u vra nga ushtarët
2 e tij pranë Tarsit[6], pasi ata mësuan se në Ilirik ishte bërë pernador Probi – pothuaj Hanibali i dytë, për njohuritë e tij të mëdha ushtarake në lidhje me stërvitjen e gjithanshme të ushtarëve dhe në kalitjen e rinisë. Dhe me të vërtetë, ashtu si Hanibali
3 mbolli pjesën më të madhe të Afrikës me ullinj me ndihmën e legjioneve, pushimi i të cilëve shikohej si diçka e dyshimtë nga shteti dhe komandantët, po në të njëjtën mënyrë Probi e mbushi Galinë, provincat e Panonisë dhe kodrat e Myzisë me hardhi, kuptohet, pasi qenë zhdukur fiset barbare, të cilat u futën për shkak se perandorët tanë u vranë nga dora kriminale e njerëzve të tyre. Njëkohësisht me këtë u mundën nga ushtria Saturnini[7] në Orient dhe Bonosi në Agripinë, për arsye se që të dy bënë përpjekje të merrnin pushtetin me forcat ushtarake, që ata komandonin. Për këtë arsye, pasi çdo gjë ishte ripushtuar dhe qetësuar, flitet se ai pati thënë se së shpejti ushtarët do të jenë të tepërt.
4 Për këtë arsye, ata shumë të zemëruar më në fund e vranë atë[8] rreth vitit të gjashtë[9] në Sirm, kur i detyroi të thanin me anë kanalesh qytetin e tij të lindjes, i cili për shkak të tokës moçalore dëmtohej nga ujërat e dimrit.

22 **39** Në të njëjtën kohë[10] persët kërcënonin shumë Orientin, kurse Juliani dhe fiset kuinkuengentane[11] Afrikën. Prej këtu një i quajtur Akil, përvetësoi shenjat
23 e pushtetit perandorak në Aleksandrinë e Egjiptit. Për këtë arsye /Diokletiani
24 dhe Maksimiani/ zgjodhën për cezarë Jul Kostantin dhe Galer Maksimianin, e mbiemëruar "Armentari"[12] dhe u bënë kushërinj me ta. Pasi u ndanë me

---

[1] Është fjala për vrasjen e perandorëve Filip Arabit e birit të tij.
[2] Është fjala për luftën e Galienit kundër pretendentëve për pushtetin perandorak, Ingenit dhe Regalianit në Ilirik (viti 258).
[3] Këtu bëhet falë për shkretimet e mëdha të krahinave ballkanike dhe të Azisë së Vogël nga gotët, markomanët së bashku me karpët, boranët, burgundët dhe sarmatët rreth viteve 60 të shek. III.
[4] Është fjala për Zenobën, sundimtaren e Palmyrës.
[5] Mark An Floriani, pretendent për pushtetin perandorak, i ngritur nga disa reparte të Azisë së Vogël.
[6] Tarsi, qytet në Kiliki.
[7] Saturnini u shpall si perandor në Aleksandri. Pas pak kohe ai qe thyer nga ushtria e Probit (280).
[8] Probin.
[9] Viti i gjashtë i sundimit të tij.
[10] Në vitet 293-296.
[11] Me këtë emër quheshin disa fise numide.
[12] Armentari, do të thotë "Çobani".

bashkëshortet e para të tyre, i pari mori thjeshtrën e Herkulit[1], kurse tjetri – të bijën e Diokletianit, po ashtu sikurse dikur Augusti veproi me Neronin, Tiberin dhe të bijën e tij Julien.

Atdheu i gjithë këtyre[2] ka qenë Iliriku. Megjithëse pak të qytetëruar, ata kanë qenë mjaft të kalitur në vështirësitë e jetës fshatare dhe ushtarake dhe qenë shumë të dobishëm për shtetin.

Dhe meqenëse vështirësitë e luftërave, për të cilat folëm më sipër, e shtrëngonin përherë e më tepër tërë shtetin, ai u nda në katër pjesë: Galia përtej Alpeve iu besua Konstantit, Afrika dhe Italia – Herkulit, Galerit – tokat e Ilirikut, deri tek ngushticat e Pontit, kurse tokat e tjera – Valerit. Në këtë kohë[3] u thyen markomanët[4], dhe fisi i karpëve një pjesë e të cilit qe shpërngulur që nga koha e Aurelianit, tani u vendos i tëri në tokën tonë.

40 Galeri i zemëruar akoma më tepër nga kjo gjë, pasi u këshillua me Jovin[5], shpalli si perandor Licinin me të cilin e lidhte një miqësi e vjetër. Ai e la atë për të mbrojtur Ilirikun dhe Thrakinë dhe u nis për në Romë...

Galeri vdiq nga një plagë e pashërueshme. Ai pati fituar në Panoni toka mjaft të dobishme për shtetin, pasi preu pyje shumë të mëdha dhe lidhi me Danubin liqenin Pelson[6].

Për këtë ai e quajti provincën me emrin e gruas së tij Valeria[7].

41 Atëherë Vetrani, me prejardhje nga vendet e egra të Myzisë së Sipërme, njeri krejtësisht analfabet, i trashë nga mendja dhe për këtë arsye shumë i keq nga padituria e tij, pati marrë në mënyrë jo të ndershme pushtetin[8], meqenëse kujdesej për ushtarët e tij, si komandant i ushtrive në Ilirik.

3) EPITOMAE DE CAESARIBUS

(Shkurtim i librit mbi perandorët)

29 Deci, i lindur në Bubalia, në Panoninë e Ulët, sundoi 30 muaj.

35 Aureliani rridhte nga një baba i thjeshtë i cili, siç tregojnë, ka qenë kolon, i shumë të ndriturit senatorit Aurel diku në mes Dakisë dhe Maqedonisë. Ai sundoi 5 vjet dhe 6 muaj...

Në këtë kohë Septimi, pasi u shpall perandor tek dalmatët u vra menjëherë prej të vetëve.

37 Probi, i biri i një fshatari, që merrej me kopshtari dhe emri i të cilit ishte Dalmat, sundoi 6 vjet. Ai i theu perandorët e shpallur: Saturninin në Orient, Prokulin dhe Bonosin në Agripinë. U dha leje galëve dhe panonëve që të kenë hardhi. Me punën e ushtarëve mbolli me hardhi malin Alma në Sirm dhe Aureun në Myzinë e Sipërme. Ai u vra në Sirm në një kullë hekuri.

---

[1] Maksimian Herkuli, bashkaugust i Diokletianit.
[2] D.m.th. i katër perandorëve të lartpërmendur.
[3] Në vitin 295.
[4] Markomanët, fis german qenë thyer në vitin 295, kurse karpët në vitin 296.
[5] Me emrin Jov mbiquhej Diokletiani.
[6] Pelson, liqeni i sotëm Balaton.
[7] Provinca Valeria, e shkëputur nga provinca e Panonisë së Ulët, në periudhën mbas Diokletianit përfshinte Hungarinë e sotme Perëndimore, me kufirin lindor lumin Danub.
[8] Mbas vrasjes së perandorit Konstans, ushtritë në Ilirik ngritën si perandor plakun Vetran. Kjo ndodhi me 1 mars të vitit 350.

39 Diokletiani dalmatas, libert i senatorit Anulin, para se të merrte sundimin quhej Diokles, emër të cilin e kishte nga mëma dhe njëkohësisht nga qyteti Diokle, por kur mori fuqinë e shtetit romak e ndërroi emrin në Graj sipas zakonit romak, dhe sundoi 25 vjet.

40 Pasardhësit e Diokletianit, nga karakteri kanë qenë të tillë: Aurel Maksimiani, i mbiquajtur Herkul, ka qenë i egër nga natyra, i ndezur nga pasioni, budalla në këshillat e tij. Rridhte nga një familje fshatare në Panoni. Edhe sot afër Sirmit gjendet një vend, ku ka qenë ndërtuar një pallat. Atje prindërit e tij punonin si mëditës.

41 Dhe kështu, pushteti në perandorinë romake qe ndarë në mes tre bijve të Konstantinit: Konstantinit, Konstantit dhe Konstansit. Secili nga ata morën veçmas, për të sunduar këto pjesë: Konstantini i ri – të gjitha tokat përtej Alpeve; Konstanti – Azinë dhe Orientin, duke filluar nga ngushticat e Propontit; Konstansi – Ilirikun, Italinë dhe Afrikën; Delmati – Thrakinë, Maqedoninë dhe Ahenë; Hanibaliani, i vëllai i cezar Delmatit – Armeninë dhe popuj fqinjë.

44 Joviani, i biri i Varronianit, banues i tokës së Singidunit, provincës së Panonisë, sundoi 7 muaj.

46 Valenti, së bashku me vëllanë Valentinianin, për të cilin folëm më sipër, sundoi 13 vjet dhe 5 muaj. Ky Valent, kur filloi luftën e përgjakshme me gotët, i plagosur nga shigjeta, u soll në një kalibe të varfër fshatare. Gotët arritën papritmas, e dogjën atë, dhe ai vetë u dogj në zjarr.

Valenti kishte këto cilësi për t'u lavdëruar: qe mbrojtës i mirë i bujqve, i ndryshonte shumë rallë gjyqtarët, qe besnik ndaj shokëve të tij, zemërohej por pa dëmtuar dhe pa qenë i dëmshëm për ndonjërin, por qe shumë i pavendosur.

47 Gratiani i lindur në Sirm, sundoi bashkë me të atin 8 vjet e 85 ditë...

Kur *[Gratiani]* vuri re se Thrakia dhe Dakia ishin bërë pothuaj tokë amtare e zotëruesve të tyre gotë dhe taifalë, dhe se një rrezik i madh i kërcënohej pushtetit romak nga hunët dhe alanët, më të egër ndërmjet të egërve, thirri nga Hispania Teodosin[1)], i cili po kalonte vitin e 33-të të tij, dhe me pëlqimin mirëpritës të të gjithëve, i dha një të tretën e perandorisë.

48 Teodosi, i biri i Honorit dhe Termantisë, me prejardhje hispane dhe me origjinë nga perandori Trajan, pasi u shpall perandor pranë Sirmit nga Augusti Gratian, sundoi 17 vjet. Dhe Teodosi qe një zgjerues dhe mbrojtës i shkëlqyer i shtetit. Kështu në beteja të ndyshme mundi hunët dhe gotët, të cilët e patën dobësuar atë gjatë sundimit të Valentit.

[1)] Teodosi I, perandor romak.

PANEGJIRIKËT LATINË

Titulli Panegjirikët latinë (Panegyrici latini) i është dhënë një përmbledhësi prej 12 fjalimesh lëvduese drejtuar perandorëve romakë nga Trajani deri tek Teodosi I. Ne njohim vetëm disa nga oratorët që i mbajtën këto fjalime: Eumenin dhe Nazarin, bashkëkohës të perandorëve Diokletian dhe Konstantin; Klaud Mamertinin, që zinte poste të larta (ndër të tjera edhe sundimtar i prefekturës së Ilirikut) në kohën e Julianit (361-363), të cilit i thur lëvdata, dhe Pakatin që mburr sundimin e perandorit Teodosit I.

Nga këta Eumeni përfaqëson prozën e vonë romake. Veprimtarinë e tij letrare ai e zhvilloi kryesisht në Gali. Nga fjalimet e tij ne kemi zgjedhur ato pasazhe që interesojnë Ilirikun.

Fjalimet për Maksimilian Herkulin, që po i japim këtu pjesërisht, nuk kanë asnjë lidhje me Mamertinin, që përmendëm sipër, por me një orator tjetër me të njëjtin emër.

Në përgjithësi fjalimet e panegjirikëve, me përjashtim të atij të Pakatit, nuk kanë ndonjë vlerë të madhe historike. Qëllimi i tyre kryesor është të ngrenë në qiell, me fraza dhe fjalë të mëdha, shërbimet që i paskëshin sjellë perandorisë romake perandorët, të cilëve i kushtohen fjalimet. Për historinë e Ilirisë ato kanë një farë vlere, mbasi përmbajnë disa të dhëna të veçanta. Në to flitet sidomos për dyndjet e barbarëve në tokat e Ballkanit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Aemilius Baehrens, XII Panegyrici Latini. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1874.

6 **XI** Dhe kështu, pasi shtypi me një përpjekje të madhe, kryengritjen e alamanëve[1], ai /Juliani/ i cili pak përpara kishte përshkuar në krye të një ushtrie fitimare krahina, lumenj dhe male me emra akoma të padëgjuar, duke fluturuar nëpër mbretëritë më të largëta të popujve të egër dhe duke prerë koka mbretërish, u duk papritur në Ilirik[2]. Dhe ne pamë me çudi, shoqëruesit e lumtur të udhëtimit të tij, dhe se si popullsia e qyteteve nuk dinte nëse duhej besuar ajo që shihte.

7 Për plotësimin e detyrave, që i dilnin përpara, mund të ishte me të vërtetë e mjaftueshme vetëm shpejtësia, por perandori ynë nuk kënaqej, duke u kujdesur për shtetin vetëm në një mënyrë. Ai u mor përnjëherësh me shumë gjëra pa u lodhur nga vështirësitë. Dhe që të mund të rregullonte në të njëjtën kohë gjendjen e provincave të tij më besnike, dhe njëkohësisht t'i çorientonte të gjithë barbarët, duke i frikësuar nga afër, ai vendosi të lundrojë vazhdimisht nëpër Hister...

9 Dhe si qe e mundur, duke lundruar nëpër Hister, të përhapësh të mira deri në detin Adriatik, deri në detin Tyrren, deri në Mareotikë? Dhe me të vërtetë, pikërisht në këtë kohë dalmatët u lehtësuan nga çmimet shumë të mëdha të kuajve[3], kurse epirotët të dërrmuar nga barra e padurueshme e taksave, nëpërmjet kujdesit tënd o perandor, jo vetëm shpëtuan nga skamja, por bile u qe ritkhyer një jetë e pasur dhe e begatshme. Qyteti Nikopol, të cilin i hyjnizuari August e ndërtoi si monument përkujtimor për fitoren pranë Aktit, u shndërrua pothuaj i tëri në gërmadha të vajtueshme: u shkatërruan shtëpitë e fisnikëve, forumet mbetën pa mbuloje dhe çdo gjë u mbulua nga ndyrësia, dhe pluhuri, meqenëse nuk tregohej kujdes për ujësjellësit... Mjafton të dihet se gjithë qytetet e Maqedonisë, Ilirikut dhe Peloponezit me një ose dy urdhëra të perandorit të madh, përnjëherësh u përtërinë pasi u rindërtuan muret e tyre. Në të gjitha vendet filloi të rrjedhë uji, dhe ajo që para pak kohe ishte e thatë dhe po zhuritej nga etja, tani u mbyt në ujët e pastër e të rrjedhshëm: sheshet, vendet për shetitje, gimnazet u mbushën me njerëz të gëzuar që dëfrenin, kremtonin ditët e festave të vjetra dhe festoheshin të reja për nder të perandorit.

---

[1] Është fjala për luftat e Julianit në Gali në vitet 355-359 kundër alamanëve dhe fiseve të tjera germane.
[2] Këtu autori ka parasysh arritjen e Julianit në Sirm.
[3] Përpara romakët u merrnin dalmatëve si detyrim kuaj. Më vonë ky detyrim ose taksë në natyrë u zëvendësua me vleftën e kalit në para, vleftë e cila shtohej vazhdimisht. Në kohën e Julianit, me sa duket, kjo vleftë u ul. Krahaso Cod. Theod. XI 17,1.

32 **XII** ... Më në fund ti[1] u jep të drejtën që të kryejnë shërbimin ushtarak bashkë me ne, poujve barbarë të cilët premtojnë se do të shërbejnë vullnetarisht, në mënyrë që të hiqen nga limesi këto hordhi të dyshimta dhe të kthehen në forca ndihmëse të ushtrisë sonë. Të tërhequr nga kjo mirësi e jotja, të gjitha fiset skythe[2] erdhën në një numër aq të madh, saqë dukej sikur t'i kishe urdhëruar të mblidheshin rekrutë të rinj nga barbarët e tu. O vepër e denjë për t'u përmendur! Pas komandantëve dhe flamujve romakë, marshonte armiku i dikurshëm i Romës dhe ndiqte flamujt, kundër të cilit pati luftuar. Dhe tani si ushtar romak ai mbushte qytetet e Panonisë, të cilat jo shumë kohë përpara ai i pati çpopulluar me sulmet e tij...

[1] Është fjala për Teodosin I (379-395)
[2] Është fjala këtu për gotët.

AMIAN MARCELINI

Amian Marcelini lindi ndërmjet viteve 332 e 335 të e. sonë në Antiohi të Sirisë. Ishte me prejardhje greke, por i pëlqente të hiqej si romak dhe të shkruante në gjuhën latine. Shërbeu në ushtri në kohën e Konstantit II. Më vonë në vitin 360 u tërhoq në jetën private. Në vitin 378 vendoset përfundimisht në Romë, ku i vuri vetes për detyrë të shkruajë historinë e Romës aty ku e kishte ndërprerë Taciti. Kjo vepër e njohur me titullin "Res Gestae" (Historia) është një nga më të mirat e më të përpiktat e historiografisë romake. Përbëhej nga 31 libra dhe trajtonte kohën nga perandori Nerva (viti 96 i e sonë) e deri tek Valensi (viti 378 i e. son). Nga kjo vepër na janë ruajtur vetëm librat 14-31, ku autori flet mbi historinë e kohës së tij që nga viti 353 deri në vitin 378.

Amiani ishte pagan, ai kishte një simpati të madhe për Julianin, megjithëkëtë gjykimi që jep mbi të është më se objektiv; ai nuk i kalon në heshtje gabimet e tij. Historia e Amianit i përshtatet shijes së kohës dhe ka paraqitje retorike, por shpesh herë ai del nga tema duke u hedhur në tregimet me brendi gjeografike.

Vepra e Amianit i lë shumë pas të gjitha burimet e tjera historike të kohës qoftë përsa i përket vlerës së saj historike, qoftë dhe paanshmërisë. Kjo vepër ka një rëndësi burimore të dorës së parë edhe për historinë e Ilirikut në shek. IV. Në të jepen të dhëna me karakter historik, gjeografik dhe etnografik; përmenden qytete, kështjella dhe rrugë, flitet për masat që mori Roma për mbrojtjen e pellgut të Danubit dhe brendisë së vendit; jepen gjithashtu të dhëna nga jeta ekonomike, shoqërore dhe administrative, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Collection des auteurs latins, Ammien Marcellin etc. avec la traduction en français publiées sous la direction de M. Nisard. Paris 1869.

AMMIANI MARCELLINI

RES GESTAE

(Historia)

LIBRI XVII

13 ... Perandori /Konstanti/ kurorëzoi këtë seri suksesesh, duke i dhënë Ilirikut një sigurim të dyfishtë[1]. Ai e pati këtë mendim dhe vetë e zbatoi. Popujt e shpërngulur megjithëse dyshoheshin si të paqëndrueshëm, por që në të ardhmen mund të pritej nga ata një përmirësim, i vendosi në tokat e të parëve të tyre. Dhe për të kurorëzuar këtë mirësi, u dha atyre një mbret, dhe jo një të panjohur, por një të zgjedhur prej tij, një prijës me gjak mbretëror, shpirtmirë dhe me epërsi trupore. Kjo sjellje plotësisht e drejtë tregoi para ushtrisë karakterin e Konstantit, prandaj ushtria i dha për të dytën herë njëzëri titullin sarmatik të quajtur kështu nga populli që kishte nënshtruar. Në çastin e nisjes së tij, ai mblodhi të gjitha kohortet, centuriet e manipulet dhe pastaj duke hipur mbi podiumin e tij, i rrethuar nga flamuj e shqiponjat dhe krerët kryesorë të ushtrisë, u foli këto fjalë shumë të përshtatshme për të shkaktuar tek ata një përshtypje të mirë:

"Mbrojtës besnikë të fuqisë romake, kujtimet e lavdisë, unë e di, janë për njerëzit trima një kënaqësi shumë e këndshme. Unë dua, pra, pasi mbrojtja e një hyjnie na ka dhënë fitoren, të përmend para jush, i përmbajtur, atë që secili nga ju ka bërë para betejës dhe në zjarrin e saj. Ç'është më e bukur dhe më e drejtë që të arrijë në kujtimin e pasardhësve, se sa të përmendet ushtari për trimërinë e tij dhe komandanti për drejtimin e mirë? Armiku i egërsuar që kishte ngritur krye pa arsye në mungesë tonë, kur ishim të zënë në luftën për shpëtimin e Italisë e të Galisë, shkatërronte Ilirikun, duke shkretuar tokat përtej kufijve.

LIBRI XIX

11 Me gjithë arsyet për të qenë i shqetësuar, Konstanti kalonte dimrin i qetë në Sirm, kur pushimi i tij u turbullua nga një lajm shumë shqetësues[2]. Limigantët sarmatë, të cilët sikurse e kemi thënë kishin dëbuar nga tokat e të parëve zotëruesit e tyre, dhe që një vit më parë ishin vendosur larg për të mos trazuar më, po jepnin një provë të re të shqetësimit të tyre. Ata ishin larguar pak nga pak nga krahinat e caktuara për banim, duke pushtuar krahinat pranë kufijve, dhe sipas zakonit të

[1] Në vitin 358 e. sonë.
[2] Në vitin 359 e. sonë.

tyre po plaçkitnin me një guxim të dyfishtë, gjë që duhej ndaluar shpejt.
Perandori kuptoi se çfarëdo vonese e shtonte paturpësinë e tyre. Ai mblodhi me shpejtësi gjithandej një shumicë ushtarësh dhe u bë gati për luftë në fillim të pranverës. Ai kishte dy arsye për të patur besim /në fitoren/. Nga njëra anë dëshira e ushtarëve e ngacmuar nga plaçkitjet e pasura të luftës së mëparshme, ishte garanci për përpjekje të reja në luftën që po fillonte, dhe nga ana tjetër ushtria ishte plotësuar me të gjitha, që më parë, në saje të kujdesit të Anatolit, prefektit të Ilirikut, pa qenë nevoja për të humbur kohë për këtë...

LIBRI XXI

7 ... I kërcënuar nga të dy anët, Konstanti nuk dinte në çfarë krahu të shkonte. Duhej të shkonte larg të kërkonte Julianin, apo të qëndronte dhe t'i bënte ballë persëve të cilët po kalonin Eufratin?[1] Pas shumë bisedimesh me oficerët kryesorë të tij, ai u ndal tek mendimi që së pari t'u jepte fund luftimeve ose së paku të merrej vesh me armikun, i cili e shtrëngonte gjithnjë më tepër, pastaj si të sigurohej kjo të kalonte Ilirikun e Italinë dhe t'i binte Julianit para se ai të vinte në zbatim planin e tij.

9 ... Ndërkaq, mijëra zëra dëgjoheshin për këtë, dhe nuk vonoi e u përhap lajmi në gjithë Ilirinë, si zakonisht duke u zmadhuar, se Juliani, fitues mbi popuj e mbretër, përparonte, duke u mburrur për sukseset, në krye të një ushtrie të madhe. Pas këtij lajmi prefekti i pretorëve Tauri iku sikurse të ishte para një invadimi të huaj dhe kaloi me shpejtësi Alpet Jule, duke bërë që të ndiqte shembullin e tij edhe prefekti Florenti. Konies Lucialiani që komandonte në Sirm ushtrinë e dy provincave, me të marrë vesh lajmin e afrimit të Julianit, tërhoqi nga vende të ndryshme të gjithë ushtarët dhe vendosi të qëndronte. Por barka e tij /e Julianit/ e shpejtë si një shigjetë ose si një urë zjarri e hedhur nga një makinë luftarake arriti në Bononi, 10 milje nga Sirmi; ai menjëherë u gjend në tokë, në atë kohë kur hëna po zhdukej e si rrjedhim nata ishte e errët; me të shpejtë nisi te Luciliani Dagalaifin me disa ushtarë të armatosur lehtë, duke i urdhëruar që t'a sillte atë qoftë edhe me forcë. /Luciliani/ po pushonte, i shqetësuar nga zhurma e armëve; duke parë se ishte rrethuar nga të panjohur ai e kuptoi se ç'kishte ngjarë, dhe i frikësuar nga emri i Julianit, megjithëse pa dashje, ju bind atyre. Ky komandant i kalorësisë, i shtrënguar të përulej para forcës, zuri vend në kalin parë që i dhanë dhe u dërgua te prijësi si një rob i thjeshtë. Frika dukej sikur e kishte bërë krejtësisht të paaftë, por kur pa se i dhanë për të puthur purpuren erdhi në vete dhe me një zë më të sigurt tha; "Ky vend nuk është për ju, dhe rrezikoni veten kot me një pakicë të tillë njerëzish". Juliani iu përgjigj me një buzëqeshje të hidhur: "Mbaji këshillat e tua për Konstantin. Nuk kam ndërmend të këshillohem me ju, por dua t'ju heq frikën, mos e kuptoni ndryshe
10 butësinë time".

Mbasi largoi Lucilianin ai nuk u deh nga suksesi, por duke u bërë gjithnjë më aktiv e më i vendosur, pasi edhe rrethanat ishin të tilla, ai marshoi drejt qytetit /Sirmit/ që sipas mendimit të tij ishte gati t'i dorëzohej. Sa iu afrua periferisë së gjerë të tij, banorë e ushtarë erdhën grumbuj-grumbuj para tij me flakse e lule, duke e përshëndetur me emrat zot e august dhe duke e brohoritur e përcollën deri në pallat. Kjo ngjarje e mbushi me gëzim: ai shihte të ardhmen plot shpresë, se edhe qytetet e tjera do të ndiqnin shembullin e metropolit, të përmendur për popullsinë e shumtë, se ai do të mirpritej kudo. Të nesërmen organizoi për popullin, i cili kishte shfaqur për të një gëzim të madh, një vrapim me karroca dhe ditën tjetër mori me shpejtësi rrugën

[1] Në vitin 361 e. sonë.

drejt grykës së Sukëve, të cilën e pushtoi pa luftë duke i lënë pastaj mbrojtjen e saj Nevitas, për besnikërinë e të cilit nuk kishte asnjë dyshim. Është mirë që të japim një mendim rreth këtij vendi. Është një ngushticë e formuar nga bashkimi i dy vargmaleve të Hemit e të Rodopit, nga të cilët njëri mbështetet në brigjet e Istrit kurse tjetri në ato të Aksit.

... Këto male[1] formojnë midis Thrakisë e Ilirisë një pengesë të fortë, duke lënë nga njëra anë vendin e dakëve dhe Serdikën dhe nga tjetra qytetet e Thrakisë e Filipopolin... Nga ana që bie nga Iliria, mali ulet në një mënyrë shumë pak të rrëpirët, dhe pjerrësia thuajse nuk ndihet fare... Pasi rregulloi të gjitha gjërat ashtu si e kërkonin rrethanat dhe mbasi la aty komandantin e kalorësisë, perandori erdhi në Nes, një qytet i madh, që të mendonte i qetë për masat që nevojiteshin për të siguruar suksesin e veprimeve të tij. Ai dërgoi atje Viktorin[2] shkrimtar-historian, të cilin e kishte parë në Sirm dhe e emëroi konsull të Panonisë së Dytë dhe e nderoi me një shtatore bronzi si një njeri me një virtyt shembullor, që shumë më vonë u bë prefekt i Romës.

12 ... Komes Marciani, thuhej, kishte formuar një rrjetë stacionesh të shpërndara në Thraki dhe marshonte drejt qafës së Sukëve[3]. Juliani po ashtu merrte masa për të gjitha nevojat e rastit. Ai përqëndroi ushtrinë e tij të Ilirikut të përbërë nga trupa të sprovuara dhe të gatshme kurdoherë për të ndjekur udhëheqësin e tyre luftarak në mes rreziqeve...

13 ... Në mes këtij turbullimi, arrinin herë pas here lajme[4] shumë të sigurta se Juliani, pas një marshimi të shpejtë, kishe kaluar Italinë e Ilirikun; se ai kishte pushtuar grykën e Sukëve, se nga të gjitha anët i vinin përforcime, dhe se më në fund do të sulmonte me të gjitha forcat Thrakinë...

... "Në kohën kur ju zmbrapnit, duke i mundur, këto hordhi të egra që silleshin nëpër Ilirik, Juliani, në duart e të cilit kisha vënë ruajtjen e galëve, i fryrë nga ndonjë sukses që kishte pasur mbi germanët gjysmë të zhveshur dhe i shtyrë nga tërbimi i verbuar, u bashkua me një grusht nga këta njerëz, të cilët etja e gjakut dhe lakmia e paepur për plaçkitje, i hedh në ndërmarrje të dëshpëruara, dhe kundër çdo drejtësie kurdis me ta për përmbysjen e shtetit"[5].

LIBRI XXIV

1 ... Më në fund, për ta zmadhuar ushtrinë e tij në sytë e armikut dhe për t'u krijuar atyre idenë e një fuqie të epërme, ai /Juliani/, u kujdes që radhët e ushtrisë të shpërndaheshin, të mbulonin një terren gati dhjetë milje, midis ballit dhe praparojës, manovër kjo e përdorur shpesh dhe me zotësi nga Pirrua, mbret i epirotëve, një nga gjeneralët më të ditur, përsa i përket artit për të përfituar nga tmerri, për të shtrirë ose për të mbledhur radhët në betejë dhe për të shtuar apo pakësuar forcat e tij ushtarake para syve të armikut, sipas nevojës...

LIBRI XXVI

5 ... Valentiniani pati si kryeqytet Mediolanin, Valenti-Konstantinopolin. Salusti kishte prefekturën e Orientit, kurse Mamertini-Italinë, Afrikën e Ilirikun dhe Germaniani provincat e Galisë...

---

[1] Vargmalet e Rodopit dhe të Hemit.
[2] Aurel Viktori.
[3] Sot Portat e Trajanit.
[4] Të perandorit Konstanti.
[5] Nga fjala e Konstantit para ushtarëve të tij.

7 ... Prokopi kishte edhe një projekt që kërkonte vendosmëri e vëmendje: ishte çështja të pushtonte Ilirikun, por njerëzit që kishte zgjedhur, të paaftë dhe të hutuar, kujtuan se kishin bërë gjithçka, duke blerë përkrahës me disa moneta me fytyrën e prijësit të ri dhe kombinime të tjera të këtij lloji. Kështu shpejt ata ranë në duart e Ekuitit, komandant ushtarak i vendit, i cili i vrau në mënyrë të ndryshme. Për t'i dalë para përpjekjeve të tjera të këtij lloji, Ekuiti e forcoi rojen e tri ngushticave, me anë të cilave perandoria e Orientit lidhej me provincat e veriut, d.m.th., kalimin nga Dakia Analumase, qafën e famshme të Sukëve dhe atë që njihet me emrin Akontisma, në Maqedoni. Këto masa bënë që uzurpatori të mos shpresonte kurrë më të fitonte Ilirikun, dhe të humbiste burime të rëndësishme, të cilat ai mund t'i kishte për luftë...

8 ... Kurse ai /Valenti/ shkoi nga Nikomedia në Kalhedoni, ku deshi të nxiste rrethimin me forcë. Nga lart e mbuluan me sharje duke e quajtur Sabar. Sabaja bëhet nga elbi apo gruri dhe është një pije që e përdorin në Ilirik të varfërit.

LIBRI XXX

7 ... Valentiniani patjetër do të hakmerrej plotësisht për shkretimin e Ilirikut, po të mos kishte vdekur, në kohën e sukseseve të tij.

AMBROZI

Ambrozi është një ndër shkrimtarët e njohur kishtarë të shek. IV të e. sonë. Lindi rreth vitit 340 në Trier të Gjermanisë në një familje të pasur dhe mori arsim në Romë. Gjatë shërbimit si peshkop (qysh nga viti 374) ai bëri një luftë të pamëshirshme kundër arianizmit dhe ishte përkrahës i flaktë i pavarësisë së kishës nga pushteti laik.

Në shkrimet e tij të shumta e të ndryshme ai merr për model oratorin e madh latin Ciceronin. Disa nga veprat e tij, kryesisht "De oficiis ministrorum" (Mbi detyrat e nëpunësve), "De fide ad Gratianum Augustum" (Mbi besimin tek perandori gratian) dhe "Epistolae" (Letrat), kanë rëndësi për ne mbasi hedhin një vështim mbi gjendjen e Ilirisë dhe të provincave të tjera ballkanike në periudhën e dyndjeve të gotëve (376-382).

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Ambrosit, De officiis ministrorum libri III; De fide ad Gratianum Augustum libri V; Epostolarum classis I et II. Migne Patrologia Latina XVI, 1880.

SANCTI AMBROSII

1. DE OFFICIIS MINISTRORUM

(Mbi detyrat e nëpunësve)

LIBRI I

70 **15** Bujaria më e madhe është që të blihen robërit, të nxirren nga duart e armikut, të shpëtohen njerëzit nga vdekja dhe më tepër gratë nga përdhunimi, t'u kthehen fëmijët prindërve të tyre dhe prindërit fëmijëve të tyre, të kthehen qytetarët në atdheun e tyre. Të gjitha këto janë të njohura nga shkretimi i Ilirikut dhe i Thrakisë. Nëqoftëse do mblidheshin në një vend të gjithë robërit, të cilët shiten gjithkund nëpër botë, ata nuk do mund të plotësonin numrin e robërve të njërës nga këto provinca. Kishte, mgjithatë, nga ata që i çlironte kisha, të cilët dëshironin të ktheheshin në skllavëri, që ishte më e rëndë se robëria, sepse e urrenin mëshirën e huaj. (§86, col. 129A)

2 DE FIDE

(Mbi besimin)

LIBRI III

140 **16** Nuk është e këndshme që të kujtojmë për vrasjet, torturat dhe internimet e të krishterëve, për kryerjen e detyrës së priftit nga njerëz të pafe, për shërbimet e kryera nga tradhtarë. A nuk dëgjuam në se është tronditur nga zërat djallëzore dhe njëkohësisht nga lëvizjet e barbarëve i gjithë ai limes që fillon nga kufijtë e Thrakisë dhe kalon nëpër Dakinë Analumase dhe Myzinë dhe nëpër gjithë Valerien panone? Ç'mund të na sjellë kjo fqinjësi[1] kaq mbytëse? Dhe si do mund të mbrohej shteti romak duke u ruajtur në këtë mënyrë? (§ 496, col. 613 A)

3. EPISTOLAE

(Letrat)

16 **8** Episkop Anemi tha:
"Koka e Ilirikut nuk mund të jetë tjetër, përveçse qyteti Sirm. Dhe unë jam peshkop i këtij qyteti". (§ 790, col. 960 B)

76 Emrat e peshkopëve dhe priftërinjve, të cilët morën pjesë në sinod[2]
... Anemi, peshkop i Sirmit në Ilirik. (§ 805, col.979 A).

---

[1] Është fjala për fqinjësi në mes të gotëve dhe perandorisë.
[2] Ky është sinodi i njohur i thirrur me 3.IX.381 në qytetin Akuile, i cili luajti një rol të madh në luftën kundër arianizmit.

EUSEB HIERONYMI

Hieronymi, me prejardhje ilire, lindi rreth vitit 340 të e. sonë në qytetin Stridon të Dalmatisë dhe vdiq në moshën 80 vjeç. Ai rridhte nga një familje e pasur dhe qe një nga shkrimtarët më të dëgjuar paleokristianë. Mësoi në Romë e në qytete të tjera të Italisë dhe bëri udhëtime të gjata duke përfshirë edhe gadishullin e Ballkanit.

Hieronymi na ka lënë një trashëgimi të madhe letrare, kryesisht me përmbajtje fetare. Ai njihet si përkthyes i Biblës në gjuhën latine, por merita e tij kryesore qëndron në përkthimin latinisht dhe në plotësimin deri në vitin 378 të Kronikës së Eusebit të Cezaresë. Për plotësimin e saj Hieronymi shfrytëzoi veprat e Suetonit, Kyprianit, Tertulianit, të kronografit anonim të vitit 354, etj. Ai shkroi ndër të tjera "Liber de viris illustribus sive de scriptoribus eclesiasticis" (Libër mbi njerëzit e shquar apo mbi shkrimtarët kishtarë); "Commentariorum in Sophoniam prophetam liber" (Libër komentarësh për profetin Sofon) dhe "Epistolae" (Letra).

Përsa i ërket të dhënave që na jep Hieronymi mbi historinë e Ilirisë, këto janë të natyrave të ndryshme. Në to flitet për sulmet e gotëve dhe barbarëve të tjerë në fundin e shek. IV, për shkatërrimet e plaçkitjet që pësojnë krahinat e ndryshme të Ballkanit, për përhapjen e kristianizmit në këto këto toka; ai jep gjithashtu dhe njoftime të tjera me karakter gjeografik e administrativ.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

1) *Migne Patrologia latina,* XXII-XXX.
2) *Hieronymi De viris inlustribus* liber ex recensione Guilelmi Herdingii. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1924.
3) *Rudolf Helm, Eusebius, Werke,* Siebenter Band. *Die Chronik des Hieronymus,* Berlin 1956.

EUSEBIUS HIERONYMUS

1. EPISTOLAE

(Letrat)

16 **XL** Më rrënqethet shtati kur mendoj të tregoj për shkatërrimet në kohën tonë. Në vazhdim të njëzet vjetëve, bile edhe më tepër, gjaku romak derdhet për çdo ditë ndërmjet Konstantinopolit dhe Alpeve Jule: goti, sarmati, kuadi, alani, huni, vandalët dhe markomanët shkretojnë, plaçkisin dhe grabisin Skythinë, Thrakinë, Maqedoninë, Dardaninë, Dakinë, Thesalinë, Ahenë, Epirin, Dalmatinë dhe gjithë Panoninë[1], . Sa matrone[2], sa virgjëresha kushtuar zotit, sa njerëz të lirë dhe fisnikë u dhunuan në këto lufta! U morën robër peshkopë, u vranë presbyter dhe shërbyes të tjerë të ndryshëm të kishës. U shkatërruan kishat. Pranë altarëve të Krishtit u vendosën si në grazhd, kuajt. Kockat e martirëve u nxorën nga varret. Kudo zi, kudo ofshe dhe hija e madhe e vdekjes... (t.XXII, 344-345, col. 600).

14 **LXVI** ... Për këtë arsye ... u detyrua të dërgojmë në atdheun tonë[3] vëllanë Paulinianin, që të shiste shtëpitë e vogla gjysmë të shkatërruara, të cilat u shpëtuan duarve të barbarëve, dhe pasurinë e prindërve tanë të përbashkët, në mënyrë që mos t'u japim rast të qeshin smirëzesëve dhe atyre që mendojnë keq, duke lënë pa kryer punën e shenjtë që kemi ndërmarrë (t.XXII,403, col.647).

2. DE VIRIS INLUSTRIBUS LIBER

(Libër mbi njerëzit e shquar)

CVII Fotini, nga Galogreqia, dishepull i Marcelit, i zgjedhur si peshkop i Sirmit, u përpoq të vendosë herezinë e Hebionit, por pas kësaj u përjashtua nga kisha prej perandor Valentinianit. Shkroi shumë vëllime... (t.XXIII,938, col.743 A).

CXXXV Unë, Hieronymi, biri i Eusebit, nga qyteti Stridon i cili dikur gjendej në kufi në mes Dalmatisë dhe Panonisë dhe që u shkatërrua nga gotët deri në këtë vit[4] dhe pikërisht deri në të 14-in vit të sundimit të perandorit Teodos, shkrova këto vepra ... (t.XXIII,953, col.755 C).

---

[1] Në këtë pjesë autori ka parasysh sulmet e gotëve, sarmatëve, kuadëve e barbarëve të tjerë dhe shkretimin prej tyre të tokave të Ballkanit në çerekun e fundit të shek. IV.

[2] Gra fisnike.

[3] Është fjala për vendlindjen e Hieronymit në qytetin Stridon, që gjendet në kufi, në mes Dalmatisë e Panonisë, me sa duket në Dalmati.

[4] Nga teksti del se këtu është fjala për vitin 393, pasi Teodosi mori pushtetin perandorak në vitin 379.

3. COMMENTARIORUM IN SOPHONIAM PROPHETAM LIBER

(Libër komentarësh për profetin Sofon)

1... Kur shkatërrohen qytetet dhe vriten njerëzit, ikin dhe rallohen edhe kafshët, zogjtë e peshqit. Për këtë është dëshmitar, Iliriku, dëshmitare është Thrakia, dëshmitar është edhe vendi ku kam lindur, ku çdo gjë u zhduk përveç qiellit e tokës gjëmbave që rriten dhe pyjeve të dendur (t.XXV, 676, col.1340 D 1341 A).

4. HIERONYMI CHRONICON

(Kronika e Hieronymit)

8 XXXVIII Probi, prefekt i prefekturës Ilirike, me mbledhjen e taksave në mënyrë krejt të padrejtë, i dobësoi provincat që sundonte, përpara se ato të shkretoheshin nga barbarët (p.246 18-21 = PL,t. XXVII, col. 505-506).

RUF FESTI

Ruf Festi, i quajtur edhe Sekst Rufi, është historian i kohës së perandorit Valens (364-378). Me sa duket gjatë sundimit të tij ai mbante ofiqe me rëndësi në pushtetin perandorak, Prej tij kemi një histori të shkurtuar: "Breviarium rerum gestarum populi Romani" (Histori e shkurtër e popullit romak), që zë në gojë ngjarjet më në shenjë të historisë së Romës. Për ngjarjet paraperandorake Festi mbështetet mbi epitomet e Livit dhe Florin, kurse për periudhën tjetër, duke përfshirë edhe kohën e Diekletianit, ai shfrytëzoi të njëjtat burime si dhe Eutropi.

E re për ne tek Festi është sidomos emërtimi i 18 krahinave që përbënin Ilirikun në gjysmën e dytë të shek. IV të e. sonë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Festi Breviarium rerum gestarum populi Romani, edidit Carolus Wagner, Lipsiae – Pragae 1886.

FESTI

BREVIARIUM RERUM GESTARUM POPULI ROMANI

(Histori e shkurtër e popullit romak)

III ... Në kohën e konsujve, në mes të cilëve nganjëherë pati edhe diktatorë, para katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë vjetësh, u pushtua[1] Italia deri përtej lumit Pad, u nënshtrua Afrika, u shtruan hispanët; Galia dhe Britania u bënë tributarë. Qenë shtruar ilirët, istrët, liburnët, dalmatët; pastaj u kalua në Ahe: u nënshtruan maqedonët, u luftua me dardanët, myzët dhe thrakët, dhe u arrit deri në Danub...

Pastaj në kohën e perandorëve, para katërqind e shtatë vjetësh, kur shumë perandorë drejtonin fatin e shtetit, iu shtuan gjithashtu shtetit romak alpet bregdetare, alpet e Kotisë, të Retisë, të Norikut, të Panonisë, Myzisë dhe gjithë bregu i Danubit u kthye në provincë...

VII Nga bregdeti ne hymë dalëngadalë në Ilirik. Konsulli Levin qe i pari që përshkoi Adriatikun dhe detin Jon, dhe pushtoi qytetet bregdetare... Epirotët, të cilët kishin guxuar të kalonin me mbretin Pirro në Itali, u mundën së bashku me krahinat e grekëve dhe të maqedonasve; u bënë me ne edhe thesalët. Maqedonia tri herë ngriti krye: nën Filipin, nën Perseun dhe nën Filipin e rremë. Filipin e mundi Flaminini, Perseun – Pauli, Filipin e rremë – Meteli. Me këto triumfe edhe Maqedonia iu shtua popullit romak. Ilirët të cilët u dhanë ndihmë maqedonasve, i mundën nëpërmjet pretorit Luc Anicit, të shtyrë po nga ky rast, dhe i futëm në dorë ata bashkë me mbretin Gent; prekonsulli Kuri nënshtroi dardanët dhe myzët, dhe qe i pari komandant romak që arriti deri në Danub. Në kohën e cezarëve Jul dhe Oktavian, u hap rruga për Alpet Jule[2]. Pasi u mundën, gjithë popujt alpinë iu shtuan provincës së norikëve. Pasi u mund Batua, mbreti i panonëve, iu nënshtruan sundimit tonë Panonitë, u nënshtruan dhe amantinët, të cilët banojnë në mes Savës dhe Dravës, dhe krahina e Savës dhe e Panonisë së Dytë.

VIII Markomanët dhe kuadët u dëbuan nga krahinat e Valerisë, që gjenden midis Danubit dhe Dravës dhe kufiri në mes romakëve dhe barbarëve u vendos nga Augusti në Vindeliki, Norik, Panoni dhe Myzi. Trajani mundi dakët në kohën e mbretit të tyre Decebal dhe krijoi në tokën barbare përtej Danubit, provincën e Dakisë, që kishte rreth e përqark një gjatësi prej një mijë mile[3]. Por në kohën e perandorit Galien ajo pati humbur dhe Aureliani, pasi shpërnguli prej këndej romakët krijoi në krahinat e Myzisë dhe Dardanisë dy Dakitë. Iliriku ka tetëmbëdhjetë provinca: dy Norikët, dy Panonitë, Valerien, Savien, Dalmatinë, Myzinë e Sipërme, Dardaninë, dy Dakitë. Në dioqezën e Maqedonisë gjenden shtatë provinca: Maqedonia, Thesalia, Ahea, dy Epirët, Prevalis dhe Kreta.

---

[1] Është fjala për pushtimet e romakëve.

[2] Pjesa më lindore e Alpeve që ndajnë Istrinë nga Panonia. Nëpër këto alpe kalonte rruga nga Emona në Akuile që lidhte Italinë me Ilirikun.

[3] Një mijë milje janë rreth 1480 km.

KLAUDIANI

Klaudiani, poet romak, lindi në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. IV të e. sonë në Aleksandri të Egjiptit dhe vdiq në moshë të re rreth vitit 405 në Romë. Në vitin 395 e gjejmë në rrethet e oborrit. Tek Klaudiani kemi përfaqësuesin e fundit, njëkohësisht më të rëndësishëm të poezisë antike të vonë. Veprat e tij të shkruara greqisht e latinisht mbajnë vulën e epokës, në të cilën u krijuan dhe nuk kanë prandaj ndonjë përmbajtje të thellë ideologjike. Në vargjet e tij artistike ai përshkruan para së gjithash natyrën dhe i thur lëvdata retorike të kaluarës së perandorisë romake. Si poet i oborrit ai u ngrit në rangun e patricit dhe u nderua me një shtatore që u vendos në forum.

Klaudiani i ndikuar nga shkolla aleksandrine, shkroi një numër të madh idilesh, epigramesh e poemash me përmbajtje mitologjike. Poezitë e tij me tematikë historike, përmbajnë një material të pasur historik dhe japin me saktësi dhe besnikëri të madhe të gjitha ngjarjet e kohës. Disa nga poemat e tij formojnë një burim të rëndësishëm për historinë e Ilirëve në vitet 395-404 dhe veçanërisht për pasojat e dyndjeve të fiseve barbare në Iliri.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Claudii Claudiani Carmina recensuit Theodorus Birt; Monumenta Germaniae historica AA. X.Berolini 1892.

CLAUDII CLAUDIANI

CARMINA

(Poema)

V

.....Evropa hordhive gete[1]
i është dhënë si plaçkë dhe lojë deri tek kufijtë
e Dalmatisë plot pyje: e gjithë toka, që ndërmjet ujërave të lëvizshëm të Pontit
dhe dallgëve të Adriatikut shtrihet
e shkretë ka mbetur, pa bagëti dhe e pabanuar nga asnjë kolon
po ashtu sikurse Libia, që e zhuritur vazhdimisht
nga dielli, të kultivohet nga dora e njeriut s'mundet.
Toka thesale digjet; hesht, meqenëse u braktis nga çobanët,
Pelioni[2]; zjarri, tokat e bukës në Emathi[3] shkretoi;
krahina e Panonisë, fortesat në gjendje të vajtueshme të Thrakisë
dhe fushat e myzëve nuk shkaktojnë më lot tek asnjeri.
Sulmet për çdo vit përsëriten, kurse fushat shkretimit
i qenë nënshtruar, dhe ndjenjën e fatkeqësisë ngjarjet e zakonshme e mbytën.
Eh! sa gjëra të mëdha për një kohë të shkurtër zhduken.
Shteti, me aq shumë pak i ndërtuar
dhe i ruajtur, me përpjekjet e mijëra prijësve i krijuar,
të cilin dora romake për aq shumë vjet e pat mbrojtur
brenda një kohe të shkurtër, nga një tradhëtar dhe i paditur[4] u shkatërrua...

XV

A nuk është më mirë të vdesësh, se sa gjallë turpin të durosh?
Dhe me të vërtetë cila krahinë mbetet akoma, nëqoftëse Afrika e dorëzuar
mbretërve maurë[5], Ilirikut të vuajtur nga shkatërrimet i shtohet?

XX

Dhe tani kush marrëveshjet shkel,
pasurohet, kush atyre u përmbahet në skamje jeton; Ai[6] që shkretoi
provincën e Ahesë dhe pastaj, pa u dënuar, Epirin shkatërroi,
sundon tani Ilirikun; dhe më në fund hyn si mik
brenda mureve *[të qyteteve]* që pati rrethuar, për t'u dhënë urdhëra atyre,
gratë e të cilëve zotëron dhe fëmijët e të cilëve i vrau.

---

[1] Bëhet fjalë për sulmet e fiseve barbare në Iliri dhe Thraki në vitet 394-395.
[2] Pelioni, mal në Thesali.
[3] Emathia, emër mitologjik i Maqedonisë.
[4] Është fjala për Flav Rufinin, personalitet politik në perandorinë e Lindjes.
[5] Shkëputja e Afrikës nga perandoria e perëndimit u bë në vitin 395-397 nga sundimtari administrativ i kësaj krahine, Mauri Gildon.
[6] Alarihu.

XXII

Nga çdo anë shpejtojnë të deleguarit dhe para syve të dhëndërit tënd[1],
me zëra të shumta ata përgatiten për të lavdëruar.
.....
Pas kësaj të thurin lavdi kartagasit sepse në tokat, nga tirani
të çliruara, u bënë zotër; gjithashtu u çlirua nga rrethimi
panonasi dhe ai që ujët e Savës pi, meqenëse portat
e qyteteve të mbyllura prej kaq vjetësh mori guximin që t'i hapë.
Ai përtërin, me grihën e tij, kosat e nxira nga ndryshku.
i bën të shkëlqejnë shetrit e dëmtuar nga mospërdorimi,
njeh kasollet e tij, puth kodrat e njohura
dhe nuk i besohet se parmenda, të cilën rishtas në dorë e mori, plisa dheu po nxjerr.
Dhe pasi pret pyjet e formuara nga që toka kishte mbetur e papunuar për
një kohë të gjatë,
i rikthen ato në ara, dhe vreshta gjatë bregut plot hije të Histrit
mbjell dhe gëzohet se paguan taksën që baballarët e tij dikur paguanin,
ai, të cilin lufta e kurseu. Për deri sa ti /Stilihon/ të jesh gjallë
trupi i munduar i shtetit të dobësuar mund të përtërihet.
Ato që ne dikur humbëm gjatë sundimit të aq e aq perandorëve,
ti po i rikthen. Vetëm me mjekimin e Stilihonit
do të mund të mbyllet shenja e plagës romake.
Më në fund me kthimin e kolonit në tokën e tij,
përsëri oborri me taksat e ilirëve do të pasurohet.

XXVI

/Alarihu/ i ndezur, duke e shikuar shtrembër
plakun, që fliste fjalë të tilla, më tepër s'e duroi,
por i zemëruar, fjalimin e tij të bujshëm ia ndërpreu:
"Në qoftë se mosha e jote, e braktisur nga arsyeja dhe ndjenjat nuk do të të falte,
kurrë nuk do të duronte pa u hakmarrë kundër fyerjeve
të turpshme të gjuhës sate Danubi, sa të jem unë gjallë.
Unë që kam vënë në ikje pranë Hebrit sa e sa perandorë,
do të lejoj vallë që ti të më këshillosh për të ikur,
kur e gjithë natyra mua më nënshtrohet? Male duke rënë në këmbët
tona dhe lumenj duke u tharë ne pamë.
Perënditë getë dhe manët[2] e paraardhësve të mi nuk kanë urdhëruar kështu
që unë të kthehem dhe të eci nëpër një rrugë të kundërt.
Unë ose si ngadhnjimtar do të sundoj në këtë tokë ose
i mundur në të do të varrosem. Unë me shpejtësi kalova përmes kaq popujsh
dhe qytetesh,
kalova Alpet dhe me përkrenare ngadhënjimtare piva ujë nga Padi.
Ç'më mbetet tjetër përveç Romës? Populli i ynë me fuqinë e tij
spikaste pikërisht atëherë, kur nuk kishte besim në asnjë lloj arme;
Kurse tani që pushteti i Ilirikut më është dhënë
dhe ata komandant të tyre ushtarak më bënë, aq shumë heshta, aq shumë shpata,
aq shumë përkrenare me djersën e thrakëve përgatita,
dhe detyrova të japin për nevojat e mija taksën në hekur
qytete romake me urdhër ligjor.
Kështu fati më buzëqeshi, kurse ata, të cilët gjatë shumë viteve
i shkretova, më janë dhënë për të më shërbyer..."

---

[1] D.m.th. të Honorit.
[2] Manët ishin shpirtrat e hyjnizuar të të vdekurve tek gotët.

OROSI

Paul Orosi ishte nga qyteti Tarrakona i Spanjës, ku ai lindi aty nga fundi i shek. IV të e. sonë. Ai mori këtu një arsim fetar dhe u bë prift. Si i tillë u shqua në luftën kundër heretikëve, sidomos sektit të priscilianistëve, që e kishte qendrën në Spanjë.

Orosi është autor i një vepre historike prej shtatë librash, që mban titullin "Adversus paganos" (Kundër paganëve). Kjo histori, që përshkruan ngjarjet deri në vitin 417, në të cilën përfundoi vepra, i është kushtuar të mirënjohurit mbrojtës të krishterimit Augustinit, dhe kishte për qëllim të çfuqizonte thëniet e paganëve se të gjitha të këqiat, që kishin pllakosur njerëzimin në atë kohë, sidomos sulmet e barbarëve dhe plaçkitjet e rrënimet e tyre, vinin nga mohimi që i bëhej perëndive të vjetra.

Në veprën e Orosit, që është një burim origjinal për ngjarjet e dhjetë vjetëve të fundit të shek. IV dhe vitet e para të shek. V, jepen të dhëna të vlefshme për dyndjet barbare në Ballkan në përgjithësi dhe Ilirik në veçanti.

Për periudhën para tij Orosi është mbështetur në kronikat e Eusebit, Eutropit, Aurel Viktorit, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Pauli Orosiii Historiarum Adversus paganos libri VII ed. C. Zangenmeister. Leipzig 1899.

PAULI OROSII

HISTORIAE ADVERSUS PAGANOS

(Historia kundër paganëve)

LIBRI I

54 **12** Tani do të tregoj se cilat krahina ndan Danubi nga toka barbare e deri në
55 detin tonë. Myzia kufizohet në lindje me grykën e lumit Danub, në juglindje me Thrakinë, në jug me Maqedoninë, në jugperëndim me Dalmatinë, në perëndim me Histrinë, në veriperëndim me Panoninë, në veri me Danubin. Maqedonia kufizohet në lindje me detin Egje, në verilindje me Thrakinë, në juglindje me Eubenë dhe me gjirin Maqedonas[1], në jug me Ahenë, në perëndim me malet Akrokeraune, në
57 ngushticat e gjirit Adriatik, male të cilat gjenden kundrejt Apuljes dhe Brundizit, në perëndim me Dalmatinë, në veriperëndim me Dardaninë, në veri me Myzinë.
59 Dalmatia kufizohet në lindje me Maqedoninë, në veri me Dardaninë dhe Myzinë, në perëndim me Histrinë, gjirin liburnik dhe ishujt Liburnike, në jug me detin Adriatik.

LIBRI VII

6 **22** Fiset që ishin vendosur dhe lënë në periferi për këtë qëllim, papandehur, lëvizën sipas vullnetit të zotit nga të gjitha anët dhe të çfrenuar u futën në të gjitha
7 tokat romake[2]... Greqia, Maqedonia, Ponti dhe Azia u shkretuan nga sulmi i gotëve. Dakia përtej Danubit, humbi përgjithmonë; kuadët dhe sarmatët shkretuan Panoninë.

23 Në vitin 1025 të themelimit të Romës, Klaudi me vullnet të senatit mori
1 pushtetin si i 28-ti perandor[3]. Ai menjëherë sulmoi gotët, të cilët për 15 vjet me radhë shkretonin Ilirikun dhe Maqedoninë dhe me një thyerje të padëgjuar i zhdukin ata. Senati dekretoi për nder të tij vendosjen e një busti të artë në senat dhe ngritjen e një statuje të artë në Kapitol. Por menjëherë pas kësaj, para se të mbushte dy vjet nga
3 marrja e pushtetit, ai u sëmur dhe vdiq në Sirm. Në vitin 1027 të themelimit të qytetit të Romës[4], Aureliani, perandori i 29-të simbas radhës, mori pushtetin, të cilin e mbajti 5 vjet dhe 5 muaj. Ai shkëlqeu shumë me cilësitë e tij luftarake. Pasi
4 ndërmori një ekspeditë në Danub, ai i theu gotët në beteja të mëdha dhe vendosi pushtetin romak në kufijtë e tij të parë.

---

[1] Gjiri i Maqedonisë është, me sa duket, gjiri i Thesalonikut.
[2] Këto janë sulmet barbare në kohën e sundimit të perandorëve Valerian dhe Galien.
[3] Ngjarja ndodh në vitin 268. Orosi ka përdorur erën e themelimit të Romës, të cilën e daton këtu gabimisht në vitin 757 në vend të vitit 754/53.
[4] D.m.th. në vitin 270.

24 Por vetë Probi, në një kryengritje ushtarësh u vra në Sirm, në një kullë hekuri.

25 Dhe kështu /Galer Maksimiani/ mblodhi pa vonesë ushtri nga të gjitha anët e Ilirikut dhe Myzisë dhe duke u lëshuar papandehur kundër armikut, mundi Narseun me fuqi të madhe ushtarake dhe zotësi. Pas kësaj, po ata komandantë zhvilluan luftime të tmerrshme kundër karpëve dhe bastarnëve. Më në fund ata mundën sarmatët dhe shpërndanë nëpër fortifikimet e krahinave romake një numër shumë të madh robësh /sarmatë/. Perandorët Galeri dhe Konstanti, të parët e ndanë perandorinë romake në dy pjesë: Galer Maksimiani mori Ilirikun, Azinë dhe Orientin, kurse Konstanti Italinë, Afrikën dhe Galinë. Por Konstanti, duke qenë shumë modest u kënaq vetëm me Galinë dhe Hispanjën dhe ia lëshoi krahinat e tjera Galerit.

Galeri zgjodhi dy cezarë: Maksiminin, të cilin e vendosi në Orient dhe Severin të cilit i besoi Italinë. Ai vetë qëndroi në Ilirik.

SOZOMENI

Sozomeni, historian kishtar, lindi aty nga fundi i shek. IV në një fshat të qytetit Gaza të Palestinës. Ai u vendos pastaj në Konstantinopol, ku ushtroi profesionin e avokatit. Këtu shkroi historinë e kishës (Historia Ecclesiastica), pjesa e parë e së cilës ka humbur. Vazhdimi i saj përfshin periudhën nga viti 324 deri në 439. Por vepra e tij nuk na është ruajtur e plotë; fillimi, që trajtonte periudhën para vitit 324, dhe fundi, që bënte fjalë për ngjarjet 415-439, kanë humbur.

Si burim për historinë e tij, Sozomenit i shërbeu historiani bashkëkohës Sokrati, i cili në kohën e Theodosit II shkroi historinë e kishës nga viti 306-339.

Historisë së Sozomenit i mungon përpunimi kritik i lëndës së paraqitur. Veç kësaj ajo është spërkatur me anekdota e legjenda, kështu që vlera e saj si burim është shumë e pakët.

Për gjendjen fetare dhe politike të Ilirikut, Sozomeni flet shumë pak dhe vetëm shkarazi në kuadrin e historisë së përgjithshme romake.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Migne, Patrologia Graeca, LXVII (1859).

SOZOMENUS

HISTORIA ECCLESIASTICA

(Historia kishtare)

Col. **864B** Në atë kohë, pra, ata të krishterë që jetonin në Lindje e deri tek libiasit, të cilët kufizoheshin me Egyptin, nuk guxonin të bënin hapur mbledhjet e tyre kishtare, meqenëse Licini ndryshoi qëndrimin mirëdashës kundrejt tyre, kurse ata që jetonin në Perëndim – helenët, maqedonët dhe ilirët predikonin pa frikë besimin e tyre në sajë të Konstantinit, i cili sundonte romakët e atjeshëm.

Col. **873A** Pas betejës pranë Kibalës, dardanët, maqedonët dhe ata që jetonin rreth Istrit dhe rreth të ashtuquajturës Helladë si dhe i gjithë fisi i ilirëve kaluan nën pushtetin e Konstantinit.

Col. **1081 A-B** Thrakët, ilirët dhe ata të cilët banonin të ashtuquajturën Evropë, megjithëse nuk ishin njohur me monastiret e priftërinjve, atyre nuk u mungonin njerëzit e ditur. Në mes tyre, në atë kohë, u dallua Martini, i cili prejardhjen e kishte nga një familje e përmendur nga Savoria e Panonisë. Ai u dallua në fushatat luftarake dhe u bë kryetar i një njësie ushtarake, por ai pranoi më parë t'i shërbejë zotit dhe filloi të jetojë si njeri i ditur. Në fillim ai jetoi në Iliri, por meqenëse luftoi me fanatizëm për fenë dhe demaskoi disa nga peshkopët e atjeshëm, të cilët ishin të një mendimi me Arein, ra viktimë e intrigave të tyre dhe pasi qe rrahur shpesh herë publikisht u dërgua në mërgim.

Col. **1112 A** Kjo ngjau në këtë mënyrë: në të katërtin vit mbas sinodit të Serdikës[1)], Konstansi u vra në Galinë perëndimore. Magnenti, i cili organizoi vrasjen nënshtroi të gjithë tokën e sunduar nga Konstansi. Në Sirm u shpall si perandor nga ushtritë ilire një farë Vretani.

Col. **1149 C** Jo shumë kohë pas kësaj, perandori *[*Valenti*]* u kthye në Sirm nga Roma dhe për shkak të ndërhyrjes së peshkopëve të Lindjes e ktheu Liberin nga Beroja.

Col. **1417 B-1420 A.** *[*Gratiani*]* mendoi se duhej të largonte barbarët nga Istri, meqenëse shqetësonin ilirët dhe thrakët. *[*Ai e quajti*]* gjithashtu të nevojshme t'u ndihmonte nënshtetasve të Perëndimit, kryesisht, sepse alamanët u bënin dëme galatëve të atjeshëm. Për këtë arsye ai mori si bashkësundimtar në Sirm, Theodosin.

[1)] Viti 346.

Col. **1421 C-1424 A.** Pikërisht në kohën kur galatët e perëndimit qenë shqetësuar nga alamanët, Gratiani u kthye në pjesën e tij të perandorisë, të cilën babai i tij ia la për ta sunduar së bashku me vëllanë e tij. Kurse Ilirikun dhe tokat lindore të perandorisë ia la Theodosit. Dhe kështu lufta e tij kundër tyre përfundoi sipas dëshirës së tij. Gjithashtu edhe Theodosi arriti t'i lajë hesapet me barbarët rreth lumit Ister. Disa nga ata ai i mundi në luftë, kurse të tjerët, të cilët iu lutën që të bëheshin miq të romakëve, i mori peng, nënshkroi një marrëveshje me ta dhe arriti në Thesalonik... Ai u gëzua edhe sepse asnjë nga ilirët nuk përqafoi herezinë e Areit. Dhe kur pyeti për fiset e tjera mësoi se kishat deri tek maqedonët ishin të bashkuara.

Col. **1580 C-1581 A** Rreth kësaj kohe[1] edhe shteti kaloi një shqetësim dhe tronditje, siç ngjan në përgjithësi në kohën e grindjeve fetare. Dhe hunët, pasi kaluan Istrin, filluan të shkretonin Thrakinë... *[Stilihoni]* kërkoi t'i fusë në grindje të dy perandoritë dhe pasi siguroi nga Honori detyrën e strategut romak për udhëheqësin e gotëve Alarihun, e dërgoi atë kundër ilirëve.

[1] Viti 395.

THEODORETI

Historian kishtar nga Antiohia e Sirisë. Lindi në vitin 393 dhe në moshën 30 vjeç u bë peshkop i qytetit Kyro, në breg të Eufratit. Për këtë njihet edhe me emrin Teodoreti i Kyrit. Ai është theolog i njohur.

Theodoreti u shqua për veprimtarinë e tij të madhe në lëmin letrar. Në krye të shkrimeve të tij duhet të vihet "Historia e kishës" (Historia Ecclesiastica) e cila është një vazhdim i historisë kishtare të Eusebit dhe trajton ngjarjet që ndodhin ndërmjet viteve 323-428. Përshkruhen këtu edhe ngjarje të mëvonshme. Për arsye se Theodoreti përdor të njëjtat burime, që shfrytëzojnë edhe Sokrati e Sozomeni, historia e tij ka shumë gjëra të përbashkëta me veprat e dy autorëve të sipërpërmendur.

Theodoreti është edhe autori i shumë shkrimeve të tjera me përmbajtje fetare. Sidomos të njohura janë shkrimet e tij "Fillotheos historia" ku flitet mbi jetën e asketëve dhe "Graecarum affectionum curatio" (Shërimi i sëmundjeve pagane) ku Theodoreti lufton kundër mësimeve të paganizmit.

Në veprat e tij gjejmë të dhëna me vlerë përmbi veprimtarinë kishtare në Ilirik.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Migne, Patrologia Graeca LXXXII 1864.

THEODORETUS CYRRENSIS

HISTORIA ECCLESIASTICA

(Historia Kishtare)

Col. **996D** I bindur nga kjo letër[1], Konstanti urdhëroi që të mblidheshin peshkopët nga krahinat lindore dhe perëndimore të perandorisë në qytetin e Ilirikut Serdikë, qytet kryesor i fisit të dakëve.

Col. **997 D-1000 B** Si na mësojnë tregimet e vjetra, në Serdikë u mblodhën dyqind e pesëdhjetë arhierei. Arriti dhe Athanasi i madh, Asklepi nga Gaza, të cilin e përmenda më përpara, dhe Markeli, kryetar i mitropolisë së Ankyrës në Galati, i cili ishte peshkop edhe në kohën e sinodit të madh. Arritën dhe akuzuesit e tyre dhe ata që udhëhiqnin falangën heretike[2], gjykatësit e Athanasit. Por pasi u kuptua papërkulshmëria e sinodit dhe ngulmësia në dogmat hyjnore, ata nuk u paraqitën në sinod, megjithëse ishin të ftuar, por së bashku me gjykatësit jo të drejtë, ikën edhe akuzuesit. Këtë e tregon më së miri mesazhi i sinodit, të cilin për sqarim do ta fus në tregimin tim.

Mesazhi i Sinodit i shkruar nga peshkopët e mbledhur këtu për peshkopët e gjithë botës.

Sinodi i shenjtë i mbledhur për hir të zotit në Serdikë nga Roma, Spanja, Galia, Italia, Kalabria, Afrika, Sardanja, Panonia, Myzia, Dakia, Dardania, Dakia e Dytë, Maqedonia, Thesalia, Ahea, Epiri, Thrakia Rodopa, Azia, Karia, Bitynia, Helesponti, Frygia, Pisidia, Kapadokia, Ponti, Frygia e Dytë, Kilikia, Pamfylia, Lydia, ishujt Kyklade, Egjipti, Thebaida, Libia, Galatia, Palestina dhe Arabia, përshëndet vëllezërit nga zoti të dashur të gjithë peshkopët dhe bashkëshërbyesit e kishës së përgjithshme dhe apostolike.

Col. **1008 C-D** Udhëheqësit e tyre pas Eusebit[3] tani janë: Theodori nga Heraklea, Narcisi nga Neroniada e Kilikisë, Stefani nga Antiohia, Georgi nga Laodikea, Akaki nga Cesarea e Palestinës, Menofanti nga Efesi i Azisë, Ursaku nga Singiduni i Myzisë dhe Valenti nga Myrsa e Panonisë. Këta nuk u lejuan atyre që erdhën së bashku me ta nga Lindja, as që të hynin në sinodin e shenjtë, as nuk i lanë fare që t'i aviteshin kishës së zotit. Dhe kur shkuan në Serdikë, ata bënë në disa vende mbledhjet e tyre ku u morën vesh dhe kërcënuan se pasi të arrinin në Serdikë, nuk do shkonin fare në gjyq, as nuk do mblidheshin në një vend bashkë me sinodin e madh dhe të shenjtë, por vetëm do paraqiteshin për të justifikuar pjesëmarrjen dhe menjëherë do iknin.

---

[1] Me këtë letër perandori Konstanti I, i shtyrë nga Athanasi i Aleksandrisë, e bindi vëllanë e tij që të ruajë orthodoksinë.

[2] Pasuesit e arianizmit.

[3] Peshkopi i Nikomedisë, përkrahës i arianizmit.

Col. **1052 B-C** Të gjithë ata që luftonin për të vërtetën, e dënuan këtë mendim dhe veçanërisht ata që jetojnë në Perëndim. Këtë e dëshmon letra e tyre dërguar ilirëve[1]... Ata shkruan sa më poshtë: "Peshkopët e *[kishës]* romake Damasi, Valeriani dhe të tjerët që morën pjesë në sinodin e shenjtë, përshëndesin vëllezërit e tyre nga zoti të dashur, peshkopët në Ilirik".

Col. **1125 D-1128 A** Këtë fe predikonin etërit e mbledhur në Nike, dhe me të janë të një mendje të gjitha kishat e vendosura në Spanjë, Britani dhe Gali, në gjithë Italinë, Kampanjë, Dalmati dhe Myzi, Maqedoni dhe në gjithë Helladën.

Col. **1137 C** Peshkopët e Ilirikut përshëndesin në emër të zotit kishat e perëndisë dhe peshkopët e dioçezit të Azisë, Frygisë, Karofrygisë dhe Pakatianës.

Col. **1232 A.** Thesaloniku është një qytet jashtëzakonisht i madh dhe me popullsi të dendur. Ai i përket popullit maqedon dhe është qyteti kryesor i Thesalisë, Ahesë dhe gjithashtu dhe i shumë fiseve të tjera, të cilat sundohen nga prefekti i Ilirikut.

[1] D.m.th. episkopëve të Ilirisë.

OLYMPIODORI

Olympiodori ishte nga Theba e Egjptit. Ai duhet të ketë lindur këtu në gjysmën e dytë të shek. III. Hyri pastaj në shërbim të perandorit Theodosit II (408-450) dhe u dërgua nga ky në vitin 412 si delegat tek mbreti hun Donati. Olympiodori është autor i një vepre historike të humbur, të cilën e njohim vetëm nga një ekstrakt i patriarkut Foti. Në 22 librat e veprës së tij ai përshkruan me hollësi kohën prej 407-425 të e. sonë. Në historinë e Zosimit është përdorur gjerësisht edhe historia e Olympiodorit. Olympiodori ishte përkrahës i zjarrtë i fesë pagane dhe kundërshtar i papajtueshëm i krishterimit. Nga sa mund të kuptohet prej ekstraktit të Fotit dhe nga sa ka marrë Zosimi, del se historia e Olympiodorit shquhej për një stil të mirë pune.

Për Ilirikun ka vetëm një shënim të vogël ku flitet për mësymjen e tij nga hunët dhe sarmatët.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Historici Graeci Minores, edidit Ludovicus Dindorfius vol. I. Lipsiae, in aedibus B.G. Teubneri 1870.

OLYMPIODORI FRAGMENTA

(Fragmente të Olympiodorit)

3 fq. 451 Alarihu, prijës i gotëve, u thirr nga Stilihoni për të ruajtur Ilirikun e Honorit që i takoi në ndarjen e perandorisë nga babai Theodos. Vetë Alarihu, për shkak të vrasjes së Stilihonit dhe nga që nuk iu dha ajo që i ishte premtuar, nuk pranoi, por rrethoi dhe pushtoi Romën...

27 fq. 461 Historiani[1] thotë se ka dëgjuar nga Valeri[2], një burrë i shquar, për shtatore argjendi që ishin caktuar për ndalimin e barbarëve. Pikërisht në ditët e perandorit Kostant, thotë ai, kur në Thraki ishte sundimtar Valeri, u njoftua se ishte gjetur një thesar. Valeri arriti në vend dhe mësoi nga banorët e atjeshëm se vendi është i shenjtë, dhe se atje kishte shtatore të shenjta të kultit të vjetër. Pastaj ai i raportoi për këto perandorit dhe mori letrën, me të cilën i lejohej të merrte sendet e përmendura. Dhe kështu, pasi u gëmua vendi, u gjetën tri shtatore të punuara krejtësisht prej argjendi dhe të vendosura në mënyrë barbare, me duar të lidhura në shpinë, të veshura me veshje të larme barbare, me flokë të gjata në kokë dhe ishin të drejtuara nga veriu, d.m.th. nga krahinat barbare. Pak ditë pasi u morën këto shtatore gotët qenë të parët që u futën në gjithë Thrakinë. Pak më vonë hunët dhe pastaj sarmatët u vërsulën kundër Ilirikut dhe vetë Thrakisë. Pasi ndërmjet Thrakisë dhe Ilirikut gjëndej vendi i shenjtë, duket se të tri shtatoret qenë caktuar kundër çdo njërit nga këto popuj barbarë.

---

[1] Vetë Olympiodori.

[2] Sundimtar i provincës thrake në kohën e Konstantit III.

VEGETI

Flav Veget Renati hyn në radhën e shkrimtarëve ushtarakë të kohës së vonë romake. Mbi jetën e tij nuk dimë ndonjë gjë të sigurtë. Vepra e tij "Epitome rei militaris" (Paraqitja e shkurtër e artit ushtarak) apo "Institutorum rei militaris" (Udhëzime mbi artin ushtarak) e shkruar ndërmjet viteve 383-450 të e. sonë i është kushtuar një perandori të paemër, me sa duket Theodhosit të I (379-393) ose siç duan të besojnë disa, Valentianit të III (423-454). Në këtë vepër, të ndarë në katër kapituj, trajtohen çështje të organizimit ushtarak, taktikës, rekrutimit, rrethimit të ushtrisë romake. Në të hasim disa informata edhe mbi gjendjen ushtarake në Iliri.

Në këtë vepër autori, megjithëqë i mungon përvoja ushtarake, i ve për detyrë vetes të japë këshilla për përmirësimin e gjendjes së keqe në ushtrinë romake. Vegeti mbështetet në veprat e paraardhësve të tij si në Kolumelën, Pelagonin, Hieronin, etj.

Vepra e tij ka qenë shumë e përhapur dhe e popullarizuar në kohën e vet; në vitin 450 iu nënshtrua edhe një rishikimi.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Collection des auteurs latins, Ammien Marcellin, Jornandès, Frontin, Végèce, Modestus avec la traduction en français publiées sous la direction de M. Nisard. Paris 1869.

FLAVII VEGETII RENATI

INSTITUTORUM REI MILITARIS

(Udhëzime mbi artin ushtarak)

LIBRI I

Ushtrime në hedhjen e heshtave prej plumbi

17 Është e nevojshme, gjithashtu, që ushtarët e rinj të stërviten në hedhjen e heshtave prej plumbi, të cilat njihen me emrin martiobarbule. Dhe në të vërtetë në Ilirik kishte më parë dy legione që numëronin gjashtë mijë ushtarë dhe që quheshin martiobarbulë, sepse i përdornin me zotësi dhe guxim këto heshta. Dihet se nëpërmjet këtyre kanë qenë fituar me guxim, për një kohë të gjatë, të gjitha luftërat dhe në një shkallë të tillë, sa që Diokletiani dhe Maksimiani, kur u bënë perandorë, për nder të guximit të tyre, vendosën që martiobarbulët të quhen jovianë dhe herkulianë dhe thuhet se u pëlqenin më tepër nga gjithë legionet e tjera. Ata mbajnë zakonisht nga pesë martiobarbule të vendosura në mburojat e tyre dhe kur i hedhin në rastin e volitshëm, duket se ato pothuajse zëvendësojnë shërbimin e shigjetarëve, megjithëse të armatosur me mburoja. Dhe me të vërtetë ata i plagosin armiqtë dhe kuajt e tyre jo vetëm para se t'u afrohen, por bile dhe në largësi që arrihen me heshtat që hidhen.

Çfarë lloj armësh përdornin të vjetrit

20 Vendi e kërkon që të përpiqemi të tregojmë se me çfarë lloj arme duhet të pajisen dhe të mbrohen ushtarët e rinj. Në këtë drejtim zakoni i vjetër është zhdukur fare. Dihet se këmbësorët tonë nuk kanë armë mbrojtëse, megjithëse nga shembulli i kalorëve gotë, hunë dhe alanë ngjan që këto armë të kenë qenë të dobishme. Dhe me të vërtetë që nga themelimi i Romës dhe deri tek koha e Gratianit hyjnor, këmbësoria gjithmonë ka qenë e mbrojtur me robe të hekurta dhe me përkrenare. Por kur, për arsye të pakujdesisë dhe të përtesës, nuk zhvilloheshin më stërvitje fushore, ushtarëve filluan t'u duken shumë të rënda armët, të cilat ata rrallë i vishnin. Dhe Ĥ□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□Ĥ□□□□□□□Ĥ□'u a hiqte këmishat e hekurta dhe pastaj edhe helmetat metalike. Kur ushtarët tonë futeshin në luftim me gotët, me gjoks dhe kokë të zbuluar, ata shpesh vriteshin nga shigjetat e shumta. Dhe bile pas shumë mundjesh, të cilat sollën shkatërrimin e shumë qyteteve të mëdha, askush nuk u kujdesua që t'ua kthente këmbësorëve qoftë parzmoret, qoftë edhe helmetat e tyre... Pothuaj deri në ditët tona ka mbetur zakon që të gjithë ushtarët të mbajnë kësula lëkure, të cilat quhen panone. Kjo bëhet që ushtari, i cili gjithmonë mban diçka në kokën e tij, në kohën e luftimit të mos e ndjejë peshën e rëndë të përkrenares.

LIBRI II

Mbi detyrën e prefektit të zejtarisë

11 Përveç kësaj legioni ka zdrukthëtarë, muratorë, karpentierë, farkëtarë, piktorë dhe zejtarë të tjerë që dinë të ndërtojnë shtëpi, lëme dimërore, makina luftarake, kulla lëvizëse druri dhe mjete të tjera, me të cilat ose zaptohen qytetet armike, ose mbrohen qytetet e tyre. Këta zejtarë ose duhet të bëjnë armë të reja, karroca dhe lloje të tjera makinash luftarake, ose të rregullojnë të shkatërruarat. Legionet kishin gjithashtu punishte armësh[1] për mburoje, parzmore, harqe dhe shigjeta, heshta që hidhen, përkrenare dhe çdo lloj tjetër arme. Kujdesi kryesor i tyre ishte që në lëm të mos mungonte asgjë që ishte e nevojshme për ushtrinë, dhe kjo në një shkallë të atillë, sa që kishin bile edhe kunikularë, të cilët simbas zakonit të besëve gërmonin llagëme nën tokë, dhe pasi çponin themelet, hynin papritmas, për të pushtuar qytetet e armiqve. Kryetar i tyre i veçantë ishte prefekti i zejtarëve.

LIBRI V

Pse quhen liburne

3 Në kohë të ndryshme ka pasur shumë provinca që ishin shumë të fuqishme në det dhe për këtë arsye ka pasur dhe lloje të ndryshme anijesh. Por kur Antoni u mund nga Augusti në betejën e Aktit me ndihmën e anijeve liburne, u bë e qartë me provën e një lufte kaq të madhe, se anijet liburne ishin më të përshtatshme se të tjerat. Prandaj perandorët romakë e ndërtuan flotën e tyre me anije të ngjashme, duke marrë edhe emrin e tyre. Ja përse anijet e luftës ndërtohen tani në të njëjtin model dhe quhen liburne, sipas emrit Liburnia, që është pjesë e Dalmatisë me kryeqendër qytetin Jadertina.

Mbi përmasat e liburneve

7 Përsa i përket madhësisë, liburnet më të vogla kanë nga një sërë lopatash secila, pak më të mëdhatë nga dy dhe ato me përmasa më të përshtatshme kanë nga tri ose katër e nganjëherë nga pesë sërë lopatash. Kjo nuk duhet të na duket kaq e madhe, kur na kumtohet se gjatë luftës së Aktit sulmuan anije më të mëdha që ishin me gjashtë sërë lopatash ose më tepër...

[1] Në Gadishullin Ballkanik kishte gjashtë punishte armësh nga të cilat njera në Thesalonik dhe tjetra në Nais.

LISTA E RANGJEVE

Me emrin "Notitia dignitatum" (Lista e rangjeve) titulli i plotë i së cilës është "Notitia dignitatum tam civilium quam militarium" me shtesën "in partibus Orientis" dhe "in partibus Occidentis" kuptohet lista e gjithë rangjeve civile dhe ushtarake të kohës së vonë antike në perandorinë e Lindjes dhe të Perëndimit. Si e tillë kjo listë paraqet burimin kryesor për njohjen e organizimit administrativ dhe ushtarak të perandorisë në dy pjesët e saj në këtë periudhë të vonë antike.

Nuk dihet akoma me siguri data e saktë e përpilimit të kësaj liste. Një gjë vetëm është e qartë se ajo nuk u formua menjëherë, por për një periudhë të gjatë kohe, e cila vendoset zakonisht në mes të viteve 390 dhe 437.

Për historinë tonë të lashtë ka rëndësi gjysma e parë e listës në të cilën janë rreshtuar rangjet civile e ushtarake të krahinave të Lindjes. Pikërisht këtu jepen të dhëna të rëndësishme edhe për rangjet administrative dhe ushtarake në Ilirik; këtu përmenden shumë lokalitete sidomos të brezit kufitar danubian ku ishin vendosur njësi të shumta ushtarake. Lista e rangjeve është një nga burimet e rëndësishme që hedh dritë edhe mbi ndryshimet etnike që ndodhen në trevën e Ilirikut në periudhën e vonë antike.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Notitia Dignitatum accedunt Notitia urbis constantinopolitianae et Laterculi provinciarum, ed. O. Seek. Berolini 1876.

NOTITIA DIGNITATUM

(Lista e rangjeve)

I

LISTA E TË GJITHA RANGJEVE CIVILE DHE USHTARAKE NË KRAHINAT E LINDJES

2. Prefekti i prefekturës së Orientit[1].
3. Prefekti i prefekturës së Ilirikut[2].
4. Prefekti i qytetit Konstantinopol.
5. Dy komandantë të kalorisë dhe të këmbësorisë së oborrit.
6. (Komandant) i kalorisë dhe këmbësorisë në Orient[3].
7. (") i kalorisë dhe këmbësorisë në Thraki[4]
8. (") i kalorisë dhe këmbësorisë në Ilirik.

30. *Katër vikarë:*

31. i Azisë[5]
32. i Pontit[6],
33. i Thrakisë,
34. i Maqedonisë[7].

38. *Trembëdhjetë duksa:*

54. *Dy në Ilirik:*

55. në Dakinë Analumase[8]
56. në Myzinë e parë[9].

57. *Pesëmbëdhjetë konsularë:*

---

[1] Prefektura e Orientit ndahej në 5 dioceze: Egypti, Orienti, Ponti, Azia dhe Thrakia.
[2] Prefektura e Ilirikut përbëhej nga 2 dioceze: Maqedonia e Dakia.
[3] Në diocezin e Orientit përfshiheshin 15 provinca si: Palestina, Finikia, Siria, Kilikia, Mesopotamia, etj.
[4] Në diocezin e Thrakisë, përfshiheshin 6 provinca: si Europa, Thrakia, Hemimonti, Rodopi, Myzia e Dytë dhe Skythia.
[5] Diocezi i Azisë kishte 11 provinca.
[6] Diocezi i Pntit kishte 11 provinca.
[7] Diocezi i Maqedonisë kishte këto provinca: Ahea, Maqedonia e Parë, Kreta, Thesalia, Epiri i Vjetër, Epiri i Ri, Maqedonia Salutaris.
[8] Provinca e Dakisë Analumase (Dacia Ripensis) përfshinte Bullgarinë veri-perëndimore midis lumit Vit, Stara Planina dhe Danubit si dhe pjesë nga Jugosllavia e sotme deri tek Portat e Hekurta.
[9] Provinca e Myzisë së Parë ose e Sipërme përfshinte pellgun e lumit Moravë me bregun e Danubit në mes Beogradit dhe Milanovacit të Ulët.

74. *Tre në Ilirik:*

75. në Kretë,
76. në Maqedoni,
77. në Dakinë e Brendshme.

79. *Dyzet presidë:*

117. *Tetë në Ilirik:*

118. në Thesali,
119. në Epirin e Vjetër[1],
120. në Epirin e Ri[2],
121. në Dakinë Analumase,
122. në Myzinë e Parë,
123. në Prevalitanë[3].
124. në Dardani,
125. në Maqedoninë Salutaris[4].

III

SHENJAT[5] E PREFEKTIT TË NDRITUR TË PREFEKTURËS SË ILIRIKUT



Shenjat e prefektit të prefekturës Ilirik.

Iliriku

[1] Epiri i Vjetër përfshinte krahinat e Epirit në Jug të Vjosës deri në Akarnani.
[2] Epiri i Ri përfshinte krahinat në veri të Vjosës deri tek lumi Mat.
[3] Provinca Prevalitana përfshinte një pjesë të trevës së Jugosllavisë perëndimore deri tek lumi Drin dhe trevën e Shqipërisë së Veriut deri tek lumi Mat në jug.
[4] Provinca Maqedonia Salutaris përfshinte tokat e Maqedonisë së sotme me qytetin kryesor Stobi.
[5] Me fjalën "shenja" (insignia) kuptohen emblemet e njësive të veçanta administrative si edhe ato të reparteve ushtarake.

4. *Nën urdhërat e prefektit të ndritur të prefekturës Ilirik gjenden diocezet e poshtëshënuara:*

5. Maqedonia,
6 Dakia.

7. *Provincat e Maqedonisë janë gjashtë:*

8. Ahea
9. Maqedonia
10. Kreta,
11. Thesalia,
12. Epiri i Vjetër,
13. Epiri i Ri dhe pjesë nga Maqedonia Salutaris

14. *Provinat e Dakisë janë pesë:*

15. Dakia e Brendshme,
16. Dakia Analumase,
17. Myzia e Parë,
18. Dardania,
19. Prevalitana dhe pjesë nga Maqedonia Salutari.

20. *Ofiqet e prefektit të ndritur të prefekturës së Ilirikut:*

21. princepsi[1)],
22. kornikulari[2)],
23. ndihmësi[3)],
24. komentariensi[4)],
25. arkivari,
26. katër numerarë[5)], nga këta njëri për arin, kurse tjetri për ndërtimet,
27. ndihmësi[6)],
28. protokollisti i letrave,
29. regerendari[7)],
30. eksceptorët[8)]
31. ndihmësat,
32. singularët[9)]

[1)] Princeps quhej kryetari i çdo zyre.
[2)] Kornikulari në administratën civile ishte sekretar, ndihmës i magistratëve. Gjendja e tij ishte e afërme me atë të princepsit.
[3)] Ndihmësi (adiutor), ishte në përgjithësi ndihmës në një zyrë, në rastin tonë ndihmës i kornikularit.
[4)] Komentariensi ishte nëpunës juridik; merrej me çështjet penale.
[5)] Numearët ishin nëpunës të financës.
[6)] Ndihmësit e numerarëve (subadiuva).
[7)] Regerendari ishte nëpunës në zyrën e prefektit të prefekturës dhe të komandantëve të ushtrisë, duksave, etj. Ai merrej me çështje të postës shtetërore.
[8)] Eksceptorët ishin shkrues, sekretarë gjyqesh etj.
[9)] Singularë quheshin korrierët

33. *Prefekti i prefekturës ilirike vendoste vetë*[1)]

V

26. *Nën urdhërin e komandantit të ndritur të ushtrive të oborrit:*

27. *Pesë reparte kalorësish të oborrit:*

31. suita luftarake taifale[2)].

33. *Shtatë reparte kalorësish nga ushtritë lëvizëse:*

36. kalorë dalmatë – reparti i pestë,
37. kalorë dalmatë – reparti i nëntë.

VII

SHENJAT E KOMANDANTIT TË NDRITUR TË ORIENTIT

23. *Nën urdhërat e komandantit të ndritur të ushtrive në Orient:*

24. *dhjetë reparte kalorësish nga ushtritë lëvizëse:*

27. kalorë dalmatë – reparti i tretë

[1)] Kjo do të thotë se prefekti i prefekturës lëshonte vetë lejet për udhëtime shërbimi.
[2)] përmendja shpesh e emrave etnikë (si taifalë, gotë, skythë, dalmatë etj.) tregon se njësitë përkatëse ushtarake kanë qenë mbledhur ose nga radhët e këtyre fiseve dhe popujve, ose në fillim kanë qenë formuar prej tyre dhe më vonë plotësuar nga popullsia e asaj province ku dërgoheshin me shërbim.

IX

SHENJAT E KOMANDANTIT TË NDRITUR TË USHTRIVE NË ILIRIK



2. Britonë të vjetër, 3. Askarë të vjetër, 4. Askarë të rinj, 5. Petulantë të rinj, 6. Shigjetarë të zgjedhur, 7. Të rinj të pamposhtur, 8. Atekotë, 9. Matiarë të vendosur, 10. Ushtarë të Marsit, 11. Dianas, 12. Germanicianë të vjetër, 13. Ushtarë të legjionit të dytë, 14. Heshtarë augustianë, 15. Minevas, 16. Heshtarë të rinj.

17. *Nën urdhërat e komandantit të ndritur nga ushtrive në Ilirik:*

18. *dy reparte kalorësish nga ushtritë lëvizëse:*

19. kalorës shigjetarë të vjetër,
20. kalorës germanicianë të vjetër.

21. *një legjion i oborrit:*

22. britonë të vjetër.

23. *gjashtë njësi ushtrish ndihmëse të oborrit:*

24. askarë të vjetër[1)],
25. askarë të rinj,
26. petulantë të rinj[2)],
27. shigjetarë të zgjedhur,
28. të rinj të pamposhtur,
29. atekotë[3]

[1)] Askarë quheshin ushtarët ndihmës, të cilët transportonin sende ose njerëz në trape ose mbi rrëshiqë.
[2)] Lloj ushtrie ndihmëse
[3)] Atekotë, sipas emrit të fisit omonim që banonte në krahinat veriore të Britanisë.

30. *tetë legione nga ushtritë lëvizëse:*

31. matiarë të vendosur,
32. ushtarë marsianë,
33. dianas,
34. germanicianë të vjetër,
35. legjioni i dytë,
36. heshtarë augustianë,
37. minervas,
38. heshtarë të rinj.

39. *Edhe nëntë legione të ushtrive pseudo-lëvizëse:*

40. njësi ndihmëse - timakianë[1)],
41. ushtarë të rinj të lumtur theodosianë,
42. bugaracianë[2)],
43. skupianë[3)],
44. ulpianas[4)],
45. merencianë[5)],
46. legjioni i dytë theodosian,
47. balistarë[6)] të rinj theodosianë,
48. skampianë[7)],

49. *Të nënshtruar komandantit të ushtrive në Ilirik që shërbejnë në repartet ushtarake dhe që janë nën vartësinë e tij:*

50. *Ata kanë detyrat e poshtëshënuara:*

51. princepsi,
52. dy numerarë,
53. komentariensi,
54. primiskrinët[8)], të cilët mund të jenë numerarë,
55. skriniarët[9)],
56. eksceptorët[10)] dhe nëpunësat e tjerë të ulët,

[1)] timakianë, sipas emrit të qytetit Timacum maius dhe Timacum minus.
[2)] Bugaracianë, sipas emrit të fshatit Bugaraka në Bullgari.
[3)] Skupianë, nga emri i qytetit Skupi (pranë Shkupit të sotëm).
[4)] Ulpianas, sipas emrit të qytetit Ulpiana (Lipiana e sotme).
[5)] Merencianë, sipas emrit të qytetit Meriton në Dardani.
[6)] Balistarë, ushtarë q ëpërdornin balista.
[7)] Skampianë, nga emri i qytetit Skampa (Elbasani i sotëm).
[8)] Nëpunësa finance pothuaj po me ato funksione si numerarët.
[9)] Nëpunësa finance të caktuar për vjeljen e taksave nëpër provincat.
[10)] Shkrues.

57. komandanti i ushtrive në Ilirik - XV[1].

XI

SHENJAT E KRYETARIT TË NDRITUR TË OFIQEVE



3. *Nën urdhërat e kryetarit të ndritur të ofiqeve:*

18. *Punishtet e armëve të poshtëshënuara:*

35. *katër në Ilirik.*

36. në Thesalonik,
37. në Nais,
38. në Raciarë,
39. në Horrea Margi, për mburoje.

40. *Detyra e kryetarit të ndritur të lartpërmendur të ofiqeve kryhet nga agjentë të sigurimit dhe pikërisht nga:*

41. ndihmësi,
42. ndihmësit e tij,
43. dy ndihmësa,
44. tre për punishtet e armëve,
45. katër për barbarikarët[2],
46. për Orientin – një,
47. për Azinë – një,
48. për Pontin – një,
49. për Thrakinë dhe Ilirikun – një,
50. vrojtuesi për postën shtetërore të oborrit – një,
51. vrojtuesi për të gjitha provincat,
52. përkthyesi për popujt e ndryshëm.

---

[1] Shih shënim. 1 të faqes 379 të tekstit.

[2] Zanatçinj, të cilët punojnë në punishte shtetërore veshje të stolisura me gurë të çmuar, ar dhe argjend.

53. *Magjistri i ofiqeve vendos vetë.*

XIII

SHENJAT E KOMESIT TË NDRITUR TË THESARIT PERANDORAK



4. *Nën urdhërat e komesit të ndritur të thesarit perandorak*[1)]

5. Komesët e thesarit perandorak për të gjitha diocezet.

6. *Komesët e tregtisë.*

7. për Orentin dhe Egyptin,
8. për Myzinë, Skythinë dhe Pontin,
9. për Ilirikun,
10. kryetarët e thesarëve,
11. komesi i minierare në Ilirik.

XXVIII

KOMESI I LIMESIT[2)] EGJIPTIAN

13. *Nën urdhërat e komesit të shquar për çështje ushtarake në Egjipt:*

14. Legioni i pestë Maqedonas – në Memfis,
15. Legioni i trembëdhjetë gemina – në Rabilon.

37. *Në provincën Augustamnike*[3)]*:*

41. kohorta e parë panone augustiane – në Tohu,
42. kohorta epirote – në Kastra Judeorum.

[1)] Komes, drejtues të thesarit shtetëror (comes sacrarum largitionum).
[2)] Limes, brez kufitar.
[3)] Pjesa lindore Egjiptit.

XXXII

DUKSI I FENIKISË

17. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Ferikisë:*

18. kalorës ilirë maurë – në Ottharë[1)],
19. kalorës ilirë me mburoje – në Euhar,[2)]
21. kalorës ilirë dalmatë – në Latavë,[3)]
30. prefekt i legionit të parë ilir – në Palmyrë.

XXXIII

DUKSI I SIRISË

15. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Sirisë dhe të Sirisë së Eufratit:*

16. kalorës ilirë me mburoje – në Serianë[4)],
17. kalorës ilirë të graduar – në Okaribë[5)],

24. *Në (Sirinë) augustiane të Fufratit:*

25. kalorë ilirë dalmatë – në Barbalisë[6)],
26. kalorë ilirë maurë – në Neocezare[7)],

XXXIV

DUKSI I PALESTINËS

17. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Palestinës:*

18. kalorës ilirë dalmatë – në Benosabë[8)],
19. kalorës ilirë të graduar – në Menohi[9)],
20. kalorës ilirë me mburoja – në Hermulë[10)],
21. kalorës ilirë maurë – në Eli[11)],
22. kalorës ilirë Thamudianë – në Birsamë[12)].

XXXV

DUKSI I OSROENËS

14. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Osroenës:*

15. kalorë ilirë dalmatë – në Ganabë[13)],
16. kalorë ilirë të graduar – në Kalinikë[14)],
17. kalorë ilirë maurë – në Dabanë[15)].

[1)] 1-3) Otthara, Euhari dhe Latava, kështjella në Finiki.
[2)] 4-7) Qytete dhe kështjella në Siri.
[3)] 8-12) Qytete e kështjella në Palestinë.
[4)] 13-15) Kështjella në Mesopotami.

XXXVI

DUKSI I MESOPOTAMISË

18. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Mesopotamisë:*

19. kalorës ilirë me mburoja – në Amidë.
20. kalorës ilirë të graduar – në Resain – Theodosiopol,
21. kalorës ilirë udhëheqës – në Amidë,
22. kalorës ilirë të lumtur honorianë – në Konstantinë.

XXXVII

DUKSI I ARABISË

13. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Arabisë:*

14. kalorës ilirë me mburoja – në Mothë,
15. kalorës ilirë të graduar – në Trikomi,
16. kalorës ilirë dalmatë – në Zizë,
17. kalorës ilirë maurë – në Areopol.

XLI

DUKSI I MYZISË SË PARË

2-4		Flaviana, *Kështjellë.*	Pinku *Kështjellë.*
5-7	Trikorni, *Kështjellë*	Auremonti. *Kështjellë*	Viminaci *Kështjellë*
8-10	Lederata *Kështjellë*	Kupi *Kështjellë*	Adnovas *Kështjellë.*

11. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Myzisë së Parë:*

Reparti i kalorësve konstantianë – në Pink.
12. Reparti i kalorësve të graduar – në Flavianë.
13. Reparti i kalorësve shigjetarë – në Trikorn,
14. Reparti i kalorësve dalmatë – në Aureomont,
15. Reparti i kalorësve të graduar – në Viminac.
16. Reparti i kalorësve shigjetarë – në Lederatë.
17. Reparti i kalorësve dalmatë – në Pink.
18. Reparti i kalorësve dalmatë – në Kupi.
19.

29. *Gjithashtu legionet:*

30. Prefekti i legjionit të katërt Flavian – në Singidun,
31. Prefekti i legjionit të shtatë Klaudian – në Viminac.
32. Prefekti i legjionit të shtatë Klaudian – në Kupi.

33. Prefekti i ushtarëve... përballë Margut në lëmin Augusto-Flavian.
34. Prefekti i ushtarëve – vëzhgues – në Nove.
35. Prefekti i ushtarëve – vëzhgues – në Taliatë,
36. Prefekti i ushtarëve Vincentinë – në Lederatë,
37. Prefekti i ushtarëve – vëzhgues – në Zmirnë,
38. Prefekti i flotës istriane- në Viminac,
39. Prefekti i flotës stradene dhe germane – në Marg.

40. *Ai ka këto ofiqe:*

41. princepsin e të njëjtit ofiq, i cili pas përfundimit të shërbimit ushtarak ka të drejtë të nderohet si protektor,
42. numerarë dhe ndihmësat e tij,
43. komentariensin,
44. ndihmësin e tij,
45. protokollistin ose subskribendarin,
46. shkruesit dhe nëpunës të tjerë.

XLII

DUKS I DAKISË ANALUMASE

2-4		Dortiku *Kështjellë.*	Bononia *Kështjellë.*
5-7 8	Cebri. *Kështjellë*	Drobeta. *Kështjellë*	Augusta. *Kështjellë*
9-11	Variana. *Kështjellë.*	Almi. *Kështjellë.*	Egeta. *Kështjellë*

12. *Nën urdhërat e duksit të shquar të Dakisë Analumase:*

13. reparti i kalorësve fortenas dalmatë – në Bononie,
14. reparti i kalorësve divitenas dalmatë – në Dortik,
15. reparti i kalorësve me mburoje – në Cebri,
16. reparti i kalorësve divetenas dalmatë – në Drobetë,
17. reparti i kalorësve dalmatë – në Augustë,
18. reparti i kalorësve dalmatë – në Varianë,
19. reparti i kalorësve stablesianë – në Alm,
20. reparti i kalorësve me mburoja – në Egetë,
21. reparti i kalorësve konstantinas – në Ut.

NOTITIA DIGNITATUM

(Lista e rangjeve)

I

LISTA E TË GJITHA RANGJEVE CIVILE DHE USHTARAKE
NË KRAHINAT E PERËNDIMIT

IX

SHENJAT E MAGJISTRIT TË SHQUAR TË OFIQEVE

3. *Nën urdhërat e magjistrit të shquar të ofiqeve:*

16. *Punishtet e armëve të poshtëshënuara:*

17. *Në Ilirik:*

18. Në Sirm për mburoje, për shala lëkure dhe për armë,
22. në Salonë për armë.

XI

SHENJAT E KOMESIT TË SHQUAR TË THESARIT PERANDORAK



Fig. nr.6

3. *Nën urdhërin e komesit të shquar të thesarit perandorak:*

4. komesi i thesarit në Ilirik.

9. *drejtues të financës:*

10. drejtuesi i financës së Panonisë së Dytë, Dalmatisë dhe Savies.

21. *drejtues të thesarëve:*

22. *në Ilirik:*

23. drejtuesi i thesarit të salonasve të Dalmatisë.

45. *prokuratorë të punishteve perandorake të pëlhurave:*

46. prokuratori i punishtes së pëlhurave të Basianës, të Panonisë së Dytë, të shpërngulura nga Salona,

47. prokuratori i punishtes së pëlhurave të Sirmit, të Panonisë së Dytë,

48. prokuratori i punishtes joviane të pëlhurave në Asalato të Dalmatisë.

64. *prokuratorë të punishteve të bojaxhinjve:*

86. prokuratori i punishtes së bojaxhinjve të Salonisë së Dalmatisë,

66. komes i tregëtisë në Ilirik.

XII

SHENJAT E KOMESIT TË SHQUAR TË PASURISË SË PALLATIT



3. *nën urdhërat e komesit të shquar të pasurisë së pallatit:*

6. drejtuesi financiar i pasurisë së pallatit – në Ilirik,

20. prokuratori i pasurisë së pallatit – në Dalmati,

21. prokuratori i pasurisë së pallatit – në Savie.

XXXII

DUKS I PANONISË

3-5		Kornaku *Kështjellë.*	Teutiborgu *Kështjellë.*		Burgena *Kështjellë.*
6-10	Kuci. *Kështjellë.*	Aciminci. *Kështjellë.*	Sekunda. *Kështjellë.*	Nove. *Kështjellë.*	Albana. *Kështjellë.*
11-15	Teutibarku. *Kështjellë.*	Kornaku. *Kështjellë.*	Kuci. *Kështjellë*	Bononia. *Kështjellë.*	Kusi. *Kështjellë.*
16-20	Acirmirci. *Kështjellë.*	Rikti. *Kështjellë.*	Burgena. *Kështjellë*	Tauruni *Kështjellë.*	ad-Herkuli. *Kështjellë.*

21. *Nën urdhërat e duksit të shquar të provincës së Panonisë së Dytë Analumase dhe të Savies:*

22. reparti i kalorësve me mburoja – në Kornak,
23. reparti i kalorësve dalmatë – në Teutiborg,
24. reparti i kalorësve konstancianë – në Burgenë,
25. reparti i kalorësve të graduar – në Kucë,
26. reparti i kalorësve të vendosur – në Aciminc,
27. reparti i kalorësve italikë – në Sekundë,
28. kalorë dalmatë – në Nove,
29. kalorë dalmatë – në Alban,
30. kalorë të graduar – në Teutibark,
31. kalorë dalmatë – në Kornak,
32. kalorë shigjetarë – në Kucë,
33. kalorë dalmatë – në Bononi,
34. kalorë dalmatë – në Kusë,
35. Kalorë shigjetarë – në Acimirci,
36. kalorë dalmatë – në Rikt,
37. kalorë dalmatë – në Burgenë,
38. kalorë të graduar – në Taurun,
39. njësi ndihmëse herkuliane – në ad-Herkul,
40. njësi ushtarake ndihmëse – në Arsak ose Nove,
41. njësi ndihmëse augustiane – kundër Bononisë në kështjellën Onagrin, në tokën barbare,
42. njësi ndihmëse presidenciale – në lëmin Herkul,
43. njësi ndihmëse askarësh – në Taurun ose Marsoni,
44. prefekti i kohortës së pestë nga legioni i pestë jovian, i pjesës së sipërme – në Bononi,
45. prefekti i kohortës së pestë nga legjioni i gjashtë herkulian, i pjesës së sipërme – në
46. Aureomont,
47. prefekti i legjionit të pestë jovian – në Burgenë,
48. prefeti i legjionit të gjashtë herkulian – në Teutiborg;
    prefekti i legjionit të pestë jovian dhe i legionit të gjashtë herkulian – në kështjellën Onagrin,
49. prefekti i ushtarëve kalkarienë – në Sirm,
50. prefekti i flotës së parë flaviane – augustiane – në Sirm,
51. prefekti i flotës së dytë flaviane – në Grai,
52. prefekti i flotës së Istrit – në Mursa,
53. tribuni i kohortës së tretë të alpinëve dardanë...,

54. alla Sirmiane – në Sirm,
55. prefekti i flotës së parë panone – në Servit,
56. prefekti i flotës egete ose e Panonisë së Dytë... tani në Siscie...

60. *I njëjti duks i shquar ka këto ofiqe:*

61. princepsin e të njëjtit ofiq,
62. numerarin,
63. ndihmësin e tij,
64. komentariensin,
65. ndihmësin e tij,
66. regerendarin,
67. eksceptorët,
68. singularët dhe nëpunës të tjerë.

XL

DUKS I PROVINCAVE BRITANIKE

17. *Nën urdhërat e duksit të shquar të provincave britanike:*

19. prefekti i kalorësve dalmatë – në Presid,
43. tribuni i kohortës së dytë të dalmatëve – në Magni.

LATERCULUS VERONENSIS

LISTA E VERONËS

EMRAT E GJITHË PROVINCAVE

V. Diocezi i Myzisë ka njëmbëdhjetë provinca:

2. Dakia,
3. Myzia e Sipërme marge,
4. Dardania,
5. Maqedonia,
6. Thesalia,
7. Priantina,
8. Privalentina,
9. Epiri i Ri,
10. Epiri i Vjetër,
11. Kreta.

VI. *Dioçezi i Panonisë ka shtatë provinca:*

2. Panonia e Ulët,
3. Savia,
4. Dalmatia,
5. Valeria,
6. Panonia e Sipërme,
7. Noriku Analumas,
8. Noriku i Brendshëm.

XIII. *Fiset barbare që u dukën në kohën e perandorëve:*

24. markomanët,
26. taifrulët,
29. sarmatët,
32. skirët,
33. karpët,
34. skythët,
36. gotët.

LATERCULUS POLEMII SILVII

(Lista e Polem Silvit)

EMRAT E PROVINCAVE

V. *Në Ilirik ka 19 provinca:*

2. e para: Dalmatia (bregdetare),
3. e dyta: Panonia e Parë (në të cilën gjendet Sirmi),
4. e treta: Panonia e Dytë,
5. e katërta: Valeria,
6. e pesta: Prevali,
7. e gjashta: Myzia (e Sipërme) e Ulët,
8. e shtata: Epiri i Vjetër,
9. e teta: Epiri i Ri,
10. e nënta: Noriku (Analumas, mbi Danubin),
11. e dhjeta: Noriku (i brendshëm),
12. e njëmbëdhjeta: Savia,
13. e dymbëdhjeta: Dardania,
14. e trembëdhjeta: Hemimonti,
15. e katërmbëdhjeta: Dakia,
16. e pesëmbëdhjeta: Skythia,
17. e gjashtëmbëdhjeta: ishulli i Kretës,
18. e shtatëmbëdhjeta: Ahea,
19. e tetëmbëdhjeta: Maqedonia,
20. e nëntëmbëdhjeta: Thesalia,

PRISKU

Prisku ishte nga Thrakia. Lindi në vitet e para të shek. V dhe u mor me retorikë e filozofi. Në vitin 448 mori pjesë në delegacionin, që u dërgua nga Theodosi II tek mbreti i hunëve Atila. Këtu me sa duket iu forcua mendimi për të shkruar një histori të hunëve në kuadrin e një historie më të gjerë të kohës së vet. Nga kjo vepër, që përbëhej nga 8 libra, na janë ruajtur vetëm fragmente që trajtojnë periudhën prej viteve 433-463. Historia e tij duhet të ketë përfshirë në origjinal një periudhë shumë më të gjatë, me sa duket kohën prej 411-472.

Të dhënat e tij, të mbështetura në vrojtime personale dhe pjesërisht edhe në dokumente të shkruara, për kohën që trajtojnë kanë një rëndësi jashtëzakonisht të madhe, veçanërisht për historinë e hunëve dhe të Atilës; aty na flitet për jetën e zakonet e këtij populli dhe mbi organizimin e shtetit të hunëve. Prisku na jep disa të dhëna me vlerë edhe për historinë e Ilirikut, krahinat e ndryshme të të cilit, në kundërshtim me ndarjen administrative të kohës, ai na jep me emra të kohës antike.

Përkthimi është mbështetur në botim

Historici Graeci Minores edidit Ludovicus Dindorfius vol. I. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1870.

PRISCI FRAGMENTA

HISTORIA GOTHICA

1 b fq. 278 Skythët[1] rrethuan Naisin, qytet ilir që është i vendosur pranë lumit Danub. Thonë se /ky qytet/ ka qenë ndërtuar nga Konstantini, i cili themeloi edhe qytetin e quajtur me emrin e tij, pranë Byzantit[2]. Meqenëse qyteti /Nais/ ishte shumë i populluar dhe përveç kësaj i fortifikuar, barbarët deshën ta pushtonin dhe për këtë qëllim provuan të gjitha mënyrat. Mbrojtësit e qytetit nuk guxuan të dilnin për të luftuar dhe për këtë /barbarët/ ngritën nga ana e jugut një urë mbi lum, aty ku ai rrjedh pranë qytetit që të kalonte ushtria lehtësisht nëpër të. Ata sollën pranë mureve makina luftarake dhe në radhë të parë platforma prej trarësh, të vendosura mbi rrota fq. 279 që të lëviznin më lehtë[3]. Mbi to qëndronin ushtarë dhe shigjetonin kundër atyre që mbroheshin nëpër bedenat e mureve. Në të njëjtën kohë burrat e tjerë që gjendeshin në dy anët e platformave i shtynin me këmbë rrotat dhe i lëviznin makinat atje ku duhej, që të mund të shigjetonin me saktësi nga frëngjitë e maskuara të tyre.

Që të luftonin pa u rrezikuar, burrat qëndronin mbi një platformë e cila mbulohesh /nga një çati/ prej thuprash dhe lëkurash të regjura e të paregjura. Kjo i mbronte si nga shigjetat e zakonshme, ashtu edhe nga ato me zjarr që lëshonin kundër tyre. Kështu para mureve të qytetit u sollën shumë makina të tilla, në mënyrë që nga shumica e shigjetave, ata që gjendeshin nëpër bedenat e mureve të detyroheshin të linin vendin dhe të tërhiqeshin. U sollën edhe të ashtuquajturit "kryedeshë". Këto lloj makinash janë shumë të mëdha dhe të ndërtuara në këtë mënyrë: Një tra qëndron i varur me veriga të lira ndër drunj të vendosur në formë kulmi; një skaj i tij është me majë dhe e gjithë makina është e mbuluar në mënyrën e përshkruar më sipër që të mos rrezikoheshin ata që përdornin këto mjete. Disa vetë, nga mbrapa, e tërheqin atë fort me litar në drejtimin e kundërt të murit që duhej goditur. Pastaj ata e lëshojnë në mënyrë që me vrullin e tij /trau/ të shkatërronte çdo pjesë të murit mbi të cilin binte. Kur këto makina u vendosën pranë fortifikimit, mbrojtësit hodhën nga muret gurë të mëdhenj, që i kishin sjellë që përpara për këtë qëllim dhe i shtypën disa nga këto makina bashkë me njerëzit që i përdornin. Por ata nuk mundën t'u bëjnë ballë shumicës së madhe të këtyre makinave. Barbarët sollën dhe shkallë në mënyrë që po të shkatërrohej muri nga "kryedeshtë" ose nga ana tjetër, në qoftë se mbrojtësit nëpër bedenat e mureve do të mposhteshin nga shumica fq. 280. e makinave, të hynin nëpër pjesën e kështjellës së shkatërruar nga goditja e "kryedashit" dhe kështu të pushtonin qytetin. Për këtë do të shërbenin dhe shkallët

---

[1] Është fjala për hunët.

[2] Konstantini i Madh, themeluesi i Konstantinopolit.

[3] Këto ishin një lloj kullash lëvizëse.

që qenë sjellë nga ajo anë e murit që nuk ishte prekur akoma.

2 Skythët sulmuan romakët në kohën e panairit dhe vranë shumicën /prej tyre/. Atëherë romakët dërguan te ata delegatë dhe i akuzuan se e kishin pushtuar kështjellën dhe se kishin shkelur marrëveshjen. Skythët u përgjigjën, se ata nuk i filluan të parët veprimet armiqësore dhe se i kishin kryer këto për vetmbrojtje, pasi peshkopi i Margut kaloi në tokën e tyre, hapi varret e mbretërve të tyre dhe grabiti thesaret e vendosura në to. Në qoftë se nuk do t'u dorëzohej peshkopi dhe nuk do t'u ktheheshin, sipas marrëveshjes, të ikurit – tek romakët kishte shumë të këtillë – ata do të fillonin luftën. Romakët deklaruan se kjo akuzë nuk i përgjigjej së vërtetës. Kurse barbarët, duke ngulur këmbë për drejtësinë e fjalëve të tyre, nuk e quajtën të nevojshme që të gjykonin çështjet e diskutueshme dhe filluan luftën. Ata kaluan Istrin dhe shkatërruan një numër të madh qytetesh dhe kështjellash gjatë lumit. Ndër qytetet e pushtuara qe edhe Viminaci, qytet i Myzisë, në Iliri. Kur po ngjanin këto, disa thanë se peshkopi i Margut duhej të dorëzohej. Kështu që për shkak të një njeriu mos të rrezikohej nga lufta gjithë popullsia romake. /Peshkopi/ duke dyshuar se do ta dorëzonin, fshehurazi nga banorët e qytetit /shkoi/ tek armiqtë dhe u premtoi se do t'ua dorëzonte qytetin në qoftë se mbretërit skythë[1] do të silleshin mirë me të. Ata iu përgjigjën se do ta përkrahnin bujarisht në qoftë se me të vërtetë do të plotësonte premtimin e tij. Pasi u morën vesh dhe u betuan për sa u fjalosën, ai u kthye në tokën romake me një shumicë të madhe barbarësh dhe i vuri në pritë në
fq. bregun përballë. Natën ata u ngritën sipas një shenje të dhënë, dhe ai ia dorëzoi
281 qytetin armiqve. Pasi u shkretua në këtë mënyrë Margu, fuqia e barbarëve u rrit akoma më tepër.

7

fq. Përsëri arriti, si i deleguar, skythi Edekon, i cili pati kryer shumë heroizma dhe
286 bashkë me të edhe Oresti që rridhte nga një fis romak dhe jetonte në tokën paione[2], pranë lumit Sao, e cila i qe nënshtruar barbarit, sipas marrëveshjes së përfunduar me komandantin e romakëve perëndimorë, Aetin. Pikërisht ky Edekoni erdhi në pallat dhe dorëzoi letrën e Atilës, në të cilën ai akuzonte
fq. romakët në lidhje me të ikurit, i frikësonte ata se do të vepronte me armë në
287 qoftë se ata nuk do t'i dorëzoheshin, dhe nëqoftëse romakët nuk hiqnin dorë nga punimi i tokës së pushtuar prej tij. Kjo tokë /sipas tij/ shtrihej gjatë Istrit nga Panonia deri në Nove, në Thraki, dhe ishte e gjerë pesë ditë rrugë. Ai kërkonte gjithashtu që tregu i ilirëve të mos bëhej si përpara në breg të Istrit, por në Nais i cili, pasi u shkatërrua nga ai, u caktua si kufi në mes skythëve dhe romakëve, dhe ishte larg nga Istri pesë ditë rrugë me ecje të shpejtë burri. Ai donte, gjithashtu, që të vinin tek ai delegatë, që të bisedonin për çështjet e diskutueshme dhe këta të mos ishin njerëz të rastit, por më të shquarit në mes të konsujve. Në qoftë se do kishin frikë t'i dërgonin, atëherë ai do të shkonte vetë në Serdikë për t'i pritur. Kur i qe lexuar kjo letër perandorit, Edekoni doli përpara dhe Bigila i përktheu kërkesat e Atilës të paraqitura me gojë prej tij. Pastaj /Edekoni/ shkoi në ndërtesat e tjera, që të paraqitej tek Hrysafi, roja personale e perandorit, njeri me influencë të madhe. Ai u çudit me shkëlqimin e ndërtesave perandorake. Kur barbari hyri në bisedë me Hrysafin, Bigila që përkthente i tha atij se Edekoni i lavdëronte pallatet dhe se ishte çuditur nga pasuria e tyre.

---

[1] Është fjala, me sa duket, për bashkësundimtarët e hunëve Atilen dhe Bleden.
[2] D.m.th. penone.

Hrysafi iu përgjigj se edhe ai mund të bëhe pronar i shtëpive të mbuluara me flori dhe i pasurive, në qoftë se do t'i linte skythët dhe do të kalonte në anën e romakëve...

Eunuku Hrysaf e bindi Edekonin që të vriste Atilën. Atëherë Teodosi dhe magister Martiali u këshilluan për këtë çështje dhe vendosën të çojnë si delegat tek
8 Atila jo vetëm Bigilën, por edhe Maksimimin...
fq. Maksimini m'u lut dhe më mbushi mendjen që të udhëtoj me të në këtë
289 delegacion, dhe kështu ne u nisëm bashkë me barbarët dhe arritëm në Serdikë, e cila gjendet larg qytetit të Konstantinit trembëdhjetë ditë rrugë me ecje të shpejtë.
fq. Kur arritëm në Nais e gjetëm qytetin të braktisur nga popullsia, sepse qe
290 krejtësisht i shkatërruar nga armiqtë dhe vetëm në gërmadhat e tempujve të shenjtë u gjetën disa të sëmurë. Ne u vendosëm pak më lart nga lumi, në një vend të pastër, pasi çdo gjë në breg ishte mbushur me kockat e të vrarëve në luftë. Të nesërmen
fq. arritëm tek komandanti i njësive ushtarake në Ilirik, Aginteu, që gjendej jo larg nga
291 të ikurit, pasi ai duhej të na dorëzonte pesë nga të shtatëmbëdhjetët, për të cilët i qe shkruar Atilës. U morëm vesh dhe rregulluam që ai t'i dorëzonte hunëve pesë të ikurit. Ai u tha atyre disa fjalë dashamirëse dhe i dërgoi me ne.

Kaluam natën dhe u nisëm nga rrethet e Naisit, në drejtim të lumit Ister... Pas këtij vendi, të vështirë për t'u kaluar, arritëm në një fushë të pyllëzuar. Prej atje lundërtarët barbarë na morën në barkat e tyre prej një trungu, të punuara nga drunj të prerë dhe të thelluar, dhe na kaluan nëpër lum. Ata nuk qenë përgatitur për ne; me ta
fq. kaluan shumë barbarë që i ndeshëm rrugës, pasi Atila, gjoja, donte të kalonte në
292 tokën e romakëve për të gjuajtur. Kjo, në të vërtetë, ishte përgatitje për luftë nga ana e mbretit skyth dhe kjo nën shkakun se nuk i ishin dorëzuar të gjithë të ikurit. Pasi kaluam Istrin dhe udhëtuam bashkë me barbarët rreth shtatëdhjetë stade, u detyruam të ndaleshim në një fushë, në mënyrë që njerëzit e Edekonit të mund të lajmëronin Atilën për arritjen tonë. Bashkë me ne qëndruan edhe barbarët që na kishin sjellë deri këtu. Në mbrëmje, ku hëngrëm darkën, u dëgjuan këmbë kuajsh që po vinin në drejtimin tonë Dhe me të vërtetë arritën dy skythë të cilët na dhanë urdhërin që të shkonim tek Atila...

Të nesërmen ata na shërbyen si udhëheqës. Në orën nëntë të ditës arritëm tek shatoret e Atilës që ishin me shumicë të madhe dhe kërkuam të ngrinim çadrën mbi një kodër. Por barbarët që ishin atje na ndaluan të bënim një gjë të tillë, pasi çadra e Atilës ishte ngritur në vend të ulët. U vendosëm në atë vend që na caktuan skythët... Bigila u nis dhe ne qëndruam po në atë vend edhe një ditë pas udhëtimit të tij. Të nesërmen, bashkë me Atilën u drejtuam për në krahinat më veriore të vendit. Deri në një farë vendi udhëtuam bashkë me barbarin, pastaj morëm rrugë tjetër, të cilën na e treguan skythët që na përcollën, pasi Atila do të shkonte në një fshat që të martohej
fq. me të bijën e Eskamit. Megjithëse kishte shumë gra, ai po e merrte edhe atë sipas
299 ligjit skyth... Pasi kaluam një rrugë të gjatë, në mbrëmje u vendosëm pranë një liqeni me ujë të pijshëm që shfrytëzohej nga banorët e fshatit të afërm. Këtu ne ndeshëm romakët e perëndimit të cilët, gjithashtu, qenë dërguar si të deleguar tek Atila. Në mes tyre ishte Romuli me gradë komes, Promuti sundimtar i krahinës së Norikut dhe Romani,
fq. komandant njësie ushtarake. Bashkë me ta ishte edhe Konstanti, të cilin Aeti e kishte
301 dërguar tek Atila si shkrues, gjithashtu edhe Tatuli,i ati i Orestit që ishte bashkë me Edekonin. Këta nuk ishin delegatë, por udhëtonin bashkë me ta meqenëse ishin të afërm; Konstanti, pasi ishte njohur me ta që në Itali, kurse Tatuli për shkak të krushqisë, se i

biri i tij Oresti ishte martuar me të bijën e Romulit. Ata erdhën nga Patavia, qytet në Norik, si të deleguar që t'i kërkonin mëshirë Atilës. Ai kërkonte që t'i dorëzohesh Silvani, kryetari i punishtes së monedhave në Romë, pasi ai kishte marrë kupa floriri
fq. nga Konstanti... Në kohën kur Sirmi, që gjendet në tokën paione, u rrethua nga
302 skythët, peshkopi i qytetit ia dorëzoi kupat Konstantit me kusht që ta blente atë /peshkopin/ në qoftë se qyteti do të pushtohej sa kohë që ai do të ishte gjallë, por nëqoftëse ai vdiste të bliheshin me to banorët e qytetit të zënë rob. Mbas pushtimit të
fq. qytetit Konstanti nuk e mbajti fjalën... Pasi kaluam disa lumenj, arritëm në një fshat
303 shumë të madh. Thamë se atje gjendeshin pallatet më madhështore të Atilës, të ndërtuar me drunj dhe dërrasa të lëmuara mirë dhe të rrethuar me gardh druri, të vendosur për rreth jo për mbrojtje, por për zbukurim. Pas pallatit mbretëror, përsa i përket madhështisë, vinte shtëpia e Onegesit, e cila gjithashtu kishte gardh druri, por nuk ishte e zbukuruar me kulla si pallati i Atilës. Afër ndërtesës gjendej banja, e ndërtuar nga Onegesi, i cili pas Atilës, kishte influencën më të madhe tek skythët. Ai kishte sjellë gurë nga toka e paionëve, pasi në këtë krahinë, ku jetojnë barbarët, nuk ka as gurë, as dru, por shfrytëzojnë materialin e sjellë nga vendet e tjera. Ndërtuesi i banjës ishte rob, i sjellë nga Sirmi. Ai shpresonte se do të fitonte lirinë, si shpërblim të punës së tij, por papritur ra në një vuajtje akoma më të madhe, se sa kur ishte rob tek skythët, pasi Onegesi e la në banjë që t'i shërbente atij dhe të afërmve të tij, kur laheshin. Kur Atila hyri në fshat u prit nga vajza, të cilat vallëzonin në rreshta, nën
fq. mbulesa të holla dhe të bardha... ato këndonin këngë skythe.
304 Kur u gdhi, Maksimini më dërgoi tek Onegesi që t'i dorëzoja dhuratat e tij dhe ato që i dërgonte perandori, si dhe të njoftohesha në se ai donte të bisedonte me të
fq. dhe kur. Kur arrita bashkë me shërbyesit që mbanin dhuratat, dyert ishin akoma të
305 mbyllura dhe më duhej të prisja deri sa të dilte ndonjë njeri që të lajmëronte për ardhjen tonë.

Në kohën kur unë po prisja dhe po shetisja para gardhit të shtëpisë u afrua një njeri, i cili duke gjykuar nga veshja skythe, m'u duk si barbar. Ai më përshëndeti në gjuhën greqishte, duke më thënë: "Shëndet". Unë u çudita, se si një skyth dinte greqisht, meqenëse skythët janë një përzierje popujsh të ndryshëm; ata përveç gjuhës së tyre barbare përdorin gjithashtu dhe gjuhën e hunëve, gotëve, ose të auzonëve, kur kanë të bëjnë me romakët. Nuk është lehtë të gjendet ndonjë në mes të tyre që të flasë greqisht, me përjashtim të robërve që ata kanë sjellë nga Thrakia dhe Iliria bregdetare. Por, kur i ndesh njeriu mund t'i njohë ata nga rrobat e leckosura dhe koka e ndyrë, si njerëz që kanë rënë në fatkeqësi. Kurse ky dukej se ishte skyth, që rronte në luks, ishte i veshur mirë dhe koka e tij përreth ishte e qethur. Pasi iu përgjigja përshëndetjes, e pyeta se kush ishte, si kishte ardhur në tokën barbare dhe si e kishte pranuar mënyrën e jetës skythe. Ai më pyeti pse doja të dija këtë. Unë i thashë se kureshtja më lindi nga e folura e tij greqisht. Atëherë ai qeshi dhe tha se ishte me prejardhje grek dhe se kishte pas ardhur për tregti në qytetin e Myzisë, Viminac, i vendosur pranë Istrit; se kishte qëndruar për një kohë të gjatë në këtë /qytet/ dhe se ishte martuar me një grua shumë të pasur. Kur barbarët pushtuan qytetin, ai humbi pasurinë e fituar prej saj. Për shkak të pasurisë së tij, gjatë ndarjes së plaçkës, ai i
fq. takoi Onegesit, pasi robërit e pasur i jepeshin së pari Atilës, pastaj parisë skythe,
306 meqenëse ata kishin pushtetin më të madh. Pasi u dallua më vonë në luftën kundër romakëve dhe kundër fisit të akatirëve, ai i dha sipas ligjit skyth, zotërisë së tij, barbarin e kapur në luftë dhe kështu fitoi lirinë. Ai u martua me një barbare dhe kishte fëmijë. Kishte marrë pjesë në trapezën e Onegesit dhe e vlerësonte jetën e

tanishme më të mirë në krahasim me atë të përparshmen, sepse ata që jetojnë tek skythët, pas mbarimit të luftës, jetojnë pa punë, duke u kënaqur secili me atë që ka, dhe nuk shqetësojnë aspak ose shumë pak të tjerët dhe vetë nuk shqetësohen; kurse ata që jetojnë tek romakët në kohë lufte, vriten shumë lehtë, për derisa shpresën për shpëtim e kanë tek të tjerët; kjo ndodh pasi jo të gjithë kanë të drejtë të mbajnë armë nga frika e uzurpatorëve. Kurse ata që mbajnë armë, i dëmton akoma më tepër paaftësia e komandantëve, sepse ata nuk e drejtojnë si duhet luftën. Në kohë paqe jeta *[për romakët]* është edhe më e vështirë në krahasim me të këqijat e kohës së luftës, dhe kjo për shkak të vjeljes së taksave jashtëzakonisht të rënda dhe të dëmeve të shkaktuara nga njerëzit e këqij, pasi ligjet nuk veprojnë mbi të gjithë njëlloj; në qoftë se ai që shkel ligjin është i pasur, ai mund të mos dënohet për fajin e kryer, por
fq. nëqoftëse është i varfër dhe nuk di se si t'i rregullojë punët, merr dënimin sipas ligjit,
307 në rast se nuk vdes para dhënies së dënimit, pasi gjyqi vazhdon për një kohë shumë të gjatë dhe shpenzohen shumë para. Por më e vajtueshme nga të gjitha është se paguhet edhe vendimi i gjyqit. Pse as të fyerve nuk do t'u jepte askush të drejtë në qoftë se nuk do t'u paguanin para gjyqtarëve dhe ndihmësave të tyre. Ai tha këto dhe shumë gjëra të tjera. Atëherë unë u hodha dhe i thashë atij me të butë që të dëgjonte
fq. dhe fjalët e mia... Pasi dëgjoi duke qarë tha, se ligjet janë të mrekullueshme dhe
309 rendi shtetëror i romakëve është i mirë, por drejtuesit nuk janë të ndërgjegjshëm si ata të dikurshmit dhe e prishin këtë rend...

KODEKSI I THEODOSIT

Nën këtë titull janë përmbledhur të gjitha urdhëresat apo ligjet e shpallura qysh nga perandori Konstantin I (viti 312) e deri tek Thedhosi II (viti 437) si dhe Novelat d.m.th. urdhëresat apo ligjet e tjera, që dolën në kohën e Theodhosit e perandorëve të tjerë deri tek Anthemi (viti 467). Ky kodifikim u krye me urdhër të Theodhosit II prandaj mban edhe emrin e tij, dhe u shpall botërisht në shkurt të vitit 438.

Kodeksi përbëhet nga 16 libra të ndara në kapituj të veçantë simbas lëndës dhe rendit kronologjik. Rëndësia e kodeksit si burim për historinë e Ilirikut dhe në përgjithësi për historinë e Ballkanit, është shumë e madhe. Kodeksi përmban listën e urdhëresave që u janë drejtuar sundimtarëve civilë e ushtarakë të krahinave të ndryshme të perandorisë. Në to preken çështje me karakter ekonomik, shoqëror e juridik.

Përkthimi është bërë sipas botimit:

Theodosiani libri XVI cum constitutionibus Sirmondianis et leges novellae ad Theodosianum pertinentes, ediderunt Th. Mommsen et Paulus M. Meyer, vol. I. Berolini 1905.

CODEX THEODOSIANUS

(Kodeksi i Teodosit)

LIBRI I

Për mbrojtësit e qytetit

29,1 *Perandorët augustë Valentiniani*[1] *dhe Valenti drejtuar Probit, prefektit të prefekturës*[2]. "Ne vendosëm në mënyrë krejtësisht të dobishme që i gjithë plebi i Ilirikut të mbrohet nga institucioni i patronëve[3] kundrejt padrejtësive të të fuqishmëve. Le të kujdeset drejtësia jote që të zgjidhen në këtë institucion për secilin qytet të dioçezit të përmendur, disa burra me veti të mira, jeta e mëparshme e të cilëve lavdërohet dhe të cilët ose kanë qenë në krye të provincës, ose kanë kryer shërbimin e tyre në forum[4], ose kanë qenë agjentë të sigurimit të brendshëm, ose kanë qenë oborrtarë. Kjo të mos u besohet dekurionëve. Të mos u jepet kjo detyrë edhe atyre që kanë shërbyer ndonjëherë në rrethin e madhërisë suaj, ose tek çfarëdo guvernator province. Dhe në fakt të na referohet se cilët njerëz, në çfarë qyteti kanë qenë emëruar. Shpallur më 27 Prill (364) në kohën e konsujve, të shenjtëruarit Jovian dhe Varroman".

Për prokuratorët e punishteve tjerrëse dhe të minierave

32,5 *Po ata perandorë [Gratiani*[5]*, Valentiniani dhe Theodosi] augustë, drejtuar Eusignit*[6]*, prefekt i prefekturës.* Meqenëse prokuratorët e minierave[7] në Maqedoni, Daki të Brendshme, Myzi ose Dardani të emëruar, zakonisht, nga rrethi i kurialëve për të mbledhur taksat vjetore, e kanë braktisur këtë detyrë prej frikës nga armiqtë, të detyrohen ta kryejnë këtë detyrë, dhe këtej e tutje të mos u jepet asnjerit prej tyre mundësia që të priren nga detyra jo të përshtatshme për ta, përpara se të kryejnë me

---

[1] Ligji është i Valentinianit I.

[2] Është fjala për prefekturën e Ilirikut Probi qe zgjedhur për të parën herë prefekt i prefekturës në vitin 368, datë e cila nuk përkon me datën e dekretit.

[3] Këtu bëhet fjalë për detyrën "defensor civitatis" mbrojts i qytetit. Kjo detyrë qe krijuar për të mbrojtur shtresat e ulta të populisisë së qyteteve kundër dhunës së sundimtarëve të provincave dhe pronarëve të mëdhenj të tokave.

[4] D.m.th. kanë qenë avokatë.

[5] Me këtë urdhëresë Gratiani s'ka të bëjë mbasi ai ka vdekur që në vitin 383.

[6] Eusigni ka qenë sundimtar i prefekturës Ilirik në vitin 386.

[7] Prokuratorët e minierave ishin persona të ngarkuar për mbikqyrjen e minierave dhe për mbledhjen e taksave. Në periudhën e vonë antike ata zgjidheshin nga rrethi i aristokracisë qytetare (rrethi i kurialëve).

besnikëri dhe me zotësi shërbimin e ngarkuar si prokuratorë, për mbledhjen e taksave. Shpallur në Mediolan më 29 qershor (386), në kohën e konsujve Honorit të ri shumë fisnik, dhe shumë të ndritshmit Evod.

LIBRI III

Për martesat me barbarë

14,1 *Perandorët Valentinian dhe Valent*[1] *augustë, drejtuar Teodosit, komandant i kalorisë.* Asnjë provincial, çfarëdo shtrese që t'i takojë, ose prej çfarëdo vendi që të jetë, të mos martohet me barbare, kurse provincialja të mos lidhet me asnjë barbar. Por në qoftë se në mes të provincialëve dhe barbarëve lind, nëpërmjet martesave të tilla, ndonjë farefisni meqenëse në këto kurora është diçka e dyshimtë dhe e dëmshme le të dënohen me vdekje. Shpallur me 28 Maj (370? 373?) në kohën e konsujve Valentianian dhe Valens august.

LIBRI V

Për senatorët

2,14 *Po ata perandorë [Gratiani, Valentiniani dhe Theodosi]*[2] *august, drejtuar Klearhut*[3]*, prefekt i qytetit [Konstantinopolit].* Urdhërojmë që të gjithë ata të krahinave të Maqedonisë, të cilët janë zgjedhur në senatin augustal të qytetit Konstaninopol[4], të çlirohen nga pagimi i taksës gleba[5], po ashtu sikurse edhe senatorët thrakë. Shpallur në Konstantinopol në vitin (384) në kohën e konsujve Rihomer dhe Klearh.

Mbi pretorët dhe kuestorët

4,11 *I njëjti perandor [Konstanti II]*[6] *august drejtuar senatit*[7]. Në qoftë se dihet se ndokush ka qenë zyrtar në qytetin e Romës, të mos i ngarkohet asnjë lloj detyre shoqërore. Urdhërojmë vetëm që të kërkohen në Ahe, në Maqedoni dhe në të gjithë Ilirikun ata që mbajnë titullin "shumë i ndritur"[8], por që largohen me dredhi nga Kuria[9] e qytetit të Romës dhe rrallë ose hiç fare nuk e vizitojnë vendin, me të cilin është lidhur rangu i tyre. Le t'i tërheqin pronat e tyre të këndshme, por kur ta lypë nevoja, të jenë të pranishëm, pa humbur kohë me udhëtimin e largët. Lexuar (para senatit) më 12 gusht (357) në kohën e konsujve Konstantit august për të nëntën herë, dhe Julianit cezar, për herë të dytë.

---

[1] Ligji është i perandorit Valentinian (364-375).
[2] Ligji është i perandorit Theodosit I (379-395)
[3] Klearhu ishte prefekt i qytetit Konstantinopol në vitet 400-402.
[4] Në këtë rast bëhet fjalë për plotësimin e Senatit që ishte formuar në Konstantinopol me senatorë nga diocezet fqinje.
[5] Taksën gleba e paguanin senatorët sipas madhësisë së pronës së tyre tokësore.
[6] Ligji është i perandor Konstantit II (337-361).
[7] Ka parasysh senatin e qytetit të Romës.
[8] Titulli "shumë i ndritur", "clarissimus", ishte titulli i senatorëve.
[9] Me fjalën "kurie" nënkuptohet senati i Romës.

LIBRI VIII

Për angaritë

5,28 *Po ata perandorë [Valentiniani dhe Valenti] augustë, drejtuar Probi prefektit të prefekturës.* Ajo që është e vlefshme për Galinë[1] duhet të futet edhe në Ilirik, gjithashtu edhe në krahinat e Italisë, dhe pikërisht reda të mos transportojë më tepër se njëmijë libra, kurse në raste angarie[2] të jenë të mjaftueshme për redën një mijë e pesëqind libra, ndërsa për veredën askush mos ta ngarkojë me më tepër se tridhjetë libra. Shpallur nga Sirmi më 28 Dhjetor (368? 370? ose 373?) në kohën e konsujve Valentinian dhe Valens, augustë.

LIBRI X

Mbi peticionet

10,25 *Po ata perandorë [Arkodi dhe Honori][3] augustë, drejtuar Teodorit, prefektit të prefekturës*[4]. Meqenëse në krahinat e Ilirikut[5] pritej një inkursion barbar[6], një populli shumë e madhe vendase kërkoi strehim jashtë vendeve të tyre të lindjes. Zakonisht kundër prejardhjes së tyre të lirë drejtohet vazhdimisht lakmia e petitorëve[7] dhe u vihet atyre në mënyrë të paligjshme zgjedha e robërisë. Dhe kështu le ta dijë madhëria e jote urdhërin, se nuk duhet lejuar që të vihet dorë tek gjithë ata ilirë, të cilët i strehon toka amtare ose i ka pranuar ndonjë vend tjetër. Shpallur më 10 Dhjetor (408) në Ravenë në kohën e konsujve Bas dhe Filip.

LIBRI XI

Prona nuk mund të fitohet pa cens

3,2 *Po ai perandor [Konstantini][8] august, drejtuar Akacit, komes i Maqedonisë.* Skllevërit e regjistruar në regjistrat e censeve[9] të shiten brenda kufijve të provincës dhe ata, të cilët me anë të blerjes fitojnë të drejtën e zotërimit të skllevërve, ta dinë se duhet ta verifikojnë këtë[10]. E arsyeshme është që të ruhet e njëjta gjë dhe në zotërimin e tokës. Mbas anullimit të marrëveshjeve të po këtyre njerëzve detyrimet dhe taksat t'i kalojnë atyre, në pronësinë e të cilëve kanë shkuar (këta skllevër). Shpallur në Thesalonik më 27 shkurt (327) në kohën e konsujve Konstant dhe Maksim.

---

[1] D.m.th. për prefekturën e Galisë.
[2] Me fjalë "angari" në këtë rast kuptohet transporti i detyruar i mallrave shtetërore dhe i nëpunësve nga popullsia vendase.
[3] Ligji është i perandorit Honor (395-425). Në vend të emrit të Arkadit, i cili ka vdekur më 1 Maj të vitit 408, duhet të qëndrojë emri i Theodosit II.
[4] Të prefekturës Ilirik dhe Italisë.
[5] Është fjala për Ilirikun perëndimor.
[6] Bëhet fjalë për marshimin e Alarikut në Itali nëpërmjet Ilirikut.
[7] Petitori është një zyrtar.
[8] Ligji është i perandorit Konstantin I (306-337).
[9] Në këto regjistra shkruhej, sipas provincave, vlera e pasurisë që zotërohej dhe personat që e zotëronin.
[10] D.m.th. të verifikojnë nëse skllevërit që i blejnë, janë të rregjistruar në rregjistrat e censave të së njëjtës provincë.

Që të mos pësojnë dëme provincialët

11,1 *Perandorët augustë Valentinian*[1] *dhe Valent, drejtuar Probit, prefekt i prefekturës ilirike.* Në qoftë se ndonjëri prej atyre[2] nëpunësve, që gjenden nën urdhërat e sundimtarëve të provincave, të cilët udhëheqin zyrat e ndryshme dhe që nën çfarëdo pretekst detyrimi kundrejt shtetit kallin frikë me sjelljen e tyre të keqe, në qoftë se ndonjë njeri i tillë kushdo qoftë ai e detyron fshatarin, që t'i nënshtrohet porsi skllav i tij ose përdor për shërbimet dhe nevojat e veta qoftë skllavin, qoftë edhe kaun e tij, qoftë edhe se përvetëson dhuratat ose shërbimet që i kanë bërë shtetit fshatarët sipas kërkesave të ligjit, qoftë edhe se pranon dhurata e rushfetet e propozuara, gjë që nuk është e lejuar, atij t'i konfiskohet e gjithë pasuria dhe të dënohet me vdekje. Gjithashtu një dënim i rreptë t'i jepet edhe fshatarit, i cili kur e pyesin përgjigjet se vullnetarisht ka pranuar të punojë tek ky *[nëpunës]*. Po një dënim i tillë i rreptë t'u jepet edhe atyre, të cilët i detyrojnë pronarët e tokave t'u bëjnë atyre dhurata, ose të kryejnë shërbime ose nuk e kthejnë atë që i ofrohet. Shpallur në Agripinë me 30 shtator (368? 370? 373?) në kohën e konsujve Valentinian dhe Valens augustë.

Mbi pagimin e taksës për kuaj

Perandorët Valentinian dhe Valent[3] *augustë, drejtuar Aleksandrinit, komes i*
17,1 *thesarit privat të perandorit*[4]. Në vend që të jepen kuaj, nga të cilët mashtrohen prokuratorët tonë, më mirë le të paguhen menjëherë njëzet e tre solide, për çdo kalë që kërkohet nga kolonët dhe të nënshtruarit. Shpallur në Marcianopol më 30 Maj ¨ □□ □

Mbi detyrimet

Perandorët Honori dhe Theodosi[5] *augustë, drejtuar Herkulit prefektit të*
17,4 *prefekturës*[6] Për ndërtimin e mureve të qyteteve dhe për grumbullimin e transportimin e sendeve ushqimore për nevojat e ilirëve, le të detyrohen me punë që të gjithë, pavarësisht nga çdo privilegj. Ne urdhërojmë vetëm që nga këto ngarkesa asnjeri të mos përjashtohet nën pretekstin e çfarëdo privilegji. Detyrimeve të këtij lloji t'i nënshtrohen që të gjithë, në qoftë se e kërkojnë rrethanat, kështu që mos të kërkohet vetëm ajo që është e përshtatshme, por të gjithë të jenë të ngarkuar me këto detyrime, sipas madhësisë së pronave të tyre dhe ngarkesa të bjerë mbi të gjithë, nga më të pasurit deri tek më të varfërit. Shpallur në Konstantinopol me 11 prill (408) në kohën e konsujve Bas dhe Filip.

LIBRI XVI

Për judejt

3,12 *Po ata perandorë [Arkadi dhe Honori]*[7] *augustë drejtuar Anatolit, prefekt i prefekturës Ilirike.* Shkëlqesia e juaj të interesohet që t'i njoftojë sundimtarët (e provincave) në mënyrë që ata të kenë dijeni se mbas marrjes së këtij lajmi,

---

1) Ligji është i perandorit Valentianin I (364-375).
2) Këtu në radhë të parë është fjala për nëpunësit e ngarkuar me mbledhjen e taksave.
3) Ligji është i perandorit Valent (364-378).
4) Tehsari privat i perandorit në këtë kohë ka qenë një institucion shtetëror i cili grumbullonte të ardhurat shtetërore.
5) Ligji është i perandorit Theodos I (379-395).
6) Herkuli në vitin 408 dhe në 410 ishte sundimtar i prefekturës ilirike.
7) Ligji është i perandorit Arkad (395-408).

judejt duhet të mbrohen nga fyerjet e atyre që i sulmojnë, dhe sinagogat e tyre të lihen në qetësinë tradicionale. Shpallur në Konstantinopol në 17 qershor (397) në kohën e konsujve Cezar dhe Atik.

21 *Po ata perandorë [honori dhe Theodosi][1] augustë, drejtuar Filipit, prefekt i prefekturës Ilirike.* Asnjeri, kur është i pafaj, të mos keqpërdoret vetëm pse është jude dhe besimi i tij, çfarëdo që të jetë, mos të bëhet shkak që ai të fyhet. Sinagogat dhe shtëpitë e tyre në asnjë vend të mos digjen dhe të mos shkatërrohen gabimisht pa asnjë arsye, për më tepër bile edhe në qoftë se ndonjeri do të përzihej në ndonjë krim, për këtë është gati fuqia e gjyqeve dhe e mbrojtjes së ligjshmërisë shtetërore, që të mos i lejohet asnjeriu të hakmerret vetë. Por ne, duke dëshiruar që kjo gjë të kihet parasysh për njerëz me prejardhje nga Judea mendojmë gjithashtu, që edhe judejvet t'u kujtohet kjo gjë dhe pikërisht që të mos tregohen mendjemëdhenj dhe kryelartë nga mbrojtja që u bëhet atyre, të mos u lejohen gjithashtu gjëra të pamenduara dhe jo të ndershme kundrejt kultit kristjan. Shpallur në Konstantinopol më 6 gusht (412) në kohën e konsujve Honorit august, për të nëntën herë, dhe Theodosit august, për të pestën herë.

[1] Ligji është i perandorit Theodos II (408-450).

MALHU

Malhu, me prejardhje nga Filadelfia e Palestinës, jetoi në kapërcyellin e shekujve V dhe VI të e. sonë. Nga jeta e veprimtaria e tij letrare nuk dimë veçse pak gjëra që na kumtohen prej leksikografit Suida dhe patriarhut Foti. Nga vepra e tij historike që mbante titullin "Byzantiaka" dhe përbëhej prej 7 librash, janë ruajtur vetëm disa copa në "Excerpta de legationibus" të Konstantinit, në leksikun e Suidës dhe tek Foti. Si kohë historia e Malhut fillon, në qoftë se do t'i besonim Suidës, me sundimin e Konstantinit të Madh.

"Byzantiaka" e Malhut edhe pse e ruajtur pjesërisht, është një nga burimet kryesore për kohën nga viti 473 deri në 480. Malhu i njihte mirë ngjarjet që trajton, nga njerëz që i kishin jetuar apo parë me sy ato. Ai përpiqet të jetë sa më i paanshëm dhe nuk ngurron të kritikojë shpesh të metat e administratës bizantine dhe të shoqërisë sunduese. Me gjithë retorikën me të cilën vishet stili i veprës së tij, ai shquhet për një gjuhë të pastër dhe kuptohet lehtë.

Në njërin nga fragmentet e ruajtura të veprës së Malhut, njoftohemi me imtësi për sulmin e gotëve në trevën e atdheut tonë për pushtimin e qyteteve Skampa, Dyrrah etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Historici graeci minores edidit Ludovicus Dindorfius. Vol. I. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1870.

MALCHI FRAGMENTA

BYZANTIACA

18 fq. 408 I biri i Valamerit *[Theodorihu]*, pasi la shumë nga njerëzit e tij të vrarë nga komandantët ushtarakë romakë, iku shumë i zemëruar për shkak të humbjes që pësoi. Shkatërroi së pari qytetin maqedon Stobin dhe i vrau ushtarët e garnizonit të atjeshëm, të cilët i kundërshtuan. Kur u mor vesh lajmi se barbari ishte vendosur afër Thesalonikut, qytetarët menjëherë menduan se letra kishte qenë lexuar një ditë përpara, për mashtrim, dhe se Zenoni dhe sundimtari i qytetit donin të dorëzonte qytetin. Ata u mblodhën, rrëzuan të gjitha shtatoret e Zenonit dhe, duke sulmuar vetë sundimtarin, qenë gati ta shqyenin. Ata sollën zjarr në shtëpinë e sundimtarit dhe qenë duke e djegur atë po të mos kishin ardhur që përpara njësitë e priftërinjve dhe zyrtarët e lartë për ta shpëtuar nga zemërimi i popullit. Ata e qetësuan masën me fjalë zbutëse, duke thënë se ai nuk ishte fajtor për këtë, se as perandori nuk kishte dhënë ndonjë këshillë të dëmshme ose të keqe për qytetin, dhe se duhej organizuar mbrojtja e qytetit, duke ia besuar njeriut që dëshironin dhe që e quanin si besnik. Ata morën nga sundimtari kyçet e portave dhe ia dhanë kryepeshkopit, kurse burrat që gjendeshin në qytet formuan një roje, sa më të madhe që qe e mundur, duke iu nënshtruar vullnetarisht komandantit të saj ushtarak. Ndërkaq Zenoni, pasi e kuptoi rrezikun që i kërcënohej dhe pasi vuri re se në këtë gjendje të keqe, kur askush nuk donte të luftonte, do të ishte më mirë të largonte barbarin nga shkatërrimi i qyteteve me kushte të matura marrëveshjesh, i dërgoi Artemidorin dhe Fiken, sekretarin e vet, në kohën kur ai kishte qenë strateg. Kur arritën, ata thanë sa më poshtë: "Perandori të bëri mik të tij dhe të stolisi për mrekulli me rangjet më të larta të romakëve, të bëri gjithashtu kryetar të njësive më të mëdha ushtarake, mbasi ai të besonte plotësisht, megjithëse je barbar. Por ti, nuk dimë se si, i gënjyer nga dredhitë e armiqve tonë të përbashkët, hodhe poshtë vlerat e tua dhe pa vetëdije pranove tjetër sundimtar të mirëqenies sate. Ti nuk ke të drejtë të prekësh perandorin për sende, për të cilat ti je fajtor si kundrejt vetes ashtu edhe kundrejt atij. Dhe tani, kur vetë e vure veten në një gjendje të tillë, të mbetet në këtë rast vetëm të kesh kujdes që të mos dëmtosh popullsinë dhe qytetet për sa të jetë e mundur dhe të dërgosh delegatë që të përpiqesh të fitosh kushte më të mira nga ana e perandorit, i cili është i mirë. *[Theodorihu]* pasi i pranoi këto, dërgoi së bashku me ta delegatë në Byzant, kurse vetë ai e ruajti ushtrinë e tij që të mos digjte dhe vriste njerëz, megjithëse nuk qe e mundur të ndaloheshin ushtarët, të cilëve u mungonte çdo gjë, që të siguronin së paku të nevojshmen. Ai u nis përpara dhe erdhi në Heraklea, në Maqedoni. Meqenëse kryeprifti i këtij qyteti i dërgoi ushtrisë dhe atij vetë shumë dhurata, ai e ruajti të tërë vendin nga vuajtjet dhe ushtria e tij nuk i solli asnjë dëm popullsisë, por u përpoq të siguronte pa forcë ushqimin nga vendet fqinje të këtij qyteti. Kurse delegatët e dërguar prej tij, posa arritën në

fq. 409

fq. 410

Byzant, deklaruan se perandori duhj të dërgonte /tek Theodorihu/ një delegat të plotfuqishëm, pasi nuk ishin në gjendje ta mbanin për një kohë më të gjatë masën e madhe që të mos bënte dëme. Atëherë perandori dërgoi Adamantin, të birin e Vivianit, i cili ishte patric dhe kryetar i dikurshëm i qytetit, duke i dhënë edhe gradën konsular. Ai e urdhëroi atë që t'i jepte /Theodorihut/ tokë në Pautali, krahinë në prefekturën ilirike, jo larg nga gryka për në Thraki, qoftë për ta patu atë afër dhe gati kundër Theodorihut, të birit të Triarit, në qoftë se ai do të përpiqej të ndërmerrte ndonjë veprimtari armiqësore, qoftë edhe që ta mundëte atë më lehtë, duke e mbajtur në mes të ushtrive ilire dhe thrake, në qoftë se ai vendoste të prishte marrëveshjen. Me rastin e nisjes së Adamantit, perandori i dha atij dyqind libra ar me urdhër që t'ia jepte sundimtarit të atjeshëm, për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për furnizimin e gotëve me ushqime në Pautali, në rast se /Theodorihu/ do të shfaqte nevojën për ushqime për ushtrinë e tij në këtë vit, pasi ai nuk kishte mbjellë e as nuk kishte shpresë të merrte ushqime nga Pautalia.

Ndërsa i deleguari ishte akoma në Byzant, në Thesalonik u mblodhën ushtarë, të cilët pasi e ruajtën sundimtarin Joan, kur po dilte e sulmuan atë me shpata. Me
fq. urdhër të Zenonit Adamanti vendosi rregullin. Kur po ndodhnin këto në Thesalonik
411. i biri i Valamerit gjendej afër Heraklesë. Ky dërgoi delegatë në Epir tek Sidimundi, i cili rridhte nga i njëjti fis dhe hiqej atëherë si i nënshtruar i romakëve. Ky jetonte në Epir. Në Epidamn kishte një pronë të pasur dhe merrte rrogë nga perandori. Ai ishte kushëri i Aidoingut, i cili kishte miqësi shumë të ngushtë me Vrinën dhe ishte kryetari i të ashtuquajturve domestikë, një nga detyrat e mëdha në oborrin perandorak. Këtij, pra, i dërgoi delegatët për t'i kujtuar farefisninë e tyre të vjetër dhe e luste atë që të kërkonte dhe të zbulonte se si të bëhej zot i Epidamnit dhe i pjesës tjetër të Epirit, që të kishte mundësi, pas kaq endjeve, të vendosej në ndonjë qytet të fortifikuar më mirë, dhe pastaj të rregullonte punët sipas rastit. Sidimundi, si mori prej tij këtë lutje, mendoi se ishte më mirë që barbari të jetonte bashkë me barbarët se sa me romakët dhe erdhi në Epidamn. Duke shkuar vetë tek çdo qytetar ai i këshillonte, gjoja si për të mirën e tyre që secili të nxirrte sa më shpejt dhe në mënyrë të fshehtë plaçkat që kishin dhe të shpëtonin jetën e tyre në ndonjë ishull apo qytet tjetër, duke u thënë se kundër qytetit ishin lëshuar barbarët, dhe se ky ishte vendimi i perandorit dhe se Adamanti ishte dërguar për këtë qëllim. Prandaj, për ata do të ishte më mirë, për deri sa ai ishte akoma larg, të rregullonin punët e tyre në qetësinë më të madhe. Këta ai ua tha dhe ushtarëve, që ishin atje si roje, afro dy mijë vetë, dhe që mund ta zmbrapnin menjëherë edhe me lehtësi armikun. Ai ua mbushi mendjen që të linin të gjithë së bashku Epidamnin, duke u kallur frikë me fjalët e tij dhe duke bërë përpjekje që të përhapte vazhdimisht nga një lajm të ri se do të ishin shumë më të urryer për perandorin ata që do të kundërshtonin
fq. barbarët. Nga ana tjetër i dërgoi lajm të birit të Valamerit që të shpejtonte e të vinte
412. sa më parë. Ky po priste lajmin nga Sidimundi dhe motra e tij që vuante nga një sëmundje, nga e cila /së shpejti/ vdiq. Por ai shfrytëzoi si shkak të vonesës së tij arritjen /e pritur/ të delegatit të Zenonit dhe dëshirën që të merrte vesh, se cilat ishin vendimet e perandorit për të. Pasi varrosi motrën e tij të vdekur, mori lajmin me të cilin Sidimundi e thërriste. Ai dërgoi delegatë tek herakleasit, të cilët kishin braktisur qytetin dhe ishin mbledhur në një kështjellë të fortë, dhe kërkoi nga ata një sasi të madhe gruri dhe vere, në mënyrë që ushtria të kishte rezerva ushqimore për rrugë, pasi ai do të largohej. Por ata iu përgjigjën se asgjë nuk mund t'i jepnin, duke thënë se kishin harxhuar çdo gjë që kishin pasur në kështjellën e vogël gjatë gjithë atyre ditëve. I zemëruar nga kjo, ai dogji pjesën më të madhe të qytetit që qe

braktisur nga banorët e tij dhe u nis menjëherë. Ai u drejtua nëpër një rrugë të ngushtë dhe të vështirë që të shpinte në të ashtuquajturin Epir i Ri. Përpara dërgoi kalorësit që të zinin majat para se të vinte ushtria, në mënyrë që *[prej andej]*, pasi të hynin pa pritur të zbonin rojen që ishte atje që me sulmin e parë. Kur ata u ngjitën, ushtarët të cilët qëndronin roje nëpër mure, duke parë numrin e madh, u trembën nga dukja e tyre e papritur dhe nuk guxuan më të mbroheshin dhe as që nuk u ra ndërmend të mbyllnin fortesën. Atëherë ata u vunë në ikje, duke mos u kujdesur, nga frika e madhe, për atë që mund t'u ndihmonte. Armiqtë, nga ana e tyre, po marshonin përpara nëpër vende të shkretuara. Në krye qëndronte vetë Teodorihu, në mes Soasi, më i madhi
fq. nga komandantët e tij ushtarakë, kurse në fund qëndronte Theudimundi, biri i dytë i
413 Valamerit. Kështu Theodorihu, pasi doli i pari dhe pasi u bind se nuk kishte se kush t'i kundërshtonte, i urdhëroi ata që ishin me karrocat dhe me pajisjet tjera që të ecnin përpara të qetë, kurse ai vetë shpejtoi përpara, që të mund të pushtonte ndonjë qytet. Por kur arriti në Lyhnid, ai u zmbraps, pasi ky qytet është i vendosur në një vend të fortifikuar, brenda është plot me burime dhe që më parë ishte furnizuar me ushqime. Prej këtu, ai u nis dhe pushtoi Skampien, të cilën banorët e kishin braktisur me kohë. Duke u nisur këndej pushtoi Epidamnin. Adamanti, pasi mësoi këtë, dërgoi më parë tek Theodorihu, një nga kalorët perandorakë, të cilët quhen magjistrianë, duke e akuzuar se po vepronte kundër asaj që u kishte premtuar të deleguarve. Ai e urdhëroi atë që të rrinte i qetë, të mos merrte anijet dhe të mos ndryshonte më gjendjen e tanishme, për deri sa të mos vinte ai vetë. Të dërgonte gjithashtu dhe një njeri që të ishte dorëzënës për kthimin e delegatit dhe për sigurimin e tij të plotë. Këto i lajmëroi Adamanti dhe pasi u nis nga Thesaloniku erdhi bashkë me Filoksenin në Edesë, ku gjendej Sabiniani. Ata i dorëzuan letrën perandorake Sabinianit, e emëruan atë strateg dhe u këshilluan për gjendjen. Ata menduan se është e rrezikshme të sulmoheshin barbarët, të cilët ishin hedhur në sulm, pasi vetë Sabiniani kishte një numër të vogël mercenarësh, kurse ushtria shtetërore dhe njësitet e përgjithshme ishin të shpërndara nëpër qytetet ose shoqëronin strategun e saj, Onulfin. Për këtë ata vendosën të shpërndajnë urdhëra për të thirrur ushtarë, kurse strategu të lajmëronte se po dërgonte përpara delegatin. Kur shpërndarësit e urdhërave u nisën, i ndeshi ata kalorësi i dërguar më përpara nga Adamanti, i cili sillte me vete priftin e barbarëve, i quajtur nga kristianët prezbyter, që të ishte dorëzënës për sigurimin e jetës së Adamantit. Dhe kështu, duke e marrë atë me vete, ata shpejtuan dhe arritën në Lyhnid. Sunduesit e qytetit, - ky qytet është i pasur dhe i lulëzuar që në kohë të vjetra – dhe persona të tjerë i pritën, dhe kështu
fq. ata hynë atje. Adamanti dërgoi përsëri në Epidamn një delegat, me anë të të cilit
414 kërkonte që vetë Theodorihu, i shoqëruar prej disave, të takohej me të në ndonjë vend pranë Lyhnidit, që të merreshin vesh në lidhje me atë, për të cilën ai pati dërguar më parë delegatin, ose në qoftë se Theodorihu dëshironte që Adamanti të shkonte vetë në Epidamn, të dërgonte si peng në Lyhnid komandantët e tij ushtarakë, Soasin dhe Dagistheun, që të mbahen për deri sa ai të kthehesh. Theodorihu i dërgoi, po i urdhëroi ata që të qëndronin në Skampia dhe të dërgonin një njeri, për ta bërë Sabianin që të betohej, se edhe ai do t'ia kthente robërit të pacënuar, pasi Adamanti të kthehej shëndosh e mirë. Por Sabiniani nuk pranoi të betohesh, pasi në të kaluarën ai nuk ishte betuar në përgjithësi për asgjë dhe këtë vendim të tij të vjetër tani ai nuk donte ta prishte. Kur Adamanti i tha atij se është e nevojshme që ai të tërhiqej në këtë rast, pse përndryshe takimi nuk do bëhej, pasi ai nuk do të shkonte në qoftëse nuk merrte ndonjë garanci për jetën e tij, Sabiniani prapë nuk pranoi, duke thënë se Adamanti kishte të drejtë

të vepronte si të dinte, por dhe ai vetë nuk do të vepronte kundër zakonit të tij. Atëherë Adamanti, duke u gjetur në një gjendje të vështirë, u nis nga mbrëmja me dyqind ushtarë. Ai udhëtoi nëpër një rrugë të pjerrët e të vështirë, të panjohur prej shumicës, të ngushtë e të parrahur, nëpër të cilën për të parën herë, siç thonin
fq. 415
atëherë, e shkelnin kuajt dhe duke u sjellë rreth e përqark erdhi afër kështjellës së Epidamnit që është vendosur në një kodër të lartë dhe në përgjithësi të papushtueshme. Nën të gjendet një humnerë e madhe, pranë së cilës rrjedh një lumë i thellë. Këtu ai thirri Teodorihun i cili e dëgjoi dhe erdhi. Teodoriuhu arriti pranë lumit me pak kalorë, kurse ushtrinë tjetër e la mbrapa, larg. Adamanti nga ana e tij, i rreshtoi ushtarët rreth kodrës, që të mos rrethohej nga Theodorihu dhe qëndroi mbi një shkëmb prej ku mund të dëgjohej. Ai e ftoi edhe Theodorihun që të largonte njerëzit që e shoqëronin. Dhe kështu ata biseduan njëri me tjetrin. Theodorihu i zemëruar e akuzoi, me sa duket me të drejtë, me këto fjalë: "Unë pata vendosur të ngulesha jashtë Thrakisë, afër Skythisë, ku po të qëndroja, nuk mendoja kurrë të shqetësoja njeri dhe atje do t'i nënshtrohesha me gatishmëri perandorit për çdo gjë që ai të urdhëronte Por ju më thirrët gjoja për luftë kundër Theodorihut[1] dhe në fillim më premtuat se do të vinte menjëherë tek unë me ushtri strategu i Thrakisë, i cili nuk u pa asgjëkundi, pastaj ju më premtuat se do të vinte me mercenarët edhe Klaudi, arkëtar i luftës gote, por edhe atë nuk e pashë; më në fund më dhatë shoqërues, të cilët i lanë rrugët më të mira dhe më çuan nëpër rrugë, të cilat të shpinin tek armiqtë, nëpër rrugë të vështira dhe vende të rrëpinta. Duke ecur, siç dihet, me kalorinë, me qerret dhe pajisjet ushtarake, unë përpak isha duke humbur fare bashkë me gjithë ushtrinë time, i sulmuar papritmas nga armiqtë. Atëherë u detyrova nga nevoja të bëja marrëveshje me ta. Unë duhet që t'i falënderoj shumë, që i dorëzuar prej jush, ata më falën jetën, megjithëse mundnin të më vrisnin. Adamanti nga ana tjetër i kujtoi atij nderet që i kishte bërë perandori, se
fq. 416
e kishte bërë patric dhe strateg, rangje këto të cilat tek romakët u jepen më të merituarve dhe që e kishte mbuluar edhe me dhurata dhe pasuri të tjera. Për këtë arsye, ai kurrë nuk do të kishte pasur ndjenja dhe marrëdhënie të tjera kundrejt tij, përveçse si kundrejt babait. Adamanti u përpoq gjithashtu të mos pranonte akuzat e tij, të cilat ishin, mendoj, të vërteta dhe tha se nuk është e lejueshme që si delegat të marri tokë romake. Romakët, edhe në qoftë se e kishin mbajtur të mbyllur në Thraki, në mes malesh dhe lumenjsh dhe e kishin rrethuar me ushtri, prapseprapë vullnetarisht e lejuan që të tëhiqej. Përndryshe, kundër vullnetit të tyre, ai nuk do të mundte të lëvizte andej, bile edhe nëqoftëse do të kishte ushtrinë dhjetë herë më të madhe nga ajo e tanishmja. Dhe tani e këshillonte që të tregohej më i matur kundrejt perandorit, sepse nuk do të mundëte, në fund të fundit, ta mposhte fuqinë e romakëve që e kishte rrethuar nga të gjitha anët. Dhe kështu ai duhej nëqoftëse e dëgjonte atë, të linte Epirin dhe qytetet në këtë krahinë, pasi askush nuk do të duronte që ai të mbante qytete kaq të mëdha, nga të cilat kishte dëbuar edhe banorët e tyre. Ai duhej të vinte në Dardani. Atje përveç vendeve të populluara kishte toka të gjera, të bukura dhe pjellore që kishin nevojë për banorë. Në qoftë se i punonte ato ai mund të jetonte atje bashkë me ushtrinë e tij në bollëk të madh. Teodorihu u betua se ishte i një mendimi me këtë, megjithatë ai nuk donte të ngrinte prej këndej ushtrinë e tij, pasi ishte shumë e lodhur dhe se vetëm tani ajo kishe filluar të pushonte. Për këto arsye ai nuk mund ta shpinte atë, akoma të pashlodhur, në këtë marshim të gjatë. Ai kërkoi që të lihej tani të dimëronte këtu, duke premtuar se ushtria nuk do të dilte jashtë qyteteve që mbante dhe nuk do të shkretonte vendin.

[1] Theodorihu tjetër, të birit të Triarit.

Në qoftë se perandori do t'i pranonte të gjitha këto kushte, le të dërgonte në fillim të pranverës një njeri që ta përcillte në Dardani dhe ata do ta ndiqnin menjëherë. Ai
fq. shtoi akoma se, si garanci të plotë për këtë, ishte gati të linte pajisjet e tija ushtarake
417 dhe popullsinë që nuk merrte pjesë në luftë, në cilindo qytet që do të caktonte perandori dhe të jepte nënën dhe motrën e tij si peng, kurse ai vetë të vinte një orë e më parë me gjashtë mijë nga ushtarët e tij më të mirë në Thraki. Ai premtoi që me ndihmën e këtyre luftarëve, me ushtarët ilirë dhe me të tjerë që do t'i dërgonte atij perandori do të zhdukte të gjithë gotët nga Thrakia me kusht që në qoftë se e bënte këtë, të bëhej strateg në vend të Theodorihut dhe të lihej që të jetonte në kryeqytet si qytetar romak. Ishte gati gjithashtu, në qoftë se do të urdhëronte perandori, të shkonte edhe në Dalmati dhe të kthente Nepotin në fron. Por Adamanti i tha se ai nuk ishte i autorizuar që të merrej vesh me të për asgjë, për derisa qëndronte në këtë krahinë dhe se duhej të pyeste më parë për këtë perandorin. Dhe kështu ai do t'ia referonte atij, kurse Theodorihu duhej të priste për deri sa të mësonte vendimin e sundimtarit. Në këtë gjendje ata u ndanë njëri prej tjetrit. Ndërsa Adamanti po merrej me këtë punë, në Lyhnid ishin mbledhur tani shumë nga njësitë, sipas urdhërit të strategut. Atëherë dikush i tha Sabinianit se barbarët – në mes tyre gjendeshin Theudimundi, vëllai i Theodorihut dhe nëna e tyre – bashkë me pajisjet e tyre ushtarake, me shumicën e qereve dhe me praparojën, po zbrisnin ngadalë dhe mjaft të qetë nga Kandavia, dhe se Sabiniani mundi të shpresonte t'i zinte rob shumicën e tyre. Atëherë ai /Sabiniani/ vendosi në gadishmëri luftarake kalorinë që kishte me vete, dërgoi mjaft këmbësorë për zbulim përmes maleve dhe i paralajmëroi, se kur dhe nga ku duhej të dilnin. Pas kësaj hëngri darkë dhe pasi
fq. ngriti ushtrinë e tij, u nis aty nga mbrëmja. Me të gdhirë, ai sulmoi barbarët, që
418 ishin në udhëtim e sipër. Theudimundi dhe nëna e tij, pasi panë që po sulmoheshin, ikën me të shpejtë, ranë në fushë dhe shkatërruan menjëherë urën, nëpër të cilën kaluan. Kjo urë ngrihej mbi një hon të thellë që gjendej në mes të rrugës. Kështu ata penguan romakët që t'i ndiqnin barbarët e zbritur në fushë, por edhe të vetëve ua bënë të pamundur ikjen. Kështu, nga dëshpërimi, megjithëse ishin pak në numër, ata u lëshuan kundër kalorësve. Por kur mbi kokat e tyre simbas porosisë, u dukën këmbësorët, ata filluan të ikin në një mënyrë të atillë, sa që disa nga ata që u lëshuan kundër kalorësve u vranë prej tyre, kurse të tjerët nga të armatosurit rëndë. Sabiniani, pasi mori qerret e tyre që ishin rreth dy mijë në numër, më tepër se pesë mijë robër dhe një plaçkë të madhe, dhe pasi dogji në mal disa nga qerret që ishte vështirë t'i tërhiqte nëpër ato rrëpira, arriti në lyhnid. Atje ai gjeti Adamantin, i cili ishte kthyer nga takimi i tij me Theodorihun. Theodorihu akoma nuk dinte asgjë për atë që Sabiniani kishte bërë në mal. Sabiniani i vuri nën roje robërit fisnikë, kurse të tjerët së bashku me plaçkën i shpërndau midis ushtarëve të tij. Ai i lajmëroi qytetet, të cilët i kishte urdhëruar të përgatitnin shumë qerre për nevojat e ushtrisë
fq. që të mos merreshin me to, pasi /qerret/ e zëna të barbarëve ishin të mjaftueshme.
419 Pas kësaj Adamanti i shkroi perandorit, siç kishte premtuar, për bisedimet e tij me Theodorihun. Sabiniani dhe sundimtari Joan, gjithashtu i shkruan për veprimet e tyre, duke i zmadhuar shumë dhe i thoshin se nuk duhet bërë asnjë marrëveshje me barbarin, pasi kishin shpresë ose ta dëbonin me forcë nga vendi ose ta zhduknin, në qoftë se mbetej atje. Perandori pasi mori këto letra, mendoi se ishte më mirë të bënte luftën se sa të pranonte një paqe me turp. Ai e thirri të kthehej delegatin e tij dhe e urdhëroi që të mos bënte marrëveshje me Theodorihun, por t'i thoshte Sabinianit dhe Gentonit – ky i fundit ishte got i martuar me një romake nga Epiri, dhe kishte ushtri – të fillonte luftën me të gjitha forcat, pasi perandori nuk donte të bënte paqe me gotët...

Z O S I M I

Mbi jetën e Zosimit, që ishte përkrahës i paganizmit dhe e quante krishterimin si shkaktar të këqijave që plakosën njerëzimin në kohën e tij, nuk dimë shumë gjëra. Ai ngjan të ketë jetuar dhe shkruar në gjysmën e dytë të shek. V të e. sonë. Historia e shkruar nga Zosimi në gjuhë greke njihet nën titullin "Nea Historia" (Historia Nova) dhe përbëhet prej gjashtë librash. Vdekja e parakohshme nuk i lejoi atij ta përfundojë veprën. Historinë e perandorëve para vitit 270 ai e trajton shkurtimisht duke e përmbledhur në një libër të vetëm, ndërsa periudha tjetër deri në vitin 410, me përjashtim të kohës së Diokletianit, për të cilën hesht fare, jepet më me hollësi. Zosimi përdor një gjuhë e stil të thjeshtë, por vepra e tij është e thatë. Për ngjarjet e shek. IV dhe V ai ka përdorur si burim veprat e Eunapit dhe të Olympiodorit, që kishte po atë mendim si ai mbi fatkeqësitë që i solli krishtërimi perandorisë bizantine e mbarë botës romake.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Zosimi comitis et exadvocati fisci *Historia nova*. L. Mendelssohn, Lipsiae 1887.

ZOSIMI

HISTORIA NOVA

(Historia e Re)

LIBRI I

1 **31** Ndërkaq boranët, gotët, karpat dhe urugunët (fise që jetonin në Ister) nuk lanë pa shkatërruar asnjë pjesë të Italisë dhe Ilirikut, duke pushtuar çdo gjë pa asnjë kundërshtim.

1 **37** Në këtë situatë që mbretëronte në Lindje, kur s'kishte as pushtet as fuqi, skithët, mbasi u morën vesh dhe u bashkuan në një të gjitha fiset, një pjesë e hordhive të tyre shkretoi Ilirinë dhe shkatërroi qytetet e saj.

1 **42** Në këtë kohë, skythë të tjerë të nxitur nga sulmet e bëra më parë u lidhën me herulët, peukët dhe gotët, të cilët ishin mbledhur tek lumi Tyra që derdhet në Pont, dhe pasi ndërtuan gjashtëmijë varka mbi të cilat hypën treqind e njëzetmijë vetë lundruan nëpër Pont. Ata sulmuan qytetin e fortifikuar Tomi, por u thyen, vazhduan rrugën e tyre dhe arritën në Marcianopol, i cili gjendet në Myzi, por edhe këtu pësuan humbje dhe të shtyrë nga një erë e favorshme vazhduan lundrimin më tutje. Kur arritën ngushticat e Propontit, numri i madh i varkave nuk mundi t'i
2 qëndrojë rrjedhjes së shpejtë.

43 ... Për këtë arsye barbarët u tërhoqën nga ngushticat e Propontit dhe u
1 drejtuan për në Kyzik. Ata e lanë këtë pa arritur ndonjë fitore kaluan Helespontin dhe arritën deri në Athos. Pasi rregulluan këtu anijet, ata filluan të rrethojnë Kasandrenë dhe Thesalonikun. Ata sollën makinat rrethuese pranë mureve dhe për pak sa nuk i pushtuan këto qytete. Por, kur morën vesh se perandori po afrohej, ata i futën në brendi dhe plaçkitën të gjithë fshatrat rreth Doberës dhe Pelagonisë. Atje ata u ndeshën me kalorinë dalmate dhe humbën tremijë vetë. Pjesa tjetër që mbeti
2 luftoi me ushtrinë, që ishte bashkë me perandorin. Në betejën që u zhvillua mbetën të vrarë shumë nga të dy anët. Romakët u vunë në ikje, por pataj papritmas duke dalë nëpër rrugë të pakalueshme, u ranë barbarëve dhe vranë pesëdhjetë mijë vetë prej tyre...

45 Kur Egjypti ra nën pushtetin e palmyrasve, skythët që mbetën nga lufta kundër Klaudit pranë Naisit u tërhoqën për në Maqedoni, duke shfrytëzuar karrot si
1 mbrojtje...

1 **33** Konstantini e ndryshoi organizimin e mirë të shtetit dhe e ndau perandorinë, e cila deri atëherë ishte në një dorë, në katër pjesë. Ai i dha njërit zëvendës gjithë Egyptin, bashkë me Pentapolin libik dhe Lindjen deri në Mesopotami, dhe përveç këtyre Kilikinë, Kapadokinë, Armeninë, gjithë bregdetin e Pamfylisë deri në Trapezunt dhe kështjellat pranë Fasit. Po këtij i besoi Thrakinë dhe Myzinë me kufi deri në Aimi, deri në Rodope dhe deri tek qyteti Dobere, dhe përveç këtij Kypron dhe ishujt Kyklade pa Lemnin, Imbrin dhe Samothrakën. Tjetrit Maqedoninë, Thesalinë, Kretën, Heladën, ishujt rreth saj dhe dy Epirët; përveç tyre Ilirinë Dakinë, Tribalinë dhe Paioninë deri në Valeria dhe më në fund Myzinë e Sipërme. Të tretit gjithë Italinë, Siqelinë dhe ishujt rreth saj, pastaj Sardonën, Kyrnin dhe tokën nga syrtët në Kyrenë e deri në Libi. Kurse të katërtit keltët përtej alpeve dhe iberët bashkë me ishullin britanik. Pasi e ndau në këtë mënyrë pushtetin në mes të
2 zëvendësve, ai u kujdes ta kufizonte atë dhe në mënyrë tjetër... ai emëroi stratilatët, një për kalorinë dhe një tjetër për këmbësorinë. Perandori u dha atyre të drejtën të komandonin ushtarët dhe të dënonin të dyshimtët dhe me këtë ai ua hoqi zëvendësave dhe këtë pushtet...

PROKOPI I GAZËS

Lindi në qytetin Gaza të Palestinës dhe në dhjetëvjetshin e fundit të shek. V të e. sonë dhe vdiq po aty në moshën 62 vjeç. Nga Prokopi kemi shumë shkrime retorike. 136 letrat e tij trajtojnë tema të ndryshme, por nuk kanë ndonjë vlerë historike. Prokopi shquhet edhe si interpretues i biblës. Për ne ka rëndësi deri diku fjalimi që mbajti në Gaza me rastin e inaugurimit të një statuje të perandorit Anastas I (491-518), ku ai e mburr veprimtarinë e këtij perandori dhe na jep disa të dhëna edhe mbi vendlindjen e tij, Epidamnin.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Corpus Scriptorum Historiae Byzantinae editio emendatior et copiosior consilio B.G. Niobuhrii C.F. Pars I. Bonnae impensis ed. Weberi 1829.

PROCOPII ORATORIS URBIS GAZAE

PANEGYRICUS IN IMPERATOREM ANASTASIUM

(Panegjyriku i perandorit Anastas)

2. fq 491-492.

Sepse ty fati, sikur ta kish parashikuar mirë të ardhmen, të dhuroi të gjitha ato që i kanë hije hegjemonisë së romakëve[1]. Dhe së pari ashtu siç duhej, të dhuroi atdheun që ua kalon të tjerëve nga lumturia. Sepse Epidamnit i këndojnë shkrimtarët dhe bashkë me ta buçet për të fama si një qytet që zgjatet nga toka në det e që banohet në secilin nga të dyja dhe që ka me tepricë nga ato që mund të prodhojnë toka e deti. Sepse këtu është e mundur që njerëzit të jenë njëkohësisht banorë të ishullit dhe të kontinentit, dhe t'u qëndrojnë larg të këqiave që vinë nga të dyja, dhe të gëzojnë si njërën dhe tjetrën. Sepse atyre që vijnë nga deti ai u del përpara, sikur t'u shtrinte dorën dhe i pret me dashuri njerëzore. Dhe kur ndonjëri, duke lundruar del nga deti Jon, ulet përpara anijes dhe kthehet nga qyteti, duke u ushqyer me kënaqësi me pamjen e sendeve që shikon. Së këtejmi doli banori vendas, Epidamn, që i dha qytetit emrin...

[1] Është fjala për perandorin Anastas I që është me prejardhje nga Dyrrahu (Epidamni).

STEFAN BYZANTINI

Stefan Byzantini, leksikograf i shquar me prejardhje nga Konstantinopoli jetoi dhe punoi në shek. VI të e. sonë. Ai është autor i një leksiku të madh gjeografik të titulluar "Ethnika" ose si e kanë quajtur edhe "Peri poleon kai demon", lat. De urbibus et poulis (Mbi qytetet dhe popujt), hartimi i të cilit mendohet të jetë bërë ndërmjet viteve 528-545. Në përpilimin e kësaj vepre të rëndësishme gjeografike Stefani shfrytëzoi shumë vepra historike e gjoegrafike të autorëve antikë, si ato të Hekateut, Herodoti, Thukididit, Eforit, Strabonit, Pausanias, Herodianit, Orosit etj. Nga kjo vepër na janë ruajtur vetëm epitomet e saj dhe këto të grumbulluara nga leksikografi i kohës së Justinianit Ermolau.

Kjo vepër e Stefanit është një burim me vlerë njohurish gjeografike, topografike dhe historike.

Në veprën e tij, Stefani, i cili dallohej për njohuritë e tij të gjera, i kushton një rëndësi të madhe shkruarjes së drejtë të emrave dhe formimit të saktë të emrave të prejardhur. Leksikoni i Stefan Byzantinit ka rëndësi për historinë e Ilirisë mbasi ai na njofton jo vetëm mbi shumë qytete e fise të Ilirisë e të Epirit të njohur dhe nga burime të tjera më të vjetra, por dhe mbi qytetet të cilat nuk ndeshen në asnjë nga veprat e ruajtura të shkrimtarëve paraardhës.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Stefanus De Urbibus et populis, quem primus Thomas de Pinedo Lusitanus. Amstelodami Typis Jacobi de Jonge 1678.

STEPHANI BYZANTINI

DE

URBIBUS ET POPULIS[1)]

(Mbi qytetet dhe popujt)

ABANTIS... Abantia, që sipa mënyrës barbare *b* kthehet në *m*, u quajt nga Antigoni në Makedonika Periegesis[2)] Amantia. Kalimahu nga ana tjetër e quan Amantina:

Dhe Orikun amantin banonin

ABROI, fis pranë Adrias së taulantëve, fqinj të helidonëve, sipas Hekateut...

AGRIAI... fis i Paionisë, midis Hemit dhe Rodopit, tek Polibi libri XVIII 5,8: *Fisi, pra, i agrajve.* Quhen edhe agraioi, me katër rrokje, dhe agrieis sipas Theopompit...

ADRIA, qytet dhe pranë tij gjiri Adrias si edhe lum, sipas Hekateut. Krahina është e pasur me kullota, prodhon dy herë në vit, lindin binjakë, shpesh tre dhe katër keca në vit, gjithashtu në disa raste edhe pesë e më tepër; dhe pulat pjellin dy herë në ditë dhe nga madhësia janë më të vogla se gjithë pulat e tjera. Qytetari dhe banori adrianos, sipas Asianit. U thonë edhe adriates dhe detit-Adriatik.

ATHAMANIA, Krahinë e Ilirisë, por të tjerë thonë e Thesalisë. Emri etnik athamanes.

AIGESTAIOI, thesprotë, kështu quhen nga i pari i tyre Aigesti.

AIGYLIPS, ndodhet afër Krokyleias[3)] së Epirit. Homeri:

Banojnë edhe Krokylenë dhe Aigylipsin e ashpër.

Ky emër lindi pse është vend shkëmbor i lartë dhe i vështirë për t'u ngjitur. Emri etnik aigylipios.

AIGINION, qytet i ilirëve, sipas Strabonit. Emri etnik aiginieus.

AKYLINA, qytet ilir, Theopompi. Emri etnik akylinaios.

AMANTIA, krahinë e ilirëve pranë Orikut dhe Kerkyrës, banohej nga abantët që ikën nga Troja. Kalimahu e quan atë edhe Amantina, nga ka rrjedhur pronorja amantinika. Quhen edhe abantes. Emri etnik abantieus. I quajnë gjithashtu edhe abantas.

AMBRAKIA, qytet i Thesprotisë. E ka marrë emrin nga Ambraku, i biri i Thesprotit të Laokoonit ose prej Ambrakisë, bijës së Egjeut, për të cilën bën fjalë Filea... Emri etnik ambrakieus dhe ambrakiotes...

AMBRAKOS, qytet i vogël i Epirit, i ndryshëm nga Ambrakia. Banori, ambrakios.

AMYDON, qytet i Paionisë. Emri etnik amydonios.

[1)] Janë nxjerrë vetëm qytetet dhe fiset e Ilirisë dhe Epirit.

[2)] Përshkrim i Maqedonisë.

[3)] Krokylion, ishulli i Itakës.

AMYMNOI, fis epirot, Riani ... quhet edhe Amymnaios e Amymnaio.
AMYNTAI, fis thesprot... E përmend edhe Aristoteli në Politean e epirotëve.
ANTIGONEIA, qytet i Kaonisë në Epir... qytetari antigoneus...
APOLLONIA – e para[1]. Qytet i Ilirisë. E banonin ilirët si edhe Epidamni. Pastaj u dërguan 200 kolonistë korinthas me në krye Gylakun, i cii e quajti atë Gylakea. Emri etnik apolloniates dhe femërorja apolloniatis...
ARBON, qytet i Ilirisë, Polibi libri II. Emri etnik arbnios dhe arbonites.
ARGYRINOI, fis epirot sipas Timeut, Theonit dhe Lykofronit:

Tek argyrinët dhe malet e pyllëzuara të Keraunëve.

ARKTANES, fis epirot, Riani në Thesalika, libri IV.
HARPYIA, qytet i Ilirisë afër enhelejve, ku Batua, karrocieri i Amfiarait, erdhi dhe u vendos pasi qyteti ishte zhdukur. Polibi. Emri etnik harpyetes, *a* kthehet në *e*. Duhet të ishte harpyates.
ARRHA, qytet i Ilirisë. Emri etnik arrhaios.
ASTRAIA, qytet i Ilirisë, Hadrian Aleksandriadi, libri I:

Këta mbanin Astraian dhe Doberan.

ATINTANIA, krahinë e Maqedonisë. Banorët quhen edhe atintanes dhe atintanioi.
AUTARIATAI, fis thesprot. Haraksi,libri VII, Kronika, dhe Favorini në Pantodapai[2], dhe Eratosteni.
AFEIDANTES, Krahnë e molosëve, të quajtur kështu nga mbreti Afeidas.
APSYRTIDES, ishuj në Adria, prej Apsyrtit, të birit të Aietit, vrarë tradhëtisht nga e motra Medea. Banorët e ishujve apsyrteis dhe apsyrtoi... Artemidori në Epitome flet për ishullin Apsyrtos.
APSOROS, qytet i Ilirisë. Herodiani, libri VIII.
BAIAKE, qytet i Kaonisë. Hekateu. Emri etnik Baiakaios, mundet dhe baiakinos, por më mirë është i pari.
BARETION, fshat pranë Adrias. Theopompi, XLII, emri etnik baretinos.
BERENIKAI, me këtë emër janë gjashtë qytete. I pari është ndërtuar nga Pirrua i Ri... U quajt Berenike nga gruaja e Ptolemeut, Berenike.
BEGIS, qytet i tralëve, të cilët ishin pjesë e ilirëve. Emri etnik begites, me karakter vulgar.
BOLUROS, qytet i tralëve të Ilirisë. Begis dhe Boluros janë krahina të ilirëve. Është dhe një qytet në Thesproti.
BUTHOE, qytet i Ilirisë, sipas Filonit. Kështu quhet sepse Kadmi, i hypur mbi një çift qesh e përshkoi shpejt rrugën për në Iliri. Gjithashtu të tjerët *[thonë]* se Kadmi e quajti atë sipas emrit të qytetit egjiptian Butus, i cili u shndërrua në Buthoe. Është në të hyrë qyteti Rizon dhe lumi me të njëjtin emër. Emri etnik buthoaios.
BUTHROTOS, gadishull afër Kerkyrës. Është edhe qytet. Disa thonë se emrin e mori nga themeluesi; të tjerë tregojnë legjendën se emrin ia dha Heleni kur, duke lundruar nga Troja për në perëndim, bëri fli për zbritjen e tij në Epir. Kau që po përgatitesh për fli[3], kur po e thernin i shpëtoi thikës dhe iku me të shpejtë përmes detit, hyri në një gji dhe doli në breg të një toke të pabanuar (kishte një plagë në lëkurë) dhe atje ra e ngordhi. Atëherë Heleni e mori si orakull dhe i vuri emrin Buthrotos, siç thotë Teukri nga Kyziku. Emri etnik Buthrotios. Lepidi e thotë me *t*, butrotios.

---

[1] Këtë emër e mbanin shumë qytete të botës antike. Apollonia e Ilirisë ishte më e rëndësishmja, prandaj Stefani i jep kësaj vendin e parë.
[2] "Materiale të ndryshme".
[3] Në greqishten e vjetër kau quhet δονζ

BULINOI, fis pranë Ilirisë, kurse Artemidori quan Bulina jo fisin, por qytetin, nga i cili emri etnik bulinos.
BUNIMA, qytet i Epirit... Vepër e Odiseut, i cili e ndërtoi pranë Trampias sipas porosisë së orakullit që të shkonte tek burrat që nuk njihnin detin. Pasi bëri fli një ka ndërtoi qytetin.
BUNNOS, qytet i Ilirisë. Emri etnik bunnios sipas Artemidorit, Geografumenon, libri I.
BRYANION, qytet i Thesprotisë. Emri etnik byranios.
BRYSAKION, qytet i parthinës. Qytetarët brysakoi.
BYLLIS, qytet i Ilirisë, pranë detit, ndërtuar nga Neoptolemi i myrmidonëve. Emri etnik bylideus.
BYMAZOS, qytet i paionëve. Efori, libri XXVII.
GENOAIOI, fis i Molosisë nga Genou,i pari i tyre. Riani, në Thesalika, libri IV.
GYLAKEIA, kështu quhej Apollonia e Ilirisë, nga Gylaku prej Korinthi... Emri etnik gylakeus.
DALMION qytet i Dalmatisë, ndërmjet Ilirisë dhe Italisë. Emri etnik i njëllojtë dhe dalmieus. Është zakon i dalmatëve, që çdo tetë vjet të bëjnë ndarjen e tokës. Apiani e quan qytetin Delmimion. Kuadrati nga ana tjetër Dalmion. I quajnë dhe dalmatas.
DASARITAI, fis i Ilirisë Polibi libri VIII dhe femërorja dasaritis Quhen edhe dasarenoi dhe dasaritioi dhe dasaratinos.
DEKSAROI, fis i kaonëve, fqinj të enhelejve. Hekateu në Evorpa, thotë se banonin në rrëzë të Malit Amer.
DIZEROS, qytet i Ilirisë. Lykofroni:

Të cilët banonin në thellësi të gjirit Dizer.

... Emri etnik dizerios dhe dizerites.
DOBEROS, qytet i Paionisë. Qytetarët doberes.
DYRRAHION, qytet ilir. U quajt *Epidamn* nga Epidamni, vajza e të cilit, Melisa, lindi me Poseidonin djalin Dyrrahion... prej së cilës vendi ka marrë emrin Melissonios, ku Poseidoni u bashkua me të. Aleksandri në Europë, e quan atë Dysrahion me *s*:

Epidamni i Dysrahut në breg të detit [është].

Është dhe një tjetër në Lakoni, një prej të njëqindëve. Edhe krahina e Ilirisë *Dysrahia,* gjinia mashkullore e së cilës është Dysrahios. Kurse tani quhen dhe *dyrrahenoi,* sikurse thotë Heren Filoni në Jatrika. Dhe Filonid Dyrraheni mësoi tek Asklepiadi dhe kur ushtronte me sukses mjekësinë në atdhe, shkroi 45 libra.
DODONE, qytet i Molosisë në Epir, nga e cila ka marrë emrin edhe Zeusi i Dodonës:

Që sundon në Dodonën e ftohtë[1)]

Filokseni thotë se janë dy, ajo e Thesprotisë dhe ajo e Thesalisë, e keqe... Të tjerë e shkruajnë Bodonaie, ndërsa qyteti është Bodonon, që nderohet...
DONETTINOI, fis molos, Tiani në Thesalika, libri IV:

Donetinët dhe kerainët e shpejtë.

ENGELANES, fis i Ilirisë janë të njëjtë me enhelejtë, siç thotë Mnasea në librin III të Periegesis[2)].
ENHELEIS, fis i Ilirisë, rrjedh ose prej Enheles ose prej Enheleus. Thuhet edhe enheleai, prej Enhelees ose Enheleas. Thuhet edhe enhelis, femërorja genitiv. Banorët quhen enheleis.
ELEUTII, fis i Japygisë. Hekateu Europa, Partheni i quan *Elefantida.* Emri etnik i pari elefantinos, tjetri elefantinidos dhe elefantinites.

[1)] Homeri - Iliada
[2)] Përshkrimet

ELINI, fis thesprot. Riani në Thesalika libri IV. Dhe vendi Elenia. Është dhe qytet i Siqelisë. Emri etnik eleninos.

HELLOPIA, fshat i Eubesë dhe ishulli, nga Hellopi, i biri i Jonit. Emri etnik hellopieus. Quhej Hellopia edhe krahina rreth Dodonës, banorët e së cilës /quheshin/ helloi dhe selloi. Homeri:

Kurse për rreth [ishin] sellët.

EPIDAMNOS, qytet i Ilirisë, mbi gadishullin e quajtur Dyrrahion. Është dhe një tjetër në gjirin e Jonit. Emri etnik epidamnios gjendet tek Partheni dhe me diftong. Femërorja epidamnias.

EFYRA, qytet i Epirit, prej Efyrit, që ishte i biri i Amarakut të Thesprotit, të Pelasgut, të Lykaonit, të Gegenit, të Arkadit...

EPEIROS, vendi në përgjithësi. Disa i ndajnë atë në dy, të tjerët në tri e në katër pjesë. Prej këndej vijnë /fjalët/ epeirotes dhe epeirotikos.

THESPROTIA, qytet dhe krahinë jashtë gjirit të Ambrakisë. Emri etnik thesprotos dhe thesprotis dhe thesprotiakos.

THESALIA, prej Thesalit; më parë quhej Pelasgia...

JAPODES fis kelt, afër Ilirisë. Dionisi, libri XVI.

JAPYGIA, dy qytete, njëri në Itali dhe tjetri në Iliri, sipas Hekateut. Emri etnik japyks dhe japygios dhe japygia.

JAS, pjesë e Ilirisë. Banorët jatai. Quhet dhe Jonike.

ILLYRIA, vend afër Pangait, nga Iliri, biri i Kadmit. Banorët illyrioi dhe illyris dhe illyrias dhe Illyria, dhe Illyrion, dhe folje illyrizo, dhe ndajfolje illyristi, illyrikos.

JONION, det pranë Italisë. Eskili në Prometheu i lidhur. Disa thonë se rrjedh prej ilirit të quajtur Jon, të tjerë prej italikut Jon. Edhe Adriatiku që nga *Gaza* deri në Egypt quhet gjiri i Jonit. Jone quhej edhe Gaza prej Iut, që kishte fytyrën si të kaut.

KAMMANIA, krahinë e Thesprotisë, më vonë u quajt *Kestrina;* nëpër të cilën rrjedh Kadmi, lum i Kestrinës; e themeloi Kestrini, i biri i Helenit të Priamit. Banorët kammanoi.

KASSOPE, qytet në Molosi, i quajtur kështu nga krahina Kassopia. Emri etnik kassopaios, kassopios dhe kassopia prej kassopios, kassopias si helikonias. Herodoti e quan *Kassopos,* ndoshta gabim; të gjithë e shkruajnë me dy *s.* vetëm Herodiani me një *s.*

KELAITHOI, fis thesprot, kufi me Thesalinë, Riani, libri IV. Quhen edhe Keletheis.

KRANON, qytet i fushës pellazgjike të Thesalisë, i quajtur *Tempe* nga Hekateu në Europa. Është dhe një qytet tjetër i Athamanisë, nga Kranoni, i biri i Pellazgut.

LAKMON, majë e malit Pind nga burojnë lumenjtë Inah dhe Aia, siç thotë Hekateu, libri I... Emri etnik lakmonios.

LIBURNOI fis që banon në pjesën e brendshme të gjirit Adriatik. Hekateu, Europa. Emri etnik liburnis dhe liburnaioi. Kështu janë emëruar nga një i quajtur Liburn Atiku. Janë shpikësit e anijeve liburnike dhe të mantelit liburnika, një lloj veshje.

LISSOS, qytet i Ilirisë, dhe Akro Lissos[1]. Emri etnik lissios dhe lisseus.

LYNKOS, qytet i Epirit, Straboni libri VII. U quajt kështu nga Lynkeu. Emri etnik lynkistai, femërorja lynkistis. Quhet dhe lynkos dhe lynkeus.

LYHNIDOS, qytet i Ilirisë, i thirrur në gjininë mashkullore, dhe liqeni në gjininë femërore. Herodiani e quan atë *Lyhniton.* Emri etnik lyhnidios dhe liqeni Lyhnia dhe Lynites.

MAGIA, qytet i Ilirisë. Emri etnik mundet të jetë dhe magiates dhe magianos...

MARDONES, fis epirot. Eupoli dhe Polesi[2]

Dhe e kaonëve, dhe e paionëve dhe mardonëve...

---

[1] Lisi i Sipërm.

[2] Mbi qytetet.

MELITE, ishull ndërmjet Epirit dhe Italisë, prej nga kanë marrë emrin qentë e Melitës. Banori melitaios...
MELITUSA, qytet i Ilirisë. Polibi, libri XIII. Emri etnik melitusaios dhe melitusios.
MOLOSSIA, krahinë e Epirit. Banori molossos. Dhe femërorja molossis dhe molosa, dhe molotoi me një *t*. Vendi Molotos. Pronori molotikos.
MYLAKES, fis epirot. Lykofroni:

Janë afër krathëve dhe kufizohen me mylakët.

MYON, qytet i lokridasve në Epir. Qytetarët myones, sipas Thukididit libri III. Quhen dhe myoneis.
NARBIS qytet i Ilirisë.
NESTOS, qytet dhe lum i Ilirisë. Emri etnik nestios sipas Artemidorit, Geografumenon, libri II. Dhe Nestis vendi.
NIKOPOLIS, qytet i Epirit, sipas Marcianit... Qytetari nikopolites, siç e quan Pausania në librin X.
NORAKOS, qytet i Paionisë. Qytetari narakios, siç e quan Epafroditi në Homeriket: Se në Paioni ka hekur, i cili po të lëmohet shkëlqen shumë...
OIDANTION, qytet i ilirëve. Theopompi Filipika, libri XXXVIII. Emri etnik oidantes, si thotë Hekateu. Dhe vendi Oidantike.
OLYMPE, qytet i Ilirisë, sipas Domit Kalistratit mbi Heraklenë libri VII. Emri etnik olympaios ose olympeus.
ORESTAI, fis molos, Hekateu, Europa. Theageni në Maqedonika thotë se, mbasi Oresti u shërua nga marrëzia, duke ikur për turpin *[që bëri]* me Hermionën, erdhi në atë tokë ku pati dhe djalin Orest. Duke filluar nga ky u quajtën *orestai.* Ai mbasi u kafshua nga nepërka, vdiq në një vend të Arkadisë që quhet *Orestion*...
ORESTIA, qytet në Oresti, në malin që ngrihet mbi Maqedoninë, prej së cilës rrjedh Ptolemeu i biri Lagu, mbret i parë i Egyptit. Qytetari orestiaios. Ka dhe një tjetër Oresti në Arkadi, të cilën Eudemoni dhe Orosi e shkruajnë me diftongun *ei,* Oresteion.
PARAUAIOI, fis thesprot, Riani në Thesalika, libri IV:

Kurse bashkë me parauajt ishte dhe i famshmi Omfaliea.

Quhen me këtë emër nga që banojnë pranë lumit Auo.
PARENTION, qytet dhe liman afër Istries. Emri etnik parentionos, femërorja parentina.
PARTHOS, qytet ilir. Apollodori në Kronika. Thirret dhe në gjininë mashkullore sipas Polibit. Emri etnik parthinos.
PELION... Është edhe Pelion qytet i Ilirisë, të cilën e përmend Kuadrati. Emri etnik pelinos.
PLARAIOI, fis i Epirit. Quhet dhe *Plarioi.*
POLA, qytet i Ilirisë. Emri etnik polates dhe kep Polatikon dhe Poleatikon.
PRAKNOS, qytet i Ilirisë. Emri etnik praknioi.
PRASAIBOI, fis thesprot.
RIZON, qytet i Ilirisë dhe lumë me të njëjtin emër. Qytetari rizonitios.
SALESIOI, krahinë e paionëve.
SALONA, qytet i Ilirisë. Emri etnik salonites. Është dhe Salonai qytet i Dalmatisë, emri etnik i së cilës saloneus, sipas Priskut, libri VI.
SARDOS, si Parthos, qytet i Ilirisë, qytetarët sardenoi.
SARNUS, qytet ilir. Emri etnik sarnusios.
SESARETHOS, qytet i taulantëve siç thotë Hekateu. Emri etnik sesarethios.
SIRMION, qytet i paionëve. Emri etnik sirmieus.
SYBEROS, qytet ilir. Emri etnik syberios dhe sybereus dhe sybereites.
SYLIONES, fis kaon, sipas Rianit në Thesalika libri IV...
TAULANTIOI, fis ilir. Euforioni me *n* i quan *taulantinoi.* Aristoteli në De Mirabilibus

thotë se këta prodhonin një verë prej mjalti. Quhen dhe në gjininë asnjanëse taulantion dhe në gjininë femërore taulantis.

TEGESTRA në gjininë asnjanëse, qytet i Ilirisë afër Akuileias. Artemidori në Epitomin XI e quan atë *Tergestron,* dhe përmend edhe një fshat: *Nga fshati Tergestre deri tek gjiri i Adrias janë 5029 stade.* Qytetari tegestraios.

TEKMON, qytet i thesprotëve. Qytetari tekmonios.

TRAGASAI, krahinë e Epirit, nga Tragasi, në sajë të së cilës Poseidoni bëri krypën. Këtej rrjedh *krypa tragase,* siç thotë Helaniku në Lesbiaket libri I. Prej saj edhe fusha quhet *Halsion*[1]. Banori tragasaios.

TRALLIA, krahinë e Ilirisë. Quhen dhe tralloi e tralles tek Theopompi. Quhet dhe *Troalikida* dhe *Tralla...*

TRAMPYA, qytet i Epirit pranë Bunimos. Qytetari trampyeus e trampyetes.

TRIBALLOI, fis ilir. Aristofani në Ornithai[2]:

Ç'emra kanë perënditë e këtyre barbarëve?
- Marathonotriballë.

TRIZOI, fis në jug të Istrit. Hekateu. Europa.

TRIPOLISSOI, fis thesprot, të cilët Riani në librin XV, i quan dhe *tripolissios.*

TYMFE, mal i Thesprotisë dhe Tymfai, qytet. Emri etnik tymfaios. Dhe në femërore tymfaia. Pronorja tymfaikon. Dhe tymfaiis si ahaiis.

HYTHMITAI, fis afër liburnëve dhe syopëve, siç thtoë Hekateu në Evropa.

HYLLEIS, fis ilir nga Hylli, bir i Herakliut dhe Melitës bijës së lumit Aigais, siç thotë Apollonios, në Argonautika libri IV. Është dhe qytet Hylle, siç thotë po ai. Emri etnik hylleus dhe femërorja hylleis. Dhe tek Kalimahu hyllis, hyllidos, nga Argeia njera prej nymfeve. Ose nga Hylli, biri i Herakliut dhe Deianeirës. Gjithashtu hyllos, hylleus. Apollodori në librin II Peri Geas[3] thotë: *Mbi hyllejt janë liburnët dhe disa istrë që quhen thrakë.* Dhe femërorja hyllis. Është dhe gadishull, siç thonë, më i madh se Peloponezi, ka pesëmbëdhjetë qytete të populluara shumë. Është hyllis dhe fis në Argo, në Doridë dhe në Troezemi. Anëtari i fisit quhet hylleus. Haraks (në librin IX), *dhe pamfylët dhe hyllejtë.*

HYPAILOHIOI, fis molos. Riani në Thesalika, libri IV.

HYSKANA, qytet ilir, gjinia asnjanëse. Polibi, libri VIII. Emri etnik hyskaneus.

FAROS, ishull në detin Adriatik dhe lum me të njëjtin emër. Është edhe qytet i farasve, sipas Eforit libri XXVIII. Është dhe qytet i Ilirisë sipas Polibit, libri III. Emri etnik farioi...

KAONIA, mezi i Epirit. Banorët kaones. Helaniku në Hiereion Heras[4] libri III: *ambrakiotët dhe mbas tyre kaonët dhe epirotët.* Dhe Prokseni duke i radhitur këta thotë: *Kaonët, thesprotët, tymfajtë, traulët, amynonët, abantët, kasopët.* Quhen dhe kaonios. Euforioni në Hiliasët[5]:

Kaonët i dëgjonin thëniet e Zeusit.

Dhe femërorja Kaonia. Aleksandri i Efesit në veprën Azia dhe Lybia: *Ndërsa të poshtmit banonin Kaoninë pellazgjiike.* Quhen dhe kaonitai, Lykofroni:

Duke shfrytëzuar lumenjtë e Kaonisë së lulëzuar.

Dhe nga kaonos vjen kaonites... Në formën pronore po ai autor:

Zëri nga stolat kaonitë.

Dhe kaonikon nga kaonos. Hekateu në Europa:

Ndërsa gjiri Kiriaos dhe fusha në Kaonikë.

Dhe femërorja kaonis si ausonis. Thuhet dhe kaoneus.

KAYNOI, fis thesprot. Riani në Thesalika libri IV:

Kestrenët, kaynët dhe të ashtuquajturit elinë.

---

[1] E krypur.
[2] Zogjtë.
[3] Mbi tokën.
[4] Mbi flijimet për Herën.
[5] Të njëmijtë.

HEIMERION, kep i Thesprotisë. Emri etnik heimeries...
HELIDONION, fis ilir. Hekateu në Evropë: *Në veri të sesarëtëve banojnë helidonët.* Janë dhe shkëmbinjtë helidonikë, të cilët shumë herë i kemi përmendur. Dy kanë emra, njëri *Korydela* dhe tjetri *Melanippeia,* siç thotë Favorini në Pantodapai.
HYTON, krahinë e Epirit. Efori libri XIX. *Ata që erdhën nga Glazomena u vendosën në Epir në vendin e quajtur Hyton.* Emri etnik hytites.
ORIKOS, qytet në gjirin Jon. Hekateu në Evropa e quan *Orikun liman të Epirit: Pastaj është qyteti Buthrotos, pas këtij limani Orikos.* Edhe Apollodori shumë i admirueshëm e njohu atë si *qytet.* Thuet në gjininë mashkullore, sipas Polibit, libri VII: *Dhe banorët e Orikut janë ata që gjenden të parët afër hyrjes së Adriatikut, duke lundruar nga krahu i djathtë.* Qytetari orikios. Femërorja Orikia, krahinë dhe emër gruaje.

2) STEPHANI FRAGMENTUM

DE URBIBUS ET POPULIS

(Fragment i Stefanit nga vepra "Mbi qytetet dhe popujt).

DYRRAHION, qytet ilir, u quajt *Epidamn* nga Epidamni, bija e të cilit ishte Melisa; nga kjo dhe Poseidoni lindi Dyrrahu. Prej saj në Epidamn ka një vend që quhet Melissonios, ku Poseidoni u bashkua me të *[Melisën].* Pas Rizonit është qyteti Lis, Akrolisi dhe Epidamni, themelim i kerkyrasve, i cili tani quhet Dyrrah, me të njëjtin emër që quhej më përpara *gadishulli,* mbi të cilin është ndërtuar, sipas Filonit. Deksipi në Kronika, libri X, thotë kështu: *Dhe maqedonët, Epidamnin e tanishëm, që më vonë u quajt Dyrrah, e quajnë qytet të madh dhe të pasur të Maqedonisë.* Aleksandri në Europa e quan Dysrahion me *s:*

Epidamni i Dysrahut në breg të detit [është].

Është edhe një tjetër në Lakoni, një prej të njëqindëve. Edhe krahina e Ilirisë quhet Dyrrahia. Euforioni:

Qytetet e Dyrrahies dhe fiset e taulantëve.

Dhe është e qartë se dyrrahios *[është]* i gjinisë mashkullore. Eratosteni në: Geografumenon, libri III thotë: *Banorët fqinjë ishin taulantët.* Kurse qyteti grek Epidamni *[u ndërtua]* mbi gadishullin e quajtur Dyrrah. *[Pastaj]* lumenjtë Dril dhe Lao. Pranë tyre janë varrosur Kadmi dhe Harmonia. Gjithashtu quhen Dyrrahenoi. Kështu thotë dhe Balagri në Maqedonika: *Dhe qytetet e këtyre ndodheshin ndërmjet dyrrahenëve dhe apolloniatëve.* Dhe Heren Filoni në Jatrika thotë kështu për Filonid Dyrrahenin: *Asklepiadi kishte sidëgjues Tit Aufidin nga Siqelia, Filonid Dyrrahenin dhe Nikon Akragantinin.* Dhe prapë: *Filonid Dyraheni nga një anë mësoi tek Asklepiadi dhe nga ana tjetër, duke mjekuar me sukses në atdhe shkroi 45 libra.* Ndërsa Pausania në librin VII për qytetin e lashtë dhe të tanishëm thotë: *Epidamnasit si krahinë kanë atë që kanë pasur që në fillim, ndërsa përsa i përket qytetit, nuk kanë atë të vjetrin, prej atij janë larguar pak, ndërsa emri i qytetit Dyrrah [vjen] nga themeluesi i tij.*
DODONE, qytet i Molosisë në Epir, ku ndodhet Zeusi i Dodonës, që është i pari në Dodonë, dhe Dionisi thotë:

Dodona e Epirit shtrihet pa masë.

Ndërsa Filokseni që ka komentuar Odisenë, thotë se janë dy Dodona, ajo e Thesalisë dhe ajo e *Thesprotisë;* e Thesprotisë është Dodona ku orakulli thuhet nga një lis; tjetra ishte ajo e Thesalisë, nga e cila Akili thirri Zeusin e *Dodonës,* por duket se kështu ka qenë quajtur ky *orakull* prej *Homerit...*

KODEKSI DHE NOVELAT E JUSTINIANIT

Ky kodeks që mban emrin e perandorit Justinian (527-565) ka qenë caktuar të përmblidhte të gjitha burimet juridike të mëparshme. Për hartimin e tij u ngarkuan dhjetë nga juristët më të njohur të kohës, që e filluan punën në Shkurt të vitit 528 dhe e përfunduan në Prill të vitit 529. Më vonë u pa nevoja që kodeksi të merrej rishtas në dorë dhe t'i bëheshin korrigjimet e ndryshme në përputhje me mendimet e dhëna prej juristësh të mëparshëm. U përgatit kështu dhe u shpall publikisht teksti i rishikuar i kodeksit që hyri në fuqi në fund të dhjetorit të vitit 534. Është pikërisht ky tekst që ka arritur deri në ditët tona. Kodeksi është ndarë në 12 libra dhe përmban 4652 dekrete të rreshtuara simbas lëndës.

Ashtu si tek kodeksi i Theodosit edhe dekretet e këtij kodeksi përbëhen prej tri pjesësh: nga "Inscriptio" (mbishkrime), q ëpërmend emrin e perandorit, që nxori urdhëresën dhe emrin e personit që i drejtohej, nga vetë teksti dhe nga "subscriptio" (nënshkrimi) që përbëhet nga data e lëshimit të dekretit dhe qyteti ku është shpallur. Dekreti më i lashtë mban emrin e Hadrianit, ndërsa më i voni mban datën e vitit 534.

Rëndësia e kodeksit të Justinianit, si burim për historinë e krahinave që përfshiheshin në prefekturën e Ilirikut, qëndron në faktin se aty gjenden shumë ligje të drejtuara sundimtarëve të kësaj prefekture. Në këto ligje trajtohen çeshtje me karakter ekonomik, shoqëror dhe legjislativ, si dhe probleme të ndryshme juridike të popullsisë vendase.

Justiniani e vazhdoi veprimtarinë e tij legjislative, duke shpallur një seri urdhëresash të veçanta të njohura me emrin "Novellae constituiones" apo "Leges". Përmbledhja më e vjetër e këtyre novelave që mban emrin "Epitome Juliani", ka qenë hartuar në vitin 556. Përmbledhja e dytë e zgjeruar në përmbajtje doli ndërmjet viteve 578-582. Njihet edhe një përmbledhje e tretë me emrin "Liber authenticorum", ku janë përfshirë 134 novela të Justinianit të lëshuara ndërmjet viteve 535-57.

Novelat që po botojmë japin gjithashtu disa të dhëna me vlerë për gjendjen ekonomike e shoqërore të Ilirikut e Ballkanit gjatë sundimit të Justinianit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Corpus Iuris Civilis, editio stereotypa altera, vol. II. Codex Justinianus recognovit Paulus Krueger. Berolini 1880 dhe vol. III, Novellae, R. Schoell – G.Kroll. Berolini 1895.

L. CODEX JUSTINIANUS

(Kodeksi i Justinianit)

LIBRI I

Për peshkopët dhe klerikët e tjerë

3,35 "... Ne urdhërojmë[1] që çdo qytet, i cili ka qenë rindërtuar në vitet e mëparshme ose që nuk ka qenë qytet përpara, por është deklaruar si i tillë me mirësi perandorake, të ketë me çdo kusht një peshkop të vetin dhe të veçantë që të mos lejohet për çfarëdo arsye bile edhe me urdhër perandorak, që t'i heq, çfarëdo qyteti qoftë, të drejtën e peshkopatit të vet, territorin e tij të caktuar ose ndonjë të drejtë tjetër, dhe në këtë mënyrë t'ua nënshtrojë atë qyteteve të tjera. Dhe kush vepron kundër këtij urdhëri ose përpiqet të veprojë për t'i hequr të drejtën për një peshkopatë të vetën, qoftë qyteteve të rindërtuara ose fshatrave që janë ngritur në rangun e qyteteve, qoftë atyre që mund të rindërtohen ose shpallen si qytete, ose përpiqet nga ana tjetër, t'i heqi disa nga privilegjet e dhëna ose që mund t'u jepen në të ardhmen, përpjekja e tij jo vetëm që do të jetë e kotë, por edhe vetë ai dhe çdo njeri që u kundërshton veprave të dobishme në përgjithësi ose në veçanti, të përbuzet dhe t'i merret pasuria e tij..." (pa datë).

Për oficin "magister militum"[2]

29,4 *Perandori Anastas[3], august, drejtuar Joanit, kryekomandantit të ushtrive në Ilirik*

"Urdhërojmë që të mos lëvizen në asnjë mënyrë ushtarët nga vendet ku gjenden në vende tjera, pa urdhër të veçantë të mirësisë sonë, as të mos zvogëlohen shpenzimet e tyre në vendet, ku ata qëndrojnë. Por në qoftë se lind rastësisht ndonjë nevojë e shpejtë dhe e domosdoshme për dobinë dhe sigurimin e shtetit, atëherë prefektura e lavdishme, gjithashtu dhe oficin i juaj duhet të kujdeset menjëherë dhe pa vonesë të dërgojë tek ne raporte, ku të tregohen si vendet nga ku duhen lëvizur ushtarët, ashtu edhe vendet ku ata duhet të vendosen, emrat e njësive më të mëdha ushtarake, në rregjistrat e të cilëve këta ushtarë janë të rregjistruar dhe para së gjithash shkakun, pse këta ushtarë duhen lëvizur, në mënyrë që pas këtij raporti të merren masat e nevojshme në emër tonë (pa datë).

---

[1] Ligji është i perandorit Zenon.

[2] "Magistri militum" ishin kryekomandantët e ushtrive në pjesët kryesore të perandorisë së Lindjes. Nën urdhërat e tyre gjendeshin të gjitha njësitë ushtarake të provincave.

[3] Ligji është i perandor Anastasit I.

LIBRI II

Për marrëveshjet

4,43 *Perandori Anastas, August, drejtuar Thomait, prefekt i prefekturës Ilirik:* "Urdhërojmë që në të gjitha proçeset e ngritura dhe që kanë mbetur pa përfunduar ose ato që do të ngrihen në të ardhmen në lidhje me gjendjen e skllavit apo të adskripticit, marrëveshjet që do të bëhen ose janë bërë ta ruajnë fuqinë e tyre, në qoftë se ato nuk çfuqizohen nga ndonjë formulë tjetër e njohur juridike, dhe të mos mendohet se fuqia e tyre është e lëkundshme nga fakti se ato kanë të bëjnë me skllav ose adskript". Shpallur me 17 nëntor, në kohën e konsujve Patric dhe Hypat (viti 500).

LIBRI IV

Çfarë mallrash nuk duhet të eksportohen

41,1 *Perandorët Valentinian, Valens*[1] *dhe Gratian, Augusta, drejtuar Theodotit, kryekomandanti i ushtrive.*
"Asnjeri nuk ka të drejtë të transportojë për barbarët verë, vaj ulliri, prodhime peshku as për ushqim, as për tregti" (Shpallur midis viteve 370-375).

2 *Perandori Marcian*[2]*, August, drejtuar Konstantinit, prefekt i prefekturës.* "Asnjeri të mos guxojë t'u shesë barbarëve të huaj të çfarëdo fisi qofshin, që vinë në këtë qytet shumë të shenjtë[3] ose në qytetet dhe vendet e tjera të ndryshme, qoftë si të dërguar ose me çfarëdo shkaku tjetër, parzmore, mburoje, harqe, shigjeta, shpata të gjata dhe të shkurtëra ose çfarëdo arme tjetër në përgjithësi; asnjëri mos t'u shesë as heshta, as hekur qoftë ky i punuar ose si lëndë e parë. Pse është e rrezikshme për shtetin romak dhe pothuaj është e njëllojtë me tradhëtinë, që të furnizojmë me armë dhe të bëjmë më të fortë barbarët, të cilët duhet të kenë mungesa. Por në qoftë se ndonjeri, duke vepruar kundër ndalesës së drejtësisë sonë, shet ndokund ndonjë lloj arme barbarëve të huaj, çfarëdo prejardhje të kenë këta, urdhërojmë që t'i konfiskohen krejtësisht të gjitha pasuritë e tij dhe t'i dorëzohen fiskut, kurse ai vetë të dënohet me vdekje". (Shpallur midis viteve 455-457).

Për baballarët të cilët kanë shitur fëmijët e tyre

43,2 *Perandori Konstantin*[4]*, August, drejtuar banorëve të provincës së tij.* "Nëqoftëe ndonjëri për shkak të varfërisë dhe të nevojës shumë të madhe, ose për mungesë ushqimi ka shitur të birin ose të bijën e tij, duke qenë këta foshnje të posalindur, vetëm në këtë rast shitja është e vlefshme dhe blerësi ka mundësi ta mbajë atë si skllav. Por le t'i lejohet atij që e ka shitur ose ia ka dhënë të tjerëve ose kushdo qoftë tjetër të kërkojë lirimin e tij mjaft që të caktojë çmimin që mund të kushtojë ose të paraqesë në vend të tij një skllav të njëllojtë me të". Shpallur në Serdikë me 18 Gusht, në kohën e konsulit Konstantinit August për të tretën herë, dhe Cezarit Konstantit, për të katërtën herë (viti 329).

---

[1] Ligji është i perandorit Valens.
[2] Ligji është i perandorit Marcian.
[3] Konstantinopoli.
[4] Ligji është i Konstantinit të Madh

Për tregtinë dhe tregtarët

63,2 *Po ata Augustë*[1] *dhe Gratiani August, drejtuar Tatianit*[2]*, komes i thesarit*[3]*.* "Barbarëve jo vetëm mos t'u jepet ar, por edhe në qoftë se gjendet tek ata, le t'u tërhiqet me dredhi. Në qoftë se në të ardhmen do të dërgohet nga tregtarët ar në tokën barbare qoftë për skllevër e për çfarëdo malli, atëherë, ata të dënohen jo më me gjobë, por edhe fizikisht dhe në qoftë se gjyqtari nuk e dënon një sjellje të tillë, pasi ajo të zbulohet, /të quhet/ se ai bën përpjekje për ta mbuluar në mënyrë të ndërgjegjshme krimin (viti 374?).

LIBRI VI

Për kuptimin e fjalëve dhe të gjërave

38,5 *I njëjti August*[4] *drejtuar Joanit, prefektit të prefekturës.* "Duke iu përgjigjur pyetjes së kolegjit të avokatëve në Ilirik, përcaktojmë që fjala "familje" të ketë këtë kuptim: me këtë emërtim të quhen prindërit, fëmijët, gjithë farefisi dhe pasuria, skllevërit e liruar, patronët si edhe skllevërit... Por në raste të tjera emri "familje" duhet të kuptohet edhe si pasuri pse dhe sklelvërit dhe sendet e tjera nënkuptohet se janë pasuri e çdo njeriu". Shpallur në Konstantinopol, me 18 tetor, në vitin e dytë pas Konsulatës së Lampadit dhe Orestit, burra shumë të ndritur (viti 532).

LIBRI XI

Për kolonët ilirë

53,1 *Perandorët Augustë Valentinian*[5]*, Valens dhe Gratian drejtuar Probit*[6]*. prefektit të prefekturës.* "Urdhërojmë që kolonët dhe inkuilinët[7] në Ilirik dhe në krahinat fqinje të mos kenë të drejtë të lënë fshatin në të cilin janë caktuar të jetojnë, sipas prejardhjes dhe farefisnisë së tyre. Le të jenë robër të tokës jo me detyrime taksash, por me emrin dhe titullin "kolon", kështu që në qoftë se ikin dhe kalojnë tek një tjetër, mbasi të kthehen, të futen në burg dhe të dënohen. Të dënohen edhe ata që kanë menduar se mund të pranojnë një /kolon/ të huaj dhe të panjohur, duke rivendosur punën dhe dëmet që kanë pësuar vendet e braktisura prej tyre, dhe duke paguar gjobën, caktimin e së cilës e lëmë në dorën e gjyqtarit. Bile edhe zotëruesi i tokës që do të diktohet se ka pasur /kolonë/ të huaj të detyrohet sipas karakterit të akuzës t'i nënshtrohet dënimit pa u marrë parasysh mosditja për justifikimin. Si dëshmi për krimin është i mjaftueshëm vetëm fakti se ka mbajtur pranë vetes një të panjohur. Dhe në qoftë se ndokush në krahinat e përmendura pranon skllavin, të mos merret parasysh mosditja për justifikim, por të dënohet katërfish, duke paguar dëmet dhe humbjet e pësuara. Gjithashtu për skllevërit e liruar, në qoftë

---

[1] D.m.th. Valentiniani, Valensi dhe Gratiani. Ligji është i perandorit Valens.

[2] Tatiani është një nga figurat e shquara politike në oborrin e perandorisë së Lindjes; në gjysmën e dytë të shek. IV ai kishte detyra të ndryshme të larta.

[3] "Comes sacrarum largitionum" është një nga oficet e larta administrative e financiare në Perandori në epokën e vonë romake; kujdesej për mbledhjen e përgjithshme të taksave dhe detyrimeve si dhe për shpenzimet e shtetit.

[4] Ligji i perandorit Justinian.

[5] Ligji është i Valentinianit I.

[6] Probi sundimtari i prefekturës Ilirik në vitin 371.

[7] Inkuilinët janë një kategori fshatrash të varur.

se ndokush i pranon, të ruhet ajo që përcaktuam për kolonët e lirë". Shpallur me 15 korrik, në kohën e konsulatës së Gratianit, August për të dytën herë, dhe Probit (viti 371).

LIBRI XII

Për kohortalët, princepsët, kornikularët dhe primipilarët

57,9

Të njëjtët Augustë[1], *drejtuar Klearkut*[2], *prefektit të prefekturës Ilirik.* "Në Ilirik, ku dihet se nëpërmjet detyrave provinciale nxirren fitimet më të mëdha dhe më të shumta për nevojat shtetërore, në dikasterin e sundimtarëve të veçantë të provincave të ketë vetëm nga njëqind /nëpunës/ në numër. Dhe askush përtej këtij numri të mos kërkojë detyrë ose të vazhdojë të qëndrojë për shkak të butësisë së sundimtarëve.
Në këtë mënyrë për punë në këto dikastere të mos merren ata, të cilët nën shkakun e shërbimit tërhiqen nga fitimet e mëdha, por ata të cilët kryejnë detyrat e tyre me zellin e nevojshëm" (viti 396).

2. NOVELLAE

Urdhëresë për emërimin e sundimtarëve pa asnjë dhuratë

Nov.

VIII */ njëjti perandor drejtuar Joanit, për të dytën herë prefekt i prefekturës, ish konsul dhe patric...* Ne mësojmë se në punët shtetërore është futur një padrejtësi e plotë dhe jo shumë kohë përpara, por në këto kohët e fundit. Kjo i shqetëson të nënshtruarit tonë dhe i shpie deri në varfëri, kështu që paraqitet rreziku që të bien në skamje të madhe dhe të mos munden pa ndonjë detyrim të madh, të paguajnë as taksat e zakonshme shtetërore të përcaktuara nga ligji me bindje...
1. Dhe kështu tek ne lindi mendimi se çfarë duhet bërë me një akt të përgjithshëm, që të ndryshojmë në të mirë gjithçka është e dëmshme në provincat tona. Ne mendojmë se kjo do të bëhet pa tjetër, në qoftë se do ta rregullojmë që sundimtarët e provincave, të cilët kanë drejtimin civil në këto provinca, të ruajnë duart e tyre të pastërta dhe të përmbahen nga çdo interes, duke u kënaqur vetëm me atë që iu jepet atyre nga thesari i shtetit...
Në qoftë se atë që do të hynte në thesarin e shtetit në rrethana kur duart e sundimtarit janë të pastërta, sundimtari e merr për vete dhe /me këtë/ e bën të varfër paguesin e taksave, ky do të na mvishte këtë varfërim që ia shkakton sundimtari. Dhe sa e sa veprime të tjera të këqia ndodhin...

Pse sundimtarët e provincave i lirojnë shumë fajtorë pasi ua shesin atyre krimin, kurse nga ana tjetër dënojnë shumë të pafaj që t'u bëjnë qejfin fajtorëve. Dhe këtë ata e bëjnë jo vetëm në veprimet monetare, por dhe në paditë, ku jeta është në rrezik. Fillon ikja nga provincat dhe drejtohen këtu priftërinj, dekurionë dhe kohortalë, pronarë tokash dhe qytetarë municpesh e kolonë, dhe të gjithë ankohen dhe në mënyrë të drejtë qortojnë vjedhjet dhe padrejtësitë e sundimtarëve. Dhe ndodhin jo vetëm këto, por edhe kryengritje e qyteteve dhe kryengritjet e popujve

[1] D.m.th. Arkadi dhe Honori. Ligji është lëshuar nga perandori Arkad.
[2] Klearku, prefekt i prefekturës ilirike rreth vitit 396.

popujve, dhe pjesa më e madhe pushojnë për hir të parave. Dhe në përgjithësi ky është i vetmi burim i gjithë të këqijave. Dhe blerja e ofiqeve është fillimi dhe fundi i çdo të keqeje. Dhe nga fjalët hyjnore më e çuditshmja dhe më e drejta është kjo se dëshira për argjend është nëna e gjithë të këqijave, dhe veçanërisht kur ajo bën folenë jo në shpirtrat e qytetarëve të veçantë, por në atë të sundimtarëve... Dhe ne nuk do të ishim në gjendje as të vërenim dhe të tregonim se sa gjëra të këqjia ndodhin për shkak të vjedhjeve të sundimtarëve të provincave, meqenëse askush nuk guxon haptazi t'i dënojë, pasi ata menjëherë shfajësohen me faktin që ofiqet janë të blera. Shpallur me 15 prill në Konstantinopol në kohën e konsulatës së Belizarit (viti 535).

Për privilegjet e kryepeshkopit të Justinianës ë Parë

Nov. **XI.** *I njëjti perandor, drejtuar Katelianit Kryepeshkopit, shumë të lumtur të Justinianës së Parë.*

Meqenëse aq fort dëshirojmë të lartësojmë me mënyra të shumta dhe të ndryshme qytetin tonë të lindjes, ku për të parën herë zoti na lejoi të dukemi në këtë botë të krijuar nga ai vetë, ne duam që edhe përsa i përket pushtetit kishtar ai të rritet në shkallën më të lartë, kështu që drejtuesi shpirtëror i sotëm i ndritshëm i qytetit tonë Justiniana e Parë të bëhet jo vetëm mitropolit, por edhe kryepeshkop dhe nën pushtetin e tij të jenë disa provinca dhe pikërisht si vetë Dakia e Brendshme, ashtu edhe Dakia Analumase, gjithashtu dhe Myzia e Parë, Dardania, provinca Prevalitane, Maqedonia e Dytë dhe një pjesë nga Panonia e Dytë, e cila është në krahinën e qytetit Bacensit. Në kohë të vjetër ka qenë organizuar prefektura në Sirm dhe atje ka qenë i gjithë pushteti i lartë i Ilirikut, si për sa i përket çështjeve civile, ashtu edhe çështjeve fetare. Por më vonë, në kohën e Atilës, meqenëse vendet e të njëjtit /Ilirik/ qenë shkretuar, prefekti Apremi erdhi në Thesalonik dhe atëherë edhe denjësia peshkopale ndoqi vetë prefekturën dhe peshkopi i Thesalonikut meritoi një farë epërsie jo nga pushteti i tij, por nën hijen e prefekturës... Shpallur më 14 prill gjatë konsulatës së Belizarit shumë të lavdishëm (viti 535).

Askush, nga ata që i kanë dhënë hua bujkut, mos t'ia mbajë tokën atij.

Nov. **XXX.III** *I njëjti perandor drejtuar Dominikut, burrit të shquar, prefekt i prefekturës Ilirik.*

Për shkak të pangopshmërisë së huadhënësve të cilët, duke shfrytëzuar vështirësitë e kohës, kundrejt një ushqimi të paktë u marrin tokat fshatarëve të mjerë dhe ua mbajnë gjithë pasurinë, ne e bëmë këtë ligj, të cilin me të vërtetë, së pari e dërguam në Thraki dhe në të gjitha provincat e saja dhe tani e dërgojmë edhe në tokat e ilirëve... Le ta dijë edhe lartësia e juaj se ligji është paraparë të shtrihet mbi të gjithë, edhe mbi provincialët, edhe mbi ushtarakët mbi çdo gradë dhe mbi çdo njeri pa përjashtim... Shpallur më 15 korrik në Konstantinopol, gjatë konsulatës të shumë lavdishmit Belizar (viti 535).

Për kanonet dhe privilegjet kishtare

I njëjti perandor drejtuar të shquarit Petër, prefekt i prefekturës.

KAP. III.

Nov. **CXXXI,** ... Dhe shumë i lumturi në këtë kohë kryepeshkopi i vendlindjes sonë, Justiniana e Parë, të ketë nën juridiskionin e tij peshkopët e provincave të Dakisë së Brendshme, Dakisë Analumase, Prevalitanës dhe Dardanisë, të Myzisë së Sipërme dhe Panonisë dhe ato të udhëhiqen prej tij. Por ai vetë të jetë i drejtuar nga sinodi i tij dhe në provincat që i nënshtrohen atij të jetë zëvendës i fronit apostolik romak, sipas përcaktimit të papës së shenjtë Vigilit.
Shpallur me 18 mars në Konstantinopol në 18 vjetëshin e sundimit të zotit tonë Justinian August, babai i atdheut, dhe në vitin e katërt pas konsulatës së Vasilit shumë të lavdishëm në të 8-in indiktion (viti 545).

Për fëmijët e hedhur

Nov. **CLIII** *I njëjti perandor drejtuar Ilisë, prefektit shumë të lavdishëm të Ilirikut.*
(Hyrje) Andrei, shumë i përshpirtshëm prezbyter dhe apoksisiar i kishës shumë të shenjtë të Thesalonikut na lajmëroi për një krim të huaj për arsyen njerëzore dhe të pabesueshëm bile dhe për gjithë barbarët. Disa kanë hedhur foshnjet e posalindura dhe i kanë lënë në kishat e shenjta. Dhe pasi fëmijët u edukuan dhe u rritën nga njerëz mirëbërës, ata i kanë marrë me gjyq dhe i kanë deklaruar si skllevër. Dhe egërsinë e tyre e çojnë më tej duke u hequr lirinë, pasi janë rritur, atyre që në fillim të jetës së tyre i kishin lënë në mëshirë të vdekjes... Ne urdhërojmë që të vëzhgoni në të ardhmen mbi këtë gjë.

KAP. I.

Dhe kështu ne urdhërojmë që të jenë të lirë, me çdo kusht, ata për të cilët vërtetohet se kanë qenë hedhur në këtë mënyrë nëpër kisha, nëpër rrugë ose në vende të tjera, bile edhe në qoftë se deklaruesi ka të dhëna të sigurta për të vërtetuar se një person i tillë varet nga pushteti i tij; pse nëqoftëse në ligjet tona është caktuar që të lirohen krejtësisht skllevërit e sëmurë të cilët janë braktisur nga zotërit e tyre dhe nuk tregohet për ta kujdes nga pronarët, meqenëse shërimi i tyre është i pashpresë, atëherë si do të lejojmë që të tërhiqen në skllavëri të padrejtë ata të cilët në fillim të jetës së tyre i kanë qenë dhënë bamirësisë së njerëzve të tjerë dhe rritur prej tyre. Ne urdhërojmë kryepeshkopin e Thesalonikut, kishën e zotit që gjendet nën vartësinë e tij dhe mirësinë tënde t'u ndihmojë këtyre njerëzve dhe t'ua kthejnë lirinë. Dhe ato të cilët kryejnë këtë krim, të mos i ikin dënimeve të ligjeve tona...
Shpallur më 12 dhjetor në Konstantinopol në të 15-in vit nga sundimi i zotit tonë Justinian August, babai i atdheut, gjatë konsulatës të shumë lavdishmit Vasil (viti 541).

PROKOPI I CEZARESË

Historian i madh bizantin i kohës së Justinianit. Lindi në Cezare të Palestinës aty nga fundi i shek. V - fillimi i shek. VI i e. sonë dhe, pasi kreu studimet në shkollën e famshme të sofistëve në Gaza, erdhi dhe u vendos në Konstantinopol, ku shumë shpejt u bë një personalitet i shquar politik dhe zuri vende me rëndësi në administratën bizantine. Në vitin 527 u emërua këshilltar për çështjet juridike dhe sekretar personal i Belizarit. Si i tillë e ndoqi këtë gjeneral të famshëm në ekspeditat e tij ushtarake në Azi, në fushatën kundër persëve, në Afrikë kundër vandalëve dhe në Itali, kundër gotëve deri në vitin 540. Pjesën tjetër të kohës e kaloi duke shkruar historinë e kohës së vet. Vdiq pak më vonë se viti 565.

Prokopi shkroi tri vepra: "Oi iper ton polemon logoi" lat. "De bellis" (Historia e luftave), "Peri ktismaton" lat. "De aedificiis" (Mbi ndërtimet), "Anekdota" lat. "Historia arcana" (Historia e fshehtë). Prej tyre më e rëndësishmja është e para. Vepra është ndarë në tetë libra: dy i janë kushtuar luftërave të Justinianit kundër persëve (lib. I-II), dy luftërave kundër vandalëve (lib. III-IV) dhe tri luftërave kundër gotëve (lib. V-VII). Këto të shtatë libra dolën në dritë rreth vitit 550; i teti që është deri diku një sintezë dhe një plotësim i të parëve doli më vete më vonë. Ai u kushtohet ngjarjeve që ndodhën deri në vitin 554.

Toni i përgjithshëm i veprës është më tepër lavdërues ndaj Justinianit dhe komandantit të tij Belizarit. Megjithatë pasuria e madhe e fakteve, saktësia e tyre si dhe vlerësimi i drejtë që u bëhet ngjarjeve më të rëndësishme në këtë vepër e vënë Prokopin në radhën e historianëve më të shquar të antikitetit.

Traktatin "Mbi ndërtimet" Prokopi e shkroi rreth vitit 560, me sa duket me kërkesën e Justinianit ose për t'i bërë qejfin atij. Kjo vepër e shkruar me një stil retorik dhe me një shpirt servil është një listë e gjatë e ndërtimeve dhe fortifikimeve, që u bënë me urdhër të Justinianit në krahinat e ndryshme të perandorisë. Në të paqyrohet gjendja kritike, që kishte pushtuar perandorinë bizantine në kohën e dyndjeve barbare.

Krejt ndryshe nga përmbajtja dhe fryma është vepra e tretë e Prokopit "Historia e fshehtë". Në qoftë se në dy veprat e para Justiniani është paraqitur si sovran i drejtë e serioz, shpëtimtar e restaurues i perandorisë, këtu ai është interpretuar si një tiran mizor dhe si fajtori kryesor për të gjitha të këqijat që pësoi perandoria gjatë sundimit të tij. Në këtë vepër pasqyrohen pikëpamjet e opozitës kundër Justinianit (përfaqësues i së cilës ishte edhe Prokopi),pas dështimit të plotë të politikës së tij të fundit për restaurimin e perandorisë dhe pas gjendjes kritike që ishte krijuar në perandori me shtimin e dyndjeve barbare.

Veprat e Prokopit janë burimi kryesor për historinë e kësaj periudhe sepse ato përmbajnë të dhëna shumë të sakta të përshkruara nga dora e një historiani me përvojë, i cili është mbështetur gjerësisht si në vrojtimet personale edhe në dëshmitë e bashkëkohësve dhe dokumentet zyrtare.

Në këto vepra gjejmë njoftime shumë të rëndësishme edhe për krahinat e Ilirisë. Rëndësi të veçantë ka për ne sidomos traktati "Mbi ndërtimet", në të cilin ndodhen të dhëna shumë të vlefshme mbi gjeografinë dhe toponomastikën e Ilirisë. Në listën e gjatë të kështjellave të ndërtuara ose të rindërtuara nga Justiniani që na jep Prokopi, përmbahen edhe shumë emra qytetesh e lokalitetesh të Ilirisë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:
Procopii Caesariensis, Opera omnia, recognovit Jacobus Haury, Vol. I-II. De bellis libri I-IV et V-VIII, vol. III, 1. Historia quae dicitur arcana, Vol. III, 2, IV libri de aedificis. Lipsiae in aedtibus B.G. Teubneri 1905, 1906, 1913.

PROCOPII CAESARIENSIS

1. DE BELLO VANDALICO

(Lufta me vandalët)

LIBRI III (I)

14 **1** Pjesa më e madhe e Libisë që zgjat nëntëdhjetë ditë rrugë, i përkiste sunduesit të shtetit perëndimor; kaq është largësia prej Gadeirës deri në kufitë e Tripolit të
15 Libisë. Atij i përkiste në Evropë edhe hapësira prej shtatëdhjetë e pesë ditësh që nga shtyllat e Herakliut deri në gjirin e Jonit. Dikush mund të shtojë edhe largësinë për
16 rreth gjirit. Kurse mbreti i Lindjes trashëgoi hapësirën, që zgjat njëqind e njëzet ditë rrugë, që nga kufijtë e Kyrenës në Libi e deri në Epidamn, i cili gjendet afër gjirit të Jonit dhe që tani quhet Dyrrah. Atij, siç u tha më lart, i përkiste dhe gjithçka që ishte
17 e romakëve në bregun e Pontit Euksin. Një ditë është baras me dyqind e dhjetë stade, që është sa rruga nga Athina në Megarë. Kështu i ndanë ndërmjet tyre tokat
18 perandorët romakë[1].

Përsa u takon ishujve, Britania që ishte më e madhja e Oqeanit iu la perandorit të Perëndimit, ashtu siç e kërkonte gjendja. Ai kishte edhe Ebusën, në këtë anë të
19 ngushticave, që zgjat shtatë ditë rrugë dhe që ishte e pambrojtur nga rreziqet e detit. Ai kishte dhe dy ishuj të tjerë që në gjuhën e vendit quhen Maiorka dhe Minorka. Më së fundi çdo ishull i takonte njërit apo tjetrit perandor sipas afërsisë që kishte me kufijtë e tij.

7 **2** Përsa u takon të tjerëve, vizigotët, të cilët kishin dalë nga këto vende, në fillim lidhën aleancë me perandorin Arkad. Por më vonë (nuk është parë që barbarët t'u
8 qëndrojnë besnikë romakëve), të udhëhequr nga Alarihu, sulmuan pabesisht kundra të dy perandorëve veç e veç, dhe duke filluar nga Thrakia e trajtuan gjithë Evropën si armike. Perandori Honor, në fillim qëndronte në Romë duke shijuar qetësisht
9 paqen në pallatin e tij, pa menduar aspak për luftën. Kur mori vesh se barbarët kishin arritur në tokat e taulantëve me një ushtri shumë të madhe, ai menjëherë la pallatin
10 dhe luksin dhe shkoi në Ravenë, që është një qytet shumë i fortë në bregun e detit Jon. Ka disa që thonë se ai vetë i solli gotët për të shtypur kryengritjen e
11 nënshtetasve të tij, por me sa e njoh unë karakterin e këtij prijësi, nuk mund t'u zë besë këtyre fjalëve. Barbarët, meqë nuk gjetën asnjë qëndresë, s'lanë mizori pa bërë.
12 Ata i rrënuan aq shumë të gjitha qytetet që shtinë në dorë dhe sidomos ato që ishin në këtë anë të Jonit, saqë nuk ka mbetur më asnjë gjurmë prej tyre, me përjashtim
13 ndoshta të ndonjë kulle apo të ndonje porte. Kurse njerëzit i vranë që të gjithë duke mos bërë dallim, nëse ishin pleq apo të rinj dhe nuk kursyen as gratë e fëmijët. Për këtë arsye Italia sot është kaq pak e populluar. Ata rrëmbyen të gjitha pasuritë e Evropës dhe pasi u ngarkuan me thesaret publike të Romës dhe plaçkat e grabitura nga populli, u tërhoqën në Gali.

---

[1] Arkadi - Lindjen, dhe Honori - Perëndimin.

2. DE BELLO GOTHICO

(Lufta me gotët)

LIBRI V (I)

1 Afërsisht në këtë kohë[1], gotët që ishin vendosur me lejen e perandorit në Thraki, u ngritën me armë në dorë kundër romakëve, të udhëhequr nga Teodorihu, patric që kishte marrë në Byzant titullin konsull. Si një njeri që dinte t'i shfrytëzonte mirë rrethanat, perandori Zenon e bindi Theodorihun të hidhet në Itali dhe të hyjë në luftë me Odoakrin, të marrë për vete dhe për gotët pushtetin në perandorinë e Perëndimit; dhe është më me nder për të, i tha ai, aq më tepër që ai mban titullin e lartë të senatorit, që pasi të mundi zaptuesin e pushtetit, të vihet në krye të gjithë romakëve dhe italikëve, se sa të hyjë në një luftë kaq të vështirë me perandorin. Teodorihu, i gëzuar nga ky propozim, u nis për në Itali[2], dhe pas tij dhe gjithë gotët, duke ngarkuar në qerre fëmijët dhe gratë e tyre. Kur arritën në breg të Jonit, ata u bindën se pa anije nuk mund të hidhen në asnjë mënyrë në bregun tjetër. Atëherë ata u nisën gjatë bregdetit me qëllim që t'i binin atij përqark dhe, duke vazhduar rrugën, kaluan nëpër tokat e taulantëve dhe të fiseve të tjera që banonin këtu...

5 Si mori vesh ç'ndodhi me Amalasuntën[3], perandori *[Justinian]* vendosi të fillojë menjëherë luftën. Ky ishte viti i nëntë i sundimit të tij[4]. Dhe Mundin, kryekomandantin e Ilirisë, ai e urdhëroi të marshonte për në Dalmati, që ishte nën sundimin e gotëve, dhe të përpiqej të pushtonte Salonën...

... Mundi erdhi me ushtrinë e tij në Dalmati dhe si luftoi me gotët i mundi dhe zuri Salonën.

7 Në kohën kur perandori vepronte në këtë mënyrë dhe të dërguarit e tij ishin nisur për në Itali, gotët nën udhëheqjen e Asinarit, Gripas e të tjerëve, erdhën me një ushtri të madhe në Dalmati. Kur iu afruan Salonës, u takua me ta i biri i Mundit, Mauriku, që kishte dalë me një numër të vogël ushtarësh jo për luftë, por për zbulim. Megjithatë u bë një përleshje e madhe, në të cilën nga ana e gotëve ranë të parët dhe më trimat, kurse romakët u vranë thuajse të gjithë bashkë me komandaantin e tyre Maurikun. Kur e mori vesh Mundi, i tronditur thellë nga kjo fatkeqësi dhe i egërsuar shumë, u nis menjëherë kundër armiqve pa ndonjë rregull. U zhvillua një betejë e zjarrtë... Këtu u vranë shumë prej armiqve, kurse të tjerët ikën në rrëmujë, por Mundi, duke i ndjekur dhe vrarë të gjithë pa dallim dhe i paaftë për t'u përmbajtur nga dëshpërimi për të birin që u vra, ra nën goditjet e njërit prej atyre që iknin...

Në Salonë nuk hyri asnjë prej ushtrisë armike. Romakët që mbetën fare pa komandant, u kthyen në shtëpi, kurse gotët, meqenëse nuk u mbeti asnjë nga luftëtarët trima, të pushtuar nga frika, zunë në këtë vend kështjellat e fortifikuara. Ata nuk u besonin mureve të Salonës, aq më tepër që romakët silleshin ndaj tyre në mënyrë jo aq miqësore...

Perandori Justinian, pasi dëgjoi për të gjitha këto, dhe për ato që ndodhën në Dalmati, dërgoi në Iliri Konstantianin, komandantin e kalorësisë perandorake, duke e urdhëruar që të mbledhi atje ushtri dhe të zërë Salonën me çdo kusht, kurse Belizarin ai e urdhëroi që të shkojë, sa të jetë e mundur më shpejt në Itali dhe të veprojë

---

[1] Në vitin 487-488.

[2] Në vitin 488.

[3] Amalasunta ishte e bija e Theodorihut, e ëma dhe kujdestarja e Atalarihut, pasardhësit të Theodorihut, e cila u vra nga aristokracia gote e kryesuar nga Theodati, fis i Theodorihut.

[4] Viti 535/6.

kundër gotëve, ashtu sikurse veprohet kundër armiqve[1]. Konstantiani erdhi në
27 Epidamn dhe u ndal këtu për një kohë sa mblodhi ushtri. Gjatë kësaj kohe, gotët të udhëhequr nga Gripa erdhën me një ushtri tjetër në Dalmati dhe zunë Salonën.
28 Konstantiani, pasi i përfundoi si duhet pregatitjet dhe si u nis nga Epidamni me të gjithë flotën, arriti në Epidaur, qytet që gjendet në të djathtë për ata që lundrojnë në gjirin e Jonit. Këtu ishin njerëzit që kishte dërguar Gripa si zbulues.
29 Kur panë flotën dhe ushtrinë këmbësore të Konstantianit, atyre iu duk se gjithë deti dhe gjithë toka ishin mbuluar me ushtri, dhe si erdhën tek Gripa i thanë se
30 Konstantiani sjell me vete një numër shumë të madh njerëzish. Gripën e pushtoi një frikë e madhe dhe mendoi se do të ishte e paarsyeshme të binte në përpjekje të hapët me forcat që po vinin; përveç kësaj ai nuk donte të rrethohej nga ushtria perandorake
31 që ishte sidomos shumë e fortë në det; më shumë atë e shqetësonte fortifikimi i Salonës, sepse pjesa më e madhe e mureve të saj ishte kthyer në gërmadhë, dhe
32 qëndrimi i banorëve të këtij qyteti ndaj gotëve ishte shumë i dyshimtë. Prandaj duke u larguar prej këndej me të gjithë ushtrinë, ai e ngriti me të shpejtë lëmin në fushën
33 që gjendet midis Salonës dhe qytetit Skardona. Duke u nisur nga Epidauri, Konstantiani arriti me gjithë flotën në Lysinë, që gjendet në gji. Prej këndej ai dërgoi disa nga njerëzit e tij që të mësonin se ku gjendej Gripa me ushtrinë e tij, dhe ta
34 njoftonin atë. Pasi mësoi prej tyre për të gjitha, ai u nis me të shpejtë drejt për në Salonë.
35 Kur arriti fare afër qytetit, e nxori ushtrinë në tokë dhe u vendos atje i qetë; ndërkaq pasi zgjodhi pesëqind vetë nga ushtria e tij dhe si vuri në krye të tyre Sifilin,
36 njërin prej besnikëve të tij, e urdhëroi të zërë ngushticat, të cilat sikurse kishte dëgjuar ai, janë në periferi të qytetit. Edhe Sifili kështu bëri. Të nesërmen Konstantiani dhe gjithë ushtria hynë në Salonë nga toka dhe deti, dhe anijet hodhën
37 çengelat në port. Konstantiani filloi para së gjithash fortifikimin e Salonës, duke rindërtuar me nxitim të gjitha ato mure që ishin kthyer në gërmadha. Përsa i përket Gripës dhe ushtrisë gote ata, ditën e shtatë pasi romakët zunë Salonën, e lanë lëmin e tyre dhe shkuan në Ravenë. Kështu Konstantiani u bë zot i gjithë Dalmatisë dhe Liburnisë, dhe tërhoqi në anën e vet gjithë gotët që jetonin në këto vende. Këto ndodhën në këtë kohë në Dalmati. Mbaroi dimri dhe bashkë me të mbaroi dhe viti i parë i luftës, të cilën përshkroi Prokopi.
24 **15** ... Nga ana tjetër e gjirit, të parët janë helenët e quajtur epirotë deri tek qyteti
25 Epidamn, i cili gjendet në breg të detit. Me ta kufizon krahina Prekalis[2], pas saj ajo që quhet Dalmati, dhe ajo që lidhet me perandorinë e Lindjes. Prej këndej, më lart
26 vjen Liburnia, Istria dhe vendi i venetëve që shtrihet deri tek qyteti Ravena. Këta janë popujt bregdetarë që jetojnë në këto vende...

LIBRI VI (II)

16 **13** Në këtë kohë e njoftuan Belizarin, se kishte ardhur nga Byzanti me një ushtri të madhe Narzesi dhe gjendej në Picen[3]. Narzesi ishte eunuh dhe ruajtës i thesarit të
17 perandorit, në përgjithësi njeri i shquar dhe energjik, më shumë se ç'janë eunuhët. Ai kishte me vete pesëmijë ushtarë, të ndarë në dy reparte nën komandën e dy të tjerëve: Justinit, komandantit të ushtrive ilire, dhe të një Narzesi tjetër, i cili ishte arratisur nga Armenia...

---

[1] Viti i parë i luftës 536-537.
[2] Është fjala për krahinën Prevalis.
[3] Viti i katërt i luftës 538/9

10 Në këtë mënyrë Belizari u nis, për të dytën herë, për në Itali[1]. Meqenëse kishte me vete pak ushtarë (ata që kishte në luftë kundër midiasve ai nuk mund t'i hiqte në asnjë mënyrë nga fronti), duke kaluar nëpër Thraki dhe duke u paguar që më parë paratë, ai mblodhi vullnetarë të rinj. Erdhi tek ai, sipas urdhërit të perandorit, edhe Vitali, komandant i ushtrisë ilire, që ishte kthyer para pak kohësh nga Italia, ku kishte lënë ushtarë ilirë. Që të dy ata, pasi mblodhën rreth katërmijë vetë, u nisën për në Salonë, me qëllim që të arrinin në Ravenë dhe prej këndej, me sa të qe e mundur, të zhvillonin luftën...

11 Pastaj Belizari dërgoi besnikun e tij Torimuthin bashkë me disa nga ata që kishin ardhur me të dhe Vitalin me trupat ilire, në krahinën Emilia dhe e urdhëroi atë që të pushtonte pikat e fortifikuara të saj. Me këtë ushtri Vitali iu afrua Bononës dhe, pasi zuri një sërë fortifikimesh që iu dorëzuan vullnetarisht, u ndal i qetë në Bononë. Pak kohë më vonë të gjithë ilirët, që morën pjesë me të në këtë marshim ikën papritur, fshehurazi, dhe u kthyen në shtëpitë e tyre, megjithëse nuk u kishte bërë askush dhe nuk kishin dëgjuar prej askujt ndonjë të keqe. Ata dërguan tek perandori delegatë që t'i kërkojnë të falur dhe t'i thonë se ata u kthyen në shtëpitë e tyre jo për ndonjë arsye tjetër, por sepse, pasi kishin shërbyer në Itali një kohë të gjatë, i paguanin shumë keq dhe arka u kishte atyre shumë borxh. Ndodhi në këtë kohë edhe që ushtria e hunëve u ra ilirëve, mori robër dhe ktheu në skllevër gratë dhe fëmijët e tyre. Si morën vesh për këtë dhe të lodhur nga uria në Itali, ata ikën... Kur mori vesh largimin e ilirëve, Totila dërgoi ushtrinë e tij kundër Boninies, me qëllim që të zinte atje Vitalin dhe ata që ishin me të. Por Vitali dhe Torimuthi u bënë pritë armiqve, shumë prej tyre i vranë, të tjerët i thyen. Në këtë punë një prej fisnikëve ilirë me emrin Nazar komandant i një njësie ilire, tregoi triměri të madhe dhe heroizëm kundër armiqve.

12 Meqenëse nuk kishte forca t'u ndihmonte të rrethuarve[2]. Belizari dërgoi në Byzant Joanin, nipin e Vitalit... që t'i lutej perandorit t'u dërgonte ushtri të madhe dhe shumë para si edhe armë e kuaj. Ai duhej t'u thoshte se /Belizari/ kishte shumë pak ushtarë, por edhe ata nuk donin të luftonin, duke thënë se arka u detyrohej shuma të mëdha dhe se ata kishin mbetur pa gjë. Dhe kështu ishte me të vërtetë. Përveç kësaj Belizari i shkroi këtë letër perandorit: "Ne erdhëm në Itali, o perandor i fuqishëm, pa njerëz, pa kuaj, pa armë e para... Duke kaluar gjithë Thrakinë e Ilirinë ne mblodhën ushtarë shumë pak e të dobët, që nuk kanë mbajtur kurrë në dorë armë dhe fare pa përvojë në çështje ushtarake. Unë nuk shoh që ata që kanë mbetur këtu të jenë të kënaqur për çdo gjë. Atyre u ka hyrë frika nga armiku dhe mendja u shkon përherë në humbje, ata jo vetëm ikin nga armiku, por lënë në fushë edhe kuajt e armët. Të ardhura nga Italia nuk mund të nxjerrim, sepse ajo është pushtuar prej kohësh nga armiku. Prandaj, pa u paguar në kohë rrogat ushtarëve, ne as nuk mundemi t'i urdhërojmë ata. Mëso edhe këtë, sundues, prej atyre që të kanë shërbyer, se një pjesë e madhe janë hedhur në radhët e armikut.

29 Afërsisht në këtë kohë një ushtri skllavenësh, duke kaluar lumin Ister, bëri shkatërrime të tmerrshme në gjithë Ilirinë deri në Epidamn, duke vrarë dhe kthyer në skllevër të gjithë ata që u dilnin përpara, pa marrë parasysh gjininë apo moshën, dhe duke grabitur pasurinë[3] Bile shumë fortifikata që ishin këtu dhe që më përpara dukeshin të forta, meqenëse nuk i mbronte njeri, skllavenët mundën t'i marrin; ata u

---

[1] Viti i dhjetë i luftës 544/5.
[2] Është fjala për rrethimin e një sërë qytetesh të Italisë nga forcat e Totiles.
[3] Viti i trembëdhjetë i luftës 547-548.

përhapën nëpër krahina, duke bërë shkretime fare lirisht. Komandantët e Ilirisë i
3 ndiqnin nga mbrapa, me një ushtri prej pesëmbëdhjetëmijë vetësh, por në asnjë vend nuk vendosën t'u aviten...

1 **33** Gjatë kohës së kësaj lufte, barbarët u bënë zotër të gjithë Perëndimit[1]. Për romakët kjo luftë me gotët, megjithëse në fillim ata patën një seri fitoresh të shkëlqyera, sikurse tregova më parë, pruri në rezultatin që ata jo vetëm humbën, pa asnjë dobi për veten e tyre, shumë njerëz dhe para, por mbi të gjitha humbën edhe gjithë Italinë dhe iu desh të shohin se si Iliria dhe Thrakia iu nënshtruan grabitjes dhe asgjësimit pa asnjë mëshirë nga ana e barbarëve, meqenëse ata ishin fqinjë të këtyre vendeve...

10 Përsa u përket langobardëve, perandori Justinian u fali atyre qytetin Norik, kështjella
në Panoni dhe në shumë vende të tjera, përveç kësaj u dha edhe shuma të mëdha
11 parash. Prandaj langobardët lanë vendet, që trashëgonin dhe u ngulën këtu në breg të
12 Istrit, afër gepidëve. Këta nga ana e tyre grabitnin Dalmatinë dhe Ilirinë, deri në kufijtë e Epidamnit, dhe banorët i kthenin në skllevër. Por kur disa prej robërve mundën t'u shpëtonin dhe të kthehen në atdhe, barbarët, duke përshkuar gjithë perandorinë romake, si besëlidhës të romakëve, po të njihnin këtu ndonjë nga të arratisurit, i zinin ata si të ishin skllevër personalë të ikur dhe duke i shkëputur nga gjiri i prindërve, i merrnin me vete, sepse për këtë nuk i pengonte asnjeri. Pastaj me
13 lejen e perandorit vende të tjera të Dakisë, rreth qytetin Singidon, i zunë erulët - ata edhe tani jetojnë këtu; edhe këta e sulmonin Ilirinë dhe vendet kufitare me Thrakinë, dhe shkretonin hapësira të gjera të tyre...

1 **38** Afërsisht në këtë kohë[2] ushtria skllavene, e përbërë prej jo më shumë se tremijë vetësh, kaloi lumin Ister, pa gjetur kundërshtim nga asnjë anë, dhe pastaj, si kaloi pa vështirësi të madhe lumin Hevr, u nda në dy pjesë. Njëra pjesë kishte
2 njëmijë e tetëqind vetë, tjetra ata që mbetën.
3 Komandanti i ushtrisë romake në Iliri dhe Thraki hyri në luftë të hapët me këtë ushtri dhe megjithëse ajo ishte e ndarë në dy pjesë, romakët u thyen për shkak të sulmit të tyre të papritur, disa prej tyre u vranë, të tjerët ikën me rrëmujë. Pasi komandantët
4 romakë u thyen në këtë mënyrë nga të dy njësitë barbare, megjithëse barbarët ishin me numër më të vogël se romakët, njëra nga njësitë armike u përlesh në betejë me
5 Asbadin. Ky ishte luftëtar nga reparti i besnikëve të perandorit Justinian, që përfshihej në listën e të ashtuquajturve kandidatë[3]; ai komandonte kalorësinë e rregullt, e cila prej kohësh e kishte qendrën në kalanë thrake Tzurula, dhe përbëhej
6 nga kalorës të shumtë, të zgjedhur. Skllavenët i vunë përpara edhe këta pa vështirësi të madhe dhe në kohën e kësaj tërheqje të turpshme, vranë shumë prej tyre, kurse
7 Asbadin e zunë rob, pastaj e vranë duke e hedhur në zjarr, pasi i kishin rrjepur më parë lëkurën e kurrizit. Pas kësaj ata filluan të grabisin pa frikë të gjithë këto vende edhe në Thraki, edhe në Iliri dhe shumë kështjella si njëra, si tjetra njësi skllavenësh
8 i morën me rrethim; kurse më parë skllavenët nuk kishin guxuar asnjëherë t'u aviteshin mureve ose të dilnin në fushë *[për luftë të hapët]*, sepse këta barbarë s'kishin provuar asnjë herë më parë të kalonin në tokën e romakëve. Bile edhe lumin Istër, me sa duket, ata e kanë kaluar vetëm një herë, sikurse tregova për këtë më lart...

---

[1] Viti i katërmbëdhjetë i luftës 548-549.
[2] Viti i pesëmbëdhjetë i luftës 549-550.
[3] Kanidatët ishin kuestorë, kandidatë për perandorë.

1 **25** Në këtë kohë një turmë e madhe skllavenësh u derdh në Iliri dhe bëri atje
tmerre të papërshkruara[1]. Perandori Justinian dërgoi kundër tyre një ushtri, në krye
të së cilës, krahas me të tjerët, ishin edhe djemtë e Germanit. Meqenëse kjo ushtri
2 nga numri ishte më e vogël se ajo e armikut, udhëheqësit e saj nuk vendosën në asnjë
vend të hyjnë në luftë të hapët me të, por duke u qëndruar atyre prapa u shkaktonin
3 humbje të ndjeshme. Shumë prej tyre ata i vranë, të tjerët i zunë rob të gjallë dhe i
dërguan te perandori. Megjithatë këta barbarë bënë shkatërrime të tmerrshme. Në
4 kohën e kësaj dyndjeje grabitqare, duke qëndruar brenda kufijve të perandorisë për
një kohë të gjatë, ata mbushën rrugën me grumbuj trupash;morën robër dhe kthyen
në skllevër një numër të madh njerëzish dhe grabitën çdo gjë që mundën; meqenëse
askush nuk i luftoi, ata ikën me gjithë plaçkën në vendin e tyre... Nga kjo ushtri[2] tek
langobardët erdhi vetëm Amalfridi[3] me ata që e shoqëronin. Të gjithë të tjerët u
13 ndalën me urdhër të perandorit në Iliri, afër qytetit Ulpiana, për shkak të kryengritjes
së banorëve prej mosmarrëveshjeve që i shtynë të krishterët të luftojnë njëri kundër
tjetrit, gjë për të cilën unë do të flas në veprat e mija të mëpastajme[4].

3. HISTORIA QUAE DICITUR ARCANA

(Historia e fshehtë)

1 **6** Po tregoj tani se ç'njerëz ishin Justiniani dhe Theodora dhe se si ata
2 shkatërruan perandorinë. Kur Leoni ishte perandor në Byzant, tre fshatarë të rinj,
ilirë me prejardhje, pikërisht Zimarhu, Dityvisti dhe Justini nga Bederiana, mbasi
luftuan në atdheun e tyre për një kohë të gjatë me vështirësitë e varfërisë dhe, duke
3 dashur që të shpëtonin prej tyre, vendosën që të hynë në shërbim ushtarak. Ata u
drejtuan në këmbë dhe arritën në Byzant me torbat në krahë, në të cilat kishin futur
që nga shtëpia vetëm bukë thatë. Ata u pranuan në ushtri dhe perandori i zgjodhi për
roje të oborrit, mbasi kishin një trup të mrekullueshëm...
17 Gruaja e tij /Justinit/ quhej Lupicina; ajo ishte skllave barbare; bashkëjetonte prej
kohësh me të dhe ishte gjer sa vdiq shoqja e tij në perandori.
18 Justini nuk ka qenë kurrë i zoti t'u bëjë as mirë, as keq nënshtetasve të tij, për
19 shkak se ishte i trashë, injorant dhe i pagdhëndur. Por i nipi i tij Justiniani, kur ishte
akoma i ri dhe qeveriste vetëm në emrin e ungjit të tij, u ka shkaktuar më shumë të
këqija romakëve se sa kanë dëgjuar njerëzit në atë kohë. Nuk e kishte për gjë të
merrte mallin e të tjerëve, as të shkaktonte gjakderdhje. Për të ishte fare lehtë të
20 shkaktonte vdekjen e dhjetra mijëra të pafajshmëve. Ai nuk u kujdes për të ruajtur
gjithçka ishte vendosur me urtësi, përkundrazi, ndryshoi dhe zhduku ligjet më të
21 mira. Së fundi ai ishte një armik i tërbuar dhe një shkatërrimtar i tmershëm i gjërave
22 të mira. Murtaja që dëmtoi rëndë perandorinë nuk i mori të gjithë njerëzit. Gjysma e tyre
23 shpëtoi ose u ruajt. Por ky njeri nuk i ngjante asnjërit prej romakëve dhe ishte në vetvete
si një murtajë e dërguar nga qielli, në kohën e zemërimit të tij /qiellit/, goditjeve fatkeqe

---

[1] Viti i shtatëmbëdhjetë i luftës 551-552.
[2] Është fjala për ushtrinë që kishte nisur Justiniani, sipas marrëveshjes, në ndihmë të lagnobardëve që ishin në luftë me gepidet, një popullsi tjetër barbare.
[3] Komandant i një reparti.
[4] Për këtë Prokopi nuk ka shkruar më gjëkundi.

të cilit /qiellit/ s'mund t'u bëjë ballë njeri. Disa njerëz i vrau pa asnjë arsye, pati të
24 tjerë, të cilët i la të vuanin në një varfëri kaq të tmerrshme saqë ata kërkonin vdekjen. Disa të tjerëve bashkë me pasurinë u merrte dhe jetën. Ai nuk u mjaftua me
25 rrënimin e perandorisë romake. Ai kishte ambicjen të pushtonte Libinë dhe Italinë, në mënyrë që edhe banorët e këtyre dy provincave t'i bënte jo më pak fatkeqë se nënshtetasit e tij.

16 **18** Sundimi i gotëve, para kësaj lufte, shtrihej që nga Galia deri në kufijtë e
17 Dakisë, ku ndodhet qyteti Sirm. Që në kohën kur ushtria romake kishte ardhur në Itali germanët kishin shtënë në dorë Galinë dhe pjesën më të madhe të tokave të
18 venetëve. Gepidët mbanin Sirmin dhe vendet përqark, të cilat mund të themi shkurtimisht ishin krejt të shkreta, pa njerëz. Një pjesë të tyre e kishte zhdukur lufta,
19 të tjerë sëmundja dhe uria, të cilat janë rrjedhime të zakonshme të luftërave. Që kur
20 Justiniani mori në dorë shtetin e romakëve hunët, skllavenët dhe antët janë dyndur pothuajse çdo vit në Iliri si dhe në gjithë Thrakinë dhe të gjitha tokat që shtrihen nga gjiri i detit Jon deri në lagjet e jashtme të Byzantit - ndërmjet këtyre gjenden Hellada
21 dhe Heronezi - dhe kanë kryer akte të padëgjuara kundrejt banorëve të këtyre vendeve. Besoj se në çdo dyndje ka pasur më shumë se dyqindmijë romakë të vrarë
22 ose robër dhe të gjitha këto vende u bënë aq të shkreta sa edhe shkretëtirat e Skythisë. Pra këto janë çrregullimet që ka shkaktuar lufta në Libi dhe në Evropë.

26 **21** Shpesh, kur armiqtë hunë robëronin dhe plaçkitnin me ushtri shtetin e romakëve, komandantët e thrakëve dhe ilirëve i sulmonin në tërheqje. Por u detyruan t'i ndërpritnin këto sulme meqenëse morën letra nga perandori Justinian, me të cilat njoftoheshin të mos sulmonin barbarët, sepse ata ishin të nevojshëm të mbaheshin si
27 aleatë të romakëve, qoftë kundër gotëve, qoftë kundra disa armiqve të tjerë. Dhe që prej kësaj kohe këta barbarë, duke u sjellë si armiq, plaçkitnin dhe merrnin robër romakët e këtushëm dhe, si miq e aleatë të romakëve i sillnin në vendin e tyre,
28 bashkë me plaçkën dhe robërit.Shpesh disa nga fshatarët e këtushëm, të zemëruar pse u kishin rrëmbyer gratë dhe fëmijët, mblidheshin që të gjithë dhe, duke sulmuar ata që tërhiqeshin, vrisnin shumë prej tyre dhe shtinin në dorë kuajt bashkë me gjithë plaçkën; por nga kjo ata u gjetën para vështirësive serioze.
Disa të dërguar nga Byzanti, pa nguruar kërkonin që ata të rriheshin, të torturoheshin
29 dhe të gjobiteshin me të holla deri sa të kthenin të gjithë kuajt, që u kishin rrëmbyer barbarëve.

4. DE AEDIFICIS

(Mbi ndërtimet)

LIBRI IV

1 **1** Nëqoftëse është rrezik të lundrosh në një det të egërsuar me një barkë të pajisur keq, nuk është më pak e guximshme të duash të shprehësh me stilin tim të
2 ulët madhështinë e ndërtimeve të perandorit Justinian. Ai tregoi në të gjitha veprat e
3 tij dhe në radhë të parë në ndërtimet, një zgjuarsi kaq të lartë, sa që s'ka fjalë që të mund ta krahasojmë. Përmbi të gjitha, duke dashur me shpirt që të mos u mungonte
4 gjë atyre të Europës, ai i vendosi këto ndërtime me një përsosmëri të tillë që s'mund të përshkruhet. Në fakt ato kanë një strukturë kaq të fortë dhe janë aq të qëndrue-

shme, sa e kërkon qenia pranë Istrit dhe nevoja e mbrojtjes së këtij vendi nga
5 barbarët që gjendeshin aty afër. Fiset që gjenden në kufi të këtij vendi janë hunët,
gotët, ata që janë ngritur kundër taurëve dhe skythëve, skllavenët e sauromatët, që
historia e vjetër i paraqet mbi qerre dhe vazhdimisht në lëvizje, si dhe çdo racë tjetër
6 njerëzore që ka rastisur të banojë ose të ndërtojë këtu. Meqenëse perandori Jutinian
nuk donte të linte pa përdorur asgjë nga ato që mund t'i shërbenin për shtypjen e
tyre, ai ndërtoi një numër të pafund fortesash ku vendosi garnizone të fuqishme për
7 t'u bërë ballë armiqve, që janë të gatshëm të marrin armët edhe pa patur arsye për
këtë. Ata e bëjnë luftën pa shkak dhe pa e shpallur atë dhe nuk duan ta mbarojnë me
8 një marrëveshje. Më në fund e fillojnë pa të drejtë dhe e mbarojnë me dhunë.
9 Ndërkaq unë po vazhdoj historinë që fillova. Nuk duhet që ky kuadër kaq i bukur të
10 mbetet i papërkryer, dhe me të drejtë do të na kritikonin nëqoftëse do të lodheshim
11 së shkruari veprat e mëdha që mbreti nuk u lodh aspak së ndërtuari. Por përpara se të
flasim për ndërtimet e Evropës duhet folur për vetë Evropën. Është një pjesë e detit
Adriatik, që duke hyrë thellë në kontinent formon gjirin e Jonit. Ajo ka Epirin dhe
12 fiset e tij nga e djathta dhe Kalabrinë nga e majta... Istri rrjedh në anën e kundërt
13 dhe i jep kësaj pjese të Evropës pamjen e një ishulli. Justiniani ndërtoi këtu shumë
14 vepra të rëndësishme. Duke fortifikuar në mënyrë të sigurt gjithë Evropën e bëri këtë
të pakalueshme për barbarët që banonin mbi Istër.
15 Unë do të filloj nga atdheu i perandorit, meqenëse me të drejtë ai mban vendin e
16 parë në historinë time, ashtu sikurse edhe në Perandori. Dhe me të vërtetë,ai është i
vetmi ndër gjithë qytetet që mund të krenohet se nxori dhe rriti një perandor, veprat
e të cilit është vështirë të tregohen me gojë dhe të shkruhen me fjalë.
17 Diku tek dardanët evropianë, të cilët jetojnë përtej kufijve të epidamnasve,
pranë fortesës Bederiana, gjendet një fshat me emrin Tauris, ku ka lindur perandori
18 Justinian, themeluesi i perandorisë botërore. Ai e rrethoi këtë, në një kohë të
shkurtër, me një mur në formë katrori dhe ngriti katër kulla në të katër qoshet prej të
19 cilave edhe mori emrin Tetrapyrg[1]. Ai themeloi këtu pranë një qytet madhështor që
e quajti Justiniana Prima[2] (më përpara kështu quhej ajo në gjuhën latine). Në këtë
mënyrë ai zgjeroi me shpenzime atë /vendlindjen/ që e rriti. Duket se kjo është edhe
20 një shenjë e mirënjohjes që i shprehin romakët vendit që lindi dhe rriti shpëtimtarin
/e perandorisë/. Perandori ndërtoi këtu një ujësjellës madhështor me qëllim që të
21 kishte ujë në të gjitha stinët. Ai ka lënë gjurmë të lavdishme të madhështisë, së tij në
22 ndërtimet, me të cilat e ka stolisur qytetin, me tempujt, galeritë, sheshet publike,
23 çesmat, pallatet, banjat dhe dyqanet. Më në fund ai e bëri këtë një qytet të madh,
24 shumë të populluar dhe të pasur, në mënyrë të tillë që ai jo vetëm u ngrit në dinjitetin
e metropolit, por u zgjodh edhe si qendër e kryepeshkopit të ilirëve, meqenëse
25 qytetet e tjera ia lanë këtë nder si qytetit më të madh të vendit. Ai i jep aq shkëlqim
perandorit sa edhe ka marrë prej tij. Sepse nëqoftëse, me një anë, ai /qyteti/ ka
26 lavdinë që e lindi, ai /Justiniani/ ka kënaqësinë që e themeloi. Nuk do t'i shtoj më
gjë tjetër këtij lavdërimi. Unë e pohoj që nuk mund t'i jap asaj /Justinianës/ të gjitha
27 lavditë që meriton dhe nuk mund të gjesh shprehje që të mos jetë për nën të,
meqenëse ajo i ka dhënë perandorisë një mbret kaq të madh. Ai ka rindërtuar
28 plotësisht fortesën e Bederianës dhe e ka bërë me një strukturë më të fortë se ç'ishte
përpara. Ka pasur në Dardanai, që prej kohëve të lashta, një qytet që quhej Ulpiana.
29 Muret e këtij (që ishin duke rënë) ai i rindërtoi që të gjitha. Dhe pasi e stolisi me

---

[1] Katërkullësh.
[2] Justiniana e Parë.

madhështi dhe i dha bukurinë e sotme, i vuri emrin Justiniana Sekunda; "Sekunda" tek latinët do të thotë e dyta. Ai themeloi një qytet tjetër fqinj që e quajti Justinopol, me emrin e ungjit të tij. Ai rindërtoi muret e Sardikës, të Naisopolit, të Germanës dhe Pantalisë, në mënyrë që ato sot nuk mund të pushtohen. Ndërmjet tyre ai themeloi tre qytete të tjerë të vegjël: Kratiskarën, Kuimedabën dhe Rumisianën. Duke dashur që ta bënte lumin Ister një mbrojtje shumë të fuqishme për këto qytete dhe për gjithë Evropën ai ndërtoi, siç do ta përshkruaja pak më poshtë, shumë kështjella anës së lumit, dhe vendosi gjatë tij roje të forta, për të penguar me siguri kalimin e barbarëve. Por edhe si mbaroi këto, duke mos i zënë besë askujt dhe duke menduar se armiqtë ndoshta ndonjëherë do të mund t'i zaptonin këto /kështjella/ dhe do të sulmonin fushat e pafortifikuara dhe do të merrnin peng gjithë njerëzit e do të plaçkitnin gjithë pasurinë, nuk u mjaftua vetëm me sigurimin që sillte sistemi i fortifikatave buzë lumit, por ndërtoi edhe të tjera të veçanta. Kështu, në vazhdim të tyre, ndërtoi në fusha edhe të tjera dhe çdo arë e ktheu në një fortesë ndihmëse të kështjellave. Të gjitha këto i bëri në të quajturin Epir i Ri dhe i Vjetër. Kështu ai rindërtoi qytetin Justinianopol, i cili quhej më parë Hadrianopol.

Ai rindërtoi qytetet Nikopol, Fotikën dhe të quajturën Foinike.

Po meqenëse këto të dy të fundit ishin në tokë moçalore dhe ishte e pamundur të ndërtoheshin mure mbi themele të shëndosha, i la në gjendje siç ishin dhe u mjaftua të ndërtojë pranë tyre kështjella të forta mbi kodrat e afërta. Këtu ishte edhe një qytet i vjetër, plot me burime, prej të cilave ka marrë edhe emrin Euria. Jo shumë larg këtij qyteti gjendet një liqen, në mes të të cilit ndodhet një ishull dhe mbi të ngrihet një kodër. Liqeni këtu ndërpritet kaq pak sa që duket sikur natyra ta kishte ruajtur si vend kalimi. Këtu mbreti themeloi një qytet të fortifikuar shumë dhe e populloi me banorë që pruri nga Euria.

4 Është e drejtë të flasim për të gjitha fortifikatat e tjera që perandori Justinian ndërtoi në këtë pjesë të Europës. Nëse kjo listë do të bëhej për të huajt dhe për banorët e një shteti shumë të largët, jam i sigurt se askush nuk do t'i besonte, sepse nuk do të gjente mbështetje në dëshminë e askujt. Por unë nuk do them asgjë, që të mos jetë nga ato që kushdo i sheh me sy: banorët e vendeve për të cilat unë flas, janë ata vetë dëshmitarët e së vërtetës që po them. Prandaj unë do të bëj numërimin e fortifikatave të reja që bëri Justiniani në vendin për të cilin fola, ose të të vjetrave që ai meremetoi: dhe këtë do ta bëj në trajtë liste dhe regjistri, për të shmangur pështjellimin.

Pra fortesa të reja të ndërtuara prej mbretit në Epirin [e Ri] ishin këto:

Bulpiansos	Gemenos
Episterba	Bakuste
Skeminites	Alistros
Aona	Patapa
Stefaniakon	Epidunta
Argos	Bakusta
Aliula	Martis
Dyrrahin	Eirene
Shën Sabiani	Speretion

Aoion
Streden
Gynaikomites
Labellos
Epileon
Piskinai
Deyfrakos
Dolebin
Hedonia
Tetiana
Kithinas
Ulibula
Brebate
Thesauros

Rindërtoi këto:

Shën Stefani
Kethreon
Hapis
Peleon
Kome
Pakue
Skydreon polis
Antipagrai
Tithyra
Brebeta
Bupos
Endyneia
Dionysos
[Fortesa] e Ptohejt
Tyrkanos
Kapaza
Pupsalos
Gabraion
Dhionoia
Klementiana
Illyrin
Kilikai
Argyas
Therma
Amanteia
Paretion

Fortesa të reja të ndërtuara në Epirin e Vjetër janë këto:

Parmos
Olbos
Kionin
Markiana
Algos
Keimenos
Kseropotamos
Europe
Himairai
Helega
Homonoia
Adanon

Rindërtoi këto:

Murkiara
Kastina
Genysios
Perkos
Marmarata
Listria
Petroniana
Karmina
Shën Sabiani
Sterna e fortesës Kome
Martios
Pezion
Onalos
Dy fortesat e Shën Donatit përtej Justinianopolit dhe Fotikës
Symfygion
Pronathidon
Edones
Kastellos
Bulibas
Palyros
Trana
Poseidon
Kolofonia

Në Maedoni:

Kandida
Kolobona
Pallatet e Amyntës
Melihiza
Paskas
Aulon
Bolbos
Brigizes
Optas
Pleuron
Kaminos
Therma
Bogas
Neapolis
Kalaryos
Museion

Akremba
Adrianion
Edana
Siklai
Mymfion
Metizos
Argikianon
Bazinos
Kasopas
Parthion
Gentianon
Priniana
Thesteon
Kyrru
Gurasson
Kumarkiana
Limnederion
Burbooden
Babas
Kryniana
Pelekon
Lages
Krataia
Faskiai
Plakidiana
Hygea
Limnaai
Option
Haradros
Kasopes

Në Dardani bëri këto:
Të reja

Laberion
Kastimon
Rabeston
Kastelion
Akrenza
Terias
Drullos
Viktorias

Rindërtoi këto:
Kesiana
Tezule
Usiana
Besiana
Maskas
Liste
Keliriana
Zysbaes
Genzana
Petrizen
Eutyhiana
Mulato
Belas
Kataros
Katarekos
Pentza
Katafeteros
Dabanos
Kubinos
Germatza
Viktoriana
Azeta
Durbuliana
Surikon
Kusines
Tutiana
Balesiana
Bella
Katrelates
Kasyella
Maniana
Priskupera
Miletes
Dardapara
Kesuna
Beriniana
Lasbaros
Kastellobretara
Edetzio
Dinion
Kekola
Emastos
Kastelona
Kapomalba
Seretos
Ptoheion
Kuino
Berzana
Besaiana
Arsa
Blezo
Labutza
Kuintu
Bermezion
Katrasema
Rotun
Kobenkiles
Markeliana
Primoniana
Pamilionos
Aria

Në teritorin e qytetit Sardike

Skupion
Stenes
Markipetra
Briparon
Romaniana
Struas
Protiana
Makuniana
Skopentzana

Në krahinën e Kabetzos,[1] *Balbai u ndërtua e re, kurse u rindërtuan këto:*
Byrsia
Stamazo
Klesbestita
Duyana
Turikla
Medeka
Peplabios
Kunai
Bineos
Triskiana
Parnusta
Tzimes
Bidzo
Stenekorta
Danedebai
Ardeia

Të reja:

Burgarama
Betzas
Bregedaba
Borbrega
Turus

U rindërtuan:

Salebries
Arkunes
Duries
Buteries
Barbaries
Arbatias
Kutzusura
Etairies
Itaberies
Botes
Bitzimaias
Badziania
Banes
Bimeros
Tusudeaas
Skuanes
Skentudies
Skares
Tugurias
Bemastes
Stramentias
Lignios
Itadeba

Në teritorin e qytetit Germene, e re është Skaplizo, kurse u rindërtuan:

Germas
Kandaras
Poligeras
Skinzeries
Riginokastelon
Suegogmense

Në teritoin e qytetit Pauta[lia]

Tarporon
Suabastas
Herduskera
Blebois
Zeapuries

Në krahinën Skasetana[2]
Alaron
Magimias
Lukunanta
Balauson
Butis

Ndërtime të reja në territorin e qytetit...[3]

Kalbentia
Faranores
Stranbasta
Aldanes
Barahtestes
Sarmates
Arsena

[1] Krahinë diku në Dakinë Analumase ose në Dakinë e Brendëshme.
[2] Krahinë diku në Maqedoninë e sotme.
[3] Boshllëku me pika mendojmë se duhet plotësuar me qytetin Nais.

Brarkedon
Eraria
Berkadion
Sabiniribes
Timiana
Kandilar
Arsaza
Bikulea
Kastellion
Grofes
Garkes
Pistes
Dusmanes
Bratzista
Holodoris
Kasia
Grandeton
Urbriana
Nogeto
Gurbikon
Lautzones
Duliares
Mediana
Tiunkona
Kastellion

Kurse u rindërtuan këto:
Herkula
Mutzianikastellon
Burdopes
Kalis
Milareka
Dedbera
Hesdupara

Në krahinën e Remisianës
Britura
Subaras
Lamponiana
Stronges
Dalmatas
Primiana
Freraria
Topera
Tomes
Kuas
Tzertzenutzas
Stenes
Aiadaba
Destreba
Pretzuries
Kumudeba
Deurias
Lutzolo
Repordenes
Spelonka
Skumbro
Briparo
Tulkoburgo
Longiana
Lupofontana
Dardapara
Burdomina
Grigkiapana
Graikos
Drasimarka

Në krahinën e qytetit Akue Timathohiom u ndërtua e re; kurse të rindërtuara janë:

Petres
Skulkoburgo
Bindimiola
Braiola
Arganokili
Kastellonovo
Florentiana
Romyliana
Septekasas
Argentares
Auriliana
Gembero
Klemades
Turibas
Gribo
Halaro
Tzutrato
Mutzipara
Stendas
Skaripara
Odriuzo
Kipipene
Trasiana
Potes
Amulo
Setlotes
Timakiolon
Meridio
Meriopontede
Tredetetilius
Braiola
Motreses
Vikanovo
Kuartiana
Julioballai
Pontzas
Zanes.

5 Kështu perandori Justinian e fortifikoi krejt pjesën e brendshme të Ilirisë[1]. Ndërsa anën e Istrit, të cilin e quajnë dhe Danub, e fortifikoi me kështjella e garnizone ushtarësh. Perandorët e mëparshëm romakë kishin ngritur në të dy anët e lumit kështjella dhe qytete për të penguar kalimin e barbarëve që ishin matanë lumit Danub. Por këto qytete dhe kështjella shërbenin më shumë për të treguar që buza e Istrit nuk ishte krejt e pabanuar, se sa për t'a mbrojtur. Meqenëse atëherë barbarët nuk dinin të bënin fare rrethimin e fortifikimeve, shumë prej këtyre /fortifikimeve/ ishin me një kullë dhe me një numër të vogël ushtarësh. Kjo mjaftonte për të ndaluar kalimin e fiseve barbare. Por me ardhjen e tij, Atila me një ushtri shumë të madhe i rrafshoi pa asnjë mundim këto kështjella dhe u dynd në tokën e romakëve dhe pushtoi pjesën më të madhe të saj. Por perandori Justinian i rindërtoi këto, jo më ashtu siç ishin, por i bëri më të forta dhe shumë prej tyre krejt të reja. Në këtë mënyrë ai rivendosi në të gjithë shtetin e romakëve sigurinë e humbur. Unë do të tregoj se në ç'mënyrë u bënë të gjitha këto: Istri e ka burimin në malet e keltëve, të cilët tani quhen galë. Ai përshkon një tokë shumë të gjerë, që është gati një shkretëtirë dhe që është e banuar vetëm në disa vende prej barbarësh, të cilët ushqehen deri diku si egërsirat dhe nuk hyjnë në marrëdhënie me njerëzit e tjerë. Kur i afrohet Dakisë, ai ndan në të majtë tokat e barbarëve, ndërsa në të djathtë ato të romakëve. Ja përse romakët e quajnë Dakinë "Ripense" mbasi ripa, në gjuhën latine, do të thotë buzë, anë lumi. Singedoni është qyteti i parë dhe më i vjetër, që është ndërtuar në bregun e këtij lumi. Barbarët të cilët me kalimin e kohës, e shtinë në dorë, e rrafshuan dhe e shkretuan. Afërsisht të njëjtin fat patën dhe shumica e fortifikimeve të tjera. Kurse perandori Justinian e rindërtoi dhe e bëri edhe më të fortë, dhe aq të bukur sa s'kishte qenë kurrë ndonjëherë. Ai ndërtoi edhe një fortifikatë tetë mila larg Singedonit, e cila është quajtur për këtë arsye Oktava. Më tej ai rindërtoi plotësisht një qytet të vjetër, Viminakin, që ka qenë i rrënuar.

6 Në të dalë të Viminakut takojmë, në anën e Istrit, tri fortesa: Pinku, Kupi dhe Nova, që dikur ishin vetëm kulla. Perandori Justinian ka ngritur prej kohësh atje një numër kaq të madh shtëpish e fortifikatash, sa që i ka bërë qytete shumë të famshme. Në anën tjetër /të Istrit/, përkarshi Novës, ishte një kullë e braktisur, që në kohët e lashta e kishte emrin Literata, por që banorët e vjetër e quanin Lederata. Kjo kullë që dikur ishte lënë mbas dore u kthye nga perandori i ynë në një fortesë të rëndësishme. Pas Novës ka pasur fortifikata të ndryshme si Kantabaza, Smorne, Kampse, Tanata, Zerne dhe Dukeprata. Ka akoma shumë të tjera, në anën tjetër të lumit, të cilat janë ndërtuar që nga themelet. Mbas të quajturës koput boes, vepër e perandorit romak Trajanit, dhe shumë afër saj është një qytet i vjetër që quhet Zana. Të gjitha i ka fortifikuar në mënyrë të atillë, që këto janë bërë mbrojtjet më të fuqishme të shtetit. Nga Zana jo fort larg ndodhet një fortesë me emrin Ponti. Këtu lumi ndahet më dysh dhe rrethon një pjesë të bregut të tij, pastaj hyn në shtratin e zakonshëm. Këtë gjë nuk e bën vetiu, por detyrohet nga puna që kanë bërë njerëzit. Do të them këtu përse kjo kështjellë u quajt Pont dhe përse rrjedhja e Istrit bën këtu kthesën.

Perandori i romakëve Trajan, duke qenë energjik e ambicioz ishte i pa kënaqur që perandoria e tij nuk ishte pa kufi dhe që lumi Ister i vinte kufi. Ai dëshironte, pra, të bashkonte të dy brigjet e tij me një urë me qëllim që të mos i bëhej pengesë për të kaluar në viset e barbarëve. Unë nuk do të merrem këtu me përshkrimin e saj. Do të mjaftonte për këtë vizatimi i Apollodorit të Damaskut, arkitekt i kësaj vepre. Por sado e madhe që të ketë qenë kjo vepër, ajo u bë e panevojshme për romakët, sepse

[1] Ilirik.

kalimi i kohës dhe rrjedhja e lumit e shkatërruan. Trajani atëherë ndërtoi dy fortesa në të dy anët e lumit. Një nga këto fortesa që ishte në Daki u quajt që atëherë Pont, kurse tjetra, që ishte në vendin matanë, Theodora. Gërmadhat e urës e mbushën në një mënyrë të tillë kanalin e Istrit, sa që e bënë të palundrueshëm dhe e detyruan të ndërrojë rrjedhjen e tij e të bëjë kthesën për të cilën fola më lart. Meqenëse këto dy fortesa u rrënuan ca nga kalimi i kohës dhe ca nga dyndjet e barbarëve, perandori Justinian ndërtoi mbi themele të shëndosha fortesën e Pontit, që ndodhet në anën e djathtë të Istrit, dhe me anën e kësaj ai siguroi Ilirinë. Sa për fortifikatën Theodora ai e la, mbasi ishte gjithnjë nën mësymjet e barbarëve. Po ky perandor ndërtoi, më atë anë fortesës së Pontit, disa fortesa të tjera që quheshin: Mareburg, Susiana, Harmata, Timena, Theodoropol, Stiliburg dhe Halikaniburg.

Aty afër ndodhet një qytet i quajtur Akue ku perandori ndërtoi një pjesë të tij që ishte rrënuar. Pas këtij ndërtoi Burgonoborin, Lakoburgun dhe fortesën e mbiquajtur Dortiko. Këtë të fundit që koha e kishte bërë të papërdorshme e ktheu në një kështjellë të fuqishme. Ai e rindërtoi kaq mirë një kullë të quajtur Judea, sa që tani ajo ka pamjen e një çitadele shumë të bukur. Përveç kësaj, ai rrethoi më mirë qytetin e quajtur Burgualt, i cili kishte mbetur i shkretë dhe i pabanuar. Po kështu bëri edhe me fortifikatën e quajtur Gombe. Ai rindërtoi çitadelën Krispa, Longinianën dhe Ponte-Serin, të cilat ishin gati të rrënuara nga koha, duke bërë kështu një vepër shumë interesante. Rindërtoi kullat e Bononies dhe të Novës që kishin rënë, dhe të gjitha gërmadhat e qytetit Ratiaria. Disa prej tyre ua zgjeroi rrethin, disave ua ngushtoi ashtu si e pa të arsyeshme, për ta bërë më të vështirë hyrjen e armiqve në to. Kullën Mokatiana e ktheu në një çitadelë të pajisur me gjithçka dëshirohej. Ngushtoi sipërfaqen e Almit dhe e bëri në gjendje që t'u bëjë ballë sulmeve të armiqve. Ka shumë vende ku ndonjë kullë, që ishte e lehtë për t'u rrethuar dhe pushtuar ai e ktheu në fortesë të shëndoshë. Trikesa dhe Putedisa mund të shërbejnë si shembull. Fortesat e Kebrës i rindërtoi në mënyrë të mrekullueshme. Ai ndërtoi dy fortesa të tjera, njerën në një vend që quhet Bigranajë dhe tjetrën në një vend që quhet Ono, ku më përpara kishte pasur vetëm një kullë. Shumë afër këtyre gërmadhave të vjetra ishte një qytet i quajtur Augustes. Ai mban akoma atë emër edhe sot që është rindërtuar plotësisht nga perandori Justinian, dhe që është mbushur me një numër të madh banorësh. Çitadelës Aedaba i ka bërë të gjitha ndreqjet e nevojshme. Ai ngriti nga gërmadhat qytetin Variana dhe rrethoi me mure qytetin Valeriana, i cili ishte krejt i pambrojtur.

Ai i shtriu mendimet dhe kujdesjet e tij gjer në vendet më të largëta të buzës së Istrit. Rrethoi me mure të forta Kastra Martis[1)], Zetnukortën dhe Iskosin. Rindërtoi muret e kështjellës së vjetër me emrin Hunon buzë Istrit. Jo larg kështjellës Hune ishin ngritur dy vepra për mbrojtjen e të dy anëve të Istrit. Njëra që ndodhej në Iliri quhet Palatiol dhe tjetra që ndodhej në anën e kundërt quhej Sykibida. Këto dy vepra që ishin shkatërruar me kalimin e kohës, u merremetuan aq mirë nga perandori Justinian sa që ndihmojnë shumë në ndalimin e dyndjeve barbare. Përveç asaj, ai i rindërtoi dhe i bëri krejt të reja muret e një kështjelle të vjetër që quhet kështjella Uti. Ai rindërtoi kështjellën e Lapidarit, që është në skaj të Ilirisë. Dhe e zgjeroi aq shumë një kështjellë që quhej kështjella e Lukenariaburgut, sa që ajo ka hapësirën e një çitadele të madhe. Perandori nuk u kënaq vetëm me ndërtimin e këtyre veprave në Iliri, por ai ka bërë shumë për sigurimin e kësaj province me garnizonet që vendosi në të.

7 Ne përshkruam gjer këtu fortifikimet që ndërtoi perandori në Iliri mbi Danub...

[1)] Kështjella e Marsit, zotit të luftës.

MALALA

Joan Malala lindi në Antiohi të Sirisë rreth vitit 491 dhe vdiq në Konstantinopol më 578. Ai qëndroi në Antiohi, ku shkroi edhe 17 nga 18 librat e historisë së tij, deri në vitin 540, kur qyteti u shkatërrua nga persët. Librin e fundit, që flet për ngjarjet që ndodhin në Konstantinopol, e mbaroi fill mbas vdekjes së Justinianit.

Vepra e Malalës, me emër "Hronografia", përshkruan ngjarjet qysh nga krijimi i botës e deri në vitin 565. Për kohën para tij Malala ka përdorur, po jo në mënyrë kritike, burime të ndryshme historike, kryesisht të kohës romake.

Për ngjarjet e viteve të fundit të shek. V dhe ato të shek. VI, Malala është mbështetur në tregimet gojore të bashkëkohësve të tij. Vepra e Malalës konsiderohet si "monumenti i parë më i madhi i gjuhës popullore greke". Duhet shtuar këtu se në disa pika vërtetësia e të dhënave të tij është vënë në dyshim.

Hronografia e Malalës ka disa shënime jo me pak vlerë edhe për krahinat e Ilirikut.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Joannis Malalae Chronographia, recensuit L. Dindorf, Bonnae 1831.

JOANNIS MALALAE

CHRONOGRAPHIA

(Hronografia)

fq.302,12-15

I njëjti perandor, Probi[1)], luftoi me gotët pranë Sirmit. Në kohën e luftave të tija pllakosi një zi e madhe buke në gjithë botën. Pasi nuk kishte ushqime, ushtarët ngritën krye. Ata e sulmuan dhe e vranë atë në Sirm në moshën pesëdhjetë vjeçare.

fq. 342,4-7

Dhe kështu Valenti[2)] nuk gjendej në Konstantinopol, kur vdiq vëllai i tij, Valentiniani, sepse /Valentiniani/ e dërgoi në Sirm që kur ishte gjallë, për të luftuar kundër gotëve. Pasi i mundi plotësisht, ai u kthye.

fq.347,11-13

I njëjt perandor, Theodosi[3)], e ndau Epirin e Ri nga (Epiri) i Vjetër dhe e bëri provincë, duke i dhënë qytetit Dorrah të drejtën e qytetit dhe të kryeqendrës.

fq.392,1-2

Pas sundimit të Zenonit, u bë perandor shumë i hyjnueshëm Anastas Dikori[4)], dyrrahas nga Epiri i Ri.

fq.399,5-10

I njëjti perandor, Anastasi, thirri në Konstantinopol stratelin Hypat, të birin e Sekuindinit, dhe dërgoi në vend të tij ilirin shumë të lavdishëm Keler, burrë i urtë dhe po ky Keler ia ktheu /perandorisë/ qytetet e pushtuara nga persët.

fq.410,1-3

Pas sundimit të Anastasit, perandor u bë i hyjnueshmi Justin, thrakas[5)] nga Bederiana, në kohën e konsulatës së Magnit, në të nëntën ditë të muajit korrik, i njëmbëdhjeti indiktion.

[1)] Mark Aurel Probi (276-282).
[2)] Valenti (364-378) dhe Valentiniani (364-375).
[3)] Theodosi I (379-395).
[4)] Anastasi qe quajtur "dikor" për shkak të ngjyrave të ndryshme të syve të tij.
[5)] Justini ishte ilir nga origjina (Shih Proc. Hist. arc. 6, 2), sundoi në vitet 518-527.

fq.425,1-9

Pas sundimit të Justinit sundoi i hyjnueshmi Justinian 38 vjet, 7 muaj dhe 13 ditë[1]. Ai hypi në fron me 1 Prill, i pesti indiktion, viti 575, sipas erës antiohe, në kohën e konsulatës së Mabortit. Ai ka qenë i shkurtër, me shpatulla të gjera, me hundë të drejtë, bardhosh, me flokë të dredhura, me fytyrë të rrumbullakët, i bukur, gjysëm tullac, i qeshur, me flokë dhe mjektër të thinjur, mbrojtës shpirtmadh i besimit kristian. Ai ka qenë ndjekës i partisë së venetëve, dhe gjithashtu ka qenë thrakas nga Bederiana[2].

fq.442,8-17

I përmenduri perandor /Justinian/ dërgoi nga Konstantinopoli senatorë me ushtritë e tyre për të ruajtur qytetet e Lindjes: patricin Platon, në Amedi, patricin Theodor në Edesë; Aleksandrin, birin e Hierit, në Beroe, dhe senatorët tjerë në Suron dhe Konstantinë që të ruanin qytetet. Në të njëjtën kohë u dërgua dhe patrici Pompi me një ushtri të madhe ilirësh, isaurësh, skythësh dhe thrakësh. Për shkak të dimrit të vështirë u ndërprenë, me marrveshje, veprimet luftarake në mes të romakëve dhe persëve.

fq.450,19-451,15

Kur ishte konsull Deci, Mundi kaloi në anën e romakëve. Ai ridhte nga gepedët dhe ishte bir mbreti, por pas vdekjes së babait shkoi tek xhaxhai i tij Thraustila dhe jetoi në Sirm. Pasi mësoi këtë, sundimtari i Romës Theodoriku, i biri i Valamerit, e ftoi pranë tij Mundin. Ky pranoi dhe shkoi tek ai me njerëzit e tij, qëndroi atje, dhe luftoi në anën e Theodorikut, të birit të Valamerit. Pas kësaj Mundi iku nga Roma dhe arriti deri tek lumi Danub. Ai dërgoi të deleguar tek perandori Justinian dhe e luti atë që ta pranonte si nënshtetas të tij. Perandori e pranoi me njerëzit e tij, e bëri kryekomandant të Ilirikut dhe e dërgoi në krahinën e tij ushtarake. Pasi mori Ilirikun hunët e sulmuan me ushtri të madhe të përbërë nga barbarë të ndryshëm. Ai u doli përpara dhe i zhduku që të gjithë, kurse plaçkën e zënë dhe njërin nga mbretërit e tyre, i dërgoi /në Konstantinopol/...

---

[1] Justiniani sundoi në vitet 527-565.

[2] Edhe Justiniani ishte me origjinë ilire nga Bederiana e Dardanisë (Shih Proc. Hist. arc. 6, 2 dhe De aed. IV 1,17).

MARCELIN KOMES

Është me prejardhje nga Iliriku. Që në moshë të re shkoi në Konstantinopol ku u bë dhe sekretar i Justinianit para se ky të bëhej perandor. Më vonë veshi rrobën fetare dhe si i tillë e kaloi gjithë jetën. Nga veprat e tij na është ruajtur një kronikë "Chronicon" ku përmblidhen disa nga ngjarjet historike të periudhës prej vitit 379 e deri në vitin 534. Më vonë kësaj kronike i janë shtuar edhe ngjarjet deri në vitin 548, por kjo shtesë, me sa duket, nuk i përket Marcelinit. Me hartimin e kronikë së tij Marcelini ka pasur në dorë Orosin, Hieronymin etj.

Në këtë vepër gjejmë edhe disa të dhëna mbi lëvizjet e gotëve dhe të hunëve në trevën e Ilirikut si edhe mbi grindjet fetare që shpërthyen në disa qytete të kësaj prefekture ë kohën e Anastasit I.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Th. Mommsen, Marcellini V. C. Comitis Chronicon Monumenta Germaniae Historica AA XI 1. Berolini 1893.

MARCELLINUS COMES

CHRONICON

(Kronika)

Viti 379 (indiktioni VII). Në kohën e konsujve Auson dhe Olyber.

1 Pas vdekjes së Valensit, Augusti Gratian shpalli më 19 janar në Sirm, si perandor të 39-të, Theodosin nga Italika, qytet i Trajanit të hyjnueshëm për të sunduar vetëm pjesën lindore të shtetit. Ai ka qenë shumë besimtar dhe propagandues i kishës katolike, dhe mundi të vendoset mbi të gjithë perandorët e Lindjes, me përjashtim të Marcianit, i treti perandor mbas tij, i cili i ngjasoi atij.

2 [Theodosi] fitoi në shumë luftime dhe të mëdha kundër fiseve skythe, alane, hune dhe gote.

Viti 441 (indiktioni VIII). Në kohën e konsullit Kyr, pa kolegë.

1 Persët, saracenët, kanët, isaurët, hunët dolën nga kufijtë e tyre dhe shkretuan tokat e romakëve.

3 Mbretërit hunë me ushtrinë e tyre shumëmijëshe u futën në Ilirik dhe shkatërruan Naisin, Singidunin dhe qytete të tjera si dhe shumë qendra banimi të Ilirikut.

Viti 442 (indiktioni X). Në kohën e konsujve Eudoks dhe Dioskor.

2 Vëllezërit Bleda dhe Atila, mbretër të shumë fiseve shkretuan Ilirikun dhe Thrakinë.

Viti 447 (Indiktioni XV). Në kohën e konsujve Ardabur dhe Kalep.

2 Një luftë shumë e madhe dhe më e madhe nga e para, që na u detyrua nga mbreti Atila, shkatërroi pothuajse gjithë Evropën[1] pasi u sulmuan dhe u shkatërruan qytet

4 dhe kështjella. Me sulmet e tij mbreti Atila arriti deri në Thermopol[2]

[1] Është fjala për zotërimet ballkanike të perandorisë së Lindjes.
[2] Ndoshta këtu autori ka parasysh Thermopilet.

Viti 482 (indiktioni V). Në kohën e konsujve Trokond dhe Severin.

2 Theodorihu[1], i mbiquajtur Valamer, shkretoi dy Maqedonitë dhe Thesalinë, dhe plaçkiti deri qytetin e saj kryesor Larisën.

Viti 499 (indiktioni VII). Në kohën e konsullit Joan Gib, pa kolegë.

1 Aristi, komandant i ushtrisë në Ilirik, u nis me pesëmbëdhjetë mijë ushtarë dhe me pesëqind e njëzet karroca, të ngarkuara me armët e nevojshme për luftim, kundër bullgarëve që po shkretonin Thrakinë. Luftimi u zhvillua pranë lumit Kurta[2], ku qenë vrarë qoftë në ikje, qoftë dhe duke u hedhur nga bregu i lartë i lumit, më tepër se katërmijë nga ushtarët tanë. Dhe atje mori fund fuqia ushtarake ilire dhe qenë vrarë komandantët ushtarakë Nikostrati, Inocenti, Tanku dhe Akuilini.

Viti 516 (indiktioni IX). Në kohën e konsullit Peter pa kolegë.

1 Pasi hëngri fjalën e dhënë, perandori Anastas e shpalli veten kundërshtar të Vitalianit
3 dhe caktoi për hakmarrje Rufinin. Përveç kësaj Anastasi urdhëroi që të paraqiten personalisht para tij shërbyesit e shenjtë katolikë të Ilirikut: Laurenti i Lyhnidit[3], Domnioni i Serdikës, Alcisi i Nikopolit[4], Gajani i Naisit dhe Evangjeli i Pautalisë. Peshkopët Alcis dhe Gajan vdiqën në Byzant dhe u varrosën në një varr. Pasi Domnioni dhe Evangjeli u kthyen menjëherë në selitë e tyre, nga frika e ushtarakëve katolikë ilirë, vetëm Laurenti u përjashtua dhe u mbajt si i mërguar, për arsye se demaskonte shpesh para njerëzve të oborrit perandorin Anastas, për fenë katolike.

Viti 517 (indiktion X). Në kohën e konsujve Anastas dhe Agapit.

... Atëherë u shkretuan dy Maqedonitë dhe Thesalia, dhe kalorësit getë[5] plaçkitën deri tek Thermopylet dhe Epirin e Vjetër. Atëherë perandori Anastas, dërgoi me Paulin tek Joani, prefekt i prefekturës së Ilirikut, njëmijë ponde monedhash ari që të kthenin romakët e kapur robër. Meqenëse shpërblimi nuk qe i mjaftueshëm, robërit romakë u dogjën së bashku me shtëpitë e tyre ose u copëtuan para mureve të qyteteve të mbyllura.

Viti 518 (indiktioni XI). Në kohën e konsullit Magni, pa kolegë.

1 Nga tërmetet e vazhdueshme, në provincën dardane, menjëherë u shkatërruan njëzet e katër kështjella. Dy nga këto u fundosën së bashku me banorët, katër u shkatërruan, duke humbur gjysmën e banesave dhe të banorëve, trembëdhjetë nga

[1] Theodorihu i madh i ardhshëm, i biri i Tiudimirit.
[2] Nuk është identifikuar.
[3] Peshkop i Lyhnidit.
[4] Me sa duket këtu bëhet fjalë për peshkopin e Nikopolit në Epir.
[5] Emri get, në shumë autorë bizantinë, identifikohet me got ose vlen për të treguar dhe sllavët ose bullgarët.

fatkeqësia humbën një të tretën e shtëpive dhe po aq nga popullsia; shtatë u shkatërruan, duke humbur një të katërtën e shtëpive dhe po aq nga popullsia, kurse kështjellat fqinje u braktisën nga frika e shkatërrimit. U shkatërrua krejtësisht edhe qyteti kryesor Skupi, megjithëse pa humbjen e qytetarëve të tij, të cilët ikën para armikut. Nga ky tërmet u çanë shumë male nga e gjithë provinca, shkëmbinj u shkëputën nga masivet e tyre dhe trupat e peméve u gremisën poshtë. Në një largësi prej tridhjetë miljesh toka u ça me një gjerësi prej dymbëdhjetë hapash, dhe u pregatit kështu një hendek i thellë ku ranë shumë nga qytetarët e kështjellave, të cilët vazhdonin të iknin nga shkëmbinjtë që rrokulliseshin ose nga sulmet e armiqve. Atëherë në një kështjellë të krahinës Gavisa, e cila quhet Sarnonti, toka nxori prej shtresave të saja të përvëluara si prej një furre të nxehtë, një curril të ngrohtë dhe të vazhdueshëm uji.

Viti 530 (indiktioni VIII). Në kohën e konsujve Lampad dhe Orest.

Mundi, komandant i këmbësorisë dhe kalorësisë ilire, i pari nga të gjithë komandantët romakë, sulmoi gotët, të cilët që me kohë i binin kryq e tërthor Ilirikut, dhe i përzuri pasi vrau shumë prej tyre.

Viti 543 (indiktioni VI). Në vitin e tretë pas konsullatës së Vasilit.

2 Një vdekje në masë shkretoi tokën italike, si dhe Orientin e Ilirikun e dobësuar.

HIEROKLI

Hierokli, për prejardhjen e jetën e të cilit nuk dihet gjë, na ka lënë një vepër me përmbajtje historiko-gjeografike, që mban titullin "Synecdemus" (Shoqërues udhëtimi). Synekdemusi i Hieroklit i përpiluar në shekullin VI të e. sonë, në kohën e perandorit Justinian, kishte si qëllim kryesor t'i shërbente si guidë nëpunësve shtetëror, që shkonin me shërbim nëpër provincat e ndryshme të perandorisë.

Mendohet se për përpilimin e veprës së tij Hierokli duhet të ketë përdorur një burim tjetër më të lashtë të këtij lloji. Gjatë mesjetës "Synekdemusi" u shfrytëzua shumë nga autorë të ndryshëm.

Vepra e Hieroklit është një burim me rëndësi për të njohur gjeografinë dhe organizimin administrativ të Ilirikut në shek. VI.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Hieroclis Synecdemus, recensuit Augustus Burckhardt. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1893

HIEROCLIS SYNECDEMUS

(Guida e Hieroklit)

Të gjitha provincat dhe qytetet që sundohen nga perandori i romakëve në Konstantinopol, janë 64 provinca dhe 935 qytete sipas ndarjes[1)] (që vijon):

638 1 *VII* Provinca e parë Maqedone në Ilirik *[e sunduar]* nga konsular ka 32 qytete

2 Thesalonike	(Selaniku)
3 Pele	(Postoli)
4 Europos	(Bosaxhia)
5 Dios	(Dios, pranë Malatrisë)
6 Beroia	(Verria)
7 Eordea	(Moranliu, rrethi Kozhanit)
8 Edesa	(Edesa)
9 Kele	(pranë fshatit Banjë)
10 Almopia	(Mëgleni)
11 *[Larissa]*	(i paidentifikuar)

639	1 Herakleia Lauku	(Lerini)
	2 Antania Gemindu	(Të paidentifikuar)
	3 Nikedes	(Velushina (?) rrethi Bitoljes)
	4 Dioboros	(Doirani)
	5 Idomene	(Miletkovo, rrethi Gevgjelisë)
	6 Bragylos	(Vergu (?) rrethi Nigritës)
	7 Primaula	(Korfovuna, rrethi i Nigritës)
	8 Parthikopolis	(Nigrita)
	9 Herakleia Strymnu	(Zervohori)
	10 Serai	(Seres)

640	1 Filipoi	(Filipi)
	2 Amfipos	(Neohori)
	3 Apollonia	(Polina)
	4 Neapolis	(Kavalla)
	5 Akanthos	(Ieriso)
	6 Berpe	(Kopaçi, rrethi Nigritës)
	7 Arauros	(?)
	8 Klema Meutikon dhe Akontisma	(krahinë buzë lumit Mesta qafë pranë grykës së lumit)
	9 Ishulli Thasos	(Thasi)
	10 Ishulli Samothrake	(Samothraka)

[1)] Këtu janë shënuar vetëm provincat dhe qytetet e Ilirikut.

641 1 *VIII.* Provinca e dytë maqedone /e sunduar/ nga hegjemon, ka 8 qytete:

2 Stoloi	(në rrethin e Pustogradit)
3 Argos	(Starigradi, rrethi Veleshit)
4 Eustraion	(diku në rrjedhjen e sipërme të Strumës)
5 Pelagonia	(Bitolja)
6 Bargala	(fshati Karabinc, në rrethin e Shtipsës)
7 Kelenidin	(?)
8 Harmonia	(?)
9 Zapara	(Capari, afër Bitoljes)

651 3 *XII.* Provinca e Epirit të Vjetër / e sunduar/ nga hegjemon ka 12 qytete:

4 Metropolis Nikopolis	(Preveza)
5 Dodonai	(pranë Dramisit)
6,7 Euroia Akniu	(?)
8 Adrianupolis	(Nepravishta(?)

652

1 Apon	(?)
2 Foinike	(Finiqi i Delvinës)
3 Ankiasmos	(Saranda)
4 Butrytos	(Butrinti)
5 Fotike	(?)
6 Ishulli Kerkyra	(Korfuzi)
7 Ishulli Hethraka	

8 *XIII.* Provinca e Epirit të Ri /e sunduar/ nga konsular, ka 9 qytete:

653

1 Dyrrahun, dikur Epidamnos	(Durrësi)
2 Scampa	(Elbasani)
3 Apollonia	(Pojani i Fierit)
4 Bulis	(Hekali i Mallakastrës)
5 Amantia	(Ploça e Vlorës)
6 Polyheriupolis	(Berati)
7 Aulon	(Vlora)
8 Aulinidos metropolis	(Ohri)

654 1 Listron dhe Sceupton (?)

2 *XIV.* Provinca e Dakisë së mesme /e sunduar/ nga konsular ka 5 qytete:

3 Sardike metropolis	(Sofia)
4 Pautalia	(Kystendili)
5 Germae	(Banjat e Saparës)
6 Naisos	(Nishi)
7 Remesiana	(Bela Palanka)

655 1 *XV.* Provinca e Dakisë Analumase /e sunduar/ nga konsular ka 5 qytete:

2 Razaria metropolis	(Arçari, rrethi Vidinit)
3 Bonopia	(Vidini)
4 Akoines	(Vidrovaci)
5 Kastramartes	(Kula)
6 Iskos	(Gigeni)

7 *XVI.* Provinca e Dardanisë /e sunduar/ nga hegjemon, ka 3 qytete:

8 Skupometropolis	(Zlokuçene, pranë Shkupit)

656 1 Merion (?)
2 Ulpiana (Lipliana)
3 *XVII.* Provinca e Prebalesë *[*e sunduar*]* nga hegjemon ka 3 qytete:
4 Skodrai (Shkodra)
5 Lissos (Lezha)
6 Dorakion metropolis (Dorëzi?)

657 1 *XVIII.* Provinca e Myzisë *[*e sunduar*]* nga hegjemon, ka 5 qytete:
2 Viminakin metropolis (Kostolaci)
3 Singidonos (Beogradi)
4 Gratiana (?)
5 Prikornia (Ritopeku)
6 Orthemarhos (Kypria)

7 *XIX.* Provinca e Panonisë *[*e sunduar*]* nga hegjemon, ka 2 qytete:
8 Sermion (Mitrovica e Savës)
9 Basiana (Petrovci)
Provinat perëndimore *[*të sunduar*]* nga Roma janë 7:
.....
Provincat e Norikut
.....

AGATHIA I MYRINËS

Agathia ishte nga qyteti Myrina, në Azi të Vogël. Ai lindi këtu rreth vitit 536 dhe vdiq në Konstantinopol rreth vitit 582. Është bashkëkohës më i ri i Prokopit të Cezaresë, historinë e të cilit e plotëson, duke i shtuar edhe ngjarjet e viteve 552-558. Vepra e Agathisë "Historitë" që më vonë u quajt "Peri tes Justinianu bazileias" (Mbi mbretërinë e Justinianit) përbëhet nga 5 libra, në të cilën përshkruhen luftërat e perandorisë bizantine në kohën e Justinianit. Agathia është plot lëvdata për kohën e sundimit të këtij perandori, por ai nuk ngurron të vejë gishtin edhe mbi disa të meta të administratës bizantine të kësaj periudhe.

Nga ky autor ne kemi nxjerrë vetëm ato pak fragmente që interesojnë historinë e lashtë të vendit tonë.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Historici Graeci Minores, edidit Ludovicus Dindorfius vol. II. Menander Protector et Agathias. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1871.

AGATHIAE

HISTORIARUM LIBRI V

(Historitë)

HYRJE

Dhe pothuaj të gjitha këto gjëra do t'i gjesh tek Prokopi... për sulmet e hunëve, dhe pikërisht se si ata kaluan në atë kohë Istrin; për dëmet e mëdha që i sollën ata shtetit romak, se si e shkretuan Ilirikun, Thesalinë dhe pjesën më të madhe të Evropës...

LIBRI I

17 ... Dhe kështu *[Narzesi]*[1] duke e quajtur këtë gjë si të palejueshme, dërgoi menjëherë tek strategët një nga njerëzit e tij më të afërt të quajtur Stefan, atdheu i të cilit ishte qyteti i vogël ilir Epidamni, që t'i qortonte për frikën që i kishte zënë dhe t'i paralajmëronte se do të cilësoheshin si tradhëtarë kundër shtetit nëqoftëse nuk do të ktheheshin menjëherë në vendet e tyre të mëparshme...

LIBRI V

21 Ndërkaq pjesa tjetër e ushtrisë barbare, që ishte drejtuar kundër Hersonezit, shpesh sulmonte muret, duke përdorur shkallë dhe maqina të tjera luftarake, por vazhdimisht ata zmbrapseshin nga romakët që gjendeshin brenda *[mureve]* dhe që mbroheshin me të gjitha forcat. I udhëhiqte ata Germani, i biri i Dorotheut. Ai ishte shumë i ri, sapo i kishte djersirë mustaqja, por dallohej për cilësitë e një komandanti dhe kishte aftësi për të kryer punë të mëdha të cilat ia kalonin moshës së tij. Vendi i tij i lindjes ishte qyteti ilir që quhej në kohë të vjetra Bederiana, por që më vonë u mbiquajt Justiniana e Parë. Perandori Justinian, meqenëse kishte lindur në këtë qytet, kuptohet vetvetiu se e zbukuroi në mënyrë të përshtatëshme qytetin e tij të lindjes me ndërtesa të ndryshme dhe nga një qytet i panjohur e bëri atë të pasur dhe i dha emrin e tij...

[1] Komandant bizantin.

MENANDRI

Menandri, i mbiquajtur Protektor, për ta dalluar nga poeti grek i komedisë me të njëjtin emër, lindi në Konstantinopol aty nga mezi i shek. VI i e. sonë. Në fillim mësoi drejtësi dhe ushtroi profesionin e avokatit, por më vonë duke dashur të kënaqë dëshirën e perandorit Maurik (582-602) u mor me historiografi.

Historia e shkruar e Menandrit përbëhej, me sa duket, prej 8 librash dhe mbante titullin e thjeshtë "Historia". Ai ndjek gjurmët e Agathisë dhe e fillon historinë aty ku ky e ndërpret. Për fat të keq nga kjo histori na janë ruajtur vetëm disa fragmente.

Si burime për përpilimin e kësaj vepre Menandrit i kanë shërbyer tregimet gojore dhe dokumentat zyrtare. Të dhënat e tij janë të sakta e të shumta dhe pikërisht për këto dy arsye ato janë një burim i dorës së parë për historinë e Ilirikut. Tek historia e tij janë mbështetur edhe disa historianë më të vonë si Euagri dhe Theofilak Simokata.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Historici Graeci Minores edidit Ludovicus Dindorfius. Vol. II *Menander Protector et Agathias.* Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1871.

MENANDRI FRAGMENTA

(Fragmente të Menandrit)

25 fq. 58 ... Thuhet se kur Konimundi[1] mori vesh për traktatin[2], u tremb aq shumë, sa që dërgoi menjëherë një ambasadë te Justini për të vazhduar të mbante po atë anë, që kishte patur deri atëherë dhe për t'i ofruar atij Sirmin dhe vendin që është brenda lumit Drao. Ja si nuk kishte fare turp të shkelte betimin...

26 Në kohën kur Bajani, udhëheqësi i avarëve, mendonte të rrethonte Sirmin, mbante të lidhur përkthyesin Vitalianin dhe Komitin, të cilin perandori Justin ia kishte dërguar për të biseduar me të...

27 fq. 59 Pas betejës nën muret e kësaj fortese, Bajani dërgoi disa njerëz për të biseduar rreth paqes[3]. Disa banorë të Sirmit, duke hypur lart mbi banjon publike për të vëzhguar armiqtë, të ulur sipas zakonit, panë që larg barbarët; kur vunë re se lajmëtarët e avarëve ishin afruar, meqë nuk dinin të vërtetën, dyshuan se avarët ishin shumë dhe, duke ecur nëpër një hendek, lajmëruan në qytet. Boni i mërzitur pse nuk dinte se cilët ishin, kur mori vesh se avarët ishin të paktë dhe se vinin për bisedime, ngarkoi disa njerëz për të biseduar me ta, jashtë kështjellës. Ai ishte në shtrat për shkak të një plage. Mjeku i tij i quajtur Theodor, nuk deshi ta linte që komandanti i ushtrisë të shihej nga armiqtë, nga frika se mos ata mësonin se ai ishte i plagosur. Ai shtoi se nëqoftëse ata do ta merrnin vesh, atëherë ai duhej t'u delte që të mos e kujtonin të vdekur. Kur ambasadorët panë se atyre iu paraqitën të tjerë dhe jo ai, kujtuan se komandanti kishte vdekur dhe kërkuan që ai të vinte në mbledhje. Atëherë Theodori duke e quajtur se kjo ishte më e ngutshme për të mirën e shtetit, tha se nuk kishte pse të fshihej komandanti dhe se ishte më mirë të dilte jashtë qytetit dhe të dukej para barbarëve. Duke i lyer plagët me melhem ai e nisi atë. Kur Boni arriti para barbarëve
fq. 60 atëherë ambasadorët i folën në këtë mënyrë: "O romak, despoti i avarëve na ka urdhëruar që gjatë bisedimeve t'u themi këto: "Të mos na shajë askush se bëjmë luftë, sepse ju jeni shkaktarët e saj. Ju doni të na merrni me dhunë vendin, të cilin sa po e kemi fituar me udhëtime e mundime të shumta. Ju na keni marë Usdibadin, i cili sipas ligjit të armëve na përkiste ne. Perandori juaj na ka sharë e fyer jo një-dy herë, por shumë herë dhe nga ato që duhej të bënte nuk bëri asnjë. A është e mundur që pas këtyre të na qortojë se kemi përdorur padrejtësisht armët? Për këtë nuk gabohemi aspak. Edhe tani jemi gati megjithatë t'u japim fund mosmarrëveshjeve, duke rënë dakord me ju dhe u përket juve të merrni vendimin nëse preferoni paqen apo luftën". Boni iu përgjigj: "Nuk jemi ne që kemi filluar të parët luftën as që kemi hyrë në tokat tuaja. Përkundrazi ju e keni bërë këtë në tokat e romakëve. Nga ana tjetër perandori kishte në plan t'u jepte të holla dhe i kishte vënë në duart e ambasadorit tuaj, por kur pa se kjo nuk shërbente tjetër veçse t'u bënte akoma më të pasjellshëm për të mbajtur me kryelartësinë barbare fjalime mburrëse, në të cilat

---

[1] Konimundi ishte mbret i gepidëve.
[2] Traktati i lidhur midis Bajanit, prijësit të avarëve dhe Alboinit, mbretit të longobardëve.
[3] Në vitin 568 e. sonë.

fq. 61 rritni forcat tuaja, ai, duke qenë i matur, e gjykoi më të përshtatshme të përmbahej e të mos u jepte ato që kishte menduar. Dhe nëqoftëse ju dëshironi të dërgoni delegatë që të bisedojnë për paqe me perandorin tonë, atëherë këtë mund ta bëni, por ne nuk kemi mundësi t'u themi agjë se si do të veprojë ai". Këto fjalë që tha Boni, Bajani i quajti se ishin të arsyeshme. Megjithatë ai i drejtoi një kërkesë të re të tillë: "Unë kam turp nga se popujt që më kanë ndjekur në këtë luftë, shohin se nuk kam patur asnjë fryt. Nuk mund të largohem pa marrë me vete disa dhurata të vogla me qëllim që të mos dukem se i kam bërë veprimet luftarake kot e pa fryt. Kur jam nisur nga Skythia, s'kam sjellë asgjë me vete. Është e pamundur të kthehem pa marrë më parë ndonjë ndihmë sado të vogël". Këto kërkesa iu dukën të drejta Bonit, peshkopit të qytetit dhe të tjerëve që ishin me ta. Në fakt Bajani nuk kërkonte të merrte shumë gjëra veçse një pjatë të madhe argjendi, një sasi të vogël ari dhe një veshje mëndafshi. Megjithatë nga frika se mos bënin ndonjë gjë të papëlqyeshme për perandorin e gjykuan më mirë t'i përgjigjen Bajanit në këtë mënyrë: "Ne kemi një perandor të tmerrshëm të rëndë dhe nuk duam ta zemrojmë, duke vepruar me inisiativën tonë. Duke u ndodhur në ushtri ne nuk kemi fare të holla as edhe pasuri, ne nuk kemi veçse rrobat tona që veshim dhe armët. Pra ti e gjykon vetë se nuk mund t'u japim avarëve armët tona, sepse kjo do të ishte një ç'nderim për ne o fq. 62 hagan. Ç'kemi më të çmueshme është në vende të tjera dhe shumë larg. Nëqoftëse perandori ynë do të ketë mirësinë të të bëjë ty ndonjë dhuratë edhe ne do të jemi të kënaqur dhe nuk do të vononim ta jepnim nga ana e tij, mbasi këtë do t'ua bënim si miqve tanë dhe të nënshtruarve njëlloj".

Bajani i egërsuar nga kjo përgjigje, e kërcënoi duke u betuar se do të dërgonte trupat e tij kundër romakëve. Boni i tha që të bënte si t'i pëlqente, por e paralajmëroi se ata që do të ishin kaq të guximshëm dhe do të vinin, nuk do të kishin sukses. Ai u përgjigj se do të dërgonte të atillë kundër romakëve, të cilët edhe po të humbnin ai nuk mërzitej. Ai bëri që dhjetëmijë kutrigurë të quajtur hunë të kalonin lumin Sau dhe i urdhëroi të shkatërronin tokat e Dalmatisë, kurse vetë bashkë me ushtrinë kaloi Istrin dhe u ndal në kufijtë e gepidëve.

28 Bajani, prijësi i avarëve, mendoi të dërgonte delegatë tek romakët për të bërë marrëveshje me ta. Nga ana tjetër, i kërkonte të holla Vitalianit për të hequr dorë nga plaçkitja gjatë pushimit. Jobulida, duke marrë jo më pak se tetëqind nomisma nga sundimtari i Ilirisë, ia dha Bajanit. Për më tepër Bajani dërgoi Targitin dhe fq. 63 përkthyesin Vitalianin tek perandori për t'i kërkuar qytetin e Sirmit dhe të njëjtën shumë të hollash që Justiniani u paguante më parë kutrigurëve e utigurëve të mundur prej tij. Ai kërkonte gjithashtu Usdibadin gepidas dhe thoshte se gjithë gepidasit i takonin atij mbasi i kishte mundur. Kur ambasadorët arritën në qytetin mbretëror dhe si shkuan te perrandori, Targiti foli kështu: "O perandor, kam ardhur këtu nga ana e djalit tuaj, pasi ju jeni babai i vërtetë i Bajanit, despotit tonë. Pra, unë jam i bindur që ju do të tregoni për të një dashuri prej babai duke i kthyer atë që i përket djalit. Kështu pra janë punët tona e tuajat. Vallë a nuk do t'i japësh atij shpërblim? Ato që do t'i japësh nuk ia jep as ndonjë të huaji, as ndonjë armiku, as ka për t'u transferuar zotërimi, sepse ai do të të kthehet nëpërmjet djalit nëqoftëse ti do t'i japësh atij ato, për të cilat kam ardhur. Kur ju ta keni kthyer atë *[Usdibadin]* ai do të jetë sa i juaji dhe i yni. Ato që ai ju kërkon nëpërmjet gojës sime janë: Qyteti i Sirmit, të hollat që Justiniani kishte zakon t'u paguante çdo vit kutrigurëve e utigurëve, popujt të cilët sot i sundon Bajani dhe Usdibadin gepidas, me pronën e tij. Nuk mund të mohohet

se të gjitha këto i përkasin Bajanit". Ja ç'tha Targiti për të cilat perandori iu përgjigj: "O Targit, duket nga fjala jote që ju nuk keni ardhur këtu si ambasador, por për t'u bërë të njohura zakonet e avarëve njerëzve që nuk i njohin. Kur ne pranojmë se Justiniani u jepte të holla hunëve, kjo ndodh më tepër nga një mëshirë e madhe për
fq. varfërinë e tyre dhe për mosdashjen e një gjakderdhje, sesa për njohjen e fuqisë së
64 tyre. Do të ishte një gjë qesharake t'u jepej shenjë miqësie atyre, me të cilët ke luftuar. Por është e drejtë që ne u kemi dhënë kutrigurëve e utigurëve, të cilët ne i kemi mundur. A duhet t'u japim atë që u kemi marrë atyre që i kemi munduar? Kjo do të ishte një sjellje e padrejtë, të marrësh mundimin t'i mundësh dhe t'u japësh frutin e fitores të tjerëve. Nëqoftëse një herë tjetër kemi patur pak kujdes duke ju dhënë, është një gabim, të cilin nuk duam ta bëjmë rregull. Çfarë ta bëjmë Usdibadin, t'ua japim juve? Ne nuk jemi aq naivë për t'u treguar bujarë dhe sidomos në favor të barbarëve, të cilët nuk punojnë veçse për rrënimin e shtetit tonë. Praardhësi im i grumbulloi gepidët, që më parë jetonin të shpërndarë sa andej këtej dhe u dha si vëndbanim krahinën rreth Sirmit. Duke filluar lufta midis tyre dhe langobardëve, ne rrezikuam dhe me ndihmën tonë i bëmë të dilnin fitues. Pa këtë ndihmë ata do të binin në një robëri të mjerueshme. Ndërkaq ata nuk qenë mirënjohës ndaj mirësive tona dhe qenë kaq të pandershëm sa na ngritën edhe gracka. Për këtë ata janë bërë pa dyshim të padenjë për falje. Megjithatë, meqenëse ne e kemi bërë zakon më tepër t'i përçmojmë fajet që bëjnë kundër nesh se sa t'i dënojmë me ashpërsinë që meritojnë, ne nuk jemi hakmarrë për mospërfitim nga mjerimi, kur të tjerët i kemi shtypur. Duke qenë gjërat në këtë gjendje, kërkesat dhe ankimet që na i bëtë ne po i sjellim kundër jush dhe kërkojmë që ju të na i ktheni gepidët. Ju kërkoni t'u kthejmë Usdibadin, kurse ne do të marrim nga ju edhe gepitët e tjerë. Duke qenë romakë ne jemi në gjendje të ndreqim me urtësinë tonë gabimet,
fq. nuk jemi budallenj si kujtojnë disa. Ju kërkoni t'u japim Sirmin dhe ju e kuptoni se
65 jemi të detyruar të rrokim armët. Për më tepër na thua o Targit se hagani do të kalojë Istrin, edhe Hebrin dhe se me kushtrimin e parë do të pushtojë qytetet e Thrakisë. Por ta dini se forcat romake do t'i dalin përpara dhe do t'i presin shpresat e tij dhe për më tepër do të shkretojnë vendin e avarëve. Dhe nuk do të pushojmë duke ju ndjekur dhe vrarë deri sa raca barbare do të shkatërrohet dhe për romakët lufta është më e dobishme se paqa. Është më mirë që avarët nomadë dhe të huajt t'i kesh armiq se sa miq, pasi miqësia e tyre është e dyshimtë. Më mirë të kesh plagë në trup se sa në shpirt. Përveç këtyre o Targit, ne kemi armë, kuaj dhe dhjetëmijë hoplitë të gatshëm dhe vendimi më i keq që mund të marrim është të rrimë duarkryq". Perandori duke folur me këtë krenari, i ktheu ambasadorët e avarëve. Pastaj i shkroi Bonit duke i bërë një qortim të rëndë pse e kishte dërguar këtë ambasadë në Byzant dhe njëkohësisht e urdhëronte që të mbante armët dhe makinat gati, meqë mund të fillonte shumë shpejt lufta kundër avarëve. Boni si lexoi letrën mbretërore filloi të përgatitej për luftë.

29

Targiti erdhi menjëherë si ambasador te perandori, bëri të njëjtat kërkesa dhe
fq. mori të njëjtat përgjigje. Ai kërkonte të merrte nga romakët Sirmin mbasi e quante si
66 pronë të tij, si shpërblim për mundjen e gepidëve; ai akoma kërkonte të hollat që Justini[1] u jepte për çdo vit hunëve dhe premtonte se duke i paguar vitet e kaluara, paqa do të ruhej. Ai dëshironte që t'i kthehej Usdibadi si rob i tij që ishte dhe bëri propozime të tilla shumë të guximshme, për të cilat perandori nuk bënte asnjë fjalë. Më në fund, mbas shumë kërkesave të bëra kot për të njëjtën çështje, e liroi dhe i

[1] Gabimisht për Justiniani.

premtoi se do të dërgonte Tiberin, strateg të plotfuqishëm për të shqyrtuar kërkesat e tyre dhe t'i përfundonte të gjitha çështjet.

48 fq. 98 Meqenëse skllavenët kalonin dhe plaçkitnin Helladën dhe perandoria ishte e kërcënuar nga të gjitha anët nga rreziqe të reja që duket se lindnin njëra nga tjetra[1], Tiberi, që nuk kishte forca të gatshme për luftë, qoftë të barabartë edhe me një pjesë të kundërshtarëve, as të përballonte luftërat me ta, mbasi duhej të furnizonte forcat romake në Lindje, dërgoi një ambasadë te Bajani, prijsi i avarëve, i cili atëherë nuk kishte qëndrim armiqësor ndaj romakëve dhe qysh se u kurorëzua Tiberi kishte dëshiruar të ngarkohej me ndonjë punë dhe të nderohej nga shteti. Qëllimi i ambasadës ishte që ta bindte për një luftë kunër skllavenëve në mënyrë që shkatërrimi i vendit të tyre t'u hiqte dëshirën atyre për ta bërë këtë gjë në vendin tonë dhe në vend që të plaçkitnin tokat e romakëve të ruanin tokat e tyre. Bajani pranoi me gjithë qejf atë që Cezari dëshironte. Joani, sundimtari i ishujve dhe i qyteteve të Ilirisë qe ai që u zgjodh për këtë punë. Menjëherë sa shkoi në Paioni[2] e solli Bajanin dhe forcat e avarëve në tokat e romakëve, duke i kaluar ato mbi të quajturat anije të gjata. Thuhet se kaluan rreth gjashtëdhjetëmijë kalorës me parzmore. Që këtej menjëherë ushtria kaloi përmes Ilirisë e pastaj arriti në tokën e skythëve ku ai u dha anije me dy kiçe për të kaluar Istrin...

63 fq. 121 Bajani, hagan i avarëve, pa kërkuar ndonjë shkak qoftë edhe të rremë kundër romakëve edhe në këtë vit[3] përsëri dërgoi Targitin te mbreti që të sillte paret e grumbulluara, të cilat ishin tetëdhjetëmijë nomizma në çdo vit. Mbasi mori edhe ngarkesën tjetër të cilën e siguroi nga të hollat dhe duke pasur me vete edhe floririn, ai /Bajani/ u kthye duke shkelur paturpësisht traktatin që kishte pasë me Tiberin në fillim të mbretërimit të tij dhe duke marshuar në krye të ushtrisë së tij arriti në breg të Saut midis qytetit të Sirmit dhe Singedonit dhe u përpoq të ndërtonte një urë me qëllim që të rrethonte Sirmin. Meqenëse /Bajani/ dyshonte se do të ndalohej që të shkonte kundër romakëve nga ushtarët e garnizonit të Singedonit, të cilët kishin një përvojë të madhe dhe art në drejtimin e anijeve në lumenjtë, dhe duke dashur të përfundonte operacionin sa më parë, grumbulloi në Ister, në Panoninë e Sipërme, fq. 122 anije të shumta e të rënda. Në këto anije të cilat megjithëse nuk ishin ndërtuar sipas teknikës së ndërtimit të anijeve luftarake, por ishin vetëm përshtatur, hypi shumë hoplitë e vozitës. Këta duke i lëvizur rremat jo në mënyrë elegante, por në mënyrë barbare e të çrregullt, çanë ujin dhe duke kaluar pranë ishullit Sirmiana e prunë Bajanin bashkë me gjithë ushtrinë avare te lumi Sau. Romakët që banonin në këto qytete i zuri frika kur panë këtë operacion të tmerrshëm. Strategu i Singedonit, i quajtur Seth, dërgoi te hagani dhe e pyeti se si qe e mundur që duke kërkuar paqe me romakët ai arriti deri në lumin Sau. Njëkohësisht i thoshte se nuk mund ta shikonte me qetësi përpjekjen e tij për të hedhur urën mbi lum mbasi këtë nuk e lejonte perandori.

Hagani u përgjigj se urën e bënte për të vajtur kundër skllavenëve dhe jo kundër romakëve. Si të kalonte lumin Sau do të shkonte në tokat e romakëve dhe se pastaj do të kalonte Istrin për të marshuar kundër atyre, mbasi shpresonte se perandori romak do t'i jepte anije për këtë qëllim. Shtoi edhe se ai e kishte ndërmarrë një ekspeditë të tillë në favor të perandorit të romakëve, dhe se i kishte dhënë atij dhjetëra

[1] Në vitin 578 e. sonë.
[2] Panoni.
[3] Në vitin 580 e. sonë.

fq. 123 mijëra robër që i kishte çliruar nga duart e skllavenëve. Ai ankohej se këta popuj e kishin fyer pasi së pari nuk donin t'i paguanin tributin e caktuar për çdo vit, së dyti se kishte vrarë ambasadorët avarë që ky kishte dërguar. Për këto erdhi në Sau dhe i lutej Sethit që të pranonte ambasadorët, të cilët i çonte te perandori për t'iu lutur që t'i huante anije, mbi të cilat do të mund të kalonin Istrin dhe do të shkonte kundër skllavenëve. Më në fund ai shtoi se ishte gati të betohej në mënyrat që janë më të shenjta dhe që nuk prishen qoftë nga avarët, qoftë nga romakët dhe se nuk kishte ndonjë plan kundër romakëve apo qytetit të Sirmit, por vetëm kundër skllavenëve, prandaj donte të ndërtonte urën. Këto nuk i besuan as Sethi dhe as të tjerë që ishin në Singedon. Por ata duke ditur se ishin zënë në befasi nga kjo lëvizje e papritur meqenëse kishin pak ushtarë dhe vrapuesit e rinj ishin pak dhe nga ana tjetër, meqenëse hagani filloi të përdorte kërcënime, duke u thënë se nuk prishte aspak marrëveshjet për paqen, se nuk kishte asnjë qëllim tjetër veçse të luftonte skllavenët, që ishin armiqtë e përbashkët të romakëve dhe të avarëve, se nuk do të hiqte dorë nga ngritja e urës, dhe shtoi se nëqoftëse romakët do të guxonin të lëshonin një shigjetë kundër atyre që ndërtonin urën duhet ta dinin se kishin për të qenë shkaktarët e parë të prishjes së marrëveshjeve dhe për pasojat e kësaj të mos u vinte keq nëqoftëse nga gjendja e luftës me popullin e avarëve do të pësonte të këqija udhëheqja e romakëve; të trembur nga këto, ata të Singedonit iu lutën të bënte betimin. Atëherë ai bëri betimin në mënyrën e avarëve, me shpatë të zhveshur dhe duke mburrur veten e tij dhe popullin e avarëve tha se nëqoftëse e ndërtonte urën
fq. 124 mbi Sau, duke pasur ndonjë qëllim kundër romakëve, le të zhdukej fare ai së bashku me popullin e tij nga shpata, le të binte mbi ta qielli dhe zjarri, që ishte zoti i qiellit, le t'i mbulonin malet e pyjet që ishin rreth e rrotull dhe lumi Sau duke gufuar t'i mbulonte me ujërat e tij. Hagani pasi u betua kështu në mënyrën e barbarëve tha: "Dua të betohem tani sipas zakonit të romakëve"; Dhe në të njëjtën kohë ai kërkoi t'i thonin ç'gjë kishin më të nderuar dhe më të shenjtë në besimin e tyre, si e kanë zakon të betohen, në mënyrë që atyre t'u mbushej mendja se ai nuk do të shkelte betimin, pa pësuar zemërimin e zotit dhe ndëshkimin e drejtësisë së tij. Pra në këtë kohë peshkopi i qytetit Singedon /i dorëzoi/ librat e shenjta, nëpërmjet të cilave jepen porositë e zotit. Atëherë /hagani/ duke fshehur ndjenjat e tij në fund të zemrës u ngrit nga froni, dhe gjoja sikur i bënte këto me frikë e respekt dhe duke rënë me gjithë vullnet në gjunjë tha se betohej për zotin, që ka folur në librat e shenjta dhe se përsa kishte thënë nuk ka patur qëllim të gënjejë.

Pas kësaj Sethi pranoi ambasadorët e Haganit dhe i nisi te perandori Tiber në kryeqytet. Sa kohë që ata ishin në udhëtim për në qytetin mbretëror dhe do të priteshin nga perandori, Hagani përdori gjithë kujdesin, që mund të merret me mend, për të përfunduar urën sa më shpejt duke futur në punë pothuajse gjithë ushtrinë avare para se perandori të dëgjonte ambasadorët dhe të ndalonte ndërtimin e saj.

64 fq. 125 Si arritën ambasadorët e avarëve në kryeqytet, iu lutën perandorit që të pregatiste anijet mbi të cilat Hagani dhe ushtria e avarëve do të mund të kalonin Istrin për të luftuar kundër skllavenëve. Duke pasur besim në miqësinë e romakëve, thanë se Hagani kishte ndërtuar një urë mbi Saun për të goditur skllavenët, armiq të përbashkët të tyre. Perandori e kuptoi menjëherë se qëllimi i Haganit ishte të merrte Sirmin me anë të urisë, duke zënë të gjitha rrugët. Por duke pasur besim në paqen dhe në traktatin me avarët, nuk ishte kujdesur për të sjellë ushqime. Po ashtu duke mos pasur fare ushtarë, unë nuk them të pazot për të përballuar fuqinë e avarëve, por duke mos pasur fare dhe meqenëse ushtria ishte e zënë kundër persëve në Armeni e në Mesopotami, ai bëri sikur pajtohej me mendimin e haganit dhe e uronte për luftën kundër skllavenëve, pasi ata kishin sjellë shkatërrime në tokat e tij. Por ai shtoi se

koha nuk ishte e përshtatshme për të ndihmuar avarët në këtë ndërmarrje meqenëse tyrkët gjendeshin para Hersonit dhe se avarët nuk do të mungonin t'i ndeshnin posa të kalonin Istrin, dhe se ishte më mirë të prisnin pak kohë sa të zbulonte qëllimin e sulmit të tyrkëve, të cilin do t'ia bënte të ditur haganit. Ambasadori e pa mirë se të gjitha këto ishin shpikur posaçërisht nga perandori, i cili shpresonte t'i frikësonte me
fq. tmerrin e armëve të tyrkëve. Megjithatë ai bëri sikur e kuptoi këtë dhe, megjithëse qe
126 ai që e shpuri haganin në luftë kundër romakëve më shumë se çdo tjetër, i premtoi se do ta këshillonte që të priste. Ky premtim qe shkaku që i bëri dhurata të mëdha dhe pastaj ai u largua nga kryeqyteti.

Por duke kaluar përmes tokës së ilirëve i shoqëruar vetëm nga një numër i vogël romakësh, ai u vra nga disa skllavenë që kalonin dhe plaçkitnin këtë krahinë. Pak ditë më vonë nga ana e haganit arriti një ambasador tjetër i quajtur Solah, i cili pasi hyri te perandori i foli kështu haptazi dhe me paturpësi: "Më duket se do të ishte një gjë navie t'iu lajmëronim se dy brigjet e lumit Sao janë të bashkuara nga një urë. Ajo që duket me sy nuk mund të përgënjeshtrohet me fjalë. Romakët nuk mund të dërgojnë më në Sirm, nëpërmjet lumit, as ushqime, as edhe ndonjë ndihmë tjetër. Ajo që mund të bënin do të ishte të dërgonin një ushtri mjaft të madhe për të dëbuar me forcë ushtrinë avare dhe të shkatërronin urën, por nuk ishte rasti që perandori të hynte në luftë me avarët për një qytet të parëndësishëm, që nuk është veçse një tenxhere". Këto fjalë përdori për avarët e për haganin e tyre dhe shtoi se do të ishte më mirë *[për romakët]* të tërhiqnin ushtarët e banorët të paprekur me plaçkat që mund të mbanin dhe t'i lihej haganit qyteti i zhveshur dhe i shkretë. Shprehu edhe frikën se mos romakët e ruanin paqen me avarët vetëm tani sa kohë që ishin në luftë
fq. me persët, me qëllim që të ktheheshin pastaj me të gjitha forcat kundër avarëve. Por
127 tha se ata do të ishin gati t'i prisnin, pasi qyteti *[Sirmi]* u shërbente si fortesë dhe se nuk do të gjenin pengesa, as nga ana e lumit, as nga ndonjë rrugë tjetër; veç kësaj për ta ishte e qartë dhe fare e dukshme se jo për të mirën e avarëve dhe as për një paqe të qëndrueshme perandori kishte fortifikuar kaq shumë Sirmin. Duke shprehur kënaqësinë e haganit për dhuratat të cilat i dërgoheshin nga ana mbretit çdo vit, tha se ishte e mirë pasuria, ari, argjendi dhe veshja e mëndafshtë, por mbi të gjitha këto më i shtrenjtë e më i çmueshëm për të ishte shpirti, për të cilin ai *[hagani]* kishte frikë, mbasi i kujtoheshin se si shumë popuj të tjerë, të tërhequr nga dhurata të tilla të romakëve, kishin përfunduar në katastrofë. Prandaj as premtimet, as dhuratat nuk do ta bënin të hiqte dorë nga ndërmarrja e tij deri sa të bëhej zot i qytetit Sirm dhe i krejt ishullit Sirmia, i cili me të drejtë i përkiste atij, mbasi më përpara ka qenë i gepidëve që ishin mundur nga avarët dhe si pasojë pronat e tyre i takonin më tepër atij se sa romakëve. Këto e tronditën perandorin dhe i shkaktuan zemërim e dhimbje, dhe ai u përgjigj kështu: "Hagani nuk ma kalon as për fuqinë e armëve të tij, as për nga guximi i madh, as edhe për urtësinë e sjelljeve të tij. Ai s'ka bërë tjetër veçse ka
fq. shkelur haptas paqen dhe ka fyer zotin, në emër të të cilit ishte betuar, kjo është për
128 çdo njeri e qartë. Por megjithatë unë do t'i përgjigjem pabesisë së tij. Unë do t'i jepja më parë për grua njerën nga vajzat e mia, se sa t'i dorëzoja vullnetarisht qytetin Sirm. Nëqoftëse do ta marr me forcë dhe me dhunë ai do të ndëshkohet prej zotit të fyer dhe unë do të kem kënaqësinë që nuk desha të braktis as pjesën më të vogël të shtetit romak". Pasi përcolli ambasadorin me këtë përgjigje, ai u pregatit për të ndihmuar qytetin me të gjithë fuqinë e tij. Meqenëse nuk kishte fare ushtarë ai dërgoi strategë, hegjemonë dhe kapitenë, disa nëpërmjet Ilirisë, disa të tjerë nëpërmjet Dalmatisë me qëllim që të ruanin qytetin.

65 Theognidi pasi arriti në ishujt Kasia e Karbonaria, pranoi propozimin që iu bë për të biseduar për paqen. Vetë Bajani erdhi për këtë zbriti nga kali dhe u ul mbi një fron të artë nën një mbulesë cohe në trajtë tende. Ai kishte para gjoksit dhe fytyrës një mburoje, nga frika se mos romakët e qëllonin. Ata që kishin shoqëruar
fq. Theognidin nuk ishin larg vendit të Bajanit. Përkthyesit e hunëve premtuan qartë se
129 do të ruanin armëpushimin që u kishte dhënë perandori. Atëherë Bajani tha: "Duhet që romakët ta lëshojnë Sirmin pa luftë, sepse nuk mund ta shpëtonin qytetin, pasi rrugët ishin zënë nga të gjitha anët, se nuk do të kishin mundësi për furnizim dhe se forcat avare nuk do të pushonin së luftuari deri sa të kishin pushtuar Sirmin". Ai shtoi se kishte një arsye tjetër që mund të pranohej, për të cilën kërkonte të pushtonte qytetin meqenëse kishte frikë se mos dezertorët e ushtrisë avare kalonin te romakët, mbasi ai kishte dy dyer.

Theognidi u përgjigj se së pari ai nuk do të pushonte së luftuari, deri sa avarët nuk do të tërhiqeshin dhe se Bajani nuk duhet të shpresonte se do t'i gjente romakët ashtu siç mendonte ai.

Ja bisedimet që patën, të cilat nuk pajtoheshin aspak me paqen. Theognidi duke mos shpresuar për marrëveshje i tha Bajanit se ai tërhiqej dhe se pregatiste armët për luftë për ditën e nesërme dhe nuk do të hiqte dorë nga ndeshja me të. Pas kësaj ata u ndanë.

66 Kishte tri ditë që kishte filluar lufta kundër avarëve dhe romakët nuk guxonin të dilnin për të sulmuar urën e Dalmatisë, megjithëse ajo ishte prishur[1]. Apsihu dhe bashkë me të ata që e ruanin më parë treguan një përbuzje të madhe për romakët, sa që e braktisën dhe kaluan në anën tjetër për t'u bashkuar me ushtrinë e Bajanit.
fq. Banorët e Sirmit të shtrënguar nga uria shumë e madhe, për mungesë ushqimesh të
130 nevojshme, hanin gjëra të ndaluara, meqenëse ishte prerë kalimi në Sao. Sundimtari i Sirmit, Solomoni, që nuk kishte kryer detyrat e tij dhe që nuk kishte bërë asnjë përpjekje, mallkonte ditën e themelimit dhe ankohej për udhëheqësit romakë në një mënyrë të dëshpëruar. Për fatkeqësinë më të madhe Theognidi nuk kishte ushtarë. Kur mësoi këto perandori Tiber, gjykoi se ishte më mirë të dorëzonte qytetin, sesa të linte të çoheshin në robëri banorët dhe i dërgoi letra Theognidit t'i jepte fund luftës me një marrëveshje, në mënyrë që të gjithë banorët të dilnin që andej duke mos marrë me vete veshje. Lufta mbaroi me kushtin që t'i linin qytetin avarëve dhe se avarët do të lejonin romakët të merrnin të gjithë popullin, pa marrë asgjë me vete nga pasuria e tyre. Përveç kësaj hagani kërkoi nga romakët t'i dorëzonin të hollat e tri vjetëve të cilat nuk i kishin marrë sipas zakonit, në mënyrë që mos të ishte nevoja të përdorte armët. Ishin këto të hollat e paqes, për çdo vit rreth tetëdhjetëmijë nomizma të arta. Për më tepër ai kishte një komandant të ushtrisë së tij që kishte ikur dhe që gjendej, sikurse thuhej, te romakët për arsye se kishte qenë në marrëdhënie me gruan e Bajanit. Ai ia bëri të qartë Theognidit se duhej dorëzuar i ikuri se përndryshe nuk do të përfundonte marrëveshjen. Theognidi iu përgjigj se toka e perandorit të romakëve ishte shumë e madhe dhe e gjerë dhe se ishte shumë e
fq. vështirë për të gjetur një të ikur që fshihej ose që ndoshta kishte vdekur. Bajani i tha
131 se duhej që së paku prijësat e romakëve të betoheshin se do të bënin një kontroll të imët dhe se do t'ia dorëzonin monarhut të avarëve nëqoftëse e gjenin ose nëqoftëse kishte vdekur përsëri do ta lajmëronin.

[1] Në vitin 581 e. sonë.

EUAGRI

Historian kishtar nga Siria, lindi në vitin 536 të e. sonë në qytetin Epifania të Sirisë dhe vdiq në Konstantinopol në vitet e fundit të shek. VI. Në kryeqytetin bizantin arriti të ketë poste të larta administrative.

Vepra e tij "Historia ecclesiastica" (Historia kishtare) e ndarë në 6 libra, nuk trajton vetëm ngjarjet me karakter fetar të viteve 431-593, por përshkruan edhe ndodhinat laike të kësaj periudhe. Me këtë histori të tij Euagri është vazhduesi më i rëndësishëm i veprave të Sokratit, Sozomenit dhe Teodoretit.

Historia kishtare e Euagrit na kumton të dhëna me vlerë për shek. V-VI sidomos për luftërat kundër hunëve dhe avarëve. Disa nga këto të dhëna i mësojmë për herë të parë këtu, gjë që tregon se Euagri i ka pasë nxjerrë nga vepra sot të humbura.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

J. Bidez – L. Parmentier, The Ecclesiastic History of Euagrius with the Scholia. London 1898.

EUAGRI

HISTORIA ECCLESIASTICA

(Historia Kishtare)

I 17 *Për Atilën, mbretin e skythëve dhe se si ai shkretoi krahinat lindore dhe perëndimore. Për tërmetin e tmerrshëm që ra dhe për ngjarje të tjera të tmerrshme në botë*[1)]

Në këtë kohë, kur Atila ishte mbret i skythëve[2)], shpërtheu lufta shumë e njohur[3)]. Për të shkruan me kujdes dhe me njohuri të thella retori Prisku, i cili tregon me një gojëtari të madhe se si ai *[*Atila*]* u nis në marshim kundër krahinave lindore dhe perëndimore, çfarë dhe sa qytete pushtoi dhe nënshtroi dhe çfarë veprash kreu, para se të largohej nga kjo jetë.

Kur i njëjti Theodos[4)], mori në dorë skeptrin mbi të gjithë botën, si të thuash, ra një tërmet shumë i madh dhe i jashtëzakonshëm që i tejkaloi të gjithë tërmetet e mëparshme. Si rrjedhim i kësaj, shumë nga kullat e kryeqytetit u shkatërruan krejtësisht, u shkatërrua dhe i ashtuquajturi "Muri i Gjatë" në Hersones. Kurse toka u hap dhe u shembën shumë fsahtra. Të këqija të shumta dhe të panumërta ranë mbi tokë dhe det. Disa burime u thanë, në vende të tjera buruan ujëra të shumtë që përpara nuk ishin. Nga ana tjetër, në vende të tjera u shkulën pemët nga rrënja, dhe shumë grumbuj dheu u ngritën si male.

II 18 *Për sinodin e Kalhedonit dhe shkakun e thirrjes së tij*[5)].

Në këtë gjendje[6)] ata të Lindjes[7)] bërtisnin: "Ky është një vendim i drejtë". Kurse peshkopët e ilirëve thërrisnin: "Të gjithë gabuam, të gjithë kërkojmë falje".

Për aktet e sinodit thuhet se u lexua ajo pjesë e mesazhit të Leonit, i cili përmban sa më poshtë: "Dhe që të paraqitej ajo që është e detyrueshme për natyrën tonë, natyra hyjnore u bashkua me natyrën që i është nënshtruar vuajtjes, pasi kjo i përgjigjet larjes së mëkateve tona. Po i njëjti është ndërmjetës në mes të zotit dhe njerëzve, njeriu Jezu Krishti, i cili mund të vdesë në njerën *[*natyrë*]* dhe nuk mund të vdesë në tjetrën..."

[1)] Ky nënkapitull, sikurse dhe nënkapitujt e fragmenteve të tjerë, janë marë nga vepra e Nikefor Kalistit.
[2)] Me këtë nënkuptohen hunët
[3)] Është fjala për luftën e Atilës kundër perandorisë Bizantine në vitin 447.
[4)] Perandor Theodos II (408-450).
[5)] Sinodi kishtar i Kalhedonit u mbajt nga dt. 8 tetor e deri në 1 nëntor të vitit 451 në Kalhedon dhe mori vendime kundër mësimit heretik të Eftihit dhe Dioskorit.
[6)] Është fjala për vendimin e sinodit, me të cilin u hiqeshin fronet peshkopale peshkopëve të Aleksandrisë Dioskorit dhe pasuesve të tij, të cilët u kishin bërë presion përkrahësve të ortodoksizmit në të ashtuquajturin "sinod të banditëve" në Efes në vitin 449.
[7)] D.m.th. peshkopët e Lindjes.

Meqenëse peshkopët e Ilirisë[1] dhe të Palestinës lëkundeshin, Aeti, arhidiakon i kishës së shenjtë të Konstantinopolit, solli këto fjalë të Kyrilit[2]: "Pas kësaj, përsëri trupi i tij për hir të Zotit pësoi vdekjen për të gjithë, siç thotë apostulli Pauli. Me fjalë të tjera ai pësoi vdekjen për shkak tonë, por nuk arriti deri në njohjen e vdekjes, e cila nuk është në natyrën e tij. Kjo do të ishte marrëzi për t'u folur dhe për t'u menduar". Por siç thashë pak përpara, mishi i tij shijoi vdekjen. Dhe përsëri u kthye tek këto fjalë nga mesazhi i Leonit: "Se dy format veprojnë të shkrira njëra me tjetrën, gjë që do të thotë në vetvete se fjala kryen atë që është në natyrën e fjalës, kurse trupi kryen atë që është në natyrën e trupit. Dhe njëra nga këto shndrit me çudirat e saj kurse tjetra i nënshtrohet përbuzjes..." Meqenëse peshkopët ilirë dhe palestinas lëkundeshin kundrejt këtyre fjalëve, po ky Aeti lexoi kapitullin e mëposhtëm të Kyrilit...

Pas tyre peshkopët lindorë thirrën: "Egyptiani[3] në mërgim!". Por ilirët: "Lutemi, mëshironi të gjithë!" Pas tyre ata të Lindjes thirrën: "Egyptiani në mërgim".

Meqenëse ilirët donin të tilla gjëra përfaqësuesit e klerit të Konstantinopolit thirrën: "Dioskori në mërgim! Egyptiani në mërgim! Heretiku në mërgim! Krisht hiqe Dioskorin!". Pas tyre peshkopët ilirë dhe peshkopët e tjerë thirrën përsëri: "Të gjithë gabuam. Na fal të gjithëve ne! Dioskori në Sinod, Dioskori në kishë". Dhe pasi kaluan edhe çështje të tjera të tilla, mbaroi kjo mbledhje...

Urdhëruan gjashtë nga peshkopët e Lindjes, tre nga Ponti, tre nga Azia, tre nga Thrakia, tre nga Iliria dhe Anatolin[4] dhe tre nga zëvendësit romakë që të mblidheshin në Martyrio dhe të paraqitnin drejt dogmat e fesë.

IV 8 *Për të këqijat e përgjithshme.*

Përveç kësaj, kur Justini kishte pushtetin perandorak, Dyrrahi, i cili dikur /quhej/ Epidamn, vuajti nga tërmeti, si edhe Korinthi që gjendet në Helladë.

V 12 Kur kjo ngjau në Lindje[5], Sirmi u pushtua nga avarët. Më përpara ai gjendej në duart e gepidëve, por ata ia patën dorëzuar Justinit.

14 Dhe kështu /Tiberi/ pasi i përdori krejt paratë e mbledhura në mënyrë të keqe filloi të pregatitej për luftë. Nga fiset përtej alpeve ai mblodhi sipas vlerës ata që jetojnë rreth Renit dhe ata që banojnë në brendinë e alpeve, gjithashtu dhe nga masagetët e nga fise të tjera skythe.

Kështu ai ngriti një ushtri të madhe me burra të guximshëm. Dhe përveç këtyre mblodhi dhe paionë[6], myzë, ilirë dhe isauras. Pasi mblodhi reparte me afërsisht njëqind e pesëdhjetë mijë kalorë të guximshëm, ai e shtyu Hosroin...

VI 10 Ndërsa po ngjisnin këto punë, avarët sulmuan dy herë të ashtuquajturin "Mur të Gjatë". Ata pushtuan me rrethim Singidunin, Anhialin dhe të gjithë Helladën, si edhe qytete dhe kala të tjera, dhe robëruan /popullsinë e tyre/. Zhdukën dhe dogjën çdo gjë, pasi pjesa më e madhe e ushtrive romake ishte në Lindje[7]

---

[1] D.m.th. në Ilirik.
[2] Patriarhu i Aleksandrisë mbrojtës i ortodoksizmit.
[3] Dioskori, peshkopi i Aleksandrisë.
[4] Peshkop i Konstantinopolit.
[5] Kur po bëheshin bisedime (në vitin 524) midis mbretit persian Hosroi I dhe komandantit bizantin Trajan.
[6] Është fjala për panonë.
[7] Mendohet se ky sulm u bë në vitin 584.

JORDANI

Jordani rridhte nga një familje e pasur allane, por i pëlqente ta mbante veten për got. Jetoi dhe punoi aty nga mesi i shek. VI i e. sonë në fillim si noter dhe më vonë si peshkop në një qytet të Italisë së Jugut.

Jordani ka shkruar dy vepra: Historinë e Romës (Romana) që fillon me krijimin e botës dhe mbaron me kohën e sundimit të Justinianit dhe Historinë e gotëve (Getica), që përshkruan historinë e këtij populli prej kohëve më të lashta e deri në shpartallimin e tij të plotë, në kohën e mbretit Totila (viti 551). Ndërsa për veprën e parë Jordani shfrytëzoi Eutropin, Hieronymin, Marcelin Komesin, Florin, etj. historinë e gotëve ai e nxori duke shkurtuar dy vepra të humbura, një kronikë të Ablabit dhe Historinë gote ("Historia gothica") të Kasiodorit, që të dy me prejardhje gote. Gjuha e përdorur nga Jordani është një latinishte vulgare, megjithëqë ai e njihte mirë jo vetëm latinishten, por edhe greqishten. Ashtu sikurse dhe disa paraardhës të tij, Jordani në mënyrë të gabuar identifikon gotët me getët. Njoftimet që na jep në historinë e tij të gotëve vlejnë për njohjen e disa ngjarjeve të rëndësishme të zhvilluara në Ilirik veçanërisht në shek. IV-VI.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Jordanis romana et Getica, recensuit Theodorus Mommsen, MGH, AA, vol. V, pars I, Berolini. 1882

JORDANES

GETICA

DE ORIGINE ACTIBUSQUE GETARUM

(Prejardhja dhe veprat e getëve)

76 Pas një kohe të gjatë, në kohën e sundimit të Domitianit[1], gotët[2] duke pasur frikë
koprracinë e tij, e prishën aleancën që kishin lidhur dikur me perandorët e tjerë dhe
shkatërruan bregun e Danubit, i cili prej kohësh i përkiste perandorisë romake duke
asgjësuar ushtarët bashkë me komandantët e tyre. Në krye të kësaj province ishte në
këtë kohë pas Agripës, Op Sabini. Gotët kishin si mbret Dorpaneun. Pasi filloi lufta,
gotët i mundën romakët, i prenë kokën Op Sabinit, pushtuan dhe plaçkitën shumë
kështjella e qytete të perandorisë. I detyruar nga kjo /që u ndodhi/ nënshtetasve të
77 tij, Domitiani erdhi me të shpejtë në Ilirik me guximin që e karakterizonte dhe
thuajse me gjithë ushtrinë e shtetit të tij të komanduar nga Fusku, me ushtarë të
zgjedhur kaloi Danubin mbi një urë të ndërtuar në anije dhe marshoi kundër
78 Dorpaneut[3]. Këtu gotët, të cilët nuk ia përtuan të marrin armët, i mundën romakët
që në ndeshjen e parë dhe, pasi vranë Fuskun, grabitën thesaret në lëmet ushtarake...

Kur Gratiani[4] zgjodhi për perandor Theodosin[5] nga Spania dhe e vuri në krye
139 të principatit të Lindjes në vend të xhaxhait të tij Valentit, disiplina ushtarake u
përmirësua menjëherë dhe u zhdukën plogështia e dembelia e sundimtarëve të
mëparshëm. Kur e ndjeu këtë goti u tremb sepse perandori, i cili dallohej në
përgjithësi për mendjemprehtësi, guxim dhe gjykim të drejtë, e nxiti ushtrinë e
lodhur për vepra të guximshme si me urdhërat e tij të rrepta ashtu edhe me sjelljen
dhe përkëdheljet e tij. Dhe me të vërtetë, atëherë kur ushtarët fituan besimin në
140 vetvete, nëpërmjet një perandori më të mirë, guxuan të sulmojnë gotët dhe t'i
dëbojnë nga kufijtë e Thrakisë. Por atëherë kur perandori Theodos u sëmur dhe
gjendja shëndetësore e tij ishte pa shpresë, gotët morën guxim, dhe pasi ndanë
ushtrinë, Fritigerni u sul për të plaçkitur Thesalinë, Epirët[6] e Ahenë.

Menjëherë pasi Alarihu u bë mbret, u këshillua me njerëzit e tij dhe u mbushi
147 mendjen atyre se ishte më mirë që mbretërinë ta fitonin me përpjekjet e tyre, sesa

---

[1] Tit Flav Domitiani, perandor në vitet 81-96.
[2] Megotët duhen kuptuar geto-dakët.
[3] Dorpaneu, udhëheqësi i dakëve.
[4] Perandori Gratian (367-383).
[5] Theodosi u shpall august në vitin 379 në Sirm. Në fillim ai udhëhoqi nga Sirmi veprimet ushtarake kundër gotëve, por më vonë, kur perandori Gratian shkoi në Rein, ai e çoi qendrën e komandës në Thesalonik për të mbrojtur nga gotët Ilirikun dhe Thrakinë.
[6] Jordani e ka përdorur fjalën Epir dy herë në shumës, sepse në kohën e tij ishte akoma i gjallë kujtimi i ndarjes së Epirit në dy pjesë: në atë jugor (me qendër Nikopolin në gjirin e Artës), që në kohë të vjetra quhej Epir i Vjetër dhe më vonë Epir i Parë, dhe në atë verior (me qendër Dyrrahun), që në fillim quhej Epir i Ri dhe më vonë Epir i Dytë.

të rrinin duar kryq dhe t'u nënshtroheshin të tjerëve. Dhe në krye të ushtrisë kaloi
nëpër Panoni në kohën kur ishin konsuj Stilihoni dhe Aureliani[1] dhe duke lënë
djathtas Sirmin hyri në Itali, e cila iu duk e shkretë e pa njerëz; asnjë nuk i
kundërshtoi dhe arriti deri tek ura Kondidiane, tre milje larg kryeqytetit Ravena. Ky
148 qytet, tek i cili mund të hyhej vetëm nga njëra anë, gjendej midis kënetës, detit dhe
lumit Pad[2], dhe zotëruesit e mëparshëm të tij, sipas një tradite të vjetër, kanë qenë
enetët[3], që do të thotë të denjë për lëvdatë. Ishte i vendosur në gjirin e perandorisë
149 romake, në breg të detit Jon, si në një ishull të rrethuar nga derdhjet e ujërave që
rridhnin. Në lindje të tij ka detin; po të lundrosh në këtë det, duke u nisur nga
Korkyra dhe Hellada, nga e djathta të parët janë Epirët, pastaj Dalmatia, Liburnia,
Istria dhe kështu duke lundruar bregut deri në Veneti...
Pasi dëgjoi këtë, perandori Nepot i dha urdhër Ekdicit të linte Galinë dhe të vinte tek
241 ai duke emëruar komandant ushtarak në vend të tij Orestin. Oresti, si mori komandën
e ushtrië, u nis nga Roma kundër armiqve dhe erdhi në Ravenë, ku qëndroi dhe
shpalli peandor të birin e tij Augustulin. Kur mori vesh këtë gjë, Nepoti iku në
Dalmati ku hoqi dorë nga pushteti dhe u kthye në person privat; këtu gjendej Glykeri
i cili kishte qenë dikur perandor dhe tani kishte peshkopatën e Salonës.
265 Kurse sauromatët të cilët ne i quajmë sarmatë dhe kemandrët, dhe disa prej hunëve
zunë vend në një pjesë të Ilirikut në tokat që iu dhanë pranë qytetit Kastramartena.
Pas pak kohe mbreti Valamer dhe vëllezërit e tij Thiudemir dhe Vidimir, duke parë
270 se po vonoheshin dhuratat e zakonshme të perandorit Marcian[4] të cilat i merrnin për
ruajtjen e paqes, dërguan delegatë te perandori[5] dhe morën vesh se Theodorihu, i
biri i Triarit, po ashtu me prejardhje gote, por prej një fisi tjetër dhe jo nga amalët,
rronte mirë bashkë me të tijët, i lidhur në miqësi me romakët dhe merrte vit për vit
haraçin, ndërsa ata përbuzeshin. Të fryrë nga urrejtja, kapën armët dhe duke kaluar
nëpër gjithë Ilirikun, plaçkitën dhe shkatërruan[6].
273 .. Pasi më në fund fisi i hunëve u bë zap nga gotët, Hunimundi, udhëheqësi i
suavëve, duke kaluar në Dalmati, grabiti kopetë e gotëve që endeshin nëpër fusha,
pasi Dalmatia ishte fqinjë e Suavisë[7] dhe pak larg nga Panonia, veçanërisht në ato
pjesë ku atëherë banonin gotët...
285 Thiudimeri, i vëllai më i madh, kaloi Saun[8] me të tijët duke kërcënuar me luftë
sarmatët dhe ushtarët romakë, nëqoftëse do ta pengonin. Ato në të vërtetë e kishin
frikë atë dhe rrinin të qetë, sepse edhe nuk ia dilnin dot asaj morie njerëzish.
Thiudimeri duke parë se sukseset e ndiqnin kudo, sulmoi Naisin, qytet i parë në
286 Ilirik, kurse birin e tij Theodorihun, pasi i dha me vete komitët Astat dhe Iuvilia, e
nisi nëpërmjet kështjellës së Herkulit për në Ulpianë. Posa arritën këtu, ata e
nënshtruan menjëherë këtë ashtu edhe Stobin dhe pastaj u futën në shumë vende të
tjera të Ilirikut, që më përpara nuk i kishin pushtuar dot.

---

[1] Flav Stilihoni dhe Flav Aureliani ishin konsuj (i pari në Perëndim, kurse i dyti në Lindje) në vitin 400.
[2] Lumi i sotëm Po.
[3] Enetët janë venetët. Shpjegimi "të denjë për lëvdatë" që i jep Jordani kësaj fjale, gjoja greqishte, është vetëm një keqkuptim.
[4] Perandori Marcian (450-457), pasardhës i Theodosit II, provoi t'ua hiqte pagesën në formë dhurate barbarëve federatë, shumë të cilën ata ishin mësuar ta mirrnin rregullisht nga arka e perandorisë në kohën e Theodosit.
[5] Është fjala për perandorin Leon I (457-474).
[6] Ostrogotët e Valamerit, Thiudimerit dhe Vidimerit, duke dalë nga Panonia sulmuan Ilirinë dhe arritën deri në Dyrrah të cilin edhe e pushtuan në vitin 459.
[7] Savia
[8] Lumi Sava.

ANONIMI VALESIAN

Në vitin 1636 u botuan nga H. Valesi, së bashku me veprën e Armian Marcelinit edhe dy tregime të dy autorëve të panjohur. Meqenëse në atë kohë kujtohej se të dy tregimet rridhnin nga jë autor i vetëm, të dy punimeve iu dha si titull emri i botuesit të parë. Njëri nga të dy tregimet "Origo Constantini imperatoris" (Prejardhja e perandorit Konstantin) trajton, siç e thotë edhe vetë titulli, kohën e këtij perandori ose më drejt periudhën nga dorëheqja e Dioklecianit deri në vdekjen e Konstantinit (viti 337); tregimi i dytë merret me shtjellimin e historisë së prijësave gotë Odoakër dhe Theodorih (474-526).

Historia e Konstantinit përmban edhe disa të dhëna me vlerë për historinë e Ilirikut.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

TH. Mommsen, Origo Constantini imperatoris sive Anonymi Valesiani, pars prior. Monumenta Germaniae Historica, AA, IX, 1, Berolini 1891.

ANONYMI VALESIANI

ORIGO CONSTANTINI IMPERATORIS

(Prejardhja e perandorit Konstantin)

2 **2** Pikërisht ky Konstantin[1] lindi dhe u edukua në qytetin Nais nga nëna e tij Helena që ishte nga shtresë shumë e ulët. Më vonë ai e zbukuroi këtë qytet në mënyrë madhështore. Qe pak i arsimuar dhe peng tek Diokletiani dhe Galeri. Në kohën e po këtyre perandorëve, ai luftoi me guxim në Azi.

5 **3** Ndërkaq Cezarë u bënë dy vetë: Severi dhe Maksimini. Maksiminit[2] iu dha pushteti mbi Orientin; Galeri mbajti për vete Ilirikun, Thrakinë dhe Bityninë; Severi mori Italinë dhe atë që kishte patur Herkuli.

8 Atëherë Galeri bëri Licinin cezar në Ilirik. Pastaj ai la Licinin në Panoni...

30 **6** Kurse Konstantini e quajti Byzantin, sipas emrit të tij, Konstantinopol, për kujtim të fitores së përmendur. Ai e veshi atë, si qytetin e lindjes, me një stoli të madhe dhe deshi që të krahasohej me Romën. Pastaj mblodhi për këtë qytet nga të gjitha anët qytetarë dhe shpenzoi aq shumë para sa që për të shteroi pothuaj të gjitha pasuritë mbretërore. Ai krijoi atje edhe senatin, të një shkalle më të ulët, dhe i quajti senatorët e tij Clari[3]. Pas kësaj ai filloi luftën kundër gotëve dhe u dërgoi ndihma sarmatëve që i luteshin.

31 Kështu për shkak të veprimeve luftarake të cezar Konstantinit[4], vdiqën nga uria dhe të ftohtët pothuaj njëqindmijë vetë. Atëherë mori dhe njerëzit e lënë peng, në mes të të cilëve dhe të birin e mbretit Ariarih[5]. Kështu ai bëri paqë me gotët dhe u drejtua kundër sarmatëve, të cilët shikoheshin si njerëz të dyshimtë për t'u besuar.

Por skllevërit e sarmatëve ngritën krye kundër gjithë zotërinjve dhe i dëbuan.
32 Konstantini i pranoi ata me përzemërsi dhe i shpërndau nëpër Thraki, Skythi, Maqedoni dhe Itali me treqind mijë vetë të moshave dhe gjinive të ndryshme.

---

[1] Perandori i ardhshëm Konstantini I.
[2] I njohur si Maksimin Daja.
[3] Të ndritshëm.
[4] I biri i Konstantinit të madh, perandori i mëvonshëm Konstantini II.
[5] Prijës got i mundur nga Konstantini në vitin 332.

ISIDORI I HISPALËS

Isidori është i njohur për historinë e tij të gotëve, vandalëve dhe suevëve (Historia Gothorum, Vandalorum, Sueborum), si edhe për një kronikë të gjerë (Chronica Maiora), ku përfshiheshin ngjarje të ndryshme që nga krijimi i botës e deri në vitin 615. Ai lindi aty nga viti 560 i e. sonë në qytetin e Kartagenës në Spanjë dhe vdiq më 636 në Hispalë (Sevilja e sotme në Spanjë), ku ai shërbeu edhe si peshkop i këtij qyteti. Si burime historike Isidorit i kanë shërbyer vepra të mëparshme, ndër të tjera edhe historia e Eutropit.

Në pjesët e zgjedhura prej nesh bëhet fjalë për vërshimin e gotëve dhe hunëve në Ilirik.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Th.Mommsen, Isidori Junioris episcopi Hispalensis Historia Gothorum, Vandalorum, Sueborum, Monumenta Germaniae Historica, AA, XI, I, Berolini 1891.

ISIDORI HISPALENSIS

HISTORIA GOTHORUM VANDALORUM SUEBORUM

(Historia e gotëve, vandalëve, suebëve)

1. Historia e gotëve

4 Në vitin 294 të erës[1], viti i parë i sundimit të Valerianit dhe Galienit[2], gotët u dyndën nga Alpet, ku banonin dhe shkretuan Greqinë, Maqedoninë, Pontin, Azinë dhe Ilirikun. Nga këto vende ata pushtuan Ilirikun dhe Maqedoninë pothuaj për 15 vjet. Më vonë, të mundur nga perandor Klaudi, ata u kthyen në vendet e tyre...

2. Historia e vandalëve

76 Perandori i Lindjes Theodosi i ri[3], pregatiti luftën kundër tij[4], por kjo nuk u bë, për arsye se hunët shkretuan Thrakinë dhe Ilirikun, kështu që ushtria e dërguar kundër vandalëve u tërhoq nga Siçilia për të mbrojtur thrakët dhe ilirët.

---

[1] Vitet në veprën e Isidorit të Hispalës janë dhënë sipas numërimit hispanjoll të viteve, i cili merrte për vit fillestar vitin 38 para e. sonë.
[2] Valeriani dhe Galieni e morën pushtetin në vitin 253 dhe jo në 256, siç del nga ajo që u tha në shënimin 1.
[3] Theodosi II (408-450).
[4] Kundër mbretit vandal Genzerih (427-450).

THEOFILAKT SIMOKATA

Theofilakt Simokata, me prejardhje nga Egjipti, u vendos në Konstantinopol në kohën e perandorit Herakli (610-641). Ndër shkrimet e dala nga dora e tij vlen të përmendet vepra historike, që mban titullin "Historiae" (Historitë ose Historia botërore) e përbërë nga 8 libra. Në të vërtetë vepra e tij është një vazhdim i historisë së Menandrit, mbasi i përshkruan ngjarjet historike aty ku i ndërpret Menandri, me fjalë të tjera flet për ato ndodhi, që zhvillohen gjatë sundimit të Maurikut (582-602).

Vepra historike e Theofilakt Simokatës, megjithë të metat e saj, sidomos përsa i përket pasaktësive kronologjike, është burimi më i çmueshëm për kohën e perandorit Maurik si edhe për studimin e dyndjeve avare e sllave në Ballkan në fund të shek. VI.

Ashtu si historianët e tjerë bizantinë edhe Theofilakt Simokata ka shfrytëzuar burime më të lashta historike si Prokopin e Cezares, Menandrin, etj., por është mbështetur veç kësaj edhe në dokumenta zyrtare e tregime gojore.

Pjesët e zgjedhura prej nesh bëjnë fjalë për sulmet e hordhive avare brenda trevës së prefekturës së Ilirikut për pushtimin e qyteteve Sirm, Singidun, etj.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Theophylacti Simocattae Historiae, edidit Carolus de Boor. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri 1887.

THEOPHYLACTI SIMOCATTAE

HISTORIAE

(Historitë)

LIBRI I

3 Duke filluar tani të end pëlhurën e historisë dhe të përshkruaj luftërat barbare, po përmend së pari fushatën kundër barbarëve në një mënyrë të tillë, që t'i përgjigjet më mirë ngjarjeve, dhe të jetë më e frytshme për renditjen.

Dhe kështu në atë kohë, shumë gjëra qenë ndërmarrë prej tyre me mjaft mendjelehtësi. Ata janë hunë[1], jetojnë pranë Istrit dhe janë nga më të pabesët dhe më të pangopurit ndër popujt që bëjnë një jetë endacake. Ata dërguan delegatë te perandori Mauriku, pasi u bënë zotër të qytetit më të madh. Ai quhej Sirm dhe ishte qytet shumë në zë, i lavdëruar dhe i përmendur nga romakët që banojnë në Evropë.

Qe pushtuar jo shumë kohë para se perandori Mauriku, duke veshur purpurën dhe duke hypur në fronin e perandorëve, mori mbi vete barrën e kujdesjeve për perandorinë e romakëve. Dhe si ndodhi kjo është thënë me saktësi nga i përmenduri Menandër... Pasi qyteti u ndodh në duart e hunëve, u përfundua një marrëveshje për paqe në mënyrë që të zhdukeshin armiqësitë dhe popujt të merreshin në qetësi me punët e tyre...

Por paqja nuk zgjati më tepër se dy vjet, pasi i ashtuquajturi hagan te hunët u soll kryelartë kundrejt romakëve. Para se të prishej paqa, arriti tek ai një farë lajmi, se tek perandori rriteshin kafshë shumë të çuditshme për madhësinë dhe trupin. Për këtë arsye ai kërkoi nga perandori që t'i jepet mundësia t'i shohë. Perandori menjëherë e kënaqi kureshtjen e tij dhe i dha mundësi që të shohë elefantët, duke i dërguar më të shquarin nga këto kafshë, që rriteshin tek ai... Ai e shqetësoi perandorinë gjithashtu me kërkesën e tij për t'i dërguar krevat të punuar prej ari: sukseset e mëdha të arritura prej tij e bënë shumë kryelartë. Perandori ia dërgoi këtë dhuratë, pasi e punoi në mënyrë mbretërore. Por kryelarti u tregua akoma më mendjemadh sikur të ishte i fyer nga dhurata jo e denjë, dhe me kryelartësi ia ktheu perandorit krevatin e artë si një diçka të thjeshtë dhe me pak vlerë. Për më tepër ai kërkoi nga romakët që t'i paguanin akoma dhe njëzetmijë monedha ari mbi tetëmbëdhjetëmijë të caktuara që më përpara[2]. Dhe kur perandori, kuptohet, kundërshtoi, ai i prishi marrëveshjet dhe i hodhi në erë betimet e tij.

4 Dhe kur ngriti borinë aq të dashur në luftë, mblodhi menjëherë ushtritë e tij dhe papandehur pushtoi qytetin Singedon, që ishte i paforcuar dhe mbetur pa makina luftarake, sepse, për arsye të paqes, e gjithë Thrakia rronte në një çkujdesje të plotë.

---

[1] Këtu Simokata ka parasysh avarët, të cilët i quan hunë.

[2] Me këto kërkesa arriti në Konstantinopol përfaqësia e haganit, në Maj të vitit 583.

Paqja i kishte bërë njerëzit të pavëmendshëm dhe jo largpamës, kurse pakujdesia e
2 karakterizonte pjesën më të madhe të qytetarëve, të cilët për shkak të korrjes gjendeshin nëpër fusha. Ishte verë dhe ata mblidhnin drithëra aq sa të jetonin. Por
3 barbari nuk e zaptoi qytetin pa luftë, pasi u bë një përleshje e madhe pranë dyerve të qytetit, ku u vranë shumica e avarëve, kështu që ata patën, si të thuash, një fitore kadmike. Ata plaçkitën dhe shumë qytete të tjera fqinje bile fare lehtë dhe pa
4 mundim. E keqja qe e paparë dhe krejtësisht e papritur. Barbari, pasi shkatërroi Augustën dhe Viminacin (këto janë qytete të përmendura, q ëi paguajnë taksat e tyre provincës ilire) menjëherë u drejtua për në betejë, shkretoi Anhialin dhe shkatërroi fshatrat për rreth.

LIBRI VI

9 **3** Hagani nga ana e tij kërkoi nga perandori që të vazhdonte paqja. Por meqenëse perandori nuk i dha rëndësi fjalëve të barbarit, ky menjëherë filloi përsëri luftën. Hagani urdhëroi skllavenët të ndërtonin shumë anije që të mund të kalohej Istri.

1 **4** Por banorët e Singedonit me sulme të menjëhershme shkatërruan atë që kishin
2 bërë skllavenët dhe me zjarr bënë që të dështonin përpjekjet e tyre për të ndërtuar mjete lundruese. Si rrjedhim i kësaj, barbarët rrethuan Singedonin. Qyteti arriti në një gjendje shumë të keqe dhe kishte shpresa shumë të pakta për shpëtim. Por në
3 ditën e shtatë Hagani urdhëroi barbarët ta lënë rrethimin dhe të vinin tek ai. Barbarët kur dëgjuan këtë e lanë qytetin, por pasi morën për çlirimin dymijë dareika ari, rrobe dhe një tryezë të stolisur me ar. Hagani pas kësaj kaloi pesë parasangë[1] vendosi
4 lëmin pranë Sirmit, dhe i detyroi shumë skllavenë të nxirrnin lëndë për të pregatitur anije, me të cilat do të kalonin lumin e quajtur Sao... Me fjalë të tjera kur anijet qenë
5 gati, barbarët kaluan me to lumin e afërm. Hagani pasi rreshtoi për luftim një njësi
6 ushtrake, e urdhëroi atë që të shpejtojë përpara dhe të bëjë një sulm të tmerrshëm në tokën e romakëve...[2]

LIBRI VII

1 **10** Në të dhjetën ditë (pasi ne do të kthehemi prapë tek punët e Priskut) erdhën lajmëtarë në shatoren e strategut. Prisku mësoi se barbari kishte shkatërruar muret e Singedonit dhe detyruar banorët të braktisnin shtëpitë e tyre dhe të hidheshin në
2 tokën armike. Atëherë ai, pa asnjë vonesë, lundroi nëpër lum deri në ishullin Singan dhe zbriti aty. Ky ishull gjendet në mes të Istrit dhe është larg nga qyteti Singedon
3 tridhjetë milje. Prisku, pasi rrethoi ishullin me ushtri, arriti afër Konstantiolës me ndihmën e anijeve të shpejta, të cilat shumica e njerëzve i quajnë dromone. Në këtë
4 vend strategu ndeshi haganin dhe hyri në bisedime me barbarin për çështjen e Singedonit. Ata biseduan, duke qëndruar barbari në breg të lumit, kurse Prisku në barkë. Thonë se hagani filloi bisedën, duke pyetur Priskun: "Ç'doni ju, o romakë
5 këtu në tokën time? Pse shtrini këmbët më tepër se sa duhet? Istri është i huaj për ju, valët e tij i keni armiq. Ne e pushtuam atë me armë. Me heshtën tonë e nënshtruam atë. Hiq dorë o Prisk nga veprimi yt i çmendur. Mos prish qetësinë që e keni fituar me shumë dhurata. Respekto marrëveshjet, vigjilo që të mbahen betimet".

---

[1] Parasange = 30 stade.
[2] Ky sulm u bë në vitin 593.

1 **11** Thonë se Prisku iu përgjigj haganit si më poshtë: "O njeri, ti kryen padrejtësi
kundrejt qytetit Singedon. Ti, pasi rrëzove muret, i detyrove qytetarët fatkeqë që të
2 shpërngulen. Ki mëshirë për qytetin, i cili shumë herë ka qenë shkretuar nga ti. Vëri
6 kufi lakmisë sate..." Por hagani i zemëruar i ndërpreu fjalën dhe iu kërcënua se do të
shkatërronte dhe shumë qytete të tjera. Dhe kështu barbari la vendin, ku kishte
qëndruar, dhe u kthye në shatoren e tij. Kurse Prisku, pasi thirri Guduinin dhe i dha
ushtri romake, e urdhëroi që t'i shkonte në ndihmë Singedonit. Dhe kështu Guduini
7 lundroi në drejtim të këtij qyteti. Dy lumenj rrethojnë Singedonin - Sao dhe Drao.
Kur barbarët rreth Singedonit, panë se ushtritë romake po afroheshin me anije,
grumbulluan karrot para qytetit dhe e forcuan atë. Por me që nuk i qëndruan dot
8 sulmit të romakëve, dhe përveç kësaj me që kishin frikë nga popullsia e qytetit,
barbarët u vunë në ikje. Dhe kështu Prisku shpëtoi qytetin fatkeq. Të nesërmen
romakët rrethuan qytetin me mure. Por hagani u zemërua për këtë dhe meqenëse e
9 ndjente veten shumë të prekur, dërgoi lajmëtarë tek Prisku dhe haptazi i hodhi
poshtë marrëveshjet[1]. Në të dhjetën ditë barbari pasi mblodhi ushtritë e tij nën
kushtrimin e borisë u nis në marshim për në gjirin e Jonit.

1 **12** Në këto vende gjendet krahina e Dalmatisë. Barbari pas shumë ndalesash, arriti
në të ashtuquajturin Bonki. Dhe pasi pushtoi qytetin me makina luftarake shkatërroi
2 dyzet kala. Duke dëgjuar këto tmerre, strategu i dha Guduinit dymijë luftëtarë dhe e
dërgoi për të parë se ç'po ndodhte. Guduini i mori me vete ushtarët e zgjedhur dhe u
3 nis. Ai u largua nga rrugët e gjera dhe udhëtoi nëpër vende të vështira dhe udhë të
panjohura. Ai kishte frikë se mos binte në ndonjë fatkeqësi nëqoftëse do ta zbulonte
armiku, i cili kishte me vete hordhi barbarësh. Dhe kështu, kur iu afrua barbarëve, pa
nga një post i fshehur vëzhgimi se po kalonte ushtri e madhe. Ai dërgoi tridhjetë
4 këmbësorë, të cilët i urdhëroi që të ndiqnin armikun. Romakët kaluan nëpër një rrugë
të tërthortë. Në kohën e rojes së dytë të natës, ata zunë pritë dhe po vëzhgonin
barbarin nga një vend i fshehtë. Me fjalë të tjera romakët të fshehur në pyll sulmuan
5 me guxim, në mesnatë, barbarët që flinin. Në një largësi prej dy milje ata ndeshën në
tre burra që nuk u kishte dalë akoma pija, i kapën dhe i pyetën, aq sa kishin mundësi,
6 dhe mësuan për të gjitha planet e armikut. Romakët i lidhën dhe ia dërguan gjallë
Guduinit. Kur taksiarhu Guduin mësoi nga ata se hagani kishte ngarkuar dymijë
7 ushtarë për të ruajtur plaçkën e luftës, u gëzua për këtë lajm dhe u fsheh në një
përrua. Barbarët nga ana tjetër, kur zbardhi dita qëndruan për të ruajtur plaçkën,
kurse Guduini u doli në shpinë të tyre, i sulmoi papandehur dhe i vrau që të gjithë
8 me heshta. Pasi shpëtoi përsëri plaçkën, ia dërgoi me madhështi të madhe Priskut.
Kurse hagani, kur e mori vesh këtë humbje, u hidhërua shumë. Pastaj romakët dhe
9 barbarët që banonin pranë Istrit, për më tepër se tetëmbëdhjetë muaj, nuk bënë asgjë
që vlen të përshkruhet.

LIBRI VIII

9 **1** Pasi hagani (le të kthehemi tek ngjarja e Evropës) kaloi Istrin për t'u kthyer në
vendin e tij, meqenëse ishte përfunduar paqja, ushtritë romake në Thraki dërguan
delegatë tek perandori Maurik, për të akuzuar strategun Komentiol për tradhëti...
10 Me të vërtetë proçesi u ngrit, por perandori ua mbushi mendjen delegatëve, duke iu
lutur që të heqin dorë; padija u pezullua dhe Komentioli përsëri u bë strateg.

---

[1] Në vitin 596.

11 Kur erdhi vera, Komentioli doli nga kryeqyteti dhe pasi romakët u pajtuan me strategun, me të cilin ishin zemëruar për shkak të vuajtjes që ai u kishte sjellë, mblodhi ushtrinë, erdhi pranë lumit Ister dhe në Singedon u bashkua me Priskun[1]. **2.**
1 Në të katërtën ditë ushtritë u thirrën në mbledhje dhe pasi foli Prisku, paqja në mes të avarëve e romakëve u prish, sepse perandori Maurik urdhëroi strategët që të prishin marrëveshjen me vendim perandorak. Dhe kështu, pasi mori fund paqja,
2 romakët erdhën pranë Viminacit, ishull në lumin Ister. Me sa duket, në këtë ishull Komentioli u sëmur. Ndërsa romakët kaluan nga ishulli në tokë, hagani mësoi për
3 lëvizjen e ushtrisë romake. Atëherë barbari mblodhi ushtri dhe filloi të shkretojë tokën e romakëve, kurse katër bijve të tij i dha ushtri dhe i porositi që të ruanin brigjet e Istrit. Të bijtë e barbarit sipas urdhërit u morën me ruajtjen e brigjeve të
4 Istrit, por romakët ndërtuan trape dhe të gjithë së bashku hodhën lumin. Në breg të lumit u zhvilluan luftime dhe romakët i mundën ushtritë e armikut. Komentioli, nga ana tjetër, bashkë me Priskun qëndronte në Viminac. Ai me plotë të drejtë hoqi dorë
5 nga pjesëmarrja në luftime... Me fjalë të tjera, edhe pse romakët kaluan Istrin dhe
6 ngritën lëmin në atë anë të lumit, Prisku nuk e lëshoi ishullin sepse nuk donte të luftonte pa Komentiolin. Kurse barbarët sulmuan lëmin e tyre, për derisa ushtria
7 romake ishte pa strateg. Romakët dërguan lajmëtarë në Viminac tek strategët dhe u treguan për rrezikun. Prisku nuk donte të ndërmerrte asgjë pa Komentiolin, por meqenëse sulmi barbar qe shumë i tmerrshëm, ai vendosi të linte Komentiolin dhe të
8 kujdesej vetë për largimin e rreziqeve. Ai la Viminacin dhe erdhi në lëmin e romakëve. Ditën e dytë urdhëroi që anijet të lënë brigjet e Istrit dhe të vendosen rreth
9 Viminacit. Prisku kishte frikë se mos romakët e bregut të lumit, duke pasur anije, do të kalonin shpesh për në ishull dhe kështu ushtria romake, duke u shpërndarë në grupe të vogla do të linte lëmin me përforcime të dobëta. Meqenëse barbarët
10 pregatiteshin me nxitim për luftë, në ditën e katërt, në mëngjes herët, Prisku urdhëroi romakët të armatosen dhe, mbasi i rreshtoi ushtritë e tij në tri falanga, priti sulmet e para të armiqve. Duke mos pasur harqe, romakët hynë në luftime me barbarët me
11 heshta, në afërsi. Avarët ndanë ushtritë e tyre në pesëmbëdhjetë njësi të veçanta, kurse romakët, të frikësuar për lëmin e tyre, u rreshtuan në rradhë të dendura, të gatshëm për të pritur sulmin nga çdo anë, dhe me këtë siguruan lëmin dhe bënë luftë
12 për shumë orë. Kur dielli po përëndonte fitorja filloi të anonte nga njëra anë dhe kjo në dobi të romakëve; u vranë vetëm treqind romakë, kurse nga avaret katër mijë. Me t'u bërë natë, romakët u kthyen në lëm.
1 **3** Në ditën e tretë barbarët përsëri filluan të pregatiten për luftë. Nga ana e tij Prisku rreshtoi sa qe në gjendje ushtrinë dhe që në mëngjes doli në luftë. Ai i rreshtoi
2 forcat romake shumë mirë, duke i ndarë ato në tri pjesë, në luftë. I nxiti ato që të luftojnë me trimëri, dhe të prisnin avarët duke zgjatur krahët, në mënyrë që barbarët të binin në një fatkeqsi të papritur, kur ushtria të formonte gjysmë rrethi dhe t'i
3 mbyllte në mes. Në këtë mënyrë barbarët ranë në këtë grackë dhe u vranë nga forcat kundërshtare nëntë mijë vetë. Në përëndim të diellit ushtria fitimtare u kthye në lëm.
4 Në ditën e dhjetë strategu dëgjoi se barbarët përsëri kaluan në sulm. Në agim të ditës pasi armatosi dhe rreshtoi si duhet ushtrinë romake, marshoi në luftë. Prisku përsëri
5 rreshtoi ushtrinë në tri falanga, kurse barbari, pasi rreshtoi një falangë, u lëshua mbi Priskun. Prisku, si zgjodhi në këtë vend pozicionin më të mirë dhe i ndihmuar nga drejtimi i erës, u lëshua nga lart kundër avarëve dhe u fut në betejë

[1] Në verë të vitit 600.

6 kundër armikut me të dy krahët. Meqenëse në këto vende qe një liqen, ai shtyu barbarët drejt ujërave të tij. Kështu barbarët, të shtyrë drejt liqenit ranë në fatkeqësi
7 dhe u mbytën në mënyrë të tmerrshme. Shumë prej tyre, midis të cilëve dhe fëmijët e haganit, u mbytën në këtë liqen, kurse Prisku korri një nga fitoret më të shkëlqyera të
8 tij. Në këtë përpjekje u vranë pesëmbëdhjetë mijë barbarë. Vetë hagani, që shpëtoi me rrezik të madh për vete, u drejtua tek lumi Tisa. Në të tridhjetën ditë barbari mblodhi ushtrinë dhe kur filloi për herë të katërt të pregatitet për sulm dhe kur Prisku, strateg i romakëve, dëgjoi për këtë ai vendosi lëmin buzë lumit Tisa. Dy
9 ushtrive iu caktua dita për luftim. Kur u afrua dita e caktuar, në të zbardhur të dritës Prisku rreshtoi ushtrinë e tij në mënyrë të kundërt dhe falangën e majtë e bëri të djathtë, kurse të mesmen ai e vuri në krah të majtë. Barbari nga ana e tij armatosi
10 dhe i ndau luftëtarët në dymbëdhjetë njësi. Romakët luftonin me shumë guxim. Ata u përleshën me vendosshmëri kundër barbarëve; në këtë luftë ranë shumë armiq.
11 Dhe kështu romakët korrën këtë fitore të lavdishme. Prisku rreshtoi katër mijë vetë dhe i urdhëroi ata të kalojnë Tisën dhe të vëzhgojnë lëvizjet e armiqve. Të dërguar nga strategu ata kaluan lumin fqinj. Aty ata ranë në tre fshatra të gepidëve. Barbarët nga ana tjetër, duke mos ditur asgjë nga ngjarjet e ndodhura një ditë më parë, kishin
14 organizuar një gosti dhe festonin një festë të tyre. Ata u dhanë pas pijes dhe kaluan gjithë natën, duke pirë. Në këtë ditë, pa zbardhur drita akoma, në orët e fundit të natës romakët ranë mbi barbarët e dehur dhe bënë një përgjakje të tmerrshme: ata
13 zhdukën tridhjetëmijë barbarë[1]. Pasi morën një numër të madh robërish kaluan prapë lumin dhe ia dorëzuan Priskut plaçkën e luftës. Në të njëzetën ditë barbari përsëri mblodhi forcat pranë këtij lumi. Prandaj Priskut iu desh të kthehej përsëri tek lumi Tisa. Dhe në këtë vend u bë lufta më e madhe dhe më e përmendur. Barbarët
14 pasi pësuan, si të themi, një humbje të tmerrshme atë ditë u mbytën në ujrat e lumit; së bashku me ta u mbyt dhe një numër i madh skllavenësh. Pas humbjes u kapën të
15 gjallë barbarët dhe u kthyen në rob tre mijë avarë, gjashtë mijë e dyqind barbarë të tjerë dhe tetëmijë skllavenë. Këtyre robërve iu vunë prangat dhe strategu i dërgoi barbarët e kapur, si plaçkë lufte, në qytetin Tomi. **4** Atëherë hagani, para se
1 perandori të merrte vesh për ato që ndodhën, dërgoi të deleguar tek Mauriku për t'u përpjekur të tërheqin mbrapsht robërit. Mauriku, i trembur nga kërcënimet e barbarit
2 dhe i gënjyer nga fjalët etyre, i dha urdhër me letër Priskut t'ia kthejë haganit avarët e kapur rob. Në këtë mënyrë, barbarët i qenë dhënë nga Tomi haganit. Komentioli, si të ish zgjuar nga ndonjë ëndërr e gjatë, u duk sikur ishte shëruar nga sëmundja. Dhe
3 kështu ai shkoi në Nove dhe pasi mblodhi aty disa nga banorët vendas u kërkoi që t'i jepnin udhëheqës, për të kaluar nëpër të ashtuquajturën rrugë të Trajanit[2], meqenëse ai donte të kalonte dimrin në Byzant. Banorët vendas i kundërshtuan Komentiolit t'i tregonin këtë rrugë. Ai i tërbuar nga kjo, vrau dy nga ata që kundërshtuan. Atëherë
4 banorët e Noves i thanë Komentiolit se ata nuk kishin njeri që të mund t'i tregonte këtë rrugë, por sipas tyre dymbëdhjetë milje prej këtej ishte një plak i vjetër njëqind e dymbëdhjetë vjeçar, që e dinte rrugën ushtarake të të ashtuquajturit perandor Trajan. Atëherë strategu Komentiol shkoi në vendin e treguar dhe kërkoi nga plaku që ta udhëhiqte në këtë udhëtim. Por plaku u lëkund, u zemërua dhe e paralajmëroi
5 strategun se ndërmarrja e tij ishte shumë e vështirë, e vuri në dijeni atë se rruga ishte e vështirë dhe e papërshtatshme për t'u kaluar gjatë dimrit, sepse nuk ka

[1] Numri i të vrarëve është zmadhur shumë.
[2] Kjo rrugë bashkon Noven me Filipopolin.

6 qenë rrahur prej nëntëdhjetë vjetësh. Por strategu i kundërshtoi fjalëve të plakut dhe
7 meqenëse fitoi vendimi i paarsyeshëm, ushtritë romake u nsën në këtë udhëtim. Dhe
ja ndodhi që në këto ditë bëri një i ftohtë i madh i jashtëzakonshëm, çdo gjë u
mbulua me akull të trashë dhe, meqenëse u ngrit edhe një erë e fortë që të thante,
shumë prej ushtarëve romakë vdiqën; ngordhi edhe pjesa më e madhe e kafshëve
7 bartëse. Në këtë gjendje të vajtueshme Komentioli arriti me vështirësi në Filipopol.
Aty kaloi gjithë stinën e dimrit dhe kur afroi pranvera erdhi në Byzant[1]. Në verë
9 Mauriku e emëroi përsëri atë strateg. Në vitin e nëntëmbëdhjetë të sundimit të
perandorit Maurik[2], midis romakëve dhe barbarëve nuk ngjau asgjë. Kurse në vitin e
njëzet perandori Maurik vendosi si strateg në Evropë vëllain e tij, Petrin.
5 **5** Kështu strategu Peter, pasi mblodhi ushtrinë u drejtua për në Ister dhe arriti në
Pelastol, ku vendosi lëmin. Këtu ai kaloi gjithë stinën e verës. Në fillim të vjeshtës[3]
strategu kaloi në krahinën e Dardanisë...

[1] Në dimër të vitit 600-601, pranvera e vitit 601.
[2] Viti i nëntëmbëdhjetë i sundimit të perandor Maurikut nga 4 gusht 600 deri me 13 gusht 601.
[3] Vjeshta e vitit 601.

ANONIMI I RAVENËS

Nga fundi i shek. VII apo fillimi i shek. VIII u shkrua nga një autor i panjohur vepra me përmbajtje gjeografike, që njihet me emrin "Cosmographia" (Përshkrimi i botës). Dihet vetëm se ky autor i panjohur ishte nga Ravena e Italisë dhe prandaj u quajt Anonimi i Ravenës. Kosmografia përbëhet prej 5 librash dhe përmbledh një listë prej 5300 emrash gjeografikë që njiheshin në botën e asaj kohe. Kujtohet se në përpilimin e Kosmografisë autorit të panjohur i ka shërbyer si model ndonjë hartë e botës antike e shek. V e VI, e përngjashme me Tabelën e Peutingerit apo me Itinerarin e Antoninit. Janë shfrytëzuar prej tij edhe veprat e Orosit, Jordanit, Isidorit të Hispalës, etj.

Kosmografia e Anonimit të Ravenës përmend shumë emra gjeografikë të Ilirisë, një pjesë të mirë të të cilave e njohim edhe nga burime tjera. Për fat të keq disa nga këto emra na kumtohen në trajtën e një latinishteje të vulgarizuar, ndërsa një pjesë tjetër jepen të gjymtuar, gjë që krijon shpeshherë vështirësi për identifikimin e tyre.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Itineraria Romana, volumen alterum, Ravennatis Anonymi Cosmographia et Guidonis Geographica edidit Joseph Schnetz. Lipsiae in aedibus B.G.Teubneri, 1940.

RAVENNATIS ANONYMI

COSMOGRAPHIA

(Përshkrimi i botës)

IV 8 Më tutje afër Myzisë së Dytë[1] gjenden dy vende që quhen Epir dhe Pelagonia. Shumë mendimtarë i kanë përshkruar këto vende. Por unë i shënova sipas dijetarit grek Aristarh. Ne lexuam se në këto /vende/ kishte disa qytete nga të cilët duam të shënojmë disa dhe pikërisht:

16 Delfi	(Delfi)
17 Evenos	(Figjori)
1 Actia Nicopolis	(Preveza)
2 Rotaroio	(Butrinti)
3 Ponice	(Finiqi)

Nëpër këtë vend rrjedhin shumë lumenj dhe pikërisht

6 Calidon	(Kalidoni)
7 Evenos dhe	(Fidaris)
8 Achilois	(Aspropotami)

9 Gjithashtu, pikërisht pranë kësaj krahine Epir gjendet vendi shumë i përmendur që quhet Maqedoni. Nga ky vend kanë prejardhjen e tyre shumë dijetarë shkrimtarë. Në mes të tyre unë kam lexuar Livanin e sipërpërmendur, Hylasin dhe Aristarhun, dijetarë grekë dhe shumë herë të përmendurin Kastorin, Lolianin dhe Arbitionin - dijetarë romakë. Ata nuk e kanë shënuar njëlloj këtë vend, por secili flet ndryshe dhe secili në mënyrë të ndryshme. Por unë i përmenda qytetet e poshtëshënuara të kësaj Maqedonie sipas të sipërpërmendurit Aristarh.

Lexojmë se në këtë Maqedoni ka shumë qytete, midis të cilëve duam të përmendim disa më të rëndësihmit. Pikërisht pranë Detit të Madh[2] gjendet qyteti, i cili quhet:

9 Neapolis	(Kavala) gjithashtu dhe
10. Philippi	(Në mes Kavalës e Dramës)
11. Amphipolis	(Neohori)
12. Apollonia	(Polina)
13. Melisurgi	(Melisurgion)
14. Thesalonici	(Selaniku)
15. Pella	(Postoli)
16. Beroea	(Verria)
17. Acerdos	(pranë Karavi-Sadinës, rrethi i Verrisë)

[1] Këtu bëhet fjalë për Myzinë e Sipërme.
[2] Mesdhe.

18. Arulos	(Paleohori)
1. Bata	(Kolindro)
2. Anamo	(Elefterohori)
3. Imera	(Mikroajani)
4. Diume	(Malatri)
5. Sabatum	(në Veri të Platamonit)
6. Stenas	(Demirkapia)
7. Thuris	(I paidentifikuar)
8. Olimpius	(në mes Babës e Bakrinës)
9. Presidi	(" " " " ")
10. Licinium	(Ohri)
11. Ponservili	(Urakë)
12. Candavia	(Babia)
13. Duriana	(I paidentifikuar)

Pastaj, nga ana tjetër, në këtë Maqedoni gjenden qytetet që quhen:

16. Trillon	(Monuhi) gjithashtu edhe
17. Greron	(Korfovuni)
18. Arason	(I paidentifikuar)
1. Euporia	(Orliak)
2. Eraclia antica	(Zervohori)
3. Callicum	(Kufalovo)
4. Tauriana	(Dojran)
5. Idomenia	(Milet Kovo)
6. Stenas	(Demirkapia)
7. Asigonia	(Vojshanci)
8. Edessa	(Vodeno)
9. Celis	(pranë Banjës, rrethi Ostrovës)
10. Euriston	(Farish)
11. Ceramie	(Varosh, pranë Prilepit)
12. Istubera	(Qepigovo)
13. Jeraclea	(Bitolje)
14. Nicea	(Velushina)
15. Presidium	(Kozhle)
16. Fines	(Lepenica)

15 Jo përtej Danubit, por më tepër afër Detit të Madh, gjendet i vendosur vendi që quhet Ilirik. Dhe megjithëse shumë dijetarë përshkruajnë si Ilirik një krahinë shumë të madhe në veri, megjithatë nuk ka dyshim se ky vend quhet Ilirik. Ka shumë dijetarë që e kanë përshkruar këtë vend ilir.
Në mes tyre unë kam lexuar Provinin dhe Marcelin dhe gjithashtu dhe Maksimin dijetar romak. Por unë i caktova qytetet e këtij Ilirikut sipas Maksimit. Lexojmë se në këtë vend të Ilirikut ka shumë qytete, nga të cilët do të shënojmë disa dhe pikërisht:

17. Cubita	(Nagaevci)
18. Ceflon	(pranë Velesit)
19. Nausaron	(Mali Bukovac)
20. Scupis	(Zllokuqene, pranë Shkupit)
1. Acmeon	(Prokuplje)
2. Vindinis	(Poduevo)
3. Beciano[1)]	(Lipian, pranë Prishtinës)
4. Theclana[2)]	(")

[1-2)] Theclana dhe Beclano janë me sa duket forma të ndryshme të një emri të vetëm dhe pikërisht të Ulpianës.

5. Theranda	(Dule)
6. Gebulion	(I paidentifikuar)
7. Crebenis	(Spas, në lumin Drin)
8. Lisson	(Lezhë)
9. Nesi	(Nish)
10. Gloditana	(Peqin)

Pastaj në vetë Ilirikun, nga ana tjetër pranë Detit të Madh, gjenden këto qytete:

13. Aulona	(Vlora)
14. Absura	(I paidentifikuar)
15. Durachium	(Durrësi)
16. Plistum	(Ishmi)
17. Lissum	(Lezhë)

Nëpër këtë vend të Ilirikut rrjedhin lumenj të ndryshëm, në mes të cilëve janë edhe këta:

3. Evenus	(Fidaris)
4. Acielous	(Aspropotami)
5. Alosus	(")
6. Apsis	(Semani)
7. Genesis	(Shkumbini)

16 Gjithashtu pranë vetë Ilirikut, gjatë bregdetit, është një vend që quhet Dalmati. Ajo shtrihet që nga gjiri perëndimor. Shumë dijetarë e kanë përshkruar Dalmatinë, nga të cilët unë lexova dijetarët e lartpërmendur Probinin, Marcelin dhe Maksimin, por jo të gjithë njëlloj i përmendin këto Dalmati[1]. Por unë i shënova qytetet e poshtëshënuara të së njëjtës Dalmati, sipas Maksimit. Lexojmë se në Dalmati ka shumë qytete nga të cilët ne duam të përmendim disa nga ato që gjenden gjatë bregut të detit dhe pikërisht:

3. Burzumi	(Brica)
4. Aleta	(Komani, afër Podgoricës)
5. Saluntum	(Pranë Danilogradit)
6. Butua	(Budua)
7. Decadaron	
8. Buccinium	(Ulqini)
9. Rucinium	(Kotorri)
10. Epitaurum, d.m.th. Ragusium	(Dubrovniku)
11. Asamon	(Slani)
12. Zidion	(Trebinja)
13. Pardua, d.m.th. Stammes	(Jakovo)
14. Turres	(Utovo)
15. Narrona	(Vidi)
16.	
17. Biston	(afër Podgoracit)
1. Aronia, d.m.th. Mucru	(Macarska)
2. Oneo	(Ahnisa)
3. Netrate	(Zoljevica)
4. Petinitis	(Podstrana)

[1] Autori gabimisht mendon, me sa duket se Dalmatia ishte e ndarë në shumë pjesë.

5. Epitio	(Afër Stobrecit)
6. Umone, d.m.th. Musaro	
7. Gedate	
8. Spalation	(Split)
9. Salona	(Solin)
10. Siclisi	(Stafileo)
11. Tragurion	(Trogir)
12. Bausiona, d.m.th. Orido	
13. Pretorimo Cesaris	(pranë Baljina Glavica)
14. Arausione	(Bribiri)
15. Tabia	
16. Scardona	(Skardona)
1. Impletus	
2. Erausina	(Bribiri)
3. Nedisso	(Gradino)
4. Iader	(Zara, Zadar)

Gjithashtu edhe nga ana tjetër përtej ka qytete. Pikërisht pranë qytetit të lartpërmendur Naronë gjendet qyteti që quhet:

8. Bigeste	(Humaq)
9. Aufustianis	(Trihaljina)
10. Novas	(Runoviçi)
11. Julianum	(Lokviçiçi)
12. Tilurion	(Trilji)
13. Ponteluri	(Pranë Triljit)
14. Equon	(Citnik, pranë Sinjit)

Gjithashtu nga ana tjetër përtej ka qytete:

17. Decimin	
18. Endetrio	(Muqi)
1. Magnum	(Bjalina Glavica)
2. Promon	(fshati Teplju, pranë Dervishit)
3. Adrise	
4. Arberie	
5. Seriem	
6. Crambeis	(Dodgradje)
7. Edino	(Starigrad)

Gjithashtu afër Burzumit gjendet qyteti që quhet:

10. Medione	(Meduni)
11. Anderba	(Nikshiqi)
12. Ausustis	
13. Emanio	
14. Sarsiteron	
15. Bistue betus	(Kupresh?)
16. Monte Bulsi	(Në mes Malovandit e Suicës)
17. Libros	
18. Orbam	
19. Naurtio	
20. Epilentio	
21. Novas	

Nëpër këto Dalmati rrjedhin shumë lumenj, në mes të të cilëve ato që quhen:

3. Salon	(Jadar)
4. Margus	(Morava)
5. Drinius	(Drini)
6. Trimus[1)]	(")
7. Narenum	(Narenta)

19 Më tutje, fqinjë të këtij vendi *[Saksonisë]* janë dy vendet që quhen Panoni, d.m.th. e Ulëta dhe e Sipërmja, shumë të hapura në gjerësi dhe gjatësi. Shumë dijetarë i kanë përshkruar këto vende. Në mes tyre kam lexuar shumë herë të përmendurit Kastorin dhe Lolianin e Arbitionin, dijetarë romakë, si edhe të lartpërmendurin Aitanaridin dhe Eldevaldin, gjithashtu edhe Markumirin, dijetarë got. Por ata nuk e kanë përcaktuar në të njëjtën mënyrë pikërisht këtë vend, por njëri kështu, tjetri ndryshe. Por unë i tregoj qytetet e poshtëshënuara të Panonisë sipas të përmendurit Markumir. Lexojmë se në këtë vend ka patur shumë qytete, në mes të cilëve duam të numërojmë disa dhe këto janë:

13. Confluentes	(pranë Beogradit)
14. Taurinum	(Zemuni)
15. Idominio	(Ugrinovci)
16. Bassianis	(pranë Petrievcit)
17. Fossis	(Jarak)
18. Sirmium	(Sremska - Mitrovica)
19. Drinum	(Zvornik pranë L.Drin)
20. Saldis	(Brëçko)
1. Bassantis	(Shamac)
2. Marsonia	(Brod)
3. Mursa maior	(Osek)
4. Mursa minor	(Pterievci)

Më tej, nga ana tjetër, në vetë krahinat e Panonisë gjenden qytetet, prej të cilëve po shënojmë disa dhe pikërisht:

10. Burgenis	(Stari - Banovci)
11. Spaneatis	(Baçinci)
12. Ansilena	(Orolik)
13. Cibalis	(Vinkovci)
14. Certisiam	(Strizhivojna-Vrepole?)
15. Lavares	(I paidentifikuar)
16. Cuminion	(" ")

Nëpër këto Panoni rrjedhin shumë lumenj në mes të cilëve janë dhe lumenjtë me këto emra:

17. Ira	(Muri)
18. Bustricius	(Bistrica?)

Kjo Panoni ka një liqen shumë të madh që quhet Pelsois dhe gjithashtu lumenjtë:

1. Parsium	(I paidentifikuar)
2. Dravis	(Drava)

[1)] Mesa duket "Trimus" është një përsëritje e deformuar e "Drinus".

20 Më tej, pikërisht afër kësaj Panonie gjendet krahina e quajtur Valeria, e cila mban edhe emrin Provinca Media[1] meqenëse gjendet në mes të Panonive të lartpërmendura. Po ata dijetarë që përmendëm më sipër dhe që kanë shënuar krahinat panone, përshkruajnë krahinën Valeria. Por unë i numëroj qytetet e poshtëshënuara të kësaj Valerie sipas shkrimtarit të larpërmendur Markumirit, dijetar got.
Në këtë Valerie, mësojmë se kishte shumë qytete, nga të cilët po shënojmë disa dhe pikërisht:

14. Acunum	(Zlankamena)
15. Usum	(Petervardeu)
16. Malatis	(Banostori)
17. Catio	(pranë Sharengradit)
18. Cornacum	(pranë Vukovarit)
1. Alusione	(Këmlëd)
2. Annama	
3. Clantiburgum	
4. Livori	(pranë Kopaçit)
5. Donatianis	(Keskendi)
6. Antiana	(Batina)
7. Lugione	(Bata)
8. Belsalino	
9. Lumano	
10. Cardelaca	

Gjithashtu në anën tjetër janë qytetet:

13. Sicce	(Sisaku)
14. Fines	(Degoj)
15. Romula	(Kamensko)
16. Nomiudum	(Ozali)
17. Cruppi	(Dernovo)
18. Acerbo	(Vaiselburgu)
19. Atamine	

Kjo Valerie ka qenë pushtuar dikur nga fisi i markomanëve, siç dëshmon shumë i dituri kronograf Jordani, shpesh herë i përmendur më sipër. Një lum shumë i madh që quhet Sao shërben si kufi i kësaj Valerie.

22 Gjithashtu anës Detit të Madh, d.m.th. anës gjirit perëndimor, gjendet vendi që quhet Liburnia Tarsatike, të cilën Liburni e përshkruajnë po ata dijetarë të sipërpërmendur që përshkruajnë edhe vendin Karnih. Por unë i përmenda qytetet e poshtëshënuara të kësaj Liburnie sipas të sipërpërmendurit Markomir, dijetar got. Lexojmë se në këtë vend kanë qenë shumë qytete, nga të cilët duam të shënojmë disa, d.m.th. qyteti:

17. Elona, gjithashtu	
18. Da	(?)
19. Coriton	
1. Argerunto	
2. Bigi	
3. Ospela	(Ortpla)
4. Puplisca	
5. Senia	(Senja, qytet në Dalmati)
6. Turres	(Cerkvenica)

[1] E mesme

7. Raparia	
8. Tharsaticum	(Terseti)
9. Lauriana	(Lovrana)
10 Albona	(Albona)

Gjithashtu përtej ka qytete në këtë krahinën e Liburnisë, d.m.th.

13. Olisa	
14. Tarneum	
15. Abendone	(Cerkvina)
16. Parupion	(pranë Vitaljit?)
1. Ethetia	(Leshqe)
2. Ancus	(Verbaçi)

Gjithashtu afër vetë Liburnisë, në bregun e Detit të Madh gjendet vendi që quhet Ystria, që shtrihet në drejtim të Italisë.

V **13** ... Gjithashtu qyteti i sipërpërmendur Stomis

12. Creusa	(pranë Livadhostrosit)
13. Antheon	
14. Anticera	(Aspraspiçia)
1. Evantia	(pranë Galaxidhit)
2. (Naupastores)	Naupactos (Epakti)
3. Calidon	(?)
4. Evenus	(Fidaris)
5. Acheloum	(pranë Neohorit?)
6. Alosum	(pranë Katokut)
7. Perdoriptum	(Palco halia)
8. Actia Nicopolis	(Preveza)
9. Glicisme	(Shën Johani)
10. Diana	(Në jug të Nishtës)
11. Butaroton	(Butrinti)
12. Penice	(Finiq)
13. Acrocearion	(Llogaraja)
14. Alona	(Vlora)
15. Apollonia	(Pojani)
1. Apsum	(Babunja e Re)
2. Genesis	(Bashtova)
3. Durachium	(Durrësi)

Nga qyteti i përshkruar më sipër që quhet Larisa pothuaj që nga vetë brigjet e detit deri te qyteti që quhet Dyrrah janë gjashtëdhjetë e një qytete dhe numërohen dymbëdhjetë mijë miliare.

14. Gjithashtu qyteti Lissum	(Shkodra)
10. Scodre	(Budua)
11. Butua	
12. Decadoron	
13. Bicinion	(Ulqini)
4. Epitauron	(Dubrovniku)
15. Assidium	(Trebinje)
16. Bretorium	(Prijevori)
1. Turres	(Utovo)
2. Narrona	(Vidi)
3. Pretoria	
4. Biston	(Afër Podgoracit)

5. Aronia	(Macarska)
6. Oneon	
7. Nerente	
8. Ionopen	
9. Spalatium	(Spliti)
10. Dianion	
11. Salona	(Solini)
12. Siclis	
13. Tragurion	(Dubrovniku)
14. Pretorium Cesaris	
15. Pretorium Magnum	(Baljina Glavica)
16. Aurasione	
17. Tambia	
18. Rider	
19. Scardona	
1. Impletus	
2. Arausion	
3. Nedinon	
4. Iadera	(Zadari)
5. Enona	
6. Agit	
7. Corinthon	
8. Argerunton	
9. Bigi	
10. Ospela	
11. Publisca	
12. Senia	(Senja)
13. Turres	(Cerkvenica)
14. Raparia	
15. Tharsaticum	(Terseti)
16. Lauriana	(Lovrana)
17. Albona	(Albona)
18. Arsia	(Arsa)
1. Nesatium	(Altura)
2. Pola	(Pola)
3. Revingo	
4. Parentium	
5. Neapolis	
6. Humago	
7. Sipparis	
8. Silbonis	
9. Pirano	
10. Capris	
11. Tergeste	(Trieste)
12. Adbessicin	
13. Foriulium	
14. Putiolis	
15. Aquileia	

Nga qyteti i lartpërmendur Dyrrah pothuaj që nga brigjet e detit deri te qyteti i përmendur më sipër Ravena janë shtatëdhjetë e shtatë qytete dhe numërohen gjashtëmbëdhjetë mijë miliare.

PAUL DIAKONI

Paul Diakoni lindi në Itali, afërsisht aty nga vitit 720 dhe vdiq po këtu rreth vitit 797. Ai nuk ishte me prejardhje romake, por rridhte nga një familje e shquar langobarde. Rreth vitit 770 shkroi një histori të Romës (Historia Romana) e cila mbështetej kryesisht në veprën e Eutropit dhe për kohën përtej këtij, tek historianë më të rinj si Orosi, etj.

Mbas vitit 787 Paul Diakoni shkroi veprën e tij kryesore kushtuar popullit të vet, historinë e langobardëve (Historia langobardorum). Këtë vepër nuk e përfundoi dot; ngjarjet e përshkruara në të nuk shkojnë prandaj përtej vitit 744. Në hartimin e saj ai përdori veç tregimeve gojore edhe burime të shkruara, ndër të tjerë edhe Bedën.

Në të dy veprat e Paul Diakonit ka të dhëna, megjithëse të pakta e jo krejt të panjohura, që interesojnë edhe historinë e Ilirisë, sidomos për shek. V e VI.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Eutropi breviarium cum versionibus graecis et Pauli Landolfique additamentis, rec. Droysen, Monumenta Germaniae historica, AA, II, Berolini 1879; *Pauli Historia Langobardorum,* Scr. rerum Langobardicarum et Italicarum, saec. VI-IX.

PAULUS DIACONUS

1) HISTORIA ROMANA

(Historia romake)

16 **XIII** Në kohën[1] kur hunët po shkretonin pa mëshirë Thrakinë dhe Ilirikun, ushtria e cila qëndronte në Siçili, u kthye për të mbrojtur provincat lindore.

2 **XIV** Ndërkaq[2] mbreti i hunëve Atila i cili së bashku me vëllanë e tij Blebën[3] sundonte mbi Panoninë dhe Dakinë dhe shkretonte tmerrësisht Maqedoninë, Myzinë, Ahenë dhe dy Thrakitë, humbi vëllanë dhe bashkësundimtarin e tij dhe futi nën pushtetin e vet popujt e tij. Dhe kështu, i mbështetur në ndihmën e popujve më të fuqishëm që i qenë nënshtruar atij, mendoi të zhdukte perandorinë Perëndimore.

2) HISTORIA LANGOBARDORUM

CODICIS GOTHANI

Historia e langobardëve

Nga Kodeksi i Gotëve

2 Dhe atje /në Saksoni/ langobardët, për të parën herë zgjodhën mbretin e quajtur Agelmund... Pastaj ata kërkuan tokë më pjellore për t'u vendosur dhe u hodhën në provincën thrake, u vendosën në qytetet e Panonisë sikur t'i kishin toka të trashëguara. Këtu u ndeshën me abarët[4] dhe pasi zhvilluan me ta shumë luftime të ashpra, pushtuan Panoninë. Atëherë abarët bënë marrëveshje miqësie me langobardët dhe, siç thuhet, qëndruan atje njëzet e dy vjet.

---

[1] Në kohën e luftës së Theodosit II (vitit 441) kundër vandalëve në Afrikë.
[2] Flitet për ngjarjet e viteve 441-445.
[3] Gabim për Bleda.
[4] Gabim për avarët.

ZONARA

Joan Zonara, historian bizantin, jetoi në shek. XI-XII. Në kohën e perandorit Aleks Komnenit u bë komandant i gardës dhe njëkohësisht sekretar i perandorit. Më vonë u tërhoq nga jeta politike dhe administrative dhe u vendos si murg në malin Athos, ku edhe vdiq në vitin 1130.

Zonara shkroi një histori (Epitomae Historiarum) që nga krijimi i botës e deri në vdekjen e Aleksit I Komnen (1118). Në punimin e saj, ai u mbështet në veprat e Herodoti, Ksenofonit, Arrianit, Plutarhut, Dion Kasit, Eusebit, Prokopit, Teofanit, etj.

Historia e Zonarës ka rëndësi për ne mbasi ajo përmban disa njoftime me vlerë për historinë e Ilirisë, të cilat ai i ka nxjerrë nga autorët antikë, kryesisht nga librat e humbura të Dion Kasit.

Përkthimi është mbështetur në botimin:

Joannis Zonarae Epitomae Historiarum cum Caroli Ducangii suisque annotationibus edidit. Ludovicus Dindorfius. Vol I-VI. Lipsiae in aedibus B.G. Teubneri, 1868-1875.

JOANNIS ZONARAE

EPITOMAE HISTORIARUM

(Përmbledhje Historisë)

LIBRI VIII

2 ... Ata /tarantasit/ patën mendime të kundërta midis tyre; ndërsa të kaluarit nga mosha dhe të pasurit kërkonin përfundimin e shpejtë të paqes, të tjerët që ishin më të rinj dhe që kishin pak ose nuk kishin fare pasuri, preferonin luftën; fituan më të rinjtë. Por duke pasur frikë vendosën të thërrasin si aleat Pirro Epirotin, dhe për këtë dërguan tek ai delegatë dhe dhurata. Emili[1], me të marrë vesh këto, plaçkiti dhe shkatërroi vendin e tyre. Ata u dolën përpara romakëve por u tërhoqën, kështu që romakët mundën të pushtonin lehtë vendin e tyre dhe disa kështjella. Një pjesë e mirë nga ata që u kapën gëzuan kujdesin e Emilit dhe disa prej tyre, më të fuqishmit, u liruan; tarantasit u habitën për këtë mirëbërësi dhe shpresuan për një marrëveshje me ta. Ata morën prej romakëve, si komandant të plotfuqishëm, Agin, për të cilin kishin nevojë. Sapo ky u shpall si i tillë, Pirrua dërgoi Kinean për të penguar ato që po ndodhnin atje. Pirrua, i cili mbretëronte në të quajturin Epir, dallohej nga të gjithë për shkathtësinë, për edukatë të gjerë dhe përvojë; pjesën më të madhe të Helladës e kishte bërë për vete me sjellje të mira, ndërsa pjesën tjetër me anë të frikës. Ky si u takua me delegatët e tarantasve, e udhëhoqi drejt aleancën, duke u drejtuar më tepër kundër Siçilisë, Kartagës dhe Sardës. Por ai nguroi të drejtohet menjëherë kundër romakëve dhe u dha fjalën se do t'i ndihmonte ata /tarantasit/, por për të mos krijuar ndonjë dyshim rreth premtimeve, dhe se do t'i kthente menjëherë në shtëpi. Bëri që në marrëveshje të shtohej edhe se ai nuk do të qëndronte në Itali më tepër se sa do të ishte e nevojshme. Si përfundoi këto, pjesën më të madhe të delegatëve i mbajti si peng, kurse disa prej tyre dhe Kinean i nisi bashkë me ushtrinë... Pak më vonë Pirrua dërgoi Milonin me ushtri; duke bërë për vete rojen e kështjellës ai pushtoi akropolin e /Tarantit/. Trantasit u gëzuan për këtë mbasi nuk ishin të detyruar as të bënin roje, as të vuanin nga ndonjë gjë e lodhshme e për këtë ata u jepnin atyre /epirotëve/ ushqime dhe Pirros i dërgonin të holla.

Emili, i cili qysh më përpara gjendej në atë vend, kur mori vesh se arritën ata të Pirros dhe meqenëse për shkak të dimrit nuk mund të priste më shkoi në Apuli.

Pirrua pa pritur pranverën u nis duke marrë me vete ushtri të madhe dhe njëzet elefantë, kafshë që nuk ishin parë më parë në Itali dhe për të cilat mahniteshin dhe çuditeshin. Gjatë kalimit të Jonit, i zënë nga një dimër i madh, humbi shumë ushtarë dhe shumë anije u shpërndanë nga stuhia. Sapo zbriti në

[1] Luc Emili, konsul romak.

tokë erdhi në Tarant dhe menjëhrë i mblodhi ushtarët e tij më të fortë, me qëllim që të mos ishin të ndarë dhe të bënin rrëmujë; mbylli teatrin gjoja për shkak të luftës me qëllim që të mos mblidheshin qytetarët e të ngrinin krye, i ndaloi gjithashtu që të grumbulloheshin në gostira e festime, kurse të rinjtë i urdhëroi që të stërviteshin ose të kalonin ditën në agora. Disa, të mërzitur nga këto, ikën nga qyteti; atëherë ai vendosi roje nga të tijtë në mënyrë që asnjë të mos dilte nga qyteti; tarantasit të rënduar nga këto dhe nga furnizimi i ushtrisë me ushqime dhe meqenëse ishin të detyruar të mbanin në shtëpitë e tyre shtizëhedhësit, ndryshuan mendim duke e quajtur Pirron despot dhe jo aleat. I trembur se mos disa prej atyre që merreshin me punë politike, anonin nga romakët dhe viheshin në krye të popullit, i dërgoi me shkaqe të ndryshme një pjesë tek i biri në Epir, kurse pjesën tjetër e zhduku fshehurazi. Një farë Aristarhu, të cilin e quante si më të mirin e tarantasve, e bëri për vete, me qëllim që ta vinte në dyshim besimin që ai gëzonte në popull; dhe mbasi kjo u besua nga masa, e dërgoi edhe atë në Epir. Pasi ai /Aristarhu/ nuk pati guxim të kundërshtonte, u nis dhe arriti në Romë.

3 Pirrua këto i bënte tek tarantasit, kurse romakët më të mësuar se Pirrua erdhi në Tarant, u trembën si nga lufta që do të bënte kundra tyre në Itali, ashtu edhe për ato që thuheshin për të, se ishte luftëtar i mirë dhe se kishte një fuqi të pathyeshme. Pra rekrutuan ushtarë, grumbulluan të holla dhe dërguan roje në qytetet aleate që të mos shkëputeshin dhe kur kuptuan se disa donin të bënin kryengritje, dënuan prijësat e tyre.

Kundër Pirros dhe tarantasve, si dhe të tjerëve që u bashkuan me të, u dërgua Valer Lavini me gjithë ushtrinë që ishte në Romë. Lavini u nis menjëherë me qëllim që luftën ta bënte sa më larg vendit të tij, duke shpresuar të hutonte Pirron, nëqoftëse do të mund të bënte për vete ata që ai /Pirrua/ kishte ndërmend t'i rrethonte...

Pirrua me të marrë vesh se Lavini ishte duke u afruar, i doli përpara dhe si ngriti lëmin, donte të fitonte kohë për të pritur aleatët. Lavinit i dërgoi një letër në mënyrë krenare për ta habitur; letra shkruante kështu: "Pirrua mbret përshëndet Lavinin. Jam i njoftuar se po sillni ushtri kundër tarantasve, pra, pasi të kesh kthyer prapa ushtrinë eja tek unë. Do t'iu gjykoj unë; nëqoftëse ndonjeri do të bëjë akuza për tjetrin, unë do t'iu detyroj, jashtë vullnetit tuaj, të bëni veprime të drejta..."

Zbuluesve të Pirros që u kapën, Lavini u tregoi forcën e tij dhe pastaj i përcolli. Pirrua, i habitur nga këto lajme, nuk deshi të luftonte sepse edhe disa prej aleatëve nuk u bashkuan me të. Veç kësaj ai nuk shpresonte që gjatë luftës romakëve do t'u mungonin furnizimet. Duke menduar po të njëjtat gjëra, Lavini shpejtonte të ndeshej me të. Meqenëse ushtarët ishin të frikësuar nga fama e Pirros dhe të habitur nga elefantët, ai i mblodhi dhe u foli shumë duke i nxitur që të kenë guxim dhe vazhdoi të pregatitet për t'u ndeshur me Pirron. Ai /Pirrua/ nuk kishte ndërmend të luftonte, por që të mos kujtonin romakët se trembej, u foli njerëzve të tij dhe i nxiti për luftë. Lavini i cili u përpoq të kalonte lumin në drejtim të lëmit u pengua. Mbasi u kthye prapa ai qëndroi me këmësorinë, kurse kalorësinë bëri sikur e dërgoi për plaçkë, duke i dhënë urdhër që të shkonte shumë larg për të kaluar lumin. Në këtë mënyrë ajo u hodh befas në shpinë të armiqve, kurse Lavini, ngaqë armiqtë u tronditën, kaloi lumin dhe filloi betejën. Pirrua duke parë se ushtria e tij po ikte, vrapoi në ndihmë, por e la kalin, meqenëse u plagos, kurse atyre iu duk sikur ai vdiq. Dhe për shkak se disa u ligështuan dhe të tjerë braktisën fushën e betejës, puna ndryshoi. Si kuptoi këtë /Pirrua/ i dha Megakliut veshjen e tij që ishte më e dukshme se e të tjerëve dhe e urdhëroi ta vishte atë e të sillej gjithandej, me qëllim që ta shihnin armiqtë se ai shpëtoi dhe të trembeshin, kurse njerëzit e tij të merrnin guxim.... Në fillim gjatë

gjithë ditës luftuan në mënyrë të barabartë, por kur njëri vrau Megakliun duke kujtuar se vrau Pirron bëri që edhe të tjerët të kujtonin kështu. Nga kjo, romakët morën zemër, kurse kundërshtarët e tyre u trembën. Me të marrë vesh ngjarjen Pirrua hodhi poshtë helmetën dhe u sul me kokë të zbuluar dhe beteja u kthye në të kundërtën. Lavini, si pa këtë, urdhëroi kalorësit, të cilët i kishte në gatishmëri diku jashtë fushës së betejës, të dalin pas shpinës së armiqve. Si kundërveprim Pirrua lëshoi elefantët; nga pamja e frikshme e bishave, nga ulurimat e tyre të tmerrshme dhe nga zhurma e armëve që bënin ata që gjendeshin mbi kullat, romakët u habitën, kuajt e tyre u trembën dhe hodhën poshtë kalorësit, kurse këta të fundit ikën. E ligështuar prej këtyre, ushtria romake tërhiqej dhe duke ikur ata vriteshin nga ushtarët që qëndronin mbi kullat në kurriz të elefantëve, kurse të tjerë u vranë nga feçkat ose dhëmbët e bishave. Por dhe me këmbët e elefantëve u shtypën shumë. Edhe kalorët, duke qëndruar mbi kuaj vranë mjaft, pa humbur shumë, përveç një elefanti i cili u plagos dhe përpëlitej nga plaga, duke trembur të tjerët me ulurimat e tij. Për shkak të kësaj Pirrua qe epror në ndjekje dhe kështu romakët mbasi kaluan lumin, shpëtuan në qytetin Apulia. Shumë ushtarë dhe komandantë të Pirros humbën në këtë luftë. Kështu që duke ju përgjigjur atyre që i dërgonin përgëzime për fitore, thoshte: "Po të kem edhe një fitore të tillë, do të humbas". Romakët, megjithëse i mundi, ai i çmoi duke thënë: "Nëqoftëse bëhem mbret i romakëve atëherë do të kem pushtuar gjithë botën".

4 Pirrua nga kjo fitore mori nam të madh, shumë u bashkuan me të dhe erdhën tek ai si aleatë; mbasi i qortoi pak për ngurrimin u dha diçka nga plaçka.Kurse në Romë u prekën për humbjen. Lavinit i dërguan ushtri, nga ana e tyrrenëve çuan Tiberin dhe në qytet[1] vendosën roje pasi kishin marrë vesh se Pirrua drejtohej kundër tij. Lavini i përcolli të plagosurit dhe grumbulloi ata që ishin shpërndarë. Në këtë kohë arritën edhe ata që ishin dërguar nga Roma. Lavini si mësoi se Pirrua donte të pushtonte Kapuan, e pushtoi para tij dhe e mbrojti. Pirrua gaboi dhe u nis kundra Neapolit, por duke qenë se as këtu nuk bëri gjë, u drejtua me shpejtësi për të pushtuar Romën, duke kaluar përmes Tyrsenës për ta nënshtruar atë, mbasi mësoi se tyrsenët kishin bërë marrveshje me romakët. Pirrua duke ndjerë se Tiberi po i afrohej dhe se Lavini vinte pas atij, u tremb se mos rrethohej prej tyre në të gjitha anët në vende të panjohura dhe nuk shkoi më tej. Kur ishte duke u tërhequr dhe kur arriti në Kampania u duk Lavini me një ushtri shumë më të madhe se e para. Pirrua tha atëherë se ushtria e romakëve mbin si kokat e hydrës. Por megjithëse e radhiti ushtrinë, nuk luftoi, dhe me qëllim që të turbullonte romakët para përleshjes, urdhëroi ushtarët e tij t'u binin parzmorëve me shtizat dhe borizanët e elefantët të shoqëronin këtë zhurmë. Ata ushtuan aq tepër sa që u habitën edhe njerzit e Pirros, të cilët nuk deshën të luftonin. Si përndoi dielli Pirrua u tërhoq e arriti në Tarant. Këtu erdhën delegatët romakë për çështjen e robërve, midis tyre edhe Fabrici. Ai i gostiti miqësisht, duke shpresuar se do t'i bindte ata që të bënin marrëveshje si të mundur që ishin. Fabrici kërkonte që të merreshin vesh dhe robërit e zënë në luftë t'i jepeshin kundrejt një shpërblimi Pirrua u habit se ai nuk tha që kishte ardhur si delegat për paqen. Dhe sipas zakonit u këshillua veçmas me miqtë e tij për dorëzimin e robërve, çështjen e luftës dhe mënyrën si duhej ta trajtonte Fabricin. Miloni e këshillonte që të mos i kthente robërit as të bënte paqe me ta, por meqenëse romakët ishin të mundur edhe çështjet e tjera t'i përfundonte me luftë; kurse Kinea i këshillonte të

[1] Në Romë.

kundërtën; robërit t'i jepte pa shpërblim dhe të dërgonte në Romë delegatë dhe të holla për hir të paqes dhe të marrëveshjes. Me mendimin e këtij u bashkuan edhe të tjerët. Kështu mendonte edhe Pirrua. Pra thirri delegatët dhe u tha: "As edhe më parë o romakë unë nuk luftova me dëshirë, as edhe tani nuk dëshiroj të luftoj, unë dua që të bëhem mik i juaj prandaj edhe robërit po i liroj pa shpërblim dhe kërkoj që të merremi vesh".

Këto i tha para delegatëve të cilëve u dha të holla, duke u premtuar se të tjera do t'u jepte më vonë. Kurse duke biseduar veçmas me Fabricin i tha: "Do të dëshiroja me kënaqësi të bëhesha mik i të gjithë romakëve, veçanërisht mik i yti, mbasi shikoj që ti je një burrë i mirë dhe kërkoj që ta përfundojmë bashkë paqen". Si i tha këto, i dha atij shumë dhurata. Kurse ai i tha: "Të lavdëroj, o Pirro, që dëshiron paqen dhe nëqoftëse ajo na intereson neve do ta përfundojmë me ty. Nuk do të kërkosh nga unë, që thua se jam burrë i mirë, të bëj ndonjë veprim kundër atdheut, por as edhe këto të cilat m'i jep nuk do t'i marr. Dua të marr vesh nga ti nëse më quan burrë të mençur apo jo. Nëqoftëse jam naiv, si më quan të denjë për dhurata? Dhe nëqoftëse jam i mirë, si më urdhëron që t'i marr ato? Ki parasysh se unë kam shumë; më mjaftojnë ato që kam, pa pasur nevojë për më tepër. Ti megjithëse je shumë i pasur, je dhjetë mijë herë më i varfër. Nëqoftëse do të ishe i kënaqur nga ato që ke dhe nuk do të dëshiroje më tepër nuk do të kishe lënë as Epirin, as vendet e tjera që ke dhe të vije këtu".

Si u thanë këto, delegatët morën robërit dhe ikën. Pirrua dërgoi Kinean në Romë me shumë florinj dhe me stoli të shumëllojshme grash, me qëllim që ata burra që do të kundërshtonin, t'i korruptonin gratë e tyre të tërhequra nga stolitë.

Kinea si erdhi në Romë nuk iu afrua senatit, por kalonte kohën duke kërkuar ndonjë shkak tjetër. Duke vizituar shtëpitë e aristokratëve i bënte ata për vete me fjalë e dhurata; dhe mbasi bëri për vete shumë prej tyre hyri në senat dhe tha: "Mbreti Pirro ju dërgon fjalë se nuk ka ardhur të luftojë kundër jush, por erdhi pas lutjeve të tarantasve, prandaj edhe robërit tuaj i liroi pa shpërblim; megjithëse është në gjendje të pushtojë vendin dhe të sulmojë Romën, ai kërkon nga ju që të bëheni miq dhe aleatë të tij dhe shpreson se ka përfituar nga ju shumë, por akoma më shumë do t'u bëjë të mira".

Shumica e senatorëve ishin të kënaqur nga këto, nga dhuratat dhe robërit. Por si mori vesh këtë Api i verbër megjithëse plak e i sëmurë, urdhëroi ta sillnin në senat ku tha: "Nuk janë në interes të shtetit marrëveshjet me Pirron" dhe pastaj bëri thirrje të nxirnin jashtë qytetit Kinean dhe nëpërmjet tij t'i njoftonin Pirros të ikte që andej për në vendin e vet dhe prej andej t'u fliste atyre për paqe apo për ndonjë gjë tjetër që kishte nevojë. Këto këshilloi Api dhe senati nuk vonoi aspak, por menjëherë vendosi njëzëri që brenda ditës të nxirrnin jashtë kufive Kinean, të bënin luftë të pashpallur kundër Pirros deri sa ai të qëndronte në Itali; kurse robërit nuk i pranuan në ushtri dhe nuk i përdorën më kundër Pirros; as edhe i lanë të bashkuar, se mos duke qenë bashkë do të bënin kryengritje, por ua dorëzuan të tjerëve për t'i ruajtur.

5 Ndërsa gjatë dimrit të dy palët po bënin pregatitje, sapo hyri pranvera, Pirrua u vërsul kundër apulëve dhe disa i bëri për vete me anë të forcës disa të tjerë me anë të marrëveshjeve, deri sa romakët vepruan kundra tij kur ai gjendej në qytetin Auskul. Për shumë ditë të dy palët qëndruan pa vepruar. Romakët nuk guxonin të sulmonin mbasi ata /ushtritë e Pirros/ kishin dalë fitimtarë më parë, kurse të tjerët /vetë ushtarët e Pirros/ të dëshpëruar kishin frikë nga romakët. Disa thoshin se Deci

përgatitej duke ju lutur shpirtrave të babait dhe gjyshit dhe ushtarët e Pirros u trembën shumë se po të vdiste ai [Pirrua] ata do të humbisnin[1]; Pirrua i mblodhi ushtarët dhe u foli për këtë duke i këshilluar që të mos ligështohen as të habiten nga fjalë të tilla, mbasi nuk është e mundur që duke vdekur një njeri të mundet një shumicë, dhe shtoi se magjitë dhe iluzionet nuk kanë forcë më të madhe se burrat dhe armët. Këto tha dhe duke i argumentuar fjalët e tij i dha zemër ushtrisë. Dhe duke u marrë thellë me studimin e veshjes që përdornin pasonjësit e Decit i porositi njerëzit e tij që nëqoftëse shohin ndonjë të veshur ashtu të mos e vrasin, por ta kapin të gjallë. Kurse Pirrua e lajmëroi Decin, duke e kërcënuar, që të mos përparonte, se nëqoftëse e bënte këtë ai do ta kapte të gjallë dhe do ta zhdukte pa mëshirë... Pirrua i la romakët, që të kalonin lumin, duke pasur besim të madh tek elefantët. Romakët, bashkë me të tjera, pregatitën edhe brirë të veshur me hekur të cilët i vendosën në të gjitha anët e karrocave, me qëllim që duke goditur me ta elefantët të pengonin sulmet e tyre. Romakët, në fillim të përleshjes, i lanë të lirë për një kohë helenët, deri sa Pirrua me elefantët u drejtua kundër karrocave. Por kur e pa kështu, ky i fundit ndërhyri në krahun tjetër dhe bëri që të trembet dhe që të tërhiqet kalorësia e tyre nga egërsirat, para se të përlesheshin; po këmbësorisë nuk i bëri dëm të madh. Pas kësaj ngjarje disa prej apulëve, sulmuan lëmin e epirotëve dhe u bënë shkaktarë të fitores së romakëve. Kundër këtyre luftuan vetëm disa nga ata që dërgoi Pirrua, kurse të gjithë të tjerët u tronditën dhe duke braktisur tendat ikën të tmerruar; shumë prej tyre u vranë, kurse Pirrua si edhe shumë të tjerë që mbetën të fundit u plagosën dhe pas këtyre vuajtën shumë për mungesë ushqimesh dhe furnizimesh. Për këtë Pirrua iku në Tarant para se të arrinin romakët. Kure konsujt e kaluan lumin duke luftuar dhe kur morën vesh se të gjithë i shpërndanë u kthyen në qytetet e tyre. Pastaj ata kaluan dimrin në Apuli, kurse Pirrua po pregatitej dhe sillte ushtarë e të holla nga vendi i tij. Por kur mësoi se konsujt Fabrici e Papi kishin ardhur në lëm ndryshoi mendimin.

Deri sa konsujt e lartpërmendur ishin në lëm, një farë Nikia që hiqej si një nga të besuarit e Pirros, erdhi te Fabrici dhe i premtoi se do të vriste pabesisht Pirron. Fabrici duke mos qenë i kënaqur nga kjo, mbasi donte që të sundonte mbi armiqtë me anë të forcës si Kamili, e njoftoi Pirron për komplotin. Pirrua u habit nga kjo dhe menjëherë la të lirë pa shpërblim robërit romakë dhe dërgoi prapë delegatë për paqe. Mbasi romakët nuk dhanë asnjë përgjigje për çështjen e paqes, por kërkonin që ai të largohej nga Italia pastaj të merreshin vesh dhe njëkohësisht keqpërdornin dhe pushtonin qytetet aleatë të tij, Pirrua nuk dinte si të vepronte dhe kjo ndodhte në një kohë para se disa nga syrakuzasit, që kishin ngritur krye pas vdekjes së Agathoklit, ta thërrisnin atë, për t'i dorëzuar qytetin. Nga kjo Pirrua mori zemër dhe shpresoi se do të mund të shkatërronte gjithë Siqilinë dhe si la në Itali Milonin me qëllim që të ruante Tarantin dhe viset e tjera, u nis që të arrinte sa më parë atje. Syrakuzasit e pritën mirë dhe i bënë shumë nderime dhe atje brenda një kohe të shkurtër fitoi famë të madhe sa që kartagasit u trembën që të merrnin mercenarë nga Italia. Por shumë shpejt gjendja u kthye në të kundërtën, sepse ai shumë nga të nënshtruarit i zhduku, kurse të tjerët filluan të dyshojnë se mos i vriste edhe ata. Kartagasit duke parë se ai as ushtrinë e tij nuk e kishte të fortë, as edhe vendasit nuk i kishte për vete, filluan luftën, duke pranuar edhe syrakuzasit e ikur dhe Pirros i bënë shumë të këqija kështu
6 që ai u detyura të linte jo vetëm Syrakuzën, por edhe Siçilinë...

Pirrua si u mund në Siçili dhe si u kthye, i trajtoi ata [aleatët e tij] keq.

[1] Në këtë vend teksti nuk është fort i qartë. Me sa duket lutjet e Decit u drejtoheshin shpirtrave të të parëve të tij që të shkaktonin vdekjen e Pirros.

Lokridasit i mori me vete dhe këta si vranë rojen romake u larguan. Pastaj shkoi kundër regëve, por atje u ndal se vetë u plagos dhe humbi shumë ushtarë. Si u kthye në Lokri dhe si dënoi disa që ishin kundër tij, mori nga të tjerët grurë dhe të holla dhe u kthye në Tarant. Por meqenëse samnitët vuanin shumë prej romakëve, ai u nis përsëri dhe u vajti atyre në ndihmë. Mbasi u plagos një këlysh elefanti dhe i hodhi poshtë ata që ishin sipër, duke kërkuar të ëmën, dhe ajo u trondit nga kjo, gjithashtu u shqetësuan edhe elefantët e tjerë dhe gjithshka u bë lëmsh. Më në fund triumfuan romakët, të cilët vranë shumë dhe zunë tetë elefantë. Gjithashtu ata pushtuan edhe lëmin e tyre. Pirrua me një pakicë kalorësh iku në Tarant dhe prej andej lundroi për në Epir, duke lënë në Tarant Milonin, me një garnizon. Atyre u dha qerre të armatosura të pajisura me rrypa nga lëkura e Nikias, të cilin e kishte vrarë si tradhëtar. Kështu e dënoi Nikian; kurse disa të rinj që u tallën me të në një gosti deshi t'i dënonte dhe në pyetjen që u bëri pse u tallën me të, ata u përgjigjën: "Do të kishim thënë më shumë e më tepër të këqija nëqoftëse nuk do të na kishte dalë vera", ai qeshi dhe i la ata.

Pirrua, pra, u bë më i shquari ndër komandantët dhe shumë frikë u kalli romakëve dhe në vitin e pestë si la Italinë dhe pasi sulmoi Helladën, jo shumë më vonë vdiq në Argo. Siç thuhet një grua duke dashur ta shikonte atë nga çatia, kur ai ishte duke kaluar, gaboi dhe duke rënë e vrau atë...

7 Pastaj /romakët/ bënë një ekspeditë në të quajturën Kalabri, për arsye se kishin pranuar Pirron dhe dëmtuan aleatët; në të vërtetë ata donin të zinin Brendesin, i cili ishte një liman i mirë dhe pikë zbarkimi prej Ilirisë e Helladës, e përshtatëshme për ngarkim dhe zbarkim, dhe e pushtuan atë. Këtu dhe në vende të tjera dërguan kolonistë. Megjithëse patën kaq fitore nuk u treguan kryelartë, por senatorin Kuint Fabin ja dorëzuan apolloniatëve që janë në gjirin e Jonit, sepse ai kishte sharë delegatët e tyre; ata si e morën, e dërguan përsëri në shtëpinë e tij pa i bërë gjë.

19 Romakët e kaluan detin Jon dhe u hodhën në kontinentin helen, duke vënë si shkak për këtë lundrim të tyre këtë gjë: Isa është një ishull që ndodhet në detin Jon; banorët e saj pra, të quajtur isas, u ishin dorëzuar romakëve vullnetarisht; këtë e bënë ata sepse i rëndonte sundimi i Agronit, mbretit të sardianëve[1], i cili ishte ilir nga prejardhja. Tek ai konsujt dërguan delegatë, po ky kishte vdekur dhe meqenëse trashëgimtari i tij ishte akoma i mitur, pushtetin e sardianëve e kishte shtënë në dorë e shoqja e mbretit të sardianëve dhe njerka e djalit[2]. Kjo nuk i priti mirë delegatët romakë, dhe meqenëse këta kishin folur lirisht përpara saj, disa i lidhi dhe disa i vrau.

Mbasi romakët i shpallën luftë, ajo u tremb shumë dhe u premtoi t'u kthente delegatët që ishin gjallë, kurse ata që ishin vrarë, thoshte se i kishin vrarë kusarët. Po kur romakët i kërkuan t'u dorëzonte vrasësit, tha se nuk do të dorëzonte njeri dhe dërgoi ushtri kundër Isës. Po pastaj u tremb përsëri dhe dërgoi tek konsujt një farë Demetri, gjoja si e gatshme t'u bindej atyre në çdo gjë. U arrit një marrëveshje me të dërguarin, i cili ua dorëzoi atyre Kerkyrën. Por pasi zbarkuan në ishull, ajo prapë mori guxim, si një grua mendjelehtë dhe e paqëndrueshme dhe dërgoi ushtri edhe në Epdiamn, edhe në Apolloni. Dhe kur romakët, jo vetëm çliruan qytetet, por zunë anijet e saj që sillnin të holla nga Peloponezi, si edhe i shtinë në dorë gjithë viset e

[1] D.m.th. të ardianëve.
[2] Është fjala për Teutën.

saja anës së detit, dhe përveç kësaj, kur edhe Demetri për shkak të marrëzisë së saj u hodh në anën e romakëve, duke ua mbushur mendjen edhe të tjerëve të largoheshin, ajo u tremb dhe hoqi dorë nga sundimi. Pushtetin pastaj e mori Demetri si kujdestar i të miturit.

... Emri Ilirik, në të kaluarën përdorej në toka të tjera, më vonë kaloi në tokat e sipërme mbi Maqedoninë e Thrakinë që ndodhet brenda Hemit dhe afër Rodopit, dhe që gjendet midis këtyre maleve dhe Alpeve si dhe lumenjve Ain e Istër deri te Ponti Euksin.

20 ... Pastaj Publ Korneli dhe Mark Minuci erdhën me ushtri në Istër, ku nënshtruan shumë popuj, disa me luftë, disa me marrëveshje. Nga ana tjetër Luv Veturi dhe Gai Lutati arritën gjer te Alpet dhe shumë popuj i bënë për vete pa luftë. Në atë kohë Demetri, sundimtari i sardianëve, siç u tha edhe më sipër, sillej keq me vendasit, duke u rënë në qafë edhe fqinjëve; njerëzit besonin se ky i bënte tërë këto në sajë të miqësisë që kishte me romakët. Këtë e morën vesh konsujt Emil Pauli dhe Mark Livi dhe e thirrën të shkonte tek ata; ai jo vetëm s'vajti, po vuri dorë edhe mbi aleatët e tyre; atëherë romakët u turrën kundër tij, i cili ndodhej në Isa. Si morën vesh që më parë, se ai fshihej diku atje, dërguan një pjesë të anijeve në anën tjetër të ishullit për të luftuar; ilirët, duke kujtuar se ishin e vetmja fuqi e armikut, u lëshuan kundër atyre; në të njëjtën kohë prijësat romakë lundruan me qetësi, shkuan në një vend të përshtatshëm dhe ngritën lëmin; po atë ditë u sulmuan prej vendasve, po romakët i zmbrapsën këta me anë të dredhisë që përdorën. Atëherë meqenëse Demetri iku në Far, një ishull tjetër, romakët shkuan kundër tij, i thyen kundërshtarët dhe qytetin e pushtuan me tradhti; Demetri iku fshehurazi. Ai atëherë shkoi te Filipi, mbreti i Maqedonisë, duke pasur me vete shumë të holla. Filipi e mbajti dhe s'ua dorëzoi romakëve; po më vonë ai u kthye vetë në Iliri, u zu prej romakëve dhe u dënua.

LIBRI IX

4 ... Kurse mbreti i Maqedonisë, Filipi, u tregua haptazi i gatshëm me kartagasit. Meqenëse donte të vendoste sundimin e tij në Helladë u mor vesh me Hanibalin që të luftonin së bashku, dhe ndërsa kartagasit do të merrnin Italinë ai do të merrte Helladën dhe Epirin bashkë me ishujt...

... Filipi duke udhëtuar për në Itali erdhi deri në Kerkyrë, por kur mori vesh se Lavini ishte në Brendes, u kthye në shtëpi. Kur Lavini lundroi deri në Kerkyrë dhe qëndroi tek aleatët e romakëve, Filipi pushtoi Orikun dhe rrethoi Apolloninë. Duke mobilizuar menjëherë ushtri kundër tij, Lavini ripushtoi Orikun dhe shpëtoi Apolloninë. Filipi dogji anijet që kishte përdorur dhe që këndej u kthye në atdhe në këmbë...

15 ... Kurse Filipi për shkak të këtyre ngjarjeve /të hyrjes së romakëve në Maqedoni/ nuk dinte se ç'të bënte. Më përpara ai sillej poshtë e lart duke u mbrojtur herë nga njëri, herë nga tjetri. Në atë kohë Apusti kishte forcuar pozitat në tokat e tij, dardanët që banonin sipas ilirëve dhe maqedonëve i binin në qafë Maqedonisë, kurse disa nga ilirët dhe Amynandri mbreti i athamanëve me prejardhje thesale, që më parë kishin qenë aleatë të tij, u hodhën nga romakët...

22 ... Pra kështu vepruan roamkët, por në luftën kundër Perseut ata pësuan humbje të shumta dhe të mëdha; kudo forcat e tyre vuajtën dhe Perseu pushtoi pjesën më të madhe të Epirit e të Thesalisë...

24 ... Në të njëjtën kohë komandanti Luc Anici i dërguar kundër Gentit i mundi ata me të cilët luftoi dhe Gentin që iku e ndoqi dhe e mbylli në Skodra, ku kishte pallatet e tij. Ai qëndroi i qetë atje mbasi ajo ishte ndërtuar në majë mali dhe rrethohej me

gryka të thella, të cilat përshkohen nga lumenj të rrëmbyeshëm. Ajo /Skodra/ ishte e rrethuar me mure të forta. Meqenëse Genti nuk pati besim në forcën e saj, sulmoi dhe Anici e mundi dhe arriti deri në Epir para se të vinte Paul Emili dhe e qetësoi atë, mbasi kishte parë turbullira.

25 Pas këtyre ngjarjeve /ngjarjeve në Antiohi/ romakët bënë një ekspeditë kundër dalmatëve; ky popull është prej ilirëve, që banojnë në gjirin e Jonit; disa taulantët i quajnë helenë, meqenëse sundojnë një pjesë të Durrahut. Si shkak për luftë u gjet se disa nga banorët e afërt, duke qenë në miqësi me romakët, dëmtoheshin prej tyre dhe megjithëse romakët dërguan delegatë tek ata /dalmatët/ nuk morën asnjë përgjigje, por delegatët si i arrestuan i vranë. Ata i nënshtroi Skipion Nasika, i cili pushtoi me sulm qytetet e tyre dhe robërit i shiti; edhe shumë ngjarje kanë ndodhur, por nuk janë me rëndësi as për t'i kujtuar as për t'i përmendur në histori.

LIBRI X

27 Cezari /Oktaviani/ sulmoi edhe panonët, të cilët banojnë në drejtim të Dalmatisë pranë Istrit, prej Norikut deri në Myzinë evropiane; ata jetojnë keq, nuk kanë as toka, as klimë të mirë, nuk bëjnë as verë, as vaj, hanë e pinë njëlloj elbin e thekrën, por njihen si shumë të fuqishëm. Disa helenë duke mos ditur emrin e tyre të vërtetë i quajtën paionë. Fisi i paionëve është nga ana e Rodopit dhe në veri të Maqedonisë. Si të tjerët edhe këta i quajnë panonë. Kundër tyre sulmoi atëherë Cezari dhe në shumë beteja ai i mundi dhe më në fund i bëri për vete me marrëveshje...

32 ... Dhe mbas këtyre, të gjitha ato vende që gjenden mbi Dalmati, Maqedoni e Thraki dhe që lumi Savo, i cili derdhet në Ister, i ndan nga Panonia, kaluan nën emrin e Myzisë. Në këto vende ka edhe shumë fise të tjera, si edhe të quajturit tribalë dhe dardanë.

FJALORI I TERMAVE

FJALORI I TERMAVE

Adskripticë – Kolonë të regjistruar (të lidhur me tokën). Ndryshe nga kolonët e lirë adskripticët ose enapografët nuk kishin prona të tyre të palëvizshme. Ata punonin tokën e zotërisë së tyre dhe nuk kishin të drejtë të shkëputeshin prej kësaj vartësie.

Amforë – Enë e madhe ambalazhi me dy vegja, që shërbente për ruajtjen dhe transportimin e verës dhe të vajit.

Anona – Taksë në natyrë ose detyrim që merrej çdo vit nga fshatarët, sidomos në drithë, për furnizimin e ushtrisë ose të popullsisë së qyteteve me ushqime. Me fjalët "species annonariae" quheshin vetëm drithërat e grumbulluara në depot shtetërore.

Apotauri – Ndarje e lopëve nga demat.

Balista – Makinë luftarake që hidhte gjyle guri.

Bulé – Këshill, organi më i lartë administrativ i pushtetit ekzekutiv në qytetet-shtete helene.

Centurie – Njësia më e vogël e ushtrisë romake, e cila përbëhej nga njëqind ushtarë.

Centurion – Komandant i një centurie.

Komes – Titull i drejtuesit të një zyre të lartë civile ose ushtarake: të tillë ishin p.sh. komesi i tregëtisë, i thesarit, i minierave, i kufirit, etj.

Dareik – Monedhë e vjetër persiane prej ari që peshonte 8.32 gr.

Dekurion – Anëtar i këshillit të qytetit. Dekurionët ishin shtresa e privilegjuar e qyteteve.

Denar – Monedhë romake argjendi e barabartë me 4 gr.

Kryedash – Makinë luftarake sulmuese që përdoresh për të hapur shtigje në muret mbrojtëse të qyteteve.

Dioqezë – Njësi territoriale administrative më e vogël se preefektura dhe më emadhe se provinca. Diokletiani me reformat e tij administrative e ndau perandorinë në 12 dioqeza të tilla.

Domestikë – Quheshin pjestarët e familjes; më vonë këtë emër e morën edhe njësitë e zgjedhura ushtarake që shërbenin në pallatin e perandorëve të kohës së vonë antike, si edhe nëpunësit pranë zëvendësave të provincave.

Drahme – Njësi monetare baraz me 1/100 e minës. Një drahme atike peshonte 4,36 gr., ndërsa drahma korinthike vetëm 3.40 gr.

Dromone – Anije të shpejta.

Duks – Udhëheqës ushtarak, komandant në provincat e epokës së hershme bizantine.

Duumvir – Quhej kolegji i përbërë prej dy funksionarësh të lartë, të zgjedhur nga mbledhja e popullit në kolonitë dhe municipët romake. Ata ishin kryetarë të këshillit të qyteteve dhe ushtronin pushtetin ekzekutiv në to.

Eforët - Funksionarët më të lartë të Spartës. Kolegj i përbërë prej pesë vetash që zgjidheshin çdo vit nga mbledhja e popullit. Kryenin funksionin e gjyqtarëve më të lartë dhe ushtronin kontroll mbi jetën politike të vendit. Kontrolli i tyre shtrihej dhe mbi të dy mbretërit, pushtetin e të cilëve edhe e kufizonin.

Empor (empirion) – Treg, vend për shitblerje. Më vonë shumë nga emporët e ngritura jashtë Greqisë u shndërruan në koloni.

Falanga – Formacion ushtarak i shtrënguar prej disa radhësh në thellësi. Njihet për përsosmërinë e saj veçanërisht falanga maqedone që kishte deri në 16 rreshta thellësi dhe ishte e armatosur me heshta të gjata që quheshin sarisa. Balli i falangës arrinte në gjerësi deri në 1 km., kurse si numër ajo përfshinte deri në 16-18 mijë vetë.

Festat kuirinale – Festa publike që zhvilloheshin në njërën nga kodrat e Romës për nder të perëndisë së luftës, Kuirinit. Këto festa zhvilloheshin në Shkurt dhe me këtë rast bëheshin flijime.

Fitore kadmike – Fitore e arritur me humbje të mëdha për të dy palët kundërshtare. Ka po atë kuptim sikurse edhe shprehja "fitore e Pirros". Shprehja rrjedh nga legjenda sipas së cilës dy bijtë e Edipit, stërnipër të Kadmit, Eteokli dhe Poliniku, duke u ndeshur me njëri-tjetrin mbetën që të dy të vrarë (shih dramën e Eskilit "Të shtatë kundër Tebës")

Fylarh – Kryetar fisi. Me këtë emër në Atikë quheshin edhe komandantët e njësive të kalorisë që dilnin nga të dhjetë njësitë territoriale (filetë), sipas ndarjes së Klisthenit. Në burimet bizantine me fjalën fylarhë shpesh quheshin udhëheqësit ushtarakë të fiseve barbare, që i ishin nënshtruar Bizantit.

Gleba – Taksa që paguanin senatorët në bazë të madhësisë së pronës së tyre.

Gurë milie – Quheshin gurët që romakët vendosnin gjatë rrugëve të komunikacionit, mbi të cilët shkruhej distanca ndërmjet dy stacioneve. Një milje d.m.th. një mijë hapa, ishte baraz me 1481,5 m.

Hap – Njësi matjeje gjatësie te romakët, e barabartë me pesë këmbë ose 1.4815 m.

Hastatë – Ushtarë romakë të armatosur me heshta. Ata bënin pjesë në efektivin e legjionit romak. Një legjion kishte 1200 hastatë.

Hegemon – Sundimtar province (shih provinca).

Helie – Gjyqi i lartë shtetëror në Athinë, organi politik që qëndronte në rojë të demokracisë skllavopronare. Ai kishte të drejtën e vetos, dhe si i tillë qëndronte më lart se mbledhja e popullit, duke aprovuar ose anuluar vendimet e saj. Në Korinth helie quhej mbledhja e përgjithëshme e popullit.

Helotë – Popullsi e nënshtruar nga spartanët. Pas pushtimit helotët u shpronësuan nga toka dhe u kthyen në skllevër të pushtuesve.

Hemikoe – Gjysëm koe, njësi mase baraz me 1.64 litra.

